Tefsir Kur'ani



Abdur-rahman ibn Nasir el sa'dij

Vëllimi i parë

El fatiha - El maide

Titulli i origjinalit:
"Tejsir El kerimir-rahman
fi tefsir kelami El men-nan"

Përkthimi i tiullit të origjinalit:
"Lehtësimi i Bujarit të gjithmëshirshëm
në komentimin e Fjalës së Bamirësit të madh"

Autori:
Abdur-rahman ibn Nasir El sa'dij

Përktheu nga arabishtja:
Uthman Agolli

Redaktoi:
Ilir Haxhiaj

Korrektimi dhe arti grafik:
Silvana Halimi

Botoi:
"El huda"

Parathënia e përkthyesit

Lavdia e plotë i takon vetëm Allahut, Atë e falenderojmë dhe e lavdërojmë, tek Ai kërkojmë mbrojtje dhe strehim dhe tek Ai kërkojmë falje. Tek Allahu kërkojmë strehim dhe mbrojtje që të na ruajë nga sherri i shpirtrave tanë dhe nga fatkeqësitë që sjellin punët tona të liga. Atë që Allahu e ka udhëzuar në rrugën e drejtë ai është i udhëzuari dhe i shpëtuari, ndërsa atë që Allahu i lartësuar me urtësinë dhe drejtësinë e Tij e ka lënë në humbje, askush nuk mund ta udhëzojë në rrugën e drejtë. Dëshmoj dhe deklaroj se nuk ka të adhuruar të meritueshëm veç Allahut dhe dëshmoj dhe deklaroj se Muhamedi a.s. është robi dhe i dërguari i Allahut.

Profeti (s.a.u.s.) ka thënë: "Më i miri ndër ju është ai që e mëson Kur'ânin dhe ua mëson atë të tjerëve." Pa dyshim, aspekti më i rëndësishëm i mësimit të Kur'ânit përveç mësimit të leximit të tij, është kuptimi i tij saktësisht dhe nxjerrja e mësimeve prej tij. Vetëm me një kuptim të saktë të Kur'ânit dhe me zbatimin rrigorozisht të mësimeve të tij robi do të mund të gjejë rrugën e drejtë që e çon tek Zoti i tij. Allahu i lartësuar e ka bërë këtë Kur'ân udhëzim dhe mëshirë, shërim dhe qetësim për zemrat e besimtarëve. Por Kur'âni nuk mund të jetë i tillë nëse nuk kuptohet saktësisht, ashtu sikurse e kuptoi Profeti (s.a.u.s.) dhe shokët e tij. Ai nuk mund të jetë i tillë nëse nuk zbatohet në jetën e përditshme të muslimanit dhe muslimanes. Prandaj është detyrë për çdo musliman që ta kuptojë këtë Kur'ân dhe të japë maksimumin e tij për të punuar me të dhe për të ftuar të tjerët në atë mirësi që ofron Fjala e Zotit.

Dijetarët, që nga kohët e para e deri më sot i kanë dhënë një rëndësi shumë të madhe tefsirit të Kur'ânit. Tefsirët e shkruajtur janë të shumtë dhe sejcili prej tyre i ka dhënë rëndësi aspekteve të caktuara. Dikush e ka shpjeguar këtë Kur'ân nga ana gjuhësore duke e analizuar çdo fjalë dhe fjali të këtij Libri dhe duke qartësuar gjithçka në të. Disa të tjerë i kanë dhënë rëndësi shpjegimit të Kur'ânit nëpërmjet hadithëve të Profetit (s.a.u.s.) dhe fjalëve të sahabëve dhe tabi'inëve. Të tjerë i kanë dhënë rëndësi përnxjerrjes së ligjeve dhe dispozitave nga ajetet kur'ânore, e kështu me rradhë.

Ndër ata që janë marë me tefsirin e Kur'ânit famëlartë, është edhe shejh Abdur-raĥman ibnu Naŝir El sa'dij, Allahu e mëshiroftë. Ai është prej dijetarëve të njohur të kohëve të fundit.

Ndër cilësitë e këtij tefsiri mund të përmendim se ai nuk është i tejzgjatur dhe as tepër i shkurtuar. Ai është i mbushur me dobi të shumta dhe përfshin në vetvete mësime shumë të vyera në shumë fusha; në fushën e akides, moralit, ligjeve dhe dispozitave të përfituara nga ajetet etj, etj. Lexuesi çdo ajet që kalon, e kupton atë qartësisht dhe nxjerr prej tij mësime të shumta. Gjuha e tij është shumë e thjeshtë e kuptueshme dhe çdo kush mund të kuptojë dhe të përfitojë prej tij.

E lus Allahun e lartësuar që të na bëjë nga ata që e mësojnë Kur'ânin, e zbatojnë atë në jetën e tyre dhe ua mësojnë atë edhe të tjerëve. Ai është Bujar, Bamirës dhe Mëshirëplotë. Paqja bekimet dhe mirësitë e Allahut qofshin mbi Muhamedin, familjen e tij, shokët e tij dhe të gjithë ata që e pasuan atë me sinqeritet deri në ditën e gjykimit!

Parathënia e autorit

Të gjitha falënderimet, lavdërimet e admirimet janë për Allahun, i Cili i zbriti robit të Tij Furkanin (Kur'ânin), që është dalluesi dhe qartësuesi i hallallit nga harami, i lumturisë nga trishtimi dhe i të vërtetës nga e kota.

Ky Kur'ân është libri, të cilin Allahu, me mëshirën e Tij, e bëri udhëzues për njerëzit në përgjithësi dhe për të devotshmit (*mutekin*) në veçanti, për të kaluar nga rruga e humbjes, e mohimit (*kufr*), e gjynaheve dhe e injorancës, drejt dritës së besimit, devocionit e dijes.

Allahu i Lartësuar e zbriti këtë libër për të qenë shërim i zemrave nga sëmundjet e dyshimeve dhe epshit, si dhe për t'i stolisur ato me bindje, siguri dhe dije rreth çështjeve e pikësynimeve të larta. Ai e zbriti këtë libër për ta bërë edhe shërim të trupit nga sëmundjet, dhimbjet dhe dobësitë e tij.

Allahu na ka treguar se ky libër nuk pranon asnjë lloj dyshimi e pasigurie, për çdo aspekt të tijin, sepse ai përmban vetëm të vërtetën e madhe në çdo rrëfim, urdhër e ndalesë që sjell. Ai e zbriti këtë libër që të jetë i begatshëm, pasi në të gjen mirësi të mëdha, dije të pafundme, të fshehta, të jashtëzakonshme, qëllimet më të pastra e më të larta. Çdo begati dhe kënaqësi që fitohet në këtë jetë dhe në jetën tjetër ka si shkak vetëm ndjekjen e udhëzimeve të Kur'ânit.

Allahu i Lartësuar na ka treguar se ky libër është vërtetues dhe garantues i librave hyjnorë të mëparshëm. Ajo që dëshmohet nga Kur'âni si e vërtetë, ajo është e vërteta e pranueshme, ndërsa ajo që Kur'âni nuk e quan të vërtetë, ajo është e pasaktë dhe e papranueshme, sepse ky libër përmban esencën e së vërtetës, madje edhe më shumë se kaq.

Allahu i Lartësuar thotë për Kur'ânin: "Allahu me të udhëzon në rrugët e paqes, këdo që synon kënaqësinë e Tij." Pra, ky libër është udhëzues e orientues për në Vendin e Paqes (Xhenetit), është ndriçues i rrugës që të çon atje dhe nxitës për të shkuar drejt tij. Kur'âni është, gjithashtu, tregues i rrugës që të çon në Vendin e Dhimbjeve (Xhehenemit), dhe tërheqës i vërejtjes për të mos arritur atje.

Allahu i Lartësuar thotë:

Kitâbun uĥkimet âjâtuhû thum-me fuŝ-ŝilet min ledun ĥakîmin ħabîr:

"Libër, të cilit i janë përsosur *(i janë bërë absolutisht të sakta dhe të drejta)* ajetet, të cilët pastaj janë sqaruar plotësisht prej Atij, që është i Urtë, i Gjithëditur." [Hud 1].

Domethënë, ky libër është i përkryer në çdo aspekt. Ai është i saktë, i plotë, i drejtë, i mrekullueshëm në udhëzimet e tij dhe i vetmi burim i gjykimit të drejtë për çdo çështje.

Allahu i qartësoi ajetet e Tij në formën më të shkëlqyer dhe i përsosi ata në mënyrën më absolute, duke dalluar mes së vërtetës dhe së kotës, mes udhëzimit dhe humbjes, me një sqarim që kthjellon çdo paqartësi. Kjo ndodh sepse ky libër buron nga Ai që është *Hakimun* (i Urtë) dhe *Habir* (i Gjithëditur), i Cili tregon veçse të vërtetën, të sigurtën dhe të sinqertën. Allahu është Ai që urdhëron veçse për drejtësi, bamirësi e mbarësi dhe ndalon veçse nga ajo që është e dëmshme për dynjanë dhe për ahiretin.

Allahu i Lartësuar është betuar në emër të Kur'ânit dhe e ka cilësuar atë si *Mexhid*, që është një ndër përshkrimet më të larta e më madhështore, dhe kjo për shkak të kuptimeve gjithëpërfshirëse të këtij libri.

Allahu i Madhëruar e ka cilësuar Kur'ânin edhe si *Dhu Dhikër* (Përkujtues), sepse me anë të tij përkujtohet dija hyjnore, moralet e larta dhe veprat e mira. Prej tij nxjerr mësime e përkujtohet ai që e ka frikë Zotin.

I Lartësuari thotë: "Ne e shpallëm këtë Kur'ân në gjuhën arabe, që ju të logjikoni e të kuptoni." Pra, e zbriti në këtë gjuhë, që ne të mendojmë dhe ta kuptojmë atë.

Allahu na ka urdhëruar që të meditojmë e të thellohemi në Kur'ân, për të nxjerë mësime prej tij. Përsiatja rreth tij është çelësi i çdo të mire dhe mundësia e vetme për të arritur dijet e dobishme, të fshehta dhe të shtrenjta. E pra, Allahut i qoftë falënderimi, lavdërimi dhe mirënjohja, që e bëri Librin e Tij udhëzim, mëshirë, shërim, dritë, qartësues të rrugës, përkujtues të çdo dijeje të domosdoshme, të begatshëm, udhëzim e përgëzim për muslimanët.

Nëse kuptohet gjithçka që u tha deri tani, atëherë është e lehtë të kuptohet nevoja e madhe dhe e domosdoshme e çdo krijese të përgjegjshme (njeri apo xhind qoftë) për të

njohur mësimet e Kur'ânit dhe për t'u udhëzuar me të. Është plotësisht e drejtë që robi të bëjë të gjitha përpjekjet e të paguajë çdo çmim për të arritur të kuptojë e nxënë mësimet e Kur'ânit, me rrugët më të shkurtra e më të shpejta.

Ka shumë *tefsir*-ë (komentime e shpjegime) të Kur'ânit, të shkruar nga imamë të mëdhenj (Allahu i mëshiroftë!). Ndër ta, ka që janë tejet të zgjeruar e që shpesh e humbin qëllimin përse janë shkruar, ashtu siç ka edhe që janë tejet të shkurtuar, të mjaftuar thjesht me sqarimin nga ana gjuhësore e disa fjalëve të pakuptueshme, duke mos u futur thellë në kuptimin e vërtetë që është dashur prej tyre. Për këtë arsye, është e domosdoshme që t'i japim rëndësi të madhe qartësimit të ajeteve kur'ânore, duke vështruar me kujdes kontekstin e tyre, shkakun për të cilin janë shpallur dhe duke bërë krahasimin e tyre me njëri tjetrin.

Duhet të jemi të qartë se Kur'âni është shpallur që të shërbejë si udhërrëfyes për të gjitha krijesat, për të diturit dhe të paditurit, për të qytetëruarit dhe nomadët. Studimi i hollë dhe i thellë i ajeteve kur'ânore, duke pasur, sigurisht, njohuri të sakta rreth historisë dhe jetës së Pejgamberit (s.a.u.s.), shokëve të tij dhe ngjarjeve që ndodhën mes tij dhe armiqve të Islamit gjatë shpalljes së Kur'ânit, të çon drejt një të kuptuari dhe njohjeje të vërtetë të qëllimeve që fshihen në ato ajete. Dobitë e përvjela nga këto ajete bëhen edhe më të mëdha, nëse shoqërohen me një njohuri të gjerë dhe të thellë të gjuhës arabe dhe të disiplinave të saj.

Atij që i janë lehtësuar të tilla njohuri dhe i ka përvetësuar ato nuk i mbetet gjë tjetër, veçse të meditojë gjatë për të kuptuar ajetet e Kur'ânit. Ai duhet të mendohet thellë për tekstin dhe kuptimet e fjalëve, të drejtpërdrejta qofshin ato, ose të nënkuptuara. Nëse robi jep maksimumin e tij në këto drejtime, atëherë Allahu i Lartësuar, – që është shumë më tepër Bujar, – do t'i dhurojë atij dije të thellë mbi këtë libër, duke i zbuluar madje edhe plot njohuri të tjera, të cilat robi nuk do t'i arrinte kurrë me mundin dhe përpjekjet e veta.

Duke qenë se Allahu i Lartësuar, me mirësinë e Tij, na mundësoi bashkë me vëllezërit e mi që t'i përkushtoheshim këtij Libri famëmadh, sipas mundësive tona modeste, atëherë më lindi dëshira që të përpiloja, me sa mundësi të kisha, një tefsir të përmbledhur të Librit të Allahut të Madhëruar. Shpresa ime ishte dhe mbetet që, me bujarinë e Allahut ndaj nesh, ky tefsir të bëhet përkujtim i dobishëm për ata që punojnë për rregullimin dhe drejtimin e njerëzve, që ai të bëhet ndriçues për ata që duan të shohin të vërtetën dhe ndihmë e orientues për ata që kanë nisur udhën drejt Allahut, Zotit të gjithësisë. Kësisoj, në mënyrë që asgjë të mos humbiste dhe të harrohej, menjëherë nisa të shkruaja.

Qëllimi im kryesor me këtë libër është që të jap shpjegime sa më të qarta, duke iu larguar zbërthimeve të koklavitura e të lodhshme të kuptimeve të termave e fjalëve të ndryshme. Këtë e kam bërë duke u nisur nga fakti se qëllimi i tefsirit është pikërisht qartësimi i kuptimeve të ajeteve, si dhe për shkak se komentuesit e hershëm (Allahu i shpërbleftë ata me të mira!) kanë shkruar tefsirë të mjaftueshëm për shpjegimin e hollësishëm të termave dhe fjalëve të Kur'ânit, kështu që nuk është e nevojshme që ne ta përsërisim diçka të tillë.

Shpresoj tek Allahu i Lartësuar, dhe Atij i mbështetem e i kërkoj ndihmë, që ta lehtësojë realizimin e qëllimit tim. Nuk ka dyshim se, nëse Allahu nuk e lehtëson diçka, nuk mund të gjesh asnjë rrugë tjetër për ta arritur atë. Nëse Allahu nuk e ndihmon robin, ai kurrë nuk ka për ta arritur atë që synon.


E lus Allahun e Lartësuar që ta bëjë këtë vepër të sinqertë, vetëm për të fituar kënaqësinë e Tij! E lus të Madhëruarin që ta bëjë këtë vepër gjerësisht dhe tërësisht të dobishme, se Ai është Bamirës dhe Bujar!

O i Adhuruari im! Salavatet e plota dhe selami qofshin mbi Muhamedin, familjen dhe shokët e tij!



Vëllimi i parë

El fatiha	Hapësja	Mekase	7 ajete
El bekare	Lopa	Medinase	286 ajete
Al Imran	Familja e Imranit	Medinase	200 ajete
El nisa	Gratë	Medinase	176 ajete
El maide	Tryeza	Medinase	120 ajete



Surja 1 - El Fatiha (Sure mekase) 7 ajete

Eûdhu bil-lâhi minesh-shejtânir-raxhim

1. Me emrin e Allahut, të Mëshirshmit, Mëshiruesit!
2. Lavdia i takon plotësisht dhe vetëm Allahut, Zotit të botëve,
3. Të Mëshirshmit, Mëshiruesit,
4. Sunduesit të Ditës së Gjykimit!
5. Vetëm ty të adhurojmë dhe vetëm tek Ti mbështetje *(ndihmë)* kërkojmë!
6. Na udhëzo në Rrugën e Drejtë,
7. Në rrugën e atyre të cilët Ti i begatove, e jo në rrugën e atyre që merituan zemërimin (*Tënd)* dhe as në rrugën e të humburve!

Shpjegimi i ajeteve

***Bismil-lâhi* - "Me emrin e Allahut..."** – Domethënë, filloj (leximin e Kur'ân-it) me përmendjen dhe përkujtimin e të gjithë emrave të Allahut (duke shpresuar begatitë dhe mirësitë e shumta që të sjell ky përkujtim). Themi: "*të gjithë emrat e Allahut*", sepse fjala "emër" (*ism*), edhe pse është në numrin njëjës, duke qenë se bën pjesë në kategorinë gramatikore "pronë-pronar", sipas rregullave gjuhësore të arabishtes, ajo i përfshin të gjithë emrat e Allahut. Pra, grupi emëror: "Me emrin e Allahut", në arabisht do të thotë: "Me të gjithë emrat e Allahut."

***Allâh* - "Allah"** - Allahu është i Adhuruari. Ai është i Vetmi që meriton të veçohet duke e adhuruar. Ai është unik në meritën e adhurimit, për shkak të cilësive hyjnore me të cilat Ai përshkruhet, cilësi këto që tregojnë se Ai është Absolut dhe Madhështor në çdo aspekt.

***Er-Raĥmânir-Raĥîm.* - "Të Mëshirshmit, Mëshiruesit..."** - Këta janë dy emra që tregojnë se Allahu i Lartësuar është zotërues i mëshirës së gjerë, të madhe, e cila ka përfshirë çdo krijesë. Në fakt, mëshira, në formën e saj të plotë, është bërë vetëm për të devotshmit dhe pasuesit e denjë të të dërguarve dhe profetëve të Tij; vetëm këta do t'i përfshijë mëshira e Tij absolute, kurse të tjerët do të shijojnë veçse një pjesë të saj.

Mësoje se ndër rregullat themelore, me pajtueshmëri mes dijetarëve të parë (*selef*) dhe imamëve të drejtë, është: Besimi i drejtë në fushën e emrave dhe cilësive të Allahut të Lartësuar, si dhe të dispozitave që lidhen me ata. Kështu, në rastin tonë, ne duhet të besojmë që Allahu i Lartësuar është i Mëshirshëm dhe Mëshirues (*Er-Raĥmânu Er-Raĥîm*), duhet të besojmë se Ai është zotërues i kësaj mëshire, me të cilën është emërtuar dhe cilësuar (pra, nuk janë emra pa kuptim), dhe që kjo mëshirë lë gjurmë dhe është ndikuese tek të tjerët. Të gjitha mirësitë, pa përjashtim, janë rezultate të mëshirës së Tij. Në këtë mënyrë besohet, pra, për të gjithë emrat dhe cilësitë e Allahut të Madhëruar.

Kështu, për shembull, të njëjtën gjë themi për emrin *Alîm* (i Ditur):

1. Ai është i Dituri absolut;
2. Ai zotëron dije absolute (pra, nuk është thjesht një emër pa domethënie).
3. Ai di gjithçka, për çdo gjë.

Ose për emrin *Ḳadîr* (i Plotfuqishëm), themi:
1. Ai është i Plotfuqishmi.
2. Ai zotëron pushtetin për të bërë gjithçka.
3. Me këtë pushtet, Ai ndikon dhe arrin gjithçka që dëshiron.

- Elhamdu lil-hahi **- "Lavdia i takon vetëm Allahut"** - *El Ĥamdu* është lavdërimi që i takon Allahut të Lartësuar, për shkak të cilësive absolute dhe veprave të Tij të mrekullueshme, të cilat karakterizohen dhe e kanë pikënisjen nga drejtësia dhe bamirësia e Tij. Pra, vetëm Atij i takon lavdia e plotë, në të gjitha këndvështrimet.

- Rabbil alemin **- "Zotit të botëve"-** Domethënë, Ai është Kujdestari (*Er-Rabb*), që kujdeset për të gjitha botët (*âlemîne*), fillimisht duke i krijuar vetë ato, pastaj duke u krijuar atyre të gjitha kushtet e nevojshme për ekzistencën e tyre. Ai përkujdeset duke i furnizuar ato me mirësi të mëdha, të cilat, nëse nuk do të ishin, këto botë nuk do të mund të ekzistonin fillimisht, apo të vazhdonin ekzistencën (pas krijimit). Nuk ka asnjë mirësi që burimin të mos e ketë prej Allahut.

Përkujdesja e Allahut të Lavdëruar për krijesat e Tij është dy llojesh:
1. Përkujdesje e përgjithshme.
2. Përkujdesje e posaçme.

Përkujdesja e përgjithshme konsiston në krijimin e qenieve dhe të furnizimit të tyre, si edhe në udhëzimin e tyre tek ato gjëra të dobishme, nëpërmjet të cilave rregullohet vazhdimësia e tyre në këtë jetë.

Ndërsa përkujdesja e posaçme e Allahut, sikurse e ka edhe emrin, është specifike vetëm për të zgjedhurit dhe për të dashurit e Tij. Ai përkujdeset që t'i edukojë dhe t'i brumosë ata me *iman* (besim), u jep sukses që ta arrijnë imanin dhe gjithmonë synon që t'ua përsosë atë. Allahu përkujdeset, gjithashtu, që ngaherë të mbajë larg çdo gjë që qëndron si pengesë mes këtyre njerëzve dhe imanit. Me fjalë të tjera, kjo është përkujdesja që synon suksesin në arritjen e çdo të mire dhe në largimin nga çdo e keqe. Ndoshta është pikërisht kjo arsyeja e fshehtë, që shumica e lutjeve të drejtuara Allahut të Lartësuar nga profetët, është bërë duke përmendur emrin e Tij *Rabb*, sepse të gjitha kërkesat e tyre kanë të bëjnë me përkujdesjen e Tij të posaçme.

Nga sa u tha më sipër, kuptohet që fjala e Allahut "*Rabbil âlemîne*" (Zoti i botëve), vërteton faktin që Allahu i Lartësuar është Unik e Absolut në aspektin e krijimit, administrimit dhe bamirësisë ndaj krijesave të Tij. Ai është Unik e Absolut në panevojshmërinë e Tij ndaj të tjerëve, ndërkohë që të tjerët janë pafundësisht të varfër dhe nevojtarë para Tij, në çdo aspekt e këndvështrim.

- Mâliki jeumid-dîn - "Sunduesit..." – Allahu quhet *El Mâlik* (Sundues, Mbret), sepse Ai mbretëron. Kjo cilësi i jep të drejtën Atij për të urdhëruar dhe për të ndaluar, për të shpërblyer dhe për të ndëshkuar, për të vepruar mbi të nënshtruarit, mbi mbretërinë dhe pasurinë e Tij, në të gjitha aspektet dhe përmasat që i lejon mbretërimi dhe pushteti i Tij absolut.

- "Sunduesit të Ditës së Gjykimit" - Me këto fjalë, Allahu i Madhëruar tregon pushtetin, sundimin dhe mbretërimin e Tij në Ditën e Gjykimit, e cila është edhe Dita e Kijametit. Kjo është Dita kur njerëzit do të shpërblehen sipas veprave që do të paraqesin, të mira apo të këqija qofshin.

Ai e përmend pushtetin e Tij në Ditën e Gjykimit, sepse atë ditë, pushteti, mbretërimi dhe sundimi i Allahut do t'u shfaqet krijesave i kthjellët dhe i pastër. Atë ditë, ato do ta shohin të plotë dhe të kthjellët mbretërimin, por edhe drejtësinë e urtësinë e Krijuesit. Atë ditë do të zhduket çdo lloj

pushteti e mbretërimi nga duart e krijesave, dhe i gjithë pushteti do të jetë në dorë të Krijuesit, ndonëse kështu ka qenë gjithmonë. Ai ka qenë, është dhe do të jetë gjithmonë Sunduesi dhe Mbretëruesi i Ditës së Gjykimit dhe i të gjitha ditëve të tjera.

Atë ditë, përpara Tij do të jenë të barabartë mbretërit dhe ata poshtë tyre, skllevërit dhe të lirët. Të gjithë do të jenë të përulur e të nënshtruar ndaj madhështisë së Tij, syulur para Krenarisë së Tij. Të gjithë do të jenë në pritje të gjykimit të Allahut, duke shpresuar shpërblimin e Tij dhe të frikësuar, njëkohësisht, nga ndëshkimi i Tij.

- "Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm tek Ti mbështetje *(ndihmë)* kërkojmë" - Pra: T'i kushtojmë vetëm Ty adhurimet tona dhe të drejtohemi vetëm Ty për ndihmë, mbështetje dhe mbrojtje. Kjo kuptohet kështu, sepse në fjalinë "*Ty të adhurojmë dhe tek Ti mbështetemi*", përemrat 'Ty' dhe 'Ti' janë vendosur përpara foljes (kallëzuesit), mënyrë e cila e vë theksin tek përemri, duke i dhënë fjalisë këtë kuptim:

"Ty të adhurojmë" = *"Vetëm Ty të adhurojmë"*
"Tek ti mbështetemi" = *"Vetëm tek Ti mbështetemi"*.

Pra, vetëm Ty (o Allah) të adhurojmë, dhe asnjë tjetër veç Teje, dhe mbështetjen e ndihmën e kërkojmë veç tek Ti, e tek askush tjetër.

Në këtë ajet, adhurimi renditet përpara mbështetjes dhe kërkimit të ndihmës, edhe pse mbështetja dhe kërkimi i ndihmës janë adhurime në vetvete. Domethënë, është përmendur përfshirësi i të gjitha adhurimeve, përpara atyre që janë më vete adhurime të veçanta. Kjo është bërë për t'i dhënë përparësi të drejtës së Allahut (adhurimit), kundrejt të drejtës së robit (mbështetjes dhe kërkimit të ndihmës nga Allahu i Madhëruar dhe Bujar).

Ibadeh (adhurim, ibadet) është një term përfshirës i të gjitha atyre veprave dhe fjalëve të dukshme apo të padukshme, të cilat Allahu i do dhe është i kënaqur me to.

Ndërsa *Istiâne*-ja (mbështetja ose kërkimi i ndihmës) nënkupton kërkimin e ndihmës prej Allahut, për të arritur një të mirë dhe për t'u ruajtur nga një e keqe, duke qenë plotësisht i bindur dhe i qetë që kjo ndihmë do të të jepet.

Adhurimi kushtuar Allahut dhe kërkimi i ndihmës prej Tij janë dy kushtet që sigurojnë lumturinë e përjetshme dhe sigurinë nga çdo e keqe. Nuk ka asnjë mundësi shpëtimi pa plotësuar këto dy kushte.

Asgjë nuk mund të quhet *ibadet*, nëse nuk plotëson dy kushte:
1. Të synohet me të kënaqësia e Allahut.
2. Të jetë e argumentuar nga Tradita e Pejgamberit (s.a.u.s.).

Në renditjen e *istiâne*-s pas ibadetit, qëndron një e fshehtë tjetër: adhuruesi, në adhurimet e tij, gjithmonë ka nevojë për ndihmën e Atij të cilin e adhuron, sepse nëse Allahu nuk e ndihmon, robi nuk do të ketë kurrë mundësi të vazhdojë adhurimin e Allahut, duke zbatuar urdhrat dhe duke iu larguar ndalesave.

Pastaj i Madhëruari thotë:

- *Ihdinaŝ-ŝirâṭal musteḳîm*" -"Na udhëzo në Rrugën e Drejtë" – Domethënë: Na i trego, na udhëzo dhe na jep sukses, për të vazhduar në Rrugën e Drejtë, në rrugën e qartë, që të çon tek Allahu i Lartësuar dhe te Xhenetet e Tij.

Në këtë mënyrë, ne kërkojmë udhëzimin dhe suksesin prej Allahut të Madhëruar për dy gjëra: së pari, për njohjen e së vërtetës dhe, së dyti, për të punuar sipas kësaj të vërtete.

Ne kërkojmë prej Allahut udhëzimin në Rrugën e Drejtë dhe vijimin në këtë rrugë. Me fjalë të tjera, kërkesa bëhet fillimisht për të hyrë në Rrugën e Drejtë, dhe pastaj për të qenë i vazhdueshëm e i qëndrueshëm në këtë rrugë. Udhëzimi për të hyrë në Rrugën e Drejtë, është udhëzimi për të kuptuar dhe pranuar Islamin, dhe për të braktisur çdo fe

tjetër. Ndërsa vijimi në këtë rrugë nënkupton suksesin për të njohur imtësitë e kësaj feje, si edhe veprimin sipas dispozitave të saj.

Kjo lutje është një ndër më gjithëpërfshirëset dhe më të dobishmet për robin, prandaj, për shkak edhe të nevojës së tij të madhe në këtë aspekt, u bë e detyrueshme që ai të lutet me fjalët e saj në çdo rekat namazi që e fal për Allahun.

Kjo Rrugë e Drejtë tregohet më poshtë:

- "Në rrugën e atyre të cilët i begatove" – Kjo është pikërisht rruga e profetëve, e të sinqertëve (*sidikin*), dëshmorëve dhe e të mirëve (*ŝâlihîne*).

- "Jo në rrugën e atyre që merituan zemërimin" - Pra, Rruga e Drejtë nuk është ajo që ndoqën të mallkuarit dhe ata që merituan zemërimin e Allahut, të cilët e njohën të vërtetën dhe më pas e braktisën atë e nuk punuan sipas saj. Ata që vepruan kështu ishin çifutët dhe të ngjashmit e tyre.

- "...dhe as në rrugën e të humburve" - Rruga e Drejtë nuk është as ajo që ndoqën të humburit, ata të cilët e braktisën dhe e shpërfillën të vërtetën nga padituria dhe përhumbja e tyre, siç ishin të krishterët dhe të ngjashmit e tyre.

***

Kjo sure, edhe pse e shkurtër, ka përmbledhur mes rreshtave të saj atë që asnjë sure në Kur'ân nuk e ka në këtë mënyrë. Ajo ka përmendur dhe sqaruar të trija llojet e teuhidit, që janë:

1. Teuhidi *rububije* (ose njësimin e Zotit në veprat e posaçme të Tij, për sa u përket çështjeve të krijimit, sundimit dhe përkujdesjes së Tij ndaj krijesave), të cilin e kuptojmë nga fjala e Allahut të Madhëruar: "Zoti i botëve" (*Rabil âlemîn*).

2. Teuhidi *uluhije*, ose njësimi i Zotit i shprehur në adhurimet që kryejnë krijesat. Kjo kuptohet në ajet nga fjala *Allâh*, që në kuptimin e saj gjuhësor do të thotë "i Adhuruar", si edhe nga pjesa: "*Vetëm Ty të adhurojmë*".

3. Teuhidi *esmau ue sifat*, ose njëshmëria e Allahut në meritimin e emrave dhe atributeve të Tij absolute. Me fjalë të tjera, ky lloj teuhidi konsiston në pohimin apo pranimin e faktit që Allahu i Lartësuar është i emërtuar me emrat më të bukur dhe është i cilësuar me atributet më absolute, të cilat Ai i ka pohuar për Vetveten dhe të cilat i ka deklaruar për Të Pejgamberi (s.a.u.s.) i Tij.

Ky pohim bëhet ashtu siç është, larg çdo keqinterpretimi dhe pa u përpjekur të mohohet ndonjë prej këtyre emrave apo cilësive të Tij. Më qartë, ai bëhet duke u larguar nga mohimi i plotë i cilësive (*teatîl*), ose nga krahasimi i tyre me cilësitë e krijesave (*temthîl*), ose nga përngjasimi, përafrimi apo shëmbëllimi me diçka tjetër (*teshbîh*). Për këtë, sikurse dhe u përmend, tregon fjala '*Ĥamd*' dhe kuptimet e saj.

Gjithashtu, kjo sure dëshmon për vërtetësinë e institucionit të profetësisë, gjë të cilën e kuptojmë nga pjesa: "*Na udhëzo në Rrugën e Drejtë*", sepse udhëzimi në Rrugën e Drejtë nuk mund të arrihet pa ekzistencën e profetëve, pa të zgjedhurit e Zotit dhe pa shpalljet hyjnore.

Kjo sure flet edhe për shpërblimin e llogarinë që i pret krijesat për veprat që kanë kryer. Ky kuptim merret nga fjala e Allahut të Madhëruar: "*Mâliki jeumiddîn*" (Sunduesit të Ditës së Gjykimit). Kjo llogari e asaj dite do të jetë me drejtësi, sepse fjala '*din*' do të thotë 'shpërblim me drejtësi'.

Surja tregon bindshëm besimin e drejtë në fushën e përcaktimit të Allahut, duke pohuar faktin që robi është i lirë të veprojë, ndryshe nga çka thonë grupet e humbura, të ashtuquajtura *Xhebrie* apo *Kaderie*, të cilët ose e zhveshin robin nga çdo lloj përgjegjësie dhe mundësie veprimi, ose i japin atij pavarësi, mundësi dhe fushë veprimi absolute, të pavarur prej dëshirës dhe vullnetit suprem të Allahut të Madhëruar.

Në këtë sure kundërshtohen të gjitha grupet e humbura, gjë që shfaqet në pjesën:



"*Na udhëzo në Rrugën e Drejtë*". Rruga e drejtë nënkupton dy shtylla parimore: njohjen e së vërtetës dhe punën sipas kësaj të vërtete, dhe dihet se çdo grup i humbur është i tillë, sepse ka neglizhuar njërën prej këtyre dy shtyllave të rëndësishme.

Kjo sure nxit, gjithashtu, edhe sinqeritetin në adhurimin ndaj Allahut dhe në kërkimin e ndihmës e të mbështetjes vetëm prej Tij. Kjo kuptohet nga fragmenti: "*Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm tek Ti ndihmë kërkojmë*".

Surja 2 - El Bekare (Sure medinase)
286 ajete

Ajetet 1 – 5

Me emrin e Allahut, të Mëshirshmit, Mëshiruesit!

1. ***Elif, Lâm, Mîm.***
2. Ky është Libri! Në të nuk ka dyshime. ***(Ai është)*** **Udhëzues për të devotshmit,**
3. të cilët e besojnë të fshehtën, e përkryejnë namazin dhe prej asaj me çka i kemi furnizuar, ata shpenzojnë ***(për hir të Zotit)*****;**
4. ***(ata)*** **të cilët e besojnë atë që t'u shpall ty dhe atë që është shpallur para teje. Për ahiretin, ata janë të bindur plotësisht.**
5. Vetëm ata janë në një udhëzim ***(të sigurt)*** **nga Zoti i tyre dhe vetëm ata janë të shpëtuarit.**

Shpjegimi i ajeteve

Për sa i përket "*Bismilah*"-it, folëm më sipër. Ndërsa për sa u përket gërmave të alfabetit, të përmendura në fillim të sures, ndoshta është më e udhës heshtja ndaj kuptimit të tyre, kur nuk ka prova e dëshmi të qarta nga feja. Ne nuk themi asnjë fjalë të prerë rreth kuptimit të tyre, por për diçka jemi të sigurt: Allahu i Madhëruar nuk i ka zbritur ato pa qëllim. Ato thjesht fshehin urtësi që ne nuk i dimë.

- "Ky është Libri!" - Ky libër i madh është i tillë me kuptimin e plotë të fjalës 'libër'. Ai është përfshirës i asaj çka asnjë libër tjetër, i të parëve e i të fundmëve, nuk e ka përfshirë. Lëndë e tij është dija madhështore, është e vërteta e qartë, e sigurt dhe e pakundërshtueshme.

- "Në të nuk ka dyshime..." - Ky, pra, është një libër, tek i cili nuk mund të kihet asnjë dyshim. Mohimi i dyshimit nënkupton pohimin e të kundërtës së tij, dhe e kundërta e dyshimit është siguria (*jakîn*). Ky libër është zbulues i dijes së sigurt, e cila largon çdo dyshim apo mëdyshje.

Ja pra, sapo u përmend një rregull shumë i dobishëm në Islam, që thotë: "Mohimi i një cilësie negative nuk mund të konsiderohet kurrë si lavdërim, nëse nuk shoqërohet (apo nuk nënkupton) me pohimin e të kundërtës së saj, e cila është dhe duhet të jetë e përsosur." Vetë mohimi, i shkëputur, nuk përmban lavdërim nëse nuk shoqërohet me atë çka përmendëm.

Duke qenë se ky libër përmban në vetvete *jakin*-in (sigurinë apo dijen e sigurt) dhe duke ditur se udhëzimi në Rrugën e Drejtë mund të arrihet veçse duke marrë dijen e sigurt, atëherë Allahu i Madhëruar dëshmon dhe na jep siguri se ky libër prej të cilit duhet të marrim diturinë është:

- "Udhëzim për të devotshmit" - Fjala *'hudâ'* (udhëzim) nënkupton gjithçka me anë të së cilës dallohet rruga e drejtë nga e gabuara, dallohet dija e sigurt nga dyshimi dhe mëdyshjet. 'Udhëzim' quhet gjithçka që tregon dhe qartëson rrugët e dobishme që duhet të ndjekë robi në këtë jetë.

Diçka tjetër shumë e këndshme, që nuk mund të lihet pa u përmendur, është edhe fakti se Allahu i Madhëruar e ka përdorur fjalën *hudâ* në trajtën e pashquar, pra, duke mos përcaktuar se për çfarë drejtimi apo sfere është udhëzim ky libër. Ai nuk ka thënë: "Udhëzim për të arritur këtë apo atë gjë të dobishme". Kuptohet që kjo bëhet me qëllim të përfshirjes së një hapësire të pafund mirësish. Pra, kur i Lartësuari thotë që ky libër është "udhëzim për të devotshmit", kjo do të thotë që ai është udhëzim për të zbuluar dhe ndjekur të gjitha rrugët e mirësive, të dynjasë e të ahiretit qofshin. Ai është zbulues i mirësive kryesore dhe i degëzimeve të tyre, qartësues i së vërtetës nga e kota dhe i të saktës nga e pasakta, sqarues i rrugëve të humbjes dhe kërcënues për t'u larguar prej tyre. Ai është tregues i të gjitha mundësive të shpëtimit: dëftues i rrugëve të lumturisë së kësaj jete dhe të jetës tjetër.

Në ajet thuhet se Kur'âni është udhëzim për të devotshmit (*mutekin*), nga mund të kuptohet se ai është udhëzim vetëm për ta. Por, në një vend tjetër në Kur'ân, Allahu i Madhëruar pohon që ky libër është: "Udhëzim për të gjithë njerëzit". Kur'âni, në vetvete, është udhëzues për të gjitha krijesat, por të mjerët e fatzinjtë nuk përfitojnë nga ky udhëzim i përgjithshëm dhe nuk e pranojnë udhëzimin e plotë të Allahut. Ky udhëzim i përgjithshëm nuk ndryshon asgjë tek ata, veç faktit që justifikimi i tyre para Krijuesit nuk do të ketë vlerë, dhe kështu bëhet i merituesëm ndëshkimi prej Allahut Krenar dhe të Drejtë.

Ndërsa të devotshmit japin maksimumin për të merituar udhëzimin e vërtetë, që përmendet në Kur'ân, prandaj vetëm ata e meritojnë këtë udhëzim.

Të japësh maksimumin për të merituar udhëzimin e vërtetë, do të thotë të pajisesh me devotshmëri (*taḳuâ*). *Taḳuâ* është mburoja që të ruan nga zemërimi i Allahut dhe nga ndëshkimi i Tij. Ajo realizohet veçse duke kryer urdhëresat e Allahut dhe duke iu larguar ndalesave të Tij.

Në këtë këndvështrim, është shumë e qartë se të vetmit që përfitojnë udhëzimin e plotë nga argumentet e Zotit, janë të devotshmit.

Për të sqaruar dhe shtjelluar edhe më mirë këtë çështje, themi se udhëzimi i Allahut për krijesat është dy llojesh:

1. Udhëzimi i qartësimit (të së vërtetës) (*Hidâjetul Bejân*).

2. Udhëzimi drejt rrugës së suksesit (*Hidâjetu et-Teufiḳ*). Ky është udhëzimi për të kryer vepra të mira e për t'u larguar nga ato vepra të këqija, që të çojnë në zemërimin e Allahut dhe ndëshkimin e Tij.

Të devotshmit i kanë të dyja llojet e udhëzimit: edhe udhëzimin e qartësimit, edhe atë për të patur sukses, ndërsa disa të tjerë gëzojnë veçse udhëzimin e qartësimit (udhëzimin e përgjithshëm). Por, vetëm qartësimi i rrugës së drejtë, pa patur suksesin në veprimin sipas saj, nuk është udhëzim i plotë dhe i mjaftueshëm. Udhëzimi i plotë është njohja e së vërtetës dhe vënia e saj në zbatim.

Në vazhdim, Allahu i Madhëruar i përshkruan të devotshmit me veçoritë e tyre në aspektin e besimit dhe në aspektin e veprave të tyre, të dukshme dhe të fshehta, sepse devotshmëria, cilësia e tyre e përgjithshme, është e ndërtuar dhe e gatuar nga këto vepra dhe besime.

Kështu, Allahu i Madhëruar thotë:

- "Ata të cilët e besojnë të fshehtën" - Esenca e besimit qëndron në pohimin dhe pranimin pa mëdyshje të gjithçkaje rreth së cilës na kanë lajmëruar profetët. Kjo nënkupton nënshtrimin e plotë të të gjithë qenies tonë ndaj këtyre kumteve.

Siç shihet, problemi nuk qëndron në besimin e çështjeve të prekshme dhe të konceptueshme nga shqisat, sepse ky lloj besimi nuk e dallon mohuesin nga besimtari. E gjithë çështja është e përqendruar te besimi në të fshehtat, të cilat as i kemi parë e as i kemi dëshmuar, por që i besojmë thjesht duke u mbështetur në kumtet që na vijnë nga Allahu i Lartësuar dhe nga Pejgamberi (s.a.u.s.). Pikërisht ky është besimi që bën dallimin mes mohuesit dhe besimtarit. Ky besim është miratim i pastër dhe pohim i sinqertë i gjithçkaje që vjen nga Allahu i Lartësuar.

Besimtari beson dhe miraton gjithçka rreth së cilës na ka lajmëruar Allahu dhe Pejgamberi i Tij (s.a.u.s.), pavarësisht nëse e ka parë apo jo atë gjë rreth së cilës njoftohet. Ai e beson atë, pavarësisht nëse e kupton apo ende nuk ka arritur ta kuptojë atë gjë për të cilën urdhërohet ta besojë. Natyrisht, kjo është në kontrast të thellë me gjendjen që i karakterizon mohuesit dhe shkatërruesit, të cilët i mohojnë çështjet e fshehta. Ata i mohojnë kumtet rreth të fshehtave, thjesht dhe vetëm për shkak se mendjet e tyre të ngushta dhe të varfra nuk arrijnë t'i kuptojnë dhe t'i konceptojnë ato. Ata i mohojnë, edhe pse nuk japin as minimumin e tyre për t'u pajisur me dijen e nevojshme për të gjykuar drejt rreth këtyre kumteve.

Ndërsa mendjet e besimtarëve, që miratojnë dhe pohojnë të vërtetën, që drejtohen me udhëzimin e zbritur nga Allahu i Madhëruar, janë të ndriçuara dhe të kthjellëta.

Të besosh në të fshehtën do të thotë të besosh gjithçka rreth së cilës ka lajmëruar Allahu i Madhëruar, të jesh i sigurt rreth ngjarjeve të së shkuarës dhe të së ardhmes (që përshkruhen në tekstet hyjnore), rreth gjendjeve dhe skenave të Ditës së Gjykimit, si edhe për vërtetësinë e cilësive dhe emrave të Allahut të Madhëruar. Besimtarët i besojnë të gjitha këto. Ata besojnë në ekzistencën dhe vërtetësinë e këtyre ngjarjeve e kumteve dhe janë të sigurt rreth tyre, edhe pse ndoshta nuk mund t'i konceptojnë dhe t'i kuptojnë hollësisht dhe konkretisht se si janë në të vërtetë këto çështje. Pastaj Allahu i Lartësuar thotë:

- "E përkryejnë faljen e namazit..." - Allahu i Madhëruar, për të treguar se si e falin namazin të devotshmit, ka përdorur fjalën *'juḳîmûne'*, domethënë: e kryejnë në mënyrën më të plotë atë. Ai nuk ka thënë thjesht: "*jefalûne*" – "e bëjnë", ose "*jetûne bihi*" – "e paraqesin namazin", sepse për të kryer namazin në formën e kërkuar, me të cilën meriton gradën "i devotshëm", nuk mjafton ta paraqesësh atë thjesht në formën dhe në veprimet e jashtme. "Të përkryesh namazin" do të thotë ta realizosh atë të plotë, si në aspektin e kushteve, shtyllave, detyrave dhe syneteve të tij të jashtme, ashtu edhe në aspektin e kushteve, shtyllave, detyrave dhe syneteve që kanë të bëjnë me zemrën dhe shpirtin (aspektin e brendshëm). Kjo e fundit kryhet duke u përkujdesur që të shijosh "shpirtin" dhe ëmbëlsinë e namazit, e cila arrihet duke qenë me zemrën tënde vazhdimisht i pranishëm në gjithçka që thua dhe që vepron gjatë namazit. Vetëm ky lloj namazi është ai për të cilin Allahu i Madhëruar thotë: "Pa dyshim, namazi të frenon nga poshtërsitë dhe nga veprat e këqija."

Shpërblimi i Allahut të Madhëruar për namazin është i lidhur ngushtë me gradën e përqëndrimit në të dhe të përkushtimit ndaj tij. I njëjti gjykim vlen si për namazet e detyruara, ashtu edhe për ato vullnetare (nafile) dhe të pëlqyera (synete).

Pastaj, Allahu i Madhëruar thotë:

- "Dhe prej asaj me çka i kemi furnizuar, ata shpenzojnë *(për hir të Zotit)*" - Në këtë ajet flitet për shpenzimet e detyrueshme, sikurse janë: zekati, shpenzimet për gratë, fëmijët, të afërmit, robërit etj., por edhe për shpenzimet jo të detyrueshme, që janë të pëlqyeshme, në të gjitha sferat e mirësive.

Vështro me kujdes! Këtu Allahu nuk ka treguar se kujt duhet t'i jepen a dorëzohen këto shpenzime e kontribute, sepse si shkaqet që i bëjnë të nevojshme këto shpenzime, edhe ata që i meritojnë ato, janë të shumëllojshme. Ai nuk i ka përcaktuar edhe për faktin se, këto shpenzime bëhen në shenjë adhurimi dhe afrimi tek Allahu i Madhëruar, pavarësisht se kujt i jepen.

Duhet të përmendim edhe një moment shumë të bukur! Allahu i Madhëruar thotë: "…prej asaj me çka i kemi furnizuar". Parafjala "*prej*" tregon pjesë të së tërës. Ajo përdoret për të qartësuar krijesat se Ai kërkon prej tyre veçse një pjesë të vogël të asaj pasurie që po Ai ua ka dhënë, pjesë e cila nuk i dëmton e nuk i rëndon aspak ata. Madje, të parët që përfitojnë nga shpenzimi janë pikërisht shpenzuesit, dhe pastaj vijnë vëllezërit e tyre në nevojë.

Fjala e Allahut të Madhëruar: "*razeḳnâhum*" (…me çka i kemi furnizuar…) domethënë: Këto pasuri që ndodhen në duart tuaja, në fakt, nuk janë produkt i punës, fuqisë dhe pushtetit tuaj, por janë thjesht furnizim dhe bamirësi prej Allahut të Madhëruar, të cilat Ai i ka lënë në shërbimin dhe kujdestarinë tuaj. Kështu pra, sikurse Ai ju zgjodhi ju mbi të tjerët, duke ju bërë një favor, tregoni edhe ju mirënjohjen tuaj ndaj Tij, duke shpenzuar një pjesë të asaj që Ai ju ka dhuruar, për t'u solidarizuar me vëllezërit tuaj që nuk kanë dhe për t'i ndihmuar ata.

Është për t'u përmendur edhe fakti që, Allahu i Madhëruar, në Kur'ân, shumë shpesh i ka përmendur së bashku çështjen e namazit dhe çështjen e zekatit. Kjo përmban një urtësi të këndshme: namazi mbjell sinqeritetin ndaj të Adhuruarit, ndërsa zekati përfaqëson bamirësinë ndaj adhuruesve të Tij. E pra, lumturia e adhuruesit qëndron mbi këto dy shtylla: te sinqeriteti ndaj të Adhuruarit dhe te përpjekja për të qenë në ndihmë të krijesave; kurse shkaku i dëshpërimit dhe i humbjes qëndron tek të kundërtat e këtyre shtyllave. E si mund të jetë i lumtur ai që nuk gëzon sinqeritetin e adhurimit dhe ai që nuk është i dobishëm për krijesat?!

Pastaj, Allahu i Madhëruar thotë:

- "…dhe ata të cilët e besojnë atë që t'u shpall ty" - Pejgamberit (s.a.u.s.) iu shpall Kur'âni dhe Suneti, sikurse qartëson i Madhëruari kur thotë: "Allahu të shpalli ty Kur'ânin dhe Urtësinë (Sunetin)".

Të devotshmit, pra, besojnë gjithçka që iu shpall Pejgamberit (s.a.u.s.). Ata kurrë nuk bëjnë dallime mes pjesëve të Shpalljes që i erdhi atij, duke besuar diçka dhe duke mohuar diçka tjetër.

Mohimi mund të bëhet në këto forma: ose duke mos e pranuar atë që është shpallur nga Allahu, ose duke i dhënë asaj që është shpallur interpretime që bien ndesh me qëllimet dhe synimet që ka pasur Allahu i Madhëruar dhe Pejgamberi i Tij (s.a.u.s.). Në këtë gabim të fundit kanë rënë shumë të humbur, të cilët, kur hasin në ajete dhe hadithe që bien ndesh me mentalitetin e tyre, ua shtrembërojnë kuptimin si pa të keq, tregues ky i mospranimit të kuptimit të tyre të vërtetë. Ata, edhe pse pretendojnë se i besojnë tekstet, në momentin që i keqinterpretojnë ato, deklarojnë mohimin e tyre dhe tregojnë se, në të vërtetë, nuk i kanë besuar ato.

- "…dhe atë që u shpall para teje…" – Këtu flitet për besimin në librat dhe shpalljet hyjnore paraardhëse të Islamit. Besimi te librat hyjnorë nënkupton edhe besimin te profetët të cilëve iu shpallën këta libra. Ky besim nënkupton në mënyrë të veçantë besimin te përmbajtja thelbësore e librave kryesorë të shpallur para Kur'ânit, të cilët

ishin: Teurati, Zeburi dhe Ungjilli. Kjo, pra, është një veçori tjetër e besimtarëve të vërtetë. Ata besojnë të gjitha shpalljet qiellore dhe të gjithë profetët të cilëve iu zbritën këto shpallje, pa bërë asnjë dallim mes tyre.

Më pas, Allahu i Madhëruar vazhdon duke përmendur veçori të tjera të *mutekin*-ëve:

- "...Për ahiretin, ata janë të bindur plotësisht." – *El âhirat* është një emër që përfshin gjithçka që do të vijë pas vdekjes. Këtu vërejmë se Allahu i Madhëruar e ka veçuar përkujtimin e kësaj dite, pasi e përmend në fillim në mënyrë të përgjithësuar (kur flet për besimin në të fshehtën). Dihet që besimi në botën e përtejme është pjesë e besimit të muslimanit, madje shtyllë e këtij besimi. Allahu i Madhëruar e veçon përmendjen e kësaj dite, sepse ajo është një nga nxitëset më të fuqishme të veprave dhe të ndjenjave të domosdoshme të adhurimit, sikurse janë shpresa dhe frikë-respekti ndaj Allahut të Madhëruar.

Jakin-i, nga ana tjetër, nënkupton dijen e plotë dhe të sigurt, që nuk lë as me të voglin dyshim e luhatje dhe që domosdoshmërisht të nxit të veprosh.

- "...ata janë në një udhëzim prej Zotit të tyre..." - Fjala *"huden"* (drejtim, udhëzim) vjen në trajtën e pashquar, formë e cila (në arabisht) tregon madhështinë dhe rëndësinë e asaj që shënon kjo fjalë. Pra, ajeti kuptohet kështu: *Ata janë në një udhëzim të përkryer dhe shumë të rëndësishëm prej Zotit të tyre*.

A ka udhëzim më të mirë dhe më të rëndësishëm sesa ai që të jep sukses të stolisesh me të tilla cilësi të vyera, që janë fryte të besimit të pastër dhe nxitje për vepra të mira dhe të drejta?! A mund të ketë udhëzim tjetër të vërtetë, përveç atij që gëzojnë këta të zgjedhur?! Vetëm ky mund të quhet "udhëzim". Gjithçka tjetër e ka emrin "humbje".

Para fjalës *"huden"*, është përdorur parafjala *"ala"* (mbi, lart, sipër). Pra, fjalë për fjalë, kuptimi është: *"Ata janë mbi një udhëzim"*, për të treguar lartësinë e të udhëzuarve dhe faktin që ata qëndrojnë mbi të tjerët. Kurse kur flet për të humburit, Allahu thotë që ata janë *"fi ðalâl"*, duke përdorur parafjalën *'fi'* (në, brenda), që do të thotë se ata janë: "në humbje", ose më qartë: "të zhytur brenda humbjes". Kjo duket edhe në këtë ajet kur'ânor: "Pa dyshim që, ne ose ju, jemi ose të lartësuar në një udhëzim (*alâ huden*), ose të zhytur në një humbje të sigurt (*fî ðalâl*...).". Në fakt, i udhëzuari është gjithmonë lart, a thua se është hipur mbi "udhëzim", dhe ashtu mbi të, ai udhëton. Ndërsa i humburi është i zhytur në humbje, i poshtëruar dhe i pavlefshëm.

Pastaj i Madhëruari thotë:

"...dhe vetëm ata janë të shpëtuarit *(ose fitimtarët)*" – *"El felâh"* quhet fitimi i asaj që dëshiron dhe shpëtimi nga ajo së cilës i druhesh. Allahu i Lartësuar e ka kufizuar dhe veçuar *"felâh"*-un vetëm për ta, sepse e vetmja rrugë që të çon drejt tij është rruga e tyre. Rrugët e tjera të çojnë veçse në trishtim, shkatërrim dhe dëshpërim.

Pasi tregon cilësitë e vërteta të besimtarëve, Allahu jep edhe cilësitë e jobesimtarëve, të cilët e shfaqin haptazi mosbesimin dhe kokëfortësinë inatçore ndaj Profetit (s.a.u.s.)

Ajetet 6 – 7

6. Nuk ka dyshim, se për ata që mohojnë është njëlloj: ua tërhoqe vërejtjen apo jo, ata nuk besojnë.
7. Allahu ua ka vulosur zemrat dhe të dëgjuarit e tyre. Në shikimet e tyre ka perde dhe ata do të kenë dënim të madh.

Shpjegimi i ajeteve

- "Nuk ka dyshim, se për ata që mohojnë është njëlloj: ua tërhoqe vërejtjen apo jo, ata nuk besojnë." – Këtu Allahu i

Madhëruar na flet rreth një kategorie njerëzish, që e kanë mohuar Atë. Cilësia dalluese e tyre është mohimi (*kufr*), i cili është bërë tipar dhe veçori e pandashme e shpirtit të tyre. I Madhëruari na tregon se këta (lloj njerëzish) nuk i kthen asgjë pas nga mohimi i tyre. Ndaj tyre nuk bën dobi asnjë lloj qortimi dhe vërejtjeje. Çfarëdo që të bësh, ata do të vazhdojnë në *kufr*-in e tyre. Për ta është njëlloj: i qortove apo jo, ata nuk e gjejnë rrugën e besimit.

Kuptimi thelbësor i *kufr*-it është pikërisht refuzimi dhe mospranimi i kumtit që përcolli Profeti (a.s.), qoftë edhe i një pjese sado të vogël të tij. Ftesa në rrugën e besimit për këta mohues nuk ka asnjë lloj ndikimi tek ata, përveç faktit që ata humbasin të drejtën e justifikimit para Zotit. Sqarimi i gjithçkaje rreth besimit nuk u lë atyre asnjë hapësirë argumentuese përpara Krijuesit për mohimin dhe refuzimin e tyre.


Me sa duket, me këtë ajet, Allahu i Madhëruar kërkonte ta bindte Profetin (a.s.) që të hiqte dorë nga ideja se ata mund të besonin dhe të mos ndiente keqardhje dhe trishtim për refuzimin dhe mohimin e tyre.

Pastaj Allahu i Madhëruar tregon shkaqet që i pengojnë ata të besojnë, duke thënë:

- "Allahu ua ka vulosur zemrat dhe të dëgjuarit e tyre" – Pra, ua ka vulosur ato në mënyrë të atillë, që në ato zemra të mos hyjë kurrë besimi. Ata, pas këtij bllokimi, nuk e kuptojnë më atë gjë që u bën dobi dhe nuk mund të dëgjojnë diçka që atyre do t'u vlente.

- "Në shikimet e tyre ka perde..." - Allahu u ka vendosur perde, që i ndalon ata të shohin atë çka u vlen dhe u bën dobi.

Pa dyshim, këto të trija (zemra, të dëgjuarit dhe shikimi) janë rrugët e dijes dhe rrugët e marrjes së informacionit. Kjo do të thotë që rrugët e dijes dhe të mirësisë qëndrojnë të mbyllura para këtyre njerëzve.


الجزء الأول — سورة البقرة

إِنَّ ٱلَّذِينَ كَفَرُوا۟ سَوَآءٌ عَلَيْهِمْ ءَأَنذَرْتَهُمْ أَمْ لَمْ تُنذِرْهُمْ
لَا يُؤْمِنُونَ ۝٦ خَتَمَ ٱللَّهُ عَلَىٰ قُلُوبِهِمْ وَعَلَىٰ سَمْعِهِمْ ۖ وَعَلَىٰٓ
أَبْصَٰرِهِمْ غِشَٰوَةٌ ۖ وَلَهُمْ عَذَابٌ عَظِيمٌ ۝٧ وَمِنَ ٱلنَّاسِ
مَن يَقُولُ ءَامَنَّا بِٱللَّهِ وَبِٱلْيَوْمِ ٱلْءَاخِرِ وَمَا هُم بِمُؤْمِنِينَ ۝٨
يُخَٰدِعُونَ ٱللَّهَ وَٱلَّذِينَ ءَامَنُوا۟ وَمَا يَخْدَعُونَ إِلَّآ أَنفُسَهُمْ
وَمَا يَشْعُرُونَ ۝٩ فِى قُلُوبِهِم مَّرَضٌ فَزَادَهُمُ ٱللَّهُ مَرَضًا ۖ
وَلَهُمْ عَذَابٌ أَلِيمٌۢ بِمَا كَانُوا۟ يَكْذِبُونَ ۝١٠ وَإِذَا قِيلَ لَهُمْ
لَا تُفْسِدُوا۟ فِى ٱلْأَرْضِ قَالُوٓا۟ إِنَّمَا نَحْنُ مُصْلِحُونَ ۝١١ أَلَآ إِنَّهُمْ
هُمُ ٱلْمُفْسِدُونَ وَلَٰكِن لَّا يَشْعُرُونَ ۝١٢ وَإِذَا قِيلَ لَهُمْ
ءَامِنُوا۟ كَمَآ ءَامَنَ ٱلنَّاسُ قَالُوٓا۟ أَنُؤْمِنُ كَمَآ ءَامَنَ ٱلسُّفَهَآءُ ۗ
أَلَآ إِنَّهُمْ هُمُ ٱلسُّفَهَآءُ وَلَٰكِن لَّا يَعْلَمُونَ ۝١٣ وَإِذَا لَقُوا۟
ٱلَّذِينَ ءَامَنُوا۟ قَالُوٓا۟ ءَامَنَّا وَإِذَا خَلَوْا۟ إِلَىٰ شَيَٰطِينِهِمْ قَالُوٓا۟ إِنَّا
مَعَكُمْ إِنَّمَا نَحْنُ مُسْتَهْزِءُونَ ۝١٤ ٱللَّهُ يَسْتَهْزِئُ بِهِمْ وَيَمُدُّهُمْ
فِى طُغْيَٰنِهِمْ يَعْمَهُونَ ۝١٥ أُو۟لَٰٓئِكَ ٱلَّذِينَ ٱشْتَرَوُا۟ ٱلضَّلَٰلَةَ
بِٱلْهُدَىٰ فَمَا رَبِحَت تِّجَٰرَتُهُمْ وَمَا كَانُوا۟ مُهْتَدِينَ ۝١٦

٣

Nuk ka më shpresë që ata të besojnë, madje asnjë e mirë nuk mund të shpresohet prej tyre.

Sidoqoftë, duhet të jemi të sigurt se këto rrugë të përfitimit, domethënë rrugët e marrjes së njohurive dhe të mirësive, qëndrojnë të mbyllura para tyre veç për një shkak, i cili është i thjeshtë dhe i kuptueshëm: mohimi, refuzimi dhe kryeneçësia që ata tregojnë ndaj së vërtetës, pasi janë sqaruar plotësisht rreth saj. Në suren En'am, ajeti 110, Allahu i Lartësuar thotë: "Ne ua rrotullojmë *(largojmë)* zemrat dhe shikimet e tyre *(prej besimit)*, ashtu sikurse ata nuk e besuan atë *(Kur'ânin)* për herë të parë *(kur iu paraqit)*, dhe i lëmë ata të bredhin të hutuar në shfrenimin e tyre, që të tejkalojnë kufijtë".

Kjo nënkupton ndëshkimin e përshpejtuar, të cilin ata do ta 'shijojnë' dhe do ta përjetojnë që në këtë dynja.

Ndërsa rreth ndëshkimit të rezervuar për ta Ditën e Gjykimit, Allahu i Madhëruar thotë:

- "...dhe ata do të kenë një dënim të madh" - Ndëshkimi i madh, i përmendur këtu, është pikërisht ndëshkimi që do të përjetojnë në zjarrin e Xhehenemit. Atje do të vuajnë edhe zemërimin e të Pamposhturit dhe Krenarit (Allahut). Ky ndëshkim do të jetë i përjetshëm dhe i pandërprerë.

Më tej, Allahu i Madhëruar na jep edhe një përshkrim të munafikëve (hipokritëve), të cilët, në dukje, shfaqin Islamin, por në shpirt janë të gatuar me mosbesim:

Ajetet 8 – 10

8. Ka njerëz që thonë: "Ne e besojmë Allahun, e besojmë edhe Ditën e Gjykimit", por *(në të vërtetë)* ata nuk janë besimtarë.
9. Ata përpiqen të mashtrojnë Allahun dhe besimtarët, por, në fakt, ata mashtrojnë veçse vetveten, dhe këtë nuk e ndiejnë.
10. Në zemrat e tyre ka sëmundje, dhe Allahu ua shton sëmundjen e tyre. Ata do të kenë një ndëshkim të dhembshëm, për shkak të mohimit të tyre.

Shpjegimi i ajeteve

Mësoje se hipokrizia (*nifâḳ*) është: Të shfaqurit e mirësisë, duke fshehur përbrenda të keqen. Në këtë përkufizim hyjnë dy lloje të hipokrizisë: ajo e cila shfaqet në veprime e sjellje dhe ajo që shfaqet në besim.

Si shembull të llojit të parë mund të përmendim ato veprime e sjellje që i ka përshkruar Profeti (s.a.u.s.) në hadithin e tij, kur thotë: "Shenjat treguese të hipokritit janë: Kur flet, gënjen, kur premton, e thyen premtimin, dhe kur i besohet diçka, të tradhton.". Në një transmetim tjetër përmendet edhe kjo shenjë: "Kur polemizon, i tejkalon kufijtë *(ose nuk përmbahet)*."

Ndërsa hipokrizia që shfaqet dhe lë gjurmë në besim, është ajo që e nxjerr njeriun nga Islami dhe është treguese e kufrit të tij. Pra, ai që e ka këtë lloj hipokrizie është *kâfir* (femohues, qafir), jashtë Islamit. Pikërisht për këtë lloj *nifak*-u flitet në ajetet e mësipërme.

Në fakt, kjo lloj hipokrizie nuk ka ekzistuar dhe nuk është shfaqur para hixhretit (emigrimit të besimtarëve mekas) për në Medinë. Madje edhe pas hixhretit nuk pati shenja të tij, derisa ndodhi ngjarja e madhe e luftës së Bedrit, ku Allahu i Lartësuar, me fitoren që u dhuroi besimtarëve, tregoi fuqishëm krenarinë e tyre dhe ngriti lart famën e tyre. Në këtë moment, munafikët që jetonin në Medinë provuan poshtërimin dhe turpin. Shumë prej këtyre të poshtëruarve, për të ruajtur jetën, privilegjet dhe pasuritë e tyre, u shtirën sikur ishin në krahun e besimtarëve, ndërkohë që në zemrat e tyre fshihej mosbesimi dhe urrejtja.

Por Allahu i Madhëruar, për të shprehur butësinë dhe mëshirën e Tij ndaj besimtarëve, e përshkruan me hollësi gjendjen shpirtërore të hipokritëve, si edhe cilësitë dalluese të tyre, në mënyrë që asnjë besimtar të mos mashtrohej nga ata. Ai i shfaqi cilësitë e tyre edhe për një arsye tjetër: që ata të frenoheshin dhe të largoheshin nga shumë vepra të pista dhe të poshtra, që i bënin haptazi dhe në mënyrë të paturpshme.

Allahu i Madhëruar thotë në suren Teube, ajeti 64: "Hipokritët druhen se mos zbret ndonje sure, që t'ua nxjerrë në shesh atë që kanë në zemrat e tyre.....".

Allahu i Madhëruar i përshkruan ata, duke nxjerrë në pah esencën e hipokrizisë së tyre, kur thotë:

- "Ka njerëz që thonë: "Ne e besojmë Allahun, e besojmë edhe Ditën e Gjykimit", por ata nuk janë besimtarë." - Ata shprehin me fjalë diçka që nuk ekziston në zemrat e tyre, por Allahu i Madhëruar e përgënjeshtron këtë pretendim kur thotë: "...ata nuk janë besimtarë". Që të meritosh emrin 'besimtar' duhet ai besim, për të cilin zemra dhe gjuha janë në përputhje të plotë.

Ky pretendim bosh nuk është gjë tjetër, veçse një përpjekje e kotë për të mashtruar

Allahun e Madhëruar dhe besimtarët që e adhurojnë Atë.

- "Ata përpiqen të mashtrojnë Allahun dhe besimtarët..." – Mashtrimi është vepra e hipokritit, i cili shfaq diçka dhe fsheh diçka tjetër, për të mashtruar dhe për të arritur qëllimet e tij kundrejt të mashtruarit. E tillë është sjellja e munafikëve kundrejt Allahut të Lartësuar dhe adhuruesve të Tij besimtarë. Por, për çudi, ky mashtrim dhe kjo hipokrizi kthehet kundër tyre:

- "...por, në fakt, ata mashtrojnë veçse vetveten, dhe këtë nuk e ndiejnë..." – Vërtet, kjo është e çuditshme, se mashtruesit, në përgjithësi, ose kanë sukses me mashtrimet e tyre, duke e arritur atë që synojnë, ose dalin as të humbur e as të fituar.

Por kjo nuk ndodh me ata që përpiqen të mashtojnë Allahun dhe besimtarët. Dëmet e mashtrimit dhe të hipokrizisë, në këtë rast, rëndojnë dhe godasin pikërisht vepruesit e tyre. Ata nuk bëjnë gjë tjetër, por veçse thurin kurthe dhe mashtrime për të dëmtuar vetveten, se Allahu i Madhëruar kurrë nuk mund të dëmtohet nga kurthet dhe mashtrimet e tyre. Edhe ndaj adhuruesve të Tij besimtarë, kurthet e tyre mashtruese nuk kanë asnjë lloj ndikimi a dëmi. Fakti që hipokritët shfaqin besimin (për të mashtruar), nuk i dëmton dhe nuk i mashtron aspak besimtarët. Edhe pse me këtë hile ata mund të ruajnë të paprekur pasuritë e tyre dhe të shpëtojnë kokën, ata kurrsesi nuk mund t'i shpëtojnë poshtërimit që përjetojnë në shpirtin e tyre, nuk mund t'i shpëtojnë dëshpërimit dhe përuljes, që vijnë si pasojë e krenarisë, forcës dhe suksesit që përjetojnë besimtarët në mënyrë të vazhdueshme. Pastaj, në jetën tjetër, për ta është rezervuar një ndëshkim i ashpër, i dhembshëm dhe befasues, si pasojë e mohimit dhe e poshtërsisë së tyre.

Megjithatë, për shkak të injorancës dhe mendjelehtësisë që kanë, ata nuk e ndiejnë këtë kërcënim.

- "Në zemrat e tyre ka sëmundje, dhe Allahu ua shton sëmundjen e tyre." Sëmundja për të cilën flitet në këtë ajet është pikërisht sëmundja e dyshimit dhe hipokrizisë.

Dije se zemra është e predispozuar të goditet nga dy lloje sëmundjesh, të cilat e nxjerrin atë nga natyra e vet dhe nga pastërtia e natyrshmërisë:

1. sëmundja e dyshimeve të kota, që të çojnë teposhtë, në humbje;

2. sëmundja e epsheve, dëshirave dhe pasioneve të shfrenuara.

Mohimi i Zotit, mosbesimi, hipokrizia, dyshimet dhe sajesat në fe, të gjitha janë simptoma të sëmundjes së dyshimeve të kota. Ndërsa imoraliteti, dëshirat dhe tendencat drejt shfrenimit, animi nga gjynahet dhe veprimi i tyre janë simptoma të sëmundjes së epsheve dhe pasioneve të shfrenuara. Allahu i Lartësuar, kur këshillon gratë e Profetit (s.a.u.s.) që të jenë të ruajtura dhe të kujdesshme në shfaqjen apo fjalët e tyre, thotë më pas: "...që të mos joshet ai që ka sëmundje në zemrën e tij." [Ahzabë, 32]. Këtu, pra, është fjala për sëmundjen e epsheve të shfrenuara dhe imoralitetit.

Kushdo që Allahu i Madhëruar e ruan nga këto dy sëmundje, përfiton, së pari, siguri të plotë dhe besim të patundur, dhe, së dyti, durim kundrejt çdo poshtërsie dhe gjynahu. Këto dy cilësi e ruajnë zemrën të shëndetshme dhe të paprekur.

Thënia e Allahut të Madhëruar rreth munafikëve: **"...Në zemrat e tyre ka sëmundje, dhe Allahu ua shton sëmundjen e tyre"**, na jep të kuptojmë një urtësi të madhe të Tij në lidhje me përcaktimin e veprave të këqija që bëjnë gjynahqarët.

Duhet të kuptohet se këto gjynahe që ata bëjnë janë të përcaktuara nga Zoti i Madhëruar, si pasojë e gjynaheve paraardhëse që ata kanë bërë. Pra, këdo që merr guximin të kalojë kufijtë, Allahu i Lartësuar e sprovon me gjynahe të tjera të mëtejshme, të cilat meritojnë ndëshkimin e

Tij, sikurse thuhet në suren Enam, ajetet 110-111: "Ne ua rrotullojmë zemrat dhe vështrimet e tyre *(prej besimit)*, ashtu sikurse ata nuk e besuan atë *(Kur'ânin)* për herë të parë *(kur iu paraqit)*, dhe i lëmë ata të bredhin të hutuar në shfrenimin e tyre, që të tejkalojnë kufijtë. Edhe sikur t'u dërgonim engjëjt atyre, t'i bënim të vdekurit t'u flisnin atyre dhe t'i tubonim të gjitha gjërat para tyre, ata përsëri nuk do të besonin, nëse Allahu nuk do të donte; por shumica e tyre janë të paditur."

Ndërsa në suren Saf, ajeti 5, Ai thotë: "...dhe kur ata u shmangën *(nga e vërteta)*, Allahu ua largoi zemrat e tyre *(nga besimi)*. Allahu nuk e udhëzon në rrugë të drejtë një popull që i kalon kufijtë *(duke qenë të pabindur)*"

Në suren Teube, ajetet 75 -78, Allahu thotë: "Ka nga ata *(hipokritë)*, që kanë bërë besëlidhje me Allahun, duke thënë: "Nëse Ai na jep nga mirësitë e Tij, sigurisht që do të japim lëmoshë dhe sigurisht që do të bëhemi njerëz të mirë!" Por kur Ai u dha atyre nga mirësitë e Veta, ata u bënë koprracë dhe kthyen shpinën, duke u larguar. Prandaj, Ai ua lidhi hipokrizinë në zemrat e tyre, *(që ta kenë)* deri në Ditën kur do të dalin para Tij, sepse e shkelën premtimin e dhënë Allahut. Ata e kishin zakon gënjeshtrën. Vallë, a nuk e dinë ata se Allahu i di të fshehtat e tyre, edhe bisedat e fshehta?! Në të vërtetë, Allahu është Ai që i di të gjitha fshehtësitë."

Më tej, po në suren Teube, ajetet 124-126, thuhet: "Kur shpallet ndonjë sure, disa prej atyre *(që kanë dyshim dhe hipokrizi)* thonë: "Cilëve prej jush ua shtoi besimin kjo sure?" Për sa u përket besimtarëve, atyre *(kjo sure)* ua shton besimin dhe ata gëzohen. E sa u përket atyre që kanë sëmundje në zemrat e veta, ajo ua shton edhe më shumë dyshimin që kanë, dhe ata vdesin si mohues. Vallë, a nuk e shohin ata se çdo vit vihen në provë një ose dy herë e, megjithatë, ata as nuk pendohen, as nuk përkujtojnë?!"

Kështu pra, ndëshkimi i poshtërsisë është, ndër të tjera, poshtërsia tjetër që vjen pas saj, ashtu sikundër edhe prej shpërblimit të së mirës, ndër të tjera, është e mira tjetër që vjen pas saj. I Madhëruari thotë: "…dhe atyre që u udhëzuan, Allahu ua shton udhëzimin". [Merjem 76]. Ndërsa për ndëshkimin që i pret në jetën tjetër, Allahu thotë:

- "Ata do të kenë një ndëshkim të dhembshëm, për shkak të mohimit të tyre."

Ajetet 11 – 12

11. E kur atyre u thuhet: "Mos shkatërroni në tokë!", ata thonë: "Ne jemi vetëm përmirësues (*rregullues*)!"
12. Në të vërtetë, pikërisht ata janë shkatërruesit, por nuk e ndiejnë.

Shpjegimi i ajeteve

- "E kur atyre u thuhet: "Mos shkatërroni në tokë!" - Këta hipokritë kështillohen që të ndalen nga shkatërrimi që bëjnë në tokë. Ky shkatërrim shfaqet në shumë forma: në formën e kufrit (mohimit të Zotit dhe të drejtave të Tij), në formën e veprimit sipas rrugës ku i çon mosbesimi dhe mosbindja e tyre, në formën e shpërfilljes së urdhrave dhe të kryerjes së veprave të ulëta, në formën e nxjerrjes së sekreteve të muslimanëve, për t'ua treguar ato qafirëve, në formën e miqësisë së tyre me jobesimtarët etj.

Por kur ata kështillohen për t'u frenuar nga shkatërrimi që bëjnë në tokë,

- Thonë: "Ne jemi të vetmit përmirësues!" – Kështu, ata bëjnë njëkohësisht dy të zeza: përhapin shkatërrimin në tokë dhe këtë shkatërrim e paraqesin si rregullim dhe përmirësim, duke e shtrembëruar të vërtetën. Ata shkatërrojnë dhe besojnë se kjo është rruga e drejtë. Ky, pa dyshim, është krim shumë më i rëndë se i atyre që bëjnë poshtërsi, por e dinë dhe janë të

ndërgjegjshëm se këto janë poshtërsi. Këta të fundit janë më afër udhëzimit dhe shpresës për t'u kthyer nga rruga e gabuar, sesa ata të parët.

Munafikët thonë: "Ne jemi të vetmit përmirësues". Kështu, ata pretendojnë se të qenurit rregullues (të rendit në tokë) është cilësi e posaçme vetëm për ta, duke nënkuptuar se besimtarët nuk e kanë këtë cilësi. Por Allahu i Madhëruar ua hedh poshtë këtë pretendim, duke thënë:

- "...në të vërtetë, pikërisht ata janë shkatërruesit, por nuk e ndiejnë" – Sigurisht që nuk ka shkatërrim më të madh se ai që shkakton e përhap mohimi i Zotit dhe i argumenteve të Tij. A ka shkatërrues më të madh se ai që pengon njerëzit nga rruga e Allahut dhe që përpiqet të mashtrojë Allahun dhe të zgjedhurit e Tij?! Shkatërrues janë të gjithë ata që miqësohen me këdo që i ka shpallur luftë Allahut dhe Profetit të Tij, të cilët, si pa të keq, pretendojnë paturpësisht se ky quhet rregullim. Po a ka shkatërrim më të madh se ky?!

Në fakt, ata nuk mund ta ndiejnë dhe kuptojnë këtë, sepse nuk e kanë dijen e nevojshme, që do t`u mundësonte ta kuptonin. Dija (rreth besimit dhe fesë) që ata kanë u vlen thjesht dhe vetëm për një gjë: që të mos kenë asnjë justifikim para Allahut Ditën e Gjykimit. Atyre u janë përcjellë njohuri të mjaftueshme për të hedhur poshtë çdo argumentim dhe justifikim të tyre para Allahut.

Veprimi i poshtërsive është konsideruar si shkatërrim, sepse është ai që e shkakton prishjen e të gjitha të mirave në tokë: bimësisë, farërave, frutave, pemëve etj. Shkak i çdo shkatërrimi janë veprat e ulëta (dhe kalimi i kufijve të Zotit).

Ndërsa rregullimi i tokës nënkupton që ajo të mbushet me mirësi dhe të lulëzojë, si pasojë e bindjes ndaj Allahut dhe e besimit tek Ai. Allahu i Madhëruar i krijoi krijesat veçse për këtë qëllim dhe, pikërisht për këtë arsye, i vendosi në tokë. Ai i krijoi ata dhe u dhuron furnizim dhe të mira të shumta, me qëllim që t`i ndihmojë në bindjen dhe adhurimin kushtuar Atij. Por nëse krijesat veprojnë të kundërtën, atëherë ky është shkatërrim, pasi e nxjerr tokën nga natyra e saj, në të cilën ajo është krijuar.

Ajeti 13

13. Dhe kur atyre u thuhet: "Besoni, sikurse besuan njerëzit!" Ata thonë: " A të besojmë edhe ne ashtu sikurse besuan mendjelehtët?" Në të vërtetë, mendjelehtët janë pikërisht ata, por nuk e dinë.

Shpjegimi i ajetit

- "Dhe kur atyre u thuhet: "Besoni, sikurse besuan njerëzit!" - Kur munafikëve u thuhet: "Besoni edhe ju, me zemër dhe me gojë, sikurse besuan njerëzit, pra, sikurse besuan sahabët, pasuesit e Pejgamberit (s.a.u.s.)", ata përgjigjen me pretendimin e gënjeshtërt, duke thënë:

- "A të besojmë edhe ne ashtu sikurse besuan mendjelehtët?" – "A të besojmë edhe ne sikurse besuan mendjelehtët?" Të poshtrit! Me fjalën "mendjelehtë", ata kishin për qëllim shokët e Profetit (a.s.). Hipokritët mendonin se imani i sahabëve është pasojë e mendjelehtësisë së tyre. Ata mendonin se ishte pikërisht kjo mendjelehtësi që i detyroi ata t`i hynin luftës së ashpër me jobesimtarët e, madje, të braktisin edhe atdheun (e pasuritë) e tyre. Mendja e cekët e këtyre fatkeqëve hipokritë i shtyu ata të bënin të kundërtën e asaj që vepruan pasuesit e Profetit (s.a.u.s).

Duke pretenduar mendjelehtësinë e sahabëve, ata nënkuptonin se vetë ishin gjykues të zgjuar e mendimtarë të mëdhenj. Por, përsëri, Allahu i Madhëruar ua hodhi poshtë pretendimin e tyre, duke na treguar se mendjelehtët ishin pikërisht dhe vetëm ata.

- "Në të vërtetë, pikërisht ata janë mendjelehtët, por nuk e dinë" - Nuk ka dyshim se vetëm ata janë mendjelehtët. Në të vërtetë, mendjelehtët janë ata, sepse esenca e mendjelehtësisë është: injoranca e njeriut rreth gjërave që janë në dobi të tij dhe veprimi e ndjekja e gjërave që e dëmtojnë atë. Këto cilësi u shkojnë për shtat pikërisht munafikëve, pasi janë në përputhje të plotë me gjendjen dhe veprat e tyre.

Ndërsa mençuria e njeriut duket në njohjen e dobive dhe të mirave vetjake. Ajo duket, gjithashtu, në të punuarit pa u lodhur për të fituar dhe përvetësuar çdo gjë të dobishme për veten dhe për t'u larguar dhe shpëtuar nga çdo e keqe dhe rrezik që asaj i kanoset. Këto cilësi u shkojnë për shtat dhe janë në përputhje të plotë me gjendjen e sahabëve dhe të gjithë besimtarëve, si edhe me veprat e tyre.

Duhet kuptuar që pretendimet nuk merren në konsideratë, thjesht, për hir të fjalëve boshe dhe të menduarit sipërfaqësor. Ato merren në konsideratë vetëm nëse janë të bazuara në argumentim të fortë dhe analizë të hollë. I Lartësuari thotë:

Ajetet 14 – 15

14. Kur takohen me ata që besuan, thonë: "Ne besojmë". Por kur veçohen me shejtanët *(parinë)* e vet, u thonë: "Ne, pa dyshim, jemi me ju. Ne vetëm sa jemi tallur *(me besimtarët)*"
15. Allahu tallet me ta, duke i lënë të bredhin edhe më shumë në mosbesimin e tyre!

Shpjegimi i ajeteve

Ky është një shembull që tregon se si ata, si hipokritë që janë, thonë më gojë atë që nuk e ndiejnë në zemrat e tyre.

- "Kur takohen me ata që besuan, thonë: "Ne besojmë" - Kur ata mblidhen dhe kontaktojnë me besimtarët, shtiren se janë me ta dhe se ndjekin rrugën dhe besimin e tyre (të besimtarëve).

- "Por kur veçohen me shejtanët *(parinë)* e vet, u thonë: "Ne, pa dyshim, jemi me ju. Ne vetëm sa jemi tallur *(me besimtarët)*" - Porse kur ata veçohen e mënjanohen së bashku me "shejtanët", pra, me krerët dhe udhëheqësit e tyre në kufër, thonë: "Ne, në të vërtetë, jemi me ju, ndërsa me besimtarët thjesht po tallemi, duke u shtirur se jemi besimtarë dhe se ndjekim rrugën e tyre."

Kjo është gjendja e tyre e brendshme dhe e jashtme. Porse këto kurthe dhe mashtrime të poshtra godasin veçse vetë thurësit dhe gatuesit e tyre. I Adhuruari thotë:

- "Allahu tallet me ta" - Allahu tallet me ta dhe, duke i braktisur, i lë të bredhin edhe më shumë të çoroditur në mosbesimin e shfrenuar dhe në kalimin e kufijve. Kjo vjen si ndëshkim nga Allahu i Madhëruar, për shkak të talljes së tyre me adhuruesit e Tij.

Tallja e Allahut me ta bëhet në shumë forma. Ai tallet me ta duke e zbukuruar në sytë e tyre gjendjen dhe jetën e poshtër e fatkeqe që jetojnë. Madje, me injorancën e tyre, ata mendojnë se janë përshtatur mirë me besimtarët. Kur jeta dhe pasuritë e tyre bëhen të paprekshme, ata mendojnë se po shtiren shumë mirë si besimtarë.

Allahu i Madhëruar do të tallet me ta edhe në Ditën e Gjykimit, kur besimtarëve dhe munafikëve do t'u jepet dritë për të ecur mbi Sirat. Por, në momentin që besimtarët fillojnë të ecin të ndriçuar nga drita e tyre, drita që u është dhënë munafikëve shuhet dhe i lë ata të çoroditur në errësirën e plotë, pasi e kishin parë njëherë dritën me sy. Sa e hidhur duket shpresa e humbur, pasi e ke ndier njëherë aq pranë. Për këtë, Allahu i Madhëruar thotë: "Ditën kur i sheh besimtarët dhe besimtaret, sheh që drita e tyre ndriçon para tyre dhe në të djathtë të tyre. *(U thuhet:)* "Përgëzim për ju sot janë Xhenetet, nën të cilët rrjedhin lumenj. Aty do të jeni përgjithmonë. Kjo është ajo fitorja e madhe."

Ditën kur hipokritët dhe hipokritet u thonë atyre që besuan: "Na pritni *(ose na shikoni)*, që të ndriçohemi prej dritës suaj!" U thuhet: "Kthehuni pas *(në dynja)* dhe kërkoni ndonjë dritë!" Atëherë, ndërmjet tyre vendoset një mur, që ka një derë. Ana e brendshme e tij është mëshirë *(Xheneti)*, ndërsa ana e jashtme e tij është dënim *(Zjarri)*. Ata *(hipokritët e mbetur në errësirë)* u thërrasin atyre *(besimtarëve)*: "A nuk kemi qenë edhe ne së bashku me ju!?" – "Po *(përgjigjen besimtarët)*, por ju e shkatërruat veten *(me hipokrizi)*. Ju prisnit kob të zi për besimtarët, dyshonit në çështjet e fesë dhe u mashtruat nga jeta e dynjasë, deri kur ju erdhi caktimi i Allahut *(vdekja)*. Mashtruesi *(Shejtani)* ju mashtroi ju rreth Allahut. E sot prej jush nuk pranohet asnjë lloj kompensimi, e as prej atyre që nuk besuan. Zjarri është vendi juaj! Ai është i merituesshëm për ju. Sa përfundim i keq është ai!". [Hadidë, 12 – 15].

Më tej, Allahu i Lartësuar thotë:

- "...duke i lënë të bredhin edhe më shumë në mosbesimin e tyre" - Shprehja *'jemud-duhum"* do të thotë: ua shton edhe më shumë mundësitë vepruese, ose i lejon të vazhdojnë më thellë. Ku? Në ç`aspekt? Përgjigja: *'fi ṭuġjânihim'* – "në mosbesimin e tyre", pra: në tejkalimin e kufijve, me poshtërsi, kufër dhe mosbindje.

Fjala tjetër: "*Jea'mehûn*" domethënë: *'hallakaten të çoroditur'*. Ata hallakaten të çoroditur, të luhatur dhe gjithmonë të mbushur me mëdyshje dhe dyshime. Kjo është një formë talljeje, me të cilën Allahu i Madhëruar i 'shpërblen' ata.

Më pas, Allahu i Madhëruar, shfaq thelbin e gjendjes së tyre të vërtetë, duke thënë:

Ajeti 16

16. Ata të cilët e blenë humbjen, duke dhënë si çmim udhëzimin. Por tregtia e tyre nuk pati fitim dhe kurrë nuk qenë të udhëzuar drejt.

Shpjegimi i ajetit

- "Ata të cilët e blenë humbjen, duke dhënë si çmim udhëzimin" - "Ata" (*ulãike*), domethënë munafikët, të cilët kanë cilësitë e përmendura.


- "të cilët e blenë humbjen duke dhënë si çmim udhëzimin" - Pra, këta i kanë dhënë përparësi dhe kanë parapëlqyer humbjen, sikurse vepron dikush që dëshiron dhe i pëlqen të blejë një mall, dhe që është gati të paguajë çmimin më të lartë për ta patur atë mall. Ky krahasim është një nga më të bukurit që jep Allahu i Madhëruar, për të përshkruar gjendjen e munafikëve, të cilët e kanë konsideruar rrugën e humbjes si një mall të shtrenjtë dhe të vyer që duhet blerë, ndërsa, në të vërtetë, ajo është humbja më e skajshme dhe rruga më e frikshme e së keqes.

Ndërsa udhëzimin në rrugën e drejtë, që është suksesi dhe mirësia më e madhe që mund të ketë një njeri, ata e konsiderojnë si një çmim që mund të jepet për të arritur diçka tjetër "më të rëndësishme".

Me fjalë të tjera, ata pranojnë që të shesin udhëzimin, për të blerë humbjen, në shenjë parapëlqimi dhe vlerësimi për këtë të fundit. Kjo, pra, është tregtia e tyre e fëlliqur, dhe ky është 'fitimi' i tyre fatkeq.

- "Por tregtia e tyre nuk pati fitim"- Nëse ne do ta konsideronim të humbur dikë që këmben një dinar për të marrë një dirhem, çfarë do të thoshim për atë që jep një xhevahir për të fituar një dirhem?! Por për atë që, për hir të humbjes, shpenzon ose flak tutje udhëzimin e Allahut, duke treguar në këtë mënyrë se ai preferon trishtimin kundrejt lumturisë?!

Këta njerëz parapëlqejnë punët e ulta e të poshtra, kundrejt madhështisë dhe lartësisë së udhëzimit dhe bindjes (ndaj Allahut dhe Profetit a.s.). Kjo tregti nuk mund të jetë kurrë fitimprurëse; përkundrazi, humbja e tyre është e tmerrshme. Allahu thotë:



"Pikërisht këta janë ata të cilët do të humbin veten dhe familjet e tyre në Ditën e Gjykimit. Kjo është humbja e qartë." [El zumer 15].

- "Dhe kurrë nuk qenë të udhëzuar drejt" - Kjo fjali përforcon faktin se ata janë në humbje të sigurt dhe se kurrë ndonjëherë nuk kanë qenë të udhëzuar. Këto janë cilësitë e tyre të shëmtuara.

Allahu i Madhëruar na paraqet një tjetër anë të gjendjes së tyre, duke e qartësuar këtë me një shëmbëllim. Ai thotë:

Ajetet 17 – 20

17. Ata i përngjajnë dikujt që kërkon t'i ndizet një zjarr. Por, sapo ai *(zjarri)* e ndriçon vendin përreth, Allahu ua shuan dritën, dhe i lë mes errësirash, ku nuk shohin.

18. *(Ata janë)* Të shurdhër, memecë dhe të verbër, dhe kurrë nuk kthehen *(nga rruga e keqe).*

19. Ata, gjithashtu, i përngjajnë dikujt mes një shiu të rrëmbyer prej së larti, plot errësirë, me bubullimë e vetëtimë. Ata i vendosin gishtat në veshët e tyre prej frikës së vdekjes nga rrufeja. Allahu është rrethues i jobesimtarëve *(me dijen dhe pushtetin e Tij absolut mbi gjithçka)*

20. Vetëtima gati ua rrëmben shikimin. Sa herë që ajo u bën dritë, ata ecin në të, ndërsa kur errësohet, qëndrojnë të shtangur. E nëse do të donte, Allahu do t'ua merrte dëgjimin dhe shikimin e tyre. Allahu, pa dyshim, për çdo gjë është i Plotfuqishëm.

Shpjegimi i ajeteve

- "Ata i përngjajnë dikujt që kërkon t'i ndizet një zjarr." - Shembulli më i përshtatshëm që mund të jepet për gjendjen e tyre është ai i një personi që kërkon prej të tjerëve t'i ndezin një zjarr. Përfytyro një njeri që ka nevojë të madhe për të ndezur një zjarr, në errësirën e thellë në të cilën ndodhet, dhe këtë zjarr e kërkon nga dikush tjetër. E kërkon nga dikush tjetër, sepse ai vetë nuk ka lëndë për ta ndezur. Krijimi i këtij zjarri ndriçues është jashtë natyrës, zakonit dhe mundësive të tij.

- "Por, sapo ai e ndriçon vendin përreth..." - Për një moment, ai ndriçohet prej këtij zjarri, i cili i bën dritë gjithçkaje përreth tij. Kështu, atij i jepet mundësia të vështrojë qartë vendin ku ndodhet. Ky zjarr i ofron atij njëfarë qetësie prej çdo frike dhe ankthi që e rrethon. Duke përfituar prej tij, njeriu gjen një lloj prehjeje. Por pikërisht në atë moment, kur mendon se këtë zjarr e ka bërë pronë të tijën, nga e cila mund të përfitojë si të dojë:

- "Allahu ua shuan dritën dhe i lë mes errësirash, ku nuk shohin" – Pra, Allahu i Madhëruar e largon ndriçimin që jep ky zjarr, e bashkë me ndriçimin, edhe gëzimin e shkurtër që një njeri i tillë përjeton. Ai mbetet i vetmuar në errësirën e madhe të

zjarrit që djeg, pasi prej këtij zjarri largohet ndriçimi, por mbetet nxehtësia dhe aftësia djegëse. Atëherë, ai përhumbet e endet mes errësirave të pafund. Mbi të ngrihet e frikshme errësira e natës, errësira që krijojnë retë, errësira që krijon shiu dhe errësira e dëshpërimit, që vjen pas largimit të beftë të dritës. A mund ta përfytyrosh gjendjen e këtij të mjeri?!

E tillë është shëmbëlltyra e munafikëve. Ata kërkojnë prej muslimanëve zjarrin ndriçues të imanit, sepse për ta imani është një cilësi e huaj. Ata përfitojnë diçka nga ky zjarr, ndonëse është i ndezur nga tjetërkush. Me anë të këtij zjarri, ata sigurojnë paprekshmërinë e jetës e të pasurisë së tyre mes besimtarëve. Ky zjarr u jep njëfarë qetësie në jetën e dynjasë. Por pikërisht kur ata janë duke shijuar frytet dhe të mirat e mundit të tjetërkujt, ata i kap befas vdekja, e cila ua ndërpret atë përfitim të vagët prej dritës së besimtarëve. Pas takimit me vdekjen, ata i kaplon tërësisht ankthi, trishtimi dhe ndëshkimi i dhimbshëm. E kështu, ata do të provojnë tmerrin dhe shijen e hidhur të mohimit, të hipokrizisë dhe të çdo lloj poshtërsie tjetër, fillimisht në errësirën e varrit, dhe pastaj në errësirën e zjarrit të Xhehenemit, që do të jetë "vendprehja" e tyre e përjetshme.

Vëre me kujdes se si i përshkruan ata Allahu i Lartësuar, kur thotë se ata janë:

- "Të shurdhër, memecë dhe të verbër, - Ata janë të shurdhër kundrejt dëgjimit të çdo mirësie, janë memecë që nuk mund të flasin e të thonë kurrë fjalë të mira e të drejta, dhe janë të verbër për të parë të vërtetën e qartë.

- "...dhe kurrë nuk kthehen" - Ata nuk e ndërrojnë rrugën e tyre, për shkak se ata e kanë braktisur të vërtetën (dritën), pasi e kanë njohur njëherë atë. Kështu që, ata kurrë nuk kanë për të kthyer rrugë.

Ndryshe ndodh me dikë që është në humbje për shkak se nuk e njeh të vërtetën. Ky është më pranë udhëzimit, dhe shpresat e tij për t`u kthyer janë më të shumta.

Allahu i Madhëruar jep edhe një shembull tjetër për të qartësuar gjendjen e munafikëve, duke thënë:

- "Ata i përngjajnë dikujt, që ndodhet mes një shiu të rrëmbyer *(që bie)* prej së larti..." – Pra, rasti i tyre mund të ilustrohet edhe me një shembull tjetër: Me një njeri që ndodhet mes një shiu të dendur e të rrëmbyer, që bie nga qielli.

- "...plot errësirë dhe bubullima e vetëtima". – Domethënë, ai është i mbuluar nga errësira të shumta njëra mbi tjetrën: nga errësira e natës, nga errësira e reve dhe errësira e shiut.

- "...dhe bubullima"- Pra, ai dëgjon edhe oshtimën e frikshme të bubullimës, që buron nga retë.

- "...dhe vetëtima" - Ky njeri sheh herë pas here edhe dritën që shkreptin nga mesi i errësirave të reve. Në të tilla situata:

- "Ata i vendosin gishtat në veshët e tyre, prej frikës së vdekjes nga rrufeja". Ky është një përshkrim tjetër i gjendjes së munafikëve. Ata, kur dëgjojnë Kur'ânin, urdhrat dhe ndalesat e tij, premtimet dhe kërcënimet e përmendura në të, vendosin gishtat në veshë për të mos lejuar dëgjimin e tyre. Ata tmerrohen nga kërcënimet e Kur'ânit dhe i shqetëson çdo premtim që gjendet në të, prandaj ua kthejnë shpinën fjalëve të tij, duke e urryer shumë këtë gjendje. E tillë është edhe gjendja e njeriut në mes të shiut të rrëmbyer, që furishëm zbret nga qielli. Ai i zë veshët me gishta nga frika e vdekjes.

Por nëse për këtë të fundit shpresohet ndonjë mundësi shpëtimi, për munafikët nuk ka asnjë shans për të shpëtuar, sepse:

- "Allahu është rrethues i jobesimtarëve" - E si mund t`i shpëtojnë ata Allahut të Madhëruar e të Plotfuqishëm, i Cili është Gjithëpërfshirës dhe i Pashmangshëm, në aspektin e dijes dhe të pushtetit që ka mbi ta? Ata nuk mund t`i fshihen dijes dhe shikimit të Tij, ashtu sikurse nuk mund t'i shpëtojnë forcës dhe pushtetit të Tij absolut mbi gjithçka. Ai ua llogarit dhe ua regjistron të gjitha veprat atyre, dhe shpërblimin ka për t'ua dhënë të plotë.

Duke qenë se ata e meritojnë shurdhërinë, memecërinë dhe verbërinë ndaj udhëzimit, duke qenë se ata e meritojnë plotësisht që t'u mbyllën dyert e besimit para syve, atëherë Allahu i Madhëruar i kërcënon me një masë tjetër të dhimbshme, kur thotë:

- "Vetëtima gati ua rrëmben shikimin. Sa herë që ajo u bën dritë, ata nisin e ecin, e kur errësohet, qëndrojnë të shtangur. Nëse do të donte, Allahu do t'ua rrëmbente dëgjimin dhe shikimin e tyre." - Sikur të dëshironte Allahu i Madhëruar, Ai do t'ua hiqte edhe dëgjimin e shikimin fizik. Ky është kërcënim me një ndëshkim që mund të zbresë që në këtë jetë, para vdekjes. Pra, le të jenë më të kujdesshëm dhe më të përmbajtur me hipokrizinë dhe të keqen që ata shfaqin.

- "Allahu, për çdo gjë, është i Plotfuqishëm" - Të jeni të sigurt se Allahu është i Plotfuqishëm për gjithçka. Atij nuk i shpëton dot asgjë. Pushteti i Tij absolut i jep të drejtën dhe mundësinë që, nëse dëshiron diçka, e kryen, dhe askush nuk e kundërshton dhe nuk mund ta ndalojë Atë.

Në këtë ajet, dhe në të tjerë të ngjashëm me të, gjejmë një argument shumë të fuqishëm kundër një grupi të humbur e të devijuar, të quajtur *Kaderie*, të cilët pretendojnë se veprat e robit janë jashtë pushtetit të Allahut të Lartësuar (pra, nuk janë të nënshtruara dhe nën ndikimin e pushtetit të Tij). Ky ajet tregon qartë se edhe veprat e tyre futen te fjala e Allahut: '*In-nall-llâhe alâ kul-li shejin ḳadîr*' (Allahu, për çdo gjë, është i Plotfuqishëm).

Ajetet 21 - 22

21. O njerëz! Adhurojeni Zotin tuaj, i Cili ju krijoi ju dhe ata që ishin para jush! Kështu, pa dyshim, do të bëheni të devotshëm.
22. Ai, i Cili për ju, tokën e bëri shtrat *(vendbanim)* dhe qiellin kulm *(mburojë)*; *(është Ai)* që prej qiellit ju lëshon ujë, nëpërmjet të cilit ju siguron lloje frytesh, si furnizim për ju. Pra, përveç Allahut, askënd mos adhuroni, kur ju e dini!

Shpjegimi i ajeteve

- "O njerëz! Adhurojeni Zotin tuaj…" - Ky është një urdhër gjithëpërfshirës, që u drejtohet të gjithë njerëzve, për një çështje që, në kuptimin e saj, është po ashtu gjithëpërfshirëse. Kjo çështje, për të cilën urdhërohen të gjithë njerëzit është adhurimi (ose ibadeti). Ky term përfshin tri aspektet kryesore të adhurimit, që janë:
1. Zbatimi rigoroz i urdhrave të Allahut të Lartësuar.
2. Largimi nga të gjitha ndalesat e Tij.
3. Pranimi, pohimi dhe besimi i plotë dhe pa mëdyshje te çdo lajm e kumt i ardhur prej Allahut të Lartësuar.

Allahu Krenar e i Lartësuar i urdhëron njerëzit t'i përkushtohen asaj çështjeje, për hir të së cilës Ai i krijoi. Allahu i Madhëruar thotë në suren Dhariat, ajeti 56: "Unë i krijova xhindët dhe njerëzit veçse që të më adhurojnë".

Më poshtë, Allahu i Madhëruar shpjegon përse Ai duhet adhuruar si Një i vetëm, duke u përkujtuar dhe u qartësuar njerëzve se vetëm Ai është Zoti i tyre, i Cili kujdeset për ta, duke u mundësuar mirësi të pafundme.

- "…i Cili ju krijoi ju dhe ata që ishin para jush!" – Pra, Ai ju krijoi ju dhe të parët tuaj,

kur nuk ekzistonit fare; Ai ju solli në ekzistencë.

Por cili është qëllimi i këtij adhurimi? I Madhëruari thotë:

- "Kështu, pa dyshim, do të bëheni të devotshëm..." - Kjo frazë mund të kuptohet në dy mënyra:

1. Nëse ju ia kushtoni adhurimet tuaja veç Allahut, të Vetmit dhe Absolutit, ju do të jeni të ruajtur dhe të sigurt nga zemërimi dhe ndëshkimi i Tij, sepse keni vepruar pikërisht atë gjë që e largon nga ju zemërimin dhe ndëshkimin e Tij.

2. Nëse ju ia kushtoni adhurimet tuaja vetëm Allahut të Lartësuar e të Pashoq, ju jeni bërë të devotshëm e, sigurisht, ndër të shpëtuarit.

Të dyja kuptimet janë të sakta dhe, në fund të fundit, rrjedhin nga njëra-tjetra, sepse kush bën adhurim të pastër dhe të plotë veç për Allahun, është edhe i devotshëm, dhe kush është i devotshëm, sigurisht që ka shpëtuar prej zemërimit dhe ndëshkimit të Allahut të Lartësuar.

Më tej, i Madhëruari vazhdon të na tregojë mirësitë e Tij:

- "Ai, i Cili për ju, tokën e bëri shtrat *(vendbanim)*" – Kuptimi është: Mirësitë e Tij, të shfaqura apo të fshehta qofshin, vërshojnë pafundësisht e pandërprerë mbi ju. Ai e bëri tokën për ju të qëndrueshme dhe të qetë, si shtrat, që të sistemoheni dhe të gjeni prehje në të. Ju qëndroni të qetë në të, ndërtoni banesat tuaja, kultivoni ushqimet tuaja dhe nxirrni prej saj furnizimet e nevojshme për jetën. Mbi këtë tokë ndërtoni edhe rrugët ku ecni, për të përfituar nga të mirat e saj, e shumë e shumë të mira të tjera, të cilat i di Allahu i Lartësuar.

- "...dhe qiellin kulm *(mburojë)*"- Ndërsa qiellin, Allahu i Madhëruar e bëri si ndërtesë dhe fortesë mbrojtëse për vendqëndrimin tuaj, për tokën ku jetoni. Allahu i Madhëruar e mbushi këtë qiell me dobi të shumta, të cilat janë të domosdoshme për jetën tuaj në tokë dhe për vazhdimësinë e saj. A nuk e shihni diellin, hënën, yjet etj.?

- "...*(Ai)* që prej qiellit (*semãun*) ju lëshon ujë, nëpërmjet të cilit ju siguron lloje frytesh" - Çfarë quhet *semãun* (qiell)? *Semãun* quhet gjithçka që qëndron apo ekziston sipër teje. Për këtë arsye, shpjeguesit e Kur'ânit kanë thënë se me fjalën '*semãu*' këtu nënkuptohen retë, prej të cilave, Allahu i Madhëruar lëshon shiun.

- "...nëpërmjet të cilit ju siguron lloje frytesh" - Me anë të këtij uji, prodhohen shumë fryte të tokës. Me këtë ujë rriten dhe zhvillohen të gjitha prodhimet e tokës, duke filluar prej drithërave, frutave, perimeve, vreshtave, hurmave, agrumeve etj.

- "...si furnizim për ju" - Të gjitha këto mirësi Allahu i ka krijuar për ju, thjesht dhe vetëm që ju të ushqeheni dhe të përfitoni kënaqësi pas kënaqësish në këtë jetë, që po kaloni mbi tokë.

- "Pra, përveç Allahut, askënd mos adhuroni" – Pra, mos i përshkruani Allahut shokë e partner në adhurimin ndaj Tij. Mos i konsideroni asnjë si të ngjashëm, të njëjtë dhe të barabartë me Të. Mos merrni si të barabartë a të njëjtë me Allahun asgjë e asnjë prej krijesave, në asnjë këndvështrim. Nuk ka ndonjë krijesë që të jetë e barabartë apo e njëjtë me Allahun, dhe që të meritojë adhurimin tuaj. Asnjë krijesë nuk duhet adhuruar, por adhurohet vetëm Allahu. Asgjë nuk e meriton dashurinë tuaj, sikurse e meriton Allahu. E si mund të meritojnë krijesat adhurimin dhe dashurinë tuaj, kur ato, sikurse dhe ju, janë të krijuara, të nënshtruara, nevojtare në vetvete? Ato vetë kanë nevojë për furnizimin e Allahut. Ato nuk kanë asnjë grimcë të vogël pushteti, as në qiej e as në tokë, dhe nuk kanë asnjë lloj mundësie për t'ju sjellë juve dobi apo dëm.

- "...kur ju e dini" – Pra, mos i bëni këto gabime, kur ju e dini shumë mirë se Allahu i Madhëruar është Absolut dhe nuk ka të ngjashëm dhe të barabartë me Të, që të meritojë adhurimin tuaj.

Askush nuk mund t'i afrohet Madhështisë së Tij, as në aspektin e krijimit, furnizimit, administrimit dhe rregullimit të çështjeve të gjithësisë, dhe as në aspektin e merituesshmërisë së adhurimit dhe dashurisë së krijesave për Të. Atëherë, si është e mundur që ju adhuroni (dhe u shprehni dashurinë) zotave të tjerë, pas dijes dhe sigurisë që keni krijuar për çështjet e sipërpërmendura?! Kjo po, që konsiderohet si çudia e çudirave dhe si mendjelehtësi e papaparë.

Ky ajet përmban në vetvete disa çështje:

1. Urdhrin për të adhuruar një Zot të vetëm.

2. Ndalimin nga adhurimi i çdo gjëje tjetër veç Tij.

3. Ai është provë e qartë dhe e padiskutueshme, që vërteton detyrueshmërinë e adhurimit të Allahut të Madhëruar.

4. Ai dëshmon se çdo adhurim që kryhet dhe i përkushtohet dikujt tjetër veç Allahut, është i kotë dhe i pavlefshëm.

5. Në këtë ajet përmendet dhe vërtetohet *teuhidi rububije*, ose besimi se Allahu i Lartësuar është Unik, i Vetëm dhe Absolut, në aspektin e krijimit, furnizimit, administrimit dhe rregullimit të çështjeve të krijesave.

6. Ky ajet është ftesë për njerëzit që, ashtu sikurse ata pohojnë dhe janë të sigurt se Allahu i Lartësuar është i Vetëm, Unik, Absolut dhe i Pakrahasueshëm në aspektin e krijimit, furnizimit, administrimit dhe rregullimit të çështjeve të krijesave, në të njëjtën mënyrë duhet të pohojnë dhe të besojnë bindshëm, se ai është Unik, i Vetëm, Absolut dhe i Pakrahasueshëm edhe në aspektin e meritës së adhurimit. Ai është argumenti më i qartë logjik që, nga njëra anë, dëshmon unifikimin e Allahut në çdo aspekt dhe, nga ana tjetër, dëshmon kotësinë e adhurimit të të gjithë atyre që konsiderojnë si Zot dikë tjetër veç Allahut.

7. Ky ajet hedh poshtë shirkun, me të gjithë përmasat dhe format e tij.

Më pas Allahu i Madhëruar thotë:

Ajetet 23 – 24

23. Nëse jeni në dyshim rreth asaj që Ne ia shpallëm adhuruesit Tonë *(rreth Kur'ânit)*, atëherë paraqitni ju një kapitull të ngjashëm, si ai *(Kur'âni)*, madje i ftoni *(për ndihmë)* të gjithë zotat që ju adhuroni përveç Allahut, nëse vërtet jeni të sinqertë.

24. E në mos e paçit bërë *(deri tani)*, e as që do ta bëni kurrë *(edhe në të ardhmen)*, atëherë ruajuni Zjarrit, lënda djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët! Ai është përgatitur për jobesimtarët.

Shpjegimi i ajeteve

- "Nëse jeni në dyshim rreth asaj që Ne ia shpallëm adhuruesit Tonë..."- Allahu i Madhëruar u drejtohet këtu botës së atyre kryeneçëve, që janë rebeluar kundër profetëve, në përgjithësi. Ai u drejtohet atyre që refuzuan ftesën e Profetit të fundit, duke pretenduar se ai ishte mashtrues dhe trillues, duke u thënë: "Nëse ju, o kryeneçë, kundërshtarë dhe refuzues të Profetit, jeni në mëdyshje dhe të lëkundur në lidhje me atë çka Ne i shpallëm adhuruesit tonë (Muhamedit a.s); nëse nuk jeni të qartësuar a është ajo rruga e vërtetë apo ndonjë rrugë tjetër, atëherë ejani t'i japim zgjidhje kësaj çështjeje njëherë e mirë. Le ta zgjidhim këtë enigmë në mënyrë të qartë dhe të drejtë. Ky është Muhamedi (a.s). Ai është si ju, një njeri i thjeshtë. Nuk njihet si më oratori, dhe më i mençuri mes jush. Ju e njihni shumë mirë atë, sepse ai u rrit dhe u edukua mes jush. Ju jeni të sigurt që nuk di as shkrim, as këndim (lexim). Ky njeri pretendon që libri të cilin po jua paraqet, vjen dhe i shpallet prej Allahut. Ndërsa ju e refuzoni një fakt të tillë, duke mëtuar se ai vetëm shpif dhe trillon."

- "...atëherë paraqitni ju një kapitull të ngjashëm me të *(Kur'âni)*, madje ftojini *(për ndihmë)* të gjithë zotat që ju adhuroni përveç Allahut, nëse vërtet jeni të sinqertë" – Nëse vërtet jeni të sigurt në atë që thoni, sillni, pra, ju një kapitull, që t`i afrohet hijes së këtij libri. Madje, për këtë projekt, thirrni në ndihmë kë të doni e kë të mundni prej specialistëve të kësaj lëmie. Aq më tepër që ju njiheni si elita e elokuencës dhe krijimtarisë letrare. Aq më tepër që jeni ndezur zjarr nga urrejtja dhe armiqësia për këtë Profet. Nëse mund të krijoni një kapitull të vetëm (që t'i afrohet kësaj madhështie), atëherë pretendimi juaj qëndron.

- "E në mos e paçit bërë *(deri tani)*, e as që do ta bëni kurrë *(edhe në të ardhmen)*" - Por nëse ju dështoni, me plot kuptimin e fjalës, – dhe kurrë s'keni për t'ia arritur një diçkaje të tillë, se ky është thjesht një supozim, – atëherë kjo ka për të qenë një shenjë e madhe dhe e kthjellët, që tregon vërtetësinë e pretendimit të tij, që është Profet i Zotit të botëve. Kjo do të vërtetonte edhe saktësinë e shpalljes që i vjen nga Zoti.

E nëse profetësia e tij vërtetohet, atëherë bëhet detyrë për ju që ta besoni atë dhe që të zbatoni programin e jetës që atij po i shpallet. Nëse ju nuk e bëni realitet projektin tuaj, - që kurrë s'ka për t'u bërë realitet, - atëherë Allahu i Madhëruar ju kujton Zjarrin, nga i cili duhet të ruheni. I Madhëruari thotë:

- "...atëherë ruajuni Zjarrit, lënda djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët!" - Një zjarr i tillë nuk mund të ketë shembull në këtë jetë.

- "Ai është përgatitur për jobesimtarët". – Domethënë, ai është përgatitur për mohuesit: për ata që mohuan Allahun dhe që refuzuan profetët. Atëherë, duhet të jeni shumë të kujdesshëm kur ta mohoni atë, në momentin që ju jeni të sigurt se Muhamedi është Profeti i Allahut.

Ky ajet dhe të tjerë me të njëjtin kuptim si ai, quhen ndryshe edhe si "ajetet e sfidës". Me këto ajete sfidohen të gjitha krijesat, të cilat gjithmonë do të jenë të paafta për t`i bërë ballë kësaj sfide. Ato kurrë nuk do të mund ta përballojnë sfidën e Profetit të fundit, duke krijuar ndonjë vepër tjetër si Kur'âni, apo të ngjashëm e të përafërt me të. I Madhëruari thotë në suren Isra, ajeti 88: "Thuaj *(o Muhamed)*: "Sikur njerëzit dhe xhindet të bashkoheshin të gjithë bashkë, për të sjellë një vepër që mund t'i shëmbëllejë Kur'ânit, nuk do të mund t'ia arrinin kurrë të sillnin as shëmbëlltyrën e tij, edhe nëse do të ndihmonin dhe të bashkëpunonin të gjithë së bashku".

A ka logjikë që të pranojë se fjala e një krijese prej dheu mund t'i përngjasojë fjalës së Sunduesit dhe Mbretëruesit Absolut. Ku mund ta gjejë pushtetin, forcën dhe mundësinë i varfri e i nevojshmi nga çdo këndvështrim, që të sjellë një fjalë, që të jetë si fjala e Absolutit?! Ai (Kur'âni) është fjala e Madhështorit në çdo aspekt. Kjo pra, është jashtë logjikës dhe jashtë mundësisë njerëzore.

Çdokush që e njeh sadopak fjalën apo gjuhën, apo edhe stilistikën, nëse krahason madhështinë e këtij Kur'âni me fjalën e çdo artisti qoftë, do të zbulojë çudira.

Me fjalën e Allahut të Lartësuar: **"E në qoftë se jeni në dyshim rreth asaj që Ne ia shpallëm adhuruesit Tonë..."** e deri në fund, kuptojmë se për atë njeri që ka veç një lloj dyshimi a paqartësie që e pengon, ekziston shpresa e udhëzimit në rrugën e drejtë dhe e largimit nga rrugët e humbjes.

Ky njeri i çoroditur, i paqartë dhe i paaftë që të dallojë të vërtetën nga e gabuara dhe e kota, nëse i sqarohet e vërteta me argumente bindëse dhe nëse është i sinqertë në zbulimin e së vërtetës, ai ka shumë shpresa që të udhëzohet dhe të gjejë rrugën e drejtë.

Ndërsa kokëfortët e kryeneçët, nga ana tjetër, që e njohin të vërtetën dhe e braktisin atë, nuk mund të kthehen nga rruga e humbjes. Këta e braktisin dhe e shpërfillin të

vërtetën pasi e kanë njohur mirë atë dhe pasi janë siguruar plotësisht rreth saj. Këta janë të vetëdijshëm për veprat që kryejnë dhe për vendimet që marrin, prandaj nuk ka ndonjë mundësi që të kthehen dhe të shpëtojnë nga humbja ku janë zhytur.

Të njëjtën gjë themi edhe për atë që ka dyshime rreth të vërtetës dhe që nuk është i sinqertë në përpjekjet për ta zbuluar dhe për ta ndjekur këtë të vërtetë. Pra, edhe ky lloj njeriu, vështirë se mund të ketë sukses në gjetjen e rrugës së drejtë dhe në pasimin e saj.

Përshkrimi i Profetit (s.a.u.s) nga Allahu i Madhëruar me cilësinë e adhuruesit, kur thotë: *"alâ abdinâ"* **- "adhuruesit Tonë",** na jep një mësim shumë të rëndësishëm. Përmendja e kësaj cilësie, pikërisht në këtë moment madhështor të sfidës, tregon se ajo ishte cilësia më e vyer dhe më e lartë që mundi të arrinte Profeti (s.a.u.s).

Pejgamberi (s.a.u.s.) e arriti atë gradë të lartë, të cilën nuk e kishte arritur askush nga të parët dhe as nga të fundit, pikërisht me adhurimet që ia përkushtoi Allahut të Lavdëruar.

Me të njëjtën cilësi e ka përshkruar Allahu i Madhëruar Pejgamberin (s.a.u.s.) edhe në momentin kur flet për natën e Israsë, në suren Isra, ajeti 1: "Pa të meta është Lartmadhëria e Atij, që adhuruesin e Vet (*Muhamedin a.s.)* e zhvendosi në një pjesë të natës, prej Xhamisë së Shenjtë *(të Qabes)* drejt Xhamisë Aksa *(në Palestinë),* rrethinën e së cilës Ne e kemi bekuar, për t'i treguar atij disa nga argumentet Tona. Vërtet, Ai është Dëgjuesi dhe Vështruesi." Po kështu e ka cilësuar edhe në momentet kur flitet për zbritjen e Shpalljes: "Është i Madhëruar Ai, që ia shpalli Furkanin (*Kur'ânin)* adhuruesit të vet *(Muhamedit)*, që të bëhet Profeti i botës *(kështillues)"* [Furkanë, 1].

Fjala e Allahut të Madhëruar rreth Xhehenemit: **"Ai është përgatitur për jobesimtarët",** si dhe ajete të ngjashme me të, dëshmon për disa çështje:

1. Ky ajet është mbështetje e mendimit të pasuesve të Sunetit dhe Xhematit, të cilët besojnë se Xheneti dhe Zjarri janë të krijuar tashmë, ndryshe nga ç'mendojnë mutezilët.
2. Ky ajet tregon se muslimanët që e besojnë Allahun si Një të vetëm, edhe nëse kryejnë ndonjë gjynah të madh, nuk kanë për të qëndruar përjetësisht në Zjarr. Nëse muslimanët gjynahqarë do të qëndronin në Zjarr përjetësisht, atëherë do të ishte gabim të thuhej që: "është përgatitur për jobesimtarët", pra, që Zjarri është përgatitur (si vendqëndrim i përhershëm) vetëm për qafirët. Ky është edhe mendimi i pasuesve të Sunetit dhe Xhematit, ndryshe nga ç'mendojnë huarixhët dhe mutezilët. Ky ajet argumenton edhe faktin se ndëshkimi bëhet i merituesëm nga shkaqe të ndryshme. Shkak për ndëshkim mund të jetë kufri (mohimi i Zotit), por dhe të gjitha poshtërsitë e gjynahet, në larmishmërinë e tyre.

Ajeti 25

25. Përgëzoji ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, se do të kenë xhenete, në të cilat rrjedhin lumenj. Sa herë që u jepet ndonjë ushqim nga frutat e tij, ata thonë: "Me të tilla mirësi jemi furnizuar edhe më parë". Atyre u dhurohen mirësi të ngjashme. Atje do të kenë bashkëshorte të pastra. Ata do të jenë atje *(në Xhenet)* përjetësisht.

Shpjegimi i ajetit

Allahu i Madhëruar, pasi përmend ndëshkimin e atyre që refuzojnë besimin tek Ai, vijon me shpërblimin e besimtarëve, që e shoqërojnë besimin me vepra të mira. Kjo është një mënyrë tërheqëse dhe e urtë, që Allahu i Madhëruar e përdor në të gjithë Kur'ânin. Ai përmend njëra pas tjetrës shpërblimin dhe kërcënimin, me qëllim që robi të përjetojë vazhdimisht edhe shpresën, edhe frikën ndaj Krijuesit.

Allahu i drejtohet Profetit (s.a.u.s) dhe çdokujt që kryen misionin e tij, si dijetarët, thirrësit në fe etj., duke u thënë që:


- "Përgëzoji ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira..." – Pra, përgëzo ata që besojnë me zemrën dhe me gjuhën e tyre, dhe bëjnë vepra të mira me gjymtyrët e tyre, domethënë ata që vërtetojnë me punë të mira, atë që e besojnë me zemër dhe e shprehin me gojë.

Allahu i Madhëruar i ka cilësuar veprat e mira, të cilat janë treguese të imanit, duke përdorur fjalën "*ŝâlihât*", që do të thotë "përmirësues, rregullues". Ai ka përdorur këtë fjalë, sepse vepra të tilla bëhen shkak që gjendja e adhuruesit të rregullohet dhe të përmirësohet hap pas hapi. Me të tilla punë rregullohen dhe përmirësohen çështjet e kësaj jete dhe të jetës tjetër, që do të kalojë besimtari. Me të tilla punë zbukurohet jeta e kësaj bote dhe jeta e amshuar. Me të tilla punë largohen nga besimtari të gjitha gjendjet dhe cilësitë e këqija, dhe ai bëhet i denjë që të llogaritet mes të mirëve. Këta të mirë (*ŝâlihîn*) janë pikërisht ata, që do të meritojnë të qëndrojnë dhe të shijojnë lumturinë pranë Mëshiruesit, në xhenetet që Ai ka përgatitur. Allahu i Lartësuar urdhëron dhe thotë që përgëzoini ata se:

- "...se do të kenë xhenete..." – Domethënë, do të kenë kopshte me bimë dhe pemë të çuditshme, me fruta të këndshme dhe hije të gjera. Degët e pemëve dhe bimët kacavjerrëse që gjarpërojnë në to, bëjnë që këto kopshte të quhen "*xhennâtin*", që do të thotë: "*diçka e fshehur*", pasi në to, për shkak të dendësisë së bimësisë dhe të pemëve të shumta, banorët e lumtur lëvizin pa u dukur. Kush do të hyjë në to, do të përjetojë gëzimin dhe lumturinë e asaj jete.

Një bukuri tjetër që ndodhet dhe që shijohet në këto xhenete është edhe ekzistenca e lumenjve që rrjedhin në to. Allahu i Lartësuar thotë:

- "në të cilët rrjedhin lumenj". – Pra, në këto kopshte rrjedhin lumenj. Këta lumenj janë të llojeve të ndryshme: lumenj prej uji,


الجزء الأول سورة البقرة
وَبَشِّرِ ٱلَّذِينَ ءَامَنُوا۟ وَعَمِلُوا۟ ٱلصَّٰلِحَٰتِ أَنَّ لَهُمْ جَنَّٰتٍ
تَجْرِى مِن تَحْتِهَا ٱلْأَنْهَٰرُ ۖ كُلَّمَا رُزِقُوا۟ مِنْهَا مِن ثَمَرَةٍ
رِّزْقًا قَالُوا۟ هَٰذَا ٱلَّذِى رُزِقْنَا مِن قَبْلُ ۖ وَأُتُوا۟ بِهِۦ مُتَشَٰبِهًا ۖ
وَلَهُمْ فِيهَآ أَزْوَٰجٌ مُّطَهَّرَةٌ ۖ وَهُمْ فِيهَا خَٰلِدُونَ ﴿٢٥﴾ إِنَّ
ٱللَّهَ لَا يَسْتَحْىِۦٓ أَن يَضْرِبَ مَثَلًا مَّا بَعُوضَةً فَمَا فَوْقَهَا ۚ فَأَمَّا
ٱلَّذِينَ ءَامَنُوا۟ فَيَعْلَمُونَ أَنَّهُ ٱلْحَقُّ مِن رَّبِّهِمْ ۖ وَأَمَّا
ٱلَّذِينَ كَفَرُوا۟ فَيَقُولُونَ مَاذَآ أَرَادَ ٱللَّهُ بِهَٰذَا مَثَلًا ۘ
يُضِلُّ بِهِۦ كَثِيرًا وَيَهْدِى بِهِۦ كَثِيرًا ۚ وَمَا يُضِلُّ بِهِۦٓ
إِلَّا ٱلْفَٰسِقِينَ ﴿٢٦﴾ ٱلَّذِينَ يَنقُضُونَ عَهْدَ ٱللَّهِ مِنۢ بَعْدِ
مِيثَٰقِهِۦ ۚ وَيَقْطَعُونَ مَآ أَمَرَ ٱللَّهُ بِهِۦٓ أَن يُوصَلَ وَيُفْسِدُونَ
فِى ٱلْأَرْضِ ۚ أُو۟لَٰٓئِكَ هُمُ ٱلْخَٰسِرُونَ ﴿٢٧﴾ كَيْفَ
تَكْفُرُونَ بِٱللَّهِ وَكُنتُمْ أَمْوَٰتًا فَأَحْيَٰكُمْ ۖ ثُمَّ يُمِيتُكُمْ
ثُمَّ يُحْيِيكُمْ ثُمَّ إِلَيْهِ تُرْجَعُونَ ﴿٢٨﴾ هُوَ ٱلَّذِى خَلَقَ
لَكُم مَّا فِى ٱلْأَرْضِ جَمِيعًا ثُمَّ ٱسْتَوَىٰٓ إِلَى ٱلسَّمَآءِ
فَسَوَّىٰهُنَّ سَبْعَ سَمَٰوَٰتٍ ۚ وَهُوَ بِكُلِّ شَىْءٍ عَلِيمٌ ﴿٢٩﴾
٥

prej qumështi, prej mjalti apo prej pijesh të këndshme. Këta lumenj burojnë dhe shpërthejnë kudo ku besimtarët i kërkojnë dhe i dëshirojnë. Besimtarët e drejtojnë rrjedhën e këtyre lumenjve ku të dëshirojnë, dhe prej tyre ujitet e gjithë bimësia e xhenetit, për të gëluar me plot fruta të këndshme e të shumëllojëshme.

- "Sa herë që u jepet ndonjë ushqim nga frutat e tij, ata thonë: "Me të tilla mirësi jemi furnizuar edhe më parë" - Sa herë që ata furnizohen me ndonjë frutë prej Xhenetit, thonë: "Këtë furnizim e kemi përjetuar edhe më parë", domethënë: Këto fruta janë të të njëjtit lloj dhe cilësi. Të gjitha janë të njëllojshme për sa i përket pamjes së këndshme dhe shijes së mrekullueshme.

Nuk do të ketë ndonjë frutë që do të qëndrojë poshtë të tjerëve nga cilësitë, dhe nuk do të ketë moment që ata ta kalojnë pa shijuar dhe pa përjetuar kënaqësi në shijimin e këtyre frutave.

- "Atyre u dhurohen mirësi të ngjashme *(për nga bukuria dhe madhështia e tyre)*" - Disa thonë që kuptimi këtu është se ushqimet janë të ngjashme në emrat e tyre, por të ndryshme në shije. Disa thonë që janë të ngjashme në ngjyrë, por të ndryshme në emërtimet e tyre. Të tjerë thonë që ato janë të ngjashme me njëra-tjetrën në pamjen e tyre të bukur dhe në shijen e kënaqësinë që sjellin. Ndoshta ky shpjegimi i fundit është më i saktë për t'u pranuar.

Allahu i Madhëruar, pasi flet për vendqëndrimet e tyre, vijon më tej me gratë e besimtarëve, të cilat i përshkruan me cilësinë më të goditur, më përmbledhëse, më të shkurtër dhe më të qartë, duke thënë:

- "Atje do të kenë bashkëshorte të pastra" - Allahu i Lartësuar, përsosmërinë e bashkëshorteve të besimtarëve e jep me cilësinë "të pastra". Fjala "*mutahherah*" (të pastra) është në trajtën e pashquar (në arabisht), dhe kjo të jep të kuptosh se pastërtia e tyre nuk është e përcaktuar ose e kufizuar vetëm në këtë apo atë aspekt. Allahu i Lartësuar nuk ka thënë që ato janë të pastra dhe të ruajtura nga ajo apo kjo mangësi. Kjo, pa dyshim, është bërë me qëllim që fjala të përfshijë të gjitha dimensionet e pastërtisë dhe përsosmërisë së atyre grave. Ato janë të pastra dhe të përsosura në aspektin e moralit të tyre, të fizikut, të fjalëve që thonë, të vështrimeve që dhurojnë etj.

Nëse flasim për moralin dhe sjelljen e tyre, ato janë thellësisht shprehëse që në pamjen e tyre. Pamja e tyre shpreh thellë dashurinë për burrat e tyre. Megjithatë, këtë dashuri ato dinë ta shprehin jo vetëm me pamje, por edhe me mënyra të tjera: si me sjelljen apo me moralin e tyre.

Të këndshme janë fjalët e bukura dhe të ëmbla që ato u përcjellin burrave të tyre. Ato kanë një edukatë të shkëlqyer fjalësh dhe veprimesh, që i kënaqin pa masë burrat e tyre.

Fiziku i tyre është, gjithashtu, i pastër nga çdo lloj mangësie e dobësie, siç mund të jenë menstruacionet, lehonia, jashtëqitjet e çdo lloj sekrecioni i pështirë. Ato janë të pastra nga çdo lloj arome e pakëndëshme. Fiziku i tyre është i përsosur dhe me bukuri të rrallë. Edhe sikur t'i hetosh me vëmendje, nuk do të gjesh tek ato asnjë mangësi apo shëmtim. Ato janë të mirat, të bukurat. Ato janë të pastra në fjalët që thonë dhe në vështrimet që dhurojnë. Ato, me vështrimet e përqendruara te burrat e tyre, tregojnë se janë të mahnitura pas tyre dhe kurrë nuk thonë fjalë të shëmtuara.

Në këtë ajet janë përmendur: përgëzuesi, i përgëzuari, përgëzimi dhe shkaku i përgëzimit. Kështu, përgëzuesi është Profeti dhe kushdo që kryen misionin e tij, nga pjesëtarët e këtij umeti. Të përgëzuar janë besimtarët që bëjnë vepra të mira. Përgëzime janë xhenetet e përshkruara, me cilësitë e lartpërmendura. Kurse shkaku që bën të mundur të fitohet ky përgëzim është besimi i shoqëruar me vepra të mira.

Nuk ka asnjë mundësi përgëzimi pa iman dhe pa vepra të mira. Ky është përgëzimi më i madh i bërë nëpërmjet më të mirit të krijesave, që arrihet me mjetin më të shkëlqyer.

Ajeti tregon se është e pëlqyeshme të përgëzosh besimtarët dhe të bëhesh shkak që ata të motivohen për vepra të mira, duke iu përkujtuar shpërblimin që i pret. Veprat e mira bëhen më të thjeshta dhe më të dashura kur përkujton shpërblimin e Allahut. Përgëzimi më i madh që përjeton njeriu në këtë jetë është suksesi që i jepet atij për të besuar dhe për të bërë vepra të mira.

- "Ata do të jenë atje përjetësisht". - Pas përgëzimit të mësipërm, vjen përgëzimi në momentin e vdekjes dhe, pas vdekjes, vjen takimi me mirësitë e përjetshme, të premtuara nga Allahu i Madhëruar. E lus Allahun e Lartësuar që të na bëjë edhe neve prej të përgëzuarve. I Lartësuari thotë:

Ajetet 26 – 27

26. Allahu nuk ngurron që të marrë çfarëdo shembulli, qoftë ajo mushkojë a diçka edhe më e imët se ajo. Për sa u përket atyre që besojnë, ata e dinë se ai *(shembull)* është "e vërteta" nga Zoti i tyre. Ndërsa ata të cilët mohojnë do të thonë: "Ç'deshi Allahu me këtë si shembull?" Ai me atë *(shembull)* humb shumë, e po me të, udhëzon në rrugën e drejtë shumë, por, në të vertetë, Ai nuk humb askënd tjetër, përveç të shfrenuarve *(që i kalojnë kufijtë);*
27. ata të cilët e thyejnë besën e dhënë Allahut, pasi ajo është lidhur. Ata e shkëpusin atë *(lidhje)* që Allahu ka urdhëruar të jetë e vazhdueshme, dhe në tokë mbjellin shkatërrimin. Pikërisht ata janë të dështuarit *(që humbën gjithçka)*.

Shpjegimi i ajeteve

- "Allahu nuk ngurron që të marrë çfarëdo shembulli, qoftë ajo mushkojë a diçka edhe më e imët se ajo." – Kjo, pasi shembujt që sillen në Kur'ân janë plot urtësi dhe për të qartësuar të vërtetën. Allahu i Lartësuar nuk ngurron, ose nuk druhet, që të shfaqë të vërtetën. Me sa duket, ky ajet vjen si përgjigje ndaj atyre që i nënvlerësojnë të tillë shembuj dhe nuk u duket e drejtë sjellja në Kur'ân e këtyre shembujve rreth gjërave të imta e të parëndësishme (në dukje). Këta njerëz sikur kundërshtojnë Allahun në këtë aspekt. Por ky lloj kundërshtimi nuk është i drejtë dhe as me vend. Madje, me shembuj të sjellë, Allahu i Lartësuar kërkon të mësojë adhuruesit e Tij, dhe kjo është shprehje e mëshirës së Tij për ta. Për këtë arsye, këto shembuj duhen pranuar dhe për ta duhet shprehur mirënjohje e lavdërim.

Për këtë arsye, Allahu i Lartësuar thotë:

- "Për sa u përket atyre që besuan, ata e dinë se ai *(shembull)* është "e vërteta" nga Zoti i tyre" – Besimtarët, kur u vjen ndonjë shembull nga Allahu i Lartësuar, thellohen dhe meditojnë rreth tij, në mënyrë që ta kuptojnë atë. Nëse arrijnë të zbulojnë dhe të kuptojnë urtësitë e fshehura shembujt e dhënë, në mënyrë të shtjelluar dhe imtësisht, atyre u shtohet dija dhe besimi. Por, edhe nëse nuk mundet të kuptojnë imtësisht gjithçka, ata janë të sigurt dhe e dinë mirë se kjo është e vërtetë e sigurt e sjellë nga Zoti i tyre. Madje, ata besojnë se urtësitë e fshehura në këtë shembull të sjellë, janë të vërteta dhe të padiskutueshme, edhe nëse nuk e dinë me hollësi se cilat janë këto imtësi. Ata janë të sigurt në diçka. Allahu i Lartësuar nuk i ka sjellë këto shembuj kot, por për urtësi të shumta e të dobishme. Ai i ka sjellë, me qëllim që krijesat të përfitojnë dije dhe përvojë.

- "...ndërsa ata të cilët mohuan do të thonë: "Ç'deshi Allahu me këtë si shembull?" – Ata, duke kundërshtuar dhe shpërfillur këto shembuj, tregojnë çoroditjen e tyre. Këto shembuj të sjellë e shtojnë edhe më shumë mohimin në zemrat e tyre, sikundër besimtarëve u shtojnë dijen dhe besimin.

Prandaj Allahu i Lartësuar thotë:

- "Ai, me atë *(shembull)* humb shumë *(njerëz nga rruga e drejtë)*, e po me të, udhëzon shumë." - Kjo qe gjendja e besimtarëve dhe e qafirëve në momentin e zbritjes së ajeteve të Kur'ânit. Allahu i Lartësuar thotë: "Dhe kur zbret ndonjë kapitull *(prej Kur'ânit)*, ka prej tyre që thonë: "Cilit prej jush ia shtoi besimin kjo *(sure e shpallur)*?" Atyre që besuan u shtohet besimi dhe gëzohen për të. Ndërsa atyre që në zemrat e tyre kanë sëmundje, ajo, ndytësisë së tyre ua shton *(më shumë)* ndytësinë, dhe ata vdesin si jobesimtarë." [Teube 124,125].

Nuk ka mirësi më të madhe për adhuruesit sesa zbritja e ajeteve kuranore. E, megjithatë, këto ajete, për disa bëhen sprovë dhe çoroditje (humbje). Ato ua shtojnë të keqen mbi të keqen që i pushton, ndërsa për disa të tjerë është mëshirë dhe shtim i të mirave, mbi të mirat që pandërprerë i përjetojnë.

I lartësuar dhe i lavdëruar qoftë Ai, që dalloi kë dëshiroi prej krijesave të Tij. Ai është i Vetmi që ka pushtetin të të udhëzojë në rrugën e drejtë dhe i Vetmi që nëse të lë në humbje, askush nuk mund të të udhëzojë.

Me pas, Allahu i Madhëruar tregon shkakun e humbjes së atyre të cilët devijuan duke shpjeguar se kjo është drejtësia e Tij. Thotë i Madhëruari:

- "Por në të vertetë, *(me atë shembull)*, Ai nuk humb askënd tjetër, përveç të shfrenuarve *(fâsiḳîn)*." – *"Fâsiḳîn"* domethënë: ata që janë larg bindjes ndaj Allahut dhe mohues të rreptë të rrugës së profetëve të Allahut. Të humburit janë ata të cilët janë të qëndrueshëm e të pandryshueshëm nga këto cilësi dhe baza të tyre. E pra, urtësia e Allahut e ka përcaktuar që këta njerëz, për shkak se nuk e meritojnë udhëzimin e Tij, të mbeten në humbje, ashtu sikundër, po me urtësinë e Tij, Ai e ka përcaktuar që të udhëzojë ata që i japin përparësi imanit dhe bëjnë punë të mira.

Fisḳ-u (shfrenimi) është dy llojesh:

1. *Fisk* që të nxjerr prej fesë, domethënë të cilësuarit me të nuk kanë iman, sikurse është rasti në këtë ajet.

2. *Fisk* që nuk të nxjerr nga feja (nuk të bën jobesimtar), sikurse shfaqet në fjalën e Allahut, në suren Huxhuratë: "O ju që keni besuar! Nëse ndonjë *fâsiḳ* ju sjell ndonjë lajm, sigurohuni rreth atij lajmi…"

Më poshtë, Allahu i Madhëruar i përshkruan këta *fasik*-ë (jobesimtarë), duke thënë:

- "…ata të cilët e thyejnë besën e dhënë Allahut, pasi ajo është lidhur" - Kjo besë është dy llojesh: besë e lidhur mes tyre dhe Allahut të Lartësuar, dhe besë e lidhur mes tyre dhe njerëzve të tjerë. Kjo e fundit dokumentohet dhe regjistrohet me elementë të shumtë sigurie. E, sidoqoftë, *fasik*-ët nuk pyesin fare për kontratat dhe marrëveshjet e bëra. Ata i shkelin dhe i thyejnë si marrëveshjet që kanë me Krijuesin, ashtu dhe marrëveshjet me krijesat. Ata shpërfillin urdhrat dhe ndalesat e marra nga Krijuesi, ashtu siç shpërfillin të drejtat e krijesave dhe marrëveshjet me ta. Përveç kësaj:

- "Ata e shkëpusin atë (lidhje), që Allahu ka urdhëruar të jetë e vazhdueshme" - Këto lidhje, për të cilat Allahu i Lartësuar ka urdhëruar që të ruhen, janë të shumta. Allahu i Madhëruar na ka urdhëruar që, së pari, të mbajmë të paprekur e të vazhdueshme lidhjen mes nesh dhe Tij, duke forcuar besimin në fe dhe duke i shprehur Atij adhurimet tona në mënyrë të përsosur dhe me përkushtim.

Ai na ka urdhëruar që të mbajmë të forta, lidhjet me Profetin e Tij. Lidhjet me të mbahen duke e besuar atë, duke e ndihmuar atë (dhe fenë e tij) , duke respektuar urdhrat e tij dhe duke i dhënë hakun e tij, në çdo aspekt.

Ai na ka urdhëruar që të mbajmë lidhjet me prindërit tanë, me të afërmit, miqtë dhe me të gjitha krijesat, duke u dhënë atyre hakun, sipas dispozitave të vendosura nga Allahu i Madhëruar. Të gjitha këto lidhje duhet t`i mbajmë të forta dhe të paprekshme.

Besimtarët i mbajnë fort të gjitha ato lidhje për të cilat i ka urdhëruar Allahu i Madhëruar, duke i dhënë hakun çdo aspekti, në formën më të përsosur dhe më të bukur. Ndërsa *fasik*-ët ndërpresin dhe shkatërrojnë çdo lidhje dhe harmoni, në gjithçka që i rrethon, duke shkelur me këmbë të drejtat e të gjithëve, me shfrenimin e tyre dhe me veprat e shëmtuara që bëjnë. Veprat e tyre quhen ndryshe edhe: 'shkatërrim i tokës'. Allahu i Lartësuar e përkufizon krimin e tyre me fjalët:

- "…dhe në tokë mbjellin shkatërrimin". - Përfundimi i të tillëve është i qartë:

- "Pikërisht ata janë të dështuarit *(që humbën gjithçka)*" – Këta që u përshkruan

deri tani, janë të dështuarit dhe të humburit, qoftë në dynja, qoftë edhe në ahiret.

Allahu i Madhëruar e ka kufizuar dështimin dhe humbjen vetëm për këta lloj njerëzish, sepse dështimi i tyre është i gjithanshëm. Ata nuk kanë asnjë lloj suksesi, pasi çdo vepër e mirë (që sjell fitim e sukses), për të qenë e tillë, ka si kusht imanin. Pra, ai që nuk ka iman, nuk ka të llogaritshme as vepra të mira. Ky është dështimi dhe humbja që sjell mungesa e imanit.

Dështimi dhe humbja mund të shkaktohen ose nga kufri, ose nga gjynahet dhe gabimet, ose nga neglizhenca e treguar ndaj veprave të pëlqyeshme. Në këtë dështim dhe humbje mund të përfshihen të gjitha krijesat, përveç atyre që gëzojnë katër tipare:

1. ata që besojnë;
2. që bëjnë vepra të mira;
3. që këshillojnë njeri-tjetrin për të drejtën;
4. që këshillojnë njëri-tjetrin për durim, siç thotë i Madhëruari thotë në suren Asr: "Pasha kohën! Nuk ka dyshim se njeriu është në një humbje të sigurt. Me përjashtim të atyre që besojnë, që bëjnë vepra të mira, që porositin njëri-tjetrin t'i përmbahen të vërtetës dhe që e këshillojnë njëri-tjetrin për të qenë të durueshëm".

Me fjalë të tjera, shkaktari kryesor i humbjes dhe i dështimit qëndron në mosrealizimin e atyre mirësive, për të cilat adhuruesi i ka plotësisht mundësitë që t`i realizojë. Ndërsa pasoja e dështimit është mosarritja e asaj gjëje që është brenda mundësive për t'u arritur.

Ajetet 28 – 29

28. Si e mohoni Allahun, kur *(dihet se)* ju ishit të vdekur, e Ai ju dha jetën. Mandej, Ai ju bën të vdisni, e pastaj ju ringjall përsëri; e më pas *(përfundimisht)*, tek Ai do të ktheheni.
29. Gjithçka që ka në tokë, Ai *(Allahu)* e krijoi për ju, pastaj *(me pushtetin e Tij)* iu drejtua qiellit. Ai i përsosi ata shtatë qiej. Ai, për çdo gjë, është i Gjithëdijshmi.

Shpjegimi i ajeteve

- "Si e mohoni Allahun, kur *(dihet se)* ju ishit të vdekur, e Ai jua dha jetën" - Kjo është një pyetje retorike, që tregon një ndjenjë habie dhe qortimi njëkohësisht. Si është e mundur pra, që ju të mohoni Allahun, i Cili ju krijoi pasi nuk ekzistonit?! Ai ju dhuroi, gjithashtu, edhe një larmi të pafundme mirësish.

- "Mandej, Ai ju bën të vdisni, e pastaj ju ringjall përsëri. E më pas *(përfundimisht)*, tek Ai do të ktheheni?" - Më pas, në momentin kur afati juaj do të jetë plotësuar, Ai do ju sjellë vdekjen, për t'ju dhënë shpërblimin e veprave që kryet në këtë jetë, që në momentin kur hyni në varr. Pastaj, Ai do t'ju ringjallë në Ditën e Ringjalljes dhe të Grumbullimit të Madh, për t'u rikthyer sërish tek Ai dhe për ta marrë të plotë shpërblimin e veprave tuaja. E pra, ju jeni (në të gjitha gjendjet) nën administrimin, përkujdesjen dhe bamirësinë e Tij. Ju jeni të detyruar t`i nënshtroheni urdhrave dhe ligjit të Tij hyjnor, se pastaj do t`i nënshtroheni llogarisë dhe shpërblimit, sipas zbatimit të ligjit dhe urdhrave të Tij.

Si është e mundur që, pas gjithë këtij informacioni, ju ta mohoni Atë? A nuk tregon kjo një injorancë të thellë dhe mendjelehtësi të pamatë? Kështu që, më e mira për ju është besimi te Zoti devotshmëria ndaj Tij. Ju duhet të jeni të frikësuar prej ndëshkimit dhe të shpresoni fort shpërblimin e Tij.

- "Gjithçka që ka në tokë, Ai *(Allahu)* e krijoi për ju" – Komenti: Ai i krijoi këto të mira si bamirësi dhe mëshirë për ju, që të përfitoni prej tyre, të kënaqeni me to, dhe të nxirrni mësime e urtësi.

Ky ajet madhështor është argument që vërteton se gjërat, në origjinë, janë të pastra dhe të lejuara. Gjërat konsiderohen në origjinë si të pastra, sepse Allahu i Madhëruar i ka sjellë ato si dëshmi për të

treguar mirësitë e Tij. Përjashtim bëjnë vetëm gjërat e pista dhe të dëmshme, të cilat po nëpërmjet këtij ajeti kuptohet që janë të tilla. Kjo kuptohet nga i njëjti ajet, sepse ai tregon që shkaku i krijimit të këtyre gjërave, me të cilat Ai na tregon mirësinë dhe mëshirën e Tij, është që ne të përfitojmë dhe të kënaqemi. Ndërsa gjërat që nuk i ka krijuar për këtë qëllim, Ai i ka konsideruar të pista dhe na ka ndaluar nga ato. Me fjalë të tjera: Allahu i Lartësuar nuk mund të sjellë si prova të mirësisë dhe mëshirës së Tij, gjërat e pista dhe të dëmshme. Edhe ndalesat që Allahu i Madhëruar na ka bërë, kanë si qëllim mirësinë dhe mëshirën ndaj nesh. Pra, si në gjërat e lejuara, që janë shumë, ashtu edhe në gjërat që na i ka ndaluar, Allahu i Madhëruar tregon ndaj nesh mirësinë dhe mëshirën e Tij, duke na udhëzuar për të mira dhe duke na ndaluar nga të këqijat.

- "...pastaj iu drejtua qiellit" - Fjala *'isteuã'* në Kur'ân vjen me tri kuptime, sipas rastit:
1. Nëse vjen e vetme, e pashoqëruar me parafjalët e vendit *'ala'* (mbi, sipër) apo *'ila'* (tek, deri tek), ajo ka kuptimin 'u plotësua, u përsos', sikurse thotë Allahu i Lartësuar për Musain (a.s), në suren Kasas, ajeti 14: "E pasi ai *(Musai)* arriti moshën madhore dhe u plotësua (*isteuã*) *(u bë i pjekur, u bë i plotë)*, Ne i dhamë atij dituri dhe urtësi.".
2. Nëse ajo vjen e shoqëruar me parafjalën e vendit *'ala'* (mbi, sipër), atëherë ajo ka kuptimin "u lartësua, u ngrit sipër", sikurse thotë Allahu i Lavdëruar: "*Thumme isteuâ ala el arsh*" (Pastaj u ngrit mbi arsh). Ose siç thuhet në suren Zuhruf, ajeti 13: "Ai që i krijoi të gjitha llojet dhe ju mundësoi të udhëtoni hipur në anije ose në kafshë, të uleni mbi to (*Li testeuu alâ đhuhûrihî*) dhe, atëherë, pasi të jeni vendosur mbi to, ta përkujtoni të mirën që jua dha Zoti juaj e të thoni: "Falënderuar qoftë Ai që i nënshtroi këto për ne, sepse ne nuk do të kishim mundësi ta bënim këtë."." Fjala "*li testeû*" vjen nga "*isteuâ alâ*" *(të ngriheni dhe të qëndroni mbi to)*.
3. Nëse vjen e shoqëruar me parafjalën e vendit *'ilâ'*, që do të thotë "te, deri te", ajo ka kuptimin: "synon, ka për qëllim, drejtohet, ka për objektiv". Pra, "*isteuã ilâ*" do të thotë "synoi, u drejtua te", sikurse vjen edhe në këtë ajet: "…pastaj iu drejtua qiellit". Pra, kur Allahu i Lartësuar mbaroi krijimin e tokës, Ai synoi dhe iu drejtua krijimit të qiellit.

- "Ai i përsosi ata shtatë qiej" – Pra, i krijoi, i rregulloi dhe përsosi çdo gjë në to.

- "Ai, për çdo gjë, është i Gjithëdijshmi" - Sikurse thotë Allahu i Madhëruar në një ajet tjetër, në suren Hadidë, ajeti 4: "...Ai di gjithçka që futet në tokë dhe gjithçka që del prej saj, çfarë zbret prej qiellit dhe çfarë ngrihet në të. Ai është me ju kudo që të jeni. Allahu është vështrues i gjithçkaje që ju punoni." Ose në suren Ta Ha: "Edhe nëse ti e ngre zërin *(në lutjet e tua)*, Ai e di të fshehtën dhe atë që është më e fshehtë *(se e fshehta)*." Ai thotë gjithashtu: "Ai e di atë që e mbani të fshehur dhe atë që e publikoni".

Janë të shumta ajetet në Kur'ân, ku Allahu i Lartësuar, së bashku me faktin që është Krijues, përmend edhe dijen e Tij absolute, sikurse ka ndodhur në këtë ajet, në suren Mulk, ajeti 14: "A nuk e di Ai që ka krijuar, kur dihet se Ai depërton në thellësi të sekreteve?!"

Këtë bashkim të dy cilësive, Allahu i Madhëruar e sjell si argument për madhështinë e cilësive të Krijuesit. Krijimi i krijesave prej Tij tregon se Ai ka dituri, urtësi dhe pushtet absolut, për të arritur gjithçka që dëshiron. I Lavdëruari thotë:

Ajetet 30 – 34

30. Kur Zoti yt u tha engjëjve: "Unë po vendos në tokë një mëkëmbës." Ata thanë: "A do të vendosësh atje dikë që shkatërron dhe derdh gjak *(të pafajshëm)*, kur ne të madhërojmë Ty me lavdinë Tënde, e

(*vetëm Ty*) të shenjtërojmë?" Ai tha: "Unë di atë që ju nuk e dini".

31. E Ai *(Zoti)* ia mësoi Ademit të gjithë emrat *(e sendeve)*. Pastaj ato *(sendet)* ua paraqiti melekëve dhe tha: "Më tregoni emrat e këtyre *(sendeve)*, nëse jeni të saktë *(në pretendimin tuaj)*.

32. Ata thanë: "Pa të meta je, o Zoti ynë! Ne kemi veçse atë dije që Ti na e mësove.Vërtet, Ti je i Gjithëdijshëm e i Urtë.

33. Tha *(Allahu)*: "O Adem! Tregojua atyre *(engjëjve)* emrat e tyre *(të sendeve)*. E kur *(Ademi)* ua tregoi atyre *(engjëjve)* emrat e tyre *(sendeve)*, Zoti tha: "A nuk ju kam thënë se Unë di të fshehtën e qiejve dhe të tokës, dhe se e di shumë mirë atë që ju e shfaqni dhe atë që e fshihni?

34. Kur u thamë engjëjve: "Bini në sexhde para Ademit", ata menjëherë u përulën, përveç Iblisit. Ai refuzoi fort, shprehu mendjemadhësi dhe u bë prej mohuesve.


Shpjegimi i ajeteve

- "Kur Zoti yt u tha engjëjve: "Unë po vendos në tokë një mëkëmbës." – Ky moment shënon fillimin e shtjellimit të historisë së Ademit (a.s), babait të njerëzimit.

Kur Allahu i Madhëruar deshi të krijonte Ademin, Ai njoftoi melekët për këtë krijim që do të bënte, duke u thënë se këtë krijesë do ta vendoste si mëkëmbës dhe zëvendës në tokë. Atëherë, melekët thanë:

- "A do të vendosësh atje dikë që shkatërron dhe derdh gjak *(të pafajshëm)*" – Domethënë: A do të vendosësh atje dikë që sjell shkatërrim, duke bërë poshtërsi dhe duke mos t'u bindur Ty?

Përmendja e gjakderdhjes, që në vetvete është një krim, tregon për vëmendjen e veçantë që i kushtohet asaj. Pra, edhe pse gjakderdhja është pjesë e poshtërsive, të cilat përmenden në përgjithësi si arsye e habisë së melekëve, ajo përmendet edhe veçmas, për të treguar sa i madh është krimi që quhet vrasje ose gjakderdhje.



Ky ishte mendimi që kishin melekët rreth mëkëmbësit të tokës. Ata mendonin se ai do ta mbushte tokën me shkatërrime dhe poshtërsi, dhe për këtë arsye, në shenjë madhërimi për Allahun, i bënë Atij këtë pyetje, duke i shprehur gjithashtu se ata e adhuronin dhe e madhëronin Atë pa u përlyer me asnjë lloj poshtërsie e padrejtësie. Ata thanë:

- "...kur ne të madhërojmë Ty me lavdinë Tënde, e (vetëm Ty) të shenjtërojmë?!" - Shprehja: "e *(vetëm Ty)* të shenjtërojmë" (*Nuḳad-disu leke*), nëse e analizojmë me hollësi, mund të ketë dy kuptime:

1. Kuptimi i "*Nuḳad-disu leke*", ka mundësi të ketë lidhje me kuptimin e shprehjes: "*nukad-disuke*", pra: "Të shenjtërojmë Ty"; duke e marrë fjalën *'le'* si të vendosur për të shprehur posaçërimin e shenjtërimit vetëm për Allahun e Madhëruar. Me këtë shpjegim, kuptimi i shprehjes "*Nuḳad-disu leke*" është: "*dhe ne të shenjtërojmë vetëm Ty*".

2. Kuptimi i "*Nukad-disu leke*" mund të lidhet edhe me shprehjen: "*Nukad-disu leke enfusena*", domethënë: "*I pastrojmë dhe i lartësojmë vetet tona për Ty. I lartësojmë dhe i pastrojmë vetet tona për të kushtuar Ty adhurimin tonë*".
"*Nuķad-disu*" do të thotë "i shenjtërojmë", dhe shenjtërimi nuk është gjë tjetër veçse pastrim nga çdo e metë. Në këtë mënyrë, kuptimi i shprehjes "*nuķad-disu leke*" është: "Ne i pastrojmë shpirtrat, vetet tona nga çdo mëkat dhe cilësi e keqe, duke u pajisur me çdo cilësi të mirë dhe virtyt të lartë, si: dashuria për Allahun apo frikë-respekti dhe madhërimi për Të. Pra, për admirimin dhe adhurimin tonë ndaj Teje (o Allah), ne i pastrojmë vetet tona nga çdo cilësi e keqe."

Allahu i Lartësuar u thotë melekëve:

- "Ai tha: "Unë di atë që ju nuk e dini" – Pra, i Madhëruari tregoi se Ai dinte rreth atij mëkëmbësi që do të vendoste në tokë, atë që melekët nuk e dinin. Fjala e melekëve vinte si pasojë e mendimit dhe e gjykimit të tyre, të mbajtur fshehur në shpirtrat e tyre, por Allahu i Madhëruar e di atë që shfaqet dhe atë që fshihet.

Allahu i Lartësuar i dinte shumë mirë mirësitë që do të sillte vendosja e mëkëmbësit në tokë. Mirësitë që do të vinin në jetë me këtë mëkëmbës, do të ishin shumë herë më të mëdha se të këqijat që do të shfaqeshin prej llojit të tij.

Do të mjaftonte si arsye për vendosjen e tij në tokë fakti që Allahu i Madhëruar deshi që nga mesi i llojit të këtij mëkëmbësi (njeriut), të dalloheshin mbi të tjerët: profetët, të sinqertët, dëshmorët dhe vepërmirët, nëpërmjet të cilëve Allahu i Lartësuar do t`u shfaqte krijesave shenjat dhe argumentet e madhështisë së Tij.

Nëpërmjet njeriut, do të dilnin në pah shumë aspekte të adhurimit të Krijuesit, siç është, për shembull, lufta e përpjekja në rrugë të Allahut, të cilat kurrë nuk do të shfaqeshin nëse nuk do të vinte në ekzistencë kjo krijesë.

Kjo tokë është dëshmitare e ndjenjave dhe e aftësive të jashtëzakonshme që gjenden brenda kësaj krijese. Në këtë botë do të shfaqen prirjet e mira e të këqija, të fshehura brenda njeriut. Qeniet njerëzore sprovohen në prirjet dhe në ndjenjat e tyre, për t`u spikatur dhe për t`u dalluar armiqtë e Zotit nga të dashurit e Tij, për të dalë hapur ata që i përkasin palës së Allahut dhe ata që janë kundra Allahut, pasi nuk u binden urdhrave të Tij. Pikërisht kjo krijesë (njeriu) është shkaku që e keqja, që kishte zënë vend brenda shpirtit të Iblisit, të shfaqej me të gjitha përmasat e saj, bashkë me të gjitha cilësitë e tij.

Do të mjaftonte veç një pjesë e këtyre urtësive, për të argumentuar dhe për të justifikuar krijimin dhe vendosjen e këtij mëkëmbësi në tokë.

Duke qenë se fjala e melekëve përmbante në vetvete një lloj pretendimi nga ana e tyre, se ata ishin më të mirë, më të vyer dhe më të zgjedhur, kundrejt këtij mëkëmbësi, Allahu i Madhëruar i sqaron ata përse ishte zgjedhur njeriu mëkëmbës në tokë, duke u treguar mirësitë dhe vlerat e tij. Kështu, ata do të mësonin për vlerat e njeriut, nga njëra anë, si dhe për vërtetësinë dhe dijen absolute të Krijuesit të Tij, nga ana tjetër. Thotë i Madhëruari:

- "E Ai *(Zoti)* ia mësoi Ademit të gjithë emrat *(e sendeve)*" – Pra, Allahu i Madhëruar i mësoi Ademit emrin e çdo sendi dhe të çdo gjëje të emërtuar. Ai i mësoi emrat dhe të emërtuarit me to, i mësoi termat dhe kuptimin e tyre, madje ia mësoi emrat në formën e tyre normale dhe në formën zvogëluese.

- "...e pastaj ato ua paraqiti melekëve dhe tha: "Më tregoni emrat e këtyre *(sendeve të emërtuar)*, nëse jeni të saktë." – Pra, Allahu i Lartësuar ua paraqiti të emërtuarat melekëve, për t`ua provuar që ata nuk kishin dije rreth tyre. Ai u tha atyre: "Me tregoni rreth emrave të këtyre, nëse jeni të drejtë, të

sigurt e të vërtetë në atë që thoni. Nëse jeni të sigurt në fjalët, në mendimin dhe në pretendimet tuaja, se jeni më të mirë se ky mëkëmbës, atëherë më flisni për emrat e këtyre (të emërtuarve)!

-" Pa të meta je, o Zoti ynë!"- Kuptimi është: Ti je larg çdo të mete e mangësie, që ne të mund të kundërshtojmë apo të thyejmë urdhrin Tënd.

- "ne kemi veç atë dije që Ti na e ke mësuar…" – Kuptimi: Ne nuk kemi dije në asnjë aspekt a këndvështrim tjetër, por veçse në drejtime dhe aspekte që Ti na i ke mësuar, si mirësi dhe dhuratë prej Teje.

- "Vërtet, Ti je i Gjithëdijshmi dhe i Urti" - Kuptimi: Ti je i Dituri, i Cili ka përfshirë gjithçka në dijen e Tij.

Dijes së Tij nuk mund t'i fshihet asnjë thërrmijë që ekziston, kudo qoftë ajo, në qiell apo në tokë, që nuk mund t'i fshihet as ndonjë gjë më e vogël se thërrmija, as më e madhe se ajo.

- "…dhe i Urti" - Kuptimi: Ti je i Urti, që ka urtësinë absolute, jashtë së cilës nuk del asnjë krijesë. Të gjitha janë pjesë e urtësisë së Tij gjithëpërfshirëse: krijesat, urdhrat dhe dispozitat e Tij. Nëse ka krijuar diçka, këtë e ka bërë me një urtësi të caktuar. Nëse urdhëron për diçka, këto urdhra shfaqin urtësinë e Tij. Urtësia është: vendosja e çdo gjëje në vendin që i takon.

Kështu pra, melekët e pranuan dhe e miratuan dijen dhe urtësinë e Allahut të Lartësuar, në momentin kur u ndien të paaftë në njohjen e gjërave më të vogla dhe më të imta, për të cilat u pyetën. Ata, gjithashtu, shprehën mirënjohje për mirësitë e Allahut ndaj tyre, mes të cilave ishte edhe dija që u dhuroi për çdo gjë që nuk e dinin.

Allahu i Lartësuar i drejtohet Ademit (a.s) dhe i thotë:

- "O Adem, tregoju atyre *(engjëjve)* emrat e tyre *(të emërtuarve)*" - Kuptimi: Tregoju melekëve rreth emrave të të emërtuarve, rreth të cilëve Allahu i Lartësuar i pyeti melekët, dhe ata nuk u përgjigjën.

- "E kur *(Ademi)* ua tregoi atyre *(engjejve)* emrat e tyre *(sendeve)*, Zoti tha: "A nuk ju kam thënë se Unë di të fshehtën e qiejve dhe të tokës, apo se Unë e di atë që e shfaqni dhe atë që e fshihni *(brenda jush)*?" – Pra, kur Ademi (a.s.) i njoftoi melekët rreth emrave të gjithçkaje, atyre iu bë e qartë grada, vlera dhe niveli i Ademit, kundrejt tyre. Ata e kuptuan urtësinë e Krijuesit dhe dijen e Tij absolute për vendosjen e këtij mëkëmbësi në tokë, dhe kështu që iu dorëzuan urtësisë së Allahut të Lartësuar.

Ai di gjithçka që fshihet në qiej dhe në tokë, edhe atë që ne nuk mund ta shohim. Dhe nëse Ai e njeh të fshehtën, atëherë gjërat e hapura dhe të shfaqura domosdo që i njeh.

- "Kur u thamë engjëjve: "Bini në sexhde para Ademit, ata *(engjëjt)* menjëherë u përulën, përveç Iblisit. Ai refuzoi fort, shprehu mendjemadhësi dhe u bë prej mohuesve." - Të gjithë melekët nxituan për të zbatuar urdhrin e Allahut të Lartësuar dhe ranë në sexhde, përveç Iblisit. Ai refuzoi, shfaqi mëndjemadhësi dhe u bë prej mohuesve. Pra, vetëm Iblisi u ndalua dhe shprehu refuzim të fortë për të rënë në sexhde. Ai u tregua kryelartë, rebel dhe mendjemadh kundrejt urdhrit të Allahut dhe kundrejt vlerave dhe nivelit të Ademit (a.s.). Iblisi tha, sikurse thuhet në një ajet tjetër: "A t'i bie në sexhde atij që Ti e krijove nga balta?!"

Ky refuzim i fortë dhe kjo mendjemadhësi e mosbindje ndaj urdhrit, ishte rezultat i *kufr*-it, me të cilin Iblisi ishte i gatuar në vetvete. Pikërisht në ato momente u shfaq haptazi armiqësia që ai fshihte kundrejt Allahut të Lartësuar dhe Ademit (a.s.). Ky ishte haptazi mosbesimi dhe rebelimi i tij ndaj Allahut të Lartësuar.

Në këto ajete ka shumë mësime dhe dobi, si:

1. Pohimi për Allahun e Lartësuar i cilësisë së Tij të të folurit. Ai ka qenë dhe vazhdon të jetë i cilësuar me këtë atribut. Ai thotë çfarë të dëshirojë dhe i flet kujt të dëshirojë. Ai është i cilësuar, gjithashtu, me dije dhe urtësi.

2. Në këto ajete gjejmë dëshmi që, nëse robi nuk arrin të konceptojë dhe të kuptojë plotësisht apo imtësisht ndonjë nga urtësitë e krijimit të Allahut të Lartësuar, apo të urdhrave që përmbajnë dispozitat e Tij, atëherë ai e ka për detyrë që të dorëzohet dhe t'i pranojë ato plotësisht, pa më të voglin ngurrim a mëdyshje. Ai duhet të pranojë plotësisht urtësinë e Allahut të Lartësuar edhe nëse, ndonjëherë, do t'i duhet të hedhë poshtë dhe të akuzojë mënyrën e vet të të menduarit, të konceptimit të gjërave, që, sigurisht, është e kufizuar, shpeshherë edhe e mangët (në varësi të ndikimeve që e rrethojnë).

3. Në këtë ajet tregohet rëndësia e madhe që i kushton Allahu i Lartësuar melekëve dhe bamirësia e madhe që Ai ka bërë ndaj tyre, duke u mësuar atë që nuk e dinin dhe duke u tërhequr vëmendjen ndaj asaj që nuk e kishin mësuar.

4. Në këtë ajet tregohet dobia dhe rëndësia e dijes, në shumë aspekte:

• Allahu i Lartësuar u prezantohet melekëve duke u treguar dijen e Tij absolute dhe urtësinë e Tij madhështore.

• Ai ua bëri të qartë melekëve se në ç'aspekt Ademi (a.s.) ishte më i mirë se ata, duke deklaruar, në këtë mënyrë, se dija është cilësia më e mirë që mund të gjendet te dikush.

• Kur u shfaq vlera dhe grada e Ademit (a.s.) në aspektin e dijes, Allahu i Lartësuar i urdhëroi melekët që të binin në sexhde, në shenjë nderimi për të cilësuarin me këtë cilësi.

5. Grada e lartë në dije bie më shumë në sy para dikujt tjetër, kur, fillimisht, vihet në provë njëra palë. Kur përgjigjja jepet nga më i dituri, del dhe shfaqet më e fuqishme vlera e të diturit kundrejt palës tjetër.

6. Në këto ajete jepen mësime dhe përvoja për gradën e dy personave të rëndësishëm: babait të njerëzimit dhe babait të xhindëve. Në to jepet grada dhe vlerësimi i lartë për Ademin (a.s), babain e njerëzimit, dhe cilësitë që Allahu i Lartësuar i dhuroi Atij.

7. Gjithashtu, jepet qartë edhe armiqësia e ashpër që Iblisi shfaqi ndaj Ademit (a.s) dhe llojit të tij, e të tjera si këto.

Ajetet 35 – 39

35. Ne i thamë: "O Adem! Banoni në Xhenet, ti dhe bashkëshortja jote, dhe hani nga frutat e tij lirisht dhe ku të dëshironi. Por mos iu afroni asaj peme, e të bëheni të padrejtë *(ndaj vetes tuaj)*."

36. Por Shejtani i tronditi *(i tundoi)* ata nëpërmjet saj *(pemës)*, dhe i nxori nga ajo *(e mirë)* në të cilën ishin. Ne u thamë: "Zbritni *(dilni prej Xhenetit)*! Ju *(do të)* jeni armiq të njëri-tjetrit! Në tokë, ju do të keni vendbanim e strehim, dhe në të do të gjeni furnizim deri në një afat *(të caktuar)*.

37. Ademi, prej Zotit të vet, mësoi disa fjalë *(lutjeje)*, dhe Ai ia pranoi pendimin. Pa dyshim që Ai është Pranuesi i pendimit, Mëshiruesi.

38. Ne u thamë: "Dilni prej tij *(Xhenetit)* që të gjithë! Juve, pa dyshim, do t'ju mbërrijë udhëzim prej Meje. Çdokush që pranon udhëzimin Tim, nuk do të ketë frikë e as do të brengoset.

39. Ndërsa ata që mohojnë argumentet Tona, do të jenë banues të Zjarrit. Në të *(në Zjarr)*, ata do të jenë përjetësisht".

Shpjegimi i ajeteve

- "Ne i thamë: "O Adem! Banoni në Xhenet, ti dhe bashkëshortja jote..." - Allahu i Lartësuar e krijoi Ademin dhe e dalloi mbi krijesat e tjera. Për t'i plotësuar e përsosur më shumë mirësitë e Tij ndaj Ademit (a.s.), Allahu i Lartësuar krijoi prej Ademit një krijesë (femrën), që t'i shërbente si qetësim dhe kënaqësi për Ademin (a.s.). Ajo do të ishte një 'vendprehje' për të. Allahu i

Lartësuar i urdhëroi ata që të banonin në Xhenet dhe të ushqeheshin prej tij, duke u thënë:

- "...dhe hani nga frutat e tij lirisht dhe ku të dëshironi" - Kuptimi: Hani fruta, domethënë shumë lloje frutash, me kënaqësi dhe duke i shijuar ato.

Kështu, Ai i lejoi të provonin nga çdo gjë që shihnin në Xhenet dhe prej çdo lloji të frutave që të dëshironin. Allahu i Lartësuar i tha Ademit (a.s.), sikurse tregohet në suren Ta Ha, ajeti 119: "Ti aty *(në Xhenet)* nuk ke për të qenë i uritur e as ke për të mbetur i zhveshur. Aty nuk ke për të patur etje e as nuk do të kesh vapë."

Por, më pas, Allahu i Lartësuar, duke dashur t'i sprovonte, u tha:

- "por mos iu afroni asaj peme e të bëheni të padrejtë."- Domethënë flitej për një lloj peme që gjendej aty, mes të tjerave.

Ndalesa e drejtuar e bënte haram afrimin te pema, sepse çdo rast kur nuk respektohet një ndalesë konsiderohet padrejtësi, zullum.

Por armiku i tyre (Shejtani) vazhdoi t'u bënte atyre vesvese, t'ua zbukuronte haramin dhe t'i tundonte drejt tij, derisa:

- "Shejtani i trondit ata nëpërmjet saj *(pemës)*" – Pra, i trondit nga bazat dhe qëndrueshmëria e tyre për të mos thyer urdhrat. Këtë e arriti duke ua zbukuruar të ndaluarën, duke iu betuar atyre dhe duke u shtirur si këshilltar i mirë, që u donte të mirën. E kështu, ata u mashtruan dhe iu bindën atij.

- "...dhe i nxori ata nga ajo *(e mirë)* në të cilën ishin." - Në këtë mënyrë, ai i nxori ata nga mesi i atyre mirësive dhe kënaqësive që po shijonin, për t'u hedhur në botën e lodhjes, të mundimit dhe të përpjekjeve.

Allahu i Lartësuar i kallëzon për marrëdhëniet që do të kenë mes njëri-tjetrit, njerëzit dhe xhindët, kur thotë:

- "Ne u thamë: "Zbritni *(dilni prej Xhenetit)*! Ju *(do të)* jeni armiq të njëri tjetrit!" - Pasardhësit e Ademit (a.s.) do të jenë armiq të Iblisit dhe të pasardhësve të tij.

Dihet shumë mirë se armiku përpiqet me të gjitha mënyrat që ta godasë kundërshtarin e tij me çdo të keqe të mundshme, si edhe t'ia ndalojë e ndërpresë të mirat atij me çdo mjet dhe me çdo rrugë që ekziston.

Ky është një paralajmërim, për t'u ruajtur prej Shejtanit. Allahu i Lartësuar thotë: "Shejtani është armiku juaj dhe si të tillë konsiderojeni. Ai e thërret grupin *(pasuesit)* e vet për t'u bërë banorë të Zjarrit." Ndërsa në suren Kehf, ajeti 50, thotë: "Vallë, a në vend Tim, do ta konsideroni si mik atë dhe pasardhësit e tij, ndërkohë që ata janë armiqtë tuaj?! Sa këmbim i shëmtuar dhe i padrejtë është ky *(i mohuesve)*!"

Pastaj Allahu i Lartësuar tregon destinacionin e zbritjes:


- "Në tokë ju do të keni vendbanim e strehim, dhe atje do të gjeni furnizim, deri në një afat *(të caktuar)*" - Kuptimi: Për ju toka do të jetë vend qëndrimi dhe vend jetese, deri në një afat (të caktuar). Në të do të kaloni vitet e jetës suaj, për të shkuar pastaj në vendin për të cilën u krijuat dhe i cili u krijua për ju. Jeta juaj në tokë do të jetë e përkohshme, prandaj nuk meriton të quhet 'vendprehjeje', me plot kuptimin e fjalës.

Kjo tokë është veçse një stacion, ku ne furnizohemi, për të shkuar në destinacionin përfundimtar (Xhenet). Ajo nuk është një vendqëndrim, ku ne mund të gjejmë prehjen dhe qetësinë e plotë (të përjetshme).

- "Ademi mësoi prej Zotit të vet disa fjalë *(lutjeje)*" – Pra, Ademi (a.s) mësoi disa fjalë e lutje, me të cilat e frymëzoi Allahu i Lartësuar. Këto fjalë ishin:

قالا ربنا ظلمنا أنفسناوإن لم تغفر لنا وترحمنالنكونن من الخاسرين

Rab-benâ dhalemnâ enfusenâ ue in lem tagfir lenâ ue terĥamnâ le nekûnen-ne minel ĥâsirin!



"Ata të dy *(Ademi dhe Havaja)* thanë: "O Zoti ynë! Ne i bëmë padrejtësi vetes. Nëse Ti nuk na fal dhe nuk na mëshiron, pa dyshim që do të jemi prej të shkatërruarve *(dështuarve)*." [Araf 23].

Kështu, Ademi (a.s.) e pranoi gabimin që bëri dhe i kërkoi Allahut të Lartësuar që këtë gabim t'ia mbulonte dhe t'ia falte.
Përgjigjja ishte:

- "…dhe Ai ia pranoi pendimin. Pa dyshim që Ai është Pranuesi i pendimit, Mëshiruesi". – Pra, Allahu i Lartësuar e pranoi pendesën e Ademit (a.s) dhe e mëshiroi atë. Ai është Mëshirues (Raĥîm) ndaj adhuruesve të Tij.

Prej mëshirës së tij është edhe suksesi që Ai u jep robërve për t'u penduar, duke i falur dhe duke ua mbuluar të metat e tyre.

Pranimi i pendimit prej Allahut kuptohet në dy mënyra:
1. Me anë të suksesit për t'u penduar.
2. Me anë të plotësimit të kushteve të pranimit të tij.

- "Dilni prej tij *(Xhenetit)* që të gjithë!" - Allahu i Lartësuar përsëriti, përmendjen e zbritjes në tokë të dy të rëndësishmëve, për të njoftuar krijesat për atë që i pret ata në vendbanimin e tyre të ri (në tokë).

Thotë i Madhëruari:

- "Juve, pa dyshim, do t'ju mbërrijë udhëzim prej Meje." - Kuptimi: Në çdo kohë e në çdo periudhë, do t'ju vijë prej Meje udhëzim i qartë. Udhëzimi do të vijë nëpërmjet profetëve dhe librave që do t'u shpallen atyre. Në çdo kohë, juve do t'ju vijë ndonjë profet dhe shpallje prej Meje, që t'ju udhëzojë në rrugët e afrimit tek Unë dhe në rrugët e kënaqësisë Time. Atëherë, dijeni se:

- "Çdokush që pranon udhëzimin Tim, nuk do të ketë frikë e as do të brengoset." - Kuptimi: Çdokush prej jush që e pranon udhëzimin Tim, dhe këtë pranim e interpreton duke i besuar të dërguarit dhe librat e Mi, ka një premtim të pakthyeshëm. Secili prej jush që udhëzohet nga mësimet e tyre, me fjalë të tjera, çdokush që i beson si duhet profetët dhe librat e Mi, ka një premtim të mrekullueshëm.

Por çfarë quhet besim i drejtë? Një besim i drejtë kërkon plotësimin e dy kushteve:
1. Pohimin dhe besimin larg çdo dyshimi të të gjitha informacioneve që kanë ardhur nëpërmjet librave dhe profetëve.
2. Zbatimin me rigorozitet të urdhrave dhe largimin nga ndalesat, të cilat janë sqaruar nga profetët dhe janë porositur në ato libra.

Çdokush që i beson profetët dhe librat në këtë mënyrë të drejtë, ka një premtim prej Allahut të Lartësuar, që thotë: "…nuk do të ketë frikë e as do të brengoset."

Ndërsa në një ajet tjetër, dhe pikërisht në ajetin 123 të sures Ta Ha, thuhet: "Ai *(Allahu)* u tha: "Zbritni prej tij *(Xhenetit)* që të gjithë! Ju do të jeni armiq të njëri-tjetrit. Nëse ju vjen nga Unë udhëzim *(libër e profet)*, atëherë kush i përmbahet udhëzimit Tim, ai nuk ka për të humbur *(në të dyja jetët)*, e as

nuk ka për t'u trishtuar *(në të dyja jetët)*". Kështu, Allahu i Lartësuar ka premtuar katër gjëra për ata që ndjekin udhëzimin e Tij:

1. Ata do të jenë të ruajtur nga frika.
2. Ata do të jenë të ruajtur nga mërzitia dhe brenga.
3. Ata do të jenë të ruajtur nga humbja dhe devijimi.
4. Ata do të jenë të ruajtur nga trishtimi.

Për ta nuk do të ketë as frikë e as brenga. Ndryshimi mes këtyre dy gjendjeve qëndron në faktin se diçka e keqe dhe e papëlqyeshme, nëse ka kaluar, sjell brengë (*el ĥuzn*) në shpirtin tënd. Ndërsa kur ajo pritet të ndodhë, shkakton frikë (*el ħauf*). E pra, për ata që ndjekin udhëzimin e Allahut nuk ka frikë dhe as brengosje. Madje ata do të shijojnë të kundërtat e këtyre gjendjeve, duke qenë gjithnjë të sigurt dhe të qetë. Gjithashtu, kush ndjek udhëzimin e Tij nuk ka për të humbur a devijuar dhe nuk ka për t'u trishtuar. Përkundrazi, ai do të përjetojë të kundërtat e këtyre gjendjeve: ai do të jetë i udhëzuar dhe gjithnjë i lumtur.

Përfundimisht, njerëzit që ndjekin udhëzimet e Allahut kanë për të shijuar qetësinë, sigurinë, prehjen dhe lumturinë, si në këtë jetë, edhe në jetën tjetër. Vetëm ata mund të quhen të udhëzuar në rrugën e drejtë. Të udhëzuarit nuk përjetojnë asnjë lloj frike dhe brenge. Ata nuk shkelin në ndonjë rrugë të humbur dhe nuk e provojnë trishtimin e përjetshëm. Këta do të arrijnë gjithçka që dëshirojnë dhe do të jenë të shpëtuar nga gjithçka së cilës i druhen dhe të cilën nuk e duan.

- "Ndërsa ata që mohojnë argumentet Tona..." – Pra, ata të cilët nuk e ndjekin udhëzimin e Allahut, të sjellë nëpërmjet profetëve dhe librave:

- "...ata do të jenë banues të Zjarrit. Në të *(në Zjarr)*, ata do të jenë përjetësisht". – Pra, ata do të jenë banorë të Zjarrit, ku do të qëndrojnë përgjithmonë, duke mos dalë kurrë prej tij. Dënimi i tyre nuk do të pakësohet e lehtësohet asnjëherë dhe ata kurrë nuk do të ndihmohen.

Në këtë ajet, dhe në të tjera si ai, Allahu i Lartësuar i ndan krijesat në: krijesa të lumtura dhe krijesa të trishtuara. Në këto dy grupe klasifikohen xhindët dhe njerëzit. Ajetet kuranore përshkruajnë gjithashtu cilësitë e secilit grup, si dhe veprat që i karakterizojnë ata. Pikërisht në bazë të këtyre veprave, ata përfundojnë në vendin që u takon.

Nga ky ajet kuptohet që edhe xhindët, sikurse dhe njerëzit, do të shpërblehen me të mira dhe do të meritojnë ndëshkimet që i bëjnë hak në këtë jetë. Edhe xhindët, sikurse njerëzit, do të jenë njëlloj në përgjegjësinë që do të mbajnë, në aspektin e zbatimit të urdhrave dhe të largimit nga ndalesat hyjnore.

Ajetet 40 – 43

Më pas, Allahu i Lartësuar nis të përmendë mirësitë dhe dhuratat e shumta që u pati dhënë bijve të Israilit (çifutëve), duke thënë:

40. O bijtë e Israilit, përkujtoni të mirat e Mia, me të cilat ju begatova, dhe plotësojeni premtimin që më keni dhënë! Unë e zbatoj premtimin Tim ndaj jush. Dhe vetëm Mua të më keni frikë!
41. Besojeni atë *(Kur'ânin)*, që e shpalla si vërtetues të asaj *(shpalljeje hyjnore)* që e keni ju, e mos u bëni mohuesit e parë të tij! Mos i fshihni *(mos i mohoni)* ajetet *(ose argumentet)* e Mia për hir të një çmimi të ulët, por vetëm prej Meje ruhuni!
42. Mos e përzieni të vërtetën me të pavërtetën! Në këtë mënyrë, ju po e fshihni të vërtetën, edhe pse e dini.
43. Faleni namazin, jepeni zekatin dhe bini në *ruku* *(falni namaz bashkë)* me ata që bëjnë *ruku*!

Shpjegimi i ajeteve

- O bijtë e Israilit, përkujtoni të mirat e Mia, me të cilat ju begatova..." - Israili është Profeti Jakub (a.s.). Këto fjalë iu

drejtohen çifutëve që jetonin në Medinë dhe rreth saj. Këto fjalë vlejnë edhe për ata që vijnë pas tyre. Allahu i Lartësuar jep një urdhër që i përfshin të gjithë, pra: Përkujtoni, të gjithë ju, mirësinë Time me të cilën ju begatova.

Fjala "mirësi" i përfshin këtu të gjitha llojet e mirësive me të cilat Allahu i Lartësuar i begatoi ata, disa prej të cilave Ai do t'i përmendë në këto ajete dhe disa në ajete të tjera.

Përkujtimi i këtyre mirësive ka qëllime dhe urtësi në vetvete. Ai synon që zemrat tona të jenë mirënjohëse dhe falënderuese ndaj mirësive të përmendura, kurse gjuha jonë të jetë lavdëruese e Dhuruesit dhe shprehëse e ndjenjave të zemrës. Gjymtyrët, gjithashtu, duhet të jenë vërtetuese dhe në përputhje të plotë me fjalët që themi dhe me ndjenjat që fshehim në zemër. E vetmja mënyrë që gjymtyrët ta bëjnë këtë vërtet, është nënshtrimi i tyre për t'u përdorur në ato drejtime që dëshiron Allahu i Lartësuar dhe me të cilat Ai është i kënaqur.

Pra, përsëri kemi të bëjmë me një nxitje për pasimin e mësimeve të marra nga Profeti (s.a.u.s) dhe nga Libri i Allahut.

Më tej, i Madhëruari thotë:

- "…dhe plotësojeni premtimin që më keni dhënë! Unë e zbatoj premtimin Tim ndaj jush!" - Allahu i Lartësuar i nxit besimtarët që të mbajnë premtimin që i kanë dhënë Atij për ta besuar sinqerisht, Atë dhe profetët e Tij. Ai i nxit që ta mbajnë premtimin që i kanë dhënë për të zbatuar porositë e Tij dhe ligjin e jetës që shpalli për ta. Nëse krijesat do ta mbajnë fjalën e dhënë, atëherë edhe Allahu i Lartësuar do ta përmbushë premtimin e Tij.

Disa ajete kuranore që e qartësojnë më tepër kuptimin e këtij fragmenti janë dhe ato të sures Maide (nr. 12-14): "Në të vërtetë, Allahu mori zotimin e bijve të Israilit. Prej tyre dërguam *(caktuam)* dymbëdhjetë prijës. Allahu tha: "Unë jam me ju!" Në qoftë se falni namazin, e jepni zekatin, u besoni të dërguarve të Mi dhe i ndihmoni e respektoni *(nderoni)* ata, jepni për hir të Allahut hua të mirë, pa dyshim që Unë do t'jua fal të këqijat tuaja dhe do t'ju fus në xhenete, nën të cilët rrjedhin lumenj. E kush kundërshton pas këtij *(zotimi prej jush)*, ai e ka humbur rrugën e drejtë. Për shkak se ata e thyen zotimin e tyre, Ne i mallkuam ata dhe zemrat e tyre i bëmë të ngurta *(të ashpra)*. Ata i ndryshojnë fjalët *(në Teurat)* nga domethënia e tyre dhe e braktisën një pjesë të atyre për të cilat ishin urdhëruar. Ti vazhdimisht do të vëresh tradhtinë e një pjese prej tyre, përveç një pakice. Pra, fali ata dhe, me butësi, tolero! Allahu i do ata që bëjnë mirë. Ne e morëm zotimin edhe të atyre që thanë: "Ne jemi të krishterë!", por edhe ata e harruan një pjesë të atyre në të cilat ishin udhëzuar, prandaj Ne kemi futur ndërmjet tyre armiqësinë dhe urrejtjen, deri në Ditën e Kijametit. E më vonë, Allahu do t'ua paraqesë atyre atë që bënë."

Pastaj, Allahu i Lartësuar i urdhëron ata të pajisen me ato cilësi, që do t'ua bëjnë të mundur mbajtjen e premtimit të dhënë Atij. Ai u thotë atyre:

- "Dhe vetëm Mua të më keni frikë!" - Kur njeriu e ka frikën dhe respektin ndaj madhështisë së Allahut, kjo patjetër që do ta detyrojë t'i përmbahet premtimit, duke realizuar dhe përmbushur urdhrat e Tij dhe duke iu larguar ndalesave të Tij.

Më pas vjen një urdhër i veçantë, një urdhër për diçka, pa të cilën kurrë nuk mund të plotësohet imani. Vetëm imani i atij që ka plotësuar këtë urdhër të veçantë, që Allahu i Lartësuar ua drejton krijesave, mund të quhet *iman* i vërtetë dhe i plotë. Kështu, i Madhëruari thotë:

- "Besojeni atë *(Kur'ânin)* që e shpalla si vërtetues të asaj *(shpalljeje hyjnore)* që e keni ju…" – Kuptimi: Besojini Kur'ânit, të cilin Allahu i Lartësuar ia shpalli robit dhe Profetit të Tij të dashur, Muhamedit (a.s).

Allahu i Lartësuar i fton ata që ta besojnë dhe ta pasojnë Muhamedin (a.s), gjë që bën të detyrueshme edhe besimin e pasimin e Shpalljes (Kur'ânit dhe Sunetit) që i erdhi atij. Allahu i Lartësuar përmend edhe arsyen pse duhet pasuar ky Profet: që t'u shërbejë si nxitës më i madh për ta, pasi Ai thotë se libri që iu shpall këtij Profeti është: "*muŝaddiķal-limâ meakum*", pra: "…si vërtetues të asaj që e keni ju". Ky libër, ose kjo Shpallje, është në përputhje të plotë me atë Shpallje hyjnore që keni ju, pasi ndërmjet tyre (shpalljeve hyjnore) nuk ka dhe nuk duhet të ketë asnjë lloj kundërshtimi. Përse pra, duhet ta kundërshtoni këtë Shpallje? Nëse kjo Shpallje është në përputhje të plotë me traditën e të gjithë të dërguarve, atëherë përse refuzoni?! Përkundrazi, të parët që duhet ta pranojnë këtë Shpallje duhet të jeni pikërisht ju, që jeni të ditur rreth librave hyjnorë.

Fjala e Allahut të Lartësuar: "*muŝaddiķal-limâ meakum*" – "…si vërtetues të asaj *(shpalljeje hyjnore)* që e keni ju", përmban edhe një mesazh tjetër: Nëse ju nuk besoni atë që vërteton dhe argumenton vërtetësinë e librave tuaj, të cilët i ndiqni e i zbatoni (siç pretendoni), kështu ju keni hedhur poshtë edhe librat tuaj, sepse kjo Shpallje përmban të njëjtin mesazh që sollën edhe profetët që ju pretendoni se i pasoni, si Musai, Isai etj. Nëse ju e mohoni Shpalljen e Fundit, në të vërtetë keni hedhur poshtë edhe librat tuaj.

Pra, i vetmi verifikues i saktësisë së mësimeve hyjnore që ju keni, është ky libër, i cili përmban të vërtetën e sigurt: "*lâ rajbe fihi*" – tek ai nuk ka dyshime. Çdo tekst tjetër lë për të dëshiruar në mënyrën e përcjelljes së tij.

Një arsye tjetër që duhet t'ju bëjë ta besoni këtë Shpallje është edhe fakti që: ky Profet dhe cilësitë e Tij janë përshkruar qartë në tekstet e mbetura ende në duart tuaja. Nëse ju mohoni ato pjesë të librave tuaj ku përshkruhet dhe, madje, përgëzohet ardhja e këtij Profeti, kjo konsiderohet si mohim i një pjese të asaj që ju është shpallur juve nga Zoti juaj. Por mohimi i një pjese të Shpalljes hyjnore konsiderohet si mohim i plotë i saj, ashtu sikurse ai që mohon dhe nuk pranon të pasojë qoftë edhe një profet të vetëm, konsiderohet si mohues dhe refuzues i pasimit të të gjithë profetëve.

Allahu i Lartësuar, pasi i urdhëron ata për ta besuar këtë Profet dhe Shpalljen e Tij, Ai i ndalon ata edhe nga e kundërta e kësaj, duke thënë:

- "…e mos u bëni mohuesit e parë të tij!" – Pra, të mos bëheni mohues të Kur'ânit dhe të Profetit (s.a.u.s).

Vëreni me kujdes! Allahu i Lartësuar nuk ka thënë thjesht: "dhe mos u bëni mohues", por ka thënë: "…mos u bëni mohuesit e parë të tij". Vërtetësia e kësaj fjale zbulon një padrejtësi të madhe të tyre, sepse - sikurse e përmendëm më sipër - ata duhej të ishin të parët që ta besonin. Por duke u bërë mohuesit e parë, ata treguan nxitimin (e padrejtë) e tyre në mohimin dhe refuzimin e tij. Kjo nga njëra anë.

Nga ana tjetër, duke qenë të parët që mohonin (të vërtetën e qartë), ata u bënë shembujt e të tjerëve, të cilët do t'i pasonin në rrugën e tyre. Kështu, ata do të mbartin në shpinën e tyre edhe gjynahet e pasuesve, të cilët i përhumbën dhe i devijuan nga rruga e drejtë.

Në suren Maide, ajetet 77-79, i Madhëruari thotë: "Thuaju: "O ithtarë të librit! Mos e teproni në fenë tuaj duke dalë jashtë së vërtetës dhe mos shkoni pas pasioneve *(orekseve)* të një populli para jush, që ka humbur, që ka shkaktuar humbjen e shumë të tjerëve dhe që është larguar në tërësi prej rrugës së drejtë". Ata që mohuan të vërtetën nga bijtë e Israilit, u mallkuan prej gjuhës së Daudit dhe Isait, të birit të Merjemes. U veprua kështu, sepse ata kundërshtuan dhe e tepruan. Ata nuk ndalonin njëri-tjetrin nga e keqja që bënin. Sa e shëmtuar ishte ajo që vepronin! Ke për të parë që shumë prej tyre *(çifutë dhe krishterë)* miqësohen me ata që mohojnë. Sa e keqe është ajo që po i

përgatisin vetes së tyre! Allahu është i zemëruar me ta, dhe ata do të jenë përjetë në vuajtje të dënimit"

Ndërsa në suren Ankebut, ajeti 12, Ai thotë: "Ata që nuk besojnë u thonë atyre që besojnë: "Ejani në rrugën *(në fenë)* tonë, se gjynahet tuaja do t'i bartim ne! Po, në fakt, ata nuk do të bartin asgjë nga mëkatet e tyre. Në të vërtetë, ata janë gënjeshtarë. Ata do të bartin veç barrën e vet, e me atë të vetën edhe barrë të tjera, ndërsa Ditën e Kijametit do të merren në përgjegjësi për atë që kanë trilluar".

Por cili është shkaku që i detyron ata të bëjnë këtë zgjedhje? Atëherë, Allahu i Lartësuar përmend shkakun e saj dhe i ndalon ata nga kjo vepër, duke thënë:

- "Mos i fshihni *(mos i mohoni)* ajetet *(ose argumentet)* e Mia për hir të një çmimi të ulët" – Kuptimi: Ajetet (argumentet) e Mia mos i ndërroni apo mos i shkëmbeni me vlera të pakta, që ju mund të përjetoni në të gjitha aspektet e jetës. Mos i shkëmbeni ato me pushtete dhe ofiqe që keni frikë se mos ju largohen nëse i përkushtoheni besimit të drejtë në Allahun dhe në Profetin e Tij. Me fjalë të tjera, mos i shpenzoni ajetet e Allahut për të blerë disa dobi të përkohshme e të pakta. Kurrë mos u jepni përparësi dobive të pakta të dynjasë, kundrejt besimit dhe pasimit të ajeteve (shpalljeve) të Allahut të Lartësuar. Për të arritur këtë triumf mbi vetveten, vjen një urdhër i prerë:

- "...por vetëm prej Meje ruhuni!" – Kuptimi: Asgjëje tjetër të mos i druheni, por vetëm Mua.

Nëse do t'i druheni vetëm Allahut të Lartësuar, kjo do t'ju bëjë që t'i jepni përparësi besimit në ajetet (shpalljet) e Tij, kundrejt kënaqësive dhe interesave të kësaj bote të pavlerë dhe të parëndësishme.

Po ta shohim anasjelltas, do të thonim: Nëse ju përzgjidhni çmimin e ulët të këmbimit, atëherë kjo dëshmon për zbrazëtinë e zemrave tuaja nga *takua*-ja (frika prej Allahut) dhe për mosvlerësim të madhështisë së Tij. Më pas, i Madhëruari thotë:

- "Mos e përzieni të vërtetën me të pavërtetën! Në këtë mënyrë, ju po e fshihni të vërtetën, edhe pse e dini." – Këtu, Allahu i Lartësuar na ndalon nga dy gjëra:

1. Na ndalon nga përzierja e të vërtetës me të pavërtetën.

2. Nga fshehja e së vërtetës ose nga mossqarimi i të vërtetës.

Ai na ndalon nga këto dy gjëra, sepse qëllimi dhe misioni i atyre që u është dhënë dije dhe kanë libra, argumente dhe informacion, është pikërisht e kundërta e asaj që u përmend. Qëllimi i tyre është dallimi i së vërtetës nga e kota dhe sqarimi e qartësimi i plotë i së vërtetës.

Këto dy detyra janë të domosdoshme që, ata të cilët e duan udhëzimin ta gjejnë atë udhëzim, dhe atyre që janë të humbur t'u qartësohet rruga e pendimit dhe e kthimit. Ndërsa atyre që refuzojnë dhe kundërshtojnë, të mos u mbetet asnjë justifikim te Krijuesi për të argumentuar mospranimin e tyre.

Allahu i Lartësuar i shtjelloi shpalljet e Tij dhe i sqaroi ato me hollësi, pikërisht për të dalluar të vërtetën nga e kota dhe me qëllim që të qartësohet rruga e të udhëzuarve nga rruga e zullumqarëve. Të gjithë dijetarët që kryejnë këtë detyrë janë mëkëmbës, zëvendësues dhe pasues të denjë të profetëve. Ata janë udhëzuesit e popujve.

Ndërsa ata që e përziejnë të vërtetën me të kotën, ata që nuk e zbardhin të vërtetën, edhe pse e dinë atë, ata që e fshehin të vërtetën, të cilën e njohin shumë mirë dhe për të cilën janë urdhëruar që ta sqarojnë dhe ta shfaqin, pikërisht këta janë ftues për në Xhehenem, sepse njerëzit udhëzohen pikërisht nga dijetarët e tyre rreth çështjeve të fesë. Ata nuk pranojnë udhëzime nga askush tjetër, përveç dijetarëve të tyre.

Atëherë, zgjidhni për veten cilën të doni prej dy mundësive dhe gjendjeve.

Më pas, i Madhëruari thotë:

- "Faleni namazin, jepeni zekatin dhe bini në ruku *(falni namaz bashkë)* me ata që bëjnë ruku!" – Domethënë: falni namaz bashkë me ata që falen. Nëse ju e bëni këtë, pasi i keni besuar profetët e Allahut dhe shpalljet e Tij, atëherë ju keni kryer dy gjëra të domosdoshme për shpëtimin tuaj, duke vënë në një nivel veprat e dukshme (të jashtme) me ato të padukshme (të brendshme). Ju keni realizuar njëkohësisht dy shkaqet e lumturisë, të cilat janë: sinqeriteti ndaj Krijuesit (me besim e namaz) dhe bamirësia ndaj krijesave (me anë të zekatit). Në këtë mënyrë, ju keni adhuruar Allahun me veprime trupore, me akte shpirtërore dhe me pasuritë tuaja.

Thënia e Allahut: "*Uer-keû mear-râkiaîn*" (…dhe bini në *ruku* me ata që bëjnë *ruku*), tregon se:

1. Ky është një urdhër për të falur namazin me xhemat.

2. Falja e namazit me xhemat është e detyrueshme.

3. *Ruku*-ja është shtyllë e namazit. Ajo është shtylla pa të cilën namazi është i pavlefshëm. Arsyeja është se vetë namazi është quajtur me emrin e kësaj pjese përbërëse të tij (që është e *ruku*-ja), dhe kjo tregon se *ruku*-ja është pjesë e domosdoshme për saktësinë e namazit.

Në çdo rast, të quajturit e një adhurimi me emrin e një pjese përbërëse të tij tregon që ajo është pikërisht një nga pjesët e domosdoshme e tij, pa të cilën adhurimi është i pasaktë dhe i pavlefshëm.

Ajetet 44 – 48

44. Si i urdhëroni njerëzit për të mira, dhe e harroni vetveten, kur ju e lexoni librin *(Teuratin)*?! A nuk po mendoni?!

45. Kërkoni ndihmë me durim dhe me namaz! Vërtet, kjo është *(arritje)* e madhe, por jo për ata që kanë frikë,

46. të cilët janë të bindur se do ta takojnë Zotin e vet dhe se, pa dyshim, tek Ai do të kthehen.

47. O bijtë e Israilit! Përkujtoni të mirat e Mia, me të cilat ju begatova! Unë ju pata dalluar mbi njerëzit e tjerë *(të asaj kohe)*.

48. Ruajuni asaj dite, kur askush, askujt nuk do të mund t'i bëjë asgjë! Atë ditë nuk pranohet për të *(jobesimtarin)* asnjë ndërmjetësim. Nuk pranohet për të kompensim, e ata *(fajtorët)* nuk kanë për t'u ndihmuar.

Shpjegimi i ajeteve

- "Si i urdhëroni njerëzit për të mira …" – Të mirat këtu nënkuptojnë besimin dhe mirësitë që kryhen të nxitura prej besimit.

Kjo pyetje përmban në vetvete qortim dhe habi. Pra: Si është e mundur që i urdhëroni njerëzit për të mira, dhe pastaj:

- "…dhe e harroni vetveten" – Domethënë, harroni që, së pari, të urdhëroni veten për këto mirësi?!

Pastaj, Allahu përmend edhe një fakt tjetër, që e shton më shumë habinë:

- "…kur ju e lexoni librin *(Teuratin)*?! A nuk po mendoni?!" – Kuptimi: A nuk logjikoni, kur ju e lexoni librin, i cili urdhëron të jeni ju përqafuesit e parë të imanit dhe të veprave të tij. Si mund ta harroni veten?! A nuk mendoni pak për këtë fakt?!

Allahu i Lartësuar e ka pajisur njeriun me mendje, me anë të së cilës ai dallon gjërat që i sjellin dobi dhe mirësi. Me anë të mendjes, ai arrin të kuptojë, gjithashtu, çdo gjë që e dëmton. Kjo mendje e shtyn njeriun që të jetë zbatuesi i parë i atyre gjërave për të cilat ai i urdhëron të tjerët, dhe të jetë i pari që i largohet atyre gjërave për të cilat ai qorton dhe i ndalon të tjerët.

Kush urdhëron të tjerët për diçka, dhe vetë nuk e vepron atë, apo që i ndalon të tjerët nga diçka, dhe vetë e vepron atë, është i mangët dhe nuk mendon e gjykon drejt. Kjo

sjellje tregon paditurinë e tij të thellë. Kjo mangësi e mendjes bëhet më e spikatur kur ai është i vetëdijshëm për këtë, kur i ka kuptuar agumentat e, megjithatë, përsëri vazhdon të urdhërojë për punë të mira duke mos i vepruar vetë, dhe të ndalojë nga punët e këqija dhe t'i veprojë vetë ato.

Ky ajet, edhe pse ka zbritur duke iu drejtuar çifutëve, ai është gjithëpërfshirës. Allahu i Madhëruar thotë: "O ju që keni besuar, pse e thoni atë që vetë nuk e veproni? Për Allahun, është shumë e urryer që ta thoni atë gjë që vetë nuk e veproni". [Saf, 2-3].

Por kjo nuk do të thotë që, meqë nuk e praktikon vetë atë gjë për të cilën urdhëron apo ndalon të tjerët, atëherë njeriu ta braktisë edhe urdhërimin për të mira dhe ndalimin nga të këqijat. Përkundrazi, ky ajet është qortim për ata që nuk i plotësojnë të dyja këto detyra.

Është e kuptueshme se njeriu ka dy detyra:
1. Të urdhërojë fillimisht veten për punë të mira dhe ta ndalojë atë nga të këqijat.
2. Të urdhërojë të tjerët për këto të mira dhe t'i ndalojë ata nga ato të këqija.

Kështu, lënia e njërës detyrë nuk mund të jetë justifikim për lënien e tjetrës. Përsosmëria i takon atij që i plotëson të dyja ato, kurse i mangët është ai që i lë të dyja. Kurse ata që plotësojnë njërin kusht dhe lënë tjetrin, qëndrojnë mes dy gradave.

Nga ana tjetër, mund të themi se shpirtrat (në përgjithësi) janë të prirur që të mos i nënshtrohen atij njeriu, veprat e të cilit janë në kundërshtim me fjalët që thotë. Ndikimi që kanë tek ata veprat e kryera, është më i madh se ndikimi a gjurmët që lënë fjalët e pashoqëruara me punë.

- "Kërkoni ndihmë me durim dhe me namaz!" - Allahu i Lavdëruar na urdhëron që, për të kërkuar ndihmë për çështjet tona, duhet të jemi të duruar. Ndihmën duhet ta kërkojmë me të gjitha llojet e durimit.

Ka shumë lloje durimi, por ato më kryesoret janë:

1. Durimi që tregohet në bindjen ndaj Allahut të Lartësuar, derisa ta arrijmë atë në formën më të mirë.
2. Durimi ndaj gjynaheve dhe mosbindjes. Pra, durimi që duhet të tregojmë për t'u larguar nga haramet dhe që të mos shkelim kufijtë e Allahut.
3. Durimi gjatë ngjarjeve të dhimbshme, të cilat Allahu i Lartësuar i ka përcaktuar për ne. Ky durim konsiston në pranimin me zemër të kënaqur të këtyre përcaktimeve, duke mos shprehur as më të voglin zemërim apo pakënaqësi kundrejt tyre.

Nëse do të tregohemi të durueshëm dhe të vetëpërmbajtur në situata të vështira, ashtu si na urdhëron Allahu i Lartësuar, atëherë kjo do të jetë një ndihmë shumë e madhe për kapërcimin e tyre. Kush përpiqet të jetë i duruar, Allahu i Lartësuar ka për t'ia lehtësuar këtë gjë dhe patjetër do ta bëjë të durueshëm.

Të njëjtën gjë mund të themi edhe për namazin, i cili është treguesi i besimit në zemër dhe i cili e frenon dhe e ndalon njeriun nga çdo vepër e shëmtuar. Një namaz i tillë është rrugëzgjidhje dhe ndihmë për çdo çështje e problem.

- "Vërtet, kjo është *(arritje)* e madhe, por jo për ata që kanë frikë…" – Domethënë, për këta të fundit është e thjeshtë kjo mënyrë e kërkimit të ndihmës. Është e thjeshtë, sepse të tillë e bën droja e tyre ndaj Allahut dhe shpresa për të arritur shpërblimin e madh të Tij.

Frikë-respekti për Allahun dhe shpresa e madhe për shpërbilimin e Tij, e nxisin robin që të kërkojë ndihmë nëpërmjet këtyre mënyrave të vështira (me durim e me namaz). Madje, ai i bën ato duke qenë i kënaqur dhe me zemër të qetë, pasi kujton shpërblimin e Allahut dhe ka frikën e ndëshkimit.

Ndërsa ata të cilët nuk i kanë këto ndjenja (frikën dhe shpresën), ata nuk ka se çfarë t'i shtyjë të ndërmarrin të tilla mënyra, për të kërkuar ndihmë dhe rrugëzgjidhje. Edhe

sikur të përpiqeshin ndonjëherë të bënin ndonjë gjë të tillë, ajo do të ishte shumë e rëndë dhe e vështirë për shpirtrat e tyre, të cilat nuk janë pajisur me ndjenjën e frikë-respektit (*ħushû*) ndaj Allahut.

Por çfarë është, në fakt, ndjenja e *ħushû*-it, lehtësuesja e vetme e situatave të vështira? *Ħushû* është ndjenja e përuljes së zemrës ndaj Allahut. Ajo është prehja dhe qetësia që ndien zemra kur kujton Allahun. Ajo është një lloj përunjësie përpara Krijuesit, e shoqëruar me një ndjenjë nevoje dhe varfërie për mëshirën e Tij. Kjo përulje vjen si pasojë e besimit të patundur të adhuruesit, se do të takohet me Allahun e Lartësuar. Ky besim është burimi i këtyre ndjenjave. Prandaj i Madhëruari, duke shpjeguar cilësitë e atyre që e kanë këtë ndjenjë, thotë:

- "...të cilët janë të bindur se do ta takojnë Zotin e vet dhe se, pa dyshim, tek Ai do të kthehen" – Domethënë, të tillë janë ata që janë të sigurt se do ta takojnë Zotin e tyre dhe që Ai ka për t'i shpërblyer për veprat e tyre; janë ata të cilët janë të sigurt se, një ditë prej ditësh, do të kthehen sërish tek Ai që i solli për herë të parë në jetë.

Është përkujtimi i këtij takimi të rëndësishëm, ai që ua lehtëson atyre adhurimet që kryejnë për Allahun. Ky takim i ngushëllon ata gjatë fatkeqësive dhe sprovave. Ky takim ua lehtëson sfidat e mëdha. Takimi me Allahun ua lehtëson atyre, gjithashtu, largimin nga veprat e ndaluara e të këqija. Pikërisht për ata janë përgatitur mirësitë e përjetshme, mes atyre vendbanimeve të larta. Ndërsa ata që nuk shpresojnë takimin me Allahun, e kanë tmerrësisht të vështirë të kërkojnë ndihmë dhe rrugëzgjidhje me namaz apo me ndonjë adhurim tjetër përkushtuar Allahut të Lartësuar.

Më, pas Allahu i Lartësuar u rikujton edhe një herë bijve të Israilit mirësitë e Tij ndaj tyre, me qëllim që kjo t'i përkujtojë dhe t'u shërbejë si qortim dhe nxitje (për të qenë mirënjohës dhe të bindur). Kështu, i Lartësuari thotë:

- "O bijtë e Israilit! Përkujtoni të mirat e Mia, me të cilat ju begatova! Unë ju pata dalluar mbi njerëzit e tjerë *(të asaj kohe)*"

Pastaj Ai i kërcënon ata, për t'iu frikësuar Ditës së Kiametit. Atë ditë, askush nuk mund t'i bëjë dobi askujt. I Madhëruari thotë:

- "Ruajuni asaj dite, kur askush, askujt nuk do të mund t'i bëjë asgjë!" - Askush, sado i nderuar dhe i madh qoftë: melek, profet, apo njeri i mirë, nuk do të ketë në dorë asnjë mundësi ndihme për askënd. Ata nuk mund të ndihmojnë asnjë, sado i dashur apo i afërt të jetë ai që kërkon ta ndihmojnë. E vetmja ndihmë për njeriun do të jetë prej veprave që ka bërë.

Edhe ndërmjetësimet janë të papranueshme pa lejen dhe pa kënaqësinë e Allahut të Lartësuar. I Lartësuari thotë:

- "Atë ditë nuk pranohet për të *(jobesimtarin)* ndonjë ndërmjetësim" – Për ndërmjetësimin duhet të plotësohen dy kushte: Së pari, të jepet leja nga Allahu i Lartësuar për të dhe, së dyti, Allahu i Lartësuar të jetë i kënaqur me atë për të cilin ndërmjetësohet.


Nga ana tjetër, dihet shumë mirë që Allahu i Lartësuar nuk kënaqet nga vepra e askujt, nëse ajo vepër nuk plotëson dy kushte:

1. Të kryhet me sinqeritet për Allahun, duke kërkuar kënaqësinë e Tij.

2. Të kryhet në përputhje me traditën e Pejgamberit (s.a.u.s.) dhe mësimeve të tij.

Nuk pranohet ndërmjetësim, por as kompensim, siç thotë i Madhëruari:

- "...Nuk pranohet për të kompensim" – Për këtë, i Lartësuari thotë sërish në Kur'ân, "E sikur e tërë ajo çka gjendet në tokë, plus edhe një herë sa aq, të ishte e atyre që nuk besuan, ata do ta jepnin si kompensim, për t'i shpëtuar dënimit të tmerrshëm në Ditën e



Kijametit. Atëherë, do të përballen prej Allahut me atë *(lloj dënimi)* që nuk kanë mundur as ta mendojnë." [Zumer 47]. Domethënë, nuk do të pranohet kompensim prej tyre. Ata, gjithashtu, nuk do të ndihmohen:

- "...e ata nuk kanë për t'u ndihmuar" – Domethënë, prej atyre nuk do të largohet ajo të cilës ata i druhen dhe asnjë krijesë nuk do të ketë mundësi t'u bëjë dobi apo t'u largojë ndonjë dëm.

Thënia e Allahut: "*la texhzi nefsun an nefisin shejâ*" (...askush, askujt nuk do të mund t'i bëjë asgjë), tregon pamundësinë e të gjithëve për të bërë dobi atë ditë. Ndërsa thënia: "*ue lâ hum junsârûn*" (e ata nuk kanë për t'u ndihmuar) tregon pamundësinë e tyre për të larguar të keqen dhe të dëmshmen.

Në thënien e Allahut: "*lâ juḳbelu minhâ shefâ'atun*" (nuk pranohet për të asnjë ndërmjetësim), dhe në thënien tjetër të Tij: "*...Ue lâ ju'ḫadhu minhâ adlun*" (Nuk pranohet për të kompensim), mësohet diçka shumë e rëndësishme. Nëse njeriu e kupton se fitimi i të mirave dhe largimi i të këqijave nuk mund të arrihen duke ia kërkuar krijesave, atëherë ai kthehet për t'ia kërkuar sinqerisht ato të vetmit që mund t'ia dhurojë (Allahut). Arritja e të mirave dhe largimi i të këqijave nuk mund të bëhet, gjithashtu, as me kompensime dhe as me ndërmjetësime, sikurse ndodh mes krijesave. Atë ditë nuk do të jetë askush i aftë qoftë edhe për një grimcë dobie apo dëmi. Kjo është një ftesë e hapur që adhuruesi të lidhet fort dhe sinqerisht vetëm me Allahun e Lartësuar, duke i kërkuar të mirat veç prej Tij dhe duke kërkuar mbrojtje nga çdo e keqe vetëm tek Ai. Kjo është ftesë për ta adhuruar Atë si Një të vetëm, sepse veç Ai e meriton adhurimin tonë dhe vetëm tek Ai duhet të mbështetemi për t'i përkryer adhurimet tona.

Ajetet 49 – 57

49. Ne ju shpëtuam prej popullit të Faraonit, të cilët ju torturonin me format më të këqija, ju thernin bijtë tuaj *(meshkujt e porsalindur)* dhe linin të gjalla bijat tuaja *(vajzat e porsalindura)*. E gjithë kjo ishte një sprovë e madhe nga Zoti juaj.
50. Për ju, Ne e ndamë detin *(duke hapur shtigje në të)* e ju shpëtuam, ndërkohë që ju i patë ithtarët e Faraonit të mbyteshin.
51. Ne i premtuam Musait dyzet net *(për t'i shpallur Teuratin)*, dhe pas *(largimit të)* tij, ju adhuruat viçin *(si Zot)*, duke qenë të padrejtë.
52. Megjithatë, edhe pas kësaj *(padrejtësie të shëmtuar)*, jua falëm *(gabimin)*, që ju të bëheni mirënjohës *(ndaj Meje)*.
53. Ne i dhamë Musait Librin, Dalluesin *(e të vërtetës nga e gabuara)*, që ju të shihnit qartë udhëzimin dhe rrugën e drejtë.
54. Musai i tha popullit të vet: "O populli im! Ju u treguat të padrejtë ndaj vetvetes me adhurimin e viçit *(në vend të Zotit)*. Pendohuni para Krijuesit tuaj dhe ekzekutoni njëri-tjetrin *(i miri të vrasë kriminelin)*. Për Krijuesin tuaj, kjo është më e mira *(zgjidhje)* për ju. Ai jua pranoi

pendimin tuaj. Është Ai, Pranuesi i pendimit, Mëshiruesi.
55. Ju thatë: "O Musa! Ne nuk kemi për të të besuar, derisa ta shohim Allahun haptazi!" Menjëherë *(pas kësaj)*, ju përfshiu rrufeja, dhe ju e patë.
56. Pastaj, pas vdekjes suaj, ju ringjallëm, që të ishit mirënjohës.
57. I nënshtruam retë *(gjatë udhëtimit tuaj në shkretëtirë)*, me qëllim që t'ju bënin hije, dhe nga qielli ju furnizonim me *menna (rrëshirë e ëmbël)* dhe me shkurtëza *(duke ju thënë)*: "Hani nga të mirat me të cilat ju kemi furnizuar!". Por *(me këto padrejtësi)*, ata nuk dëmtuan asnjë tjetër, përveç vetes.

Shpjegimi i ajeteve

Tani fillojnë dhe përmenden më imtësisht mirësitë që Allahu i Lartësuar u dhuroi bijve të Israilit. Atëherë, i Lartësuari thotë:

- "Ne ju shpëtuam prej popullit të Faraonit..." – Pra, nga Faraoni, bashkë me parinë dhe ushtrinë e tij, të cilët më përpara:

- "...ju torturonin me format më të këqija" – Domethënë, me torturat më të rënda. Ata:

"...ju thernin bijtë tuaj dhe linin të gjalla bijat tuaja". - Ata i thernin meshkujt, nga frika se mos bijtë e Israilit shumoheshin, ndërsa femrat i linin të gjalla. Kështu, bijtë e Israilit përdoreshin ose për punë të rënda, si skllevër, ose vriteshin. Ky ishte poshtërimi dhe ndëshkimi më i skajshëm.

- "E gjithë kjo ishte një sprovë e madhe nga Zoti juaj" - "E gjithë kjo", pra, torturat prej Faraonit dhe shpëtimi prej Allahut të lartësuar, do t'ju bëjë të kuptoni më qartë urtësinë e Allahut në përcaktimin e sprovave dhe të shpëtimit prej tyre.

- "Për ju, Ne e ndamë detin *(duke hapur shtigje në të)* e ju shpëtuam, ndërkohë që ju i patë ithtarët e Faraonit të mbyteshin" – Pra, Allahu i Lartësuar u bëri mirësi, duke i shpëtuar njëherë e mirë prej armikut të tyre dhe duke e mbytur ushtrinë e tij mu para syve të tyre, në mënyrë që ata ta shihnin vetë se çfarë ndihme iu dha Allahu i Lartësuar, dhe kështu të gjenin prehje dhe qetësi.

Më pas, Allahu i Lartësuar u përmend atyre një mirësi tjetër, kur i premtoi Musait një periudhë dyzetnetëshe për t'i shpallur atij Teuratin (ligjin e jetës), që përmbante ligje të vyera dhe tepër efikase:

- "Ne i premtuam Musait dyzet net *(për t'i shpallur Teuratin)*" - Por me gjithë këtë mirësi të pakrahasueshme, ata nuk duruan sa të plotësohej afati dhe, pas largimit të Musait, ata nisën të adhuronin një viç. I Madhëruari thotë:

- "...dhe pas tij, ju adhuruat viçin *(si Zot)*, duke qenë të padrejtë..." – Kuptimi: Ju ishit të vetëdijshëm për padrejtësinë tuaj (pasi edhe Haruni iu foli dhe i këshilloi, por ata nuk iu bindën), duke mos patur asnjë lloj argumenti dhe justifikimi në këtë vepër të shëmtuar.

Refuzimi i të vërtetës, pas njohjes mirë të saj, është krim shumë i shëmtuar. Megjithatë, Allahu i Lartësuar i urdhëroi të pendohen. Këtë urdhër ata e morën të qartë nga goja e Profetit të tyre (Musait):

- "Musai i tha popullit të vet: "O populli im! Ju u treguat të padrejtë ndaj vetes me adhurimin e viçit *(në vend të Zotit)*. Pendohuni para Krijuesit tuaj..." - Mënyra e pendimit të tyre do të ishte duke vrarë njëri-tjetrin. [1]

"...dhe ekzekutoni njëri-tjetrin. Për Krijuesin tuaj, kjo është më e mira *(zgjidhje)* për ju. Ai jua pranoi pendimin tuaj. Është Ai, Pranuesi i pendimit, Mëshiruesi." - Pasi të bënin këtë, Allahu i

[1] I urdhëroi që ata që adhuruan viçin të egzekutoheshin nga ata që nuk e adhuruan atë.

Lartësuar do t'ua falte atyre gabimin e adhurimit të viçit.

Duke deklaruar faljen e tyre dhe qëllimin e saj, i Lavdëruari thotë:

- "Megjithatë, edhe pas kësaj, Ne ju falëm, që ju të bëheni mirënjohës *(ndaj Meje)*". – Madje, përveç faljes:

- "Ne i dhamë Musait Librin, Dalluesin *(e të vërtetës nga e gabuara)*, që ju të shihnit qartë udhëzimin dhe rrugën e drejtë." – Por, në vend të mirënjohjes, erdhi paturpësia dhe padrejtësia e tyre ndaj Allahut të Lartësuar dhe Krenar dhe ndaj Profetit të Tij. Ata i kërkuan Musait, si kusht, që të shihnin Allahun e Lartësuar.

- "Ju thatë: "O Musa! "Ne nuk kemi për të të besuar, derisa ta shohim Allahun haptazi"! Por, pas kësaj paturpësie:

- "Menjëherë ju përfshiu rrufeja, dhe ju e patë" – Domethënë, ata i kapi rrufeja, që u shkaktoi vdekjen (ose gjendje kome), dhe ata e panë njëri-tjetrin kur kjo ndodhi. Më pas, Allahu i Lartësuar i ringjalli pas vdekjes, me qëllim që të bëheshin mirënjohës.

- "Pastaj, pas vdekjes tuaj, ju ringjallëm, që të ishit mirënjohës". - Kuptimi: Pas vdekjes suaj, Allahu ju ringjalli, që të falënderonit dhe të tregoheshit mirënjohës, me mënyrën që Ai jua ka treguar në Libër dhe Traditën Profetike.

Pas gjithë këtyre, Allahu i Lartësuar u kujton edhe mirësitë e Tij gjatë bredhjes së tyre nëpër shkretëtirë, e cila nuk kishte asnjë vend me hije, ku ata mund të çlodheshin. Pikërisht në të tilla vende, erdhi mirësia dhe furnizimi i pamatë i Allahut të Lartësuar. Ai thotë:

- "I nënshtruam retë (*gjatë udhëtimit tuaj në shkretëtirë*), që t'ju bënin hije, dhe nga qielli ju furnizonim me *menna* dhe me shkurtëza". - *Menna* është një emër që përfaqëson çdo mirësi dhe furnizim të këndshëm që përfitohet pa lodhje e pa mundim, si, për shembull, kërpudhat (*kem'ah*), xhenxhefili etj. Ndërsa shkurtëza (*selua*) është një zog i vogël, që ka mish shumë të shijshëm.

Ky lloj ushqimi u zbriste nga qielli dhe aq sa u mjaftonte për të plotësuar nevojat e tyre të përditshme.

- "Hani nga të mirat me të cilat ju furnizuam!" - Kuptimi: Hani prej mirësive me të cilat ju furnizuam! E çfarë furnizimi se? Furnizim që, edhe banorët e qyteteve dhe të pasurit nuk e kishin provuar ndonjëherë.

Megjithatë, mirënjohja e tyre nuk po dukej. Madje, ata vazhduan të mos e ndryshonin ashpërsinë dhe ngurtësinë e zemrave të tyre, duke u zhytur thellë e më thellë në gjynahe dhe poshtërsi.

Sidoqoftë, me këto vepra të ndyra, të cilat ishin totalisht në kundërshtim me urdhrat e Allahut, ata nuk mund t'i bënin padrejtësi apo të dëmtonin Allahun e Lartësuar. Ai nuk mund të dëmtohet nga mosbindja e krijesave të Tij, ashtu sikurse edhe bindja nuk i sjell Atij ndonjë dobi. Ai thotë:

- "Por ata nuk na dëmtuan Ne. Ata dëmtuan veç vetveten" – Domethënë, dëmi i këtyre padrejtësive godet pikërisht ata, dhe aspak Allahun Madhështor.

Ajetet 58 – 61


58. Ne ju thamë: "Hyni në këtë qytet dhe hani aty lirisht e ku të dëshironi! Hyni te portat *(e qytetit)* të përulur dhe thoni: "Kërkojmë ndjesë *(Hittatun)*!" Sepse Ne jua falim mëkatet tuaja! Ndërsa bamirësve ua shtojmë *(të mirat)*.

59. Ata që ishin të padrejtë, e ndryshuan atë që u ishte thënë me një tjetër fjalë. Mbi ata që bënë padrejtësi, Ne lëshuam ndëshkim nga qielli, për shkak të shkeljes së kufijve të Allahut.

60. Kur Musai kërkoi ujë për popullin e tij, Ne i thamë: "Godite shkëmbin me

shkopin tënd!" Menjëherë prej tij *(shkëmbit)*, gufuan dymbëdhjetë burime. Secili grup *(fis)* e dinte vendin ku do të pinte ujë. "Hani dhe pini *(u thamë)* nga begatitë e Allahut, dhe mos vazhdoni të jeni çrregullues në tokë!"

61. Kur ju thatë: "O Musa! Ne nuk mund të durojmë vetëm një lloj ushqimi. Lute Zotin tënd për ne, që të na furnizojë me perimet që rrit toka: me tranguj, hudhra, thjerrëza dhe qepë!" Ai *(Musai)* tha: "A po preferoni ato që nuk kanë vlerë kundrejt atij ushqimi që është më i mirë?! Atëherë, zbrisni në qytet, se atje, pa dyshim, do t'i gjeni ato që kërkoni!" Mbi ta rëndoi poshtërimi dhe skamja. Ata e merituan zemërimin e Allahut. Kjo, sepse ata i mohonin argumentet e Allahut dhe i vrisnin profetët pa kurrfarë të drejte, si dhe për shkak të mosbindjes *(ndaj Zotit)* dhe shfrenimit *(të tyre)* në shkeljen e kufijve *(të Zotit)*.



Shpjegimi i ajeteve

"Ne ju thamë: "Hyni në këtë qytet dhe hani aty lirisht e ku të dëshironi!" - Edhe kjo që një tjetër mirësi ndaj tyre, pas padrejtësisë dhe mosbindjes së tyre.

Allahu i Lartësuar i urdhëroi ata të hynin në një vend, që do të ishte atdheu i tyre, vendi i krenarisë, i prehjes dhe i qetësisë për ta, ku do të shijonin furnizimin dhe të mirat e dhuruara prej Tij. Ai i urdhëroi që të hynin në këtë vend, duke shprehur nënshtrimin ndaj Allahut të Lartësuar me rënien në sexhde në momentin e hyrjes dhe duke thënë me gojë: "Kërkojmë falje (*Ĥittatun*)!"

- "Hyni te portat *(e qytetit)* të përulur dhe thoni: "Kërkojmë ndjesë (*Hittatun*)!" Sepse Ne jua falim mëkatet tuaja!" - Me këtë përulje, të shprehur me vepër (me sexhde) dhe me fjalë, ata do të pastroheshin nga gjynahet e tyre të shumta.

Kuptimi: Me kërkesën tuaj për t'jua fshirë gjynahet, Ne do t'jua fshijmë ato. Por jo vetëm kaq. Çdokush që bën vepra të mira, Allahu i Lartësuar do ta shpërblejë më shumë, si në këtë jetë, ashtu edhe në jetën tjetër, siç thotë i Lartësuari:

- "Ndërsa bamirësve ua shtojmë *(të mirat)."*

Megjithatë, jo të gjithë e pranuan këtë ofertë. Të padrejtët e shpërfillën atë, duke u tallur në mënyrë të pacipë:

- "Ata që ishin të padrejtë, e ndryshuan atë që u ishte thënë me një tjetër fjalë" – Ata, në vend të shprehjes së urdhëruar: "Kërkojmë falje (*Hittatun*)!", përdorën: "*Hintatu*", që do të thotë: "Kokër gruri". Me këtë veprim, ata treguan shpërfillje dhe tallje ndaj ofertës për t'u pastruar nga gjynahet.

Kur shpërfillja e tyre ishte kaq e madhe për një fjalë, që mund të thuhej lehtësisht, po për veprimin e sexhdes, që ishte edhe më i vështirë, si do të ishte përgjigjja e tyre?! Kështu ata, në vend që të binin në sexhde, hynë në atë vendbanim duke futur së pari të ndenjurat e tyre, të cilat i tërhiqnin zvarrë. Ndërsa të padrejtët nga mesi i tyre e

zëvendësuan shprehjen që iu kërkua të thonin me një tjetër shprehje.

Për shkak të kësaj padrejtësie dhe paturpësie të madhe, Allahu i Lartësuar zbriti për këta kriminelë një ndëshkim nga qielli.

- "Mbi ata që bënë padrejtësi, Ne lëshuam ndëshkim nga qielli, për shkak të shkeljes së kufijve të Allahut" – Pra, Allahu i Lartësuar u zbriti ndëshkimin, për shkak të kalimit të kufijve në poshtërsi nga ana e tyre.

Më pas, i Lavdëruari thotë:

- "Kur Musai kërkoi ujë për popullin e tij",- Domethënë, kërkoi ujë, që të pinin ata.

- "Ne i thamë: "Godite shkëmbin me shkopin tënd!" - Ky mund të ketë qenë ndonjë shkëmb i veçantë, por mund të ketë qenë edhe shkëmb i çfarëdoshëm.

- "Menjëherë prej tij, gufuan dymbëdhjetë burime" - Edhe fiset e bijve të Israilit ishin dymbëdhjetë në numër.

- "Secili grup *(fis)* e dinte vendin ku do të pinte ujë" - Çdo fis e dinte vendin ku duhet të pinte, dhe askush nuk e shqetësonte tjetrin. Ata pinin me qetësi, pa u ngutur dhe pa vuajtur. Pastaj Allahu i Lartësuar u thotë.

- "Hani dhe pini nga begatitë e Allahut, dhe mos vazhdoni të jeni çrregullues në tokë" - Kuptimi: Hani dhe pini prej të mirave që ju dhuruam, pa u lodhur dhe pa punuar nga ana juaj.

- "Kur ju thatë: "O Musa!..." - Përkujtoni pra, kur ju drejtuat Musait për t'i treguar se ishit mërzitur dhe velur nga mirësitë e Allahut, duke treguar një lloj shpërfilljeje dhe pakënaqësie për to. Kështu, ju i thatë atij:

"Ne nuk mund të durojmë vetëm një lloj ushqimi. Lute Zotin tënd për ne, që të na furnizojë me perimet që rrit toka: me tranguj, hudhra, thjerrëza dhe qepë!" - Kuptimi: Nuk kemi për të duruar të njëjtin ushqim gjithmonë. Ato, në fakt, ishin shumë lloje, por përsëriteshin herë pas here.

Kështu, ata filluan të numëronin disa lloje perimesh të gjelbra, si: tranguj, hudhra, thjerrëza dhe qepë. Atëherë, Musai u thotë:

- "A po preferoni ato që nuk kanë vlerë, kundrejt asaj që është më e mirë?!" – Kuptimi: A po kërkoni të konsumoni këto ushqime, në vend të asaj që është më e mirë, të cilën jua dhuronte Allahu i Lartësuar? Kjo vërtet është e çuditshme.

- "Zbrisni në qytet, se atje, pa dyshim, do t'i gjeni ato që kërkoni!" - Kuptimi: Në çdo qytet që të shkoni, keni për t'i gjetur ato ushqime që ju kërkoni, por ushqimi që ju falte Allahu i Lartësuar është më i miri dhe më i pëlqyeshmi. Atëherë, si mund ta kërkoni këtë shkëmbim?!

Kjo kërkesë dhe veprat e tjera të kryera nga ata ishin argumente të qarta, që tregonin durimin e pakët të tyre, mospërfilljen e theksuar ndaj dispozitave të Allahut të Lartësuar dhe mosmirënjohjen e tyre ndaj mirësive të Tij. Në përfundim, Allahu i shpërbleu sipas sjelljes së tyre të poshtër.

- "Mbi ta rëndoi poshtërimi dhe skamja. Ata e merituan zemërimin e Allahut" - Ata i kapi poshtërimi, që ishte diçka e dukshme me sy, dhe, njëkohësisht, u hyri 'varfëria' në zemër.

Shpirtrat e tyre nuk e provuan kurrë krenarinë dhe lartësinë. Ata kurrë nuk patën vullnet dhe ambicie të larta, sepse shpirtrat e tyre ishin të ulët, dhe të tilla ishin edhe synimet e tyre. Me kërkesat që parashtronin, ata nuk përfituan gjë tjetër, përveç zemërimit të Allahut të Lartësuar. Fitimi më i ndyrë ishte fitimi i tyre, dhe gjendja më e poshtër ishte gjendja e tyre.

Ata e merituan këtë zemërim të Allahut, për shkak të mohimit të argumenteve dhe mospërfilljes të tyre, siç thotë i Madhëruari:

- "Kjo ndodhi, sepse ata i mohonin argumentet e Allahut..." – Domethënë, zemërimi i Allahut me ta erdhi si pasojë e mohimit nga ana e tyre të argumenteve që tregonin të vërtetën dhe që e qartësonin atë. Kur ata mohuan, atëherë ndëshkimi i merituesheëm ishte zemërimi i Allahut ndaj tyre.

Një shkak tjetër për këtë zemërim ishte edhe vrasja e profetëve prej tyre. A ka padrejtësi më të madhe se kjo?! Thotë i Lartësuari:

"...dhe i vrisnin profetët pa kurrfarë të drejte." - Fjala e Allahut: "pa kurrfarë të drejte", tregon peshën e madhe të kësaj padrejtësie. Ndonëse dihet që vrasja e një Profeti nuk mund të jetë kurrë e drejtë, kjo fjalë është thënë me qëllim që askush të mos mendojë se ata e kanë bërë këtë vepër pa dije, apo nga paqartësia e tyre. Përkundrazi, ata e bënin këtë punë të shëmtuar me vetëdije të plotë dhe të bindur në atë që bënin.

Kësisoj, të gjitha pasojat ishin rezultat i poshtërsive dhe i mosbindjes së tyre ndaj Allahut të Lartësuar, siç thotë Ai:

- "si dhe për shkak të mosbindjes *(ndaj Zotit)* dhe shfrenimit *(të tyre)* në shkeljen e kufijve *(të Zotit)."* – Pra, e gjithë kjo ndodhi sepse ata ishin të pabindur. Ata ishin gjithmonë armiqësorë ndaj adhuruesve të Allahut të Lartësuar.

Gjynahet dhe mosbindja shkaktojnë njëra-tjetrën dhe bëhen nxitje për njëra-tjetrën. Hapi i parë drejt shkatërrimit është pakujdesia ose nënvleftësimi, i cili sjell së pari gjynahet e vogla, ndërsa të voglat sjellin më pas të mëdhatë. Pastaj, këto rrjedhojnë në larmi formash të bidatit, kufrit etj. E lusim Allahun të na ruajë nga çdo lloj belaje dhe sprove të tillë.


Këto ajete u drejtoheshin judejve që ishin të pranishëm gjatë kohës kur shpallej Kur'âni. Këto vepra ishin pikërisht "bëmat" e të parëve të tyre, të cilat u përmendeshin për arsye të shumta, ndër të cilat:

1. Hebrenjtë shpesh lëvdonin veten, duke pretenduar se ishin pa të meta e, madje, më të mirë se Muhamedi (a.s.) dhe besimtarët që ndoqën rrugën e tij. Atëherë, nëpërmjet Pejgamberit (s.a.u.s.), Allahu i Lartësuar ua kujtoi se çfarë kishin bërë të parët tyre, që edhe ata vetë i pranonin, madje ishin të sigurt për to. Rrëfimet në Kur'ân ua bënin të qartë se të parët e tyre, me të cilët ata lëvdoheshin, nuk ishin aq të durueshëm dhe me morale të larta, por ishin njerëz pa vullnet dhe gjithmonë të thyeshëm përpara sprovave. E pra, nëse gjendja e të parëve të tyre, me të cilët ata lëvdoheshin, kishte qenë e tillë, atëherë si mund të ishte gjendja e brezit të kohës kur vinte Shpallja?!

2. Këto ngjarje u përmendeshin atyre për t'u rikujtuar mirësitë që Allahu i Lartësuar u pati dhënë të parëve të tyre. Normalisht, mirësitë ndaj paraardhësve konsiderohen si mirësi edhe ndaj pasardhësve. Kështu, përmendja e këtyre mirësive vlente si vërejtje edhe për çifutët e brezit aktual.

3. Fakti që Allahu i Lartësuar i drejtohej këtij brezi, me qëllim që të merrte mësim prej brezit të shkuar, tregon se pjesëtarët e një bashkësie fetare janë ndihmues dhe plotësues të njeri-tjetrit. Përparimi i njërit sjell edhe përparimin e tjetrit, sikurse edhe prapambetja e njërit sjell domosdo prapambetjen e tjetrit. Veprat e mira të kryera nga njëri grup, sjellin përfitim dhe mirësi për të gjithë umetin, ashtu sikurse edhe veprat e këqija të njërit sjellin fatkeqësi dhe dënim për të gjithë të tjerët. Në rastin konkret, ata nuk hoqën dorë nga shumë vepra të këqija dhe nuk e qortonin njëri-tjetrin për t'u frenuar prej tyre. Rrjedhimisht, kush tregon miratim dhe kënaqet me një gjynah, është pjesëmarrës dhe bashkëpunëtor në atë gjynah.

Megjithatë, përveç këtyre që përmendëm ne, ka edhe shumë arsye e urtësi të tjera.



Ajetet 62 – 66

Duke gjykuar rreth grupeve të cilëve u dha libra hyjnorë, i Madhëruari thotë:

62. Vërtet, ata që besojnë *(të gjithë profetët)*, çifutët, të krishterët, sabi'inët, *(pra)* të gjithë ata prej tyre që besojnë Allahun dhe botën tjetër e që bëjnë vepra të mira, do ta kenë shpërblimin te Zoti i tyre. Për ta nuk ka frikë dhe as nuk do të brengosen.

63. *(Kujtoni)* Kur Ne morëm prej jush besën *(për bindje ndaj Meje)* dhe ngritëm mbi ju *(kodrën)* Turin, *(duke ju thënë)*: "Merreni seriozisht atë *(Teuratin)* që ju dhamë dhe mbani në mendje përmbajtjen e tij, që të jeni të devotshëm!"

64. Por edhe pas asaj *(besës)*, ju kthyet shpinën *(ndaj udhëzimeve të Zotit)*. Po të mos ishte mirësia dhe mëshira e Allahut ndaj jush, do të ishit prej të dëshpëruarve *(në të dy jetët)*.

65. Ju, tanimë, e dini rastin e atyre nga mesi juaj, të cilët nuk respektuan *(urdhrin për)* të shtunën. Ne u thamë: "Shndërrohuni në majmunë të përbuzur!"

66. Atë *(shndërrim të tyre)* e bëmë, për të marrë mësim ata që e përjetuan *(me sy)* dhe brezat pasardhës, por edhe si këshillë për të devotshmit.

Shpjegimi i ajeteve

- "Vërtet, ata që besojnë *(të gjithë profetët)*, çifutët, të krishterët, sabi'inët..."– Domethënë, gjykimi që do të vijojë vlen vetëm për ata të cilëve u është dhënë libër qiellor. Edhe sabi'iinët konsiderohen si grupacionet e krishtera.

Më tej, i Madhëruari tregon cilësitë e të shpëtuarve prej tyre:

- të gjithë ata prej tyre që besojnë Allahun dhe botën tjetër e që bëjnë vepra të mira..." Kështu, i Madhëruari përshkruan me këto cilësi besimtarët e këtij umeti (muslimanët) dhe ata të umeteve të shkuara, që ishin çifutët, të krishterët dhe sabi'inët:

1. besojnë Allahun dhe botën tjetër:

2. bëjnë vepra të mira.

Pikërisht këta do të fitojnë shpërblimin e madh që u ka përgatitur Allahu, si dhe prehjen dhe sigurinë e madhe pranë Tij:

- "...do ta kenë shpërblimin te Zoti i tyre. Për ta nuk ka frikë dhe as nuk do të brengosen" - Ata nuk do ta provojnë frikën dhe as do të brengosen. Ndërsa çdo pjesëtar i këtyre umeteve që ka mohuar Allahun, profetët dhe Ditën e Fundit, ai do të fitojë të kundërtën e atyre që u përmendën, pra: do të jetë i pushtuar nga frika dhe trishtimi.

Është shumë e rëndësishme të kuptohet se ky është thjesht një njoftim rreth këtyre umeteve, i cili i referohet periudhës para dërgimit të Muhamedit (s.a.u.s.). (Sepse pas dërgimit të Muhamedit (s.a.u.s.), askush nuk ka për të shpëtuar nëse nuk e pranon dhe nuk e pason atë (a.s.), si profet të Allahut).

Ky është një pasqyrim i gjendjes së tyre, me të dyja anët e monedhës, që bëhet për të larguar ndonjë keqkuptim që mund të lindë në shpirtrat e njerëzve, kur lexojnë ajetet e Kur'ânit. Allahu e di më së miri, por shkaku i këtij pasqyrimi vjen për të sqaruar se, jo të gjithë pjesëtarët e atyre popujve, – të parët e të cilëve u qortuan dhe mangësitë e shumta të të cilëve u trajtuan këtu, – hynin në një kategori. Pra, Allahu i Lartësuar deshi që t'i dallonte ata të cilët nuk përfshiheshin në kategorinë e përshkruar me cilësi dhe vepra të ulëta. Ndoshta, nga përmendja e sjelljeve të poshtra të brezave të parë të çifutëve, dikush mund të kuptonte gabimisht se cilësi të tilla mund të kishin vetëm çifutët. Për këtë arsye, i Madhëruari i përmend popujt në përgjithësi, duke treguar cilësitë e pjesëtarëve që do të shpërblehen dhe cilësitë e atyre që do të ndëshkohen, nga secili popull. E gjithë kjo, për të larguar çdo keqkuptim dhe për të qartësuar të vërtetën.

I lavdëruar qoftë Ai, që brenda Librit të Tij ka sjellë gjëra që habisin mendjet e të gjithë botës!

Më pas, i Madhëruari i rikthehet qortimit të bijve të Israilit për veprat e ulëta të të parëve të tyre. Ai thotë:

- "Kur Ne morëm prej jush besën..." – Kuptimi: Përkujtoni kur Ne morëm premtimet tuaja të forta, që u bënë nga ju në momente kërcënimi, kur:

- "...ngritëm mbi ju *(kodrën)* Turin" - Domethënë: Kur mbi ju qëndronte kodra Tur. Në këtë kohë, Allahu i Lartësuar ju drejtua juve dhe ju urdhëroi:

- "Merreni seriozisht atë *(Teuratin)* që ju dhamë..." - Domethënë: Pranojini ligjet që ju zbritën me Teuratin. Pranojini ato me seriozitet dhe me përgjegjësi të madhe, duke treguar durim ndaj urdhrave të Allahut. Por jo vetëm kaq:

- "...dhe mbani në mendje përmbajtjen e tij, që të jeni të devotshëm" - Kuptimi: Përkujtojeni vazhdimisht atë që ndodhet në librin tuaj, duke e lexuar vazhdimisht dhe duke mësuar prej tij. Nëse e bëni këtë, ka shpresë të madhe për ju që:

- "...që të jeni të devotshëm" - Domethënë: Me shpresë që të shpëtoni, duke u ruajtur prej dënimit të Allahut dhe prej zemërimit të Tij. Ose: Me shpresë që të bëheni si ata që ruhen nga të këqijat, duke u stolisur me devotshmëri (*taḳuâ*).

Por edhe pas marrjes së premtimit tuaj, në të tilla kushte të jashtëzakonshme:

- "Por edhe pas asaj, ju kthyet shpinën *(ndaj udhëzimeve të Zotit)*." - Pra, pas atij premtimi që dhatë në një situatë të pashlyeshme nga kujtesa, ju përsëri kthyet shpinën. Atëherë, kjo e bëri më shumë se të meritueshme që mbi ju të binin ndëshkimet më të mëdha. Megjithatë:

- "Po të mos ishte mirësia dhe mëshira e Allahut ndaj jush, ju do të ishit prej të dëshpëruarve *(në të dy jetët)*".

Thotë i Lartësuari:

- "Ju, tanimë, e keni të njohur çështjen e atyre nga mesi juaj të cilët nuk respektuan *(urdhrin për)* të shtunën". – Pra, është shumë e njohur për ju çështja e atyre që u sprovuan ditën e shtunë. Këtë histori Allahu i Lartësuar e ka sjellë gjerësisht në suren Araf, ajetet 163 – 168: "Dhe pyeti *(o Muhamed)* për fshatin që ishte në breg të detit, të cilët e shkelën rregullin e së shtunës *(kur nuk lejohej peshkimi)*. Pikërisht të shtunën, atyre u vinin peshqit sheshazi mbi ujë *(si sprovë nga Allahu)*, ndërsa ditët e tjera *(kur lejohej peshkimi)* nuk u vinin. Kështu i sprovuam ata, sepse ata i kalonin kufijtë *(e Zotit)*. Një grup prej tyre thanë: "Përse e këshilloni ju një popull, të cilin Allahu dëshiron ta shkatërrojë ose t'i japë një ndëshkim të ashpër?" Thanë *(këshilluesit)*: "

Si arsyetim para Zotit tuaj dhe me shpresë që t'u largoheni të këqijave". Por, kur ata e braktisën atë për të cilën ishin këshilluar, Ne i shpëtuam ata që ndalonin nga të këqijat, ndërsa ata që kundërshtuan, i ndëshkuam me një dënim të ashpër, për shkak se ata ishin të shfrenuar. Kur ata ngulmuan me arrogancë në kryerjen e së ndaluarës, Ne i shndërruam në majmunë të përbuzur. Pastaj Zoti yt shpalli qartë se mbi ta do të vendoste, deri në Ditën e Kijametit, sundimin e dikujt, që ka për t'i ndëshkuar ata me formën me të rëndë. Vërtet, Zoti yt është ndëshkues i shpejtë, por Ai është edhe Falës e Mëshirues. Ne i shpërndamë ata nëpër tokë, grupe-grupe. Prej tyre ka të mirë, por edhe jo të tillë. Ne i provuam me të mira dhe me të këqija, në mënyrë që të tërhiqen *(nga rruga e keqe)*."

Domethënë, ky gjynah i madh i tyre i bëri që ta meritojnë goditjen e ashpër të zemërimit të Allahut të Lartësuar, duke i shndërruar në majmunë *(dhe në derra)* të shëmtuar dhe të poshtëruar.

- "Ne u thamë: "Shndërrohuni në majmunë të përbuzur!" - Këtë ndëshkim, Allahu i Lartësuar ua dha brezave të asaj kohe si dënim, dhe brezave të mëvonshëm si përkujtim. Po ashtu, në këtë mënyrë, ata nuk mund të kenë asnjë justifikim para Allahut të Lartësuar, në rast se shkelin të tilla urdhëra e ligje. Ai e la edhe si kërcënim për të tjerët, që njerëzit t'i largohen dhe t'i frikësohen seriozisht mosbindjes ndaj Tij. Allahu i sjell kërcënimet, edhe pse, në fund të fundit, ato mund të jenë përkujtim i dobishëm veçse për të devotshmit, pasi të tjerët nuk përfitojnë aspak prej tyre.

Kështu, i Lartësuari thotë:

- "Atë *(shndërrim të tyre)* e bëmë, për të marrë mësim ata që e përjetuan *(me sy)* dhe brezat pasardhës, por edhe si këshillë për të devotshmit."

Ajetet 67 – 74

67. Musai i tha popullit të vet: "Allahu ju urdhëron që të therni një lopë!" Ata thanë: "A po tallesh me ne?!" Ai tha: "Allahut i kërkoj të më ruajë, që të mos bëhem injorant!"

68. Ata thanë: "Lute Zotin tënd për ne, të na qartësojë se si duhet të jetë ajo?" Ai tha: "Ai *(Zoti)* thotë se ajo duhet të jetë një lopë as e vjetër, as e re, por e mesme. Zbatoni pra, atë që u urdhëruat të bëni!"

69. Ata thanë: "Lute Zotin tënd për ne, që të na sqarojë çfarë ngjyre duhet të ketë ajo?" Ai tha: "Ai *(Zoti)* thotë se ajo duhet të jetë një lopë e verdhë. Ngjyra e saj duhet të jetë *(e verdhë)* e ndezur, që të kënaqë shikuesit".

70. Ata thanë: "Lute Zotin tënd për ne, që të na sqarojë çfarë lloji duhet të jetë ajo, se lopët të gjitha na duken njësoj, e ne, në dashtë Allahu, do ta gjejmë të vërtetën!"

71. Ai *(Musa)* tha: "Ai *(Zoti)* thotë se ajo duhet të jetë një lopë, që nuk i është nënshtruar punës, as duke lëruar tokën, e as duke ujitur bimët. Ajo duhet të jetë pa asnjë të metë dhe pa asnjë shenjë *(ngjyrë)* tjetër!" Ata thanë: "Tani u sqaruam plotësisht". Kështu, ata e therën atë, por, për pak, desh e lanë pa e bërë këtë punë.

72. Pasi vratë një njeri e u grindët në lidhje me të, Allahu e zbuloi atë që e mbanit të fshehtë.

73. Ju thamë: "Prekeni atë *(të vdekurin)* me një pjesë të saj *(të lopës së therur)*! Dhe kështu, Allahu do t'i ngjallë të vdekurit dhe do t'ju sqarojë argumentet e Tij, në mënyrë që të kuptoni.

74. Megjithatë, zemrat tuaja, edhe pas kësaj, u bënë si guri, madje edhe më të forta. Ka gurë prej të cilëve burojnë lumenj. Ka prej tyre që çahen dhe prej tyre del ujë. Madje ka prej tyre që, nga frika ndaj Zotit, rrokullisen tatëpjetë. Allahu nuk është i pavëmendshëm ndaj asaj që veproni ju.

Shpjegimi i ajeteve

- "Pasi vratë një njeri e u grindët në lidhje me të, Allahu e zbuloi atë që e mbanit të fshehtë". – Kuptimi: Përkujtoni atë që

ndodhi mes jush dhe Musait (a.s.), gjatë kohës kur ju vratë dikë dhe filluat të grindeshit rreth çështjes së vrasësit të tij. Madje, gjendja u acarua aq shumë, saqë po të mos vinte zgjidhja e saj prej Allahut, juve do t'ju ndodhte një fatkeqësi e madhe.

Kështu, për të zbuluar vrasësin, Musai (a.s.) u tha që, fillimisht, të thernin një lopë.

- "Musai i tha popullit të vet: "Allahu ju urdhëron që të therni një lopë!" - Pas këtij urdhëri, për ta ishte e detyrueshme që, menjëherë dhe pa humbur kohë, ta zbatonin atë, pa as më të voglin kundërshtim. Por ata nuk dinin të bënin gjë tjetër, veç refuzimit dhe kundërshtimit të urdhrave:

- "Ata thanë: "A po tallesh me ne?!""- Atëherë, Profeti i Allahut tha:

- Ai tha: "Allahut i kërkoj të më ruajë, që të mos bëhem injorant!"- Arsyeja: Sepse vetëm injorantët e të ulëtit flasin fjalë të padobishme. Janë pikërisht ata që tallen me njerëzit. Ndërsa të urtët e të mençurit e konsiderojnë talljen me të tjerët, që janë njëlloj si ata, si një nga mangësitë më të mëdha, që dëmtojnë dhe cenojnë fenë dhe mendjen e njeriut. Edhe nëse dikush mund të jetë i dalluar në shumë aspekte, kjo jo vetëm që nuk e shtyn të mençurin të tallet me të tjerët, por, përkundrazi, e nxit atë që të jetë më tepër mirënjohës ndaj Zotit dhe më tepër i mëshirshëm ndaj krijesave të Zotit.

Kur Musai (a.s.) u tha atyre këto fjalë, ata e kuptuan tashmë që çështja ishte serioze, prandaj thanë:

- "Lute Zotin tënd për ne, të na qartësojë se si duhet të jetë ajo?" – Pra, e pyetën për moshën e saj. Musai iu përgjigj:

- "Ai *(Zoti)* thotë se ajo duhet të jetë një lopë as e vjetër, as e re, por e mesme." - Pra, as lopë plakë dhe as mëshqerrë, që nuk ka lindur viça, por mes këtyre dy ekstremeve.

- "Zbatoni pra, atë që u urdhëruat të bëni!" – Pra, bindjuni urdhërit dhe lëreni mënjanë inatin dhe natyrën tuaj të kundërshtimit. Lëreni mënjanë koklavitjen e çështjeve!
Por, me gjithë këtë këshillë:

- "Ata thanë: "Lute Zotin tënd për ne, që të na sqarojë çfarë ngjyre duhet të ketë ajo?"


- "Ai *(Musai)* tha: "Ai *(Zoti)* thotë se ajo duhet të jetë një lopë e verdhë. Ngjyra e saj duhet të jetë *(e verdhë)* e ndezur, që të kënaqë shikuesit". Domethënë, t'i gëzojë dhe t'i kënaqë vështruesit e saj, prej bukurisë dhe pamjes që do të ketë.

- "Ata thanë: "Lute Zotin tënd për ne, që të na sqarojë çfarë lloji duhet të jetë ajo, se lopët të gjitha na duken njësoj, e ne, në dashtë Allahu, do ta gjejmë të vërtetën!" - Ata, me natyrën e tyre për t'i ngatërruar gjërat, thanë që lopët u dukeshin të ngjashme, dhe për këtë arsye nuk po e gjenin dot atë që dëshironte Zoti. Por:

- "Ai *(Musa)* tha: "Ai *(Zoti)* thotë se ajo duhet të jetë një lopë, që nuk ka shërbyer për të lëruar tokën, e as për të ujitur bimët. Ajo duhet të jetë pa asnjë të metë dhe pa asnjë njollë *(ngjyrë)* tjetër!" - Domethënë, pa mangësi, e pa lodhur me punë dhe pa asnjë ngjyrë a njollë tjetër në të.

Atëherë, pas gjithë kësaj koklavitjeje dhe teprimi me pyetjet e tyre të panevojshme, ata thanë:

- "Tani u sqaruam plotësisht" – Kuptimi: Vetëm tani na sqarove plotësisht. Megjithatë, një reagim i tillë vinte prej paditurisë që ata kishin, pasi e vërteta u ishte bërë e qartë që në fillim. Nëse ata do të kishin marrë çfarëdolloj lope, që në krye të herës, ajo do të ishte e pranueshme dhe e mjaftueshme për të plotësuar urdhërin e Allahut të Lartësuar. Por ata e koklavitën çështjen me pyetjet e tyre të shumta dhe të



panevojshme. Për këtë arsye, merituan që edhe Allahu i Lartësuar t'ua vështirësonte dhe ngatërronte më tepër çështjen. Madje, nëse së fundmi, ata nuk do të thonin: "…në dashtë Allahu, do ta gjejmë të vërtetën", ata përsëri nuk do të gjenin zgjidhje.

- "Kështu, ata e therën atë, por, për pak, desh e lanë pa e bërë këtë punë". – Domethënë, ata e therën lopën, me cilësitë e saj të kërkuara, por gati sa nuk mbetën pa rrugëzgjidhje, për shkak të asaj natyre gërnjare, që i karakterizonte.

- "Pasi vratë një njeri e u grindët në lidhje me të, Allahu e zbuloi atë që e mbanit të fshehtë". - Kështu, pasi e therën lopën e kërkuar, Allahu i Lartësuar i urdhëroi ata që, me një pjesë të saj, të preknin të vrarin, siç tregon i Madhëruari:

- "Ju thamë: "Prekeni atë me një pjesë të saj!" Dhe kështu, Allahu do t'i ngjallë të vdekurit" – Kuptimi: Prekeni të vrarin me një gjymtyrë të lopës së therur, ose me çfarëdo pjese të trupit të saj. Kur ata e prekën të vdekurin me një pjesë të lopës, Allahu i Lartësuar e ringjalli të vdekurin. E pas kësaj, Allahu i Lartësuar ua nxori jashtë ato që mbanin fshehur, sepse vetë i ringjalluri kallëzoi se cilët kishin qenë vrasësit e tij.

Pamja e ringjalljes me sy nga ana e tyre, ishte një mrekulli, që tregonte pushtetin dhe fuqinë absolute të Allahut për të ringjallur të vdekurit.

- "dhe do t'ju sqarojë argumentet e Tij, në mënyrë që të kuptoni" - Kuptimi: Allahu i Lartësuar jua solli këtë argument, me shpresë që ju të mendoni seriozisht dhe të largoheni nga çdo gjë që është në dëmin tuaj.

"Megjithatë, zemrat tuaja, edhe pas kësaj, u bënë si guri…" - Kuptimi: Zemrat tuaja u forcuan dhe ashpërsuan më tepër, aq sa nuk u bënte më dobi asnjë qortim. Ato nuk ndikoheshin nga asnjë lloj përkujtimi.

- "…edhe pas kësaj" – Domethënë, edhe pasi Allahu i Lartësuar ju nderoi me plot mirësi të mëdha, pasi ju paraqiti shumë argumente, shenja dhe mrekulli të qarta. Pra, pas gjithë këtyre, zemrat tuaja nuk duhej kurrsesi që të ngurtësoheshin, por të zbuteshin. Ato duhej të prekeshin thellë e t'i nënshtroheshin Allahut të Lartësuar.

Më tej, Allahu i Lartësuar e përshkruan ashpërsinë e zemrave të tyre nëpërmjet disa krahasimeve. Ai thotë se ato:

- "u bënë si guri" – Pra, ato u bënë të forta si gurët, madje edhe më shumë se aq. Dhe të mendosh se guri është edhe më i fortë se vetë hekuri apo plumbi, sepse këto të fundit, kur i fut në zjarr, shkrihen dhe zbuten, ndërsa guri jo, nuk zbutet.

- "madje edhe më të forta" - Pra, ngurtësia e tyre ua kalonte asaj të gurëve. Madje, gurët janë më të mirë se zemrat e tyre, siç thotë i Lartësuari:

- "Ka gurë prej të cilëve burojnë lumenj. Ka prej tyre që çahen dhe prej tyre del ujë. Madje, ka prej tyre që, nga frika ndaj Zotit, rrokullisen tatëpjetë" – Pra, me të tilla cilësi, gurët janë më të mirë se ato zemra.

Pas përshkrimit të zemrave të tyre, Allahu i Lartësuar u jep më të ashprin kërcënim:

- "Allahu nuk është i pavëmendshëm ndaj asaj që veproni ju". – Kuptimi: Allahu është absolutisht i ditur rreth veprave tuaja. Ai i ka ruajtur dhe i ka shënuar të gjitha punët tuaja, të mëdhatë dhe të voglat, dhe, me siguri, ka për t'ju shpërblyer për to në mënyrën më të drejtë.

Shumë interpretues të Kur'ânit i kanë mbushur librat e tyre me rrëfime e gojëdhëna hebraike (të ashtuquajtura *israilijate*), për të shpjeguar ajetet kur'ânore. Këtë metodë ata e mbështesin në fjalën e Profetit (s.a.u.s.), që thotë: *"Tregojini rrëfimet e bijve të Israilit, se nuk ka problem."* Por, sipas meje, qëndrimi më i drejtë në këtë çështje është që përcjellja e historive të ardhura nga hebrenjtë, edhe pse lejohet të kryhet si veprim, nuk do të thotë që ato mund të përdoren bashkë me argumentet tona, për të shpjeguar ajetet e Librit të Allahut, sepse asnjë e dhënë nuk lejohet të paraqitet si shpjeguese e Kur'ânit, nëse ajo nuk është e mbështetur dhe vërtetuar nga goja e Pejgamberit (s.a.u.s.). Edhe në rastin më të mirë, kur rrëfimet e judejve dhe të të krishterëve nuk bien ndesh me fenë tonë, ne i konsiderojmë ashtu sikurse na ka mësuar Pejgamberi (s.a.u.s.), kur thotë: *"As mos i besoni ehlu kitab-ët dhe as mos i përgënjeshtroni ata!"* Rrjedhimisht, nëse këto informacione janë të pasigurta e të dyshimta, atëherë ne duhet të jemi shumë të rezervuar në përdorimin e tyre, sidomos kur flitet për interpretimin e ajeteve të Kur'ânit.

Në fenë Islame, dihet se është detyrë që ta besojmë Kur'ânin e shenjtë pa patur as më të voglin dyshim. Ne duhet të jemi plotësisht të sigurt për saktësinë e termave dhe fjalëve të tekstit të Kur'ânit, nga njëra anë, dhe të kuptimeve të tij, nga ana tjetër. Për këtë arsye, nuk duhet dhe nuk lejohet që ne t'i nxjerrim kuptimet e Kur'ânit duke u mbështetur në histori dhe rrëfenja, që janë të paqarta e të pasigurta në transmetimet e tyre. Aq më tepër që, në të shumtën e rasteve, të krijohet bindja se ato janë thjesht trillime dhe legjenda. Pra, të tilla informacione nuk mund të jenë kurrsesi shpjeguese të librit më të sigurt në botë. Po ashtu, ato kurrë nuk mund të merren si të pranueshme dhe të sigurta, thjesht dhe vetëm se dikush i përdor si shpjeguese të ajeteve të Kur'ânit. Tefsiret u mbushën me të tilla rrëfenja pikërisht për shkak të pakujdesisë nga ana e atyre dijetarëve që e bënë këtë gjë.

Allahu i Lartësuar i jep sukses dhe udhëzon atë që do në rrugën e drejtë dhe të saktë.

Ajetet 75 – 79

75. A shpresoni se ata do t'ju besojnë, kur dihet se një grup i tyre i dëgjonin fjalët e Allahut dhe, pasi i kishin kuptuar, i ndryshonin ato?! Ata e dinin mirë *(krimin që bënin).*

76. Kur ata takohen me besimtarët, thonë: "Ne besojmë". Por kur veçohen me njëri-tjetrin, thonë: "A po u tregoni atyre *(muslimanëve)* për atë që Allahu ju ka shpallur juve, që ata të kenë argumente para Zotit tuaj, kundër jush?! A nuk e kuptoni?!"

77. A thua, vallë, se nuk e dinë ata që Allahu e di atë që ata e fshehin dhe atë që ata e shprehin hapur?

78. Ka prej tyre që janë të paditur dhe nuk e njohin Librin. Ata njohin veçse trillime dhe jetojnë vetëm me shpresa. Ata vetëm hamendësojnë.

79. Mjerë për ata që, me duart e veta e shkruajnë librin, e pastaj thonë: "Ky është prej Allahut", për të arritur ndonjë fitim të paktë. Mjerë ata, për çka shkruan me duart e tyre! Mjerë ata, për çka fitojnë!

Shpjegimi i ajeteve

- "A shpresoni se ata *(ehlul kitab-ët)* do t'ju besojnë…" – Nëpërmjet këtij ajeti, besimtarët njoftohen se është e kotë të shpresojnë që *ehlul kitab*-ët (të krishterët dhe çifutët) do të udhëzohen në rrugën e drejtë. Nuk ka shpresë që ata të besojnë, sepse vetë sjellja e tyre, që e tregon një gjë të tillë, e bën thuajse të pamundur udhëzimin dhe besimin e tyre.

Më pas, Allahu i Lartësuar e shpjegon këtë dhe thotë:

- "…kur dihet se një grup i tyre i dëgjonin fjalët e Allahut dhe, pasi i kishin kuptuar, i ndryshonin ato?! Ata e dinin mirë *(krimin që bënin).*" - Kjo pra, ishte sjellja e tyre. Ata i tjetërsonin dhe i shtrembëronin fjalët e Allahut, pasi i kishin kuptuar shumë mirë në fillim, dhe këtë e bënin me vetëdije. Fjalëve të Allahut të Lartësuar, ata u mvishnin kuptime që Ai kurrë nuk i kishte dashur. Pastaj, këto mendime të gabuara, ua përcillnin të tjerëve si të sakta dhe të vërteta prej Zotit të Madhëruar. Ata, pa të drejtë, i bënin njerëzit që të besonin se këto mësime ishin vërtet prej Zotit.

Atëherë, nëse ata silleshin kështu kundrejt librit të tyre, të cilin e mbajnë si të shenjtë, si mund të prisni që ata t'ju besojnë ju dhe librit tuaj, në mënyrë të drejtë dhe të saktë, pa e tjetërsuar atë?! Pa dyshim, kjo është gjëja e fundit që mund të pranohet apo që mund të mendohet.

Më pas, Allahu i Lartësuar na përshkruan sjelljen e munafikëve nga radhët e *ehlul kitab*-ëve në marrëdhëniet e tyre me besimtarët, duke thënë:

- "Kur ata takohen me besimtarët, thonë: "Ne besojmë"." – Pra, ju deklaronin besimtarëve se edhe ata besonin, por kjo ndodhte vetëm me gjuhë, sepse ata thonin diçka që, në fakt, nuk e kishin në zemër.

- "Por kur veçohen me njëri-tjetrin, thonë: "A po u tregoni atyre *(muslimanëve)* për atë që Allahu ju ka shpallur juve, që ata të kenë argumente para Zotit tuaj, kundër jush?!"" - Domethënë, ata qortonin njëri-tjetrin, duke thënë: A po u deklaroni atyre se edhe ju besoni në vërtetësinë e fesë së tyre? A e dini që kjo mund të shfrytëzohet prej tyre si argument kundër jush?! A e dini që ata do të thonë për ne: "Ata e pranuan se rruga jonë dhe besimi ynë është i vërtetë dhe i saktë, ndërsa rruga dhe feja e tyre është e kotë". Dhe, sigurisht, këtë do ta përdorin si argument kundër jush para Allahut, Zotit tuaj.

- "A nuk e kuptoni?!" – Kuptimi: "A nuk po mendoheni pak dhe të hiqni dorë prej atij veprimi, të cilin ata do ta përdorin si argument kundër jush?" Këto janë fjalë që ata ua thonin njëri-tjetrit me qortim.

- "A thua, vallë, se nuk e dinë ata që Allahu e di atë që ata e fshehin dhe atë që ata e shprehin hapur?" - Ata, edhe nëse e fshehin atë që besojnë në zemër dhe e shprehin kur janë me njëri-tjetrin, duke menduar se, në këtë mënyrë, besimtarët nuk do të kenë mundësi të argumentojnë kundër tyre Ditën e Gjykimit, kjo nuk do t'u vlejë aspak. Ky është një gabim shumë i madh dhe një shprehje e paditurisë së tyre të thellë. Kjo fshehje nuk do t'u vlejë aspak, sepse Allahu i Lartësuar e di gjithçka që ata e fshehin dhe gjithçka që ata shfaqin. Po ashtu, Ai do t'ua shfaqë besimtarëve gjendjen e tyre të vërtetë.

- "Ka prej tyre që janë të paditur dhe nuk e njohin Librin. Ata njohin veçse trillime dhe jetojnë vetëm me shpresa. Ata vetëm hamendësojnë" - Pra, prej *ehlul kitab*-ëve ka shumë që janë të paditur, njerëz të thjeshtë, që nuk kanë asnjë dije rreth librave të shenjtë. Ata nuk dinë më shumë sesa thjesht të lexojnë atë që u paraqitet. Ata nuk dinë asgjë se çfarë kanë bërë dijetarët e tyre të parë. Brezat e mëvonshëm dinë veçse të ndjekin teza dhe ide të pabazuara e të pasigurta, të cilat i pranojnë verbërisht prej 'dijetarëve' të tyre.

Në këto ajete, Allahu i Lartësuar përshkruan gjendjen e dijetarëve të tyre, nga njëra anë, dhe të njerëzve të thjeshtë, nga ana tjetër. Ai na tregon, gjithashtu, për betejën shpirtërore të shtiracakëve dhe të atyre që nuk pranuan të shtiren si besimtarë muslimanë.


Dijetarët e *ehlul kitab*-ëve vazhdojnë me kokëfortësi dhe arrogancë në rrugën e tyre, edhe pse e dinë që ajo është e gabuar dhe të çon në Zjarr. Ndërsa njerëzit e zakonshëm janë pasues të verbër të dijetarëve të tyre, duke mos parë se kë pasojnë, dhe pse u besojnë. Ata janë krejtësisht të paqartë në rrugën që ndjekin. Këto dy grupe, pra, janë të pashpresë për t'u udhëzuar.

- "Mjerë për ata që, me duart e veta e shkruajnë librin, e pastaj thonë: "Ky është prej Allahut"", - Allahu i Lartësuar i kërcënon ata që i ndryshojnë, i tjetërsojnë ose që i keqinterpretojnë librat e Zotit, dhe ua përcjellin njerëzve si të vërteta nga Allahu i Lartësuar. Ata u thonë njerëzve: "Ky libër është shpallur prej Allahut." Kështu, ata shfaqin të gabuarën dhe fshehin të vërtetën.

Po çfarë i shtyu të veprojnë në këtë mënyrë? Thotë i Lartësuari:

- "...për të arritur ndonjë fitim të paktë." - E gjithë dynjaja, nga fillimi deri në fund, vlen shumë pak, por ata e përdorin të kotën dhe gënjeshtrën si kurth dhe si mjet për të përfituar padrejtësisht nga pasuritë e njerëzve. Kësisoj, ata u bëjnë padrejtësi njerëzve në dy drejtime: duke u tjetërsuar e shkatërruar fenë dhe duke i penguar nga rruga e vërtetë, nga njëra anë, dhe duke ua zhvatur pasurinë, nga ana tjetër. Madje, kjo mënyrë e marrjes së pasurisë është nga më të rëndat. Ajo është shumë herë më e madhe se vjedhja e zakonshme.

Për këtë arsye, Allahu i Lartësuar u bën atyre dy kërcënime:


الجزء الأول سورة البقرة
أَوَلَا يَعْلَمُونَ أَنَّ ٱللَّهَ يَعْلَمُ مَا يُسِرُّونَ وَمَا يُعْلِنُونَ ﴿٧٧﴾
وَمِنْهُمْ أُمِّيُّونَ لَا يَعْلَمُونَ ٱلْكِتَٰبَ إِلَّآ أَمَانِيَّ وَإِنْ هُمْ
إِلَّا يَظُنُّونَ ﴿٧٨﴾ فَوَيْلٌ لِّلَّذِينَ يَكْتُبُونَ ٱلْكِتَٰبَ بِأَيْدِيهِمْ
ثُمَّ يَقُولُونَ هَٰذَا مِنْ عِندِ ٱللَّهِ لِيَشْتَرُوا۟ بِهِۦ ثَمَنًا قَلِيلًا ۖ
فَوَيْلٌ لَّهُم مِّمَّا كَتَبَتْ أَيْدِيهِمْ وَوَيْلٌ لَّهُم مِّمَّا يَكْسِبُونَ
﴿٧٩﴾ وَقَالُوا۟ لَن تَمَسَّنَا ٱلنَّارُ إِلَّآ أَيَّامًا مَّعْدُودَةً ۚ قُلْ
أَتَّخَذْتُمْ عِندَ ٱللَّهِ عَهْدًا فَلَن يُخْلِفَ ٱللَّهُ عَهْدَهُۥٓ ۖ أَمْ
تَقُولُونَ عَلَى ٱللَّهِ مَا لَا تَعْلَمُونَ ﴿٨٠﴾ بَلَىٰ مَن كَسَبَ سَيِّئَةً
وَأَحَٰطَتْ بِهِۦ خَطِيٓـَٔتُهُۥ فَأُو۟لَٰٓئِكَ أَصْحَٰبُ ٱلنَّارِ ۖ هُمْ
فِيهَا خَٰلِدُونَ ﴿٨١﴾ وَٱلَّذِينَ ءَامَنُوا۟ وَعَمِلُوا۟ ٱلصَّٰلِحَٰتِ
أُو۟لَٰٓئِكَ أَصْحَٰبُ ٱلْجَنَّةِ ۖ هُمْ فِيهَا خَٰلِدُونَ ﴿٨٢﴾ وَإِذْ أَخَذْنَا
مِيثَٰقَ بَنِىٓ إِسْرَٰٓءِيلَ لَا تَعْبُدُونَ إِلَّا ٱللَّهَ وَبِٱلْوَٰلِدَيْنِ
إِحْسَانًا وَذِى ٱلْقُرْبَىٰ وَٱلْيَتَٰمَىٰ وَٱلْمَسَٰكِينِ وَقُولُوا۟
لِلنَّاسِ حُسْنًا وَأَقِيمُوا۟ ٱلصَّلَوٰةَ وَءَاتُوا۟ ٱلزَّكَوٰةَ ثُمَّ
تَوَلَّيْتُمْ إِلَّا قَلِيلًا مِّنكُمْ وَأَنتُم مُّعْرِضُونَ ﴿٨٣﴾
١٢

- "Mjerë ata, për çka shkruan me duart e tyre!" - Pra, mjerë ata për mashtrimin, duke ndryshuar, keqinterpretuar dhe tjetërsuar fjalët e Allahut.

- "Mjerë ata, për çka fitojnë!" – Pra, mjerë ata, për pasurinë e fituar në mënyrë pa të drejtë. Fjala *'uejl'* nënkupton ashpërsinë e ndëshkimit dhe të dëshpërimit që i pret ata. Ky është vërtet një kërcënim i frikshëm dhe i ashpër.

Shejhu i Islamit Ibn Tejmije, pasi përmend këto ajete (nr. 75-79), thotë: "Allahu i Madhëruar i ka qortuar dhe u ka tërhequr vërejtjen atyre që i ndryshojnë dhe i tjetërsojnë kuptimet e fjalëve të Allahut. Këtu përfshihen edhe ata që përpiqen t'i japin Kur'ânit dhe fjalëve të Pejgamberit (s.a.u.s.) kuptime të kota, që ata vetë i kanë sajuar, pa bazë të qëndrueshme.

Gjithashtu, Allahu i Madhëruar qorton nëpërmjet këtyre ajeteve edhe ata që nuk kuptojnë asgjë prej Librit. Këtu përfshihen edhe ata që nuk meditojnë rreth ajeteve

kur'ânore, por që vetëm i lexojnë dhe i këndojnë ato.

Në këtë qortim përfshihen edhe ata që shkruajnë vetë libra, në të cilët kundërshtohet Libri i Allahut, me qëllimin që të fitojnë diçka nga kjo dynja. Jo vetëm kaq, por ata pretendojnë se ajo çfarë shkruhet në librat e tyre është e vërteta prej Allahut, është ligji i Zotit dhe feja e pranuar prej Tij. Ata mëtojnë se në librat e tyre paraqitet kuptimi i saktë i Librit të Allahut dhe i Sunetit të Profetit (s.a.u.s.), ose kuptimi i drejtë që patën selefët dhe imamët e mëdhenj të këtij umeti. Ata pretendojnë, gjithashtu, se shkrimet e tyre paraqesin themelet e fesë, të cilat duhet të besohen dhe pasohen nga të gjithë.

Në këto ajete përfshihen edhe ata që i fshehin argumentet që gjejnë në Kur'ân dhe në Sunetin e Profetit (s.a.u.s.), me qëllimin që të mos ua mundësojnë kundërshtarëve që t'i përdorin si argumente kundër tyre rreth së vërtetës. Këto cilësi gjenden të spikatura më shumë te pasuesit e egove dhe të ideve boshe, sikurse janë *rafidi*-të (sufitë, shiitët etj.), por ka të tillë edhe shumë dijetarë të *fikh*-ut."

Ajetet 80 – 82

80. Ata thonë: "Ne nuk do të na kapë Zjarri më tepër se disa ditë të caktuara!" Thuaju: "A mos keni marrë prej Allahut ndonjë premtim? Se Allahu nuk e thyen premtimin e vet? Apo po thoni për Allahun diçka që nuk e dini?"
81. Përkundrazi! Çdokush që bën keq dhe që mbulohet nga gjynahu i tij, do të jetë banor i Zjarrit, ku do të jetë përjetësisht.
82. Kurse ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, do të jenë banorë të Xhenetit, ku do të jenë përjetësisht.

Shpjegimi i ajeteve

- "Ata thonë: "Ne nuk do të na kapë Zjarri më tepër se disa ditë të caktuara!"" - Pasi përmend veprat e tyre të shëmtuara, Allahu tregon edhe një tjetër cilësi të tyre të poshtër: faktin që ata lëvdohen dhe e paraqesin veten e tyre të pastër dhe larg gabimeve. Ata, me mendjemadhësi, pretendojnë se do të shpëtojnë prej ndëshkimit të Allahut dhe se do të shijojnë shpërblimin e Tij, duke thënë se Zjarri ka për t'i prekur veçse disa ditë të numëruara. Në këtë mënyrë, ata kryejnë njëkohësisht dy shkelje, pasi jo vetëm që bëjnë gjynahe, por edhe ndihen të sigurt prej ndëshkimit të Allahut.

Megjithatë, Allahu i Lartësuar ua hedh poshtë këtë pretendim, duke sjellë një pyetje. Ai i thotë Profetit (s.a.u.s.):

- "Thuaju: "A mos keni marrë prej Allahut ndonjë premtim? Se Allahu nuk e thyen premtimin e vet?" – Kuptimi: Thuaju atyre, o Pejgamber (s.a.u.s.): A kini marrë ndonjë premtim prej Allahut, se është vërtet kështu si thoni?!

Dihet që premtimi i Allahut për ruajtje nga ndëshkimi dhe për dhënie shpërblimi është vetëm për ata që e meritojnë, dhe ato bëhen të merituesshme veçse kur pajisesh me iman dhe kur vepron sipas tij. Ky premtim është vetëm për ata që e besojnë vërtet Allahun dhe të Dërguarin e Tij, si dhe që iu binden atyre. Vetëm kundrejt këtyre është i vlefshëm premtimi i Allahut, dhe, pa dyshim, që ai do të shkojë në vend. Kështu që, kur ju shprehni të tilla pretendime, ose keni ndonjë premtim nga Allahu i Lartësuar, ose shpifni kundër Tij.

- "Apo po thoni për Allahun diçka që nuk e dini?" - Me këtë ajet, Allahu i Lartësuar na mëson se mëtimet e tyre mund të jenë:
- ose të mbështetura te ndonjë premtim i Allahut të Lartësuar, dhe në këtë rast do të ishin të sakta;
- ose ata shpifin ndaj Allahut të Lartësuar, dhe kështu pretendimet e tyre do të ishin të pavërteta, duke u bërë të merituesshëm për ndëshkimin dhe poshtërimin nga Allahu.

Vetë gjendja dhe e kaluara e tyre dëshmon se ata kurrë nuk e kanë marrë ndonjë premtim të tillë, sepse ata kanë qenë gjithnjë

të famshëm për mohimin e shumë profetëve. Madje, kanë shkuar edhe më larg se kaq: ata kanë patur guximin dhe paturpësinë që t'i vrasin disa profetë. Mosbindja ndaj urdhrave të profetëve dhe thyerja e pakteve dhe e premtimeve ka qenë një cilësi e pandashme e tyre, përgjatë gjithë kohërave. Kështu që, me këtë biografi të përlyer, për ta është e pashmangshme mundësia e dytë, që: ata shpifin dhe mashtrojnë kundrejt Allahut. Ata flasin në emër të Tij pa patur dije dhe pa fakte, por dihet shumë mirë që, të flasësh në emër të Allahut pa dije dhe pa fakte, konsiderohet një prej harameve më të mëdha. Ky është një veprim tepër i shëmtuar.

Më tej, Allahu i Lartësuar përmend një gjykim gjithëpërfshirës. Përballë këtij ligji janë njëlloi si bijtë e Israilit, ashtu edhe të tjerët, pa asnjë ndryshim. Ky është një gjykim i pakthyeshëm, në të cilin nuk ndikojnë as ëndrrat dhe dëshirat boshe dhe as pretendimet e pabaza. Thotë i Lartësuari:

- **"Përkundrazi!"** – Pra, çështja nuk është aspak ashtu si pretendoni ju. Përse? Përgjigjja:
- **"Çdokush që bën keq…"** - Fjala "*sejjieten*" (e përkthyer 'keq') është (në arabisht) një emër i pashquar, i përdorur në fjali kushtore dhe, si e tillë, ajo përfshin të gjitha llojet e gjynaheve, duke filluar nga *shirk*-u (gabimi më i madh) e më poshtë. Kësisoj, kuptimi i fjalisë do të ishte: Çdokush që ka bërë keq, çfarëdo grade qoftë kjo e keqe, duke filluar nga shirku e gjithçka poshtë tij.

Por sqarimi i mëpasshëm e kufizon kuptimin gjithëpërfshirës të kësaj fjale, duke treguar se qëllimi është për gjynahun e *shirk*-ut. I Madhëruari thotë:


- **"…dhe që mbulohet nga gjynahu i tij"** - Pra, ky gjynah e ka mbuluar e pushtuar, pa i lënë asnjë mundësi shpëtimi. Atëherë, dihet se nuk ka gjynah tjetër që nuk të lë asnjë mundësi shpëtimi, veç *shirk*-ut. I Madhëruari thotë në një ajet tjetër: "S'ka dyshim se Allahu nuk e fal *shirk*-un, ndërsa përveç atij *(gjynahu)*, Ai ia fal gjynahet kujt të dëshirojë. Kush adhuron dikë tjetër veç Allahut, ai ka bërë një gjynah të madh." [Nisa 48]. Nga ana tjetër, Allahu thotë: "O robërit e Mi, të cilët e keni ngarkuar me shumë gjynahe veten tuaj, mos e humbni shpresën ndaj mëshirës së Allahut, sepse vërtet Allahu i fal të gjitha mëkatet. Ai është Falësi, Mëshiruesi!" [Zumer 53]. Arsyeja është se njeriun që e ka imanin e pastër, kurrë nuk mund ta mbulojnë (ose mbysin) përfundimisht gabimet e tij.

Atëherë, sipas ajetit, i përjetshëm në zjarrin e Xhehenemit nuk do të jetë ai që ka bërë një të keqe çfarëdo, por ai që i ka bërë *shirk* Zotit. Ky gabim do ta fundosë në humbje, pa i lënë asnjë mundësi shpëtimi.

Ajeti i mësipërm është përdorur padrejtësisht si argument nga hauarixhët, rreth rrugës dhe qëndrimit të tyre të gabuar. Ata pretendojnë se çdo gjynah, sado i vogël apo i madh qoftë ai, është kufër, domethënë konsiderohet si mohim i Zotit dhe, për këtë arsye, e bën të merituesshme përjetësinë në zjarrin e Xhehenemit.

- "…**do të jetë banor i Zjarrit, ku do të jetë përjetësisht"** – Kështu, hauarixhët nuk i kanë dhënë rëndësi specifikimit që Allahu i Lartësuar ka bërë me pohimin e mëparshëm, që nënkupton *shirk*-un. Pra, ata nuk e marrin në konsideratë pjesën: **"dhe që është mbuluar nga gjynahu i tij"**, domethënë, nga shirku i tij. Për më tepër, ky specifikim mbështetet edhe nga ajete të tjera, si, për shembull, ajeti 48 i sures Nisa, që e përmendëm më lart, por edhe shumë ajete të tjera, në të cilat kuptohet qartë që, të përjetshëm në zjarrin e Xhehenemit do të jenë vetëm ata që bëjnë gjynahun e madh të shirkut ose të kufrit, dhe që vdesin në këtë gjendje.

Është e çuditshme se të gjithë sektet e humbura, sa herë që përpiqen t'i mbështesin idetë e tyre të kota me argumente nga Kur'âni dhe Tradita autentike e Pejgamberit



(s.a.u.s.), kundërpërgjigjja ndaj tyre do të gjendet shumë thjesht në vetë argumentin që ata përdorin. Pra, faktet që ata përdorin bëhen argumente kundër tyre dhe jo pro tyre.

Më tej, Allahu i Lartësuar vazhdon me një gjykim të patjetërsueshëm rreth krijesave, duke vijuar me përfundimin e të mirëve:

- **"Kurse ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, do të jenë banorë të Xhenetit, ku do të jenë përjetësisht."** – Domethënë, do të jenë ata që, përveçse besojnë Allahun, engjëjt, shpalljet dhe librat e Zotit, profetët e Zotit, Ditën e Gjykimit etj., bëjnë edhe vepra të mira.

Veprat e njeriut mund të konsiderohen të mira, veçse nëse plotësojnë dy kushte:

1. Të kryhen me nijet të sinqertë vetëm për hir të Allahut, duke synuar kënaqësinë e Allahut të Lartësuar.

2. Të jenë në përputhje me Traditën autentike të Pejgamberit (s.a.u.s.).

Shkurtimisht, kuptimi i përmbledhur i këtij ajeti na çon në përfundimin se të shpëtuarit dhe fitimtarët e lumtur do të jenë vetëm ata që kanë besuar dhe kanë bërë vepra të mira. Ndërsa të dëshpëruarit dhe të shkatërruarit përjetësisht në zjarrin e Xhehenemit do të jenë mohuesit e Zotit dhe idhujtarët, domethënë ata që, përveç Allahut, adhurojnë zota të tjerë.

Ajetet 83 – 86

83. Ne morëm zotimin e bijve të Israilit *(për këto urdhra)*: "Mos adhuroni askënd tjetër, përveç Allahut! Të silleni mirë ndaj prindërve, të afërmve, jetimëve, të varfërve! Njerëzve t'u thoni fjalë të mira *(të vërteta)*! Faleni namazin dhe jepeni zekatin!" Por ju e thyet zotimin dhe ia kthyet shpinën *(rrugës së drejtë)*, përveç një pakice prej jush.

84. Ne morëm zotimin tuaj që të mos derdhnit gjakun tuaj dhe të mos dëbonit njëri-tjetrin nga vendi juaj! Ju i pranuat *(këto kushte)*. Edhe ju *(të sotmit)* jeni dëshmitarë për këtë.

85. Por, jeni pikërisht ju *(që dhatë besën)*, që masakruat njëri-tjetrin. Ndërsa disa të tjerë *(prej jush)* i dëbuat nga vendi i tyre, duke bashkëpunuar *(me idhujtarët)* kundër tyre me poshtërsi dhe padrejtësi. Nëse ata bien robër tek ju, ju e pranoni kompensimin për *(t'i liruar)* ata *(duke zbatuar kështu një urdhër të Teuratit)*. Por edhe dëbimi i tyre nga vendi është i ndaluar për ju *(atëherë, pse këtë nuk e zbatoni?!)*. A e besoni një pjesë të Librit, e tjetrën e mohoni?! E çfarë ndëshkimi pritet për ata që bëjnë gjëra të tilla?! Ata, veç poshtërimit në jetën e kësaj bote, në Ditën e Gjykimit do të flaken në dënimin më të ashpër. Allahu nuk është i pavëmendshëm ndaj asaj që veproni ju.

86. Ata e vlerësuan jetën e kësaj bote mbi botën tjetër, por atyre nuk do t'u lehtësohet dënimi dhe kurrë nuk do të ndihmohen.

Shpjegimi i ajeteve

Në këto ajete, Allahu i Lartësuar sjell disa urdhra, të cilët përbëjnë themelet e kësaj feje. Në fakt, këto parime themelore kanë qenë gjithmonë të njëjta, të pandryshueshme për të gjithë popujt dhe në të gjitha kohërat. Allahu i Lartësuar i ka urdhëruar të gjithë profetët për ruajtjen të paprekshme dhe të pandryshueshme të këtyre bazave të besimit dhe të fesë. Këto baza kanë qenë gjithmonë garantuese të mirësive të përgjithshme të të gjithë njerëzimit, në çdo vend dhe në çdo kohë. Ato nuk mund të tjetërsohen kurrë apo të anulohen nga parime të tjera të ndryshme.

Për këtë arsye, Allahu i Lartësuar na urdhëron edhe në ajete të tjera, si:

"Adhuroni Allahun e mos adhuroni përveç Tij asgjë tjetër! Silluni mirë ndaj prindërve, të afërmve, jetimëve, të varfërve, fqinjëve të afërt dhe të largët, ndaj atij që keni pranë, ndaj udhëtarit *(që ka mbetur ngushtë)* dhe ndaj atyre që janë robër nën pushtetin tuaj. Në të vërtetë, Allahu nuk i do njerëzit arrogantë dhe mburravecë". [Nisa 36].

Ose: "Thuaj: "Ejani t'ju lexoj atë që vërtet jua ndaloi Zoti juaj: (*Ai ju urdhëroi)* Të mos adhuroni përveç Tij asgjë, të silleni mirë me prindërit, të mos i vrisni fëmijët tuaj për shkak të varfërisë, sepse Ne ju ushqejmë ju dhe ata; të mos u afroheni gjynaheve të hapura apo të fshehta dhe të mos vrisni atë që Allahu e ka ndaluar të vritet, veçse kur është e drejtë. Këto janë porositë e Tij, në mënyrë që ju të mendoni thellë. Mos iu afroni pasurisë së jetimit, derisa ai të arrijë pjekurinë, veçse në mënyrën më të mirë! Masni dhe peshoni me drejtësi! Ne nuk ngarkojmë asnjë njeri përtej mundësive të veta. Kur të flisni *(të dëshmoni)*, duhet të jeni të drejtë, edhe kur çështja është për të afërmit tuaj. Plotësojeni zotimin që i bëni Allahut! Këto janë porositë e Tij, me qëllim që ju të përkujtoni. Kjo është rruga Ime e drejtë, prandaj përmbajuni asaj, e mos ndiqni rrugë të tjera, të cilat ju largojnë nga rruga e Tij. Këto janë porositë e Tij për ju, në mënyrë që ju të ruheni." [En'am 151-153].

Ose: "Mos vër zot tjetër me Allahun, se do të bëhesh i qortuar e i braktisur. Zoti yt ka dhënë urdhër të prerë që të mos adhuroni asgjë tjetër veç Tij dhe të silleni në mënyrë bamirëse ndaj prindërve. Nëse njërin prej tyre, ose që të dy, i ka kapur pleqëria pranë kujdesit tënd, atëherë mos u thuaj atyre as "of", e as mos u bëj i vrazhdë ndaj tyre, por thuaju fjalë të mira dhe, në shenjë mëshire, shtrije pranë tyre krahun përulës e respektues. Gjithashtu thuaj *(lutu):* "Zoti im! Mëshiroji ata të dy, sikurse më edukuan mua kur isha i vogël". Zoti juaj e di më së miri atë që keni në shpirtin tuaj. Nëse jeni bamirës, atëherë Ai është Falës ndaj atyre që pendohen. Jepi çdo të afërmi të drejtën që i takon, edhe të varfërit, edhe udhëtarit, por mos shpenzo tepër e më kot! Pa dyshim, ata që e teprojnë janë vëllezër të shejtanëve, dhe shejtani është mohues i madh ndaj Zotit të Tij. Nëse detyrohesh t'ua kthesh shpinën atyre *(të afërmve etj.)*, duke shpresuar mëshirën nga Zoti yt, atëherë thuaju atyre fjalë të mira. Mos e shtrëngo dorën tënde, e as mos e lësho atë pa fre, që të mbetesh i qortuar dhe duarthatë. S'ka dyshim se është Zoti yt Ai që furnizon me bollëk atë që do dhe ia kufizon atij që do. Rreth robërve të Vet, Ai është i Gjithëdijshëm e Gjithëshikues. Mos i vrisni fëmijët tuaj nga frika e varfërisë, se Ne ua sigurojmë furnizimin atyre dhe juve! Vrasja e tyre është vërtet një krim i madh! Mos iu afroni imoralitetit! Ai është vërtet një vepër e shëmtuar dhe një rrugë shumë e keqe! Mos e vrisni njeriun që Allahu e ka ndaluar të vritet, përveç se me drejtësi *(sipas ligjit)*. Nëse dikush vritet pa të drejtë, Ne i kemi dhënë të drejtë kujdestarit të tij *(të kërkojë drejtësi)*. Por edhe ai të mos e kalojë kufirin në vrasje, sepse ai është i ndihmuar *(prej Zotit)*. Mos iu afroni pasurisë së jetimit, përveçse kur keni qëllim të mirë *(për t'ia shtuar)*, derisa ai ta arrijë pjekurinë e vet! Zbatojini premtimet tuaja, sepse për premtimin ka përgjegjësi! Masën mbusheni

mirë kur matni *(me enë)*, dhe peshoni me peshore të saktë. Kjo është më e dobishme për ju dhe ka përfundim më të mirë. Mos iu qas asaj për të cilën nuk ke njohuri! Dëgjimi, shikimi dhe zemra, të gjithë do të mbajnë përgjegjësi. Mos ec nëpër tokë me mburrje, sepse ti as nuk mund ta çash tokën, as nuk mund të arrish lartësinë e maleve! E keqja e të gjitha këtyre është e urryer nga Zoti yt. Këto janë nga urtësia, që Zoti yt ta shpalli ty. Mos adhuro veç Allahut ndonjë zot tjetër, dhe pastaj të hidhesh në Xhehenem si fajtor dhe i dëbuar." [Isra, 22-39].

- "Ne morëm zotimin e bijve të Israilit" - Për shkak të ngurtësisë dhe ashpërsisë së zemrave të tyre, duhej që për çdo dispozitë që u shpallej, për çdo urdhër që u drejtohej, t'u merreshin shumë betime se do të ishin të bindur. Vetëm nëpërmjet përbetimeve mund të shpresohej se ata do të zbatonin ndonjë urdhër, sepse zakonisht nuk e mbanin fjalën e dhënë dhe gjithmonë i shkelnin dispozitat.

E kështu, Allahu i Madhëruar mori premtimin e tyre për zbatimin e këtyre urdhrave:

- "Mos adhuroni askënd, përveç Allahut!" - Ky është një urdhër i qartë, për të adhuruar Allahun si Një të vetëm, pa i vënë të barabartë. Ky përbën themelin e fesë, mbi të cilin ngrihen të gjitha veprat e tjera. Asnjë punë nuk pranohet nëse nuk është ndërtuar mbi këtë bazë. Kjo është e drejta që ka Allahu i Lartësuar mbi krijesat e Tij.

Pastaj i Madhëruari përmend një detyrë tjetër:

- "Të silleni mirë ndaj prindërve, të afërmve, jetimëve, të varfërve!" - Ky është urdhër për të gjitha llojet e bamirësisë. Ne jemi të urdhëruar, gjithashtu, t'u bëjmë atyre mirësi me të gjitha mënyrat, me fjalë dhe me vepra.

Ky ajet na ndalon edhe nga e kundërta e bamirësisë, që është keqtrajtimi apo shkaktimi i mërzitjes për ta.

Më konkretisht, ajeti na urdhëron që të jemi bamirës ndaj prindërve dhe na ndalon që të mos bëjmë bamirësi ndaj tyre apo që t'u shkaktojmë mundime, sepse urdhri për të kryer diçka të caktuar nënkupton gjithashtu edhe ndalimin nga e kundërta e saj.

Dihet që, bamirësia ka dy të kundërta, të cilat janë:
- Kryerja e të këqijave dhe keqtrajtimi.
- Mosbërja bamirësi, edhe nëse nuk bëhet keqtrajtim.

E para është krim shumë i madh, ndërsa e dyta është e ndaluar, haram. Sigurisht që këto dy gjynahe nuk kanë të njëjtën gradë.

E njëjta gjë thuhet edhe për mbajtjen e lidhjeve me të afërmit, jetimët dhe me të varfërit.

Bamirësia ndaj këtyre kategorive nuk mund të përkufizohet duke numëruar llojet dhe mënyrat e saj. Bamirësia (*ihsan*) është një emër përfshirës i të gjithë fjalëve dhe veprave që i kënaqin dhe ndihmojnë ato kategori njerëzish.

Pastaj Allahu i Madhëruar na udhëron që të jemi bamirës ndaj të gjithë njerëzve:

- "Njerëzve t'u thoni fjalë të mira (të vërteta)!" – "Fjalë e mirë" konsiderohet urdhërimi i njerëzve për punë e fjalë të mira dhe ndalimi i tyre nga punët dhe fjalët e këqija. "Fjalë e mirë" konsiderohet edhe mësimi i dijes, përhapja e selamit, buzëqeshja e të tjera të ngjashme.

Duke qenë se është e pamundur që të jesh bamirës ndaj të gjithë njerëzve me pasurinë tënde, Allahu i Lartësuar na ka urdhëruar që të tregohemi bamirës ndaj tyre me diçka të përballueshme nga çdokush: me fjalët dhe me sjelljet tona.

Sipas rregullit të përmendur më sipër (që urdhri për diçka konsiderohet edhe si ndalesë nga e kundërta e saj), ky ajet na ndalon, gjithashtu, nga përdorimi i çdo fjale të shëmtuar dhe të keqe. Madje kjo ndalesë është e përgjithshme. Ne jemi të ndaluar nga çdo fjalë e keqe dhe e shëmtuar qoftë, edhe

kundër qafirëve apo në adresë të tyre. Për këtë arsye, Allahu i Lartësuar, në një ajet tjetër në Kur'ân, na mëson dhe thotë: "Të polemizoni me ata që u është dhënë Libri *(para jush)* veçse në mënyrën më të mirë." [Ankebut, 46].

Një nga kushtet e moralit të lartë njerëzor, për të cilin Allahu i ka urdhëruar adhuruesit e Tij, është edhe zbatimi i urdhrit që ata të jenë të kontrolluar dhe të kujdesshëm në fjalët dhe në veprat e tyre. Ai i urdhëron adhuruesit e Tij që të mos jenë të vrazhdë ose ofendues dhe të mos polemizojnë në mënyrë të shëmtuar, por të jenë shembuj të moralit të lartë. Ai i ka urdhëruar ata që të jenë të butë, të mëshirshëm, tolerantë, të sjellshëm dhe respektues ndaj çdokujt. Ata duhet të jenë durimtarë dhe të përmbajtur gjatë ballafaqimit me fyerjet dhe mundimet që njerëzit u shkaktojnë, dhe të gjitha këto duhet t'i bëjnë duke llogaritur e shpresuar shpërblimin e Allahut të Lartësuar, duke çuar në vend urdhrin e Tij.

Pastaj Allahu i Lartësuar i urdhëron ata për dy gjëra:

- **"Faleni namazin dhe jepeni zekatin!"** - Sikurse e kemi thënë më përpara, falja e namazit simbolizon dhe kultivon sinqeritetin ndaj Allahut, ndërsa dhënia e zekatit është mishërim dhe kultivim i bamirësisë ndaj krijesave.

Kush i sheh këto urdhra dhe ndalesa me kujdes e kupton se Allahu i Lartësuar paraqet me anë të tyre bamirësinë dhe mëshirën e Tij ndaj krijesave që urdhërohen dhe ndalohen rreth këtyre çështjeve të rëndësishme. Kjo mëshirë bëhet edhe më e dukshme kur Allahu i Lartësuar, për t'i bërë njerëzit më të përgjegjshëm në zbatimin e këtyre dispozitave të dobishme për ta, u kërkon të betohen për zbatimin e tyre.

E me gjithë këto bamirësi, cili qe qëndrimi që mbajtën paraardhësit e çifutëve të sotëm? Thotë i Lartësuari:

- **"Por ju e thyet zotimin dhe ia kthyet shpinën"** – Nga shprehja *'teuel-lejtum'* (ia kthyet shpinën) kuptohet se ky prapësim u bë në një mënyrë të atillë, që tregonte se ata nuk e kishin më dëshirën për t'u rikthyer në besimin dhe në rrugën e drejtë. Mes atyre që devijojnë dhe humbasin rrugën e drejtë, ka shpeshherë edhe nga ata që e dëshirojnë kthimin në të dhe afrimin tek Allahu i Lartësuar. Ndërsa këta u larguan që të mos ktheheshin kurrë. E lusim Allahun e Lartësuar të na ruajë nga të tilla shkatërrime dhe dëshpërime të papërballueshme!

Nga këto fjali, ndonjë mund të kuptojë që askush prej tyre nuk qëndroi në rrugën e drejtë dhe nuk e ndoqi më udhëzimin, por Allahu i Lartësuar na lajmëron se mes tyre kishte edhe burra që qëndruan si malet, të patundur në rrugën e drejtë. Edhe pse të paktë në numër, gjithsesi ekzistonin, siç thotë i Lartësuari:

- **"...përveç një pakice prej jush" -** Pra, përveç një pakice, të cilët Allahu i Lartësuar i ruajti, të tjerët e humbën rrugën dhe shpresat.

Në ajetet e mëposhtme, Allahu i Madhëruar na njofton për veprimet e ulëta të çifutëve që jetonin në Medinë, gjatë kohës së Muhamedit (s.a.u.s.). Në Medinë, para Islamit, jetonin dy fise të mëdha arabe: Eusi dhe Hazrexhi. Ata ishin në idhujtari. Mes tyre zhvilloheshin luftëra të mëdha. Më pas, erdhën në Medinë edhe tri fise çifutësh: Benu Kurejdhat, Benu Nadirët dhe Benu Kajnukat. Secili nga këto tri fise bëri aleat nga një grup arabësh të Medinës. Në këtë mënyrë, nëse ndodhte luftë mes fiseve arabe, edhe çifutët merrnin pjesë nën flamurin e aleatëve përkatës. Kështu, në mënyrë të pashmangshme, çifuti vriste çifutin, ose e dëbonte, ose edhe e grabiste. Ndërsa pas lufte, nëse grupet kishin kapur robër, i shkëmbenin ata me njëri- tjetrin.

Judejtë, sipas ligjit të tyre, ishin të urdhëruar që të mos derdhnin gjakun e njëri-tjetrit, të mos e dëbonin njëri-tjetrin prej

shtëpive të tyre, dhe nëse mes tyre kishte robër, të nxitonin që t'i kompensonin dhe t'i lironin ata robër që ishin çifutë.

I Madhëruari thotë:

- **"Ne morëm zotimin tuaj që të mos derdhnit gjakun tuaj dhe të mos dëbonit njëri-tjetrin nga vendi juaj! Ju i pranuat *(këto kushte)*. Edhe ju *(të sotmit)* jeni dëshmitarë për këtë"** - Por ata, në vend që t'i zbatonin këto rregulla të vendosura nga Allahu i Lartësuar mes tyre, i shkelën ato pa ngurruar. Ata shkelën dy urdhrat e parë dhe zbatuan të tretin:

- **"Por, jeni pikërisht ju *(që dhatë besën)* që masakruat njëri-tjetrin. Ndërsa disa të tjerë *(prej jush)* i dëbuat nga vendi i tyre, duke bashkëpunuar *(me idhujtarët)* kundër tyre me poshtërsi dhe padrejtësi. Nëse ata bien robër tek ju, ju e pranoni kompensimin për *(t'i liruar)* ata *(duke zbatuar kështu një urdhër të Teuratit)*. Por edhe dëbimi i tyre nga vendi është i ndaluar për ju"** – Pra, nga njëra anë, ata pranonin çështjen e kompensimit të robërve, ndërsa, nga ana tjetër, kryenin vrasje dhe dëbime prej shtëpive. Prandaj Allahu i Lartësuar i qorton ashpër për këtë veprim të shëmtuar, që rridhte nga besimi i tyre i mangët:

- **"A e besoni një pjesë të Librit, e tjetrën e mohoni?!"** - Kuptimi: A po e besoni (dhe zbatoni) një pjesë të Librit (për çështjen e kompensimit të robërve) dhe pjesën tjetër (për vrasjen, dëbimin dhe plaçkitjen) po e mohoni?! Ky ajet flet për zbatimin e urdhrave dhe për largimin nga ndalesat, të cilat janë pjesë e imanit.

Pastaj i Madhëruari na tregon se cili është ndëshkimi i atyre që bëjnë të tilla gjëra:

- **"E çfarë ndëshkimi pritet për ata që bëjnë gjëra të tilla?! Ata, veç poshtërimit në jetën e kësaj bote..."** - Dhe vërtet, ashtu ndodhi. Allahu i Lartësuar i poshtëroi ata që në këtë jetë. Nëpërmjet Profetit të Tij, Ai i vrau ata që merituan vrasjen, i robëroi ata që merituan robërinë dhe i dëboi prej vendeve të tyre ata që e merituan dëbimin. Ky ishte poshtërimi në jetën e dynjasë.

- **"...në Ditën e Gjykimit do të flaken në dënimin më të ashpër. Allahu nuk është i pavëmendshëm ndaj asaj që veproni ju"** - Ditën e Gjykimit, ata do t'i nënshtrohen ndëshkimit më të rëndë.

Pastaj i Lartësuari na tregon shkakun që nxiti tek ata besimin në një pjesë të Librit dhe mohimin e pjesës tjetër të tij:

- **"Ata e vlerësuan jetën e kësaj bote mbi botën tjetër"** - Ata mohuan sepse, nëse nuk do të shkonin në ndihmë të aleatëve të tyre arabë, kundër vëllezërve të tyre çifutë, do të turpëroheshin para njerëzve. Pra, zgjodhën si më të pranueshme që të thyenin urdhrin e Zotit dhe të vrisnin njëri-tjetrin, për shkak të turpit prej njerëzve. Por çfarë fituan me këtë? I Lartësuari thotë:

- **"...por atyre nuk do t'u lehtësohet dënimi dhe kurrë nuk do të ndihmohen"** – Pra, kurrë nuk do të gjejnë prehje dhe shpëtim prej dënimit të ashpër në zjarrin e Xhehenemit, i cili do të jetë vijimisht i ashpër. Qetësia do të jetë një emër i harruar për ta dhe akush nuk do t'i ndihmojë për të shpëtuar nga kjo bela.

Ajetet 87 – 88

87. Ne i dhamë Librin *(Teuratin)* Musait, pas të cilit dërguam shumë profetë të tjerë. Isait, birit të Merjemes, i dhamë mrekulli të qarta dhe e fuqizuam me Shpirtin e Shenjtë. Sa herë që ndonjë i dërguar *(i Zotit)* ju sillte diçka *(ligje e porosi)* që nuk ju pëlqente, ju tregoheshit kryeneçë! Disa prej tyre i mohuat e disa i vratë.

88. Ata thonë: "Zemrat tona janë të vulosura!" Jo, s'është ashtu, por Allahu i ka mallkuar për shkak të refuzimit të së vërtetës, prandaj shumë pak prej tyre besojnë.

Shpjegimi i ajeteve

- "Ne i dhamë Librin *(Teuratin)* Musait…" - Nga mirësitë më të mëdha që Allahu i Lartësuar u bëri Beni Israilëve, ishte dërgimi tek ta i Musait (a.s.) si profet, të cilit i shpalli Teuratin.

- "…pas të cilit dërguam shumë profetë të tjerë" – Vargu i profetëve vazhdoi edhe pas Musait (a.s.).

- "Isait, birit të Merjemes, i dhamë mrekulli të qarta" - Derisa u dërgoi Profetin e fundit nga mesi i tyre, Isain (a.s.), të cilin e pajisi me shenja dhe mrekulli të pamohueshme, të cilat çdokush duhet t'i besonte. Madje, i Lavdëruari e përforcoi atë edhe me *Rûĥul Kudus*-in, Shpirtin e Shenjtë, siç thotë Ai:

- "…dhe e fuqizuam me Shpirtin e Shenjtë" – Disa shpjegues të Kur'ânit janë të mendimit se *Rûĥul Kudus*-i ishte meleku Xhibril. Disa janë të mendimit se *Ruhul Kudus* është besimi i fortë që Allahu i Lartësuar mbjell në zemrat e besimtarëve, nëpërmjet të cilit ata bëhen të pathyeshëm.

Por, me gjithë këto mrekulli dhe shenja të mëdha, ata përdorën të njëjtin kriter për të pranuar ose jo profetët dhe mësimet e tyre:

- "Sa herë që ndonjë i dërguar *(i Zotit)* ju sillte diçka *(ligje e porosi)* që juve nuk ju pëlqente, ju tregoheshit kryeneçë! Disa prej tyre i mohuat e disa i vratë." – Kuptimi: Kur ju erdhën profetët, ju i dhatë përparësi dëshirave tuaja. Ishin pikërisht dëshirat tuaja të pakontrolluara që ju bënë kryeneçë ndaj imanit. Ato ju shtynë t'i mohonit të dërguarit e Allahut, madje më keq, disa edhe t'i vrisnit. Shkaku ka qenë i njëjtë: parapëlqimi i dëshirave të veta kundrejt udhëzimit të Allahut, zgjedhja e kënaqësive të kësaj jete të shkurtër përkundër jetës së amshuar në kënaqësinë e Allahut të Madhëruar.

- "Ata thonë: "Zemrat tona janë të vulosura!" – Kështu, Allahu i Lartësuar tregon një justifikim qesharak nga ana e tyre, të cilin ata e përdornin shpesh, për të justifikuar mosbesimin që kishin ndaj ftesës së Muhamedit (s.a.u.s.). Ata justifikoheshin se nuk mund ta besonin dhe ndiqnin atë, sepse zemrat e tyre ishin të vulosura e, rrjedhimisht, nuk mund t'i kuptonin dot ato që ai u thoshte. Kësisoj, ata pretendonin se ishin të justifikuar përpara Allahut të Lartësuar, pasi nuk kishin dije rreth këtij Profeti dhe argumenteve të tij.


Por ky qe një mashtrim nga ana e tyre, për shkak të të cilit ata u mallkuan nga Allahu i Lartësuar, siç thotë Ai:

- Jo, s'është ashtu, por Allahu i ka mallkuar për shkak të refuzimit të së vërtetës, prandaj shumë pak prej tyre besojnë." – Pra, Allahu i Lartësuar e ka quajtur "mohim" pretendimin e tyre, për të cilin meritonin mallkimin, dëbimin larg mëshirës së Mëshiruesit. Për këtë arsye, janë të pakët ata që besojnë mes tyre, sepse i pakët është imani brenda zemrave të tyre.

Ajetet 89 – 90

89. Kur atyre u erdhi Libri *(Kur'âni)* prej Allahut, që ishte vërtetues i atij *(libri hyjnor)* që e kishin pranë, – edhe pse përpara kësaj, ata shpresonin me ardhjen e tij ndihmën *(e Allahut)* kundër jobesimtarëve, – pra, kur u erdhi ajo që e njihnin mirë, ata e mohuan atë. Mallkimi i Allahut qoftë mbi jobesimtarët!
90. Sa e shëmtuar është ajo, për hir të së cilës ata shitën veten! Atë që e shpalli Allahu, ata nuk e besuan nga zilia e tyre. Ata nuk mund ta pranonin që Allahu, me mirësinë e Tij, t'ia zbriste Shpalljen kujt të dëshironte prej robërve të Vet. Prandaj ata merituan zemërim mbi zemërim. Jobesimtarët kanë dënim poshtërues.

Shpjegimi i ajeteve



- "Kur atyre u erdhi Libri *(Kur'âni)* prej Allahut, që ishte vërtetues i atij *(libri hyjnor)* që e kishin pranë..." – Pra, diçka ndodhi në momentin kur atyre iu erdhi Libri prej Allahut të Lartësuar, nëpërmjet më të mirit të krijesave dhe vulës së profetëve, libër i cili ishte vërtetuesi i Teuratit, që ata e kishin ende në duart e tyre.

Ata ishin aq të sigurt për ardhjen e këtij Profeti, saqë kur luftonin kundra idhujtarëve, u kërcënoheshin atyre e u thonin se koha e Profetit të fundit po afrohej, dhe atëherë ata do të hakmerreshin ndaj tyre.

- "...edhe pse përpara kësaj, ata shpresonin me ardhjen e tij ndihmën *(e Allahut)* kundër jobesimtarëve..." - Por kur u shfaq Profeti (a.s.), që me aq padurim po e prisnin, - e së bashku me të, edhe Libri i Zotit, - ata e mohuan, megjithëse e njihnin shumë mirë.
I Madhëruari thotë:

- "...pra, kur u erdhi ajo që e njihnin mirë, ata e mohuan atë. Mallkimi i Allahut qoftë mbi jobesimtarët! - Ata mohuan të nxitur thjesht nga smira. Ata nuk mund të duronin që Allahu i Lartësuar t'i dhuronte prej mëshirës së Tij cilit të dëshironte prej robërve të Vet. Vërtet, ky qe një shkëmbim i dështuar i tyre, siç thotë i Lartësuari:

- "Sa e shëmtuar është ajo, për hir të së cilës ata shitën veten! Atë që e shpalli Allahu, ata nuk e besuan nga zilia e tyre. Ata nuk mund ta pranonin që Allahu, me mirësinë e Tij, t'ia zbriste Shpalljen kujt të dëshironte prej robërve të Vet." - Dhe, për këtë arsye, ata u mallkuan dhe merituan zemërimin e Allahut.

- "Prandaj ata merituan zemërim mbi zemërim. Jobesimtarët kanë dënim poshtërues" - Ata merituan tmerrin pas zemërimit, sepse në jetën tjetër ndëshkimi i tyre do të jetë i dhimbshëm e shkatërrues. Ata do të flaken në mes të Zjarrit të ndezur fort, duke humbur përgjithmonë mundësinë për të qenë pranë Krijuesit të tyre.

Sa i keq do të jetë përfundimi i tyre! Sa e ulët ishte 'tregtia' e tyre! Ata, në vend që të besonin Allahun, librat e Tij dhe profetët e Tij, zgjodhën mohimin e Tij dhe mohimin e librave e të profetëve të Tij. Meqenëse të gjitha këto i bënë duke qenë plotësisht të ndërgjegjshëm e duke e njohur mirë të vërtetën, ata e merituan ndëshkimin që i pret.

Ajetet 91 – 93

91. Dhe kur atyre u thuhet: "Besoni atë që e ka shpallur Allahu!", ata thonë: "Ne besojmë atë që na u shpall neve", kurse atë *(Shpalljen)* që ka ardhur më pas e mohojnë, edhe pse ajo është e vërtetë dhe vërtetuese e asaj që e kanë ata. Thuaj: "Nëse ishit besimtarë, atëherë përse i vrisnit profetët e Allahut?"
92. Juve ju erdhi Musai me argumente të qarta, por pas *(largimit të)* tij, ju adhuruat viçin, duke u bërë të padrejtë.

93. Kur morëm prej jush premtimin, duke ngritur mbi ju *(kodrën)* Turin, ju thamë: "Merreni seriozisht atë që ju kemi dhënë dhe dëgjoni!" Ata thanë: "Ne dëgjuam, por kundërshtojmë". Si pasojë e mosbesimit, për zemrat e tyre u bë i dashur adhurimi i viçit. Thuaj: "Nëse jeni besimtarë, atëherë besimi juaj është duke ju udhëzuar për keq!"

Shpjegimi i ajeteve

- "Dhe kur atyre u thuhet: "Besoni atë që e ka shpallur Allahu!"" – Pra, çifutët u urdhëruan që ta besonin Kur'ânin, të cilin Allahu i Lartësuar ia shpalli Profetit Muhamed (s.a.u.s.), por ata refuzuan me mendjemadhësi, duke thënë:

- "Ne besojmë atë që na u shpall neve", kurse atë *(Shpalljen)* që ka ardhur më pas e mohojnë..." – Pra, ata pretenduan se besonin vetëm ato shkrime hyjnore që iu ishin shpallur atyre, dhe mohonin çdo libër tjetër të mëvonshëm. Ky qe një pretendim i padrejtë nga ana e tyre, sepse ata e kishin të detyrueshme që të besonin gjithçka që Zoti i shpallte njerëzimit, pa bërë dallime mes shpalljeve. Vetëm kjo mënyrë besimi është e vlefshme dhe e dobishme, pra: besimi i të gjitha shpalljeve të Allahut të Lartësuar, drejtuar të gjithë profetëve.

Nëse dikush bën dallime në besim ndërmjet profetëve dhe librave hyjnore, domethënë në pranimin e disave dhe mospranimin e disa të tjerëve, në fakt ai nuk ka besuar asnjërin prej tyre, dhe kjo vepër konsiderohet si kufër i vërtetë. Për këtë, thotë i Madhëruari në suren Nisa, ajetet 150-152: "Vërtet, ata që mohojnë Allahun dhe të Dërguarin e Tij, të cilët dëshirojnë ta ndajnë *(besimin në)* Allahun nga *(besimin në)* të dërguarit e Tij, duke thënë: "Ne disa i besojmë e disa nuk i besojmë", duke pretenduar se kanë zgjedhur një rrugë të ndërmjetme, pikërisht ata janë mohuesit e vërtetë. Ne kemi përgatitur dënim poshtërues për mohuesit. Ndërsa atyre që besojnë Allahun dhe të Dërguarin e Tij, pa bërë dallim mes asnjërit prej tyre, Ai do t'u japë shpërblimin. Allahu është Falës dhe Mëshirëplotë."

Më pas, Allahu i Lartësuar e kundërshton gabimin e tyre me një argumentim të padiskutueshëm:

- "...edhe pse ajo është e vërtetë dhe vërtetuese e asaj që kanë ata..." – Pra, Allahu i Lartësuar ua hedh poshtë mohimin atyre me dy fakte:

1. Duke thënë: *'ue huel ĥaķķu'* (ajo është e vërtetë). Domethënë, Shpallja (ose Kur'âni) është e vërteta e sigurt në gjithçka që ajo përmban, nga të gjitha këndvështrimet. Ajo është e vërteta e sigurt, për sa u përket rrëfimeve që përmban dhe dispozitave për të cilat na urdhëron dhe na ndalon, dhe kjo për një arsye të thjeshtë: sepse është prej Allahut të Lartësuar. Kështu që mohimi i këtyre të vërtetave të pa kundërshtueshme të shpallura nga vet Allahu i Lartësuar, në të vertetë konsiderohet mohim dhe rebelim ndaj vet Krijuesit, Allahut të Lartësuar.

2. Duke thënë: *'muŝaddiķal-limâ meahum'* (vërtetuese e asaj që kanë ata). Pra, ajo është miratuese e të vërtetave që gjenden mes tyre, në librat e tyre. Por jo vetëm kaq. Ajo është, madje, edhe garantuese e argumentuese e vërtetësisë së tyre.

Atëherë, (thotë kuptimi i ajetit) përse e besoni atë që ju ka zbritur juve dhe e mohoni simotrën e saj? A nuk tregon kjo thjesht një ndjekje të egos tuaj? E pra, veprimi juaj nuk mund të konsiderohet kurrsesi si ndjekje e udhëzimit të drejtë, por ai është vetë humbja dhe pasimi i të kotës.

Këtu shfaqet një çështje tjetër, që duhet kuptuar mirë. Meqë Kur'âni është vërtetues dhe sigurues i saktësisë së teksteve hyjnore që ata kanë në duart e tyre, kjo do të thotë që ata duhet të jenë besimtarët e parë të tij. Ata nuk kanë mundësi tjetër që të provojnë saktësinë dhe autenticitetin e ndonjë pjese nga librat që kanë në duart e tyre, përveç verifikimit që mund t'u bëjë Shpallja e fundit e Allahut. Shpallja e fundit është e vetmja

dëshmi për ta, që mund të vërtetojë, pra, saktësinë e ndonjë pjese nga librat e tyre, dhe kjo për shumë arsye.

Por si mund ta vërtetojnë saktësinë e librave të tyre, kur ata shpërfillin, mohojnë dhe nuk pranojnë të vetmen rrugë për ta arritur këtë? A nuk është kjo një marrëzi apo një mendjelehtësi e theksuar?

Si përfundim, themi se ata, duke mohuar Shpalljen e fundit, në të vërtetë kanë mohuar edhe ato tekste që kanë në duart e tyre.

Më poshtë, Allahu i Lartësuar sjell edhe fakte të tjera, të cilat tregojnë qartë se ata, edhe librin e tyre nuk e kanë besuar ashtu sikurse pretendojnë. I Lartësuari thotë:

- "Thuaj: "Nëse ishit besimtarë, atëherë përse i vrisnit profetët e Allahut?"" - Kuptimi: Mos vallë, vrasja e profetëve konsiderohet si shenjë e besimit tuaj tek ata?!

- "Juve ju erdhi Musai me argumente të qarta…" - Kuptimi: Musai (a.s.) u dërgua si profet ndër ju dhe solli argumente shumë të qarta dhe të sigurta të së vërtetës, por megjithatë:

- "…por pas *(largimit të)* tij, ju adhuruat viçin…" - Por edhe pas këtyre argumenteve, ju bëtë gjynahun e madh. A konsiderohet kjo si shenjë besimi nga ana juaj? Jo, kurrsesi!

- "…duke u bërë të padrejtë…" – Pra, ju nuk keni asnjë justifikim për këtë padrejtësi tuajën. Ky veprim konsiderohet "padrejtësi", dhe jo besim.

Rastet kur ata kanë shprehur mosbesimin janë të shumta. Ja edhe një shembull tjetër, që tregon i Lartësuari:

- "Kur morëm prej jush premtimin, duke ngritur mbi ju *(kodrën)* Turin, ju thamë: "Merreni seriozisht atë që ju kemi dhënë dhe dëgjoni!"" - Kuptimi: Allahu i Lartësuar ju urdhëroi në të tilla kushte, që të bëheshit të dëgjueshëm.

Shprehja: "*ue smeû*" (dëgjoni) është urdhër për të dëgjuar, që, në fakt, nënkupton bindjen dhe nënshtrimin ndaj urdhrave. Por, a dëgjuan ata në këtë mënyrë?

- "Ata thanë: "Ne dëgjuam, por kundërshtojmë". " – Kështu, ata u kthyen në natyrën e tyre të përhershme, që nuk dinë tjetër të thonë, por veçse: "*Semi'nâ ue aŝajnâ*" (Dëgjuam, por nuk u bindëm).

Atëherë, ky lloj qëndrimi e meriton plotësisht vendimin e të Urtit për ta, i Cili thotë:

- "Si pasojë e mosbesimit, për zemrat e tyre u bë i dashur adhurimi i viçit…" - Domethënë, për shkak të mohimit të tyre të vazhdueshëm, ata e merituan që për zemrat e tyre të bëhej i dashur, madje një dëshirë e parezistueshme, adhurimi i viçit.

Subhanallah! Po a mund të quhet *iman* ai që të çon në të tilla përfundime?

Thotë i Lartësuari:

- "Thuaj: "Nëse jeni besimtarë, atëherë besimi juaj qenka duke ju udhëzuar për keq!"" – Kuptimi: Ju pretendoni se keni besim, e madje lëvdoheni mes njerëzve për besimin tuaj, duke pretenduar se është e vërteta e sigurt. Por çfarë mund të thoni për vrasjen e profetëve të Allahut me duart tuaja? Po kur adhuruat viçin si zot, pasi Musai (a.s.) ju la vetëm për një moment? Çfarë mund të thoni për refuzimin e urdhrave dhe ndalesave që atij iu shpallën prej Zotit, edhe pas kërcënimit që ju bë me kodrën Tur, e cila u ngrit mbi kokat tuaj? E, megjithatë, ju e pranuat se do të ishit të rregullt, por vetëm me fjalë, sepse e shkelët premtimin me veprat tuaja. Kjo është feja që ju pretendoni?


Nëse ky do të quhej besim, sipas pretendimit tuaj, atëherë, më e pakta që mund të thuhet është: U poshtëroftë dhe u harroftë ai besim që e shtyn njeriun të kalojë kufijtë e Zotit, duke e mohuar dhe

kundërshtuar Atë dhe profetët e Tij! U poshtëroftë ai besim që e zhyt njeriun në gjynahe pa fund!

Por dihet shumë mirë se besimi i sinqertë e nxit njeriun për vepra të mira dhe e ndalon nga çdo vepër e keqe. Atëherë, si përfundim, nuk ka dyshim në mashtrimin dhe kotësinë e pretendimeve të tyre.

Ajetet 94 – 96

94. Thuaj: "Nëse bota tjetër është tek Allahu vetëm për ju, jo për njerëzit e tjerë, kërkojeni vdekjen, nëse jeni të sinqertë."
95. Por për shkak të veprave të tyre, ata nuk do ta kërkonin kurrë atë. Allahu i njeh të padrejtët.
96. Është e sigurt se ata janë njerëzit më lakmues për të jetuar, madje edhe më lakmues se idhujtarët. Çdokush prej tyre do të dëshironte të jetonte një mijë vjet. Por edhe sikur të jetonte aq, kjo nuk do ta shpëtonte atë prej dënimit. Allahu e sheh çka veprojnë ata.


الجزء الأول سورة البقرة
قُلْ إِن كَانَتْ لَكُمُ ٱلدَّارُ ٱلْآخِرَةُ عِندَ ٱللَّهِ خَالِصَةً مِّن
دُونِ ٱلنَّاسِ فَتَمَنَّوُا۟ ٱلْمَوْتَ إِن كُنتُمْ صَٰدِقِينَ ﴿٩٤﴾ وَلَن
يَتَمَنَّوْهُ أَبَدًۢا بِمَا قَدَّمَتْ أَيْدِيهِمْ ۗ وَٱللَّهُ عَلِيمٌۢ بِٱلظَّٰلِمِينَ
﴿٩٥﴾ وَلَتَجِدَنَّهُمْ أَحْرَصَ ٱلنَّاسِ عَلَىٰ حَيَوٰةٍ وَمِنَ ٱلَّذِينَ أَشْرَكُوا۟
يَوَدُّ أَحَدُهُمْ لَوْ يُعَمَّرُ أَلْفَ سَنَةٍ وَمَا هُوَ بِمُزَحْزِحِهِۦ مِنَ
ٱلْعَذَابِ أَن يُعَمَّرَ ۗ وَٱللَّهُ بَصِيرٌۢ بِمَا يَعْمَلُونَ ﴿٩٦﴾ قُلْ مَن
كَانَ عَدُوًّا لِّجِبْرِيلَ فَإِنَّهُۥ نَزَّلَهُۥ عَلَىٰ قَلْبِكَ بِإِذْنِ
ٱللَّهِ مُصَدِّقًا لِّمَا بَيْنَ يَدَيْهِ وَهُدًى وَبُشْرَىٰ لِلْمُؤْمِنِينَ
﴿٩٧﴾ مَن كَانَ عَدُوًّا لِّلَّهِ وَمَلَٰٓئِكَتِهِۦ وَرُسُلِهِۦ وَجِبْرِيلَ
وَمِيكَىٰلَ فَإِنَّ ٱللَّهَ عَدُوٌّ لِّلْكَٰفِرِينَ ﴿٩٨﴾ وَلَقَدْ أَنزَلْنَآ
إِلَيْكَ ءَايَٰتٍۭ بَيِّنَٰتٍ ۖ وَمَا يَكْفُرُ بِهَآ إِلَّا ٱلْفَٰسِقُونَ ﴿٩٩﴾
أَوَكُلَّمَا عَٰهَدُوا۟ عَهْدًا نَّبَذَهُۥ فَرِيقٌ مِّنْهُم ۚ بَلْ أَكْثَرُهُمْ
لَا يُؤْمِنُونَ ﴿١٠٠﴾ وَلَمَّا جَآءَهُمْ رَسُولٌ مِّنْ عِندِ ٱللَّهِ مُصَدِّقٌ
لِّمَا مَعَهُمْ نَبَذَ فَرِيقٌ مِّنَ ٱلَّذِينَ أُوتُوا۟ ٱلْكِتَٰبَ
كِتَٰبَ ٱللَّهِ وَرَآءَ ظُهُورِهِمْ كَأَنَّهُمْ لَا يَعْلَمُونَ ﴿١٠١﴾
١٥

Shpjegimi i ajeteve

- "Thuaj: "Nëse bota tjetër është tek Allahu vetëm për ju, jo për njerëzit e tjerë", - Kuptimi: Thuaju atyre, o Muhamed, duke i ftuar që të vërtetojnë pretendimin e tyre: Ju thoni se Xheneti është vetëm për juve dhe se atje do të hyjnë veçse ata që janë çifutë ose krishterë. Ju pretendoni, gjithashtu, se zjarri i Xhehenemit do t'ju prekë veçse për disa ditë të caktuara. Atëherë, nëse jeni të sinqertë dhe të sigurt në këtë pretendim:

- "...kërkojeni vdekjen, nëse jeni të sinqertë." - Kjo qe një sfidë e hapur, në të cilën Profeti (s.a.u.s.) i ftonte ata.

Në fakt, flitet për një lloj "*mubâheletu*", domethënë për një lloj përbetimi, ku dy grupe kundërshtare me njëri-tjetrin e lusin Allahun që të ndëshkojë dhe mallkojë atë palë që është mashtruese prej tyre.

Pra, kjo duket si një ftesë që u bëhet atyre për një ballafaqim të tillë, ku të kërkohet mallkimi mbi mashtruesit e padrejtë. Në të tilla kushte, atyre nuk u mbetet gjë tjetër veçse të zgjedhin mes dy mundësive: ose të besojnë tek Allahu dhe te Profeti i Tij, ose të luten që mashtruesit dhe të padrejtët t'i kapë vdekja. Kjo mundësi e dytë duhej të ishte e thjeshtë për ata, me pretendimin që kishin, pasi vdekja do t'i afronte më shumë te Xhenetet e përjetësisë, që – sipas tyre – janë përgatitur vetëm për ta.

Por ata nuk e pranuan një ballafaqim të tillë, dhe kjo ishte dëshmi e kryeneçësisë së tyre kundër Allahut dhe Profetit të Tij.

Ata e dinin shumë mirë se ishin në gabim, siç thotë i Madhëruari:

- "Por për shkak të veprave të tyre, ata nuk do ta kërkonin kurrë atë. Allahu i njeh të padrejtët. - Për shkak të mohimit, rebelimit dhe poshtërsive të tyre, ata kurrë nuk do ta dëshironin vdekjen. Ata e dinin shumë mirë se kjo do të thoshte përshpejtim i ndëshkimit të hidhur, për shkak të veprave të tyre të shëmtuara.

Vdekja është gjëja më e trishtueshme dhe më e keqe për ta, madje:

- "Eshtë e sigurt se ata janë njerëzit më lakmues për të jetuar, madje edhe më lakmues se idhujtarët." - Ata janë njerëzit më të dhënë pas kësaj jete. Ata e duan këtë jetë me shumë se çdo njeri tjetër, madje edhe më shumë se idhujtarët, të cilët nuk besojnë asnjë profet dhe asnjë libër qiellor.

Aq e madhe është dashuria e tyre për këtë jetë, sa Allahu i Lartësuar e përshkruan në këtë mënyrë:

- "Çdokush prej tyre do të dëshironte të jetonte një mijë vjet. Por edhe sikur të jetonte aq, kjo nuk do ta shpëtonte atë prej dënimit." - Ky është përshkimi i një dashurie të pamatë për këtë jetë, sepse ata kërkojnë dhe dëshirojnë diçka të pamundur, për të kënaqur dëshirat e tyre kundrejt kësaj jete.

Megjithatë, ata nuk arrijnë ta kuptojnë se, edhe sikur të jetonin aq kohë, kjo nuk do t'i shpëtonte ata nga dënimi i pashmangshëm që i pret. Kërcënimi i Allahut do t'i ndjekë gjithmonë nga pas, siç thotë i Madhëruari:

- "Allahu e sheh se çka veprojnë ata." – Domethënë, ata kurrë nuk mund t'i ikin këtij kërcënimi të Allahut, që u kujton llogarinë e drejtë të Tij për punët e tyre të shëmtuara.

Ajetet 97 – 99

97. Thuaju atyre që janë armiq të Xhibrilit, se ai e ka zbritur Kur'ânin në zemrën tënde me urdhrin e Allahut, si vërtetues të asaj që ishte shpallur para tij dhe si udhëzues e përgëzues për besimtarët.
98. Kush është armik i Allahut, i engjëjve të Tij, i të dërguarve të Tij, i Xhibrilit dhe i Mikailit, ta dijë se Allahu është armik i jobesimtarëve.
99. Ne të kemi shpallur ty argumente të qarta, të cilat nuk i mohon askush, përveç të shthururve.

Shpjegimi i ajeteve

- "Thuaju atyre që janë armiq të Xhibrilit, se ai e ka zbritur Kur'ânin në zemrën tënde me urdhrin e Allahut..." – Pra, thuaju atyre që pretendojnë se shkaku që i pengon të besojnë është pikërisht afërsia dhe miqësia jote me engjëllin Xhibril (a.s.), dhe se po të ishte ndonjë melek tjetër i Allahut, ata do të të besonin dhe do të miratonin Shpalljen që të është zbritur ty. Domethënë, thuaju atyre se ky është thjesht një pretendim dhe justifikim i pabazë nga ana juaj, dhe një shprehje mendjemadhësie e paturpshme e juaja ndaj Allahut. Arsyeja është se ju e dini shumë mirë që është Xhibrili (a.s.) ai, nëpërmjet të cilit Allahu i Lartësuar ia zbriti Kur'ânin Muhamedit (a.s.) dhe e futi në zemrën e tij. Është Xhibrili (a.s.) ai që i ka zbritur shpalljet tek të gjithë profetët para teje. Pra, ai është veçse një i ngarkuar me mision prej Allahut të Madhëruar, një i dërguar dhe i urdhëruar prej Zotit te profetët.

Të mos harrojmë, gjithashtu, se ky libër që Xhibrili (a.s.) e solli prej Allahut të Lartësuar te Profeti i fundit, është miratues, vërtetues dhe në përputhje të plotë me shpalljet e tjera, të përcjella po nga ai. Xhibrili (a.s.) ka përcjellë te njerëzit veçse atë që i ka lejuar dhe urdhëruar Zoti i tij dhe i njerëzve, Allahu i Lartësuar.

- "...si vërtetues të asaj që ishte shpallur para tij..." – Kuptimi: Xhibrili (a.s.) e solli Kur'ânin në zemrën tënde, me lejen e Allahut të Lartësuar, që të jetë vërtetues, garantues dhe saktësues i shpalljeve të mëparshme. Në Shpalljet hyjnore nuk mund dhe nuk duhet të ketë asnjë lloj kundërshtie.

- "...dhe si udhëzues e përgëzues për besimtarët" - Ky libër është udhëzues dhe tregues i rrugës së shpëtimit prej të gjitha llojeve të devijimit dhe përhumbjes. Ai përmban udhëzimin e plotë dhe të mjaftueshëm për të shpëtuar dhe për t'u ruajtur nga rrugët e humbjes dhe të

shkatërrimit. Ky është kuptimi i cilësimit të Shpalljes si "udhëzim".

Gjithashtu, kjo Shpallje, të cilën ata e refuzojnë, është përgëzim e sihariq për besimtarët, për mirësitë që i presin ata në të dyja jetët: në dynja dhe në ahiret.

Atëherë, çfarë kuptimi ka armiqësia me një të dërguar të Allahut, me një melek, i cili sjell të tilla mirësi prej Allahut të Lartësuar dhe Mëshirues?! A nuk tregon kjo, në fakt, armiqësi dhe rebelim kundrejt vetë Zotit të botërave, i cili e dërgon atë? A nuk tregon kjo mohim dhe refuzim të paskrupullt dhe të padrejtë të argumenteve dhe udhëzimeve të Tij?

Nëse armiqësia ndaj Allahut, ndaj profetëve dhe ndaj shpalljeve të Tij do të kishte një përshkrim ekzakt, do të ishte pikërisht ai që jep Allahu, kur thotë:

- "Kush është armik i Allahut, i engjëjve të Tij, i të dërguarve të Tij, i Xhibrilit dhe i Mikailit, ta dijë se Allahu është armik i jobesimtarëve". - E si të mos i konsiderojë armiq ata, të cilët, kur shprehin armiqësinë dhe urrejtjen e tyre ndaj Xhibrilit (a.s.), në të vërtetë kanë shprehur urrejtjen për Allahun, për Dërguesin e Xhibrilit?! Në këtë mënyrë, ata urrejnë të gjithë melekët e tjerë, profetët dhe shpalljet e tyre. A nuk e meritojnë këta të quhen jobesimtarë?

E me gjithë këto pretendime të kota të tyre, Allahu i Lartësuar pohon diçka shumë të mrekullueshme për këtë Kur'ân, edhe pse ata nuk i kënaq një gjë e tillë:

- "Ne të kemi shpallur ty argumente të qarta..." - Ky Kur'ân është udhëzues për ata që e kërkojnë udhëzimin prej tij. Ndërsa për ata që i kthejnë shpinën, ky do të jetë dëshpërim, sepse me sqarimet e tij, ata nuk do të kenë asnjë justifikim para të Madhëruarit. Ata nuk do të kenë asnjë justifikim, sepse Kur'âni është aq i qartë, aq i kthjellët, aq i sigurt në gjithçka që përshkruan, që urdhëron dhe që ndalon, saqë nuk mund të mohohet dhe shpërfillet nga askush. Thotë i Lartësuari:

- "...të cilat nuk i mohon askush, përveç të shthururve (*fasikin*)" - Pra, atë nuk e mohon askush, përveç atyre që kanë dalë jashtë kontrollit të vetes dhe jashtë kufijve të Allahut, që nuk i binden të Madhëruarit dhe që janë mendjemëdhenj e kundërshtues.

Ajetet 100 – 103

100. A thua sa herë që ata bënin ndonjë premtim, një grup prej tyre e thyente atë? Jo, por shumica e tyre nuk besojnë.
101. Kur atyre u erdhi një i Dërguari prej Allahut, si vërtetues i asaj që ata kishin, një grup prej tyre e flakën pas shpine Librin e Allahut, sikur të mos kishin dijeni.
102. Ata vepruan ashtu si shejtanët në kohën e sundimit të Sulejmanit. Por Sulejmani nuk ishte mohues. Mohues ishin shejtanët, të cilët u mësonin njerëzve magjinë dhe atë *(lloj magjie)* që u zbriti dy engjëjve në Babiloni: Harutit dhe Marutit. Ata *(dy engjëjt)* nuk ia mësonin *(magjinë)* askujt, para se t'i thonin: "Ne jemi dërguar vetëm për t'ju sprovuar, pra mos u bëj mohues *(duke mësuar magjinë)*!" Dhe njerëzit mësuan nga ata të dy se si ta ndanin burrin prej gruas së vet, megjithëse askujt nuk mund t'i bënin dëm me atë *(magji)*, pa lejen e Allahut. Ata mësonin çka u sillte dëm, e nuk u sillte asnjë dobi. Ata ishin krejtësisht të vetëdijshëm se kush e përvetësonte atë *(magjinë)*, nuk do të kishte pjesë në jetën tjetër. Sa e keqe është ajo për të cilën ata shitën veten! Ah, sikur ta dinin!
103. Sikur ata të kishin besuar dhe të ishin ruajtur, shpërblimi prej Allahut do të ishte shumë më i dobishëm. Ah, sikur ta dinin!

Shpjegimi i ajeteve

- "A thua sa herë që ata bënin ndonjë premtim, një grup prej tyre e thyente atë?" - Kjo pyetje fsheh në vetvete një habi të madhe, për sa u përket betimeve të shumta

të tyre, ndaj të cilave kurrë nuk patën durim të ishin të qëndrueshëm. Shprehja: "sa herë që" të jep të kuptosh përsëritjen e përhershme të këtij veprimi. A thua se dinin të bënin gjë tjetër veç saj?! Sa herë që premtonin, ata e shkelnin fjalën e dhënë.

Po cili që shkaku i kësaj paqëndrueshmërie? Thotë i Lartësuari:

- "Jo, por shumica e tyre nuk besojnë." – Pra, ky është shkaku. Mosbesimi i tyre i shtynte në mënyrë të pashmangshme drejt thyerjes së premtimeve. Nëse besimi i tyre do të ishte i sinqertë, për ta do të flitej ndryshe, sikurse thotë Allahu i Lartësuar për besimtarët e vërtetë: "Prej besimtarëve, ka burra që e kanë mbajtur premtimin e dhënë..." [Ahzab, 23].

- "Kur atyre u erdhi një i Dërguar prej Allahut, si vërtetues i asaj që ata kishin..." – Kuptimi: Kur atyre u shkoi Profeti i nderuar, me këtë Libër të madh, që vërtetonte dhe argumentonte tekstet që gjendeshin në duart e tyre, ata e mohuan dhe refuzuan ta pasonin, duke pretenduar se besonin vetëm Shkrimet e tyre.

Por vetë mospranimi i Librit të Allahut nga ana e tyre e përgënjeshtronte qëndrimin që ata mbanin, madje tregonte edhe mohimin e Shkrimeve të tyre, sikurse e thamë më lart.

- " ...një grup prej tyre e flakën pas shpine Librin e Allahut, sikur të mos kishin dijeni." - Pra, me mohimin e Kur'ânit, ata e hodhën pas shpine Librin e Allahut, duke treguar mospërfillje ndaj tij.

Thënia e Allaut të Lartësuar: **"...sikur të mos kishin dijeni"**, tregon se sa i shëmtuar dhe sa pa vend ishte ky refuzim i tyre. Ata vepruan njëlloj sikurse ata që nuk kishin aspak dije rreth librave të shpallur nga Allahu. Madje gjendja e tyre ishte më e mjerë se e të tjerëve, të cilët mohuan pa dije.

Pas këtij veprimi, ata nuk mund të pretendonin se rruga që ndiqnin ishte e mbështetur në tekste hyjnore, sepse mohimi i Kur'ânit nënkuptonte dhe mohimin e asaj pjese të vërtetë që gjendej në librat e tyre.

Allahu i Lartësuar dhe i Urtë ka vendosur në gjithësi një rregull të pakthyeshëm dhe të pandryshueshëm, që tregon urtësinë e Tij të madhe. Sipas këtij rregulli, çdokush që e braktis ose e hedh poshtë atë gjë që i bën dobi, ose që i ka të gjitha mundësitë që të përfitojë prej saj, por nuk përfiton, atëherë ky njeri do të sprovohet duke u bërë që të angazhohet me diçka tjetër, që, në fakt, i bën dëm. Sipas këtij rregulli të urtë, çdokush që e braktis adhurimin e Rrahmanit (Allahut), ai patjetër do të adhurojë tjetërkë veç Tij. Kush e braktis dhe nuk e kultivon dashurinë për Allahun, shpresën dhe frikë-respektin për Të, atëherë domosdo që zemra e tij do të mbushet me dashurinë për dikë tjetër veç Tij. Ajo zemër do të shpresojë diçka tjetër veç Allahut dhe do të frikësohet prej çdo gjëje tjetër veç Allahut. Po ashtu, ai që nuk e shpenzon pasurinë e tij për t'iu bindur Allahut dhe për të arritur kënaqësinë e Tij, do ta shpenzojë atë në rrugën e Shejtanit, në bindjen dhe nënshtrimin ndaj tij. Kush nuk i përulet Allahut, Zotit të tij, sigurisht që ka për t'u nënshtruar para krijesave. Dhe në fund, ai që e braktis të vërtetën, do të sprovohet duke ndjekur të kotën.

E njëjta gjë ndodhi me këta çifutë. Kur ata e braktisën Librin e Allahut (në kohën e tyre), u sprovuan duke pasuar atë që sollën shejtanët në kohën e Sulejmanit: ata filluan të ushtronin magjinë.


- "Ata vepruan ashtu si shejtanët në kohën e sundimit të Sulejmanit." - Në kohën e Sulejmanit (a.s.), shejtanët filluan t'u mësonin njerëzve magjinë, madje pretendonin se edhe vetë Sulejmani (a.s.) e ushtronte atë. Ata shpifnin duke thënë se ai (a.s.) e arriti pushtetin dhe pasurinë që kishte nëpërmjet magjisë.

Por Allahu i Lartësuar ua hedh poshtë këtë trillim ndaj Profetit të Tij dhe thotë:

- "Por Sulejmani nuk ishte mohues. Mohues ishin shejtanët..." - Profeti i Tij kurrë nuk mund të bënte një vepër kufri. Sulejmani kurrë nuk e mësoi magjinë dhe as nuk e përdori atë. Ata që bënë kufër ishin pikërisht shejtanët, të cilët u mësonin njerëzve magjinë dhe i nxisnin për ta ushtruar atë. Ata ishin shumë të zellshëm për t'i çuar njerëzit në humbje.

Të tillë ishin edhe çifutët, që pasuan magjinë e shfaqur nëpërmjet dy engjëjve në Babiloni, në vendin ku ndodhet Iraku sot.

- "...të cilët u mësonin njerëzve magjinë dhe atë *(lloj magjie)* që u zbriti dy engjëjve në Babiloni: Harutit dhe Marutit" - Këta dy engjëj u shfaqën si sprovë për njerëzit. Allahu i Lartësuar deshi t'i sprovonte njerëzit me këta dy engjëj, të cilët njihnin magjinë dhe mund t'ua mësonin atë të tjerëve. Por para se t'ua mësonin magjinë, ata gjithmonë i paralajmëronin njerëzit, siç tregon Allahu i Lartësuar:



- "Ata nuk ia mësonin atë *(magjinë)* askujt, para se t'i thonin: "Ne jemi dërguar vetëm për t'ju sprovuar, pra mos u bëj mohues *(qafir)*!" - Ata nuk ia mësonin askujt magjinë, para se ta paralajmëronin dhe ta këshillonin se kjo qe sprovë prej Allahut të Lartësuar.

Pra, çdo person e këshillonin: "Mos u mashtro, mos e mëso magjinë, se ajo është vepër kufri." Kështu, ata i ndalonin njerëzit nga magjia, duke i paralajmëruar se ajo konsiderohet si mohim ndaj Allahut.

Ndërsa përhapja e magjisë nëpërmjet shejtanëve ishte shkatërrimi vetë. Ata synonin që të devijonin njerëzit nga rruga e vërtetë dhe t'i çonin drejt humbjes. Madje, ata e justifikonin këtë shejtanëzi të tyre duke gënjyer se edhe Sulejmani (a.s.) e ushtronte atë vepër. Por është e sigurt që Allahu i Lartësuar kurrsesi nuk mund ta lejonte një Profet të Tij që të binte në grada kaq të ulta. Edhe dy engjëjt ishin veçse sprovë për njerëzit, të cilët në çdo rast paralajmëroheshin që të mos e mësonin magjinë, se përndryshe nuk do të kishin asnjë justifikim para Allahut të Lartësuar.

Kështu pra, çifutët filluan të mësonin magjinë prej shejtanëve dhe prej dy melekëve, duke i hedhur pas shpine këshillat e të dërguarve të Allahut. Ata iu dhanë me gjithë shpirt kësaj vepre shejtanëzore, dhe dihet që çdokush i përkushtohet asaj gjëje që i shkon për shtat.

Pastaj Allahu i Lartësuar përmend dëmet që sjell magjia:

- "Dhe njerëzit mësuan nga ata të dy se si ta ndanin burrin prej gruas së vet" - Dihet që dashuria mes bashkëshortëve, për nga rëndësia, nuk krahasohet me asnjë dashuri tjetër ndërnjerëzore. Duke folur për këtë ndjenjë të fuqishme mes atyre të dyve, i Lartësuari thotë: "Ai *(Allahu)* vendosi mes jush dashuri dhe mëshirë". Kurse magjia, nga ana e saj, i humbet dhe i zhduk këto ndjenja. Kjo tregon, gjithashtu, se magjia

është e vërtetë dhe ndikuese, por ajo dëmton vetëm nëse Allahu i Lartësuar e lejon një gjë të tillë.

Megjithatë, duhet ditur që, nëse Allahu i Lartësuar e lejon diçka, kjo nuk do të thotë me domosdo që Ai ka dashuri për atë gjë. Allahu i Lartësuar mund të lejojë të ndodhë edhe diçka që nuk e pëlqen, pasi lejimi i Tij është dy llojesh:

- Lejim në funksion të përcaktimit të Tij hyjnor (*idhnun kaderij*). Këtë lloj, Allahu i Lartësuar, me urtësinë e Tij, e ka dëshiruar që të ekzistojë si sprovë për njerëzit, pavarësisht se ajo mund të jetë e urryer për Atë, sikurse është edhe rasti i përmendur në këtë ajet (për magjinë).

- Lejim sipas dispozitave të drejta të Sheriatit të Allahut (*idhun sherij*). Me fjalë të tjera, ky lejim është më tepër një urdhër prej Allahut për të bërë diçka. Nëse lejimi i parë mund të jetë ose jo i urryer për Allahun e Lartësuar, lloji i dytë është veçse i dashur për Të, sepse Allahu i Lartësuar urdhëron veçse për atë që është e mirë dhe e dashur për Atë.

- "...megjithëse askujt nuk mund t'i bënin dëm me atë *(magji)*, pa lejen e Allahut" - Ky ajet, por dhe ajete të ngjashme me të, dëshmon se shkaqet në këtë gjithësi, sado të fortë ta kenë ndikimin, ato përsëri janë të varura nga përcaktimi dhe lejimi i Krijuesit. Ato kurrsesi nuk janë të pavarura në ndikimin dhe veprimin e tyre.

Ky është një parim shumë i rëndësishëm, të cilin asnjë sekt nuk e ka kundërshtuar, përveç *kaderive*, të cilët pretendojnë se veprat e robërve janë krejtësisht të pavarura nga fakti se a i lejon apo jo i Plotfuqishmi. Ata mendojnë që Allahu i Lartësuar nuk ka aspak mundësi që të ndikojë në veprimet e tyre! Por e vërteta është se asgjë nuk mund t'i shpëtojë pushtetit absolut të të Plotfuqishmit. Ata, në këtë mënyrë, kanë kundërshtuar Librin e Allahut, Traditën e Pejgamberit (s.a.u.s.) dhe mendimin konsensual të sahabëve dhe tabi'inëve. Më tej, i Madhëruari thotë se dija rreth magjisë nuk ka kurrfarë dobie:

- "Ata mësonin çka u sillte dëm, e nuk u sillte asnjë dobi". - Në disa lloje gjynahesh, njeriu mund të gjejë ndonjë dobi të kësaj dynjaje. Por Allahu i Lartësuar na lajmëron se mësimi i magjisë nuk të sjell asnjë lloj dobie, as në dynja e as në jetën tjetër. Për shembull, për alkoolin dhe kumarin, Ai thotë: "Thuaju se ato janë gjynahe të mëdha, por kanë edhe dobi për njerëzit. Megjithatë, gjynahu i tyre është më i madh se dobia që sjellin." [Bekare, 219]. Ndërsa magjinë e ka konsideruar si një dëmtuese të pastër, pa kurrfarë dobie. Asgjë nuk e bën të nevojshme mësimin e saj.

Të tilla janë të gjitha gjërat të cilat na i ka ndaluar Allahu i Lartësuar: ose janë krejtësisht të dëmshme, ose kanë dobi të papërfillshme përballë dëmeve dhe gjynaheve që sjellin.

Ndërsa urdhëresat e Tij, ose janë tërësisht të dobishme, ose dobia dhe shpërblimi i madh i tyre e bën të papërfillshëm atë pak mundim dhe dëm që ato sjellin në këtë jetë.

- "Ata ishin krejtësisht të vetëdijshëm se kush e përvetësonte atë *(magjinë)*, nuk do të kishte pjesë në jetën tjetër." - Domethënë, çifutët e dinin shumë mirë se kjo tregti e tyre për të blerë magjinë, duke e paguar me gjënë më të vyer, do të sillte për ta një përfundim të dëshpëruar. Ata e dinin se nuk do të kishin pjesë në mëshirën e Allahut. Me këtë shkëmbim, ata merituan ndëshkimin e përjetshëm. Kësisoj, ata nuk e kryen veprën e ulët nga padituria, por ata thjesht shprehën qartë dashurinë e tyre për këtë jetë, kundrejt jetës së amshuar pranë Allahut dhe mëshirës së Tij.

- "Sa e keqe është ajo për të cilën ata shitën veten! Ah, sikur ta dinin!" – Kuptimi: Si është e mundur që ata nuk e kuptojnë se çfarë humbën nga duart, dhe se çfarë dëshpërimi të përjetshëm fituan?!

- "Sikur ata të kishin besuar dhe të ishin ruajtur, shpërblimi prej Allahut do të ishte shumë më i dobishëm. Ah, sikur ta dinin!"

Ajetet 104 – 105

104. O ju që keni besuar! Mos thoni: "*Raina*", por thoni: "*Undhurna*" dhe dëgjoni! Për jobesimtarët ka dënim të dhembshëm.
105. Ata që nuk besojnë, si ithtarët e Librit, ashtu edhe idhujtarët, kurrë nuk do të donin që juve t'ju vijë ndonjë e mirë nga Zoti juaj. Por Allahu ia dhuron mëshirën e Vet kujt të dëshirojë. Allahu është Zoti i mirësisë së madhe.

Shpjegimi i ajeteve

- "O ju që keni besuar! Mos thoni: "*Raina*"..." – Besimtarët, gjatë mësimit të dispozitave të fesë prej Profetit (s.a.u.s.), i thonin shpesh atij "*Râinâ*" (Vështrona), domethënë: Na shiko se si reagojmë ndaj caktimit të dispozitave. Ky ishte një kuptim i drejtë dhe i pranueshëm i kësaj fjale, por çifutët e përdornin atë me kuptime të këqija e të shëmtuara. Kështu, ata shfrytëzuan rastin dhe filluan t'i drejtoheshin Profetit (s.a.u.s.) me fjalën "*Râinâ*", duke mos patur si qëllim kuptimin e saktë dhe të drejtë të saj, por pikërisht kuptimin e keq të fjalës. Si rrjedhojë, Allahu i Lartësuar i ndaloi besimtarët nga përdorimi i kësaj fjale, për t'ua hequr atë mundësi çifutëve, edhe pse, në vetvete, ajo fjalë nuk kishte ndonjë të keqe.

Ky ajet shërben si argument që, nëse diçka të çon drejt së ndaluarës, ajo konsiderohet gjithashtu e ndaluar, edhe nëse, në vetvete, është e lejuar. Me fjalë të tjera: e lejuara konsiderohet e ndaluar, nëse të çon drejt së ndaluarës.

Ky ajet na nxit, gjithashtu, që të ruajmë edukatën e të folurit dhe të kontrollojmë fjalët që përdorim. Ai na nxit që të përdorim ato fjalë që kanë vetëm kuptime të mira, larg domethënieve të shëmtuara e fyese. Prej tij mësojmë që duhet të largohemi nga përdorimi i fjalëve me kuptime që nuk i shkojnë për shtat besimtarit. I Lartësuari na urdhëron që të themi fjalë që nënkuptojnë vetëm të mirën.

Në këtë rast, Allahu i Lartësuar i urdhëroi besimtarët që të thonin: "*Unđhurnâ*":

- "por thoni: "*Undhurna*"..." – Kuptimi: Fjala "*Unđhurnâ*" është e mjaftueshme dhe tepër e goditur për të shprehur mendimin tuaj, duke mos nënkuptuar asgjë të ndaluar.
- "dhe dëgjoni!" – Këtu Allahu i Lartësuar na ka urdhëruar që të bindemi. Me fjalën "*uesmeu*" (dëgjoni) nuk është treguar në mënyrë të veçantë se çfarë duhet të dëgjohet. Kjo është bërë me qëllim që ajo të përfshijë të gjitha ato gjëra që duhet të dëgjohen, qofshin ato nga Kur'âni apo nga Suneti i Pejgamberit (s.a.u.s.).


Ky dëgjim duhet plotësuar me të trija fazat e tij, që janë: së pari, dëgjimi me kujdes i fjalëve, së dyti të kuptuarit e tyre dhe, së treti, bindja ndaj atyre që dëgjove dhe i kuptove.

Siç shihet, ky ajet është nxitje për një edukatë të lartë në të folur dhe për bindje të plotë.

Pas kësaj, i Madhëruari kërcënon qafirët me një dënim të dhembshëm:

- "Për jobesimtarët ka dënim të dhembshëm"

- Ata që nuk besojnë, si ithtarët e Librit, ashtu edhe idhujtarët, kurrë nuk do të donin që juve t'ju vijë ndonjë e mirë nga Zoti juaj. – Domethënë, qafirët, të çfarëdo ngjyre qofshin, nuk dëshirojnë kurrë që muslimanët të gëzojnë ndonjë të mirë. Në ajet thuhet: "*min ħajrin*" - "prej mirësisë", domethënë çdo lloj mirësie, qoftë ajo e madhe apo e vogël. Pra, ata nuk dëshirojnë që besimtarëve t'u jepet ndonjë lloj mirësie, e vogël apo e madhe qoftë ajo. Kjo ndjenjë vjen nga smira dhe urrejtja që ata kanë kundër tyre. Ata nuk dëshirojnë kurrsesi që



Allahu t'i dallojë muslimanët me mirësitë e Tij, mbi të tjerët.

Por ata nuk mund ta kufizojnë mirësinë e Allahut, sepse:

- "Allahu ia dhuron mëshirën e Vet kujt të dëshirojë. Allahu është Zoti i mirësisë së madhe." – Dhe prej mirësive më të mëdha që Ai ju ka falur është shpallja e këtij Libri madhështor, është dërgimi i Profetit tuaj, me synimin që t'ju pastrojë ju (në çdo aspekt) dhe t'ju mësojë Kur'ânin dhe Urtësinë profetike. Nëpërmjet tij, Allahu dëshiron që t'ju mësojë juve atë që ju nuk e dini. Ai është i Lavdëruar dhe meriton mirënjohjen më të thellë.

Ajetet 106 – 107

106. Ne nuk shfuqizojmë asnjë ajet *(ose dispozitë ligjore)*, apo ta lëmë në harresë, e të mos sjellim një tjetër më të dobishëm se ai, ose të ngjashëm me të. A nuk e di ti se Allahu është i Plotpushtetshëm për gjithçka?!

107. A nuk e di ti se vetëm Allahut i takon sundimi i qiejve dhe i tokës?! Përveç Allahut, ju nuk keni asnjë ndihmues dhe asnjë mbrojtës tjetër.

Shpjegimi i ajeteve

- "Ne nuk shfuqizojmë asnjë ajet *(ose dispozitë ligjore)*, apo ta lëmë në harresë, e të mos sjellim një tjetër më të dobishëm se ai, ose të ngjashëm me të." - Shfuqizimi (ose anulimi i një dispozite) është, në fakt, një ndryshim gjykimi. Pra, ngarkimi i të përgjegjshmëve ligjërisht me një tjetër dispozitë ligjore, ose rrëzimi plotësisht i kësaj dispozite.

Çifutët nuk e pranonin shfuqizimin si praktikë, duke pretenduar se ai nuk lejohet të bëhet me dispozitat e Allahut. Pavarësisht nga kjo, e vërteta është se shfuqizimi i dispozitave njihej mirë në fenë e tyre. Ai është përmendur dhe zbatuar edhe në Teurat. Kështu që, ky refuzim nga ana e tyre nuk ishte gjë tjetër, por veçse një shprehje e radhës e kufrit dhe mosbindjes së tyre të pakuptimtë.

Në këtë ajet, Allahu i Lartësuar na tregon urtësinë e kësaj praktike ligjore. I Lartësuari dhe i Urti na mëson se zëvendësimin e një dispozite apo heqjen e plotë të saj e bën veçse për të sjellë një dispozitë tjetër, që do të jetë më e mirë për njeriun, ose e ngjashme me të parën (për nga urtësia e dobia). Kjo tregon se dispozita zëvendësuese nuk mund të jetë kurrë më pak e dobishme dhe e vleftshme sesa ajo që është anuluar, sepse mirësia e Allahut vjen gjithmonë në rritje, sidomos kundrejt këtij umeti të begatë, të cilit Ai ia lehtësoi dispozitat ligjore në mënyrën më të mirë.

Më pas, i Urti na bën të ditur se kushdo që nuk e pranon praktikën ligjore (hyjnore) të shfuqizimit, në të vërtetë ka cenuar të drejtat absolute të sundimit dhe të pushtetit të Allahut të Lartësuar:

- "A nuk e di ti se Allahu është i Plotpushtetshëm për gjithçka?! A nuk e di

ti se vetëm Allahut i takon sundimi i qiejve dhe i tokës?!"

- "Përveç Allahut, ju nuk keni asnjë ndihmues dhe asnjë mbrojtës tjetër." - Meqë Ai është Sunduesi dhe Pronari juaj, atëherë Ai mund të veprojë si të dëshirojë në lidhje me ju. Ai e ka të drejtën absolute që të veprojë mes ju, ashtu si e kërkon bamirësia dhe mëshira e Tij ndaj jush. Ai është Pronari juaj i dashur, Bamirës dhe i Mëshirshëm. dhe të tilla janë edhe përcaktimet e Tij. Këtë synojnë edhe urdhrat dhe ndalesat e Tij, domethënë dispozitat që ka sjellë Ai për krijesat e Veta.

Atëherë, ashtu sikurse nuk lejohet të kundërshtojmë dhe as të revoltohemi kundrejt përcaktimeve të Tij mbi ne, po kështu nuk lejohet që ta kundërshtojmë apo të shfaqim pakënaqësi për ndonjë dispozitë të vendosur apo të anuluar prej Tij. Ne jemi të nënshtruar ndaj urdhrave dhe përcaktimeve të Tij. Ne nuk kemi të drejtë të kundërshtojmë asgjë, sidomos në çështjet që lidhen me atributin e Tij të Sunduesit dhe Zotëruesit të gjithësisë. Allahu i Lartësuar është Ai që përkujdeset për adhuruesit e Tij dhe gjithmonë i ndihmon ata për të arritur gjërat e dobishme dhe për t'u larguar nga gjërat e dëmshme. Prej përkujdesjes së Tij është pikërisht edhe caktimi i këtyre dispozitave, që janë shprehje e urtësisë dhe e mëshirës së Tij ndaj tyre.

Çdokush që vështron me kujdes të gjitha dispozitat e anuluara, e kupton shumë thjesht dhe qartë urtësinë dhe mëshirën e madhe të Allahut të Lartësuar në urdhrat e Tij; e kupton shumë mirë se, me sa butësi dhe lehtësi i udhëzon adhuruesit e Tij drejt asaj që është më e dobishme për ta, pa e ndier dhe pa e kuptuar.

Ajetet 108 – 110

108. A doni ta pyesni të Dërguarin tuaj ashtu si u pyet Musai?! Ai që e ndërron besimin me mosbesim, e ka humbur rrugën e drejtë.

109. Shumë ithtarë të Librit do të dëshironin që, pas besimit tuaj, t'ju kthejnë në jobesimtarë, të shtyrë nga zilia e tyre personale, edhe pasi u ishte bërë e qartë e vërteta. Falini dhe tolerojini ata, derisa Allahu ta sjellë urdhrin e Vet. Allahu ka pushtet për gjithçka.

110. Faleni namazin dhe jepeni zekatin! Çfarëdo të mire të përgatitni për veten tuaj, do ta gjeni tek Allahu. S'ka dyshim se Allahu është Vështrues i çdo veprimi tuaj.

Shpjegimi i ajeteve

- "A doni ta pyesni të Dërguarin tuaj ashtu si u pyet Musai?" - Allahu i Lartësuar i ndaloi besimtarët muslimanë, ose çifutët, që të pyesnin Profetin (a.s.) ashtu sikurse u pyet Musai më përpara.

Po cilat janë ato pyetje që u ndaluan t'i bëhen Profetit (a.s.), ose cilat pyetje, në përgjithësi, janë të ndaluara të bëhen? Pyetjet dhe kërkesat e ndaluara janë ato që bëhen thjesht për të polemizuar dhe për të kundërshtuar të vërtetën, domethënë ato që nuk drejtohen për të mësuar të vërtetën, por për të polemizuar rreth saj dhe për ta hedhur poshtë atë. Ja një shembull në Kur'ân: "Ithtarët e Librit kërkojnë prej teje (o Muhamed) që t'u zbresësh një libër prej qielli. Në fakt, ata i kërkuan Musait diçka edhe më të madhe *(duke i thënë)*: "Na trego Allahun haptazi!" Atëherë i shkatërroi rrufeja, për shkak të poshtërsisë që bënë. Pastaj zgjodhën viçin *(për adhurim)*, pas shenjave të qarta që iu patën ardhur. Ne ua falëm atë dhe i dhamë Musait pushtet të dukshëm." [Nisa 153]. Ose: "O ju besimtarë! Mos pyesni për gjëra që, sikur t'ju kthehej përgjigjja e drejtpërdrejtë, nuk do t'ju pëlqente, e nëse do të pyesnit për to kur shpallej Kur'âni, ato do t'ju bëheshin të qarta. Allahu jua ka falur kërshërinë. Allahu është Falës dhe i Butë. Të tilla pyetje i ka

bërë edhe një popull para jush, por pastaj u bënë jobesimtarë." [Maide 101, 102].

Pra, këto lloj pyetjesh e kërkesash janë të ndaluara, ndërsa pyetjet dhe kërkesat nëpërmjet të cilave synohet udhëzimi dhe e vërteta janë të pëlqyeshme të bëhen. Madje, Allahu i Lartësuar na ka urdhëruar që t'i bëjmë të tilla pyetje: "Pyesni përkujtuesit *(dijetarët)*, nëse nuk dini". [Nahl 43].

Po ashtu, Allahu i Lartësuar i ka miratuar besimtarët muslimanë në shumë pyetje e kërkesa të drejtuara Profetit të Tij dhe nuk i ka qortuar për të tilla pyetje, si për shembull, në suren Bekare: "Të pyesin ty për alkoolin dhe bixhozin. Thuaju …". Ose: "Të pyesin ty për jetimin…" etj., që tregojnë se të tilla pyetje a kërkesa nuk janë të qortueshme.

Pyetjet dhe kërkesat e ndaluara mund të çojnë edhe në mohim. Për këtë arsye, Allahu i Lartësuar ka tërhequr vërejtjen dhe ka thënë.

- "Ai që e ndërron besimin me mosbesim, e ka humbur rrugën e drejtë."

Më pas, Allahu i Lartësuar na zbulon një ndjenjë të brendshme të fortë, që vlon brenda gjoksit të tyre:

- "Shumë ithtarë të Librit do të dëshironin që, pas besimit tuaj, t'ju kthejnë në jobesimtarë" - Ata përpiqen me të gjitha mënyrat për të arritur këtë qëllim të poshtër. Ata i provojnë të gjitha llojet e kurtheve, por nuk e kuptojnë që ato u kthehen mbrapsht, për të goditur pikërisht ata.

Kurthet e tyre janë të larmishme. Duke na treguar një mënyrë të tyre për të dëmtuar muslimanët, i Lartësuari thotë në suren Al Imran, ajetet 72-74: "Disa nga ithtarët e Librit thonë: "Besojeni paradite atë që u është shpallur atyre që kanë besuar, dhe mohojeni pasdite. Ndoshta kështu edhe ata do të tërhiqen". Po ashtu: "Mos i besoni askujt, përveç atyre që janë të fesë suaj!" Thuaju *(o i Dërguar)*: "I vetmi udhëzim është udhëzimi i Allahut!" *(Ata i thonin njëri-tjetrit):* "Kurrë mos besoni se ndokujt po i jepet *(profecia, dija urtësia dhe mirësitë e mëdha)*, sikurse u është dhënë juve, përndryshe, *(ditën e gjykimit)*, do të polemizojnë kundër jush para Zotit tuaj! Thuaju: "E gjithë mirësia është në duar të Allahut! Ai ia jep atë kujt të dëshirojë. Allahu është Dhurues i gjerë, i Gjithëdijshëm". Ai dallon kë të dojë me mëshirën e Vet. Allahu është Zotërues i mirësisë së madhe."."

Ajo çfarë i shtynte në këtë veprim ishte thjesht smira e tyre, sepse ata e dinin mirë të vërtetën, siç thotë i Lartësuari:

- "të shtyrë nga zilia e tyre personale, edhe pasi u ishte bërë e qartë e vërteta." – Por, si gjithmonë, Allahu i Lartësuar urdhëroi që, përballë kësaj sjelljeje dhe synimi të keq të tyre, besimtarët t'i falnin dhe t'i toleronin, derisa Ai të sillte një gjykim përfundimtar për ta:

- "Falini dhe tolerojini ata, derisa Allahu ta sjellë urdhrin e Vet." – Dhe, vërtet, Allahu i Lartësuar e solli vendimin për ta, duke i urdhëruar besimtarët për xhihad. Në këtë mënyrë, u shua flaka e ndezur në zemrat e besimtarëve, të cilët kishin duruar dhe toleruar për aq kohë. Ata vranë atë që meritonte vrasjen, robëruan atë që meritonte robërimin dhe dëbuan ata që e merituan dëbimin. Allahu është i Plotfuqishëm që të ligjërojë çfarë të dëshirojë për robërit e Tij, siç thotë edhe Vetë:

- "Allahu ka pushtet për gjithçka"

Në ajetet e mëposhtme, Allahu i Lartësuar i udhëron besimtarët që t'i përkushtohen adhurimit të Allahut të Lartësuar:

- "Faleni namazin dhe jepeni zekatin!" - Duke falur namazin, duke dhënë zekatin dhe duke vepruar çdo gjë që kënaq Allahun e Lartësuar, Ai u premton se do t'i shpërblejë

me mirësinë e Tij. Për çdo gjë që do të kryejnë për hir të Tij, atyre nuk do t'u humbë kurrë shpërblimi, pasi do ta gjejnë atë të plotë tek Allahu i Lartësuar, madje edhe më tepër se aq, prej mirësisë së Tij:

- "Çfarëdo të mire të përgatitni për veten tuaj, atë do ta gjeni tek Allahu." - Dhe kush mund t'i llogarisë veprat më mirë dhe më drejt sesa Allahu i Lartësuar, që vështron dhe di gjithçka?!

- "S'ka dyshim se Allahu është Vështrues i çdo veprimi tuaj." - Ai i ka vështruar dhe i ka ruajtur saktësisht të gjitha veprat e tyre.

Ajetet 111 – 112

111. Ata *(ithtarët e Librit)* thonë: "Nuk ka për të hyrë në Xhenet askush, përveç atij që është çifut ose i krishterë!" Këto janë trille të tyre! Thuaju: "Sillni provat tuaja, nëse keni të drejtë!"
112. Përkundrazi, ai që i është dorëzuar Allahut dhe është bamirës, e ka shpërblimin e vet te Zoti i tij. Për ata nuk ka frikë, as nuk kanë pse të mërziten.

Shpjegimi i ajeteve

Çifutët pretendojnë se në Xhenet do të hyjnë veç ata. Edhe të krishterët, nga ana e tyre, thonë se në Xhenet do të hyjnë veçse të krishterët. Kështu secila palë pretendon se Xheneti është i përgatitur vetëm për ta. Porse Allahu i Lartësuar na tregon se këto janë thjesht pretendime e hamendje të tyre, sepse ato nuk mund të jenë kurrsesi të pranueshme, kur janë të paargumentuara saktësisht.

- "Ata *(ithtarët e Librit)* thonë: "Nuk ka për të hyrë në Xhenet askush, përveç atij që është çifut ose i krishterë!""

- "Këto janë trille të tyre!" – Pra, këto janë thjesht ëndrra me sy hapur nga ana e tyre. Nëse ata janë të qetë dhe të sigurt në pretendimin e tyre, duhet të sjellin faktet për ta mbështetur atë. Nëse do të pranohej çdo fjalë e pretendim që del nga njerëzit, pa u mbështetur në argumente të sakta, atëherë çdokush do të pretendonte gjithçka, pa patur asnjë ndryshim mes mëtuesve. Argumentimi i saktë është i vetmi vërtetues apo përgënjeshtrues i pretendimeve.

- "Thuaju: "Sillni provat tuaja, nëse keni të drejtë!"" - Meqë ata nuk sollën asnjë lloj argumenti, kuptohet vetvetiu që ky qe pretendim i gënjeshtërt i tyre.


Më pas, Allahu i Lartësuar na jep një kriter shumë të qartë dhe të kuptueshëm për të dalluar se cili do të hyjë në Xhenet e cili jo? Ky gjykim i përfshin të gjithë. Thotë i Lartësuari:

- "Përkundrazi, ai që i është dorëzuar Allahut dhe është bamirës..." – Pra, çështja nuk qëndron sikurse ëndërroni ju. Dëshirat dhe pretendimet tuaja nuk hyjnë aspak në punë, nëse nuk ia përkushtoni të gjitha veprat dhe adhurimet tuaja Allahut të Lartësuar, duke e drejtuar zemrën veçse tek Ai, dhe, përveç kësaj, duke qenë bamirës (*muhsin*). Pra, sinqeriteti i zemrës duhet të shoqërohet me një adhurim të saktë, që të bëhesh *muhsin*.

Fjala "*muhsin*" vjen nga "*ahsene juhsinu*", domethënë: "e rregulloi, e kreu mirë", ndërsa shprehja: "*ahsenehû etkanehû*" do të thotë: "e kreu në formën më të mirë". Kësisoj, "*ue hue muĥsin*" domethënë: "ai që e kryen adhurimin ndaj Allahut në formën më të shkëlqyer".

Asnjë adhurim nuk quhet i pranueshëm nga Allahu, nëse nuk kryhet sipas rregullit dhe mënyrës që Ai e ka dëshiruar dhe e ka sqaruar në Sheriatin që ia shpalli Muhamedit (a.s.). Vetëm ai njeri që e kryen këtë lloj adhurimi mund të quhet *muhsin* ose bamirës.

Mësojeni se vetëm ata që plotësojnë dy kushtet e mëposhtme do të jenë banues të Xhenetit:



1. Kanë sinqeritet në adhurim (duke e bërë atë vetëm për Allahun).
2. E kryejnë adhurimin sipas Sheriatit të përcaktuar nga Allahu i Lartësuar.

Pra, vetëm për këta është premtimi i pakthyeshëm nga Allahu i Lartësuar, i Cili thotë:

- "...e ka shpërblimin e vet te Zoti i tij. Për ata nuk ka frikë, as nuk kanë pse të mërziten." - Ata do të trashëgojnë përjetësisht shpërblimet e përgatitura prej Allahut, Zotit të tyre, në Xhenetet e mrekullueshme. Ata do t'i përjetojnë të dyja llojet e lumturisë: lumturinë që sjell shpëtimi nga zjarri i Xhehenemit dhe nga dëshpërimi i përjetshëm, si dhe lumturinë që sjell arritja e paqes dhe e sigurisë në Xhenetin e kënaqësisë së përjetshme.

Ajeti 113

113. Çifutët thonë: "Të krishterët nuk mbështeten në asgjë *(në fenë që pasojnë)*". Të krishterët thonë: "Çifutët nuk mbështeten në asgjë". Ndërkohë që të dyja palët lexojnë Librin. Po këto fjalë thonë edhe ata që janë injorantë. Në Ditën e Gjykimit, Allahu do të gjykojë ndërmjet tyre për kundërshtimet që ata kanë mes njëri-tjetrit.

Shpjegimi i ajetit

- "Çifutët thonë: "Të krishterët nuk mbështeten në asgjë *(në fenë që pasojnë)*". Të krishterët thonë: "Çifutët nuk mbështeten në asgjë"." - Smira e tyre ishte aq e fortë, saqë i shtynte ata të shanin dhe përgojonin njëri-tjetrin me fjalët më të ulëta. Ata e quanin njëri-tjetrin të humbur, të devijuar, madje edhe jobesimtarë. Kjo smirë i bënte ata të vepronin njëlloj si injorantët, që nuk kishin asnjë lloj dije nga librat.

- "Ndërkohë që të dyja palët lexojnë Librin. Po këto fjalë thonë edhe ata që janë injorantë."– Pra, edhe pse ata kanë dituri dhe kritere për të gjykuar, përsëri kryejnë veprime të injorantëve, të cilët flasin, shajnë e gjykojnë pa patur dije.

- "Në Ditën e Gjykimit, Allahu do të gjykojë ndërmjet tyre për kundërshtimet që ata kanë mes njëri-tjetrit." – Pra, megjithatë, Allahu i Lartësuar do të gjykojë mes tyre Ditën e Gjykimit. Ai do të qartësojë me drejtësi gjykimin e secilës palë, në të gjitha aspektet. Ai do ta bëjë këtë me gjykimin e Tij të drejtë, rreth të cilit i informoi njerëzit nëpërmjet shpalljeve dhe profetëve të Tij.

Atë ditë, askush nuk do të dalë me sukses dhe askush nuk do të shpëtojë prej ndëshkimit, përveç atyre që kanë besuar të gjithë të dërguarit e Allahut, duke zbatuar urdhrat dhe duke iu larguar ndalesave. Ndërsa ata që nuk u janë përmbajtur këtyre dispozitave, me të drejtë do të quhen: "të shkatërruar e të dëshpëruar përjetësisht."

Ajeti 114

114. E kush mund të jetë më mizor se ai që, në xhamitë e Allahut, pengon të përmendet emri i Tij dhe përpiqet për shkatërrimin e tyre. Ata nuk do të hyjnë në to, përveçse duke qenë të frikësuar. Në këtë jetë, ata meritojnë poshtërim, ndërsa në botën tjetër do të kenë dënim të madh.

Shpjegimi i ajetit

- "E kush mund të jetë më mizor se ai që, në xhamitë e Allahut, pengon të përmendet emri i Tij dhe përpiqet për shkatërrimin e tyre. Ata nuk do të hyjnë në to, përveçse duke qenë të frikësuar." – Domethënë, nuk ka zullumqarë më të mëdhenj sesa ata që i mbyllin xhamitë, në mënyrë që në to të mos përmendet emri i Allahut dhe mos adhurohet Ai, ose e thënë ndryshe: ata që pengojnë faljen e namazit dhe çdo adhurim tjetër që kryhet në to.

Në fragmentin: "*ue seâ fî ħarâbihâ*" (…dhe përpiqet për shkatërrimin e tyre), fjala "*seâ*" ka kuptimin: "përpiqet duke provuar të gjitha mënyrat dhe mjetet për të arritur qëllimin".

Ndërsa për pjesën "për shkatërrimin e tyre", mund të themi se shkatërrimi i xhamive (*el ħarâbu*) është dy llojesh:

1. Shkatërrim fizik, nga ana materiale, sikurse është shembja apo përdhosja e objektit, e çdo lloji a mënyre qoftë.

2. Shkatërrim që kryhet duke i penguar përkujtuesit dhe adhuruesit e Allahut, që të adhurojnë Allahun brenda faltores. Me pak fjalë, ky lloj shkatërrimi nënkupton pengimin e shfrytëzimit të xhamive për atë qëllim që ato janë ndërtuar.

Ky ajet i përfshin të gjithë ata njerëz që i bëjnë këto punë. Për shembull, i tillë ishte Abrahaja dhe ushtria e tij, që synonte të shembte Qaben. Këtu hyjnë edhe kurejshët, të cilët e penguan Profetin (a.s.) të shkonte drejt Qabes, në vitin e Hudejbijes. Të tillë ishin edhe ata të krishterë që shkatërruan Xhaminë e Shenjtë në Kuds (Palestinë). Në këtë kategori përfshihen edhe shumë e shumë të tjerë, të cilët, me shkatërrimin apo mbylljen e xhamive, synojnë të pengojnë njerëzit nga rruga e Allahut. Ata thjesht shprehin armiqësinë e tyre ndaj Allahut dhe ndaj profetëve të Tij.

Për shkak të kësaj pune të shëmtuar, Allahu i Lartësuar ua ndaloi atyre futjen në xhami. Edhe nëse ata do të hynin në to, do të ishin të frikësuar dhe të poshtëruar. Kështu, Allahu i Lartësuar ua ktheu me të njëjtën monedhë. Ata donin të frikësonin dhe poshtëronin frekuentuesit e xhamive, por Allahu i Lartësuar mbolli frikën dhe poshtërimin në zemrat e tyre.

Kështu ndodhi me idhujtarët, të cilët e munduan dhe u përpoqën të pengonin Profetin e Allahut dhe besimtarët nga Xhamia e Shenjtë. Por nuk kaloi shumë dhe Profeti (a.s.), me lejen e Allahut të Lartësuar, hyri si triumfator në Mekë. Pas kësaj ngjarjeje, idhujtarët nuk do të hynin kurrë më në atë vend të pastër dhe të shenjtë, pasi i Lartësuari tha: "O besimtarë! Në të vërtetë, idhujtarët janë të ndyrë, prandaj të mos i afrohen më Xhamisë së Shenjtë pas këtij viti. Dhe mos kini frikë nga varfëria, sepse, po deshi, Allahu ju bën të pasur me mirësitë e veta. Vërtet, Allahu është i Gjithëdijshëm dhe i Urtë." [Teube 28].

"Ushtria e Elefantit" pësoi të njëjtin fat. Allahu i Lartësuar na rrëfen se çfarë bëri me ta: "Vallë, a nuk e ke dëgjuar ti se çfarë bëri Zoti yt me njerëzit e Elefantit? A nuk ua prishi atyre kurthin *(për shembjen e Qabes),* duke dërguar kundër tyre tufa zogjsh, të cilët i gjuajtën me gurë prej balte të pjekur? Dhe kështu, i bëri si byk i përtypur." [Fil 1-5].

Po kështu e pësuan edhe të krishterët në xhaminë e Kudsit, në Palestinë, dhe kështu do të ndodhë gjithmonë me cilindo që vepron në të njëjtën mënyrë.

Këto konsiderohen si shenja shumë të mëdha, sepse Allahu i Lartësuar ka lajmëruar rreth tyre para se ato të ndodhnin,

dhe ato kanë ndodhur pikërisht ashtu si i ka përshkruar Allahu i Lartësuar.

Disa dijetarë janë mbështetur në këto ajete për të thënë, gjithashtu, se nuk lejohet futja e qafirëve në xhami.

- "Në këtë jetë, ata meritojnë poshtërim, ndërsa në botën tjetër do të kenë dënim të madh" - Kështu, jobesimtarët meritojnë poshtërimin që në këtë jetë, kurse në jetën tjetër do t'i nënshtrohen ndëshkimit të madh.

Nëse nuk ka kriminel më të madh se ai që shkatërron xhamitë e Allahut ose që nuk lejon të përmendet emri i Allahut në to, atëherë mund të themi se nuk ka tregues më të madh për besimin në zemra, sesa përpjekjet për të ngritur dhe mirëmbajtur xhamitë e Allahut, qoftë nga ana fizike, qoftë nga ana funksionale. Për këtë, i Madhëruari thotë: "Për xhamitë e Allahut përkujdeset veçse ai që beson Allahun dhe Ditën e Gjykimit, që fal namazin, jep zekatin dhe nuk i frikësohet askujt tjetër veç Allahut. Shpresohet që të tillët të jenë prej të udhëzuarve." [Teube 18].

Madje, Allahu i Lartësuar ka urdhëruar që të ngrihen xhami dhe në to të përkujtohet emri i Tij. Ai ka urdhëruar që atyre t'u kushtohet respekt dhe përkujdesje maksimale, nga njëra anë, dhe ka kërcënuar penguesit, nga ana tjetër. I Lartësuari thotë: "S'ka dyshim se ata të cilët nuk besojnë dhe pengojnë prej rrugës së Allahut dhe prej Xhamisë së Shenjtë *(Qabes)*, – të cilën Ne e kemi bërë *(vend adhurimi)* për të gjithë njerëzit pa dallim, qofshin vendas ose të ardhur, – dhe ata që përpiqen të bëjnë ndonjë të keqe a ndonjë padrejtësi në të, Ne kemi për t'i bërë të shijojnë një dënim të hidhur. Kujtoje kur Ne ia treguam Ibrahimit vendin e Shtëpisë *(duke e urdhëruar):* "Mos adhuro asgjë tjetër veç Meje! Pastroje Shtëpinë Time për ata që vijnë rrotull saj *(bëjnë tavaf)*, që qëndrojnë në këmbë, që përkulen dhe që bëjnë sexhde duke u falur." [Haxh 25, 26].

Për xhamitë ka shumë rregulla, por më kryesoret janë ato që u përmendën më lart.

Ajeti 115

115. Të Allahut janë Lindja dhe Perëndimi, pra, ngado që të ktheheni është Fytyra e Allahut. Vërtet, Allahu është i Gjerë dhe i Gjithëditur.

Shpjegimi i ajetit

- "Të Allahut janë Lindja dhe Perëndimi" - Allahu i Lartësuar ka përmendur në mënyrë të veçantë këto dy kahe, sepse ato paraqesin shenja madhështore. Në to ndodh lindja e diellit dhe perëndimi i tij. Duke qenë Zotërues i këtyre dy drejtimeve të rëndësishme, atëherë Ai është edhe Zotërues i drejtimeve të tjera të horizontit.

- "...ngado që të ktheheni është Fytyra e Allahut." – Kuptimi: Nëse ju ktheheni në një drejtim të caktuar, duke zbatuar me përpikmëri urdhrin e Allahut, do ta gjeni Allahun e Lartësuar në atë drejtim. Pra, ngado që të drejtoheni, andej është drejtimi i duhur, nëse këtë e keni bërë me fakte prej Allahut të Lartësuar. Kështu, nëse ju drejtoheshit fillimisht drejt Kudsit kur faleshit, dhe tanimë drejtoheni drejt Qabes, ky është drejtimi i duhur dhe i saktë, sepse këtë e bëtë të mbështetur në fakte nga Zoti juaj. Nëse ju faleni mbi një objekt lëvizës, ku nuk mund të mbani një drejtim të caktuar, atëherë çdo drejtim ku ktheheni është i saktë dhe i pranuar nga Allahu i Lartësuar, sepse Ai e ka ligjëruar dhe e ka lejuar një gjë të tillë. Nëse nuk e dini drejtimin e Kibles dhe faleni në një drejtim të caktuar, pasi jeni përpjekur fillimisht me çdo mënyrë të mundshme për të gjetur drejtimin e duhur, ai drejtim është i saktë dhe i pranuar tek Allahu i Lartësuar. Edhe nëse më pas zbuloni se ai nuk ishte drejtimi i Kiblës, përsëri namazi i falur mbetet i saktë, sepse Allahu i Lartësuar nuk ka ngarkuar asnjë përtej mundësive. Po të njëjtin gjykim ka edhe ai që falet duke qenë i lidhur në një

mënyrë të tillë, që nuk ka mundësi të drejtohet nga Kibla, apo ai që është i sëmurë e prandaj s'mund të kthehet andej: drejtimi i tyre, në të dyja rastet, është i saktë dhe i pranueshëm nga Allahu i Lartësuar. Shkurtimisht, të gjitha drejtimet të cilat i ka lejuar dhe i ka urdhëruar i Madhëruari, janë të sakta dhe të pranuara nga Ai.

Kjo pjesë e ajetit dëshmon, gjithashtu, se Allahu i Lartësuar ka Fytyrë, sepse fjala '*uexhh*' domethënë 'fytyrë'. Ky atribut i Tij pohohet dhe pranohet për Të, ashtu sikurse i shkon madhështisë së Tij. Fytyra e Tij nuk i përngjan asgjëje, sepse çdo gjë tjetër është krijesë, dhe mes Krijuesit e krijesës nuk ka asnjë mundësi përngjasimi.

- "Vërtet, Allahu është i Gjerë dhe i Gjithëditur." – Kuptimi: Mirësitë e Allahut janë të gjera dhe cilësitë e Tij janë madhështore, pikërisht sepse dija dhe bamirësia e Tij janë të gjera. Ai ua ka lehtësuar çështjet njerëzve dhe i toleron ata në shumë mangësi që kanë, duke ua pranuar veprat e tyre të mangëta dhe duke i shpërblyer për to. Ai është i Lavdëruari pafundësisht dhe vetëm Atij i takon mirënjohja e plotë.

Ajetet 116 – 117

116. Ata thonë: "Allahu ka fëmijë". I pastër është Ai nga kjo e metë! E Tij është gjithçka në qiej dhe në tokë. Atij i është nënshtruar gjithçka.
117. Ai është Krijuesi i qiejve dhe i tokës. Kur dëshiron diçka, Ai vetëm i thotë: "Bëhu!", dhe ajo bëhet.

Shpjegimi i ajeteve

- "Ata thonë: "Allahu ka fëmijë"" - Këtë gjë e kanë thënë çifutët, të krishterët dhe shumë idhujtarë. Ata, padrejtësisht dhe paturpësisht, e kanë përshkruar Allahun me diçka që kurrsesi nuk i shkon për shtat madhështisë së Tij. Kjo është një fyerje e madhe dhe shpifje e ulët. Kështu ata i bëjnë padrejtësi vetvetes.

Por Allahu i Lartësuar vazhdon të jetë Durimtar, duke i mëshiruar ata në këtë jetë. Ai vazhdon t'i ruajë dhe t'i furnizojë, me gjithë fyerjet e tyre të vazhdueshme në adresë të Tij.

- "I pastër është Ai nga kjo e metë!. – Kuptimi: I shenjtë, i pastër është Ai nga çdo e metë me të cilën e përshkruajnë qafirët dhe të padrejtët. Ai është i pastër dhe larg çdo cilësie që nuk i shkon madhështisë së Tij. Ai është i Plotë në çdo aspekt. Mangësia është shumë larg Tij, në çdo këndvështrim.

Ndonëse fakti që Ai është i pastër nga çdo e metë mjafton si kundërpërgjigje ndaj tyre, Allahu i Lartësuar u sjell edhe një tjetër argument:

- "E Tij është gjithçka në qiej dhe në tokë" - Kuptimi: Të gjitha janë pronë e Tij dhe të gjithë i janë nënshtruar Atij. Ai ka të drejtë të veprojë në pasurinë dhe mbretërinë e Tij, me të gjitha të drejtat që i jep sundimi i tij Absolut.

- "Atij i është nënshtruar gjithçka." - Të gjithë i janë nënshtruar dhe janë nën përkujdesjen e Tij.

Kështu pra, nëse të gjithë janë krijesat e Tij dhe të gjithë kanë nevojë për kujdesin e Tij, ndërsa Ai nuk ka nevojë për asnjë prej tyre, atëherë si mund të mendohet që mes krijesave të Tij të jetë dikush biri i Tij?! Dihet që fëmija do të jetë prej natyrës së prindit të tij, sepse fëmija është një pjesë prej prindit.

Allahu i Lartësuar është Sunduesi dhe Nënshtruesi i gjithçkaje, ndërsa ju jeni të sunduar dhe të nënshtruar. Ai është i Pasur dhe nuk ka nevojë për asgjë, ndërsa ju jeni të varfër e nevojtarë për Atë, në çdo aspekt. Atëherë, si mund të mendohet që prej këtij lloji të dalë një fëmijë i të Pakrahasueshmit, Absolutit?! Kjo është ideja më boshe dhe më e pavlerë që mund të jetë shprehur ndonjëherë.

Duhet ditur se nënshtrimi ndaj Allahut është dy llojesh:
1. Nënshtrim i përgjithshëm, të cilin e kanë të gjitha krijesat. Të gjitha krijesat janë të nënshtruara ndaj Tij dhe kanë nevojë për përkujdesjen e Tij.
2. Nënshtrim i posaçëm. Ky është nënshtrimi i adhurimit. Pra, këtë e kanë vetëm të nënshtruarit me vullnet dhe vetëdije, të cilët e adhurojnë Allahun e Madhëruar.

Në ajetin e mësipërm flitet për llojin e parë të nënshtrimit. Ndërsa lloji i dytë përmendet në ajete të tjera, si për shembull: "Dhe qëndroni në këmbë për Allahun, duke i shprehur Atij nënshtrimin tuaj". [Bekare, 238]. Më tej, i Madhëruari thotë:

- "Ai është Krijuesi i qiejve dhe i tokës" – Domethënë, Ai është Krijuesi i qiejve dhe i tokës, në një mënyrë të shkëlqyer dhe të përkryer, pa pasur asnjë shembull të mëparshëm.

- "Kur dëshiron diçka, Ai vetëm i thotë: "Bëhu!", dhe ajo bëhet." – Pra, për Allahun asgjë nuk është e vështirë apo e pamundur që të kryhet.

Ajetet 118 – 119

118. Ata që nuk dinë thonë: "Përse Allahu nuk flet me ne, ose, së paku, të na sillte ndonjë shenjë?!" Po kështu thonin edhe ata që ishin para tyre. Të ngjashme janë fjalët e tyre. Të ngjashme janë edhe zemrat e tyre. Ne i sqaruam argumentet për një popull që është i sigurt.
119. Pa dyshim, Ne të dërguam ty me të vërtetën, si përgëzues dhe paralajmërues. Ti nuk do të mbash përgjegjësi për banuesit e Zjarrit të madh.

Shpjegimi i ajeteve

- "Ata që nuk dinë thonë: "Përse Allahu nuk flet me ne, ose, së paku, të na sillte ndonjë shenjë."" - Domethënë, ata thonë: "Përse Allahu nuk flet me ne, ashtu sikurse u ka folur profetëve?! Ose, së paku, të na sjellë ndonjë shenjë." Ata kërkojnë shenja dhe argumente, sipas mendjeve të tyre të prishura. Ata marrin guximin të kërkojnë të tilla paturpësi. Kjo tregon kundërshtimin e tyre ndaj Krijuesit dhe mosbindjen ndaj Profetit të Tij.

Ja si tregon Allahu i Lartësuar se çfarë kanë thënë ata:

"Ju thatë: "O Musa! Ne nuk kemi për të të besuar, derisa ta shohim Allahun haptazi!" Menjëherë *(pas kësaj)*, ju përfshiu rrufeja, dhe ju e patë." [Bekare 55].

"Ithtarët e Librit kërkojnë prej teje *(o Muhamed)* që t'u zbresësh një libër prej qielli. Në fakt, ata i kërkuan Musait diçka edhe më të madhe *(duke i thënë):* "Na trego Allahun haptazi!" Atëherë i shkatërroi rrufeja, për shkak të poshtërsisë që bënë. Pastaj zgjodhën viçin *(për adhurim)*, pas shenjave të qarta që u patën ardhur. Ne ua falëm atë dhe i dhamë Musait pushtet të dukshëm." [Nisa, 153].

"Ata që nuk e shpresojnë takimin Tonë, thonë: "Përse të mos na dërgohen engjëj *(si profetë në vend të njerëzve)*, ose përse të mos e shohim Zotin tonë?" Kështu, ata e çmuan lart veten e tyre dhe e tejkaluan me arrogancën e tyre. Por për kriminelët nuk do të ketë gëzim atë ditë, kur t'i shohin engjëjt. Ata (*engjëjt)* do t'u thonë: "Juve ju është e ndaluar çdo e mirë!" [Furkan, 21, 22].

"Ne u sollëm njerëzve në këtë Kur'ân shembuj të çdo lloji, por shumica e njerëzve nuk duan gjë tjetër, përveç mohimit. Ata thonë: "Nuk të besojmë ty derisa të na nxjerrësh prej tokës burime. Ose të kesh kopshte me hurma e me rrush, e të bësh që mes tyre të rrjedhin vazhdimisht lumenj. Ose, ashtu sikurse pretendon ti (*se do të na dënojë Zoti)*, le të bierë mbi ne qielli copa-copa. Ose të na sjellësh Allahun dhe engjëjt pranë nesh. Ose të kesh një shtëpi prej ari, apo të ngjitesh lart në qiell. Madje edhe ngjitjen tënde në qiell ne nuk do ta besojmë, derisa të na sjellësh një libër që ta lexojmë?!" Thuaju: "*Subhanallah*! A mos jam unë gjë

tjetër, përveçse një profet-njeri?!" [Isra 89 – 94]. Pra, siç shihet:

- "Po kështu thonin edhe ata që ishin para tyre. Të ngjashme janë fjalët e tyre. Të ngjashme janë edhe zemrat e tyre" - Kjo ka qenë gjithmonë sjellja e tyre ndaj profetëve të Allahut. Ata gjithmonë kanë kërkuar shenja, duke treguar kështu kokëfortësinë e tyre, pasi nuk e kanë bërë këtë për të gjetur udhën e drejtë. Ata nuk e kanë patur kurrë dëshirën për të mësuar të vërtetën. Të gjithë profetët kanë sjellë argumente dhe shenja, të cilat të çojnë domosdoshmërisht në besim, por ata që nuk e duan udhëzimin kështu do të sillen ngaherë.

- "Ne i sqaruam argumentet për një popull që është i sigurt." – Kuptimi: Këto ajete janë shumë të qarta për çdo njeri që kërkon dhe synon udhëzimin. Shenjat dhe argumentet e Allahut i sjellin zemrës një siguri të tillë, që largon çdo dyshim dhe luhatje.

Më pas, Allahu i Lartësuar na përkujton një shenjë të vetme, që përmbledh të gjitha shenjat me të cilat Allahu i Lartësuar tregon vërtetësinë dhe sinqeritetin e Profetit dhe të Shpalljes së tij:

- "Pa dyshim, Ne të dërguam ty me të vërtetën" – Ky argument i përfshin të gjitha argumentet e shenjat që Allahu solli me Pejgamberin e Tij (s.a.u.s.).

Ky argument përbëhet nga tri elementë kryesorë, që janë:

1. Vetë dërgimi i Profetit (s.a.u.s.).

2. Biografia, tradita dhe udhëzimet e Profetit (s.a.u.s.).

3. Mësimi i të vërtetës së madhe nëpërmjet Profetit (s.a.u.s.).

Dy elementë e parë të argumentimit i përmban pjesa: "Ne të dërguam ty…", kurse i treti gjendet në pjesën: "…me të vërtetën".

Por si mund të jetë argument që vërteton saktësinë dhe vërtetësinë e këtij Profeti vetë dërgimi i tij?! Kjo mund të kuptohet plotësisht nëse shihet në këtë kontekst:


Së pari, gjendja e njerëzimit para dërgimit të këtij Profeti ishte shumë e rëndë. Njerëzit adhuronin putat, zjarrin, kryqin dhe i kishin tjetërsuar porositë e profetëve të tyre. Ata jetonin në errësirën e plotë të kufrit, duke qenë krejt të pashpresë. Përjashtim bënte vetëm një pakicë e vogël, e papërfillshme, që kishte mbetur nga ato bashkësi që kishin patur dikur libër hyjnor, të cilat ishin zhdukur para se të shfaqej profeti Muhamed (s.a.u.s.).

Së dyti, duhet kuptuar që, Allahu i Lartësuar nuk i ka krijuar njerëzit për t'i lënë të çoroditur. Ai nuk do t'i linte ata pa i udhëzuar, sepse Ai është i Urti dhe i Dituri. Allahu është, gjithashtu, i Plotfuqishëm dhe Mëshirues. Rrjedhimisht, urtësia dhe mëshira e Tij mbi krijesat do të shfaqej me dërgimin e Pejgamberit (s.a.u.s.), i cili do t'i urdhëronte njerëzit që të adhuronin Mëshiruesin si Një të vetëm, duke mos i shoqëruar Atij asgjë e asnjë.

Në këtë kontekst, çdo njeri me mend e kupton domosdoshmërinë e dërgimit të një Profeti të vërtetë e të sinqertë, dhe kjo vërteton se ai ishte realisht i Dërguari i Allahut.

Po për sa i përket pikës së dytë, në çfarë mënyre tregon historia dhe tradita e Pejgamberit (s.a.u.s.) për vërtetësinë e tij si i Dërguar prej Allahut të Lartësuar? Çdokush që sheh me imtësi historinë e tij të plotë të jetës, që nga koha para Shpalljes e deri në çastin e fundit, fëmijërinë dhe edukimin e tij me cilësitë më të larta, dhe pastaj sheh se si cilësitë e tij të shkëlqyera dhe morali i tij i lartë, me kalimin e viteve, u përsosën dhe u shtuan më shumë, patjetër që do të arrijë në këtë përfundim. Arsyeja është se këto janë pikërisht cilësi të profetëve të Allahut, në përgjithësi, dhe cilësitë e përsosura të një të Dërguari të madh, në veçanti. Allahu i Lartësuar i ka bërë cilësitë e karakterit si treguesit më të fortë të sinqeritetit apo të mashtrimit të njeriut.

Ndërsa elementi i tretë që vërteton se ai njeri ishte i Dërguari i Zotit të botëve është



njohja e të vërtetës të cilën ai e solli prej Zotit të botëve. Ai solli Kur'ânin e shenjtë dhe, nëpërmjet tij, ligjin e jetës. Në Kur'ân gjenden përshkrime të sakta të ngjarjeve të së kaluarës dhe të së ardhmes, gjenden urdhra që nxisin për çdo vepër e fjalë të mirë e të dobishme, gjenden ndalesa që na frenojnë e largojnë prej çdo cilësie dhe vepre të shëmtuar dhe të dëmshme. Kur'âni përmban mrekulli të panumërta.

Si përfundim, ky fragment i ajetit që po zbërthejmë i përfshin të gjitha llojet e argumenteve dhe të shenjave të vërtetësisë së Shpalljes.

- "...si përgëzues dhe paralajmërues." – Domethënë, Allahu i Lartësuar e dërgoi profetin Muhamed si përgëzues për ata që i binden dhe pasojnë rrugën e Tij, se do të jenë të lumtur në këtë jetë dhe në jetën tjetër; dhe si paralajmërues (*nedhîra*) i atyre që kundërshtojnë dhe nuk i binden, se do të përjetojnë dëshpërimin dhe ndëshkimin e kësaj jete dhe të jetës tjetër.

- "Ti nuk do të mbash përgjegjësi për banuesit e Zjarrit të madh." – Kuptimi: Ti nuk ke përgjegjësi për ta. Ti ke për detyrë veçse përcjelljen e qartë të mesazhit, ndërsa llogaria dhe marrja në përgjegjësi e tyre është detyrë e Allahut të Lartësuar.

Ajeti 120

120. Çifutët dhe të krishterët nuk do të jenë të kënaqur kurrë me ty, derisa të pasosh fenë e tyre. Thuaju: "Udhëzimi i drejtë është udhëzimi i Allahut." E nëse pas diturisë që të ka zbritur, ti ndjek dëshirat e tyre, atëherë nuk ke për të patur ndihmues dhe mbrojtës tjetër, të të shpëtojë prej Allahut."

Shpjegimi i ajetit

- "Çifutët dhe të krishterët nuk do të jenë të kënaqur kurrë me ty, derisa të pasosh fenë e tyre" - Allahu i Lartësuar tregon se çifutët dhe të krishterët nuk do të kënaqeshin kurrë me Profetin (s.a.u.s), derisa ai të pasonte fenë dhe rrugën e tyre. Ata e ftonin në fenë e tyre, duke pretenduar se ajo ishte feja dhe udhëzimi i drejtë.

Atëherë, Allahu i Lartësuar e urdhëroi Profetin e Tij që t'ua hidhte poshtë këtë pretendim, duke thënë:

- "Thuaju: "Udhëzimi i drejtë është udhëzimi i Allahut."" - Kuptimi: Vetëm udhëzimi të cilin unë e solla prej Allahut të Lartësuar është ai që meriton të quhet udhëzim i drejtë. Ndërsa rruga që ju pasoni dhe pretendoni se është e drejtë, në të vërtetë është ndjekje e dëshirave tuaja të sëmura. Prandaj i Lartësuari thotë më poshtë:

- "E nëse pas diturisë që të ka zbritur, ti ndjek dëshirat e tyre, atëherë nuk ke për të patur ndihmues dhe mbrojtës tjetër, të të shpëtojë prej Allahut." – Ky ajet dëshmon se është e ndaluar rreptësisht pasimi i dëshirave dhe i rrugës së çifutëve dhe të

krishterëve. Ai na ndalon nga përngjasimi me ta në cilësitë e tyre tipike dhe që lidhen me fenë që ata kanë.

Ky ajet, edhe pse i drejtohet Profetit (a.s.), dispozita e tij vlen për të gjithë umetin, sepse në këto raste merret për bazë kuptimi gjithëpërfshirës i ajetit dhe jo personi të cilit i drejtohet ky tekst. Kështu thotë edhe një parim në Sheriatin Islam: Kuptimi gjithëpërfshirës i tekstit është më parësor për t'u marrë në konsideratë, sesa shkaku specifik për të cilin ka ardhur ky tekst. Më tej, i Lartësuari thotë:

Ajetet 121 – 123

121. Ata të cilëve ua dhamë Librin dhe e ndjekin me përpikmëri, ashtu si duhet, pikërisht ata e besojnë atë. Ndërsa ata që e mohojnë atë, pikërisht dhe vetëm ata janë të dështuarit.
122. O bijtë e Israilit! Përkujtoni të mirat e Mia, me të cilat ju begatova! Unë ju pata dalluar mbi njerëzit e tjerë *(të asaj kohe).*
123. Dhe ruajuni një dite, kur askush nuk do të mund ta ndihmojë tjetrin për asgjë! Prej askujt nuk pranohet kompensim, dhe askujt nuk do t'i bëjë dobi asnjë ndërmjetësim. Ata nuk do të ndihmohen.

Shpjegimi i ajeteve

- "Ata të cilëve ua dhamë Librin dhe e ndjekin me përpikmëri atë, ashtu si duhet" - Allahu i Lartësuar na njofton se Kur'ânin e besojnë ata të cilëve Ai u dhuroi Librin, duke u bërë kështu një mirësi të madhe, dhe që e ndjekin atë ashtu sikurse e meriton ai të ndiqet. Fjala '*tilâueh*' do të thotë 'ndjekje e diçkaje hap pas hapi'. [2]

Ndjekja me përpikmëri e Librit nënkupton pranimin e plotë të dispozitave të tij. Kështu për shembull, ata e konsiderojnë të lejuar atë që në Libër quhet e tillë, dhe e konsiderojnë të ndaluar atë që në Libër vlerësohet si e tillë. Ata punojnë sipas urdhrave të përnxjerra nga ajetet e qarta dhe të drejtpërdrejta, por ata i besojnë me pastërti edhe ajetet që kanë një fushë më të gjerë kuptimore.

- "...pikërisht ata e besojnë atë." - Pikërisht ata do të lumturohen, domethënë ata të cilët e njohin mirësinë e Allahut të Lartësuar dhe tregojnë mirënjohjen dhe falënderimin për të. Janë ata që besojnë të gjithë profetët (dhe Shpalljet) dhe nuk bënë asnjë dallim mes tyre. Këta janë besimtarët e vërtetë.

Ndërsa ata që besojnë një pjesë të shpalljeve dhe e mohojnë një pjesë tjetër, ata janë në rrezik. Këta Allahu i Lartësuar i kërcënon duke thënë:

- "Ndërsa ata që e mohojnë atë, pikërisht dhe vetëm ata janë të dështuarit."

- "O bijtë e Israilit! Përkujtoni të mirat e Mia, me të cilat ju begatova! Unë ju pata dalluar mbi njerëzit e tjerë *(të asaj kohe)"*

Pastaj Ai i kërcënon ata, për t'iu frikësuar Ditës së Kiametit. Atë ditë, askush nuk mund t'i bëjë dobi askujt. I Madhëruari thotë:

- Dhe ruajuni një dite, kur askush nuk do të mund ta ndihmojë tjetrin për asgjë! - Askush, sado i nderuar dhe i madh qoftë: melek, profet, apo njeri i mirë, nuk do të ketë në dorë asnjë mundësi ndihme për askënd. Ata nuk mund të ndihmojnë asnjë, sado i dashur apo i afërt të jetë ai që kërkon ta ndihmojnë. E vetmja ndihmë për njeriun do të jetë prej veprave që ka bërë.

Edhe ndërmjetësimet janë të papranueshme pa lejen dhe pa kënaqësinë e Allahut të Lartësuar. I Lartësuari thotë:

- Prej askujt nuk pranohet kompensim, dhe askujt nuk do t'i bëjë dobi asnjë ndërmjetësim. – Për ndërmjetësimin duhet të plotësohen dy kushte: Së pari, të jepet leja nga Allahu i Lartësuar për të dhe, së dyti, Allahu i Lartësuar të jetë i kënaqur me atë për të cilin ndërmjetësohet.

[2] Ajo ka edhe kuptimin "lexoj, këndoj Kur'ânin" (Sh.p.).

Nga ana tjetër, dihet shumë mirë që Allahu i Lartësuar nuk kënaqet nga vepra e askujt, nëse ajo vepër nuk plotëson dy kushte:

3. Të kryhet me sinqeritet për Allahun, duke kërkuar kënaqësinë e Tij.

4. Të kryhet në përputhje me traditën e Pejgamberit (s.a.u.s.) dhe mësimeve të tij.

Nuk pranohet ndërmjetësim dhe as kompensim, siç thotë i Madhëruari:

- Prej askujt nuk pranohet kompensim – Për këtë, i Lartësuari thotë sërish në Kur'ân, "E sikur e tërë ajo çka gjendet në tokë, plus edhe një herë sa aq, të ishte e atyre që nuk besuan, ata do ta jepnin si kompensim, për t'i shpëtuar dënimit të tmerrshëm në Ditën e Kijametit. Atëherë, do të përballen prej Allahut me atë *(lloj dënimi)* që nuk kanë mundur as ta mendojnë." [Zumer 47]. Domethënë, nuk do të pranohet kompensim prej tyre. Ata, gjithashtu, nuk do të ndihmohen:

- Ata nuk do të ndihmohen. – Domethënë, prej atyre nuk do të largohet ajo të cilës ata i druhen dhe asnjë krijesë nuk do të ketë mundësi t'u bëjë dobi apo t'u largojë ndonjë dëm.

Thënia e Allahut: "*la texhzi nefsun an nefisin shejâ*" (…askush, askujt nuk do të mund t'i bëjë asgjë), tregon pamundësinë e të gjithëve për të bërë dobi atë ditë. Ndërsa thënia: "*ue lâ hum junsârûn*" (e ata nuk kanë për t'u ndihmuar) tregon pamundësinë e tyre për të larguar të keqen dhe të dëmshmen.

Në thënien e Allahut: "*lâ juḳbelu minhâ adlun*" (Prej askujt nuk pranohet kompensim), dhe në thënien tjetër të Tij: "*…Ue lâ tenfeuha shefâah*", (nuk do t'i bëjë dobi asnjë ndërmjetësim) mësohet diçka shumë e rëndësishme. Nëse njeriu e kupton se fitimi i të mirave dhe largimi i të këqijave nuk mund të arrihen duke ia kërkuar krijesave, atëherë ai kthehet për t'ia kërkuar sinqerisht ato të vetmit që mund t'ia dhurojë (Allahut). Arritja e të mirave dhe largimi i të këqijave nuk mund të bëhet, gjithashtu, as me kompensime dhe as me ndërmjetësime, sikurse ndodh mes krijesave. Atë ditë nuk do të jetë askush i aftë qoftë edhe për një grimcë dobie apo dëmi. Kjo është një ftesë e hapur që adhuruesi të lidhet fort dhe sinqerisht vetëm me Allahun e Lartësuar, duke i kërkuar të mirat veç prej Tij dhe duke kërkuar mbrojtje nga çdo e keqe vetëm tek Ai. Kjo është ftesë për ta adhuruar Atë si Një të vetëm, sepse veç Ai e meriton adhurimin tonë dhe vetëm tek Ai duhet të mbështetemi për t'i përkryer adhurimet tona.

Ajetet 124 – 126

124. Kur Allahu e sprovoi Ibrahimin me disa urdhërime, dhe ai i përmbushi ato, Ai *(Allahu)* tha: "Unë po të bëj ty imam të njerëzimit"! Ai tha: "Edhe prej pasardhësve të mi *(bëj të tillë)*!" Tha *(Allahu)*: "Premtimin Tim nuk mund ta gëzojnë të padrejtët!"

125. Kujtoni kur Shtëpinë *(Qaben)* e bëmë vendgrumbullimi për njerëzit dhe sigurie për ta *(duke thënë):* "Vendin ku qëndroi Ibrahimi bëjeni vend adhurimi!" Ibrahimin dhe Ismailin i urdhëruam: "Pastrojeni Shtëpinë Time për ata që bëjnë tavaf, për ata që qëndrojnë në të, dhe për ata që bien në ruku dhe në sexhde!"

126. Kur Ibrahimi tha: "O Zoti im! Bëje këtë një qytet të sigurt! Furnizoji banorët e tij me fruta të shumëllojshme, ata që besuan Allahun dhe jetën tjetër!" Ai *(Allahu)* tha: "Edhe atij që nuk beson do t'ia mundësoj kënaqësinë e furnizimit Tim për një kohë të shkurtër. Por, pastaj, do ta flak në dënimin e Zjarrit. Sa përfundim i shëmtuar është ai!"

Shpjegimi i ajeteve

- "Kur Allahu e sprovoi Ibrahimin me disa urdhërime, dhe ai i përmbushi ato…" - Në këto ajete, Allahu i Lartësuar na flet rreth Profetit dhe të dashurit të Tij, Ibrahimit (a.s.), për gradën e lartë të të cilit pajtohen të

gjithë njerëzit. Të gjitha grupet fetare pretendojnë se janë pasues të tij: çifutët, të krishterët, madje edhe politeistët.

Allahu i Lartësuar e sprovoi atë me disa fjalë, pra, me disa dispozita. Ai e sprovoi duke e ngarkuar me disa urdhra dhe duke e ndaluar me disa ndalesa.

Në këtë mënyrë i ka sprovuar njerëzit Allahu i Lartësuar gjithmonë, për t'u dalluar i sinqerti dhe gënjeshtari. Përballë sprovave, gënjeshtari poshtërohet, sepse ai thyhet para tyre dhe nuk tregon durimin e kërkuar prej Allahut. Nga ana tjetër, i sinqerti lartësohet dhe nderohet, sepse qëndron i palëkundur dhe i duruar. Veprat e tij të mira tregojnë sinqeritetin që fshihet në zemrën e tij.

Ndër të përzgjedhurit më të mirë është Ibrahimi (a.s.), i dashuri i Zotit të botëve. Ai e çoi në vend amanetin e ngarkuar prej Zotit të tij. Ai i plotësoi me përpikmëri të gjitha dispozitat e ngarkuara. Për këtë arsye, Allahu i Lartësuar e shpërbleu përkushtimin e lartë që ai kishte, saqë edhe sot e kësaj dite vazhdon të ndihet ky shpërblim.

I Madhëruari thotë:

- "Ai *(Allahu)* tha: "Unë po të bëj ty imam të njerëzimit!"" - Allahu i Lartësuar e bëri Ibrahimin (a.s.) udhëheqës të njerëzimit. Kështu, fjalët që Allahu i Lartësuar i thotë atij kanë këtë kuptim: "Të gjithë duhet të ndjekin udhëzimin dhe rrugën tënde. Të gjithë duhet të ecin pas teje, pas gjurmëve të tua, për të arritur lumturinë e përjetshme. Kjo do të jetë fama dhe lavdia jote ndër breza. Të gjithë do të të duan dhe do të të respektojnë. Ky do të jetë shpërblimi yt në përjetësi."

Betohem në Allah se kjo është grada më e lartë, për arritjen e së cilës punojnë garuesit dhe ata që përpiqen. Ajo qe shkalla më e lartë, të cilën e arritën profetët më të shquar dhe pasuesit e denjë të rrugës së Allahut. Atë shkallë e kanë synuar të gjithë ata që ftuan njerëzimin në rrugën e lumturisë.

Ibrahimi (a.s.), pasi u gëzua me këtë gradë që ia dhuroi atij Zoti i gjithësisë, e dëshiroi atë edhe për pasardhësit e tij:

- "Ai tha: "Edhe prej pasardhësve të mi *(bëj të tillë)*!"" – Pra, e kërkoi një gradë të tillë edhe për pasardhësit e tij, që të lumturoheshin më tepër edhe ai, edhe ata.

Ky është një tregues tjetër i madhështisë së këtij Profeti, i cili kërkonte të mirën për njerëzimin, duke e dëshiruar me ngulm udhëzimin e tyre në rrugën e drejtë. Ai dëshironte që të shtoheshin të mirët dhe të udhëzuarit.

I lavdëruar qoftë Allahu i Lartësuar, për këta njerëz që ka krijuar dhe për këta gjigandë që ka sjellë në jetë!

Më pas, Allahu i Ditur dhe i Mëshirshëm i përgjigjet, duke thënë:

- "Tha *(Allahu)*: "Premtimin Tim nuk mund ta gëzojnë të padrejtët!"" – Kuptimi: Statusin e udhëheqësit të botës dhe të udhëzuesit të saj në rrugën e drejtë nuk do ta meritojnë ata që janë të padrejtë, zullumqarë.

Çdokush që e dëmton vetveten duke kryer padrejtësi, nuk ka për ta aritur kurrë atë gradë të lartë, sepse janë dy gjëra krejt të kundërta. Ajo mund të arrihet veçse me dy cilësi: me durim dhe me siguri. Durimi duhet për zbatimin e ligjeve hyjnore, ndërsa siguria tregohet ndaj premtimit të Allahut.

Kësisoj, kjo gradë kërkon besim të lartë, vepra të mira, cilësi të bukura të moralit, drejtësi, dashuri totale vetëm për të Madhëruarin, frikë nda Tij dhe rendje pas çdo gjëje që e kënaq Atë. E si mund t'i afrohet kësaj grade, i padrejti ndaj vetvetes dhe ndaj gjithçkaje që e rrethon?! I padrejti as që mund ta mendojë këtë lloj nderimi. Nëse e shohim ajetin anasjelltas, kuptojmë se kush nuk është i padrejtë do ta arrijë këtë gradë. Me fjalë të tjera, pasojat kanë nevojë për shkaqet, dhe kjo gradë nuk mund të arrihet pa realizuar shkaqet që e sjellin atë.

Pastaj Allahu i Lartësuar na sjell një shembull, që shpjegon përse Ibrahimi (a.s.) ishte prijësi i njerëzimit. Është pikërisht Shtëpia e Lashtë, Qabja, e cila u ndërtua nga Ibrahimi (a.s.). Vizita e saj përbën një nga shtyllat mbi të cilat ngrihet Islami dhe një nga mënyrat më të mira për fshirjen e gjynaheve dhe faljen e tyre nga Allahu i Lartësuar. Në të ndodhen gjurmët e të dashurit të Allahut, Ibrahimit (a.s.), dhe të pasardhësve të tij. Më tej, i Madhëruari thotë:

- "Kujtoni kur Shtëpinë *(Qaben)* e bëmë vendgrumbullimi për njerëzit dhe sigurie për ta..." – Kuptimi: Allahu e bëri Qaben vendin ku vizitorët synojnë të arrijnë mirësitë e kësaj jete dhe të jetës tjetër, mirësitë për dynjanë dhe për fenë e tyre. Ata shkojnë dhe vijnë në të, dhe gjithmonë ndiejnë dëshirën dhe mallin për t'u kthyer tek ajo.

Po ashtu, Allahu i Lartësuar e ka bërë atë vend paqeje dhe prehjeje për të gjithë njerëzit që hyjnë në të. Ajo është e sigurt për të gjithë, madje edhe për kafshët e bimët. [3] Ajo ka qenë vend sigurie për të gjithë edhe në kohën para Islamit. Atëherë, për shembull, nëse dikush shihte vrasësin e babait të vet në atë vend, nuk e prekte me dorë dhe as nuk e kërcënonte, në shenjë nderimi për Shtëpinë e Lashtë. Ndërsa pas Islamit, ky nderim dhe kjo siguri u shtua edhe më shumë. Në përfundim, kjo Shtëpi është bërë vendi më i sigurt dhe më i nderuar në faqen e dheut.

Allahu i Lartësuar na urdhëron që edhe ne ta adhurojmë Atë si një të vetëm duke pasuar gjurmët e Prijësit të njerëzimit, Ibrahimit (a.s.), kur thotë:

- "Vendin ku qëndroi Ibrahimi bëjeni vend adhurimi!" – Togun: "*Meḳâmi Ibrâhîme*" (Vendin e Ibrahimit) mund ta kuptojmë në dy mënyra:

1. Ai mund të tregojë pikërisht vendin që kështu quhet edhe sot (*Meḳâmi Ibrâhîme*), i cili ndodhet përballë portës së Qabes. Në këtë mënyrë, urdhri i Allahut të Madhëruar mund të nënkuptojë faljen e dy rekatëve namaz, veprim që kryhet te ky vend i njohur, pasi ka përfunduar tavafi. Është e pëlqyeshme që këta dy rekatë të falen duke u vendosur në një pozicion të tillë, që *Meḳâmi Ibrâhîme* të jetë mes personit që falet dhe Qabes. Të këtij mendimi janë shumica e shpjeguesve të Kur'ânit.

2. Por ka mundësi që me togun *Meḳâmi Ibrâhîme* të jenë pasur për qëllim vendet ku Ibrahimi (a.s.) kreu adhurimet e tij gjatë haxhit, duke filluar nga tavafi, sa'ji, qëndrimi në Arafat, qëndrimi në Musdelife, gjuajtjet e gurëve, kurbani e rite të tjera të haxhit. Në këtë rast, fjala "*muṣal-lâ*", që në mendimin e mësipërm kishte kuptimin: "vendfalje e namazit", tani do të kishte kuptim më të gjerë.

Në mënyrë të përmbledhur, sipas mendimit të parë, fjala: "*muṣal-lâ*" domethënë: "vend për faljen e namazit", ndërsa sipas mendimit të dytë: "vend ku kryhen adhurimet".

Gjithsesi, Allahu i Lartësuar në këtë ajet na urdhëron që, në të gjitha veprimet dhe adhurimet që kryhen gjatë haxhit, ne duhet të marrim si shembull Ibrahimin (a.s.). Ndoshta ky kuptim është më parësor për t'u marrë në konsideratë, sepse ai e përfshin edhe kuptimin e parë.

- "Ibrahimin dhe Ismailin i urdhëruam: "Pastrojeni Shtëpinë Time për ata që bëjnë tavaf, për ata që qëndrojnë në të, dhe për ata që bien në ruku dhe në sexhde!"" – Kështu, Allahu i Lartësuar u shpalli atyre të dyve urdhrin që ta pastronin Shtëpinë e Allahut nga idhujtaria, mohimi dhe poshtërsitë ndaj tij, por ta pastronin edhe nga gjërat e pista.

Më pas, Allahu thotë: "…për ata që bëjnë tavaf". Edhe pse namazi është më i miri ndër tri adhurimet e përmendura, Allahu i

[3] Arsyeja është se në Vendin e Shenjtë, në Mekë, nuk lejohet vrasja e kafshëve dhe prerja e bimësisë.

Lartësuar ka përmendur së pari tavafin, sepse ai nuk mund të bëhet gjetkë, por veçse në Qabe. Pastaj ka përmendur *itikaf*-in, i cili, gjithashtu, mund të bëhet veçse në xhami, dhe më pas e ka përmendur namazin, i cili mund të falet edhe diku tjetër. Pra, Allahu i Lartësuar i ka urdhëruar dy profetët e Tij që ta pastronin Shtëpinë e Tij, me qëllim që ajo t'u shërbente të lartpërmendurve në mënyrat që i shtjelluam.

Allahu i Lartësuar thotë: "Pastrojeni Shtëpinë Time", duke e përcaktuar Qaben si Shtëpinë e Tij, për të treguar kështu shumë dobi dhe urtësi. Ky përcaktim, për shembull, do të bënte që Ibrahimi dhe Ismaili (a.s.) të tregonin një përkujdesje maksimale për pastrimin e saj. Ata do të derdhnin të gjitha energjitë e tyre për pastrimin e shtëpisë së Allahut.

Ky përcaktim është një nderim i madh i kësaj Shtëpie. Kjo nënkupton që edhe robërit duhet ta nderojnë dhe respektojnë këtë Shtëpi. Është pikërisht kjo përkatësi e Qabes shkaku i tërheqjes së habitshme të saj. Zemrat gjithmonë anojnë për nga ajo, duke qenë gjithnjë të përmalluara të shkojnë drejt saj:

- "Kur Ibrahimi tha: "O Zoti im! Bëje këtë një qytet të sigurt! Furnizoji banorët e tij me fruta të shumëllojshme, ata që besuan Allahun dhe jetën tjetër!"" - Kjo ishte lutja që Ibrahimi (a.s.) bëri për këtë vend. Ai u lut që Allahu i Lartësuar ta bënte atë një vend të sigurt dhe t'i furnizonte banorët e tij me lloje të shumta mirësish e frutash.

Më pas, Ibrahimi (a.s.) e veçoi duanë për besimtarët, duke treguar në këtë mënyrë një edukatë të lartë ndaj Allahut të Lartësuar. Në fillim, Ibrahimi (a.s.) u lut për të gjithë pasardhësit e tij, por Allahu i Lartësuar ia kufizoi lutjen, duke përjashtuar të padrejtët. Ndërsa kur u lut për furnizimin e banorëve të Qabes, ai e kufizoi këtë lutje vetëm për besimtarët. Por dihet që furnizimi i Allahut është gjithëpërfshirës, si për qafirët, edhe për besimtarët, si për të bindurit dhe për të pabindurit. Prandaj i Madhëruari thotë:

- "Ai *(Allahu)* tha: "Edhe atij që nuk beson do t'ia mundësoj kënaqësinë e furnizimit Tim për një kohë të shkurtër." - Kuptimi: Unë do t'i furnizoj të gjithë, muslimanët dhe qafirët. Por muslimanët, furnizimin Tim do ta përdorin për punë të mira, për të adhuruar Allahun e Lartësuar. Dhe, në fund, ata do të kthehen për të shijuar mirësitë e Xhenetit. Ndërsa qafirët do të shijojnë mirësitë e Mia gjatë kësaj jete të shkurtër, por pastaj:

- "Por, pastaj, do ta flak në dënimin e Zjarrit". - Do ta zhys atë me detyrim, duke e poshtëruar në një ndëshkim të madh, në zjarrin e Xhehenemit.


- "Sa përfundim i shëmtuar është ai!" - Ky është përfundimi më i keq.

Ajetet 127 – 129

127. Kur Ibrahimi dhe Ismaili, duke ngritur themelet e Shtëpisë *(Qabes)*, luteshin: "O Zoti ynë! Pranoje prej nesh, se me të vërtetë Ti je Dëgjuesi dhe i Dituri!"
128. Zoti ynë! Na bëj të përulur ndaj Teje! Bëj që edhe pasardhësit tanë të jenë një popull i përulur ndaj Teje! Na i mëso rregullat e adhurimit tonë dhe na e prano pendimin tonë! Pa dyshim, Ti je Pranuesi i pendimit, Mëshiruesi!"
129. Zoti ynë! Dërgo ndër ta një të dërguar nga gjiri i tyre, që t'u lexojë atyre ajetet e Tua, t'u mësojë atyre Librin *(Kur'ânin)* dhe Urtësinë *(Traditën profetike)*, dhe t'i pastrojë ata. S'ka dyshim se Ti je Ngadhënjyesi dhe i Urti.

Shpjegimi i ajeteve

- "Kur Ibrahimi dhe Ismaili, duke ngritur themelet e Shtëpisë *(Qabes)*, luteshin…" Domethënë, përkujto kohën kur Ibrahimi dhe Ismaili ndërtonin themelet e Shtëpisë së


الجزء الأول سورة البقرة
وَإِذْ يَرْفَعُ إِبْرَٰهِـۧمُ ٱلْقَوَاعِدَ مِنَ ٱلْبَيْتِ وَإِسْمَٰعِيلُ رَبَّنَا تَقَبَّلْ
مِنَّآ ۖ إِنَّكَ أَنتَ ٱلسَّمِيعُ ٱلْعَلِيمُ ﴿١٢٧﴾ رَبَّنَا وَٱجْعَلْنَا مُسْلِمَيْنِ
لَكَ وَمِن ذُرِّيَّتِنَآ أُمَّةً مُّسْلِمَةً لَّكَ وَأَرِنَا مَنَاسِكَنَا وَتُبْ عَلَيْنَآ ۖ
إِنَّكَ أَنتَ ٱلتَّوَّابُ ٱلرَّحِيمُ ﴿١٢٨﴾ رَبَّنَا وَٱبْعَثْ فِيهِمْ رَسُولًا مِّنْهُمْ
يَتْلُوا۟ عَلَيْهِمْ ءَايَٰتِكَ وَيُعَلِّمُهُمُ ٱلْكِتَٰبَ وَٱلْحِكْمَةَ
وَيُزَكِّيهِمْ ۚ إِنَّكَ أَنتَ ٱلْعَزِيزُ ٱلْحَكِيمُ ﴿١٢٩﴾ وَمَن يَرْغَبُ عَن مِّلَّةِ
إِبْرَٰهِـۧمَ إِلَّا مَن سَفِهَ نَفْسَهُۥ ۚ وَلَقَدِ ٱصْطَفَيْنَٰهُ فِى ٱلدُّنْيَا ۖ
وَإِنَّهُۥ فِى ٱلْءَاخِرَةِ لَمِنَ ٱلصَّٰلِحِينَ ﴿١٣٠﴾ إِذْ قَالَ لَهُۥ رَبُّهُۥٓ أَسْلِمْ ۖ
قَالَ أَسْلَمْتُ لِرَبِّ ٱلْعَٰلَمِينَ ﴿١٣١﴾ وَوَصَّىٰ بِهَآ إِبْرَٰهِـۧمُ بَنِيهِ
وَيَعْقُوبُ يَٰبَنِىَّ إِنَّ ٱللَّهَ ٱصْطَفَىٰ لَكُمُ ٱلدِّينَ فَلَا تَمُوتُنَّ
إِلَّا وَأَنتُم مُّسْلِمُونَ ﴿١٣٢﴾ أَمْ كُنتُمْ شُهَدَآءَ إِذْ حَضَرَ يَعْقُوبَ
ٱلْمَوْتُ إِذْ قَالَ لِبَنِيهِ مَا تَعْبُدُونَ مِنۢ بَعْدِى ۖ قَالُوا۟ نَعْبُدُ
إِلَٰهَكَ وَإِلَٰهَ ءَابَآئِكَ إِبْرَٰهِـۧمَ وَإِسْمَٰعِيلَ وَإِسْحَٰقَ إِلَٰهًا
وَٰحِدًا وَنَحْنُ لَهُۥ مُسْلِمُونَ ﴿١٣٣﴾ تِلْكَ أُمَّةٌ قَدْ خَلَتْ ۖ لَهَا مَا كَسَبَتْ
وَلَكُم مَّا كَسَبْتُمْ ۖ وَلَا تُسْـَٔلُونَ عَمَّا كَانُوا۟ يَعْمَلُونَ ﴿١٣٤﴾
٢٠

Lashtë. Ajeti na tregon se si ata merreshin me ndërtimin e saj të shoqëruar nga një ndjenjë e vazhdueshme frikë-respekti ndaj Krijuesit dhe nga një shpresë e madhe për shpërblimin e Allahut. Aq të forta dhe të pranishme ishin këto ndjenja, saqë ata, edhe gjatë punës, pëshpërisnin lujte, që Allahu i Lartësuar t'ua pranonte veprën dhe adhurimin e tyre. Ata e bënin këtë, me qëllim që dobia e kësaj pune të ishte e plotë.

- "O Zoti ynë! Pranoje prej nesh, se me të vërtetë Ti je Dëgjuesi dhe i Dituri!" - Pastaj ata bënë një lutje të mrekullueshme. Ata u lutën për veten dhe për pasardhësit e tyre, që Allahu i Lartësuar t'i udhëzonte dhe t'i forconte në ushtrimin e Islamit.

- "Zoti ynë! Na bëj të përulur ndaj Teje! Bëj që edhe pasardhësit tanë të jenë një popull i përulur ndaj Teje!" - Thelbi i Islamit është përulje e plotë e zemrës dhe ndaj Zotit të saj, që rrjedhon detyrmisht në nënshtrimin e gjithë qënies ndaj Krijuesit Madhështor.

- "Na i mëso rregullat e adhurimit tonë" - Duke qenë se Islami nënkupton edhe nënshtrimin me veprime fizike, ata u lutën që Allahu i Lartësuar t'ua mësonte adhurimet në mënyrë të shtjelluar. Ata thanë: "*Ue erinâ menâsikenâ*", domethënë: "Na i trego adhurimet tona", apo më shkoqur: "Na i trego sikur t'i shihnim me sy ato adhurime". Pra, i kërkuan një sqarim shumë të hollësishëm, që t'u dukej sikur po i shihnin me sy.

Fjala "*menâsikenâ*" (adhurimet tona) mund të ketë si qëllim të gjitha veprat e ritet e haxhit, sikurse tregon edhe konteksti i këtyre ajeteve. Por, gjithashtu, ajo mund të tregojë edhe diçka më përfshirëse se këto adhurime të veçanta. Ka mundësi që ata të jenë lutur që Allahu i Lartësuar t'ua sqaronte atyre të gjitha çështjet e fesë, të gjitha adhurimet që përmban Islami, sikurse kuptohet drejtpërdrejt nga fjala: "adhurimet", e cila është në numrin shumës. Ajo mund të përfshijë të gjitha adhurimet e Islamit, edhe pse ky term përdoret më së shumti për ritet e haxhit.

Në përgjithësi, lutja e tyre konsistonte në arritjen e dijes së dobishme dhe të punës me të, për vetë ata dhe për pasardhësit e mëvonshëm, për të mësuar dijen e dobishme dhe për të bërë vepra të mira, sipas kësaj dijeje.

Por në *dua*-në e tyre, ata përmendën edhe një detaj shumë të rëndësishëm:

- "dhe na e prano pendimin tonë! Pa dyshim, Ti je Pranuesi i pendimit, Mëshiruesi!" - Ata u lutën që Allahu t'ua pranonte pendimin, sepse sado që robi të përpiqet t'i përsosë adhurimet e tij ndaj Allahut të Madhëruar, ai patjetër që do të bëjë gabime. Këto gabime e bëjnë të domosdoshëm pendimin tek Allahu Falës dhe Mëshirues.

- "Zoti ynë! Dërgo ndër ta një të dërguar nga gjiri i tyre, që t'u lexojë atyre ajetet e

Tua” - Ata i kërkuan Allahut të Lartësuar që Ai të dërgonte nga mesi i pasardhësve të tyre një profet. Kjo ndodhi për disa arsye, si:
- që grada e Ibrahimit dhe e Ismailit të lartësohej edhe më shumë;
- që pasardhësit t’i nënshtroheshin dhe ta pasonin rrugën e atij Profeti që do të vinte, duke e njohur mirë atë;
- që ai Profet t’u mësonte atyre ato gjëra që nuk do t’i dinin. I Lartësuari thotë:

- “...që t’u lexojë atyre ajetet e Tua” – Domethënë, që t’ua lexojë tekstin fjalë për fjalë, t’ua mësojë atë përmendësh, dhe pastaj t'i mësojë se si ta ruajnë atë që do të mësojnë.

- “...t’u mësojë atyre Librin dhe Urtësinë” – Pra, t'u mësojë dhe sqarojë atyre kuptimin e Kur’ânit dhe të Urtësisë (Sunetit).

- “...dhe t’i pastrojë ata” - T'i pastrojë duke i edukuar që të punojnë punë të mira dhe të largohen nga çdo punë e fjalë e keqe të cilat nuk i lenë shpirtrat të pastrohen dhe të lartësohen.

- “S’ka dyshim se Ti je Ngadhënjyesi dhe i Urti.” – Ngadhënjyesi (*El Azîzu*) është Ai i Cili i mposht dhe nënshtron gjithçka, i Cili është i plotfuqishëm për gjithçka dhe që para fuqisë së të Cilit, askush nuk mund të qëndrojë. Ndërsa i Urti (*El Hakîmu*) është Ai i Cili i vendos gjërat në vendin që e meritojnë.

Kështu, ata iu lutën Allahut, që ka këto cilësi, që ta dërgonte këtë Profet mes tyre, ashtu si i shkon madhështise së Ngadhënjyesit dhe të Urtit.

Allahu i Lartësuar iu përgjigj lutjes së tyre dhe e dërgoi Profetin e nderuar, nëpërmjet të cilit Ai mëshiroi, në mënyrë të veçantë, pasardhësit e Ibrahimit dhe Ismailit, dhe të gjitha krijesat, në përgjithësi. Për këtë arsye, edhe Profeti (a.s.) ka thënë: *“Unë jam fryt i lutjes së babait tim, Ibrahimit (a.s.).”*.

Ajetet 130 – 135

130. Prej fesë së Ibrahimit largohet veç ai që e nënçmon vetveten. Ne, vërtet, e zgjodhëm atë në këtë botë. Pa dyshim, në botën tjetër, ai do të jetë ndër të mirët.
131. Kur Zoti i tij i tha: “Përulu!”, ai tha: “Iu përula Zotit të gjithësisë!”.
132. Ibrahimi ua dha këtë porosi bijve të tij; po ashtu edhe Jakubi: “O bijtë e mi, Allahu ua ka zgjedhur fenë, prandaj mos vdisni ndryshe, por vetëm duke qenë muslimanë të nënshtruar ndaj Tij!”
133. A ishit ju të pranishëm, kur Jakubi, në momentin e vdekjes, u tha bijve të vet: “Çfarë do të adhuroni pas meje?” Ata thanë: “Do të adhurojmë Zotin tënd dhe Zotin e etërve të tu: Ibrahimit, Ismailit dhe Is’hakut, që është një Zot i vetëm. Vetëm Atij i nënshtrohemi!”
134. Ai ishte një popull që tashmë ka kaluar. Atyre u takon ajo që fituan vetë dhe juve ju takon ajo që keni fituar vetë. Ju nuk jeni përgjegjës për veprat e tyre.
135. Ata thonë: “Bëhuni çifutë ose të krishterë, që të gjeni rrugën e drejtë!” Thuaj: “Në asnjë mënyrë! Ne jemi të fesë së drejtë të Ibrahimit, që ishte besimtar monotesit. Ai nuk ka qenë kurrë idhujtar”.

Shpjegimi i ajeteve

- “Prej fesë së Ibrahimit largohet veç ai që e nënçmon vetveten.” - Askush nuk mund të devijojë nga rruga e Ibrahimit pasi të ketë njohur dhe mësuar gjithë këto të dhëna rreth cilësive të larta të tij, përveç atyre që e zhvlerësojnë veten, duke u kënaqur me këtë gjendje, ose veç ata që e shesin veten më lirë sesa i falimentuari shet mallin e vet.

I parë anasjelltas, ky ajet do të kuptohej kështu: Nuk ka njeri më të mirë, më të plotë, më të udhëzuar, sesa dikush që ndjek rrugën dhe fenë e Ibrahimit (a.s.), sepse Ibrahimi ishte i zgjedhuri i Allahut në dynja dhe ahiret. I Lartësuari thotë më tej:

- “Ne, vërtet, e zgjodhëm atë në këtë botë”. – Pra, Allahu i Lartësuar e përzgjodhi atë

mbi njerëzit e tjerë, duke i dhënë sukses për të bërë punë të mira. Ai e udhëzoi atë që t'i kryente këto vepra, të cilat e bënë atë më të drejtin ndër më të dalluarit dhe ndër më të përzgjedhurit e Allahut.

- "Pa dyshim, në botën tjetër, ai do të jetë ndër të mirët." - Në ahiret ai do të jetë prej të mirëve (*sâlihîn*), të cilëve u takojnë gradat më të larta në xhenetet e përjetësisë. Ai e meritonte këtë gradë, sepse ishte i bindur e i nënshtruar.

- "Kur Zoti i tij i tha: "Përulu!", ai tha: "Iu përula Zotit të gjithësisë!"." - Ai u përgjigj menjëherë urdhrit të Zotit të tij, duke thënë me gjuhën e fjalëve, të ndjenjave dhe të veprave: "Iu përula Zotit të gjithësisë". Ai menjëherë shfaqi sinqeritetin dhe përkushtimin në adhurimin e Allahut, si Një të vetëm dhe të Pashoq. Ibrahimi (a.s.) iu dorëzua Allahut duke kryer çdo vepër që Ai e dëshironte dhe pëlqente, në shenjë dashurie dhe madhërimi për Të. Ai u kthye gjithmonë tek Allahu i Lartësuar, për çdo çështje dhe në çdo gjendje. Njësimi i Allahut u bë cilësia e pandryshueshme e natyrës së tij.

Më pas, Ibrahimi (a.s.) këshillon e porosit edhe pasardhësit e tij, në mënyrë të tillë që ato fjalë të përkujtohen gjithmonë. E tillë ishte edhe porosia e Jakubit (a.s.) për pasardhësit e tij:

- "Ibrahimi ua dha këtë porosi bijve të tij; po ashtu edhe Jakubi: "O bijtë e mi, Allahu ua ka zgjedhur fenë" – Kësisoj, ata i këshilluan pasardhësit e tyre që të pasojnë fenë të cilën Zoti i tyre e zgjodhi për ta. Allahu, me këtë fe që u zgjodhi, tregoi mëshirën e tij për ata. Ai e solli fenë me qëllim që ata ta pranojnë dhe ta zbatojnë rigorozisht në jetën e tyre, duke kryer urdhrat e Tij dhe duke u zbukuruar me moralet dhe cilësitë e vyera, të cilat Ai i ka porositur.

Më tej, Ai porosit që njerëzit të jenë të vazhdueshëm në këtë fe, duke mos u larguar kurrë nga ajo.

- "...prandaj mos vdisni ndryshe, por vetëm duke qenë muslimanë të nënshtruar ndaj Tij!" – Kuptimi: Edhe vdekja t'ju gjejë si muslimanë, si zbatues të fesë që Allahu i Lartësuar ka zgjedhur për ju. Në këtë mënyrë, duke qenë të vazhdueshëm në ushtrimin e fesë së Allahut, edhe në ringjallje do të jeni muslimanë, sepse kush jeton si musiman, i tillë do të vdesë dhe si i tillë do të ringjallet tek Allahu i Lartësuar.

Çifutët pretendonin se ishin pasues të fesë së Ibrahimit dhe të Jakubit (Israilit), por Allahu i Lartësuar ua hodhi poshtë këtë pretendim, duke u thënë:

- "A ishit ju të pranishëm, kur Jakubi, në momentin e vdekjes, u tha bijve të vet:" – Domethënë, a ishit ju në momentet kur Jakubit i ishte afruar vdekja dhe ai pyeti bijtë e tij, me qëllim që t'i provonte dhe për të qetësuar zemrën e tij se ata do t'i përmbaheshin porosive të Allahut. Ai u tha atyre:

- "Çfarë do të adhuroni pas meje?" - Dhe ata i dhanë një përgjigje, e cila e qetësoi zemrën e tij:

- "Ata thanë: "Do të adhurojmë Zotin tënd dhe Zotin e etërve të tu: Ibrahimit, Ismailit dhe Is'hakut, që është një Zot i vetëm. Vetëm Atij i nënshtrohemi!"" – Kuptimi: Do të adhurojmë një Zot të vetëm. Veç Allahun do të adhurojmë dhe nuk do t'i shoqërojmë Atij shok në adhurim. Ne do të jemi muslimanë, të dorëzuar dhe të nënshtruar, duke zbatuar porositë e Tij. Pra, ata premtuan për dy gjëra: për njësim të Allahut me sinqeritet dhe për vepra të mira, sipas porosive të Tij.

Është e sigurt që ata nuk ishin të pranishëm në momentet e kësaj porosie të madhe. Ne na tregon Allahu i Lartësuar se si Jakubi (a.s.) i këshilloi pasardhësit e tij për

fenë e drejtë monoteiste, dhe jo për fenë çifute. Pastaj i Madhëruari thotë:


- "Ai ishte një popull që tashmë ka kaluar. Atyre u takon ajo që fituan vetë dhe juve ju takon ajo që keni fituar vetë. Ju nuk jeni përgjegjës për veprat e tyre." – Pra, çdokush do të marrë aq sa ka punuar, duke u shpërblyer me drejtësi për veprat dhe gjithçka që do të paraqesë. Askush nuk do të merret në përgjegjësi për gabimet e gjynahet e tjetrit. Secilit do t'i bëjë dobi veçse besimi dhe devotshmëria e tij ndaj Allahut.

Kjo do të thotë që lidhja që bëni ju (nënkupton ajeti) me ata popuj të mëparshëm, duke pretenduar se jeni pasues të fesë së tyre, është diçka e pavlefshme dhe e parëndësishme, prandaj është më mirë për ju, që të rishikoni gjendjen tuaj të tanishme. Vështroni punët dhe fjalët tuaja, dhe gjykoni në meritoni shpëtimin apo ndëshkimin, sepse ju nuk do të pyeteni për ato që bënë popujt e kaluar, edhe nëse pretendoni se jeni prej tyre dhe pasues së fesë së tyre, por do të llogariteni për veprat tuaja.

- "Ata thonë: "Bëhuni çifutë ose të krishterë, që të gjeni rrugën e drejtë!"" - Secili prej dy grupeve, çifutët dhe krishterët, duke pretenduar se janë në rrugë të drejtë, i ftojnë muslimanët për të ndjekur udhëzimin dhe rrugën e tyre. Ata pretendojnë se vetëm ata janë të udhëzuar, ndërsa çdo rrugë tjetër është e gabuar.

Atëherë, Allahu i Lartësuar urdhëron që kësaj ftese ne t'i përgjigjemi kështu:

- "Thuaj: "Në asnjë mënyrë! Ne jemi të fesë së drejtë të Ibrahimit, që ishte besimtar monotesit. Ai nuk ka qenë kurrë idhujtar". - Pra, jemi ne që ndjekim fenë e Ibrahimit (a.s.), i cili, sikurse u përmend, ishte i përkushtuar dhe i nënshtruar vetëm ndaj Allahut. Ai ishte adhurues vetëm i Allahut, duke i kthyer shpinën çdo gjëje tjetër. Ai ishte praktikues i monoteizmit dhe larg idhujtarisë. Për këtë arsye, udhëzimi dhe lumturia gjenden në pasimin e rrugës së


الجزء الأول سورة البقرة
وَقَالُوا۟ كُونُوا۟ هُودًا أَوْ نَصَٰرَىٰ تَهْتَدُوا۟ ۗ قُلْ بَلْ مِلَّةَ إِبْرَٰهِـۧمَ
حَنِيفًا ۖ وَمَا كَانَ مِنَ ٱلْمُشْرِكِينَ ﴿١٣٥﴾ قُولُوٓا۟ ءَامَنَّا بِٱللَّهِ وَمَآ
أُنزِلَ إِلَيْنَا وَمَآ أُنزِلَ إِلَىٰٓ إِبْرَٰهِـۧمَ وَإِسْمَٰعِيلَ وَإِسْحَٰقَ وَيَعْقُوبَ
وَٱلْأَسْبَاطِ وَمَآ أُوتِىَ مُوسَىٰ وَعِيسَىٰ وَمَآ أُوتِىَ ٱلنَّبِيُّونَ مِن
رَّبِّهِمْ لَا نُفَرِّقُ بَيْنَ أَحَدٍ مِّنْهُمْ وَنَحْنُ لَهُۥ مُسْلِمُونَ ﴿١٣٦﴾
فَإِنْ ءَامَنُوا۟ بِمِثْلِ مَآ ءَامَنتُم بِهِۦ فَقَدِ ٱهْتَدَوا۟ ۖ وَّإِن تَوَلَّوْا۟
فَإِنَّمَا هُمْ فِى شِقَاقٍ ۖ فَسَيَكْفِيكَهُمُ ٱللَّهُ ۚ وَهُوَ ٱلسَّمِيعُ ٱلْعَلِيمُ
﴿١٣٧﴾ صِبْغَةَ ٱللَّهِ ۖ وَمَنْ أَحْسَنُ مِنَ ٱللَّهِ صِبْغَةً ۖ وَنَحْنُ لَهُۥ
عَٰبِدُونَ ﴿١٣٨﴾ قُلْ أَتُحَآجُّونَنَا فِى ٱللَّهِ وَهُوَ رَبُّنَا وَرَبُّكُمْ
وَلَنَآ أَعْمَٰلُنَا وَلَكُمْ أَعْمَٰلُكُمْ وَنَحْنُ لَهُۥ مُخْلِصُونَ ﴿١٣٩﴾
أَمْ تَقُولُونَ إِنَّ إِبْرَٰهِـۧمَ وَإِسْمَٰعِيلَ وَإِسْحَٰقَ وَيَعْقُوبَ
وَٱلْأَسْبَاطَ كَانُوا۟ هُودًا أَوْ نَصَٰرَىٰ ۗ قُلْ ءَأَنتُمْ أَعْلَمُ أَمِ
ٱللَّهُ ۗ وَمَنْ أَظْلَمُ مِمَّن كَتَمَ شَهَٰدَةً عِندَهُۥ مِنَ ٱللَّهِ ۗ وَمَا ٱللَّهُ
بِغَٰفِلٍ عَمَّا تَعْمَلُونَ ﴿١٤٠﴾ تِلْكَ أُمَّةٌ قَدْ خَلَتْ ۖ لَهَا مَا كَسَبَتْ
وَلَكُم مَّا كَسَبْتُمْ ۖ وَلَا تُسْـَٔلُونَ عَمَّا كَانُوا۟ يَعْمَلُونَ ﴿١٤١﴾
٢١

Ibrahimit, ndërsa humbja dhe dëshpërimi gjenden në çdo rrugë tjetër veç kësaj.

Ajetet 136 – 138

136. Thoni: "Ne besojmë tek Allahu, tek ajo që na u shpall neve dhe tek ajo që iu shpall Ibrahimit, Ismailit, Is'hakut, Jakubit dhe Esbatëve *(dymbëdhjetë bijve të Jakubit)*, tek ajo që iu dha Musait, Isait dhe gjithçka që u është dhuruar profetëve nga Zoti i tyre. Ne nuk bëjmë dallim në asnjërin prej tyre. Ne vetëm Atij i jemi nënshtruar.

137. Pa dyshim, nëse ata do të besonin ashtu siç besoni ju, ata vërtet do ta gjenin udhëzimin në rrugën e drejtë. Por nëse refuzojnë, atëherë ata gjithmonë do të jenë kundërshtarë. Por Allahu ju mjafton kundër tyre. Ai është Dëgjuesi dhe i Dijshmi.

138. Kjo *(fe)* është ngjyra e Allahut. E kush jep ngjyrë më të mirë se Allahu?! Ne jemi adhurues të Tij.

Shpjegimi i ajeteve

- "Thoni: "Ne besojmë tek Allahu..." – Kjo fjali i përmbledh të gjitha çështjet e parimet që janë të detyrueshme të besohen.

Iman-i është pranimi i plotë dhe i sigurt me zemër i themeleve të fesë, pranim i cili duhet të shfaqet në aktet e zemrës (si: frika, shpresa apo dashuria ndaj Allahut) dhe në veprimet konkrete të trupit. Kësisoj, zemra dhe gjymtyrët e njeriut duhet të sillen dhe punojnë të diktuara nga besimi.

Sipas këtij përkufizmi, në *iman* hyjnë jo vetëm pesë shtyllat kryesore të Islamit, por edhe të gjitha veprat e mira, të cilat nxiten nga imani. Kështu, kur në Kur'ân dhe Sunet përmendet në një kontekst vetëm fjala '*iman*' (e pashoqëruar me fjalën "Islam"), ajo nënkupton të gjitha ato që sapo i përmendëm.

Po kështu thuhet edhe për fjalën 'Islam', e cila vërtet i nënkupton pesë shtyllat e njohura të fesë, që janë Shehadeti, falja e namazit, agjërimi i Ramazanit, dhënia e zekatit dhe kryerja e haxhit, por kur ajo përmendet e vetme në kontekst, e pashoqëruar me fjalën "*iman*", atëherë ajo përfshin në kuptimin e saj edhe çështjet e imanit.

Nga ana tjetër, nëse në një tekst të caktuar përmenden së bashku edhe fjala '*Islam*', edhe fjala '*iman*', atëherë secila prej tyre shihet me kuptimin e vet specifik, domethënë: "Islami" nënkupton veprat të jashtme ose të dukshme, ndërsa "Imani" tregon pranimin me zemër të çështjeve themelore të fesë. Po kështu thuhet edhe kur në një tekst përmenden të shoqëruar bashkë termat '*Iman*' dhe '*vepra të mira*', ku me "*vepra të mira*", nënkuptohen punët e dukshme, të shfaqura me gjymtyrë dhe me gjuhë.

Më konkretisht, kur Allahu i Lartësuar thotë: "Thoni: "Ne besojmë..."", ky nuk është një urdhër për të thënë vetëm një fjalë goje, por është urdhër për të shprehur me fjalë diçka që është në përputhje të plotë me atë që ndien zemra. Fjalët duhet të jenë zëdhënëse të zemrës, dhe vetëm ato e meritojnë shpërblimin. Kurse fjalët që thuhen të pashoqëruara nga besimi me zemër, konsiderohen hipokrizi dhe kufër.

Fjalët e thëna thjesht me gojë, duke mos u shoqëruar me akte zemre, kanë pak dobi dhe nuk janë ndikuese tek të tjerët. Megjithatë, njeriu mund të shpërblehet ndonjëherë për to, nëse janë fjalë të mira dhe nëse ai ka në zemër themelet e besimit. Kësisoj, ka një ndryshim shumë të madh mes një fjale të thënë me gojë, të pashoqëruar me akte zemre, dhe një fjale të thënë me gojë, të shoqëruar me akte zemre.

Fjala e Allahut të Lartësuar: '*Ḳûlû*' (Thoni...) tregon një urdhër, një nxitje për të ngritur zërin lart në shfaqjen haptazi të besimit të drejtë, në ushtrimin e tij dhe në ftesën e të tjerëve për ta pranuar dhe përqafuar të vërtetën, sepse besimi i drejtë është themeli i kësaj feje, mbi të cilin ajo ngrihet.

Më tej, Allahu i Lartësuar na urdhëron të themi: "Ne besojmë...". Edhe nga ky fragment mund të përfitojmë diçka shumë të vlefshme. Allahu i Lartësuar na urdhëron ta themi këtë fjalë jo në vetën e parë të numrit njëjës, por në shumës: "Ne besojmë...". Kjo është një këshillë shumë e vlefshme, që na e dhuron Zoti ynë. Forma e saj na tregon se ne duhet të jemi si një trup i vetëm. Umeti duhet të bashkohet kur vjen çështja te besimi. Të gjithë duhet ta shtrëngojmë fort 'litarin' e Allahut dhe duhet të nxisim njëri tjetrin për bashkëpunim. Vetëm kur ne të mblidhemi rreth besimit të pastër dhe autentik, mund ta kemi të drejtën të themi: "Ne besojmë...". Vetëm kur punët tona të synojnë kënaqësinë e Allahut dhe të jenë të mbështetura në fe, do të jemi një trup i vetëm, ku të gjithë thonë njëzëri: "Ne besojmë...".

Ky urdhër për bashkim dhe unitet përmban edhe ndalesën nga e kundërta e tij, që është përçarja dhe kundërshtimi mes njëri-tjetrit. Besimtarët duhet të jenë si një

trup i vetëm, ku secili kujdeset për tërësinë e quajtur 'umet'.

Fjala e Allahut të Lartësuar: "Thoni: "Ne besojmë tek Allahu…" dëshmon se lejohet të pohojmë dhe të deklarojmë për vetet tona që ne besojmë. Madje, kjo është e detyrueshme dhe nuk konsiderohet si mburrje, nga e cila jemi ndaluar. Ndërsa te deklarata tjetër: "Unë jam besimtar" vërehet një lloj lëvdimi i vetvetes, prandaj duhet që, pas saj, të themi: "*Inshâ Allâh*" (Në dashtë Allahu). Pra, duhet të themi: "Unë jam besimtar, në dashtë Allahu". Në këtë mënyrë, largohet edhe ajo nuancë vetëmburrjeje që ndihet në këtë fjali.

Po çfarë kuptimesh përmbledh në vetvete shprehja: "Ne besojmë tek Allahu…"? Kjo shprehje do të thotë: Ne besojmë që Ai ekziston dhe është Një i vetëm e i Pashoq. Ne besojmë se Ai është absolut në të gjitha atributet e Tij dhe larg çdo mangësie apo dobësie. Allahu meriton të adhurohet i vetëm, me të gjitha llojet e adhurimit. Asnjë lloj adhurimi nuk lejohet t'i përkushtohet dikujt tjetër, veç Tij.

- "…tek ajo që na u shpall neve" – Shpallja hyjnore, të cilën jemi të detyruar ta besojmë, përfshin në kuptimin e saj jo vetëm Kur'ânin, por dhe Sunetin e Profetit (a.s.), sikurse thotë Allahu i Lartësuar në suren Nisa: "Dhe Allahu të shpalli ty Librin *(Kur'ânin)* dhe Urtësinë *(Sunetin)*." Kështu, Allahu i Lartësuar na urdhëron që të deklarojmë besimin në gjithçka që përmban Libri i Allahut dhe Tradita profetike, duke filluar nga cilësitë e Krijuesit, cilësitë e profetëve të Tij, e duke vazhduar me lajmet rreth Ditës së Gjykimit, përshkrimet e ngjarjeve të së kaluarës dhe të së ardhmes, e pastaj me dispozitat ligjore, të cilat vijnë nga urdhrat e Krijuesit dhe nga ndalesat e Tij. Kur'âni dhe Suneti përmbajnë gjithashtu përshkrime të dënimit dhe të shpërblimit në ahiret, por edhe shumë e shumë gjëra të tjera, të cilat duhen besuar në mënyrën që u tha më sipër, pra: duke i besuar me zemër, duke i deklaruar me gojë, duke i zbatuar në jetë dhe duke i ftuar të tjerët në të.

- "…dhe tek ajo që iu shpall Ibrahimit, Ismailit, Is'hakut, Jakubit dhe Esbatëve *(dymbëdhjetë bijve të Jakubit)*, tek ajo që iu dha Musait, Isait…" – Pra, ne jemi urdhëruar të deklarojmë hapur edhe besimin tek të dërguarit e Zotit dhe tek të tëra shpalljet hynore në përgjithësi.

Ne i besojmë të gjithë profetët përgjithësisht, por në mënyrë të veçantë duhet të besojmë profetët e cilësuar në këtë ajet, sepse ata u pajisën nga Zoti i tyre me ligjet më të fuqishme.

- "Ne nuk bëjmë dallim në asnjërin prej tyre." – Pra, ne i besojmë të gjithë profetët, sepse ata kanë qenë të gjithë prej Allahut të Lartësuar.

Ky element është ai që i karakterizon muslimanët dhe i dallon ata nga të tjerët, si: çifutët, të krishterët, sabijinët etj., të cilët, duke mëtuar që besojnë librat dhe profetët e tyre, ata mohojnë të tjerët, duke bërë, në këtë mënyrë, dallim mes të dërguarve të Allahut. Ata bëjnë dallime mes profetëve dhe shpalljeve të Allahut, duke pranuar disa prej tyre dhe duke mohuar disa të tjera. Këto veprime të tyre e hedhin poshtë pretendimin se ata i besojnë librat dhe profetët e Zotit. Madje, edhe vetë Profeti të cilin ata pretendojnë se e besojnë dhe e ndjekin, edhe ai vetë i ka besuar dhe pranuar të gjithë të dërguarit e Zotit dhe, në mënyrë të veçantë, të Dërguarin e fundit, Muhamedin (a.s.). Kështu ata, duke mohuar dhe duke mos besuar Muhamedin (a.s.), kanë mohuar edhe Profetin e tyre, i cili i ka lajmëruar qartë rreth tij.

- "…dhe gjithçka që u është dhuruar profetëve nga Zoti i tyre" - Dhurata e përmendur këtu është feja që iu dha profetëve nga Zoti i tyre. Kjo është dhurata më e madhe, që garanton lumturinë në këtë jetë dhe në jetën tjetër.

Allahu i Lartësuar na urdhëron që ne të besojmë dhe të pasojmë diturinë e dobishme dhe mirësitë me të cilat Ai i pajisi profetët. Ai na urdhëron që të besojmë dhe të pasojmë dhuratën më madhështore që u bëri atyre, Shpalljen hyjnore.

Gjithashtu, nga ky fragment kuptojmë se profetët janë veçse përçues të qartë të mesazhit të Zotit, e asgjë më tepër. Ata nuk kanë në dorë asnjë mundësi që t'i bëjnë dobi dikujt, sepse gjithçka është në dorën e Krijuesit.

Pjesa: "…nga Zoti i tyre" tregon se Allahu i Lartësuar është absolut në *rububije*-n e Tij (pra, në pozitën e Tij si Zot, Krijues dhe Kujdestar i krijesave të Tij). Në *rububije*-n e Tij përfshihet edhe shpallja e librave dhe dërgimi i profetëve, sepse Ai nuk do ta lejonte kurrë lënien e krijesave në çoroditje, pa orientim dhe pa ditur se ku shkojnë dhe si jetojnë.

Ky fragment tregon edhe dallimin e qartë mes profetëve të vërtetë dhe profetëve të rremë, sepse ajo që u është dhënë profetëve është "…nga Zoti i tyre". Mjafton të shohësh me vëmendje se çfarë kanë thënë ata dhe se për çfarë i kanë ftuar njerëzit, për të kuptuar ndryshimin mes tyre. Profetët e Zotit kanë ftuar veçse në ato gjëra që janë të mira dhe të dobishme dhe kanë ndaluar veçse nga ato gjëra që janë të këqija dhe të dëmshme. Secili prej tyre ka pranuar dhe miratuar profetët e tjerë të Zotit, duke dëshmuar për vërtetësinë e tyre. Mes mësimeve të tyre nuk ka ndryshime dhe kundërshtime esenciale, sepse të gjitha ato kanë patur një burim të vetëm, Zotin e botëve. I Lartësuari thotë: "Sikur Shpallja të ishte prej dikujt tjetër veç Allahut, do të gjeje në të kundërshti të shumta". [Nisa 82].

Ndërsa ata që hiqen si profetë të Zotit janë kontradiktorë në ato që thonë. Ata kundërshtojnë profetët e tjerë, madje edhe vetveten, në mesazhet që sjellin dhe në dispozitat që ligjërojnë. Urdhrat dhe ndalesat e tyre janë larg Ligjit të përhershëm të Zotit. Këtë mund ta kuptojë shumë thjesht çdokush që lexon fjalët e të gjithë profetëve, kumtet e tyre dhe dispozitat ligjore që ata kanë sjellë.

Pasi sqarohet se çfarë duhet besuar në mënyrë të përgjithshme dhe çfarë duhet besuar në mënyrë të shtjelluar, ajeti vijon me një thënie tjetër, e cila nënkupton se, përveç besimit, të cilin duhet ta shfaqim dhe ta deklarojmë, duhet që edhe të punojmë sipas rrugës që kushtëzon ky besim:

- "Ne vetëm Atij i jemi nënshtruar." – Pra, nuk mjafton vetëm besimi, por duhet deklaruar edhe nënshtrimi i plotë ndaj Tij me vepra, sipas rrugës që na udhëzon besimi. Pra, thoni: Ne vetëm ndaj Tij jemi të nënshtruar, vetëm para madhështisë së Tij, dhe duke adhuruar vetëm Atë. Ne e adhurojmë Atë me adhurime të shfaqura e të dukshme dhe me adhurime të fshehura e të padukshme.

Në fakt, Allahu i Lartësuar nuk ka thënë: "Ne i jemi nënshtruar Atij" (*Ue naĥnu muslimûne lehû*), por ka thënë me rend të ndryshëm të fjalëve: "Ne Atij i jemi nënshtruar" (*Ue naĥnu lehû muslimûn*), pra, ndaj askujt tjetër veç Tij. Kjo ka kuptimin: Ne jemi të sinqertë në adhurimin tonë ndaj Tij dhe nuk adhurojmë asnjë tjetër veç Tij.

Ky ajet, edhe pse i shkurtër, përmban në vetvete shumë mësime dhe këshilla. Kështu, së pari, ai nxit për njësimin e Allahut me të trija llojet e teuhidit: *rububije*, *uluhije* dhe *esma ue sifaat*.

Së dyti, ajeti nxit për të besuar të gjithë profetët dhe të gjitha shpalljet e Allahut, por në mënyrë të veçantë ata profetë që përmenden aty dhe shpalljet që u zbritën atyre. Ky veçim i tyre në ajet tregon për rëndësinë e madhe të tyre. Besimi i tyre duhet të jetë patjetër me zemër dhe i shprehur me gojë e me gjymtyrë. Me fjalë të tjera, ajeti nxit për të qenë të sinqertë në këtë besim dhe në veprat që duhen kryer.

Së treti, ajeti tregon kriterin për të dalluar profetët e vërtetë të Allahut nga profetët e rremë.

Së katërti, ai tregon mëshirën e Allahut të Lartësuar, i Cili i mëson adhuruesit e Tij se si të shprehen drejt, për të shfaqur besimin e tyre.

Së pesti, në këtë ajet shfaqen dhuratat dhe mirësitë e rralla të Tij në sqarimin e fesë së drejtë, e cila i udhëzon adhuruesit e Tij drejt lumturisë në këtë jetë dhe në jetën tjetër.

I lavdëruar qoftë Allahu i Lartësuar, që në Librin e Tij ka sqaruar gjithçka dhe që e solli atë si udhëzim dhe si mëshirë për ata që besojnë sinqerisht tek Ai!

- "Pa dyshim, nëse ata do të besonin ashtu siç besoni ju..." – Kuptimi: Nëse ithtarët e Librit do të besonin në të njëjtën mënyrë siç besuat edhe ju, ata do të ishin të udhëzuar drejt. Nëse ata do të besonin të gjithë profetët, të gjithë librat e Zotit dhe, në mënyrë të veçantë, sikur të besonin Muhamedin (a.s.) dhe Kur'ânin; pra, nëse ata do t'i dorëzoheshin dhe nënshtroheshin vetëm Allahut, Një të vetëm dhe të Pashoq dhe nuk do të bënin asnjë dallim mes profetëve të Allahut, atëherë për ta do të thuhej me të drejtë se:

- "...ata vërtet do ta gjenin udhëzimin në rrugën e drejtë." – Pra, do të konsideroheshin të udhëzuar në rrugën e drejtë. Vetëm kjo është rruga që të çon në Kopshtet e mirësive.

Me fjalë të tjera, ata nuk kanë asnjë mundësi tjetër të gjejnë udhën e saktë, përveçse duke ndjekur mënyrën e besimit që ka umeti i fundit (muslimanët).

Ata thonë: "Bëhuni çifutë ose të krishterë, që të gjeni rrugën e drejtë!". Por ky pretendim hidhet poshtë, sepse 'udhëzim' quhet vetëm pranimi i dijes së saktë, të vërtetë dhe të sigurt, i shoqëruar me punën sipas asaj që ajo dikton.

Kësisoj, e kundërta e udhëzimit shfaqet në dy forma: me mospranim të dijes së saktë, të vërtetë dhe të sigurt, dhe me moszbatim të asaj çfarë dikton kjo dije e saktë. Këto janë dhe shkaqet e fjalëve dhe veprave të tyre kontradiktore. Ata gjithmonë janë në kundërshti me njëri tjetrin, madje edhe me vetveten. Për këtë arsye, i Lartësuari thotë:

- "Por nëse refuzojnë, atëherë ata gjithmonë do të jenë kundërshtarë". - Nëse ata i kthejnë shpinën udhëzimit, me të dyja mënyrat e lartpërmendura, atëherë ata do të jenë gjithnjë të zhytur në kontradikta pa fund e pa krye.

- "ata gjithmonë do të jenë kundërshtarë" – Domethënë, do të jenë kundër së vërtetës, kundër Allahut dhe kundër Profetit të Tij.

Ky lloj pozicionimi i tyre shoqërohet gjithmonë me një armiqësi të ashpër, e cila i nxit ata vazhdimisht që të tallen me figurën e Profetit (s.a.u.s.). Për këtë arsye, Allahu i Lartësuar premton se do ta ruajë Profetin dhe figurën e tij të nderuar, të respektuar e të dashur.

- "Por Allahu ju mjafton kundër tyre. Ai është Dëgjuesi dhe i Dijshmi." – Pra, Allahu i Lartësuar do të jetë i mjaftueshëm kundër çdo përpjekjeje të tyre për të ulur figurën e Profetit, të nxitur nga pozicionimi i tyre i keq, në anën e kundërt të udhëzimit. Allahu i Lartësuar është i mjaftueshëm, sepse Ai është Dëgjuesi, që dëgjon të gjitha zërat e krijesave, në çfarëdo gjuhe të thuhen, për të gjitha nevojat që paraqesin, dhe Ai është i Dituri, që di gjithçka: të fshehtat dhe të shfaqurat.

Në fakt, Allahu i Lartësuar e mbajti premtimin e Tij dhe e ndihmoi Profetin e Tij kundër çdo armiku që qëndronte me palën tjetër. Shumë prej tyre u vranë dhe shumë u dëbuan. Secili mori atë që meritonte.

Kjo është një mrekulli e Kur'ânit, sepse Allahu i Lartësuar ka lajmëruar për diçka para se ajo të ndodhte, dhe ngjarja ka ndodhur pikërisht ashtu sikurse është paralajmëruar.

- "Kjo *(fe)* është ngjyra e Allahut." - Kuptimi: Qëndrojini besnikë "ngjyrës" së

Allahut, domethënë fesë së Tij. Jepini përkujdesjen maksimale kësaj feje, duke zbatuar gjithçka që ajo udhëzon, sepse ajo zbukuron pamjen tuaj të jashtme dhe të brendshme. Besojini të gjitha çështjet e fesë dhe zbatojini ato gjithmonë, derisa feja t'ju bëhet si "ngjyra" juaj. Vetëm duke qenë si ngjyrë apo natyrë e juaja, kjo fe do t'ju udhëzojë dhe do t'ju nxisë që t'i nënshtroheni urdhrave dhe dispozitave të saj. Ju duhet t'i zbatoni dispozitat e Allahut me vullnet të lirë, të bindur, të nënshtruar dhe të kënaqur, duke qenë të prirur dhe të motivuar nga dashuria për Të. Nëse ndodh kështu, atëherë feja është kthyer për ju në natyrën tuaj, e cila do t'ju udhëzojë ju drejt lumturisë në këtë jetë dhe në jetën tjetër. E si mund të ndodhë ndryshe me një njeri, natyra e të cilit e nxit atë që të shfaqë moralet dhe cilësitë më të larta dhe të kryejë veprat më të pastra dhe më të nderuara?

Më pas, vjen kjo pyetje, e cila habit çdo mendjendritur që e merr në konsideratë:

- "E kush jep ngjyrë më të mirë se Allahu?! Ne jemi adhurues të Tij" – Pra, nuk ka "ngjyrë" më të mirë se ajo që ju jep Allahu i Lartësuar, domethënë nuk ka cilësi më të mira, sesa cilësitë që fal Allahu i Lartësuar.

Nëse do të njohësh cilësitë me të cilat Allahu i Madhëruar i pajis adhuruesit e Tij, dhe të bësh dallimin mes tyre dhe cilësive të tjetërkujt, mjafton të krahasosh të bukurën me të kundërtën e saj. Po ashtu, vështroni një adhurues të sinqertë të Allahut, që e beson Zotin e tij me një iman të saktë. Ju do të shihni se ky iman ka lënë shenja të dukshme në qenien e këtij adhuruesi, pasi zemra e tij i është nënshtruar totalisht Allahut, kurse gjymtyrët i punojnë vazhdimisht për të kënaqur Krijuesin. Ai stoliset gjithnjë e më tepër me cilësi dhe sjellje të bukura, nga njëra anë, dhe largohet nga çdo cilësi e shëmtuar dhe e mangët, nga ana tjetër. Përshkrimi i tij është: i sinqertë në fjalët që thotë dhe në veprat që bën, i durueshëm, tolerant, i vetëpërmbajtur, i ndershëm, guximtar, fjalëartë dhe punëmirë. Atë e karakterizon dashuria e fortë për Allahun e Lartësuar dhe frikërespekti ndaj Tij. Udhërrëfyesit e këtij njeriu janë gjithmonë frika dhe shpresa ndaj të Adhuruarit, ndërsa bashkudhëtarë të tij janë sinqeriteti ndaj të Adhuruarit dhe bamirësia ndaj krijesave.

Nga ana tjetër, vështro një njeri që mohon Zotin e Tij dhe endet larg Tij. Ai u drejtohet krijesave, në vend që t'i drejtohet Krijuesit. Ky njeri është i mveshur me cilësitë më të shëmtuara, si: kufri, idhujtaria, mashtrimi, tradhëtia, pabesia dhe pandershmëria. Ai është keqbërës ndaj krijesave, me fjalët dhe me punët e tij. Ai nuk njeh as sinqeritet ndaj Krijuesit dhe as bamirësi ndaj krijesave.

Duke krahasuar këto dy raste, mund të kuptojmë ndryshimin mes cilësive që jep Allahu i Lartësuar dhe cilësive që ofrojnë të tjerët. Është e qartë: "ngjyra" që jep feja e Allahut është e pakrahasueshme dhe e paarritshme nga ndonjë fe tjetër. Madje, nuk ka cilësi me të poshtra sesa ato që formon çdo fe tjetër, veç fesë së Allahut të Lartësuar. Më pas, i Madhëruari tregon shkakun e dhënies së kësaj "ngjyreje":

- "Ne jemi adhurues të Tij." – Domethënë, kjo natyrë ndërtohet mbi dy shtylla, të cilat i përmban në vetvete kuptimi i fjalës "adhurim". Shtyllën e parë e përbën çdo fjalë apo vepër, e shfaqur apo e fshehur, të cilën Allahu i Lartësuar e do dhe është i kënaqur me të, dhe e cila mund të jetë e tillë veçse nëse është Allahu i Lartësuar Ai që e ka ligjëruar atë, nëpërmjet Profetit të Tij. Pra, është e domosdoshme që, për një adhurim të caktuar, të kemi argument nga Allahu i Lartësuar dhe profetët e Tij, sepse përndryshe ai nuk quhet adhurim. Kjo është shtylla e parë, mbi të cilën krijohet "ngjyra që jep Allahu", domethënë: adhurimi i mbështetur në fe.

Ndërsa shtylla e dytë është sinqeriteti në adhurim. Pra, nuk mjafton vetëm adhurimi i mbështetur në fe, nëse ai nuk kryhet me

sinqeritet vetëm për hir të Allahut të Lartësuar.

Po si kuptohet ky kusht i dytë nga fragmenti i mësipërm?

Në ajet thuhet (në arabisht): *Lehû âbidûn* (Fjalë për fjalë: "Jemi vetëm të Tij adhurues"), dhe nuk thuhet: "*Abidûne lehû*" (Jemi adhurues të Tij). Domethënë, gjymtyrët e fjalisë nuk janë në rendin e tyre të zakonshëm. Me ndryshimin e rendit, theksohet që adhurimi i përket vetëm Allahut, ndërsa rendi normal i fjalëve lë hapësirë në domethënie, duke u kuptuar ndoshta që: përveç Tij, ata të mund të adhuronin edhe ndonjë tjetër. Ky është pikërisht treguesi i kushtëzimit të sinqeritetit në adhurim.

Kjo fjali përmban edhe diçka tjetër shumë të bukur. Në të është përdorur emri foljor "*âbidûn*" (adhurues), dhe nuk është përdorur folja "adhuroj". Në gjuhën arabe, emri foljor tregon vazhdimësinë dhe qëndrueshmërinë e veprimit të foljes nga ai rrjedh. Kjo tregon që, cilësitë që të fal feja e Allahut të Lartësuar janë të qëndrueshme ose të pandryshueshme dhe, më konkretisht, adhurimi është bërë cilësi e pandashme e këtyre besimtarëve.

Ajetet 139 - 141

139. Thuaju: "A kërkoni të polemizoni me ne për Allahun, kur Ai është Zoti ynë dhe Zoti juaj?! Ne kemi veprat tona, e ju keni veprat tuaja. Ne jemi të sinqertë ndaj Tij.
140. A po thoni se Ibrahimi, Ismaili, Is'haku, Jakubi dhe Esbatët kanë qenë çifutë ose të krishterë?!" Thuaju: "A jeni ju më të ditur apo Allahu? Kush është më i padrejtë se ai që e fsheh të vërtetën prej Allahut, duke e patur pranë vetes?! Allahu nuk është i pavëmendshëm ndaj asaj që veproni ju".
141. Ai ishte një popull që shkoi. Atyre u takon ajo që fituan dhe juve ju takon ajo që keni fituar. Ju nuk jeni përgjegjës për gjërat që kanë bërë ata.

Shpjegimi i ajeteve

- "Thuaju: "A kërkoni të polemizoni me ne për Allahun" - Polemika (*el meĥâxhxhetu*) është një diskutim që zhvillohet mes dy palëve, për çështje mbi të cilat ata kanë mendime të ndryshme. Secila palë synon që të vërtetojë tezën e vet dhe të hedhë poshtë tezën e tjetrit, duke bërë maksimumin në grumbullimin e argumenteve dhe në trajtimin e tyre.

Është e domosdoshme që polemika të zhvillohet në mënyrën më të mirë dhe më paqësore. Gjatë saj, duhet synuar ndjekja e rrugës më të shkurtër për të hedhur poshtë qëndrimin e gabuar dhe për ta udhëzuar palën tjetër në qëndrimin e saktë.

Polemikat kanë edhe një qëllim tjetër. Nëpërmjet tyre, u shpalosen faktet kryeneçëve, të cilët, me polemikat e tyre, nuk kanë për qëllim të zbulojnë të vërtetën, dhe kështu atyre u hiqet mundësia për t'u justifikuar para Krijuesit. Ata nuk do të mund të thonë se nuk e dinin.

Polemikë e frytshme dhe e dobishme është ajo nëpërmjet së cilës kërkohet qartësimi i së vërtetës dhe hedhja poshtë e të gabuarës. Ndërsa çdo polemikë që nuk e ka këtë qëllim, është thjesht tregues mendjemadhësie dhe dëshire për të shfaqur vetveten. Të tilla polemika nuk kanë mirësi, por ato sjellin veçse të këqija.

Ithtarët e Librit pretendonin se ishin të përzgjedhurit e Zotit. Ata thonin se askush tjetër nuk i meritonte mirësitë e Zotit, pasi ata ishin të zgjedhurit e Tij, por Allahu i Lartësuar sqaron se ky qe një pretendim i kotë dhe i pabazuar.

- "...kur Ai është Zoti ynë dhe Zoti juaj?!" – Pra, nëse Zoti i të gjithëve është vetëm një, atëherë çfarë argumenti keni ju për të vërtetuar se Ai është Zoti juaj? A keni fakte që tregojnë se Ai përkujdeset veçse për ju? E vërteta është se të gjithë jemi të barabartë para Tij. Ndryshimi qëndron vetëm në veprat që ne bëjmë për Të.

- "Ne kemi veprat tona, e ju keni veprat tuaja." – Domethënë, secili prej nesh kryen punë me të cilat dallohet prej tjetrit.

Allahu i Lartësuar i sheh veprat e secilës palë, ndërkohë që të dyja palët janë të barabarta para Zotit, përsa i përket llogaritjes së këtyre veprave. Të dyja palët kanë një Zot të vetëm dhe të dyja ato kryejnë punë, nëpërmjet të cilave kërkojnë të afrohen te Zoti i tyre. Atëherë, ku qëndron ndryshimi mes dy grupeve? Ata që mëtojnë se ka ndryshim, duhet të sjellin argumente, ose, në të kundërt, kemi të bëjmë vetëm me një tezë të pavërtetueshme, e cila nuk meriton vëmendje. Në fakt, ajo është veçse shprehje e mendjemadhësisë së tyre.

I vetmi kriter dallues mes krijesave është sinqeriteti që ato tregojnë në adhurimin e Zotit të tyre. Të zgjedhurit e Zotit janë vetëm ata që pasojnë mësimet e vërteta të Tij dhe që e adhurojnë Atë si një të vetëm, me mënyrën që Ai e ka sqaruar nëpërmjet Profetit të Tij. I Lartësuari e tregon këtë cilësi të të përzgjedhurve, kur thotë:

- "Ne jemi të sinqertë ndaj Tij" – Të tillë janë të përzgjedhurit e Zotit. Ky është dallimi mes miqve të Rrahmanit dhe miqve të Shejtanit: sinqeriteti. Në varësi të kësaj vetie zhvillohen cilësitë e tjera të të dyja grupeve. Secila palë duket nga veprat që kryen.

Siç u tha më lart, në këtë ajet jepet një mësim i mirë për metodën se si duhet të zhvillohet një polemikë. Kështu, gjatë saj, është e këshillueshme që të nxirren të përbashkëtat dhe të kundërtat e diskutuesve. Në këtë mënyrë, do të arrihet që, për të përbashkëtat, të bihet dakord, ndërsa për të kundërtat do të diskutohet me argumente të shëndosha, derisa të gjendet zgjidhja e duhur.

- "A po thoni se Ibrahimi, Ismaili, Is'haku, Jakubi dhe Esbatët kanë qenë çifutë ose të krishterë?!" - Ky qe një tjetër pretendim i tyre. Ata thonin se të gjithë këta profetë kanë qenë predikues të fesë së tyre. Allahu i Lartësuar e hedh poshtë këtë pretendim të gënjeshtërt, duke thënë:

- "Thuaju: "A jeni ju më të ditur apo Allahu?" - Allahu i Lartësuar thotë në suren Ali Imran, ajetet 64-67: "Thuaju *(o i Dërguar)*: "O ithtarë të Librit! Ejani në një fjalë të vetme, të përbashkët mes nesh dhe jush: 'Të mos adhurojmë askënd tjetër, përveç Allahut. Le të mos i bëjmë pjesë askujt tjetër në adhurimet që ia përkushtojmë Atij. Le të mos e konsiderojmë njëri-tjetrin si zota, përveç Allahut!' E në qoftë se ata refuzojnë, thoni: "Dëshmoni pra, se ne jemi muslimanë!"

O ithtarë të Librit! Pse po polemizoni me ne rreth Ibrahimit?! A nuk u shpallën Teurati dhe Ungjilli shumë kohë pas tij?! A nuk e kuptoni?

Ju jeni ata që polemizoni për gjëra që i dini, por përse polemizoni për atë që s'keni kurrfarë dijenie *(për Ibrahimin)*? Allahu e di të vërtetën e ju nuk dini. Ibrahimi nuk ka qenë as çifut, as i krishterë. Ai ka qenë larg besimeve të kota, ishte musliman dhe nuk ishte idhujtar."

Kurse ata thonin që Ibrahimi ishte çifut ose i krishterë. E kështu, të drejtë kishin ose ata, ose Allahu i Lartësuar; nuk ka mundësi të tretë për këtë çështje. Atëherë, përgjigjja është aq e qartë dhe e sigurt, saqë është e panevojshme të citohet. Kjo është njëlloj si t'i përgjigjesh pyetjes: "Nata është më e shndritshme apo dita?" Ose: "Më i nxehtë është zjarri apo uji?" Ose: "Idhujtaria është më e mirë apo teuhidi?". Përgjigjja e këtyre pyetjeve është, pra, shumë e qartë dhe e sigurt.

Edhe ata vetë e dinin shumë mirë se Ibrahimi dhe të gjithë profetët që ata numëruan, nuk ishin as çifutë, as krishterë. Por, pavarësisht nga kjo, ata e fshehën këtë fakt të vërtetë, që është si drita e diellit. Prandaj i Lartësuari thotë më tej:

- "Kush është më i padrejtë se ai që e fsheh të vërtetën prej Allahut, duke e patur pranë vetes" - E vërteta e pakundërshtueshme gjendej mes librave të dhënë prej Zotit. Ata duhej ta respektonin këtë të vërtetë dhe ta nxirrnin në pah atë. Por ata, jo vetëm që e fshehën, por vazhdojnë të mbrojnë me forcë të kundërtën e saj.

Krimi i tyre ishte i shumëfishtë, sepse ata:
- Së pari, e fshehën të vërtetën, duke mos u folur njerëzve rreth saj.
- Së dyti, shfaqën të kundërtën e të vërtetës, domethënë mashtrimin.
- Së treti, ata i ftonin të tjerët që ta besonin mashtrimin si të vërtetë, duke i penguar në këtë mënyrë ata prej së vërtetës të sigurt prej Zotit.

Kjo është padrejtësia më e madhe që mund t'u bëhet krijesave. Për këtë arsye, ata do të meritojnë ndëshkimin, siç thotë i Lartësuari:

- "Allahu nuk është i pavëmendshëm ndaj asaj që veproni ju". – Kuptimi: Ai e ka ruajtur me saktësi çdo vepër të tyren dhe e ka bërë gati "shpërblimin" për ta. Ndëshkimi më i rëndë është ai i përgatitur për krimet e tyre. Zjarri është vendi më i keq dhe më i tmerrshëm që është përgatitur për të padrejtët dhe mizorët.


Ky është stili i mrekullueshëm i Kur'ânit, që, pasi përmend veprat e krijesave të cilat kërkojnë shpagim të merituar, vijon menjëherë të tregojë dy cilësi të Krijuesit: dijen dhe pushtetin e Tij për gjithçka. Kjo mënyrë nxit shpresën, por edhe frikën. Ajo nxit dëshirën për të bërë vepra të mira dhe për t'iu larguar veprave të këqija.

Përmendja e këtyre cilësive është tregues edhe për diçka tjetër: çdo dispozitë e ligjëruar prej Zotit dhe çdo shpërblim për to në dynja dhe në ahiret, vjen si rrjedhojë e emrave, cilësive dhe veprave të Zotit. Me fjalë të tjera, emrat, cilësitë dhe veprat e të Madhërishmit nënkuptojnë që duhet të ekzistojnë si dispozitat e sjella në këtë jetë prej Krijuesit të botës, ashtu edhe shpërblimet dhe shpagimet që lidhen me zbatimin ose jo të këtyre dispozitave. Asgjë nuk del jashtë domethënies së emrave, cilësive dhe veprave të mrekullueshme të Zotit të gjithësisë. Pastaj thotë i Lartësuari:

- "Ai ishte një popull që shkoi. Atyre u takon ajo që fituan dhe juve ju takon ajo që keni fituar. Ju nuk jeni përgjegjës për gjërat që kanë bërë ata." - Këto ajete u sqaruan edhe më sipër, por Allahu i Lartësuar i përsërit me qëllim që askush të mos e lidhë shpëtimin e vet me krijesat ose me faktin që është pasardhësi i këtij apo i atij njeriu të mirë. Çdokush do të merret në përgjegjësi për punët e veta, jo për të parët e tij. Askush nuk do të përjetojë shpërblimin apo ndëshkimin që meriton tjetri. I vetmi kriter përzgjedhjeje tek Allahu janë veprat e mira, sipas mësimeve të sjella nga profetët. Prejardhja e njeriut nuk e ndihmon atë në marrjen e shpërblimit apo të ndëshkimit.

Ajetet 142 – 143

142. Njerëzit mendjelehtë do të thonë: "Çfarë i ktheu ata *(muslimanët)* prej Kiblës *(drejtimit të faljes)* së mëparshme?" Thuaju: "Të Allahut janë Lindja dhe Perëndimi. Ai udhëzon në rrugën e drejtë atë që do".
143. Dhe kështu, Ne ju bëmë ju një popull të ekuilibruar, për të qenë dëshmitarë *(në Ditën e Gjykimit)* ndaj njerëzve. Edhe i Dërguari ka për të qenë dëshmitar ndaj jush. Kiblën nga e cila ti drejtoheshe e ndryshuam vetëm për t'u dalluar ata që pasojnë sinqerisht të Dërguarin, nga ata që kthehen pas. Vërtet, kjo provë qe e rëndë, por jo për ata që Allahu i ka udhëzuar. Dijeni se Allahu nuk ua humb besimin *(namazin)* tuaj. Vërtet, Allahu është Përdëllimtar dhe i Mëshirshëm me njerëzit.



سَيَقُولُ ٱلسُّفَهَآءُ مِنَ ٱلنَّاسِ مَا وَلَّىٰهُمْ عَن قِبْلَتِهِمُ ٱلَّتِى كَانُوا۟
عَلَيْهَا ۚ قُل لِّلَّهِ ٱلْمَشْرِقُ وَٱلْمَغْرِبُ ۚ يَهْدِى مَن يَشَآءُ إِلَىٰ صِرَٰطٍ
مُّسْتَقِيمٍ ﴿١٤٢﴾ وَكَذَٰلِكَ جَعَلْنَٰكُمْ أُمَّةً وَسَطًا لِّتَكُونُوا۟
شُهَدَآءَ عَلَى ٱلنَّاسِ وَيَكُونَ ٱلرَّسُولُ عَلَيْكُمْ شَهِيدًا ۗ وَمَا
جَعَلْنَا ٱلْقِبْلَةَ ٱلَّتِى كُنتَ عَلَيْهَآ إِلَّا لِنَعْلَمَ مَن يَتَّبِعُ ٱلرَّسُولَ
مِمَّن يَنقَلِبُ عَلَىٰ عَقِبَيْهِ ۚ وَإِن كَانَتْ لَكَبِيرَةً إِلَّا عَلَى ٱلَّذِينَ
هَدَى ٱللَّهُ ۗ وَمَا كَانَ ٱللَّهُ لِيُضِيعَ إِيمَٰنَكُمْ ۚ إِنَّ ٱللَّهَ
بِٱلنَّاسِ لَرَءُوفٌ رَّحِيمٌ ﴿١٤٣﴾ قَدْ نَرَىٰ تَقَلُّبَ وَجْهِكَ فِى ٱلسَّمَآءِ ۖ
فَلَنُوَلِّيَنَّكَ قِبْلَةً تَرْضَىٰهَا ۚ فَوَلِّ وَجْهَكَ شَطْرَ ٱلْمَسْجِدِ
ٱلْحَرَامِ ۚ وَحَيْثُ مَا كُنتُمْ فَوَلُّوا۟ وُجُوهَكُمْ شَطْرَهُۥ ۗ وَإِنَّ
ٱلَّذِينَ أُوتُوا۟ ٱلْكِتَٰبَ لَيَعْلَمُونَ أَنَّهُ ٱلْحَقُّ مِن رَّبِّهِمْ ۗ وَمَا ٱللَّهُ
بِغَٰفِلٍ عَمَّا يَعْمَلُونَ ﴿١٤٤﴾ وَلَئِنْ أَتَيْتَ ٱلَّذِينَ أُوتُوا۟ ٱلْكِتَٰبَ
بِكُلِّ ءَايَةٍ مَّا تَبِعُوا۟ قِبْلَتَكَ ۚ وَمَآ أَنتَ بِتَابِعٍ قِبْلَتَهُمْ ۚ
وَمَا بَعْضُهُم بِتَابِعٍ قِبْلَةَ بَعْضٍ ۚ وَلَئِنِ ٱتَّبَعْتَ أَهْوَآءَهُم مِّنۢ
بَعْدِ مَا جَآءَكَ مِنَ ٱلْعِلْمِ ۙ إِنَّكَ إِذًا لَّمِنَ ٱلظَّٰلِمِينَ ﴿١٤٥﴾

Shpjegimi i ajeteve

Këto ajete përmbajnë disa çështje. Në to përmendet një prej mrekullive të Profetit (s.a.u.s.). Ato përmbajnë gjithashtu një ngushëllim, i cili i qetësoi zemrat e besimtarëve. Ajetet tregojnë kundërshtimin e qafirëve ndaj caktimit të Zotit dhe urdhrave të Tij, si edhe përgjigjen ndaj këtij kundërshtimi me tri pika. Në ajete paraqiten cilësitë e atyre që kundërshtojnë ligjet e Zotit, nga njëra anë, si edhe cilësitë e atyre që i pranojnë plotësisht këto ligje, nga ana tjetër.

Allahu i Lartësuar në këto ajete flet për një kategori njerëzish, të cilët i quan '*sufehâ*' - mendjelehtë. Këta mendjelehtë kundërshtojnë dispozitat e shpallura prej Allahut të Lartësuar. *Sufehâ* quhen ata të cilët nuk dinë të dallojnë se çfarë është e mirë dhe çfarë është e keqe për ta. Madje, ata janë aq të paqëndrueshëm dhe të nxituar, saqë për hir të gjërave më të ulëta, janë gati të shesin të mirat më të mëdha që mund të ketë një njeri.

Njerëzit mendjelehtë për të cilët flet ajeti janë çifutët, të krishterët dhe të gjithë ata që kundërshtojnë dispozitat e shpallura nga Zoti. Në rastin konkret, kundërshtimi ishte për shkak të ndryshimit të Kiblës. Gjatë kohës kur jetonin në Mekë, muslimanët ishin të urdhëruar të drejtoheshin për nga Xhamia e Shenjtë në Palestinë, kur ata falnin namazin. Po kështu vazhduan të faleshin edhe pas emigrimit në Medinë, për afro një vit e gjysmë. Në këtë caktim të Tij, Allahu i Lartësuar kishte fshehur mjaft urtësi, disa prej të cilave do të tregohen më poshtë. Një vit e gjysmë pas vajtjes në Medinë, Allahu i Lartësuar, me urtësinë e Tij, i urdhëroi besimtarët që të drejtoheshin për nga Qabja.

Allahu i Lartësuar i lajmëroi besimtarët se mendjelehtët patjetër që do ta kundërshtonin urdhrin e Tij, duke thënë:

- "Njerëzit mendjelehtë do të thonë: "Çfarë i ktheu ata prej Kiblës së mëparshme?"" – Pra, cili qe shkaku që muslimanët e ndryshuan Kiblën nga Bejtul Mukadesi, Xhamia e Shenjtë në Palestinë, në drejtim të Qabesë? Çfarë i shtyu ata të bënin këtë ndryshim?

Kjo pyetje e tyre shprehte kundërshtim të hapur dhe pakënaqësi ndaj caktimit të Zotit dhe ndaj ligjeve të shpallura prej Tij. Ajo qe një shprehje e poshtër e mosmirënjohjes ndaj dhuratave dhe mirësive të falura prej Allahut Bujar dhe të Urtë.

Por Allahu i Madhëruar i qetësoi besimtarët, fillimisht, duke i paralajmëruar ata për fjalët që do të dëgjonin prej mendjelehtëve. Ai u tregoi se të tilla fjalë kundërshtuese buronin veçse prej njerëzve mendjelehtë, të paditur dhe të pafe. Urdhrat e Zotit i kundërshtojnë veçse mendjecekëtit. Kështu, nuk ia vlen që të shqetësohesh për hir të këtyre mendjelehtëve. Të urtët dhe të diturit nuk duhet të merakosen për fjalët e atyre, sepse është shumë e qartë se nga vijnë ato.

Ky ajet tregon, pra, se urdhrat dhe dispozitat e shpallura prej Allahut i kundërshtojnë veçse ata që janë mendjelehtë, injorantë dhe inatçorë. Ndërsa të diturit, të urtët, të udhëzuarit dhe besimtarët i pranojnë pa mëdyshje këto urdhra dhe dispozita. Ata jo vetëm që i pranojnë, por edhe nënshtrohen plotësisht për zbatimin e tyre. I Lartësuari thotë:

- në suren Ahzabë, ajeti 36: "Kur Allahu ose i Dërguari i Tij vendos për një çështje, nuk i takon asnjë besimtari dhe asnjë besimtareje që, në çështjet e tyre personale të gjejnë ndonjë zgjidhje tjetër. Kush e kundërshton Allahun dhe të Dërguarin e Tij, është larguar shumë prej së vërtetës."

- në suren Nisa, ajeti 65: "Për Zotin tënd, jo, ata nuk janë besimtarë, nëse nuk të zgjedhin ty për të gjykuar në konfliktin mes tyre, nëse ndiejnë pakënaqësi nga gjykimi yt e nëse nuk të binden sinqerisht."

- në suren Nurë, ajetet 51, 52: "Kur besimtarët ftohen që ndërmjet tyre të gjykojë Allahu dhe i Dërguari i Tij, e vetmja fjalë që duhet të thonë është: "Dëgjuam dhe u bindëm!" Ata janë të shpëtuarit. Ata që respektojnë Allahun dhe të Dërguarin e Tij, që ia kanë frikën Allahut dhe i përmbahen udhëzimit të Tij, ata janë fitimtarët."

Duke i përshkruar ata si "mendjelehtë", është e panevojshme që t'i jepet ndonjë përgjigje pyetjes së tyre idiote. Nuk ia vlen që atyre t'u kushtohet vëmendje më shumë se kaq. Megjithatë, edhe në këtë rast, Allahu i Lartësuar nuk do të lejonte që ky dyshim dhe kundërshtim i hedhur prej *sufehâ*-ve të kalonte pa u sqaruar dhe pa përgjigje. Allahu i Lartësuar e bëri këtë, me qëllim që në zemrat e njerëzve të mos mbetej asnjë lloj paqartësie. Ai thotë:

- "Thuaju: "Të Allahut janë Lindja dhe Perëndimi. Ai udhëzon në rrugën e drejtë atë që do". - Kështu pra, nëse Lindja dhe Perëndimi janë pronë e Allahut, atëherë kjo do të thotë që nuk ka asnjë drejtim tjetër në gjithësi që të mos jetë pronë e Tij. Edhe udhëzimi për të kuptuar të vërtetën është në dorën e Tij. Ai udhëzon në rrugën e drejtë kë dëshiron. Ndryshimi i Kiblës është, gjithashtu, udhëzim i urtë i dhuruar prej Tij, që ju njerëz të faleni drejt Kiblës së babait tuaj, Ibrahimit (a.s.). Atëherë, kur çështja qëndron kështu, përse kundërshtojnë ata? Përse e kundërshtojnë urdhrin për t'u drejtuar në njërin nga kahet që është, gjithsesi, pronë e Allahut të Lartësuar?

Vetëm fakti që drejtimi i ri i faljes, sikurse të gjitha drejtimet e tjera, është pronë e Allahut, do të mjaftonte që ai të respektohej pa ngurruar. Atëherë, si duhet të veprohet kur dihet se ai vjen si dhuratë nga Allahu i Lartësuar, si një udhëzim drejt rrugës së lumturisë dhe mirësisë?! Përgjigjja është e qartë. Nënshtrimi duhet të jetë i plotë dhe me kënaqësinë më të madhe. Ata që i kundërshtojnë të tilla urdhra i shtyn veçse zilia kundër besimtarëve, për dhuratat dhe mirësitë që Zoti u jep atyre .

- "Ai udhëzon në rrugën e drejtë atë që do". – Sipas kuptimit të drejtpërdrejtë të ajetit, udhëzimi i njerëzve është i kushtëzuar nga dëshira absolute e Allahut të Urtë dhe të Drejtë për t'i udhëzuar ose jo ata. Ky kuptim është tepër i saktë dhe i pakundërshtueshëm. Me fjalë të tjera, nuk ka dyshim se askush nuk mund ta gjejë udhëzimin e drejtë nëse këtë nuk e dëshiron Allahu i Lartësuar dhe i Drejtë. Por ky fakt nuk i bën të pavlefshme shkaqet njerëzore që bëjnë të merituesheëm udhëzimin ose humbjen, sepse si udhëzimi, ashtu edhe humbja e rrugës së drejtë, kanë shkaqe që i bëjnë të merituesheme ato.

Vërtet Allahu i Lartësuar udhëzon atë që Ai dëshiron, por këtë e bën në përputhje të plotë me urtësinë dhe drejtësinë e Tij. Po me urtësinë dhe drejtësinë e Tij, Ai i lë në humbje ata që dëshiron. Nëse robi i zbaton dhe u nënshtrohet shkaqeve që të çojnë në udhëzim, atëherë Allahu i Lartësuar, me urtësinë, dijen dhe drejtësinë e Tij, i jep

sukses atij për të ecur në rrugën e udhëzimit. E njëjta gjë vlen edhe për devijimin.

Ajetet e Kur'ânit shpjegojnë njëri-tjetrin. Kështu, në një prej tyre thuhet:

"Allahu fton për në Xhenet, dhe atë që do e udhëzon në rrugë të drejtë. Atyre që bëjnë vepra të mira u takon e mira *(Xheneti)*, madje edhe më tepër *(të shohin Allahun)*. Fytyrat e tyre nuk i mbulon pluhuri i zi, as nënçmimi. Ata janë banues të Xhenetit, ku do të jenë përjetësisht. Për ata që bëjnë të këqija, dënimi i të keqes së tyre do të jetë me të njëjtën masë. Ata do t'i mbulojë poshtërimi dhe nuk do të mund t'i mbrojë kush nga Allahu. Fytyrat e tyre do të jenë si t'i kishte mbuluar errësira e natës. Ata do të jenë banues të Zjarrit, ku do të jenë përjetësisht." [Junus 25-27].

Diku tjetër, Allahu thotë: "Thuaju: "A ka ndonjë prej idhujve tuaj që mund të drejtojë në rrugën e drejtë ndonjë të humbur?" Thuaju: "Vetëm Allahu udhëzon në të vërtetën. Atëherë, pra, a është më e drejtë të shkohet pas Atij që udhëzon në rrugën e drejtë, apo pas atij që as vetë nuk është i udhëzuar, veç nëse e udhëzon dikush tjetër? Ç'është me ju? Si gjykoni?" Shumica e tyre ndjekin veçse hamendje, por hamendja nuk është asgjë para së vërtetës. Allahu e di shumë mirë se çfarë bëjnë ata." [Junus 35-36].

Allahu thotë gjithashtu: "Pasha natën, që me errësirë mbulon gjithësinë! Pasha ditën, kur ajo shkëlqen! Pasha Atë që krijoi mashkullin e femrën! Vërtet, veprat tuaja janë të ndryshme. Për sa i përket atij që jep dhe ruhet, atij që beson bindshëm në më të mirën, Ne do t'ia lehtësojmë atij më të lehtën. E për sa i përket atij që tregohet koprrac, që e ndien veten të pavarur *(nga Zoti)* dhe që e mohon më të mirën, Ne do t'i lehtësojmë atij më të vështirën. Atij nuk do t'i bëjë dobi pasuria e vet, kur ai të shkatërrohet. Është detyrë e Jona udhëzimi. Vetëm e Jona është bota tjetër dhe kjo botë." [Lejl 1-13].

Në ajetet e mëposhtme, Allahu i Lartësuar tregon shkakun e udhëzimit të këtij umeti (muslimanëve) në gjithçka të mirë dhe të drejtë:

- "Dhe kështu, Ne ju bëmë ju një popull të ekuilibruar…" – Kuptimi: Ju bëmë të ekuilibruar, ju mbushëm me mirësi, e kështu ju shpëtuam.

Ekstremet janë gjithmonë në rrezik, dhe ky është një fakt. Ndërsa muslimanët Allahu i Lartësuar i ka udhëzuar të gjejnë ekuilibrin e artë në të gjitha çështjet, të fesë apo të jetës qofshin.

Kështu për shembull, nëse flasim për qëndrimin ndaj profetëve, ata i qëndrojnë besnikë mesit të artë. Ata nuk e teprojnë në lëvdimin dhe madhërimin e tyre, sikurse bëjnë krishterët, të cilët e konsiderojnë Isain si Zot dhe si bir të Zotit. Por ata as nuk tregohen të padrejtë, duke shpërfillur profetët e duke shkuar në ekstremin tjetër, sikurse vepruan çifutët, të cilët mohuan shumë profetë dhe shumë të tjerë i vranë. Muslimanët i besojnë të gjithë profetët, pa dallim, duke mos lejuar asnjë prishje të ekuilibrit të caktuar nga Zoti i gjithësisë. Ata i besojnë profetët ashtu sikurse janë në të vërtetë: si njerëz, si krijesa, si adhurues të Zotit të tyre, të cilët përçonin mesazhin e Tij ndër njerëz.

Edhe ligjet që ata zbatojnë në jetën dhe në fenë e tyre janë të ekuilibruar, sepse ato nuk janë të ashpra dhe të vështira, sikurse janë ato të çifutëve. Por, nga ana tjetër, muslimanët nuk lejohen të kalojnë në ekstrem, duke i shpërfillur këto ligje, sikurse bëjnë krishterët, që pothuajse nuk kanë kufij që t'u përmbahen.

Çifutët, sipas ligjit të tyre, lejohen të falen veçse nëpër sinagogat e tyre. Po sipas fesë së tyre, ndyrësia në rroba nuk mund të pastrohet me ujë. Atyre iu bënë të ndaluara shumë nga ushqimet e mira, si ndëshkim për poshtërsitë e tyre. Ky është njëri ekstrem. Ndërsa në ekstremin tjetër qëndrojnë të krishterët, të cilët nuk njohin

ndonjë gjë si të papastër apo të ndaluar. Ata lejojnë gjithçka që ka kjo botë.

Ndërsa të ekuilibruarit janë të tillë në të gjitha çështjet e fesë dhe të jetës. Allahu i Lartësuar u ka lejuar atyre çdo gjë të pastër, të dobishme dhe të mirë, qofshin këto në ushqime, pije, veshje apo në marrëdhëniet ndërnjerëzore. Ai u ka ndaluar atyre veçse gjërat që janë të papastra, të dëmshme dhe të këqija.

Ky popull (muslimanët) ka fenë më të ekuilibruar dhe moralin më të lartë. Veprat e tyre kanë vetëm një synim: përmirësimin. Allahu i Lartësuar i dhuroi këtij populli dituri, butësi, drejtësi dhe mëshirë, cilësi që nuk ia ka dhuruar asnjë bashkësie të mëparshme.

Allahu i Lartësuar i bëri muslimanët një popull të ekuilibruar në drejtësinë dhe urtësinë e tyre, për një arsye të caktuar, siç e thotë në vijim:

- "...për të qenë dëshmitarë ndaj njerëzve..." - Për shkak të drejtësisë dhe urtësisë së tyre të madhe, ata do të dëshmojnë për popujt e tjerë, dhe kurrë nuk do të ndodhë e kundërta. Ata që ky popull i quan "të pranuar tek Zoti", ata do të jenë vërtet të tillë. Ndërsa ata të cilët janë "të papranueshëm" në gjykimin e muslimanëve, ata do të jenë të tillë edhe për Allahun e Lartësuar.

Dikush mund të thotë: Si mund të pranohet dëshmia e njërës palë për tjetrën, kur ato do t'i nënshtrohen të dyja të njëjtit gjykues? Aq më tepër që gjykimi i njërës palë kundër tjetrës është i papranueshëm, kur ato janë në konflikt me njëra tjetrën. Atëherë, si është e mundur që, Ditën e Gjykimit, do të pranohet gjykimi i muslimanëve kundër popujve të tjerë?

Përgjigja: Është e vërtetë që, gjykimi i ndërsjelltë i palëve në konflikt me njëra-tjetrën nuk lejohet dhe nuk merret në konsideratë. Por kjo ndalesë vlen vetëm për rastet kur të dyja palët janë të akuzuara dhe të përlyera. Ndërsa kur njëra palë nuk është e akuzuar apo e përlyer, çështja ndryshon. Kështu shpjegohet edhe dëshmia e umetit islam Ditën e Gjykimit. Duke qenë se muslimanët janë të pajisur me drejtësi dhe dituri, ata e meritojnë që të gjykojnë dhe të dëshmojnë për popujt e tjerë, sepse kushte të dëshmisë dhe gjykimit janë që ato të kryhen me dije dhe me drejtësi. Si rrjedhojë, ato do të jenë të pranueshme Ditën e Gjykimit.

Nëse dikush do ta kundërshtonte këtë gjykim dhe do të kërkonte ndonjë argument për drejtësinë e këtij umeti (muslimanëve) në dëshminë e tyre, Allahu i Lartësuar e ka plotësuar edhe këtë kërkesë. Për të gjykuar dhe dëshmuar mbi drejtësinë dhe dijen e muslimanëve, Ai ka zgjedhur dëshmitarin më të ditur dhe më të drejtë, krijesën më të mirë, Profetin e fundit, Muhamedin (a.s.):

- "Edhe i Dërguari ka për të qenë dëshmitar ndaj jush" - Ndër dëshmitë e këtij umeti ndaj popujve të tjerë, mund të përmendim se, Ditën e Gjykimit, Allahu i Lartësuar do t'i pyesë profetët: A e përçuat mesazhin Tim ndër popujt tuaj? Ata, sigurisht, do të përgjigjen se e kryen detyrën e ngarkuar. Por, kur Allahu i Lartësuar do t'i pyesë popujt në të cilët ata u dërguan si profetë, popujt do ta mohojnë këtë fakt. Ata nuk do ta pranojnë që profetët e përcollën mesazhin e Zotit. Atëherë, profetët do të kërkojnë dëshminë e popullit të fundit, muslimanëve, të cilët do të dëshmojnë se çdo profet e kreu me përkushtim dhe totalisht detyrën e ngarkuar prej Allahut. Për vërtetësinë dhe saktësinë e kësaj dëshmie, do të dëshmojë edhe Profeti i umetit të fundit, Muhamedi (s.a.u.s.).

Ky ajet provon se mendimi unanim i këtij umeti është argument i sigurt, i tillë që është detyrë të besohet, të pranohet dhe të zbatohet. Ky umet nuk mund të bjerë në pajtueshmëri mendimi për diçka të gabuar. Ai nuk mund të pranojë një gjë të gabuar si të saktë, sepse Allahu i Lartësuar e ka cilësuar atë si "*ueseța*" (të ekuilibruar) në dije dhe drejtësi. Nëse muslimanët do të binin të

gjithë në konsensus për diçka të gabuar, atëherë nuk do të meritonin të quheshin të tillë. Këtë qëndrim e përforcon edhe fjala e Allahut të Madhëruar:

- "...për të qenë dëshmitarë ndaj njerëzve" - Nëse ky umet dëshmon se diçka është hallall apo haram, sipas gjykimit të Zotit, atëherë kjo dëshmi është e pakundërshtueshme, sepse ata janë të pagabueshëm në këtë drejtim. Muslimanët janë të pagabueshëm në qëndrimet e tyre unanime, sepse përndryshe nuk do të meritonin të përzgjidheshin që të dëshmonin mbi të gjithë popujt e tjerë.

Nga ky ajet mësojmë, gjithashtu, se dëshmia, gjykimi dhe dhënia e fetvave janë të papranueshme, nëse ai që i kryen nuk e gëzon cilësinë "*adâle*" [4].

- "Kiblën nga e cila ti drejtoheshe e ndryshuam..." – Fjala është për kiblën e parë, që ishte drejt Xhamisë së Shenjtë në Palestinë.

Sigurisht që ky vendim kishte urtësi në vetvete. Allahu i Lartësuar ka dituri absolute dhe nuk ka nevojë që, për të ditur diçka, të provokojë krijesat që ta shfaqin atë të cilën e mbajnë të fshehur brenda shpirtit të tyre. Ai i sjell sprovat me qëllim që krijesat ta shfaqin qëndrimin që e mbajnë të fshehur dhe, në këtë mënyrë, të bëjnë të merituesëm shpërblimin ose ndëshkimin e Tij. Allahu i Lartësuar nuk do të gjykonte kurrë për të dhënë shpërblime dhe ndëshkime, duke u bazuar thjesht në dijen e Tij absolute për të fshehtat. Shpërblimi ose ndëshkimi janë të lidhur ngushtë me veprat, të cilat shfaqen dhe lënë gjurmë. Kjo është drejtësia absolute e të Madhërishmit. Ai ndëshkon veçse pas sqarimit të argumenteve dhe qartësimit të së vërtetës nga ana e Tij. Ai nuk ndëshkon thjesht dhe vetëm duke u bazuar në dijen e Tij të fshehtë rreth krijesave, por sipas veprave të kryera prej tyre, pasi kështu ato nuk do të kenë asnjë justifikim para Krijuesit. Allahu i Lartësuar thotë:

- "...vetëm për t'u dalluar ata që pasojnë sinqerisht të Dërguarin, nga ata që kthehen pas..." – Domethënë, për t'u dalluar qartë ata që e pasojnë rrugën e Profetit, pasi e njohën mirë atë.

Njeriu e ka detyrë që, pasi ta ketë njohur të vërtetën, ta pasojë atë rigorozisht në të gjitha rastet, sepse ai është thjesht një krijesë, e cila duhet me domosdo t'i nënshtrohet ligjeve të Krijuesit të saj dhe të zbatojë urdhrat e Tij. Aq më tepër që, edhe në librat e para të Zotit sqarohej qartë që Profeti i fundit do të drejtohej nga një kah tjetër për të kryer faljen e namazit dhe, më konkretisht, drejt Qabes.

Ai që realisht e kërkon rrugën e drejtë nuk ia lejon vetes që të mos bindet dhe të mos pasojë të vërtetën e sigurt. Përkundrazi, argumentet ia shtojnë edhe më shumë atij besimin dhe bindjen ndaj Profetit të fundit të Allahut.

Ndërsa ata që ia kthejnë shpinën të vërtetës së qartë dhe të sigurt, duke ndjekur pasionin dhe mendjemadhësinë e vet, pa dyshim që do të zhyten edhe më shumë në mosbesimin e tyre. Më shumë do të çoroditen e turbullohen. Të tillët, si fatkeqë e të pashpresë, vazhdimisht do të sjellin argumente të pabaza dhe të pafaktuara. Justifikimet e tyre do të jenë gjithmonë të ndërtuara mbi dyshime e hamendësi.

- "Vërtet, kjo provë qe e rëndë," - Kjo dispozitë për ndryshimin e Kiblës ishte shumë e vështirë për t'u pranuar. I Madhëruari thotë se ajo ishte sprovë e madhe.

- "...por jo për ata që Allahu i ka udhëzuar" - Ai i ka udhëzuar ata që ta kuptojnë drejt se kjo dispozitë është një mirësi e madhe nga Zoti i tyre. Kjo është një

[4] **Adil** është ai që cilësohet si i rregullt në fenë e tij, dhe i pa cënuar nga cilësi të dukshme që tregojnë mangësinë e fesë dhe moralit të tij.

mirësi, ndaj së cilës duhet të tregohesh mirënjohës.

E si të mos tregohesh mirënjohës ndaj Allahut të Lartësuar, kur Ai na drejtoi drejt kësaj Shtëpie madhështore, të cilën e dalloi mbi të gjitha vendet e tjera. Vizita e kësaj Faltoreje për haxh dhe umre është një nga kushtet e Islamit dhe shkak për fshirjen e të gjitha gjynaheve të robit. Këto mirësi e lehtësojnë shumë pranimin, madje me kënaqësi, të dispozitës së zbritur prej Allahut të Lartësuar.

Ndërsa të tjerët, të cilët nuk janë udhëzuar të kuptojnë mirësitë që fsheh kjo dispozitë, sigurisht që do ta kenë të vështirë t'i përballojnë ndryshime të tilla kaq të mëdha. Pastaj i Madhëruari thotë:

- "Dijeni se Allahu nuk ua humb besimin *(namazin)* tuaj". - Është e pamundur të mendohet një gjë e tillë për Allahun e Lartësuar. Është jashtë çdo mundësie që Allahu t'ua humbasë dhe t'ua çojë dëm veprat dhe besimin e të mirëve.

Ky është një përgëzim shumë i madh për këdo që Allahu i Lartësuar e ka begatuar me besim dhe me fenë Islame: Ai do t'ia mbrojë besimin dhe do ta ruajë nga devijimi. Ruajtja që jep Allahu i Lartësuar në këtë aspekt është dy llojesh:

1. Që adhuruesi të mos e humbasë besimin e tij prej shumë faktorëve që e shkaktojnë një gjë të tillë, siç janë, për shembull, sprovat, fatkeqësitë, dëshirat apo pasionet e shfrenuara.

2. Ndërsa lloji i dytë i ruajtjes së Allahut të Lartësuar është suksesi që Ai i jep adhuruesit për ta shtuar e plotësuar imanin e tij. Ai i jep sukses atij të cilit dëshiron t'ia ruajë imanin besimin, duke i krijuar çdo mundësi për këtë gjë. Ashtu sikurse e udhëzon që të gjejë rrugën e besimit fillimisht, në të njëjtën mënyrë e ndihmon që ta përsosë dhe ta ruajë atë më tej, të pacënuar. Kësisoj, Allahu e plotëson mirësinë e Tij ndaj adhuruesit, duke ia shtuar imanin, por edhe shpërblimin për veprat që kryhen në emër të këtij imani, sepse besimtarin e vërtetë nuk mund ta devijojnë kurrë sprovat, sado të mëdha qofshin ato.

Nga Fjala e Allahut të Lartësuar: "Kiblën nga e cila ti drejtoheshe e ndryshuam vetëm për t'u dalluar ata që pasojnë sinqerisht të Dërguarin nga ata që kthehen pas…" dikush mund të kuptojë gabimisht se, sprova mund të bëhet shkak që, edhe disa besimtarë të kthehen mbrapa dhe të braktisin besimin e tyre. Por Allahu i Lartësuar, në ajetin që vjen më poshtë, e mohon kategorikisht këtë mendim të gabuar, kur thotë: "Allahu nuk do t'jua humbasë kurrë besimin tuaj". Kështu, Ai deklaron që, sprovat, sado të mëdha qofshin, nuk mund ta devijojnë besimtarin dhe nuk mund t'ia humbasin besimin atij.

Ky premtim përfshin edhe ata të cilët vdiqën para se të ndryshohej Kibla. Pra, Allahu i Lartësuar nuk do t'ua humbasë besimin edhe asaj kategorie njerëzish, sepse ata nuk bënë gjë tjetër, por veçse zbatuan urdhrat e Allahut dhe të Profetit të Tij. Bindje ndaj Allahut quhet zbatimi i përpiktë i urdhrave të Tij, në çdo kohë qofshin ato.

Ky ajet dëshmon, gjithashtu, për saktësinë e mendimit të Ehli Sunetit, se: edhe veprat janë pjesë e imanit, pasi ai Allahu i ka quajtur punët e gjymtyrëve (namazin) "iman".

- "Të jeni të sigurt se Allahu është shumë i Butë dhe Mëshirues ndaj njerëzve." - Allahu i mëshiron shumë njerëzit. Prej kësaj mëshire shumë të madhe është edhe plotësimi i mirësive të Tij ndaj tyre, duke ua ruajtur dhe shtuar besimin që ua dhuron fillimisht. Është pikërisht mëshira e Tij që i dallon ata mbi njerëzit që shtiren si besimtarë dhe mashtrojnë. Po prej mëshirës së Tij ishte edhe sprova e mësipërme, nëpërmjet së cilës Ai e shtoi edhe më tepër besimin dhe bindjen e tyre. Me mëshirën e Tij, Ai ua ngriti gradat shumë lart, duke i urdhëruar ata që të drejtoheshin për nga

Faltorja më e nderuar që ekziston mbi tokë, e cila është Qabja.

Ajetet 144 – 145

144. Ne të shohim që kthen shpesh fytyrën tënde nga qielli. Ne do të të drejtojmë ty nga një Kible e dashur për ty. Ktheje pra, fytyrën tënde drejt Xhamisë së Shenjtë *(Qabes)*! Kudo që të jeni *(o besimtarë)*, kthejini fytyrat tuaja drejt saj! Ata të cilëve u është dhuruar Libri sigurisht që e dinë se kjo është e vërteta nga Zoti i tyre. Allahu nuk është i pakujdesshëm ndaj asaj që ata punojnë.

145. Edhe sikur t'u sillje atyre që u është dhënë Libri *(çifutëve dhe krishterëve)* çdo lloj argumenti, ata nuk do ta pasonin Kiblën tënde. As ti nuk do ta pasosh Kiblën e tyre. Asnjëra palë prej tyre nuk do ta pasojë Kiblën e tjetrës. Nëse ti, edhe pas dijes që të ka ardhur, do të pasoje dëshirat e tyre, atëherë ti do të ishe vërtet i padrejtë.

Shpjegimi i ajeteve

- "Ne të shohim që kthen shpesh fytyrën tënde nga qielli." - Profeti (a.s.) e kthente vazhdimisht fytyrën nga qielli, duke pritur me mall dhe dëshirë një urdhër nga Zoti për t'u drejtuar gjatë faljes së namazit për nga Qabja.

Allahu i Lartësuar, për të treguar rëndësinë e madhe që i kushtonte Profeti (s.a.u.s.) ndryshimit të Kiblës, thotë që ai kthente fytyrën, dhe jo thjesht vështrimin. Nga dëshira e madhe që kishte për Kiblën e zemrës, Qaben, Profeti (a.s.) nuk hidhte drejt qiellit vetëm shikimin e tij, por kthehej i gjithi me fytyrën e tij, duke pritur me mall urdhrin e Zotit.

- "Ne do të të drejtojmë ty nga një Kible e dashur për ty." - Kuptimi: Nga dashuria jote për atë drejtim, Ne do të të drejtojmë me fytyrë nga Qabja. Ky ajet dëshmon për gradën e lartë të Muhamedit (a.s.), sepse Allahu i Lartësuar u kujdes që t'ia përmbushte dëshirën Profetit (s.a.u.s.).

Më pas, Allahu i Lartësuar urdhëron qartë për t'u kthyer drejt Qabes:

- "Ktheje pra, fytyrën tënde drejt Xhamisë së Shenjtë (*Qabes*)!" – Në fakt, "*el- uexhhu*" quhet pjesa e përparme e trupit të njeriut.

- "Kudo që të jeni *(o besimtarë)*, kthejini fytyrat tuaja drejt saj!" – Pra, kudo qofshi, në tokë, në det, në lindje, në perëndim, në jug, në veri etj., kthehuni në drejtim të Kiblës madhështore, që është Qabja.

Ky ajet është provë që tregon se drejtimi nga Qabja është kusht i domosdoshëm për saktësinë e namazit, farz apo nafile qoftë ai.

Nëse është e mundur, duhet që të drejtohesh pikërisht drejt Qabes. Por nëse kjo është krejtësisht e pamundur, atëherë duhet të drejtohesh me përafërsi nga ajo anë.

Nga dobitë e ajetit mund të përmendim, se devijimi me trup nga Kibla e prish namazin, sepse ky drejtim është kusht i domosdoshëm për saktësinë e faljes. Urdhri për të kryer diçka nënkupton që e kundërta e saj të jetë e ndaluar. Pra, kur jemi urdhëruar që të drejtohemi nga Kibla, kjo nënkupton se devijimi prej saj gjatë namazit është i ndaluar.

Pastaj Allahu i Lartësuar vijon me një fakt shumë të rëndësishëm: Dijetarët e ithtarëve të Librit e dinin shumë mirë se kjo dispozitë e Zotit ishte një e vërtetë e sigurt dhe e pakundërshtueshme.

- "Ata të cilëve u është dhuruar Libri sigurisht që e dinë se kjo është e vërteta nga Zoti i tyre." - Ata e kanë patur të shkruar në librat e tyre se cila do të ishte Kibla e Profetit të fundit, por ata e fshehin dhe e mohojnë një fakt të tillë, për shkak të zilisë që mbush zemrat e tyre. Meqenëse ata e kundërshtojnë të vërtetën për të tilla shkaqe, atëherë nuk ia vlen të shqetësohesh për ta dhe për kundërshtimet e tyre.

Njeriu, për nga natyra, shqetësohet për kundërshtimet e të tjerëve ndaj tij, sidomos kur çështjet janë të diskutueshme. Por kur sigurohesh që kundërshtari nuk ka asnjë bazë në kundërshtimet e tij dhe e vërteta qëndron në anën tënde, atëherë nuk ia vlen aspak të shqetësohesh për të. E vetmja gjë që besimtari duhet të presë në të tilla situata është ndëshkimi i merituar për kundërshtimin e padrejtë të tyre. Pra, ndëshkimi mbi të padrejtët pritet të zbresë në këtë jetë dhe në jetën tjetër. Për këtë arsye, Allahu i Lartësuar kërcënon duke thënë:

- "Allahu nuk është i pakujdesshëm ndaj asaj që ata punojnë." - Ai ua ruan me përpikmëri e me drejtësi shënimet për veprat që ata kryejnë, dhe po me drejtësi Ai përgatit shpagimin. Kjo thënie përmban kërcënim për mohuesit e të vërtetës dhe përgëzim, qetësi e kënaqësi për besimtarët e sinqertë, që i përmbahen kësaj të vërtete të ardhur nga Zoti.

Nga përkushtimi dhe dëshira e madhe për të udhëzuar krijesat në rrugën e drejtë, Profeti (s.a.u.s.) bënte ç'ishte e mundur që t'i këshillonte ata dhe t'ua qartësonte të vërtetën. Ai trishtohej shumë kur krijesat nuk i nënshtroheshin urdhrave të Zotit.

Mes atyre që mohuan Zotin dhe treguan mendjemadhësi ndaj pasimit të Profetit të Tij, ishin edhe çifutët e të krishterët, që kishin librat e tyre qiellorë, të cilët ata i lexonin. Ata e dinin të vërtetën, por e mohuan Profetin (s.a.u.s.) me vetëdije. Për këtë arsye, Allahu i Lartësuar e njofton Profetin (s.a.u.s.) se:

- "Edhe sikur t'u sillje atyre që u është dhënë Libri *(çifutëve dhe krishterëve)* çdo lloj argumenti, ata nuk do ta pasonin Kiblën tënde" – Kuptimi: Çfarëdo argumenti dhe fakti që të sjellësh për të qartësuar dhe vërtetuar fjalën tënde, ata kurrë nuk kanë për të ndjekur drejtimin dhe udhëzimet e tua. Ata kurrë nuk do ta pasojnë rrugën tënde, sepse shkaku i mosbesimit dhe mosbindjes së tyre nuk është padituria ndaj së vërtetës. Ata e njohin shumë mirë të vërtetën, por ata të mohojnë thjesht nga zilia dhe inati kundër teje.

Dihet shumë mirë se faktet dhe argumentet vlejnë veç për ata që e kërkojnë sinqerisht të vërtetën, por nuk arrijnë ta dallojnë atë. Vetëm këta e gjejnë rrugën e udhëzimit, pasi u sqarohet e vërteta. Ndërsa për ata që e braktisin me vetëdije të vërtetën, nuk ka shpresa për t'u udhëzuar.


Në fakt, ata nuk janë në kundërshtim vetëm me të tjerët, por ata kundërshtohen edhe mes njëri-tjetrit dhe asnjëra palë nuk ka për ta pasuar udhëzimin e ofruar nga pala tjetër.

- "As ti nuk do ta pasosh Kiblën e tyre. Asnjëra palë prej tyre nuk do ta pasojë Kiblën e tjetrës." – Kuptimi: Kur ata nuk pranojnë udhëzimet e njëri-tjetrit, atëherë si mund të presësh që ata të pasojnë udhëzimet e tua, o Muhamed?! Ata janë armiq ziliqarë e të pabindur.

Thënia: "As ti nuk do ta pasosh Kiblën e tyre" është më shprehëse sesa thjesht: "Mos e ndiq rrugën e tyre", sepse vetë fakti që Profeti (a.s.) ishte kundërshtar i hapur i rrugës së tyre e bënte të pamundur që ai t'i ndiqte ata dhe, si rrjedhojë, ishte e panevojshme që Allahu i Lartësuar ta urdhëronte Profetin dhe t'i thoshte: "Mos e ndiq rrugën e tyre!".

Gjithashtu, këtu mund të përmendim edhe diçka tjetër. Pas fjalëve: "As ti nuk do ta pasosh Kiblën e tyre", Allahu i Lartësuar nuk thotë: "…edhe nëse ata të sjellin çdo lloj argumenti". Kur foli për ta, Allahu i Lartësuar e tha një gjë të tillë, kurse në këtë rast nuk e thotë. Përse? Sepse ithtarët e Librit nuk kanë asnjë argument që të mund të vërtetojë qëndrimin e tyre.

Profeti (s.a.u.s.) nuk mund të ishte kurrë pasues i tyre, sepse qe i bindur se ata ishin në humbje. Pasi e vërteta është sqaruar plotësisht dhe me fakte, bëhet e



panevojshme që për çdo dyshim të japësh përgjigje. Mjafton të kuptohet qartë e vërteta, dhe çdo gjë që bie ndesh me të është e refuzuar vetvetiu. Megjithatë, edhe sikur të bëhej, do të ishte jo e detyrueshme.

- "Nëse ti do të pasoje dëshirat e tyre..." – Këtu Allahu i Lartësuar ka thënë: "Nëse ti do të pasoje dëshirat e tyre (*ehuãehum*)", dhe nuk ka thënë "Nëse do të pasoje fenë e tyre" (*dînehum*), sepse ajo që kanë ata nuk meriton të quhet 'fe', por thjesht dëshirë e pabazuar. Madje, edhe ata vetë e dinë dhe e pranojnë se rruga që ata ndjekin nuk quhet fe dhe as besim i bazuar në të vërtetën e Zotit. Kush braktis fenë e drejtë të Zotit, domosdo që do të bëhet pasues i nënshtruar i dëshirave dhe pasioneve të tij. Për këtë, thotë i Lartësuari: "A e ke parë ti *(Muhamed)* atë që, duke e ditur, dëshirën e vet e konsideron si Zot?! Atë Allahu e ka humbur nga rruga e drejtë, ia ka mbyllur të dëgjuarit dhe zemrën, dhe mbi shikimin e tij ka vënë perde. E, përveç Allahut, kush mund ta udhëzojë atë?! A nuk merrni mësim?!" [Xhathije 23].

- "...edhe pas dijes që të ka ardhur..."- Pra, nëse ndjek dëshirat e tyre pasi të kanë ardhur dija dhe argumentet që vërtetojnë se ti je në rrugën e drejtë dhe ata në të kotën, atëherë:

- "...atëherë ti do të ishe vërtet i padrejtë." - Edhe pse është përjashtuar më përpara mundësia që Profeti (s.a.u.s.) të ndiqte dëshirat e tyre, kjo thuhet për përforcim, që një gjë e tillë as të mos mendohet. Nëse do të ndodhte e kundërta, ai do të ishte sikurse ata, i padrejtë.

E ku ka padrejtësi më të madhe se ta njohësh të vërtetën dhe pastaj ta refuzosh atë! Ku ka padrejtësi më të rëndë se të dish të dallosh të vërtetën nga e kota, dhe pastaj t'i japësh përparësi të kotës mbi të vërtetën!

Edhe pse në këtë ajet Allahu i Lartësuar i drejtohet Profetit (s.a.u.s.), këto këshilla i drejtohen edhe popullit të tij, umetit musliman. Pra, nëse vetë Profeti (a.s.), me gradat e larta dhe veprat e tij të shkëlqyera, do të quhej i padrejtë po ta bënte një gjë të tillë, atëherë çfarë mund të mendosh për të tjerët poshtë tij?! Kështu pra, muslimanët duhet që t'i largohen rrugës së të humburve dhe të ruhen nga pasimi i çdo udhe të gabuar, përveç asaj të dëftyer nga Allahu dhe Profeti i tij (a.s.) e cila është e vetmja udhë e drejtë.

Ajetet 146 – 148

146. Ata, të cilëve u kemi dhënë Librin *(çifutët dhe të krishterët)*, e njohin atë *(Profetin Muhamed)* ashtu sikurse njohin bijtë e vet. Por disa prej tyre e fshehin të vërtetën, edhe pse e dinë.
147. E vërteta vjen nga Zoti yt, prandaj mos u bëj nga ata që dyshojnë.
148. Çdokush ka një drejtim, të cilit i përkushtohet. Garoni në vepra të mira! Kudo që të jeni, Allahu ka për t'ju tubuar

të gjithëve. Allahu është i Plotpushtetshëm për gjithçka.

Shpjegimi i ajeteve

- "Ata, të cilëve u kemi dhënë Librin *(çifutët dhe të krishterët)*, e njohin atë *(Profetin Muhamed)* ashtu sikurse njohin bijtë e vet." - Allahu i Lartësuar na tregon se ithtarët e Librit ishin të sigurt se Muhamedi qe profet i dërguar nga Allahu. Ata e dinin se libri që ai solli ndër njerëz qe, pa dyshim, shpallje e vërtetë nga Zoti i gjithësisë. Ata e njihnin këtë fakt ashtu siç njihnin fëmijët e tyre, të cilët nuk mund t'i ngatërronin me tjetër njeri. Njohja e tyre rreth Muhamedit (s.a.u.s.) ishte aq e sigurt, saqë nuk linte asnjë vend për dyshim.

- "Por disa prej tyre e fshehin të vërtetën, edhe pse e dinë." – Por, pavarësisht nga kjo, shumica e tyre, që parapëlqyen mohimin kundrejt besimit dhe bindjes, i fshehën provat e qarta rreth këtij Profeti të madh, që ndodheshin në duart e tyre. Ata e bënë këtë, edhe pse e dinin se qe një padrejtësi shumë e madhe. I Lartësuari thotë: "E kush është më mizor se ai që fsheh dëshminë e Allahut, të cilën e ka pranë vetes?! Allahu nuk është aspak i pavëmendshëm ndaj asaj që veproni ju". [Bekare 140].

Këto fjalë ishin një ngushëllim për zemrën e Profetit (s.a.u.s.) dhe për zemrat e besimtarëve. Ato, gjithashtu, i këshillojnë besimtarët që të jenë të ruajtur nga dyshimet dhe e keqja e atyre të padrejtëve që e fshehin të vërtetën.

Nga ky ajet kuptohet se, mes ithtarëve të Librit pati edhe nga ata që nuk pranuan ta fshihnin të vërtetën, pas dijes dhe sigurisë që krijuan rreth Pejgamberit (s.a.u.s.), ashtu siç pati edhe nga ata që e mohuan këtë të vërtetë nga padija e tyre.

Nga kjo rrjedh që, është detyrë për dijetarin e të vërtetës, që ta shfaqë, ta zbulojë dhe ta qartësojë atë, me të gjitha mundësitë, rrugët dhe mjetet e tij. Ai e ka detyrë që t'ua zbukurojë të vërtetën njerëzve të paditur, me qëllim që ata ta pranojnë atë lehtësisht dhe me dëshirë. Dijetari, gjithashtu, duhet të punojë që t'ia çjerrë maskën mashtrimit, duke treguar fytyrën e vërtetë të atyre që e fshehin të vërtetën. Ai duhet që, njerëzve të thjeshtë, t'ua bëjë të shëmtuar dhe të urryer rrugën e mashtrimit, në mënyrë që ata të largohen dhe të ruhen prej saj.

Por mashtruesit dhe fshehësit e të vërtetës vepruan të kundërtën e detyrës së dijetarit, prandaj ata u shkatërruan të gjithë: dijetarë dhe injorantë, prijës dhe pasues.

- "E vërteta vjen nga Zoti yt" - E çfarë mund ta meritojë këtë emër më shumë sesa kjo Shpallje e mrekullueshme, sesa ai udhëzim i sjellë prej Allahut të Lartësuar nëpërmjet të Dërguarit të Tij?

Kjo Shpallje meriton më shumë se çdo gjë tjetër të quhet "e vërteta e sjellë nga Zoti", sepse ajo përmban qëllime të larta dhe dispozita të drejta. Ajo është pastruesja e shpirtrave dhe nxitësja e tyre drejt përkushtimit për arritjen e çdo të mire dhe për largimin nga çdo e keqe. E si të mos ishte e tillë, kur dihet se ajo buron nga vetë Zoti, që përkujdeset për adhuruesit e Tij. Prej përkujdesjes së Tij të posaçme është edhe shpallja e Kur'ânit, i cili pastron dhe lartëson mendjet e shpirtrat. Me anë të tij, arrihet çdo mirësi e mbarësi, në dynja apo në ahiret.

- "...prandaj mos u bëj nga ata që dyshojnë" - Mos lejo të hyjë në zemrën tënde asnjë lloj dyshimi rreth vërtetësisë së Shpalljes. Përkundrazi, shtoji edhe më shumë përsiatjet mbi librin e Zotit tënd, që të shtosh edhe më tepër sigurinë që tashmë e ke. Meditimi i gjatë dhe i thellë mbi Kur'ânin ka për të larguar çdo lloj dyshimi.

- "Çdokush ka një drejtim, të cilit i përkushtohet." – Kuptimi: Çdo populli, të cilit i kemi zbritur rregulla për të zbatuar, i kemi përcaktuar një pikë nga e cila duhet të drejtohej gjatë kryerjes së adhurimeve.

Përcaktimi i Kiblës së adhurimeve është nga ato lloj ligjesh, që e pranojnë anulimin dhe ndryshimin, në varësi të kohës dhe situatës. Duhet kuptuar që, çështja themelore dhe më e rëndësishme është nënshtrimi dhe bindja ndaj urdhrave dhe dispozitave të Zotit. Njeriu duhet t'i nënshtrohet dhe bindet Krijuesit të tij, në çdo kohë, dhe duhet të synojë gjithmonë afrimin tek Ai me punë të mira. Vetëm kjo i mundëson njeriut lumturinë në të dyja jetët. Çdokush që e humb këtë mundësi dhe nuk stoliset me të tilla cilësi, është i destinuar të dëshpërohet në këtë jetë dhe në jetën tjetër të pasosur. Bindja ndaj urdhrave të Zotit është e vetmja mundësi shpëtimi. Kjo është pohuar nga të gjitha Shpalljet hynore dhe të gjithë janë të një mendimi për këtë çështje. Madje, shkaku pse Allahu i Lartësuar i krijoi krijesat është nënshtrimi dhe bindja ndaj Tij. Më tej, i Madhëruari urdhëron dhe thotë:

- "Garoni në vepra të mira" - Allahu i Lartësuar urdhëron për të garuar me punë të mira. Ky urdhër kërkon më shumë sesa thjesht të kryejmë vepra të mira, sepse garimi nënkupton edhe përpjekjen për t'i kryer ato në formën më të plotë e më të bukur.

Kush garon në këtë jetë për të bërë punë të mira do të jetë i pari që do të shijojë kënaqësinë e Xhenetit në ahiret. Ai do të arrijë i pari në të. Garuesit do të kenë gradat më të larta në atë botë.

Fjala "*ħajrât*" (vepra të mira) i përfshin të gjitha llojet e veprave të mira, qofshin ato të detyrueshme apo vullnetare, qofshin ato namaze, agjërime, sadaka, haxh, xhihad në rrugën e Allahut etj. Ajo përfshin çdo punë të mirë, qoftë mirësia e saj vetëm për vepruesin apo edhe për të tjerët.

Duke qenë se nxitësi më i madh për të garuar në punë të mira është shpërblimi i përgatitur tek Allahu, ajeti vijon:

- "Kudo që të jeni, Allahu ka për t'ju tubuar të gjithëve. Allahu është i Plotpushtetshëm për gjithçka." - Nuk ka dyshim se Allahu i Lartësuar ka për t'i grumbulluar të gjitha krijesat Ditën e Gjykimit, për t'i shpërblyer ato, me drejtësinë dhe bamirësinë e Tij, për gjithçka që kanë bërë në dynja. Çdokush do të marrë shpërblimin për aq sa ka punuar.

Në suren Nexhm, ajeti 31, i Lartësuari thotë: "Allahut i përket gjithçka që gjendet në qiej dhe në tokë, për t'i dënuar ata që bëjnë keq, sipas veprave të veta, e për t'i shpërblyer ata që bënë mirë, me shpërblimin më të mirë." Ky ajet është argument dhe nxitës për të kryer çdo adhurim në formën dhe mënyrën më të mirë, si për shembull, falja e namazit sapo hyn koha e tij, kryerja pa vonesë e agjërimit të ditëve të mbetura nga Ramazani, kryerja e haxhit, dhënia e zekatit në kohën e tij të përcaktuar. Përkryerja e adhurimit farz nënkupton edhe plotësimin e tij me anë të adhurimeve vullnetare. Kështu, mangësitë e namazeve farze i plotësojnë namazet vullnetare, e kështu me radhë.

Subhanallah! Sa madhështor është ky ajet! Sa i dobishëm është ai për adhuruesit!!

Ajetet 149 – 150

149. Ngado që të shkosh, ktheje fytyrën tënde drejt Xhamisë së Shenjtë! Me të vërtetë, kjo është e vërteta e sigurt nga Zoti yt. Allahu nuk është i pavëmendshëm ndaj asaj që ju veproni.
150. Ngado që të shkosh, ktheje fytyrën tënde drejt Xhamisë së Shenjtë! Kudo që të gjendeni, kthejini fytyrat tuaja drejt saj, që njerëzit të mos kenë argument kundër jush, përveç atyre që janë të padrejtë. Megjithatë, ju mos u frikësoni prej atyre, por frikësohuni vetëm prej Meje, që Unë ta përsos mirësinë Time ndaj jush dhe që ju të gjeni rrugën e drejtë.

Shpjegimi i ajeteve

- "Ngado që të shkosh, ktheje fytyrën tënde drejt Xhamisë së Shenjtë!" - Kudo qofsh, o

Profet i Zotit, në vendin tënd, gjatë udhëtimeve etj., drejtohu nga ana e Xhamisë së Shenjtë, Qabes!

Pastaj i Madhëruari i drejtohet umetit në përgjithësi.

- "Me të vërtetë, kjo është e vërteta e sigurt nga Zoti yt." - Fjalia ka dy përforcues: "*inne*" (me të vërtetë) dhe pjesëzën "*le*" tek "*lel ĥaḳḳu*" (e vërteta e sigurt).

Këtë përforcim e ka bërë që të mos mbetet në zemër asnjë dyshim rreth të vërtetës së sjellë nga Zoti, si edhe për të siguruar besimtarët se ky është një urdhër që duhet zbatuar me përpikmëri, dhe nuk është një punë e lënë në dëshirën e adhuruesit.

- "Allahu nuk është i pavëmendshëm ndaj asaj që ju veproni" – Allahu është Vështruesi i veprave dhe i gjendjeve tuaja, prandaj kujtojeni gjithmonë këtë mbikëqyrje, duke zbatuar urdhrat e Tij dhe duke iu larguar ndalesave të Tij. Ai nuk është i pavëmendshëm ndaj veprave tuaja, por për to do të merrni shpërblimin e plotë dhe me drejtësi: e mira me të mirë dhe e keqja me të keqe. Më tej, Allahu i Lartësuar thotë:

- "Ngado që të shkosh, ktheje fytyrën tënde drejt Xhamisë së Shenjtë! Kudo që të gjendeni, kthejini fytyrat tuaja drejt saj, që njerëzit të mos kenë argument kundër jush..." – Kuptimi: Këtë dispozitë (urdhrin për tu kthyer drejt Qabes) e sollëm, me qëllim që të ndërpritet çdo lloj kundërshtimi ndaj jush, prej idhujtarëve apo prej ithtarëve të Librit, çifutë e të krishterë qofshin.

Nëse do të mbetej si Kible xhamia në Palestinë, të dyja grupet kundërshtare do të kundërshtonin. Kështu, ithtarët e Librit do të kundërshtonin, sepse ata e kishin të shkruar në librat e tyre se Kibla e Profetit të fundit do të ishte Qabja. Ndërsa idhujtarët arabë do të kundërshtonin, sepse Qabja ishte lavdia e tyre. Ata e quanin veten "pasardhës të Ibrahimit dhe të Ismailit", dhe nëse Profeti (s.a.u.s.) do të vazhdonte të drejtohej drejt xhamisë në Palestinë, kjo do të konsiderohej për ta si shpërfillje e lavdisë së të parëve të tyre. Nëse Muhamedi (s.a.u.s.) nuk do të drejtohej nga Qabja, ata do të thonin: "Si pretendon ai se është pasues i fesë së Ibrahimit dhe nga pasardhësit e tij, ndërkohë që nuk drejtohet nga Shtëpia e Zotit, të ndërtuar nga vetë Ibrahimi?!"

Vetëm këto dy lloj kundërshtimesh mund të merreshin në konsideratë, prandaj ia vlente një përgjigje për ta. Ndërsa të tjerët, të cilët kundërshtonin pa u mbështetur askund, nuk meritonin asnjë vëmendje. Me fjalë të tjera, këto argumente nga Zoti vlenin vetëm për ata që kërkonin të vërtetën, ndërsa për ata që kërkonin të arrinin veçse qëllimet dhe dëshirat e tyre të sëmura, ato nuk bënin dobi, siç thotë i Lartësuari:

- "...përveç atyre që janë të padrejtë." – Pra, këta njerëz nuk mund të përfitojnë nga faktet dhe provat e sjella, sepse ata nuk e duan sqarimin e të vërtetës. Për të tillët nuk ia vlen të shqetësohesh dhe as të kesh frikë, siç thotë i Lartësuari:

- "Megjithatë, ju mos u frikësoni prej atyre, por frikësohuni vetëm prej Meje" – Arsyeja është se "argumentet" e tyre janë boshe dhe të destinuara të hidhen poshtë. Si të tillë, ata nuk ngjallin respekt në zemrat e atyre që i dëgjojnë. Ndërsa ai që flet të vërtetën, fiton autoritet e respekt te çdokush që e sheh dhe e dëgjon.

Ky urdhër i Allahut të Lartësuar është një begati e madhe prej Tij, sepse çdo mirësi e ka zanafillën te frikë-respekti ndaj Allahut. Ai që nuk i frikësohet shikimit të Allahut, nuk mund të frenohet nga poshtërsitë prej asgjëje tjetër. Asgjë tjetër nuk mund ta bëjë atë t'i bindet urdhrave të Zotit të Tij.

Kthimi i muslimanëve drejt Qabes ngjalli polemika të shumta, të cilat u nxitën nga ithtarët e Librit, munafikët dhe idhujtarët. Ata i nxisnin bisedat rreth kësaj teme, duke hedhur herë pas here dyshimet dhe helmet e tyre.

Për këtë arsye, Allahu i Lartësuar e shtjelloi gjerësisht këtë çështje në Librin e Tij. Ai e përforcoi gjykimin e Tij me disa elementë, të cilët u përmendën më lart, por dhe me disa të tjerë, që do tregohen më poshtë.

Një element i tillë përforcues është, për shembull, përsëritja e kësaj dispozite tri herë, edhe pse një herë do të ishte e mjaftueshme. Po ashtu, zakonisht, urdhrat e Allahut të Lartësuar ose i drejtohen Profetit (a.s.), dhe nëpërmjet tij nënkuptohet i tërë umeti, ose i drejtohen umetit në përgjithësi. Në këtë rast, Allahu i Lartësuar i përdor të dyja mënyrat, si mjet përforcues, edhe pse do të mjaftonte vetëm njëra. Kështu, Ai i drejtohet fillimisht Profetit (a.s.): "Ngado që të shkosh, ktheje fytyrën tënde drejt Xhamisë së Shenjtë!" Pastaj i drejtohet edhe umetit në përgjithësi: "Kudo që të gjendeni, kthejini fytyrat tuaja drejt saj".

Allahu i Lartësuar u ktheu përgjigje të gjitha dyshimeve të hedhura nga mohuesit, duke i sqaruar ato një për një, dhe kjo tregon për rëndësinë e madhe të kësaj çështjeje. Ai preu çdo shpresë të mohuesve se Muhamedi (a.s.) do të ndiqte Kiblën e ithtarëve të Librit, dhe ky është, gjithashtu, element përforcues.

Përforcues tjetër gjendet edhe te thënia: "Me të vërtetë, kjo është e vërteta e sigurt nga Zoti yt." Do të mjaftonte lajmi i madh i Allahut të Lartësuar për ndryshimin e Kiblës, që kjo dispozitë të zbatohej menjëherë dhe pa ngurrim. E, megjithatë, Allahu i Lartësuar i thotë këto fjalë, për të siguruar njerëzit se kjo qe një e vërtetë prej Atij.

Element tjetër përforcues është edhe një informacion i sjellë prej Atij, që është Njohësi i të fshehtave. Allahu i Lartësuar lajmëroi se Kibla e Profetit të fundit të botës ishte pikërisht ajo për të cilën Ai i urdhëroi besimtarët, por mohuesit e fshehën dhe e mohuan padrejtësishit një gjë të tillë.

Kjo dispozitë ishte shprehje e dashurisë dhe e mëshirës së Allahut të Lartësuar për këtë umet. Ai e deklaron një fakt të tillë, kur tregon qëllimin e saj:

- "...që Unë ta përsos mirësinë Time ndaj jush..." - Mirësitë e Allahut ndaj këtij umeti do të vazhdojnë të ndjekin njëra tjetrën, përjetësisht. Në themel të tyre qëndron udhëzimi për të pranuar fenë e Tij të drejtë, të cilën e sqaroi nëpërmjet Profetit të Tij të fundit dhe Librit që i shpalli atij. Ky është burimi i çdo mirësie të këtij umeti të ekuilibruar, të cilat janë plotësuese të mirësisë kryesore, të shumta në numër dhe mjaft të larmishme.

Për mirësinë e Tij ndaj profetit Muhamed dhe umetit të tij, Allahu i Lartësuar thotë: Sot *(ditën e Arafatit)*, u dëshpëruan ata që mohuan *(Allahun dhe Profetin)* dhe e humbën çdo shpresë, që t'ju largojnë prej fesë suaj. Mos u frikësoni prej tyre, por vetëm Mua mu frikësoni! Sot e përsosa për ju fenë tuaj, e plotësova dhuntinë Time ndaj jush dhe u kënaqa që Islami të jetë feja juaj. [Maide 3].

I lavdëruar qoftë Allahu, për mirësitë dhe begatitë e panumërta që na ka dhuruar, të cilat ne nuk mundemi as t'i numërojmë, e jo më ta falënderojmë aq sa Ai e meriton.

- "...dhe që ju të gjeni rrugën e drejtë." - Kjo na tregon një tjetër arsye të ligjërimit të këtyre dispozitave. Pra, Allahu i Lartësuar i caktoi këto rregulla, me qëllim që ne të udhëzohemi në rrugën e drejtë.

Udhëzimi arrihet veçse duke njohur të vërtetën e sjellë prej Zotit dhe duke e zbatuar atë. Allahu i Lartësuar, me mëshirën e Tij të pamatë, ua ka lehtësuar njerëzve rrugën e udhëzimit dhe gjithmonë i nxit ata për ta ndjekur atë. Ai ua ka qartësuar të vërtetën plotësisht, në mënyrën më të plotë. Madje, për ta ndriçuar sa më mirë të vërtetën, Allahu i Lartësuar ka përcaktuar që të padrejtët të shfaqin dyshime, të cilat Ai ua shpjegon më pas adhuruesve të Tij. Nga debatet e kundërshtimet, Allahu ka përforcuar shenjat e Profetit të Tij dhe i ka nxjerrë fytyrën gënjeshtrës.

Nëse pasuesit e të kotës nuk do të polemizonin, ndoshta çështjet do të mbeteshin të panjohura në hollësitë e tyre për shumë njerëz. Allahu i Urtë dhe i Ditur e nxjerr të vërtetën në pah me urtësinë dhe dijen e Tij. Çështjet qartësohen më mirë kur ballafaqohen me të kundërtat e tyre. Po të mos ishte nata, nuk do të kuptohej plotësisht dobia e ditës. Po të mos ekzistonte e shëmtuara, nuk do të konceptohej e bukura. Po të mos ishte errësira, si do të njihej drita? Nëse nuk do të shfaqej e kota, edhe e vërteta nuk do të zbulohej plotësisht.

Allahu qoftë i lavdëruar për këto mirësi!

Ajetet 151 – 152

151. Ashtu siç dërguam mes jush një profet nga gjiri juaj, që t'ju lexojë ajetet Tona, që t'ju pastrojë, t'ju mësojë Librin dhe Urtësinë, dhe t'ju mësojë atë që nuk e dini.
152. Më përkujtoni, që edhe Unë t'ju kujtoj. Më falënderoni e mos më mohoni!

Shpjegimi i ajeteve

Në këto ajete, Allahu i Lartësuar na kujton se dispozita për Kiblën, plotësimi i begative të Tij ndaj nesh dhe udhëzimi në rrugën e drejtë nuk janë as mirësitë e para e as të fundit që Ai u ka falur adhuruesve të Tij.

- "Ashtu siç dërguam mes jush një profet nga gjiri juaj..." – Pra, mirësitë e lartpërmendura janë të ngjashme me mirësinë e dërgimit të një Profeti nga mesi juaj. Allahu i Lartësuar kujdeset për adhuruesit e Tij, duke u falur mirësitë themelore në fillim, dhe duke vazhduar më tej me mirësitë plotësuese.

Më e madhja mirësi ishte pikërisht përzgjedhja e një Profeti nga mesi i tyre. Ai zgjodhi një Profet, të cilit ata ia dinin prejardhjen dhe përkatësinë farefisnore. Kështu, ata ishin të sigurt për sinqeritetin dhe pastërtinë e tij si njeri, pasi ata e njihnin atë si besnik, të ndershëm, të moralshëm dhe të urtë.

Po përse u dërgua ai Profet? Thotë i Lartësuari:

"...që t'ju lexojë ajetet Tona..." – Domethënë, ajetet kur'ânore dhe çdo fjalë tjetër të sjellë prej Allahut.

Shpjegimi: Profeti i fundit ju lexon juve gjithçka, nëpërmjet së cilës ju do të dalloni të vërtetën nga e kota. Nëpërmjet Shpalljes, ju do të dalloni rrugën e drejtë nga e gabuara.

Shpallja hyjnore ju sqaroi fillimisht njëshmërinë e Allahut dhe faktin se Ai është i Vetmi që meriton adhurimet tuaja. Nëpërmjet saj, ju u siguruat plotësisht rreth sinqeritetit dhe vërtetësisë së Profetit të Zotit, dhe e kuptuat domosdoshmërinë e besimit dhe të pasimit të rrugës së tij. Po nëpërmjet Shpalljes, ju mësuat ligjin e jetës, të cilin duhet ta zbatoni derisa të takoni Krijuesin tuaj. Ajo ju njohu me gjithçka që ju pret dhe për Ditën e Premtuar. Ajo ju pajisi me *jaḳîn*-in, me sigurinë e plotë në premtimin e Zotit, e cila është nxitësja e çdo të mire. Më tej:

- "...që t'ju pastrojë" – T'ju pastrojë moralin nga çdo cilësi e ulët dhe shpirtin nga çdo gjë e keqe. Allahu do t'ju pastrojë nga idhujtaria, dhe do t'jua mbushë zemrën me teuhid, fillimisht, pastaj do t'ju pastrojë nga cilësitë e këqija, dhe do t'ju pajisë me virtyte të larta. Këto do të bëhen nëpërmjet Profetit dhe mësimeve të tij.

Allahu do t'ju nxjerrë nga idhujtaria në teuhid, nga mashtrimi në sinqeritet, nga tradhtia në besnikëri, nga mendjemadhësia në modesti, nga morali më i ulët në moralin më të lartë. Ai do t'ju shpëtojë nga armiqësia dhe urrejtja që keni ndaj njëri-tjetrit, dhe do t'ju fusë në miqësi dhe dashuri mes jush.

Mirësi tjetër që Allahu i Lartësuar u bëri adhuruesve nëpërmjet Vulës së profetëve, ishte edhe mësimi i Librit dhe Urtësisë, siç thotë Ai:

- "...t'ju mësojë Librin dhe Urtësinë" - Libri është Kur'âni. Domethënë, Profeti do

t'ju mësojë të lexoni Kur'ânin dhe të kuptoni brendinë e tij.

Por ai do t'ju mësojë edhe atë që quhet *ĥikmet*-in, domethënë urtësinë. Siç kanë thënë disa dijetarë, qëllimi me këtë fjalë është Suneti ose Tradita profetike. Ndërsa disa të tjerë janë të mendimit se fjala "*ĥikmet*" nënkupton hollësitë e Sheriatit të zbritur nga Allahu i Lartësuar. Kështu, sipas tyre, kuptimi është: Nëpërmjet Profetit, ju do të aftësoheni që, përveç kuptimit të Kur'ânit dhe të Sunetit, të cilët përfshihen në fjalën "Libër", ju do të mësoni edhe imtësitë e ligjit hyjnor, duke i dhënë çdo gjëje vendin e vet.

Me kuptimin e dytë, fjala 'Libër' përfshin Kur'ânin dhe Sunetin. Edhe kjo mundësi është e saktë, sepse Tradita profetike është plotësuese dhe shpjeguese e Kur'ânit.

- "...dhe t'ju mësojë atë që nuk e dini" - Para ardhjes së Profetit të fundit, njerëzit ishin të paditur dhe në humbje të thellë. Ata nuk e njihnin të vërtetën dhe as nuk punonin sipas saj, prandaj çdo mësim i vyer dhe çdo vepër e mirë që ka arritur ky umet, është rezultat dhe fryt i ardhjes së Profetit të nderuar.

Profeti (s.a.u.s.) është mirësia më e madhe që Allahu i Lartësuar u ka falur adhuruesve të Tij, e cila e bën të detyrueshme mirënjohjen e tyre ndaj Tij.

Më tej, i Madhëruari thotë:

- "Më përkujtoni, që edhe Unë t'ju kujtoj." - Në këtë ajet, Allahu i Lartësuar na urdhëron që ne ta përkujtojmë vazhdimisht Atë. Nëse e bëjmë këtë, atëherë Ai na ka premtuar shpërblimin më të madh që mund të ëndërrojë një adhurues: "...që edhe Unë t'ju kujtoj".

Profeti (s.a.u.s.) përcjell tek ne këto fjalë të Allahut të Lartësuar dhe Bujar, që thotë: *"Atë që më përkujton Mua në veten e Tij, Unë e përkujtoj atë në veten Time. Atë që më përkujton Mua në një grup njerëzish, Unë e kujtoj atë në një grupim më të mirë se ai".*

Përkujtimi më i plotë dhe më i mirë i adhuruesit për Zotin e tij është ai që bëhet me gjuhë dhe zemër bashkë. Ky lloj përkujtimi shton në zemër njohjen dhe dashurinë për Allahun e Lartësuar. Për këtë arsye, Allahu i Lartësuar e shpërblen atë njeri me mirësi të shumta.

Përkujtimi i Allahut të Lartësuar është kushti kryesor për t'u treguar mirënjohës ndaj Tij, prandaj Allahu i Lartësuar urdhëron veçanërisht për përkujtimin, dhe pastaj urdhëron përgjithësisht për mirënjohje ndaj Tij.

Në vijim, i Lartësuari thotë:

- "Më falënderoni..." – Kuptimi: Jini mirënjohës për mirësitë që ju kam dhuruar dhe për të këqijat që ju kam larguar.

Mirënjohja bëhet me zemër, me fjalë dhe me vepra. Mirënjohja me zemër bëhet duke i pranuar plotësisht dhe me përulje mirësitë e Zotit. Mirënjohja me fjalë bëhet duke e falënderuar dhe duke e lavdëruar Allahun e Lartësuar. Mirënjohja me vepra bëhet duke i kryer ato si bindje ndaj Krijuesit dhe ndaj urdhrave të Tij dhe duke iu larguar ndalesave të Tij.

Nëse robi tregon vërtet një mirënjohje të tillë, ai garantohet për dy gjëra:

1. Ruajtja e paprekur e mirësive, të cilat i zotëron.

2. Shtimi i mirësive ekzistuese dhe i të mirave që ende nuk i zotëron.

I Lartësuari thotë: "Dhe *(përkujtoni)* kur Zoti juaj njoftoi: "Nëse falënderoni, Unë do t'jua shtoj *(të mirat)*, e nëse mohoni, s'ka dyshim se dënimi Im është i ashpër!" [Ibrahim, 7]. Nga ky urdhër që Allahu i Lartësuar u jep adhuruesve, për të qenë mirënjohës ndaj Tij, pas përmendjes së mirësive që u përmendën më sipër, kuptojmë që ato janë mirësitë më të mëdha për të cilat duhet falënderuar Allahu i Lartësuar. Me fjalë të tjera, urdhri për të qenë mirënjohës, tregon se mirësitë e lartpërmendura janë shumë të mëdha.

A ka mirësi më të madhe se dija që Allahu i Lartësuar i dhuroi këtij umeti, me anë të së cilës lartësohen dhe pastrohen mendja, trupi dhe shpirti?! Allahu jo vetëm që i pajisi me këtë dije të dobishme, por edhe u dha sukses që të veprojnë dhe të jetojnë sipas saj. E pra, kjo është mirësia më e madhe, e cila kurrë nuk zhduket, edhe nëse ikën çdo lloj mirësie tjetër. Prandaj është detyrë për këdo, të cilit Allahu i Lartësuar i dhuroi këtë dije dhe i dha sukses që të punojë dhe të jetojë sipas saj, që ta falënderojë Atë pareshtur. Duke falënderuar Allahun, mirësitë e Tij ruhen, dhe jo vetëm kaq, por edhe shtohen më tepër. Mirënjohësve, Allahu i Lartësuar ua shton mirësitë dhe i ruan nga sëmundja e vetëkënaqësisë.

Duke qenë se mirënjohja është e kundërta e mohimit, Allahu i Lartësuar thotë:

- "...e mos më mohoni!" - Fjala *"kufr"* (mohim) është përdorur këtu përballë fjalës *"shukr"* (mirënjohje). Pra, është fjala për mohimin e mirësive dhe mosmirënjohjen ndaj tyre. Por ka mundësi që fjala "mohim" të jetë sjellë me një kuptim më të gjerë, në të cilin hyn mohimi i Zotit dhe të gjitha llojet e tjera të poshtërsive dhe të mosmirënjohjes. Në këtë vështrim, Allahu i Lartësuar na i ka ndaluar të gjitha llojet e mohimit.

Ajetet 153 - 157

153. O ju që keni besuar! Kërkoni ndihmë me durim dhe me namaz! Vërtet, Allahu është me durimtarët.
154. Për ata që u vranë në rrugën e Allahut, mos thoni: "Janë të vdekur!" Jo, ata janë të gjallë, por ju nuk e kuptoni.
155. Ne patjetër që do t'ju sprovojmë ndonjëherë me frikë, me uri, me humbje në pasuri ose në njerëz, dhe me pakësim të prodhimit. Por ti përgëzoji durimtarët,
156. të cilët, kur i godet ndonjë sprovë, thonë: "Ne, pa dyshim, jemi të Allahut, dhe vetëm tek Ai do të kthehemi!".
157. Vetëm këta kanë tek Zoti i tyre bekime dhe mëshirë, dhe vetëm këta janë të udhëzuarit në rrugën e drejtë.

Shpjegimi i ajeteve

- "O ju që keni besuar! Kërkoni ndihmë me durim dhe me namaz!" - Allahu i Lartësuar i urdhëron besimtarët që, në të gjitha çështjet fetare ose të kësaj dynjaje, të kërkojnë ndihmë dhe zgjidhje me anë të dy mënyrave: me durim dhe me namaz.

Durimi do të thotë ta nënshtrosh veten që të pranojë ato gjëra që ajo i urren. Në fakt, ka tri lloje durimi:

1. Durimi që tregohet në bindjen ndaj Allahut të Lartësuar, derisa të zbatosh çdo urdhër të Tij.

2. Durimi që duhet të tregojmë për t`u larguar nga haramet dhe për të mos shkelur kufijtë e Allahut.

3. Durimi gjatë ngjarjeve të dhimbshme, të cilat Allahu i Lartësuar i ka përcaktuar për ne, duke i pranuar ato me zemër të kënaqur dhe duke mos shprehur as më të voglin zemërim rreth tyre.

Durimi është ndihma më e madhe për të arritur gjithçka. Të paduruarit nuk kanë asnjë rrugë për të arritur objektivat e tyre, sidomos kur bëhet fjalë për nënshtrimin e vetes në kryerjen e adhurimeve të vazhdueshme, të cilat janë të vështira për shpirtin. Ato nuk mund të kryhen pa qenë i pajisur me durim, që shërben për të kapërcyer çdo moment vështirësie. Nëse adhuruesi është sistematik në durimin që tregon, do të arrijë çdo pikësynim dhe do të shpëtojë nga çdo gjë së cilës i druhet. Por nëse ai e lëshon veten para vështirësive dhe vuajtjeve që shkakton durimi, do t'i humbasë të gjitha.

E njëjta gjë mund të thuhet edhe për largimin nga ndalesat e Allahut të Lartësuar. Vërtet ato janë shumë të vështira për t'u përballuar, por kjo nuk do të thotë që është e pamundur. Prej tyre mund të largohesh vetëm duke patur shumë durim, i cili arrihet

duke iu mbështetur Allahut të Madhëruar dhe duke kërkuar ndihmën e Tij.

Të tilla janë edhe fatkeqësitë ose vuajtjet që Zoti ka përcaktuar për njeriun. Vështirësia e tyre shtohet sidomos kur ato zgjasin për një kohë të gjatë, sepse kjo shkakton dobësim të fuqisë trupore, shpirtërore dhe psikologjike, që nevojiten për të qenë të vazhdueshëm në durimin dhe kënaqësinë me caktimin e Allahut. Pas një kohe të gjatë sprovash, shpeshherë, njeriu shpërthen në pakënaqësi dhe ankesa, të cilat janë shprehje e durimit të dobët dhe mospranimit të caktimit të Allahut.

Si përfundim, nëse njeriu nuk pajiset me durim, duke iu mbështetur Allahut, duke iu drejtuar vetëm Atij për gjithçka që e shqetëson dhe duke i shprehur Atij varfërinë dhe nevojën e tij për ndihmën dhe çlirimin e Allahut, atëherë është e pamundur që ai t'i kalojë sprovat me sukses. Pra, nga ky ajet kuptohet që robi e ka të domosdoshme të pajiset me durim, në çdo kohë dhe në çdo gjendje.

Allahu i Lartësuar ka urdhëruar që ta kultivojmë durimin dhe na ka treguar se Ai është në krah të durimtarëve:

- "Vërtet, Allahu është me durimtarët". – Domethënë, Allahu është me ata, për të cilët durimi është bërë një cilësi e pandashme, një virtyt i përhershëm, por që, sigurisht, është fituar me ndihmën e Allahut të Lartësuar dhe Bujar. Me durimin e dhuruar, atyre u lehtësohet çdo mundim: çdo fatkeqësi e madhe, për ta bëhet e vogël.

Allahu i Lartësuar thotë se është me durimtarët. Kjo prani është e posaçme vetëm për ta dhe shoqërohet me dashurinë, ndihmën, udhëzimin, suksesin dhe fitoren që Allahu i Lartësuar u fal atyre. Sikur durimtarët të mos kishin shpërblim tjetër përveç këtij afrimiteti të Allahut të Lartësuar, kaq do të mjaftonte si privilegj për ta. Ky është njëri lloj i aferësisë së Zotit me krijesat, domethënë "afërsia e posaçme".

Ndërsa lloji i dytë është "afërsia e përgjithshme", që tregon se Allahu i Lartësuar është pranë krijesave në përgjithësi, me dijen dhe pushtetin e Tij absolut, sikurse thotë Ai në suren Hadidë: "Ai është afër jush kudo që të jeni...".

Më tej, Allahu i Lartësuar na ka urdhëruar që të kërkojmë ndihmë edhe me namaz, sepse namazi është shtylla e fesë dhe drita e besimtarëve. Ai është lidhja e fortë mes adhuruesit dhe Zotit të Tij.

Kur namazi i adhuruesit është i plotë në të gjitha aspektet, qoftë në veprime apo fjalë, dhe nëse ai është i pranishëm në namaz me zemrën e tij, duke e ndier thellësisht se po del përpara Krijuesit dhe duke qenë përqendruar totalisht në lutjet e tij, atëherë një namaz i tillë bëhet patjetër një ndihmë e jashtëzakonshme për këdo që kërkon ndihmë dhe mbështetje. Ky lloj namazi të ndalon, gjithashtu, nga çdo fjalë dhe vepër e shëmtuar, nga njëra anë, dhe të nxit për të kryer çdo urdhër të Zotit, nga ana tjetër.

- "Për ata që u vranë në rrugën e Allahut, mos thoni: "Janë të vdekur!"" - Pasi urdhëroi që për çdo çështje të kërkojmë ndihmë dhe zgjidhje me durim, Allahu i Lartësuar sjell një rast konkret, për të cilin duhet të kërkojmë ndihmë me durim: xhihadi në rrugën e Tij.

Xhihadi është ndër veprat më të vështira për trupin dhe për shpirtin, nga njëra anë, dhe një nga adhurimet më të larta që njeriu mund të bëjë për Zotin e Tij, nga ana tjetër. Ai është shumë i vështirë të kryhet, sepse mund të të çojë në humbjen e jetës, e cila është shumë e dëshirueshme për njeriun.

Çdo gjë që bën njeriu nuk është gjë tjetër, por veçse përpjekje për të zbukuruar jetën dhe për të shmangur çdo pakënaqësi të saj. Sigurisht që asnjë i mençur nuk do të hiqte dorë nga kjo gjë kaq e shtrenjë, nëse nuk do të shkëmbehej me diçka tjetër akoma më të shtrenjtë. Kështu, Allahu i Lartësuar na ka treguar se kush lufton për lartësimin e fjalës së Allahut dhe që në tokë të adhurohet


vetëm Allahu i Lartësuar, atëherë, edhe nëse vdes në luftë, ai do të fitojë një jetë shumë herë më të mirë dhe begati shumë herë më të mëdha. Jeta tjetër do të jetë shumë herë më e shtrenjtë sesa jeta e sakrifikuar për Zotin e Tij dhe shumë herë më e mirë sesa mund të përfytyrohet.

- "Jo, ata janë të gjallë, por ju nuk e kuptoni." – Allahu i Lartësuar e përshkruan më hollësisht gjendjen e tyre në një ajet tjetër: "Kurrsesi mos thoni për ata që kanë rënë dëshmorë në rrugën e Allahut: "Kanë vdekur". Përkundrazi, ata janë të gjallë tek Zoti i tyre, duke u ushqyer. Ata janë të gjëzuar me të mirat që u ka dhënë Allahu, dhe i përgëzojnë ata që ende nuk u janë bashkuar radhëve të tyre, se për ta nuk do të ketë frikë dhe as nuk do të brengosen. Ata janë të gjëzuar me mirësinë e Allahut, sepse Allahu nuk ua humb shpërblimin besimtarëve." [Al Imran, 169-171].

E ku ka më të mirë se jeta pranë Krijuesit, pranë Allahut të Lartësuar?! Trupi i tyre kënaqet me ushqim, pije dhe gjëra të tjera, ndërsa shpirti përjeton lumturinë e përhershme, pasi kanë harruar çdo lloj frike dhe brenge.

Kjo është jeta e dëshmorëve në jetën e varrit (*berzah*), e cila është, pa dyshim, më e mirë se jeta e dynjasë. Profeti (s.a.u.s.) na e ka përshkruar jetën e tyre në një hadith, ku thuhet se shpirtrat e dëshmorëve që vriten në rrugën e Zotit qëndrojnë brenda disa zogjve jeshilë dhe shëtisin nëpër Xhenet, ku hanë, pinë dhe shijojnë mirësitë e dhuruara nga Zoti i tyre. Ata shëtisin nëpër lumenjtë e Xhenetit, hanë prej frutave të tij, për t'u kthyer pastaj dhe për t'u prehur në disa kandilë të varur nën Fronin e Allahut të Lartësuar.

Ky ajet është nga nxitësit më të fortë të xhihadit në rrugën e Zotit dhe për durimin gjatë tij. Nëse adhuruesit e dinë se çfarë është përgatitur për luftëtarët në rrugën e Zotit, atëherë askush nuk do t'ia lejonte vetes të mbetej mbrapa në këtë drejtim. Në



të kundërt, kur dija për këtë çështje është e pakët ose mungon, ulet dhe vullneti për t'u përpjekur në këtë rrugë dhe dobësohet durimi për hir të Zotit. Kjo dobësi ia shton akoma më tepër gjumin të fjeturve.

Si pasojë, plogështia në këtë aspekt bëhet shkak që njeriut t'i shpëtojnë nga duart shumë mirësi. E si të mos jetë kështu, kur Allahu i Lartësuar thotë në ajetet e mëposhtme:

"Allahu bleu prej besimtarëve shpirtrat dhe pasurinë e tyre për t'u dhënë Xhenetin. Ata luftojnë në rrugën e Allahut, vrasin dhe vriten. Ky është një premtim të cilin Ai e vërtetoi në Teurat, Ungjill dhe Kur'ân. E kush është zbatues më i sigurt i premtimit të vet sesa Allahu?! Pra, gëzojuni tregtisë që e bëni me Të! Ky është suksesi i madh". [Teube, 111].

"Pa dyshim, ata të cilët besuan, ata që u shpërngulën dhe që luftuan në rrugën e Allahut, ata vërtet shpresojnë në mëshirën e Tij. Allahu është Falës dhe Mëshirues." [Bekare, 218].

"Dilni *(në luftë)*, qoftë ajo e lehtë ose e rëndë! Luftoni për hir të Allahut me pasurinë dhe me veten tuaj! Kjo është gjëja më e dobishme për ju, nëse e kuptoni." [Teube, 41].

"O ju që keni besuar, a t'ju tregoj për një tregti të bujshme, që ju shpëton prej një dënimi të dhembshëm: T'i besoni Allahut dhe të Dërguarit të Tij, dhe të luftoni në rrugën e Allahut me pasurinë dhe veten tuaj. Kjo është shumë herë më e dobishme për ju, nëse e dini. Ai *(Allahu)* ju fal gjynahet tuaja, ju fut në Xhenete, nëpër të cilët rrjedhin lumenj, dhe në pallate të bukura, në Xhenetet e amshueshme, - që është suksesi më i madh, - por *(ju jep)* edhe gjëra të tjera që ju i dëshironi, si ndihmë prej Allahut dhe fitore e afërt. E pra, përgëzoji besimtarët!" [Saf, 10-13].

"Allahu do të sjellë një popull që Ai e do *(atë popull)* dhe ata e duan Atë. Një popull që janë modestë dhe të butë ndaj besimtarëve, por të ashpër dhe të fortë ndaj mohuesve, që lufton në rrugën e Allahut dhe që nuk i frikësohet kërcënimit të asnjë kërcënuesi. Kjo cilësi *(e atij populli)* është dhuratë që Allahu ia jep atij që do. Allahu është Dhurues i madh dhe i Ditur." [Maide 54].

Betohem në Allahun e Madhëruar se, sikur njeriu të kishte një mijë shpirtra dhe të gjitha t'i jepte për hir të Zotit, nuk do të ishte shumë për të merituar këtë shpërblim të mrekullueshëm, të premtuar nga Allahu i Lartësuar. Për këtë arsye, dëshmorët, kur shohin dhe gëzojnë shpërblimin e përgatitur për ta, dëshirojnë që të kthehen përsëri në dynja dhe të bien sërish dëshmorë në rrugën e Zotit, dhe kjo të përsëritet disa herë.

Ky ajet vërteton jetën në *berzah*, me mirësitë apo ndëshkimet e saj. Ky fakt mbështetet edhe nga shumë dëshmi të përcjella prej Profetit (s.a.u.s.).

Allahu i Lartësuar na tregon se adhuruesit do të sprovohen gjithmonë me sprova dhe fatkeqësi, me qëllim që të dallohen të sinqertët nga shtirakët, durimtarët nga të paduruarit. Kjo është një normë e pandryshueshme e Allahut të Urtë, që patjetër do të zbatohet ndër njerëz. Nëse do të kishte vetëm mirësi e kënaqësi, atëherë nuk do të dalloheshin besimtarët e vërtetë nga shtirakët zullumqarë, dhe kjo përzierje do të ishte shumë e keqe. Me fjalë të tjera, sprovat nuk synojnë që t'u largojnë besimtarëve imanin që kanë apo t'i largojnë ata nga feja e Allahut të Lartësuar, por që të dallohen qartë të sinqertët, duke i ngritur edhe më lart në gradat e tyre, nga mashtruesit shtiracakë.

Më pas, Allahu i Lartësuar na njofton për fushat në të cilat Ai do të na sprovojë durimin dhe këmbënguljen tonë në bindjen ndaj Tij:

- "Ne patjetër që do t'ju sprovojmë ndonjëherë me frikë, me uri" – Sipas kuptimit të fjalëve (në arabisht), Allahu i Lartësuar thotë që do të na sprovojë me diçka të vogël prej atyre që quhen frikë e uri, e jo me plot kuptimin e tyre. Përndryshe, nëse do të na sprovonte me frikë apo uri të plotë, ne do të shfaroseshim. Por dihet që sprova synon të provojë durimin dhe bindjen ndaj Krijuesit, e jo të shkatërrojë, sepse atëherë do të quhej ndëshkim.

- "...me humbje në pasuri ose në njerëz, dhe me pakësim të prodhimit" – Humbjet në pasuri mund të vijnë nga shkaqe të ndryshme, si: përmbytjet, stuhitë, tërmetet, grabitjet nga hajdutët, bastistjet nga mbretërit e padrejtë etj.

Ndërsa humbja në njerëz nënkupton vdekjen e të dashurve të zemrës, të fëmijëve, të afërmve etj., ose sëmundjet që godasin këta njerëz.

Me humbjet në prodhimtari nënkuptohet pakësimi i fryteve dhe i prodhimeve të tokës, në të mbjella, pemëtari etj. Këto mund të bëhen nëpërmjet furtunave, breshërit, ngricave, rënies së zjarreve, sëmundjeve apo nga ndonjë formë tjetër ndëshkimi prej Allahut, si karkalecat etj. Këto sprova

patjetër që do të ndodhin, sepse ashtu ka thënë Allahu i Urtë.

Gjatë sprovave, njerëzit ndahen në dy grupe: durimtarë dhe jodurimtarë. Jodurimtarëve u ikin nga duart dy mirësi të mëdha pas këtyre sprovave: së pari, mirësia e shkatërruar nga fatkeqësia dhe, së dyti, shpërblimi i pamasë nëse do të tregoheshin të durueshëm. Domethënë, ata humbin si nga dynjaja, ashtu edhe nga ahireti, duke mos përmendur dobësimin e imanit. Ata nuk e kanë virtytin e durimtarit, që kënaqet dhe është mirënjohës ndaj Allahut për caktimet dhe vendimet e Tij, por, përkundrazi ata zemërohen me këto caktime.

Ata që Allahu i Lartësuar i ka pajisur me durim nuk zemërohen dhe nuk shfaqin pakënaqësi ndaj caktimit të Tij, as me fjalë dhe as me veprime, sepse ata mendojnë për shpërblimin që i pret tek Zoti i tyre për durimin e treguar, duke qenë të sigurt për këtë. Shpërblimi i Allahut është shumë herë më i madh sesa humbja e shkaktuar nga sprovat. Madje, ata i shohin këto sprova si mirësi prej Zotit, sepse nëpërmjet tyre arrihen gradat e larta. Kush respekton urdhrat e Zotit, fiton patjetër shpërblimin e Tij. Më tej, Allahu i Lartësuar thotë:

- "Por ti përgëzoji durimtarët..." – Pra, përgëzoji ata, se shpërblimi i tyre do të jetë pa masë. Këtë përgëzim e meritojnë veçse të duruarit, të cilët:

- "...kur i godet ndonjë sprovë, thonë: "Ne, pa dyshim, jemi të Allahut...". – Domethënë, ne jemi pronë e Tij dhe nën sundimin e Tij, që bazohet në drejtësi dhe mëshirë. Ne jemi të nënshtruar ndaj përcaktimit dhe urdhrave të Tij. Ne nuk kemi në pronësinë tonë asgjë, as pasuritë tona, madje as veten tonë. Kështu, nëse Mbretëruesi bën diçka me urtësinë e Tij, Ai vepron në pasurinë dhe në mbretërinë e Tij. Askujt nuk i takon ta kundërshtojë për atë që Ai vendos dhe përcakton në pronën e Tij.

Por duhet të dihet se Allahu është i Urti dhe i Mëshirshmi. Ai është më i mëshirshëm ndaj robërve të Tij sesa ata ndaj vetvetes. Kur adhuruesi mendon rreth këtij fakti, atëherë ai kënaqet për caktimin e Zotit dhe bëhet mirënjohës për të, pasi është i sigurt që ai është më i miri për të, ndonëse për momentin kjo mirësi nuk mund të duket. Robi e di, gjithashtu, se ai dhe pasuria e tij janë, në fakt, pronë e Allahut.

Më tej, Allahu i Lartësuar thotë:

- "...dhe vetëm tek Ai do të kthehemi!" – Pra, ne do të kthehemi tek Ai një ditë, patjetër. Ne do të takohemi me Allahun në Ditën e Premtuar, kur çdokush do të shpërblehet për veprat që ka bërë. Kështu, nëse tregohemi të duruar dhe llogarisim shpërblimin për çdo sprovë që na godet, atë ditë ne do të marrim shpërblimin, sikurse na ka premtuar Zoti ynë. E nëse zemërohemi dhe shfaqim pakënaqësi me caktimin e Allahut, atëherë na pret veçse zemërimi i Zotit dhe humbja e shpërblimit. Përkujtimi i faktit që robi një ditë do të kthehet te Zoti i tij, është një nga ndihmësit më të fortë.

Allahu i Lartësuar vijon:

- "Vetëm këta kanë tek Zoti i tyre bekime dhe mëshirë, dhe vetëm këta janë të udhëzuarit në rrugën e drejtë." – Kështu, ata kanë tri shpërblime:

1. Bekime (*ŝaleuât*) prej Zotit të tyre, që nënkupton faljen e gjynaheve dhe përmendjen që i bën Zoti robit mes engjëjve.

2. Mëshira e madhe e Zotit të tyre. Prej mëshirës së Tij është edhe suksesi që Ai u jep atyre për t'u treguar të durueshëm në sprovat e Tij, si edhe shpërblimi i madh për durimin e tyre.

3. Udhëzimi në rrugën e drejtë. Ata e njohin të vërtetën dhe punojnë me të. Ata e dinë se janë pronë e Zotit të tyre dhe se tek Ai do të kthehen për t'u shpërblyer. Jo vetëm kaq, por ata punojnë sipas kësaj dijeje, duke shfaqur durim për hir të Zotit.

Ky ajet tregon, gjithashtu, se të paduruarit nuk kanë për t'i fituar këto shpërblime të durimtarëve. Me fjalë të tjera, ky ajet, përveçse është përgëzim për durimtarët, është edhe kërcënim për të paduruarit.

Ndryshimi mes dy grupeve është shumë i madh. Mundimi i durimtarëve është i vogël dhe i shkurtër, ndërsa jodurimtarët do të zhyten në vuajtje pa fund, në ahiret.

Këto ajete i përgatitin njerëzit për të qenë të qëndrueshëm ndaj fatkeqësive, para se ato të ndodhin, dhe kjo ua lehtëson shumë çështjen atyre. Ajetet të ndihmojnë të kryesh detyrën e durimit, duke treguar shpërblimin e kësaj vepre dhe duke nënkuptuar pasojat e mosdurimit.

Në to tregohet, gjithashtu, se sprovat janë të llojeve të ndryshme dhe normë e pandryshueshme e Krijuesit.

Ajeti 158

158. Vërtet, Safa dhe Merva janë nga simbolet e Allahut, prandaj ai që shkon në Qabe për haxh ose për umre, nuk ka asnjë gjynah nëse sillet mes tyre. Kush bën vepra të mira vullnetarisht, ta dijë se Allahu është Mirënjohës e i Gjithëdijshëm.

Shpjegimi i ajetit

- **"Vërtet, Safa dhe Merva janë nga simbolet e Allahut..."** – Kështu, Allahu i Lartësuar thotë se kodrat Safa dhe Merva, ku adhurohet Ai, janë dy nga simbolet e fesë së Tij. Duke qenë të tilla, ato duhen nderuar dhe respektuar, pasi i Lartësuari ka thënë që: "Kush i respekton shenjat e Allahut, tregon për devotshmërinë e zemrës së tij." [Haxh].

Atëherë, Safa dhe Merva janë shenja të Allahut, dhe madhërimi i tyre tregon devotshmërinë e zemrës. Duke qenë se devotshmëria e zemrës është detyrë e çdo adhuruesi, atëherë edhe ecja mes Safas dhe Mervas është detyrë për ata që kryejnë haxhin apo umren. Të këtij mendimi janë shumica e dijetarëve, megjithëse kjo mbështetet edhe nga hadithet e përcjella nga Profeti (s.a.u.s.), i cili ka thënë: *"Mësoni prej meje ritet tuaja (të adhurimit, në haxh etj.)!"*

- **"...prandaj ai që shkon në Qabe për haxh ose për umre, nuk ka asnjë gjynah nëse sillet mes tyre"** – Këtu flitet për mendimin e gabuar të disave, të cilëve iu duk i gabuar riti i rendjes mes Safas dhe Mervas, meqë kështu ishte vepruar edhe në kohën para Islamit. Por Allahu i Lartësuar bën të qartë se ky rit nuk ishte gjynah. Megjithatë, mohimi i gjynahut për këtë veprim nuk tregon se ai është jo i detyrueshëm për t'u kryer.

Allahu i Lartësuar thotë se për atë që bën haxhin dhe umren nuk është gjynah që të kryejë rendjen (*sa'j*) mes Safas dhe Mervas. E parë anasjelltas, kjo tregon se *sa'j*-i mes Safas dhe Mervas nuk bëhet jashtë riteve të haxhit dhe umres. Pra, ai nuk është një adhurim i veçantë, që mund të kryhet më vete. Ai nuk është si tavafi rreth Qabes, i cili, përveç që kryhet gjatë Haxhit dhe Umres, mund të bëhet edhe si adhurim më vete.

Kështu, *sa'j*-i mes Safas dhe Mervas, qëndrimi në Arafat dhe në Muzdelife dhe gjuajtja e gurëve, janë adhurime që nuk mund të kryhen jashtë kuadrit të haxhit. Nëse këto vepra kryhen jashtë haxhit, atëherë nuk quhen më adhurime, por sajime (bidate) në fe, sepse bidatet në fenë e Allahut janë dy llojesh: së pari, adhurime që Allahu nuk i ka ligjëruar dhe, së dyti, adhurime të cilat janë ligjëruar nga Allahu që të kryhen me një mënyrë dhe formë të caktuar, por që adhuruesi i kryen në forma dhe mënyra të tjera, të ndryshme nga ato që ka përcaktuar Allahu.

- **"Kush bën vepra të mira vullnetarisht..."** – Pra, çdokush që kryen vepra të mira, me sinqeritet për Zotin, e mira do ta gjejë.

Të mirat që mund të kryejë robi janë të llojeve të ndryshme, si për shembull: haxhi, umra, tavafi rreth Qabes, namazi, agjërimi etj.

Në ajetin e agjërimit, ku thuhet: "…ajo është më e mirë për të", tregohet një rregull i mrekullueshëm, i vendosur nga Allahu i Lartësuar, sipas të cilit: sa herë që adhuruesi bën ndonjë punë të mirë, duke shprehur bindje ndaj Zotit, aq më shumë i shtohet mirësia dhe grada tek Zoti i tij. Veprat e mira ia shtojnë imanin adhuruesit, ndërsa imani i lartë ia ngre atij gradat tek Allahu i Lartësuar.

Ndërsa ky ajet, që thotë: "Kush bën vepra të mira vullnetarisht…", tregon se gradat e adhuruesit ngrihen kur ai shton vullnetarisht veprat e mira.

Nga fjala "*hajran*" (vepra të mira) kuptojmë se ky lartësim arrihet vetëm me ato vepra që quhen të mira, e jo me të tjera. Veprat quhen të mira vetëm nëse Allahu i Lartësuar i ka cilësuar të tilla nëpërmjet Librit dhe Profetit të Tij. Me fjalë të tjera, gradat e larta nuk mund të arrihen duke shtuar vepra e adhurime, të cilat nuk janë cilësuar si të tilla nga Allahu. Tek Allahu i Lartësuar mund të afrohesh dhe mund të fitosh kënaqësinë e Tij veçse me mënyrat që Ai i pëlqen dhe i ka ligjëruar për një gjë të tillë, nëpërmjet profetëve të Tij dhe librave të shenjtë me të cilët i pajisi ata. Mirësia nuk mund të arrihet me rrugë jo të mira. Ai që përpiqet të afrohet tek Allahu i Lartësuar me bidate arrin të fitojë veçse lodhjen e kotë. Madje, kur e di se adhurimi që kryen nuk është ligjëruar nga Zoti i tij, atij i shtohen të këqijat dhe largohet nga Allahu i Lartësuar.

- "…ta dijë se Allahu është Mirënjohës e i Gjithëdijshëm." - *Shâkirun* (Mirënjohës) dhe *Shekûrun* janë dy emra të Allahut të Lartësuar, që tregojnë për mirësinë dhe mëshirën e Tij. Ata tregojnë mirënjohjen e Tij, duke shpërblyer çdo punë të adhuruesve, sado e vogël qoftë ajo, madje për një vepër të vogël, Allahu Bujar shpërblen shumëfish.

Shenjë tjetër e mirënjohjes së pakufishme të Allahut Bujar është edhe fakti që, kur adhuruesi përpiqet për të kryer urdhrat e Tij dhe për t'iu larguar ndalesave të Tij, Allahu e ndihmon atë dhe i jep sukses që të jetë i vazhdueshëm në këtë rrugë. Madje, jo vetëm që e ndihmon, por edhe e përkujton atë në Mbretëritë e qiellit, duke ia ngritur famën dhe gradat e tij.

Allahu i Lartësuar dhe Bujar e shpërblen bindjen e robit duke i dhuruar atij dritë dhe besim të pastër në zemër, forcë në trup, mirësi në jetë dhe begati në vepra. Këto janë shenjat e mirënjohjes nga Allahu Bujar për bindjen e adhuruesit në këtë jetë. Ndërsa në jetën tjetër, atë e pret shpërblimi i plotë.

Tregues tjetër i mirënjohjes së Allahut ndaj robit të bindur është edhe premtimi i Tij se, kush e lë diçka për hir të Tij, Allahu do t'ia kompensojë me diçka më të mirë se ajo që robi do të lërë. Nëse robi i afrohet Allahut një pëllëmbë, Ai do t'i afrohet robit një krah, e nëse robi i afrohet një krah, Ai do t'i afrohet edhe më shumë. Nëse robi i afrohet Allahut me hap, Ai do t'i afrohet atij duke rendur. Kush bën tregti me Zotin e tij, do të marrë shumëfishin e asaj që do të japë.

Por Allahu i Lartësuar, përveçse është Mirënjohës i madh, Ai është edhe *Alîm*, pra, i Gjithëditur. Ai e di më mirë se çdokush tjetër se cili e meriton mirënjohjen e Tij. Ai e di shumë mirë se cilët adhurues e meritojnë shpërblimin e plotë, sepse Ai njeh shumë mirë qëllimet, besimin dhe përkushtimin e tyre, në varësi të të cilëve jep edhe shpërblimin e merituar. Allahu e di shumë mirë dallimin mes adhuruesve dhe asnjërit nuk ia humbet hakun. Çfarëdo pune, sado e vogël dhe e parëndësishme të duket, nuk i shpëton dijes së Tij gjithëpërfshirëse. Të gjithë do ta gjejnë të plotë shpërblimin e veprave të tyre, sipas qëllimit që kanë patur në këtë jetë, se asgjë nuk i shpëton të Gjithëdituri.

Ajetet 159 – 162

159. Ata të cilët fshehin argumentet e qarta dhe udhëzimin që Ne shpallëm, pasi Ne ua sqaruam ato njerëzve në Libër, i mallkon Allahu, i mallkojnë edhe mallkuesit.
160. Mirëpo atyre që pendohen, që përmirësohen dhe ua tregojnë njerëzve atë që kishin fshehur, Unë ua pranoj pendimin, sepse Unë jam Pranuesi i pendimeve dhe Mëshiruesi.
161. Mbi ata që mohojnë dhe vdesin si jobesimtarë rëndon mallkimi i Allahut, i engjëjve dhe i të gjithë njerëzimit.
162. Ata do të jenë përgjithmonë atje *(në Xhehenem)*. Atyre nuk do t'u lehtësohet vuajtja dhe as nuk do t'u jepet afat.

Shpjegimi i ajeteve

Këto ajete, ndonëse kanë zbritur për ithtarët e Librit (çifutët dhe të krishterë), që fshehën të vërtetën rreth Kur'ânit dhe Muhamedit (s.a.u.s.), ato janë paralajmërim për të gjithë ata njerëz që mundohen të fshehin ndonjë gjë prej Shpalljes së Zotit.

- "Ata të cilët fshehin argumentet e qarta dhe udhëzimin që Ne shpallëm, pasi Ne ua sqaruam ato njerëzve në Libër..." - Ky ajet përfshin të gjithë ata që fshehin argumentet e qarta të Shpalljes së Zotit ose udhëzimet për të arritur çdo të mirë dhe për t'u ruajtur nga çdo e keqe. Me fjalë të tjera, ajeti flet për ata që fshehin të vërtetën, e cila të udhëzon të ecësh në rrugën e drejtë, për te Zoti i Lartësuar, ose për ata që fshehin udhëzimin që të çon në Xhenet dhe të largon nga Zjarri i Xhehenemit.

Allahu i Lartësuar u ka marrë premtimin dijetarëve, se ata do ta përcjellin të vërtetën dhe kurrë nuk do ta fshehin atë. Ata që nuk e mbajnë këtë premtim kanë dy të këqija: së pari, ata janë fshehës të së vërtetës së shpallur nga Zoti dhe, së dyti, janë të padrejtë ndaj njerëzve të thjeshtë, sepse i drejtojnë në humbje dhe shkatërrim.

Të tillët sigurisht që e kanë hak mallkimin e Allahut dhe të çdo krijese, siç thuhet më tej:

- "...i mallkon Allahu, i mallkojnë edhe mallkuesit." - Ata e meritojnë këtë mallkim, sepse ata mashtrojnë krijesat dhe shkatërrojnë lidhjet e tyre me Zotin. Ata i largojnë njerëzit nga mëshira e Allahut, prandaj shpërblehen sipas veprës së tyre.

Në anën tjetër, dijetarët që u mësojnë njerëzve të mirën, që u tregojnë atyre rrugën për tek Allahu dhe kënaqësia e Tij, do të shpërblehen me mëshirë dhe grada të larta nga Allahu. Për ta luten edhe melekët, madje edhe peshqit e detit, sepse përpiqen të përmirësojnë krijesat dhe lidhjen e tyre me Zotin. Ata u mësojnë krijesave fenë e Zotit dhe rrugët për të fituar mëshirën e Tij.

Atëherë, sikurse dijetarët e së vërtetës do të shpërblehen për punën e mirë që kanë kryer, po ashtu ata që e fshehin të vërtetën do të shpërblehen për punën e tyre të keqe. Ata do të meritojnë mallkimin, sepse janë bërë kundërshtarë të rrugës së Zotit dhe të urdhrave të Tij. Allahu i Lartësuar i qartëson argumentet e Tij për njerëzit, ndërsa ata i fshehin ose i shtrembërojnë ato. Të tillët e meritojnë ndëshkimin e paralajmëruar në këtë ajet. Por Allahu i Lartësuar përjashton nga ky gjykim një kategori:

- "Mirëpo atyre që pendohen, që përmirësohen dhe ua tregojnë njerëzve atë që kishin fshehur...". - Nga ky paralajmërim shpëtojnë vetëm ata që plotësojnë disa kushte, si më poshtë:
1. Pendohen, domethënë që kthejnë rrugë dhe heqin dorë nga gjynahu, duke qenë të trishtuar për çfarë ka ndodhur dhe duke qenë të vendosur për të mos iu kthyer atij gjynahu kurrë.
2. Përmirësohen, duke rregulluar veprat e tyre. Nuk mjafton vetëm që ta lësh të keqen, por duhet patjetër të kryhesh të mira dhe të rregullosh atë që ke prishur.

3. Tregojnë të vërtetën. Pra, për ata që e kanë fshehur deri dje të vërtetën, nuk mjafton vetëm të heqin dorë nga kjo vepër, derisa të rregullojnë atë që kanë prishur dhe t'u tregojnë njerëzve se çfarë kanë mbajtur të fshehur.

Njerëzve që plotësojnë këto tri kushte, Allahu i Lartësuar ua pranon pendimin, sepse porta e pendimit qëndron gjithmonë e hapur për këdo që plotëson kriteret e marrjes së faljes nga Zoti i tij.

Allahu i Lartësuar është Pranues i pendimeve, siç thotë Ai:

- "...atyre Unë ua pranoj pendimin, sepse Unë jam Pranuesi i pendimeve dhe Mëshiruesi" – *El Teuuâb* (Pendim-pranuesi) është Ai, i Cili, nëse robërit i kthehen të penduar nga gjynahet, Ai u përgjigjet plot mëshirë dhe falje. Nëse ata kthehen tek Ai, edhe Ai kthehet tek ata plot dhurata dhe mirësi, të cilat ua ka penguar fillimisht për shkak të padrejtësive të tyre.

Allahu është edhe *Rrahîm* (Mëshiruesi), që ka një mëshirë të madhe dhe gjithëpërfshirëse. Pranimi i pendimit dhe kthimi në rrugën e drejtë është fryt i mëshirës së Allahut, sepse është *Rrahîm*-i Ai që u jep sukses të pendohen dhe të kthehen tek Ai. Është po Mëshiruesi, që pasi u jep sukses të kthehen tek Ai të penduar, ua pranon pendimin dhe përgatit shpërblim të madh për ta, si butësi dhe nder prej bujarisë së Tij.

Ky është gjykimi për të penduarit dhe të kthyerit sinqerisht tek Zoti i tyre. Ndërsa ata që mohojnë dhe vazhdojnë në rrugën e humbjes derisa t'u vijë vdekja, ata që kurrë nuk kthehen tek Allahu, derisa të dorëzojnë shpirtin e tyre, ata kanë tjetër gjykim.

- "Mbi ata që mohojnë dhe vdesin si jobesimtarë rëndon mallkimi i Allahut, i engjëjve dhe i të gjithë njerëzimit." - Ashtu sikurse mohimi i Zotit dhe fshehja e së vërtetës mbeten cilësi të pandryshuara të tyre, edhe mallkimi do të jetë i pandërprerë mbi ta, sepse gjykimi është në varësi të veprës së kryer. Ata do të jenë përjetësisht në ndëshkim, për shkak të kufrit të tyre dhe të mallkimit që ai sjell me vete, siç thotë i Lartësuari:

- "Ata do të jenë përgjithmonë atje *(në Xhehenem)*. Atyre nuk do t'u lehtësohet vuajtja dhe as nuk do t'u jepet afat." - Dënimi i tyre nuk do të pakësohet apo të zbutet. Ai do të jetë përherë i ashpër. Atyre nuk do t'u jepet më afat tjetër, që të kthehen nga rruga e gabuar. Mundësia që iu jepet në dynja është e mjaftueshme dhe, me vdekjen e tyre, nuk ka më asnjë shans për të shpëtuar.

Ajetet 163 – 164

163. Zoti juaj është Një i vetëm. Nuk ka të adhuruar tjetër *(me meritë)*, përveç Tij. Ai është i Mëshirshmi, Mëshiruesi.
164. Është fakt se, në krijimin e qiejve dhe të tokës, në ndërrimin e natës dhe të ditës, në anijet që lundrojnë në det për t'u sjellë dobi njerëzve, në shiun që Allahu e lëshon prej qielli, duke ngjallur përmes tij tokën e vdekur dhe duke përhapur në të çdo lloj gjallese, në lëvizjen e erërave dhe në retë që lëvizin mes qiellit dhe tokës, (*pra, në të gjitha këto,*) ka shenja për njerëzit që dinë të mendojnë.

Shpjegimi i ajeteve

- "Zoti juaj është Një i vetëm." – Këtu Allahu i Lartësuar na tregon për diçka, dhe Ai është më i drejti dhe më i vërteti në thëniet e Tij. Ai thotë se Zoti ynë është Një i vetëm, Unik, i Pashembullt për sa i përket Qenies së Tij, emrave e cilësive të Tij dhe veprave të Tij. Nuk ka të krahasueshëm me Të, nuk ka të barabartë me madhështinë e Tij, nuk ka të ngjashëm me Atë, në të gjitha aspektet. Nuk ka Zot e as kujdestar tjetër për krijesat, përveç Atij.

- "Nuk ka të adhuruar tjetër *(me meritë)*, përveç Tij". - Duke qenë i tillë, atëherë Ai

është i vetmi që meriton të adhurohet, të duhet e të admirohet. Askush tjetër nuk meriton adhurim, përveç Allahut të Lartësuar.

- "Ai është i Mëshirshmi, Mëshiruesi." Ai është i cilësuar me mëshirën më të madhe, së cilës nuk mund t'i përafrohet asnjë mëshirë tjetër. Mëshira e Tij ka përfshirë çdo gjë. Me mëshirën e Tij u sollën në ekzistencë të gjitha krijesat. Ato u përsosën vetëm me mëshirën e Krijuesit të tyre. Me mëshirën e Tij, krijesat ruhen nga çdo e keqe që u kanoset. Me mëshirën e Tij, Ai iu paraqit krijesave me emrat, cilësitë dhe dhuratat e Tij. Po me mëshirën e Tij, Ai u mësoi atyre gjithçka që u rregullon atyre dynjanë dhe besimin. Këtë e bëri duke u dërguar profetë dhe libra të ndritur.

Nëse njeriu e kupton dhe bindet se çdo mirësi vjen vetëm nga Zoti, dhe se krijesat nuk mund të sjellin as dëm, as dobi, me siguri që do ta adhurojë si Zot të vetëm Allahun e Lartësuar. Ai do të bindet plotësisht se Allahu i Lartësuar është i vetmi që i meriton të gjitha llojet e adhurimit. Zemra e tij do të drejtohet vetëm tek Allahu i Lartësuar, duke shprehur për Të dashurinë, frikën, respektin, shpresën, madhërimin, mbështetjen e plotë etj.

Pa dyshim, adhurimi për dikë tjetër veç Allahut është vepra më e shëmtuar. Si mund të adhurosh një krijesë prej dheu dhe të lësh adhurimin për Krijuesin e gjithësisë. Si mund të adhurosh një rob të nënshtruar, nevojtar në të gjitha drejtimet, dhe të lësh adhurimin e Krijuesit, Sunduesit e të Plotfuqishmit për gjithçka. Si mund të lësh adhurimin e Atij që mbretëron mbi gjithçka dhe të Cilit i është nënshtruar çdo gjë?!

Ky ajet dëshmon se Allahu i Lartësuar është Unik në madhështinë, pushtetin dhe meritën e adhurimit. Askush tjetër nuk meriton të adhurohet përveç Tij. Në ajet, Allahu i Lartësuar është përshkruar me cilësinë e mëshirës absolute, shenja të së cilës janë ekzistenca e çdo të mire dhe largimi i çdo të keqeje, e, rrjedhimisht, adhurimin e meriton veçse Ai që ka këto cilësi.

Më pas, Allahu i Lartësuar përmend argumente më të shtjelluara rreth njëshmërisë së Tij. Ai tregon se krijesat e mrekullueshme dëshmojnë se Ai që i ka krijuar është i Vetëm, Unik, Absolut, i Plotfuqishëm, i Urtë, i Ditur, i Mëshirshëm, domethënë, me cilësitë më të larta, prandaj Ai është i vetmi që meriton të adhurohet në qiej dhe në tokë.

Porse këto shenja e argumente u vlejnë veç njerëzve që mendojnë e përsiaten rreth tyre, duke kuptuar, si rezultat, njëshmërinë e Krijuesit.

- "Është fakt se, në krijimin e qiejve dhe të tokës..." - Qiejt janë krijuar të lartë, të gjerë, të fiksuar mirë e të rregullt. Në ta janë vendosur diej, hëna e yje. Ata janë rregulluar në mënyrë të tillë që të jenë të dobishëm për tokën dhe banorët e saj.

Ndërsa toka është krijuar e përshtatshme për banorët e saj, me kushtet e nevojshme që ata të jetojnë në të dhe të përfitojnë prej saj. Në tokë ka aq shumë shenja që tregojnë madhështinë e Krijuesit të saj, sa është e pamundur që të mos nxirren mësime. Krijuesi i saj duhet patjetër të ketë fuqi absolute, duhet të jetë i Ditur, i Urtë dhe shumë i Lartë, sepse toka është e përsosur në të gjitha aspektet. Ai duhet të jetë shumë i mëshirshëm, sepse në tokë dhe rreth saj gjendet gjithçka e dobishme dhe e domosdoshme për jetën në të.

Gjithë këto argumente tregojnë qartë se Allahu është i Vetëm, prandaj duhet që adhurimet t'i përkushtohen vetëm Atij, i Cili përkujdeset dhe i mëshiron krijesat e Tij, duke u dhënë çdo gjë që kanë nevojë.

- "...në ndërrimin e natës dhe të ditës..." - Edhe në ndryshimet e natës dhe të ditës ka argumente. Ato pasojnë njëra-tjetrën, duke qenë herë dita më e gjatë, e herë nata; ndonjëherë janë edhe të barabarta. Ato ndryshojnë edhe në temperaturat e tyre.


Kështu janë sistemuar edhe stinët, në të cilat ka mirësi të pazëvendësueshme për jetën e gjallesave. Krijesat kanë nevojë edhe për natën, edhe për ditën; nuk mund të ketë jetë normale pa ato të dyja.

Të gjitha këto ndryshime bëhen sipas një rregulli të mrekullueshëm, që habit edhe njerëzit më të ditur. Të gjitha këto, a nuk tregojnë për dijen, urtësinë, pushtetin, forcën dhe mëshirën absolute të Atij që i ka krijuar dhe rregulluar në këtë mënyrë, të Atij që madje përkujdeset për to, duke u mundësuar çdo nevojë në këtë vendbanim të tyre të përkohshëm. Rrjedhimisht, ky pushtet, përkujdesje e mëshirë e Tij, e bëjnë të detyrueshme që adhurimi t'i kushtohet vetëm Allahut.

Pas shenjave të tilla, zemra mbushet vetëm me dashurinë dhe adhurimin për Krijuesin e tyre. Ajo mbushet plot shpresë e frikë për të Madhëruarin. Krijesat që meditojnë në të tilla mrekulli, me siguri që nxitojnë të bëjnë çdo gjë që kënaq Krijuesin e tyre të Dashur dhe të Mëshirshëm.

- "...në anijet që lundrojnë në det për t'u sjellë dobi njerëzve" - Përveç shenjave në qiej dhe në tokë, Allahu i Lartësuar na udhëzon që të mendojmë për anijet që lundrojnë në det dhe, në fakt, për çdo gjë tjetër që Allahu i Lartësuar na ka mundësuar të ndërtojmë, që e përdorim dhe përfitojmë. Le të meditojmë se si Allahu i Lartësuar e bëri ajrin, tokën e ujin, të atillë që të jenë të vlefshëm për shfrytëzimin e mjeteve, nga të cilët përfitojmë.

Njerëzit mund të transportojnë çdo gjë me ndihmën e disa mjeteve, të cilat mund të funksionojnë veçse prej ligjeve që ka vendosur Krijuesi. Ato janë vërtet një ndihmë shumë e madhe, pa të cilat jeta do të vështirësohej. Kush i udhëzoi dhe mësoi ata për të prodhuar të tilla mjete? Kush u mundësoi çdo gjë të nevojshme që ato të prodhohen dhe të funksionojnë? A mos vallë, ata e bënë detin, ajrin e tokën të përshtatshëm për mjetet e prodhuara prej


الجُزءُ الثَّانِي سُورَةُ البَقَرَة

إِنَّ فِي خَلْقِ ٱلسَّمَٰوَٰتِ وَٱلْأَرْضِ وَٱخْتِلَٰفِ ٱلَّيْلِ وَٱلنَّهَارِ
وَٱلْفُلْكِ ٱلَّتِي تَجْرِي فِي ٱلْبَحْرِ بِمَا يَنفَعُ ٱلنَّاسَ وَمَآ أَنزَلَ ٱللَّهُ
مِنَ ٱلسَّمَآءِ مِن مَّآءٍ فَأَحْيَا بِهِ ٱلْأَرْضَ بَعْدَ مَوْتِهَا وَبَثَّ فِيهَا
مِن كُلِّ دَآبَّةٍ وَتَصْرِيفِ ٱلرِّيَٰحِ وَٱلسَّحَابِ ٱلْمُسَخَّرِ بَيْنَ
ٱلسَّمَآءِ وَٱلْأَرْضِ لَءَايَٰتٍ لِّقَوْمٍ يَعْقِلُونَ ﴿١٦٤﴾ وَمِنَ ٱلنَّاسِ
مَن يَتَّخِذُ مِن دُونِ ٱللَّهِ أَندَادًا يُحِبُّونَهُمْ كَحُبِّ ٱللَّهِ ۖ وَٱلَّذِينَ
ءَامَنُوٓا۟ أَشَدُّ حُبًّا لِّلَّهِ ۗ وَلَوْ يَرَى ٱلَّذِينَ ظَلَمُوٓا۟ إِذْ يَرَوْنَ
ٱلْعَذَابَ أَنَّ ٱلْقُوَّةَ لِلَّهِ جَمِيعًا وَأَنَّ ٱللَّهَ شَدِيدُ ٱلْعَذَابِ ﴿١٦٥﴾
إِذْ تَبَرَّأَ ٱلَّذِينَ ٱتُّبِعُوا۟ مِنَ ٱلَّذِينَ ٱتَّبَعُوا۟ وَرَأَوُا۟ ٱلْعَذَابَ
وَتَقَطَّعَتْ بِهِمُ ٱلْأَسْبَابُ ﴿١٦٦﴾ وَقَالَ ٱلَّذِينَ ٱتَّبَعُوا۟ لَوْ أَنَّ
لَنَا كَرَّةً فَنَتَبَرَّأَ مِنْهُمْ كَمَا تَبَرَّءُوا۟ مِنَّا ۗ كَذَٰلِكَ يُرِيهِمُ ٱللَّهُ
أَعْمَٰلَهُمْ حَسَرَٰتٍ عَلَيْهِمْ ۖ وَمَا هُم بِخَٰرِجِينَ مِنَ ٱلنَّارِ ﴿١٦٧﴾
يَٰٓأَيُّهَا ٱلنَّاسُ كُلُوا۟ مِمَّا فِي ٱلْأَرْضِ حَلَٰلًا طَيِّبًا وَلَا تَتَّبِعُوا۟
خُطُوَٰتِ ٱلشَّيْطَٰنِ ۚ إِنَّهُۥ لَكُمْ عَدُوٌّ مُّبِينٌ ﴿١٦٨﴾ إِنَّمَا يَأْمُرُكُم
بِٱلسُّوٓءِ وَٱلْفَحْشَآءِ وَأَن تَقُولُوا۟ عَلَى ٱللَّهِ مَا لَا تَعْلَمُونَ ﴿١٦٩﴾

٢٥

tyre? Po zjarrin, mineralet a lëndët e ndryshme, të cilat ata i përdorin në prodhimin e mjeteve të tyre, kush i krijoi dhe ua mundësoi që t'i kenë? Mos vallë, të gjitha këto janë krijuar rastësisht? Apo i ka krijuar vetë njeriu, i cili del nga barku i nënës i paditur, i pafuqishëm dhe nevojtar për gjithçka?!

A nuk është Allahu i Lartësuar Ai, i Cili, pasi e krijon njeriun të dobët, i jep fuqi dhe dije të nevojshme për jetën e tij? Pa dyshim, është Allahu Ai që i mëson njeriut çdo gjë që Ai dëshiron t'i mësojë. Ai që i lehtëson të gjitha këto mirësi është i Vetmi dhe Absoluti, i Dituri, i Urti, i Cili ka pushtet mbi gjithçka, Allahu i Lartësuar. Të gjitha krijesat i janë nënshtruar vullnetit të Tij absolut. Ato janë të përulura përpara madhështisë së Tij dhe kurrë nuk mund të dalin jashtë ligjit të Tij të pandryshueshëm.

Njeriu është veçse një hallkë, mes shkaqeve që sjellin pasoja në këtë jetë. Ai është veç një hallkë, mes hallkave të shumta, nëpërmjet të cilave Allahu i Lartësuar sjell

në këtë jetë gjëra të mrekullueshme. Edhe kjo është një arsye tjetër që e gjithë dashuria, shpresa, frika dhe të gjitha adhurimet t'i përkushtohen Dhuruesit të Madh dhe të Vetëm të këtyre mirësive, Allahut të Lartësuar.

- "...në shiun që Allahu e lëshon prej qielli, duke ngjallur përmes tij tokën e vdekur" - Nëpërmjet ujit, kësaj krijese të çuditshme, Allahu i Lartësuar i ruan jetën çdo gjëje të gjallë në këtë botë, si: njerëzve, bimëve, kafshëve, shpendëve etj. Krijesat nuk mund të jetojnë pa të.

A nuk dëshmon, pra, ky ujë dhe gjithçka që zhvillohet nëpërmjet tij, për pushtetin absolut të Atij që e krijoi dhe e zbriti nga qielli? A nuk tregon ai mëshirën, butësinë dhe përkujdesjen e Zotit ndaj krijesave, për çdo nevojë të jetës së tyre? A nuk duket qartë nevoja e domosdoshme e krijesave për mëshirën e Tij, në çdo kënd që ta shohësh?! A nuk i bën ky shi, i zbritur me mëshirë nga lart, që ata ta adhurojnë Dhuruesin e tij, Allahun Bujar dhe të Mëshirshëm. A nuk tregon ringjallja që shiu i bën tokës, për ringjalljen e madhe të krijesave? Allahu që e ringjall tokën e tharë me anë të shiut, a nuk e ka pushtetin dhe forcën për t'i ringjallur krijesat dhe për t'i marrë në llogari Ditën e Gjykimit?

- "...dhe duke përhapur në të çdo lloj gjallese..." - Prej shenjave të pushtetit dhe madhështisë së Tij është edhe shumëllojshmëria e gjallesave që Ai ka krijuar dhe shpërndarë nëpër dete, ajër dhe tokë. Të gjitha këto gjallesa, Allahu ia ka nënshtruar njeriut, me qëllim që ai të përfitojë prej tyre, për shembull, duke ngrënë mishin e tyre, duke pirë qumështin e tyre, duke i përdorur për transport, për ruajtje, për gjueti etj. Ai jo vetëm i ka vënë këto krijesa në shërbim të njeriut, por edhe për furnizimin e tyre kujdeset Vetë. Allahu i Lartësuar furnizon njerëzit, por edhe kafshët që ata përdorin. Ai përkujdeset për gjithçka, siç thotë: "Nuk ka asnjë gjallesë në tokë që Allahu të mos ia ketë garantuar furnizimin. Ai e di vendbanimin dhe vendstrehimin e saj. Të gjitha këto janë në Librin e Njohur (*Levhi Mahfudh*)." [Hudë 6].

- "...në lëvizjen e erërave" – Domethënë, të erërave të ftohta dhe të nxehta, jugore dhe veriore, lindore e perëndimore e të ndërmjetme. Shpesh, erërat shpërndajnë retë e qiellit ose i grumbullojnë ato. Ato janë bartëse të pjalmit, dhe kështu ndihmojnë në pllenimin e bimëve. Shpesh, erërat sjellin rrebeshe, dhe herë të tjera i largojnë ato. Ndonjëherë, erërat sjellin mëshirë, e ndonjëherë ndëshkim dhe shkatërrim.

Kush është ai që i përdor këto erëra në këtë mënyrë? Kush i bën ato të sjellin kaq shumë dobi, pa të cilat krijesat nuk do t'ia dilnin dot? Kush i bën ato të rregullojnë jetën e gjallesave? Kush i bën ato që të ndihmojnë në riprodhimin e bimësisë? Pa dyshim që është Allahu Krenar, i Urtë, i Mëshirshëm e i Dashur, që përkujdeset me butësi për krijesat e Tij. Për këtë arsye, vetëm Ai e meriton adhurimin, vetëm Ai e meriton t'i nënshtrohesh, ta duash, t'i tregosh pendimin e t'i bindesh duke kryer vepra të mira, sipas udhëzimeve të Pejgamberit të Tij (s.a.u.s.).

Një tjetër shenjë e madhe e madhështisë dhe pushtetit të Allahut të Lartësuar është zhvendosja e reve mes qiellit dhe tokës.

- "...dhe në retë që lëvizin mes qiellit dhe tokës, *(pra, në të gjitha këto,)* ka shenja për njerëzit që dinë të mendojnë" - Si është e mundur që retë e mëdha, të ngarkuara rëndë me ujë, lëvizin nëpër qiell, duke shkuar atje ku dëshiron i Urti? Ato lëvizin me dëshirën dhe pushtetin e Allahut, i Cili ngjall bimësinë dhe jetën në tokën e vdekur nëpërmjet shiut që lëshojnë ato. Është Allahu që e zbret shiun në tokë kur njerëzit kanë nevojë. Kur shiu bëhet i dëmshëm, Ai e ndal atë, duke dhënë shpresë. Është Allahu që e zbret shiun me mëshirë dhe e largon atë

me përkujdesjen dhe dashurinë e Tij. Madhështor është pushteti i Tij dhe të pafundme janë mirësitë e dhuruara prej Tij!

A nuk është turp për njerëzit që të jetojnë në tokën ë Tij, të kënaqen me furnizimin dhe mirësitë e Tij, dhe pastaj t'i përdorin ato për të fituar zemërimin e Tij?! A nuk është krim që këto mirësi të përdoren duke shpërfillur urdhrat e Tij dhe në mosbindje ndaj Tij?! Megjithatë, a nuk tregon kjo, nga ana tjetër, durimin, faljen, mëshirën, butësinë dhe tolerancën e madhe të të Madhërishmit? I lavdishëm qoftë përherë emri i Tij!

Si përfundim, mund të themi se, sa më tepër të meditojë njeriu i ditur rreth krijesave, sa më shumë të meditojë rreth shenjave të mëshirës dhe butësisë së Krijuesit, që shfaqen në këto krijesa, aq më tepër do të bindet se ato janë krijuar nga i Madhërishmi për një qëllim të lartë. Ato janë faqet e një libri të madh, ku shkruhen shenjat dhe argumentet e Zotit të gjithësisë, ku Ai flet për madhështinë dhe njëshmërinë e Tij absolute. Ato janë të mbushura me argumente të qarta, që tregojnë për vërtetësinë e fjalëve të profetëve dhe për vërtetësinë e Ditës së Ringjalljes. Asgjë nuk ndodh pa një qëllim dhe vetvetiu, por çdo gjë është e drejtuar dhe e llogaritur nga i Madhërishmi.

Nga ajeti kuptohet, gjithashtu, se si bota qiellore, edhe ajo tokësore kanë nevojë për mëshirën dhe përkujdesjen e Allahut, i Cili është Madhështor e i Pasur në çdo aspekt. Ai nuk ka nevojë për asgjë dhe asnjë nga krijesat e Tij. Për këtë arsye, Ai është i vetmi që meriton të adhurohet. Nuk ka Zot tjetër veç Tij.

Ajetet 165 – 167

165. Ka njerëz që, në vend të Allahut, besojnë idhujt, të cilët i duan sikurse Allahun. Por, për ata që besuan, dashuria për Allahun është shumë më e fortë. Sikur ta dinin ata që bëjnë padrejtësi se, kur ta shohin dënimin, ata do të binden se e tërë fuqia i takon vetëm Allahut, dhe se Allahu është Ndëshkues i rreptë.

166. Kur paria të distancohet prej pasuesve të tyre, kur të gjithë do ta shohin dënimin dhe kur lidhjet mes tyre do të këputen.

167. Atëherë, pasuesit do të thonë: "Ah, sikur të na lejohej një kthim *(në dynja)* dhe t'i braktisnim, sikurse ata na braktisën tani!" Kështu, Allahu do t'ua tregojë veprat e tyre, si dëshpërim për ta, dhe ata kurrë nuk kanë për të dalë prej Zjarrit.

Shpjegimi i ajeteve

Sa bukur lidhen këto ajete me ato paraardhëset! Pasi solli disa argumente bindëse për njëshmërinë e Tij, Allahu i Lartësuar vijon e thotë se përsëri ka njerëz në botë që, së bashku me Allahun, adhurojnë zota të tjerë, duke i konsideruar ata të barabartë me Të.

- "Ka njerëz që, në vend të Allahut, besojnë idhujt, të cilët i duan sikurse Allahun." – Pra, ata i konsiderojnë idhujt e tyre si të barabartë me Allahun, në kushtimin e adhurimit dhe dashurisë së tyre. Njerëz të tillë janë në humbje të sigurt, sepse kundërshtojnë hapur të vërtetën e qartë dhe kanë zgjedhur të jenë kundërshtarë të Zotit. Ata nuk meditojnë mbi ajetet e Allahut të Lartësuar ose mbi shenjat dhe argumentet e Tij në gjithësi. Ata nuk kanë asnjë lloj justifikimi për zgjedhjen e gabuar që kanë bërë, prandaj e meritojnë ndëshkimin e Allahut.

Ata e dinë shumë mirë se Allahu i Lartësuar është i vetmi Krijues, Furnizues, Administrues dhe Kujdestar i krijesave, por gabimi i tyre është se ata adhurojnë edhe zota të tjerë, duke e menduar këtë si një mënyrë që të afron tek Allahu i Lartësuar.

Nga fjalët e përdorura në ajet, kuptohet se 'zotat' e tyre, në fakt, nuk e meritojnë të adhurohen, por janë njerëzit e humbur që i trajtojnë ashtu. Thënë ndryshe, ata nuk janë gjë tjetër, por veçse emërtime të kota, pa lidhje me realitetin, sikurse thotë i Lartësuari: "Ata *(që i adhuroni ju)* nuk janë gjë tjetër, por vetëm se emra që ju dhe

prindërit tuaj i keni vënë. Allahu nuk zbriti ndonjë fakt për ta, por ata *(idhujtarët)* ndjekin vetëm hamendjet dhe dëshirat e tyre, megjithëse u ka ardhur udhëzimi prej Zotit të tyre." [Nexhm, 23].

Allahu i Lartësuar nuk mund të ketë të barabartë me Të. Krijesa nuk mund të jetë kurrë si Krijuesi. Vetëm Allahu i Lartësuar është Krijuesi, ndërsa çdo gjë tjetër veç Tij është krijesë. Vetëm Zoti është Furnizues, dhe çdo gjë tjetër është e furnizuar dhe nevojtare për furnizimin e Tij. Allahu i Lartësuar është i Pasuri, që nuk ka nevojë për asgjë, ndërsa ne jemi të varfër e nevojtarë ndaj Tij për çdo gjë. Ai është Absolut në çdo aspekt, ndërsa ne jemi të mangët në çdo aspekt. Allahu i Lartësuar është i Vetmi që ka në dorë dobinë dhe dëmin, ndërsa krijesat nuk kanë në dorë të bëjnë as dobi e as dëmin më të vogël.

Nga e gjithë kjo, kuptohet se sa i kotë është besimi i atyre që, përveç Allahut, adhurojnë zota të tjerë, duke i konsideruar si të barabartë me Të, ndërkohë që asnjë krijesë, qoftë engjëll, profet, njeri i mirë, idhull etj., nuk mund të jetë e barabartë me Allahun.

I vetmi që meriton dashuri të plotë dhe nënshtrim total është Allahu i Lartësuar. Për këtë, Allahu i Lartësuar i lëvdon besimtarët, duke thënë se:

- "...Por, për ata që besuan, dashuria për Allahun është shumë më e fortë." – Pra, besimtarët e duan Zotin e tyre të vetëm, Allahun e Lartësuar, me një dashuri shumë më të fortë dhe më të madhe se dashuria e këtyre idhujtarëve për idhujt e tyre.

Besimtarët ia kushtojnë të gjithë dashurinë vetëm Allahut të Lartësuar, ndërsa idhujtarët lënë vend në zemrat e tyre edhe për idhujt e tyre. Dashuria e besimtarëve për Allahun është shumë më e fortë, sepse ata duan Atë që e meriton vërtet dashurinë. Dashuria për Allahun siguron lumturinë dhe suksesin e adhuruesve të Tij në këtë jetë dhe në jetën tjetër.

Ndërsa idhujtarët duan ato gjëra që nuk meritojnë asnjë grimcë dashurie. Dashuria ndaj idhujve është shkatërrim dhe trishtim. Ajo e prish gjendjen e robit dhe e çorodit atë në çdo drejtim, madje të çon drejt ndëshkimit më të rëndë. Për këtë arsye, i Lartësuari i kërcënon idhujtarët, duke thënë:

- "...Sikur ta dinin ata që bëjnë padrejtësi..." – Domethënë, ata që bëjnë padrejtësi duke adhuruar idhujt e tyre. Ata iu nënshtrohen idhujve, në vend që t'i nënshtrohen Allahut, Zotit të krijesave. Veç kësaj, ata i pengojnë krijesat e Zotit nga rruga e drejtë dhe nga besimi i saktë. Ata janë të padrejtë ndaj vetes dhe të tjerëve, sepse bëjnë vepra që janë në dëm të tyre.

- "...se, kur ta shohin dënimin..." – Domethënë, kur ta shohin me sytë e tyre të ballit, Ditën e Gjykimit.

"...ata do të binden se e tërë fuqia i takon vetëm Allahut, dhe se Allahu është Ndëshkues i rreptë!" - Atëherë do të binden plotësisht se fuqia dhe pushteti është vetëm në dorën e Allahut të Lartësuar. Atë ditë do të binden se idhujt nuk kanë në dorë asnjë lloj fuqie për të ndihmuar adhuruesit e tyre. Atë ditë, ata do ta shohin qartë dobësinë dhe pafuqinë e idhujve, të cilët i kanë adhuruar përveç Allahut të Lartësuar.

Në këtë dynja, idhujatarët nuk janë të qartë. Ata mendojnë që edhe idhujt e tyre kanë pushtet për çështje të ndryshme. Ata mendojnë se idhujt e tyre i afrojnë më tepër te Allahu i Lartësuar, dhe se vetëm nëpërmjet tyre mund të arrijnë kënaqësinë e Tij. Por ky iluzion i tyre është i kotë, prandaj çdo vepër e përpjekje që bëjnë ka për të dështuar. Për ta është i merituesshëm dhe i pashmangshëm ndëshkimi i ashpër në ahiret, ndërsa idhujt të cilëve u shprehin adhurimin dhe dashurinë e tyre, nuk kanë për t'i sjellë asnjë dobi dhe nuk kanë për t'i larguar asnjë dëm. Madje, pikërisht prej tyre,

nga të cilët presin të mira, do t'u vijë ndëshkimi.

- "Kur paria të distancohet prej pasuesve të tyre, kur të gjithë do ta shohin dënimin dhe kur lidhjet mes tyre do të këputen." – Paria dhe të pasurit e mohuesve do të distancohen nga pasuesit dhe adhuruesit e tyre atë ditë. Atë ditë do të ndërpritet çdo lidhje që ata kanë në jetën e dynjasë, sepse ato janë ndërtuar jo për hir të Allahut dhe jo sipas udhëzimeve të Tij, por janë krijuar mbi baza të paqena. Veprat dhe përpjekjet e tyre do të asgjësohen dhe ata do të binden se idhujt e tyre ishin të gënjeshtërt. Adhurimet që ata mendojnë se do t'u sjellin dobi, janë pikërisht fatkeqësia dhe trishtimi i tyre i pafund. Ata do të jenë përjetësisht në zjarrin e Xhehenemit dhe kurrë nuk do të dalin prej tij. A ka dëshpërim më të madh sesa ky?!

E gjithë kjo do të ndodhë, sepse ata ndjekin dhe zbatojnë të kotën, me vullnet të lirë. Ata shpresojnë te diçka që nuk ekziston, dhe kështu i lidhin zemrat e tyre me hiçin. Me shkatërrimin e veprave të tyre, do të zhduken edhe shpresat e tyre, dhe kjo do t'i bëjë ata të vuajnë tmerrësisht.

Kjo situatë është krejt e kundërt me gjendjen e atyre që i kanë lidhur zemrat me Mbretin e vërtetë, me Allahun. Ata kryejnë çdo vepër e adhurim me sinqeritet vetëm për Njëshin dhe Absolutin, Allahun e Madhëruar. Ata shpresojnë tek i Vetmi që mund të shpresohet. Ata e vendosin të vërtetën në vendin që i takon. Si të tillë, adhurimet e tyre janë të pranueshme e të shpërblyeshme. Ata do të dalin të fituar me veprat që do të paraqesin. Shpërblimi i tyre ka për të qenë i pandërprerë, pranë Zotit të tyre. Në suren Muhamed, ajetet 1-3, i Lartësuari thotë: "Atyre të cilët nuk besojnë, madje pengojnë edhe të tjerët nga rruga e Allahut, Ai ua asgjëson veprat që bëjnë. Ndërsa atyre që besojnë, bëjnë vepra të mira dhe e besojnë atë që iu shpall Muhamedit, e cila është e vërtetë prej Zotit të tyre, atyre ua fshin gjynahet dhe ua përmirëson gjendjen."

- "Atëherë, pasuesit do të thonë: "Ah, sikur të na lejohej një kthim *(në dynja)* dhe t'i braktisnim, sikurse ata na braktisën tani!" Kështu, Allahu do t'ua tregojë veprat e tyre, si dëshpërim për ta, dhe ata kurrë nuk kanë për të dalë prej Zjarrit." - Ditën kur të shohin rezultatet e veprave të tyre të kota, të mashtruarit që kanë ndjekur parinë e tyre, do të dëshirojnë të kthehen sërish në dynja, që t'u jepet edhe një herë mundësia të distancohen dhe të braktisin parinë e tyre mashtruese, që i kanë penguar nga rruga e drejtë e Zotit. Kështu, ata do të kërkojnë të rikthehen në dynja, me qëllim që të largohen nga idhujtaria dhe që adhurimin, dashurinë e nënshtrimin t'ia përkushtojnë Allahut, të Vetmit Zot në qiej dhe në tokë. Por afati i tyrë atëherë do të ketë skaduar, sepse nuk ka më kohë për të kryer vepra.

Megjithatë, pretendimi i tyre se po të ktheheshin sërish në dynja, do të adhuronin vetëm Allahun me sinqeritet, është i gënjeshtërt, sepse ata përsëri do t'u ktheheshin veprave të tyre të ndyra. Prandaj ato do të jenë veçse fjalë nga ana e tyre, të cilat shprehin dëshpërimin dhe pikëllimin për braktisjen që do t'u bëjë paria atë ditë të vështirë, Ditën e Gjykimit.

Atë ditë, në supet e secilës do të rëndojë gjynahu i vet, ndërsa kreu i të gjithë të këqijave është Iblisi, i cili, Ditën e Dëshpërimit do t'u mbajë një fjalim të shëmtuar pasuesve të tij. Allahu i Lartësuar thotë: "E kur gjithçka të ketë përfunduar, Shejtani do të thotë: "Vërtet, Allahu ju kishte premtuar të vërtetën. Edhe unë ju kisha premtuar, por nuk e zbatova premtimin tim. Megjithatë, unë nuk kisha asnjë fuqi ndaj jush *(që t'ju detyroja)*. Unë veçse ju bëja ftesë, e ju më përgjigjeshit. Prandaj mos më qortoni mua, por qortoni veten! tashmë unë nuk mund të jem shpëtimtari juaj, e as ju nuk mund të jeni shpëtimtarët e mi. Unë distancohem nga idhujtaria juaj në të shkuarën *(në jetën e dynjasë)"*. Nuk ka dyshim se jobesimtarët do të kenë dënim të

dhembshëm. Ndërsa ata të cilët besojnë dhe bëjnë vepra të mira do të vendosen në Xhenete, nëpër të cilët rrjedhin lumenj, ku do të jenë përgjithmonë, me lejen e Zotit të tyre. Përshëndetja e tyre atje do të jetë "Selam!". [Ibrahim 22,23].

Ajetet 168 – 171

168. O njerëz! Hani nga ato ushqime të lejuara dhe të mira që gjenden në tokë, e mos shkoni pas hapave të shejtanit. Ai është vërtet armiku juaj i betuar.
169. Ai ju urdhëron vetëm për të këqija dhe poshtërsi. Ai ju shtyn që të thoni për Allahun gjëra që nuk i dini.
170. Kur atyre *(idhujtarëve)* u thuhet: "Pasoni atë që shpalli Allahu!" Ata thonë: "Jo, ne ndjekim atë rrugë që kishin të parët tanë!" Edhe sikur të parët e tyre të mos kishin kuptuar asgjë dhe të mos ishin të udhëzuar në rrugën e drejtë.
171. Mohuesit u përngjajnë bagëtive, të cilat, kur i thërret dikush *(bariu)*, dëgjojnë vetëm britmë dhe zë. Ata janë të shurdhër, memecë, të verbër dhe nuk kuptojnë asgjë.

Shpjegimi i ajeteve

- "O njerëz! Hani nga ato ushqime të lejuara dhe të mira që gjenden në tokë" - Ky është një urdhër që i drejtohet të gjithë njerëzimit, besimtarëve dhe jobesimtarëve, që tregon bujarinë e Allahut të Lartësuar ndaj tyre. Ai i urdhëron njerëzit që të hanë nga prodhimet e gjallesat e tokës, qofshin ato drithëra, fruta, agrume, kafshë etj., por me kusht që ato duhet të jenë të lejuara prej Tij. Njerëzit nuk duhet të prekin as ato gjëra që ndihmojnë në përhapjen e haramit, i cili sjell shkatërrim në tokë.

Ndërsa kusht i dytë është që ato duhet të jenë të mira e të këndshme, e jo të ndyra e të neveritshme, si p.sh. gjaku, mishi i derrit etj.

Ky ajet vërteton se, çdo gjë, në origjinën e saj, është e lejuar të hahet dhe të shfrytëzohet. Ndërsa haram është vetëm ajo gjë për të cilën ka fakte se Zoti e ka bërë të tillë. Gjërat e ndaluara janë dy llojesh:
1. Të ndaluara për shkak se janë vetë të ndyra e të dëmshme. Këto janë të kundërtat e gjërave të mira e të këndshme.
2. Të ndaluara jo për shkak se janë vetë të ndyra e të dëmshme, por për shkak të pasojës apo gjynahut ku ato të çojnë. Ato të shpien në shkeljen e të drejtave të Zotit, ose në shkeljen e të drejtave të krijesave. Ky lloj është i kundërt me kategorinë e gjërave hallall, të lejuara nga Allahu.

Kështu, përfitimi prej begative të Zotit duhet të plotësojë dy kushte: së pari, ato të jenë vërtet të mira, të këndshme e të pastra dhe, së dyti, të jenë të lejuara, në mënyrë të tillë që të mos shkelin të drejtat e Zotit dhe as të robërve.

Ky ajet vërteton, gjithashtu, që të ushqyerit sa për të mbajtur veten gjallë është i detyrueshëm për njeriun. Kjo do të thotë që, nëse ai nuk e bën një gjë të tillë, është gjynahqar, sepse urdhërimi tregon detyrim, dhe kush nuk e zbaton atë pa arsye të pranueshme, meriton ndëshkimin e të Madhëruarit.

Pasi urdhëron rendjen pas gjërave që sjellin dobi e mirësi, Allahu i Madhëruar ndalon ndjekjen e rrugëve të humbjes, të cilat të çojnë në shkatërrim dhe dëshpërim. Ai i ndalon njerëzit nga pasimi i hapave të shejtanit, i cili është armiku i tyre i përbetuar, duke thënë:

- "...e mos shkoni pas hapave të shejtanit. Ai është vërtet armiku juaj i betuar." – Pra, mos shkoni pas hapave të të mallkuarit.

Hapat e shejtanit janë urdhrat e tij. Ato përfshijnë të gjitha zullumet, duke filluar nga ato të pafalshmet, si mohimi i Zotit dhe idhujtaria, e duke vazhduar me gjynahet e tjera, si bërja haram e gjërave që Allahu i Lartësuar i ka bërë të lejuara, apo urdhërimin për ngrënien e ushqimeve që janë haram.

Allahu i Lartësuar e ka cilësuar shejtanin si: "*aduun mubîn*", domethënë armik që e

shfaq hapur armiqësinë, pa e fshehur aspak atë. Ky armik, me urdhrat që jep, synon veçse mashtrimin dhe të keqen e njeriut. Ai dëshiron që edhe njeriu të bëhet banor i Zjarrit përvëlues.

Kështu, Allahu i Lartësuar nuk është mjaftuar duke na ndaluar nga pasimi i hapave të shejtanit, por na ka bërë të qartë, gjithashtu, se ai është armiku ynë i hapur.

Më tej, Allahu i Lartësuar, që është më i vërteti në fjalët e Tij, na përshkruan urdhrat e këtij armiku të mallkuar, që të shtyn larg mëshirës së Mëshiruesit:

- "Ai ju urdhëron vetëm për të këqija dhe poshtërsi." - Kuptimi: Ai ju urdhëron për të këqija, të cilat e trishtojnë personin që i kryen ato.

Fjala "të këqija" përfshin të gjitha llojet e gjynaheve dhe të mosbindjes ndaj Zotit. Më pas vjen fjala "*faĥshã*" – "poshtërsi", domethënë vepra e keqe në mosbindje ndaj Zotit, e cila sigurisht që përfshihet në termin "të këqija", por ajo përmendet në mënyrë të veçantë për të përshkruar më hollësisht gjërat për të cilat urdhëron shejtani. Kështu, shejtani i urdhëron njerëzit për bërë të këqija, të cilat sjellin dëshpërim për vepruesit e tyre, dhe për të bërë vepra të ulëta, sikurse janë imoraliteti, konsumi i pijeve dehëse, vrasja pa të drejtë e tjetrit, shpifjet, koprracia etj., të cilat janë të fëlliqura për çdo njeri me logjikë.

Një ndër veprat më të ndyra për të cilën shejtani i urdhëron njerëzit, është edhe ajo që thotë Allahu: "Ai ju shtyn që të thoni për Allahun gjëra që nuk i dini" - Në këtë përcaktim hyjnë:

- Ata që flasin rreth Allahut pa dije të sigurt dhe pa dëshmi të qarta, të sjella nga Ai, nëpërmjet Profetit të Tij.

- Ata që flasin rreth dispozitave dhe përcaktimeve të Zotit, pa dije dhe pa fakte.

- Ata që e përshkruajnë Allahun ndryshe nga ç'e ka përshkruar Ai Veten dhe ndryshe nga ç'e ka përshkruar Atë Profeti i Tij.

- Ata të cilët ia mohojnë Zotit ato cilësi, emra dhe vepra të Tij, të cilat Ai i ka pohuar për Veten e Tij dhe i ka pohuar për të Profeti i Tij.

- Ata të cilët pretendojnë se Allahu i Lartësuar ka partnerë të barabartë me Të, të cilët i afrojnë adhuruesit e tyre tek Allahu i Lartësuar. Këta besojnë se idhujt, të cilët i adhurojnë dhe u përkushtohen, do t'i afrojnë më shumë tek Allahu i Lartësuar.

- Ata të cilët thonë: "Allahu e ka bërë këtë të lejuar dhe atë të ndaluar, për këtë ka urdhëruar dhe për atë ka ndaluar", duke mos pasur asnjë dije dhe dëshmi nga Allahu i Lartësuar dhe Profeti i Tij.

- Ata të cilët pretendojnë se Allahu e ka krijuar këtë apo atë gjë, për këtë shkak dhe atë arsye, duke mos pasur për këtë dëshmi të sigurt nga Zoti dhe Profeti i Tij.


- Ata të cilët i interpretojnë fjalët e Allahut dhe të Profetit të Tij, duke u dhënë atyre kuptime që Allahu i Lartësuar dhe Profeti i tij nuk i kanë synuar kurrë, por që i kanë sajuar veç njerëzit e humbur. Ata e kuptojnë fjalën e Allahut dhe të Profetit të Tij veçse në formën dhe mënyrën e diktuar nga grupet e humbura, që janë pasues të shejtanit.

Njerëzit që flasin për Allahun pa dije konsiderohen si pasuesit më të këqij të shejtanit, sepse ata i pengojnë njerëzit të pinë nga i vetmi burim i shpëtimit të tyre, që është fjala e Zotit dhe e Profetit të Tij.

Të folurit për Allahun pa dije dhe pa fakte është nga ligësitë më të mëdha që shejtani i mallkuar dhe ushtria e tij urdhërojnë. Ata përdorin të gjitha kurthet dhe mashtrimet për të devijuar krijesat nga e vetmja rrugë e vërtetë.

Ndërsa Allahu i Lartësuar, nga ana tjetër, urdhëron për drejtësi, për vepra të mira e bamirësi ndaj të afërmve, dhe ndalon nga veprat e ulëta, të këqija dhe padrejtësitë.

Kështu, robi gjendet mes dy ftesave, prandaj le të jetë i kujdesshëm se cilën rrugë do të pasojë, se fjalën e kujt do të dëgjojë dhe do të zbatojë. A do të ndjekë ftesën e Allahut drejt lumturisë së dynjasë dhe të ahiretit? A



do të pranojë urdhrin, bindja ndaj të cilit sjell sukses, lumturi dhe prehje? A do të pasojë rrugën e Bamirësit të madh, i cili urdhëron veçse për mirësi dhe çdo gjë të dobishme dhe ndalon nga çdo gjë e keqe, e neveritshme dhe e dëmshme? Apo do të zgjedhë ftesën e shejtanit të mallkuar, i cili është armik i hapur i tij?!

Si mund të ndjekë robi rrugën e atij që i dëshiron të keqen, dëshpërimin dhe vuajtjen në këtë jetë dhe në jetën tjetër?! A nuk e di ai se çdo e keqe vjen si pasojë e pranimit të ftesës së shejtanit dhe e miqësimit me të?! I mallkuari urdhëron veçse për vepra të fëlliqura e shkatërruese, dhe ndalon nga çdo vepër e mirë dhe e dobishme.

Pastaj Allahu i Lartësuar flet për gjendjen e idhujtarëve dhe për mënyrën se si reagojnë ata kur ftohen për të pasuar rrugën e drejtë, të sjellë nga Profeti i Allahut. Ai na tregon përgjigjen e tyre, kur ftohen për të pasuar Shpalljen nga Zoti i gjithësisë. Kështu, edhe pse janë njohur me ftesat e mësipërme, ata thonë:

- "Kur atyre *(idhujtarëve)* u thuhet: "Pasoni atë që shpalli Allahu!" Ata thonë: "Jo, ne ndjekim atë rrugë që kishin të parët tanë!"" – Pra, ata mjaftohen me pasimin e verbër të paraardhësve të tyre, duke qëndruar mospërfillës ndaj udhëzimit të sjellë nga profetët e Zotit. Ata nuk i shqetëson fakti që të parët e tyre, rrugën e të cilëve e pasojnë verbërisht, kanë qenë injorantë, të humbur dhe të larguar nga rruga e drejtë e Zotit. Justifikimi i tyre për refuzimin e të vërtetës është shumë i dobët dhe i pavend. Madje, ai vërteton se refuzimi i tyre bëhet me vetëdije, dhe kështu ata nuk tregohen të drejtë në vlerësimin e të vërtetës. Nëse do të synonin dhe do të përpiqeshin sinqerisht që të gjenin udhëzimin e vërtetë, pa dyshim që do ta mësonin dhe pranonin atë. Çdokush që synon të vërtetën dhe bën një krahasim mes saj dhe të kotës, e kupton lehtësisht se cila është e vërteta dhe, nëse do të jetë njeri i drejtë, do ta pasojë pa u lëkundur atë.

Pastaj i Madhëruari thotë:

- "Edhe sikur të parët e tyre të mos kishin kuptuar asgjë dhe të mos ishin të udhëzuar në rrugën e drejtë." - Kjo tregon se ata janë njerëz që nuk e pranojnë apo nuk janë të aftë që ta pranojnë të vërtetën. Ata nuk e mposhtin dot kryeneçësinë e tyre. Për këta lloj njerëzish, Allahu i Lartësuar sjell një shembull, i cili përshkruan gjendjen e tyre kur ftohen të ndjekin fenë e drejtë të Allahut.

- "Mohuesit u përngjajnë bagëtive, të cilat, kur i thërret dikush *(bariu)*, ato dëgjojnë vetëm britmë dhe zë." – Pra, ata u përngjajnë bagëtive, të cilat veç sa dëgjojnë zërin e bariut, por nuk kuptojnë se çfarë thotë ai. Edhe mohuesit, ashtu si bagëtitë, e dëgjojnë atë që i fton në rrugën e drejtë, por nuk reagojnë me logjikë ndaj zërit që dëgjojnë. Për këtë arsye, Allahu thotë:

- "Ata janë të shurdhër, memecë, të verbër dhe nuk kuptojnë asgjë." – Ata janë '*summun*', pra, të shurdhër, që nuk e

dëgjojnë të vërtetën me logjikë, për ta kuptuar dhe për t'iu bindur asaj. Ata janë *'umjun'* - të verbër, që nuk i shohin faktet, për ta dalluar të vërtetën nga e kota, dhe nuk marrin mësime prej tyre. Ata janë gjithashtu *'bukmun'* – memecë, që nuk e thonë kurrë të vërtetën, e cila është në dobinë e tyre.

Cili është shkaku i kësaj gjendjeje? Allahu i Lartësuar thotë: "ata nuk kuptojnë". Pra, shkaku është që ata nuk kanë mendje të shëndoshë, por janë mendjelehtë dhe injorantë.

E si mund të dyshosh në mendjelehtësinë e dikujt që, kur ftohet në rrugën e drejtë, kur ftohet për t'u larguar nga shkatërrimi e për t'u ruajtur nga ndëshkimi, kur urdhërohet për vepra të mira, që janë në dobi të tij, kur ftohet në rrugën që i siguron suksesin dhe lumturinë, ai, çuditërisht, e refuzon ftesën dhe nuk i bindet urdhrit të Zotit të tij?! Çfarë mund të thuhet tjetër për një njeri, i cili, me vetëdije, i hyn rrugës së Zjarrit, duke ndjekur të kotën dhe duke shpërfillur të vërtetën?! A mund të thuhet që një i tillë është i mençur?! Jo, pa dyshim që ai është më mendjelehti dhe më injoranti që mund të ekzistojë.

Ajetet 172 - 173

172. O ju që keni besuar! Hani nga të mirat me të cilat ju kemi begatuar dhe falënderoni Allahun, nëse jeni të sinqertë në adhurimin e Tij.
173. Juve ju janë ndaluar veçse të ngordhurat, gjaku, mishi i derrit dhe ato *(kafshët)* që theren në emër të dikujt tjetër veç Allahut. E kush detyrohet *(të hajë njërën nga këto)*, duke mos pasur për qëllim shijen dhe duke mos e tepruar, për të nuk është gjynah *(nëse i ha)*. Vërtet, Allahu është Falës e Mëshirues.

Shpjegimi i ajeteve

- "O ju që keni besuar!" - Ky urdhër u drejtohet besimtarëve, pas atij që i drejtohej të gjithë njerëzimit. Ky veçim ndodh për arsye se të vetmit që përfitojnë vërtet prej urdhrave dhe ndalesave të Zotit janë pikërisht besimtarët. Ata janë të vetmit që i marrin në konsideratë urdhrat dhe ndalesat, duke i respektuar ato, dhe këtë e bëjnë të shtyrë vetëm nga besimi që kanë në zemër.

- "Hani nga të mirat me të cilat ju kemi begatuar" - Në këtë ajet, Allahu i Lartësuar i urdhëron besimtarët që të përfitojnë prej çdo gjëje që quhet e mirë dhe e këndshme, si dhuratë prej Zotit Bujar dhe Mëshirues. Ai i urdhëron, gjithashtu, që ata të jenë mirënjohës për mirësitë e dhuruara prej Tij, duke i shpenzuar dhe shfrytëzuar ato për bindjen ndaj Zotit të tyre. Kështu, Allahu i Lartësuar u jep besimtarëve të njëjtat urdhra që u ka dhënë profetëve të Tij, siç thuhet në ajet: "O ju të dërguar të Zotit! Hani prej mirësive dhe punoni vepra të mira…" [Haxh]. Mirënjohja për të cilën Allahu i Lartësuar urdhëron besimtarët është pikërisht "kryerja e veprave të mira" për të cilën ka urdhëruar profetët.

Duke qenë se ky ajet u drejtohet besimtarëve, aty nuk përmendet që gjërat duhet të jenë të lejuara, sikurse ndodh në ajetin që u drejtohet njerëzve në përgjithësi. Arsyeja është se nuk ka nevojë që t'u thuhet besimtarëve, se të mirat që duhet të hanë, duhet të merren në mënyrë të lejuar, pasi besimi i tyre nuk i lejon të shfrytëzojnë diçka në mënyrë jo të lejuar.

Po ashtu, nëse njeriu i përdor mirësitë e Zotit për të adhuruar Atë, ai nuk do të merret në përgjegjësi për to Ditën e Gjykimit. Ai i ka hallall ato mirësi që i shfrytëzon dhe i përdor në bindjen ndaj Zotit. Ndërsa mohuesi, i cili nuk i shfrytëzon mirësitë e Zotit për ta adhuruar Atë dhe për të treguar mirënjohjen ndaj Tij, do të merret në përgjegjësi për to në Ditën e Gjykimit, edhe nëse i përdor ato në mënyrë të lejuar në këtë botë. Mirësitë që ai mund të gëzojë në këtë jetë, duke qenë se nuk tregohet mirënjohës për to dhe nuk i shfrytëzon për adhurimin e Zotit, në realitet ai i ka haram dhe do të mbajë përgjegjësi për to.

- "…dhe falënderoni Allahun, nëse jeni të sinqertë në adhurimin e Tij." - Me fjalë të tjera, ajeti kuptohet kështu: Ai që nuk tregon mirënjohje ndaj Zotit, nuk e adhuron Atë si Një të vetëm, sepse çdokush që tregohet mirënjohës ndaj Tij, patjetër që do të jetë adhurues i Tij dhe zbatues i rregullt i të gjitha urdhrave të Tij.

Ky ajet tregon, gjithashtu, se konsumimi i gjërave të mira dhe të lejuara bëhet shkak dhe ndihmë për të kryer vepra të mira, dhe çka është më e rëndësishme, që ato të konsiderohen si të pranuara te Zoti i Lartësuar.

Shfrytëzimi i mirësive e bën të detyrueshme mirënjohjen për to, e cila sjell dy gjëra, njëra më e mirë se tjetra: së pari, ruajtjen e imanit dhe të mirësive ekzistuese dhe, së dyti, shtim të mirësive të tjera. Mosmirënjohja ose mohimi i mirësive, nga ana tjetër, largon mirësitë ekzistuese dhe ato që priten të vijnë.

Më tej, pasi lejon përdorimin e gjërave të pastra, të këndshme dhe të dobishme, Allahu i Lartësuar ndalon gjërat e pista, të këqija e të dëmshme, duke thënë:

- "Juve ju janë ndaluar veçse të ngordhurat, gjaku, mishi i derrit" – "Të ngordhura" (*el mejtetu*) konsiderohen kafshët që kanë ngordhur jo prej therjes së rregullt të përcaktuar nga Sheriati. Ato ndalohen të hahen, sepse janë të pista dhe të neveritshme. Në shumicën e rasteve, ngordhja vjen si pasojë e sëmundjeve të ndryshme të kafshës, dhe kjo ia shton më tepër dëmin.

Prej të ngordhurave, që ndalohen të hahen, përjashtohen karkalecat e tokës dhe të gjitha gjallesat e detit. Këto dy kategori janë të lejuara dhe të pastra, edhe nëse nuk theren sipas Sheriatit.

Ndërsa gjaku i ndaluar është lëngu i damarëve, që del me forcë, sikurse është përcaktuar në një ajet tjetër të Kur'ânit: "Thuaj: "Unë nuk gjej në atë që më është shpallur mua asnjë ushqim të ndaluar, veç nëse ai është: cofëtinë, gjak i derdhur ose mish derri, se këto janë të ndyra; dhe përveç mishit që është therur jo në emër të Allahut E kush detyrohet *(t'i hajë këto të ndaluara)*, duke mos pasur për qëllim shijen dhe duke mos e tepruar, *(ta dijë se)* Zoti yt është Falës e Mëshirues." [En'am 145].

- "…dhe ato *(kafshët)* që theren në emër të dikujt tjetër veç Allahut." – Domethënë, gjatë therjes të së cilave përmendet emri i dikujt tjetër, përveç Allahut, qofshin ata idhuj prej guri, të vdekur, varre etj.

Këto që u përmendën deri tani nuk janë të gjitha llojet e të ndaluarave, por janë ato që quhen të këqija, të pisëta, të neveritshme e të dëmshme. Me fjalë të tjera, këto janë sjellë si shembuj, për të treguar se Allahu i Lartësuar ka ndaluar veçse gjërat e neveritshme dhe të dëmshme.

Allahu i Lartësuar na i bëri të ndaluara këto gjëra të neveritshme, në shenjë butësie dhe mëshire ndaj nesh, për të na ruajtur nga çdo gjë e dëmshme. Megjithatë, Allahu i Lartësuar dhe i Mëshirshëm thotë:

- "E kush detyrohet *(të hajë njërën nga këto)*, duke mos pasur për qëllim shijen dhe duke mos e tepruar, për të nuk është gjynah *(nëse i ha)*" – Pra, çdokush që ndihet i detyruar për të konsumuar këto ushqime të ndaluara, i lejohet ta bëjë, por me disa kushte:

Së pari, të jetë i detyruar për t'i përdorur ato. Një rast i tillë është, për shembull, kur njeriu nuk ka asgjë për të konsumuar përveç këtyre harameve; përndryshe mund të vdesë. Një rast tjetër është kur kërcënohet seriozisht, nëse nuk e konsumon atë haram.

Së dyti, të mos synojë haramin, ndërkohë që ka mundësi të përdorë hallallin, ose kur nuk është e domosdoshme diçka e tillë. Pra, kur nuk është plotësuar kushti i të qenit i detyruar, i shtrënguar.

Kusht tjetër është që të mos teprohet me masën e lejuar. Pra, nuk duhet të kalohet masa mbi të domosdoshmen.

Për atë njeri që e ka të domosdoshëm përdorimin e haramit, pasi nuk ka asnjë mundësi të përdorë hallallin, dhe nuk e tejkalon masën që e ka të domosdoshme, për atë, pra, Allahu i Lartësuar thotë që nuk ka gjynah. Ai nuk do të merret në përgjegjësi për konsumin e kësaj të ndaluare. Madje, në rast të tillë, njeriu është i urdhëruar që ta konsumojë atë, për të mbajtur trupin gjallë. Ai e ka të ndaluar që të shkojë me këmbët e veta drejt shkatërrimit dhe vdekjes; ai e ka të ndaluar të vrasë veten. Për këtë arsye, njeriu do të merret në përgjegjësi nëse e le ushqimin deri në vdekje, sepse konsiderohet si vetëvrasje.

Ky lejim është mëshirë nga Allahu i Lartësuar për adhuruesit e Tij, prandaj e mbyll ajetin duke përmendur dy emrat e Tij të bukur:

- "Vërtet, Allahu është Falës e Mëshirues." - Duke qenë se lejimi i këtyre të ndaluarave është i kushtëzuar, dhe dihet që robi nuk mund t'i përmbushë plotësisht kushtet e caktuara, atëherë Allahu i Lartësuar tregon se Ai është Falës e Mëshirues, mbulues i të metave dhe mangësive të robit. Allahu fal dhe mëshiron shumë, sidomos kur nevoja e madhe e rëndon njeriun.

Ky ajet vërteton rregullin e madh në Islam, që thotë: "Domosdoshmëria e bën të lejueshme të ndaluarën". Pra, në çdo situatë ku njeriu detyrohet të përdorë haramet, Sunduesi i Mëshirshëm ia lejon një gjë të tillë. Allahut i qoftë përherë lavdia dhe mirënjohja!

Ajetet 174 – 176

174. Ata që fshehin nga Libri atë që shpalli Allahu, për të fituar me të një shpërblim të vogël, ata fusin vetëm zjarr në barkun e tyre. Në Ditën e Gjykimit, Allahu nuk do t'u flasë atyre dhe as nuk do t'i shfajësojë, por ata do të kenë një dënim të dhembshëm.

175. Ata e kanë këmbyer humbjen me udhëzimin dhe kanë parapëlqyer dënimin, në vend të shpëtimit. Sa të durueshëm do të jenë ata ndaj Zjarrit?!

176. Kjo, për shkak se Allahu e zbriti Librin me të vërtetën e sigurt. Sigurisht, ata që nuk u pajtuan rreth tij, janë në përçarje, shumë larg nga e vërteta.

Shpjegimi i ajeteve

Këto ajete janë një kërcënim i ashpër për këdo që fsheh diçka prej Shpalljeve që Allahu i Lartësuar u dha profetëve. Ato janë kërcënim për këdo që fsheh dijen për të cilën Allahu i Lartësuar, atyre që ua dhuroi, u mori besën se do t'ua sqaronin njerëzve dhe nuk do ta fshihnin.

- "Ata që fshehin nga Libri atë që shpalli Allahu, për të fituar me të një shpërblim të vogël..." – Domethënë, ata të cilët për hir të kësaj bote mashtruese dhe të parëndësishme, e shpërfillin urdhrin e Allahut për qartësimin e së vërtetës. Për këta është një kërcënim i ashpër:

- "...ata fusin vetëm zjarr në barkun e tyre." - Fitimi që ata marrin me mënyrën e fëlliqur është haram e i shëmtuar. Për këtë arsye, zjarri në barkun e tyre është shpërblimi më i drejtë, sipas punës që kanë bërë.

- "Në Ditën e Gjykimit, Allahu nuk do t'u flasë atyre" - Allahu do të jetë i zemëruar me ta, prandaj nuk do t'i përfillë kërkesat e tyre. Kjo do të jetë shumë më e dhimbshme për ta, sesa vetë ndëshkimi në Zjarr.

- "...dhe as nuk do t'i shfajësojë, por ata do të kenë një dënim të dhembshëm." - Domethënë, Allahu nuk do t'i pastrojë ata nga cilësitë e tyre të ulta, sepse nuk kanë bërë kurrë ndonjë vepër për të cilën mund të lëvdohen dhe mund të meritojnë kënaqësinë e Allahut të Lartësuar dhe shpërblimin e Tij.

Allahu i Lartësuar nuk i pastron ata për të vetmen arsye: për shpërfilljen nga ana e tyre e Librit të Zotit, duke mos zbatuar dispozitat e Tij dhe duke mos i ftuar njerëzit që ta pasojnë dritën e sjellë nëpërmjet tij.

- "Ata e kanë këmbyer humbjen me udhëzimin dhe kanë parapëlqyer dënimin, në vend të shpëtimit." - Ata nuk e ndjekin udhëzimin e sjellë në Librin e Zotit, por i kthejnë shpinën atij, duke parapëlqyer rrugën e humbjes, kundrejt dritës së udhëzimit, duke zgjedhur ndëshkimin, kundrejt faljes së Zotit. Të tillëve u shkon për shtat veçse zjarri i Xhehenemit.

- "Sa të durueshëm do të jenë ata ndaj Zjarrit?!" - *Subhanallah*! A mund ta durojnë ata zjarrin e Xhehenemit! Ku do ta gjejnë forcën për ta përballuar?!

- "Kjo, për shkak se Allahu e zbriti Librin me të vërtetën e sigurt." - Ky shpagim i drejtë që u bëhet tyre, duke mos u dhënë sukses të gjejnë udhën e drejtë, ka një shkak: se Allahu i Lartësuar e zbriti Librin me të vërtetën e pakundërshtueshme.

Një e vërtetë e padiskutueshme është fakti që, vepërmirët do të shpërblehen me të mira dhe vepërkëqijtë do të marrin atë që u takon. Nëpërmjet të vërtetës së sigurt dallohet udhëzimi i drejtë nga rrugët e humbjes.

Për këto arsye, kush përpiqet të ndryshojë Librin e Zotit dhe qëllimet e tij, meriton ndëshkimin më të madh.

- "Ata që nuk u pajtuan rreth tij" – Domethënë, ata të cilët u kundërshtuan rreth librit të Zotit.

Kundërshtimi i një libri hyjnor bëhet në dy mënyra: së pari, duke besuar një pjesë të tij dhe duke mohuar pjesën tjetër dhe, së dyti, duke e ndryshuar apo tjetërsuar atë sipas shijeve, interesave dhe dëshirave të njerëzve. Një gjë është e sigurt: zbatimi rigoroz i Librit të Zotit sjell unitet e dashuri mes njerëzve, ndërsa kundërshtimi i tij sjell përçarje, urrejtje dhe armiqësi mes tyre.

Këta lloj njerëzish janë, ashtu sikurse thotë Allahu i Lartësuar:

- "…në përçarje, shumë larg nga e vërteta." – Arsyeja është se ata e kundërshtojnë Librin e Zotit, që sjell të vërtetën e sigurt, që, rrjedhimisht, sjell bashkimin e të gjithëve në një qëndrim. Nëse do të ndiqnin të vërtetën që ndodhet në Librin hyjnor, ata do të shpëtonin nga ndarjet, fraksionet e grupimet, që gjithmonë janë në kundërshti dhe armiqësi me njëri tjetrin. Ndërsa fatlumët nga ithtarët e Librit, të cilët i besojnë plotësisht të gjitha shpalljet e Zotit, gjykojnë me Librin e Tij në çdo çështje dhe, për këtë arsye, janë të bashkuar e të lumtur.

Në këto ajete ka shumë dobi e mësime. Aty paraqitet kërcënimi i ashpër për këdo që fsheh pjesë nga shpalljet e Zotit, duke i dhënë përparësi jetës së kësaj dynjaje mashtruese, por duke merituar ndëshkimin dhe zemërimin e Allahut të Lartësuar. Ne mësojmë se Allahu i Lartësuar nuk do t'i pastrojë kurrë të tillë njerëz, që bëjnë këtë punë, që nënkupton se atyre nuk do t'u jepet sukses për të gjetur e ndjekur udhëzimin e drejtë dhe nuk do t'u mbulohen të metat me faljen dhe mëshirën e Allahut. Shkaku i këtij shpagimi është përzgjedhja me vetëdije e tyre e ndëshkimit të Zotit, kundrejt faljes dhe mëshirës së Tij.


Allahu i Lartësuar thotë për ta: "Sa të durueshëm do të jenë ata ndaj Zjarrit?!" Pra, ata që bëjnë shkaqet që të fusin në Xhehenem, duke qenë të vetëdijshëm për këtë, duket sikur mendojnë se mund të durojnë zjarrin e përgatitur për ta. Por Allahu i Lartësuar hedh poshtë çdo pandehmë të gabuar për Zjarrin që i pret, pasi ai është shumë më i madh sesa mund të përfytyrohet.

Në ajete mësojmë se Libri i shpallur nga Zoti përmban të vërtetën e sigurt, e cila është e vetmja mënyrë për bashkim mes njerëzve. Ata që kundërshtojnë Librin hyjnor kanë

humbur thellë e larg, duke u bërë pjesë e përçarjes së madhe, që trazon botën.

Ajeti 177

177. Mirësia nuk është që thjesht t'i ktheni fytyrat tuaja drejt lindjes ose perëndimit. Mirësi e vërtetë është e atij që beson Allahun, Ditën e Fundit, engjëjt, librat dhe profetët; e atij që, prej pasurisë që e do, u jep të afërmve, jetimëve, të varfërve, udhëtarëve të mbetur në rrugë, lypsave dhe për lirimin e robërve; e atij që fal namazin e jep zekatin; dhe e atyre që, kur premtojnë, e mbajnë fjalën e dhënë; e atyre që janë të durueshëm në skamje, në sëmundje dhe në flakën e luftës. Vetëm këta e tregojnë sinqeritetin e tyre dhe vetëm këta janë të devotshëm.


الجزء الثاني — سورة البقرة — الحزب

لَّيْسَ ٱلْبِرَّ أَن تُوَلُّوا۟ وُجُوهَكُمْ قِبَلَ ٱلْمَشْرِقِ وَٱلْمَغْرِبِ
وَلَٰكِنَّ ٱلْبِرَّ مَنْ ءَامَنَ بِٱللَّهِ وَٱلْيَوْمِ ٱلْءَاخِرِ وَٱلْمَلَٰٓئِكَةِ
وَٱلْكِتَٰبِ وَٱلنَّبِيِّۦنَ وَءَاتَى ٱلْمَالَ عَلَىٰ حُبِّهِۦ ذَوِى ٱلْقُرْبَىٰ وَٱلْيَتَٰمَىٰ
وَٱلْمَسَٰكِينَ وَٱبْنَ ٱلسَّبِيلِ وَٱلسَّآئِلِينَ وَفِى ٱلرِّقَابِ وَأَقَامَ
ٱلصَّلَوٰةَ وَءَاتَى ٱلزَّكَوٰةَ وَٱلْمُوفُونَ بِعَهْدِهِمْ إِذَا عَٰهَدُوا۟ ۖ
وَٱلصَّٰبِرِينَ فِى ٱلْبَأْسَآءِ وَٱلضَّرَّآءِ وَحِينَ ٱلْبَأْسِ ۗ أُو۟لَٰٓئِكَ ٱلَّذِينَ
صَدَقُوا۟ ۖ وَأُو۟لَٰٓئِكَ هُمُ ٱلْمُتَّقُونَ ﴿١٧٧﴾ يَٰٓأَيُّهَا ٱلَّذِينَ ءَامَنُوا۟ كُتِبَ
عَلَيْكُمُ ٱلْقِصَاصُ فِى ٱلْقَتْلَى ۖ ٱلْحُرُّ بِٱلْحُرِّ وَٱلْعَبْدُ بِٱلْعَبْدِ وَٱلْأُنثَىٰ
بِٱلْأُنثَىٰ ۚ فَمَنْ عُفِىَ لَهُۥ مِنْ أَخِيهِ شَىْءٌ فَٱتِّبَاعٌۢ بِٱلْمَعْرُوفِ وَأَدَآءٌ
إِلَيْهِ بِإِحْسَٰنٍ ۗ ذَٰلِكَ تَخْفِيفٌ مِّن رَّبِّكُمْ وَرَحْمَةٌ ۗ فَمَنِ ٱعْتَدَىٰ
بَعْدَ ذَٰلِكَ فَلَهُۥ عَذَابٌ أَلِيمٌ ﴿١٧٨﴾ وَلَكُمْ فِى ٱلْقِصَاصِ حَيَوٰةٌ يَٰٓأُو۟لِى
ٱلْأَلْبَٰبِ لَعَلَّكُمْ تَتَّقُونَ ﴿١٧٩﴾ كُتِبَ عَلَيْكُمْ إِذَا حَضَرَ
أَحَدَكُمُ ٱلْمَوْتُ إِن تَرَكَ خَيْرًا ٱلْوَصِيَّةُ لِلْوَٰلِدَيْنِ وَٱلْأَقْرَبِينَ
بِٱلْمَعْرُوفِ ۖ حَقًّا عَلَى ٱلْمُتَّقِينَ ﴿١٨٠﴾ فَمَنۢ بَدَّلَهُۥ بَعْدَ مَا سَمِعَهُۥ
فَإِنَّمَآ إِثْمُهُۥ عَلَى ٱلَّذِينَ يُبَدِّلُونَهُۥٓ ۚ إِنَّ ٱللَّهَ سَمِيعٌ عَلِيمٌ ﴿١٨١﴾

٢٧

- "Mirësia nuk është që thjesht t'i ktheni fytyrat tuaja drejt lindjes ose perëndimit." – Kuptimi: Bamirësia që u kërkohet adhuruesve nuk është thjesht kthimi drejt lindjes apo perëndimit, që të lodheni aq shumë me të tilla diskutime e polemika të gjata, shumica e të cilave sjellin veçse përçarje dhe armiqësi.

Kjo fjali i ngjan shumë për nga ndërtimi thënies së Profetit (s.a.u.s.): *"I fortë nuk është ai që arrin të mundë tjetrin me forcë. I fortë është ai që e përmban veten gjatë zemërimit."*

- "...Mirësi e vërtetë është e atij që beson Allahun..." – Pra, që beson se Ai është i Vetëm dhe Absolut, me cilësitë më të larta, larg çdo mangësie që i përshkruajnë krijesat.

- "...Ditën e Fundit..." – Ky nocion përfshin, në fakt, gjithçka që do të ndodhë pas vdekjes, ashtu siç na e ka përshkruar Allahu dhe Profeti i Tij.

- "...engjëjt..." – Engjëjt, për vërtetësinë e të cilëve na ka dëshmuar Allahu dhe Profeti i Tij, në Kur'ân dhe në Sunet.

- "...librat..." – Domethënë, të gjithë librat që Zoti ia ka zbritur njerëzimit, nëpërmjet profetëve. Më madhështori i tyre është Kur'âni, prandaj çdokush duhet të besojë në vërtetësinë e gjithçkaje që përmendet në të, dhe duhet ta marrë seriozisht çdo dispozitë e ligj të sjellë në të, për të rregulluar jetën njerëzore.

- "...dhe profetët..." – Pra, duhen besuar të gjithë profetët në përgjithësi, dhe në mënyrë të veçantë Vula e tyre, Profeti i fundit, Profeti i mëshirës, Muhamedi (s.a.u.s.).

- "...e atij që, prej pasurisë që e do, u jep të afërmve, jetimëve, të varfërve, udhëtarëve të mbetur në rrugë, lypsarëve dhe për lirimin e robërve" – "*El mâle*" quhet çdo pasuri që është nën pronësinë e njeriut, qoftë ajo e madhe apo e vogël. Pra, shprehja e bamirësisë së njeriut është shpenzimi i pasurisë që ai zotëron, në fushat në të cilat na ka nxitur Allahu i Lartësuar që të

shpenzojmë. Madje, njeriu duhet të shpenzojë nga kjo pasuri edhe atëherë kur pasuria është shumë e nevojshme dhe robi e ka të vështirë që të japë.

Allahu i Lartësuar thotë: "…prej pasurisë që e do". Pra, shenjë e bamirësisë është edhe shpenzimi i asaj pasurie që robi e dëshiron ta ketë pranë dhe të mos e shpenzojë. Dihet që pasuria është shumë e dashur për njeriun dhe ai e ka shumë të vështirë që ta japë atë, prandaj shpenzimi i saj është tregues bamirësie. Në të njëjtën kohë, ai që e shpenzon pasurinë e tij, edhe pse e do shumë atë, duke synuar që të afrohet tek Allahu i Lartësuar, ka dëshmuar për imanin e tij të pastër.

Por cili konsiderohet si shpenzues i pasurisë nën presionin e dashurisë për të? I tillë konsiderohet ai që shpenzon atë pjesë të pasurisë që e do më shumë dhe ai që jep ndërkohë kur rrezikon varfërinë. I pari, edhe pse ka pasuri tjetër për ta shpenzuar, jep pikërisht atë pjesë që është më e dashura dhe më e çmuara për të, sikurse thotë i Lartësuari në suren Al imran, ajeti 92: "Nuk keni për ta arritur devotshmërinë e vërtetë, derisa të jepni nga ajo *(pasuri)* që e doni." Ndërsa i dyti, është njeriu që jep sadaka, ndërkohë që ka shumë pak pasuri, sepse ai jep nën trysninë e frikës nga varfëria dhe skamja.

Pastaj Allahu i Lartësuar tregon se kujt i jepen këto pasuri:

- "…të afërmve…" - Pra, të parët njerëz që e meritojnë bamirësinë me pasuri, me vepra, me ndjenja dhe me fjalë, janë të afërmit. Të afërmit janë njerëzit që, kur ata lumturohen, edhe ti gëzohesh, e kur ata trishtohen, edhe ti trishtohesh. Të afërmit janë ata që të gjenden pranë në kohë nevoje.

Kështu, ndër bamirësitë më të mëdha është ruajtja e lidhjeve me të afërmit, duke i ndihmuar me pasuri apo duke u thënë fjalë të mira e ngushëlluese. Sigurisht, kjo bëhet në varësi me nevojat e tyre dhe të shkallës së afrimitetit me ta.

- "…jetimëve…" - Ndër njerëzit që meritojnë më së shumti bamirësi janë jetimët,[5] të cilët nuk kanë mundësi që të sigurojnë jetesën e tyre dhe të jenë të pavarur.

Kjo është një shprehje e mëshirës të madhe të Allahut të Lartësuar për krijesat e Tij. Ai është më i kujdesshëm, më i dashur e më i mëshirshëm për robin, sesa prindi për fëmijën e tij. Allahu i Lartësuar i urdhëron njerëzit që të shpenzojnë pasurinë e tyre për fëmijët që nuk i kanë prindërit, në mënyrë që ata të mos e ndiejnë mungesën e përkujdesjes së tyre. Një gjë është e sigurt: Kush e mëshiron jetimin e tjetrit, ta dijë se edhe jetimi i tij do të mëshirohet.

- "…të varfërve…" – Të varfërit kanë të drejta në pasurinë e të pasurve, sepse këta të fundit duhet të ndihmojnë që t'ua largojnë varfërinë atyre, ose, së paku, t'ua lehtësojnë atë. Pra, të pasurit duhet të japin çfarë të munden, për të ndihmuar vëllezërit e tyre të varfër.

- "…udhëtarëve të mbetur në rrugë…" - Prej atyre që duhen ndihmuar, janë edhe udhëtarët që kanë mbetur në mes të rrugës për shkaqe të ndryshme dhe janë larg vendit dhe pasurisë së tyre. Allahu i Lartësuar na nxit që ne të japim prej pasurisë sonë, me qëllim që t'i ndihmojmë këta nevojtarë të përfundojnë udhëtimin e tyre.

Dihet shumë mirë se udhëtimi ka të papritura dhe nevoja të shumta. Për këtë arsye, ata të cilët Allahu i Lartësuar i ka begatuar me të mira materiale dhe me qetësinë pranë vendit dhe pasurisë së tyre, duhet të tregohen mëshirues e bamirës ndaj atij që gjendet larg vendit, pasurisë dhe njerëzve të tij. Ndihma jepet sipas rastit, për shembull, duke e furnizuar me ushqim për udhëtimin e tij, duke i mundësuar mjetin e

[5] Në Islam, 'jetim' konsiderohet fëmija të cilit (ose së cilës) i ka vdekur babai, ose të dy prindërit, dhe ende nuk ka arritur moshën e pjekurisë.

transportit, duke e ndihmuar të plotësojë detyrimet që e pengojnë të kthehet në vendin e tij etj.

- "...lypsarëve..." – Kështu quhen ata të cilët nevoja i shtyn që të kërkojnë. I tillë është, për shembull, dikush që nuk arrin të paguajë ndonjë gjobë të detyrueshme ndaj shtetit, ose dikush që u kërkon njerëzve që të japin për ndërtimin e një xhamie, shkolle, për shërbime të përgjithshme etj. Këta duhen ndihmuar, edhe pse mund të jenë të pasur, porse nevoja urgjente i shtyn që të kërkojnë.

- "...dhe për lirimin e robërve..." – Domethënë, për çlirimin nga skllavëria, në mënyrë të drejtpërdrejtë, ose duke ndihmuar skllavin që ka bërë marrëveshje me zotërinë për të blerë lirinë e tij. Këtu hyn edhe çlirimi i muslimanëve të burgosur ose të kapur rob nga qafirët ose nga tiranët.

- "...e atij që fal namazin e jep zekatin..." – Një shprehje e bamirësisë, të cilën jemi urdhëruar ta kryejmë, është edhe falja e namazit e dhënia e zekatit.

Tashmë është përmendur disa herë që Allahu i Lartësuar e përmend faljen e namazit bashkë me dhënien e zekatit, për shkak se janë dy adhurimet më të mira dhe dy mënyrat më efikase për t'iu afruar Zotit të botëve. Ato janë adhurime që përfshijnë zemrën, trupin dhe pasurinë e robit. Namazi dhe zekati janë matësit e imanit dhe treguesit e sigurisë që gjendet në zemrën e robit për vërtetësinë e premtimit të Zotit.

- "...dhe e atyre që, kur premtojnë, e mbajnë fjalën e dhënë..." – Këtu flitet për premtimin për të kryer diçka që Allahu e ka bërë të detyrueshme, ose që vetë robi ia bën të detyrueshme vetvetes.

Në fakt, në këtë përkufizim hyjnë të gjitha të drejtat e Allahut të Lartësuar mbi robërit e Tij, sepse Allahu i Lartësuar ua ka bërë të detyrueshme adhuruesve që të plotësojnë detyrimet ndaj Tij, të cilat ata me vetëdije i kanë pranuar, duke premtuar se do t'i plotësojnë. Këtu përfshihen edhe të drejtat e krijesave, të përcaktuara nga Allahu i Lartësuar, që të plotësohen në marrëdhëniet mes tyre. Këtu bëjnë pjesë edhe përbetimet e robit, të cilat nuk i ka bërë të detyrueshme Allahu i Lartësuar, por vetë robi ia bën detyrim vetvetes; edhe këto, pra, duhet të çohen në vend dhe të plotësohen.

- "...e atyre që janë të durueshëm në skamje, në sëmundje dhe në flakën e luftës." – Bamirësi tjetër që është urdhëruar të kryhet, është edhe durimi i shprehur në tri momentet e përshkruara në ajet.

- "...në skamje" – Pra, bamirës të vërtetë janë ata që tregohen të durueshëm në gjendje varfërie.

I varfri ka nevojë për durim, për shumë arsye dhe në shumë drejtime. Ai ka nevojë për durim të madh që të përballojë dhimbjet trupore dhe psikologjike, të cilat i përjetojnë veç të varfërit. Nëse të pasurit gëzojnë dhe shijojnë kënaqësi të ndryshme, i varfëri vuan. Kur ha një ushqim që nuk i pëlqen, ai vuan. Kur ndien nevojën të vishet mirë dhe nuk mundet, ai vuan. Kur shikon të tashmen dhe të ardhmen që e pret, dhe ndihet i pasigurt për të, ai vuan. Kur ndien ftohtë dhe nuk gjen me çfarë të ngrohet, ai përsëri vuan.

Të gjitha këto, pra, janë sprova, të cilat jemi urdhëruar t'i durojmë, duke llogaritur shpërblimin e Allahut të Lartësuar për to.

- "...në sëmundje" - Pra, të duruarit gjatë sëmundjeve të të gjitha llojeve. Për çdo sëmundje që godet njeriun është i nevojshëm durimi.

Kur është sëmurë, shpirti dobësohet dhe trupi ndien dhimbje. Sëmundjet janë shumë të vështira për t'u përballuar, sidomos kur ato zgjasin. Në të tilla kushte, njeriu është i urdhëruar të tregohet i durueshëm, që të arrijë shpërblimin e pamasë, të përgatitur nga Allahu i Lartësuar për durimtarët.

- "...në flakën e luftës" – Një nga situatat që kërkon durimin më të madh është koha gjatë betejës kundër armiqve, për të cilët jemi urdhëruar që t'i luftojmë. Durimi në këtë rast është nga veprat më të vështira për shpirtin, sepse janë momente kur njeriu e ndien afër frikën nga vrasja, plagosja apo kapja rob. Për këtë arsye, durimi në luftime është shumë i nevojshëm. Në fakt, luftëtarit në rrugën e Zotit të Madhëruar i lehtësohet durimi kur llogarit shpërblimin e Allahut të Lartësuar dhe faktin që ndihma vjen prej Zotit të gjithësisë, i Cili ka premtuar fitore dhe ndihmë për durimtarët.

- "Vetëm këta e tregojnë sinqeritetin e tyre dhe vetëm këta janë të devotshëm." – Pra, vetëm ata që kanë cilësitë e lartpërmendura janë të sinqertë, që e vërtetojnë besimin e tyre me vepra. Ata kanë besim të drejtë, vepra të mira dhe moral të lartë. Ata janë të sinqertë, që e vërtetojnë besimin, me anë të veprave të tyre.

Por ata meritojnë të quhen edhe "të devotshëm", sepse ata i largohen haramit dhe i zbatojnë me përpikmëri urdhrat e Zotit të tyre. E si të mos u përmbahen dispozitave të vendosura nga Zoti i tyre, kur dihet se ato janë kultivuese të çdo cilësie të lartë.

Mbajtja e premtimeve dhe e përgjegjësive i përfshin të gjitha fushat e jetës dhe të fesë, ndërsa adhurimet e cituara në këtë ajet janë adhurimet më të mëdha të Islamit. Ai që tregohet rigoroz në zbatimin e tyre, me siguri që në adhurimet e tjera do të jetë shumë i rregullt.

Këta janë bamirësit, të sinqertët e të devotshmit. Shpërblimi që Allahu i Lartësuar ka përgatitur për të tillë njerëz, në këtë jetë dhe në jetën tjetër, është i pamundur të tregohet e përshkruhet në një libër të vetëm si ky, me të tilla përmasa.

Ajetet 178 - 179

178. O ju që keni besuar! Për ju u bë obligim shpagimi me barazi *(kisas)* për krimin e vrasjes: i liri për të lirin, skllavi për skllavin dhe femra për femrën. Kurse ai, të cilit i falet gjaku prej vëllait të vet nuk ekzekutohet. Pas faljes, le të sillen butë me të falurin. Ndërsa shpagimi *(kompensimi për vrasjen)*, le t'u jepet me mirësi. Ky është lehtësim dhe mëshirë prej Zotit tuaj. E kushdo që, pas kësaj, e kapërcen kufirin, ka një dënim të dhimbshëm.

179. Në këtë ligj është jeta juaj, o ju mendarë, në mënyrë që të përmbaheni!

Shpjegimi i ajeteve

- "O ju që keni besuar! Për ju u bë obligim shpagimi me barazi *(kisas)* për krimin e vrasjes" - Me këtë dispozitë, Allahu i Lartësuar tregon mirësinë e Tij ndaj besimtarëve, pasi, vërtet, shpagimi me të njëjtën masë i krimit të vrasjes është një nga mirësitë më të mëdha që Zoti ka ligjëruar për njerëzimin.

Allahu i Lartësuar e ka bërë të detyrueshme që vrasësi të ekzekutohet me të njëjtën mënyrë sikurse ai ka ekzekutuar viktimën e tij. Vetëm në këtë mënyrë vendoset drejtësia dhe barazia mes robërve.

Ky urdhër, siç duket nga fillimi, u drejtohet të gjithë besimtarëve. Të gjithë e kanë detyrë që ta dorëzojnë vrasësin para ligjit, që të marrë dënimin e merituar. Madje edhe të afërmit e vrasësit, edhe vetë vrasësi duhet t'i dorëzohet ligjit, në mënyrë që të afërmit e viktimës të marrin shpagimin, nëse ata e kërkojnë një gjë të tillë. Nuk u lejohet besimtarëve që të ndalojnë të afërmit e viktimës të kërkojnë shpagimin, nëse ata duan të ekzekutojnë vrasësin, sipas ligjit përkatës. Ky pengim ndodhte gjatë kohës së injorancës, para Islamit, por jo në Islam. Në kohën e injorancës, ata e strehonin vrasësin, me qëllim që t'i fshihej ligjit, por në Islam drejtësia duhet të shkojë në vend.

Pastaj Allahu i Lartësuar vijon të shpjegojë zbatimin e kësaj dispozite, duke thënë:

- "...i liri për të lirin, skllavi për skllavin dhe femra për femrën". Nga pjesa: "*femra për femrën*" duket, në pamje të parë, sikur drejtësia kërkon që vrasësi dhe i vrari të jenë të së njëjtës gjini, domethënë, sikur femra vritet për femrën, e jo për mashkullin, ndërsa mashkulli vritet për mashkullin, e jo për femrën. Por ky këndvështrim është i papranueshëm dhe nuk merret për bazë. Me fjalë të tjera, nuk është e domosdoshme që vrasësi dhe viktima të kenë të njëjtën gjini, që shpagimi të quhet i drejtë. Për këtë që themi, ne sjellim dy fakte:

Së pari, është vetë fjala e Allahut të Lartësuar: "i liri për të lirin", që do të thotë se mashkulli të ekzekutohet për mashkullin, femra për femrën, femra për mashkullin dhe mashkulli për femrën, sepse fjala "i lirë" i përfshin të gjithë këta.

Këtu duhet të sqarojmë diçka. Çdo tekst që lexohet ka një kumt të drejtpërdrejtë dhe një tjetër të fshehur, të nënkuptuar. Në rastin tonë, katër kategoritë që nxirren nga fraza: "i liri për të lirin" kuptohen në mënyrë të drejtpërdrejtë nga fjalët e saj. Ndërsa kumti i nxjerrë më sipër nga fraza "femra për femrën" është një nënkuptim i saj. Dihet shumë mirë në parimet e *fikh*-ut, se kumtet e drejtpërdrejta janë më parësore për t'u marrë në konsideratë, sesa kumtet e nënkuptuara të tekstit. Kështu, kumti i drejtpërdrejtë i frazës: "i liri për të lirin", në të cilën hyjnë katër grupet e mësipërme, është më parësore që të pranohet, kundrejt kumtit të nënkuptuar të frazës: "femra për femrën", e cila, në pamje të parë, duket sikur tregon që kusht për drejtësinë është edhe marrja në konsideratë e gjinisë së vrasësit dhe viktimës. Por kjo mbështetet edhe nga hadithet e sakta, ku sqarohet se edhe mashkulli vritet për femrën.

Këtu duhet sqaruar edhe diçka tjetër. Nga kjo dispozitë e përgjithshme bëjnë përjashtim prindërit, sepse nuk vritet prindi për fëmijën e tij. Pra, nëse një prind vret fëmijën e tij, ai nuk dënohet me vdekje për këtë krim. Ky përjashtim mbështetet në Traditën profetike, që e sqaron mirë një gjë të tillë. Ai mbështetet edhe në fjalën e Allahut "*kisas*", pra: "shpagim me barazi", sepse nuk është e drejtë dhe nuk tregon barazi që prindi të ekzekutohet për fëmijën që ka vrarë, pasi një prind ka aq shumë dashuri dhe dhembshuri për fëmijën e tij, saqë kurrë nuk do ta vriste atë, veçse në dy raste: ose kur ai (prindi) është mangët nga mendja, ose për shkak të një arsyeje shumë të fortë, që e ka bërë thuajse të pashmangshme këtë vrasje.

Nga kjo dispozitë përjashtohen, gjithashtu, edhe jobesimtarët, sepse ajeti u drejtohet në mënyrë të veçantë besimtarëve. Pra, nuk është e drejtë që, për një jobesimtar, të vritet një besimtar. Ky qëndrim mbështetet në Traditën profetike. Megjithatë, për disa dijetarë, nuk është e drejtë që të ekzekutohet besimtari, i dashuri i Allahut, për hir të një qafiri, që është armik i Allahut. [6]

Thënia e Allahut të Lartësuar: "i liri për të lirin" në aspektin e saj të nënkuptuar, tregon se i liri nuk ekzekutohet nëse vret një rob (skllav).

Fakti i dytë që tregon se nuk është e domosdoshme që vrasësi dhe viktima të kenë të njëjtën gjini, është thënia e Allahut të Lartësuar: "skllavi për skllavin", e cila i përfshin të gjithë llojet e skllevërve, meshkuj apo femra qofshin, të shtrenjtë apo të lirë në çmim. Me fjalë të tjera, thënia: "skllavi për skllavin" nënkupton që skllavi (mashkull) ekzekutohet nëse ka vrarë një skllav (mashkull), skllavja ekzekutohet nëse ka vrarë një skllave, skllavi ekzekutohet nëse ka vrarë një skllave, dhe një skllave ekzekutohet nëse ka vrarë një skllav.

Ky ajet tregon, gjithashtu, se shpagimi parësor i krimit të vrasjes është dënimi me vdekje i vrasësit, ndërsa kompensimi me pasuri është dytësor dhe zëvendësues. Kjo

[6] Ndërsa hanefijtë janë të mendimit që, edhe në këtë rast, duhet të mbahet drejtësia dhe barazia, domethënë që krimi duhet dënuar edhe nëse një besimtar vret një jobesimtar padrejtësisht.

do të thotë që vrasësi nuk dënohet me vdekje në rast se të afërmit e viktimës pranojnë kompensimin me pasuri ose e falin vrasësin. Për këtë, i Madhëruari thotë:

- "Kurse ai, të cilit i falet gjaku prej vëllait të vet nuk ekzekutohet. Pas faljes, le të sillen butë me të falurin. Ndërsa shpagimi, le t'u jepet me mirësi." - Nëse vrasësit i falet jeta nga ana e të afërmve të viktimës, ose të paktën nga disa prej tyre, ekzekutimi rrëzohet dhe bëhet e detyrueshme pagesa e kompensimit. I takon kujdestarit të viktimës që të zgjedhë mes ekzekutimit dhe kompensimit.

Nëse kujdestari i viktimës ia fal jetën vrasësit, ai duhet që, pas kësaj, të sillet njerëzishëm me vrasësin, duke mos e rënduar atë. Edhe kompensimin duhet ta kërkojë brenda normave njerëzore, duke e ngushtuar sa më pak vrasësin, të cilin e ka falur.

Më pas vjen këshilla për palën tjetër. Edhe vrasësi duhet të tregohet korrekt dhe mirënjohës, duke e dhënë masën pasurore të kompensimit pa e vonuar. Ai duhet ta vlerësojë faljen dhe tolerimin e palës tjetër, sepse bamirësia e falësit duhet shpërblyer veçse me sjellje të mirë e mirënjohje.

Kështu, Allahu i Lartësuar i urdhëron të dyja palët për drejtësi e mirësi. Familjen e viktimës e udhëron që të sillet me butësi dhe me tolerancë, ndërsa vrasësin, të cilit i falet jeta, e urdhëron që ta dorëzojë kompensimin me mirënjohjeje dhe pendesë.

Në fragmentin: "atij që i falet jeta prej vëllait të tij" gjejmë një shenjë apo një nxitje për të pasur dhembshuri mes njëri-tjetrit. Allahu thotë: "prej vëllait të tij", për të ngjallur ndjenjën e mëshirës mes muslimanëve edhe në të tilla situata, kur urrejtja pushton zemrat. I Lartësuari kujton vëllazërinë në Islam, për të shtuar dhembshurinë, me qëllim që të mos këmbëngulet në ekzekutimin e vrasësit. Kësisoj, është më mirë që vëllai t'ia falë gjakun vëllait të tij musliman dhe ta pranojë me butësi kompensimin e ofruar prej tij. Madje, më mirë akoma do të ishte falja e vrasësit, pa kërkuar prej tij asnjë lloj kompensimi.

Nga ky fragment i mësipërm kuptohet, gjithashtu, se vrasësi i muslimanit, me veprën e tij, nuk bën kufër që të nxjerr nga Islami, sepse Allahu i Lartësuar e ka quajtur familjen e të vrarit "vëlla" të vrasësit. Pa dyshim, vëllazëria që është pasur për qëllim këtu është pikërisht vllazëria në fenë Islame.

Siç u tha, një musliman nuk bëhet qafir sepse vret një musliman tjetër. E nëse vrasja, që është gjynahu më i madh pas kufrit dhe shirkut, nuk e bën muslimanin qafir, atëherë sigurisht që gjynahet e tjera që qëndrojnë poshtë vrasjes, nuk e bëjnë muslimanin qafir. Thënë ndryshe, muslimani nuk bëhet qafir nëse bën çfarëdo gjynahu tjetër, përveç kufrit dhe shirkut. Por, pa dyshim, me të tilla gjynahe, besimi i tij ulet shumë.

Nëse të afërmit e viktimës, qoftë dhe disa prej tyre, e pranojnë ta falin vrasësin, atëherë jeta e këtij të fundit mbrohet. Askush nuk lejohet ta vrasë atë apo të tregojë armiqësi ndaj tij, siç thotë i Madhëruari:

- "Ky është lehtësim dhe mëshirë prej Zotit tuaj. E kushdo që, pas kësaj, e kapërcen kufirin, ka një dënim të dhembshëm." - Çdokush që i shfaq armiqësi dhe hakmerret duke e vrarë vrasësin, pasi këtij i është dhënë njëherë falja, ka për të patur një dënim të dhimbshëm në ahiret. Ndërsa në dynja, mbi të do të rëndojë ligji për krimin e vrasjes.

Disa dijetarë mendojnë se shprehja "dënim i dhembshëm", nuk tregon dënimin në ahiret, por dënimin në dynja, që do të thotë se një vrasës i tillë, që kryen hakmarrje pas faljes, dënohet me vdekje. Pra, ai që guxon të vrasë atë të cilit i është falur gjaku, ose prej të cilit është pranuar kompensimi pasuror, duhet të dënohet me vdekje dhe nuk lejohet që të falet, sipas disa dijetarëve.

Megjithatë, më i saktë është mendimi i parë, që thotë se: "dënimi i dhembshëm" do

të jetë dënimi në ahiret. Ndërsa në dynja, ndëshkimi i këtij vrasësi bëhet sipas ligjit përkatës, sepse krimi i tij nuk ndryshon nga krimi i të tjerëve. Edhe ai trajtohet si një vrasës, që gjykohet me të njëjtin ligj.

Pastaj Allahu i Lartësuar na tregon urtësinë e Tij në caktimin e dispozitës së shpagimit me drejtësi dhe barazi për krimin e vrasjes:

- "Në këtë ligj është jeta juaj, o ju mendarë, në mënyrë që të përmbaheni!" – Domethënë, nëpërmjet këtij ligji ruhet gjaku i pafajshëm dhe frenohen kriminelët. Nëse njeriu e di shumë mirë se, nëse vret, do të vritet, ai do ta frenojë veten nga ky krim i shëmtuar. Gjithashtu, kur njerëzit shohin ndëshkimin e kriminelit, ai bëhet një mësim shumë i mirë për ta. Nëse shpagimi për vrasjen nuk do të ishte vrasja, atëherë ky krim i shëmtuar nuk do të frenohej kurrë.

Të gjitha dënimet penale të Sheriatit janë e vetmja mundësi frenimi të krimit dhe padrejtësisë. Kjo tregon se Allahu që i ligjëroi ato është, pa dyshim, i Dituri, i Urti dhe Falësi.

Fjala "jetë" në ajetin e mësipërm, është në trajtën e pashquar, për të treguar (në arabisht) kështu dobinë e madhe që u sjell njerëzve ky ligj i drejtë. Madje, duke qenë se vlerën e këtij ligji mund ta kuptojnë veçse mendimtarët e mëdhenj, Allahu iu drejtohet pikërisht atyre, duke thënë: "…o ju mendarë…".

Kjo tregon se Allahu i Lartësuar e dëshiron dhe kënaqet që njerëzit të meditojnë dhe të përdorin mendjen e tyre, për të studiuar hollësisht ligjet e sjella prej Tij. Ai i do ata që përnxjerrin urtësitë dhe dobitë e dispozitave të Tij, sepse ato tregojnë që Ligjvënësi është Absolut në urtësinë e madhështinë e Tij. Ato tregojnë qartë drejtësinë e Tij të pakrahasueshme dhe mëshirën e Tij të gjerë. Njerëzit që meditojnë dhe përnxjerrin urtësitë dhe dobitë e ligjeve të Allahut, e meritojnë të quhen mendarë, dijetarë. Ata janë vërtet të privilegjuar e të përzgjedhur, sepse vetë Madhështori (Allahu) i ka quajtur "mendarë". Mjafton kaq si nderim për ata që dinë të mendojnë.

Thënia e Allahut: "në mënyrë që të përmbaheni", tregon dobinë e njohjes dhe të zbatimit të dispozitave të Tij. Për atë që e njeh Zotin e Tij dhe madhështinë e Tij, apo që arrin të njohë urtësitë në dispozitat e Tij, sigurisht që do të ketë shtim të bindjes dhe të nënshtrimit të plotë ndaj Atij. Njohësi i mirë i këtyre çështjeve e ndien madhështinë e Allahut, prandaj nuk ia lejon vetes që të shkelë kufijtë e të Madhërishmit. Ky njeri meriton të quhet 'i përmbajtur' ose 'i devotshëm', sepse devotshmëria nuk është gjë tjetër, por veçse të ruajturit nga ndëshkimi i Zotit, duke zbatuar urdhrat e Tij dhe duke iu larguar ndalesave të Tij. Devotshmëria është ruajtja e kufijve të Zotit, në shenjë madhërimi dhe dashurie për Të.

Ajetet 180 – 182

180. Jeni urdhëruar që, nëse dikujt i afrohet vdekja, nëse lë pasuri nga pas, e ka detyrim lënien e testamentit për prindërit dhe për më të afërmit! Testamenti duhet bërë me drejtësi. Për ata që janë të devotshëm, kjo është detyrë që nuk tolerohet.
181. Kush e ndryshon testamentin pas dëgjimit të tij, ta dijë se gjynahu është i atyre që e ndryshojnë. Vërtet, Allahu është Dëgjues dhe i Dijshëm.
182. E kush i trembet testament-lënësit se, gabimisht po largohet nga drejtësia, ose qëllimisht do të bëjë mëkat, dhe vendos drejtësinë mes tyre, ai nuk ka bërë gjynah. Vërtet, Allahu është Falës e Mëshirues.

Shpjegimi i ajeteve

Ajeti u drejtohet besimtarëve, duke u treguar atyre se Allahu i Lartësuar ka përcaktuar me ligj edhe çështjen e testamentit.

- "Jeni urdhëruar që, nëse dikujt i afrohet vdekja, nëse lë pasuri nga pas, e ka detyrim

lënien e testamentit për prindërit dhe për më të afërmit! Testamenti duhet bërë me drejtësi." – Pra, nëse dikujt i afrohet vdekja, domethënë, nëse i shfaqen shenjat e saj, si ndonjë sëmundje e rëndë ose diçka tjetër që tregon se vdekja është e pashmangshme, ndërkohë që ai ka pasuri të madhe, atëherë e ka për detyrë që të lërë një testament të veçantë për prindërit dhe për njerëzit më të afërm. Këtë duhet ta bëjë sipas rregullit, duke mos e tepruar me të largëtit dhe të neglizhojë të afërmit. Për secilin, ai duhet marrë në konsideratë afërsinë farefisnore dhe nevojat për ndihmë.

- "Ky është detyrim për ata që janë të devotshëm." – Kështu, kjo dispozitë është detyrë, e cila duhet kryer. Madje, Allahu i Lartësuar e ka lidhur atë me devotshmërinë.

Shumica e shpjeguesve të Kur'ânit janë të mendimit se ky ajet është i shfuqizuar. Sipas tyre, dispozita e tij është zëvendësuar me një tjetër, që ka ardhur më pas, e shtjelluar në ajete të tjera, të quajtura "ajetet e trashëgimisë". Në ajetet e trashëgimisë sqarohet se nuk lejohet të lësh testament për ata që janë trashëgimtarë të ligjshëm të pasurisë tënde, sepse Sheriati i ka përcaktuar si personat që trashëgojnë, edhe masën e trashëgimisë që ata trashëgojnë.

'*Uasijet*' quhet pasuria që i vdekuri lë si porosi për t'iu shpërndarë të afërmve të tij. Ajo përjashtohet nga trashëgimia e përcaktuar me ligj. Në ajetet e trashëgimisë dhe në hadithet që flasin për këtë çështje, sqarohet se trashëgimtarët e ligjshëm, mes të cilëve janë edhe prindërit e të vdekurit dhe më të afërmit e tij, nuk lejohet që, përveç trashëgimisë së përcaktuar nga Sheriati, të përfitojnë edhe nga '*uasijet*'-i.

Disa thonë se fragmenti: "për prindërit dhe për më të afërmit" flet për atë pjesë të të afërmve për të cilët Sheriati nuk ka përcaktuar trashëgimi. Pra, me fjalë të tjera, Allahu urdhëron që personi, të cilit po i afrohet vdekja, të lerë me porosi që, prej pasurisë së tij, t'u jepet edhe prindërve apo më të afërmve, të cilët nuk marrin pjesë nga trashëgimia. Por ky lloj shpjegimi i ajetit nuk mund të pranohet, përderisa nuk ka ndonjë fakt mbështetës nga Allahu dhe Profeti i Tij. Nuk ka prova që të na shtyjnë të kuptojmë se këtu flitet për ata prindër dhe të afërm që nuk janë trashëgimtarë të ligjshëm.

Megjithatë, qëndrimi më i drejtë në këtë çështje është që ky ajet nuk ka pse të konsiderohet si i anuluar. Ai është një ajet përgjithësues, i cili urdhëron besimtarët, të cilëve u afrohet vdekja, që të lënë testament, ku të përcaktojnë një pjesë pasurie e bamirësie për prindërit e tyre dhe për më të afërmit e tyre. Ajeti nuk na sqaron se për cilët lloj prindërish dhe të afërmish të të vdekurit bëhet fjalë. Pra, ai nuk përcakton a bëhet fjalë për prindërit dhe të afërmit të cilët përfitojnë edhe nga trashëgimia e përcaktuar nga Sheriati, apo për ata prindër e të afërm për të cilët Sheriati nuk ka përcaktuar pjesë. Ky ajet është përgjithësues, ndërsa Sheriati ia ka lënë zakoneve të njerëzve përcaktimin e masës së këtij testamenti, pa rënë ndesh me ligjin e fesë.

Por pasi Allahu i Lartësuar solli dispozita për trashëgiminë në ajete të tjera, në të cilat përcakton si personat që trashëgojnë, edhe masën e trashëgimisë, atëherë ajeti i sipërpërmendur u qartësua më shumë. Nëse do ta shihnim atë të veçuar nga ajetet që janë zbritur për trashëgiminë, do të mendonim se jemi të urdhëruar që, sipas zakoneve të njerëzve që nuk bien ndesh me Sheriatin, ne duhet të lëmë testament për prindërit dhe të afërmit, pa dallim, a trashëgojnë ligjërisht, apo jo. Kështu, zbritja e ajeteve të tjera të trashëgimisë e kufizon gjithëpërfshirjen e ajetit të mësipërm, duke kuptuar që ai flet për ata prindër dhe të afërm të cilët, për ndonjë shkak a cilësi të tyre, nuk përfitojnë trashëgimi sipas përcaktimit të ligjit. Në këtë mënyrë bëhet harmonizimi mes kuptimit të ajeteve.

Pra, nuk është e nevojshme të thuhet se ky ajet është i anuluar, sikurse deklaron një grup, dhe as të thuhet se ai është "i posaçëm"

vetëm për atë kategori prindërish dhe të afërmish për të cilët Sheriati nuk ka caktuar pjesë. Qëndrimi më i saktë është ai që sapo shtjelluam më lart, sepse ajetet janë shpjegues të njëri-tjetrit, dhe këtu kemi të bëjmë me një ajet të pashkoqitur, i cili bëhet i kuptueshëm nëpërmjet ajeteve të tjera.

Falë Allahut, nëpërmjet këtyre kritereve, dijetarët arrijnë të shohin qartë të vërtetën që ndodhet mes ajeteve dhe fjalëve të Profetit (s.a.u.s.). Puna e parë në kësi rastesh është gjetja e një mënyre harmonizimi mes teksteve të ardhura nga Allahu dhe Profeti (s.a.u.s.), para se të pretendojmë se kemi të bëjmë me një anulim dispozitash apo posaçërim të kuptimit të tyre, pa pasur argument të qartë për këtë.

Më pas, duke qenë se shpeshherë njerëzit mendojnë që trashëgimtarët e tyre nuk do ta plotësojnë porosinë e lënë, ose që mund ta ndryshojnë atë sipas dëshirave të tyre, ata nuk lënë fare testamente të tilla. Për këtë arsye, Allahu i Lartësuar bën një kërcënim të hapur për ata që dëgjojnë dhe e kanë për detyrë zbatimin e testamentit të të vdekurit, duke thënë:

- Kush e ndryshon testamentin pas dëgjimit të tij, ta dijë se gjynahu është i atyre që e ndryshojnë" – Pra, të gjithë ata që dëgjojnë testamentin dhe e kuptojnë shumë mirë se cilëve u adresohet ai, dhe pastaj e ndryshojnë atë, duke mos e çuar në vend porosinë, kanë gjynah dhe meritojnë ndëshkimin e Allahut të Lartësuar, ndërsa personi që lë testamentin e merr shpërblimin e tij të plotë tek Allahu i Lartësuar. Gjynahu i moszbatimit të testamentit rëndon vetëm mbi moszbatuesit e tij, të cilët e kanë dëgjuar dhe e kuptuar mirë qëllimin e personit.

- "Vërtet, Allahu është Dëgjues dhe i Dijshëm." – Pra, Allahu i Lartësuar i dëgjon të gjitha fjalët e atij që lë testamentin, i cili duhet ta ndiejë këtë mbikëqyrje dhe të mos bëjë ndonjë shkelje.


Allahu i Lartësuar na përkujton, gjithashtu, se Ai është *Alim*, i Dijshëm. Ai i di qëllimet dhe motivet e testament-lënësit. Ai i di edhe veprat e atyre që dëgjojnë dhe kuptojnë testamentin, të cilët e kanë detyrë ta zbatojnë ashtu si e dëgjojnë dhe e kuptojnë atë. Nëse testament-lënësi përpiqet maksimalisht që të mbajë drejtësi në këtë çështje, Allahu i Lartësuar do ta shpërblejë atë, edhe nëse gabon.

Por kjo vlen edhe si kërcënim për ata që dëgjojnë testamentin dhe e kuptojnë atë, që të mos bëhen të padrejtë dhe ta ndryshojnë atë, sepse Allahu i Lartësuar di çdo qëllim, motiv dhe vepër të robit. Pra, le të jenë të gjithë të kujdesshëm prej vështrimit dhe dijes absolute të Allahut për çdo çështje.

Nëse porosia e testament-lënësit është e padrejtë, ata që janë të pranishëm gjatë lënies së saj, duhet ta këshillojnë personin që të tregohet i drejtë, duke i mësuar rrugën më të mirë. Pra, nëse testament-lënësi bën padrejtësi, me apo pa dashje, ai duhet këshilluar nga të pranishmit, por nëse përsëri nuk heq dorë nga padrejtësia e tij, atëherë kjo porosi nuk lejohet të zbatohet. Në një rast të tillë, çështja duhet zgjidhur si është më e drejta dhe më e mira, me vullnetin dhe pranimin e palëve.

Ai që këshillon për drejtësi, për ta shpëtuar testament-lënësin nga barra e padrejtësisë, bën një vepër mjaft të çmuar. Po ashtu, edhe nëse testamenti i padrejtë ndryshohet, nuk është gjynah, sepse kjo ndihmon të vendoset drejtësia sipas Sheriatit dhe paqja mes njerëzve. Për këtë arsye, Allahu i Lartësuar thotë më poshtë:

- "E kush i trembet testament-lënësit se, gabimisht po largohet nga drejtësia, ose qëllimisht do të bëjë mëkat, dhe vendos drejtësinë mes tyre, ai nuk ka bërë gjynah. Vërtet, Allahu është Falës e Mëshirues." – Pra, Allahu i Lartësuar i fal të gjitha gabimet e robërve. Ai është shumë i butë dhe tolerues me ata që pendohen. Ai është falës i atij robi që heq dorë nga pasuria që i takon,



për t'i dhënë përparësi më shumë vëllait të vet, në shenjë bamirësie, drejtësie dhe mëshire. Kush tregohet tolerant me të tjerët, ta dijë se edhe Allahu i Lartësuar do të tregohet tolerant me të. Madje, nëse njerëzit vendosin që ta rregullojnë çështjen e testamentit me mirëkuptim mes tyre, duke shpresuar që i vdekuri i tyre të falet nga Allahu i Lartësuar për padrejtësinë në porosinë e tij, atëherë Allahu i Lartësuar nuk ka për t'i zhgënyer, por ka për ta falur të vdekurin, për shkak të veprimit të tyre, sepse Allahu i Lartësuar i mëshiron shumë adhuruesit e Tij. A nuk është shprehje e mëshirës së Tij edhe ky ligj i Tij, nëpërmjet të cilit njerëzit mëshirojnë dhe përkujdesen për njëri-tjetrin?!

Ajetet janë një nxitje e fortë që njeriu të lërë testament, duke përcaktuar me drejtësi ata që përfitojnë prej tij, pasi për çdo padrejtësi do të mbahet përgjegjësi. Ajetet nxisin, gjithashtu, për gjetjen e mirëkuptimit dhe vendosjen e drejtësisë, edhe sikur për këtë do të duhet të ndryshohet porosia.

Ajetet 183 – 185

183. O ju që keni besuar! Agjërimi është bërë detyrë për ju, sikurse ka qenë edhe për ata që ishin para jush, me qëllim që të bëheni të devotshëm.
184. Ai është disa ditë me numër. Të sëmurët prej jush ose udhëtarët, le të agjërojnë më vonë po aq ditë *(sa kanë lënë pa agjëruar)*. Për ata që nuk e përballojnë dot *(agjërimin)*, është i detyruar si kompensim ushqimi *(ditor)* i një të varfëri. Nëse dikush jep vullnetarisht më tepër, do të jetë më mirë për të. Megjithatë, të agjëroni është më mirë për ju, në qoftë se dini.
185. Muaji i Ramazanit është ai në të cilin ka zbritur Kur'âni, që është udhërrëfyes për njerëz, sqarues i rrugës së drejtë dhe dallues. Kushdo nga ju që e jeton këtë muaj, le të agjërojë! Ndërsa kush është i sëmurë ose në udhëtim, le të agjërojë po aq ditë *(sa ka lënë pa agjëruar)* më vonë. Allahu dëshiron për ju lehtësimin. Ai nuk dëshiron vështirësinë për ju. Plotësojeni numrin e ditëve dhe madhërojeni Allahun për udhëzimin, që të bëheni mirënjohës!

Shpjegimi i ajeteve

- "O ju që keni besuar! Agjërimi është bërë detyrë për ju, sikurse ka qenë edhe për ata që ishin para jush" - Në këto ajete, Allahu i Lartësuar u tregon besimtarëve një mirësi të madhe për ta, që është agjërimi. Agjërimi ka qenë i detyrueshëm edhe për popujt e mëparshëm, pasi ai është i dobishëm për të gjitha kohërat.

Ky ajet shërben si nxitje e këtij umeti, për të garuar me popujt e mëparshëm në kryerjen e veprave të mira që i kushtohen Allahut. Kështu, ata nxiten për të arritur cilësitë më të mira, që do të thotë se agjërimi nuk është thjesht një vepër e vështirë për t'u kryer. Pastaj, Allahu i Lartësuar na tregon qëllimin e lartë të këtij adhurimi, duke thënë:

- "...me qëllim që të bëheni të devotshëm." - Agjërimi është një nga mënyrat më efikase për t'u pajisur me devotshmëri. Ai është zbatim i urdhrit të Allahut dhe largim nga ndalesat e Tij, ashtu si vetë devotshmëria, që është ruajtja nga ndëshkimi dhe zemërimi i Zotit duke kryer urdhrat dhe duke iu larguar ndalesave të Tij. Agjërimi e ndalon agjëruesin nga disa gjëra, si nga: të ngrënit, të pirit, marrëdhëniet seksulale etj. Besimtari iu largohet këtyre veprimeve, ndonëse nefsi ia kërkon me forcë, me qëllim që të afrohet tek Allahu i Lartësuar, duke shpresuar shpërblimin e Tij. Siç shihet, pra, ky adhurim ka lidhje të drejtpërdrejtë me devotshmërinë.

Nëpërmjet agjërimit, robi ushtrohet që të ndiejë mbikëqyrjen e Zotit të tij. Edhe sikur t'i ketë të gjitha mundësitë për të shijuar kënaqësitë e nefsit, ai u largohet atyre, sepse nuk do që të shkelë ligjet dhe rregullat e të Dashurit të Tij, Allahut të Ditur dhe të Urtë. Agjëruesi e ndien gjatë gjithë kohës vështrimin e Allahut dhe është shumë i sigurt për të.

Nga ngjashmëritë e agjërimit me devotshmërinë (*takua*) është edhe fakti se, agjërimi ia ngushton shejtanit rrugët e tij në trupin e njeriut. Dihet se shejtani lëviz nëpër trupin e njeriut ashtu sikurse qarkullon edhe gjaku i tij, por gjatë agjërimit, damarët ngushtohen e, rrjedhimisht, ngushtohen edhe rrugët e shejtanit për të mashtruar dhe nxitur njeriun në gjynahe. E dihet, gjithashtu, se njeriu i pakëson shumë gjynahet gjatë agjërimit.

Agjërimi të çon drejt devotshmërisë, sepse, në të shumtën e rasteve, njeriu që agjëron i shton veprat e mira në bindje ndaj Zotit, dhe nuk ka dyshim se veprat të bëjnë të devotshëm.

Një njeri i pasur, kur agjëron, e ndien vështirësinë dhe vuajtjen e të varfërit, që nuk ka mundësi të ushqejë veten dhe familjen e tij. Kështu, ai bëhet më i dhembshur ndaj të tjerëve, prandaj përpiqet t'i ndihmojë ata me pasuri, dhe dihet se shpenzimi në rrugën e Zotit është cilësi e devotshmërisë.

- "Ai është disa ditë me numër." – Vërtet, Allahu i Lartësuar e bëri agjërimin detyrim për ne, por gjithashtu na njoftoi se ai zgjat vetëm për disa ditë të numëruara, të cilat nuk e dëmtojnë dhe nuk e stërmundojnë njeriun. Përkundrazi, kjo detyrë është shumë e lehtë për t'u përmbushur dhe me shpërblim tepër të madh.

Lehtësimi i Allahut të Lartësuar nuk ndalon këtu. Ai thotë:

- "Të sëmurët prej jush ose udhëtarët, le të agjërojnë më vonë po aq ditë". – Pra, për shkak të vështirësisë që zakonisht hasin këto dy kategori njerëzish, Allahu i Lartësuar u ka dhënë lehtësimin që, agjërimin e detyrueshëm të Ramazanit ta kryejnë në ditët e tjera pas këtij muaji, kur të jenë shëruar apo kur të jenë kthyer nga udhëtimi. Kështu, ata do ta marrin shpërblimin të plotë tek Zoti.

Nga ajeti kuptojmë se ditët e paagjëruara të Ramazanit duhet të plotësohen detyrimisht, qofshin ato ditë të lëna plotësisht apo përgjysëm.

Ajeti dëshmon se lejohet të zëvendësohen ditët e paagjëruara me ditë të tjera, edhe nëse nuk janë të njëjta në gjatësinë e tyre. Pra, nëse Ramazani, për shembull, ka qenë në stinën e verës, kur ditët janë të gjata, ato mund të zëvendësohen edhe me ditë të shkurtra dimri, sepse Allahu nuk ka përcaktuar gjë të tillë në ajet. Mjafton që të plotësohet vetëm numri i tyre.

- "Për ata që nuk e përballojnë dot *(agjërimin)*, është i detyruar si kompensim ushqimi *(ditor)* i një të varfëri. Nëse dikush jep vullnetarisht më tepër, do të jetë më mirë për të." - Këtu flitet për mëshirën e madhe të Allahut, i Cili, para se ta bënte detyrim të plotë agjërimin për njerëzit, u dha atyre disa dispozita lehtësuese. Kështu, në fillim, edhe ai që kishte mundësi të

agjëronte, mund të mos agjëronte, por ishte i detyruar të kompensonte, duke ushqyer një të varfër. Kjo u bë me qëllim që detyrimi t'u vinte sa më i lehtë.

Megjithatë, edhe pse i lejoi që, në vend të një dite agjërimi, të ushqenin një të varfër, Allahu tha:

- "Megjithatë, të agjëroni është më mirë për ju, në qoftë se dini." - Por pas disa kohësh, Allahu i Lartësuar e bëri agjërimin të detyrueshëm për cilindo që mund të agjërojë. Ndërsa kush nuk mundet, duhet që ditët e lëna pa agjëruar, t'i agjërojë më vonë.

Ndërsa disa të tjerë janë të mendimit se ky ajet flet për atë kategori njerëzish, të cilët e kanë të vështirë agjërimin, sepse mund të sjellë probleme të mëdha për ta, sikurse mund të jenë, për shembull, pleqtë e shtyrë në moshë. Për këtë kategori njerëzish lejohet që të mos agjërojnë, por ata e kanë të detyrueshme që të japin kompensim, duke ushqyer nga një të varfër për çdo ditë të paagjëruar. Ky mendim i dytë është më i saktë për t'u pranuar.

- "Muaji i Ramazanit është ai në të cilin ka zbritur Kur'âni, që është udhërrëfyes për njerëzit, sqarues i rrugës së drejtë dhe dallues." – Kuptimi: Muaji që duhet të agjëroni është muaji i Ramazanit, në të cilin zbriti Kur'âni, mirësia e madhe e Zotit tuaj.

Këtu përmenden disa cilësi të Kur'ânit. Kështu, ai quhet "udhërrëfyes për njerëzit", për t'u treguar atyre mirësitë e dynjasë dhe të ahiretit. Së dyti, ai cilësohet "sqarues i rrugës së drejtë", për ta bërë këtë me mënyrën më të thjeshtë dhe më të kuptueshme. Dhe më pas Kur'âni quhet "dallues", sepse ai të mundëson të shohësh dhe të dallosh rrugën e drejtë nga rruga e gabuar. Ai bën dallimin mes të lumturve, që do të jenë përherë në kënaqësinë e Allahut, dhe të dështpëruarve, që do të vuajnë përjetësisht ndëshkimin dhe zemërimin e Zotit.

Siç shihet, ky është muaj madhështor, prandaj duhet mbushur me adhurime kushtuar Zotit të gjithësisë, pikësëpari me agjërim.

Kjo është urtësia e Allahut dhe mëshira e Tij. Vetëm pasi tregon dobitë e këtij muaji të madh dhe urtësinë e agjërimit gjatë tij, Ai thotë:

- "Kushdo nga ju që e jeton këtë muaj, le të agjërojë!" - Me këtë ajet, pra, u bë i detyrueshëm agjërimi i Ramazanit për çdonjë që ka mundësi të agjërojë dhe nuk është në udhëtim.

Dikush mund të mendonte se ky ajet, përveçse anulon kompensimin për ata që mund të agjërojnë, anulon edhe lehtësimin për të sëmurët e udhëtarët, prandaj Allahu i Lartësuar e përmend sërish lehtësimin për të sëmurët dhe udhëtarët, që të largohet ky keqkuptim. Ai thotë:

- "Ndërsa kush është i sëmurë ose në udhëtim, le të agjërojë po aq ditë *(sa ka lënë pa agjëruar)* më vonë." – Kjo bëhet sepse Allahu i Lartësuar kërkon që të na i lehtësojë në maksimum rrugët që të çojnë drejt kënaqësisë së Tij.

- "Allahu dëshiron për ju lehtësimin. Ai nuk dëshiron vështirësinë për ju." - Ai dëshiron të na thjeshtësojë çdo rrugë të mirë dhe të drejtë. Për këtë arsye, të gjithë urdhrat e Tij janë shumë të thjeshtë në origjinën e tyre.

Në rastet kur, për shkaqe të justifikueshme nga Sheriati, zbatimi i këtyre urdhrave vështirësohet, Ai ka sjellë dispozita lehtësuese, të cilat ose mund ta anulojnë krejt urdhrin e parë, ose mund të bëjnë disa lehtësime të tij.

Çështja e lehtësimeve të Zotit për adhuruesit e Tij është mjaft e gjerë, saqë përfshin çdo aspekt të Sheriatit, prandaj këtu nuk mund të përmenden të gjitha ato.

Më pas, Allahu i Lartësuar thotë.

- "Plotësojeni numrin e ditëve..." - Allahu i Lartësuar e di më mirë, por, me sa duket, ky sqarim është i nevojshëm për ndonjë që mendon se qëllimet e larta të Ramazanit mund të plotësohen edhe duke agjëruar një pjesë të tij. Pra, Allahu i Lartësuar thekson se duhen plotësuar të gjitha ditët e këtij muaji.

Dhe, si përfundim, Allahu i Lartësuar duhet adhuruar dhe falënderuar për suksesin që u jep besimtarëve në kryerjen e agjërimit dhe për qartësimin e të vërtetës:

- "...dhe madhërojeni Allahun për udhëzimin, që të bëheni mirënjohës!" - Këtu bëjnë pjesë edhe *tekbir*-et, të cilat fillojnë që në momentin kur shfaqet hëna e re e muajit *sheval,* që tregon mbarimin e Ramazanit, dhe vazhdojnë deri në kohën e hytbes së namazit të Bajramit, ditën e festës.

Ajeti 186

186. Kur adhuruesit e Mi të pyesin për Mua, *(thuaju se)* Unë jam afër. Unë i përgjigjem lutjes, kur lutësi më lutet. Le të më përgjigjen Mua dhe të më besojnë vetëm Mua, që të bëhen të udhëzuar drejt!

Shpjegimi i ajetit


Ky ajet ka ardhur si përgjigje e një pyetjeje që iu drejtua Profetit (s.a.u.s.) prej njërit nga shokët e tij, i cili tha: *"O i Dërguari i Allahut! A është afër Zoti ynë, që t'i flasim me zë të ulët, apo është larg, që ta ngremë zërin kur flasim?!"* Pas kësaj pyetjeje, Allahu i Lartësuar zbriti:

- "Kur adhuruesit e Mi të pyesin për Mua, *(thuaju se)* Unë jam afër." - Allahu i Lartësuar është afër. Ai është Mbikëqyrës i vazhdueshëm i robërve të Tij. Ai vështron imtësisht të fshehtat dhe ato që shfaqen haptazi. Ai e sheh edhe atë që është më e fshehtë se e fshehta. Ai di, madje, edhe për atë shikimin vjedhurazi të syve apo për gjërat që fshihen në gjoksin e njeriut. Allahu është pranë robit që lutet, duke iu përgjigjur lutjeve të tij, prandaj Ai thotë:

- "Unë i përgjigjem lutjes, kur lutësi më lutet."- Lutjet ose *dua*-të janë dy llojesh:
1. Lutje adhurimi. Të tilla janë lutjet e robit që Allahu i Lartësuar t'i japë ato që ai kërkon dhe ta ruajë nga ato që ai i druhet, jo duke ia kërkuar konkretisht ato, por duke kryer adhurimet për të cilat Allahu i Lartësuar ka premtuar se do të japë si shpërblim ato që robi kërkon. Për shembull, njeriu dëshiron të futen në Xhenet. Këtë ai mund t'ia kërkojë Allahut të Lartësuar me dy mënyra: ose duke iu drejtuar Atij me një kërkesë konkrete, pra, duke thënë: "O Zot, të lutem më fut në Xhenet!", ose duke ia kërkuar këtë gjë tërthorazi, duke kryer ato vepra dhe adhurime për të cilat Allahu i Lartësuar ka premtuar si shpërblim futjen në Xhenet. Kjo mënyrë e fundit është "lutje adhurimi", ndërsa lloji tjetër është:
2. Lutje kërkese. Kjo do të thotë t'i kërkosh Allahut të Lartësuar diçka konkrete, si për shembull: "O Zot, më jep rizk hallall, ma shto pasurinë time, m'i ruaj të mirat që më ke dhënë" etj. Këto ishin dy mënyrat me të cilat ne mund t'i lutemi Allahut të Lartësuar.

Edhe afërsia e Zotit me krijesat është dy llojesh:
1. Afërsi e përgjithshme. Kjo do të thotë që Allahu i Lartësuar është pranë të gjitha krijesave të Tij me dijen dhe pushtetin e Tij.
2. Afërsi e posaçme, që nënkupton se Allahu i Lartësuar është pranë adhuruesve të Tij dhe atyre që i luten Atij. Kjo afërsi shprehet duke iu përgjigjur lutjeve të tyre, duke i ndihmuar e duke iu dhënë sukses.

Allahu i Lartësuar ka premtuar se do t'i përgjigjet robit kur ai bën ndonjë lutje të lejuar, por me kusht që zemra e tij të jetë e përqendruar në lutje dhe të jetë i pastër nga çdo gjë që bëhet pengesë për pranimin e lutjes, sikurse është, për shembull, të ushqyerit me haram dhe pengesa të tjera të cilat i ka sqaruar Profeti (s.a.u.s.).



Premtimi i Allahut është akoma më pranë zbatimit kur lutësi plotëson kushtet parësore që mundësojnë përgjigjen e lutjes, të cilat janë: besimi i patundur tek Allahu, nënshtrimi dhe bindja e plotë ndaj urdhrave të Tij, si edhe largimi prej ndalesave të Tij. Prandaj Allahu i Lartësuar thotë më pas:

- "Le të më përgjigjen Mua dhe të më besojnë vetëm Mua, që të bëhen të udhëzuar drejt!" – Pra, vetëm duke iu përgjigjur urdhrave të Zotit dhe duke besuar gjithçka që Ai ka urdhëruar të besojmë, vetëm atëherë do të jemi të udhëzuar. Udhëzimi i premtuar në këtë rast është pranimi i imanit dhe kryerja e veprave të mira.

Duke iu përgjigjur Allahut dhe duke e besuar Atë, besimtarët nuk do të çoroditen kurrë e të besojnë gjëra të kota apo të kryejnë vepra që bien ndesh me besimin e drejtë, sepse përgjigjja ndaj ftesës së Allahut dhe besimi i pastër bëjnë që atyre t'u dhurohet dija e pastër, e drejtë dhe e saktë, sikurse thuhet në suren Maide: "O ju që keni besuar! Nëse bëheni të devotshëm, Ai do t'ju mundësojë të dalloni *(të vërtetën nga e kota)*"

Ajeti 187

187. Gjatë netëve të agjërimit, e keni të lejuar kontaktin *(intim)* me gratë tuaja, të cilat janë mburojë për ju dhe ju jeni mburojë për to. Allahu e dinte se ju nuk do ta mbanit veten, prandaj jua pranoi pendimin dhe jua fali gabimin tuaj. Tani, kontaktoni me to dhe kërkoni atë që Allahu ka përcaktuar për ju. Hani e pini, derisa të dallohet qartë peri i bardhë nga peri i zi, në agim. Pastaj, vazhdojeni agjërimin deri në mbrëmje. Mos kryeni marrëdhënie me to *(gratë)* kur qëndroni për *itikaf* në xhami. Këta janë kufijtë e Allahut, prandaj mos iu afroni atyre. Në këtë mënyrë, Allahu ua sqaron njerëzve argumentet e Veta, që ata të ruhen.

Shpjegimi i ajetit

- "Gjatë netëve të agjërimit, e keni të lejuar kontaktin *(intim)* me gratë tuaja, të cilat janë mburojë për ju dhe ju jeni mburojë për to." - Në fillim, po të flinin gjumë pas perëndimit të diellit, besimtarët e kishin të ndaluar që të hanin, të pinin dhe të kryenin marrëdhënie intime me gratë e tyre, deri në perëndimin e ditës tjetër të agjërimit. Por kjo ishte shumë e vështirë për ta. Madje, shpesh ata e thyenin urdhrin e Zotit për netët e Ramazanit. Për këtë arsye, i Madhëruari tha:

- "Allahu e dinte se ju nuk do ta mbanit veten, prandaj jua pranoi pendimin dhe jua fali gabimin tuaj." - Nëse nuk do të vinte ky lehtësim i Zotit, ata do të vazhdonin në gjynahe e mosbindje ndaj Tij. Jo vetëm kaq, por Allahu i Lartësuar ua fali besimtarëve ato gabime që kishin bërë para se të zbriste ky lehtësim prej Tij.

- "Tani, kontaktoni me to..." – Domethënë, kontaktoni me gratë me të gjitha mënyrat e kontaktit që më parë ishin të ndaluara.

- "...dhe kërkoni atë që Allahu ka përcaktuar për ju." - Pra, edhe në kontaktin me to, motivohuni për të kërkuar shpërblim prej Allahut. Dihet shumë mirë se qëllimi më i madh prej kontaktit me gratë është sjellja në jetë e pasardhësve të mirë, që adhurojnë Allahun, dhe ruajtja e nderit. Le të jetë ky, pra, qëllimi i marrëdhënieve me bashkëshorten, që të arrihet shpërblimi nga Allahu i Lartësuar.

Megjithatë, njeriu duhet të kërkojë edhe mirësi të tjera të muajit të Ramazanit, të cilat janë më të rëndësishme se marrëdhëniet e burrit me gruan e tij, në mënyrë që të afrohet më shumë tek Allahu i Lartësuar. Kështu, thënia e Allahut të Lartësuar: "kërkoni atë që Allahu ka përcaktuar për ju", përfshin edhe mirësi të tjera, prej të cilave është edhe Nata e Kadrit. Me këtë kuptim, Allahu i Lartësuar na udhëzon që të kërkojmë sevapin e Natës së Kadrit duke shtuar adhurimet e duke mos e tepruar me shijimin e kënaqësive të lejuara në këtë natë. Kënaqësitë trupore mund të arrihen në çdo natë tjetër, ndërsa Nata e Kadrit mund të kërkohet veçse gjatë netëve të Ramazanit.

- "Hani e pini, derisa të dallohet qartë peri i bardhë nga peri i zi, në agim." - Ky është kufiri i lejimit të ngrënies, pirjes dhe kontaktit intim.

Ajeti tregon se nuk prishet agjërimi i atij që nuk është i sigurt në ka hyrë koha e agut (kur fillon agjërimi), apo jo, dhe, për këtë arsye, vazhdon të hajë dhe të pijë, sepse Allahu i Lartësuar thotë: "...derisa të dallohet qartë". Pra, nëse akoma nuk është bërë e qartë hyrja e kohës së agjërimit, dhe ti vazhdon të hash, kjo nuk e prish agjërimin tënd.

Ky ajet dëshmon, gjithashtu, se ngritja për syfyr, për të ngrënë ushqim, është e pëlqyeshme, sepse Allahu i Lartësuar thotë: "Hani e pini...".

Nga ajeti mësohet se është e pëlqyeshme që ngrënia e syfyrit të vonohet sa më shumë që të jetë e mundur, brenda kohës së lejuar, pasi ky qe një lehtësim nga Allahu i Lartësuar për adhuruesit, dhe ky lehtësim bëhet më i plotë kur hamë dhe pimë sa më afër kohës së fillimit të agjërimit.

Ajeti tregon, gjithashtu, se është e lejueshme që të gdhihesh xhunub, edhe nëse ka hyrë koha e agjërimit, sepse Allahu thotë: "...derisa të dallohet qartë peri i bardhë nga peri i zi, në agim", dhe dihet se njeriu, po kreu marrëdhënie seksuale deri në kohën kur hyn koha e agjërimit, kjo kohë do ta gjejë patjetër xhunub.

- "Pastaj, vazhdojeni agjërimin deri në mbrëmje." – Pra, deri në perëndimin e diellit, largojuni atyre gjërave që e prishin agjërimin.

Megjithatë, jo të gjithëve u lejohet kontakti me gratë e tyre gjatë netëve të Ramazanit, dhe këta janë ata që kanë vendosur të bëjnë *itikaf* në xhami, siç thotë i Lartësuari:

- "Mos kryeni marrëdhënie me to *(gratë)* kur qëndroni për *itikaf* në xhami." – Ky ajet tregon se të qëndruarit në xhami për adhurim të vazhdueshëm (*itikaf*) është i ligjëruar në Islam. Ai tregon, gjithashtu, se itikafi lejohet të kryhet veçse në xhami. Madje, meqë fjala "*el mesâxhid*" (xhami) në ajet është në trajtën e shquar (në arabisht), nga kjo kuptohet që itikafi lejohet të bëhet jo në çdo lloj xhamie, por veçse në xhamitë e rregullta, ku falet namazi në të pesta vaktet.

Përveç këtyre, ajeti tregon se marrëdhëniet seksuale e prishin itikafin.

- "Këta janë kufijtë e Allahut, prandaj mos iu afroni atyre." – Këta janë kufijtë e Zotit, të vendosur prej Tij, të cilët nuk duhen prekur.

Këtu Allahu i Lartësuar nuk ka thënë: "mos i shkelni ato", por thotë: "mos iu afroni". Forma e parë ndryshon nga e dyta,

sepse urdhri për të mos iu afruar kufijve të Zotit i përfshin të dyja llojet e harameve: haramet që janë të tilla në vetvete, pra, që Zoti i ka ndaluar sepse janë të këqija, të pista e të dëmshme, dhe haramet që janë të tilla sepse të çojnë në gjëra të tjera të këqija dhe të dëmshme.

Kështu, njeriu urdhërohet që t'u largohet harameve sa më shumë që të jetë e mundur, madje që të braktisë edhe çdo rrugë që të çon drejt harameve.

Kur flet për haramet, Allahu i Lartësuar thotë: "Mos iu afroni atyre!". Ndërsa kur flet për urdhëresat e Tij, që domosdoshmërisht duhen kryer, thotë: "Mos i shpërfillni ato!".

- "Në këtë mënyrë, Allahu ua sqaron njerëzve argumentet e Veta..." - Kështu, Allahu i Lartësuar ua sqaron me hollësi dispozitat adhuruesve të Tij.

- "...me qëllim që ata të ruhen", - Domethënë, që ata të pajisen me *takua,* me devotshmëri.

Dihet shumë mirë se kufijtë e Zotit nuk mund të ruhen nëse nuk janë të sqaruar mirë. Kur ata qartësohen për robin, ai e di si duhet të veprojë: të vërtetën e pranon dhe e zbaton, ndërsa së gabuarës i largohet dhe i ruhet. Ka shumë njerëz të cilët bëjnë një haram, sepse nuk e dinë se ai është haram, por nëse u qartësohet një gjë e tillë, ata largohen prej tij.

Kur njerëzve u qartësohen argumentet dhe dispozitat e Allahut, atyre nuk u mbetet më justifikim para Tij, prandaj, që t'i ruhen ndëshkimit dhe zemërimit të Allahut, ata duhet të bëhen të devotshëm.

Ajeti 188

188. Mos e hani pasurinë e njëri-tjetrit në mënyrë të palejuar. Mos ndërhyni te gjykatësit me rryshfete, për të grabitur në mënyrë të padrejtë një pjesë të pasurisë së njerëzve të tjerë, kur ju e dini.

Shpjegimi i ajetit

- "Mos e hani pasurinë e njëri-tjetrit në mënyrë të palejuar." – Kuptimi: Mos i merrni pasuritë tuaja me padrejtësi.

Fjala e përdorur është "*emuâlekum*" – "pasuritë tuaja", edhe pse qëllimi është "pasuritë e të tjerëve". Kështu, Allahu i Lartësuar na udhëzon që ne ta konsiderojmë shoqërinë si një bashkësi të vetme, ku nuk ka "ne" dhe "të tjerë". Pasuria e vëllait konsiderohet si pasuria ime. Ashtu sikurse nuk duam që të na i marrin pasurinë tonë pa të drejtë, po të njëjtën gjë duhet të dëshirojmë edhe për vëllain musliman. Nëse do t'ia lejonim vetes që të merrnim pasurinë e vëllait pa të drejtë, po kështu duhet të pranonim që edhe të tjerët të na merrnin pasurinë tonë pa të drejtë.

Duke qenë se fitimi dhe marja e pasurisë prej tjetrit është dy llojesh: e drejtë dhe e padrejtë, Allahu i Lartësuar përcaktoi si të ndaluar vetëm përfitimin me padrejtësi. Ka shumë forma përfitimi të padrejta, prej të cilave mund të përmendim:

1. Marrja e pasurisë nëpërmjet grabitjes, vjedhjes, mashtrimit, shkeljes së amanetit e të tjera si këto.

2. Kërkimi dhe pranimi i rryshfeteve, përfitimi nga fajdet, kumari e të tjera të ngjashme. Të gjitha këto mënyra fitimi janë të padrejta dhe nuk janë të lejuara nga Sheriati.

3. Marrja e pasurisë së njerëzve duke ngrënë në peshë, duke mashtruar në shitblerje, qiradhënie etj.

4. Të marrësh tjetrin në punë dhe të mos i japësh hakun që i takon (sipas marrëveshjes).

5. Fitimi që merr njeriu për një punë, së cilës nuk ia bën hyzmetin ashtu siç duhet.

6. Fitimi që merret për adhurime, të cilat nuk mund të jenë të sakta nëse me to synohet shpërblimi material, e jo kënaqësia e Allahut.

7. Përfitimi prej zekatit dhe sadakasë, nëse nuk hyn në kategorinë e njerëzve që përfitojnë prej tyre. E tillë është edhe marrja

prej kësaj pasurie më tepër sesa është e përcaktuar nga Sheriati, ose më tepër sesa është e nevojshme.

Të gjitha këto që u përmendën janë mënyra të ndaluara të përfitimit të pasurisë së njerëzve. Këto mënyra janë të palejueshme, edhe sikur të arrihen nëpërmjet gjykatësve, të cilëve u është dhënë rryshfet.

- "Mos ndërhyni te gjykatësit me rryshfete, për të grabitur në mënyrë të padrejtë një pjesë të pasurisë së njerëzve të tjerë, kur ju e dini." – Shpesh, ndodh që njerëz të padrejtë, me mundësitë dhe argumentimin e tyre, i bindin gjykatësit që t'i lejojnë të përfitojnë padrejtësisht nga pasuritë e të tjerëve. Por, sido që të jetë, gjykimi i një gjykatësi nuk e bën të lejuar tek Allahu atë që është haram dhe nuk e bën haram atë që është e lejuar. Tek Allahu i Lartësuar çështjet mbeten gjithnjë ashtu sikurse janë në të vërtetë. Pra, njeriu i padrejtë të mos mendojë kurrë që vendimi i gjykatësit në favor të tij është i pranueshëm tek Allahu, sepse Allahu i Lartësuar i njeh fshehtësitë deri në imtësi.

Atëherë, nëse dikush fiton padrejtësisht një pasuri, në bazë të një vendimi gjykate, e ka përsëri haram që ta marrë atë pasuri. Nëse ai e merr, konsiderohet prej atyre që hanë pasurinë e njerëzve pa të drejtë, prandaj meriton ndëshkimin e Allahut të Lartësuar. Ndëshkimi i tij është i merituesheëm, sepse ai e ka grabitur pasurinë e tjetrit me vetëdije dhe me mashtrim.

Po kështu edhe avokati i çështjes së këtij të padrejti duhet të mos bëhet palë me padrejtësinë. Pra, nëse ai sigurohet që klienti i tij nuk ka të drejtë në pretendimet e veta, atëherë nuk i lejohet që ta mbrojë, sikurse thotë i Lartësuari në një ajet tjetër: "Mos u tregoni të dobët në ndjekjen e armiqve, sepse nëse ju ndjeni dhimbje, edhe ata, sikurse ju, ndjejnë dhimbje, por ju shpresoni nga Allahu atë çka ata nuk e shpresojnë. Allahu është i Dijshëm e i Urtë. Ne të zbritëm ty *(Muhamed)* Librin *(Kur'ânin)* me plot të vërteta, që të gjykosh mes njerëzve me atë që të mëson Allahu. Mos u dil në ndihmë tradhtarëve. Pra, kërkoji falje Allahut, se Allahu është Falës e Mëshirues. Mos i mbro ata që mashtrojnë vetveten! Allahu nuk i do tradhtarët e gjynahqarët." [Nisa, 105].

Ajeti 189

189. Të pyesin ty për hënat. Thuaj: "Ato janë përcaktime të kohës për njerëzit dhe për haxhin." Nuk është mirësi të hyni në shtëpitë tuaja nga mbrapa tyre. Mirësi e vërtetë është për atë që ruhet. Në shtëpi hyni nga dyert e tyre. Kini frikë Allahun, që të shpëtoni!

Shpjegimi i ajetit

- "Të pyesin ty për hënat." – Kuptimi: Të pyesin për fazat e hënës, se çfarë dobie dhe çfarë urtësie fshihet pas tyre.

Allahu i Lartësuar, me mëshirën dhe urtësinë e Tij, e ka krijuar hënën dhe e ka bërë të shfaqet në faza të ndryshme. Kështu, kur shfaqet hëna e re, e cila është e hollë sa mezi duket, atëherë fillon muaji hënor. Pastaj ajo vazhdon e plotësohet dalëngadalë, derisa vjen mesi i muajit, kohë kur hëna është e plotë. Pas kësaj faze, hëna fillon përsëri të hahet, deri në përfundim të muajit, kur ajo zhduket.

- Thuaj: "Ato janë përcaktime të kohës për njerëzit dhe për haxhin."- Allahu i Lartësuar i bëri këto faza të hënës, me qëllim që njerëzit të mund të përcaktojnë kohën e adhurimeve të tyre, si: haxhin, agjërimin, kohën e zekatit etj. Allahu i Lartësuar ka përmendur haxhin, sepse ai kryhet në muaj të përcaktuar dhe kërkon një kohë të gjatë për t'u kryer.

Me anë të fazave të hënës përcaktohen edhe afati i borxheve apo i qiradhënieve, kohëpritja e një gruaje të divorcuar, gjatësia e një shtatzënie etj. Këto llogaritje janë tepër të nevojshme për krijesat, dhe Allahu i Lartësuar i ka bërë shumë të thjeshta ato me

anë të hënës, qoftë për të moshuar apo për fëmijë, për të ditur apo injorantë. Nëse llogaritja do të bëhej me vite diellore, do të ishte e vështirë, sepse këtë mënyrë e njohin njerëz të rrallë, që janë të specializuar në këtë fushë.

- "Nuk është mirësi të hyni në shtëpitë tuaja nga mbrapa tyre. Mirësia e vërtetë është për atë që ruhet. Në shtëpi hyni nga dyert e tyre." - Ensarët (medinasit) dhe të tjerë, kur vishnin ihramin për të kryer haxhin, nuk hynin në shtëpitë e tyre nga porta, derisa të përfundonin haxhin dhe të hiqnin ihramin. Ata mendonin se kjo ishte një vepër e mirë, me të cilën mund të afroheshin tek Allahu i Lartësuar. Por Allahu i Lartësuar bëri të ditur se nuk e konsideronte si adhurim një vepër të tillë, sepse Ai nuk e kishte ligjëruar atë. Allahu mund të adhurohet veçse me vepra të cilat Ai i ka ligjëruar dhe i ka sqaruar nëpërmjet Profetit dhe Kur'ânit. Pra, çdokush që kryen një vepër, me qëllim për të adhuruar Allahun, por që Allahu nuk e ka ligjëruar atë si të tillë, ai ka bërë veçse një bidat.

Kështu, Allahu i ndaloi "adhurime" të tilla të pabaza dhe i urdhëroi besimtarët që të hynin në shtëpitë e tyre nga dyert, jo nga dritaret.

Me këtë, Allahu i Lartësuar u mësoi besimtarëve një rregull shumë të rëndësishëm në Islam, që konsiderohet si parim kryesor i Sheriatit (domethënë që, nuk lejohet të adhurohet Zoti me vepra dhe mënyra që Ai nuk i ka ligjëruar nëpërmjet Kur'ânit dhe Profetit të Tij).

Nga ajeti kuptohet, qoftë edhe tërthorazi, se njeriu duhet të synojë që, në zgjidhjen e çdo çështjeje, të zgjedhë rrugën më të thjeshtë dhe më të shkurtër brenda kufijve të Sheriatit. Kësisoj, edhe ata që urdhërojnë njerëzit për vepra të mira dhe i ndalojnë ata nga të këqijat, duhet të jenë të kujdesshëm që të zgjedhin rrugët më të thjeshta dhe më efikase, me qëllim që fjala e tyre të pranohet. Në të njëjtën mënyrë duhet të veprojnë edhe mësuesit, të cilët duhet të zgjedhin mënyrat dhe rrugët më të thjeshta për të mësuar nxënësit, që të arrihen rezultatet e kërkuara.

Çdo njeri që ka synime të larta dhe të drejta, nëse ndjek mënyrat e ligjshme dhe tregohet i durueshëm në rrugën e tij, me siguri që do t'i arrijë rezultatet e synuara, me ndihmën e Sunduesit të Madh, Allahut të Lartësuar.

- "Kini frikë Allahun, që të shpëtoni!" - Ky është thelbi i bamirësisë për të cilën Allahu i Lartësuar i urdhëron krijesat: devotshmëri e vazhdueshme, duke zbatuar urdhrat e Tij dhe duke iu larguar harameve. Kjo është bamirësia që të shpëton nga çdo e keqe dhe që të dhuron çdo lloj të mire. Devotshmëria është rruga e vetme e arritjes së suksesit, prandaj kush nuk e arrin devotshmërinë, nuk mund ta arrijë kurrë suksesin.

Ajetet 190 – 193

190. Luftoni në rrugën e Allahut, kundër atyre që ju sulmojnë dhe mos e teproni, se Allahu nuk i do ata që e teprojnë.
191. Asgjësojini ata kudo që t'i zini. Dëbojini ata prej vendit, sikurse ju dëbuan ata juve. Sprovimi *(fitne-ja)* është më i rëndë se vrasja. Mos i luftoni ata pranë Xhamisë së Shenjtë *(Qabes)*, për sa kohë që edhe ata nuk ju luftojnë ju në të. Por nëse ju sulmojnë, atëherë shfarosini. Ky është ndëshkimi ndaj jobesimtarëve.
192. E nëse heqin dorë, atëherë Allahu është, pa dyshim, Falës e Mëshirues.
193. Luftojini ata, derisa të zhduket sprovimi *(fitne-ja)* dhe adhurimi t'i kushtohet vetëm Allahut. Nëse ata ndalen, atëherë ndaleni edhe ju luftën, por jo ndaj atyre që kanë bërë krime.

Shpjegimi i ajeteve

Në këto ajete, Allahu i Lartësuar urdhëron për luftë në rrugën e Tij. Ky urdhër ka ardhur pas emigrimit të muslimanëve në Medinë, kur ata u fuqizuan

për të zhvilluar një luftë të tillë, sepse në fillim muslimanët ishin urdhëruar të tregoheshin të përmbajtur.


- "Luftoni në rrugën e Allahut..." - Allahu i Lartësuar ka urdhëruar që ne të luftojmë dhe e ka përcaktuar qartë motivin e kësaj lufte, duke thënë: "Luftoni në rrugën e Allahut". Ky urdhër bëhet për të qenë të sinqertë ndaj Tij edhe në luftën që zhvillojmë.

Me fjalë të tjera, lufta që na urdhëron Allahu i Lartësuar është ajo që zhvillohet për hir të kënaqësisë së Tij dhe për vendosjen e drejtësisë. Ndërsa luftërat e tjera, sidomos ato që ndodhin mes muslimanëve, janë të padrejta.

- "...kundër atyre që ju sulmojnë" - Lufta zhvillohet kundër atyre që synojnë dhe përgatiten për luftë kundër muslimanëve. Kjo do të thotë që lufta bëhet kundër burrave të përgjegjshëm mendërisht, që synojnë të luftojnë muslimanët. Me fjalë të tjera, nuk luftohen pleqtë, fëmijët dhe gratë, të cilët nuk synojnë luftën dhe nuk kanë mundësi që ta zhvillojnë atë.

- "...dhe mos e teproni, se Allahu nuk i do ata që e teprojnë" – Pra, Allahu i Lartësuar na ndalon nga tejkalimi i kufijve, i çdo natyre qoftë ai. Kështu, për shembull, nuk lejohet të vrasësh gratë, fëmijët, pleqtë, të sëmurët mendorë apo njerëzit e fesë që nuk luftojnë, sepse konsiderohet teprim dhe padrejtësi e madhe. Nuk lejohet, gjithashtu, shfarosja e kafshëve, e bimësisë apo e të mbjellave pa qenë e nevojshme dhe e dobishme, sepse quhet padrejtësi. Nuk lejohet as të shpërfytyrosh apo të gjymtosh të vrarët. Nuk lejohet, po ashtu, të vrasësh jomuslimanët që kanë pranuar t'i paguajnë xhizjen shtetit Islam, pasi edhe ky konsiderohet tejkalim i kufijve të Zotit.

- "Asgjësojini ata kudo që t'i zini. Dëbojini ata prej vendit, sikurse ju dëbuan ata juve. Sprovimi *(fitne-ja)* është më i rëndë se


الجزء الثاني سورة البقرة
وَاقْتُلُوهُمْ حَيْثُ ثَقِفْتُمُوهُمْ وَأَخْرِجُوهُم مِّنْ حَيْثُ أَخْرَجُوكُمْ ۚ وَالْفِتْنَةُ
أَشَدُّ مِنَ الْقَتْلِ ۚ وَلَا تُقَاتِلُوهُمْ عِندَ الْمَسْجِدِ الْحَرَامِ حَتَّىٰ يُقَاتِلُوكُمْ
فِيهِ ۖ فَإِن قَاتَلُوكُمْ فَاقْتُلُوهُمْ ۗ كَذَٰلِكَ جَزَاءُ الْكَافِرِينَ ﴿١٩١﴾ فَإِنِ انتَهَوْا
فَإِنَّ اللَّهَ غَفُورٌ رَّحِيمٌ ﴿١٩٢﴾ وَقَاتِلُوهُمْ حَتَّىٰ لَا تَكُونَ فِتْنَةٌ وَيَكُونَ
الدِّينُ لِلَّهِ ۖ فَإِنِ انتَهَوْا فَلَا عُدْوَانَ إِلَّا عَلَى الظَّالِمِينَ ﴿١٩٣﴾ الشَّهْرُ الْحَرَامُ
بِالشَّهْرِ الْحَرَامِ وَالْحُرُمَاتُ قِصَاصٌ ۚ فَمَنِ اعْتَدَىٰ عَلَيْكُمْ فَاعْتَدُوا
عَلَيْهِ بِمِثْلِ مَا اعْتَدَىٰ عَلَيْكُمْ ۚ وَاتَّقُوا اللَّهَ وَاعْلَمُوا أَنَّ اللَّهَ مَعَ
الْمُتَّقِينَ ﴿١٩٤﴾ وَأَنفِقُوا فِي سَبِيلِ اللَّهِ وَلَا تُلْقُوا بِأَيْدِيكُمْ إِلَى التَّهْلُكَةِ
وَأَحْسِنُوا ۛ إِنَّ اللَّهَ يُحِبُّ الْمُحْسِنِينَ ﴿١٩٥﴾ وَأَتِمُّوا الْحَجَّ وَالْعُمْرَةَ لِلَّهِ ۚ
فَإِنْ أُحْصِرْتُمْ فَمَا اسْتَيْسَرَ مِنَ الْهَدْيِ ۖ وَلَا تَحْلِقُوا رُءُوسَكُمْ حَتَّىٰ يَبْلُغَ
الْهَدْيُ مَحِلَّهُ ۚ فَمَن كَانَ مِنكُم مَّرِيضًا أَوْ بِهِ أَذًى مِّن رَّأْسِهِ فَفِدْيَةٌ
مِّن صِيَامٍ أَوْ صَدَقَةٍ أَوْ نُسُكٍ ۚ فَإِذَا أَمِنتُمْ فَمَن تَمَتَّعَ بِالْعُمْرَةِ إِلَى الْحَجِّ
فَمَا اسْتَيْسَرَ مِنَ الْهَدْيِ ۚ فَمَن لَّمْ يَجِدْ فَصِيَامُ ثَلَاثَةِ أَيَّامٍ فِي الْحَجِّ
وَسَبْعَةٍ إِذَا رَجَعْتُمْ ۗ تِلْكَ عَشَرَةٌ كَامِلَةٌ ۗ ذَٰلِكَ لِمَن لَّمْ يَكُنْ أَهْلُهُ حَاضِرِي
الْمَسْجِدِ الْحَرَامِ ۚ وَاتَّقُوا اللَّهَ وَاعْلَمُوا أَنَّ اللَّهَ شَدِيدُ الْعِقَابِ ﴿١٩٦﴾
٣٠

vrasja." - Ky është një urdhër për t'i asgjësuar ata, kudo që të gjenden, në çdo kohë e çdo periudhë, qoftë kur lufta me ta është mbrojtëse, qoftë kur është sulmuese.

Më pas, nga ky përgjithësim, Allahu i Lartësuar përjashton disa vende e situata nga lufta, duke thënë:

- "Mos i luftoni ata pranë Xhamisë së Shenjtë *(Qabes)*, për sa kohë që edhe ata nuk ju luftojnë ju në të. Por nëse ju sulmojnë, atëherë shfarosini. Ky është ndëshkimi ndaj jobesimtarëve." – Pra, nuk lejohet zhvillimi i luftërave në Xhaminë e Shenjtë, në Qabe. Por në rast se janë ata që e fillojnë luftën, lejohet t'i kundërpërgjigjesh armiqësisë së tyre me luftë. Ky gjykim vlen për të gjitha kohërat dhe është i detyrueshëm të respektohet.

Lufta kundër tyre nuk ndërpritet kurrë, derisa ata të kthejnë rrugë, të lënë mohimin e Zotit dhe të bëhen muslimanë. Nëse ata pendohen dhe pranojnë t'i nënshtrohen Allahut si muslimanë, Allahu e pranon

pendimin e tyre dhe u fal çfarëdo gjynahu që të kenë bërë më parë. Kjo është mëshira dhe bujaria e madhe e Allahut të Lartësuar për krijesat.

- "E nëse heqin dorë, atëherë Allahu është, pa dyshim, Falës e Mëshirues." - Dikush mund të mendojë, me të drejtë, se zhvillimi i luftës në Xhaminë e Shenjtë është një krim shumë i rëndë, atëherë, si është e mundur që kjo të lejohet?! Për këtë arsye, Allahu i Lartësuar thotë se *fitne*-ja është më e keqe se vetë vrasja dhe lufta në Xhaminë e Shenjtë.

Kësisoj, *fitne*-ja ose sprovimi i njerëzve me kufër dhe duke i penguar ata nga rruga e drejtë, është më e keqe sesa lufta që zhvillohet në Xhaminë e Shenjtë, prandaj nuk ka arsye që muslimanët të shqetësohen për luftën që mund të bëhet atje, të provokuar nga qafirët.

Në këtë ajet mbështetet edhe parimi në Islam, i cili thotë: "Lejohet kryerja e një vepre me dëm më të vogël, për të shmangur një tjetër me dëm më të madh".

Më poshtë, Allahu i Lartësuar tregon shkakun e ligjërimit të luftës në rrugën e Tij.

- "Luftojini ata, derisa të zhduket sprovimi (*fitne*-ja) dhe adhurimi t'i kushtohet vetëm Allahut." – Kjo do të thotë se qëllimi i luftës nuk është derdhja e gjakut të qafirëve dhe marrja e pasurive të tyre, por: "të zhduket sprovimi (*fitne*-ja) dhe adhurimi t'i kushtohet vetëm Allahut." Pra, që feja dhe adhurimi i Allahut të Lartësuar të mbizotërojë në tokë, mbi të gjitha fetë dhe adhurimet e tjera. Ndërsa f*itne*-ja që duhet zhdukur është politeizmi, mohimi i Zotit, pengimi nga rruga e Zotit dhe çdo vepër tjetër e keqe dhe shkatërruese.

Nëse këto qëllime arrihen, atëherë nuk ka pse të ketë më luftë dhe të vrarë, prandaj Allahu i Lartësuar thotë:

"Nëse ata ndalen, atëherë ndaleni edhe ju luftën, por jo ndaj atyre që kanë bërë krime." - Kuptimi: Nëse ata e ndalojnë luftën, atëherë nuk merren masa ndëshkuese kundër askujt, përveçse kundër atyre që kanë bërë krime, të cilat duhen shpaguar, sipas shkallës dhe llojit të tyre.

Ajetet 194 – 195

194. Ky muaj i shenjtë është për atë muaj të shenjtë. Shkelja e shenjtërive le të ndëshkohet në të njëjtën mënyrë. Pra, nëse ju sulmojnë, sulmojini edhe ju po në atë masë. Kini frikë nga Allahu dhe dijeni se Allahu është, pa dyshim, me të devotshmit.
195. Shpenzoni në rrugë të Allahut dhe mos e çoni veten drejt shkatërrimit. Bëni mirë, se Allahu i do vërtet bamirësit!

Shpjegimi i ajeteve

- "Ky muaj i shenjtë është për atë muaj të shenjtë. Shkelja e shenjtërive le të ndëshkohet në të njëjtën mënyrë." – Ky ajet ka dy shpjegime. Si fillim, duhet ditur që idhujtarët e ndaluan Profetin (s.a.u.s.) dhe sahabët që të vizitonin Qaben, vitin kur u krye Marrëveshja e Hudejbijes. Sipas marrëveshjes, atë vit, muslimanët duhet të ktheheshin në shtëpi, dhe vizitën e Qabes ta kryenin vitin e ardhshëm. Dhe ashtu ndodhi. Muslimanët e kryen vizitën e Qabes një vit më pas, gjatë muajit të shenjtë *dhul kide*.

Në këtë kontekst, ajeti: "Ky muaj i shenjtë është për atë muaj të shenjtë" mund të shihet si një përgëzim për besimtarët, duke i njoftuar ata se adhurimi i tyre i lënë përgjysmë një vit më parë, tashmë është plotësuar me sukses.

Por ka mundësi që kuptimi i kësaj fjalie të jetë edhe kështu: "Nëse ata ju luftojnë gjatë muajve të shenjtë, edhe ju mund t'i luftoni në muajt e shenjtë. Nuk ka pengesë dhe as gjynah për ju që t'i kundërpërgjigjeni agresionit të tyre, qoftë edhe në muajt e shenjtë."

Nëse kuptimi është ky i dyti, atëherë fjalia pasuese: "Shkelja e shenjtërive le të ndëshkohet në të njëjtën mënyrë" është një

gjykim që përfshin jo vetëm përdhosjen e muajve të shenjtë, por edhe përdhosjen e vendeve të shenjta, të riteve të shenjta etj., për të cilat Sheriati ka urdhëruar që të respektohen. Në këtë mënyrë, çdokush që guxon të përdhosë diçka të shenjtë, duhet të marrë dënimin përkatës, si për shembull: kush bën luftë në muajt e shenjtë duhet të luftohet, kush përdhos vendet e shenjta duhet të ndëshkohet sipas ligjit, kush vret një njeri duhet të dënohet me vdekje, kush plagos apo gjymton tjetrin duhet të ndëshkohet në të njëjtën mënyrë, kush merr pasurinë e dikujt duhet të dënohet duke ia marrë pasurinë, për të çuar në vend padrejtësinë që ka bërë.

Pyetje: Personi të cilit dikush i ka cenuar një të drejtë, a e ka të lejuar që ta marrë hakun e vet nga pasuria e cënuesit, në çdo rast e situatë, apo jo?

Dijetarët i kanë dhënë përgjigje të ndryshme kësaj pyetjeje, por mendimi më i saktë do të shtjellohet më poshtë.

Këtu kemi të bëjmë me dy raste:

1. Nëse e drejta që ka njeriu kundrejt tjetrit është shumë e qartë dhe e sigurt, atëherë atij i lejohet që të marrë prej pasurisë së tjetrit, kur ky i fundit nuk ia jep hakun që meriton. Për shembull, bujtësi ka të drejtë që të pritet prej njeriut tek i cili ka bujtur. Nëse ai pritësi nuk ia jep hakun e tij si mysafir, atëherë mysafirit i lejohet të marrë prej pritësit aq sa Sheriati e ka përcaktuar hakun e tij.

Gjithashtu, gruaja e fëmijët kanë të drejta mbi pasurinë e burrit. Këto të drejta janë përcaktuar nga Sheriati. Nëse burri nuk ua jep këto të drejta, atëherë atyre u lejohet që të marrin nga pasuria e tij aq sa Sheriati e ka përcaktuar qartë dhe konkretisht për të drejtat e tyre.

2. Rasti i dytë është kur e drejta e dikujt nuk është e përcaktuar qartë, në mënyrë konkrete dhe të sigurt, si për shembull, kur dikush e mohon se i ka borxh dikujt tjetër ose kur kemi të bëjmë me mashtrime dhe vjedhje të pavërtetuara. Në të tilla raste nuk lejohet që të merret prej pasurisë së të akuzuarit, derisa të shqyrtohet dhe të përcaktohet qartësisht kjo e drejtë, e cila mund të jetë objekt abuzimi.

Kjo mënyrë trajtimi e çështjes është harmonizim i gjitha fakteve që janë dëshmuar për atë.

Më tej, Allahu i Lartësuar e përforcon më shumë një parim të Sheriatit, kur thotë:

- "Pra, nëse ju sulmojnë, sulmojini edhe ju po në atë masë." - Duhet të jemi të kujdesshëm në praktikat e shpagimit, në mënyrë që të mos bëhemi të padrejtë, në vend që të vendosim drejtësinë. Shpagimi duhet të bëhet me drejtësi, duke mos lejuar asnjë lloj teprimi, sado i vogël qoftë ai.

Allahu di gjithçka për krijesat e Tij. Shpesh, nga dëshira për të shfryrë dufin e urrejtjes kundër atij që i ka bërë padrejtësi dhe kur, njëkohësisht, i hapet udha për të marrë shpagim, njeriu kërkon më tepër dhe e kalon kufirin në marrjen e hakut të tij. Për këtë arsye, Allahu i Lartësuar i ka këshilluar adhuruesit e Tij që të jenë gjithnjë të devotshëm dhe respektues ndaj dispozitave të Tij:

- "Kini frikë nga Allahu dhe dijeni se Allahu është, pa dyshim, me të devotshmit." – Pra, jini të vazhdueshëm në devotshmërinë tuaj ndaj Allahut, duke ruajtur kufijtë e Tij. Nëse jeni të tillë, dijeni se Allahu është me të devotshmit. Ai është pranë tyre, duke i ndihmuar, mbështetur e duke iu dhënë sukses.

Njeriu që ka Allahun e Lartësuar pranë, do të jetë i lumtur përjetësisht, ndërsa ai që nuk ka devotshmëri të vazhdueshme, do të braktiset nga Allahu i Lartësuar e do të mbetet thjesht me forcat e tij. Por kush braktiset në këtë mënyrë, e ka shkatërrimin më afër se vetë damari i qafës së tij.

- "Shpenzoni në rrugë të Allahut..." - Allahu i Lartësuar i urdhëron adhuruesit që të shpenzojnë për hir të Tij, për të ndihmuar luftën në rrugën e Tij.

Ta japësh pasurinë në rrugë të Zotit do të thotë që ta shpenzosh atë në të gjitha mënyrat që të afrojnë te Zoti, si për shembull, për të varfërit, për të afërmit dhe për ata që e kemi detyrë t'i furnizojmë.

Megjithatë, mënyra më e mirë dhe më e rëndësishme e shpenzimit të pasurisë është për ndihmën dhe mbështetjen e luftës (*xhihad*) në rrugën e Zotit. Kush e shpenzon pasurinë për këtë qëllim, është edhe vetë luftëtar në rrugën e Allahut; ai është *muxhahid* me pasurinë e tij.

Lufta me shpenzimin e pasurisë është *farz*, ashtu sikurse është edhe lufta me pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të vetes tënde. Ajo është shumë e dobishme, saqë shpeshherë është vendimtare për fitoren e muslimanëve dhe për poshtërimin e politeizmit dhe të ndjekësve të tij. Pasuria është faktor shumë i rëndësishëm në fuqizimin e fesë së Allahut. Ajo është për xhihadin si shpirti për trupin: sikurse trupi nuk mund të jetojë pa shpirtin, edhe lufta nuk mund të jetojë nëse nuk ka pasuri të mjaftueshme.

Nëse braktis shpenzimin në rrugë të Allahut, do të pengosh në njëfarë mënyre luftën në rrugën e Tij. Por nëse bllokohet lufta në rrugë të Tij, atëherë do të fuqizohen kufri dhe shirku, do të forcohen armiqtë e Islamit, dhe kjo do të thotë që të çosh veten tënde, me duart e tua, drejt shkatërrimit. Për këtë arsye, Allahu i Lartësuar paralajmëron, duke na kujtuar pasojat e neglizhencës së luftës në rrugën e Tij:

- "...mos e çoni veten drejt shkatërrimit." – Vajtja me dëshirë drejt vetëshkatërrimit bëhet në dy mënyra kryesore:

1. Duke mos zbatuar urdhrat e Zotit, e të marrësh si pasojë shkatërrimin e trupit dhe të shpirtit tënd.

2. Duke bërë ato gjëra që shkaktojnë drejtpërdrejt shkatërrimin e trupit e të shpirtit.

Këto dy mënyra përfshijnë nën vete shumë veprime të njeriut, si për shembull, lënia e xhihadit në rrugën e Zotit apo mosshpenzimi për këtë qëllim, që, siç e thamë, sjellin si pasojë mbizotërimin e qafirëve ndaj muslimanëve. E tillë është edhe hapja e një lufte që është e pamundur të fitohet, apo ndërmarrja e një udhëtimi në një vend të mbushur me egërsira e gjarpërinj, apo ngjitja në një pemë apo objekt të lartë e të rrezikshëm e të tjera të ngjashme. Si vetëshkatërrim konsiderohet edhe zhytja e vetes në gjynahe, apo humbja e shpresës për faljen e Zotit, apo mosbindja ndaj urdhrave të Tij.

Duke qenë se shpenzimi i pasurisë për hir të Zotit është një mënyrë e bamirësisë, Allahu i Lartësuar e përforcon këtë urdhër me një urdhër tjetër, që i përfshin të gjitha llojet e bamirësisë:

- "Bëni mirë, se Allahu i do vërtet bamirësit!" - Ky urdhër është për të gjitha mënyrat e bamirësisë, sepse fjala "bamirësi" këtu nuk është e përcaktuar.

Bamirësia mund të bëhet me shumë mënyra, si: duke pajtuar njerëzit, duke urdhëruar për vepra të mira dhe duke ndaluar nga veprat e këqija, duke përcjellë dijen e dobishme për dynjanë dhe për ahiretin, duke përmbushur nevojat e njerëzve, duke zgjidhur ose duke lehtësuar hallet dhe problemet e tyre, duke vizituar të sëmurët, duke marrë pjesë në xhenaze, duke udhëzuar të devijuarit e çdo vepër tjetër që Allahu i Lartësuar na ka urdhëruar t'i kryejmë ndaj njerëzve.

Nga veprat më të mira që mund të kryejë robi, është përsosja e adhurimeve që ai kryen për hir të Allahut të Lartësuar. Profeti (s.a.u.s.) e ka shpjeguar kështu këtë çështje: *"Ta adhurosh Allahun e Lartësuar sikurse do ta bëje një gjë të tillë po ta shihje haptazi Atë, pasi edhe pse ti nuk mund ta shohësh Atë, Ai pa dyshim të sheh ty."*

Për ata që gëzojnë të tilla cilësi, Allahu thotë: "Për ata që bëjnë bamirësi, do të ketë të mira, madje më tepër" [Junus 26]. Këta njerëz e kanë afër Allahun, domethënë

udhëzimin, ndihmën dhe suksesin e Tij, në çdo çështje.

Pas sqarimit të dispozitave të agjërimit dhe të luftës, Allahu i Lartësuar vijon me dispozitat që lidhen me haxhin.

Ajeti 196

196. Kryeni të plotë haxhin dhe umren, për hir të Allahut! Nëse pengoheni, atëherë bëni kurban çfarë *(kafshe)* të keni më të lehtë. Mos e rruani kokën, derisa kurbani të arrijë në vendin e vet. Por, për ata që janë të sëmurë ose kanë plagë në kokë, kompensimi është me agjërim, sadaka ose kurban. Kur jeni të sigurt *(nga armiqtë)*, atëherë ai që kryen umren deri në haxh, le të bëjë kurban, sipas mundësisë. Ai që nuk ka, le të agjërojë tri ditë gjatë haxhit dhe shtatë ditë kur të jetë kthyer *(në shtëpi)*. Kështu bëhen dhjetë ditë të plota. Ky është rregulli për ata që nuk e kanë familjen pranë Xhamisë së Shenjtë. Pra, kijeni frikë Allahun, dhe dijeni se Allahu është ndëshkues i rreptë.

Shpjegimi i ajetit

- "Kryeni të plotë haxhin dhe umren, për hir të Allahut!" - Dijetarët kanë parë në këtë ajet argumente për disa çështje.

Kështu, ajeti provon se kryerja e haxhit dhe e umres është detyrë ndaj Zotit, me të gjitha ritet përbërëse të tyre, ashtu sikurse na i ka mësuar Profeti (s.a.u.s.), i cili ka thënë: *"Mësojini prej meje ritet dhe adhurimet!"* Po te ky ajet janë mbështetur edhe ata që kanë thënë se kryerja e umres është vaxhib, gjithashtu.

Nëse nis kryerja e haxhit dhe e umres, atëherë, që nga ky çast, bëhet i detyrueshëm plotësimi i tyre deri në fund, edhe sikur haxhi dhe umreja që po kryhen të jenë thjesht vepra vullnetare për atë njeri (sepse farz është vetëm hera e parë).

Haxhi dhe umreja duhen kryer në mënyrën më të plotë të mundshme, dhe jo të kryhen thjesht shtyllat dhe vaxhibet e tyre, sepse Allahu thotë: "Kryeni të plotë haxhin dhe umren...".

Allahu na urdhëron që të jemi të sinqertë ndaj Tij në kryerjen e adhurimeve tona. Haxhi dhe umreja duhen kryer për të fituar kënaqësinë e Tij, sepse Ai thotë që ta kryejmë haxhin dhe umren: "...për hir të Allahut".

Nuk lejohet që haxhi dhe umreja të ndërpriten, përveç rastit që tregon Allahu i Lartësuar, kur thotë:

- "Nëse pengoheni, atëherë bëni kurban çfarë *(kafshe)* të keni më të lehtë." – Kuptimi: Nëse pengoheni që të arrini në Qabe për të kryer ritet tuaja, për shkak të ndonjë sëmundjeje, nga ndonjë armik etj., atëherë rrugëzgjidhja është: "...atëherë bëni kurban çfarë *(kafshe)* të keni më të lehtë." Pra, bëni kurban atë kafshë që keni mundësi ta bëni.

Për kurban mund të bëhet një deve, që vlen për shtatë vetë, ose një lopë për shtatë vetë, ose një bagëti e imët për një person.

Pas therjes së kurbanit, i penguari nga shkaqet e mësipërme rruan kokën dhe del prej ihramit. Kështu veproi Profeti (s.a.u.s.) dhe shokët e tij në rastin kur u penguan nga idhujtarët e Mekës për të kryer e përfunduar pelegrinazhin në Qabe, vitin e Marrëveshjes së Hudejbijes.

Nëse nuk gjen apo nuk ka mundësi që të therë kurban, atëherë njeriu detyrohet të agjërojë dhjetë ditë, - sikurse vepron ai që kryen haxhin *temetu* kur nuk gjen dhe nuk ka mundësi të bëjë kurban, - pastaj lejohet të dalë nga ihrami.

- "Mos e rruani kokën, derisa kurbani të arrijë në vendin e vet." - Qethja ose rruajtja e kokës apo e qimeve të çdo pjese të trupit, me çdo mënyrë qoftë, konsiderohet si një nga veprimet që e prishin ihramin, i cili duhet plotësuar pa tjetër nga ai që kryen haxhin dhe umren.

Këto veprime e prishin ihramin, sepse gjatë kësaj kohe njeriu duhet t'i lërë mënjanë

ato komoditete që zakonisht ia mundëson vetes, dhe të angazhohet maksimalisht me adhurimin e Zotit. Kjo bëhet që, ditën kur të dalë para Zotit në Arafat, të jetë i përunjur, me flokë të shpupuritur e të pluhurosur, për të qenë kështu më afër mëshirës së Tij.

Të njëjtin gjykim ka edhe heqja e qimeve nga pjesët e tjera të trupit, siç u tha më lart. Madje, disa dijetarë e konsiderojnë edhe prerjen e thonjve të njëjtë me heqjen e flokëve, duke e parë nga këndvështrimi i mësipërm.

Ky ndalim vazhdon deri në ditën e therjes së kurbanit. Pra, thënia e Allahut: "..derisa kurbani të arrijë në vendin e vet" ka kuptimin: derisa të theren kurbanet, ditën e Bajramit.

Më e mira është që rruajtja e flokëve të bëhet pas therjes së kurbaneve, sikurse e tregon edhe kuptimi i drejtpërdrejtë i ajetit. [7]

Dijetarët shohin në këtë ajet mbështetje për një çështje tjetër. Kush kryen haxhin *temetu*, fillimisht bën umren. Pasi mbaron umren dhe çlirohet nga ihrami, ai duhet ta veshë përsëri ihramin, tashmë për të kryer haxhin. Në këtë lloj haxhi, adhuruesi i sjell me vete bagëtitë që do të bëjë kurban. Kështu, duke përdorur si dëshmi fjalën e Allahut: "..derisa kurbani të arrijë në vendin e vet", dijetarët thonë që, edhe në këtë lloj haxhi, adhuruesit nuk i lejohet të heqë ihramin dhe të rruajë apo të qethë kokën para se të theren bagëtitë e kurbanit, ditën e Bajramit.

Adhuruesi që kryen haxhin *temetu* mund t'i çojë bagëtitë që do bëjë kurban në vendtherjen e tyre, para ditës së Bajramit. Por thjesht dërgimi i bagëtive në vendtherje, nuk mjafton për të bërë të lejueshme rruajtjen e flokëve dhe heqjen e ihramit, sepse qëllimi i ajetit është: "...derisa bagëtitë të theren ditën e kurbaneve."

Allahu i Lartësuar i ka bërë këto rregulla të ihramit, me qëllim që adhuruesi të ketë një pamje që tregon nënshtrimin dhe modestinë e tij, nga njëra anë, dhe përkushtimin total ndaj Zotit, nga ana tjetër.

Por nëse dikush dëmtohet nga kjo gjë, atëherë Allahu i Lartësuar thotë:

- "Por, për ata që janë të sëmurë ose kanë plagë në kokë, kompensimi është me agjërim, sadaka ose kurban." - Nëse dikush vuan nga diçka, e cila mund të largohet veçse duke hequr flokët, atij i lejohet që ta rruajë kokën, por e ka detyrë të bëjë një nga tri gjërat vijuese si kompensim: ose të agjërojë tri ditë, ose të ushqejë gjashtë të varfër, ose të bëjë një kurban të pranueshëm. Ai është i lirë të zgjedhë mes këtyre tri alternativave.

Këto lehtësime vlejnë edhe për veprimet e tjera që janë të ndaluara të kryhen gjatë kohës së ihramit, si: prerja e thonjve, mbulimi i kokës (për burrat), veshja e rrobave të qepura (përveç ihramit) dhe parfumosja. Të gjitha këto, pra, që janë të ndaluara gjatë ihramit, lejohen të kryhen kur janë të domosdoshme, por më pas duhet të jepet kompensimi përkatës, sipas mënyrës së lartpërmendur. Më tej, i Lartësuari thotë:

- "Kur jeni të sigurt *(nga armiqtë)*, atëherë ai që kryen umren deri në haxh, le të bëjë kurban, sipas mundësisë." – Pra, ai që bën umren dhe lirohet nga ihrami deri për haxh, duhet të therë një kurban, si falënderim për lehtësimet dhe mirësitë e haxhit *temetu*, i cili mundëson që të bëhen dy adhurime (umre dhe haxh) në një udhëtim të vetëm.

Kurbani është edhe si falënderim për lehtësimet që i krijohen pas kryerjes së umres, duke pritur fillimin e haxhit, sepse pas përfundimit të umres, hiqet ihrami dhe lejohen ato komoditete që nuk bëhen gjatë ihramit, derisa vjen koha e haxhit, për ta veshur ihramin përsëri.

Kurban duhet të therë edhe ai që kryen haxhin e llojit *ḳirân*, sepse edhe ai kryen

[7] Ky ajet tregon në mënyrë të drejtpërdrejtë se nuk lejohet rruajtja para therjes së kurbanit, por sipas shpjegimit të Profetit, ne themi se është më mirë që rruajtja të bëhet pas kurbanit (Sh.p.).

umren e haxhin bashkë, në një kohë të vetme.

- "Ai që nuk ka, le të agjërojë tri ditë gjatë haxhit dhe shtatë ditë kur të jetë kthyer *(në shtëpi)*. Kështu bëhen dhjetë ditë të plota." - Kush nuk mund të therë kurban, e ka për detyrë që të agjërojë tri ditë gjatë kohës së haxhit dhe shtatë ditë kur të kthehet në vendin e vet, pas haxhit. Tri ditët gjatë haxhit fillojnë që në çastin kur vishet ihrami për të kryer umren, dhe vazhdojnë deri në ditën e tretë pas ditës së kurbanit, ose deri në ditën e fundit të gjuajtjes së gurëve dhe të qëndrimit në Mina. Megjithatë, më e mira është që të agjërohet dita e shtatë, e tetë dhe e nëntë e muajit *dhul hixhe*, pra, tri ditët para Bajramit.

Ndërsa shtatë ditët e mbetura nga dhjetëshja e domosdoshme për t'u agjëruar, duhet të agjërohen pas përfundimit të riteve të haxhit. Me fjalë të tjera, lejohet të agjërosh që kur ndodhesh ende në Mekë, gjatë rrugës së kthimit, ose kur të mbërrish në vendin tënd.

- "Ky është rregulli për ata që nuk e kanë familjen pranë Xhamisë së Shenjtë." - Kjo dispozitë, domethënë detyrimi i therjes së një kurbani për atë që e bën haxhin *temetu*, është e vlefshme për ata që nuk janë vendas në Mekë, ose që nuk jetojnë pranë Xhamisë së Shenjtë. Pra, kjo dispozitë vlen për ata që jetojnë larg Mekës dhe që kur vijnë në të, quhen "udhëtarë". Vetëm këta e kanë të detyrueshme që të therin kurban, si falënderim për kryerjen e dy adhurimeve (të haxhit dhe umres) në një udhëtim të vetëm. Ndërsa ata që banojnë pranë Xhamisë së Shenjtë, të cilët konsiderohen si vendas, e jo si udhëtarë, nuk duhet të bëjnë kurban, sepse nuk ka arsye për një gjë të tillë.

- "Pra, kijeni frikë Allahun..." - Ruajuni ndëshkimit të Allahut, duke iu përmbajtur kufijve të Tij në të gjitha çështjet tuaja. Ruajuni zemërimit të Tij, duke zbatuar rigorozisht urdhrat e Tij dhe duke iu larguar ndalesave të Tij. Edhe urdhrat dhe ndalesat që kanë të bëjnë me haxhin, të cilat u përmendën në këtë ajet, duhet të jenë në qendër të vëmendjes suaj, prandaj kurrë mos i neglizhoni ato!

- "...dhe dijeni se Allahu është ndëshkues i rreptë." - Allahu është ndëshkues i rreptë i atyre që nuk u binden urdhrave të Tij dhe nuk u largohen ndalesave të Tij.


Ja përse duhet devotshmëria (*takua*). Kush ia ka frikën ndëshkimit të Allahut të Lartësuar, ruhet që të mos shkelë kufijtë e Tij, duke shpresuar shpërblimin e Tij. Ndërsa ata që nuk i ruhen ndëshkimit dhe zemërimit të Allahut dhe nuk shpresojnë faljen dhe shpërblimin e Tij, sigurisht që do të kryejnë harame dhe do të guxojnë të lënë detyrimet e Tij.

Ajeti 197

197. Haxhi kryhet në muajt e caktuar. Për ata që nisin haxhin në këta muaj nuk lejohen marrëdhëniet intime, shkelja e dispozitave të Sheriatit dhe as grindjet. Çfarëdo mirësie që të bëni, Allahu e di shumë mirë. Pajisuni me gjërat që ju duhen *(për rrugë)*, por pajisja më e mirë është devotshmëria. Mua të më frikësoheni, o njerëz të mendjes!

Shpjegimi i ajetit

- "Haxhi kryhet në muajt e caktuar." - Muajt e haxhit Allahu i Lartësuar i ka quajtur "muajt e caktuar", sepse ata njiheshin shumë mirë nga njerëzit të cilëve iu drejtua fillimisht ky Kur'ân. Tek arabët, duke qenë se ishin pasardhës të Ibrahimit (a.s.), kishin mbetur ende disa rite fetare të drejta, mes të cilëve edhe disa nga ritet e haxhit. Pra, meqenëse ata i njihnin muajt kur kryhej haxhi, Allahu i Lartësuar nuk i përcakton konkretisht, me emër, sikurse ka bërë me muajin e agjërimit, kohët e faljes së namazit etj.


الجُزءُ الثَّانِي سُورَةُ البَقَرَةِ

ٱلْحَجُّ أَشْهُرٌ مَّعْلُومَٰتٌ ۚ فَمَن فَرَضَ فِيهِنَّ ٱلْحَجَّ فَلَا
رَفَثَ وَلَا فُسُوقَ وَلَا جِدَالَ فِى ٱلْحَجِّ ۗ وَمَا تَفْعَلُوا۟ مِنْ
خَيْرٍ يَعْلَمْهُ ٱللَّهُ ۗ وَتَزَوَّدُوا۟ فَإِنَّ خَيْرَ ٱلزَّادِ ٱلتَّقْوَىٰ ۚ
وَٱتَّقُونِ يَٰٓأُو۟لِى ٱلْأَلْبَٰبِ ﴿١٩٧﴾ لَيْسَ عَلَيْكُمْ جُنَاحٌ
أَن تَبْتَغُوا۟ فَضْلًا مِّن رَّبِّكُمْ ۚ فَإِذَآ أَفَضْتُم مِّنْ
عَرَفَٰتٍ فَٱذْكُرُوا۟ ٱللَّهَ عِندَ ٱلْمَشْعَرِ ٱلْحَرَامِ ۖ
وَٱذْكُرُوهُ كَمَا هَدَىٰكُمْ وَإِن كُنتُم مِّن قَبْلِهِۦ
لَمِنَ ٱلضَّآلِّينَ ﴿١٩٨﴾ ثُمَّ أَفِيضُوا۟ مِنْ حَيْثُ أَفَاضَ
ٱلنَّاسُ وَٱسْتَغْفِرُوا۟ ٱللَّهَ ۚ إِنَّ ٱللَّهَ غَفُورٌ رَّحِيمٌ ﴿١٩٩﴾
فَإِذَا قَضَيْتُم مَّنَاسِكَكُمْ فَٱذْكُرُوا۟ ٱللَّهَ كَذِكْرِكُمْ
ءَابَآءَكُمْ أَوْ أَشَدَّ ذِكْرًا ۗ فَمِنَ ٱلنَّاسِ مَن يَقُولُ
رَبَّنَآ ءَاتِنَا فِى ٱلدُّنْيَا وَمَا لَهُۥ فِى ٱلْءَاخِرَةِ مِنْ خَلَٰقٍ
﴿٢٠٠﴾ وَمِنْهُم مَّن يَقُولُ رَبَّنَآ ءَاتِنَا فِى ٱلدُّنْيَا حَسَنَةً
وَفِى ٱلْءَاخِرَةِ حَسَنَةً وَقِنَا عَذَابَ ٱلنَّارِ ﴿٢٠١﴾ أُو۟لَٰٓئِكَ
لَهُمْ نَصِيبٌ مِّمَّا كَسَبُوا۟ ۚ وَٱللَّهُ سَرِيعُ ٱلْحِسَابِ ﴿٢٠٢﴾

٣١

Shumica e dijetarëve janë të mendimit se muajt e haxhit janë *shevali*. *dhul kide* dhe dhjetë ditët e para të *dhul hixhes*, kur zakonisht vishet ihrami për kryerjen e haxhit.

- "Për ata që nisin haxhin në këta muaj... " – Pra, ata që veshin ihramin, e kanë të detyrueshme përfundimin e Tij, edhe nëse janë duke kryer haxh nafile.

I Lartësuari thotë: "*Men ferađa*" (Për ata që nisin...). Fjala '*ferada*' ka kuptimin: "e nisin e ia bëjnë të detyrueshme vetes". Kështu, ata që e nisin haxhin dhe umren dhe, për një arsye a tjetër, i ndërpresin ato, atëherë ka disa rregulla, që do të shtjellohen më poshtë, të cilat ata duhet t'i zbatojnë.

Këtu duhet sqaruar çështja e rrethanorit të kohës: "...në këta muaj": A tregon ai se veshja e ihramit për haxh bëhet veçse brenda këtyre muajve, apo mund të bëhet edhe jashtë tyre?

Imam Shafi'iju dhe shumë pasues të tij mendojnë se, sipas ajetit, haxhi mund të nisë (dhe ihrami mund të vishet) veçse brenda këtyre muajve.

Megjithatë, nëse do të thonim që ky ajet mbështet edhe mendimin e kundërt, nuk do të ishim të gabuar, sepse përcaktimi i kohës në këtë ajet nuk është i paqëllimshëm. Nga thënia e Allahut të Lartësuar: "Për ata që nisin haxhin në këta muaj...", kuptohet se haxhi mund të niska edhe jashtë këtyre muajve, sepse, në të kundërt, ç'kuptim do të kishte ky përcaktim i kohës në ajet?

- "...nuk lejohen marrëdhëniet intime, shkelja e dispozitave të Sheriatit dhe as grindjet." – Pra, është detyrë që të nderohet gjendja e ihramit dhe riti i haxhit, sidomos nëse haxhi nis gjatë këtyre muajve. Sapo të vishet rroba e ihramit, atëherë duhet të ruhesh prej çdo gjëje që e prish këtë gjendje apo që ia ul shpërblimin.

Gjendja e ihramit cenohet nga shumë vepra, të cilat Allahu i ka përmbledhur në tri:

1. Marrëdhëniet seksuale dhe gjithçka që i nxit ato, si puthjet, fjalët joshëse etj.

2. Çdo lloj gjynahu që ka të bëjë me moskryerje të ndonjë detyrimi apo me bërje harami.

3. Grindjet, zënkat e polemikat, të cilat nxisin urrejtjen dhe përçarjen. Këto e prishin gjendjen e ihramit ose, të paktën, e ulin shpërblimin e haxhit.

Dihet se një nga qëllimet kryesore të haxhit është kultivimi i përuljes para Allahut të Lartësuar dhe afrimi tek Ai me sa më shumë vepra dhe fjalë të mira, duke u larguar nga veprat dhe fjalët e këqija. Vetëm në këto kushte haxhi meriton të quhet "i pranuar" te Zoti i gjithësisë, dhe haxhi i pranuar ka si shpërblim veçse futjen në Xhenet.

Në fakt, veprat e mësipërme, që prishin ihramin, nuk janë të ndaluara vetëm gjatë kohës së haxhit. Ato janë të ndaluara në çdo kohë qoftë, por gjatë kohës së haxhit, ndalesa e tyre është më e fortë. Çdo vend

dhe kohë ka veçorinë e vet, dhe koha e haxhit ka gjithashtu veçorinë e vet.

Mësojeni mirë, të dashur vëllezër e motra besimtare, se kënaqësinë e Allahut të Lartësuar mund ta fitosh vetëm duke u larguar nga haramet dhe duke kryer urdhrat e Tij. Më tej, Allahu i Lartësuar thotë:

- "Çfarëdo mirësie që të bëni, Allahu e di shumë mirë. Pajisuni me gjërat që ju duhen (*për rrugë*), por pajisja më e mirë është devotshmëria." – Pra, çfarëdo lloj të mire që të kryeni, Allahu e di shumë mirë. Kjo konsiderohet si një nxitje shumë e fortë për të kryer vepra të mira, sidomos në ato vende dhe kohë të bekuara. Gjatë haxhit, njeriu duhet të përpiqet t'i shtojë sa më shumë veprat e mira, si namazet, agjërimin, sadakatë, fjalët e mira etj.

Pastaj Allahu i Lartësuar na urdhëron që të furnizohemi mirë për këtë udhëtim të bekuar, sepse ka shumë dobi. Nëse merr furnizim të nevojshëm, je i pavarur nga të tjerët, madje mund të jesh një ndihmë e madhe për ta. Kështu mund të marrësh edhe sevapin e ndihmës ndaj mysafirëve e udhëtarëve.

Ky ishte furnizimi i nevojshëm për kryerjen e këtij adhurimi. Ndërsa furnizimi që ka vlerë përgjithmonë, madje është i domosdoshëm për çdo njeri që kërkon suksesin dhe shpëtimin në jetën e dynjasë dhe në jetën e ahiretit, ai ka një emër tjetër: ai quhet "devotshmëri". Ky është furnizimi i domosdoshëm për të mbërritur "shëndoshë e mirë" në Vendin e Përjetësisë (në Xhenet), ku kënaqësitë dhe lumturia nuk kanë fund. Ndërsa ai që nuk është pajisur ende me devotshmëri, do ta ketë të vështirë këtë rrugë, e ndoshta mund të mos arrijë kurrë në destinacionin e të devotshmëve.

Ky është një vlerësim shumë i lartë për cilësinë e devotshmërisë, prandaj Allahu i Lartësuar i udhëron të diturit, të urtët e të mençurit, që të përpiqen seriozisht për t'u pajisur me këtë virtyt të çmuar, duke thënë:

- "Mua të më frikësoheni, o njerëz të mendjes!" – Kuptimi: O njerëz të mençur, që keni dituri dhe logjikë të drejtë, ruajuni ndëshkimit dhe zemërimit të Zotit tuaj, duke u pajisur me devotshmëri!

Allahu i urdhëron që të jenë të devotshëm, sepse kjo cilësi ua nxjerr në pah mençurinë dhe diturinë. Madje, braktisja dhe shpërfillja e devotshmërisë është tregues i injorancës dhe i mendjelehtësisë së njeriut.

Ajeti 198

198. Nuk është gjynah të kërkoni bereqet nga Zoti juaj. Kur të ktheheni prej Arafatit, përmendeni Allahun në vendet e shenjta! Përmendeni Atë, i Cili ju ka udhëzuar, se ju më parë ishit të humbur.

Shpjegimi i ajetit

Pasi urdhëroi për *takua*-n, Allahu i Lartësuar thotë diçka tjetër që i qetëson zemrat e besimtarëve. Më parë, disa njerëz mendonin se, po të bënte haxhiu tregti gjatë kohës së haxhit, do t'i humbte krejt shpërblimi i adhurimit. Për këtë arsye, Allahu i Lartësuar tregoi se ky qe një mendim i gabuar:

- "Nuk është gjynah të kërkoni bereqet nga Zoti juaj." – Kuptimi: Nuk është gjynah që të kërkoni mirësitë e Zotit tuaj duke bërë tregti apo diçka tjetër gjatë kohës së haxhit. Mjafton që tregtia apo puna për të fituar në hallall të mos ju pengojë nga kryerja e detyrave të haxhit dhe të mos ju shtyjë në kryerjen e harameve gjatë tij.

Pra, nëse adhuruesi i kryen plotësisht detyrimet e tij gjatë haxhit, nuk ka gjynah që të kërkojë, në mënyrë të lejuar, bereqetin e Allahut. Megjithatë, ai duhet t'i kushtojë rëndësi kënaqësisë së Allahut, duke mos u mbështetetur në forcat e veta gjatë kësaj përpjekjeje, por t'i mbështetet plotësisht Atij që i mundëson këto të mira.

- "Kur të ktheheni prej Arafatit, përmendeni Allahun në vendet e shenjta!" – Te kjo fjali mbështetet argumentimi i shumë çështjeve. Kështu, për shembull, qëndrimi në Arafat është shtyllë e haxhit, - ashtu siç njihej nga arabët dikur, - sepse "kthimi prej Arafatit" mund të kuptohet veçse pas qëndrimit në të.

Allahu na urdhëron që ta përkujtojmë Atë në vendet e shenjta, pra, në Muzdelife. (Edhe ky rit ka qenë i njohur nga arabët e hershëm). Pas kthimit prej Arafatit, duhet kaluar një natë në Muzdelife, në mënyrë që të nesërmen të përgatitesh për kurbanin. Pasi të falësh namazin e sabahut në Muzdelife, duhet të qëndrosh atje dhe të bësh lutje, derisa të zbardhë. Në fakt, "përkujtim i Allahut" quhet çdo e mirë që adhuruesi kryen, farz apo synet qoftë ajo.

Ajeti tregon, gjithashtu, se qëndrimi në Muzdelife kryhet pas kthimit prej Arafatit dhe qëndrimit në të. Qëndrimi në Arafat dhe në Muzdelife janë nga ritet e domosdoshme që duhen kryher gjatë haxhit.

Muzdelifeja është pjesë e territorit të shenjtë, sikurse thuhet në ajet, ndërsa Arafati nuk bën pjesë në këtë territor, sepse, në të kundërt, do të ishte i panevojshëm cilësimi i Muzdelifesë si "e shenjtë", nëse edhe Arafati do të ishte i tillë.

- "Përmendeni Atë, i Cili ju ka udhëzuar, se ju më parë ishit të humbur." – Pra, përkujtojeni Allahun e Lartësuar, në shenjë mirënjohjeje për mirësinë e Tij ndaj jush, duke ju udhëzuar pasi ishit të humbur, duke ju mësuar atë që nuk e dinit më parë. Kjo e fundit është mirësia më e madhe e Tij ndaj nesh, që e bën të detyrueshëm falënderimin dhe lavdërimin e Tij nga ana jonë, duke e përmendur Atë me gojë dhe me zemër.

Ajeti 199

199. Pastaj zhvendosuni ashtu siç zhvendosen të gjithë njerëzit dhe kërkojini falje Allahut! Pa dyshim, Allahu është Falës e Mëshirues.

Shpjegimi i ajetit

- "Pastaj zhvendosuni ashtu siç zhvendosen të gjithë njerëzit" – Kuptimi: Pas Muzdelifesë, zhvendosuni andej nga shkojnë njerëzit për plotësimin e riteve të haxhit, sepse në atë mënyrë janë zhvendosur njerëzit gjithmonë, nga koha e Ibrahimit (a.s.) e deri në kohët e sotme.

Kjo "zhvendosje" ka qenë e njohur për ta dhe nënkuptonte disa lëvizje e veprime, si: gjuajtjen e gurëve në Akabe, therjen e kurbaneve, tavafin e largimit (i cili quhet kështu sepse kryhet pas largimit nga Muzdelifeja), rendjen mes dy kodrave Safa dhe Merva, qëndrimin në Mina gjatë netëve të gjuajtjes së gurëve e deri në përfundimin e të gjitha riteve të haxhit.

- "...dhe kërkojini falje Allahut! Pa dyshim, Allahu është Falës e Mëshirues." - Duke qenë se largimi nga Muzdelifeja nënkupton ritet e fundit të haxhit, Allahu i Lartësuar i urdhëron besimtarët që të kërkojnë falje për mangësitë e tyre dhe të shtojnë sa më shumë përkujtimin e Tij.

Në fakt, adhuruesi duhet të veprojë kështu sa herë që përfundon një adhurim: t'i kërkojë falje Allahut të Lartësuar për çdo mangësi dhe dobësi të shfaqur gjatë adhurimit, dhe t'i shprehë mirënjohje të thellë Atij, sepse ishte Allahu që ia dha suksesin për ta plotësuar atë adhurim.

Adhuruesi duhet ta shohë punën e tij gjithnjë si të mangët. Ai nuk duhet të mendojë asnjëherë se e ka përkryer adhurimin ndaj Zotit të Tij apo se, në këtë mënyrë, i ka bërë mirë Zotit të tij dhe prandaj meriton grada të larta. Kush mendon kështu, në fakt, meriton urrejtjen e Zotit dhe mospranimin prej Tij të adhurimit që bën ky rob. Nëse jo, atëherë ai meriton që Allahu i Lartësuar t'ia pranojë veprat modeste dhe t'i japë sukses të mëtejshëm, në arritjen e të tjera të mirave.

Më poshtë, Allahu i Lartësuar përshkruan gjendjen dhe llojet e ndryshme të njerëzve, për sa u përket kërkesave dhe qëllimeve të tyre.

Ajetet 200 – 202

200. E kur t'i përfundoni ritet, përmendeni Allahun sikurse i përkujtoni prindërit tuaj, madje përmendeni edhe më shumë. Ka njerëz që thonë: "O Zoti ynë! Na jep në këtë botë!" Për të këtillët nuk ka pjesë në botën tjetër.
201. Por ka edhe të tjerë që thonë: "Zoti ynë, na jep të mira në këtë jetë dhe në jetën tjetër, dhe na ruaj prej dënimit në Zjarr!"
202. Këta do ta kenë pjesën e tyre për atë që kanë bërë. Allahu është i shpejtë në llogari.

Shpjegimi i ajeteve

- "E kur t'i përfundoni ritet, përmendeni Allahun sikurse i përkujtoni prindërit tuaj, madje përmendeni edhe më shumë." - Arabët e kishin zakon që, pas përfundimit të haxhit, të tuboheshin dhe të përkujtonin bëmat e të parëve të tyre. Për këtë arsye, Allahu i Lartësuar i urdhëroi ata që të përkujtonin mirësitë e Tij ndaj tyre më shumë sesa bëmat e të parëve të tyre.

- "Ka njerëz që thonë: "O Zoti ynë! Na jep në këtë botë!" Për të këtillët nuk ka pjesë në botën tjetër." - Ka njerëz që i kërkojnë Allahut vetëm ato gjëra që lidhen me dynjanë. Ata kërkojnë gjithçka që ua kërkon epshi i tyre i shfrenuar. Ata kanë si pikësynim veçse plotësimin e dëshirave të kësaj jete të shkurtër dhe nuk mendojnë aspak për ahiretin. Për këtë arsye, ata nuk do të kenë pjesë në ahiret.


- "Por ka edhe të tjerë që thonë: "Zoti ynë, na jep të mira në këtë jetë dhe në jetën tjetër, dhe na ruaj prej dënimit në Zjarr!" - Këta e lusin Allahun e Lartësuar që t'ua rregullojë çështjet e të dyja jetëve. Ata kërkojnë ndihmën e Tij në rregullimin e të dyja jetëve, duke i shfaqur Atij nevojën e tyre për ndihmën dhe suksesin e Tij.

- "Këta do ta kenë pjesën e tyre për atë që kanë bërë. Allahu është i shpejtë në llogari." - Si njëri grup, edhe tjetri do ta marrin shpërblimin për veprat që bëjnë në dynja. Allahu i Lartësuar do t'i shpërblejë ata në varësi të këtyre veprave dhe të qëllimeve të tyre. Ky shpërblim do të bazohet në dy parime të gjykimit të Tij: në drejtësinë e Tij absolute dhe në bamirësinë e Tij të gjerë, dhe për këto, Ai e meriton të lavdërohet, të admirohet dhe të falënderohet thellësisht.

Nga këto ajete mësojmë se Allahu i Lartësuar i përgjigjet lutjes së çdo lutësi që i drejtohet Atij. Po ashtu, duhet kuptuar mirë se përgjigjja ndaj lutësve nuk tregon gjithmonë se Allahu i do ata. Por, kur bëhet fjalë për lutje që synojnë të përsosin fenë dhe të ardhmen e njeriut në jetën tjetër, atëherë plotësimi i tyre është argument i sigurt se Allahu i Lartësuar e do atë person dhe është pranë Tij me dijen, mëshirën, ndihmën, mbrojtjen dhe suksesin e dhënë prej Tij. Besimtarët, kur i luten Allahut të Lartësuar, nuk thonë vetëm: "Na jep në dynja", sikurse thonë qafirët, por ata thonë: "Na jep të mira në dynja", pra, e përcaktojnë kërkesën e tyre me fjalën "të mira".

Tek "të mirat e dynjasë" bëjnë pjesë një mori gjërash, nga të cilat mund të përmendim furnizimin e këndshëm, të bollshëm, hallall dhe të lehtë për t'u arritur, një bashkëshorte të mirë, të dashur dhe të sjellshme, fëmijët e edukuar, të dashur, që të kënaqin syrin dhe shpirtin, gëzimi dhe lumturia, dituria e dobishme, veprat e mira e shumë të tjera si këto, që janë të lejuara dhe të dashura për robin.

Ndërsa tek "të mirat e ahiretit" bëjnë pjesë shumë gjëra të tjera, si: shpëtimi prej ndëshkimit që nga momenti i vdekjes e deri në Ditën e Llogarisë para Zotit, ruajtja nga ndëshkimi në zjarrin e Xhehenemit, arritja e kënaqësisë së Zotit, arritja e shpërblimit që


الجزء الثاني سورة البقرة
الحزب ٤
وَٱذۡكُرُواْ ٱللَّهَ فِيٓ أَيَّامٖ مَّعۡدُودَٰتٖۚ فَمَن تَعَجَّلَ فِي
يَوۡمَيۡنِ فَلَآ إِثۡمَ عَلَيۡهِۚ وَمَن تَأَخَّرَ فَلَآ إِثۡمَ عَلَيۡهِۚ لِمَنِ
ٱتَّقَىٰۗ وَٱتَّقُواْ ٱللَّهَ وَٱعۡلَمُوٓاْ أَنَّكُمۡ إِلَيۡهِ تُحۡشَرُونَ
٢٠٣ وَمِنَ ٱلنَّاسِ مَن يُعۡجِبُكَ قَوۡلُهُۥ فِي ٱلۡحَيَوٰةِ ٱلدُّنۡيَا
وَيُشۡهِدُ ٱللَّهَ عَلَىٰ مَا فِي قَلۡبِهِۦ وَهُوَ أَلَدُّ ٱلۡخِصَامِ ٢٠٤
وَإِذَا تَوَلَّىٰ سَعَىٰ فِي ٱلۡأَرۡضِ لِيُفۡسِدَ فِيهَا وَيُهۡلِكَ ٱلۡحَرۡثَ
وَٱلنَّسۡلَۗ وَٱللَّهُ لَا يُحِبُّ ٱلۡفَسَادَ ٢٠٥ وَإِذَا قِيلَ لَهُ ٱتَّقِ ٱللَّهَ
أَخَذَتۡهُ ٱلۡعِزَّةُ بِٱلۡإِثۡمِۚ فَحَسۡبُهُۥ جَهَنَّمُۚ وَلَبِئۡسَ
ٱلۡمِهَادُ ٢٠٦ وَمِنَ ٱلنَّاسِ مَن يَشۡرِي نَفۡسَهُ ٱبۡتِغَآءَ
مَرۡضَاتِ ٱللَّهِۗ وَٱللَّهُ رَءُوفُۢ بِٱلۡعِبَادِ ٢٠٧ يَٰٓأَيُّهَا ٱلَّذِينَ
ءَامَنُواْ ٱدۡخُلُواْ فِي ٱلسِّلۡمِ كَآفَّةٗ وَلَا تَتَّبِعُواْ خُطُوَٰتِ
ٱلشَّيۡطَٰنِۚ إِنَّهُۥ لَكُمۡ عَدُوّٞ مُّبِينٞ ٢٠٨ فَإِن زَلَلۡتُم مِّنۢ بَعۡدِ
مَا جَآءَتۡكُمُ ٱلۡبَيِّنَٰتُ فَٱعۡلَمُوٓاْ أَنَّ ٱللَّهَ عَزِيزٌ حَكِيمٌ
٢٠٩ هَلۡ يَنظُرُونَ إِلَّآ أَن يَأۡتِيَهُمُ ٱللَّهُ فِي ظُلَلٖ مِّنَ ٱلۡغَمَامِ
وَٱلۡمَلَٰٓئِكَةُ وَقُضِيَ ٱلۡأَمۡرُۚ وَإِلَى ٱللَّهِ تُرۡجَعُ ٱلۡأُمُورُ ٢١٠
٣٢

Zoti ka premtuar për vepërmirët, aférsia te Krijuesi i Dashur dhe Mëshirues etj.

Rrjedhimisht, lutja për këto dy lloje të mirash konsiderohet si lutja më gjithëpërfshirëse që mund të bëjë njeriu, prandaj ajo e meriton që të përsëritet shpesh dhe të zërë vend në zemrën dhe gjuhën e besimtarëve. Vetë Profeti (a.s.) e përsëriste shpesh këtë lutje dhe i nxiste të tjerët që ta bënin një gjë të tillë: "*Rabbenâ, âtinâ fiddunjâ ĥaseneten, ue fil âĥirati ĥaseneten, ue ḳinâ adhâben-Nâr*" (Zoti ynë, na jep të mira në këtë jetë dhe të mira në jetën tjetër, dhe na ruaj prej dënimit në Zjarr!)"

Ajeti 203

203. Përkujtojeni Allahun në ditë të caktuara. Kush ngutet e ikën për dy ditë, nuk bën gjynah. Por edhe ai që e shtyn nuk bën gjynah. Këto rregulla janë për atë që synon të jetë i përpiktë. Pra, ruhuni prej Allahut dhe dijeni se do të tuboheni para Tij.

Shpjegimi i ajetit

- "Përkujtojeni Allahun në ditë të caktuara." - Allahu i Lartësuar na urdhëron që ta përkujtojmë Atë në ditë të caktuara, të cilat janë tri ditët pas festës së Kurban Bajramit dhe të cilat quhen Ditët e Teshrikut. Këto ditë janë veçuar për shumë arsye, si:

- Për vlerën e madhe të tyre tek Allahu i Lartësuar.

- Në këto ditë kryen ritet e fundit të haxhit, prandaj duhet përkujtuar shumë Allahu i Lartësuar.

- Gjatë këtyre ditëve, njerëzit janë të ftuarit e Zotit në ditët e festës. Madje, për këtë arsye dhe për shkak se ato janë ditë gëzimi, ngrënieje, pirjeje etj., është i ndaluar agjërimi i tyre. Profeti (s.a.u.s.) ka thënë: "*Ditët e Teshrikut janë ditë kënaqësie, me ngrënie, pirje dhe me përkujtim të Allahut*".

- Gjatë këtyre ditëve përmendet shumë Allahu i Lartësuar, por sidomos në disa situata të veçanta, si: gjatë hedhjes së gurëve në Akabe, gjatë therjes së kurbaneve apo pas përfundimit të namazeve farze, kur besimtarët thonë: "*Allâhu ekber, Allâhu ekber, Allâhu ekber, lâ ilâhe il-lall-llâh, Allâhu ekber, Allâhu ekber, ue lil-lâhil ĥamd*". Disa dijetarë thonë se gjatë këtyre ditëve janë të pëlqyeshme edhe tekbiret, pra, të thuash: "Allahu ekber" sa më shumë.

- "Kush ngutet e ikën për dy ditë, nuk bën gjynah." – Pra, ai që përfundon gjuajtjen e gurëve për dy ditë dhe del prej Minasë para perëndimit të diellit të ditës së dytë të gjuajtjeve, nuk bën gjynah që largohet dhe nuk rri për ditën e tretë të gjuajtjes së gurëve.

- "Por edhe ai që e shtyn nuk bën gjynah." - Pra, edhe ai që qëndron në Mina për ditën e tretë të gjuajtjeve të gurëve nuk bën gjynah.

Është një lehtësim nga Allahu i Lartësuar për adhuruesit e Tij, që ua ka bërë të lejuara të dyja mundësitë. Megjithatë, të qëndrosh tri ditë është më mirë sesa dy ditë, sepse një

ditë më shumë do të thotë adhurime më shumë.

Në fakt, ajeti: "Kush ngutet e ikën për dy ditë, nuk bën gjynah..." edhe mund të keqkuptohet, duke menduar se kush i plotëson apo nuk i plotëson tri ditët e qëndrimit nuk merr gjynah për asnjë vepër tjetër që ka bërë, pra, është i pastër nga të gjitha gjynahet. Por e vërteta nuk qëndron kështu, sepse askush nuk është i pastër nga gjynahet pas mbarimit të haxhit, përveç një kategorie të caktuar njerëzish, për të cilët Allahu i Lartësuar thotë:

- "Këto rregulla janë për atë që synon të jetë i përpiktë." – Pra, vetëm ata që e kanë frikë ndëshkimin dhe zemërimin e Allahut dhe tregohen të kujdesshëm në përmbushjen e çdo dispozite, do të jenë të pastruar dhe të shpëtuar prej gjynaheve. Ndërsa ata që u ruhen vetëm disa gjërave dhe neglizhojnë të tjerat, do të shpërblehen për aq sa kanë bërë. Prandaj i Madhëruari thotë në vijim, duke e kujtuar disa herë këtë urdhër:

- "Pra, ruhuni prej Allahut dhe dijeni se do të tuboheni para Tij" – Kuptimi: Ruajuni ndëshkimit dhe zemërimit të Allahut, duke plotësuar urdhrat e Tij dhe duke u larguar nga ndalesat e Tij. Nëse e bëni këtë, të jeni të sigurt dhe të qetë se, kur të ktheheni tek Ai, do ta merrni të plotë shpërblimin e veprave të mira.

Ai që druhet dhe i respekton dispozitat e Zotit, ka për ta gjetur shpërblimin e devotshmërisë së tij. Ndërsa ai që nuk ruhet dhe i shpërfill dispozitat e Zotit të tij, do të marrë ndëshkimin e merituar.

Nëse njeriu e di se do të vijë një ditë, kur shpërblimi për veprat e kryera do të jepet me drejtësi, atëherë kjo është nxitje tepër e fortë për të që të pajiset me *takua*. Për këtë arsye, Allahu i Lartësuar thotë: "...dijeni se do të tuboheni para Tij", që kjo dije të thellohet dhe të shtohet prej adhuruesve të Tij.

Ajetet 204 - 207

204. Ka ndonjë njeri, fjalët e të cilit të mahnisin në këtë botë dhe që betohet në Allahun për çfarë ka në zemrën e tij, por që, në realitet, është kundërshtari më i rreptë.
205. Ky, me të kthyer shpinën, nxiton nëpër tokë që të përhapë të këqijat, duke shkatërruar të mbjellat dhe kafshët. Por Allahu nuk e do shkatërrimin.
206. E kur i thuhet atij: "Ki frikë Allahun!", atë e kap euforia, ndërsa arroganca e tij e zhyt edhe më thellë në gjynahe. I mjafton atij Xhehenemi si ndëshkim. Pa dyshim, vendbanimi më i tmerrshëm është ai i tij.
207. Ka njerëz që, për hir të Allahut, flijojnë vetveten. Allahu është shumë i butë me adhuruesit.

Shpjegimi i ajeteve

Pas ajeteve që nxisin besimtarët ta përkujtojnë shumë Allahun e Lartësuar, sidomos në vendet dhe kohët e veçanta të adhurimeve, vijohet me përshkrimin e atyre njerëzve, të cilët flasin shumë, por që veprat e tyre i tradhtojnë. Subhanallah! Fjalët, ose do ta ngrenë lart njeriun që i flet, ose do ta zhysin poshtë. Kështu, Allahu i Lartësuar thotë:

- "Ka ndonjë njeri, fjalët e të cilit të mahnisin në këtë botë..." – Pra, ka njerëz, fjalët e të cilëve prekin zemrat e dëgjuesve. Teksa i dëgjon, mendon se fjalët e tyre janë plot dobi dhe mirësi. Madje ata, për të vërtetuar fjalët e tyre, betohen në Zotin se, ato që shprehin me fjalë i kanë edhe në zemër, domethënë se janë të sinqertë.

- "...dhe që betohet në Allahun për çfarë ka në zemrën e tij..." – Pra, për të treguar pastërtinë dhe sinqeritetin e tyre, ata betohen në Allahun, duke pretenduar se ato që thonë me gojë i kanë edhe në zemër. Por, në fakt, ata janë gënjeshtarë, sepse fjalët e tyre nuk përputhen aspak me veprat dhe

ndjenjat e tyre. Nëse do të ishin të sinqertë, atëherë fjalët që thonë do t'i vërtetonin me veprat që bëjnë, sikurse ndodh me besimtarët e sinqertë. Më tej, Allahu i Lartësuar thotë:

- "...por që, në realitet, është kundërshtari më i rreptë." – Pra, nëse dikush polemizon me ta ose i kundërshton për një çështje të caktuar, ata shpalosin menjëherë një armiqësi të paparë, tregohen të papërmbajtur, fyes dhe kokëfortë në qëndrimet e tyre, duke shfaqur kështu shumë cilësi të ulëta, që nuk u përkasin besimtarëve të sinqertë. Besimtarët e sinqertë janë njerëz të thjeshtë e të sjellshëm. Ata i nënshtrohen së vërtetës, janë tolerantë dhe falës.

- "Ky, me të kthyer shpinën, nxiton nëpër tokë që të përhapë të këqijat, duke shkatërruar të mbjellat dhe kafshët." – Njerëz të tillë, që flasin fjalë mahnitëse dhe betohen për sinqeritet, sapo largohen prej teje, rendin gjithandej nëpër tokë, duke kryer të liga, të cilat janë dhe shkaku kryesor i shkatërrimit të saj: i të mbjellave, bagëtive, i gjallesave në përgjithësi etj. Ato sjellin, gjithashtu, pakësimin e bereqetit në tokë.

- "Por Allahu nuk e do shkatërrimin." – Pra, nëse Allahu nuk e do shkatërrimin, atëherë Ai i urren personat të cilët e shkaktojnë atë, edhe sikur ata të thonë fjalë të bukura e tërheqëse.

Nga ky ajet kuptojmë se fjalët që thonë njerëzit nuk janë tregues të sinqeritetit apo të mashtrimit të tyre. Ato nuk mund ta vërtetojnë tërësisht se dikush është i mirë apo i keq, pasi ky gjykim mund të jepet veçse duke krahasuar fjalët me veprat e tyre. Madje, për të gjykuar drejt veprat e një personi, duhet t'ia shohësh ato në mënyrë të vazhdueshme dhe sistematike, pasi për këtë nuk mjafton vetëm një rast. Pra, në përfundim, nuk mjafton thjesht deklarata e tij për vetveten dhe as një gjykim i bazuar mbi një vëzhgim të përciptë të veprave të tij.

Pastaj i Lartësuari tregon një cilësi tjetër të këtij soji njerëzish, që përhapin shkatërrimin në tokë:

- "E kur i thuhet atij: "Ki frikë Allahun!", atë e kap euforia, ndërsa arroganca e tij e zhyt edhe më thellë në gjynahe." - Kur ata këshillohen që të kenë frikë Allahun, i kap euforia dhe u rritet mendja, saqë nuk duan ta pranojnë më të vërtetën, madje tregohen të ashpër me këshilluesit e tyre. Kështu, ata bëjnë dy të këqija: vepra të ndyra dhe fyerje ndaj kritikuesve. Të tillët meritojnë një kërcënim të madh, siç thotë Allahu:

- "I mjafton atij Xhehenemi si ndëshkim. Pa dyshim, vendbanimi më i tmerrshëm është ai i tij." - Për këta njerëz është i mjaftueshëm ndëshkimi në Xhehenem, i cili do të jetë vendbanimi i zullumqarëve dhe mendjemëdhenjve. Atje ndëshkimi do të jetë i vazhdueshëm dhe vuajtjet të përjetshme, pa asnjë shpresë për shpëtim. Atyre nuk do t'u lehtësohen kurrë dhimbjet dhe kurrë nuk do të shpresojnë ndonjë gjë të mirë. Kjo është drejtësia për krimet dhe padrejtësitë e tyre. Allahu na ruajt nga një përfundim i tillë!

- "Ka njerëz që, për hir të Allahut, flijojnë vetveten. Allahu është shumë i butë me adhuruesit." - Këta janë të suksesshmit, të cilët i ka udhëzuar Allahu i Lartësuar që të flijojnë veten për hir të kënaqësisë së Tij. Ata e japin shpirtin me dëshirë, sepse duan të fitojnë kënaqësinë dhe shpërblimin e madh të Zotit të tyre. Ata e japin jetën për hir të Tij, i Cili është shpërblyesi më i mirë dhe ofruesi i çmimit më të lartë për shpirtin e tyre. Ata e falin shpirtin për hir të të Mëshirshmit dhe të dashurit të tyre, për Allahun e Lartësuar, sepse është pikërisht mëshira dhe dashuria e madhe e Tij, që u ka dhënë atë sukses. Çmimi që jep Allahu i Lartësuar për shpirtrat e tyre është shumë i shtrenjtë dhe i

mrekullueshëm: "Allahu blen prej besimtarëve shpirtrat dhe pasuritë e tyre, për t'u dhënë atyre Xhenetin." [Teube, 110].

Në këtë ajet, Allahu i Lartësuar tregon dy fakte: që besimtarët e sinqertë e shesin shpirtin e tyre për të arritur kënaqësinë e Allahut të Lartësuar, dhe që Ai është i Butë (*Raûf*) me besimtarët. Ky fakt i dytë i siguron besimtarët se Allahu do ta plotësojë qëllimin që ata kanë, për të cilin ata shesin dhe shpirtin e tyre dhe që është: arritja e kënaqësisë së Tij.

Ajetet 208 – 209

208. O ju që keni besuar, hyni në Islam tërësisht e mos ndiqni hapat e shejtanit, se ai është armiku juaj i hapur.
209. E nëse devijoni, pasi ju kanë ardhur argumentet e qarta, dijeni se Allahu është i Plotfuqishëm e i Urtë.

Shpjegimi i ajeteve

- "O ju që keni besuar, hyni në Islam tërësisht" - Ky është një urdhër i Allahut të Lartësuar, drejtuar të gjithë besimtarëve, që ata të hyjnë tërësisht në Islam. Pra, ata urdhërohen që t'i zbatojnë të gjitha dispozitat e Islamit, duke mos lënë asnjërën prej tyre.

Kështu, Allahu i Lartësuar i urdhëron besimtarët që të mos bëhen si ata që adhurojnë vetëm pasionet dhe dëshirat e tyre të shfrenuara dhe të padrejta, të cilët, nëse Sheriati u përshtatet me dëshirat e tyre, e ndjekin dhe e zbatojnë pikë për pikë, por nëse Sheriati bie ndesh dhe dëshirat e tyre, atëherë ata e braktisin atë. Me fjalë të tjera, në këtë ajet Allahu i Lartësuar na urdhëron që dëshirat dhe synimet tona t'ia nënshtrojmë Sheriatit dhe fesë së zbritur nga Ai.

Njeriu është i urdhëruar që të kryejë vepra të mira aq sa të ketë mundësi. E nëse shikon se disa prej tyre i ka të pamundura t'i realizojë, atëherë le vendosë me zemër se do t'i bëjë dhe të japë maksimumin, sepse kështu, edhe nëse nuk e arrin qëllimin, do të marrë shpërblimin njëlloj si për kryerjen e tyre.

Të hysh tërësisht në Islam, në të gjitha aspektet e tij, nuk është e mundur pa kundërshtuar rrugët e shejtanit. Prandaj Allahu i Lartësuar thotë menjëherë pas urdhrit të parë:

- "...e mos ndiqni hapat e shejtanit, se ai është armiku juaj i hapur." - Hapat e shejtanit janë veprat që kundërshtojnë porositë e Zotit. Nga ana tjetër, dihet se armiku yt i deklaruar kërkon veçse të keqen tënde, prandaj të shtyn në çdo gjë që është në dëmin tënd.

Por, me gjithë këto paralajmërime dhe udhëzime, njerëzit përsëri mund të neglizhojnë, prandaj Allahu i Lartësuar sjell një tjetër kërcënim, në mënyrë që ata të jenë gjithmonë të kujdesshëm dhe të vëmendshëm:

- "E nëse devijoni, pasi ju kanë ardhur argumentet e qarta, dijeni se Allahu është i Plotfuqishëm e i Urtë." – Kuptimi: Nëse ju devijoni, edhe pasi ju është dhënë dije e sigurt dhe e qartë për përfundimin e të pabindurve, atëherë kujtoni se Allahu është i Plotfuqishëm (*Azîz*) dhe i Urtë (*Hakîm*).

Ky është vërtet një kërcënim shumë i frikshëm dhe i ashpër, që të shtyn të jesh i kujdesshëm ndaj çdo veprimi që mund të çojë në humbje, sepse Allahu i Lartësuar është *Azîz* dhe, si i tillë, Ai e ndëshkon atë që nuk i bindet dhe devijon, dhe sepse Allahu është *Hakîm*, prandaj i jep çdokujt atë që i takon.

Ajeti 210

210. E ç'presin tjetër ata, që t'u vijë Allahu përmes hijeve të reve, bashkë me engjëjt, dhe çështja të ketë marrë fund?! Vetëm tek Allahu kthehen të gjitha çështjet.

Shpjegimi i ajetit

- "E ç'presin tjetër ata, që t'u vijë Allahu përmes hijeve të reve, bashkë me engjëjt, dhe çështja të ketë marrë fund?! Vetëm tek Allahu kthehen të gjitha çështjet. - Në këtë ajet vjen një kërcënim i ashpër dhe i frikshëm, prej të cilit të rrëqethet lëkura dhe dridhet zemra. Thotë i Lartësuari (sipas kuptimit të ajetit): Çfarë presin këta përhapës të shkatërrimit në tokë, që të ndalin poshtërsitë e tyre?! Mos, vallë, po presin Ditën kur do të llogariten drejt veprat e tyre?! Këtë presin pasuesit e hapave të shejtanit dhe mospërfillësit e urdhrave të Zotit?!

Ajo ditë do të jetë e tmerrshme. Zemrat e mizorëve do të jenë në ankth të pandërprerë dhe çdo përhapës i shkatërrimit do të marrë dënimin e merituar. Atë ditë, Allahu i Lartësuar do të palosë qiejt dhe tokën, do të shkatërrojë yjet dhe planetet, do të mbështjellë diellin dhe hënën. Të gjithë melekët do të zbresin për të rrethuar krijesat në Sheshin e Llogarisë, të përcaktuar nga Zoti i botërave. Atë ditë do të vijë vetë Allahu i Lartësuar, Krijuesi i krijesave, ashtu si i takon madhështisë së Tij, për të gjykuar me drejtësi.

Në këtë ditë të frikshme, Allahu i Lartësuar do të gjykojë krijesat me drejtësi. Atë ditë do të vendosen peshoret dhe do të maten veprat. Atë ditë do të ketë fytyra të bardha e të ndriçuara, të cilat do të jenë fytyrat e të mirëve fatlumë. Por atë ditë do të ketë edhe fytyra të nxira, të cilat do të jenë fytyrat e të këqijve të dëshpëruar. Kështu do të dallohen atë ditë të mirët nga të këqijtë, sepse çdokush do të shpërblehet sipas punës që ka bërë. Zullumqarët, atë ditë, do të kafshojnë duart e tyre nga ankthi dhe tmerri i asaj të vërtete, që tashmë do ta përjetojnë ashtu siç ajo është.

Ky ajet dhe shumë të tjerë si ai, vërtetojnë saktësinë e qëndrimit të *ehli sunet*-it rreth atributeve të Krijuesit, të cilët pranojnë dhe pohojnë për Allahun të gjitha ato atribute të cilat Ai i ka pohuar për Veten e Tij dhe të cilat i ka pohuar për Të Profeti i Tij (a.s.). Kështu, ata besojnë se Allahu i Lartësuar ngjitet lart (*isteua*), se Ai zbret (*nezele*) dhe se Ai vjen (*mexhîu*). Të gjitha këto, Allahu i Lartësuar i ka pohuar për Veten e Tij. Ata i pranojnë këto atribute të Krijuesit dhe i pohojnë ato për Të ashtu sikurse i shkon madhështisë së Tij, duke mos i përngjasuar ato me asgjë, por edhe duke mos e tjetërsuar kuptimin e tyre të drejtpërdrejtë.

Ndryshe veprojnë mohuesit e atributeve të Zotit, të cilët janë të shumëllojshëm, si për shembull, *xhehmi*-të, *mutezil*-ët, *eshari*-jtë etj. Disa prej tyre i mohojnë krejtësisht atributet e Krijuesit, ndërsa disa të tjerë u bëjnë interpretime të pabaza ajeteve kur'ânore që flasin për këto atribute. Madje, me këto lloj interpretimesh që u japin teksteve hyjnore, ata, në njëfarë mënyre, akuzojnë Allahun dhe Profetin e Tij, se nuk e kanë qartësuar të vërtetën plotësisht dhe mjaftueshëm, prandaj duhen "mendjet e ndritura" të tyre që të kuptohet fjala e Allahut dhe fjala e Profetit të Tij! Ndërsa ne të tjerët duhet të presim, derisa këta "të mençur" të na tregojnë kuptimin "e vërtetë" të tyre!

Në fakt, këta lloj interpretuesish nuk kanë asnjë provë apo bazë që të mbrojnë tezat e tyre, qoftë në transmetimet e sakta që kanë ardhur prej Allahut dhe Profetit (a.s.), qoftë në argumentimet logjike.

Për sa u përket të dhënave të sakta që kanë ardhur prej Allahut dhe Profetit të Tij (a.s.), edhe vetë grupimet e lartpërmendura e pranojnë se kuptimet e drejtpërdrejta të atyre teksteve dëshmojnë për qëndrimin e drejtë të *ehli sunet*-it. Kështu, e vetmja mënyrë për të mbështetur tezat e tyre është që këto tekste t'ua nënshtrojnë kritereve të tjera të gabuara për interpretim, duke u dhënë atyre kuptime të ndryshme nga domethëniet e tyre të drejtpërdrejta dhe të qarta. Por kritere të tilla shtrembëruese nuk mund të pranohen kurrsesi nga një njeri që ka në zemrën e tij sado pak iman.

Për sa i përket argumentimit logjik, ata nuk mund të vërtetojnë në asnjë mënyrë se mendja e shëndoshë nuk i pranon të tilla

atribute për Zotin, të cilat Ai i ka pohuar për Veten dhe që Profeti i Tij i ka pohuar për Të. Për shembull, nëse përdorim logjikën e pastër, si do t'i përgjigjeshim kësaj pyetjeje: Cili është pa të meta?! Ai që vepron, që ka aftësi vepruese dhe ndihmuese, apo ai që nuk i ka cilësi të tilla, që nuk ka fuqi të veprojë a të arrijë diçka?!

Veprimet e Allahut të Lartësuar që kanë lidhje me Veten e Tij apo me krijesat e Tij, tregojnë se Ai është Absolut, pa asnjë të metë. Nëse ata pretendojnë se pohimi i atributeve që Allahu i ka pohuar për Veten e Tij dhe që Profeti i Tij i ka pohuar për Të, është një lloj përngjasimi i Allahut me krijesat e Tij, atëherë ne përgjigjemi duke u thënë: Të dyja palët jemi dakord se të flasësh rreth atributeve të Zotit do të thotë që të flasësh rreth Qenies së Tij. Atëherë, nëse pranojmë se Qenia e Tij nuk i përngjan asnjë prej krijesave të Tij, përse të mos e pranojmë këtë rregull edhe për atributet e Tij. Pra, le të themi që Ai ka atribute të cilat nuk i përngjajnë asnjë prej atributeve të krijesave të Tij, dhe çështja mbyllet me kaq. Nëse pranojmë që atributet e Tij janë ashtu sikurse i përshtaten Madhështisë së Tij, atëherë ne e përjashtojmë përngjasimin e cilësive të Tij me cilësitë e krijesave.

Përveç këtyre, ka njerëz të cilët pranojnë disa atribute të Zotit dhe mohojnë disa të tjera, siç ka gjithashtu që i pranojnë emrat e Zotit, por mohojnë cilësitë e Tij. Të këtillëve u themi: Për ju ka veç dy mundësi: ose të pranoni të gjithë emrat dhe cilësitë që Zoti i ka pohuar për Veten e Tij dhe që Profeti i Tij i ka pohuar për Të, ose t'i mohoni të gjithë këta emra dhe cilësi, e në këtë mënyrë të mohoni vetë Zotin e botërave. Ndërsa mundësia e tretë, ajo që ofroni ju, është tepër kontradiktore me veten. Çfarë dallimi ka mes atyre atributeve të Zotit që ju i pranoni dhe atyre atributeve që ju nuk i pranoni?!

Ata nuk mund të sjellin asnjë argument bindës për qëndrimet e tyre, megjithëse pretendojnë se cilësitë dhe emrat e Zotit që ata i pranojnë, për nga kuptimi që kanë, nuk tregojnë ngjashmëri të Krijuesit me krijesat, gjë që, sipas tyre, nuk ndodh me emrat dhe cilësitë që ata nuk i pranojnë.


Ehli sunet-i përgjigjet: "Edhe emrat e atributet e Allahut që ju i mohoni nuk tregojnë ngjashmëri me krijesat, po t'i gjykoni nga i njëjti këndvështrim me të cilin ju shihni ata emra dhe atribute të Allahut që nuk i mohoni."

Ata përgjigjen me arrogancë: "Nga ata emra dhe cilësi që ju pohoni për Zotin e botëve, ne mund të kuptojmë veçse një përngjasim të Tij me krijesat."

Ehli sunet-i kundërpërgjigjet: "Edhe ne, po të përdorim mënyrën tuaj të gjykimit rreth emrave dhe cilësive të Zotit, do t'i shohim ato emra dhe cilësi që ju i pranoni, si përngjasim të Tij me krijesat. Me fjalë të tjera, emrat dhe cilësitë që ju i pranoni nuk kanë asnjë ndryshim nga cilësitë dhe emrat që ju i mohoni, nëse përdorim të njëjtën mënyrë gjykimi dhe të njëjta kritere për trajtimin e tyre. Ose, më mirë, na jepni argumentet tuaja që tregojnë se cilësitë dhe emrat që ju i pranoni dhe i pohoni për Zotin e botës, nuk kuptohen si përngjasim me krijesat!

Kur ata sjellin argumentet e tyre, ne u themi: Argumentet që ju i përdorni për të pranuar disa emra e cilësi të Allahut, që, sipas jush, nuk nënkuptojnë përngjasim të Allahut me krijesat, janë po ato që edhe ne të *ehli sunet*-it përdorim që të vërtetojmë se emrat dhe cilësitë që ju i mohoni nuk nënkuptojnë përngjasim të Allahut me krijesat.

Ata që pohojnë disa cilësi dhe emra të Allahut dhe mohojnë disa të tjera, ndërkohë që Allahu i Lartësuar dhe Profeti i Tij i kanë pranuar dhe pohuar të gjitha ato, janë kontradiktorë me veten e tyre dhe të turbullt në çdo gjykim që japin. Ata nuk mund të arrijnë askund, në çdo mënyrë që të argumentojnë, qoftë me fakte konkrete, qoftë nga ana logjike. Madje, atyre që kundërshtojnë dëshmitë e ardhura nga Zoti dhe Profeti i Tij, u duhet gjithashtu që të



سَلۡ بَنِيٓ إِسۡرَٰٓءِيلَ كَمۡ ءَاتَيۡنَٰهُم مِّنۡ ءَايَةم بَيِّنَةٖۗ وَمَن يُبَدِّلۡ نِعۡمَةَ
ٱللَّهِ مِنۢ بَعۡدِ مَا جَآءَتۡهُ فَإِنَّ ٱللَّهَ شَدِيدُ ٱلۡعِقَابِ ٢١١ زُيِّنَ
لِلَّذِينَ كَفَرُواْ ٱلۡحَيَوٰةُ ٱلدُّنۡيَا وَيَسۡخَرُونَ مِنَ ٱلَّذِينَ ءَامَنُواْۘ وَٱلَّذِينَ
ٱتَّقَوۡاْ فَوۡقَهُمۡ يَوۡمَ ٱلۡقِيَٰمَةِۗ وَٱللَّهُ يَرۡزُقُ مَن يَشَآءُ بِغَيۡرِ حِسَابٖ
٢١٢ كَانَ ٱلنَّاسُ أُمَّةٗ وَٰحِدَةٗ فَبَعَثَ ٱللَّهُ ٱلنَّبِيِّـۧنَ مُبَشِّرِينَ
وَمُنذِرِينَ وَأَنزَلَ مَعَهُمُ ٱلۡكِتَٰبَ بِٱلۡحَقِّ لِيَحۡكُمَ بَيۡنَ ٱلنَّاسِ
فِيمَا ٱخۡتَلَفُواْ فِيهِۚ وَمَا ٱخۡتَلَفَ فِيهِ إِلَّا ٱلَّذِينَ أُوتُوهُ مِنۢ بَعۡدِ
مَا جَآءَتۡهُمُ ٱلۡبَيِّنَٰتُ بَغۡيَۢا بَيۡنَهُمۡۖ فَهَدَى ٱللَّهُ ٱلَّذِينَ ءَامَنُواْ
لِمَا ٱخۡتَلَفُواْ فِيهِ مِنَ ٱلۡحَقِّ بِإِذۡنِهِۦۗ وَٱللَّهُ يَهۡدِي مَن يَشَآءُ
إِلَىٰ صِرَٰطٖ مُّسۡتَقِيمٍ ٢١٣ أَمۡ حَسِبۡتُمۡ أَن تَدۡخُلُواْ ٱلۡجَنَّةَ وَلَمَّا
يَأۡتِكُم مَّثَلُ ٱلَّذِينَ خَلَوۡاْ مِن قَبۡلِكُمۖ مَّسَّتۡهُمُ ٱلۡبَأۡسَآءُ وَٱلضَّرَّآءُ
وَزُلۡزِلُواْ حَتَّىٰ يَقُولَ ٱلرَّسُولُ وَٱلَّذِينَ ءَامَنُواْ مَعَهُۥ مَتَىٰ نَصۡرُ
ٱللَّهِۗ أَلَآ إِنَّ نَصۡرَ ٱللَّهِ قَرِيبٞ ٢١٤ يَسۡـَٔلُونَكَ مَاذَا يُنفِقُونَۖ قُلۡ
مَآ أَنفَقۡتُم مِّنۡ خَيۡرٖ فَلِلۡوَٰلِدَيۡنِ وَٱلۡأَقۡرَبِينَ وَٱلۡيَتَٰمَىٰ وَٱلۡمَسَٰكِينِ
وَٱبۡنِ ٱلسَّبِيلِۗ وَمَا تَفۡعَلُواْ مِنۡ خَيۡرٖ فَإِنَّ ٱللَّهَ بِهِۦ عَلِيمٞ ٢١٥

shkelin edhe mbi argumentimet logjike që ata përdorin. Vetëm në këtë mënyrë ata mund t'i qëndrojnë besnikë mendimit të tyre. Por ky quhet veçse fanatizëm i tërbuar dhe i kotë.

Ajeti 211

211. Pyeti bijtë e Israilit se sa argumente të qarta u kemi dhënë atyre. E kush i mohon të mirat e Allahut, pasi i janë dërguar, të jetë i sigurt se Allahu e ka ndëshkimin të ashpër.

Shpjegimi i ajetit

"Pyeti bijtë e Israilit se sa argumente të qarta u kemi dhënë atyre." – Kuptimi: Sa e sa argumente të qarta u kemi dhënë, që vërtetojnë sinqeritetin e profetëve që kemi dërguar tek ata.

Në fakt, ata i njohën dhe i kuptuan mirë argumentet e Zotit, por, megjithatë, nuk treguan mirënjohje ndaj Tij. Ata i shpërfillën mirësitë e Zotit, duke i mohuar ato dhe duke mos u bindur. Kështu, ata e merituan që Allahu i Lartësuar të zbriste ndëshkimin e Tij mbi ta dhe të mos u caktonte pjesë në shpërblimet e Tij të mëdha.

- "E kush i mohon të mirat e Allahut, pasi i janë dërguar, të jetë i sigurt se Allahu e ka ndëshkimin të ashpër." – Pra, me fjalë të tjera, Allahu i Lartësuar deklaron se atyre që begatohen me mirësi të dynjasë apo edhe me iman, dhe nuk shprehin mirënjohje ndaj Tij, atyre do t'u zhduken këto mirësi.

Çdo mirësi së cilës nuk i jepet haku i mirënjohjes është e destinuar që të largohet dhe të shndërrohet në të kundërtën e saj, sepse në vend të mirënjohjes për të, në zemrën e robit ka zënë vend mosmirënjohja dhe mohimi. Pra, me mosmirënjohjen e tij, bëri që në vend të mirësive të mbizotërojnë të këqijat.

Ndërsa atyre që e falënderojnë Allahun për mirësitë e dhuruara, jo vetëm që nuk u largohen ato mirësitë që kanë, por ato u shtohen vazhdimisht nga Allahu i Lartësuar dhe Bujar.

Ajeti 212

212. Atyre që nuk besojnë u është hijeshuar jeta e kësaj bote, e madje tallen me ata që besojnë. Por ata që e ruajnë devotshmërinë do të qëndrojnë sipër tyre Ditën e Kijametit. Allahu begaton pa masë atë që Ai dëshiron.

Shpjegimi i ajetit

- "Atyre që nuk besojnë u është hijeshuar jeta e kësaj bote, e madje tallen me ata që besojnë..." – Këtu flitet për ata që mohojnë Allahun, që shpërfillin argumentet e Tij, nuk u binden profetëve të Tij dhe nuk i nënshtrohen ligjit të Tij. I Madhëruari na tregon se këtyre njerëzve u është zbukuruar dhe u është bërë shumë e dashur kjo botë. Ajo është bërë shumë e dashur për zemrat e tyre dhe shumë e bukur për sytë e tyre. Ata e gjejnë prehjen dhe kënaqësinë në këtë botë. Dëshirat, ëndrrat, qëllimet dhe veprat e tyre janë të lidhura vetëm me të. Ata i

përkushtohen kësaj jete totalisht, dhe me të gjithë qenien e tyre. Ata janë gjithnjë të zënë me grumbullimin e të mirave të saj. Në zemrat e tyre kjo botë zë një vend mjaft të rëndësishëm. Ata i adhurojnë bukuritë e saj dhe nderojnë këdo që arrin të grumbullojë shumë prej saj.

Ndërsa me besimtarët, të cilët nuk e vlerësojnë dynjanë më shumë sesa e meriton, ata tallen e thonë: "Këta na qenkan të zgjedhurit e Zotit?! Këta ka zgjedhur Zoti për t'u falur mirësi?!" Shikoni se sa i mangët është vështrimi i tyre për jetën. Ata mendojnë se njerëzit më të mirë janë ata që kanë më tepër pasuri. Por këta të mjerë nuk e dinë se dynjaja është veç një vend sprove, për të bërë sa më shumë vepra të mira. A nuk e shohin ata se në këtë jetë goditen me fatkeqësi edhe besimtarët, edhe mohuesit? Por besimtarët, edhe kur sprovohen me ndonjë fatkeqësi, imani i ndihmon që të bëjnë durim, duke llogaritur shpërblimin nga Allahu. Imani ua lehtëson atyre përballimin e sprovave të dynjasë, gjë e cila nuk ndodh aspak me jobesimtarët.

Përfundimsht, Allahu i Lartësuar nuk i mat gradat e njerëzve me pasuri apo me ofiqe të kësaj dynjaje, por Ai sheh vetëm devotshmërinë ndaj Tij. Megjithatë, këto grada do të duken qartë në Ditën e Kijametit, siç thotë Allahu i Lartësuari:

- "Por ata që e ruajnë devotshmërinë do të qëndrojnë sipër tyre Ditën e Kijametit." - Atë ditë do të duken gradat e larta dhe njerëzit që i meritojnë ato. Më lart do të qëndrojnë ata që janë të pajisur me devotshmëri, të cilët i ruhen zemërimit dhe ndëshkimit të Zotit të tyre duke zbatuar urdhrat e Tij dhe duke iu larguar ndalesave të Tij, të shtyrë nga madhërimi dhe dashuria për Atë. Të tillët do të shijojnë çdo lloj kënaqësie dhe do të jenë të lumtur.

Ndërsa qafirët do të jenë shumë poshtë, të zhytur në shtresat më të ulëta të zjarrit të Xhehenemit. Atje do të vuajnë pa fund ndëshkimin, poshtërimin dhe dëshpërimin përjetësisht, sepse e meritojnë. Kështu, ky ajet është njëkohësisht sihariq për besimtarët dhe kërcënues për qafirët.

Mirësitë e kësaj bote dhe të tjetrës janë në dorë të Zotit, i Cili i shpërndan ato sipas urtësisë së Tij:

- "Allahu begaton pa masë atë që Ai dëshiron." - Mirësitë e kësaj bote u jepen edhe besimtarëve, edhe qafirëve, ndërsa mirësitë që kanë të bëjnë me zemrën, siç janë dija e sigurt dhe e dobishme, imani i fortë, dashuria për Allahun, shpresa për shpërblimin e Tij dhe frikërespekti ndaj Tij u jepen veçse të nderuarve, të përzgjedhurve.

Ajeti 213

213. Njerëzit ishin dikur një bashkësi e vetme. Pastaj Allahu dërgoi profetët, si përgëzues dhe si qortues. Ai u zbriti atyre edhe Librin me të vërtetën, për të gjykuar njerëzit në çështjet që kundërshtoheshin mes tyre. Pas qartësimit të argumenteve, askush nuk kundërshtoi më, përveç arrogantëve të verbuar nga zilia dhe armiqësia për njëri-tjetrin. Me mëshirën e Tij, Allahu i udhëzoi besimtarët tek e vërteta e çështjeve, për të cilat kishin kundërshtime. Allahu udhëzon në rrugë të drejtë atë që dëshiron.

Shpjegimi i ajetit

- "Njerëzit ishin dikur një bashkësi e vetme. Pastaj Allahu dërgoi profetët, si përgëzues dhe si qortues." – Pra, në fillim, njerëzit ishin të gjithë në rrugë të drejtë dhe adhuronin një Zot, vetëm Allahun. Kështu vazhduan për rreth dhjetë shekuj pas kohës së profetit Nuh (a.s.). Pastaj ata u ndanë në dy grupe të mëdha: një grup i qëndroi besnik rrugës së drejtë, duke e adhuruar Zotin të vetëm dhe duke iu bindur veç Atij, ndërsa grupi tjetër filloi të adhurontë zota të tjerë veç Allahut dhe u larguan nga bindja dhe nënshtrimi ndaj Tij. Atëherë, Allahu i Lartësuar dërgoi mes njerëzve, gjatë gjithë

kohërave, profetët e Tij, për t'u përcjellë krijesave të vërtetën, të argumentuar dhe të provuar. Ata vinin me argumente të qarta, që nuk u linin krijesave asnjë justifikim para Zotit të tyre, nëse do vazhdonin të ndiqnin rrugën e humbjes.

Disa mendojnë se ajeti tregon se njerëzit ishin të gjithë të bashkuar në rrugën e humbjes. Pra, sipas këtij mendimi tjetër, të gjithë ishin në humbje, të zhytur në kufër, mosbindje ndaj Allahut dhe në shkatërrim total, duke mos pasur as dritë, as iman. Pastaj Allahu i Lartësuar, nga mëshira e Tij, u dërgoi profetë, si përgëzues dhe qortues.

Profetët ishin përgëzues për ata që do t'i bindeshin Allahut. Përgëzimi i tyre ishte se frytet e bindjes ndaj Allahut janë nga më të mirat: furnizim i bollshëm, hallall dhe i ndershëm, forcë në trup, mendje e shpirt dhe një jetë e këndshme. Por, pa dyshim, fryti më i mrekullueshëm që sjell bindja e nënshtrimi ndaj Allahut është arritja e kënaqësisë së Tij dhe e Xhenetit të përhershëm.

Zoti i dërgoi profetët edhe si qortues e paralajmërues. Ata qortonin dhe paralajmëronin njerëzit që nuk bindeshin dhe nuk i nënshtroheshin Allahut, se do të shijonin frytet e hidhura të mosbindjes, të cilat janë: furnizimi i vështirë, dobësia, poshtërimi dhe jeta e trishtuar. Por më i hidhur nga gjithçka është zemërimi i Allahut dhe zjarri i Xhehenemit, ku ata do të qëndrojnë përjetësisht.

- "Ai u zbriti atyre edhe Librin me të vërtetën..." - Allahu i Lartësuar u shpalli profetëve të vërtetën e u dha urdhra të drejtë.

Çdo gjë në librat e Zotit është e drejtë dhe sqaruese e themeleve të besimit, të ligjeve dhe dispozitave për jetën. Vetëm nëpërmjet këtyre librave mund t'u jepet zgjidhje kundërshtimeve mes krijesave, siç thotë Allahu i Lartësuar:

- "...për të gjykuar njerëzit në çështjet që kundërshtoheshin mes tyre." - Kështu, librat e Zotit kanë zbritur pikërisht për t'u sqaruar njerëzve çështjet për të cilat ata nuk pajtohen me njëri-tjetrin. Për këtë arsye, kurdoherë që ka kundërshtime mes njerëzve, është detyrë për ta që ta gjejnë zgjidhjen në udhëzimet e Allahut të Lartësuar, të cilat gjenden në Kur'ân dhe në Sunetin e Profetit (a.s.). Nëse Kur'âni dhe hadithet e Profetit (a.s.) nuk do të mjaftonin për zgjidhjen e konflikteve mes njerëzve, Allahu i Lartësuar nuk do të na udhëzonte që t'i kërkonim zgjidhjet në ato dy burime.

Megjithatë, edhe pse ndjekja e mësimeve të Zotit në librat e shenjtë mundëson bashkimin e njerëzve, ata përsëri u përçanë, sepse i kundërshtuan këto mësime, për shkak të smirës dhe urrejtjes:

- "Pas qartësimit të argumenteve, askush nuk kundërshtoi më, përveç arrogantëve të verbuar nga zilia dhe armiqësia për njëri-tjetrin." – Pra, ata u përçanë, për shkak të smirës dhe urrejtjes që vlonte në zemrat e tyre, edhe pas zbritjes së argumenteve të qarta. Ata kundërshtuan mësimet dhe librat e Zotit, ndërkohë që duhet t'u besonin dhe t'i nënshtroheshin atyre. Me këtë veprim, ata humbën dhe u larguan shumë larg nga rruga e drejtë.

Ndërsa besimtarët e nënshtruar, respektuesit e mësimeve të Zotit, u udhëzuan drejt të vërtetës, me mëshirën e Zotit të tyre:

- "Me mëshirën e Tij, Allahu i udhëzoi besimtarët tek e vërteta e çështjeve, për të cilat kishin kundërshtime." - Allahu i Lartësuar i ka udhëzuar besimtarët e sinqertë të këtij umeti, që të gjejnë të vërtetën në të gjitha çështjet ku janë kundërshtuar popujt e tjerë që kanë patur libër hyjnor dhe që tashmë kanë humbur rrugën dhe kanë devijuar. Ky ummet është udhëzuar prej mëshirës së Allahut të Lartësuar dhe me vullnetin e Tij, prandaj ka

mundur të gjejë rrugën e drejtë për çdo çështje që ka patur kundërshtime.

- "Allahu udhëzon në rrugë të drejtë atë që Ai dëshiron." - Allahu i Lartësuar ia bën të gjitha krijesave ftesën e Tij për të ndjekur rrugën e drejtë, sepse Ai është i Drejti. Kështu, krijesat nuk do të kenë asnjë justifikim Ditën e Gjykimit kur të dalin para Tij, siç thotë Allahu: "Përkujto kur Zoti yt nxori nga shpina e bijve të Ademit pasardhësit e tyre dhe i bëri dëshmues të vetes së tyre *(duke u thënë)*: "A nuk jam Zoti juaj?" Ata thanë: "Po, dëshmojmë!". "Atëherë mos thoni në Ditën e Kijametit: "Ne kemi qenë të pavëmendshëm ndaj kësaj". Ose: "Prindërit tanë ishin idhujtarë, kurse ne ishim pasardhësit të tyre. A do të na shkatërrosh për atë që kanë bërë ata mohues të së vërtetës?!" [Araf 172-174].

Pavarësisht nga kjo, jo të gjithë iu përgjigjën ftesës së Tij. Jo të gjithëve iu dha suksesi që t'i nënshtrohen dhe dorëzohen Atij, por vetëm ata të cilët Ai i zgjodhi për t'i mëshiruar dhe për t'u dhënë sukses, vetëm ata e gjetën rrugën e vërtetë. Pra, kush është në rrugën e drejtë, e ka gjetur atë vetëm me mëshirën, butësinë, bujarinë dhe bamirësinë e Zotit të Tij. Ndërsa ata që mohojnë, nuk i përgjigjen ftesës, sepse kështu ka vendosur drejtësia dhe urtësia e Allahut të Lartësuar.

Ajeti 214

214. A mendoni se do të hyni në Xhenet pa u provuar edhe ju si ata që ishin para jush, të cilët kur goditeshin nga skamja, sëmundjet e tronditjet e mëdha, i Dërguari, e bashkë me të edhe besimtarët, thoshte: "Kur do të vijë ndihma e Allahut?!" Ja, ndihma e Allahut është afër!"

Shpjegimi i ajetit

- "A mendoni se do të hyni në Xhenet pa u provuar edhe ju si ata që ishin para jush..." - Në këtë ajet, Allahu i Lartësuar na tregon një rregull të pakthyeshëm, të vendosur për krijesat e Tij, duke thënë se Ai do t'i sprovojë ato, pa diskutim, me të mira e me të këqija, ashtu sikurse veproi me popujt e tjerë më të hershëm. Ky është ligji i Tij i pandryshueshëm.

Çdokush që përqafon fenë e Zotit dhe kërkon të zbatojë dispozitat e Tij, patjetër që do të sprovohet. Ata që bëjnë durim në këto sprova, për t'iu nënshtruar vullnetit të Zotit, ata që përqendrohen në fenë e Zotit dhe nuk zbrapsen nga asnjë lloj vështirësie që hasin rrugës, pikërisht ata janë të sinqertët, të cilët meritojnë gradat më të larta dhe lumturinë më të madhe. Ata zotërojnë, gjithashtu, mjetin e domosdoshëm për t'u bërë prijës të njerëzve, domethënë durimin.

Ndërsa ata që i konsiderojnë si ndëshkim prej Zotit vështirësitë për shkak të fesë, ata që thyhen në rrugën e Zotit nga çdo lloj sprove, ata që janë të paqëndrueshëm në synimet e larta, pikërisht këta janë mashtrues, që vetëm pretendojnë se e besojnë Zotin e tyre. Imani nuk është thjesht me të pretenduar dhe me të ëndërruar, ai nuk është thjesht me fjalë të thëna me gojë, por sinqeriteti i imanit duhet të vërtetohet me vepra.

Edhe bashkësitë para nesh janë sprovuar, madje shumë rëndë. Thotë i Lartësuari:

- "...të cilët kur goditeshin nga skamja, sëmundjet e tronditjet e mëdha..." - Ata janë sprovuar me varfëri, sëmundje e me çdo gjë që të trondit, si për shembull, kërcënimet për vrasje, për internim, për marrje të pasurisë, për zhdukjen e të dashurve të zemrës e të tjera si këto. Aq e fortë dhe e frikshme ishte tronditja e tyre gjatë këtyre sprovave, saqë ndihma e Allahut u dukej shumë larg, edhe pse ishin të sigurt se ajo do t'u vinte. Aq e fortë ishte tronditja e tyre, saqë:

- "...i Dërguari, e bashkë me të edhe besimtarët, thoshte: "Kur do të vijë ndihma e Allahut?!" - Por i Madhëruari na ka mësuar se lehtësimi vjen menjëherë pas

vështirësisë, se kur çështja ngushtohet, patjetër do të vijë çlirimi, siç thotë më pas:

- "Ja, ndihma e Allahut është afër!" - Çdokush që përqafon të vërtetën, do të sprovohet. Nëse njeriu bën durim ndaj sprovave, duke llogaritur shpërblimin e Zotit, atëherë ato do t'i shndërrohen në lumturi e gëzim, në qetësi dhe prehje, ndërsa në fund, do të dalë fitues mbi çdo armik të tijin. Këto sprova, gjithashtu, do t'i shërojnë çdo sëmundje që mund të gjendet në shpirtin dhe zemrën e tij. Ky ajet është i ngjashëm me disa ajete të tjera, si Ali Imran 172-175 dhe Ankebut 1-7.

Ajeti 215

215. Të pyesin ty se çfarë duhet të japin për sevap. Thuaju: "Çfarëdo bamirësi që bëni, bëjeni për prindërit, për të afërmit, për jetimët, për të varfërit dhe për udhëtarët. Për çdo të mirë që bëni, s'ka dyshim se Allahu e di në imtësi.

Shpjegimi i ajetit

- "Të pyesin ty se çfarë duhet të japin për sevap." – Kuptimi: Të pyesin ty rreth shpenzimeve, domethënë, çfarë duhet të shpenzojmë dhe për kë duhet të shpenzojmë. Për të dyja pyetjet, Allahu i Lartësuar kthen përgjigje:

- "Thuaju: "Çfarëdo bamirësi që bëni, bëjeni për prindërit, për të afërmit, për jetimët, për të varfërit dhe për udhëtarët." - Për sa i përket përgjigjes së pyetjes se çfarë duhet shpenzuar e dhënë, Allahu i Lartësuar ka përdorur një fjalë, që i përfshin të gjitha llojeve të mirësive, shumë apo pak qofshin ato.

Pastaj i Madhëruari na tregon kategoritë më të rëndësishme të njerëzve që duhet të përfitojnë nga shpenzimet e tua:

1. Të parët që meritojnë bamirësinë tënde janë prindërit e tu. Bamirësia ndaj tyre është detyrim dhe padrejtësia ndaj tyre është gjynah i madh. Një nga bamirësitë më të mëdha ndaj tyre është shpenzimi i pasurisë për t'i kënaqur ata, ashtu sikurse edhe një nga padrejtësitë më të mëdha që mund të bësh ndaj tyre është mosshpenzimi i pasurisë për kënaqësinë e tyre. Shpenzimi dhe mbulimi i nevojave të tyre financiare është detyrim për çdo fëmijë që e ka mundësinë ta bëjë këtë.

2. Pas prindërve, njerëzit që meritojnë më shumë shpenzimet dhe përkujdesjen tënde janë të afërmit, sipas shkallës së tyre të afërsisë, duke filluar me më të afërmit, pastaj më të largëtit, dhe duke marrë në konsideratë nevojat e tyre. Bamirësia ndaj të afërmve ka dy lloje shpërblimesh: Shpërblimin për sadakanë dhe shpërblimin për ruajtjen e lidhjeve farefisnore.

3. Jetimët, në kategorinë e të cilëve hyjnë minorenët që nuk kanë njeri të përkujdeset për ta, ndërkohë që as vetë nuk mund ta sigurojnë jetën e tyre. Kështu, ata janë në nevojë dhe shpenzimi për ta është i domosdoshëm. Për këtë arsye, Allahu i Lartësuar i ka porositur adhuruesit e Tij që të tregojnë kujdes e mëshirë ndaj tyre. Kjo është butësia dhe mëshira e Allahut me krijesat e Tij.

4. Të varfërit. Këtu hyjnë njerëzit të cilët, nga varfëria e madhe, nuk kanë as gjërat më të domosdoshme për jetën e tyre. Edhe këtyre duhet t'u krijohet mundësia për të jetuar, duke u plotësuar nevojat e tyre të domosdoshme, në mënyrë që ata mos detyrohen të lypin e të përçmohen.

5. Udhëtarët. Flitet për ata udhëtarë që, për ndonjë arsye të caktuar, kanë mbetur në mes të rrugës dhe nuk kanë mundësi që të kthehen në vendin e tyre apo atje për ku janë nisur. Edhe këta duhen ndihmuar që të arrijnë në destinacionin e tyre.

Allahu i Lartësuar i ka veçuar këto kategori, për shkak të nevojës së tyre të madhe për ndihmë.

Më pas, Allahu i Lartësuar jep një gjykim më gjithëpërfshirës për bamirësinë:

- "Për çdo të mirë që bëni, s'ka dyshim se Allahu e di në imtësi." - Çdo lloj sevapi që bëni ndaj këtyre kategorive, edhe të tjerëve veç tyre, Allahu i Lartësuar e di shumë mirë. Madje, jo vetëm shpenzimet tuaja, por edhe çdo vepër të mirë që kryeni për t'u afruar tek Allahu dhe për të fituar kënaqësinë e Tij, Ai e di shumë mirë, sepse kështu kuptohet nga fjalët e përdorura në ajet.

Deklarimi se Allahu di gjithçka që ata bëjnë do të thotë për besimtarët se Ai do të shpërblejë gjithçka të mirë që ata kanë bërë ose që kanë patur për qëllim të bëjnë. Ai do t'i shpërblejë ata në varësi të qëllimit dhe të sinqeritetit të tyre. Allahu i Lartësuar e di shumë mirë se kush shpenzon më shumë e kush më pak, kush shpenzon për çështjet më të domosdoshme e kush jo.

Ajeti 216


216. Juve ju është bërë detyrim lufta, ndonëse e urreni atë. Por ndodh që ju ta urreni diçka, por ajo të jetë më e mirë për ju, siç ndodh që ju ta doni diçka, por ajo të jetë e keqe për ju. Allahu di e ju nuk dini.

Shpjegimi i ajetit

- "Juve ju është bërë detyrim lufta, ndonëse e urreni atë." - Ky ajet është faktues se lufta në rrugën e Zotit është detyrë.

Në fillimet e Islamit, për shkak të dobësisë së tyre, muslimanët e kishin të ndaluar që të hapnin luftë. Por pas emigrimit të Profetit në Medinë, muslimanët u shtuan dhe u fuqizuan, prandaj Allahu i Lartësuar i urdhëroi ata për luftë në rrugën e Tij.

Allahu i Lartësuar na tregon se xhihadi është i vështirë për njeriun, sepse ka shumë mundime dhe lodhje, madje mund të përballesh edhe me vdekjen. E, megjithatë, xhihadi konsiderohet prej atyre mirësive të cilat nuk kanë asnjë të keqe brenda tyre. Shpërblimi i tij është jashtëzakonisht i madh, ndërkohë që të shpëton përfundimisht prej ndëshkimit të dhimbshëm. Luftëtarëve në


الجزء الثاني سورة البقرة
كُتِبَ عَلَيْكُمُ ٱلْقِتَالُ وَهُوَ كُرْهٌ لَّكُمْ ۖ وَعَسَىٰٓ أَن تَكْرَهُوا۟
شَيْـًٔا وَهُوَ خَيْرٌ لَّكُمْ ۖ وَعَسَىٰٓ أَن تُحِبُّوا۟ شَيْـًٔا وَهُوَ شَرٌّ
لَّكُمْ ۗ وَٱللَّهُ يَعْلَمُ وَأَنتُمْ لَا تَعْلَمُونَ ﴿٢١٦﴾ يَسْـَٔلُونَكَ عَنِ ٱلشَّهْرِ
ٱلْحَرَامِ قِتَالٍ فِيهِ ۖ قُلْ قِتَالٌ فِيهِ كَبِيرٌ ۖ وَصَدٌّ عَن سَبِيلِ
ٱللَّهِ وَكُفْرٌۢ بِهِۦ وَٱلْمَسْجِدِ ٱلْحَرَامِ وَإِخْرَاجُ أَهْلِهِۦ مِنْهُ
أَكْبَرُ عِندَ ٱللَّهِ ۚ وَٱلْفِتْنَةُ أَكْبَرُ مِنَ ٱلْقَتْلِ ۗ وَلَا يَزَالُونَ
يُقَٰتِلُونَكُمْ حَتَّىٰ يَرُدُّوكُمْ عَن دِينِكُمْ إِنِ ٱسْتَطَٰعُوا۟ ۚ وَمَن
يَرْتَدِدْ مِنكُمْ عَن دِينِهِۦ فَيَمُتْ وَهُوَ كَافِرٌ فَأُو۟لَٰٓئِكَ
حَبِطَتْ أَعْمَٰلُهُمْ فِى ٱلدُّنْيَا وَٱلْـَٔاخِرَةِ ۖ وَأُو۟لَٰٓئِكَ أَصْحَٰبُ
ٱلنَّارِ ۖ هُمْ فِيهَا خَٰلِدُونَ ﴿٢١٧﴾ إِنَّ ٱلَّذِينَ ءَامَنُوا۟ وَٱلَّذِينَ
هَاجَرُوا۟ وَجَٰهَدُوا۟ فِى سَبِيلِ ٱللَّهِ أُو۟لَٰٓئِكَ يَرْجُونَ رَحْمَتَ
ٱللَّهِ ۚ وَٱللَّهُ غَفُورٌ رَّحِيمٌ ﴿٢١٨﴾ ۞ يَسْـَٔلُونَكَ عَنِ ٱلْخَمْرِ وَٱلْمَيْسِرِ ۖ
قُلْ فِيهِمَآ إِثْمٌ كَبِيرٌ وَمَنَٰفِعُ لِلنَّاسِ وَإِثْمُهُمَآ أَكْبَرُ
مِن نَّفْعِهِمَا ۗ وَيَسْـَٔلُونَكَ مَاذَا يُنفِقُونَ ۖ قُلِ ٱلْعَفْوَ ۗ كَذَٰلِكَ
يُبَيِّنُ ٱللَّهُ لَكُمُ ٱلْـَٔايَٰتِ لَعَلَّكُمْ تَتَفَكَّرُونَ ﴿٢١٩﴾
٣٤

rrugën e Allahut u është premtuar se do të dalin fitimtarë mbi armiqtë e tyre. Ata meritojnë të shijojnë plaçkën e luftës, por edhe shumë mirësi të tjera të kësaj bote dhe të tjetrës.

- "Por ndodh që ju ta urreni diçka, por ajo të jetë më e mirë për ju..." – Pra, edhe pse lufta është e urryer për shpirtin, ajo është e mirë në çdo aspekt që ta shohësh.

- "...siç ndodh që ju ta doni diçka, por ajo të jetë e keqe për ju." – Për shembull, kur dikush i bën bisht xhihadit në rrugën e Allahut, për të ruajtur rehatinë e jetës, në fakt, ky veprim i tij do t'i sjellë vetëm të këqija, duke filluar nga poshtërimi prej armiqve të Islamit e të tjera më pas. Shpërfillja e xhihadit sjell dobësimin dhe nënshtrimin e plotë të muslimanëve, largon shpërblimet e mëdha dhe afron ndëshkimin e dhembshëm të Allahut të Lartësuar.

Ky ajet na tregon një rregull të përgjithshëm, që thotë: Të gjitha veprat e

mira, edhe pse ndonjëherë janë të vështira të kryhen dhe të urryera nga shpirti i njeriut, ato sjellin mirësi të shumta për të. Ndërsa të gjitha veprat e këqija, edhe pse janë të dëshirueshme për njeriun që t'i kryejë, për shkak të kënaqësive që ai mendon se arrin nëpërmjet tyre, ato mbeten të këqija dhe sjellin shumë të këqija të tjera.

Në çështjet e dynjasë, për sa i përket besimtarit, nëse ai e do diçka dhe Allahu i Lartësuar përcakton që ajo të mos i jepet, ai gjithsesi është në mirësi. Pra, edhe nëse i shpëton nga duart diçka që është e mirë në vështrimin e tij, ai është i kënaqur dhe duhet të jetë i tillë, sepse besimtari është i bindur për një fakt: Allahu i Lartësuar është më i mëshirshëm për robin, sesa vetë robi për vetveten. Gjithashtu, Allahu i Lartësuar është më i pushtetshëm për të sjellë mirësi për robin e Tij, sesa robi për vetveten. Kjo e bën adhuruesin që të jetë shumë mirënjohës ndaj Allahut të Madhëruar.

Thotë i Lartësuari:

- "Allahu di e ju nuk dini." - Duke qenë se çështja qëndron kështu, atëherë është e kështillueshme që ju të kënaqeni gjithmonë me caktimet e Zotit tuaj, pavarësisht në ju kënaqin ato apo jo.

Ajeti 217

217. Të pyesin për luftën në muajin e shenjtë. Thuaju: "Lufta gjatë tij është e rëndë, por pengimi nga rruga e Allahut, mosbesimi ndaj Tij, pengimi nga Xhamia e Shenjtë *(Qabja)* dhe dëbimi i banorëve të saj nga ajo, janë gjynahe edhe më të mëdha tek Allahu. Sprovimi është edhe më i rëndë se vrasja. Ata do t'ju luftojnë vazhdimisht për t'ju zbrapsur nga feja juaj, nëse munden. E kush zbrapset nga feja e tij dhe vdes si jobesimtar, atij i zhduken veprat në këtë jetë dhe në jetën tjetër. Të tillët janë banorë të Zjarrit dhe në të do të jenë përjetësisht.

Shpjegimi i ajetit

Urdhri i Allahut të Lartësuar për të zhvilluar luftë kundër qafirëve është i vlefshëm, në përgjithësi, që të zbatohet në çdo kohë dhe në çdo vend, me përjashtim të disa kohëve dhe vendeve. I Lartësuari thotë:

- "Të pyesin për luftën në muajin e shenjtë." - Shumica e dijetarëve janë të mendimit se dispozita e ndalesës së luftës gjatë muajve të shenjtë është anuluar me dispozitën tjetër, e cila i urdhëron besimtarët që t'i luftojnë idhujtarët kudo që t'i gjejnë.

Ndërsa disa komentues të Kur'ânit janë të mendimit se këtu nuk kemi të bëjmë me anulim dispozitash, por me një kufizim të dispozitave gjithëpërfshirëse. Për shembull, Allahu i Lartësuar thotë: "Juve ju është bërë detyrim lufta", ose në ajetin tjetër të sures Teube, ku thotë: "...Luftojini idhujtarët totalisht", ose në ajetin e përmendur më parë: "Luftojini ata kudo që t'i gjeni". Këto ajete janë gjithëpërfshirëse dhe na japin të kuptojmë se idhujtarët duhen vrarë të gjithë, kudo dhe kurdoherë që të kapen, pa përjashtim. Por ka ajete të tjera në Kur'ân, që e kufizojnë gjithëpërfshirjen e tyre, siç është ajeti vijues:

- "Thuaju: "Lufta gjatë tij është e rëndë..." - Ky ajet i përjashton muajt e shenjtë nga fusha gjithëpërfshirëse e ajeteve të mësipërme. Kështu, ajetet që na urdhërojnë për të zhvilluar luftë kundër idhujtarëve, pa treguar kufizim kohe e vendi, duhen vështruar në kontekst me ajetet përjashtuese të disa kohëve dhe vendeve të shenjta.

Në këtë vështrim, zhvilimi i luftës në muajt e shenjtë vazhdon të jetë i ndaluar. Këtë mendim e përforcon edhe fakti që, një nga shkaqet më të rëndësishme që këta muaj quhen të shenjtë është se nuk lejohet të bësh luftë gjatë tyre.

Megjithatë, duhet të jetë e qartë se, gjatë muajve të shenjtë, është e ndaluar lufta mësymëse apo kur muslimanët kërkojnë të çlirojnë vende të tjera. Ndërsa kur bëhet fjalë për luftë mbrojtëse, ajo nuk është e ndaluar

gjatë muajve të shenjtë, madje edhe në vendet e shenjta.

Shkak për zbritjen e këtij ajeti është ngjarja që ndodhi gjatë ekspeditës ushtarake të dërguar nga Profeti (a.s.), nën udhëheqjen e Abdullah Ibn Xhahshit. Gjatë ekspeditës, kur muslimanët arritën të merrnin edhe shumë pasuri nga një karvan i kurejshëve, ata kapën rob një idhujtar, të quajtur Amër Ibn Hadramij. Më pas, muslimanët e vranë idhujtarin, edhe pse ishin në muajin e shenjtë Rexheb, sikurse vijnë rrëfimet rreth kësaj ngjarjeje. Pikërisht për shkak të vrasjes së këtij idhujtari nga muslimanët gjatë muajit të shenjtë Rexheb, idhujtarët filluan të flisnin dhe të shanin muslimanët, sepse kishin shkelur ligjin e muajve të shenjtë.

Por edhe në këtë rast, idhujtarët nuk kishin të drejtë me fyerjet e tyre, sepse ata kryenin vepra shumë më të shëmtuara dhe shumë më të këqija se lufta që zhvilluan muslimanët në muajt e shenjtë. Allahu i Lartësuar thotë:

- "...por pengimi nga rruga e Allahut, mosbesimi ndaj Tij, pengimi nga Xhamia e Shenjtë *(Qabja)*..." - Veprat e idhujtarëve, të cilët pengonin njerëzit që besonin Zotin dhe Profetin e Tij, përpjekjet e tyre të shumta për të sprovuar besimtarët në fenë e tyre dhe për t'i kthyer nga rruga e drejtë, të gjitha këto ishin shumë herë më të këqija dhe më të shëmtuara. Ata ndalonin luftën në muajt e shenjtë, por harronin se ata vetë bënin diçka më të shëmtuar se lufta. Për shembull, ata mohonin Zotin e botëve. Vetëm kaq do të mjaftonte për të kuptuar të keqen e tyre. Mohimi i Zotit është e keqja më e madhe që mund të bëjë dikush. Por, sa e shëmtuar bëhet kjo e keqe kur kryhet në muajt e shenjtë dhe në vendin e shenjtë, në Qabe?! Jo vetëm kaq, por ata dëbuan nga Xhamia e Shenjtë banorët e merituar të saj: Profetin (a.s.) dhe sahabët e tij.

Allahu i Lartësuar i ka quajtur Profetin (a.s.) dhe sahabët "banorët e Xhamisë së Shenjtë". Dhe në fakt, banorë të vërtetë të Xhamisë së Shenjtë janë vetëm besimtarët e sinqertë, që e mbushin atë xhami me adhurimin e Allahut të Lartësuar.

Pra, një tjetër krim i idhujtarëve, që është më i keq se lufta gjatë muajve të shenjtë, ishte edhe nxjerrja e adhuruesve të Allahut nga Xhamia e Shenjtë, siç thotë i Lartësuari:

- "...dhe dëbimi i banorëve të saj nga ajo, janë gjynahe edhe më të mëdha tek Allahu." – Idhujtarët, jo vetëm që i dëbuan besimtarët prej Vendit të Shenjtë, por edhe i pengonin vazhdimisht ata që të shkonin e të adhuronin Allahun atje, ndonëse e dinin shumë mirë se ai vend ishte për të gjithë njëlloj, sepse të gjithë e kishin të drejtën që ta adhuronin Allahun në të.

Tërë këto vepra ishin më të mëdha si gjynahe tek Allahu i Lartësuar, dhe të gjitha ato i përmbledh fjala "*fitne*" - sprovim, siç thuhet më tej:

- "Sprovimi është edhe më i rëndë se vrasja." - Pra, *fitne*-ja është gjynah më i madh sesa vetë lufta dhe vrasja gjatë muajve të shenjtë. Nga kjo kuptohet se idhujtarët ishin të padrejtë kur kritikonin muslimanët për luftën në muajt e shenjtë.

Allahu i Lartësuar na tregon se ata do të përpiqen vazhdimisht, me të gjitha mënyrat, madje edhe me luftë, që t'i kthejnë besimtarët nga rruga e drejtë.

- "Ata do t'ju luftojnë vazhdimisht për t'ju zbrapsur nga feja juaj, nëse munden." - Allahu i Lartësuar na tregon se qafirët gjithmonë kanë për t'i luftuar muslimanët. Po ashtu, qëllimi i tyre kryesor nuk është grabitja e pasurisë dhe as vrasja e muslimanëve, por është kthimi i tyre nga besimtarë në jobesimtarë. Ata dëshirojnë që edhe muslimanët të kthehen në qafirë, dhe kështu të bëhen prej banorëve të Zjarrit. Për hir të këtij qëllimi, ata i shpenzojnë të gjitha energjitë e tyre. Por Allahu i Lartësuar thotë në suren Teube, ajetet 32-33: "Ata duan ta shuajnë dritën e Allahut me gojën e tyre. Por

Allahu dëshiron ta përsosë dritën e Tij, ndonëse jobesimtarët e urrejnë këtë gjë. Është Ai që e dërgoi të Profetin e Tij me udhëzim të drejtë e fe të vërtetë, për ta bërë që të dominojë mbi të gjitha fetë, edhe pse e urrejnë idhujtarët." Ose në një ajet tjetër: "Ata që nuk besojnë e shpenzojnë pasurinë e tyre për të penguar nga rruga e Allahut. Ata do të shpenzojnë, por ajo pasuri do të bëhet dëshpërimi i tyre, sepse ata do të mposhten. Ata që mohojnë do të mblidhen të gjithë në Xhehenem." [Enfal, 36].

Këto ajete flasin për të gjithë qafirët, e në mënyrë të veçantë për çifutët dhe të krishterët. Ata përdorin çdo mënyrë për t'i joshur njerëzit që të pasojnë fenë e tyre. Ata përpiqen nëpërmjet misionarëve, mjekëve, shkollave e shumë shërbimeve të tjera që u ofrojnë njerëzve në nevojë, duke u kërkuar atyre që të braktisin Islamin dhe besimin e drejtë në një Zot. Ata përpiqen që të fusin në zemrën dhe mendjen e muslimanëve lloj-lloj dyshimesh, që t'i lëkundin nga feja e tyre e drejtë. Por ata harrojnë diçka: Ai që ua hapi sytë muslimanëve, që të besojnë fenë e vërtetë, Islamin, Ai që e plotësoi mirësinë e Tij ndaj tyre, duke e bërë të pandryshueshme fenë e tyre, është vetë Allahu, Krijuesi i gjithësisë. E pra, Ai që i mëshiroi dhe i përzgjodhi ata për t'i udhëzuar në Islam, është po Ai që shpresohet t'ua plotësojë dhe përsosë dritën e tyre, deri në destinacionin e tyre. Ai përkujdeset për ta, duke i ruajtur dhe duke i mëshiruar. Askush nuk mund ta shuajë dritën që Allahu e ka dhuruar. Kurthet e tyre do t'u kthehen mbrapsht dhe të dëmtuarit do të jenë vetëm ata, ndërsa feja dhe fjala e Allahut do të lartësohet dhe do të fitojë.

Ajeti i mësipërm e përshkruan me saktësi veprimtarinë e qafirëve të sotëm, ashtu si edhe të qafirëve të dikurshëm.

- "E kush zbrapset nga feja e tij dhe vdes si jobesimtar, atij i zhduken veprat në këtë jetë dhe në jetën tjetër. Të tillët janë banorë të Zjarrit dhe në të do të jenë përjetësisht." - Allahu i Lartësuar na tregon se ata që mposhten para këtyre sprovave dhe e braktisin Islamin, pastaj vazhdojnë të jetojnë si mohues derisa vdesin, ata do të kenë ndëshkim shumë të ashpër.

Ata që braktisin Islamin dhe vdesin si qafirë kanë shumë dënime. Së pari, atyre u asgjësohen veprat e tyre në dynja dhe në ahiret, sepse kur njeriu nuk është musliman, atëherë veprat e tij janë të pavlefshme, të papranueshme dhe të pashpërblyeshme nga Allahu i Lartësuar. Më pas, ata do të jenë banorë të Xhehenemit, ku do të jenë përjetësisht.

Megjithatë, nëse njeriu braktis Islamin, pastaj kthehet përsëri në Islam, atëherë atij i llogariten dhe i shpërblehen edhe veprat e mira që ka kryer gjatë kohës kur ishte fillimisht musliman, sepse ajeti tregon që veprat u asgjësohen vetëm atyre që e braktisin Islamin dhe vdesin si qafirë.

Të njëjtën gjë themi edhe për ata që bëjnë nga ato lloj gjynahesh (përveç kufrit) që fshijnë veprat e mira. Nëse ata pendohen për këto gjynahe, atëherë veprat e mira u kthehen sërish, dhe kështu do të shpërblehen.

Ajeti 218

218. Vërtet, ata që besuan dhe që emigruan e luftuan në rrugë të Allahut, ata kanë shpresa për mëshirën e Tij. Allahu është Falës e Mëshirues.

Shpjegimi i ajetit

- "Vërtet, ata që besuan dhe që emigruan e luftuan në rrugë të Allahut..." - Allahu i Lartësuar bën një premtim të mrekullueshëm për ata që kanë këto cilësi:

1. besojnë sinqerisht;
2. emigrojnë për hir të Zotit;
3. luftojnë në rrugën e Zotit .

Këto cilësi janë kushtet e lumturisë. Mbi to ndërtohet adhurimi. Ato përcaktojnë suksesin ose humbjen e njeriut.

Kështu, i pari është besimi. Mos pyet për vlerën e tij! E si mund të pyesësh për vlerën e tij, kur ai është kriteri dallues mes të lumturve dhe të dështpëruarve, mes banorëve të Xhenetit dhe banorëve të Xhehenemit. Nëse zemra e robit ka iman, atëherë veprat dhe adhurimet e tij do të pranohen dhe shpërblehen nga Allahu i Madhëruar. E nëse zemra e robit është bosh, pa iman, prej këtij njeriu nuk pranohet as kompensim dhe as rryshfet. Prej tij nuk pranohet asnjë lloj vepre, qoftë ajo e detyrueshme apo vullnetare.

I dyti është emigrimi për hir të Allahut, i cili e ndan njeriun nga gjërat më të dashura të dynjasë: nga atdheu, pasuria dhe farefisi i tij. Ai i lë të dashurit e tij dhe largohet prej tyre vetëm për hir të Allahut dhe për të ndihmuar fenë e Zotit.

Më pas vjen lufta ose xhihadi në rrugë të Allahut. Xhihadi nënkupton shpenzimin e të gjitha forcave dhe mundësive të njeriut, për të luftuar kundër armiqve të Islamit. Xhihad do të thotë, gjithashtu, përpjekje maksimale për të ndihmuar fenë e Allahut dhe për të shkatërruar fenë e shejtanit.

Xhihadi është kulmi i veprave të mira dhe për të është caktuar shpërblimi më i lartë. Ai është faktori më i rëndësishëm që ndihmon në përhapjen e Islamit dhe pakësimin e idhujtarisë. Nëpërmjet xhihadit ruhet më së tepërmi paprekshmëria e muslimanëve, ruhet siguria e jetës, e pasurisë dhe e familjes së tyre.

Kështu, njerëzit që i kanë të tilla cilësi e meritojnë të shpresojnë mëshirën e Allahut të Lartësuar:

- "...ata kanë shpresa për mëshirën e Tij." - Këta e meritojnë të shpresojnë për mëshirën e Allahut të Lartësuar, sepse janë përpjekur me të gjitha forcat e mënyrat për ta arritur atë.

Ky ajet fakton se shpresa për shpëtim konsiderohet e drejtë nëse njeriu bën maksimumin për ta arritur atë. Ndërsa shpresat që shoqërohen me dembelizëm në kryerjen e sebepeve që sjellin lumturinë, quhet pazotësi, dështim ose ëndrra me sy hapur. Ato tregojnë dobësi, mungesë vullneti dhe mangësi në logjikë. Njerëz të tillë i përngjajnë atij që shpreson të bëhet me fëmijë, por pa kryer marrëdhënie me gruan e tij, ose atij që shpreson të korrë shumë, kur ende nuk ka mbjellë.

Ky ajet tregon edhe diçka tjetër shumë të rëndësishme. Njeriu, sado vepra të mira të ketë kryer, nuk duhet ta mbështesë shpëtimin e tij tek këto vepra, por duhet që gjithmonë të shpresojë mëshirën e Zotit të tij. Shpëtimi i tij është vetëm te mëshira e Zotit. Ai duhet të shpresojë që Zoti t'ia pranojë veprat, t'ia mbulojë mangësitë dhe t'ia falë gjynahet. Vetëm me mëshirën dhe faljen e Zotit mund të shpresohet shpëtimi. Prandaj i Madhëruari thotë në vijim:

- "Allahu është Falës e Mëshirues." – Pra, Ai është Falës i robit që pendohet sinqerisht dhe plotësisht. Ai është Mëshiruesi, mëshira e të Cilit ka përfshirë gjithçka.

Ky ajet shërben si përgëzim për njerëzit që kryejnë vepra të mira, se Allahu i Lartësuar do t'i falë ata. Veprat e mira i fshijnë të këqijat dhe janë shkak që Allahu t'i mëshirojë robërit e Tij.

Nëse njeriu falet nga Mëshiruesi, kjo do të thotë se ai ka marrë siguri të plotë që nuk do të ndëshkohet në dynja dhe në ahiret, sepse ndëshkimet vijnë për shkak të gjynaheve të robit. Nëse gjynahet fshihen, atëherë robi shpëton dhe është i ruajtur prej ndëshkimit. E kur njeriu përfshihet nga mëshira e Mëshiruesit, kjo do të thotë se ai do të përfitojë çdo mirësi të dynjasë dhe të ahiretit. Madje, vetë veprat e tij të mira, si: të besuarit tek Allahu, emigrimi për hir të Allahut dhe xhihadi janë shenja të mëshirës së madhe të Mëshiruesit ndaj atij.

Nëse Allahu nuk do t'u jepte sukses, robërit e Tij as nuk do t'i kishin dëshiruar këto vepra, e aq më pak t'i kryenin ato. Nëse Allahu nuk do t'i ndihmonte, ata nuk do të arrinin kurrë që t'i bënin ato vepra. Nëse

nuk do të ishte mirësia e Allahut, ata nuk do t'i përsosnin veprat e tyre dhe Ai kurrë nuk do t'ua pranonte veprat e mangëta.

Allahut i takon mirësia, në fillim dhe në fund. Ai jep sukses dhe Ai mundëson shkaqet e pasojat.

Ajeti 219

219. Të pyesin ty për verën dhe bixhozin. Thuaju: "Ato sjellin të këqija të mëdha, por edhe dobi për njerëzit. Megjithatë, e keqja e tyre është më e madhe sesa dobia." Të pyesin se çfarë të shpenzojnë. Thuaju: "Tepricën". Kështu jua sqaron Allahu argumentet, që ju të mendoni..

Shpjegimi i ajetit

- "Të pyesin ty për verën dhe bixhozin." – Kuptimi: Të pyesin ty, o Profet i Zotit, për ligjin mbi pijet dehëse dhe kumarin.

Pijet dehëse dhe bixhozi kanë qenë shumë të përhapura në kohën para Islamit, si dhe në fillim të epokës islamike. Me sa duket, njerëzit ndienin diçka dhe donin të qartësoheshin plotësisht rreth këtyre dy fenomeneve kaq të përhapura. Atëherë, Allahu i Lartësuar e urdhëroi Profetin e Tij që të tregonte se ato kanë edhe dobi, edhe dëme për njeriun. Por dëmi i tyre është më i madh se dobia.

Në këtë mënyrë, Allahu i Lartësuar i udhëzoi njerëzit që, duke përdorur mendjen e tyre, të fillonin e të largoheshin prej atyre gjërave të dëmshme. Kjo qe një formë e përshkallëzuar e caktimit të një ligji, i cili mund të ishte i vështirë që të pranohej menjëherë nga njerëzit. Në këtë mënyrë, Allahu i Lartësuar përgatiti terrenin, që më pas të sillte dispozitën përfundimtare të ndalimit të këtyre dy veprave të lartpërmendura. Më tej, i Lartësuari thotë:

- "Thuaju: "Ato sjellin të këqija të mëdha, por edhe dobi për njerëzit. Megjithatë, e keqja e tyre është më e madhe sesa dobia." – Pra, i Lartësuari na tregon se të këqijat që ato sjellin janë më të mëdha se ndonjë dobi që mund të përfitohet prej tyre.

A ka dëmtim më të rëndë sesa dëmtimi që i shkaktohet të menduarit ose pasurisë? Gjithashtu, ato dy vepra të pengojnë nga përkujtimi i Allahut dhe nga falja e rregullt e namazit. Jo vetëm kaq, por ato nxisin edhe armiqësinë e urrejtjen mes njerëzve. E pra, dëme të tilla nuk mund të krahasohen kurrë me ato pak dobi që mund të fitohet nëpërmjet tyre. Duke tregtuar pije dehëse apo duke luajtur kumar, mund të fitohet pasuri, madje, me përdorimin e tyre, njeriu provon një lloj kënaqësie, por përballë dëmeve që ato shkaktojnë, këto 'dobi' janë të papërfillshme.

Ky ajet vjen si qortim i ashpër për njerëzit, që ata të largohen prej kënaqësive të fituara në këtë mënyrë. Mendja e shëndoshë duhet t'i japë përparësi gjithmonë asaj që është më e dobishme dhe më larg dëmit. Ajo kurrë nuk mund t'i afrohet diçkaje, dëmi i së cilës është më i madh se dobia e saj.

Duke qenë se njerëzit asokohe ishin mësuar dhe ishin lidhur shumë fort me të tilla mënyra argëtimi dhe fitimi, atëherë Allahu i Lartësuar zbriti ajete të tilla nxitëse për të menduar dhe si parapërgatitje për shpirtrat dhe mendjet e besimtarëve, para zbritjes së ajeteve (në suren Maide, 90-92) që i ndalojnë rreptësisht pijet dehëse dhe kumarin. Sigurisht që kjo tregon butësinë, mëshirën dhe urtësinë e Krijuesit për ne.

Fjala "verë" (*el ħamru*) në ajet nënkupton çdo lloj pijeje dehëse, që e mpin dhe e turbullon mendjen. Ndërsa 'bixhoz' (*el mejsir*) quhen të gjitha ato lojëra, si tavlla, shahu etj., ku palët pjesëmarrëse vendosin pasuri, të cilat i merr ai që fiton lojën. Pra, çdo lloj loje që bëhet për të fituar pasuri në këtë mënyrë është e ndaluar, edhe nëse loja në vetvete mund të jetë e lejuar nga Sheriati.

- "Të pyesin ty se çfarë të shpenzojnë." - Kjo është një pyetje për masën e shpenzimit. Sa kërkon Allahu i Lartësuar prej pasurive tona, për të fituar kënaqësinë e Tij?

Allahu i Lartësuar e lehtësoi këtë çështje, duke dhënë përgjigjen vijuese:

- "....Thuaju: "Tepricën"..." - Pra, Allahu i Lartësuar na tregon se prej pasurive tona kërkon atë që (në arabisht) quhet "*el afu*", domethënë ajo pjesë e pasurisë që çdokush e ka të thjeshtë ta japë, sepse është shtesë mbi nevojat e njeriut. Me fjalë të tjera, nëse njeriu ia ka plotësuar vetes dhe familjes së tij kushtet e domosdoshme të jetesës ose gjërat e nevojshme për një jetë normale, atëherë pasuria që tepron pas këtyre quhet "*el afu*". Pikërisht nga kjo pasuri kërkon Allahu i Lartësuar që ne të shpenzojmë për hir të Tij.

Nevojat e njerëzve ndryshojnë në varësi të vendit, kohës, shtresës së tyre etj. Gjithsesi, çdokush është në gjendje të japë prej pasurisë së tepërt të tij, qoftë edhe një gjysmë hurme. Për këtë arsye, Allahu i Lartësuar e urdhëroi Profetin e Tij që ta pranonte ndjesën e njerëzve dhe të merrte prej tyre veçse tepricën e pasurisë. Në këtë mënyrë, Ai urdhëroi që njerëzit të mos ngarkoheshin më shumë sesa mbanin.

Këtu duhet kuptuar një fakt shumë i rëndësishëm. Allahu i Lartësuar, me detyrimet që na ka ngarkuar, nuk kërkon që të plotësojë nevojat apo dëshirat e Tij personale, sepse Ai nuk ka nevojë për asgjë. Por Allahu nuk i ka sjellë dispozitat e Tij as që të na rëndojë ne. Përkundrazi, çdo urdhër i Tij synon që të na lumturojë dhe të na lehtësojë çdo çështje, prandaj Ai meriton lavdërimin dhe mirënjohjen tonë të plotë për gjithçka që ka ligjëruar.

Pasi e sqaroi çështjen e mësipërme, Allahu i Lartësuar thotë:

- "Kështu jua sqaron Allahu argumentet..." - Kuptimi: Allahu i Lartësuar jua sqaron juve çështjet e dobishme. Këto janë argumente që i ndihmojnë njerëzit të dallojnë të vërtetën nga e kota, të saktën nga e gabuara.

- "....që ju të mendoni *(për këtë botë dhe për botën tjetër)* [8]" - Kuptimi: Ky lloj sqarimi bëhet që ju të përdorni mendjet tuaja dhe të meditoni thellë rreth urtësive të Sheriatit. Kështu, ju do të bindeni se urdhrat e Allahut shërbejnë për lumturinë në këtë jetë dhe në jetën tjetër. Ju do ta kuptoni, gjithashtu, se kjo dynja do të mbarojë shpejt dhe do të zhduket, ndërsa ajo që mbetet është jeta e ahiretit dhe çfarë keni përgatitur për të. Në këtë mënyrë, ju do të dini se çfarë duhet të refuzoni e ta nënçmoni dhe çfarë duhet të pranoni dhe ta vlerësoni.

Ajeti 220

220. "....për këtë botë dhe për botën tjetër.[9] Të pyesin ty për jetimët. Thuaju: "Përzgjedhja e më të mirës për ta është bamirësi. E nëse i përzieni me ju, *(dijeni se)* ata janë vëllezërit tuaj." Allahu di ta dallojë prishësin nga rregulluesi. Sikur të dëshironte Allahu, Ai do t'ju rëndonte. Vërtet, Allahu është Krenar e i Urtë.


Shpjegimi i ajetit

- "Të pyesin ty për jetimët." - Kur Allahu i Lartësuar zbriti ajetet e sures Nisa që flasin për jetimët, kjo i rëndoi pak muslimanët. Në njërin prej tyre, i Lartësuari thotë: "Vërtet, ata që e hanë pasurinë e jetimit pa të drejtë, e mbushin barkun e tyre me zjarr dhe do të digjen në Zjarrin flakërues." [Nisa, 10]. Kështu, pas shpalljes së këtyre ajeteve, besimtarët filluan që t'ua veçonin edhe ushqimin jetimëve që kishin nën përgjegjësi, duke u frikësuar se mos hanin prej pasurisë së tyre. Pra, edhe pse sipas zakonit të asaj kohe, ishte normale që të shoqëroje jetimët në ushqimin e tyre, muslimanët hoqën dorë

---

[8] Fragmenti që ndodhet në kllapa është pjesë e ajetit vijues. Pra, ajeti pasardhës, me nr. 220, fillon kështu: "…për këtë botë dhe për botën tjetër", por për qëllim komentimi dhe për të plotësuar kontekstin, ne po e vendosim këtu.

[9] Ky fragment hyrës i këtij ajeti duhet parë si vazhdim i ajetit paraardhës, ku edhe është shpjeguar. Shih më lart.



nga ky veprim, nga frika se mos quhej ngrënie e padrejtë e pasurisë së jetimit, për të cilën Allahu i Lartësuar kërcënon aq ashpër në ajetin e sipërcituar. Ky qe shkaku pse ata e pyetën Profetin (a.s.) rreth kësaj çështjeje, domethënë, deri ku është kufiri i të vepruarit me pasurinë e jetimëve? Dhe Allahu i Lartësuar u ktheu përgjigje:

- "Thuaju: "Përzgjedhja e më të mirës për ta është bamirësi." – Kuptimi: Qëllimi juaj duhet të jetë gjithmonë që ta ruani dhe ta shtoni pasurinë e jetimit me mënyrat e lejueshme.

- "E nëse i përzieni me ju, *(dijeni se)* ata janë vëllezërit tuaj. Allahu di ta dallojë prishësin nga rregulluesi." - Kuptimi: Lejohet që të përzihen pasuritë tuaja me të tyret, nëse qëllimi është bamirësia ndaj tyre dhe kujdesi për të mos i dëmtuar. Ata duhet t'i konsideroni si vëllezërit tuaj, dhe dihet që vëllezërit përziejnë me njëri-tjetrin shumë gjëra, qoftë edhe ushqimin.

Siç kuptohet, në të tilla raste, përcaktimin e bën qëllimi i mirë dhe puna e pastër. Nëse Allahu i Lartësuar sheh që dikush kërkon ta ndihmojë jetimin, pa patur asnjë qëllim që të abuzojë me pasurinë e tij (jetimit), atëherë Ai është Falës e Mëshirues. Edhe nëse dikush përfiton diçka prej pasurisë së jetimit, pa qëllim të keq dhe pa abuzuar, për atë nuk është gjynah. Allahu i Lartësuar e ka bërë atë kërcënim pikërisht për ata që synojnë të përfitojnë prej pasurisë së jetimit dhe të abuzojnë me të. Një normë islame thotë: "Mjetet gjykohen njëlloj si qëllimet e tyre."

Ky ajet tregon se lejohet bashkëveprimi dhe përzierja në çështjen e ushqimit dhe në çdo fushë tjetër të marrëdhënieve ndërnjerëzore. Ky lehtësim është tregues i mëshirës dhe mirësisë të Zotit ndaj nesh.
Më tej, Allahu i Lartësuar thotë:

- "Sikur të dëshironte Allahu, Ai do t'ju rëndonte. Vërtet, Allahu është i Plotfuqishëm e i Urtë." - Allahu i Lartësuar thotë se, po do të dëshironte Ai, edhe mund të na e vështirësonte çështjen dhe ne të binim në gjynah, sepse Allahu është i Plotfuqishëm dhe ka fuqi që të nënshtrojë gjithçka. Ai është, gjithashtu, i Urtë, dhe çdo vepër e Tij është në bazë të urtësisë dhe përkujdesit të Tij për krijesat.

Duhet ditur se plotfuqishmëria e Allahut nuk bie ndesh me urtësinë e Tij. Disa njerëz thonë se Allahu i Lartësuar bën çfarë të dojë, qoftë ajo në përputhje me urtësinë e Tij ose në kundërshtim me të. Por kjo shprehje është shumë e gabuar. Ajo nuk duhet thënë e as menduar. Ne duhet të themi, duke qenë të bindur, se veprat dhe ligjet e Allahut burojnë gjithmonë nga Urtësia e Tij. Ai nuk ka krijuar asgjë kot, pa qëllim apo pa kuptim. Në çdo vepër të krijuar prej Tij ka një urtësi, pavarësisht në e kuptojmë ne apo jo. Po kështu, edhe ligjet që Allahu i ka bërë për njerëzit burojnë nga urtësia e Tij dhe janë plot urtësi. Kurrë nuk mund të mendohet se ndonjë ligj i Tij është pa ndonjë urtësi të caktuar. Për çdo gjë që ka

urdhëruar, Allahu i Lartësuar e ka bërë veçse për shkak të mirësisë e dobisë që gjendet në të. Ajo mirësi mund të jetë ose pa asnjë të keqe në vete, ose dobia e saj mund të jetë më e madhe se ndonjë e keqe që përmban. Në të njëjtën mënyrë, Allahu na ndalon nga ndonjë gjë veçse për shkak të së keqes që gjendet në të, qoftë ajo e keqe e pastër, pa asnjë të mirë në të, qoftë e keqe me ndonjë dobi të vogël në të. Të gjitha këto tregojnë për urtësinë dhe mëshirën e Allahut të Madhëruar.

Ajeti 221

221. Mos u martoni me idhujtare, derisa ato të besojnë. Një skllave besimtare është më e vlefshme se një idhujtare, edhe nëse kjo e fundit mund t'ju mahnisë. Mos jepni *(gra)* tek idhujtarët, derisa ata të besojnë. Një skllav besimtar është më i vlefshëm se një idhujtar, edhe nëse ky i fundit mund t'ju mahnisë. Ata ju ftojnë për në Zjarr, ndërsa Allahu, me mëshirën e Vet, ju fton në Xhenet dhe në faljen e gjynaheve tuaja. Ai u sqaron njerëzve argumentet e Veta, që ata të përkujtojnë.

Shpjegimi i ajetit

- "Mos u martoni me idhujtare, derisa ato të besojnë. Një skllave besimtare është më e vlefshme se një idhujtare, edhe nëse kjo e fundit mund t'ju mahnisë." – Kuptimi: Mos u martoni me gra idhujtare, derisa ato ta besojnë Zotin si Një të vetëm dhe të përqafojnë Islamin. Një besimtare, sado e shëmtuar që të jetë, ajo është më e mirë se një idhujtare, sado e bukur qoftë kjo e fundit.

Ky ajet i përfshin të gjitha llojet e idhujtareve, por është ajeti i pestë i sures Maide, në të cilin Allahu i Lartësuar përjashton nga ky ligj gratë prej ithtarëve të Librit (të krishteret dhe çifutet).

Më tej, Allahu i Lartësuar thotë:

- "Mos jepni *(gra)* tek idhujtarët, derisa ata të besojnë. Një skllav besimtar është më i vlefshëm se një idhujtar, edhe nëse ky i fundit mund t'ju mahnisë." - Ky është një gjykim që i përfshin të gjithë llojet e jomuslimanëve, për të cilin nuk ka ndonjë përjashtim, sikurse ndodh me gjykimin e mësipërm.

Pastaj Allahu i Lartësuar tregon urtësinë e ndalimit të këtyre martesave:

- "Ata ju ftojnë për në Zjarr..." - Me fjalët, veprat dhe sjelljen e tyre, idhujtarët të ftojnë për në zjarrin e Xhehenemit.

Në fakt, përzierja me ta është shumë e rrezikshme, dhe jo thjesht për çështjet e kësaj jete, por për vetë ahiretin.

Duke marrë parasysh qëllimin që ka sjellë Allahu i Lartësuar për të ndaluar këto lloj martesash, mund të themi se është e ndaluar që të përzihesh dhe të krijosh afrimitet me çdo lloj idhujtari apo bidatçiu. Nëse Allahu i Lartësuar e ka ndaluar martesën me ta, nga e cila ndonjëri mund të synojë shumë dobi, atëherë si do të jetë gjykimi për përzierjen me ta në çështje me rëndësi më të vogël sesa martesa? Sigurisht, që ndalimi është më i fortë. Po ashtu, ndalimi bëhet akoma më i rreptë nëse në këto marrëdhënie, idhujtarët dalin superiorë ndaj muslimanëve.

Thënia e Allahut të Lartësuar: "Mos jepni *(gra)* tek idhujtarët" dëshmon edhe për një dispozitë tjetër: në martesën e femrës duhet marrë patjetër në konsideratë leja e kujdestarit të saj ligjor. Por ku e si duket kjo? Vëreni me kujdes dallimet mes dy rasteve që trajtohen në ajet. Në fillim thuhet: "Mos u martoni me idhujtare...". Më pas thuhet: "Mos jepni *(gra)* tek idhujtarët...". Kështu, në rastin e parë, ajeti u drejtohet meshkujve, që ata të mos martohen me idhujtare. Edhe në rastin e dytë, ajeti u drejtohet po meshkujve: "Mos jepni...". Këtu kundrinori është i nënkuptuar (gra), edhe pse nuk është përmendur drejtpërdrejt në ajet. Pra kuptimi i ajetit është: "Ju mos jepni gra për nuse tek idhujtarët, derisa ata të besojnë". Nëse leja e kujdestarit ligjor të gruas do të ishte e parëndësishme, atëherë ajeti, në rastin e

dytë, nuk do t'u drejtohej meshkujve që të mos jepnin gratë tek idhujtarët, por do t'u drejtohej vetë grave (duke u thënë atyre vetë: "Mos u martoni me burra idhujtarë!").

- "...ndërsa Allahu, me mëshirën e Vet, ju fton në Xhenet dhe në faljen e gjynaheve tuaja." - Allahu i Lartësuar i fton adhuruesit e Tij që të ecin në rrugën drejt Xhenetit, në rrugën që të çon tek falja e Tij dhe mbulimi i gjynaheve. Falja e Zotit dhe mbulimi i gjynaheve janë të vetmet mundësi që e ruajnë njeriun nga ndëshkimet dhe vuajtjet. Pra, Allahu i Lartësuar i fton adhuruesit që të arrijnë mirësitë e Xhenetit dhe të shpëtojnë nga ndëshkimi në Xhehenem. Në fakt, Allahu i Lartësuar na fton të kryejmë vepra të mira, të marrim dije të dobishme dhe të pendohemi sinqerisht. Çfarë ftese e mrekullueshme! Ftesë për t'u pajisur me dije të dobishme, me vepra sipas kësaj dijeje dhe të sinqerta për Allahun, dhe ftesë për t'u penduar nga gjynahet.

- "Ai u sqaron njerëzve argumentet e Veta, që ata të përkujtojnë." - Allahu i Lartësuar i sjell këto dispozita dhe urtësitë e tyre për njerëzit, që ata t'i përkujtojnë vazhdimisht ato. Përkujtimi është i domosdoshëm për njerëzit, sepse nëpërmjet tij kujtohen gjërat e harruara dhe zbatohen ato që janë lënë pas dore.

Ajetet 222 – 223

222. Të pyesin ty për gjendjen e menstruacioneve. Thuaj: "Ajo është gjendje e dëmshme, prandaj largohuni prej grave gjatë menstruacioneve dhe mos iu afroni *(për marrëdhënie intime)*, derisa të pastrohen. Pasi të pastrohen, atëherë afrojuni tek ato *(për marrëdhënie intime)*, ashtu siç ju ka lejuar Allahu. Allahu i do ata që pendohen dhe ata që pastrohen.
223. Gratë tuaja janë 'vendmbjellje' për ju, prandaj afrojuni 'vendmbjelljes' suaj si të dëshironi. Por përgatitni diçka për veten tuaj dhe ruhuni prej Allahut. Dijeni se, pa dyshim, takimi do të jetë tek Ai! Përgëzoji besimtarët!

Shpjegimi i ajeteve

- "Të pyesin ty për gjendjen e menstruacioneve. Thuaj: "Ajo është gjendje e dëmshme..." - Allahu i Lartësuar u bën të ditur besimtarëve këtë pyetje, e cila i është drejtuar Profetit (a.s.): "Kur gruas i vijnë të përmuajshmet, a duhet që të largohemi totalisht prej saj, ashtu sikurse veprojnë çifutët?"

Allahu i Lartësuar na tregon se menstruacionet janë të dëmshme dhe, normalisht, urtësia e Tij kërkon që të na ndalojë nga çdo gjë që na dëmton. Për këtë arsye, i Lartësuari thotë:

- "...prandaj largohuni prej grave gjatë menstruacioneve" – Pra, Allahu i Lartësuar na ndalon nga kryerja e marrëdhënieve seksuale me gratë gjatë kohës së menstruacioneve. Ky veprim është haram dhe të gjithë dijetarët janë të këtij mendimi.

Sipas ajetit, ndalimi nuk është gjithëpërfshirës, por është i kufizuar vetëm në periudhën e menstruacioneve dhe në vendin (organin femëror) nga ato dalin. Ndërsa prekja e gruas, puthja e saj, ngrënia ushqim apo fjetja bashkë me të janë të lejueshme. Megjithatë, edhe ky lejim nuk është i plotë, sepse Allahu i Lartësuar thotë më pas:

- "...dhe mos iu afroni *(për marrëdhënie intime)*, derisa të pastrohen." - Kjo tregon që edhe prekjes në vendet afër vendit të menstruacioneve (nga kërthiza deri te gjunjët) është mirë që t'i largohesh. Kështu vepronte Profeti (a.s.), nëse donte të përkëdhelte ndonjë nga gratë e tij kur ishin në të përmuajshmet e tyre. Ai nuk u afrohej pjesëve që përmendëm.

Ky ndalim vazhdon derisa ato të shohin pastrimin nga gjaku. Megjithatë, për t'u bërë të lejueshme marrëdhëniet seksuale me to duhet të plotësohen dy kushte: pastrimi ose ndalimi i gjakut, që është kushti i parë, dhe

larja me ujë e krejt trupit, që është kushti i dytë. Prandaj i Lartësuari thotë:

- "Pasi të pastrohen, atëherë afrojuni tek ato *(për marrëdhënie intime)*, ashtu siç ju ka lejuar Allahu." – Kuptimi: Pasi ato të lahen, atëherë është e lejueshme ajo që ishte e ndaluar, domethënë lejohet që të shkoni me gratë tuaja, por vetëm ashtu si Zoti e ka lejuar.

Ky ajet, sikurse kuptohet, e bën të detyrueshme larjen me ujë të krejt trupit – ose *gusl*-in – për gruan, pas përfundimit të menstruacioneve. Gjithashtu, ai tregon se gusli është i vlefshëm veçse pas ndalimit të gjakut dhe shfaqjes së shenjave të pastrimit.

Kjo dispozitë vjen si mëshirë e Allahut për adhuruesit e Tij, për t'i ruajtur ata nga çdo gjë e dëmshme.

Pastaj thotë i Lartësuari:

- "Allahu i do ata që pendohen dhe ata që pastrohen." – Siç shihet, dy kategori njerëzish që Allahu i Lartësuar i do janë:
1. ata që gjithmonë pendohen dhe kërkojnë falje për mangësitë dhe gjynahet e tyre;
2. ata që gjithmonë ruhen dhe largohen nga gjynahet dhe çdo gjë e dëmshme.

Ky ajet tregon ligjshmërinë dhe shpërblimin e pastërtisë, që Allahu i Lartësuar e do. Pastërtia është kusht për saktësinë e namazit, të tavafit, për lejueshmërinë e prekjes së Kur'ânit etj. Në fakt, pastërtia që Allahu i Lartësuar e pëlqen nuk është vetëm pastërtia fizike, që arrihet me ujë a me diçka tjetër, por edhe pastërtia shpirtërore, që arrihet duke u larguar nga veset e ulëta e nga veprat e ndyra.

- "Gratë tuaja janë 'vendmbjellje' për ju, prandaj afrojuni 'vendmbjelljes' suaj si të dëshironi." – Pra, burrave u lejohet që të kënaqen me çdo lloj pozicioni në marrëdhëniet seksuale me gratë e tyre, veçse duhet që ky kontakt të kryhet në vendin që Allahu e ka quajtur, në mënyrë figurative, "vendmbjellje". Thënë ndryshe, kontakti seksual lejohet veçse në organin nga lind fëmija dhe pozicionet janë të gjitha të lejueshme.

Ka shumë hadithe të përcjella saktësisht prej Profetit (s.a.u.s.), që tregojnë se marrëdhëniet jashtë "vendmbjelljes" janë haram, madje është i mallkuar ai që bën një veprim të tillë.


- "Por përgatitni diçka për veten tuaj..." - Parapërgatisni vepra të mira, për të cilat të shpresoni shpërblimin tek Allahu. Vepër e mirë është edhe dhurimi i kënaqësisë bashkëshortit ose bashkëshortes, nëse bëhet duke synuar shpërblimin e Allahut ose lënien e pasardhësve të mirë, që t'i shërbejnë Allahut të Lartësuar.

- "...dhe ruhuni prej Allahut." - Ky është një urdhër shumë i njohur: të jemi të pajisur me devotshmëri, në çfarëdolloj gjendjeje. Gjithmonë të jemi të kujdesshëm dhe të mos i kalojmë kufijtë e vendosura nga Zoti ynë. Pastaj Allahu i Lartësuar na tregon diçka, që është nxitëse shumë e fortë për pajisjen me devotshmëri:

- "Dijeni se, pa dyshim, takimi do të jetë tek Ai!" – Kuptimi: Duke qenë të sigurt se një ditë do të dilni para Tij dhe do të shpërbleheni për veprat tuaja, me siguri që do të tregoheni të durueshëm dhe këmbëngulës për t'u pajisur me devotshmëri.

Pastaj Allahu përmend edhe një nxitës tjetër për të qenë i devotshëm:

- "Përgëzoji besimtarët!" - Këtu nuk është përcaktuar lloji i mirësisë, me të cilën duhet të përgëzohen besimtarët, dhe kjo bëhet për efekt gjithëpërfshirjeje. Pra, Allahu na përgëzon se do të na nderojë me gjithçka që na gëzon dhe na qetëson. Besimtarëve u takon përgëzimi për në dynja dhe për në ahiret. Ata do të fitojnë çdo të mirë dhe do të shpëtojnë nga çdo e keqe, sipas gradës së besimit të secilit. Madje, edhe besimi, të cilin


الجزء الثاني سورة البقرة

لَا يُؤَاخِذُكُمُ اللَّهُ بِاللَّغْوِ فِي أَيْمَانِكُمْ وَلَٰكِن يُؤَاخِذُكُم بِمَا كَسَبَتْ
قُلُوبُكُمْ ۗ وَاللَّهُ غَفُورٌ حَلِيمٌ ﴿٢٢٥﴾ لِّلَّذِينَ يُؤْلُونَ مِن نِّسَائِهِمْ تَرَبُّصُ
أَرْبَعَةِ أَشْهُرٍ ۖ فَإِن فَاءُوا فَإِنَّ اللَّهَ غَفُورٌ رَّحِيمٌ ﴿٢٢٦﴾ وَإِنْ عَزَمُوا
الطَّلَاقَ فَإِنَّ اللَّهَ سَمِيعٌ عَلِيمٌ ﴿٢٢٧﴾ وَالْمُطَلَّقَاتُ يَتَرَبَّصْنَ بِأَنفُسِهِنَّ
ثَلَاثَةَ قُرُوءٍ ۚ وَلَا يَحِلُّ لَهُنَّ أَن يَكْتُمْنَ مَا خَلَقَ اللَّهُ فِي أَرْحَامِهِنَّ
إِن كُنَّ يُؤْمِنَّ بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ الْآخِرِ ۚ وَبُعُولَتُهُنَّ أَحَقُّ بِرَدِّهِنَّ فِي
ذَٰلِكَ إِنْ أَرَادُوا إِصْلَاحًا ۚ وَلَهُنَّ مِثْلُ الَّذِي عَلَيْهِنَّ بِالْمَعْرُوفِ ۚ
وَلِلرِّجَالِ عَلَيْهِنَّ دَرَجَةٌ ۗ وَاللَّهُ عَزِيزٌ حَكِيمٌ ﴿٢٢٨﴾ الطَّلَاقُ مَرَّتَانِ ۖ
فَإِمْسَاكٌ بِمَعْرُوفٍ أَوْ تَسْرِيحٌ بِإِحْسَانٍ ۗ وَلَا يَحِلُّ لَكُمْ أَن تَأْخُذُوا
مِمَّا آتَيْتُمُوهُنَّ شَيْئًا إِلَّا أَن يَخَافَا أَلَّا يُقِيمَا حُدُودَ اللَّهِ ۖ
فَإِنْ خِفْتُمْ أَلَّا يُقِيمَا حُدُودَ اللَّهِ فَلَا جُنَاحَ عَلَيْهِمَا فِيمَا افْتَدَتْ
بِهِ ۗ تِلْكَ حُدُودُ اللَّهِ فَلَا تَعْتَدُوهَا ۚ وَمَن يَتَعَدَّ حُدُودَ اللَّهِ فَأُولَٰئِكَ
هُمُ الظَّالِمُونَ ﴿٢٢٩﴾ فَإِن طَلَّقَهَا فَلَا تَحِلُّ لَهُ مِن بَعْدُ حَتَّىٰ تَنكِحَ زَوْجًا
غَيْرَهُ ۗ فَإِن طَلَّقَهَا فَلَا جُنَاحَ عَلَيْهِمَا أَن يَتَرَاجَعَا إِن ظَنَّا أَن
يُقِيمَا حُدُودَ اللَّهِ ۗ وَتِلْكَ حُدُودُ اللَّهِ يُبَيِّنُهَا لِقَوْمٍ يَعْلَمُونَ ﴿٢٣٠﴾
٣٦

Allahu e dhuron, është pjesë e përgëzimit dhe e premtimit të Allahut të Lartësuar. Ky ajet dëshmon për dashurinë e madhe të Allahut të Lartësuar për besimtarët. Allahu i Lartësuar e do çdo gjë që kënaq dhe gëzon besimtarët. Ky ajet tregon, gjithashtu, se është e pëlqyeshme të mbushësh zemrat e besimtarëve me gëzim, sepse kështu i shkathtëson ata dhe u nxit vullnetin për të kryer vepra të mira. Besimtarët mund t'i lumturosh duke u treguar e kujtuar se çfarë shpërblimi të madh ka përgatitur Allahu i Lartësuar për ta, në këtë jetë dhe në jetën tjetër.

Ajetet 224 - 225

224. Mos i bëni betimet tuaja në Allahun pengesë, kur doni të bëni vepra të mira, të ruheni nga të këqijat dhe të pajtoni njerëzit. Allahu është Dëgjues dhe i Gjithëditur.

225. Allahu nuk ju merr në përgjegjësi për betimet tuaja të paqëllimta, por për ato që i bëni qëllimisht me gjithë zemër. Allahu është Falës dhe i Butë.

Shpjegimi i ajeteve

- "Mos i bëni betimet tuaja në Allahun pengesë, kur doni të bëni vepra të mira, të ruheni nga të këqijat dhe të pajtoni njerëzit." - Qëllimi i betimit është madhërimi i atij në emër të të cilit përbetohesh dhe vërtetimi i asaj çështjeje për të cilën betohesh.

Allahu i Lartësuar na ka urdhëruar që t'u përmbahemi betimeve dhe t'i plotësojmë ato. Normalisht, betimet duhet të plotësohen në të gjitha rastet, pa përjashtim. Megjithatë, Allahu i Lartësuar ka bërë disa përjashtime në këtë çështje. Kështu, për shembull, nëse plotësimi i betimit të çon në lënien e diçkaje tjetër që është më e dashur për Allahun e Lartësuar, atëherë betimi nuk duhet të plotësohet. Allahu i Lartësuar i ka ndaluar adhuruesit e Tij që, për hir të plotësimit të një betimi, të lënë veprat e mira apo të mos largohen nga veprat e këqija. Po ashtu, Ai i ka ndaluar njerëzit që t'i nxjerrin përbetimet si pengesë për të mos u pajtuar mes njëri-tjetrit. Ai që betohet se do të lërë pa kryer një detyrim, në fakt, e ka detyrë që ta thyejë betimin e tij dhe ta kompensojë atë sipas rregullit. Ai e ka haram që ta mbajë betimin e bërë. Gjithashtu, kush betohet se do të lërë një vepër që është e pëlqyeshme që të kryhet (*mustehab*), e ka të pëlqyeshme që ta thyejë betimin e bërë dhe ta kompensojë sipas rregullit. Kush betohet se do të kryejë një vepër që është haram, ai e ka të detyrueshme që ta thyejë betimin e bërë dhe duhet ta kompensojë atë sipas rregullit. Për atë që betohet se do të kryejë një vepër që është e papëlqyeshme (*mekrûh*), është e pëlqyeshme (*mustehab*) që ta thyejë atë betim dhe ta kompensojë atë sipas rregullit. Së fundi, kush betohet për kryerjen apo moskryerjen e një çështjeje të lejuar, duhet t'i përmbahet betimit dhe të mos e thyejë atë.

Me këtë ajet, dijetarët mbështesin parimin e njohur në Islam, që thotë: Nëse ka

përplasje interesash, atëherë i jepet përparësi atij më të rëndësishmit.

Më pas, Allahu i Lartësuar e përfundon ajetin me dy emra të mrekullueshëm të Tij, duke thënë:

- "Allahu është Dëgjues dhe i Gjithëditur." – Ai është Dëgjues (*Semîun*), domethënë Ai i dëgjon të gjitha zërat dhe fjalët që thuhen. Ai është edhe i Gjithëditur (*Alîmun*), pra, i di motivet dhe qëllimet e njerëzve. Allahu i dëgjon fjalët e atyre që betohen dhe i njeh qëllimet e tyre, a janë të mira apo të këqija.

Ky ajet është një vërejtje nga Allahu i Lartësuar që të jemi të kujdesshëm, sepse Ai i di shumë mirë fjalët dhe qëllimet tona. Ai është i drejtë në gjykimin e Tij dhe bamirës ndaj krijesave. Pastaj thotë i Lartësuari:

- "Allahu nuk ju merr në përgjegjësi për betimet tuaja të paqëllimta, por për ato që i bëni qëllimisht me gjithë zemër." – Pra, Allahu i Lartësuar nuk na merr në përgjegjësi për ato betime që dalin shpesh nga goja, pa pasur qëllim betimin. Të tilla janë disa shprehje të zakonshme, si: "Jo, për Zotin" ose: "Po, për Zotin" etj., që njerëzit i thonë rëndom, pa pasur si qëllim betimin.

Ky ajet tregon, gjithashtu, se për fjalët që njeriu thotë, ashtu si edhe për veprat që ai kryen, duhet të merret në konsideratë qëllimi që ai ka me to.

- "Allahu është Falës dhe i Butë." - Ai është Falës (*Gafûrun*), që ia mbulon gjynahet atij që pendohet dhe kthehet tek Ai. Allahu është i Butë (Halîmun), që nuk nxitohet të dënojë atë që bën gabime ndaj Tij. Ai e mëshiron dhe ia mbulon gjynahet robit të Tij, edhe pse është i Plotfuqishëm për ta ndëshkuar, me drejtësinë e Tij.

Ajetet 226 – 227

226. Për ata që betohen se do të ndahen prej grave të tyre, afati i pritjes është katër muaj. Në qoftë se heqin dorë *(nga betimi)*, atëherë s'ka dyshim se Allahu është Falës e Mëshirues.

227. E në qoftë se ata e kanë vendosur për divorcim, Allahu është Dëgjues e i Gjithëditur.

Shpjegimi i ajeteve

- "Për ata që betohen se do të ndahen prej grave të tyre, afati i pritjes është katër muaj." - Këtu bëhet fjalë për betimet që kanë të bëjnë, në mënyrë të veçantë, me marrëdhëniet e burrit me gruan.

Kështu, kur burri betohet se nuk do të kryejë më marrëdhënie seksuale me gruan e tij për katër muaj e ose më pak se 4 muaj, atëherë ai është i lirë që të zgjedhë njërën prej këtyre alternativave: ose të thyejë betimin dhe ta kompensojë sipas rregullit, ose ta mbajë betimin deri në përfundim të katër muajve. Gjatë kësaj kohe, gruaja nuk ka asnjë të drejtë që të kërkojë ndarjen prej tij apo të ankohet gjetkë, sepse për katër muaj, burrit i lejohet një gjë e tillë.

Por nëse burri betohet se nuk do të kryejë marrëdhënie me gruan e tij për një periudhë më të gjatë se katër muaj, ose përgjithmonë, atëherë ai ka vetëm dy mundësi pas mbarimit të katër muajve: ose ta thyejë betimin e ta kompensojë sipas rregullit, duke iu kthyer jetës dhe marrëdhënieve normale, ose ta divorcojë përfundimisht gruan e tij. Nëse ai nuk pranon që ta ndajë gruan, atëherë ndërhyn gjykatësi dhe i ndan ata me forcën e ligjit.

Megjithatë, thyerja e këtij lloj betimi është më e dashur për Allahun e Lartësuar, i Cili thotë:

- "Në qoftë se heqin dorë *(nga betimi)*, atëherë s'ka dyshim se Allahu është Falës e Mëshirues." – Pra, nëse ata e lënë betimin për të mos kryer marrëdhënie me gruan dhe i kthehen marrëdhënieve normale, atëherë Allahu i Lartësuar ua fal pasojat e betimit të pambajtur, sepse Ai është Falës.

Allahu është edhe Mëshirues, pasi prej mëshirës së Tij është mundësia që Ai u ka

dhënë njerëzve që të thyejnë betimet e tyre, duke bërë një kompensim të thjeshtë. Përfytyroni sikur të na e kishte bërë të detyrueshme mbajtjen e të gjitha betimeve tona, se çfarë do të ndodhte. Prej mëshirës së Tij është edhe butësia, ngrohtësia e dashuria që Ai i kthen në këtë mënyrë familjes, duke i nxitur bashkëshortët që t'i kthehen marrëdhënieve të domosdoshme për një jetë normale.

- "E në qoftë se ata e kanë vendosur për divorcim..." - Nëse burri, pas mbarimit të katër muajve, nuk i kthehet marrëdhënieve normale, atëherë kjo fakton se ai është i vendosur për t'u ndarë. Kjo tregon se ai nuk ka më dëshirë kundrejt gruas së vet. Në këtë rast, bëhet i detyrueshëm divorci. Edhe nëse burri refuzon një gjë të tillë, atë e kryen gjykatësi me forcën e ligjit.

- "Allahu është Dëgjues e i Gjithëditur." - Ky është një kërcënim i ashpër për ata që betohen kështu veçse për të dëmtuar gruan dhe për t'i shkaktuar vuajtje asaj.

Ajeti i mësipërm tregon se ky lloj betimi funksionon vetëm kur bëhet për bashkëshorten, sepse Allahu i Lartësuar thotë: "Për ata që betohen se do të ndahen prej grave të tyre" *(pra, jo prej skllaveve)*.

Gjithashtu, ky ajet dëshmon se është e detyrueshme kryerja e marrëdhënieve seksuale me gruan të paktën një herë në katër muaj, sepse pas katër muajve ndërprerjeje, burri ose duhet t'i rikthehet marrëdhënieve, ose duhet të ndahet me forcën e ligjit, nëse nuk pranon ta ndajë gruan e vet.

Ajeti 228

228. Gratë e ndara *(nga burri)* janë të detyruara të presin deri në tri perioda. Atyre nuk u lejohet ta fshehin atë që Allahu krijon në mitrën e tyre, nëse vërtet e besojnë Allahun dhe Ditën e Fundit. Burrat e tyre kanë të drejtë t'i rikthejnë ato gjatë kësaj kohe, nëse duan të pajtohen. Ato *(gratë)* kanë të drejta, sikurse edhe përgjegjësi. Burrat kanë një shkallë përparësie ndaj tyre. Allahu është i Gjithëfuqishëm e i Urtë.

Shpjegimi i ajetit

- "Gratë e ndara *(nga burri)* janë të detyruara të presin deri në tri perioda." - Dijetarët kanë mendime të ndryshme rreth kuptimit të fjalës "*kur'un*" (periodë), që është përmendur në ajet. Kështu, disa janë të mendimit se ajo tregon ciklin e mestruacioneve. Pra, sipas këtij shpjegimi, gruaja e ndarë duhet të presë deri sa t'i kalojnë tri cikle mestruacionesh. Ndërsa të tjerë mendojnë se me fjalën "*kur'un*" është për qëllim shikimi i pastrimit, pas përfundimit të mestruacioneve. Sipas këtij mendimi, gruaja e ndarë duhet të presë sa të bëhen tri periudha pastrimi.

Megjithatë, më i saktë është mendimi i parë, që thotë se *'kur'un'* quhet cikli i mestruacioneve. Pra, sipas mendimit më të saktë, gruaja duhet të presë që asaj t'i vijnë tri herë të përmuajshmet.

Kjo dispozitë e sjellë nga Allahu i Lartësuar ka vërtet shumë urtësi. Me kalimin e tri periodave, ne sigurohemi që gruaja nuk është shtatzënë dhe, në këtë mënyrë, ruhemi nga përzierja e përkatësive farefisnore. Madje, për ta përforcuar këtë qëllim, Allahu i Lartësuar i ka urdhëruar gratë e ndara, duke thënë:

- "Atyre nuk u lejohet ta fshehin atë që Allahu krijon në mitrën e tyre..." – Pra, Allahu i Lartësuar ua ka ndaluar atyre që të fshehin barrën, sepse fshehja e saj sjell dëme dhe çrregullime të mëdha. Nëse gruaja e fsheh shtatzëninë me burrin që e ka ndarë, ajo, në këtë mënyrë, nuk ia njeh atësinë prindit të vërtetë, por ia kalon dikujt tjetër në vend të tij. Por kjo do të thotë që mes fëmijës dhe prindit të ndërpriten plotësisht marrëdhëniet farefisnore, të cilat janë të detyrueshme që të mbahen të lidhura. Po ashtu, mes fëmijës dhe babait zhvleftësohet trashëgimia dhe çdo dispozitë që lidhet me

të drejtat dhe detyrimet mes prindit dhe fëmijës. Fëmija do të ndalohet që të takojë të afërmit e tij. Ai, kështu, mund që të martohet me dikë me të cilën nuk i lejohet martesa, si për shembull, me motrën e tij, me hallën, me tezen etj., sepse ai nuk e di përkatësinë e tij të vërtetë. Nëse ai nuk e njeh babain e vërtetë, shkatërrohen të gjitha dispozitat e ndërtuara mbi bazën e lidhjes së gjakut, pasi të afërm të tij konsiderohen njerëz të gabuar. Kjo gjë, pa dyshim, sjell një dëm të pallogaritshëm, që veç Zoti i krijesave mund ta dijë.

Në fakt, kur gruaja e di që është shtatzënë, por e fsheh këtë të vërtetë, me qëllim që të mund të ndahet më shpejt nga burri i parë, atëherë martesa e saj me një burrë të dytë konsiderohet e pavlefshme. Rrjedhimisht, ajo konsiderohet se po bën një gjynah mjaft të madh, që quhet *zina* ose marrëdhënie seksuale të jashtëligjshme. Sikur ndër dëmet dhe të këqijat e fshehjes së shtatzënisë të ishte veçse kjo e fundit, kaq do të mjaftonte për të qenë më të ruajtur.

Ndërsa gruaja që gënjen e thotë se i janë plotësuar të trija ciklet e periodave, me qëllim për ta përshpejtuar ndarjen, është në rrezik të madh dhe faj të rëndë, sepse ajo kështu cenon të drejtën e burrit të saj dhe i ka lejuar dikujt tjetër atë çka nuk meriton të jetë e tija. Rrjedhojat e këtij veprimi janë shumë të këqija dhe të dëmshme.

Edhe në rastin kur ajo gënjen e thotë që nuk i kanë ardhur periodat, me qëllim që të zhvasë sa më tepër prej burrit, atëherë kjo konsiderohet si marrje e pasurisë së tjetrit pa të drejtë. Me një veprim të tillë, gruaja merr gjynah të dyfishtë: së pari, me plotësimin e kohës së saj të pritjes, ajo gjithsesi nuk ka të drejtë të përfitojë prej pasurisë së burrit, edhe pse me mashtrim e fsheh një fakt të tillë. Së dyti, ajo tjetërson gjykimin e Sheriatit duke mashtruar. Kështu, madje ekziston mundësia që burri të kërkojë ta kthejë pas mbarimit të vërtetë të kohës së pritjes, dhe në këtë mënyrë të ndodhë një e keqe më e madhe: marrëdhëniet seksuale jashtëmartesore, sepse koha e saj e pritjes ka mbaruar, edhe pse ajo e fsheh një fakt të tillë. Prandaj Allahu i Lartësuar e ka përforcuar këtë dispozitë duke thënë:

- "...nëse vërtet e besojnë Allahun dhe Ditën e Fundit." - Duke parë gjithë këto dëme dhe të këqija që sjell fshehja e shtatzënisë, atëherë kush e bën këtë tregon se nuk e beson Allahun dhe Ditën e Llogarisë. Nëse do ta besonte Allahun dhe do të ishte e bindur për Ditën e Llogarisë, gruaja nuk do ta merrte kurrë guximin për një veprim të tillë.

Ky ajet vërteton se dëshmia e gruas për veten e saj, në çështje të tilla si shtatzënia dhe periodat, është e pranueshme dhe e mjaftueshme. Pastaj i Lartësuari thotë:

- "Burrat e tyre kanë të drejtë t'i rikthejnë ato gjatë kësaj kohe..." - Burrat e kanë të drejtën që, gjatë kohës së pritjes, t'i kthejnë e t'i marrin sërish gratë e tyre.
Më tej, Allahu i Lartësuar tregon se cili duhet të jetë qëllimi i ribashkimit të çiftit:

- "...nëse duan të pajtohen" - Pra, kthimi lejohet vetëm nëse palët duan të afrohen, të rregullojnë marrëdhëniet dhe t'i rikthehen martesës së rregullt, që ndërtohet mbi dashurinë dhe mëshirën.

Duke e parë ajetin anasjelltas, kuptojmë që nëse burri nuk i ka motivet e mësipërme të ribashkimit, atëherë ai nuk e ka të drejtën për ta kthyer gruan e tij. Me fjalë të tjera, atij nuk i lejohet që ta rikthejë gruan me qëllimin që ta dëmtojë dhe t'i shkaktojë vuajtje asaj. Lind pyetja: A konsiderohet i ligjshëm një veprim i tillë, edhe pse qëllimi i tij është i keq?

Shumica e dijetarëve janë të mendimit se ky veprim konsiderohet i pranueshëm ligjërisht dhe dispozitat që lidhen me të janë të ligjshme, edhe burri merr gjynah për qëllimet e tij të këqija. Ndërsa disa të tjerë thonë që, nëse burri nuk ka synim marrëdhëniet normale, atij nuk i lejohet që ta

kthejë gruan. Në të kundërt, veprimi i tij është i paligjshëm, sikurse tregon ajeti.

Një tjetër urtësi që fshihet pas urdhrit të Allahut për pritjen e gruas është se, ndoshta, gjatë kësaj pritjeje, burri ndryshon mendje për ndarjen, madje, të dyja palëve u jepet mundësia që të mendojnë më gjatë rreth ndarjes apo bashkimit. Kjo tregon se Allahu i Lartësuar e do shumë afrimitetin dhe dashurinë mes bashkëshortëve. Ai nuk e dëshiron ndarjen mes tyre, sikurse thuhet edhe në një hadith të Profetit (a.s.): "Hallalli më i urryer për Allahun është divorci."[10]

Ky qe rasti kur burri ka të drejtë që ta rikthejë gruan e ndarë, gjatë kohës së pritjes së saj ose brenda tri cikleve të saj. Ndërsa kur koha e pritjes mbaron (*talak bain*), atëherë ndryshon çështja, sepse burri nuk ka më të drejtë që ta kthejë gruan e tij. Megjithatë, nëse të dyja palët duan të ribashkohen përsëri, ato duhet të bien dakord për një akt të ri martesor, me të gjitha kushtet e tij. Kështu që, në këtë rast të dytë, burri nuk e ka më të drejtën ekskluzive për ta rikthyer gruan e ndarë, por duhet patjetër edhe pëlqimi i palës tjetër, domethënë i gruas. Pastaj i Lartësuari thotë:

- "Ato (*gratë*) kanë të drejta, sikurse edhe përgjegjësi." – Pra, të drejtat dhe përgjegjësitë e bashkëshortëve ndaj njëri-tjetrit janë të ndërsjellta. Të dyja palët kanë të drejta dhe përgjegjësi ndaj njëri-tjetrit, që duhet t'i zbatojnë. Ka të drejta dhe përgjegjësi që janë të detyrueshme për t'u përmbushur, ashtu siç ka edhe të drejta dhe përgjegjësi që janë të pëlqyeshme të përmbushen.

Të drejtat dhe përgjegjësitë e bashkëshortëve ndaj njëri-tjetrit përcaktohen shpeshherë nga tradita dhe zakonet e vendit, nëse ato nuk bien ndesh me Sheriatin. Çdo vend ka traditën dhe zakonet e veta në përcaktimin e të drejtave dhe përgjegjësive të bashkëshortëve kundrejt njëri-tjetrit. Po kështu, çdo kohë dhe epokë ndikon në ndryshimin e këtyre të drejtave dhe përgjegjësive.

Thënia e Allahut: "sipas zakonit" tregon se, si kritere për të caktuar të drejtat dhe përgjegjësitë mes dy bashkëshortëve janë tradita dhe zakonet e njerëzve, të pranuara gjerësisht prej tyre. Në bazë të këtyre kritereve, gjykohet, për shembull, se cilat janë detyrimet e burrit kundrejt gruas së tij në aspektin e ushqimit të saj, veshmbathjeve, strehimit, shpenzimeve të domosdoshme për të gjatë kohës së pritjes etj. Për çdo popull, epokë apo vend, ka gjykim të veçantë për këto çështje, sipas zakonit dhe traditës.

Megjithatë, zakonet dhe traditat e njerëzve që nuk bien ndesh me Sheriatin, merren në konsideratë vetëm në rastet kur dy bashkëshortët nuk kanë vendosur paraprakisht kushte ndaj njëri-tjetrit. Nëse ata kanë vendosur kushte paraprake mes njëri-tjetrit, atëherë ndryshon çështja, sepse në të tilla raste merren në konsideratë këto kushte, dhe jo zakonet e traditat e njerëzve. Kushtet e ndërsjellta janë të detyrueshme të plotësohen nga palët, përveç nëse ato bien në kundërshtim me ndonjë ligj të Allahut.

- "Burrat kanë një shkallë përparësie ndaj tyre." – Pra, burrat janë një gradë më lart kundrejt grave të tyre, për sa u përket të drejtave. I Lartësuari thotë në suren Nisa, ajeti 34: "Meshkujt kanë autoritet mbi gratë, për arsye se Allahu i ka dalluar disa mbi disa të tjerë dhe meqë ata shpenzojnë nga pasuria e vet."

Burrat qëndrojnë më lart se gratë në shumë aspekte. Kështu, për shembull, profetësia, detyra e gjykatësit, udhëheqja fetare apo shtetërore dhe shumë përgjegjësi të tjera të rëndësishme janë të veçanta për burrat, pasi nuk lejohet që në të tilla detyra e pozicione të vendosen gratë. Një fushë tjetër ku burri ka më tepër përparësi se gruaja është edhe trashëgimia, sepse burrit i takon pjesë më e madhe në trashëgimi se gruas.

[10] Edhe pse saktësia e këtij hadithi është përfolur (Sh.p.).

- "Allahu është i Gjithëfuqishëm e i Urtë." - Allahut i takon pushteti absolut, para të cilit nënshtrohet gjithçka. Atij i takon mbretërimi dhe sundimi absolut. Gjithçka i është nënshtruar urdhrit dhe pushtetit të Tij.

Por Allahu, përveç pushtetit absolut, ka edhe urtësinë absolute. Në çdo vepër dhe përcaktim të Allahut gjendet urtësia madhështore e Tij.

Nga ky ajet kuptohet se, në përgjithësi, të gjitha gratë që ndahen nga burri duhet të presin tri perioda. Por nga ky rregull bëjnë përjashtim disa kategori grash, si:

1. Gratë shtatzëna, pasi koha e pritjes së tyre nuk është tri cikle menstruacionesh, por është deri sa të lirohen nga barra e tyre. Gratë me të cilat burrat ende nuk kanë kryer marrëdhënie seksuale, pas aktit të martesës. Këto nuk duhet të presin deri në tri perioda pasi ndahen nga burri, madje nuk janë të detyruara të presin aspak.

2. Skllavet ose robëreshat, pasi koha e pritjes së tyre është dy cikle menstruacionesh, ndryshe nga të lirat. Ky qëndrim vjen i dëshmuar nga sahabët, por edhe konteksti i ajeteve të mësipërme tregon se në to bëhet fjalë për gratë e lira, jo për skllavet.

Ajeti 229

229. Ndarja mund të bëhet dy herë. Pastaj, ose jetesë bashkëshortore normale, ose divorc me mirëkuptim. Juve *(burrave)* nuk ju lejohet t'u merrni atyre *(grave)* asgjë nga ajo që u keni dhuruar më parë, vetëm nëse që të dy palët druheni se nuk do të mund t'u përmbaheni kufijve të Allahut. E nëse keni frikë se nuk do të mund t'u përmbaheni kufijve të Allahut, atëherë për të dyja palët nuk është gjynah nëse ajo *(gruaja)* jep kompensim. Këta janë kufijtë e Allahut, prandaj mos i shkelni ata! Ata që shkelin kufijtë e Allahut janë vërtet zullumqarë.

Shpjegimi i ajetit

Në kohën para Islamit dhe në fillimet e tij, burri e linte dhe e kthente gruan e tij sa herë të donte, pa kufizime. Nëse dëshironte që ta bënte gruan e tij të vuante, e ndante atë, dhe kur afrohej mbarimi i afatit të pritjes, e kthente atë përsëri. Pastaj e ndante përsëri, dhe përsëri e kthente. Kështu vepronte vazhdimisht, duke i shkaktuar gruas aq vuajtje, saqë vetëm një Zot e di. Për këtë arsye, i Madhëruari tha:

- "Ndarja mund të bëhet dy herë." – Pra, ndarja pas së cilës burri ka të drejtën që ta rikthejë gruan e vet, është e lejuar të bëhet vetëm dy herë. Kështu, burrit i jepet mundësia për ta rikthyer gruan e tij vetëm dy herë. Kaq është mëse e mjaftueshme që ai të reflektojë kundrejt gruas së tij ashtu si duhet. Nëse veprimi përsëritet më shumë se dy herë, atëherë nuk konsiderohet i drejtë, madje mund të jetë tregues që me ndarjen dëshirohet vuajtja dhe lëndimi i gruas. Burri që e përsërit një veprim të tillë kundrejt gruas së tij tregon se ai nuk ka qëllim që të jetojë me të normalisht, madje synon dëmtimin e saj. Për këtë arsye, Allahu i Lartësuar i urdhëron burrat që, pas bashkimit prej ndarjes së dytë:

- "... ose jetesë bashkëshortore normale, ose divorc me mirëkuptim." – Pra, burri duhet ose ta mbajë gruan për një jetë bashkëshortore normale, sipas rregullave dhe zakoneve të njerëzve të rangut të tyre, ose ta ndajë atë me mirëkuptim.

Siç shihet, Allahu e ka urdhëruar burrin që, nëse nuk do që të jetojë me gruan e tij, ta ndajë atë me mirësi. Kjo do të thotë që burri, pas ndarjes, të mos i marrë gruas asgjë prej pasurisë që i ka dhënë, sepse atëherë do të ishte padrejtësi ndaj saj.

Për këtë arsye, i Lartësuari thotë më tej:

- "Juve *(burrave)* nuk ju lejohet t'u merrni atyre *(grave)* asgjë nga ajo që u keni dhuruar më parë, vetëm nëse që të dy palët druheni se nuk do të mund t'u përmbaheni kufijve të Allahut." – Pra, nuk lejohet që burri t'ia marrë sërish gruas ato gjëra që i ka

dhënë më parë, qoftë ky mehri apo ndonjë shpenzim tjetër.

Vetëm në një rast lejohet që gruaja t'ia kthejë mehrin burrit të saj, në shkëmbim të ndarjes prej tij. Kështu, nëse ata mendojnë se nuk do t'i zbatojnë dispozitat e Allahut kundrejt njëri-tjetrit, atëherë gruas i lejohet që të kërkojë divorcin prej burrit të saj dhe, si shkëmbim, ajo i kthen atij mehrin. Ky rast quhet *ẖul'un*. Më konkretisht, nëse gruaja nuk e pëlqen burrin e saj, për shkak të ndonjë vesi të ulët, të ndonjë mangësie fizike apo fetare të tij, dhe mendon se nuk do të mund t'ia plotësojë atij detyrimet që Zoti i ka përcaktuar, i lejohet asaj që të kërkojë ndarjen prej burrit të saj. Në shkëmbim, ajo i kthen mbrapsht burrit mehrin, pa iu konsideruar si gjynah. I Lartësuari thotë:

- "E nëse keni frikë se nuk do të mund t'u përmbaheni dispozitave të Allahut, atëherë për të dyja palët nuk është gjynah nëse ajo *(gruaja)* jep kompensim." – Pra, nuk konsiderohet aspak gjynah që ajo t'ia kthejë mbrapsht dhuratën martesore burrit të saj, dhe nuk është gjynah për burrin që ta pranojë atë, nëse vërtet mendojnë se nuk mund t'i plotësojnë dispozitat e Zotit ndryshe.

Ky ajet tregon lejueshmërinë e *ẖul'un*-it, domethënë, të marrëveshjes mes çiftit për t'u ndarë me kërkesën e gruas. Ajeti tregon, gjithashtu, që edhe gruas i lejohet të kërkojë ndarjen prej burrit të saj, por me kusht që kjo ndarje të jetë nxitur nga shkaku që Allahu thotë në këtë: "nëse keni frikë se nuk do të mund t'u përmbaheni kufijve të Allahut". Pra, vetëm nëse gruaja krijon bindje në vetvete, se nuk mund t'i japë burrit të saj atë që ai e meriton, asaj i lejohet që të kërkojë ndarjen prej tij, pasi divorci është, parimisht, në dorën e burrit.

- "Këta janë kufijtë e Allahut, prandaj mos i shkelni ata!" - Këta janë kufijtë e Zotit, domethënë ligjet e Tij, që janë të detyrueshëm për ju që t'i zbatoni dhe të mos i shkelni.

- "Ata që shkelin kufijtë e Allahut janë vërtet zullumqarë." - E ku ka zullumqarë më të mëdhenj se ata që nëpërkëmbin mirësitë e Zotit dhe parapëlqejnë haramet dhe endjen jashtë kufijve të vendosura nga Ai. Këtyre të padrejtëve nuk u mjaftojnë ato që Zoti ua ka lejuar, por kërkojnë përtej kufijve të Tij.

Padrejtësitë e robit janë tri llojesh:

- Në llojin e parë hyn padrejtësia më e madhe e robit kundrejt Zotit të tij, e që është shirku, politeizmi. Allahu i Lartësuar nuk e fal këtë lloj padrejtësie, vetëm nëse robi pendohet dhe ndreqet.

- Në llojin e dytë hyjnë padrejtësitë e robit kundrejt krijesave. Këto lloj padrejtësish, Allahu i Lartësuar nuk ka për t'i toleruar aspak, derisa robi t'i kompensojë një për një krijesat, të cilave u ka bërë padrejtësi.

- Në llojin e tretë përfshihen padrejtësitë e robit kundrejt Zotit të tij, por që janë më të vogla se shirku. Falja ose jo e këtyre padrejtësive është në dëshirën dhe mëshirën e Allahut të Lartësuar: nëse do, Ai i fal, e nëse jo, Ai u jep ndëshkimin e merituar, sipas urtësisë dhe drejtësisë së Tij.

Ajeti 230

230. E nëse ai *(burri)* e ndan atë *(për herë të tretë)*, pas kësaj atij nuk i lejohet më ta rimarrë, derisa ajo të martohet me një burrë tjetër. E nëse ky i fundit *(burri i dytë)* e divorcon atë, atëherë nuk ka pengesë për ata dy *(gruaja me burrin e parë)* të ribashkohen, nëse vërtet mendojnë se do t'i zbatojnë dispozitat e Allahut. Këto janë dispozitat e Allahut, të cilat Ai ua sqaron njerëzve që dinë.

Shpjegimi i ajetit

- "E nëse ai *(burri)* e ndan atë *(për herë të tretë)*, pas kësaj atij nuk i lejohet më ta rimarrë, derisa ajo të martohet me një burrë

tjetër.” – Pra, pas ndarjes së tretë, burrit nuk i lejohet më që ta kthejë gruan e tij, derisa të plotësojë disa kushte, si më poshtë:

Së pari, ajo duhet të martohet me një burrë tjetër. Fjala “*nikâĥ*” (martesë), në Sheriat, nënkupton martesën e plotë, me të gjitha kushtet e saj, përfshirë edhe marrëdhëniet intime mes bashkëshortëve. Ky është një gjykim të cilin nuk e kundërshton askush. Pra, është kusht që gruaja të lidhet në martesë me një burrë tjetër, me një akt të rregullt procedurial, pas të cilit duhet të kryhen marrëdhënie intime mes bashkëshortëve.

Së dyti, martesa e gruas me një burrë tjetër duhet të jetë me dëshirë dhe jo me qëllimin që ajo të mund të kthehet te burri i parë. Nëse martesa e dytë kryhet formalisht, sa për të bërë të mundur rikthimin te burri i parë, atëherë ajo është e pavlefshme dhe e paligjshme si martesë. Por nëse kjo martesë bëhet me dëshirë dhe mes çiftit kryhen marrëdhënie seksuale, dhe pastaj divorcohen, vetëm atëherë i lejohet gruas që të rikthehet tek burri i parë, nëse e ndan burri i dytë.

Duhet ditur që, nëse kjo grua është skllave dhe bën marrëdhënie me zotërinë e saj, kjo nuk e bën të lejuar rikthimin e saj te burri i parë, sepse zotëria i saj nuk konsiderohet si bashkëshorti i saj. Më pas, i Lartësuari thotë:

- “E nëse ky i fundit *(burri i dytë)* e divorcon atë, atëherë nuk ka pengesë për ata dy *(gruaja me burrin e parë)* të ribashkohen...” - Pas prishjes së martesës së dytë, me kushtet e sipërpërmendura, nuk është e ndaluar që gruaja të rimartohet me burrin e parë, duke bërë një akt martesor të ri, sipas kushteve të vendosura mes tyre.

Në këtë martesë, është kusht pranimi i të dyja palëve dhe ata duhet të mendohen mirë që të plotësojnë detyrimet dhe përgjegjësitë ndaj njëri tjetrit, siç thotë Allahu i Lartësuar:

- “...nëse vërtet mendojnë se do t’i zbatojnë dispozitat e Allahut.” – Pra, nëse mendojnë se do t'i plotësojnë detyrimet dhe përgjegjësitë ndaj njëri-tjetrit, mund të kthehen përsëri në një martesë të rregullt. Në këtë martesë, ata duhet të pendohen dhe të largohen nga çdo lloj fjale a veprimi që çoi në ndarjen e tyre të parë.

Nga vështrimi i ajetit anasjelltas kuptojmë se, nëse ata nuk mendojnë se do të rregullohet gjë në marrëdhëniet e tyre dhe se, përsëri do të shkelin detyrimet dhe përgjegjësitë mes njëri-tjetrit, atëherë ata marrin gjynah nëse i kthehen përsëri martesës, sepse nuk lejohet t’i hysh asnjë veprimi, me të cilin nuk ruhen kufijtë e Allahut dhe nuk zbatohen dispozitat e Tij.


Ky ajet tregon se njeriu duhet të jetë i kujdesshëm në marrjen e përgjegjësive, të vogla apo të mëdha qofshin ato. Nëse ai sheh se mund t'i përballojë ato me sukses, atëherë le t'i hyjë punës. Por nëse sheh se nuk ka mundësi dhe forca t'i përballojë, atëherë duhet të frenohet dhe të mos i ndërmarrë ato veprime.

Pas sqarimit të këtyre dispozitave, Allahu i Lartësuar thotë:

- “Këto janë dispozitat e Allahut, të cilat Ai ua sqaron njerëzve që dinë.” - Këto janë dispozita të cilat Allahu i ka sqaruar, por jo të gjithë njerëzit përfitojnë prej tyre. Vetëm të diturit janë ata që përfitojnë prej këtyre dispozitave, e madje u mundësojnë edhe të tjerëve që të përfitojnë.

Ky ajet tregon vlerën dhe gradën e lartë të dijetarëve. Allahu i Lartësuar e ka bërë sqarimin e dispozitave që të përfitojnë veçanërisht dijetarët. Këta ka zgjedhur Allahu i Lartësuar për t'u bërë mirësi dhe dobi.

Nga ky ajet kuptojmë, gjithashtu, se Allahu i Lartësuar dëshiron që adhuruesit e Tij të përpiqen dhe të thellohen për të kuptuar dispozitat e Tij, të cilat Ai ia shpalli profetit Muhamed (a.s.), si udhëzim për njerëzimin.



Ajeti 231

231. E kur t'i keni ndarë gratë dhe ato t'i jenë afruar mbarimit të kohës së pritjes, atëherë ose i ktheni si duhet, ose i lëshoni si duhet. Mos i ktheni ato sa për t'i dëmtuar, dhe kështu të tejkaloni kufijtë. E kush e bën këtë, pa dyshim që ka dëmtuar veten e vet. Dispozitat e Allahut mos i merrni për shaka! Përkujtoni të mirat e Allahut ndaj jush, *(përkujtoni)* edhe atë që ju shpalli *(Kur'ânin)* dhe Urtësinë, me të cilat ju udhëzon! Ruajuni prej Allahut e dijeni se Allahu është i Dijshëm për gjithçka.

Shpjegimi i ajetit

- "E kur t'i keni ndarë gratë dhe ato t'i jenë afruar mbarimit të kohës së pritjes, atëherë ose i ktheni si duhet, ose i lëshoni si duhet." – Pra, pasi t'i keni ndarë gratë dhe kur ato të jenë në prag të mbarimit të kohëpritjes, atëherë keni dy mundësi: ose t'i ktheni përsëri, duke synuar një jetë bashkëshortore normale, ku çdokush të plotësojë të drejtat e tjetrit dhe përgjegjësitë e veta, ose t'i lini ato të lira. Mos i ktheni ato përsëri, duke synuar dëmtimin dhe vuajtjen e tyre.

I Lartësuari e përforcon edhe më shumë këtë ndalesë të fundit, kur thotë.

- "Mos i ktheni ato sa për t'i dëmtuar, dhe kështu të tejkaloni kufijtë." – Pra, me rikthimin e grave, mos synoni dëmtimin dhe vuajtjen e tyre.

Një veprim të tillë, Allahu i Lartësuar e ka quajtur tejkalim kufijsh dhe ai që vepron kështu ka shkelur kufijtë e Zotit, duke lënë hallallin dhe duke u lidhur me haramin. Në këtë rast, hallalli është kthimi i gruas duke patur qëllim të mirë, ndërsa harami është kthimi i gruas duke synuar dëmtimin e saj.

Allahu i Lartësuar e përforcon edhe një herë këtë ndalesë, duke thënë:

- "E kush e bën këtë, pa dyshim që ka dëmtuar veten e vet." - Ai e ka dëmtuar vetveten, sepse çdo padrejtësi ndaj krijesave sjell patjetër dëmtim të vetes.

Pastaj thotë i Lartësuari:

- "Dispozitat e Allahut mos i merrni për shaka!" - Allahu i Lartësuar i ka sqaruar mirë kufijtë e Tij, nëpërmjet dijes së saktë dhe punës me të. Këta kufij qartësohen që robi të qëndrojë brenda tyre dhe të mos guxojë që t'u afrohet apo t'i shkelë ata.

Allahu i Urtë dhe i Lartësuar nuk i ka përcaktuar dispozitat e Tij pa ndonjë qëllim, por për të dhënë të vërtetën e sigurt dhe të drejtën, duke u kushtuar atyre një rëndësi shumë të madhe. Për këtë arsye, i Madhërishmi na ndalon nga tallja dhe mospërfillja e dispozitave të Tij. Askush nuk mund të luajë dhe të tallet me dispozitat e Tij.

Tallje me dispozitat e Zotit do të thotë të guxosh t'i shkelësh ato dhe të mos zbatosh detyrimet e përcaktuara nga Ai. Në rastin tonë, tallje me dispozitat e Zotit është kur

burri synon me bashkimin apo ndarjen nga gruaja thjesht dëmtimin e saj. I tillë është edhe përshpejtimi i ndarjes, duke e divorcuar gruan përfundimisht me një herë të vetme (pra, t'i thuash gruas: "Je e divorcuar tri herë, dhe s'ka kthim") etj. Të gjitha këto janë vepra të nxituara, që tregojnë njëfarë mosvlerësimi të kufijve të vendosur nga Zoti, të cilët duan kujdes maksimal, sepse mund të bësh padrejtësi. Me çdo dispozitë të vendosur, Allahu i Lartësuar synon për robërit e Tij lehtësimin dhe mirësinë e tyre, por ato duhen trajtuar ashtu si u takon.

- "Përkujtoni të mirat e Allahut ndaj jush...." – Pra, përkujtoni çdo mirësi që Allahu jua ka dhuruar.

Përkujtimi i Zotit bëhet në tri mënyra:

- Së pari, duke e lavdëruar dhe duke i shprehur Atij mirënjohjen me fjalë e lavde.

- Së dyti, me zemër, duke i njohur dhe duke e pranuar se mirësitë janë dhuratë e Tij.

- Së treti, me trup e gjymtyrë, duke i vënë ato në përdorim për të treguar bindjen e plotë ndaj Allahut.

- "...edhe atë që ju shpalli, Librin dhe Urtësinë, me të cilat ju udhëzon!" – Pra, përkujtoni në mënyrë të veçantë mirësinë më të madhe të Tij ndaj jush: Kur'ânin dhe Urtësinë, domethënë, Sunetin e Profetit (s.a.u.s.). Nëpërmjet këtyre dy burimeve, Ai sqaroi të gjitha rrugët e mirësisë dhe ju nxiti fort për t'i ndjekur ato. Në to, Ai ka treguar edhe rrugët e humbjes, me qëllim që ju të ruheni dhe të largoheni prej tyre. Allahu prezantoi Veten e Tij nëpërmjet Kur'ânit dhe Sunetit, ju mësoi se si duhet të veproni me të dashurit e Tij dhe si të veproni me armiqtë e Tij. Nëpërmjet tyre, Ai ju mësoi juve çdo gjë që ju nuk e dinit.

Disa janë të mendimit se fjala '*el Ĥikme*' (Urtësia), në ajet, nënkupton përsiatjen në të fshehtat dhe urtësitë e Sheriatit. Sipas këtij mendimi, *el kitâb* (Libri) është Kur'âni, por dhe Suneti, që sqaron dispozitat e Zotit. Ndërsa *el Ĥikme* (Urtësia) nënkupton zbulimin e urtësive që fshihen pas këtyre dispozitave.

Në fakt, që të dyja shpjegimet janë të sakta dhe plotësojnë njëra tjetrën. Allahu i Lartësuar, kur tregon shkakun e zbritjes së këtyre dy formave të Shpalljes, thotë: "...me të cilat ju udhëzon!" Pra, nëpërmjet Shpalljes, Ai ju qorton dhe ju tërheq vëmendjen, që të udhëzoheni. Kjo e përforcon edhe më shumë mendimin se "*el Ĥikme*" nënkupton njohjen e fshehtësive dhe urtësive të dispozitave të Sheriatit, të cilat u shpallën në *el kitâb* (Kur'ân dhe Sunet), sepse fjala "*jeiđhukum*" (ju udhëzon, ju këshillon) vjen nga "*meuiđhatun*" (udhëzim, këshillë). Por udhëzimi kuptohet veçse si qartësim i dispozitave, i urtësive dhe i hollësive të tyre, si dhe i mënyrave nxitëse për të vepruar apo për mos vepruar. Njohja e ligjeve të Zotit, që gjenden në *el kitab* (Kur'ân dhe Sunet), largon injorancën.

Por që njeriu të sqarohet dhe të pasojë vërtet udhëzimin, nevojitet edhe ajo që quhet '*el Ĥikme*', pra, qartësimi me hollësi i urtësive të dispozitave të Zotit dhe nxitja për t'i zbatuar ato rigorozisht. Vetëm në këtë mënyrë mund të shpresojë njeriu shpërblimin dhe mund t'i frikësohet ndëshkimit.

Përfundimisht, që të dyja janë të nevojshme: edhe *el kitâb*-i, edhe *el Ĥikme*-ja. Që të dyja janë dhurata të Allahut të Lartësuar, prandaj Ai e meriton përkujtimin, lavdinë dhe mirënjohjen e plotë për çdo mirësi të dhuruar.

Më pas, i Madhëruari jep një porosi tepër të madhe:

- "Ruajuni prej Allahut e dijeni se Allahu është i Dijshëm për gjithçka." – Kuptimi: Ruajuni ndëshkimit dhe zemërimit të Tij, duke ruajtur kufijtë e vendosur nga Ai, të cilët duhen vlerësuar dhe zbatuar rigorozisht. Ai di gjithçka që ju bëni. Me dijen e Tij, Ai solli këto ligje e dispozita nga

më të mirat, për t'ju siguruar juve çdo mirësi, për çdo kohë dhe çdo vend. Madje, mirësia dhe udhëzimi juaj i drejtë nuk mund të gjenden askund tjetër, përveçse në Kur'ân dhe Sunet. Allahu qoftë i lavdëruar për mirësitë që u ka falur adhuruesve të Tij!

Ajeti 232

232. Kur t'i keni ndarë gratë dhe ato të kenë përmbushur afatin e tyre të pritjes, mos i pengoni që të rimartohen me burrat e tyre, nëse ka pëlqim mes çiftit, ashtu si kërkojnë rregullat, nga të cilat përfitojnë vetëm ata që e besojnë Allahun dhe botën tjetër. Kjo është më e dobishme dhe më e pastër për ju. Allahu e di, e ju nuk e dini.

Shpjegimi i ajetit

- "Kur t'i keni ndarë gratë dhe ato të kenë përmbushur afatin e tyre të pritjes, mos i pengoni që të rimartohen me burrat e tyre, nëse ka pëlqim mes çiftit, ashtu si e kërkojnë rregullat..." – Ky ajet u drejtohet kujdestarëve ligjorë të grave të divorcuara. Allahu i Lartësuar nuk i lejon ata që, pas mbarimit të kohëpritjes, ta ndalojnë gruan të martohet përsëri me burrin nga i cili është ndarë, nëse bien dakord mes tyre.

Pas ndarjes, babai apo vëllai i gruas, nga zemërimi, mund të duan që ta pengojnë vajzën të rimartohet me të njëjtin burrë. Por Allahu i Lartësuar i ndalon ata nga një veprim i tillë, nëse burri dhe gruaja bien dakord që të rimartohen. Madje kjo lloj ndalese është shumë e fortë, sepse Allahu i Lartësuar thotë:

- "...nga të cilat përfitojnë vetëm ata që e besojnë Allahun dhe botën tjetër." – Pra, kush beson Allahun dhe Ditën e Llogarisë nuk e pengon femrën që të rimartohet me ish-burrin e saj, nëse ata të dy bien dakord për rikthimin e normalitetit. Madje kjo është më e pastër dhe më e mirë për ata, siç thotë Allahu i Lartësuar:

- "Kjo është më e dobishme dhe më e pastër për ju." - Kjo është më e mirë dhe më e drejtë për ju.

Pra, kujdestari i vajzës të mos mendojë aspak se ndalimi i rimartesës së saj me bashkëshortin e dikurshëm është veprim i drejtë dhe i mirë. Madje, të tilla qëndrime vijnë shpeshherë nga fodullëku i njerëzve, por Allahu i Lartësuar dëshiron të mirën dhe lehtësimin e adhuruesve të Tij.

- "Allahu e di, e ju nuk e dini." - Askush të mos mendojë se moslejimi është më i drejtë, sepse Allahu, i Cili e ka lejuar rimartesën e gruas me ish-burrin e saj, është më i ditur rreth mirësive dhe drejtësisë, ndërsa ne jemi të paditur. Kush e di më mirë se cila është më e drejta dhe më e dobishmja për ne? Kush është ai që më së tepërmi i dëshiron ato për ne? Kush është i plotfuqishëm për të na i dhuruar dhe për të na i ruajtur ato? Vetëm Allahu mund t'i bëjë të gjitha këto për ne, me mënyra që ne i njohim ose jo.

Ky ajet është argument për domosdoshmërinë e lejes së kujdestarit të vajzës për saktësinë e martesës. Pra, leja e kujdestarit të vajzës është e domosdoshme, që martesa të jetë e saktë dhe e ligjshme. Si kuptohet kjo nga ajeti? Kjo kuptohet nga fakti që Allahu i Lartësuar i ka ndaluar kujdestarët e vajzës nga pengimi i rimartesës së saj me ish-burrin, dhe ndalesa mund të ishte veçse për diçka që është në kompetencën e tyre. Thënë ndryshe, nëse leja e tyre për martesën e vajzës nuk do të ishte e rëndësishme në martesë, atëherë nuk kishte pse të ndaloheshin nga kjo gjë. Allahu i Lartësuar i ndalon ata të pengojnë vajzën që të martohet, sepse leja e tyre është kusht për saktësinë e martesës.

Ajeti 233

233. Nënat le t'u japin gji foshnjave të tyre dy vite të plota, për ato që duan ta plotësojnë gjidhënien. I ati i fëmijës ka përgjegjësi për furnizimin dhe veshmbathjen e tyre, ashtu si është zakoni.

Askush nuk ngarkohet më tepër sesa ka mundësi. Nëna të mos dëmtohet me fëmijën e saj, e as babai me fëmijën e tij. Edhe trashëgimtari ka të njëjta përgjegjësi. E nëse pas një konsultimi dhe pëlqimi, ata vendosin për ndërprerjen e gjidhënies, kjo nuk përbën ndonjë gjynah për ta. Nëse ju dëshironi gjidhënëse tjetër për fëmijën tuaj, kjo nuk përbën ndonjë gjynah për ju, me kusht që pagesën t'ia bëni në mënyrë të duhur. Ruajuni prej Allahut dhe dijeni se Allahu ju sheh se çka bëni.

Shpjegimi i ajetit

- "Nënat le t'u japin gji foshnjave të tyre dy vite të plota, për ato që duan ta plotësojnë gjidhënien." - Allahu e ka konsideruar këtë normë si diçka të njohur dhe të padiskutueshme ndër njerëz. Pra, ishte e panevojshme që t'i urdhëroje njerëzit për një çështje të tillë.

Fjala "vit", që është përdorur në ajet, mund të përdoret për treguar një vit të plotë, por ajo mund të tregojë edhe një periudhë më të gjatë, prandaj Allahu i Lartësuar e ka përcaktuar qartë, duke thënë: "dy vite të plota."

Pasi fëmija të mbushë dy vjet, gjidhënia e tij është plotësuar. Pas plotësimit të dy vjetëve, qumështi i gjirit konsiderohet për të si çdo ushqim tjetër. Për këtë arsye, pas plotësimit të dy viteve, gjidhënia nuk është më faktor në asnjë çështje ligjore. Me fjalë të tjera, gjidhënia që të bën vëlla, motër, bir apo bijë prej qumështi, është ajo që kryhet brenda dy viteve të para të foshnjës.

Në Kur'ân gjendet edhe një ajet tjetër që flet për çështjen e gjidhënies, i cili thotë: "...barra dhe gjidhënia zgjasin 30 muaj." Pra, duke qenë se gjidhënia e plotë zgjat dy vjet, ose 24 muaj, atëherë del që koha më e shkurtër e shtatzënisë (që merret parasysh nga Sheriati) është 6 muaj. Pra, gruaja mund të lindë një fëmijë edhe për gjashtë muaj.

- "I ati i fëmijës ka përgjegjësi për furnizimin dhe veshmbathjen e tyre, ashtu si është zakoni." - Burri e ka detyrë përkujdesjen për ushqimin dhe veshjen e nënës së fëmijës, pavarësisht në janë të ndarë apo jo. Ky kujdes për të është si kompensim për gjidhënien e saj.


Ky ajet tregon që, edhe nëse gruaja vazhdon të jetojë me burrin e saj, ajo nuk ka të drejtë të kërkojë për gjidhënien më shumë se aq sa e ka përcaktuar Allahu në këtë ajet. Asaj i takon aq sa është normale dhe e zakonshme për atë vend dhe popull ku jeton, pa rënë ndesh me Sheriatin.

Çdokush detyrohet sipas mundësisë së tij, siç thotë i Madhëruari:

- "Askush nuk ngarkohet më tepër sesa ka mundësi." – Kështu, i varfëri nuk ngarkohet me shpenzimet e një të pasuri. Madje, ai që nuk ka asgjë, nuk ngarkohet me shpenzime, derisa të ketë mundësi t'i përballojë ato.

- "Nëna të mos dëmtohet me fëmijën e saj, e as babai me fëmijën e tij." - Nuk lejohet që të lëndohet nëna me fëmijën e saj, për shembull, duke mos e lejuar atë që t'i japë gji fëmijës, ose që t'i japë përkujdesjen e nevojshme. Por edhe babai nuk duhet që të dëmtohet me këtë fëmijë, për shembull, kur nëna nuk pranon t'i japë gji fëmijës së tij, ose kërkon prej tij shpenzime dhe përkujdesje më të mëdha sesa është e nevojshme. Nga ajeti kuptohet (pikërisht nga pjesa: "*ue alel meulūdi lehû*"), gjithashtu, se fëmija i takon babait të tij. Ai është dhuratë e Zotit për të, është një pjesë e tij, që ka dalë në jetë. Për këtë arsye, babait i lejohet të marrë prej pasurisë së fëmijës së tij, pranon apo jo ky fëmijë, ndërsa nënës nuk i lejohet një gjë e tillë.

- "Edhe trashëgimtari ka të njëjta përgjegjësi." - Nëse fëmija nuk e ka babain dhe nuk ka pasuri që të përballojë shpenzimet e gjidhënies, atëherë është detyrë e trashëgimtarëve të fëmijës që të përballojnë shpenzimet e gjidhënëses. Kjo tregon, gjithashtu, se është detyrë e të



afërmve të pasur që të ndihmojnë të afërmit në nevojë.

- "E nëse pas një konsultimi dhe pëlqimi, ata vendosin për ndërprerjen e gjidhënies, kjo nuk përbën ndonjë gjynah për ta." – Pra, nëse dy prindërit vendosin me mirëkuptim që t'ia ndalojnë gjidhënien fëmijës para plotësimit të dy vjetëve, kjo është e lejueshme, por me dy kushte: së pari, me pëlqimin e të dyve dhe, së dyti, pas konsultimit të çështjes: a e dëmton kjo fëmijën, apo jo. Nëse fëmija nuk dëmtohet dhe ata janë dakord, atëherë ndërprerja e gjidhënies para plotësimit të dy vjetëve është e lejueshme.

I parë ndryshe, ajeti na jep të kuptojmë se, nëse thyhet njëri kusht i lartpërmendur, nuk lejohet ndërprerja e gjidhënies. Pra, nëse njëri prind nuk është dakord, ose kur ndërprerja është e dëmshme për fëmijën, atëherë ajo është e ndaluar.

- "Nëse ju dëshironi gjidhënëse tjetër për fëmijën tuaj, kjo nuk përbën ndonjë gjynah për ju, me kusht që pagesën t'ia bëni në mënyrë të duhur." – Pra, nëse dëshironi të gjeni gjidhënëse tjetër për fëmijën tuaj, përveç nënës, edhe kjo është e lejueshme, por me kusht që të mos synohet dëmtimi i nënës. Po ashtu, gjidhënëses duhet t'i jepet shpërblimi i plotë dhe në kohë, sipas rregullit.

- "Ruajuni prej Allahut dhe dijeni se Allahu ju sheh se çka bëni." - Për çdo vepër që bëni, Allahu do t'ju shpërblejë me të mira ose me të këqija, sipas meritave.

Ajeti 234

234. Kur ata *(burrat)* vdesin dhe lënë gra pas, ato *(gratë)* duhet të presin katër muaj e dhjetë ditë. Kur ato e plotësojnë afatin e tyre të pritjes, nuk është më përgjegjësia juaj *(e kujdestarëve ligjorë të gruas)* se çfarë bëjnë ato me veten e tyre, në mënyrë të njerëzishme. Allahu e di hollësisht se çka bëni.

Shpjegimi i ajetit

- "Kur ata *(burrat)* vdesin dhe lënë gra pas, ato *(gratë)* duhet të presin katër muaj e dhjetë ditë." - Pas vdekjes së burrit, gruaja e ka për detyrë të presë katër muaj e dhjetë ditë pa u martuar. Kjo periudhë lihet me qëllim që, gjatë saj, të qartësohet nëse gruaja ka mbetur shtatzënë apo jo. Dihet se, në hyrje të muajit të pestë, foshnja nis të lëvizë në bark.

Ky ajet duket se i përfshin të gjitha gratë. Pra, sipas tij, çdo grua së cilës i ka vdekur burri duhet të presë katër muaj e dhjetë ditë. Megjithatë, nga ky gjykim përjashtohen disa kategori grash, siç janë gratë shtatzëna, të cilat duhet presin derisa ato të lindin e të lirohen nga barra, dhe skllavet, të cilat presin sa gjysma e kohëpritjes së grave të lira, pra, dy muaj e pesë ditë.

- "Kur ato e plotësojnë afatin e tyre të pritjes, nuk është më përgjegjësia juaj *(e kujdestarëve ligjorë të gruas)* se çfarë bëjnë ato me veten e tyre, sipas rregullave normale." – Pra, pas mbarimit të kohës së pritjes, nuk është gjynah për ju nëse ato i kthehen jetës normale, zbukurimeve, makijazhit, parfumosjes etj. Megjithatë, kjo duhet të jetë, sikurse ka thënë Allahu i Lartësuar: sipas rregullave normale, e jo me teprime dhe me harame.

Ky ajet tregon se është e detyrueshme për gruan që të mbajë zi për burrin e saj të vdekur katër muaj e dhjetë ditë. Të gjithë janë të një mendimi për këtë çështje. Ky gjykim nuk vlen për gratë e divorcuara.

- "Allahu e di hollësisht se çka bëni." - Allahu e di hollësisht çdo vepër tuajën, e shfaqur qoftë apo e fshehtë, e madhe apo e vogël. Për çdo vepër që kryeni, Allahu i Lartësuar ka përgatitur shpërblimin e Tij, të bazuar në drejtësi dhe bamirësi.

Thënia e Allahut: "**nuk është më përgjegjësia juaj"**, tregon se kujdestari ligjor është përgjegjës për veprimet e gruas së cilës i ka vdekur burri. Ai duhet ta ndalojë atë, nëse ajo i kalon kufijtë. Ai ka të drejtën ta detyrojë atë, që të qëndrojë brenda rregullave. Kjo është detyrë për të ose, në të kundërt, ai ngarkohet me gjynahe për çdo gabim të saj të dukshëm.

Ajeti 235

235. Nuk është gjynah për ju, nëse, tërthorazi, u kërkoni dorën për martesë këtyre grave apo nëse e mbani të fshehtë këtë qëllim në veten tuaj. Allahu e di se ju do t'ua shprehni atyre *(dëshirën për martesë)*, por mos u premtoni fshehurazi, veç nëse u thoni fjalë të lejueshme. Mos lidhni martesë, derisa të përfundojë afati i pritjes së tyre. Ta dini se Allahu e di se çfarë fshihni në shpirtin tuaj, pra, kini kujdes prej Tij! Dhe dijeni se Allahu është Falës dhe i Butë.

Shpjegimi i ajetit

- "Nuk është gjynah për ju, nëse, tërthorazi, u kërkoni dorën për martesë këtyre grave apo nëse e mbani të fshehtë këtë qëllim në veten tuaj. Allahu e di se ju do t'ua shprehni atyre *(dëshirën për martesë)*..." - Në këtë ajet, Allahu i Lartësuar sjell një gjykim për gratë të cilave u kanë vdekur burrat dhe që janë në kohëpritjen e tyre. Ky gjykim vlen edhe për gratë e divorcuara për herë të tretë, që janë në kohëpritje. Pra, nuk i lejohet asnjë burri që t'u shfaqë këtyre dy kategorive të grave propozimin për martesë në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Më tej, i Lartësuari thotë:

- "...por mos u premtoni fshehurazi..." – Pra, nuk lejohet që grave të këtyre dy kategorive t'u shprehet hapur propozimi për martesë, gjatë kohës së pritjes së tyre, por hedhja e propozimit në mënyrë indirekte është e tolerueshme nga Allahu i Lartësuar, sikurse kuptohet nga ajeti.

Mes dy rasteve ka ndryshim. Nëse dikush i propozon hapur për martesë një gruaje të tillë, kjo sjell shumë probleme. Për shembull, kjo mund ta shtyjë gruan që ta përshpejtojë qëllimisht përfundimin e kohëpritjes së saj, duke gënjyer se i kanë mbaruar të trija ciklet e periodave të saj, e kështu të martohet me tjetrin. Kjo, sigurisht, që është një padrejtësi e madhe në shumë aspekte. Së pari, në këtë mënyrë, gruaja shkel të drejtën e burrit të saj të parë, duke mos plotësuar kohën e pritjes për të. Së dyti, ajo bashkohet me dikë tjetër para kohës kur i lejohet një gjë e tillë, prandaj kjo martesë e dytë quhet e parregullt dhe e paligjshme. Përveç këtyre që përmendëm, ka edhe shumë pasoja të tjera.

Ky ajet dëshmon për rëndësinë që i jep Sheriati ndalimit të së keqes dhe rrugëve të saj. Në Islam është e ndaluar jo vetëm e keqja, por edhe rrugët e mjetet që të çojnë tek ajo. Një rregull i madh i Islamit thotë: Çdo mjet dhe rrugë që të çon në haram është haram.

Ky ajet, gjithashtu, tregon për rëndësinë e madhe që Sheriati u kushton të drejtave dhe përgjegjësive bashkëshortore në Islam.

Fjalët e tërthorta, që e nënkuptojnë propozimin, nuk janë të ndaluara, sepse ato mund të kuptojnë edhe gjëra të tjera, përveç martesës:

- "...veç nëse u thoni fjalë të lejueshme..." – Fjalë të tilla janë, për shembull: "Unë do të doja të martohesha këto kohë", ose: "Kur të mbarosh pritjen, do të doja të flisnim bashkë për diçka", etj.

Allahu i Lartësuar e ka lejuar propozimin e tërthortë, sepse ai nuk sjell dëmet që shkakton propozimi i drejtpërdrejtë. Ndërhyrjet jo të drejtpërdrejta janë lejuar, sepse shpirti i njeriut i kërkon me ngut të tilla çështje. Për këtë arsye, Allahu i Lartësuar ka lënë një lloj hapësire, që njerëzit të përmbushin kërkesat e tyre të forta në këtë aspekt. Ai na tregon se nuk kemi gjynah për dy gjëra: "...nëse, tërthorazi, u kërkoni dorën për martesë këtyre grave apo nëse e mbani të fshehtë këtë qëllim në veten tuaj".

- Allahu e di se ju do t'ua shprehni atyre (*dëshirën për martesë*), - Allahu i Lartësuar e di shumë mirë çdo dëshirë të njerëzve për t'u lidhur në martesë, por – sikurse u tha më lart – nuk lejohet propozimi i qartë dhe i drejtpërdrejtë për martesë ndaj grave që janë në pritje.

Në fakt, ato që lejohen janë vetëm fjalët e tërthorta, brenda normave të Sheriatit. Ndërsa për sa i përket nënshkrimit të aktit të martesës, ai nuk lejohet absolutisht, para se të përfundojë koha e pritjes, siç thotë i Lartësuari:

- "Mos lidhni martesë, derisa të përfundojë afati i pritjes së tyre." – Pra, nuk lejohet në asnjë mënyrë lidhja e martesës së re para mbarimit të kohës së pritjes.

- "Ta dini se Allahu e di se çfarë fshihni në shpirtin tuaj, pra, kini kujdes prej Tij!" - Jini të kujdesshëm në çdo gjë që doni të bëni. Synoni të mirën dhe largojuni qëllimeve të këqija. Këtë ta bëni duke shpresuar shpërblimin e Zotit dhe duke iu frikësuar ndëshkimit të Tij.

- "Dhe dijeni se Allahu është Falës dhe i Butë." - Allahu është Falës i madh (*Gafûrun*) i çdokujt që bën të tilla gabime, por që kthehet i penduar dhe i kërkon falje Zotit të tij. Ai është i Butë (*Halîm*), që nuk nxitohet të ndëshkojë të pabindurit dhe gjynahqarët për të këqijat e tyre, edhe pse është i Plotfuqishëm për t'i ndëshkuar ata.

Ajeti 236

236. Nuk është gjynah për ju nëse i divorconi gratë me të cilat ende nuk keni kryer marrëdhënie dhe të cilave ende nuk ua keni përcaktuar e dhënë mehrin. Jepuni dhe përkujdesuni për to: pasaniku sipas mundësive të tij, dhe i varfëri sipas mundësive së tij. Përkujdesja dhe furnizimi i tyre sipas zakonit është detyrë për bamirësit.

Shpjegimi i ajetit

- "Nuk është gjynah për ju nëse i divorconi gratë me të cilat ende nuk keni kryer marrëdhënie dhe të cilave ende nuk ua keni përcaktuar e dhënë mehrin." - Nuk është gjynah për ju nëse i ndani gratë tuaja para se të keni kryer marrëdhënie seksuale me to dhe para se t'u keni përcaktuar mehrin. Kjo është e lejuar për ju, edhe pse i lëndon disi gratë nga gjendja shpirtërore.

Por për të zbutur këtë lëndim, Allahu i Lartësuar i urdhëron burrat që t'i nderojnë këto gra, duke u falur diçka prej pasurisë së tyre. Thotë i Lartësuari:

- "Jepuni dhe përkujdesuni për to: pasaniku sipas mundësive të tij, dhe i varfëri sipas mundësive së tij." - Jepuni atyre diçka prej pasurisë, si zbutje të ndonjë lëndimi që mund t'u keni shkaktuar atyre.

Çdokush le të japë sipas mundësisë dhe sipas zakonit të atij vendi e atij populli, siç thotë i Lartësuari:

- "Përkujdesja dhe furnizimi i tyre sipas zakoneve është detyrë për bamirësit." – Domethënë, me një furnizim sipas zakonit e traditës së njohur nga njerëzit. Ky veprim është një detyrë për bamirësit, të cilët nuk duhet të hezitojnë kurrë për plotësimin e kësaj dispozite.

Burri është ai që i kërkon gruas në fillim ta lidhë zemrën me të dhe që bëhet shkak që ajo ta dojë burrin e saj. Për këtë arsye, tani që ai bëhet shkak për ta ndërprerë këtë dashuri, po ashtu duhet që ta lehtësojë lëndimin e zemrës së saj, duke i dhuruar diçka nga pasuria e vet.

Subhanallah! Sa madhështore është kjo dispozitë hyjnore! Ajo është vërtet një tregues i qartë i mëshirës së Atij që e përcaktoi atë! E ku ka ligjvënës më të mirë se Allahu, për ata njerëz që kanë siguri në premtimin e Tij!

Ky qe rregulli që lidhej me gratë e divorcuara para përcaktimit të mehrit të tyre dhe para kontaktit seksual me to. Më pas, Allahu i Lartësuar sjell dispozitën rreth atyre grave të divorcuara, me të cilat nuk është kontaktuar seksualisht, por që u është përcaktuar mehri. Kështu, i Lartësuari thotë:

Ajeti 237

237. E nëse i divorconi para se të kryeni marrëdhënie intime me to, por ndërkohë ua keni përcaktuar atyre masën e dhuratës martesore *(mehrit)*, atëherë është detyrë për ju që t'u jepni gjysmën e asaj që keni caktuar, veç nëse ato jua falin ose veç nëse atyre ua falin ata që kanë në dorë lidhjen e martesës. Tolerimi është më afër devotshmërisë. Mos e harroni bamirësinë ndërmjet jush! Vërtet, Allahu e sheh me imtësi atë që veproni.

Shpjegimi i ajetit

- "E nëse i divorconi para se të kryeni marrëdhënie intime me to, por ndërkohë ua keni përcaktuar atyre masën e dhuratës martesore *(mehrit)*, atëherë është detyrë për ju që t'u jepni gjysmën e asaj që keni caktuar..." – Pra, gratë që divorcohen para kryerjes së kontaktit seksual dhe pasi u është përcaktuar masa e mehrit, meritojnë që t'u jepet gjysma e mehrit të përcaktuar, ndërsa gjysma tjetër i takon burrit. Ky është rregulli bazë në këtë çështje, i cili është i detyrueshëm të zbatohet, nëse nuk ka tolerime nga asnjëra palë.

Por në rast se ka falje dhe tolerancë të ndërsjelltë, atëherë Allahu i Lartësuar ka lënë hapësirën për bamirësi, duke thënë:

- "...veç nëse ato jua falin ose veç nëse atyre ua falin ata që kanë në dorë lidhjen e martesës" – Pra, nga ky detyrim nuk shpëton askush, përveç dy rasteve:


1. Kur gruaja e divorcuar toleron dhe pranon që t'ia kthejë ish-burrit të saj gjysmën e mehrit të përcaktuar për të, duke ia dhuruar atij të plotë.

2. Kur burri toleron dhe ia lë të plotë mehrin ish-gruas së tij, duke i falur edhe gjysmën e vet, që i takon me ligj.

Pra, pjesa: "...veç nëse ato jua falin" nënkupton gratë, ndërsa: "ata që kanë në dorë lidhjen e martesës" bën fjalë për burrat, sepse ata e kanë në dorë çështjen e martesës.

Disa janë të mendimit se rasti i dytë i përjashtimit nga dispozita për përgjysmimin e mehrit flet për kujdestarin e vajzës, kur ai toleron dhe ia fal ish-bashkëshortit të saj të gjithë mehrin. Por ky mendim është i dobët, sepse kujdestari i vajzës nuk ka kompetenca të tolerojë për një të drejtë që nuk i takon atij. Ai nuk është pronar i mehrit dhe as kujdestar i tij. Gjysma e mehrit është pronë e vajzës dhe jo e kujdestarit të saj. Kështu që mendimi më i saktë rreth kësaj pjese të ajetit është se ajo bën fjalë për ish-bashkëshortin e gruas.

- "Tolerimi është më afër devotshmërisë. Mos e harroni bamirësinë ndërmjet jush!"



– Kështu, Allahu i Lartësuar i nxit adhuruesit për të qenë falës, tolerues dhe bamirës me njëri-tjetrin, duke na treguar se këto virtyte janë më pranë devotshmërisë. Në fakt, toleranca, bamirësia dhe falja janë shenja të devotshmërisë së njeriut. Ai i nxit adhuruesit për të tilla veprime, sepse ato janë bamirësi, dhe çdo bamirësi të zgjeron gjoksin dhe të qetëson zemrën.

Njeriu nuk duhet të lërë pas dore veprat e mira dhe humanizmin. Ai nuk duhet të shpërfillë sjelljen e mirë në marrëdhëniet shoqërore. Allahu i Lartësuar na kujton të jemi bamirës në këto marrëdhënie, sepse kjo është grada më e lartë e etikës shoqërore.

Në plotësimin e të drejtave dhe përgjegjësive ndaj njëri-tjetrit, njerëzit ndahen në dy grada:

1. Ata që qëndrojnë striktë në respektimin e të drejtave dhe përgjegjësive ndaj njëri-tjetrit, pa bërë asnjë lëshim tjetër. Ky qëndrim është, gjithsesi, korrekt dhe i paqortueshëm.

2. Ata që tolerojnë, që falin dhe që tregohen bujarë ndaj tjetrit. Ata falin kur është fjala për plotësimin e disa detyrimeve të palës tjetër ndaj tyre. Ata japin edhe kur nuk e kanë të detyrueshme që të japin. Ata heqin dorë nga disa të drejta vetjake, për hir të mirësjelljes. Kjo është një gradë shumë e lartë, që njeriu nuk duhet ta shpërfillë, qoftë edhe në disa raste të caktuara, sidomos kur bëhet fjalë për marrëdhëniet me njerëzit që ai haset e përzihet më shpesh.

Allahu i Lartësuar do t'i shpërblejë bamirësit për sjelljen e tyre, me bujarinë e Tij të madhe:

- **"Vërtet, Allahu e sheh me imtësi atë që veproni."** – Pra, ai sheh çdo vepër tuajën dhe do t'iu shpërblejë me bujarinë dhe mirësinë e Tij.

Ajetet 238 – 239

238. Vazhdoni rregullisht namazet, sidomos namazin e mesëm, dhe kini frikë Allahun.
239. Kur jeni në gjendje frike, faluni duke ecur ose duke qenë hipur. Por kur ndiheni të sigurt, përkujtojeni Allahun ashtu si ju mësoi Ai ato që ju nuk i dinit.

Shpjegimi i ajeteve

- **"Vazhdoni rregullisht namazet, sidomos namazin e mesëm"** - Allahu i Lartësuar na urdhëron që të jemi të rregullt në kryerjen e namazeve, dhe në mënyrë të veçantë për "namazin e mesëm", i cili është namazi i ikindisë.

Që të jemi të rregullt në kryerjen e namazeve, do të thotë që t'i falim ato në kohën e tyre të përcaktuar nga Zoti, t'i realizojmë të gjitha shtyllat, kushtet, vaxhibet dhe synetet e tyre, si edhe t'i falim ato me përkushtim e përqendrim maksimal.

Allahu i Lartësuar na udhëzon që të jemi të rregullt me namazet, sepse vetëm në këtë mënyrë do të jemi të rregullt edhe me adhurimet e tjera, madje do të jemi të ruajtur edhe nga kryerja e gjynaheve. Këto kanë

vlerë sidomos kur shoqërohen me frikë dhe nënshtrim ndaj Allahut:

- "...dhe kini frikë Allahun" – Pra, Allahu i Lartësuar na urdhëron që këto adhurime t'i kryejmë duke qenë të druajtur ndaj Tij.

Ky ajet na urdhëron që të falemi duke qëndruar në këmbë me frikë dhe madhërim për Zotin, dhe na ndalon që të themi gjatë namazit fjalë që nuk i përkasin atij. Ky është namazi që duhet të falim për Zotin tonë, kur jemi të qetë, në kushte normale. Ndërsa në kushte të jashtëzakonshme lufte, frike dhe pasigurie ka rregulla të tjera. I Lartësuari thotë: **- "Kur jeni në gjendje frike, faluni duke ecur ose duke qenë hipur." -** Allahu i Lartësuar ka thënë: "Kur jeni në gjendje frike...", dhe nuk i ka përmendur rastet se kur mund të frikësohet njeriu. Kjo bëhet për të përfshirë çdo lloj frike në këtë gjykim, për frikën nga kriminelët, qafirët, egërsirat etj. Pra, nëse për shkak të frikës, nuk mund ta falim namazin në formën e përshkruar më lart, atëherë lejohet që ta falim atë duke ecur në këmbë ose duke qenë të hipur në kafshë ose mjet tjetër, kur mund të ndryshojë edhe drejtimi për nga Kibla. Pra, në të tilla kushte, kjo është e tolerueshme.

Ky ajet është argument shumë i fortë që e bën të detyrueshme faljen e namazit në kohën e vet. Duke qenë se Allahu i Lartësuar ka lejuar që të shkelen disa kushte të namazit, që janë të domosdoshme për saktësinë e tij në situata normale, vetëm që namazi të falet në kohën e vet të caktuar, kjo tregon se respektimi i kohës së tij është vërtet shumë i rëndësishëm. Me fjalë të tjera, nuk lejohet shtyrja e namazit jashtë kohës së tij, qoftë edhe në kushte të jashtëzakonshme frike e pasigurie. Namazi brenda kohës së tij, edhe me mangësi të tjera, është më i pëlqyer dhe më i vlefshëm sesa namazi jashtë kohe që kryhet i plotë dhe me përkushtim maksimal. Është detyrë e domosdoshme që falja e namazit të bëhet brenda kohës së vet, edhe nëse thyhen disa kushte të tjera të tij.

- "Kur jeni në gjendje frike, faluni duke ecur ose duke qenë hipur. Por kur ndiheni të sigurt, përkujtojeni Allahun." - Pasi të largohet frika që ju pengonte ta falnit namazin në formën e duhur, atëherë përkujtojeni Allahun e Lartësuar me të gjitha mënyrat e format, ndër të cilat është edhe falja e namazit.

- "...ashtu si ju mësoi Ai ato që ju nuk i dinit." – Kuptimi: Përkujtojeni Allahun e Lartësuar për mirësitë e mëdha që ju ka dhuruar, mes të cilave janë udhëzimi dhe mësimi juaj i gjithçkaje që nuk e dinit. Vërtet, kjo është një mirësi e mrekullueshme e një dhuratë e paçmuar, e cila meriton mirënjohjen tonë të thellë.

Nëse ne tregojmë mirënjohje për këto mirësi dhe përkujtojmë Dhuruesin e tyre, sikurse Ai na ka udhëzuar, atëherë me siguri që mirësitë ndaj nesh do të jenë të qëndrueshme, madje do të shtohen e shumëfishohen prej Tij.

Ajetet 240 – 242

240. Ata që janë duke vdekur dhe kanë gra që do t'i lënë pas, le të lënë me testament furnizimin për gratë e tyre për një vit rresht, pa i nxjerrë ato prej shtëpisë. Por, nëse ato vetë dalin, ju nuk merrni gjynah për ato veprime sipas normave që ato bëjnë me vetveten. Allahu është Krenar e i Urtë.
241. Dhurimi i diçkaje dhe përkujdesja sipas normave ndaj të divorcuarave janë detyrime për të devotshmit.
242. Kështu jua shpjegon Allahu argumentet e Veta, me qëllim që ju të kuptoni.

Shpjegimi i ajeteve

- "Ata që janë duke vdekur dhe kanë gra që do t'i lënë pas, le të lënë me testament furnizimin për gratë e tyre për një vit rresht, pa i nxjerrë ato prej shtëpisë." - Burrat të cilët janë duke vdekur dhe që do të lënë pas vetes gratë e tyre, duhet që të lënë me testament pasuri të mjaftueshme për

gratë e tyre, aq sa u duhet atyre për një vit të plotë, në mënyrë që ato të mos e kenë të nevojshme të dalin nga shtëpitë e tyre.

- "Por, nëse ato vetë dalin, ju nuk merrni gjynah për ato veprime sipas normave që ato bëjnë me vetveten. Allahu është Krenar e i Urtë." – Pra, nëse ato vetë dëshirojnë që të dalin nga kjo përkujdesje, atëherë kujdestarët e grave nuk ngarkohen me gjynah nëse ato gra bëjnë me veten e tyre disa vepra të lejuara.

Cilat qenkan këto vepra të lejueshme, të cilat nuk përbëjnë gjynah? Janë ato veprime që Allahu i ka përshkruar si "*min mearuf*", pra, veprime sipas normave të pranuara gjerësisht nga njerëzit, por që nuk bien ndesh me Sheriatin. Kështu, për shembull, grave u lejohet të zbukurohen ose të përdorin parfumin, por brenda kufijve të vendosur nga Sheriati.

Disa thonë që dispozita e këtij ajeti është anuluar me dispozitën e ajetit 234 të kësaj sureje, ku thuhet se gruaja së cilës i vdes burri e ka të detyrueshme të presë katër muaj e dhjetë ditë pas vdekjes së burrit. Ndërsa disa të tjerë janë të mendimit se nuk kemi të bëjmë me anulim dispozitash, porse ajeti 234 tregon kohën që është e detyrueshme për gruan të presë. Pra, gruaja e ka detyrim që të presë katër muaj e dhjetë ditë pas vdekjes së burrit, ndërsa pas kalimit të kësaj kohe, për të është e pëlqyeshme që të vazhdojë të presë edhe më gjatë. Megjithatë, kjo pëlqyeshmëri është në varësi të gjendjes së gruas dhe nevojave të saj.

Me fjalë të tjera, ky ajet që po trajtojmë tani (nr. 240) nxit për një vepër të pëlqyeshme. Gruaja që dëshiron ta nderojë edhe më shumë burrin e vdekur, por duke marrë parasysh edhe nevojat e saj, le ta plotësojë pritjen deri në një vit.

Si argument që tregon se plotësimi i periudhës njëvjeçare është i pëlqyeshëm dhe jo i detyrueshëm, mund të përmendim edhe një fakt tjetër, që ceket në këtë ajet. Allahu i Lartësuar na tregon se, nëse ato dalin me dëshirën e tyre nga përkujdesja njëvjeçare, para plotësimit të një viti, ky veprim nuk e ngarkon me gjynah kujdestarin e tyre ligjor. Prandaj, nëse plotësimi i periudhës njëvjeçare do të ishte i detyrueshëm dhe gratë do ta thyenin këtë detyrim, atëherë ky do të ishte një gjynah. Thënë ndryshe, kur Allahu i Lartësuar na tregon se dalja e tyre nuk është gjynah, kjo tregon që plotësimi i vitit nuk është i detyrueshëm për to. Si përfundim, këtu nuk kemi të bëjmë me shfuqizim dispozitash, por kemi të bëjmë me sqarim më të hollësishëm të kufijve të detyrimit dhe të pëlqimit.

- "Dhurimi i diçkaje dhe përkujdesja sipas normave ndaj të divorcuarave janë detyrime për të devotshmit." – Siç shihet, këtu flitet për të gjitha llojet e të divorcuarave. Sipas ajetit, dhurimi dhe përkujdesja janë të detyrueshëm ndaj të gjitha grave që divorcohen, me çdo lloj mënyre qoftë ky divorc.

Megjithatë, sipas mendimit më të saktë, dhuratat janë të detyrueshme t'u jepen vetëm atij lloji të divorcuarash, me të cilat nuk është kryer kontakt seksual dhe të cilave ende nuk u është përcaktuar mehri. Ndërsa për llojet e tjera të të divorcuarave, dhënia e dhuratave është e pëlqyeshme, sikurse u tha më sipër. Ky mendim është më i saktë, sepse vërtet që ky ajet i përfshin të gjitha llojet e të divorcuarave, por i parë së bashku me ajetet e tjera, gjithëpërfshirja e tij kufizohet vetëm me një kategori të caktuar të divorcuarash. Kështu, në ajetin 236 të sures Bekare, u tha që dhënia e dhuratave është e detyrueshme posaçërisht vetëm për të divorcuarat para kontaktit dhe para përcaktimit të mehrit: "Nuk është gjynah për ju nëse i divorconi gratë me të cilat ende nuk keni kryer marrëdhënie dhe të cilave ende nuk ua keni përcaktuar e dhënë mehrin. Jepuni dhe përkujdesuni për to: pasaniku sipas mundësive të tij, dhe i varfëri sipas mundësive së tij. Përkujdesja dhe furnizimi i tyre sipas zakonit është detyrë për

bamirësit." Pra, të tilla norma janë të detyrueshme të zbatohen nga çdo njeri që kërkon t'i ruhet ndëshkimit të Zotit të tij.

- "Kështu jua shpjegon Allahu argumentet e Veta, me qëllim që ju të kuptoni." - Pra, kështu na i sqaron neve Allahu i Lartësuar kufijtë e Tij, hallallin dhe haramin dhe çdo ligj të dobishëm për ne. Ai i sjell këto dispozita, që ne të mendohemi thellë rreth tyre dhe të nxjerrim prej tyre urtësi dhe qëllime të larta. Çdokush që mendon thellë rreth teksteve të sjella nga Zoti, duke nxjerrë prej tyre urtësi dhe dispozita, me siguri që do të punojë i nxitur prej tyre. Pastaj thotë i Madhëruari:

Ajetet 243 - 245

243. A nuk i ke parë ata që, edhe pse ishin me mijëra, u larguan prej atdheut të vet për t'i shpëtuar vdekjes? Por Allahu u tha atyre: "Vdisni!" E pastaj Ai i ringjalli. Allahu është Bamirës i madh ndaj njerëzve, por shumica e tyre nuk janë mirënjohës.
244. Luftoni për hir të Allahut, dhe ta dini se Allahu është Dëgjues dhe i Gjithëditur.
245. Kush është ai që do t'i japë Allahut një "hua" të mirë, që Ai t'ia shtojë atë shumëfish? Allahu shtrëngon dhe po Ai çliron. Vetëm tek Ai është kthimi juaj.

Shpjegimi i ajeteve

- "A nuk i ke parë ata që, edhe pse ishin me mijëra, u larguan prej atdheut të vet për t'i shpëtuar vdekjes?" - Në këtë ajet, Allahu i Lartësuar na tregon historinë e disa mijëra njerëzve, të cilët u larguan nga vendi i tyre me një qëllim të vetëm: për t'i shpëtuar vdekjes nga një fatkeqësi që u kanosej. Porse caktimit të Allahut nuk mund t'i shpëtosh! Kështu, Allahu i Lartësuar u tha:

- "Por Allahu u tha atyre: "Vdisni!" E pastaj Ai i ringjalli." – Pra, ata vdiqën që të gjithë. Më pas, Allahu i Lartësuar i ringjalli ata, ndoshta për shkak të lutjes së Profetit të tyre, ose për ndonjë shkak tjetër. Ai i ringjalli ata, duke u treguar në këtë mënyrë mëshirën, butësinë dhe faljen e Tij të madhe. Ai i ringjalli ata, për t'u qartësuar krijesave fuqinë e Tij të padiskutueshme për ringjalljen e të vdekurve.

Më pas, Allahu i Lartësuar thotë:

- "Allahu është Bamirës i madh ndaj njerëzve, por shumica e tyre nuk janë mirënjohës." - Megjithëse Allahu i Lartësuar u dhuron krijesave mirësi të jashtëzakonshme, shumica e tyre nuk tregojnë mirënjohje. Madje shumë prej tyre, mirësitë e dhuruara nga Allahu i Lartësuar, i shfrytëzojnë për të kryer gjynahe ndaj Tij. Pak njerëz i njohin mirësitë e Zotit dhe shumë pak prej tyre i përdorin ato për të falënderuar Atë dhe për të treguar mirënjohjen ndaj Tij.

Pastaj, i Lartësuari na urdhëron që të luftojmë për hir të Tij, kundër armiqve të rrugës së drejtë. Ai na urdhëron që të luftojmë për të përhapur ndër njerëz fenë e Tij: adhurimin e një Zoti të vetëm:

- "Luftoni për hir të Allahut, dhe ta dini se Allahu është Dëgjues dhe i Gjithëditur." – Pra, rregullojeni qëllimin e luftës suaj, duke synuar me veçse kënaqësinë e Allahut.

Mësojeni se lënia e xhihadit nuk sjell asnjë lloj dobie e mirësie. Nëse mendoni se, duke lënë xhihadin, do të ruani jetën dhe sigurinë tuaj, jeni të gabuar. Për këtë arsye përmend Allahu i Lartësuar historinë e popullit që u shpërngulën masivisht nga vendi i tyre për t'i shpëtuar vdekjes, por që nuk patën shpëtim, sepse përsëri vdiqën. Edhe pse u munduan t'i ruheshin vdekjes duke ikur, ata nuk shpëtuan dot prej saj. Atyre u erdhi vdekja andej nga nuk e kishin menduar. Pra, sikurse atyre nuk u bëri dobi asnjë masë që morën kundër vdekjes, dijeni se edhe ju nuk mund t'i shpëtoni asaj duke braktisur detyrën për të bërë xhihad. Luftoni pra, se xhihadi është mirësia që kërkoni.

Duke qenë se xhihadi ka nevojë për pasuri që të zhvillohet, Allahu i Lartësuar na urdhëron që të shpenzojmë për këtë qëllim, duke thënë:

- "Kush është ai që do t'i japë Allahut një "hua" të mirë, që Ai t'ia shtojë atë shumëfish?" - Kush dëshiron që t'i shtohen shpërblimet tek Allahu i Lartësuar, le të shpenzojë çfarë të ketë më të lehtë prej pasurisë së tij në rrugët e shumta të mirësisë, të cilat i ka sqaruar Allahu i Lartësuar dhe Profeti i Tij, e në mënyrë të veçantë për të mbështetur dhe forcuar xhihadin në rrugën e Zotit.

Shpenzime të tilla, Allahu i Lartësuar i ka quajtur "hua" të mirë, pra, shpenzim të mirë. Jo çdo lloj shpenzimi shpërblehet nga Allahu i Lartësuar. I vetmi shpenzim që shpërblehet nga Allahu i Lartësuar, është shpenzimi i mirë.

Një shpenzim quhet i mirë vetëm nëse plotëson dy kushte:
1. të jetë prej pasurisë hallall;
2. të jepet për hir të Allahut, duke synuar kënaqësinë e Tij.

Vetëm për këtë lloj shpenzimi ka premtuar Allahu i Lartësuar shumëfishim të mirësive, duke thënë:

- "...që Ai t'ia shtojë atë shumëfish?" - Një vepër të mirë, Allahu i Lartësuar e shpërblen dhjetëfish, njëqindfish ose më tepër. Kjo bëhet në varësi të disa kushteve, si:
- në varësi të gjendjes së atij që shpenzon;
- në varësi të qëllimit që njeriu kërkon të arrijë me shpenzimin;
- në varësi të dobisë së arritur nëpërmjet atij shpenzimi;
- në varësi të nevojës që ndihet për atë shpenzim.

Njeriu ndoshta mendon se, duke shpenzuar shumë, do të varfërohet. Për të larguar këtë mendim të gabuar, Allahu i Lartësuar thotë:
- "Allahu shtrëngon dhe po Ai çliron. – Është Allahu i Lartësuar Ai që ia shton pasurinë atij që Ai do dhe ia pakëson, gjithashtu, atij që Ai do. Kjo tregon se administrimi i të gjitha çështjeve është vetëm në dorën e Allahut. Ai vendos për gjithçka.

Mosdhënia për bamirësi nuk e shton pasurinë, ashtu sikurse edhe shpenzimi në rrugë të Allahut nuk e pakëson pasurinë. Madje, jo vetëm që nuk pakëson asgjë, por Ditën e Gjykimit, Allahu i Lartësuar do të japë shpërblim të plotë për pasurinë që robi ka shpenzuar për hir të Tij. Për këtë arsye, i Lartësuari thotë:

- "Vetëm tek Ai është kthimi juaj." - Tek Ai do të kthehen të gjithë, për t'u llogaritur dhe për t'u shpërblyer plotësisht e me drejtësi për gjithçka që kanë bërë në këtë jetë.

Ky ajet tregon qartë se masat që ndërmerr robi nuk mund ta ndryshojnë gjykimin dhe përcaktimin e drejtë të Allahut për krijesat. Ato nuk mund ta ndryshojnë drejtësinë dhe urtësinë që ka përcaktuar Zoti i gjithësisë, sidomos ato lloj masash që shpërfillin urdhëresat e Tij.

Në këtë ajet përmendet, gjithashtu, një mrekulli e madhe që Zoti i ka shfaqur njerëzimit. Ajo është ringjallja e të vdekurve që në këtë botë, duke treguar kështu fuqinë e Tij absolute për ta bërë këtë gjë.

Ky ajet na urdhëron që të luftojmë dhe të shpenzojmë për të triumfuar feja e Allahut. Por ai na tregon edhe shkaqet që na shtyjnë të shpenzojmë dhe të luftojmë për këtë çështje: Kështu, Allahu e ka quajtur këtë lloj shpenzimi "hua të mirë", gjë që na jep të kuptojmë se ajo do të kthehet mbrapsht patjetër, sikurse është detyrë që të kthehet huaja. Jo vetëm kaq, por Allahu premton se do ta kthejë shumëfish shpërblimin e Tij. Përveç kësaj, në ajet tregohet se shtimi dhe pakësimi i pasurisë është në dorë të Allahut të Lartësuar dhe të askujt tjetër, dhe kjo të nxit që të japësh jetën dhe pasurinë vetëm për hir të Tij. Në fund, Allahu na kujton se të gjithë tek Ai do të kthehemi një ditë, për t'u llogaritur dhe për t'u shpërblyer për veprat tona.

Ajeti 246

246. A nuk e ke parë parinë e bijve të Israilit, pas Musait, kur i thanë një Profeti të tyre: "Cakto për ne një mbret, që të luftojmë në rrugën e Allahut!" Ai u tha: "Po sikur të ndodhë që lufta t'ju bëhet detyrë dhe ju të mos luftoni?" Ata thanë: "E pse të mos luftojmë në rrugën e Allahut, kur dihet se ne jemi dëbuar nga atdheu dhe fëmijët tanë?!". Por kur u ngarkuan me detyrën për të luftuar, ata u sprapsën, përveç një pakice prej tyre. Allahu është i Gjithëditur rreth të padrejtëve.

Shpjegimi i ajetit

- "A nuk e ke parë parinë e bijve të Israilit, pas Musait..." - Këtu Allahu i Lartësuar na tregon me vërtetësi historinë e parisë së bijve të Israilit.


Allahu i Lartësuar i përmend këta në mënyrë të veçantë, sepse janë pikërisht paria dhe të zgjedhurit e një kombi ata të cilët kërkojnë të mirën e kombit të tyre, ndërsa populli ecën në gjurmët e tyre. Ata vendosin për çështjet e popullit dhe populli i thjeshtë i pason dhe u bindet.

Kështu, pas Musait (a.s.), një grup prej parisë së bijve të Israilit shkuan te një Profet, që ishte i dërguar mes tyre, e i thanë:

- "...kur i thanë një Profeti të tyre: "Cakto për ne një mbret, që të luftojmë në rrugën e Allahut!" - Ata i kërkuan këtij Profeti që ai t'u përcaktonte atyre një mbret, një udhëheqës të zotin, që t'i bashkonte të gjitha fiset e përçara të bijve të Israilit dhe t'i udhëhiqte në luftë kundër armiqve të tyre.

Ndoshta asokohe, çifutët nuk kishin një mbret ose një prijës që t'i udhëhiqte në luftë kundër qafirëve dhe t'i bashkonte fiset e tyre të përçara, sikurse ndodh zakonisht, kur asnjë fis nuk pranon udhëheqës tjetër veç udhëheqësit të vet.

Në këtë mënyrë, ata kërkuan prej Profetit që të përcaktonte udhëheqësin, të cilit duhet t'i bindeshin të gjithë. (Te bijtë e Israilit


الجُزءُ الثَّانِي سُورَةُ البَقَرَة
أَلَمْ تَرَ إِلَى ٱلْمَلَإِ مِنۢ بَنِىٓ إِسْرَٰٓءِيلَ مِنۢ بَعْدِ مُوسَىٰ إِذْ
قَالُوا۟ لِنَبِىٍّ لَّهُمُ ٱبْعَثْ لَنَا مَلِكًا نُّقَٰتِلْ فِى سَبِيلِ ٱللَّهِ ۖ
قَالَ هَلْ عَسَيْتُمْ إِن كُتِبَ عَلَيْكُمُ ٱلْقِتَالُ أَلَّا تُقَٰتِلُوا۟ ۖ
قَالُوا۟ وَمَا لَنَآ أَلَّا نُقَٰتِلَ فِى سَبِيلِ ٱللَّهِ وَقَدْ أُخْرِجْنَا
مِن دِيَٰرِنَا وَأَبْنَآئِنَا ۖ فَلَمَّا كُتِبَ عَلَيْهِمُ ٱلْقِتَالُ تَوَلَّوْا۟
إِلَّا قَلِيلًا مِّنْهُمْ ۗ وَٱللَّهُ عَلِيمٌۢ بِٱلظَّٰلِمِينَ ﴿٢٤٦﴾ وَقَالَ لَهُمْ
نَبِيُّهُمْ إِنَّ ٱللَّهَ قَدْ بَعَثَ لَكُمْ طَالُوتَ مَلِكًا ۚ
قَالُوٓا۟ أَنَّىٰ يَكُونُ لَهُ ٱلْمُلْكُ عَلَيْنَا وَنَحْنُ أَحَقُّ
بِٱلْمُلْكِ مِنْهُ وَلَمْ يُؤْتَ سَعَةً مِّنَ ٱلْمَالِ ۚ قَالَ إِنَّ ٱللَّهَ
ٱصْطَفَىٰهُ عَلَيْكُمْ وَزَادَهُۥ بَسْطَةً فِى ٱلْعِلْمِ وَٱلْجِسْمِ ۖ
وَٱللَّهُ يُؤْتِى مُلْكَهُۥ مَن يَشَآءُ ۚ وَٱللَّهُ وَٰسِعٌ عَلِيمٌ ﴿٢٤٧﴾
وَقَالَ لَهُمْ نَبِيُّهُمْ إِنَّ ءَايَةَ مُلْكِهِۦٓ أَن يَأْتِيَكُمُ
ٱلتَّابُوتُ فِيهِ سَكِينَةٌ مِّن رَّبِّكُمْ وَبَقِيَّةٌ مِّمَّا
تَرَكَ ءَالُ مُوسَىٰ وَءَالُ هَٰرُونَ تَحْمِلُهُ ٱلْمَلَٰٓئِكَةُ ۚ
إِنَّ فِى ذَٰلِكَ لَءَايَةً لَّكُمْ إِن كُنتُم مُّؤْمِنِينَ ﴿٢٤٨﴾
٤٠

dërgoheshin gjithmonë profetë. Sa herë që vdiste një profet, dërgohej një tjetër). Kur ata i bënë këtë kërkesë Profetit të tyre, ai u tha:

- "Ai u tha: "Po sikur të ndodhë që lufta t'ju bëhet detyrë dhe ju të mos luftoni?"" – Kështu, Profeti u tërhoqi vërejtjen që të mos i bënin bisht detyrimit, pasi ai të hynte në fuqi. Nëse lufta do t'u bëhej detyrë prej Zotit, ata nuk duhej t'i kthenin shpinën asaj.

Në këtë mënyrë, Profeti u ofroi atyre edhe një mundësi për të jetuar në paqe dhe për t'u menduar mirë, para se të kërkonin prej Allahut gjëra që ndoshta nuk do t'i përballonin dot. Por, pavarësisht nga kjo, ata nuk e pranuan këtë ofertë dhe kërkuan me ngulm luftën, duke pasur besim të plotë në qëllimin që i patën vënë vetes:

- "Ata thanë: "E pse të mos luftojmë në rrugën e Allahut, kur dihet se ne jemi dëbuar nga atdheu dhe fëmijët tanë?!" - Ky

ishte mendimi i tyre. Pra, ata thanë: "E çfarë na pengon ne nga lufta, ndërkohë që jemi të detyruar të luftojmë? Ne jemi dëbuar nga atdheu ynë. Familjet dhe fëmijët tanë janë robër të armikut tonë. Kaq është mëse e mjaftueshme që ne të nisim luftën, edhe pse ende nuk na është bërë detyrim. E si të mos luftojmë pastaj, kur përveç kësaj, lufta do të na bëhet detyrim edhe prej Zotit?!" Me këto fjalë, ata shfaqën një gatishmëri të plotë për të luftuar, nëse Zoti do t'ua bënte të detyrueshme këtë gjë.

Porse fjalët nuk janë gjithçka. Është tepër e rëndësishme që fjalët të shprehin me sinqeritet atë që ndien dhe dëshiron zemra. Kështu, duke qenë se qëllimet e tyre nuk ishin të sinqerta dhe zemrat e tyre nuk ishin të pastra në atë që kërkonin, dhe kur mbështetja e tyre tek Allahu i Lartësuar nuk ishte e saktë dhe e rregullt, atëherë shikoni se çfarë ndodhi me ta:

- "Por kur u ngarkuan me detyrën për të luftuar, ata u sprapsën, përveç një pakice prej tyre." - Ata u frikësuan shumë nga kjo luftë kundër armikut të tyre dhe filluan të tregonin dobësinë e tyre për ta përballuar atë sfidë. Ajo që pak më parë i nxiste për të luftuar, u zhduk nga kujtesa e tyre. Shumica u tmerruan dhe u zbrapsën të frikësuar nga pranimi i kësaj sfide. Këtë gjë nuk e bëri vetëm një pakicë nga mesi i tyre. Këta ishin ata të cilët i ruajti Allahu i Lartësuar, duke ua forcuar zemrat dhe duke i bërë të qëndrueshëm në këtë sfidë. Vetëm këta i qëndruan besnikë urdhrit të Allahut dhe filluan sinqerisht të përgatiteshin për ballafaqimin e madh me armikun. Ata merituan nderimin në këtë jetë dhe në jetën tjetër.

Ndërsa shumica tjetër u treguan të padrejtë ndaj vetes dhe e shpërfillën urdhrin e Zotit të tyre, i Cili thotë:

- "Allahu është i Gjithëditur rreth të padrejtëve." - Pas kësaj, duke iu përgjigjur kërkesës së parashtruar, Profeti i tyre tha:

Ajetet 247 – 248

247. Profeti i tyre u tha: "Allahu caktoi Talutin, si mbretin tuaj." Ata thanë: "Si mund të jetë mbretëria në dorën e tij, kur ne kemi më shumë merita për të qenë mbretër sesa ai?! Madje, ai nuk është as i pasur?!" Ai tha: "Atë e zgjodhi Allahu si mbretin tuaj, duke e pajisur me dituri të gjerë e me fuqi trupore!" Allahu ia jep pushtetin kujt të dojë. Allahu është Bujar i madh dhe i Gjithëdijshëm.

248. Profeti i tyre u tha: "Shenjë e sundimit të tij është ardhja tek ju e Arkës, tek e cila do të gjeni qetësim nga Zoti juaj. Në të ndodhet edhe diçka që ka mbetur nga thesari i familjes së Musait dhe Harunit. Atë e bartin engjëjt. S'ka dyshim se ky është një fakt për ju, nëse jeni besimtarë."

Shpjegimi i ajeteve

- "Profeti i tyre u tha: "Allahu caktoi Talutin, si mbretin tuaj." - Ky ishte një caktim i drejtpërdrejtë nga Allahu i Lartësuar dhe, si i tillë, ai duhej pranuar pa asnjë diskutim. Por dihet se çifutët dinë veçse të kundërshtojnë, prandaj, si përherë, ata thanë:

- "Ata thanë: "Si mund të jetë mbretëria në dorën e tij, kur ne kemi më shumë merita për të qenë mbretër sesa ai?! Madje, ai nuk është as i pasur?!"" – Kuptimi: Si mund të jetë mbret dikush që qëndron shumë më poshtë se ne, për sa i përket prejardhjes dhe pozitës së tij shoqërore?! Sipas këtyre kritereve, jemi ne që e meritojmë më shumë pushtetin. Jo vetëm kaq, por ai është edhe i varfër, që nuk ka se me çfarë ta ndërtojë mbretërinë dhe pushtetin e tij.

Këto ishin parametrat e tyre për të përzgjedhur udhëheqësit e tyre. Ata mendonin gabimisht se udhëheqësi duhet të zgjidhet patjetër prej të pasurve e fisnikëve. Ata nuk e dinin se janë disa cilësi të tjera që

përcaktojnë se cili e meriton të jetë mbret apo udhëheqës. Pastaj thotë i Madhëruari:


- "Ai tha: "Atë e zgjodhi Allahu si mbretin tuaj, duke e pajisur me dituri të gjerë e me fuqi trupore!" - Kuptimi: Allahu e përzgjodhi atë nga mesi juaj, duke i dhuruar dije të gjerë dhe trup të fuqishëm.

Mendja e ndritur dhe trupi i fortë janë dy elementë që i japin sukses të plotë udhëheqësit. Nëse një prijës gëzon dije të gjerë dhe fuqi për ta ekzekutuar këtë dije, ecuria e veprave do të jetë e sigurt dhe frytdhënëse. Nëse mungon njëra prej tyre, atëherë patjetër që veprat do të çalojnë. Nëse mbreti ka fuqi, por nuk ka urtësi dhe mençuri, në mbretërimin e tij do të ndodhin padrejtësi dhe kalim të kufijve të Zotit. Kur forca ushtrohet pa urtësi dhe mençuri, ajo nuk mund të sjellë kurrë drejtësi dhe mirësi. Po ashtu, kur diturisë i mungon forca, atëherë ajo nuk mund të vihet në jetë.

- "Allahu ia jep pushtetin kujt të dojë. Allahu është Bujar i madh dhe i Gjithëdijshëm." - Këto janë cilësitë e duhura për zgjedhjen e një udhëheqësi. Allahu është Bujar (*Uasiun*) i madh me mirësitë dhe dhuratat e Tij. Të gjithë janë të barabartë përpara bujarisë së Tij: i fismi dhe jo i fismi, i pasuri dhe i varfëri, të gjithë kanë të drejtë që të përfitojnë nga mëshira dhe dhuratat e Tij. Por përveç kësaj, Ai është edhe i Gjithëditur (*Alim*). Ai e di më mirë se çdokush tjetër se cili meriton që të përfitojë nga dhuratat dhe mirësitë e Tij. Ai e di shumë mirë se kujt ia fal begatitë e Tij.

Me këto fjalë, Allahu i Lartësuar u largoi atyre nga mendjet çdo lloj dyshimi dhe pakënaqësie për atë përzgjedhje. Ai i bindi ata se i përzgjedhuri i plotësonte më së miri kushtet për të qenë një udhëheqës i denjë. Allahu i Lartësuar ia jep pushtetin kujt të dëshirojë dhe askush nuk mund ta kthejë mbrapsht vendimin e Tij të urtë.

Megjithëse ky ishte një argumentim i kthjellët si drita e diellit, Profeti i tyre u solli


الجُزۡءُ الثَّانِي سُورَةُ البَقَرَة
فَلَمَّا فَصَلَ طَالُوتُ بِٱلۡجُنُودِ قَالَ إِنَّ ٱللَّهَ مُبۡتَلِيكُم
بِنَهَرٖ فَمَن شَرِبَ مِنۡهُ فَلَيۡسَ مِنِّي وَمَن لَّمۡ يَطۡعَمۡهُ
فَإِنَّهُۥ مِنِّيٓ إِلَّا مَنِ ٱغۡتَرَفَ غُرۡفَةَۢ بِيَدِهِۦ فَشَرِبُواْ مِنۡهُ
إِلَّا قَلِيلٗا مِّنۡهُمۡ فَلَمَّا جَاوَزَهُۥ هُوَ وَٱلَّذِينَ ءَامَنُواْ
مَعَهُۥ قَالُواْ لَا طَاقَةَ لَنَا ٱلۡيَوۡمَ بِجَالُوتَ وَجُنُودِهِۦۚ
قَالَ ٱلَّذِينَ يَظُنُّونَ أَنَّهُم مُّلَٰقُواْ ٱللَّهِ كَم مِّن فِئَةٖ
قَلِيلَةٍ غَلَبَتۡ فِئَةٗ كَثِيرَةَۢ بِإِذۡنِ ٱللَّهِۗ وَٱللَّهُ مَعَ
ٱلصَّٰبِرِينَ ٢٤٩ وَلَمَّا بَرَزُواْ لِجَالُوتَ وَجُنُودِهِۦ قَالُواْ
رَبَّنَآ أَفۡرِغۡ عَلَيۡنَا صَبۡرٗا وَثَبِّتۡ أَقۡدَامَنَا وَٱنصُرۡنَا
عَلَى ٱلۡقَوۡمِ ٱلۡكَٰفِرِينَ ٢٥٠ فَهَزَمُوهُم بِإِذۡنِ ٱللَّهِ
وَقَتَلَ دَاوُۥدُ جَالُوتَ وَءَاتَىٰهُ ٱللَّهُ ٱلۡمُلۡكَ
وَٱلۡحِكۡمَةَ وَعَلَّمَهُۥ مِمَّا يَشَآءُۗ وَلَوۡلَا دَفۡعُ ٱللَّهِ ٱلنَّاسَ
بَعۡضَهُم بِبَعۡضٖ لَّفَسَدَتِ ٱلۡأَرۡضُ وَلَٰكِنَّ ٱللَّهَ ذُو
فَضۡلٍ عَلَى ٱلۡعَٰلَمِينَ ٢٥١ تِلۡكَ ءَايَٰتُ ٱللَّهِ نَتۡلُوهَا
عَلَيۡكَ بِٱلۡحَقِّۚ وَإِنَّكَ لَمِنَ ٱلۡمُرۡسَلِينَ ٢٥٢
٤١

edhe një argument tjetër përforcues, që ata ta pranonin totalisht dhe me zemër të qetë:

- "Profeti i tyre u tha: "Shenjë e sundimit të tij është ardhja tek ju e Arkës, tek e cila do të gjeni qetësim nga Zoti juaj. Në të ndodhet edhe diçka që ka mbetur nga thesari i familjes së Musait dhe Harunit. Atë e bartin engjëjt. S'ka dyshim se ky është një fakt për ju, nëse jeni besimtarë."" - Kjo qe një shenjë madhështore dhe e prekshme për ata njerëz. Ata, si shenjë, do të shihnin Arkën, brenda së cilës ndodheshin disa relike të mbetura prej familjes së Musait dhe Harunit. Kur ta shihnin atë, zemrat e tyre do të gjenin prehje dhe ata do të bindeshin plotësisht. E si të ndodhte ndryshe, kur ata do të shihnin me sytë e tyre engjëjt duke e bartur atë Arkë?!

Ajetet 249 – 250

249. Kur Taluti u nis së bashku me ushtrinë, tha: "Allahu do t'ju sprovojë me

një lumë. Ai që pi prej tij, nuk është me mua, e kush nuk e provon atë, ai është me mua, përveç atij që pi vetëm një grusht me dorën e vet." Por ata pinë prej tij, me përjashtim të një pakice. E kur ai *(Taluti)* tok me besimtarët kaluan lumin, shumë prej tyre thanë: "Ne nuk kemi fuqi sot të luftojmë kundër Xhalutit dhe ushtrisë së tij!" Por ata që ishin të bindur për takimin me Allahun thanë: "Sa e sa grupe të vogla kanë triumfuar ndaj grupeve të mëdha, me dëshirën e Allahut!" Allahu është me durimtarët.

250. Kur dolën përballë Xhalutit dhe ushtrisë së tij, thanë: "Zoti ynë! Na dhuro durim! Na i përforco këmbët tona dhe na ndihmo kundër jobesimtarëve!"

Shpjegimi i ajeteve

- "Kur Taluti u nis së bashku me ushtrinë, tha:..." – Kështu, pasi Taluti u zgjodh mbret i tyre dhe pasi pushteti i tij u forcua dhe u stabilizua, filluan përgatitjen për luftën që po afrohej.

Para se Taluti të nisej me ushtrinë e bijve të Israilit, të cilët ishin të shumtë në numër, i njoftoi se Allahu i Lartësuar do t'i përballte ata me një sprovë, prej së cilës do të dalloheshin të qëndrueshmit dhe të bindurit për të luftuar, nga të lëkundurit dhe dyshuesit:

- "Allahu do t'ju sprovojë me një lumë. Ai që pi prej tij, nuk është me mua, e kush nuk e provon atë, ai është me mua..." – Kuptimi: Kush do të pijë prej atij lumi, nuk do të jetë më prej nesh.

Ata nuk e meritojnë që të marrin pjesë në luftë, sepse ata nuk janë në gjendje të bëjnë durim për një sprovë shumë më të lehtë sesa lufta. Të tillët janë të paqëndrueshëm dhe të padurueshëm.

- "...përveç atij që pi vetëm një grusht me dorën e vet." – Pra, ky qe një lehtësim: ai që do të pinte prej lumit veçse një grusht ujë, me dorën e vet, do të tolerohej.

Ndoshta, me atë masë të vogël uji që u lejoi të pinin, Allahu i Lartësuar do t'u sillte begati dhe do t'ua bënte mëse të mjaftueshme.

Sprovimi ishte vërtet i vështirë, sepse ata kishin shumë pak ujë me vete, ndërkohë që i kishte përfshirë një etje e madhe. Pikërisht në këto kushte, ata duhej të pinin vetëm një grusht ujë nga lumi.

- "Por ata pinë prej tij, me përjashtim të një pakice." - Shumica e tyre pinë prej lumit më shumë sesa iu lejua, dhe kështu nuk merituan që të merrnin pjesë në luftë. Paaftësia e tyre për të duruar një sprovë të tillë, ishte argument i qartë që vërtetonte se ata do të ishin të padurueshëm ndaj vështirësive të një lufte të gjatë. Ata nuk do ta përballonin kurrë atë luftë që i priste.

Ky largim i pjesës më të madhe të ushtrisë bëri që ata të durueshmit të shtonin edhe më tepër lutjet drejtuar Allahut të Lartësuar, që Ai t'u përforconte zemrat dhe këmbët. Kjo i dha mbështetjes së tyre tek Allahu i Lartësuar të tjera përmasa. Ata i shkëputën plotësisht shpresat te forcat dhe aftësitë e tyre. E vetmja shpresë për ta ishte tashmë ndihma e Allahut të Lartësuar dhe durimi në luftën kundër armikut.

Allahu i Lartësuar na përshkruan gjendjen e tyre para betejës:

- "E kur ai *(Taluti)* tok me besimtarët kaluan lumin, shumë prej tyre thanë:..." – Pra, shumica e atyre që i rezistuan sprovës së lumit, kur panë armikun e madh në numër dhe forcat e tyre të pakta, thanë:

- "Ne nuk kemi fuqi sot të luftojmë kundër Xhalutit dhe ushtrisë së tij!" - Duke parë ushtrinë e madhe të armiqve dhe armatimin e tyre, ata u shkurajuan dhe menduan se ishin shumë të dobët dhe të pafuqishëm përballë asaj ushtrie. Megjithatë, mes tyre ishte një pakicë heroike:

- "Por ata që ishin të bindur për takimin me Allahun thanë:..." - Ata kishin siguri të plotë për takimin me Allahun, Zotin e tyre. Besimi i tyre ishte i qëndrueshëm dhe i patundur.

Kështu, ata filluan të qetësonin zemrat e pjesës tjetër të ushtrisë, të ngjallnin optimizëm dhe të këshillonin për durim dhe qëndrueshmëri. Ata u thanë vëllezërve të tyre:

- "Sa e sa grupe të vogla kanë triumfuar ndaj grupeve të mëdha, me dëshirën e Allahut!" - Mësojeni se ai që vendos në çdo çështje është Allahu i Lartësuar. Çdo gjë është në dorën e Tij dhe bëhet sipas urtësisë dhe mëshirës së Tij. Krenar do të jetë ai që Zoti e nderon. I poshtëruar do të jetë ai që Zoti e poshtëron. Numri i madh i forcave dhe fuqia ushtarake nuk vlejnë nëse Allahu i Lartësuar ka shkruar për ta humbjen dhe poshtërimin. Nga ana tjetër, numri i vogël dhe dobësia bëhen të parëndësishëm kur pranë tyre qëndron ndihma e Allahut.

- "Allahu është me durimtarët." - Allahu është pranë të duruarve me ndihmën, suksesin dhe fitoren e dhënë prej Tij. Shkaku më i madh dhe më i rëndësishëm nëpërmjet të cilit adhuruesi fiton ndihmën e Zotit, është durimi dhe qëndrueshmëria për hir të Tij.

Ky përkujtim i sinqertë pati një ndikim shumë të madh në zemrat e tyre, prandaj, të rreshtuar përballë armikut, ata thanë:

- "Kur dolën përballë Xhalutit dhe ushtrisë së tij, thanë: "Zoti ynë! Na dhuro durim! Na i përforco këmbët tona dhe na ndihmo kundër jobesimtarëve!"" – Kuptimi: "O Zot, mbushi zemrat tona me durim e qëndrueshmëri, dhe forcoi ato në këtë përballje të vështirë! O Zot, forcoji këmbët tona, që të mos tronditen gjatë betejës së ashpër dhe që të mos tërhiqemi prej saj! O Zot, na dhuro fitoren mbi armikun, mbi popullin qafir!" Nga ky ajet kuptojmë, gjithashtu, se Xhaluti dhe ushtria e tij ishin qafirë.

Për këtë arsye, duke parë përgatitjen e tyre maksimale për luftë dhe durimin e tyre në betejë, Allahu i Lartësuar zbriti ndihmën e Tij:

Ajeti 251

251. Me ndihmën e Allahut, ata i mposhtën *(armiqtë)*, ndërsa Xhalutin e vrau Daudi, të cilit Allahu i dhuroi pushtet e urtësi dhe i mësoi çdo gjë që ai dëshironte të dinte. Sikur Allahu të mos i mbronte njerëzit me anë të disave prej tyre, toka do të shkatërrohej, por Allahu është Bamirës i madh ndaj njerëzimit.

Shpjegimi i ajetit

"Me ndihmën e Allahut, ata i mposhtën *(armiqtë)*, ndërsa Xhalutin e vrau Daudi..." - Daudi (a.s.) ishte pjesëtar i ushtrisë së Talutit. Ishte pikërisht ai që e vrau me dorën e vet Xhalutin, mbretin e qafirëve. Me guximin, fuqinë dhe durimin e tij, ai triumfoi mbi Xhalutin.

Allahu i Lartësuar e nderoi Daudin, duke i dhuruar pushtet dhe urtësi të madhe. Ai u bë mbreti i bijve të Israilit.

"...Allahu i dhuroi pushtet e urtësi .." – Pushteti ishte mbretërimi te bijtë e Israilit, ndërsa urtësia ishte profetësia. Pra, Allahu i Lartësuar e bëri atë profet, duke i dhënë një ligj hyjnor dhe duke e udhëzuar në rrugën e drejtë. Pastaj, i Lartësuari thotë:

"...dhe i mësoi çdo gjë që ai dëshironte të dinte." - Allahu i mësoi shumë Daudit (a.s.) rreth ligjit hyjnor dhe çështjeve të udhëheqjes. Allahu i Lartësuar i dhuroi atij pushtet, pasuri dhe profetësi, ndërkohë që para Daudit kishte patur profetë që nuk kishin qenë mbretër.

Pas kësaj fitoreje, bijtë e Israilit gjetën qetësi në trojet e tyre, dhe kështu vazhduan ta adhuronin Allahun e Lartësuar në paqe, ndërkohë që armiqtë e tyre u poshtëruan. Të

gjitha këto ishin fryte të xhihadit që ata zhvilluan në rrugë të Allahut. Nëse nuk do të kishin treguar durim në luftën e tyre, asgjë nga këto nuk do të kishte ndodhur. Prandaj thotë i Lartësuari:

"**Sikur Allahu të mos i mbronte njerëzit me anë të disave prej tyre, toka do të shkatërrohej...**" - Sikur Allahu i Lartësuar të mos i mbronte njerëzit nëpërmjet atyre që bëjnë xhihad, atëherë në tokë do të ndodhnin shkatërrime të mëdha dhe do të mbizotëronin mizorët, të poshtrit dhe qafirët. Njerëzit do të pengoheshin nga adhurimi i Allahut të Lartësuar dhe në tokë nuk do të shfaqeshin simbolet e fesë së Tij.

- "...por Allahu është Bamirës i madh ndaj njerëzimit." - Prej bamirësisë së Allahut është edhe ligjërimi i xhihadit, nëpërmjet të cilit Ai u mundëson adhuruesve të Vet lumturinë dhe ruajtjen prej çdo armiku që u kanoset. Nëpërmjet xhihadit, besimtarët bëhen të palëkundshëm në tokë. Allahu i ndihmon ata me disa mënyra që njerëzit i njohin dhe me disa mënyra të tjera që i di vetëm Ai, e askush tjetër. Më tej, i Lartësuari thotë:

Ajeti 252

252. Këto janë argumentet e Allahut, që po t'i lexojmë ty me vërtetësi. S'ka dyshim se ti je prej të dërguarve.

Shpjegimi i ajetit

- "Këto janë argumentet e Allahut, që po t'i lexojmë ty me vërtetësi." - Këto janë ngjarje e argumente të Allahut, të cilat Ai na i tregon me vërtetësi, sikurse kanë ndodhur në realitet. Kjo bëhet që ne të marrim informacione të sigurta, dhe pastaj të nxjerrim mësime nga këto histori të vërteta.

- "S'ka dyshim se ti je prej të dërguarve." - Kjo është një dëshmi madhështore, e dhënë prej Allahut të Lartësuar për Muhamedin (a.s.). Ai dëshmon se Muhamedi (a.s.) është profet i Zotit të botëve.

Ndër argumentet e faktet më të qarta që vërtetojnë se Muhamedi (a.s.) ishte profet i Zotit të gjithësisë, janë edhe këto ngjarje historike të kohës së hershme, për të cilat Muhamedi nuk dinte asgjë më parë. Në këto rrëfime flitet për profetët e Zotit, për pasuesit e tyre të denjë, për armiqtë e profetëve, për luftërat e zhvilluara në rrugën e Zotit etj. Nëse Allahu i Lartësuar nuk do t'ia shpallte atij këto ngjarje, ai vetë nuk do të kishte mundësi që t'i tregonte me aq vërtetësi, imtësi dhe saktësi, sepse si ai, si populli i tij, mes të cilit jetonte, nuk kishin asnjë lloj njohurie rreth atyre ngjarjeve. Kjo tregon se, me të vërtetë, ai ishte profet i zgjedhur prej Zotit të botëve. Ai ishte profet që nuk fliste nga mendja e vet, por thoshte atë që dëgjonte, atë që i shpallej prej Allahut. Ai ishte Profeti i madh, të cilin Zoti e dërgoi me të vërtetën e sigurt, me fenë e përkryer, për ta bërë të triumfojë mbi çdo fe tjetër, edhe pse këtë gjithashtu gjë e urrejnë idhujtarët.

***

Në ngjarjen e mësipërme ka shumë mësime për ata që dinë të mendojnë. Kështu, nëse një popull kërkon të përparojë dhe të arrijë synimet e veta, është e domosdoshme që të mençurit dhe paria e tij të mblidhen së bashku dhe të diskutojnë qetësisht rreth problemeve dhe çështjeve që duan të zgjidhin. Ata duhet ta kuptojnë mirë çdo problem dhe pastaj të gjejnë rrugët e zgjidhjes së tij, duke punuar sipas rregullave dhe detyrave të vendosura. Kështu vepruan paria dhe të mençurit e bijve të Israilit, të cilët, për arritjen e qëllimeve që kishin, iu drejtuan Profetit të tyre. Ata dinin se ku ta kërkonin urtësinë dhe mënyrën për t'u bashkuar dhe për të gjetur një mënyrë të përbashkët. Vetëm duke ndjekur ato këshilla, ata do të bashkonin radhët, duke qenë të sigurt në kauzën e tyre.

E vërteta qartësohet më shumë kur bëhen pyetje rreth saj. Pas përgjigjes së pyetjeve,

fitohet një siguri e plotë dhe qetësuese. Kështu ndodhi edhe me bijtë e Israilit, të cilët kërkuan sqarime të hollësishme rreth meritës së Talutit për të qenë mbret i tyre. Pas përgjigjeve që morën, atyre nuk u mbeti më asnjë dyshim tjetër.


Nëse te një udhëheqës bashkohen mençuria e lartë dhe fuqia e madhe, atëherë udhëheqja e tij do të jetë e përsosur dhe efikase. Nëse nuk është njëri prej këtyre elementëve, udhëheqja e tij do të jetë e mangët. Këtë mësim e përfitojmë nga fakti se Allahu i Lartësuar, për të argumentuar meritën e Talutit për të qenë mbret, thotë se i kishte dhënë atij këto dy cilësi: dijen dhe pushtetin, apo forcën për të ekzekutuar këtë dije.

Po ashtu, mbështetja thjesht në forcat e veta, duke e harruar dhe shpërfillur ndihmën e Allahut, është shkak për humbje dhe dështim në çdo punë të nisur. Ndërsa kërkimi i ndihmës nga Allahu, lutjet drejtuar Atij, durimi dhe qëndrueshmëria janë shkaqet e suksesit dhe të fitores.

Në ngjarjen e mësipërme, në fillim, disa prej bijve të Israilit thanë: "E pse të mos luftojmë në rrugën e Allahut, kur dihet se ne jemi dëbuar nga atdheu dhe fëmijët tanë?!" Me sa duket, ky vetëbesim i tepruar i çoi ata në humbje dhe bëri që t'i kthejnë shpinën sfidës, siç thotë Allahu i Lartësuar: "Por kur u ngarkuan me detyrën për të luftuar, ata u sprapsën, përveç një pakice prej tyre."

Ndërsa grupi tjetër i besimtarëve, të cilët iu mbështetën Zotit dhe kërkuan ndihmën e Tij me durim dhe vendosmëri, merituan ndihmën e Tij dhe fitoren: "Kur dolën përballë Xhalutit dhe ushtrisë së tij, thanë: "Zoti ynë! Na dhuro durim! Na i përforco këmbët tona dhe na ndihmo kundër jobesimtarëve!""

Në të tilla sprova del qartë urtësia e madhe e Zotit, i Cili nuk do t'i lejonte kurrë njerëzit të pretendonin besimin pa i sprovuar. Prej urtësisë së Tij, është vendosur ky kriter, i cili dallon qartë të mirin nga i


الجزء الثالث سورة البقرة
تِلْكَ الرُّسُلُ فَضَّلْنَا بَعْضَهُمْ عَلَىٰ بَعْضٍ مِّنْهُم مَّن كَلَّمَ اللَّهُ
وَرَفَعَ بَعْضَهُمْ دَرَجَاتٍ ۚ وَآتَيْنَا عِيسَى ابْنَ مَرْيَمَ الْبَيِّنَاتِ
وَأَيَّدْنَاهُ بِرُوحِ الْقُدُسِ ۗ وَلَوْ شَاءَ اللَّهُ مَا اقْتَتَلَ الَّذِينَ مِن
بَعْدِهِم مِّن بَعْدِ مَا جَاءَتْهُمُ الْبَيِّنَاتُ وَلَٰكِنِ اخْتَلَفُوا
فَمِنْهُم مَّنْ آمَنَ وَمِنْهُم مَّن كَفَرَ ۚ وَلَوْ شَاءَ اللَّهُ مَا اقْتَتَلُوا
وَلَٰكِنَّ اللَّهَ يَفْعَلُ مَا يُرِيدُ ﴿٢٥٣﴾ يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا أَنفِقُوا
مِمَّا رَزَقْنَاكُم مِّن قَبْلِ أَن يَأْتِيَ يَوْمٌ لَّا بَيْعٌ فِيهِ وَلَا خُلَّةٌ وَلَا
شَفَاعَةٌ ۗ وَالْكَافِرُونَ هُمُ الظَّالِمُونَ ﴿٢٥٤﴾ اللَّهُ لَا إِلَٰهَ إِلَّا هُوَ
الْحَيُّ الْقَيُّومُ ۚ لَا تَأْخُذُهُ سِنَةٌ وَلَا نَوْمٌ ۚ لَّهُ مَا فِي السَّمَاوَاتِ
وَمَا فِي الْأَرْضِ ۗ مَن ذَا الَّذِي يَشْفَعُ عِندَهُ إِلَّا بِإِذْنِهِ ۚ يَعْلَمُ
مَا بَيْنَ أَيْدِيهِمْ وَمَا خَلْفَهُمْ ۖ وَلَا يُحِيطُونَ بِشَيْءٍ مِّنْ عِلْمِهِ إِلَّا
بِمَا شَاءَ ۚ وَسِعَ كُرْسِيُّهُ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضَ ۖ وَلَا يَئُودُهُ حِفْظُهُمَا ۚ
وَهُوَ الْعَلِيُّ الْعَظِيمُ ﴿٢٥٥﴾ لَا إِكْرَاهَ فِي الدِّينِ ۖ قَد تَّبَيَّنَ الرُّشْدُ مِنَ
الْغَيِّ ۚ فَمَن يَكْفُرْ بِالطَّاغُوتِ وَيُؤْمِن بِاللَّهِ فَقَدِ اسْتَمْسَكَ
بِالْعُرْوَةِ الْوُثْقَىٰ لَا انفِصَامَ لَهَا ۗ وَاللَّهُ سَمِيعٌ عَلِيمٌ ﴿٢٥٦﴾
٤٢

keqi, të sinqertin nga mashtruesi dhe të duruarin nga frikacaku.

Prej mëshirës së Tij, Allahu i Lartësuar e ka bërë detyrë për besimtarët që të luftojnë kundër qafirëve dhe hipokritëve, që të frenojnë të keqen dhe padrejtësitë që ata përhapin nëpër tokë. Madje, Allahu i Lartësuar na tregon se, nëse nuk do të kishte një qëndresë të forcave të mira kundër forcave të errëta, toka do të shkatërrohej. E pra, është mëshira e Allahut që përcaktoi këtë mirësi për njerëzimin. Më pas, i Lartësuari thotë:

Ajeti 253

253. Këta janë të dërguarit. Disa prej tyre i dalluam nga të tjerët. Pati prej tyre të cilëve Allahu u foli, e disa i ngriti në shkallë më të lartë. Isait, birit të Merjemes, i dhamë shenja dhe e përforcuam me Shpirtin e Shenjtë. Sikur të donte Allahu, ata që jetuan pas tyre nuk do të luftonin mes njëri-tjetrit pasi u kishin ardhur më parë shenjat hyjnore. Megjithatë, ata u përçanë.

Prej tyre pati që besuan, pati edhe që nuk besuan. Sikur të dëshironte Allahu, ata nuk do të luftonin mes njëri-tjetrit, por Allahu vepron çka dëshiron.

Shpjegimi i ajetit

- "Këta janë të dërguarit. Disa prej tyre i dalluam nga të tjerët. Pati prej tyre të cilëve Allahu u foli, e disa i ngriti në shkallë më të lartë." – Kështu, Allahu i Lartësuar na tregon se Ai i ka dalluar disa profetë mbi disa të tjerë.

Allahu i dalloi profetët mbi njerëzit e tjerë me Shpalljen hyjnore që u zbriti dhe duke i dërguar ata si ftues të popujve në adhurimin e Allahut të vetëm. Pastaj, Allahu i Lartësuar i dalloi disa prej këtyre profetëve mbi disa të tjerë, me disa veçori. Ai i bëri ata shumë të dobishëm për njerëzimin. Disave prej tyre, Ai u foli drejtpërdrejt, pa ndërmjetësinë e engjëllit Xhibril, sikurse i foli Musait, të birit të Imranit (a.s.). Ndërsa Profetin e fundit, Muhamedin (a.s.), e lartësoi mbi të gjithë. Tek ai u bashkuan të gjitha cilësitë e vyera që gjendeshin të shpërndara në profetët e tjerë. Cilësitë e tij e ngritën famën dhe madhështinë e tij mbi të parët dhe të fundit.

- "Isait, birit të Merjemes, i dhamë shenja..." - Allahu i Lartësuar i dhuroi Isait (a.s) shenja dhe mrekulli të qarta, që dëshmonin bindshëm se ai ishte profet i zgjedhur i Tij. Ato tregonin, gjithashtu, se Isai ishte një adhurues i madh i Zotit.

Isai (a.s) ishte rezultat i fjalës (Bëhu!) së Allahut të Lartësuar drejtuar Merjemes. Ai ishte një prej shpirtrave (njerëzve) që Allahu i Lartësuar e krijoi në mënyrë të mrekullueshme.

- "...dhe e përforcuam me Shpirtin e Shenjtë." - Allahu i Lartësuar e pajisi Isain (a.s.) me "*Rûĥul Ķudus*" - Shpirtin e Shenjtë.

Rreth fjalës "*Rûĥul Ķudus*", dijetarët kanë dhënë dy shpjegime, si:

1. *Rûĥul Ķudus* quhet besimi i fortë dhe siguria tek Allahu, me të cilët Ai e fuqizoi Isain (a.s.).

2. *Rûĥul Ķudus* quhet engjëlli Xhibril (a.s.). Pra, sipas këtij shpjegimi, Allahu i Lartësuar e fuqizoi Isain (a.s.) duke urdhëruar Xhibrilin (a.s.) që të qëndronte pranë tij, si ndihmë dhe mbështetje për të. Në fakt, Xhibrili (a.s.) i qëndronte vazhdimisht pranë Isait (a.s.) dhe e ndihmonte atë, me urdhrin e Zotit të gjithësisë.

- "Sikur të donte Allahu, ata që jetuan pas tyre nuk do të luftonin mes njëri-tjetrit pasi u kishin ardhur më parë argumentet." - Pas qartësimit të së vërtetës, njerëzit duhej të bashkoheshin të gjithë rreth saj, por nuk ndodhi kështu, sepse ata e kundërshtuan atë padrejtësisht:

- "Megjithatë, ata u përçanë. Prej tyre pati që besuan, pati edhe që nuk besuan. Sikur të dëshironte Allahu, ata nuk do të luftonin mes njëri-tjetrit..." – Kështu, si rezultat i kundërshtimit dhe devijimit nga e vërteta, erdhi përçarja dhe armiqësia mes tyre. Largimi nga e vërteta solli urrejtjen dhe luftërat e padrejta.

Por megjithëse largimi nga e vërteta është shkak shumë i fortë që sjell urrejtjen dhe luftën, nëse Allahu i Lartësuar do të dëshironte që kjo të mos ndodhte, ajo kurrë nuk do të ndodhte. Kjo tregon se dëshira dhe urtësia e Allahut të Lartësuar qëndrojnë mbi shkaqet. Shkaqet sjellin pasojat vetëm kur nuk bien ndesh me dëshirën dhe përcaktimin e urtë dhe të drejtë të Krijuesit. Nëse dëshira dhe urtësia e Zotit kanë vendosur për diçka të caktuar, atëherë çdo shkak bëhet i pavlefshëm. Asgjë nuk mund të sjellë në ekzistencë të kundërtën e asaj që Zoti e përcakton të jetë, me urtësinë dhe drejtësinë e Tij. Prandaj i Madhëruari thotë:

- "...por Allahu vepron çka dëshiron." - Dëshira e Tij është mbisunduese. Përcaktimi i Tij është i padiskutueshëm.

Ky ajet dhe ajete të tjera të ngjashme me të tregojnë se Allahu i Lartësuar përherë ka qenë, është dhe do të jetë dëshirues dhe veprues i çdo gjëje, sipas drejtësisë dhe urtësisë së Tij. Prej atyre gjërave që Ai bën janë edhe ato veprime rreth të cilave Allahu i Lartësuar na ka treguar në Librin e Tij dhe nëpërmjet Profetit të Tij. Në to është sqaruar se Allahu i Lartësuar ngjitet lart, zbret (në qiellin e dynjasë) apo edhe që flet. Pra, Allahu i Lartësuar na ka njoftuar për Veten e Tij, edhe Profeti (s.a.u.s.) na ka njoftuar rreth Zotit të Tij, se Ai flet dhe vepron me ato lloj fjalësh dhe veprash, që njerëzit janë mësuar t'i quajnë "veprime me vetëdije".

Këtu nuk mund të lëmë pa përmendur një dobi të rëndësishme. Një individ i përgjegjshëm ligjërisht, ashtu siç e ka detyrë që ta njohë Zotin e tij, po ashtu është i detyruar që të njohë edhe profetët e Zotit. Ai duhet të dijë hollësisht se çfarë cilësish dhe karakteristikash kanë patur profetët, çfarë duhet të besojmë për ta, e çfarë jo. Dija rreth tyre lejohet të merret veçse nëpërmjet informacionit të sigurt që kemi marrë prej Zotit në librat e shenjtë (të pacenuar në origjinalitetin e tyre). Përshkrimi i tyre është, gjithashtu, i qartë në shumë ajete të Kur'ânit. Prej tyre, mund të përmendim shkurtimisht disa karakteristika:

1. Profetët kanë qenë vetëm burra, e asnjëherë femra.

2. Ata kanë qenë gjithmonë banorë të rregullt të qendrave të banimit, e jo endacakë.

3. Ata kanë qenë të dalluar mes njerëzve, për cilësitë e tyre të mrekullueshme.

4. Ata kanë qenë të ruajtur nga çdo cilësi që do të cenonte vërtetësinë e të qenurit të tyre profetë dhe të zgjedhur të Zotit mbi njerëzit e tjerë. Kështu, nuk mund të gjesh ndonjë profet që ka qenë gënjeshtar, tradhtar, shkelës premtimesh apo që të ketë fshehur të vërtetën e sjellë prej Zotit të tij. Ata kanë qenë të ruajtur nga mangësitë e turpshme dhe të rënda.

5. Ata nuk mund të miratoheshin nga Zoti i gjithësisë nëse gabonin në çështje që lidheshin me urdhëresat dhe ligjet e Tij.

6. Allahu i Lartësuar i veçoi dhe i përzgjodhi ata për t'u shpallur udhëzimin hyjnor për njerëzimin. Për këtë arsye, është detyrë që të besojmë gjithçka që ata kanë thënë. Është detyrë që t'u bindemi çdo urdhri a ndalese të tyre. Kush nuk i beson profetët ka bërë kufër dhe konsiderohet si qafir. Ai që cenon sadopak figurën e ndonjërit prej tyre është gjithashtu qafir, që dënohet me vdekje sipas Sheriatit Islam.

Argumentet për këto që përmendëm janë të shumta. Çdokush që mediton në Kur'ân i bëhet e qartë e vërteta.

Pastaj, Allahu i Lartësuar thotë:

Ajeti 254

254. O ju që keni besuar! Shpenzoni një pjesë nga ajo me të cilën Ne ju kemi furnizuar, para se të vijë një ditë, kur nuk do të ketë më as tregti, as miqësi dhe as ndërmjetësim. Jobesimtarët, ata janë zullumqarë.

Shpjegimi i ajetit

- "O ju që keni besuar! Shpenzoni një pjesë nga ajo me të cilën Ne ju kemi furnizuar, para se të vijë një ditë, kur nuk do të ketë më as tregti, as miqësi dhe as ndërmjetësim." - Ky urdhër për të shpenzuar vetëm një pjesë të pasurisë, është mëshirë prej Allahut të Lartësuar, i Cili i nxit besimtarët që të japin prej pasurisë së tyre, qoftë pjesën e detyrueshme, qoftë edhe të pëlqyeshme. Kjo tregon mëshirën e Tij për ta, sepse çdo shpenzim për hir të Zotit do të ketë shpërblim të madh Ditën e Gjykimit, atë ditë kur çdokush do të ketë nevojë qoftë edhe për një thërrmijë mirësie, që të shpëtojë prej ndëshkimit të Xhehenemit. Atë ditë, çdo njeri do të dëshironte që të jepte si kompensim të gjithë tokën të mbushur me flori, veç që të shpëtonte nga ndëshkimi i tmerrshëm. Por, atë ditë nuk pranohet asnjë kompensim nga krijesat. Atë ditë nuk do të

bëjë dobi as i dashuri, as miku e shoku, as pushteti dhe as lidhjet e ngushta. Asgjë e asnjë nuk mund ta shpëtojë robin, as me ndërmjetësim e as me pasuri. Ajo është dita e dështimit për të humburit. Ajo është dita e dëshpërimit për të padrejtët. Atë ditë do të dëshpërohen të gjithë ata që neglizhuan të drejtat e detyrimet e tyre dhe ata të cilët nuk i dhanë hakun atij që e meritonte, domethënë ata që nuk i plotësuan detyrimet ndaj Allahut dhe detyrimet ndaj krijesave. Ata e kanë shpërfillur hallallin dhe e kanë tepruar me harame.

Megjithatë, padrejtësia më e madhe është kufri, mohimi i Zotit dhe të adhuruarit e dikujt tjetër veç Tij. Adhurimet të cilat njeriu duhet t'ia përkushtojë Allahut të Lartësuar, qafiri ia përkushton dikujt tjetër, duke adhuruar krijesat, në vend të Krijuesit. Prandaj i Madhëruari thotë:

- "Jobesimtarët, ata janë zullumqarë." - Nga kjo fjali kuptohet një lloj përkufizimi i padrejtësisë vetëm te këta njerëz. Pra, të padrejtët dhe mizorët më të mëdhenj janë pikërisht dhe vetëm mohuesit. Vërtet që kufri ose shirku është padrejtësia më e madhe, siç thotë Allahu i Lartësuar në suren Lukman: "Shirku është pa dyshim, padrejtësia më e madhe."

Ajeti 255

255. Allahu është Një! Nuk ka të adhuruar tjetër përveç Tij. Ai është *El Haj-ju* dhe *El Kaj-jûm*. Atë nuk e kap dremitja dhe as gjumi. Vetëm e Tij është gjithçka, në qiej dhe në tokë. Askush nuk mund të ndërmjetësojë tek Ai, përveç se me lejen e Tij. Ai e di të tashmen dhe të ardhmen. Të tjerët dinë vetëm aq sa Ai ka dëshiruar t'u mësojë, nga ajo që Ai di. *Kursijj*-a e Tij përfshin qiejt dhe tokën. Atë nuk e lodh përkujdesi ndaj të dyjave. Ai është i Larti, i Madhi.

Shpjegimi i ajetit

Ky ajet është ajeti më madhështor i Kur'ânit. Ai është ajeti më i mirë, më i vyer dhe më i dobishëm, sepse ai bart në vetvete shpjegime për çështje madhështore. Ai përmban cilësitë më të bukura të Zotit të Lartësuar. Janë të shumta hadithet e përcjella nga Profeti (s.a.u.s.) për dobitë dhe mirësitë e këtij ajeti. Në këto hadithe jemi nxitur që ta shpeshtojmë leximin e këtij ajeti në gjendje dhe momente të ndryshme, madje në mënyrë të përditshme. Ne nxitemi që ta lexojmë këtë ajet në mëngjes e në mbrëmje, para gjumit, pas namazeve farze etj. Vërtet, ky ajet është shumë i rëndësishëm dhe i dobishëm.

Allâhu, lã ilâhe il-lâ huel Ĥaj-jul Ķaj-jûm.

- "Allahu është Një! Nuk ka të adhuruar tjetër përveç Tij. Ai është *El Haj-ju* dhe *El Kaj-jûm*." - Allahu i Lartësuar na tregon për Veten e Tij, se nuk ka të adhuruar tjetër me meritë përveç Tij. Askush tjetër nuk meriton të adhurohet me dashuri e madhërim, veç Allahut. Të gjitha adhurimet duhen bërë veçse për Të, sepse vetëm Ai është i Absoluti në cilësitë e Tij. Mirësitë e Tij janë madhështore të pakufishme. Vetëm Allahu e meriton të adhurohet, sepse çdo gjë tjetër është krijesë, dhe çdo krijesë e ka të domosdoshme që të jetë e nënshtruar dhe e bindur ndaj urdhrave të Tij.

Robi e meriton që të jetë i nënshtruar dhe adhurues i Zotit të vet. Ai nuk duhet kurrsesi t'i shpërfillë urdhrat e Allahut dhe kurrë nuk duhet të guxojë që t'u afrohet ndalesave të Tij. Çdo gjë tjetër, veç Allahut, është e kotë dhe nuk e meriton që të adhurohet, t'i nënshtrohesh dhe që t'i bindesh. Çdo gjë, veç Krijuesit, është krijesë, dhe si e tillë, ajo është e mangët e nënshtruar dhe nevojtare në çdo aspekt për kujdesin e Krijuesit të saj. E si mund t'i adhurosh krijesat?! Asnjë lloj adhurimi nuk lejohet që t'ua përkushtosh krijesave.

El Haj-ju dhe *El Kaj-jûm* janë dy emrat më të mëdhenj të Allahut. Ata përmbajnë në vete të gjithë emrat dhe cilësitë e Zotit të

gjithësisë, nëse i sheh në dy aspektet e tyre kuptimore: në aspektin e drejtpërdrejtë dhe në aspektin deduktiv.

Kështu, në kuptimin e drejtpërdrejtë, *El Haj-ju* quhet ai që gëzon jetën e plotë nga çdo aspekt, pa asnjë mangësi. Nëse Allahu ka këtë emër dhe cilësi, atëherë patjetër që duhet të ketë edhe cilësi të tjera absolute të Qenies së Tij, sikurse janë: të dëgjuarit, të shikuarit, dituria, pushteti, fuqia etj., sepse ndryshe Ai nuk do ta meritonte të quhej *El Haj-ju*, me kuptimin e plotë të kësaj fjale.

Emri i Allahut *El Kaj-jûm* tregon se Ai nuk ka nevojë për asgjë dhe për asnjë përkujdesje, ndërkohë që gjithçka tjetër ka nevojë për përkujdesjen e Tij. Ky është kuptimi i drejtpërdrejtë i emrit *El Kaj-jûm*. Nga ana tjetër, prej kuptimit të këtij emri rrjedh se Allahu, që quhet i tillë, duhet të ketë edhe emra e atribute të tjera që tregojnë se Ai është absolut në veprat e Tij. Çdo vepër e Zotit për të cilën Ai vetë na e ka përshkruar në Kur'ân ose nëpërmjet Profetit të Tij, është tregues dhe rrjedhojë e të qenurit të Tij *El Kaj-jûm*. Nuk ka cilësi absolute që të mos i përkasë *El Kaj-jûm*-it, sepse emri *El Kaj-jûm* kërkon që të jesh i cilësuar me atribute, të cilat tregojnë madhështinë dhe përsosmërinë e veprave dhe të urtësisë. Këtu përfshihen, gjithashtu, të gjitha atributet e Zotit që tregojnë për veprimet e Tij, si për shembull, fakti që Ai bën gjithçka që dëshiron, apo që Ai ngrihet lart dhe zbret, apo që Ai i flet ndonjë krijese ku dhe kur të dëshirojë Ai, apo që Ai krijon, furnizon, jep jetë, jep vdekje e ringjall. Çdo lloj përkujdesjeje vjen prej Atij që është i quajtur *El Kaj-jûm*. Gjithçka që ndodh në botë bën pjesë në veprimet e *El Kaj-jûm*-it.

Për këtë kuptim kaq të gjerë e gjithëpërfshirës që kanë këta dy emra, disa dijetarë të mëdhenj kanë thënë se ata të dy bashkë përbëjnë atë emër të madh të Allahut, që, nëse i lutesh Atij me të (*El Haj-ju - El Kaj-jum*), Allahu nuk ta kthen mbrapsht lutjen dhe të përgjigjet; nëse i kërkon Allahut diçka duke iu drejtuar me këtë emër (të përbërë), Ai ta jep atë gjë.

Allahu i Lartësuar është vërtet *El Haj-ju El Kajjum*, dhe këtë fakt Ai e shtjellon në vijim, duke thënë:

Lâ te'ħudhuhû sinetu-ue lâ neûm
- "Atë nuk e kap dremitja dhe as gjumi." - E si mund ta kapë dremitja apo gjumi Atë që quhet *El Haj-ju El Kaj-jum*?!

lehû ma fis-semâuâti ue mâ fil erđ
- "Vetëm e Tij është gjithçka në qiej dhe në tokë." - Allahu është Sunduesi dhe Pronari i gjithçkaje. Çdo gjë është e nënshtruar dhe pronë e Tij. Ai është Krijuesi, Furnizuesi, Administrues e Kujdestari i gjithçkaje. Çdo gjë tjetër, veç Atij, është krijesë, që ka nevojë për furnizimin dhe përkujdesjen e të Mëshirshmit. Krijesat nuk kanë në dorë asnjë grimcë pushteti, as në qiej dhe as në tokë. Prandaj i Madhëruari thotë më tej:

men dhal-ledhî jeshfeu indehũ il-lâ bi idhnih
- "Askush nuk mund të ndërmjetësojë tek Ai, përveç se me lejen e Tij." - Askush nuk mund të ndërmjetësojë tek Allahu, pa i dhënë leje vetë Ai, Sunduesi i botës.

Ndërmjetësimi dhe ndihma janë plotësisht në dorën e Allahut të Lartësuar. Nëse i Madhëruari dëshiron të mëshirojë ndonjë prej krijesave të Tij, atëherë Ai lejon dikë tjetër, që është prej krijesave të nderuara dhe të zgjedhura të Tij, që të ndërmjetësojë për të parin. Po ashtu, ndërmjetësuesi nuk mund ta fillojë ndërmjetësimin pa i dhënë leje Allahu i Lartësuar.

jea'lemu mâ bejne ejdîhim ue mâ ħalfehum. Ue lâ juĥîtûne bi shejim-min ilmihî il-lâ bimâ shãe
- "Ai e di të tashmen dhe të ardhmen. Të tjerët dinë vetëm aq sa Ai ka dëshiruar t'u mësojë, nga ajo që Ai di." - Ai i di në hollësi të gjitha gjërat: të shkuarat, të sotmet dhe të ardhmet. Allahu përfshin me dijen e Tij të gjitha çështjet, në imtësi. Ai i njeh të dukshmet dhe të fshehtat. Ndërsa krijesat

dinë dhe veprojnë veçse aq sa u ka mundësuar Ai.

Uesia Kursij-juhus-semâuâti uel erd. Ue la je'ûduhû ĥifdhuhumâ

- "*Kursij-j*-a e Tij përfshin qiejt dhe tokën. Atë nuk e lodh përkujdesi ndaj të dyjave."

– *Kursij-j* (kuptimi i drejtpërdrejtë gjuhësor: "karrige, stol, ndenjëse") quhet vendi në këmbët e Fronit të Allahut. Kjo tregon për madhështinë e Tij dhe për pushtetin e Tij absolut. *Kursijj*-a nuk është krijesa më e madhe që Allahu ka krijuar. Froni i Tij është, për shembull, shumë herë më i madh se *Kursijj*-a, por ka edhe krijesa të tjera që janë më të mëdha se ajo, të cilat i di veçse Allahu i Madhëruar.

Pra, duke qenë se *Kursijj*-a përfshin qiejt e gjerë e madhështorë, tokën dhe gjithçka që gjendet mes qiejve dhe tokës, atëherë ç'mund të thuash për Fronin e Allahut? Çfarë mund të thuash për ato që janë më të mëdha se *Kursijj*-a?! Të gjitha këto dëshmojnë për madhështinë e Krijuesit. Vetëm madhështia e këtyre krijesave trullos mendjen, verbon shikimin, trondit malet dhe habit burrat më të mençur. Atëherë, çfarë mund të themi për madhështinë e Krijuesit të tyre. Çfarë do të mendonim për Atë që, mes këtyre krijesave, ka vendosur urtësi dhe të fshehta të mrekullueshme? Çfarë do të mendonim për Atë që përkujdeset për botën dhe gjithë krijesat e Tij, pa u lodhur dhe pa e patur të vështirë? Thotë i Lartësuari:

ue huel alij-jul Aдhîm.

- "Ai është i Larti, i Madhi." – Allahu është i Larti (*Alijju*), që ndodhet mbi Fronin e Tij. Ai është i Larti, që ka nënshtruar çdo krijesë me pushtetin e Tij. Ai është i Larti, me emrat dhe cilësitë më të larta të Tij.

Allahu është i Madhi (*El Adhîm*). Para madhështisë së Tij zhduket pushteti dhe mbretërimi i tiranëve më të mëdhenj. Përpara madhështisë së Tij nënshtrohen e poshtërohen edhe mbretërit më të ashpër. I lavdishëm qoftë Allahu, i Madhërishmi, Krenari, i Lartësuari, i Pushtetshmi, i Pamposhturi dhe Nënshtruesi i gjithçkaje.

Ky ajet i përfshin të trija llojet e teuhidit: *rububije*, *uluhije* dhe teuhidin e emrave dhe të cilësive të Allahut. Ai tregon për gjithëpërfshirjen e pushtetit, pasurisë dhe dijes së Allahut. Ajeti tregon për lartësinë dhe fuqinë e Tij mbi çdo krijesë. Ky ajet është sqarues i besimit të muslimanit në emrat, cilësitë dhe veprat e Zotit të tij. Në të gjenden emrat dhe cilësitë më madhështore të Allahut.

Ajeti 256

256. Në fe nuk ka dhunë. Është sqaruar e vërteta nga e kota. Kush e braktis *tagut*-in dhe beson Allahun, ai është kapur pas lidhjes më të fortë, e cila kurrë nuk këputet. Allahu është Dëgjues e i Gjithëdijshëm.

Shpjegimi i ajetit

- "Në fe nuk ka dhunë. Është sqaruar e vërteta nga e kota" - Allahu i Lartësuar na tregon se në fe nuk duhet të ketë dhunë, sepse është diçka e panevojshme. Dhuna apo detyrimi me pahir bëhet veçse për çështje të errëta, të papranueshme, me shenja e argumente të paqarta, ose për ndonjë çështje shumë të urryer për shpirtin. Ndërsa kjo fe e drejtë është shumë e qartë, e pranueshme dhe e kuptueshme për shpirtin. Bazat e saj janë shumë të qarta. Rrugët e transmetimit të saj deri tek ne janë të sigurta dhe të verifikueshme. Çështjet e Islamit janë të shtjelluara e të shpjeguara shumë qartë. Me këtë fe është ndarë e drejta nga e gënjeshtërta. Mjafton për një njeri të mençur që t'i hedhë vetëm një vështrim të shkurtër kësaj feje, dhe patjetër që do ta pëlqejë dhe do ta dëshirojë për veten e vet.

Ndërsa qëllimprishurit apo shpirtzinjtë e shohin qartë të vërtetën, por me vetëdije zgjedhin të kotën. Ata e shohin të mirën, por shkojnë tek e shëmtuara. Të tillë njerëz nuk ia vlen të detyrohen për të pranuar këtë fe madhështore. Allahu nuk ka nevojë për adhurimin e askujt, aq më tepër, të këtyre të

prishurve. Nuk është e nevojshme që këta të detyrohen të pranojnë fenë e Allahut, sepse është e padobishme dhe e pafrytshme. Kush e pranon fenë i detyruar, nuk e ka besimin të saktë, madje e ka të papranueshëm.


Megjithatë, ky ajet nuk tregon aspak se lufta ndaj qafirëve agresorë është e ndaluar. Kuptimi i tij është se kjo fe, me mrekullinë e saj, e bën çdo mendjekthjellët e zemërpastër që ta pranojë me vullnet të lirë atë, pa qenë e nevojshme që të detyrohet me forcë për një gjë të tillë. Këtu nuk ceket aspak çështja e luftës kundër qafirëve, e cila trajtohet në ajete të tjera.

Ky ajet mund të shërbejë si argument që fakton se lejohet marrja e xhizjes edhe nga jomuslimanët e tjerë, përveç të krishterëve e çifutëve, sikurse thonë shumë dijetarë.

- "Kush e braktis *tagut*-in dhe beson Allahun, ai është kapur pas lidhjes më të fortë, e cila kurrë nuk këputet" - Ai që mohon dhe refuzon adhurimin e gjithçkaje tjetër veç Allahut, dhe i largohet bindjes dhe pasimit të rrugës së shejtanit, dhe pastaj beson sinqerisht Allahun, duke patur një iman të pastër, që e nxit për ta adhuruar dhe për t'iu bindur plotësisht Zotit të tij, pra, ky njeri është lidhur fort me fenë e drejtë dhe të saktë. Ai ka përqafuar fenë, themelet e së cilës janë të patundshme. Kush e pranon këtë fe do të jetë shumë i sigurt dhe i qartë në rrugën e tij, sepse ai është kapur fort pas një lidhjeje që nuk këputet dhe që nuk të lë kurrë në baltë.

Ndërsa çdokush tjetër që vepron të kundërtën, e ka zgjidhur e lëshuar këtë lidhje, që është e vetmja mundësi shpëtimi dhe ruajtjeje nga ndëshkimi i përjetshëm. Çdokush që mohon Allahun dhe adhuron idhujt (*tagut*), shpreson veçse diçka të kotë, që e ka përfundimin në Zjarrin e përjetshëm.

- "Allahu është Dëgjues e i Gjithëdijshëm." - Allahu di çdo gjë dhe synimet e çdokujt. Ai do ta shpërblejë secilin me drejtësi, sipas veprave që ka bërë dhe


الجزء الثالث سورة البقرة
اللَّهُ وَلِيُّ الَّذِينَ آمَنُوا يُخْرِجُهُم مِّنَ الظُّلُمَاتِ إِلَى النُّورِ ۖ
وَالَّذِينَ كَفَرُوا أَوْلِيَاؤُهُمُ الطَّاغُوتُ يُخْرِجُونَهُم مِّنَ
النُّورِ إِلَى الظُّلُمَاتِ ۗ أُولَٰئِكَ أَصْحَابُ النَّارِ ۖ هُمْ فِيهَا
خَالِدُونَ ﴿٢٥٧﴾ أَلَمْ تَرَ إِلَى الَّذِي حَاجَّ إِبْرَاهِيمَ فِي رَبِّهِ
أَنْ آتَاهُ اللَّهُ الْمُلْكَ إِذْ قَالَ إِبْرَاهِيمُ رَبِّيَ الَّذِي يُحْيِي
وَيُمِيتُ قَالَ أَنَا أُحْيِي وَأُمِيتُ ۖ قَالَ إِبْرَاهِيمُ فَإِنَّ اللَّهَ يَأْتِي
بِالشَّمْسِ مِنَ الْمَشْرِقِ فَأْتِ بِهَا مِنَ الْمَغْرِبِ فَبُهِتَ الَّذِي
كَفَرَ ۗ وَاللَّهُ لَا يَهْدِي الْقَوْمَ الظَّالِمِينَ ﴿٢٥٨﴾ أَوْ كَالَّذِي
مَرَّ عَلَىٰ قَرْيَةٍ وَهِيَ خَاوِيَةٌ عَلَىٰ عُرُوشِهَا قَالَ أَنَّىٰ يُحْيِي
هَٰذِهِ اللَّهُ بَعْدَ مَوْتِهَا ۖ فَأَمَاتَهُ اللَّهُ مِائَةَ عَامٍ ثُمَّ بَعَثَهُ ۖ
قَالَ كَمْ لَبِثْتَ ۖ قَالَ لَبِثْتُ يَوْمًا أَوْ بَعْضَ يَوْمٍ ۖ قَالَ بَل
لَّبِثْتَ مِائَةَ عَامٍ فَانظُرْ إِلَىٰ طَعَامِكَ وَشَرَابِكَ لَمْ يَتَسَنَّهْ ۖ
وَانظُرْ إِلَىٰ حِمَارِكَ وَلِنَجْعَلَكَ آيَةً لِّلنَّاسِ ۖ وَانظُرْ إِلَى
الْعِظَامِ كَيْفَ نُنشِزُهَا ثُمَّ نَكْسُوهَا لَحْمًا ۚ فَلَمَّا
تَبَيَّنَ لَهُ قَالَ أَعْلَمُ أَنَّ اللَّهَ عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ ﴿٢٥٩﴾
٤٣

sipas qëllimeve që ka patur. Qoftë ata që u lidhën me të vërtetën dhe ndoqën rrugën e drejtë, qoftë ata që e shpërfillën dhe e lëshuan atë lidhje, të gjithë do të marrin shpërblimin që meritojnë.

Më pas, Allahu i Lartësuar na tregon shkakun e zgjedhjeve të ndryshme që bëjnë njerëzit:

Ajeti 257

257. Allahu është i dashuri i atyre që besojnë dhe i nxjerr ata prej errësirave në dritë. Ndërsa kujdestarë të atyre që nuk besojnë janë shejtanët, të cilët i nxjerrin ata prej drite për t'i futur në errësira. Këta janë banorë të Zjarrit, ku do të qëndrojnë përjetësisht.

Shpjegimi i ajetit

- "Allahu është i dashuri i atyre që besojnë..." - Allahu është i dashuri i atyre që besojnë, sepse ata e kanë zgjedhur Allahun si mikun dhe të dashurin e tyre. Ata e kanë

pranuar dhe janë të kënaqur që Ai të jetë i dashuri dhe kujdestari i çështjeve të tyre. Ata nuk e largojnë për asnjë çast vëmendjen, përkushtimin dhe dashurinë e tyre prej Tij. Ata nuk adhurojnë asnjë e asgjë tjetër, veç Tij. Vetëm Atij i shprehin dashurinë dhe madhërimin e tyre të plotë. Për hir të kësaj dashurie për Allahun, ata i përmirësojnë veprat e fjalët e tyre. Për hir të Zotit, ata i shfaqin urrejtjen dhe armiqësinë jobesimtarëve, armiqve të Tij. Nga ana tjetër, Allahu i Lartësuar i ka dalluar e veçuar ata me dashurinë dhe mirësitë e Tij.

- "...dhe i nxjerr ata prej errësirave në dritë." - Prej mëshirës dhe dashurisë së Allahut për ta, është edhe udhëzimi i tyre në rrugën e drejtë, duke i nxjerrë ata prej errësirave në dritë.

Errësirat që mbulojnë njerëzit janë të shumta: errësira e kufrit, errësira e mosbindjes ndaj Zotit të Lartësuar, errësira e injorancës etj. I Dashuri i besimtarëve i shpëtoi ata prej këtyre errësirave, duke i nxjerrë ata në dritën e qartë të besimit, bindjes ndaj Tij dhe në dritën e dijes së dobishme, të sigurt e të vërtetë të ardhur prej Tij.

Shpërblimi ndaj punëmirëve është i shumëfishtë. Ata do të jenë të sigurt, të qetë e të ruajtur nga tmerri i errësirës së varrit dhe errësirës së Ditës së Ringjalljes. Ata do të jenë të ruajtur prej këtyre errësirave, për t'u lumturuar me mirësinë e përjetshme, në prehjen e amshuar. Ata do të shijojnë përgjithmonë gëzimin e dhuruar prej të Dashurit të tyre, Allahut të Mëshirshëm.

- "Ndërsa kujdestarë të atyre që nuk besojnë janë shejtanët..." - Miku i atyre që mohojnë Zotin e gjithësisë është Shejtani i mallkuar, i dëbuar nga mëshira e të Madhërishmit. Ata e kanë zgjedhur Shejtanin dhe ushtrinë e tij si mikun dhe të dashurin e tyre. Ata i kanë shprehur atij dashurinë dhe nënshtrimin e tyre, në vend që këtë ta bënin për Krijuesin, që aq shumë përkujdeset për ta. Për shkak të asaj padrejtësie nga ana e tyre, Allahu i Lartësuar u la shejtanëve rrugë të lirë kundër këtyre mosmirënjohësve.

- "...të cilët i nxjerrin ata prej drite për t'i futur në errësira." - Për këtë arsye, ata i zhysin mohuesit thellë e më thellë në mosbindjen dhe poshtërsitë e tyre ndaj Krijuesit. Ata vazhdimisht i nxisin ata në rrugët e së keqes, për të mos dalë kurrë prej tyre. Ata i privojnë miqtë e tyre nga drita e besimit, e bindjes ndaj Zotit dhe e dijes së dobishme, që të udhëzon në çdo të mirë të dynjasë dhe ahiretit. Ata i zhysin miqtë e tyre thellë e më thellë në errësirat e mohimit, mosbindjes ndaj Zotit dhe injorancës rreth çdo të mire. Ndëshkimi i tyre në këtë jetë do të jetë, si fillim, privimi nga të mirat dhe dhuratat e Zotit të gjithësisë. Ata i kanë humbur përfundimisht mirësitë e përjetshme, gëzimin dhe lumturinë që do të shijojnë besimtarët, të dashurit e Zotit, sepse ata vetë kanë parapëlqyer dashurinë dhe miqësinë me Shejtanin dhe ushtrinë e tij. Dhe më pas, ata do të ringjallen sërish bashkë, por tashmë duke vuajtur ndëshkimin e përjetshëm të ahiretit. Prandaj thotë i Madhëruari:

- "Këta janë banorë të Zjarrit, ku do të qëndrojnë përjetësisht."

Ajeti 258

258. A nuk e ke parë atë që polemizoi me Ibrahimin rreth Zotit të tij, pasi Allahu i kishte dhënë pushtet të madh? Kur Ibrahimi tha: "Zoti im është Ai që jep jetë dhe vdekje!" Ai tha: "Edhe unë jap jetë dhe shkaktoj vdekje!" Ibrahimi tha: "Zoti im e sjell diellin nga lindja, sille ti nga perëndimi!" Atëherë, ai që nuk besonte mbeti i hutuar. Allahu nuk i udhëzon në rrugë të drejtë njerëzit zullumqarë.

Shpjegimi i ajetit

- "A nuk e ke parë atë që polemizoi me Ibrahimin rreth Zotit të tij, pasi Allahu i kishte dhënë pushtet të madh?" - Domethënë, a ke mësuar, a di për injorancën, paturpësinë dhe kokëfortësinë e atij që polemizonte për çështje që nuk lënë vend për dyshime?

Ai u tregua i tillë veçse për një shkak: sepse Allahu i kishte dhënë pushtet e pasuri të madhe. Kjo e kishte bërë atë që të kalonte kufijtë dhe të ishte mizor me popullin e tij. Arroganca e kishte shtyrë, gjithashtu, që të polemizonte me Ibrahimin (a.s.) rreth Zotit të gjithësisë, duke pretenduar, madje, se ishte i barabartë me Zotin dhe mund të bënte gjithçka që bënte edhe Zoti.

- "Kur Ibrahimi tha: "Zoti im është Ai që jep jetë dhe vdekje!"" - Ibrahimi (a.s.) i tregoi një fakt shumë të rëndësishëm për t'u kuptuar: se Allahu ka pushtetin absolut për të administruar çdo çështje, se në dorën e Tij është gjithçka. Për ta sqaruar këtë, Ibrahimi (a.s.) u mjaftua duke përmendur një nga fuqitë më të mëdha që janë në dorën e Zotit: dhënien e jetës dhe marrjen e saj. Dhënia e jetës është zanafilla e saj në këtë dynja, ndërsa vdekja shënon fillimin e dytë të jetës: atë të ahiretit.

Por ky polemizues kryeneç përgjigjet :

- "Ai tha: "Edhe unë jap jetë dhe shkaktoj vdekje!"" - Po ta vështrojmë me kujdes, ai nuk ka thënë: "Unë jam ai që jap jetë dhe jap vdekje". Pra, ai po dredhonte në mënyrën e argumentimit, duke bërë lojra fjalësh.

Ai kurrsesi nuk mund të pretendonte se dhënia e jetës apo vdekja ishin në dorën e tij. Ai mendonte se, duke urdhëruar që një njeri të ekzekutohej, në këtë mënyrë kishte dhënë vdekjen, dhe nëse urdhëronte që të lihej gjallë, në këtë mënyrë kishte dhënë jetë. Kështu, ai mendonte se bënte të njëjtën gjë si edhe Allahu i Lartësuar. Por ky krahasim nuk ishte aspak i drejtë dhe i pranueshëm për një polemikë.

Kur Ibrahimi (a.s.) e pa se ai nuk po polemizonte sipas rregullave dhe nuk po bënte asnjë argumentim të drejtë, i solli atij një tjetër fakt, të cilit ai nuk mund t'i bënte bisht apo ta kalonte me lojra fjalësh.

- "Ibrahimi tha: "Zoti im e sjell diellin nga lindja, sille ti nga perëndimi!"" – Kështu, Ibrahimi (a.s.), duke marrë në konsideratë mënyrën argumentuese të kundërshtarit, i tha se meqë Allahu e sjell diellin nga lindja, le ta sillte ai nga perëndimi. Me fjalë të tjera: "Nëse vërtet mendon se ti ke pushtet të barabartë me Zotin dhe mund të kryesh çdo gjë që e kryen Zoti, atëherë bëje këtë që të them. Sille diellin nga perëndimi!"

Përpara kësaj sfide të Ibrahimit, kundërshtari mbeti i habitur dhe i çarmatosur.

- "Atëherë, ai që nuk besonte mbeti i hutuar." – Pra, u çorodit, u turbullua dhe nuk mund të kthente një përgjigje. Me kaq, polemika mori fund dhe dyshimet e tij u hodhën poshtë.

Çdo kryeneç e arrogant që kërkon të kundërshtojë të vërtetën, do të ketë gjithmonë të njëjtin përfundim. Ai gjithmonë ka për të qenë i mposhtur, sepse Allahu i Lartësuar thotë:

- "Allahu nuk i udhëzon në rrugë të drejtë njerëzit zullumqarë." – Pra, Allahu do t'i lërë ata gjithmonë të zhytur në kufrin dhe humbjen e tyre, sepse kjo është vetë zgjedhja e tyre. Ata e kanë zgjedhur me vullnet humbjen dhe mohimin. Nëse ata do të kërkonin udhëzimin dhe rrugën e drejtë, Allahu i Lartësuar do t'u mundësonte atyre çdo mënyrë dhe rrugë që ata t'i gjenin.

Ky ajet është argument i prerë i qartë që vërteton se Allahu i Lartësuar është absolutisht i vetëm në zotërimin dhe pushtetin e Tij mbi gjithçka. Ky fakt bën të detyrueshëm që Ai të veçohet dhe të adhurohet si Një i vetëm. Vetëm Atij duhet t'i përkushtojmë çdo adhurim, vetëm tek Ai

duhet të kthehemi të penduar, të përkushtuar me nënshtrim dhe bindje, vetëm Ai e meriton që t'i mbështetesh e t'i kërkosh zgjidhje për gjithçka dhe në të gjitha gjendjet.

Për ngjarjen e treguar në ajet, imam Ibn Kajimi (Allahu e mëshiroftë!) ka thënë: "Në këtë dialog mes Ibrahimit (a.s.) dhe atij mbreti, fshihet diçka e bukur dhe shumë e vërtetë. Politeizmi në botë është shfaqur mbi dy koncepte kryesore të gabuara: ose mbi adhurimin e yjeve dhe trupave qiellorë, ose mbi adhurimin e varreve apo të të vdekurve. Pikërisht këto dy koncepte kryesore idhujtarie kanë marrë pamje e forma të ndryshme nga njerëzit. Kështu, në përgjithësi, idhujt kanë format e pamjet ose të trupave qiellorë, ose të njerëzve që kanë vdekur. Ndërsa Ibrahimi (a.s.), me dy argumentet që solli, në mënyrë tepër të zgjuar, i hodhi poshtë të dyja këto forma idhujtarie kaq të përhapura në botë.

Me argumentin e parë që solli, Ibrahimi (a.s.) vërtetoi që i vetmi që mbizotëron, sundon dhe vepron në këtë botë është Allahu i Lartësuar. Të gjithë i janë nënshtruar pushtetit dhe sundimit të Tij. Të gjithë jetojnë dhe vdesin sipas përcaktimit dhe pushtetit të Tij. Nga kjo kuptohet që asnjë krijesë e nënshtruar ndaj Zotit nuk meriton që të adhurohet, duke i kushtuar dashuri, madhërim dhe bindje totale, sepse kjo është e drejta e Atij që i sundon krijesat. Si mund ta lësh adhurimin e Sunduesit, Dhuruesit të jetës dhe të vdekjes, dhe të adhurosh atë, jeta dhe vdekja e të cilit është në dorën e dikujt tjetër? Krijesat nuk kanë mundësi të bëjnë as dëm, as dobi, qoftë kur janë gjallë, qoftë kur janë të vdekura. Atëherë, si mund të konsiderohet si zot dhe të adhurohet një gjë kaq e pafuqishme?! Si mund të adhurohen këta idhuj dhe jo i Plotfuqishmi?!

Në argumentin e dytë, Ibrahimi (a.s.) përmend diellin, një prej trupave qiellorë më të spikatur dhe më të dobishëm, që shumë njerëz e kanë adhuruar. Ibrahimi (a.s.) thotë se ky diell është nën drejtimin dhe pushtetin e të Plotpushtetshmit, Allahut të Madhëruar. Dielli, pra, është i nënshtruar dhe lëviz sipas caktimit të dikujt tjetër. Dielli nuk ka pushtet mbi asgjë. Ai thjesht lëviz dhe vepron sipas ligjeve të vendosura nga Krijuesi i tij. Me fjalë të tjera, trupat qiellorë nuk e meritojnë adhurimin e krijesave, sepse edhe ata janë të krijuar dhe të nënshtruar ndaj pushtetit të të Plotfuqishmit." (Marrë nga libri "Çelësi i derës së lumturisë"). Më pas, i Lartësuari thotë:

Ajeti 259

259. Po për atë që kaloi pranë një vendbanimi të rrënuar që nga themelet dhe tha: "E si mund ta risjellë Allahu në jetë këtë, pas këtij shkatërrimi?" Allahu e la atë të vdekur për njëqind vjet, pastaj e ringjalli dhe i tha: "Sa qëndrove ashtu *(i vdekur)*?" Ai tha: "Një ditë, ose një pjesë të ditës." Allahu i tha: "Jo, ti ke ndenjur ashtu për njëqind vjet. Shikoje ushqimin dhe pijen tënde! Ato nuk janë prishur fare. Shikoje edhe gomarin tënd! E për të bërë ty argument për njerëzit, shiko se si i lidhim sërish eshtrat dhe pastaj i veshim me mish!" Kur atij iu bë e qartë kjo, tha: "U binda se Allahu është vërtet i Plotfuqishëm për gjithçka!"

Shpjegimi i ajetit

Edhe ky është një argument tjetër që tregon se Allahu i Lartësuar është i Vetëm në pushtetin e tij mbi krijesat. Ai është i Vetmi që jep jetën dhe vdekjen dhe që përkujdeset për gjithçka.

- **"Po për atë që kaloi pranë një vendbanimi të rrënuar që nga themelet dhe tha:.." –** Ky njeri shkoi pranë një vendbanimi të rrënuar e pa banorë. Shtëpitë ishin të shëmbura, ndërsa të gjithë banorët kishin vdekur. Aty kishte humbur çdo shenjë jete. Vendi kishte një pamje të shkretë dhe të frikshme. Duke parë këtë skenë, ky njeri tha:

- "E si mund ta risjellë Allahu në jetë këtë, pas këtij shkatërrimi?" - Ai e shihte shumë të vështirë një gjë të tillë, për shkak të padijes që kishte rreth pushtetit dhe fuqisë së Allahut të Lartësuar.

Megjithatë, Allahu i Lartësuar, duke dashur të mirën për këtë njeri, i tregoi atij një shenjë në veten e tij dhe në gomarin që ai mbante me vete. Njeriu kishte me vete edhe ca ushqim e pije. Kështu, i Lartësuari tregon:

- "Allahu e la atë të vdekur për njëqind vjet, pastaj e ringjalli dhe i tha: "Sa qëndrove ashtu *(i vdekur)*?" Ai tha: "Një ditë, ose një pjesë të ditës." - Njeriut iu duk një kohë shumë e shkurtër, sepse ai i kishte humbur të gjitha ndjesitë gjatë vdekjes, pas së cilës u ringjall në të njëjtën periudhë të vitit me kohën kur vdiq.

- "Allahu i tha: "Jo, ti ke ndenjur ashtu për njëqind vjet. Shikoje ushqimin dhe pijen tënde! Ato nuk janë prishur fare." -. Pra, ato nuk kishin ndryshuar aspak gjendjen e tyre, ndonëse kishin kaluar gjithë ato stinë e vite. Kjo dëshmon për fuqinë e Allahut, i Cili i ruajti ushqimin dhe pijen që të mos ndikoheshin nga faktori kohë dhe të mos prisheshin. Dihet që ushqimi dhe pija janë gjëra që prishen shumë shpejt.

- "Shikoje edhe gomarin tënd!" - Gomari i tij kishte ngordhur dhe ishte tretur tërësisht. Atij i kishin dalë kockat, të cilat i ishin shpërbërë dhe i ishin shpërndarë andej-këtej.

- "E për të bërë ty argument për njerëzit..." – Kuptimi: Allahu i Lartësuar do ta bëjë këtë njeri argument për njerëzit, duke treguar qartë fuqinë e plotë të Tij për të ringjallur të vdekurit nga varri. Kjo provë do të shihej me sy dhe do të përjetohej në realitet. Allahu i Lartësuar e bëri këtë, që të vërtetonte fjalët e profetëve rreth ringjalljes dhe Ditës së Llogarisë.

- "...shiko se si i lidhim sërish eshtrat dhe pastaj i veshim me mish!" - Kuptimi: shikoji kockat, se si i lidhim me njëra tjetrën. Pastaj shikoje me sytë e tu se si Allahu i Lartësuar do t'i veshë me mish ato kocka të lidhura, sikurse urdhëron Ai.

- "Kur atij iu bë e qartë kjo, tha: "U binda se Allahu është vërtet i Plotfuqishëm për gjithçka!" – Nga kuptimi i drejtpërdrejtë i ajetit shihet se ky burrë nuk e besonte ringjalljen. Megjithatë, Allahu i Lartësuar deshi që ta udhëzonte dhe ta bënte atë shembull për njerëzit e tjerë. Ky shpjegim mbështetet në tri fakte:


Së pari, ai njeri tha: "E si mund ta risjellë Allahu në jetë këtë, pas këtij shkatërrimi?" Nëse do të ishte një profet apo adhurues i mirë i Zotit, ai nuk do ta thoshte kurrë një gjë të tillë.

Së dyti, Allahu i Lartësuar i shfaqi disa shenja te ushqimi e pija, te gomari dhe te vetja e tij, që ai ta shihte të vërtetën me sytë e tij, dhe ta besojnte atë që e mohonte. Në ajet nuk thuhet gjë se atij fshati iu kthye jeta apo u rindërtua. As konteksti i ajeteve nuk e tregon një gjë të tillë. Pastaj, kjo nuk do të kishte ndonjë dobi. Çfarë prove do të ishte për ringjalljen një fshat që ribëhet pas shkatërrimit?! Por e tillë do të ishte pikërisht prova që ai e pa vetë me sy tek ushqimi, pija, gomari dhe te vetja e tij.

Së treti, në ajet thuhet: "Kur atij iu bë e qartë...". Pra, vetëm pasi atij iu bë e qartë ajo që nuk e dinte dhe nuk e besonte, ai e mësoi dhe u bind për atë (për ringjalljen). Megjithatë, Allahu e di më mirë.

Ajeti 260

260. Po kur Ibrahimi tha: "Zoti im! Më mundëso të shoh se si i ngjall të vdekurit!" Ai *(Zoti)* i tha: "A nuk beson?!" Ai *(Ibrahimi)* u përgjigj: "Sigurisht që besoj, por desha që zemrës time t'i shtohej bindja." Ai *(Zoti)* tha: "Merr katër shpendë, e pastaj, në çdo kodër vendos nga një pjesë të tyre! Pastaj thirru atyre, dhe ata


الجزء الثالث
سورة البقرة
وَإِذْ قَالَ إِبْرَٰهِـۧمُ رَبِّ أَرِنِى كَيْفَ تُحْىِ ٱلْمَوْتَىٰ ۖ قَالَ أَوَلَمْ
تُؤْمِن ۖ قَالَ بَلَىٰ وَلَٰكِن لِّيَطْمَئِنَّ قَلْبِى ۖ قَالَ فَخُذْ أَرْبَعَةً مِّنَ
ٱلطَّيْرِ فَصُرْهُنَّ إِلَيْكَ ثُمَّ ٱجْعَلْ عَلَىٰ كُلِّ جَبَلٍ مِّنْهُنَّ جُزْءًا
ثُمَّ ٱدْعُهُنَّ يَأْتِينَكَ سَعْيًا ۚ وَٱعْلَمْ أَنَّ ٱللَّهَ عَزِيزٌ حَكِيمٌ
٢٦٠ مَّثَلُ ٱلَّذِينَ يُنفِقُونَ أَمْوَٰلَهُمْ فِى سَبِيلِ ٱللَّهِ كَمَثَلِ حَبَّةٍ
أَنۢبَتَتْ سَبْعَ سَنَابِلَ فِى كُلِّ سُنۢبُلَةٍ مِّا۟ئَةُ حَبَّةٍ ۗ وَٱللَّهُ
يُضَٰعِفُ لِمَن يَشَآءُ ۚ وَٱللَّهُ وَٰسِعٌ عَلِيمٌ ٢٦١ ٱلَّذِينَ يُنفِقُونَ
أَمْوَٰلَهُمْ فِى سَبِيلِ ٱللَّهِ ثُمَّ لَا يُتْبِعُونَ مَآ أَنفَقُوا۟ مَنًّا وَلَآ
أَذًى ۙ لَّهُمْ أَجْرُهُمْ عِندَ رَبِّهِمْ وَلَا خَوْفٌ عَلَيْهِمْ وَلَا هُمْ
يَحْزَنُونَ ٢٦٢ ۞ قَوْلٌ مَّعْرُوفٌ وَمَغْفِرَةٌ خَيْرٌ مِّن صَدَقَةٍ
يَتْبَعُهَآ أَذًى ۗ وَٱللَّهُ غَنِىٌّ حَلِيمٌ ٢٦٣ يَٰٓأَيُّهَا ٱلَّذِينَ ءَامَنُوا۟
لَا تُبْطِلُوا۟ صَدَقَٰتِكُم بِٱلْمَنِّ وَٱلْأَذَىٰ كَٱلَّذِى يُنفِقُ مَالَهُۥ
رِئَآءَ ٱلنَّاسِ وَلَا يُؤْمِنُ بِٱللَّهِ وَٱلْيَوْمِ ٱلْءَاخِرِ ۖ فَمَثَلُهُۥ كَمَثَلِ
صَفْوَانٍ عَلَيْهِ تُرَابٌ فَأَصَابَهُۥ وَابِلٌ فَتَرَكَهُۥ صَلْدًا ۖ لَّا يَقْدِرُونَ
عَلَىٰ شَىْءٍ مِّمَّا كَسَبُوا۟ ۗ وَٱللَّهُ لَا يَهْدِى ٱلْقَوْمَ ٱلْكَٰفِرِينَ ٢٦٤
٤٤

kanë për të ardhur me shpejtësi! Dije se Allahu është i Plotfuqishëm e i Urtë".

Shpjegimi i ajetit

- "Po kur Ibrahimi tha: "Zoti im! Më mundëso të shoh se si i ngjall të vdekurit!"" - Edhe kjo ngjarje është një dëshmi e qartë, që vërteton pushtetin absolut të Allahut të Lartësuar për të ringjallur të vdekurit, për t'i marrë në përgjegjësi dhe për t'i shpërblyer me drejtësi. Kështu, Allahu i Lartësuar na tregon se si i dashuri dhe i zgjedhuri i Tij, Ibrahimi (a.s.), i kërkoi Atij që ta shihte me sy se si bëhej ringjallja e të vdekurve. Ibrahimi (a.s.) ishte plotësisht i sigurt se Allahu i Lartësuar kishte mundësi ta bënte atë, porse ai dëshironte që këtë të vërtetë të sigurt ta shihte me sytë e tij, që të arrinte një gradë më të lartë sigurie. Ai donte të fitonte atë që quhet "*ajnul jakîn*", sigurinë e shikimit me sy të kësaj të vërtete të padiskutueshme.

Allahu i Lartësuar i tha:

- "Ai *(Zoti)* i tha: "A nuk beson?!" Ai *(Ibrahimi)* u përgjigj: "Sigurisht që besoj, por desha që zemrës time t'i shtohej bindja." - Ibrahimi (a.s.) gjithmonë hulumtonte që të zbulonte argumente sa më të qarta dhe të sigurta, nëpërmjet të cilave të fuqizonte imanin dhe të përkryente *jakin*-in. Kështu veprojnë të mëdhenjtë e të mençurit.

Zoti i tij iu përgjigj kësaj kërkese të madhe.

- "Ai *(Zoti)* tha: "Merr katër shpendë dhe copëtoji, e pastaj, në çdo kodër vendos nga një pjesë të tyre! Pastaj thirru atyre, dhe ata kanë për të ardhur me shpejtësi!" - Allahu i Lartësuar e urdhëroi që të merrte katër zogj, t'i copëtonte dhe t'i shpërndante copat e tyre në kodrat përreth, që të mund të shikonte më pas me sytë e tij ringjalljen e tyre. Pastaj i tha që t'u thërriste atyre copave pa jetë, dhe ato, menjëherë pas kësaj thirrjeje, do të merrnin jetë të plotë dhe do të bashkoheshin ashtu si më parë, duke fluturuar drejt Ibrahimit (a.s.).

Profeti Ibrahim (a.s.) i kreu të gjitha porositë e Allahut dhe e pa me sytë e tij atë që kërkoi të shihte. Ky, në fakt, ishte veç një tregues shumë i vogël i pushtetit dhe fuqisë që ka Allahu i Lartësuar në qiej dhe në tokë, të cilin Ai ia tregoi haptazi Ibrahimit (a.s.).

Pastaj Allahu i Lartësuar i tha Ibrahimit (a.s.):

- "Dije se Allahu është i Plotfuqishëm e i Urtë". - Allahu është i Plotfuqishëm. Ai ka fuqi të sjellë në ekzistencë çdo gjë. Asgjë nuk mund të dalë jashtë kontrollit dhe pushtetit të Tij. Gjithçka është e nënshtruar ndaj pushtetit dhe madhështisë së Tij dhe asgjë nuk del jashtë Urtësisë së Tij. Ai nuk bën asgjë pa një qëllim të caktuar.

Pastaj thotë i Lartësuari:

Ajeti 261

261. Pasuria e atyre që e shpenzojnë atë në rrugë të Allahut përngjan me një farë, prej

së cilës mbijnë shtatë kallinj, ku në secilin kalli ka njëqind kokrra. Allahu ia shumëfishon atij që Ai dëshiron. Allahu është Bujar i madh e i Gjithëdijshëm.

Shpjegimi i ajetit

Disa ajete më lart, Allahu i Lartësuar tha: "Kush është ai që do t'i japë Allahut një "hua" të mirë, që Ai t'ia shtojë atë shumëfish?". Ndërsa tani, Ai sqaron se si bëhet ky shumëfishim i shpërblimit:

- "Pasuria e atyre që e shpenzojnë atë në rrugë të Allahut përngjan me një farë, prej së cilës mbijnë shtatë kallinj, ku në secilin kalli ka njëqind kokrra." – Shprehja: "...në rrugë të Allahut..." domethënë: në bindje ndaj Tij dhe për kënaqësinë e Tij. Sigurisht, shpenzimi më i mirë, në këtë rast, është pikërisht në mbështetje të luftës në rrugën e Zotit.

Allahu i Lartësuar na sjell një ilustrim tepër të qartë dhe të thjeshtë të shumëfishimit të shpërblimit të Tij. Ai na i sjell këtë shembull të prekshëm, me një qëllim shumë të rëndësishëm: që të forcohet edhe më shumë siguria për premtimin e Tij. Kur bashkohet forca e argumenteve të dukshme me forcën e besimit të brendshëm, shpirti fiton një bindje e siguri të palëkundur, dhe, si rezultat, do të nënshtrohet plotësisht për të kryer vepra të mira, të shpërblyeshme nga Allahu i Lartësuar. Kështu, njeriu do t'i shtojë shpenzimet në rrugën e mirësisë, sepse shpërblimi që ai pret është shumë i sigurt dhe shumë i madh.

- "Allahu ia shumëfishon atij që Ai dëshiron." – Pra, Allahu i Lartësuar ia jep këtë shumëfishim atij që Ai dëshiron.

Dëshira e Allahut të Lartësuar për të dhënë shpërblime dhe për t'i shumëfishuar ato, është në përputhje me urtësinë dhe dijen e Tij madhështore. Për të bërë këtë shumëfishim, Allahu i Madhëruar merr në konsideratë shumë gjëra, si:

- gjendjen e atij që shpenzon, domethënë shkallën e sinqeritetit të tij në qëllimin e këtij shpenzimi;
- llojin e shpenzimit, ose shkallën e dobisë së tij dhe të nevojës për të;
- fushën në të cilën shpenzohet dhe kategorisë që ajo i jepet.

Nga këto kritere varet shumëfishimi i shpërblimit, ndonëse dihet që Allahu i Lartësuar e shpërblen pa kufi atë që Ai dëshiron.

- "Allahu është Bujar i madh e i Gjithëdijshëm." - Allahu është Bujar me mirësitë dhe dhuratat që jep. Atij nuk ia pakëson mirësitë shpërblimi që u jep njerëzve dhe Ai nuk trembet nga kërkesat e asnjë lloj lutësi. Prandaj, askush të mos mendojë se ky shumëfishim është një lloj teprimi në premtimet për shpërblim. Allahu i Lartësuar e jep gjithmonë atë që e premton. Atij nuk i pakësohet kurrë mirësia, sado që t'ua shumëfishojë shpërblimet njerëzve. Sigurisht, këto shpërblime jepen sipas urtësisë dhe dijes së Tij, sepse Allahu është i Gjithëdijshëm. Ai e di shumë mirë se kush i meriton ato dhe kush jo.

Ajeti 262

262. Ata që e shpenzojnë pasurinë e tyre në rrugë të Allahut, dhe që atë çfarë japin nuk e shoqërojnë me të përmendur e me mburrje, pikërisht ata e kanë shpërblimin e vet te Zoti i tyre. Për ta nuk ka frikë dhe as do të brengosen.

Shpjegimi i ajetit

- "Ata që e shpenzojnë pasurinë e tyre në rrugë të Allahut..." - Shprehja: "...në rrugë të Allahut..." domethënë: në bindje ndaj Tij dhe në ndihmë të rrugës së Tij.

Këtu shtrohet një çështje tepër delikate, për të cilën Allahu i Lartësuar na këshillon. Ai thotë:

- "...dhe që atë çfarë japin nuk e shoqërojnë me të përmendur e me mburrje..." – Pra, ne duhet që, shpenzimet të cilat i bëjmë në shenjë bindjeje ndaj Allahut dhe për të ndihmuar rrugën e Tij, të mos i shkatërrojmë me dy gjëra:

Së pari, duke ia kujtuar tjetrit se çfarë i kemi dhënë. Ne duhet të jemi të kujdesshëm që të mos ndihemi mbi vëllezërit tanë, as me fjalë e as me zemër. Disa njerëz, kur i bëjnë dikujt ndonjë nder, ia kujtojnë vazhdimisht atij, duke kërkuar kështu që t'u njihet dhe t'u shpërblehet ai nder që kanë bënë. Pra, nuk duhet vepruar kurrsesi në këtë mënyrë.

Së dyti, duke mos e munduar tjetrin. Pra, shpenzimet që kryejmë për hir të Allahut nuk duhet t'i shoqërojmë me fjalë dhe vepra fyese, që e ulin palën tjetër.

Kështu pra, duhet të ruhemi nga këto dy gabime që bëhen shpesh në kësi rastesh. Ne duhet të jemi të thjeshtë dhe të kujdesshëm në çdo fjalë dhe vepër që bëjmë.

- "...pikërisht ata e kanë shpërblimin e vet te Zoti i tyre. Për ta nuk ka frikë dhe as do të brengosen." - Këta do të marrin atë shpërblim që i përshtatet mirësisë që kanë bërë. Ata do të jenë të sigurt nga çdo frikë dhe brengë. Ata do të fitojnë të mirat dhe do të shpëtojnë nga të këqijat, sepse kanë bërë vepra të mira e të sinqerta për Allahun dhe i kanë ruajtur këto vepra nga çdo fjalë, ndjenjë apo vepër që e shkatërron dhe e zhvlerëson shpërblimin e tyre.

Ajeti 263

263. Një fjalë e mirë dhe falja janë më të vlefshme se një lëmoshë që shoqërohet me fjalë fyese. Allahu është i Vetëmjaftueshëm dhe i Butë.

Shpjegimi i ajetit

- "Një fjalë e mirë dhe falja janë më të vlefshme se një lëmoshë që shoqërohet me fjalë fyese." - Një fjalë e ëmbël, e pranueshme nga zemra, është më e mirë se një sadaka e shoqëruar me fjalë e vepra fyese. Fjalë e mirë është ajo që e gëzon dhe e qetëson zemrën e tjetrit. Fjalën e mirë mund t'ia thuash tjetrit edhe kur nuk ke mundësi t'i japësh gjë, ndoshta edhe duke bërë lutje për të.

Për sa i përket faljes, kuptimi është që ta falësh atë që sillet e flet keq kundër teje, sepse kjo është madhështore. Të mos ndërmarrësh masa ndëshkuese kundër atij që të dëmton, por përkundrazi ta falësh, është vërtet një cilësi e rrallë. Shpesh lypësi mund të të ofendojë me ndonjë fjalë apo veprim të tijin, por falja dhe justifikimi i tij ka shumë shpërblim. Kështu, fjalët e mira dhe falja e të tjerëve janë më të çmuara sesa sadakaja e shoqëruar me mburrje. Edhe fjalët e mira janë një lloj sadakaje. Që të dyja bashkë, fjala e mirë dhe falja e të tjerëve janë bamirësi, të cilat nuk kanë asnjë të keqe në vete.

Nga ajeti kuptohet se sadakaja që nuk pasohet me të përmendur dhe me mburrje është më e mirë se fjalët e mira dhe falja. Kjo tregon se sa e keqe është të përmendurit e sadakasë dhe mburrja me të. Ajo është haram dhe e shkatërron shpërblimin e sadakasë. Arsyeja është se merita për dhurimin e mirësive i takon vetëm Allahut. Kur i vetmi dhurues dhe bamirës është Allahu i Lartësuar, atëherë si mund t'ia përmendësh tjetrit mirësitë që i ke bërë dhe të lëvdohesh?! A po lëvdohesh me mirësitë dhe dhuratat e Allahut?! Nga ana tjetër, ai që mburret dhe e përkujton mirësinë e vet kërkon me këtë sjellje që t'i mbajë të përulur nën vete ata të cilëve u ka dhënë, por edhe kjo i takon vetëm Allahut.

Me fjalë të tjera, përulja, nënshtrimi dhe bindja bëhen vetëm ndaj Allahut të Lartësuar. Allahu i Lartësuar është i pasur dhe nuk ka nevojë për adhurimin e askujt, ndërsa çdo gjë tjetër është e varfër dhe nevojtare. Çdo gjë ka nevojë për mëshirën dhe mirësinë e Tij në të gjitha drejtimet, kohët, gjendjet. Pra, duhet kuptuar mirë se, çdo adhurim e vepër të mirë që kryejmë

është thjesht për të mirën dhe dobinë tonë. Ne duhet të përpiqemi që të mos i shkatërrojmë adhurimet tona me ato vepra që prishin dhe asgjësojnë shpërblimet e adhurimeve, sepse kështu nuk i bëjmë dëm askujt tjetër, veç vetes sonë.

Më tej, i Lartësuari thotë:

- "Allahu është i Vetëmjaftueshëm dhe i Butë." - Allahu i Lartësuar është i Vetëmjaftueshëm (*Ĝanijun*), që nuk ka nevojë për asgjë: as për adhurimet dhe as për veprat tona të mira. Por Ai është edhe i Butë (*Ĥalîm*) ose tolerues kundrejt atij që bën gabime dhe nuk bindet, edhe pse është i plotfuqishëm mbi krijesat e Tij. Ai nuk nxitohet për t'i ndëshkuar ato, edhe pse e meritojnë një ndëshkim të tillë. Mëshira, butësia dhe bamirësia e Tij janë aq të mëdha, saqë bëjnë që Ai kurrë të mos nxitohet për t'i ndëshkuar të pabindurit dhe gjynahqarët. Allahu i afatizon ata dhe ua sqaron argumentet e madhështisë së Tij, që ata të mund të kthehen të penduar dhe të nënshtruar. Megjithatë, kur ata nuk kanë në vetvete asnjë mirësi të vogël, sa të shpresohet ndreqja e tyre, kur atyre nuk u bëjnë më dobi shenjat dhe argumentet e qarta të Zotit, atëherë ndëshkimi i Tij mbi ta bëhet i pakthyeshëm. Në këtë rast, ata nuk mund t'i shpëtojnë më ndëshkimit të të Urtit e të Drejtit dhe kurrë nuk do të shpërblehen dhe nuk do të shijojnë mirësitë e Tij.

Ajeti 264

264. O ju që keni besuar! Mos i prishni lëmoshat tuaja me të përmendur dhe me ofendime, siç bën ai që e jep pasurinë e vet sa për sy e faqe, dhe nuk e beson Allahun dhe as Ditën e Fundit. Ky ngjan me atë gurin e madh e të lëmuar, mbi të cilin ka pak dhe, por që kur e zë rrebeshi, e lë sërish të zhveshur. Ata nuk arrijnë asgjë nga ato gjëra që kanë bërë. Allahu nuk e udhëzon popullin jobesimtar.


Shpjegimi i ajetit

- "O ju që keni besuar! Mos i prishni lëmoshat tuaja me të përmendur dhe me ofendime..." - Në këtë ajet, Allahu i Lartësuar na ndalon nga shkatërrimi i sadakave, jo nga vetë sadakatë. Me mëshirën e Tij, Ai na tregon se shpërblimi i sadakasë shkatërrohet me të përmendur dhe me mburrje. Kjo është vërtet një këshillë e çmuar, që Allahu i Lartësuar na e dhuron nga butësia dhe mëshira e Tij.

Ajeti tregon, gjithashtu, se veprat e këqija i fshijnë dhe i shkatërrojnë veprat e mira. Në suren Huxhuratë ajeti 2, Allahu i lartësuar na tregon për një nga veprat e këqia e cila i fshin punët e mira. Thotë Allahu i Lartësuar: O ju që keni besuar! Mos e ngrini zërin tuaj mbi zërin e profetit dhe mos iu drejtoni atij me fjalë sikurse i drejtoheni njëri-tjetrit, e kështu të asgjësohen veprat tuaja duke mos e ndier".

Pra, sikurse veprat e mira i fshijnë të këqijat, ashtu edhe veprat e këqija i shkatërrojnë dhe i zhvlerësojnë veprat e mira. Ky ajet dhe thënia tjetër e Allahut: "Mos i shkatërroni veprat tuaja…" na nxisin që t'i përsosim dhe t'i ruajmë veprat e mira nga çdo gjë që mund të shkatërrojë shpërblimin e tyre. Allahu i Lartësuar na nxit për një gjë të tillë, që veprat dhe mundi ynë të mos na shkojnë kot.

- "...siç bën ai që e jep pasurinë e vet sa për sy e faqe, dhe nuk e beson Allahun dhe as Ditën e Fundit." - Këtu Allahu na tregon se veprat tona, edhe pse fillimisht mund të nisin për hir të Tij, në momentin që shoqërohen me të përmendur dhe me mburrje, ato asgjësohen. Ato konsiderohen njëlloj si veprat që bëhen veçse për syfaqësi ndaj njerëzve. Njerëzit që veprojnë kështu nuk besojnë Allahun dhe as Ditën e Llogarisë, prandaj nuk do t'u pranohet asnjë lloj vepre dhe mundi që shpenzojnë. Veprat e tyre janë plotësisht të refuzuara, sepse dihet se asnjë vepër nuk pranohet nga Allahu i Lartësuar, derisa të plotësojë dy



وَمَثَلُ ٱلَّذِينَ يُنفِقُونَ أَمۡوَٰلَهُمُ ٱبۡتِغَآءَ مَرۡضَاتِ ٱللَّهِ
وَتَثۡبِيتٗا مِّنۡ أَنفُسِهِمۡ كَمَثَلِ جَنَّةِۭ بِرَبۡوَةٍ أَصَابَهَا وَابِلٞ
فَـَٔاتَتۡ أُكُلَهَا ضِعۡفَيۡنِ فَإِن لَّمۡ يُصِبۡهَا وَابِلٞ فَطَلّٞ
وَٱللَّهُ بِمَا تَعۡمَلُونَ بَصِيرٌ ٢٦٥ أَيَوَدُّ أَحَدُكُمۡ أَن تَكُونَ لَهُۥ
جَنَّةٞ مِّن نَّخِيلٖ وَأَعۡنَابٖ تَجۡرِي مِن تَحۡتِهَا ٱلۡأَنۡهَٰرُ لَهُۥ
فِيهَا مِن كُلِّ ٱلثَّمَرَٰتِ وَأَصَابَهُ ٱلۡكِبَرُ وَلَهُۥ ذُرِّيَّةٞ
ضُعَفَآءُ فَأَصَابَهَآ إِعۡصَارٞ فِيهِ نَارٞ فَٱحۡتَرَقَتۡۗ كَذَٰلِكَ
يُبَيِّنُ ٱللَّهُ لَكُمُ ٱلۡأٓيَٰتِ لَعَلَّكُمۡ تَتَفَكَّرُونَ ٢٦٦ يَٰٓأَيُّهَا
ٱلَّذِينَ ءَامَنُوٓاْ أَنفِقُواْ مِن طَيِّبَٰتِ مَا كَسَبۡتُمۡ وَمِمَّآ أَخۡرَجۡنَا
لَكُم مِّنَ ٱلۡأَرۡضِۖ وَلَا تَيَمَّمُواْ ٱلۡخَبِيثَ مِنۡهُ تُنفِقُونَ
وَلَسۡتُم بِـَٔاخِذِيهِ إِلَّآ أَن تُغۡمِضُواْ فِيهِۚ وَٱعۡلَمُوٓاْ أَنَّ ٱللَّهَ غَنِيٌّ
حَمِيدٌ ٢٦٧ ٱلشَّيۡطَٰنُ يَعِدُكُمُ ٱلۡفَقۡرَ وَيَأۡمُرُكُم بِٱلۡفَحۡشَآءِۖ
وَٱللَّهُ يَعِدُكُم مَّغۡفِرَةٗ مِّنۡهُ وَفَضۡلٗاۗ وَٱللَّهُ وَٰسِعٌ عَلِيمٞ
٢٦٨ يُؤۡتِي ٱلۡحِكۡمَةَ مَن يَشَآءُۚ وَمَن يُؤۡتَ ٱلۡحِكۡمَةَ فَقَدۡ
أُوتِيَ خَيۡرٗا كَثِيرٗاۗ وَمَا يَذَّكَّرُ إِلَّآ أُوْلُواْ ٱلۡأَلۡبَٰبِ ٢٦٩

kushtet e njohura: të kryhet me sinqeritet për Allahun, duke shpresuar me të vetëm shpërblimin e Tij, dhe vepra të jetë në përputhje me mësimet dhe porositë e Allahut dhe Profetit të Tij.

Kështu, veprat e hipokritit nuk janë për Allahun, por për veten e tij ose për famën ndër njerëz. Për këtë arsye, të gjitha veprat e tij janë të kota, nuk merren në konsideratë dhe kurrë nuk do të shpërblehen. Allahu i Lartësuar na sjell një shembull shumë të goditur për këta lloj njerëzish:

- "Ky ngjan me atë gurin e madh e të lëmuar, mbi të cilin ka pak dhe, por që kur e zë rrebeshi, e lë sërish të zhveshur." - Këta njerëz dhe veprat e tyre i shëmbëllejnë një guri shumë të lëmuar dhe të mbuluar me dhe, i cili, kur goditet nga një shi i rrëmbyer, zhvishet tërësisht prej atij dheu.

E tillë është gjendja e hipokritëve. Zemrat e tyre janë të ashpra e të forta, sikurse është guri. Ndërsa sadakatë dhe veprat e tyre të mira janë si pluhuri a dheu që zë guri i lëmuar përsipër. Kur i padituri e sheh gurin e mbuluar me dhe, mendon se ka të bëjë me një tokë pjellore. Por kur zbulohet e vërteta që fshihet nën të, atëherë çdokush e kupton se veprat e tij kanë qenë mashtruese. Zemra e tyre nuk është vendi i përshtatshëm për t'u mbjellë dhe për të dhënë fryte të dobishme.

Syfaqësia dhe motivet e këqija nuk e lejojnë njeriun që të përfitojë nga ndonjë vepër e tij, prandaj i Madhëruari thotë:

- "Ata nuk arrijnë asgjë nga ato gjëra që kanë bërë." - Prej veprave që bëjnë dhe prej mundit që harxhojnë, ata nuk do të përfitojnë absolutisht asgjë, sepse ata ia përkushtojnë këto vepra e mund atij që nuk i meriton. Ata i kryejnë veprat për të kënaqur krijesat, jo për të fituar kënaqësinë e Allahut të Madhëruar. Ata mundohen të kënaqin atë që nuk ka në dorë as dëm, as dobi, dhe braktisin adhurimin e Atij që ka në dorë gjithçka. Pikërisht për këtë shpërfillje të tyre, Allahu i Lartësuar ua ka devijuar zemrat, që të mos shohin më udhëzimin, siç thotë në vijim:

- "Allahu nuk e udhëzon popullin jobesimtar." – që e fshehin të vërtetën, e mohojnë dhe e rrefuzojnë atë pa të drejtë.

Ajeti 265

265. Ndërsa shembulli i atyre që pasurinë e vet e japin nga bindja e tyre dhe duke kërkuar kënaqësinë e Allahut është një kopsht në një rrafshnaltë, ku bie shi me bollëk dhe jep fryte dyfish. Por edhe nëse nuk bie shi me bollëk, atje bie një vesë shiu e mjaftueshme. Allahu sheh se çfarë veproni.

Shpjegimi i ajetit

Ky shembull është për ata që shpenzojnë pasurinë e tyre për të arritur kënaqësinë e Allahut, të cilët do të shpërblehen shumëfish nga ana e Tij.

- "Ndërsa shembulli i atyre që pasurinë e vet e japin nga bindja e tyre dhe duke kërkuar kënaqësinë e Allahut..." - Qëllimi i këtyre me sadakatë që japin është kënaqësia e Zotit dhe afrimi tek Ai. Një cilësi tjetër e tyre është se ata japin me gjithë shpirt, e jo me zemër të thyer apo të lëkundur.

Sadakaja që jep njeriu dëmtohet shpesh nga dy faktorë: së pari, nga syfaqësia, kur njeriu synon që të tjerët ta falënderojnë dhe ta lëvdojnë për sadakanë që ka dhënë; dhe, së dyti, nga luhatja që mund të ndiejë gjatë dhënies, duke mos pasur dëshirën dhe vullnetin e plotë për veprën që po bën. Edhe ky është një defekt shumë i shëmtuar, që duhet shmangur dhe larguar.

Por kategoria fatlume që përshkruan ky ajet ka shpëtuar nga të dyja këto mangësi në dhënien e sadakave. Ata i kanë shpëtuar dëshirës për t'u dukur, sepse ata shpenzojnë "duke kërkuar kënaqësinë e Allahut". Ata nuk e kanë as defektin e dytë, sepse Allahu thotë që e japin pasurinë duke qenë të bindur e shumë të motivuar.
Shembulli i këtyre fatbardhëve është:

- "...është një kopsht në një rrafshnaltë, ku bie shi me bollëk..." – Pra, një kopsht ose një pyll shumë i dendur, me hije shumë të forta dhe të freskëta.

Fjala "*xhennetun*" (kopsht), në thelb, tregon "diçka të mbuluar e të fshehur", sepse edhe pemët e kopshtit, kur janë të dendura e të ndërthurura me njëra-tjetrën, e mbulojnë dhe e fshehin gjithçka që jeton dhe gjallëron poshtë tyre.

Ky kopsht i dendur, pra, ndodhet në një pllajë të hapur, të cilën e rreh dielli në çdo moment të ditës. Sigurisht që një vend i tillë do të ketë prodhimtari të lartë, për shkak të vendndodhjes shumë të favorshme të tij. Përveç pozicionit të mrekullueshëm, Allahu tregon edhe një veçori tjetër të tij. Atje bien shira të bollshëm, që e ushqejnë tokën dhe bimësinë e saj.

Atëherë, me kushte të tilla, prodhimi i këtij kopshti do të jetë shumë i lartë, siç thotë Allahu i Lartësuar:

- "...dhe jep fryte dyfish." – Pra, për shkak të cilësive të shkëlqyera të tokës, të kushteve klimaterike dhe të vendodhjes, prodhimet e këtij kopshti të dendur janë dyfish më të mëdha. E si do të ishte ndryshe, kur shiu i bollshëm ushqen një tokë cilësore?!

Pastaj Allahu i Lartësuar thotë:

- "Por edhe nëse nuk bie shi me bollëk, atje bie një vesë shiu e mjaftueshme." - Pra, edhe nëse nuk bie shi i madh në atë vend të begatë, por bie vetëm pak, ai përsëri është i mjaftueshëm që prodhimet të jenë të kënaqshme.

Ky është shembulli i atyre që shpenzojnë shumë apo pak, sipas mundësisë së tyre. Secilit i shtohet shpërblimi në varësi të mundit të shpenzuar. Sadakaja e tyre jep fryte të mira, sido që të jetë ajo, e vogël apo e madhe, sepse është "toka" e mirë.

Pastaj, duhet ditur edhe diçka tjetër shumë e rëndësishme. Ai që ua fal njerëzve begatinë e pasurinë që ata kanë është Allahu i Lartësuar, i Cili është më i mëshirshëm me ta, sesa ata për veten e tyre. Nëse Ai synon gjithmonë të mirën e tyre, ata ndonjëherë mund të kërkojnë të kundërtën, për shkak të injorancës.

Subhanallah! Nëse do të mësohej ekzistenca e një kopshti të tillë të begatë në këtë dynja, atëherë të gjithë njerëzit do ta kërkonin me ngulm, madje do të vriteshin për ta pasur, edhe pse është thjesht një mirësi e kësaj jete, që ka mangësitë e saj dhe që shkakton lodhje e mundime. Mjafton të mendosh që ajo kënaqësi e ka një fund dhe që do të vijë një ditë që ajo do të lihet pas.

Ky është një shembull i vogël, për të ilustruar sadopak shpërblimin e madh të atij që shpenzon me gjithë zemër dhe pa hezituar për të kënaqur Allahun e Lartësuar. Besimtari e shikon atë përshkrim me syrin e arsyes dhe me dritën e imanit. Duke soditur

këtë mrekulli, ai mahnitet me mirësitë që të ofron premtimi i sigurt i Allahut.

Megjithatë, ka shpirtra të fjetur që përsëri nuk reagojnë ndaj kësaj mrekullie. Mos, vallë, kjo është një mospërfillje ndaj mirësive të përjetshme të ahiretit? Apo është shprehje e dobësisë së besimit rreth vërtetësisë së premtimit të Allahut dhe shpërblimeve të Tij të pafundme?! E themi këtë sepse, nëse robi do të kishte siguri të plotë ndaj premtimit të Zotit dhe nëse imani do të kishte rrënjë të thella në zemrën e tij, atëherë ai do të përvëlohej nga malli për të Dashurin dhe të Adhuruarin e zemrës së tij. Ai nuk do të rrinte kurrsesi pa shpenzuar gjërat më të çmuara, për të kënaqur Allahun e Lartësuar, sepse shpresa për shpërblimin e Allahut do të ishte e papërballueshme për ta shpërfillur.

E si mund të tregohesh mospërfillës, kur Allahu i Lartësuar thotë:

- "Allahu sheh se çfarë veproni." - Allahu vështron dhe e di shumë mirë veprimtarinë e çdo njeriu, madje Ai i di shumë mirë edhe pikësynimet e gjithësecilit. E, rrjedhimisht, Allahu do ta shpërblejë secilin me shpërblimin më të mirë, sipas drejtësisë, urtësisë dhe mëshirës së Tij.

Pastaj i Madhëruari thotë:

Ajeti 266

266. A dëshiron ndonjëri prej jush të jetë si ai që ka një kopsht me hurma e rrush, në të cilin rrjedhin lumenj e ka nga të gjitha frutat, por që ta ketë kapur pleqëria dhe pranë tij të ketë pasardhës të mitur, dhe pastaj, atë *(kopshtin)* ta godasë ndonjë valë zjarri e ta djegë?! Kështu jua sqaron Allahu argumentet, për të menduar.

Shpjegimi i ajetit

- "A dëshiron ndonjëri prej jush të jetë si ai që ka një kopsht me hurma e rrush, në të cilin rrjedhin lumenj e ka nga të gjitha frutat..." - Ky është shembulli i njerëzve të cilët vërtet shpenzojnë shumë për të kënaqur Allahun e Lartësuar, por pastaj bëjnë vepra të këqija, të cilat i fshijnë shpërblimet e veprave të mira. Të tillë njerëz, Allahu i Lartësuar i krahason me pronarin e një kopshti të begatë me hurma dhe rrush. Allahu ka veçuar këto dy fruta, sepse ato janë të shijshme, ushqyese dhe shumë të dobishme.

Në këtë kopsht ka edhe lumenj që rrjedhin, të cilët ujisin bimësinë, pa e lodhur njeriun. Ky kopsht i begatë është shumë i dashur për të zotin e tij.

- "...por që ta ketë kapur pleqëria dhe pranë tij të ketë pasardhës të mitur..." - Përfytyrojeni këtë pronar, të cilit i janë shfaqur thinjat. Ai është i dobët dhe nuk ka fuqi të përkujdeset ndaj kopshtit të tij, edhe pse e dëshiron aq shumë atë!

Pronarin e mundon edhe diçka tjetër: ai ka pranë vetes pasardhës të mitur, që nuk mund ta ndihmojnë, madje ata janë një barrë më tepër për të. Jeta e tij dhe e tyre është e lidhur ngushtë me këtë kopësht.

Në një gjendje të tillë, përfytyroni se si do të ndihet ky njeri kur kopshtin e tij ta godasë një valë zjarri:

- "...dhe pastaj, atë *(kopshtin)* ta godasë ndonjë valë zjarri e ta djegë?!" - Përfytyrojeni këtë njeri në momentin kur sheh kopshtin e tij të digjet e të shkrumbohet! Çfarë trishtimi, ankthi e frike do të ndiejë ai! Nëse trishtimi do të vriste dikë, viktimë do ishte ky njeri.

E tillë është gjendja e atyre njerëzve që bëjnë vepra të mira dhe kënaqin Allahun e Lartësuar. Veprat e mira janë pemët që japin fruta e që kënaqin syrin dhe shpirtin. Adhurimi i vazhdueshëm i Zotit është si ky kopsht, që sjell lumturi e gëzim. Ndërsa vala që kërcënon këtë mrekulli janë veprat e këqija, të cilat shkatërrojnë dhe asgjësojnë çdo lumturi dhe gëzim të njeriut. Këtë valë e krijojnë, pra, veprat e këqija dhe mosbindja ndaj Zotit. Ajo valë vjen me zjarr, që përvëlon dhe shkrumbon.

Në fakt, zjarri që 'djeg' veprat e mira është më i rëndë sesa ai që djeg një kopsht të begatë, sepse kur njeriu vdes, ka një nevojë të madhe për ndonjë vepër të mirë, për të përballuar ankthin dhe frikën që sjell llogaria e drejtë para Allahut të Lartësuar. Pas vdekjes, njeriu nuk mund të bëjë më vepra të mira. Atëherë, kush do të dëshironte që, edhe ato pak vepra të mira prej të cilave pritet shpërblimi, të asgjësohen Ditën e Vështirë, Ditën e Gjykimit?! Kush do ta dëshironte një gjendje të tillë Ditën e takimit me Allahun e Drejtë?! Allahu i Lartësuar është i shpejtë në llogaritjen e robit dhe të veprave të tij.

Kështu, nëse njeriu do ta përfytyronte këtë skenë dhe do të kishte sadopak mend në kokë, nuk do t'ia lejonte vetes një fund të tillë. Porse dobësia e besimit dhe mendjelehtësia sjellin veçse të këqija. Të tilla vepra, edhe nëse do t'i bënte një i çmendur, do të konsideroheshin të rrezikshme dhe dëshpëruese. Prandaj i Lartësuari na urdhëron që të mendojmë thellë në të tillë shembuj e të vemë në punë arsyen:

- "Kështu jua sqaron Allahu argumentet, për të menduar."

Ajetet 267 - 268

267. O ju që keni besuar! Jepni nga më e mira e asaj që keni fituar dhe nga ajo që Ne e nxjerrim prej tokës për ju! Mos nxitoni të jepni më të pavlefshmen nga ajo, të cilën nuk do ta pranonit asnjëherë për veten tuaj, veçse po të ishit symbyllur. Dijeni se Allahu është i Vetëmjaftueshëm dhe i Lavdëruar.
268. Shejtani ju frikëson me varfëri dhe ju urdhëron për të këqija, ndërsa Allahu ju garanton falje e begati. Allahu është Bujar i madh e i Gjithëdijshëm.

Shpjegimi i ajeteve

- "O ju që keni besuar! Jepni nga më e mira e asaj që keni fituar dhe nga ajo që Ne e nxjerrim prej tokës për ju!" - Allahu i Lartësuar i urdhëron adhuruesit e Tij, besimtarët e vërtetë, që të shpenzojnë për hir të Tij. Por Allahu i Lartësuar e ka përcaktuar se si duhet të jenë këto shpenzime. Ata duhet të shpenzojnë pasurinë që është e mirë, e pastër dhe e dobishme.

Pra, nga larmia e gjërave të mira, të këndshme e të dobishme që Zoti jua mundësoi t'i zotëroni, jepni një pjesë të tyre, në shenjë falënderimi dhe mirënjohjeje për Atë, por edhe në shenjë solidariteti dhe plotësimi të disa detyrimeve që keni kundrejt vëllezërve tuaj në nevojë. Shpenzoni nga këto mirësi, që kjo të shërbejë si pastrim për pasuritë që zotëroni. Mes mirësive që Zoti ju ka dhuruar dhe prej të cilave kërkon që të shpenzoni, përzgjidhni gjithmonë atë që është e mirë dhe e këndshme, ashtu sikurse do të zgjidhnit për veten tuaj. Më tej, i Madhëruari na ndalon nga e kundërta e asaj që u tha më lart:

- "Mos nxitoni të jepni më të pavlefshmen nga ajo, të cilën nuk do ta pranonit asnjëherë për veten tuaj, veçse po të ishit symbyllur." – Pra, kurrë mos synoni ta "hiqni qafe" detyrimin, duke dhënë pjesën më të keqe dhe më të pavlefshme të pasurisë tuaj. Mos jepni atë pjesë të pasurisë që edhe vetë nuk do të pranonit ta merrnit ndryshe, veç symbyllurazi.

- "Dijeni se Allahu është i Vetëmjaftueshëm dhe i Lavdëruar." - Allahu është i Vetëmjaftueshëm dhe nuk ka nevojë për asgjë prej jush. Ai nuk përfiton asgjë prej sadakave tuaja. Çdo vepër e juaja kthehet pikërisht tek ju. Ai është edhe i Lavdëruar, sepse të lavdëruara dhe madhështore janë të gjitha ato për të cilat ju urdhëron. Urdhrat e Tij janë të lavdërueshëm, virtytet në të cilat ju fton janë të larta e të drejta. Juve nuk ju takon të bëni gjë tjetër, përveçse t'i zbatoni urdhrat dhe porositë e Tij, sepse ato janë ushqim i

domosdoshëm për zemrën tuaj dhe jetë e lumturi për shpirtin tuaj.

Më pas, kujdes! Ruajuni që të mos ndiqni hapat e shejtanit, armikut tuaj:

- "Shejtani ju frikëson me varfëri dhe ju urdhëron për të këqija..." – Kuptimi: Shejtani ju fton që të mos i bindeni urdhrit të Zotit tuaj për të shpenzuar. Ai ju urdhëron për koprraci. Që t'ia arrijë qëllimit të tij, ai ju frikëson duke ju thënë që, nëse e shpenzoni pasurinë tuaj, ju do të varfëroheni dhe do të bëheni nevojtarë për vete.

Porse këto nuk janë këshilla të një miku që të do të mirën. Përkundrazi, ato janë këshilla mashtruese. Ja cili është qëllimi i vërtetë i shejtanit, siç thotë i Lartësuari: "Ai e fton partinë e tij që të bëhen banues të Zjarrit të ndezur fort".

Kurrsesi mos iu bindni atij që ka të tilla qëllime ogurzeza, por bindjuni Zotit tuaj, i Cili ju urdhëron që të shpenzoni aq sa të keni mundësi, pa u dëmtuar. Bëjeni këtë, sepse Allahu ju premton diçka më të mirë:

- "...Allahu ju garanton falje e begati." – Pra, Allahu u premton falje gjynahesh atyre që shpenzojnë për hir të Tij. Ai premton edhe diçka tjetër, që quhet begati (*faḍlen*). Begatia nënkupton çdo mirësi që synon njeriu në jetën e dynjasë dhe ahiretit. Begatia është zëvendësimi i shpejtë i pasurisë që shpenzohet dhe shumëfishimi i saj. Begatia është qetësia shpirtërore, që të lumturon dhe gëzon. Begatia është mirësia që robi do të përjetojë kur të jetë vetëm në varr. Begatia është shpërblimi i premtuar për veprën e mirë, që do të jetë i shumëfishuar e që do të merret në një ditë shumë të vështirë e në çaste shumë të nevojshme, pikërisht Ditën e Gjykimit dhe të shpërblimit me drejtësi.

Të gjitha këto nuk janë aspak shumë për Allahun e Lartësuar. Ato janë shumë të vogla e shumë të thjeshta për t'u përmbushur nga ana e Tij, sepse Ai thotë:

- "Allahu është Bujar i madh e i Gjithëdijshëm." – Pra, Allahu është Bujar i madh me mirësitë që dhuron. Ai është edhe i Gjithëdijshëm. Ai i njeh me hollësi të gjitha shpenzimet që bëjnë njerëzit, të vogla qofshin apo të mëdha, të fshehta apo të hapura. Sigurisht, i Gjithëdijshmi do të shpërblejë me mëshirë dhe me bujari për çdo gjë që shpenzohet dhe i përkushtohet Atij me sinqeritet. Le të shohë, pra, njeriu se cilës ftesë duhet t'i përgjigjet.

Këto ajete flasin për çështje shumë të rëndësishme. Ato nxisin për të shpenzuar për hir të Allahut, ashtu sikurse na porosit Ai. Në to shpjegohet se çfarë e shtyn njeriun që të shpenzojë: besimi dhe shpërblimi i madh nga Allahu. Ato vërtetojnë se zekati i floririt, i argjendit dhe i mallrave tregtare është detyrim ligjor, që duhet të jepet. Ky gjykim përfitohet pikërisht nga fragmenti: "Jepni nga më e mira e asaj që keni fituar...".

Zekati është detyrim ligjor edhe për prodhimet që nxirren nga toka, qofshin ato bimë, farëra, drithëra apo thesare e minerale, sepse Allahu thotë: ue mim-mã aḥrexhnâ lekum- minel erḍi / dhe nga ajo që e nxorrëm për ju prej tokës.

Ky ajet tregon se zekati është detyrë të jepet nga ai që zotëron, bimësinë, drithërat apo siç quhet, "dobitë" e tokës, jo për pronarin e tokës. Sepse Allahu i Lartësuar thotë: "...dhe nga ajo që Ne e nxjerrim prej tokës për ju!".

Për ato pasuri që nuk përdoren për t'u kultivuar dhe për t'u shtuar, nuk duhet të jepet zekat, siç mund të jenë pasuritë e paluajtshme: toka, makina, shtëpia etj., ose edhe enët dhe mjetet e jetesës që njeriu i përdor dhe përfiton prej tyre. Të njëjtin gjykim ka edhe pasuria që njeriu nuk e ka në kontroll të tij, siç mund të jetë pasuria që ia kanë grabitur dhe nuk dihet se cili ia ka grabitur, ose një borxh i dhënë, që nuk e di se a do ta marrë mbrapsht apo jo. Pra, edhe për këtë lloj pasurie nuk kërkohet që të jepet zekat, sepse Allahu i Lartësuar e ka bërë të detyrueshëm zekatin për atë pasuri që

përdoret për t'u shtuar dhe kultivuar, siç janë prodhimet e tokës apo pasuria që shtohet nga mallrat e tregtisë. Ndërsa pasuritë që nuk e kanë këtë qëllim, nuk llogariten për zekat.

Ajeti tregon se pasuria me cilësi të ulët nuk është e vlefshme për t'u dhënë si zekat. Thënë ndryshe, zekati i dhënë me të tillë mall është i pavlefshëm, sepse Allahu i Lartësuar thotë: "Jepni nga më e mira e asaj që keni fituar...".

Ajeti 269

269. Ai ia dhuron urtësinë atij që do. Dhe, pa dyshim, kujt i është dhënë urtësia, i është dhuruar mirësi e madhe. Por këtë mirësi e kuptojnë veçse të mençurit.

Shpjegimi i ajetit

Allahu i Lartësuar ka sjellë urdhra që përmbajnë në vetvete të fshehta dhe urtësi të mëdha, por që Ai nuk ia mundëson kujdo që t'i kuptojë e t'i zbatojë. Prandaj thotë i Lartësuari:

- "Ai ia dhuron urtësinë atij që do." - Ai ia jep urtësinë atij që dëshiron. Urtësia është dija e dobishme, puna e mirë dhe njohja e thellë e dispozitave të Allahut të Lartësuar.

- "Dhe, pa dyshim, kujt i është dhënë urtësia, i është dhuruar mirësi e madhe. Por këtë mirësi e kuptojnë veçse të mençurit." - E ku ka mirësi më të madhe se ajo pa të cilën nuk mund të përfytyrohet lumturia në të dy jetët dhe shpëtimi prej dëshpërimit në të dyja jetët? Ky ajet jep një vlerësim të veçantë për cilësinë e rrallë të urtësisë. Ajo është një cilësi e mrekullueshme, të cilën e kanë privilegj vetëm trashëgimtarët e profetëve, dijetarët vepërmirë.

Përsosmëria e adhuruesit është e lidhur ngushtë me aftësitë dhe forcën e tij në dije dhe në punën me këtë dije. Aftësia e robit në dije përsoset duke njohur të vërtetën dhe qëllimin e saj. Ndërsa aftësia vepruese e tij përsoset kur ai kryen të mirën dhe lë të keqen. Vetëm në këtë mënyrë ai bëhet i drejtë dhe i saktë në fjalët dhe në veprimet e tij. Vetëm pas njohjes së të vërtetës dhe punës sipas saj, robi mund t'i vendosë gjërat atje ku duhet. Vetëm atëherë ai do të jetë i urtë në lidhje me vetveten dhe me të tjerët. Pa këto dy elementë, ai nuk do t'ia arrijë kurrë qëllimit për të qenë i urtë.

Ajeti 270


270. Për çdo gjë që shpenzoni nga pasuria dhe për çdo betim që të bëni, Allahu është i Gjithëditur. Për zullumqarët nuk ka ndihmues.

Shpjegimi i ajetit

- "Për çdo gjë që shpenzoni nga pasuria dhe për çdo betim që të bëni, Allahu është i Gjithëditur." - Këtu bëhet fjalë për shpenzimet që bëhen në rrugë të Zotit, të çfarëdo lloji qofshin ato: të detyrueshme apo të pëlqyeshme, të vogla apo të mëdha, ato për të cilat ka urdhëruar Allahu i Lartësuar apo ato të cilat vetë robi ia ka bërë të detyrueshme vetes së vet. Pa dyshim që Allahu i Lartësuar i di të gjitha këto, sepse Atij nuk i fshihet asgjë. Ai di edhe qëllimet e çdo vepruesi. Nëse nxitësi i tyre është dëshira e sinqertë për të kënaqur Allahun e Madhëruar, atëherë Ai do të japë shpërblim të madh për to.

Nga ana tjetër, nëse robi nuk e përmbush detyrimin për të shpenzuar, ose e përmbush atë, por duke pasur si synim vetëm kënaqësinë e krijesave, atëherë ai është treguar i padrejtë, zullumqar, sepse i vendos gjërat jo në vendin që u takon. Për këtë arsye, ai meriton ndëshkimin më të dhimbshëm:

- "Për zullumqarët nuk ka ndihmues." – Pra, ata nuk do të marrin ndihmë prej asnjë krijese. Askush nuk do të mund t'i shpëtojë prej ndëshkimit dëshpërues dhe të hidhur.



Ajeti 271

271. Nëse i jepni sadakatë haptazi, kjo është mirë, por nëse ua jepni të varfërve fshehurazi, kjo është edhe më mirë për ju, sepse kështu Ai *(Allahu)* ua fal gjynahet tuaja. Allahu i di hollësisht veprat tuaja.

Shpjegimi i ajetit

- "Nëse i jepni sadakatë haptazi, kjo është mirë..." - Pra, nëse i jepni sadakatë haptas, në mënyrë që t'ju shohin të tjerët, ato janë të mira, por nëse me to synohet kënaqësia e Allahut. Nëse sadakatë jepen për të kënaqur Krijuesin, ato nuk i dëmton aspak fakti që jepen haptazi. Ato janë të mira, sepse nëpërmjet tyre arrihet qëllimi i lartë: shpërblimi i Allahut të Lartësuar.

- "...por nëse ua jepni të varfërve fshehurazi, kjo është edhe më mirë për ju." - Nga ky ajet kuptohet se sadakaja që i jepet të varfërit fshehtas, është më e mirë se sadakaja që i jepet atij haptaz.

Pra, ky gjykim është i vlefshëm kur bëhet fjalë për sadakatë që u jepen të varfërve, sepse kështu e ka veçuar Allahu i Lartësuar, duke thënë: "...nëse ua jepni të varfërve fshehurazi...". Me fjalë të tjera, nëse sadakatë nuk u jepen të varfërve, por shpenzohen në lëmi të tjera të shpenzimit, fshehja e sadakasë nuk është më e mirë se dhënia e saj haptazi.

Kriteri gjykues, në të tilla raste, varet nga dobia që shpresohet me shfaqjen ose jo të të tilla veprave. Kështu, nëse sadakaja e hapur shërben për të nxitur të tjerët që edhe ata të japin, sigurisht që kjo mënyrë është më e mirë.

Thënia e Allahut të Lartësuar: "nëse ua jepni të varfërve", tregon se njeriu duhet të sigurohet mirë se kujt po ia jep sadakanë, pasi mund të ketë më të varfër dhe më nevojtarë se ai të cilit po ia jep. Sadakadhënia ka një shpërblim të madh nga Allahu i Madhëruar, që thotë:

- "...sepse kështu Ai *(Allahu)* jua fal gjynahet tuaja." – Pra, për sadakanë e dhënë shpërblimi që merr njeriu është dy llojesh: të mira të shumta nga Allahu dhe largim të këqijash, sepse kur Allahu i Lartësuar të fal gjynahet, do të thotë që je i ruajtur nga pasojat e tyre të këqija, që janë fatkeqësi e dënime të ndryshme.

- "Allahu i di hollësisht veprat tuaja." - Çfarëdolloj pune që të kryejmë, të mirë apo të keqe, të vogël apo të madhe, të pakët apo të shumtë, ajo është e ditur dhe e shënuar nga Allahu, dhe për të është përgatitur shpërblim me drejtësi.

Ajeti 272

272. Nuk është detyrë e jotja udhëzimi i tyre. Është Allahu që udhëzon në rrugë të drejtë atë që Ai do. Çfarëdo të mire që të jepni, e keni për veten tuaj. Por çdo gjë ta jepni veçse për hir të Allahut, sepse çdo të

mirë që ju jepni do t'ju kompensohet në mënyrë të plotë, pa ju cenuar aspak".

Shpjegimi i ajetit

- "Nuk është detyrë e jotja udhëzimi i tyre. Është Allahu që udhëzon në rrugë të drejtë atë që Ai do." - Allahu i Lartësuar, duke iu drejtuar Profetit të Tij, i thotë se udhëzimi i krijesave për të besuar apo jo, nuk është në kompetencën e tij. Detyra e një Profeti është thjesht përcjellja dhe sqarimi i të vërtetës. Ndërsa udhëzimi i tyre, që të besojnë apo jo, është në dorën e Zotit.

Ky ajet mbështet qëndrimin se lejohet që sadakatë t'u jepen edhe jomuslimanëve, domethënë atyre që ende nuk janë udhëzuar të kuptojnë dhe të besojnë, sepse, më tej, Allahu i Lartësuar thotë:

- "Çfarëdo të mire që të jepni, e keni për veten tuaj. Por çdo gjë ta jepni veçse për hir të Allahut..." – Pra, çfarëdo lloj të mire që të shpenzoni, të madhe apo të vogël, që ua jepni muslimanëve apo jomuslimanëve, mirësia e saj kthehet tek ju. Pra, ajeti nuk e përcakton që sadakatë duhet t'u jepen vetëm muslimanëve, por ai është gjithëpërfshirës.

Në fakt, Allahu i Lartësuar na tregon këtu për sadakatë e besimtarëve, të cilët japin veçse për një qëllim të caktuar: që të kënaqin Allahun e Lartësuar, sepse besimi i tyre i pengon ata që të kenë ndonjë qëllim tjetër veç këtij. Besimi i tyre i detyron ata që të jenë të sinqertë e të pastër.

- "...sepse çdo të mirë që ju jepni do t'ju kompensohet në mënyrë të plotë, pa ju cenuar aspak" - Shpërblimin për çdo bamirësi tuajën do ta gjeni të plotë Ditën e Gjykimit. Juve nuk do t'ju preket asgjë, domethënë nuk do t'ju pakësohet aspak shpërblimi që meritoni dhe nuk do t'ju shtohen aspak të këqijat që keni bërë.

Më poshtë, Allahu i Lartësuar na udhëzon që t'ia japim sadakanë një kategorie të caktuar njerëzish, të cilët konsiderohen si më parësorët dhe që kanë gjashtë cilësi:

Ajeti 273

273. Ajo *(sadakaja)* u takon të varfërve, të cilët janë të angazhuar në rrugën e Allahut dhe nuk kanë mundësi të lëvizin nëpër tokë. Ata nuk lypin, prandaj ai që nuk e di gjendjen e tyre mendon se ata janë të pasur. Ata njihen nga vetë pamja e tyre, ndonëse ata nuk kërkojnë me ngulm dhe nuk i bezdisin njerëzit. Çfarëdo të mire që të jepni, s'ka dyshim se Allahu e di shumë mirë.

Shpjegimi i ajetit

- "Ajo *(sadakaja)* u takon të varfërve, të cilët janë të angazhuar në rrugën e Allahut dhe nuk kanë mundësi të lëvizin nëpër tokë." - Cilësia e parë e atyre që e meritojnë më shumë sadakanë është skamja e tyre. Cilësia e dytë është: të jenë të angazhuar në rrugën e Allahut, domethënë, të jenë të përkushtuar në bindjen ndaj Allahut dhe të luftojnë në rrugën e Zotit. Si të tillë, ata nuk mund ta braktisin detyrën që kanë mbi supe. Ndërsa cilësia e tretë është pamundësia e tyre për të kërkuar rizkun, siç thotë i Lartësuari: "nuk kanë mundësi të lëvizin nëpër tokë", pra, që të kërkojnë rizkun.

- "Ata nuk lypin, prandaj ai që nuk e di gjendjen e tyre mendon se ata janë të pasur." – Kështu, cilësia e katërt është: nëse nuk e di gjendjen e tyre, mendon se ata janë të pasur. Kjo ndodh, sepse ata janë të rezervuar në kërkesat e tyre dhe nuk bezdisin askënd. Ky është tregues për durimin e tyre në detyrën që i kanë vënë vetes.

- "Ata njihen nga vetë pamja e tyre, ndonëse ata nuk kërkojnë me ngulm dhe nuk i bezdisin njerëzit. - Cilësia e pestë është: ata mund t'i njohësh nga shenjat e tyre.

Ata vërtet mund të dallohen, por jo nga çdokush. Pra, kjo fjalë nuk bie ndesh me cilësinë e lartpërmendur, ku Allahu thotë:

"...ai që nuk e di gjendjen e tyre mendon se ata janë të pasur". Ata në të vërtetë nuk bien në sy, sepse janë shumë të vetëpërmbajtur, aq sa ai që nuk i njeh nuk mund t'i dallojë dhe të gjykojë se janë të varfër, por një njeri inteligjent e i sprovuar mund t'i njohë ata shumë mirë, duke u nisur nga shenjat e tyre, të cilat Allahu i Lartësuar i ka sqaruar.

Ndërsa cilësia e gjashtë e tyre është: "...ata nuk kërkojnë me ngulm dhe nuk i bezdisin njerëzit". Pra, edhe nëse mund të ndodhë që të kërkojnë ndonjëherë, këtë nuk e bëjnë me këmbëngulje, por e bëjnë vetëm njëherë dhe me butësi.

Këta janë njerëzit që meritojnë të parët sadakanë, sepse ata kanë cilësi shumë të vyera. Megjithatë, kujtdo që t'i jepen, sadakatë konsiderohen si bamirësi, për të cilën dhënësi do të shpërblehet. Prandaj i Madhëruari thotë përsëri:

- "Çfarëdo të mire që të jepni, s'ka dyshim se Allahu e di shumë mirë." – Pra, çfarëdo që të shpenzoni dhe kujtdo që t'ia jepni, Allahu e di shumë mirë dhe do t'ju shpërblejë, gjithashtu, më së miri.

Më poshtë, Allahu i Lartësuar flet për sadakadhënësit në mënyrë përmbledhëse.

Ajeti 274

274. Ata që e shpërndajnë pasurinë e vet natën dhe ditën, fshehurazi dhe haptazi, ata e kanë shpërblimin te Zoti i tyre. Për ta nuk ka as frikë, as dëshpërim.

Shpjegimi i ajetit

- "Ata që e shpërndajnë pasurinë e vet natën dhe ditën, fshehurazi dhe haptazi..." – Domethënë, ata që e shpenzojnë pasurinë e tyre në rrugën e Zotit, pra, për hir të Tij e jo për të përmbushur dëshirat e ndaluara apo të papëlqyeshme; ata që shpenzojnë natën dhe ditën, fshehtas apo haptas.

- "...ata e kanë shpërblimin te Zoti i tyre. Për ta nuk ka as frikë, as dëshpërim." – Njerëz të tillë do të kenë një shpërblim shumë të madh nga Zoti i tyre Bujar. Kur ata që kanë kryer vepra të këqija do të jenë të mbushur me ankth e frikë për veprat e tyre, këta fatlumë do të jenë të çliruar nga çdo lloj frike. Atë ditë, ata që e kanë tepruar duke shkelur kufijtë e Zotit dhe duke neglizhuar dispozitat e Tij, do të dëshpërohen dhe do të trishtohen, ndërsa këta të tjerët do të lumturohen, duke arritur çdo gjë që dëshirojnë. Këta do të gëzohen, sepse do të shpëtojnë nga çdo e keqe që i druheshin më parë.

Kjo është gjendja e bamirësve, të cilët kujdesen për robërit nevojtarë të Zotit. Ata kujdesen për të plotësuar detyrimet e veta ndaj Zotit dhe detyrimet ndaj krijesave të Tij.

Ndërsa më poshtë, Allahu i Lartësuar na jep një pasqyrim të palës tjetër, që janë të kundërtit e bamirësve. Ata janë të padrejtët vepërkëqij, të cilët jo vetëm që nuk përmbushin detyrimet e tyre ndaj Krijuesit, por shkelin plotësisht edhe të drejtat e krijesave të Zotit.

Ajeti 275

275. Ata që e hanë kamatën, ata do të ngrihen ashtu sikurse ngrihet i çmenduri nga prekja e shejtanit. Kështu, sepse ata thanë: "Edhe shitblerja është njësoj si kamata!" Por Allahu e ka lejuar shitblerjen dhe e ka ndaluar kamatën. Atij që, kur i arrin këshilla prej Zotit të tij, distancohet prej saj *(kamatës)*, i takon plotësisht pasuria e grumbulluar më parë dhe çështja e tij mbetet tek Allahu. Por ata që i kthehen sërish asaj, ata do të jenë banues të Zjarrit, ku do të rrinë përjetësisht.

Shpjegimi i ajetit

- "Ata që e hanë kamatën, ata do të ngrihen ashtu sikurse ngrihet i çmenduri nga prekja e shejtanit." - Allahu i Lartësuar na flet në këtë ajet për ata që hanë ose përdorin kamatën. Gjendja e tyre është shumë e keqe dhe përfundimi i tyre do të jetë shumë i

frikshëm. Kur ata të ngrihen nga varri për t'u gjykuar, ata do të dallohen nga të tjerët, sepse do të ngrihen si të çmendur, ose më saktë, si ata që i ka çmendur shejtani. Ata do të ngrihen nga varri të çoroditur, të dehur e të tmerruar, duke pritur llogarinë e vështirë dhe ndëshkimin e madh.


- "Kështu, sepse ata thanë: "Edhe shitblerja është njësoj si kamata!"" – Këto fjalë mund t'i thotë veçse një injorant ose një kryeneç, që bën sikur nuk di. Për shkak të këtyre fjalëve të rënda, Allahu i Lartësuar do t'i ndëshkojë ata duke u dhënë një lloj gjendjeje që e përjetojnë të çmendurit.

Ka mundësi që thënia e Allahut të Lartësuar: "...ata do të ngrihen ashtu sikurse ngrihet i çmenduri nga prekja e shejtanit", të tregojë edhe gjendjen e tyre në këtë jetë. Pra, duke qenë se ata tregohen të palogjikshëm kur rendin për të fituar pasurinë e të tjerëve me padrejtësi, Allahu i Lartësuar i dënon duke ua dobësuar aftësinë e të menduarit. Aq i rëndë është ky dënim, saqë ata, me sjelljen e tyre, u përngjajnë të çmendurve. Ata janë të paqëndrueshëm, të turbullt e të çoroditur.

Më pas, duke shfaqur urtësinë e Tij dhe në përgjigje të shpërfilljes së tyre, Allahu i Lartësuar thotë:

- "Por Allahu e ka lejuar shitblerjen dhe e ka ndaluar kamatën." - Për shkak të nevojës së madhe që kanë njerëzit për shitblerjen dhe dobitë e saj gjithëpërfshirëse, Allahu i Lartësuar e ka lejuar tregtinë. Përndryshe, ndalimi i saj do të sillte vështirësi tepër të mëdha për ta.

Ky ajet merret si bazë për të gjykuar lejimin e çdo lloj mënyre fitimi që ushtrojnë njerëzit. E thënë ndryshe, çdo mënyrë fitimi apo bashkëveprimi mes njerëzve që plotëson nevojat e tyre dhe ka dobi gjithëpërfshirëse është e lejuar, përveç atyre mënyrave që Sheriati i ndalon. Mënyrat të cilat Sheriati i ka ndaluar nuk duhen ndjekur, sepse ato janë të dëmshme dhe shkaktojnë padrejtësi e


الجزء الثالث سورة البقرة
الَّذِينَ يَأْكُلُونَ الرِّبَوٰا۟ لَا يَقُومُونَ إِلَّا كَمَا يَقُومُ الَّذِى
يَتَخَبَّطُهُ الشَّيْطَٰنُ مِنَ الْمَسِّ ۚ ذَٰلِكَ بِأَنَّهُمْ قَالُوٓا۟ إِنَّمَا الْبَيْعُ
مِثْلُ الرِّبَوٰا ۗ وَأَحَلَّ اللَّهُ الْبَيْعَ وَحَرَّمَ الرِّبَوٰا ۚ فَمَن جَآءَهُۥ
مَوْعِظَةٌ مِّن رَّبِّهِۦ فَٱنتَهَىٰ فَلَهُۥ مَا سَلَفَ وَأَمْرُهُۥٓ إِلَى اللَّهِ ۖ وَمَنْ
عَادَ فَأُو۟لَٰٓئِكَ أَصْحَٰبُ ٱلنَّارِ ۖ هُمْ فِيهَا خَٰلِدُونَ ﴿٢٧٥﴾ يَمْحَقُ
اللَّهُ الرِّبَوٰا وَيُرْبِى الصَّدَقَٰتِ ۗ وَاللَّهُ لَا يُحِبُّ كُلَّ كَفَّارٍ أَثِيمٍ
﴿٢٧٦﴾ إِنَّ الَّذِينَ ءَامَنُوا۟ وَعَمِلُوا۟ الصَّٰلِحَٰتِ وَأَقَامُوا۟ الصَّلَوٰةَ
وَءَاتَوُا۟ الزَّكَوٰةَ لَهُمْ أَجْرُهُمْ عِندَ رَبِّهِمْ وَلَا خَوْفٌ عَلَيْهِمْ
وَلَا هُمْ يَحْزَنُونَ ﴿٢٧٧﴾ يَٰٓأَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا۟ ٱتَّقُوا۟ اللَّهَ
وَذَرُوا۟ مَا بَقِىَ مِنَ الرِّبَوٰٓا إِن كُنتُم مُّؤْمِنِينَ ﴿٢٧٨﴾ فَإِن لَّمْ تَفْعَلُوا۟
فَأْذَنُوا۟ بِحَرْبٍ مِّنَ اللَّهِ وَرَسُولِهِۦ ۖ وَإِن تُبْتُمْ فَلَكُمْ رُءُوسُ
أَمْوَٰلِكُمْ لَا تَظْلِمُونَ وَلَا تُظْلَمُونَ ﴿٢٧٩﴾ وَإِن كَانَ
ذُو عُسْرَةٍ فَنَظِرَةٌ إِلَىٰ مَيْسَرَةٍ ۚ وَأَن تَصَدَّقُوا۟ خَيْرٌ لَّكُمْ
إِن كُنتُمْ تَعْلَمُونَ ﴿٢٨٠﴾ وَٱتَّقُوا۟ يَوْمًا تُرْجَعُونَ فِيهِ إِلَى
اللَّهِ ۖ ثُمَّ تُوَفَّىٰ كُلُّ نَفْسٍ مَّا كَسَبَتْ وَهُمْ لَا يُظْلَمُونَ ﴿٢٨١﴾
٤٧

pakënaqësi mes palëve. Kështu Allahu i Lartësuar e ka lejuar tregtinë, por e ka ndaluar fajden, sepse ajo është padrejtësi dhe sjell të këqija për të gjithë.

Kamata është dy llojesh: *nesie* [11] dhe *fadl* [12]. Që të dyja janë të ndaluara, mbështetur në

[11] Kamata nesie (kamatëvonesa) është shtesa e vendosur si kusht, që kërkon borxhdhënësi nga borxhmarrësi, mbi pagesën e një detyrimi, nëse ky nuk shlyhet në afatin e caktuar. Me fjalë të tjera është kamata që rrjedh si pasojë e dhënies borxh me interes. Sa më shumë të vonohet shlyerja e borxhit aq më shumë shtohet interesi (kamata). Ky është lloji i kamatës që është ndaluar me argument nga Kur'âni, syneti dhe konsensusi i gjithë umetit.

[12] Kamata fadl (kamata e differences) është blerja e monedhave me monedha (të të njëjtit lloj) apo e ushqimit me ushqim (të të njëjtit lloj), me diferencë në peshë apo në masë. Me fjalë të tjera të blesh 1000 euro me 1200 euro, apo të blesh 1 kv grurë vendi me 1.5 kv grurë importi. Në hadithin e transmetuar nga Ubadetu ibnu Samit, Profeti a.s.: "Floriri me flori, argjendi me argjend, gruri me grurë, elbi me elb, hurma me hurmë, kripa me kripë; të gjitha këto duhet të jenë të të njëjtit lloj, të të njëjtës masë, dorë më dorë (në moment jo me vonesë). Nëse ndryshojnë llojet, shisni e blini si të doni,

Kur'ân dhe Sunet. Ndalimi i kamatës *nesie* mbështetet edhe në qëndrimin unanim të dijetarëve për këtë çështje, ndërsa ata që e konsiderojnë të lejuar kamatën *fadl* kanë kundërshtuar në këtë mënyrë gjithë ato tekste të përcjella me saktësi. Prandaj themi që kamata, me të dyja llojet e saj, është një nga gjynahet e mëdha dhe shkatërruese.

- "Atij që, kur i arrin këshilla prej Zotit të tij, distancohet prej saj *(kamatës)*, i takon plotësisht pasuria e grumbulluar më parë dhe çështja e tij mbetet tek Allahu." – Pra, nëse dikujt i mundësohet, si mëshirë nga Allahu i Lartësuar, që t'i tërhiqet vërejtja për t'u larguar nga kjo vepër e keqe, dhe ai i largohet asaj, atëherë çdo përfitim nga kamata që ai ka marrë përpara se t'i vinte këshilla, i falet dhe konsiderohet si pasuri e tij. Ai është i falur, si shpërblim për pranimin e këshillës dhe nënshtrimin ndaj dispozitave të Zotit të tij.

Nga ajeti kuptojmë, gjithashtu, se ai që nuk heq dorë edhe pas vërejtjes që i bëhet, do të merret në përgjegjësi për veprat e këqija që ka bërë edhe para vërejtjes, edhe pas vërejtjes. Veprat e njeriut do të llogariten dhe do të shpërblehen me drejtësi prej Allahut të Lartësuar.

- "Por ata që i kthehen sërish asaj, ata do të jenë banues të Zjarrit, ku do të rrinë përjetësisht." - Pra, kush i rikthehet asaj, do të jetë banues i përjetshëm i Zjarrit.

Të tilla tekste, në kuptimin e tyre të drejtpërdrejtë, tregojnë se ata që bëjnë gjynahe të mëdha do të jenë në zjarr të Xhehenemit përgjithmonë. Por, sikurse dihet, në Xhehenem do të jenë përjetësisht veçse ata që kanë bërë kufër dhe shirk, ndërsa të tjerët, me gjynahe poshtë këtyre, nuk do të rrinë përjetësisht atje.

Atëherë, ç'shpjegim ka për tekste të tilla, të cilat, në kuptimin e tyre të drejtpërdrejtë, tregojnë se në zjarr të Xhehenemit do të jenë përjetësisht edhe vepruesit e gjynaheve të mëdha, përveç kufrit dhe shirkut?

Dijetarët kanë dhënë shpjegime të ndryshme për këtë çështje, por shpjegimi më i saktë është ky që vijon: Të gjitha ato gjynahe për të cilat Sheriati ka lajmëruar se të lënë përjetësisht në zjarrin e Xhehenemit është e vërtetë që janë të tilla, domethënë që e bëjnë të detyrueshme që vepruesi i tyre të jetë përjetë në Xhehenem. Çdokush që i kryen ato vepra mund të jetë përjetësisht në Zjarr, nëse nuk ka se çfarë ta pengojë një gjë të tillë. Po cilat janë ato gjëra që e pengojnë një gjë të tillë? Dihet me siguri, sipas teksteve të Kur'ânit dhe të Sunetit dhe sipas *ixhma*-it të selefëve, se imani dhe teuhidi janë penguesit e vetëm që e shpëtojnë njeriun nga përjetësia në zjarrin e Xhehenemit. Pra, nëse njeriu nuk ka as besim, as teuhid, këto vepra e bëjnë të meritueshëm ndëshkimin e përjetshëm të tij në zjarrin e Xhehenemit.

---

por, dorë më dorë (jo me vonesë)." Transmeton Muslimi.

Pra nëse blejme flori me flori, hurma me hurma, e kështu me rradhë, duhet të kemi dy gjëra parasysh:

1. pavarësisht nga cilësia e produktit, masë apo pesha, si e mallit ashtu edhe e çmimit, duhet të jenë të njëjta pa diferencë. 100 gram flori blihen me 100 gr flori sido që të jetë cilësia; 100 kg oriz vendi blihen me 100 kg oriz importi, sido që të jetë cilësia, e kështu me rradhë.
2. blerja të bëhet në moment dorë më dorë, jo me afat. Pra nuk lejohet të shesësh 100 kg oriz me 100 kg oriz por që pagesa të mos bëhet menjëherë e të bëhet më vonë.

Ndërsa nëse blejmë flori me argjend, apo hurma me kripë, e kështu me rradhë, nuk ka problem të ndryshojë masa apo pasha, por mbetet në fuqi kushti I dytë, pra mos vonesa e pagesës. 100 gr flori mund të blihet me 300 gr argjend, por me kusht që pagesa të bëhet dorë më dorë pa toleruar asnjë lloj vonese (pra pagesa të bëhet pa u larguar nga mexhlisi).

A vlen ky gjykim edhe për lloje të tjera mallrash apo jo, kjo është temë më vete dhe dijetarët kanë dhënë mendime të ndryshme për të. Kjo është sqaruar në librat e fikhut gjerësisht.

Ajeti 276

276. Allahu e zhduk kamatën dhe e shton sadakanë. Allahu nuk e do asnjë mohues dhe gjynahqar.

Shpjegimi i ajetit

- "Allahu e zhduk kamatën dhe e shton sadakanë." – Kuptimi: Allahu e zhduk, e largon begatinë e kamatës. Ajo është shkak për largimin e begatisë dhe për shkaktimin e problemeve në pasuri. Edhe sikur ta shpenzosh në bamirësi këtë lloj pasurie, nuk merr kurrë shpërblim prej saj. Përkundrazi, ajo do të jetë rruga për t'u futur në Zjarr. Ndërsa nga ana tjetër, Allahu thotë që Ai "e shton sadakanë", domethënë fal begati të madhe në atë pasuri prej së cilës shpenzohet dhe e shpërblen shumëfish shpenzuesin.

Ky gjykim është i drejtë, sepse është sipas punës së bërë. Fajdexhiu u bën padrejtësi njerëzve duke u marrë pasurinë me një mënyrë jo të ligjshme, jo të lejueshme nga Allahu i Lartësuar. Për këtë shkak, ai meriton që pasuria e tij të shkojë kot, të jetë e pabegatshme. Ndërsa ai që bën bamirësi ndaj njerëzve, duke shpenzuar me të gjitha mënyrat, meriton bujarinë e Zotit të tij, dhe dihet shumë mirë se Allahu i Lartësuar është më bujar se robi i Tij. Ai e nderon dhe e kënaq atë me mirësi më të shumta e më të mëdha sesa ato që robi i jep për të kënaqur krijesat e Tij.

- "Allahu nuk e do asnjë mohues dhe gjynahqar." - Allahu i Lartësuar nuk e do atë që është mohues i madh e i vazhueshëm, pra, këmbëngulës në mohimin dhe mosmirënjohjen e tij ndaj Zotit. Këtë mosmirënjohje ai e shpreh duke mos shpenzuar në ato drejtime për të cilat Zoti i tij e ka urdhëruar. Ai e shpreh mosmirënjohjen e tij duke dhunuar të tjerët, të cilët gjithmonë heqin keq prej sherrit të tij.

Allahu nuk e do as atë që është gjynahqar i madh, atë që bën vepra të cilat meritojnë ndëshkimin e Tij.

Allahu i Lartësuar përmendi në fillim ata që hanë fajdenë, duke thënë që nëse ata do të ishin besimtarë, nuk do të vazhdonin në kryerjen e një vepre të tillë të shëmtuar. Më pas, Ai flet për besimtarët dhe i urdhëron ata që të qëndrojnë larg fajdeve.

Ajeti 277

277. S'ka dyshim se, ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, që e falin namazin dhe e japin zekatin, e kanë shpërblimin te Zoti i tyre. Ata nuk do të kenë kurrfarë frike dhe as do të brengosen.

Shpjegimi i ajetit

Këto fjalë janë shpjeguar më parë (shih ajetet 62 dhe 262 të sures Bekare).

Ajeti 278

278. O ju që besoni! Kini frikë Allahun dhe hiqni dorë prej asaj që u ka mbetur nga kamata, nëse jeni besimtarë të sinqertë.

Shpjegimi i ajetit

Allahu u drejtohet besimtarëve me cilësinë e tyre të vyer: besimin. Për çfarë i porosit Allahu i Lartësuar besimtarët? Ai i porosit për të lënë kamatën, madje duke e konsideruar largimin prej saj si shenjë të besimit të tyre, kur thotë: "...hiqni dorë prej asaj që u ka mbetur nga kamata, nëse jeni besimtarë të sinqertë". Ai përmend besimin e tyre, sepse vetëm besimtarët janë ata që e pranojnë këshillën e Zotit të tyre. Vetëm ata i nënshtrohen urdhrave dhe i zbatojnë dispozitat e Tij.

Allahu i Lartësuar i urdhëron besimtarët për devotshmëri, duke zbatuar dispozitat e Tij dhe duke ruajtur kufijtë e Tij. Prej dispozitave që duhen zbatuar për të qenë i sigurt nga ndëshkimi i Zotit, është edhe heqja dorë nga kamata, nëse ekziston ende një kontratë e tillë. Ndërsa kontratat e shkuara me kamatë janë të falura, nëse

njeriu pendohet sinqerisht. Ndërsa ai që nuk pendohet pas këshillës së Zotit të tij dhe nuk i nënshtrohet urdhrit të Tij, atëherë ai i ka deklaruar luftë Zotit:

Ajeti 279

279. E në qoftë se nuk e bëni këtë, atëherë dijeni se jeni në luftë me Allahun dhe të Dërguarin e Tij. Nëse pendoheni, atëherë ju takon malli juaj fillestar, se kështu nuk dëmtoni dhe as vetë nuk dëmtoheni.

Shpjegimi i ajetit

- "E në qoftë se nuk e bëni këtë, atëherë dijeni se jeni në luftë me Allahun dhe të Dërguarin e Tij." – Ky njeri guxon të bëjë një zgjedhje të tillë, ndërkohë që është aq i pafuqishëm para Zotit të tij, që është i Plotfuqishëm e i Urtë. Ai vërtet e afatizon të padrejtin e kriminelin, por kur e ndëshkon, e ndëshkon ashtu siç i ka hije të Plotfuqishmit.

- "Nëse pendoheni, atëherë ju takon malli juaj fillestar, se kështu nuk dëmtoni dhe as vetë nuk dëmtoheni." - Nëse pendoheni, atëherë ju takon kapitali juaj fillestar, pa përfshirë fitimin nga kamata. Kështu nuk u bëni padrejtësi të tjerëve, duke mos u marrë shtesë mbi borxhin, dhe të tjerët nuk ju bëjnë padrejtësi juve, duke mos iu dhënë më pak nga shuma e borxhit.

Ajeti 280

280. Po në qoftë se tjetri është në gjendje të vështirë, atëherë afatizojeni, derisa të lehtësohet. Por, po t'ia falni, është shumë më mirë për ju, nëse e dini.

Shpjegimi i ajetit

- "Po në qoftë se tjetri është në gjendje të vështirë, atëherë afatizojeni, derisa të lehtësohet." - Nëse borxhliu është ngushtë dhe nuk mundet që ta shlyejë borxhin, atëherë është detyrë për huadhënësin që ta afatizojë borxhliun, derisa ai të ketë mundësi për shlyerje.

- "Por, po t'ia falni, është shumë më mirë për ju, nëse e dini." – Pra, nëse bëni bamirësi duke ia falur të gjithë borxhin apo një pjesë të tij, kjo është një vepër e shkëlqyer.

Ajeti 281

281. Dhe ruajuni asaj dite kur do të ktheheni tek Allahu, kur secilit do t'i jepet e plotë ajo që ka fituar, pa iu bërë asnjë padrejtësi.

Shpjegimi i ajetit


Ky është nga ajetet e fundit që janë shpallur prej Kur'ânit. Ai është një ajet madhështor, prandaj është përzgjedhur për të qenë mbyllja e dispozitave, urdhrave e ndalesave të ligjëruara nga Zoti i gjithësisë. Ky ajet është shumë i përshtatshëm për këtë mbyllje, sepse përmban premtimin për shpërblim dhe paralajmërimin për ndëshkim ndaj atyre që e meritojnë.

Ai që e di me siguri se do të kthehet te Zoti i tij, i Cili do ta marrë në llogari për çdo gjë që ka bërë, qoftë ajo e madhe apo e vogël, e shfaqur apo e fshehur, sepse Allahut nuk mund t'i fshihet asgjë, atëherë një njeriu të tillë do t'i mbushet zemra me ndjenja devotshmërie, me frikë dhe me shpresë. Nëse zemra e robit nuk i ka këto njohuri, atëherë nuk ka asnjë mundësi që ajo të mbushet me të tilla ndjenja të mrekullueshme, të cilat i përjeton vetëm adhuruesi dhe askush tjetër.

Ajeti 282

282. O ju që keni besuar! Kur merrni hua prej njëri-tjetrit për një afat të caktuar, shkruajeni atë! Le të mbajë shënim me drejtësi një shkrues! Shkruesi të mos ngurrojë të shkruajë ashtu si e ka mësuar Allahu! Ai le të shkruajë, ndërsa ai që merr borxh të diktojë, duke iu frikësuar Allahut, Zotit të tij, e duke mos lënë mangët asgjë.

Në qoftë se ai që ngarkohet me borxh është i papjekur mendërisht, ose i mitur, ose nuk është në gjendje të diktojë, atëherë le të diktojë me drejtësi kujdestari i tij ligjor. Kërkoni që të dëshmojnë dy burra nga mesi juaj. Nëse nuk bëhen dy burra, atëherë, duke rënë dakord për njerëzit e zgjedhur, merrni një burrë e dy gra, në mënyrë që, nëse njëra prej tyre harron, t'ia përkujtojë tjetra. Dëshmitarët nuk duhet të refuzojnë kur ftohen për të dëshmuar. Dhe mos përtoni ta shkruani atë *(borxhin)* dhe afatin e tij, qoftë i vogël apo i madh. Kjo është më e drejtë tek Allahu, më e vlefshme si dëshmi dhe më larg dyshimeve. Nëse është shitblerje e atypëratyshme midis jush, atëherë nuk është ndonjë gjynah të mos e shënoni. Megjithatë, kur bëni shitblerje, dëshmojeni me dëshmitarë. Nuk duhet të dëmtohen as shkruesi, as dëshmitarët, prandaj, nëse e bëni, do të jetë tejkalim nga ana juaj. Kini frikë Allahun! Allahu ju dhuron dituri. Allahu është i Dijshëm për çdo gjë.



Shpjegimi i ajetit

Ky quhet "ajeti i borxhit", i cili është ajeti më i gjatë në Kur'ân. Në të sqarohen rregulla e ligje shumë të rëndësishme.

- "O ju që keni besuar! Kur merrni hua prej njëri-tjetrit për një afat të caktuar, shkruajeni atë!" - Lejohet dhënia dhe marrja e të gjitha llojeve të borxhit, sepse Allahu i Lartësuar i ka miratuar besimtarët në këto marrëveshje mes tyre, duke treguar rregullat që lidhen me mbarëvajtjen e tyre.

Për sa i përket shitblerjes që quhet *selem* [13] (shitblerja me porosi), ajo ka dy kushte që të konsiderohet e lejueshme:

1. Të shlyhet në një afat kohor, pra, jo në moment.

2. Ky afat duhet të jetë i përcaktuar dhe i qartë nga palët. Nuk lejohet që afati të jetë i papërcaktuar.

Ajeti na urdhëron që të mbajmë procesverbal për çdo lloj borxhi. Ky urdhër mund të jetë ose në formën e prerë, pra, i detyrueshëm për t'u zbatuar, ose i pëlqyeshëm. Kjo varet nga shkalla e nevojës për një procesverbal. Nëse do të neglizhonim dokumentimin e këtyre kontratave, do të ishim të ekspozuar ndaj ngatërresave të ndryshme, ndaj gabimeve, harresave etj., të cilat do të sillnin grindje e mosmarrëveshje, e ky do të ishte një gabim i rëndë.

- "Le të mbajë shënim me drejtësi një shkrues! Shkruesi të mos ngurrojë të shkruajë ashtu si e ka mësuar Allahu!" - Është detyrë për shkruesin që të shkruajë procesverbalin, nëse ftohet për një vepër të tillë.

[13] Shitblerje me porosi, sipas legjislacionit Islam është çdo lloj akti shitblerje në të cilin malli porositet me cilësi të caktuara, me pagesë në vendin e aktit, por që malli të dorëzohet në një afat kohor të pranuar nga të dyja palët. Profeti a.s. ka thënë: "*Kush parapaguan për një mall të vonuar le të përcaktojë masën, peshën dhe kohën.*"

Shkruesi duhet të jetë i drejtë, i devotshëm dhe i ruajtur nga gjynahet e shfaqura. Pra, nuk duhet të jetë *fasik*, nuk duhet të jetë një njeri që njihet si gjynaqar dhe që shkel urdhrat dhe kufijtë e Zotit haptazi. Prej *fasik*-ut nuk pranohet dëshmia as me gojë, as me shkrim.

Ai është i detyruar që të mbajë drejtësi për të dyja palët. Atij nuk i lejohet që të anojë nga njëra palë, për asnjë shkak apo arsye.

Shkruesi duhet të jetë specialist në fushën e dokumentimit. Ai duhet të dijë se çfarë konsiderohet si dokument që vërteton marrëveshjet dhe saktësinë e tyre, sepse drejtësia mund të vihet në vend vetëm nëpërmjet kësaj rruge e mënyre.

Nëse një dokument i tillë është i nënshkruar dhe i saktë, ai merret gjithmonë për bazë, edhe nëse dëshmitarët mund të kenë vdekur.

Allahu i Lartësuar thotë: "Shkruesi të mos ngurrojë të shkruajë ashtu si e ka mësuar Allahu!" Pra, nuk lejohet për një njeri të cilit Allahu i Lartësuar i ka dhuruar dije në përpilimin e aktmarrëveshjeve, që të refuzojë të kryejë këtë punë, nëse ajo i kërkohet. Ashtu sikurse Allahu i Lartësuar i ka falur të tilla aftësi të mrekullueshme, ashtu duhet që edhe ai të tregohet bamirës ndaj atyre që kanë nevojë për të tilla shërbime.

- "Ai le të shkruajë, ndërsa ai që merr borxh të diktojë, duke iu frikësuar Allahut, Zotit të tij, e duke mos lënë mangët asgjë." - Allahu urdhëron që shkruesi të mbajë shënim veçse ato fjalë që ia dikton ai që merr borxhin, pra, huamarrësi.

Ai që dikton tekstin e procesverbalit është huamarrësi, i cili e ka për detyrë që ta shlyejë plotësisht borxhin. Ai është i urdhëruar, gjithashtu, që, gjatë diktimit, të qartësojë në detaje huanë që duhet ta shlyejë.

Ajeti tregon se dëshmia e njeriut për vetveten është e pranueshme dhe e vlefshme, sepse kur ai firmos dokumentin të cilin vetë e ka diktuar, dokumenti ka forcë ligjore, edhe nëse më pas ai pretendon se është bërë gabimisht apo se ka paqartësi.

Për sa u përket hollësirave rreth huasë në aspektin e masës, cilësisë, afatit të saj etj., nëse ka kundërshtime mes dy palëve nënshkruesve, atëherë fjala që merret në konsideratë dhe që pranohet ligjërisht është fjala e huamarrësit, i cili e ka për detyrë që ta shlyejë huanë. Nëse fjala e tij do të ishte e pavlefshme, atëherë urdhri i Allahut për të mos pakësuar asgjë prej borxhit do të ishte pa vlerë. E thënë ndryshe, nëse pohimi i borxhliut do të ishte i pavlefshëm ligjërisht, atëherë edhe urdhri i Allahut për të mos lënë gjë mangët gjatë diktimit do të ishte i pavlefshëm dhe i kotë. Por meqë kjo nuk ka mundësi të jetë, atëherë në rast kundërshtimesh mes nënshkruesve (dhe në mungesë të dokumentit) merret parasysh pohimi i huamarrësit (ndërsa huadhënësi duhet të sjellë dokumentin, për të vërtetuar pretendimin e tij).

Huamarrësi e ka haram që të fshehë ndonjë gjë prej pikave të kontratës, në çdo aspekt qoftë ajo.

- "Në qoftë se ai që ngarkohet me borxh është i papjekur mendërisht, ose i mitur, ose nuk është në gjendje të diktojë, atëherë le të diktojë me drejtësi kujdestari i tij ligjor." – Nëse huamarrësi nuk mund ta diktojë procesverbalin, për shkak të moshës së vogël apo të paaftësisë së tij mendore ose fizike, apo për shkaqe të tjera si këto, atëherë lejohet që në vend të tij, të diktojë përfaqësuesi i tij ligjor. Ai dikton dhe firmos dokumentin, duke mbajtur përgjegjësi ligjore në vend të të paaftit.

Përfaqësuesi ligjor është përgjegjës për të gjitha detyrimet e huamarrësit, sepse Allahu e ka përcaktuar se ky përfaqësim duhet të jetë me drejtësi.

Është kusht që përfaqësuesi ligjor të jetë i ndershëm, sepse diktimi me drejtësi nuk mund të bëhet nga një *fasik* ose nga një njeri

që i thyen haptazi urdhrat dhe dispozitat e Zotit.

Nga ajeti kuptohet se roli i kujdestarit ligjor njihet edhe në fushën e pasurive dhe të nënshkrimit të marrëveshjeve.

Detyrimi për larjen e borxhit nuk rëndon kurrsesi mbi përfaqësuesin ligjor, por mbi pajtuesin e këtij përfaqësuesi ligjor.

Marrëveshjet e nënshkruara nga të paaftët ligjërisht konsiderohen si të pavlefshme, sepse e drejta për të diktuar procesverbalin i takon përfaqësuesit të tyre ligjor, e jo vetë atyre. Kjo dispozitë është si mëshirë dhe butësi e Allahut të Lartësuar për krijesat e Tij. Ai përkujdeset për ta, që t'u ruajë pasurinë dhe të drejtat e tyre.

Nga ajeti kuptohet se çdo veprim i përfaqësuesit ligjor me pasuritë e të paaftëve ligjërisht, është i saktë dhe i pranueshëm nga drejtësia.

Është e lejueshme për njeriun që të mësojë gjithçka që i nevojitet rreth palës tjetër, për të bërë të mundur që dokumenti të jetë sa më i saktë, më i sigurt dhe më i plotë ligjërisht, sepse nëse një urdhër i caktuar mund të përmbushet vetëm nëpërmjet një mënyre tjetër, atëherë edhe kjo mënyrë tjetër është e detyrueshme që të kryhet. Ndjekja e mënyrave nëpërmjet të cilave plotësohen urdhrat e Zotit është *farz kifaje*, pra, një detyrim kolektiv që patjetër duhet përmbushur. Nëse e lënë të gjithë njerëzit pa e zbatuar, të gjithë marrin gjynah, por nëse e kryen dikush, përgjegjësia e të tjerëve bie. Kështu, duke qenë se Allahu i Lartësuar ka urdhëruar që për huatë dhe për kontratat e tjera të mbahet procesverbal, dhe duke qenë se kjo mund të arrihet veçse duke mësuar mënyrën e ndërtimit të kontratave, atëherë kjo e fundit është e detyrueshme që të kryhet nga dikush prej muslimanëve.

- "Kërkoni që të dëshmojnë dy burra nga mesi juaj." - Ajeti na urdhëron për të marrë dëshmitarë gjatë kontratave dhe marrëveshjeve tregtare. Megjithatë, ky urdhër nuk është i formës së prerë, pra, nuk është i detyrueshëm që të zbatohet. Ai është thjesht i pëlqyeshëm që të bëhet.

Qëllimi i këtij urdhri është që të na udhëzojë për të qenë të kujdesshëm në ruajtjen e të drejtave dhe detyrimeve të ndërsjellta. Pra, të gjitha këto dispozita janë vetëm në dobi të të përgjegjshmëve ligjërisht.

Megjithatë, ka raste kur prania e dëshmitarëve gjatë një aktmarrëveshjeje është e detyrueshme, si për shembull, kur ato kryen nga kujdestarët ligjorë të jetimit apo kur kemi të bëjmë me një kontratë vakëfi. Dëshmitarët në të tilla raste janë të domosdoshëm, me qëllim që të drejtat e palëve të përcaktohen dhe të ruhen të paprekura.

Numri i domosdoshëm i dëshmitarëve gjatë kontratave është dy burra, ose një burrë dhe dy gra. Duke u mbështetur në argumentet e transmetuara në traditën profetike, pranohet edhe dëshmia e një dëshmitari të vetëm, por duke u betuar.

Dëshmia e të miturve nuk pranohet, sepse ajeti e përcakton që duhet të jetë 'burrë' ose 'grua'.

- "Nëse nuk bëhen dy burra, atëherë, duke rënë dakord për njerëzit e zgjedhur, merrni një burrë e dy gra..." - Dëshmia e grave pa praninë e një dëshmitari mashkull në marrëveshjet e ndryshme nuk pranohet, sepse Allahu i Lartësuar e ka marrë në konsideratë dëshminë e tyre vetëm kur është edhe prania e burrave. Dikush mund të shprehet se Allahu i Lartësuar ka thënë që, në dëshmi, dy gra zëvendësojnë një burrë, dhe ky kusht mund të plotësohet njëlloj, qofshin apo jo burrat aty. Megjithatë, Allahu e di më mirë.

Dëshmia e skllavit në moshë madhore është njëlloj e pranueshme si dëshmia e të lirit, sepse thënia e Allahut: "Kërkoni që të dëshmojnë dy burra nga mesi juaj" i përfshin si të lirët, ashtu dhe skllevërit, pa u bërë ndonjë dallim mes tyre.

Dëshmia e jobesimtarëve, burra apo gra qofshin, është e papranueshme dhe e pavlefshme ligjërisht, sepse ata nuk janë prej nesh, ndërsa Allahu i Lartësuar thotë: "...dy burra nga mesi juaj". Gjithashtu, dihet se dëshmia ka si kusht të domosdoshëm që dëshmitari të jetë i drejtë e i ndershëm, dhe qafirët nuk e plotësojnë këtë kusht.

Ajeti tregon përparësinë e burrit kundrejt gruas në këtë çështje. Pra, në rastin e dëshmisë, një burrë zëvendësohet me dy gra. Ky dallim bëhet sepse burri është kryesisht më i fortë dhe më i qëndrueshëm në kujtesën dhe, rrjedhimisht, në dëshminë e tij.

- "...në mënyrë që, nëse njëra prej tyre harron, t'ia përkujtojë tjetra." – Ky ajet tregon se, nëse dikush e harron për momentin dëshminë që ka bërë, por pastaj arrin ta rikujtojë i ndihmuar nga një tjetër, dëshmia e tij është e saktë dhe e vlefshme ligjërisht, sepse Allahu i Lartësuar thotë: "...nëse njëra prej tyre harron, t'ia përkujtojë tjetra".

Sipas nënkuptimit të ajetit, nëse dëshmitari ka frikë se e harron dëshminë rreth një të drejte të detyrueshme për t'u plotësuar, atëherë ai e ka detyrë që ta shkruajë atë, sepse çdo gjë pa të cilën nuk mund të arrihet diçka e detyrueshme, është vetë e detyrueshme.

- "Dëshmitarët nuk duhet të refuzojnë kur ftohen për të dëshmuar." - Nuk i lejohet dëshmitarëve që t'i bëjnë bisht dëshmisë, pa pasur justifikim të pranueshëm nga Sheriati. Megjithatë, nëse personi nuk i plotëson kushtet si dëshmues, nuk e ka të detyrueshme që të dëshmojë, sepse edhe nëse dëshmon, ajo dëshmi do të ishte e pavlefshme ligjërisht.

- "Dhe mos përtoni ta shkruani atë *(borxhin)* dhe afatin e tij, qoftë i vogël apo i madh." - Ajeti na ndalon që të ngurrojmë të shkruajmë çfarëdolloj kontrate borxhi, i vogël apo i madh qoftë si, afatshkurtër apo afatgjatë, nëse këtë e kërkojnë palët. Ne nuk duhet të bezdisemi nga të tilla procedura, se, në fund të fundit, janë për të mirën tonë.

- "Kjo është më e drejtë tek Allahu, më e vlefshme si dëshmi dhe më larg dyshimeve." - Ajeti sqaron urtësinë e mbajtjes me shkrim të procesverbaleve për marrëveshjet tregtare dhe për huamarrjet. Ai thotë se, në këtë mënyrë mund të vendoset drejtësia mes njerëzve dhe të ruhet qetësia mes palëve.

Nuk ka dyshim se kontratat dhe dëshmitë më shkrim janë më të sigurta dhe më larg dyshimeve e keqkuptimeve, të cilat janë gjithmonë burim polemikash dhe mosmarrëveshjesh.

Ajeti tregon se, ai që dyshon dhe nuk ka siguri për dëshminë që do të japë, e ka të ndaluar të dëshmojë, derisa të sigurohet plotësisht për të.

- "Nëse është shitblerje e atypëratyshme midis jush, atëherë nuk është ndonjë gjynah të mos e shënoni. Megjithatë, kur bëni shitblerje, dëshmojeni me dëshmitarë." – Siç shihet, lejohet mosmbajtja e procesverbaleve për shitblerjet e shpejta, që bëhen atypëraty, sepse në këto raste të drejtat e ndërsjellta plotësohen totalisht dhe në moment.

Megjithatë, edhe pse procesverbali me shkrim i këtyre lloj kontratave tregtare të shpejta nuk është i detyrueshëm, përsëri është e ligjshme që aty të ketë dëshmitarë.

- "Nuk duhet të dëmtohen as shkruesi, as dëshmitarët..." - Nuk lejohet që shkruesi të dëmtohet duke u detyruar, për shembull, që të shkruajë në kohë të papërshtatshme për të, kur ai është i zënë me diçka tjetër të rëndësishme etj. Po kështu, nuk lejohet të dëmtohet as dëshmitari, sido që të jetë, për shembull, duke e thirrur të dëshmojë ndërkohë që ai është sëmurë, kur ka vështirësi të ndryshme etj.

Por folja *judar-ra* (dëmtohen) mund të merret edhe si në formë veprore, pra mund të jetë edhe: "dëmtojnë". Me këtë kuptim, ajeti ndalon shkruesin dhe dëshmitarin që të jenë dëmtues të palëve, për shembull, duke mos u shërbyer atyre ose duke u kërkuar shpërblim shumë të lartë për punën e ofruar.


- "...prandaj, nëse e bëni, do të jetë tejkalim nga ana juaj." - Kush i shkel këto dispozita është *fâsiḳ*, domethënë, njeri që i kalon kufijtë e Zotit. Një i tillë është paralajmëruar për dënim.

Nga ajeti kuptohet se cilësitë pozitive mund të gjenden ndonjëherë bashkë me ato negative tek një njeri. Për shembull, nuk është e pamundur që te dikush që ka iman të gjendet edhe ndonjë masë hipokrizie. Në këtë ajet, Allahu i Lartësuar thotë: "nëse e bëni, do të jetë tejkalim nga ana juaj". Pra, Ai nuk ka thënë që: "do të bëheni tejkalues, të prishur". Ai u është drejtuar besimtarëve dhe i ka konsideruar ata si të tillë por ka pohuar gjithashtu edhe praninë e tejkalimit përveç besimit.

Nga ajeti mësojmë, gjithashtu, se "**el adaletu"** ndershmëria dhe pastërtia e dëshmitarit është kusht për pranimin e dëshmisë së tij. Sepse Allahu i madhëruar thotë: "**mim-men terđaune minesh-shuhedâi duke rënë dakord për njerëzit e zgjedhur."**

"**el adaletu"** ndershmëria dhe pastërtia e njeriut përcaktohet nga qëndrimi dhe tradita e përgjithshme e shoqërisë në atë vend dhe në atë kohë që jeton njeriu. Atë që njerëzit e një kohe apo vendi e konsiderojnë "të ndershëm", ai është i pranueshëm si dëshmitar. Nga ana tjetër, ajeti tregon se dëshmia e një personi me ndershmëri "të panjohur" është e papranueshme, derisa të dëshmohet se ai është vërtet i ndershëm e i drejtë.

- "Kini frikë Allahun! Allahu ju dhuron dituri. Allahu është i Dijshëm për çdo gjë." - Këto ishin vetëm disa nga dispozitat e


الجزء الثالث سورة البقرة
وإن كنتم على سفر ولم تجدوا كاتبا فرهن مقبوضة ۖ
فإن أمن بعضكم بعضا فليؤد الذي اؤتمن أمانته وليتق
الله ربه ۗ ولا تكتموا الشهادة ۚ ومن يكتمها فإنه
ءاثم قلبه ۗ والله بما تعملون عليم ﴿٢٨٣﴾ لله ما في السموت
وما في الأرض ۗ وإن تبدوا ما في أنفسكم أو تخفوه
يحاسبكم به الله ۖ فيغفر لمن يشاء ويعذب من يشاء ۗ
والله على كل شيء قدير ﴿٢٨٤﴾ ءامن الرسول بما أنزل إليه
من ربه والمؤمنون ۚ كل ءامن بالله وملئكته
وكتبه ورسله لا نفرق بين أحد من رسله ۚ وقالوا
سمعنا وأطعنا ۖ غفرانك ربنا وإليك المصير ﴿٢٨٥﴾ لا يكلف
الله نفسا إلا وسعها ۚ لها ما كسبت وعليها ما اكتسبت ۗ
ربنا لا تؤاخذنا إن نسينا أو أخطأنا ۚ ربنا ولا تحمل
علينا إصرا كما حملته على الذين من قبلنا ۚ ربنا
ولا تحملنا ما لا طاقة لنا به ۖ واعف عنا واغفر لنا
وارحمنا ۚ أنت مولىنا فانصرنا على القوم الكفرين ﴿٢٨٦﴾
٤٩

përfituara prej këtij ajeti të mrekullueshëm, nga mendja dhe përpjekjet tona modeste. Në Librin e Allahut ka urtësi dhe dispozita të shumta, kuptimin e të cilave, Allahu i Lartësuar i nderon dhe ua mundëson që t'i zbulojnë atyre adhuruesve të Tij që Ai dëshiron.

Ajeti 283

283. E në qoftë se gjendeni në udhëtim dhe nuk gjeni shkrues, atëherë merrni një plaçkë peng. E nëse i besoni njëri-tjetrit, atëherë ai që ka marrë diçka me mirëbesim le ta përmbushë atë që i është besuar, dhe le ta ketë frikë Allahun, Zotin e tij. Mos e fshihni dëshminë, se ai që e fsheh atë është me zemër gjynahqare. Allahu di çdo gjë që bëni ju.

Shpjegimi i ajetit

- "E në qoftë se gjendeni në udhëtim dhe nuk gjeni shkrues..." – Pra, nëse jeni në udhëtim dhe nuk keni mundësi që t'i shkruani marrëveshjet tuaja, atëherë:

- "...atëherë merrni një plaçkë peng." - Këtë peng e merr huadhënësi, si garanci për borxhin e dhënë.

Ajeti tregon se, nëse pengu nuk i është dorëzuar huadhënësit, atëherë ai nuk është i vlefshëm si garanci.

Gjithashtu, nëse më pas palët kanë kundërshtime rreth plaçkës së lënë peng (për sasinë apo cilësinë e saj, për shembull), atëherë merret në konsideratë pohimi i penglënësit. Përse? Sepse është penglënësi ai që e lë plaçkën si garanci, në vend të dokumentit që vërteton borxhin, dokument që duhej të diktohej po prej tij. Nëse nuk do të ishte i besueshëm pohimi i huamarrësit për pengun e lënë nga ai, atëherë plaçka e lënë peng do të ishte e pavlefshme si garanci. Kjo do të ishte njëlloj sikur të thoshim që deklarata e huamarrësit e diktuar në procesverbal është e pavlefshme si dokument, pasi pengu i lënë është në vend të dokumentit të shkruar.

Duke qenë se qëllimi i pengut është garancia e borxhit, kjo praktikë lejohet jo vetëm gjatë udhëtimeve, por edhe në kushte normale. Allahu i Lartësuar e ka sjellë këtë si zgjidhje në situata jo të zakonta, sepse atëherë nevoja për një zgjidhje të tillë është e domosdoshme, pasi kur je në udhëtim nuk është e thjeshtë të gjesh shkrues për të dokumentuar një marrëveshje.

- "E nëse i besoni njëri-tjetrit, atëherë ai që ka marrë diçka me mirëbesim le ta përmbushë atë që i është besuar..." - Të gjitha këto masa ndërmerren nëse mes huadhënësit dhe huamarrësit apo mes dy palëve në marrëveshje ka njëfarë pasigurie për plotësimin e të drejtave të tyre. Por nëse palët kanë siguri të ndërsjelltë për plotësimin e të drejtave dhe detyrimeve, atëherë kjo, pra lënia në mirëbesim dhe mos marrja peng apo mos dokumentimi i aktit, është diçka e lejuar. Por, në këtë rast, pala marrëse duhet të jetë e drejtë në përmbushjen e detyrimeve të saj. Ajo nuk duhet të bëjë asnjë lloj padrejtësie.

- "...dhe le ta ketë frikë Allahun, Zotin e tij" – Pra, pala që ka marrë diçka prej tjetrit me mirëbesimin e tij, le të ketë frikë Zotin dhe t'i përgjigjet bamirësisë së tjetrit me bamirësi, duke qenë e drejtë në kthimin e hakut të tij.

- "Mos e fshihni dëshminë..." – Arsyeja është se e vërteta është e lidhur ngushtë me dëshminë. Ajo nuk mund të vihet në vend pa të. Ai që e fsheh të vërtetën ka bërë një gjynah të madh. Duke e fshehur të vërtetën, dëshmuesi ka mashtruar dhe, si rrjedhojë, ka shkelur të drejtat e të tjerëve, për të cilat do të mbajë përgjegjësi para Zotit të tij.

- "...se ai që e fsheh atë është me zemër gjynahqare. Allahu di çdo gjë që bëni ju." - Këto norma, me të cilat Allahu i Lartësuar udhëzon adhuruesit e Tij, përmbajnë urtësi dhe dobi gjithëpërfshirëse. Ato tregojnë se, nëse krijesat do të merrnin mësim nga udhëzimet e Krijuesit të tyre, jeta e tyre do të shkëlqente jo vetëm në dynja, me të gjitha problemet e saj, por edhe në ahiret, sepse ato rregullojnë fenë dhe besimin e tyre. Ato rregullojnë lidhjet e krijesave me Zotin e tyre.

E si mund të ndodhë ndryshe, nëse krijesa zbaton udhëzime të ndërtuara mbi drejtësinë, rregullimin dhe mirësinë? Vetëm nëpërmjet tyre mund të arrihet në shuarjen e grindjeve e të keqkuptimeve. Vetëm nëpërmje tyre mund të rregullohet jeta e krijesave.

Allahu qoftë i lavdëruar ashtu si i takon lartësisë dhe madhështisë së Tij, sepse ne nuk mund ta lavdërojmë Atë dhe t'i shprehim adhurimin tonë ashtu si Atij i takon.

Ajeti 284

284. Vetëm të Allahut janë ç'ka në qiej dhe ç'ka në tokë. E shfaqni apo e mbani të fshehtë atë që e keni në shpirtin tuaj, Allahu përsëri do t'ju marrë në përgjegjësi. Ai fal atë që do dhe e dënon atë që do. Allahu është i fuqishëm për gjithçka.

Shpjegimi i ajetit

- "Vetëm të Allahut janë ç'ka në qiej dhe ç'ka në tokë." - Allahu i Lartësuar na tregon në këtë ajet se gjithçka që ekziston në qiell dhe gjithçka që ekziston në tokë është e krijuar nga Ai, i Cili i furnizon dhe i administron çështjet e tyre. Allahu përkujdeset që ata të vënë në vijë çdo problem të tyre. Është Ai që i udhëzon krijesat se si t'i rregullojnë çështjet e tyre të jetës dhe ato të besimit fetar.

Gjithçka është pronë e Allahut, të gjithë janë robër e krijesa të Tij, që nuk kanë asgjë në dorë për veten e tyre. Askush nuk mund t'i sigurojë vetes së vet dëm apo dobi. Ata nuk mund të japin as jetë, as vdekje e as ringjallje. Ata janë nënshtruar të gjithë ndaj dikujt tjetër, ndërkohë që Zotëruesi i tyre është Allahu. Është Ai që vepron me sundimin e Tij dhe administron çështjet e tyre. Çdo gjë në gjithësi ndodh në përputhje me urtësinë, drejtësinë dhe bamirësinë e Allahut.

- "E shfaqni apo e mbani të fshehtë atë që e keni në shpirtin tuaj, Allahu përsëri do t'ju marrë në përgjegjësi." - Allahu u ka dhënë krijesave të Tij disa urdhra e disa ndalesa, dhe pastaj do t'i marrë në pyetje për veprimet dhe sjelljet e tyre, për gjithçka që ata e shfaqin apo që e mbajnë të fshehur.

- "Ai fal atë që do dhe e dënon atë që do." - Allahu fal atë rob që përpiqet dhe punon atë gjë që sjell faljen dhe mëshirën e Tij. Nga ana tjetër, Allahu ndëshkon atë rob që bën gjynahe, për të cilat ai nuk është i detyruar t'i bëjë, por i bën thjesht me vetëdije dhe vullnet të lirë.

- "Allahu është i fuqishëm për gjithçka." - Allahut nuk mund t'i shpëtojë asgjë. Çdo krijesë është e nënshtruar ndaj pushtetit, dëshirës, dijes, përcaktimit dhe shpërblimit të drejtë të Allahut. Asgjë nuk mund të dalë jashtë këtyre kornizave.

Ajeti 285

285. I Dërguari e besoi atë që iu shpall prej Zotit të tij, po ashtu edhe besimtarët. Secili i besoi Allahut, engjëjve të Tij, shpalljeve të Tij dhe të dërguarve të Tij *(duke thënë):* "Ne nuk bëjmë dallim mes asnjërit prej të dërguarve të Tij." Ata thonë: "Dëgjuam dhe u bindëm! Kërkojmë faljen Tënde, o Zoti ynë! Vetëm tek Ti është e ardhmja jonë!".

Shpjegimi i ajetit

âmener-resûlu bi mâ unzile ilejhi mir-rab-bihî uel mu'minûn

- "I Dërguari e besoi atë që iu shpall prej Zotit të tij, po ashtu edhe besimtarët." - Në këtë ajet, Allahu i Lartësuar na pasqyron besimin e profetëve dhe të pasuesve të tyre të denjë. Besimi i tyre ishte i shfaqur me nënshtrim, bindje, pendim të sinqertë e kërkim faljeje për mangësitë e tyre.

kul-lun âmene bil-lâhi

- "Secili i besoi Allahut..." - Ky besim është pranimi dhe pohimi i gjithçkaje që Allahu i Lartësuar na ka treguar rreth Vetes së Tij Ne duhet të besojmë, gjithashtu, gjithçka që kanë treguar profetët rreth Zotit të tyre.

Profetët kanë folur qartë rreth emrave dhe cilësive të plota e absolute të Allahut. Ne duhet t'i besojmë ato, duke i marrë në mënyrë të përgjithshme dhe në mënyrë të hollësishme. Besimi në Allahun kërkon që ne ta konsiderojmë Atë të pastër nga çdo përngjasim dhe shembëllim me krijesat, por duhet, gjithashtu, që të mos mohojmë asnjë cilësi të Tij të pohuar nga vetë Ai ose nga

Profeti i Tij. Ne duhet ta konsiderojmë Atë të pastër nga çdo cilësi e mangët dhe e papranueshme për Të.

ue melãiketihî ue kutubihî ue rusulihî.

- "...engjëjve të Tij, shpalljeve të Tij dhe të dërguarve të Tij..." – Ne duhet të besojmë dhe të pohojmë për engjëjt gjithçka që është transmentuar saktësisht prej Sheriatit rreth tyre. Ne duhet të besojmë, po ashtu, gjithçka që na kanë sjellë profetët dhe gjithçka që përmbajnë librat e Zotit. Profetët kanë sjellë mesazhe, urdhra, ndalesa, dispozita e ligje; të gjitha këto duhen besuar dhe trajtuar ashtu si duhet.

lâ nufer-riḳu bejne eĥadim-mir-rusulih

- "Ne nuk bëjmë dallim mes asnjërit prej të dërguarve të Tij." - Besimtarët e drejtë nuk bëjnë dallime mes profetëve, por i besojnë të gjithë, sepse ata kanë qenë zëdhënësit e Zotit te krijesat. Sikur të mohosh vetëm njërin prej profetëve konsiderohet si mohim i të gjithë atyre, madje konsiderohet mohim i Zotit.

Ue ḳâlû semi'nâ ue eṭa'nâ

- "Ata thonë: "Dëgjuam dhe u bindëm!"" - Besimatrët e drejtë thonë "Dëgjuam". Pra, ata i dëgjojnë me vëmendje dhe përkushtim urdhrat dhe ndalesat e Zotit. Ata janë të vëmendshëm ndaj kufijve të Tij.

Pastaj thonë: "...u bindëm". Për çdo urdhër dhe ndalesë që dëgjojnë, ata nuk e neglizhojnë, por binden dhe i zbatojnë. Ata thonë: "I dëgjuam ato që Ti na urdhërove dhe na ndalove dhe u bindëm, duke i zbatuar ato". Ndryshe nga të dëshpëruarit, të cilët thonë: "Dëgjuam, por nuk bindemi!"

ĝufrâneke rab-benâ ue ilejkel maŝîr

- "Kërkojmë faljen Tënde, o Zoti ynë! Vetëm tek Ti është e ardhmja jonë!"" - Duke qenë se njeriu shfaq mangësi në përmbushjen e dispozitave të vendosura nga Zoti, ai gjithmonë do ketë nevojë për faljen dhe mëshirën e Tij.

Kështu, ne duhet të themi vazhdimisht: "Kërkojmë faljen tënde, o Zoti ynë! Kërkojmë faljen Tënde për çdo mangësi tonën në plotësimin e adhurimeve! Kërkojmë faljen Tënde edhe për shkeljen e kufijve dhe gjynahet që bëjmë! Ne kërkojmë që të na i mbulosh dhe të na i fshehësh të gjitha ato gjynahe dhe padrejtësi që kemi bërë!"

Pastaj vjen një fjalë nxitëse dhe qortuese njëkohësisht: "Vetëm tek Ti është e ardhmja jonë!" Të gjitha krijesat do të grumbullohen një ditë te Zoti i tyre, ku do të shpërblehen për të mirat ose të këqijat që kanë bërë.

Ajeti 286

286. Allahu nuk ngarkon asnjë përtej mundësive të tij: ai *(robi)* do të marrë atë çfarë ka fituar dhe do të ketë kundra atë çfarë ka merituar. "Zoti ynë, mos na dëno nëse harrojmë ose gabojmë! Zoti ynë, mos na ngarko me barrë të rëndë, siç ngarkove ata që ishin para nesh! Zoti ynë, mos na ngarko më tepër sesa kemi fuqi! Na i shlyej gjynahet, na i mbulo të këqijat e na mëshiro! Ti je Mbrojtësi ynë! Na ndihmo kundër popullit jobesimtar!

Shpjegimi i ajetit

Kur u shpall ajeti 284 i kësaj sureje, dhe pikërisht thënia e Allahut të Lartësuar: "Vetëm të Allahut janë ç'ka në qiej dhe ç'ka në tokë. E shfaqni apo e mbani të fshehtë atë që e keni në shpirtin tuaj, Allahu përsëri do t'ju marrë në përgjegjësi. Ai fal atë që do dhe e dënon atë që do. Allahu është i fuqishëm për gjithçka", kjo vërtet i rëndoi dhe i frikësoi shumë muslimanët, sepse menduan se do të merreshin në përgjegjësi për çdo gjë që kalon nëpër zemër, qoftë një mendim a qëndrim i konsoliduar, qoftë thjesht një mendim i çastit. Por Allahu i Lartësuar i sqaroi ata, duke u thënë:

lâ jukel-lifull-llâhu nefsen il-lâ us'ahâ -

- "Allahu nuk ngarkon asnjë përtej mundësive të tij" – Pra, Allahu i Lartësuar nuk ngarkon asnjë përtej mundësive të tij. Madje, Ai nuk ngarkon as me diçka që mund të jetë disi e vështirë për t'u përballuar, siç thuhet në suren Haxh: "Ai nuk ju ka ngarkuar me ndonjë vështirësi në fe...".

Të gjithë urdhrat dhe ndalesat hyjnore, në thelb, nuk janë të vështira të përmbushen. Përkundrazi, ato meritojnë me plot të drejtë të quhen ushqim për shpirtin dhe ilaç për trupin. Ato parandalojnë të këqijat që mund të prekin njeriun. Çdo urdhër i Allahut të Lartësuar është mëshirë dhe bamirësi për krijesat. Edhe në ato raste kur, për ndonjë shkak të caktuar, zbatimi i urdhrave bëhet i vështirë ose i pamundur, Ai ka vënë dispozita lehtësuese, për t'ua thjeshtuar krijesave zbatimin e ligjeve të Tij.

lehâ mâ kesebet ue alejhâ mektesebet.

- "...ai *(robi)* do të marrë atë çfarë ka fituar dhe do të ketë kundra atë çfarë ka merituar." - I Lartësuari na tregon se çdokush do të shpërblehet plotësisht për veprat e mira që ka bërë. Gjithashtu, mbi secilin do të rëndojë çdo vepër e keqe që ka bërë. Askush nuk do të marrë mbi supe peshën e gjynaheve të tjetërkujt, dhe askush nuk do të marrë shpërblimin e veprave të mira të dikujt tjetër.

Për të treguar përpjekjet për të bërë vepra të mira, të cilat do të shpërblehen nga Ai, Allahu i Lartësuar ka thënë: "*lehâ mâ kesebet*", që nënkupton (në arabisht) se veprat e mira dhe shpërblimi për to fitohen edhe pa shumë lodhje, sepse mundësitë e robit për të kryer vepra të mira janë shumë të mëdha dhe shumë të thjeshtëzuara. Madje edhe thjesht duke pasur si qëllim kryerjen e një vepre të mirë, ai e merr shpërblimin sikur e ka bërë atë vepër të mirë, edhe nëse nuk arrin ta finalizojë atë.

Ndërsa kur flet për veprat e këqija, për mënyrën e kryerjes së tyre dhe për shpagimin që meritojnë, Allahu thotë: "*ue alejhâ ma iktesebet*", duke përdorur fjalën "*iktesebe*" = meritoi plotësisht. Pra, kuptimi është: njeriut nuk i shkruhet puna e keqe, derisa ai ta kryejë atë, ndryshe nga vepra e mirë, e cila shkruhet dhe shpërblehet edhe nëse ai e ka vetëm si qëllim.

Në këtë ajet, Allahu i Lartësuar foli rreth besimit të Profetit dhe besimtarëve të mirë. Ai tregoi, gjithashtu, se çdokush do të shpërblehet sipas punës që ka kryer. Më pas, është normale që adhuruesi të shfaqë mangësi, duke gabuar dhe harruar, por Allahu nuk e ngarkon atë tej fuqive dhe mundësive të Tij, prandaj udhëzon që ne të lutemi me disa fjalë të mrekullueshme. Profeti (a.s.) na ka treguar se kur besimtarët i drejtohen Allahut të Lartësuar me këto fjalë të veçanta, Ai thotë: "E pranoj lutjen tuaj!"

Rab-benâ lâ tu'âhidhnâ in-nesînâ eu eẖta'nâ

- "Zoti ynë, mos na dëno nëse harrojmë ose gabojmë!" – Kuptimi: Mos na merr në përgjegjësi, nëse harrojmë ose gabojmë.

Por cili është ndryshimi mes harresës dhe gabimit? Harresa ndodh kur lihet pa zbatuar një urdhër, për shkak të pakujdesisë së zemrës. Kështu, besimtarët i kërkojnë falje Allahut për ato dispozita të cilat i kanë lënë pa zbatuar, për shkak të harresës.

Ndërsa gabimi ndodh kur synohet diçka e lejueshme për t'u vepruar, por që më pas finalizohet duke kryer diçka tjetër të palejueshme, pa qëllim. Me fjalë të tjera, të synosh kryerjen e diçkaje të lejueshme, por gabimisht të veprosh të palejueshmen. Pra, besimtari kërkon falje edhe për veprat e kryera gabimisht. Megjithatë, Allahu i Lartësuar ia ka falur këtij umeti të dyja këto lloj mangësish, në shenjë butësie dhe mëshire ndaj tyre.

Duke u mbështetur në këtë ajet, janë nxjerrë shumë dispozita lehtësuese, prej të cilave mund të përmendim:

- Nëse falesh duke qenë i veshur me rroba të vjedhura ose të papastra, e ke namazin të saktë, nëse e harron një fakt të tillë gjatë kohës që kryen namazin.

- Nëse harron se në rroba apo në trup ke papastërti, dhe falesh me to, namazi është i saktë, domethënë, nuk ka nevojë të përsëritet.

- Nëse gjatë namazit harron se je duke u falur dhe fillon të flasësh fjalë që s'i përkasin faljes, namazi nuk prishet, sepse çdo gjë ka ndodhur nga harresa.

- Nëse kryen ndonjë vepër që prish ihramin e haxhit dhe umres, duke e harruar se je në *ihram*, je i falur nga Allahu. Megjithatë, këtu duhet pasur parasysh që, nëse me këtë vepër sjell dëme, ato duhet të zhdëmtohen dhe kompensohen sipas ligjit.

- Nëse betohesh se nuk do të bësh diçka dhe e thyen këtë betim nga harresa, nuk ke gjynah dhe nuk e ke të detyrueshëm kompensimin e betimit të thyer, sepse ky betim nuk konsiderohet i thyer.

- Nëse dikush vret dikë gabimisht, pa dashje, pa qëllim, ose shkatërron pasurinë e dikujt gabimisht, pa dashje, ai nuk ka gjynah tek Allahu i Lartësuar. Ndërsa dëmet e shkaktuara duhet patjetër të kompensohen, sepse e drejta e tjetrit duhet vënë në vend.

- Në të gjitha ato raste kur është e detyrueshme thënia e "*Bismilah*-it" dhe harrohet të thuhet, kjo harresë është e falur dhe e padëmshme.

Rab-benâ ue lâ taĥmil alejnã iŝran kemâ ĥameltehû alel-ledhîne min ḳablinâ.

- "Zoti ynë, mos na ngarko me barrë të rëndë, siç ngarkove ata që ishin para nesh!" – Kuptimi: Mos na ngarko me atë *iŝran*. *Isran* quhen dispozitat e vështira për t'u zbatuar dhe për t'u përballuar.

Allahu i Lartësuar ia ka plotësuar këtë lutje umetit tonë, duke u dhënë lehtësime në të gjitha fushat e Sheriatit dhe jetës njerëzore, dhe kjo ka ndodhur vetëm për këtë umet.

Rab-benâ ue lâ tuĥam-milnâ mâ lâ ṭâḳate lenâ bih-

- "Zoti ynë, mos na ngarko më tepër sesa kemi fuqi!" - Edhe këtë lutje e ka plotësuar i Mëshirshmi dhe i Dashuri. Atij i qoftë lavdia dhe mirënjohja e plotë!

uea'fu an-nâ ueġfir lenâ uerĥamnâ -

- "Na i shlyej gjynahet, na i mbulo të këqijat e na mëshiro!" - Falja dhe mbulimi i gjynaheve janë garanci për shpëtimin nga çdo gjë e keqe që njeriu i druhet në këtë jetë dhe në jetën tjetër. Ndërsa mëshira është ajo, nëpërmjet së cilës rregullohen të gjitha çështjet dhe arrihet çdo gjë e dëshiruar dhe e mirë, në këtë jetë dhe në jetën tjetër.

ente meulânâ fenŝurna alel ḳaumil kâfirîn.

- "Ti je Mbrojtësi ynë! Na ndihmo kundër popullit jobesimtar!" - "*Meulânâ*", domethënë: Zoti ynë, Sunduesi, i Pushtetshmi, i Adhuruari, Kujdestari ynë. *Meulânâ* është Ai që vazhdon të përkujdeset për krijesat e Tij dhe, në mënyrë të veçantë, për të zgjedhurit dhe të dashurit e Tij, që nga momenti që i krijon.

O Zoti ynë, mirësitë e Tua janë të pashtershme e të pandërprera në asnjë çast, që kur na krijove dhe na furnizove me të mira. Mirësitë e Tua vetëm shtohen. Mirësia më e madhe është pikërisht Islami. Kjo është mirësia më e madhe që kemi, sepse të gjitha mirësitë e tjera janë degëzime dhe rrjedhime të saj. Ne po të lutemi, o Zoti ynë, që ta plotësosh dhe ta vazhdosh këtë mirësi të madhe, duke na ruajtur prej mohuesve e mosmirënjohësve ndaj Teje. Ata të mohojnë Ty dhe të dërguarit e Tu. Ata dalin kundër besimtarëve të Tu të sinqertë, të cilët përhapin mirësinë dhe fenë Tënde. Ata e shpërfillin adhurimin dhe ligjin Tënd. Na ndihmo, o Zot, kundër tyre, me ndihmën dhe suksesin Tënd! Na ndihmo kundër tyre, duke na dhuruar argumentim bindës dhe të qartë! Na ndihmo kundër tyre edhe me fuqi, edhe me shpatë, nëse e kërkojnë vetë një gjë të tillë! Na ndihmo të përhapim në tokë mirësinë, që të sundojë paqja dhe adhurimi Yt! Na ndihmo kundër tyre, duke na udhëzuar në besimin e drejtë dhe veprat sipas tij!

Vërtet, ndihma e Allahut është afër atyre që besojnë dhe kryejnë vepra të mira!

Surja 3 - Al Imran (Sure medinase)
200 ajete

Gati 80 ajetet e para të kësaj sureje trajtojnë mënyrën e polemikës me të krishterët, duke hedhur poshtë pretendimet dhe tezat e tyre të pabaza për fenë e Zotit. Ata ftohen, gjithashtu, për të pasuar fenë Islame. Në fillim të kësaj sureje flitet rreth të krishterëve, ashtu si fillim të sures Bekare flitej rreth çifutëve.


Ajetet 1 – 6

1. Elif, Lam, Mim
2. Allahu është Një! Nuk ka Zot tjetër përveç Tij. Ai është *Hajjun* dhe *Kajûjm*.
3. Ai ta zbriti ty *(Muhamed)* Librin me të vërtetën e sigurt, si vërtetues të librave të mëparshëm. Ai e zbriti më parë Teuratin dhe Ungjillin,
4. si udhëzim për njerëzit. Ai ka zbritur Dalluesin. S'ka dyshim se ata që mohojnë argumentet e Allahut, i pret ndëshkimi i rreptë. Allahu është Ngadhënjyes e Shpagimtar.
5. S'ka dyshim se Allahut nuk mund t'i fshihet asgjë në tokë dhe as në qiell.
6. Është Ai që ju krijon ju në mitër, ashtu si dëshiron. Nuk ka të adhuruar përveç Tij. Ai është Ngadhënjyes dhe i Urtë.

Shpjegimi i ajeteve

- "Allahu është Një! Nuk ka zot tjetër përveç Tij. Ai është *Hajjun* dhe *Kajjûm*." - Allahu i Lartësuar e fillon këtë sure duke përmendur njëshmërinë e Tij në meritën për adhurim, ose me teuhidin *uluhije*.

Allahu është Zoti. Nuk ka të adhuruar tjetër përveç Tij. Adhurimi dhe nënshtrimi nuk lejohet të bëhen për asnjë tjetër veç Tij. Çdo i adhuruar tjetër, veç Tij, është i kotë, i padobishëm, i pavlefshëm. I Adhuruari i



vërtetë është Allahu, sepse Ai i ka cilësitë që duhet të ketë një i adhuruar.

Dy cilësitë kryesore të Tij si Zot janë ato që tregojnë dy emrat e përmendur në këtë ajet: *Hajjun* dhe *Kajjûm*.

El Hajjun quhet ai që gëzon jetën e plotë nga çdo aspekt, pa asnjë mangësi. Nëse Allahu ka këtë emër dhe cilësi, atëherë patjetër që duhet të ketë edhe cilësi të tjera absolute të Qenies së Tij, sikurse janë: të dëgjuarit, të shikuarit, dituria, pushteti, fuqia etj., sepse ndryshe Ai nuk do ta meritonte të quhej *El Hajjun*, me kuptimin e plotë të kësaj fjale.

Emri i Allahut *El Kajjum* tregon se Ai nuk ka nevojë për asgjë dhe për asnjë përkujdesje, ndërkohë që gjithçka tjetër ka nevojë për përkujdesjen e Tij. Ai ekziston pa pasur nevojën dhe ndihmën e asgjëje. Ai është i pavarur nga gjithçka, ndërsa të gjitha krijesat janë të varura prej Tij, sepse Ai i krijon, i furnizon dhe u mundëson vazhdimësinë e ekzistencës. Ai i udhëzon robërit e Vet drejt çdo të mire që rregullon jo

vetëm trupin, por edhe zemrën dhe shpirtin e tyre. Shenjë e përkujdesjes së Tij për krijesat, madje treguesi më i madh i mëshirës së Tij ndaj tyre, është shpallja e Kur'ânit dhe dërgimi i Profetit (s.a.u.s.).

- "Ai ta zbriti ty *(Muhamed)* Librin me të vërtetën e sigurt" - Ky është libri më i madh dhe më i rëndësishëm që është shpallur. Ai përmban dhe qartëson të vërtetën e sigurt.

Të vërteta janë të gjitha kumtet që ky libër sjell për njerëzit. Të drejta janë ligjet dhe dispozitat e ligjëruara nëpërmjet tij. Kumtet, urdhrat, ndalesat dhe kufijtë e sqaruar në të janë të vërtetë, të garantuar prej Zotit të botëve.

Këtë të vërtetë të sigurt Allahu i Lartësuar e ka shpallur me një qëllim madhështor: që krijesat të adhurojnë Zotin e gjithësisë dhe të studiojnë e jetojnë sipas udhëzimeve të sjella në librin e Tij të qartë.

- "...si vërtetues të librave të mëparshëm." - Kur'âni është vërtetues i librave hyjnorë të mëparshëm, pra, që u shpallën para tij. Ai shërben si i vetmi matës për të dalluar vërtetësinë e lëndës që ndodhet në librat hyjnorë të mëparshëm. Të vërteta në librat e mëparshëm janë vetëm ato që Kur'âni i dëshmon dhe i konsideron si të tilla. Çdo gjë që ky libër e refuzon, konsiderohet e papranueshme. Ai është në përputhje të plotë me linjën e drejtë e të pandryshueshme të të gjithë profetëve. Të gjithë librat hyjnorë kanë dëshmuar për vërtetësinë dhe sinqeritetin e këtij Profeti, sepse bazat e rrugës së tyre janë të njëjta. Ithtarët e Librit, nga ana tjetër, nuk kanë asnjë mundësi për të vërtetuar saktësinë e librave të tyre, përveçse nëpërmjet profetit Muhamed (a.s.). Vetëm nëse besojnë këtë profet dhe shpalljen që i është dhuruar atij nga Zoti i gjithësisë, ata mund të vërtetojnë saktësinë e librave të tyre dhe mund të konsiderohen se, vërtet i besojnë ato. Nëse e mohojnë Profetin dhe Shpalljen që atij i është dhënë, ata kanë dëshmuar, me ose pa dashje, mohimin e librave të tyre.

- "Ai e zbriti më parë Teuratin dhe Ungjillin, si udhëzim për njerëzit" - Para shpalljes së Kur'ânit, Allahu i Lartësuar i shpalli Teuratin Musait dhe Ungjillin Isait (a.s.). Këto shpallje Ai i solli si udhëzim për njerëzit dhe u sqaroi atyre udhëzimin nga devijimi. Kush e pranon udhëzimin e Allahut, do të gjejë rrugën e drejtë, dhe kush e shpërfill atë, do të mbesë në errësirat e humbjes.

- "Ai ka zbritur Dalluesin." - Allahu i bëri librat e Tij si dallues të së vërtetës, duke sjellë në to fakte të sigurta, që tregojnë qëllimin e Tij me njerëzimin. Nëpërmjet shpalljeve të Tij, Allahu ka qartësuar për njerëzit gjithçka për të cilën ata kanë nevojë. Tashmë njerëzit janë të qartë për të gjitha dispozitat dhe ligjet që Zoti ka përcaktuar për ta. Edhe ligjet e Zotit janë tanimë shumë të qarta dhe shumë të thjeshta për t'u kuptuar, saqë askush nuk mund të ketë më justifikim përpara Tij, askush nuk mund të justifikojë mosbesimin dhe mosbindjen ndaj Zotit të gjithësisë. Për këtë arsye, i Lartësuari thotë më tej:

- "S'ka dyshim se ata që mohojnë argumentet e Allahut, i pret ndëshkimi i rreptë." - Ata që i mohojnë shpalljet e Zotit, pasi u janë sqaruar plotësisht, ata i pret një dënim shumë i rëndë, të cilin nuk mund ta përfytyrojë apo ta përshkruajë askush, veç Atij që e ka krijuar.

- "Allahu është Ngadhënjyes e Shpagimtar." - Allahu është Ngadhënjyes. Askush nuk mund t'i shpëtojë llogarisë dhe gjykimit të Tij të drejtë. Ai është gjithashtu Shpagues i atyre që tregohen të pabindur e mospërfillës ndaj udhëzimit të Tij.

- "S'ka dyshim se Allahut nuk mund t'i fshihet asgjë në tokë dhe as në qiell." - Kjo

tregon se Allahu i Lartësuar ka përfshirë me dijen e Tij absolute gjithçka që ekziston dhe që mund të dihet. Ai njeh atë që duket dhe atë që nuk duket, të shfaqurën dhe të fshehtën. Zoti di edhe për embrionin në barkun e nënës. Ai shikon atë që shikimi i krijesave nuk mund ta arrijë. Ai di atë që krijesat kurrë nuk mund ta dinë. Ai përkujdeset për ta në mënyrën më të mirë. Ai i krijon dhe përcakton për ta çdo gjë që e kanë të nevojshme.

- "Është Ai që ju krijon ju në mitër, ashtu si dëshiron." – Ai, me urtësinë e Tij, përcakton që këto krijesa të ekzistojnë ashtu sikurse e do Ai. Për dikë përcakton që të dalë i plotë, për dikë tjetër cakton që të jetë i mangët, dikë e bën të bukur, e dikë tjetër të shëmtuar, dikë e përcakton të jetë mashkull, e dikë tjetër femër.

- "Nuk ka të adhuruar përveç Tij. Ai është Ngadhënjyes dhe i Urtë." - Këtu pohohet përsëri se adhurimin e meriton vetëm Allahu.

Në këto ajete, nga njëra anë, kundërshtohen të krishterët, të cilët pretendojnë se Isai (Jezusi) është Zot dhe se ai e meriton të adhurohet, e nga ana tjetër, tregohet se Allahu i Lartësuar është i plotë dhe absolut si *Hajjun* dhe *Kajjum*, sikurse e përmendëm, që do të thotë se Allahu i Lartësuar është i plotë e absolut në të gjitha cilësitë e Tij.

Ajetet tregojnë se Allahu i Lartësuar ka bërë gjithmonë ligje dhe dispozita, të cilat udhëzojnë njerëzimin drejt lumturisë në të dyja jetët. Megjithatë, njerëzit gjithmonë janë ndarë në dy grupe: të udhëzuar dhe të humbur, e këtu deklarohet ndëshkimi i atyre që nuk e pranojnë dhe e shpërfillin udhëzimin.

Ajetet tregojnë, gjithashtu, dijen gjithëpërfshirëse të Krijuesit, si edhe faktin që dëshira dhe urtësia e Tij janë vendimtare dhe të pakthyeshme.

Ajeti 7

7. Është Ai *(Allahu)* që ta zbriti ty Librin. Në të ka ajete të qarta (*muhkematun*), të cilat janë bazë e Librit. Në të ka ajete të tjera, që janë jo shumë të qarta (*muteshabihat*). Por ata që në zemrat e tyre kanë anim nga e shtrembëra, gjurmojnë ato që janë jo shumë të qarta, për të shkaktuar hutim, gjoja sikur kërkojnë komentin e tyre. Por, përveç Allahut, askush nuk e di domethënien e tyre të saktë. Dijetarët e pajisur me dituri të thellë thonë: "Ne i besojmë atij *(Kur'ânit)*. Të gjitha *(ajetet)* janë nga Zoti ynë!" Por këtë e kuptojnë vetëm ata që janë të mençur.

Shpjegimi i ajetit

Ajetet e Kur'ânit janë cilësuar si *muĥkemâtun* dhe *muteshâbihât*. *Muĥkemâtun* vjen nga rrënja "*ĥakeme jaĥkumu*" ose "*aĥkeme juĥkimu*", që ka disa kuptime, si për shembull: "i përkryer në gjykimet që jep", ose: "absolutisht i qartë dhe i kuptueshëm".

Nëse merret kuptimi i parë, mund të themi se të gjitha ajetet e Kur'ânit janë të përkryera, për sa i përket gjykimit që ato japin. Me këtë kuptim, në fakt, kjo fjalë është përdorur në ajetin e parë të sures Hudë, ku Allahu i Lartësuar thotë: "Ky është Libër me ajete të përkryera (*uĥkimet*)..."

Kështu, ky libër është i përsosur në çdo aspekt. Ai është i saktë, i plotë, i drejtë dhe i mrekullueshëm në udhëzimet e Tij. Ai është i vetmi burim i gjykimit të drejtë për çdo çështje qoftë. Në suren Maide, ajeti 50, Allahu i Lartësuar thotë: "E kush është më i mirë se Allahu në gjykimet (*ĥukmen*) e Tij...". Edhe fjala "*muteshâbih*" ka kuptime:

1. I ngjashëm, i përafërt, i njëjtë.

2. I paqartë, i pakuptueshëm, që ka nevojë të sqarohet, të qartësohet, që ka më shumë se një kuptim.

Nëse e marrim me kuptimin e parë, pra: i ngjashëm, i përafërt ose i njëjtë, atëherë, si shpjegim të ajetit të mësipërm, mund të themi se të gjitha ajetet e Kur'ânit janë të ngjashme, të njëjta e të përafërta me njëra-

tjetrën, për sa i përket bukurisë, madhështisë dhe lartësisë së fjalëve të tyre. Të gjitha ajetet janë të përafërta e vërtetuese të njëra-tjetrës.

Megjithatë, në ajetin që po trajtojmë, fjala "*muĥkem*" ka kuptimin: "i qartë, absolutisht i kuptueshëm, që nuk ka nevojë të sqarohet më shumë". Ndërsa fjala "*muteshâbih*" ka kuptimin: "i paqartë, që ka më shumë se një kuptim, që ka nevojë të sqarohet dhe të qartësohet". Thotë i Lartësuari:

- "Është Ai *(Allahu)* që ta zbriti ty Librin. Në të ka ajete të qarta (*muhkemat*), të cilat janë bazë e Librit. Në të ka ajete të tjera, që janë jo shumë të qarta (*muteshabihat*)." - Në librin e shpallur nga Allahu i Lartësuar ka ajete *muĥkemât*, pra, të qarta e të prera në kumtin e tyre e shumë të lehta për t'u kuptuar. Pikërisht këto ajete, Allahu i Lartësuar i ka quajtur si "nëna e Librit", pra, themeli mbi të cilin ndërtohen të gjitha gjykimet. Ato përbëjnë shumicën e ajeteve kur'ânore dhe nën dritën e tyre shpjegohen e kuptohen edhe ajetet e tjera, që kanë nevojë të sqarohen.

Pra, në Kur'ân ka edhe ajete të tjera, të cilat Allahu i Lartësuar i quan *muteshâbihât*, të paqarta, të cilat keqkuptohen nga mendje të ndryshme, sepse ato përmbajnë shumë kuptime dhe, rrjedhimisht, edhe argumentimi me to është i paqëndrueshëm, i paqartë ose jo i sqaruar plotësisht. Madje, disa mund të marrin nga të tilla ajete kuptime të nxituara, të gabuara, nëse nuk i shohin nën dritën e ajeteve të tjera, që janë *muĥkemât*.

Kështu, Allahu i Lartësuar na tregon se në Kur'ân ka ajete të qarta e të kuptueshme lehtë nga çdokush, të cilat janë pjesa dërrmuese e librit. Ato duhet të shërbejnë si bazë për të ndërtuar gjykimet tona. Nën dritën e tyre duhet parë çdo ajet tjetër i këtij libri, që mund të jetë i paqartë e që ka nevojë të kthjellohet dhe të drejtkuptohet.

Por ka edhe ajete që janë *muteshâbih*, të paqarta për disa njerëz. Ato janë të pakuptueshme, që kanë nevojë të sqarohen dhe të kuptohen nën dritën e ajeteve të tjera, që janë *muĥkemât* ose të qarta. Kësisoj, është detyrë për çdo lexues të Kur'ânit që, ajetet e paqarta t'i kuptojë duke u mbështetur në ajetet e qarta. Në këtë mënyrë, çdokush do të kuptojë se Kur'âni, në tërësinë e tij, vërteton dhe sqaron vetveten. Nuk mund të gjesh kundërthënie në Librin e Zotit. Megjithatë, njerëzit janë ndarë në dy grupe:

- "Por ata që në zemrat e tyre kanë anim nga e shtrembra, gjurmojnë ato që janë jo shumë të qarta, për të shkaktuar hutim, gjoja sikur kërkojnë komentin e tyre." - Grupi i parë janë ata që kanë në zemër prirje për devijim nga rruga e drejtë. Qëllimet e tyre janë të këqija dhe motivet e tyre janë të sëmura. Ata synojnë devijimin e njerëzve nga e vërteta. Zemrat e tyre janë larguar shumë nga drita e udhëzimit, saqë kurrë nuk mund ta gjejnë rrugën e drejtë. Këta gjurmojnë ajetet e paqarta dhe nuk i shohin ato nën dritën e ajeteve të qarta. Ata i lënë mënjanë ajetet e qarta dhe përqendrohen tek të paqartat, madje i konsiderojnë këto ajete si baza mbi të cilat ndërtojnë gjykimet e tyre. Ata i kuptojnë ajetet e qarta veçse në errësirën e ajeteve të paqarta, ndërkohë që duhet të vepronin të kundërtën. Qëllimi i tyre është përhapja e fitnes. Ata kërkojnë të sprovojnë mendjen, zemrën dhe besimin e pastër të besimtarëve, duke i turbulluar me këto ajete të paqarta, që duhen kuptuar nën dritën e ajeteve të qarta. Ata mund t'i turbullojnë besimtarët veçse nëpërmjet ajeteve që janë të pakapshme për shumë njerëz, sepse ajetet *muĥkeme* janë të qarta dhe lehtësisht të kuptueshme për çdo njeri që kërkon udhëzimin e drejtë.

- "Por, përveç Allahut, askush nuk e di domethënien e tyre të saktë. Dijetarët e pajisur me dituri të thellë thonë: "Ne i besojmë atij *(Kuranit)*. – Në fakt, ky ajet mund të lexohet në dy mënyra, dhe që të dyja janë të lejueshme dhe të mundshme për t'u pranuar.

Mënyra e parë:

"*Ue ma jealemu te' uîlehũ il-lell-llâhu / Uerrâsiĥûne fil ilmi jeḳûlûne âmen-nâ bihî*" (Por, përveç Allahut, askush nuk e di domethënien e tyre të saktë. / Dijetarët e pajisur me dituri të thellë thonë: "Ne i besojmë atij.").

Kjo është mënyra e leximit që bëhet nga shumica e dijetarëve të Kur'ânit. Kështu, mund të themi se, nëse në këtë ajet, shprehja "*te'uîlehû*" (shpjegimin e tyre) flet për njohjen e çështjeve të fshehta, të pashpjeguara dhe të pashpalosura në këtë botë ashtu sikurse janë në të vërtetë, atëherë patjetër që kjo është një dije që nuk e ka askush tjetër, veç Zotit, sepse vetëm Ai i di gjërat konkretisht, qartësisht ashtu sikurse janë në të vërtetë.

E kush mund t'i dijë konkretisht se si janë cilësitë e Zotit, apo se si do të jetë në realitet Dita e Gjykimit?! Madje, ne e kemi të ndaluar që të "rrëmojmë" në të tilla lloj dijesh, të pamundura për t'u arritur në thelbin e tyre, ashtu sikurse i di Zoti i botëve.

Pra, nëse shprehja: "*te'uîlehû*" ka kuptimin e lartpërmendur, atëherë është e detyrueshme që, gjatë leximit të ajetit, të bëjmë një pauzë të detyrueshme te fjala: "*Allah*", siç e treguam më lart.

Mënyra e dytë e leximit është:

"*Ue mâ jealemu te' uîlehû il-lell-llâhu uerrâsiĥûne fil ilmi*" (Dhe shpjegimin e tyre e di veçse Allahu dhe të thelluarit në dije.)

Në këtë rast, shprehja "*te'uîlehû*" nuk ka kuptimin e mësipërm, por një kuptim më të ngushtë. Pra, shpjegimin e ajeteve të paqarta, që kanë nevojë për shpjegim, e di veçse Allahu i Lartësuar dhe dijetarët e mëdhenj, të cilët dinë t'i kuptojë ato nën dritën e ajeteve të qarta. Ndërsa çështjet e fshehta mund t'i dijë plotësisht veçse Allahu i Gjithëdijshëm. Ne nuk duhet të thellohemi dhe të kërkojmë shpjegime të imta e konkrete për ato gjëra të fshehta, që ne nuk mund t'i njohim më tepër sesa na ka mundësuar Zoti i gjithësisë, sepse po të ishte e nevojshme njohja e të tilla imtësive, atëherë ato do të na i tregonte i Urti nëpërmjet Profetit të Tij.

Njëherë, imam Maliku u pyet: "O Imam! Allahu thotë në Kur'ân: "*Er-Rraĥmânu alel Arshi-steuâ*" (Mëshiruesi u lartësua mbi Fron). Si u lartësua?!" Imam Maliku iu përgjigj: "Që u lartësua, kjo dihet, dhe është e detyrueshme që ta besojmë këtë si vepër të Zotit, por pyetja rreth saj është *bidat*."

Aq sa na është lejuar të dimë është e mjaftueshme për ne dhe duhet besuar sikurse na është thënë. Ashtu siç bëri imam Maliku, ashtu duhet vepruar për të gjitha cilësitë e veprat e Zotit, nëse dikush pyet dhe kërkon të dijë rreth tyre në mënyrë të hollësishme e konkrete. Allahu i Lartësuar na ka treguar mjaftueshëm rreth tyre, pa na i shpjeguar konkretisht dhe në imtësi. Për ne është detyrë që të qëndrojmë atje ku Allahu na ka urdhëruar të qëndrojmë, dhe të mos e kalojmë kufirin.

Të devijuarit rendin dhe rrëmojnë te çështjet e pashtjelluara, edhe pse kjo nuk ka asnjë dobi dhe asnjë rëndësi për ta. Ata vazhdojnë me të tilla pyetje, edhe pse njohja e përgjigjeve të tyre është jashtë mundësive njerëzore. Ato i di në mënyrë të plotë veçse Allahu i Lartësuar. Ndërsa ata që Zoti i ka quajtur "të thelluar në dije", i besojnë ajetet *muteshâbihât* ashtu sikurse i ka sjellë Zoti i gjithësisë, dhe nuk mundohen që të zbulojnë më tej imtësitë e tyre. Ata ia lënë këto çështje Zotit e, në këtë mënyrë, ata janë të ruajtur prej devijimit dhe humbjes.

Megjithatë, nëse bëhet fjalë për vështrim të ajeteve *muteshâbihât* nën dritën e ajeteve *muĥkemât*, kjo është diçka që Zoti e ka lejuar, madje ka urdhëruar që të veprohet kështu, nëse ajetin e mësipërm e lexojmë me mënyrën e dytë.

Allahu i Lartësuar na tregon një cilësi të dijetarëve, të cilët, për të shpjeguar ajetet *muteshâbihât*, mbështeten në ajetet *muĥkemât* dhe thonë:

- "Të gjitha *(ajetet)* janë nga Zoti ynë!" – Të gjitha kumtet që vijnë prej Allahut nuk

mund të jenë kurrë kontradiktore, por ato janë gjithmonë në harmoni të plotë me njëra-tjetrën dhe vërtetuese e qartësuese të njëra-tjetrës.

Këtu vërtetohet saktësia e një rregulli shumë të rëndësishëm. Duke qenë se çdo informacion në Kur'ân vjen prej Allahut, atëherë dijetarët e dinë se ndonjë paqartësi e ajeteve *muteshâbihât* mund të zbardhet nëpërmjet ajeteve *muhkemât*, edhe nëse për momentin, ndoshta, mund të mos kuptohet lidhja mes tyre.

Allahu i Lartësuar na ka nxitur që të besojmë dhe t'i dorëzohemi plotësisht ligjeve dhe dispozitave të Tij. Ai na ka ndaluar, nga ana tjetër, të ndjekim ajetet *muteshâbihât*, nëse nuk i shohim nën dritën e ajeteve *muhkemât*.

Pastaj Allahu i Lartësuar na thotë diçka shumë të rëndësishme:

- "Por këtë e kuptojnë vetëm ata që janë të mençur." – Vetëm të mençurit e mendjendriturit, që janë ajka e njerëzimit, përfitojnë nga mësime të tilla. Ata ndjekin çdo gjë që u bën dobi dhe u largohen atyre gjërave që i dëmtojnë. Ndërsa të tjerët janë fundërrina, që nuk dinë të arrijnë askund dhe nuk mund të përfitojnë nga këshillat dhe porositë e Zotit. Atyre nuk u bën aspak dobi përkujtimi, sepse i kanë mendjet bosh. Ata nuk dinë të dallojnë atë që u bën dobi dhe atë që i dëmton, se mendjet e tyre janë jofunksionale.

Më pas, Allahu i Lartësuar na tregon edhe një cilësi tjetër të të mençurve, që luten:

Ajetet 8 – 9

8. "Zoti ynë, mos na i devijo zemrat tona, pasi na drejtove! Na dhuro mëshirën Tënde! Pa dyshim, Ti je Dhuruesi i madh!".
9. "Zoti ynë, Ti je Ai që do t'i tubosh njerëzit në një ditë, për të cilën nuk ka dyshim. Allahu nuk e shkel premtimin e Vet".

Shpjegimi i ajeteve

- "Zoti ynë, mos na i devijo zemrat tona, pasi na drejtove!" – Kuptimi: Mos i lejo zemrat tona që të devijojnë, të largohen nga e vërteta, për shkak të injorancës apo arrogancës! Të lutemi të na bësh të përqendruar e të vazhdueshëm në rrugën e drejtë! Të lutemi Ty, të na bësh të udhëzuar dhe udhëzues! Na forco dhe na bëj të qëndrueshëm dhe besnikë në rrugën Tënde të drejtë! Na ruaj nga devijimi dhe sëmundja e zemrave të të devijuarve.

- "Na dhuro mëshirën Tënde! Pa dyshim, Ti je Dhuruesi i madh!" - Na dhuro mëshirën e madhe, që të kemi sukses në arritjen e çdo të mire dhe në ruajtjen nga rreziku i çdo të keqeje, sepse ti je Bamirës e Dhurues i madh. Mirësia Jote ka përfshirë çdo gjallesë!

- "Zoti ynë, Ti je Ai që do t'i tubosh njerëzit në një ditë, për të cilën nuk ka dyshim. Allahu nuk e shkel premtimin e Vet." - Allahu i Lartësuar do t'i tubojë njerëzit dhe do t'i shpërblejë ata sipas punëve të tyre: vepërmirët me të mira dhe vepërkëqijtë me ndëshkim.

Kështu, Allahu i Lartësuar i ka përshkruar dijetarët me shtatë cilësi të vyera, të cilat i sjellin lumturinë robit në të dyja jetët: Ata kanë dije të dobishme, e cila është rruga e vetme që të çon tek Allahu i Lartësuar, sepse nëpërmjet saj qartësohen ligjet e Tij. Ata nuk kanë thjesht dije të dobishme, por kanë dije të thellë. Kush zotëron një dije të tillë është një dijetar i madh. Në fakt, Allahu i Lartësuar u ka mësuar atyre dijen sipërfaqësore dhe dijen e thellë. Këta të zgjedhur janë shumë të ditur për sa u përket të fshehtave dhe imtësive të Sheriatit, dhe kjo dije duket në veprat që ata kryejnë.

• Allahu i Lartësuar na tregon se këta të zgjedhur i besojnë të gjitha ajetet e e Librit (Ata thonë: "Të gjitha janë nga Zoti ynë...") dhe për të shpjeguar ajetet *muteshâbih*, ata bazohen në ajetet *muhkeme*.

• Ata vazhdimisht dhe me përulje i kërkojnë Allahut t'i ruajë e shpëtojë nga çdo e keqe, me të cilat Allahu i Lartësuar ka sprovuar ata që parapëlqyen devijimin kundrejt udhëzimit të qartë të Zotit të tyre.

• Ata vazhdimisht i përkujtojnë mirësitë e Zotit ndaj tyre dhe tregojnë mirënjohje për to. Ata thonë: "Zoti ynë, mos na i devijo zemrat tona, pasi na i udhëzove në udhën e drejtë!".

• Ata e lusin vazhdimisht Allahun e Mëshirshëm që t'u dhurojë nga mëshira e Tij. Kjo lutje për mëshirë u mundëson atyre arritjen e çdo të mire që e dëshirojnë dhe ruajtjen e shpëtimin nga çdo e keqe, së cilës i ruhen dhe i frikësohen. Ata thonë: "Na dhuro mëshirën Tënde!"

• Ata afrohen dhe kërkojnë ndërmjetësime tek Allahu më anë të lutjeve të tyre dhe me mënyra të lejuara afrimi dhe ndërmjetësimi. Ata afrohen më shumë te Zoti i tyre duke u lutur me emrin e Tij *Uehhâb* (Dhurues).

• Allahu i Lartësuar na tregon se ata kanë dije dhe siguri të plotë rreth Ditës së Gjykimit me drejtësi. Kjo i nxit gjithmonë ata që të punojnë vepra të mira dhe vazhdimisht t'i ruhen devijimit dhe gjynaheve.


Ajetet 10 – 13

10. Është e sigurt se, atyre që nuk besojnë nuk do t'u vlejë asgjë para Allahut, as pasuria e as fëmijët e tyre, por do të jenë lënda djegëse e Zjarrit.

11. Kështu ndodhi edhe me pasuesit e Faraonit dhe ata të mëhershmit. Ata i mohuan argumentet Tona. Për këtë arsye, Allahu i shkatërroi për fajet e tyre. Allahu ndëshkon shumë ashpër.

12. Thuaju *(o Muhamed)* atyre që nuk besojnë: "Do të jeni të mposhtur dhe do të hidheni në Xhehenem. Sa i shëmtuar është ai shtrat!".

13. Për ju ishte përvojë e madhe kur dy palët u përballën me njëra-tjetrën. Njëra palë luftonte në rrugën e Allahut, kurse pala tjetër ishin jobesimtarë. Ata *(besimtarët)* panë se të tjerët *(qafirët)* ishin



dy herë më shumë se ata. Por Allahu përforcon atë që dëshiron me ndihmën e Vet. Vërtet, në atë ngjarje pati një mësim të madh për ata që kanë mendje të kthjellët.

Shpjegimi i ajeteve

- "Është e sigurt se, atyre që nuk besojnë nuk do t'u vlejë asgjë para Allahut, as pasuria e as fëmijët e tyre" - Allahu i Lartësuar tregon se ata që mohojnë Atë dhe profetët e Tij, ata që refuzojnë të binden dhe të pasojnë fenë dhe Librin e Tij (Kur'ânin), meritojnë një ndëshkim të ashpër. Askush nuk mund t'i shpëtojë ata nga ky ndëshkim i merituar: as pasuria, as fëmijët e tyre, sepse këto nuk do t'u vlejnë aspak tek Allahu i Lartësuar.

Në jetën e dynjasë, ndoshta, me pasurinë dhe fëmijët e tyre, ata mund të shpëtojnë prej rreziqeve që u kanosen. Për këtë arsye, ata thonë, sikurse tregon Allahu i Lartësuar në suren Sebe, ajetet 35-37: "Ne kemi shumë pasuri dhe fëmijë, prandaj nuk do të

ndëshkohemi apo të vuajmë ndonjëherë". Porse Ditën e Gjykimit, ata do të përballen me diçka që kurrë nuk e kanë llogaritur dhe menduar, siç thotë Allahu në suren Zumer, ajetet 47 dhe 48: "Edhe sikur e tërë çka gjendet në tokë, plus edhe një herë aq, të ishte e jobesimtarëve, ata do ta jepnin të gjithën për t'i shpëtuar dënimit të tmerrshëm në Ditën e Kijametit. Ata do të kenë prej Allahut atë (lloj ndëshkimi) që nuk kanë mundur as ta mendojnë. Ata do të përballen me të këqijat që me duart e tyre i fituan. Për ta u bë i pashmangshëm dënimi, për shkak të talljeve që ata bëjnë.".

Tek Allahu nuk kanë asnjë vlerë pasuria dhe fëmijët e robit, por atje bëjnë dobi veçse besimi i sinqertë, i shoqëruar me vepra të mira. Më tej, Allahu i Lartësuar thotë:

- "...por do të jenë lënda djegëse e Zjarrit" - Dënimi i këtyre mohuesve do të jetë zjarri i Xhehenemit, madje ata do të jenë lënda djegëse e tij. Ata do të qëndrojnë në të përjetësisht e pandërprerë.

- "Kështu ndodhi edhe me pasuesit e Faraonit dhe ata më të hershmit." - Që pasuria dhe fëmijët nuk u bëjnë dobi qafirëve, ka qenë një ligj i pandryshueshëm i Allahut të Lartësuar për të gjithë popujt. Kështu ishte për popullin e Faraonit, por edhe për të tjerët para e pas tyre. Të njëjtin përfundim do të kenë të gjithë 'faraonët' e çdo kohe, sado të fuqishëm qofshin në pushtetin e tyre, sado të mëdha të jenë pasuritë dhe pasuesit e tyre. Çdokush që mohon të vërtetën e shpallur nga Zoti, çdokush që nuk pranon t'i nënshtrohet rrugës së drejtë dhe të pasojë profetët e Zotit, do të ketë po atë përfundim.

- "Ata i mohuan argumentet Tona. Për këtë arsye, Allahu i shkatërroi për fajet e tyre." – Pra, Allahu i Lartësuar do t'i ndëshkojë ata, për shkak të mosbesimit dhe mosbindjes së tyre, sepse Allahu i Lartësuar është i Drejtë. Ai nuk i bën padrejtësi askujt. Çdo gjykim i Tij është i drejtë dhe i pakundërshtueshëm.

- "Allahu ndëshkon shumë ashpër." - Allahu ka përgatitur ndëshkim të ashpër për këdo që përmbush shkaqet që e bëjnë të merituesheëm këtë ndëshkim. Shkaqet që sjellin ndëshkimin janë kufri dhe gjynahet, me të gjitha llojet dhe ngjyrat e tyre.

Pastaj i Madhëruari thotë:

- "Thuaju *(o Muhamed)* atyre që nuk besojnë: "Do të jeni të mposhtur dhe do të hidheni në Xhehenem. Sa i shëmtuar është ai shtrat!". - Këto fjalë, nga njëra anë, u dhanë shpresë besimtarëve se fitorja dhe ndihma e Allahut do të ishte me ta dhe, nga ana tjetër, kërcënonin hapur mohuesit e Zotit, që luftonin të drejtën. Dhe, vërtet, ashtu ndodhi. Allahu i Lartësuar i ndihmoi besimtarët dhe bëri që ushtria e të vërtetës të triumfonte mbi armiqtë e të vërtetës, që ishin mohues të kategorive të ndryshme, si idhujtarë, çifutë, të krishterë etj.

Ndihma e Allahut do të vazhdojë të jetë me këtë popull të drejtë, me adhuruesit e Tij të sinqertë, me ushtarët e Tij besimtarë dhe besnikë. Allahu do të jetë me ta deri në Ditën e Gjykimit. Kjo profeci e Kur'ânit është një prej mrekullive të tij, e dëshmuar me sy prej njerëzve, që vërteton se ai libër është fjalë e Zotit të gjithësisë.

Më tej, Allahu i Lartësuar na tregon që, përveçse qafirët do të jenë gjithmonë të mposhtur në këtë jetë, në jetën tjetër ata do të tubohen në vendin e ndëshkimit dhe të vuajtjes së përjetshme, në zjarrin e Xhehenemit. Ai është një vend që ata vetë e përgatisin dhe e dëshirojnë për veten e tyre. Nuk ka vendqëndrim më të keq se ai i tyre dhe nuk ka ndëshkim më të rëndë se ndëshkimi i tyre.

- "Për ju ishte përvojë e madhe kur dy palët u përballën me njëra-tjetrën. Njëra palë luftonte në rrugën e Allahut, kurse pala tjetër ishin jobesimtarë." - Për ju ka shumë

mësime nga përballja mes dy ushtrive në betejën e Bedrit.

Dy ushtritë ishin: njëra që luftonte në rrugën e Allahut, ku ishte Profeti (a.s.) dhe shokët e tij; dhe tjetra ishte ushtria e qafirëve, të cilët refuzuan t'i bindeshin Zotit të tyre dhe të pasonin udhëzimin që solli Profeti i Tij. Këta dolën në luftë gjithë mendjemadhësi dhe plot urrejtje për Profetin e besimtarët. Ata dolën që të pengonin njerëzit nga rruga e Zotit, dhe këtë e bënin thjesht për të shitur mend dhe për të fituar famë.

Allahu i Lartësuar përcaktoi që dy palët kundërshtare të përballeshin me njëra tjetrën në Bedër, ndërkohë që idhujtarët ishin disa herë më tepër në numër se besimtarët. Por Allahu i Lartësuar thotë:

- "Ata *(besimtarët)* panë se të tjerët *(qafirët)* ishin dy herë më shumë se ata. Por Allahu përforcon atë që dëshiron me ndihmën e Vet. Vërtet, në atë ngjarje pati një mësim të madh për ata që kanë mendje të kthjellët."
- Besimtarët e panë që numri i idhujtarëve të cilët vërsuleshin kundër tyre ishte shumë më i madh. Allahu i Lartësuar e përforcon këtë fakt duke treguar se besimtarët e panë me sytë e ballit këtë pabarazi numerike.

Megjithatë, Allahu i Lartësuar i ndihmoi besimtarët, duke u dhuruar fitoren kundër qafirëve. Besimtarët i mposhtën bindshëm idhujtarët, duke vrarë krerët e tyre dhe duke robëruar shumë të tjerë. Kjo fitore u mundësua veçse prej Allahut, i Cili ishte ndihmëtari i tyre. Allahu i Lartësuar ndihmon çdonjë që ndihmon fenë e Tij dhe mposht e shkatërron çdonjë që e mohon Atë dhe udhëzimin e sjellë nëpërmjet Profetit të Tij.

Në këtë ngjarje ka mësime për ata që dinë të nxjerrin mësime, dhe ata që mund të nxjerrin mësime prej të tilla ngjarjeve janë veçse të mençurit. Kështu, të fituarit do të jenë gjithmonë ata që besojnë dhe pasojnë të vërtetën e sjellë prej Allahut dhe Profetit të Tij. Këta do të jenë pala e ndihmuar prej Allahut. Ndërsa të dështëruarit e të mundurit do të jenë gjithmonë ata që mohojnë të vërtetën dhe ndjekin të kotën, për të cilën nuk kanë asnjë bazë e argument të sigurt.

Nëse do të merrnim në konsideratë forcat ushtarake dhe shkaqet materiale të fitores së një lufte, do ta shihnim si të pamundur fitoren e një ushtrie të vogël e të paarmatosur mirë, kundër një ushtrie të madhe në numër e të fuqishme në armatim. Por përballë këtij realiteti që ne jemi mësuar të shohim me sy dhe ta besojmë, ndodhet një realitet tjetër më i fuqishëm dhe vendimtar se ai që shohim me shqisat tona. Këtë realitet mund ta ndiejnë dhe dëshmojnë veçse ata që shohin me dritën e imanit dhe që kanë mbështetje të plotë tek Allahu i Lartësuar. Ky realitet quhet: "ndihma e Allahut për besimtarët e Tij". Allahu i Lartësuar i ndihmon gjithmonë dhe u dhuron fitore adhuruesve të Tij mbi çdo jobesimtar, sado i madh e i fuqishëm qoftë.

Ajetet 14 – 17

14. Njerëzve u është ëmbëlsuar dashuria ndaj të këndshmeve, ndaj grave, djemve e ndaj pasurisë së madhe prej ari e argjendi, ndaj kuajve të stolisur, ndaj bagëtisë e bujqësisë. Këto janë kënaqësi të kësaj bote, po tek Allahu është e ardhmja më e mirë.
15. Thuaju: "A t'ju lajmëroj për diçka shumë më të mirë se ato? Për ata që janë të devotshëm janë përgatitur te Zoti i tyre kopshte, nëpër të cilët rrjedhin lumenj, ku ata do të jenë përjetësisht. Atje do të kenë bashkëshorte të pastra dhe kënaqësinë e Allahut. Allahu është Shikues i robërve të Vet.
16. Janë ata të cilët thonë: "Zoti ynë, ne besuam me sinqeritet! Na i fal gjynahet tona dhe na ruaj prej ndëshkimit të Zjarrit!"
17. Dhe ata që janë të durueshëm, të drejtë, të devotshëm e dorëdhënës, dhe ata që në kohën e agimit kërkojnë ndjesë.

Shpjegimi i ajeteve

- **"Njerëzve u është ëmbëlsuar dashuria ndaj të këndshmeve, ndaj grave, djemve e ndaj pasurisë së madhe prej ari e argjendi, ndaj kuajve të stolisur, ndaj bagëtisë e bujqësisë."** - Allahu i Lartësuar na tregon se njerëzve u është ëmbëlsuar dashuria për bukuritë e kësaj jete, duke përmendur në mënyrë të veçantë disa prej tyre, sepse ato janë bukuritë më të mëdha të dynjasë. Çdo bukuri e kënaqësi tjetër është degëzim i këtyre kryesoreve. Në suren Kehf, ajeti 7, i Lartësuari thotë: "Gjithçka që është mbi tokë, Ne e bëmë stoli të saj, për t'i provuar ata, se cili prej tyre do të jetë më vepërmirë".

Kënaqësitë e numëruara në ajet janë mjaft tërheqëse. Shpirti dhe zemra e njeriut i dëshiron shumë ato. Megjithatë, kundrejt këtyre kënaqësive, njerëzit ndahen në dy grupe:

1. Ata që e konsiderojnë arritjen e këtyre kënaqësive si qëllimin kryesor të jetës së tyre. Këta, çdo fjalë, vepër, mendim apo ndjenjë e kanë vetëm për hir të këtyre kënaqësive. Dëshira për të arritur këto kënaqësi i shmang ata nga qëllimi për hir të së cilit Allahu i Lartësuar i ka krijuar, duke u shndërruar kështu në kafshë të vërteta. Për ta është e rëndësishme thjesht që të përmbushin epshet dhe dëshirat e tyre, pa u shqetësuar aspak se me ç'rrugë do ta arrijnë këtë. Ata nuk shqetësohen aspak se si i fitojnë dhe si i shpenzojnë të mirat që zotërojnë. Ja, për të tillë njerëz, bukuritë joshëse të kësaj bote janë shkak për ndëshkimin dhe dëshpërimin e tyre.

2. Ata që e dinë cili është qëllimi i vërtetë i stolive të kësaj jete. Ata e dinë që Allahu i Lartësuar i ka bërë ato për të provuar besimin e njerëzve, për t'u dalluar qartë ata që i japin përparësi bindjes ndaj Tij dhe kënaqësisë së Tij, nga ata që parapëlqejnë përmbushjen e kënaqësive të pakontrolluara të kësaj dynjaje.

Grupi i dytë i përdor bukuritë e kësaj jete thjesht si mjete për të arritur qëllimin kryesor: adhurimin e Allahut. Nëpërmjet kësaj jete dhe çdo çasti të saj, ata mundohen të grumbullojnë sa më shumë furnizime për rrugën e gjatë që i pret pas vdekjes. Çdo kënaqësi të kësaj bote ata e përdorin si ndihmë për të arritur përsosjen e adhurimit dhe kënaqësinë e Zotit të tyre. Kënaqësitë dhe stolitë e kësaj jete zënë vend vetëm në trupin e tyre, ndërsa shpirti dhe zemra e tyre përkushtohen për të arritur një qëllim tjetër, shumë më të lartë dhe më të vyer. Ata e dinë se mirësitë e dynjasë janë sikurse i përshkruan Allahu i Lartësuar:

- **"Këto janë kënaqësi të kësaj bote, po tek Allahu është e ardhmja më e mirë."** - Çdo kënaqësi që shijojnë në këtë dynja, ata e shndërrojnë në një urë për të shkuar në lumturinë e përjetshme.

Ata bëjnë një tregti shumë të madhe, duke shpresuar shpërblim dhe dhurata të mrekullueshme. Për këtë kategori njerëzish, bukuritë e kësaj jete janë mjete që i çojnë të sigurt te Zoti i tyre.

Ky ajet është qetësues e ngushëllues për të gjithë ata të varfër që nuk kanë mundësi të shijojnë mjaft kënaqësi të kësaj bote, të cilat i provojnë të pasurit. Ajeti është, gjithashtu, edhe përkujtim dhe qortim për çdo njeri që mashtrohet nga bukuritë e kësaj dynjaje. Nga ana tjetër, ai nxit të mençurit e të urtët që të tregohen asketë ndaj botës mashtruese dhe stolive të saj të kufizuara dhe të përkohshme. Ai i nxit ata që të shohin me zemrat dhe besimin e tyre shumë lart, te premtimet e mrekullueshme të Allahut.

"Thuaju: "A t'ju lajmëroj për diçka shumë më të mirë se ato? Për ata që janë të devotshëm janë përgatitur te Zoti i tyre kopshte, nëpër të cilët rrjedhin lumenj, ku ata do të jenë përjetësisht." - Allahu i Lartësuar na tregon se mirësitë e përgatitura për të devotshmit janë shumë herë më të çmuara se mirësitë e kësaj jete të shkurtër. Ato janë kopshte të dendura e të larta, me banesa të gjera, të rehatshme e plot luks.

Kopshtet janë të mbushura me pemë të llojllojshme. Nëpër to rrjedhin lumenj, sipas dëshirës së tyre.

- "Atje do të kenë bashkëshorte të pastra dhe kënaqësinë e Allahut." - Gratë do të jenë të pastra nga çdo ndyrësi e jashtme dhe e brendshme, trupore, shpirtërore dhe morale.


Të gjitha këtyre mirësive u shtohet e u plotësohet bukuria e vlera edhe nga fakti që ato do të jenë të përjetshme për besimtarët. Përveç kësaj, kjo përjetësi do të jetë në kënaqësinë e Allahut. Kënaqësia e Allahut ndaj tyre është mirësia më e madhe që ata do të shijojnë.

A mund të krahasohen, pra, kënaqësitë e kësaj jete me ato të ahiretit? Bëj për veten tënde zgjedhjen më të mirën, duke kujtuar dallimin mes dy jetëve, dhe mos harro!

- "Allahu është Shikues i robërve të Vet." – Allahu i di në hollësi dëshirat e njerëzve. Ai i di të mirat dhe të këqijat që përmban shpirti ynë. Ai e di shumë mirë se çfarë i përshtatet secilit. Ai i jep sukses atij që Ai dëshiron, dhe lë në humbje atë që Ai dëshiron.

Allahu i Lartësuar që i bëri përshkrimin më të bukur Xhenetit të Tij, përshkruan më pas edhe krijesat që e meritojnë atë vend. Kështu, të vetmit që do t'i gëzojnë këto premtime janë të devotshmit, domethënë ata që i ruhen ndëshkimit dhe zemërimit të Zotit të tyre, duke zbatuar çdo urdhër të Tij dhe duke u larguar nga çdo gjë që Ai e ka ndaluar. Këta luten vazhdimisht dhe thonë:

- "Janë ata të cilët thonë: "Zoti ynë, ne besojmë me sinqeritet! Na i fal gjynahet tona dhe na ruaj prej ndëshkimit të Zjarrit!" - Një cilësi e tyre është edhe fakti që ata afrohen tek Allahu i Lartësuar dhe ndërmjetësojnë tek Ai me besimin e tyre, që Ai t'i falë dhe të mbulojë të metat e tyre. Ata thonë: "O Zoti ynë, ne besojmë, prandaj, për hir të këtij besimi, na i fal gjynahet tona dhe na ruaj nga dënimi i Zjarrit!".


الجزء الثالث سورة آل عمران

الَّذِينَ يَقُولُونَ رَبَّنَآ إِنَّنَآ ءَامَنَّا فَٱغْفِرْ لَنَا ذُنُوبَنَا
وَقِنَا عَذَابَ ٱلنَّارِ ﴿١٦﴾ ٱلصَّٰبِرِينَ وَٱلصَّٰدِقِينَ وَٱلْقَٰنِتِينَ
وَٱلْمُنفِقِينَ وَٱلْمُسْتَغْفِرِينَ بِٱلْأَسْحَارِ ﴿١٧﴾ شَهِدَ ٱللَّهُ
أَنَّهُۥ لَآ إِلَٰهَ إِلَّا هُوَ وَٱلْمَلَٰٓئِكَةُ وَأُو۟لُوا۟ ٱلْعِلْمِ قَآئِمًۢا
بِٱلْقِسْطِ ۚ لَآ إِلَٰهَ إِلَّا هُوَ ٱلْعَزِيزُ ٱلْحَكِيمُ ﴿١٨﴾ إِنَّ ٱلدِّينَ
عِندَ ٱللَّهِ ٱلْإِسْلَٰمُ ۗ وَمَا ٱخْتَلَفَ ٱلَّذِينَ أُو۟تُوا۟ ٱلْكِتَٰبَ
إِلَّا مِنۢ بَعْدِ مَا جَآءَهُمُ ٱلْعِلْمُ بَغْيًۢا بَيْنَهُمْ ۗ وَمَن يَكْفُرْ
بِـَٔايَٰتِ ٱللَّهِ فَإِنَّ ٱللَّهَ سَرِيعُ ٱلْحِسَابِ ﴿١٩﴾ فَإِنْ حَآجُّوكَ
فَقُلْ أَسْلَمْتُ وَجْهِىَ لِلَّهِ وَمَنِ ٱتَّبَعَنِ ۗ وَقُل لِّلَّذِينَ أُو۟تُوا۟
ٱلْكِتَٰبَ وَٱلْأُمِّيِّۦنَ ءَأَسْلَمْتُمْ ۚ فَإِنْ أَسْلَمُوا۟ فَقَدِ ٱهْتَدَوا۟ ۖ
وَّإِن تَوَلَّوْا۟ فَإِنَّمَا عَلَيْكَ ٱلْبَلَٰغُ ۗ وَٱللَّهُ بَصِيرٌۢ بِٱلْعِبَادِ ﴿٢٠﴾
إِنَّ ٱلَّذِينَ يَكْفُرُونَ بِـَٔايَٰتِ ٱللَّهِ وَيَقْتُلُونَ ٱلنَّبِيِّـۧنَ
بِغَيْرِ حَقٍّ وَيَقْتُلُونَ ٱلَّذِينَ يَأْمُرُونَ بِٱلْقِسْطِ مِنَ
ٱلنَّاسِ فَبَشِّرْهُم بِعَذَابٍ أَلِيمٍ ﴿٢١﴾ أُو۟لَٰٓئِكَ ٱلَّذِينَ حَبِطَتْ
أَعْمَٰلُهُمْ فِى ٱلدُّنْيَا وَٱلْءَاخِرَةِ ۖ وَمَا لَهُم مِّن نَّٰصِرِينَ ﴿٢٢﴾
٥٢

Është pikërisht Allahu i Lartësuar që u ka dhënë sukses dhe që i ka udhëzuar, dhe po nga Ai ata kërkojnë që, ashtu sikurse i ka udhëzuar në besim, t'ua mbulojë të metat, t'ua falë gabimet dhe t'i ruajë nga dënimi i Zjarrit.

Pastaj Allahu i Lartësuar tregon disa cilësi të tjera të të devotshmëve:

- "Dhe ata që janë të durueshëm, të drejtë, të devotshëm e dorëdhënës, dhe ata që në kohën e agimit kërkojnë ndjesë." – Pra, të devotshmit janë edhe të durueshëm. Ata ia nënshtrojnë veten bindjes ndaj Zotit. Ata durojnë gjithçka, për të plotësuar urdhrat që i do dhe i pëlqen Allahu. Ata durojnë për t'u larguar nga çdo gjynah dhe mosbindje ndaj Allahut të Lartësuar. Ata janë të durueshëm përballë çdo përcaktimi të Zotit të tyre. Ata janë të kënaqur me caktimin e Zotit dhe janë të durueshëm. Ata nuk tregojnë asnjë pakënaqësi apo zemërim me caktimin e Allahut të Lartësuar.

Të devotshmit janë, gjithashtu, të vërtetë e të sinqertë në besimin e tyre. Veprat, fjalët, ndjenjat dhe besimi i tyre janë të çiltra. Ata nuk janë shtiracakë.

Të devotshmit janë dorëdhënës. Ata shpenzojnë çdo lloj pasurie me të cilën Zoti i tyre i ka privilegjuar nga të tjerët. Ata janë në ndihmë të vazhdueshme ndaj krijesave të Zotit, e në mënyrë të veçantë ndaj të afërmve të tyre.

Të devotshmit janë kërkuesit e faljes gjatë kohës së agimit, dhe kjo është cilësi jashtëzakonisht e rrallë. Edhe pse gëzojnë virtyte të larta, si ato që u përmendën më sipër, ata e shohin veten me sy kritik dhe kurrë nuk pretendojnë se janë të devotshëm. Përkundrazi, ata mendojnë se janë shumë të mangët në fjalët dhe veprat e tyre, për të pretenduar një gjë të tillë. Për këtë arsye, ata e ndjejnë veten të detyruar që të kërkojnë falje nga Zoti i tyre i madhërishëm. Madje, ata nuk kërkojnë falje dosido, por përpiqen që këtë ta bëjnë në kohë të përzgjedhura, me qëllim që përgjigjja e Zotit të jetë më pranë dhe më e sigurt. Kjo dëshmon se me sa shumë ngulm e kërkojnë ata faljen nga Zoti i tyre. Ata luten në kohën e agimit, sepse atëherë e shpresojnë faljen nga Allahu i Madhëruar.

Për shpjegimin e kësaj cilësie të të devotshmëve, Hasen el Basriu ka thënë: "Ata e zgjasin namazin e natës deri në kohën e agimit, pastaj ulen, shprehin pendesë dhe kërkojnë falje prej Zotit të tyre."

Këto ajete, ndër të tjera, flasin për:

- gjendjen e njerëzve në raport me kënaqësitë e kësaj jete të shkurtër;
- për mirësitë, zbukurimet dhe luksin e kësaj dynjaje, dhe për faktin që ato janë të papërfillshme në krahasim me jetën tjetër dhe bukuritë e saj të përjetshme;
- për bukuritë e mrekullueshme të Xhenetit dhe për çdo mirësi që gjendet në të, duke na nxitur që të bëjmë dallimin mes dy jetëve.

Duke na nxitur që t'i studiojmë mirësitë e secilës jetë, para se të bëjmë përzgjedhjen tonë, Allahu i Lartësuar na tregon se Ai dëshiron prej nesh që t'i japim përparësi ofertës së Tij për të hyrë në Xhenetin e përjetësisë. E si mund të zgjedhim mirësitë e dynjasë të shkurtër, që e ka një fund, përpara mirësive të mrekullueshme dhe të përjetshme të Xhenetit?!

Allahu ka përshkruar banorët e Xhenetit, me cilësitë e tyre të rralla. Ata janë të devotshmit, të cilët i ruhen ndëshkimit dhe zemërimit të Zotit të tyre, duke zbatuar urdhrat e Tij dhe duke iu larguar ndalesave të Tij, të cilat Ai i ka sqaruar në Kur'ân dhe nëpërmjet Profetit të Tij. Allahu i tregon më konkretisht disa virtyte të të devotshmëve, me të cilat adhuruesi e stolis veten e tij. Ato cilësi janë kritere për të gjykuar në mund të jesh prej banorëve të Xhenetit apo jo.

Ajetet 18 – 20

18. Allahu dëshmon, e po ashtu edhe engjëjt, dhe njerëzit e dijes, se nuk ka të adhuruar tjetër me meritë përveç Tij. Ai është Zbatuesi i drejtësisë. Nuk ka të adhuruar tjetër përveç Tij, Fuqiplotit e të Urtit.

19. Feja e pranueshme tek Allahu është Islami. Ata të cilëve u është dhënë Libri kundërshtuan veçse pasi u erdhi e vërteta, të nxitur nga zilia mes tyre. E kush mohon argumentet e Allahut, le ta dijë se Allahu është i shpejtë në llogarinë e Tij.

20. E nëse ata polemizojnë me ty, ti thuaju: "Unë, me tërë qenien time, i jam dorëzuar Allahut; e po kështu edhe pasuesit e mi!" Thuaju atyre që u është dhënë Libri dhe injorantëve: "A e pranoni fenë Islame?" Nëse e pranojnë Islamin, atëherë e kanë gjetur të vërtetën, e nëse refuzojnë, ti ke për detyrë vetëm kumtimin. Allahu i vështron me imtësi krijesat.

Shpjegimi i ajeteve

- **"Allahu dëshmon, e po ashtu edhe engjëjt, dhe njerëzit e dijes, se nuk ka të adhuruar tjetër me meritë përveç Tij." -** Ky është një argument tepër i fortë, që vërteton

se adhurimi i takon veç Allahut të Lartësuar, prandaj është i detyrueshëm pranimi i tij. Ai përmban: dëshminë e Zotit të Lartësuar, që është e sigurt dhe e pakundërshtueshme; dëshminë e engjëjve të Tij, këtyre krijesave të pastra, të drejta e besnike; dhe dëshminë e dijetarëve, të mençurve e të urtëve.

Dëshmia e Allahut të Lartësuar që vërteton njëshmërinë e Tij në adhurimin që meriton, është shumë e thjeshtë, e kuptueshme dhe bindëse. Fakti që nuk ka zot tjetër që meriton të adhurohet me dashuri dhe nënshtrim të plotë, është shumë i kuptueshëm për robërit e Allahut, nëse ata dinë të vështrojnë te krijimi në përgjithësi dhe te vetet e tyre. Allahu i Lartësuar thotë: "Ne do t'ua bëjmë atyre të mundshme që t'i shohin argumentet Tona në horizonte dhe në vetet e tyre, derisa t'u bëhet e qartë se ai (Kur'âni) është i vërtetë. A nuk mjafton që Zoti yt është dëshmitar për çdo gjë?" [Fusilet, 53].

Mjaftojnë vetëm disa shenja që duken qartë në këtë botë, që njerëzit të binden plotësisht për këtë të vërtetë të madhe e të pakundërshtueshme: që askush nuk meriton të adhurohet me dashuri dhe nënshtrim të plotë, përveç Allahut të Lartësuar, Krijuesit dhe Kujdestarit të të gjitha krijesave.

Çdokush që e njëson Zotin e tij me adhurime, me dëshirë, bindje dhe nënshtrim total ndaj Tij, do të jetë i pamposhtur e gjithmonë fitimtar mbi çdo idhujtar, që refuzon ta njësojë Allahun në adhurim ose që refuzon çdo mësim të sjellë prej Zotit nëpërmjet profetëve. Njësuesi i Zotit do të triumfojë gjithmonë, mbi çdo lloj idhujtari e mohuesi, edhe nëse kjo do të ishte jashtë çdo mundësie njerëzore. A nuk është kjo shenjë, që vërtet Allahu është Një, i Pashoq dhe i Gjithëpushtetshëm?! Sigurisht që po. Ky triumf i përhershëm është argument i pakundërshtueshëm, që vërteton se Zoti është Një, i Plotfuqishëm, Absolut dhe Vetëvendosës. Ai është Allahu, i Vetëm dhe i Plotfuqishëm për gjithçka.

Nëse shohim natyrën e mirësive dhe përkujdesjes së Allahut të Lartësuar për krijesat, do të kuptojmë që Ai është Një, i Vetëm, i Pashoq në sundimin dhe pushtetin e Tij. Nuk ka asnjë mirësi që krijesat ta shijojnë e të mos jetë prej Tij. Vetëm Ai i dhuron mirësitë dhe vetëm Ai i largon të këqijat, fatkeqësitë dhe dhimbjet. Krijesat janë absolutisht të pafuqishme për të sjellë të mira dhe për të larguar të këqijat, qoftë nga vetja e tyre, qoftë për të tjerët. Nëse me adhurimin që krijesat bëjnë, kërkohet apo synohet arritja e çdo të mire dhe largimi i çdo të keqeje, në këtë jetë dhe në jetën tjetër, atëherë shumë thjesht duhet të pranohet se i vetmi që meriton adhurimin është Allahu i Lartësuar, sepse është Ai që e ka në dorë dhurimin e të mirave dhe ndalimin e të këqijave. Nëse me adhurimin që bëjnë krijesat synohet që të kënaqet Allahu, Krijuesi, Ai që përkujdeset për ta, atëherë shumë thjesht duhet pranuar që vetëm Allahu meriton të kënaqet me adhurimet që i përkushtohen Atij. A nuk është ky një argument i padiskutueshëm që Allahu i Lartësuar është i Vetmi që meriton adhurimet tona?!

Pa dyshim, argumentet e Zotit janë të pafundme. Ato tregojnë se Ai është i Vetmi të Cilit duhet t'i përkushtohesh me dashuri, madhërim dhe nënshtrim të plotë. Këto janë fakte mëse të mjaftueshme për njerëzit që dinë të mendojnë.

Për sa i përket dëshmisë së engjëjvë, ajo është përcjellë tek ne nëpërmjet Librit të Allahut dhe fjalëve autentike të Profetit (a.s.). Nuk ka dyshim që Kur'âni dhe Tradita profetike janë përcjellë tek ne me rrugët më të sigurta të kalimit të informacionit.

Edhe dëshmia e dijetarëve të mençur e të urtë është tepër bindëse, sepse ata janë pika e referimit të njerëzimit për kuptimin dhe qartësimin e të gjithave çështjeve, qofshin ato të fesë, por edhe të dynjasë.

Sigurisht që për këtë çështje të madhe, referimi tek të diturit është i domosdoshëm, të cilët janë të gjithë të një mendimi të

përbashkët se Allahu është Një i vetëm. Të gjithë ata e besojnë këtë fakt, prandaj i ftojnë të tjerët që ta pranojnë dhe t'i binden këtij realiteti. Ata gjithmonë u tregojnë njerëzve rrugën që duhet të ndjekin për të njësuar Allahun me adhurimet e tyre.

Pas këtyre tri dëshmive të padiskutueshme, është e detyrueshme për krijesat që ta besojnë dhe ta pranojnë të nënshtruar këtë të vërtetë të sigurt, të përcjellë deri tek ne sipas rregullave strikte të transmetimit. Është detyrë për ta që ta besojnë se Zoti që meriton të adhurohet me dashuri, madhërim dhe përkushtim, është Allahu i Lartësuar, Një dhe i Pashoq. Është detyrë për ta, gjithashtu, që pas këtij besimi, të veprojnë në përputhje me të.

Ky ajet tregon se dija më e vyer është njohja e njëshmërisë së Allahut të Lartësuar. Vlera e kësaj dijeje qëndron në faktin se, për të vërtetuar saktësinë e saj, Allahu i Lartësuar e ka dëshmuar Vetë, duke sjellë madje edhe dëshminë e krijesave më të zgjedhura të Tij. Dihet shumë mirë se dëshmia mund të jetë e pranueshme veçse kur bazohet mbi një dije të sigurt e të palëkundshme, njëlloj sikur të jetë parë me sytë e ballit. Edhe një herë, pra, dija e sigurt rreth njëshmërisë së Allahut në meritën e adhurimit, është dija më e rëndësishme, sepse ajo vërteton dëshminë më të rëndësishme, atë të teuhidit.

Ajeti tregon se ai që nuk ka arritur këtë nivel të dijes rreth teuhidit të Allahut, saqë të dëshmojë me drejtësi për këtë çështje, nuk e meriton që të quhet dijetar i urtë.

Gjithashtu, ky ajet vlerëson lart diturinë, në përgjithësi. Për të dëshmuar mbi çështjen më të rëndësishme në këtë ekzistencë, njësimin e Tij në meritën e adhurimit, Allahu i Lartësuar dalloi dijetarët mbi njerëzit e tjerë. Vetëm dëshmia e tyre është e vlefshme si argument në këtë çështje. A nuk është ky një vlerësim i lartë për diturinë? Dëshminë e dijetarëve, Allahu i Lartësuar e vuri pranë dëshmisë së Tij dhe të engjëjve të Tij. A nuk është ky një vlerësim i lartë për diturinë? Kaq do të ishte e mjaftueshme, pra, për të treguar vlerën e lartë të diturisë dhe të dijetarëve. Allahu e ka përmendur diturinë si cilësi të lartë të dijetarëve, kur i quan ata: "të zotët e dijes".

Dituria i lartëson njerëzit. Për shkak të dijes së tyre, Allahu i Lartësuar i bëri dijetarët dëshmitarë te njerëzit. Ata janë argumentet e Zotit te njerëzit. Prania e tyre në mesin e njerëzve hedh poshtë çdo justifikim para Zotit, nëse këta njerëz nuk i përfillin fjalët dhe porositë e Tij, të përcjella dhe të sqaruara nga dijetarët. Allahu ua ka bërë detyrim njerëzve që të binden dhe të punojnë sipas këshillave të dijetarëve të drejtë.

Dijetarët ndikojnë që njerëzit të punojnë dhe t'i kryejnë adhurimet sipas udhëzimeve të Zotit. Për këtë arsye, ata kanë shpërblime të mëdha. Po ashtu, çdokush që punon sipas këshillave të dijetarëve të drejtë, do të ketë shpërblim të madh. Në peshoren e dijetarëve do të futen shpërblimet e të gjithë njerëzve që punojnë dhe e adhurojnë Allahun sipas dijes dhe udhëzimit të drejtë të përcjellë prej tyre. Kjo tregon vlerën e madhe të dijes së drejtë dhe të saktë, të punës me të dhe të përhapjes së saj ndër njerëz. Kjo është begati prej Allahut, të cilën Ai ia jep kujt të dëshirojë.

Vlera e dijes duket edhe nga fakti që Allahu i Lartësuar i ka përzgjedhur dijetarët për të dëshmuar pikërisht për shkak të dijes së tyre. Kjo tregon se Allahu i Lartësuar i konsideron dijetarët, si dëshmues të drejtë e të pranueshëm. Njerëzit me dije të drejtë, të thellë e të saktë janë një garanci e mirë për krijesat, sepse i ruajnë nga devijimi prej së vërtetës. Nëse njerëzit u përmbahen udhëzimeve të dijetarëve të drejtë, ata gjithmonë do të jenë të udhëzuar. Ky, pa dyshim, është vlerësim për dijen.

Pasi pohon dhe dëshmon meritën e Tij për t'u adhuruar i vetëm, Allahu i Lartësuar vijon të dëshmojë se Ai është i Drejtë. Pra, Ai na tregon se argumentet dhe dëshmitë e Veta i ka sjellë me drejtësi:

- "Ai është Zbatuesi i drejtësisë." – Allahu ka qenë dhe është gjithmonë i Drejtë në veprat e Tij, në administrimin e çështjeve të krijesave të Tij dhe përkujdesjen ndaj tyre. Ai i udhëzon në rrugë të drejtë krijesat, me të gjitha urdhrat e Tij dhe me të gjitha ndalesat e Tij. Ai është i Drejtë në gjithçka që ka krijuar dhe që ka përcaktuar në këtë ekzistencë.

Pastaj Allahu i Lartësuar dhe i Drejtë e përsërit edhe një herë dëshminë e mrekullueshme, duke thënë:

- "Nuk ka të adhuruar tjetër përveç Tij, Fuqiplotit e të Urtit." - Kjo dëshmi është vërtetuar dhe mbështetur me plot argumente, qofshin ato logjike, qofshin të transmetuara saktësisht prej Allahut dhe Profetit të Tij. Aq të qarta, bindëse dhe të kuptueshme janë këto argumente, saqë kjo dëshmi është e pakundërshtueshme për ata që dinë të shohin dhe të kuptojnë.

Për sa u përket argumenteve të ardhura në Kur'ân dhe Sunet për teuhidin, ato janë të shumta dhe të larmishme. Në shumë prej tyre urdhërohet dhe nxitet për ta besuar dhe për ta dëshmuar atë.

Në Kur'ân dhe në Sunet ka shumë tekste që na urdhërojnë që t'i duam ata që e besojnë, që dëshmojnë dhe që punojnë sipas dëshmisë për njëshmërinë e Allahut të Lartësuar. Në Kur'ân dhe në Sunet ka shumë tekste, gjithashtu, që na nxisin të urrejmë çdo njeri që nuk e beson, që nuk e dëshmon dhe që nuk punon sipas kësaj dëshmie. Ato na nxisin që ta urrejmë dhe ta konsiderojmë si armik këdo që nuk e njëson Allahun e Lartësuar me adhurime, me dashuri dhe nënshtrim të plotë.

Në Kur'ân dhe në Sunet ka shumë tekste që tregojnë për ndëshkimin që i pret ata që adhurojnë të tjerë zota veç Allahut, të Vetmit që meriton adhurimin. Allahu i Lartësuar dhe Profeti i Tij i kanë paralajmëruar idhujtarët që e shpërfillin dëshminë: "*Nuk ka të adhuruar tjetër me meritë, përveç Allahut*", të vetmen shpresë për të qenë të lumtur. Madje kur lexon Kur'ânin, të krijohet bindja se ai është shpallur vetëm për të qartësuar këtë dëshmi te krijesat.

Për sa u përket argumenteve logjike rreth vërtetësisë së kësaj dëshmie të madhe, edhe ato janë të shumta dhe të thjeshta për t'u kuptuar. Madje, është vetë Kur'âni, i cili na nxit dhe na udhëzon që të fusim në punë logjikën për të kuptuar se i vetmi Zot që meriton të adhurohet me dashuri, madhërim dhe nënshtrim është Allahu, Një dhe i Pashoq. Më poshtë mund të përmendim disa nga mënyrat kryesore të Kur'ânit që na nxisin të argumentojmë logjikisht rreth vërtetësisë së shehadetit:

Kështu, Kur'âni argumenton dhe vërteton se Allahu i Lartësuar është i Vetëm e Absolut në veprat e Tij. Pra, Ai është i vetmi Krijues, Furnizues, Sundues, i vetmi që përkujdeset dhe rregullon çështjet e gjithësisë. Kur'âni na kujton se të gjithë njerëzit e pranojnë këtë fakt të pamohueshëm, që është skalitur thellë në shpirtin e çdonjërit prej tyre.

Më konkretisht, Allahu i Lartësuar na udhëzon që të përdorim një logjikë shumë të thjeshtë për t'u kuptuar, duke na thënë: Nëse ju, o krijesa, e dini dhe keni siguri të plotë se Allahu i Lartësuar është Absolut dhe i Vetëm në krijimin, pushtetin, furnizimin dhe përkujdesjen ndaj krijesave të Tij, a nuk do të thotë kjo që Ai duhet të jetë i Vetmi që të meritojë dashurinë, nënshtrimin, madhërimin dhe përkushtimin tuaj të plotë?! Pa dyshim që, pas këtij argumentimi logjik, në zemrat tuaja nuk do të ketë të adhuruar tjetër, përveç Allahut.

Janë të shumta ajetet që sqarojnë dhe vërtetojnë se Allahu i Lartësuar është i vetmi Krijues, Sundues, Furnizues e Kujdestar i krijesave. Nëse një fakt i tillë zë vend në zemrat dhe mendjet e krijesave, ai bëhet një shtysë e fortë dhe një argument i qartë që edhe Zoti i tyre të jetë po Allahu, Absoluti, i vetmi në pushtetin e Tij madhështor.

Kur'âni argumenton dhe vërteton se Allahu i Lartësuar është i vetmi Dhurues i mirësive të kësaj jete dhe të jetës tjetër. Allahu është i vetmi që mund të largojë të keqen, të dëmshmen, dëshpërimin dhe fatkeqësitë. Çdo mirësi që gëzojnë krijesat, e madhe apo e vogël qoftë, e dukshme apo e fshehur, është thjesht dhuratë dhe mëshirë nga Zoti i gjithësisë. Çdo e keqe a dëshpërim, çdo fatkeqësi a mundim që largohet ndodh thjesht prej Zotit, që me urtësi dhe butësi vepron ndër krijesa. Ai është i vetmi që mund të ndikojë në këtë gjithësi. Asnjë krijesë nuk ka mundësi për të ndihmuar veten apo të tjerët, ose të grumbullojë të mirat dhe të largojë të këqijat për veten a për të tjerët. I vetmi që i ka në dorë të gjitha këto është Allahu i Lartësuar, i Mëshirshëm dhe i Urtë. Ajetet që e pohojnë një fakt të tillë janë të shumta në Kur'ân dhe në Sunet. Atëherë, e gjithë kjo, a nuk të bind se i vetmi të cilit duhet t'ia përkushtosh adhurimet është Allahu, sepse Ai ka në dorë të mirën dhe të keqen? Nëse me adhurimet tona duam të arrijmë të mirat e kësaj jete dhe të jetës tjetër, atëherë ç'kuptim do të kishte të adhuronin dikë që nuk ka në dorë asgjë nga këto?! Kësisoj, veçse Ai që është i Plotpushtetshëm e i Vetëm në sjelljen e të mirave dhe në largimin e të këqijave prej nesh, veçse Ai duhet të adhurohet. A nuk ishte Kur'âni që na shtyu të mendonim e logjikonim në këtë mënyrë?

Allahu i Lartësuar ka bërë në Kur'ân një përshkrim të hollësishëm të idhujve, që njerëzit i adhurojnë së bashku me Atë. Të gjithë idhujt kanë një të përbashkët: të gjithë janë të dobët, të papushtetshëm e të pafuqishëm për të sjellë të mira apo për të larguar të këqijat. Ata nuk janë në gjendje të ndihmojnë as veten dhe as të tjerët, për nevojat e tyre. Ata nuk shohin dhe as dëgjojnë. Edhe nëse janë nga ata që mund t'i dëgjojnë kërkesat e lutësve, ata janë krejt të pafuqishëm t'u përgjigjen lutjeve të tyre. Ata janë të mangët e nevojtarë. Ky përshkrim është një nxitje për të përdorur logjikën: A mund të adhurohet diçka e tillë, e mangët, e pafuqishme dhe e papushtetshme?!

Nga ana tjetër Allahu i Lartësuar flet në Kur'ân shumë qartë rreth emrave, cilësive dhe veprave të Tij të mrekullueshme. Ai na tregon për pushtetin e tij absolut mbi gjithçka, e për shumë atribute të tjera, që përshkruajnë madhështinë dhe lavdinë e Tij. Edhe kjo është një nxitje shumë e fortë për të vënë në punë logjikën e pastër. Nëse një mendje e shëndoshë e njeh Allahun e Lartësuar dhe cilësitë e Tij, nga njëra anë, e nëse njeh edhe mangësitë e gjithçkaje tjetër veç Tij, nga ana tjetër, sigurisht që do ta kuptojë se kë duhet të adhurojë. Një mendje e shëndoshë nuk mund të pranojë që të adhurohet dikush tjetër veç Allahut Madhështor, Unik e Absolut në çdo cilësi të Tij. Dashuria e plotë, madhërimi, nënshtrimi e bindja totale duhet t'i kushtohen veçse Madhështorit, Absolutit, e Unikut në meritën për t'u adhuruar. Ai është i Ploti, që s'ka mangësi, i Lavdishmi, Krenari, i Plotpushtetshmi, i Pamposhturi. Ndërsa krijesat janë të nënshtruara, të varfëra, nevojtare e të mangëta. Ato nuk mund të dëgjojnë, që të përgjigjen, nuk mund të shikojnë, që të ndihmojnë, dhe nuk mund të gjykojnë drejt e as të logjikojnë.

Një argument tjetër logjik shumë i fortë bazohet në përvojën e njohur të njerëzve, gjatë gjithë kohërave. Njerëzimi ka dëshmuar përgjatë gjithë historisë së tij, se Allahu i Lartësuar i ka ndihmuar dukshëm adhuruesit e Tij të sinqertë, të cilët i janë përkushtuar vetëm Atij me dashuri, madhërim, nënshtrim dhe bindje. Ai gjithmonë i ka nderuar ata me një larmi mirësish dhe dhuratash. Ndërsa, nga ana tjetër, Ai i ka poshtëruar e shkatërruar që në këtë jetë të gjithë ata që kanë adhuruar zota të tjerë veç Tij. E gjithë kjo, pa dyshim, ka ndodhur për një shkak të vetëm: sepse Allahu i Lartësuar e ka bërë teuhidin shkak dhe mënyrë që mundëson arritjen e çdo të mire dhe që largon çdo të keqe të kësaj jete dhe të jetës tjetër. Ndërsa idhujtarinë, Allahu

i Lartësuar e ka bërë shkak që të çon në përjetimin e çdo të keqeje të kësaj jete dhe të jetës tjetër. Çdo ndëshkim dhe fatkeqësi që u ndodh njerëzve në fenë e tyre dhe në çështjet e dynjasë, vjen si pasojë e idhujtarisë dhe e shenjave të saj. Logjika e këtij argumenti është shumë e thjeshtë: Ndihma që Allahu u ofron adhuruesve të sinqertë e njësuesve të bindur, dëshmon se ata janë në rrugë të drejtë.

Në shumë histori të profetëve me popujt e tyre, Allahu i Lartësuar përmend se Ai i ka ndihmuar gjithnjë të bindurit ndaj Tij dhe ndaj profetëve dhe i ka shkatërruar idhujtarët. Pastaj, në fund të këtyre historive, Allahu i Lartësuar na udhëzon që të përdorim logjikën, duke thënë, për shembull: "Vërtet, në të gjitha këto histori ka argumente bindëse". Për çfarë? Në këto ngjarje ka fakte e argumente për të mençurit, që ata të kuptojnë se njësimi i Allahut me adhurim është e vetmja mundësi shpëtimi e suksesi në të dyja jetët. Ndërsa braktisja e teuhidit, nga ana tjetër, është rruga e shkatërrimit, ndëshkimit dhe dëshpërimit. Ky është një argument logjik shumë i fortë, që përforcon atë të vërtetë të madhe e të pamohueshme.

Allahu i Lartësuar ka bërë shumë mënyra të tilla argumentimi në Kur'ân, me qëllim që ne të meditojmë. Argumentet e Tij janë të qarta e të kuptueshme, në mënyrë që askush të mos ketë ndonjë lloj justifikimi. Allahut i takon lavdia, mirënjohja dhe falënderimi!

- "Feja e pranueshme tek Allahu është Islami." - Allahu i Lartësuar, pasi argumentoi bindshëm se vetëm Ai është Zoti që meriton të adhurohet me dashuri, madhërim, përkushtim, nënshtrim e bindje, vijon që të sqarojë fenë, domethënë ligjin dhe mënyrën e adhurimit që Ai pëlqen dhe e ka përzgjedhur për njerëzimin. Ai na tregon se feja, me anë të së cilës njerëzit duhet të adhurojnë Atë, është Islami.

Islami është: dorëzim, përkushtim dhe nënshtrim ndaj Zotit të vetëm. Islam do të thotë që t'i dorëzohesh një Zoti të vetëm, duke e adhuruar me dashuri dhe me bindje, ashtu sikurse të është shtjelluar prej Profetit të Zotit. Islam do të thotë të zbatosh gjithçka që Zoti e ka sqaruar në Librin e Tij ose nëpërmjet Profetit dhe traditës së tij.

Islami është feja e vetme e pranuar nga Zoti i gjithësisë. Kjo fe ndërtohet mbi bazën e sinqeritetit ndaj Zotit në dashurinë ndaj Tij, frikërespektin për Të, në shpresën, pendimin dhe lutjet e shprehura Atij. Islami mbështetet, gjithashtu, mbi sinqeritetin në pasimin e traditës dhe udhëzimit të sjellë prej Profetit të Zotit. Ky është thelbi i fesë së vetme, që e kanë sjellë të gjithë profetët. Të gjithë kanë ftuar për sinqeritet në adhurimin e Allahut, dhe që ky adhurim të jetë sipas mësimeve dhe udhëzimeve të Tij.

Megjithatë, ithtarët e Librit filluan të kishin kundërshtime mes njëri tjetrit, për shkak të urrejtjes dhe smirës së tyre.

- "Ata të cilëve u është dhënë Libri kundërshtuan veçse pasi u erdhi e vërteta, të nxitur nga zilia mes tyre." - Urrejtja dhe smira e tyre shkaktoi padrejtësi dhe armiqësi mes njëri-tjetrit, edhe pse Allahu i kishte urdhëruar që të bashkoheshin të gjithë në fenë e Tij. Shkak i kësaj fatkeqësie ishin ata vetë, sepse refuzuan të vërtetën që u erdhi prej Zotit, e cila është mundësia e vetme e shpëtimit dhe mëshirimit. Ata e refuzuan Muhamedin (s.a.u.s.) dhe Kur'ânin, dhe kjo ndodhi prej mosbindjes së tyre.

- "E kush mohon argumentet e Allahut, le ta dijë se Allahu është i shpejtë në llogarinë e Tij." - Allahu është Llogaritës i shpejtë i veprave të robit dhe Gjykues i drejtë. Allahu do t'i japë secilit atë që i takon dhe që e ka fituar me duart e veta. Në mënyrë të veçantë do të trajtohen ata që nuk e kanë pranuar të vërtetën, pasi e kanë njohur në fillim; këta lloj njerëzish meritojnë dënim të dhimbshëm.

Më pas, Allahu i Lartësuar e urdhëron Profetin e Tij që, kur të diskutonte e

polemizonte me të krishterët apo me të tjerë si ata, t'u deklaronte atyre hapur Islamin:

- "E nëse ata polemizojnë me ty, ti thuaju: "Unë, me tërë qenien time, i jam dorëzuar Allahut; e po kështu edhe pasuesit e mi!" – Kuptimi: "Thuaju atyre se unë dhe ata që ndjekin rrugën time, i jemi dorëzuar plotësisht dhe vetëm Allahut të Lartësuar. Ne kemi braktisur çdo fe tjetër, veç Islamit, sepse jemi të sigurt për kotësinë e tyre." Kjo deklaratë ua pret shpresat atyre që duan që ju të lini fenë Islame dhe të përqafoni fetë e tyre të humbura. Ajo shërben, gjithashtu, si rifreskim i besimit tuaj në momente lëkundjesh. Ajo hedh poshtë justifikimet e çdokujt që ndjek rrugët e gabuara për të adhuruar Allahun e Lartësuar.

Dikush mund të pyesë: Pse kjo deklaratë hedh poshtë justifikimet e çdokujt që ndjek rrugët e humbjes?

Për t'u përgjigjur, duhet të kujtojmë ato që kemi thënë më sipër. Allahu i Lartësuar e argumentoi vërtetësinë e njëshmërisë së Tij në meritën për adhurim me dëshminë e dijetarëve, e cila është argument për të gjitha krijesat. Pas qartësimit të së vërtetës, askush nuk mund të justifikohet para Allahut, nëse nuk i dorëzohet plotësisht Atij. Po ashtu, është e padiskutueshme që më i miri, më i dalluari dhe më i dituri i krijesave rreth Allahut të Lartësuar, ishte dhe mbetet Profeti ynë, Muhamedi (s.a.u.s.). Pas tij, më të ditur ishin sahabët që e pasuan atë, të cilët kishin grada të ndryshme dijeje. Në përgjithësi, mendjet e tyre ishin të ndritura dhe dija e tyre ishte e saktë, e sigurt dhe e padiskutueshme. Askush nuk mund t'u afrohet atyre në këto aspekte, e jo më që të jetë i barabartë me ta.

Kështu, meqë njëshmëria e Allahut në meritën e adhurimit është vërtetuar me aq shumë argumente logjike dhe tradicionale, që i përmendëm më sipër, dhe meqë ajo është shpjeguar nga më i dituri dhe më i përsosuri i krijesave, atëherë ajo nuk ka më vend për as më të voglin dyshim në saktësinë e saj. Kjo do të thotë se feja e vetme e pranuar nga Allahu i Lartësuar është feja që ushtroi dhe predikoi ky Profet i ditur dhe umeti i tij. Çdo fe tjetër është e kotë, e papranueshme dhe e pajustifikueshme nga Allahu i Lartësuar.

Më tej, i Lartësuari thotë:

- "Thuaju atyre që u është dhënë Libri dhe injorantëve: "A e pranoni fenë Islame?" – Pra, Allahu i Lartësuar na udhëzon që t'u drejohemi atyre që u është dhënë Libri (të krishterëve dhe çifutëve) dhe të paditurve, paganëve, idhujtarëve, arabë e joarabë, dhe t'u themi: "Dorëzohuni dhe nënshtrohuni ndaj një Zoti të vetëm, duke e adhuruar me dashuri, madhërim, përkushtim, nënshtrim e bindje!"

- "Nëse e pranojnë Islamin, atëherë e kanë gjetur të vërtetën, e nëse refuzojnë, ti ke për detyrë vetëm kumtimin." – Kuptimi: Nëse ata pranojnë që të adhurojnë dhe t'i nënshtrohen një Zoti të vetëm, atëherë ata janë udhëzuar tek e vërteta. Kështu, ata kanë gjetur rrugën e drejtë, ashtu sikurse ju, dhe janë bërë vëllezërit tuaj, duke patur përgjegjësi dhe të drejta të njëjta me ju.

Por nëse ata refuzojnë që ta pranojnë Islamin, dhe ndjekin fe të tjera veç tij, atëherë dije (o Pejgamber) se detyra jote është, thjesht, kumtimi i mesazhit të Zotit në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme. Nëse e kryen këtë detyrë, ti do ta marrësh shpërblimin tënd.

Askush nuk mund të justifikohet para Zotit, nëse nuk pason rrugën tënde (o Pejgamber). Pas qartësimit të së vërtetës, shpagimi i drejtë i Zotit është i pashmangshëm mbi të padrejtët. Prandaj Allahu i Lartësuar thotë:

- "Allahu i vështron me imtësi krijesat." – Që do të thotë se Ai tashmë e ka përgatitur shpagimin, me drejtësinë e Tij absolute.

Ajetet 21 – 22

21. Ata të cilët i mohojnë argumentet e Allahut, vrasin profetët pa të drejtë, vrasin edhe njerëzit që kështillojnë për të drejtën, ata lajmëroji për një ndëshkim të dhembshëm e pikëllues.
22. Ata i kanë asgjësuar veprat e tyre në këtë botë dhe në botën tjetër. Ata nuk kanë për të patur ndonjë mbrojtës.

Shpjegimi i ajeteve

- "Ata të cilët i mohojnë argumentet e Allahut..." - Këta njerëz kanë kryer krimin më të madh dhe më të shëmtuar. Ata mohojnë argumentet e pakundërshtueshme të Zotit, të cilat tregojnë të vërtetën e sigurt. Kështu, ata dëshmojnë se janë në gradën më të çmendur të mohimit, kokëfortësisë dhe arrogancës.

- "...vrasin profetët pa të drejtë" - Ata kanë vrarë profetët e Zotit, të cilët janë krijesat që duhen dashur, respektuar dhe pasuar më shumë, pas Allahut.

E drejta e profetëve është e drejta më e rëndësishme pas së drejtës së Zotit. Allahu i Lartësuar e ka bërë të detyrueshme për krijesat bindjen ndaj profetëve të dërguar mes tyre. Krijesat e kanë detyrë që t'i besojnë ata plotësisht, t'i mbështesin dhe ndihmojnë ata në misionin e tyre, t'i respektojnë dhe t'i duan më shumë se çdo njeri tjetër në këtë botë.

Ndërsa këta kriminelë bënë të kundërtën e asaj për të cilën ishin urdhëruar:

- "...vrasin edhe njerëzit që kështillojnë për të drejtën, ata lajmëroji për një ndëshkim të dhembshëm e pikëllues." - Ata vrasin edhe njerëzit që udhëzojnë për vepra të mira dhe ndalojnë nga të këqijat. Ata vrasin bamirësit ndaj krijesave dhe këshilluesit për mirë. Bamirësisë së tyre ata iu përgjigjen me krimin më të ulët.

Prandaj, për shkak të atij krimi të ulët, ata meritojnë ndëshkimin më të dhembshëm. Ndëshkimi i tyre nuk mund të tregohet apo përshkruhet me fjalë. Ai do përfshijë trupat e tyre, zemrat e tyre dhe shpirtrat e tyre.

Për shkak të krimeve të shëmtuara, veprat e tyre do të fshihen dhe asgjësohen:

- "Ata i kanë asgjësuar veprat e tyre në këtë botë dhe në botën tjetër. Ata nuk kanë për të patur ndonjë mbrojtës." – Atyre nuk do t'u bëjë dobi asnjë vepër, sepse gjithçka iu është asgjësuar nga krimet e tyre të shëmtuara. Akush nuk do t'i ndihmojë ata që t'i shpëtojnë dënimit apo që t'iu lehtësohet ai. Kështu, ata do të humbin çdo fije shprese për ndonjë të mirë dhe shpëtim, por do të jenë të zhytur pa shpresë në mes të së keqes dhe dëshpërimit.


Këto janë cilësi të çifutëve dhe pasuesve të tyre. Allahu i shëmtoftë dhe i ndëshkoftë ata! Sa të poshtër janë treguar ndaj Allahut, profetëve të Tij dhe ndaj atyre që udhëzojnë njerëzit në rrugën e drejtë!

Ajetet 23 – 25

23. A nuk i sheh ti ata, të cilëve u është dhënë mjaft nga Libri, e të cilët, kur thirren që ndërmjet tyre të gjykojë Libri i Allahut, një grup prej tyre prapësohet?! Ata janë refuzues.
24. Këtë e bëjnë, ngase thonë: "Ne nuk do të na djegë Zjarri, përveçse disa ditë." Shpifja që bënë i ka mashtruar keq për fenë e tyre.
25. E si do të jetë gjendja e tyre, kur t'i tubojmë një ditë, për të cilën nuk ka dyshim dhe kur çdo njeriu do t'i jepet ajo që ka fituar, duke mos iu bërë asnjë e padrejtë.

Shpjegimi i ajeteve

- "A nuk i sheh ti ata, të cilëve u është dhënë mjaft nga Libri, e të cilët, kur thirren që ndërmjet tyre të gjykojë Libri i Allahut, një grup prej tyre prapësohet?! Ata janë refuzues." - Në këto ajete Allahu i Lartësuar përshkruan disa cilësi të atyre që i begatoi fillimisht, duke u dhuruar libër hyjnor. Për


الجزء الثالث سورة آل عمران

أَلَمْ تَرَ إِلَى الَّذِينَ أُوتُوا نَصِيبًا مِّنَ الْكِتَابِ يُدْعَوْنَ إِلَىٰ كِتَابِ
اللَّهِ لِيَحْكُمَ بَيْنَهُمْ ثُمَّ يَتَوَلَّىٰ فَرِيقٌ مِّنْهُمْ وَهُم مُّعْرِضُونَ ﴿٢٣﴾
ذَٰلِكَ بِأَنَّهُمْ قَالُوا لَن تَمَسَّنَا النَّارُ إِلَّا أَيَّامًا مَّعْدُودَاتٍ ۖ
وَغَرَّهُمْ فِي دِينِهِم مَّا كَانُوا يَفْتَرُونَ ﴿٢٤﴾ فَكَيْفَ إِذَا جَمَعْنَاهُمْ
لِيَوْمٍ لَّا رَيْبَ فِيهِ وَوُفِّيَتْ كُلُّ نَفْسٍ مَّا كَسَبَتْ وَهُمْ
لَا يُظْلَمُونَ ﴿٢٥﴾ قُلِ اللَّهُمَّ مَالِكَ الْمُلْكِ تُؤْتِي الْمُلْكَ مَن
تَشَاءُ وَتَنزِعُ الْمُلْكَ مِمَّن تَشَاءُ وَتُعِزُّ مَن تَشَاءُ وَتُذِلُّ مَن
تَشَاءُ ۖ بِيَدِكَ الْخَيْرُ ۖ إِنَّكَ عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ ﴿٢٦﴾ تُولِجُ اللَّيْلَ
فِي النَّهَارِ وَتُولِجُ النَّهَارَ فِي اللَّيْلِ ۖ وَتُخْرِجُ الْحَيَّ مِنَ الْمَيِّتِ
وَتُخْرِجُ الْمَيِّتَ مِنَ الْحَيِّ ۖ وَتَرْزُقُ مَن تَشَاءُ بِغَيْرِ حِسَابٍ ﴿٢٧﴾
لَّا يَتَّخِذِ الْمُؤْمِنُونَ الْكَافِرِينَ أَوْلِيَاءَ مِن دُونِ الْمُؤْمِنِينَ ۖ
وَمَن يَفْعَلْ ذَٰلِكَ فَلَيْسَ مِنَ اللَّهِ فِي شَيْءٍ إِلَّا أَن تَتَّقُوا مِنْهُمْ
تُقَاةً ۗ وَيُحَذِّرُكُمُ اللَّهُ نَفْسَهُ ۗ وَإِلَى اللَّهِ الْمَصِيرُ ﴿٢٨﴾ قُلْ
إِن تُخْفُوا مَا فِي صُدُورِكُمْ أَوْ تُبْدُوهُ يَعْلَمْهُ اللَّهُ ۗ وَيَعْلَمُ
مَا فِي السَّمَاوَاتِ وَمَا فِي الْأَرْضِ ۗ وَاللَّهُ عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ ﴿٢٩﴾
٥٣

këtë mirësi të mrekullueshme ndaj tyre, ata duhej të tregoheshin mirënjohës, duke qenë të parët që do t'i besonin dhe që do të punonin me të. Ata duhej të ishin të parët që duhej të nxitonin t'i nënshtroheshin dhe t'i përkushtoheshin zbatimit të ligjeve dhe dispozitave të shpallura prej Zotit.

Allahu i Lartësuar na tregon se, kur ata ftohen që të gjykojnë dhe të zbatojnë gjykimin e Zotit, të sjellë në Librin e Tij, një grup prej tyre kthen shpinën dhe refuzojnë t'i nënshtrohen zbatimit të tij. Me trup, ata kthyen shpinën, ndërsa zemrat e tyre kundërshtuan urdhrin. Ky përshkrim është shumë i rëndë për ta. Ai është edhe një vërejtje për ne, që kurrë të mos veprojmë sikurse ata të mjerë, në mënyrë që të mos na godasë ndëshkimi që goditi edhe ata.

Përkundrazi, është e detyrueshme për këdo që ftohet të gjykojë me Librin e Allahut, që të dëgjojë me kujdes, të bindet dhe të nënshtrohet. Thotë Allahu i Lartësuar: "Kur thirren besimtarët për gjykim ndërmjet tyre tek Allahu dhe tek i Dërguari i Tij, e vetmja fjalë e tyre duhet të jetë: "Dëgjuam dhe u bindëm!" Të tillët janë të shpëtuarit. Kush respekton Allahun dhe të Dërguarin e Tij, që ia ka frikën Allahut dhe i përmbahet udhëzimit të Tij, të tillët do ta arrijnë atë që dëshirojnë." [Nur 51-52].

Është një shkak i caktuar që i bëri ithtarët e Librit që të shpërfillnin ligjin e Zotit dhe të zhyteshin në krime e mosbindje. Ky ishte një mendim i gabuar dhe i pabazë nga ana e tyre, që Allahu i Lartësuar e shpjegon:

- "Këtë e bëjnë, ngase thonë: "Ne nuk do të na djegë Zjarri, përveçse disa ditë." Shpifja që bënë i ka mashtruar keq për fenë e tyre". - Ata e trilluan vetë këtë pretendim të tyre dhe tashmë e konsiderojnë si të vërtetë të pamohueshme. Madje, ata punojnë duke u mbështetur në këtë supozim të pabazë. Atyre nuk u ka bërë dobi asnjë këshillë dhe kërcënim prej Zotit. Përkundrazi, të dehur nga një ëndërr e pabazë, ata janë zhytur në poshtërsi dhe harame. Ata kanë mashtruar veten se do të hyjnë në Xhenet, dhe e marrin këtë si një fakt të kryer. Por ky është veçse një mashtrim, që nuk ka asnjë bazë të besueshme dhe të sigurt. Përfundimi i të tillëve është i tmerrshëm:

- "E si do të jetë gjendja e tyre, kur t'i tubojmë një ditë, për të cilën nuk ka dyshim dhe kur çdo njeriu do t'i jepet ajo që ka fituar, duke mos iu bërë asnjë e padrejtë." – Kuptimi: Si do të jetë gjendja e këtyre të vetëmashtruarve atë ditë të tmerrshme?! Sa e frikshme do të jetë përballja me tmerrin e asaj dite të vështirë! Gjendja e tyre atë ditë është e paimagjinueshme për ne sot.

E tillë do të jetë gjendja e këtyre mashtruesve të vetes dhe e të tjerëve, sepse ajo është dita e shpagimit me drejtësi për çdo vepër të paraqitur. Atë ditë nuk do t'i mohohet askujt shpërblimi dhe e drejta e vet. Në varësi të punëve, do të jetë edhe shpërblimi i merituar. Prandaj, nëse sheh veprat e këtyre fatzinjve, e kupton se ata do

të jenë njerëzit që do të kalojnë ndëshkimin më të ashpër dhe më të dhembshëm.

Ajetet 26 – 27

26. Thuaj: "O Allah! O Sundues i gjithçkaje! Ti ia jep pushtetin atij që do, dhe ia heq pushtetin atij që do! Ti e lartëson atë që do, dhe e poshtëron atë që do! Vetëm në dorën Tënde është çdo e mirë! Vërtet, Ti je i Fuqishëm për gjithçka!"
27. Ti e fut natën në ditë dhe e fut ditën në natë. Ti nxjerr nga i vdekuri të gjallin dhe nga i gjalli të vdekurin! Ti e begaton pa masë atë që do!

Shpjegimi i ajeteve

- "Thuaj: "O Allah! O Sundues i gjithçkaje!" – Këtu, Profeti udhëzohet se si t'i drejtohet Allahut të Madhërishëm. Pra, thuaj: "O Zoti im, Ti je pronari i çdo pasurie! Ti je Sunduesi i Plotpushtetshëm! Në dorën Tënde është gjithçka! Gjithçka është pronë e të Madhërishmit! Pushteti suprem të përket vetëm Ty! Çdo gjë është pasuri e Jotja dhe vetëm e Jotja! Askush tjetër nuk vepron dhe nuk rregullon çështjet e krijesave, veç Teje. Asgjë nuk lëviz në gjithësi pa lejen Tënde të bazuar në urtësi dhe mëshirë!"

Pastaj përmenden disa vepra dhe gjykime që i përkasin vetëm Zotit të botëve:

- "Ti ia jep pushtetin atij që do, dhe ia heq pushtetin atij që do!" - Ky ajet është tregues se Allahu i Lartësuar do t'ia heqë pushtetin çdo tirani zullumqar dhe do t'ia dhurojë atë popullit që ndjek Muhamedin (s.a.u.s.) dhe udhëzimin që ai solli prej Zotit të tij. Dhe, vërtet, Ai e bëri diçka të tillë.

Marrja e pushtetit varet plotësisht nga vullneti i Allahut të Madhëruar. Por kjo nuk do të thotë që faktorët e forcimit dhe të mbajtjes së pushtetit, që Zoti i ka përcaktuar si të tillë, të jenë të pavlefshëm. Marrja dhe humbja e pushtetit varet nga disa shkaqe, që zakonisht e bëjnë të mundur një gjë të tillë. Në varësi të plotësimit të këtyre shkaqeve, që Zoti i ka lejuar të jenë të tilla, merret apo hiqet pushteti. Një gjë është e sigurt: asgjë në gjithësi, qoftë ajo shkak apo pasojë, nuk ndodh jashtë vullnetit suprem të Allahut. Është Ai që ka përcaktuar gjithçka me ekuilibër, i bazuar në dijen dhe drejtësinë e Tij. Asnjë shkak nuk mund të sjellë pasoja, nëse i Dituri e i Urti nuk e lejon një gjë të tillë.

Disa nga shkaqet që Allahu i Lartësuar i ka përcaktuar si të tilla për të fituar pushtetin dhe sundimin në tokë, janë:
1. Besimi dhe veprat e mira. Besimi i pastër, i vërtetë, i bazuar në dije të saktë nga Zoti, dhe veprat e mira të bazuara në këtë dije dhe besim të saktë, janë shkaqe vendimtare që sjellin afrimin, vëllazërimin dhe unifikimin e radhëve të muslimanëve.
2. Përpjekja maksimale dhe pajisja me njohuritë dhe mjetet e nevojshme për arritjen e pushtetit. Pra, marrja e masave me të gjitha fuqitë mendore, fizike e shpirtërore.
3. Durimi, me të gjitha format e tij, dhe mospërçarja e radhëve të besimtarëve.

Thotë Allahu i Lartësuar: "Atyre nga mesi juaj të cilët kanë besuar dhe bëjnë vepra të mira, Allahu u premton se do t'i bëjë zotërues në atë tokë, ashtu siç ka bërë zotërues ata që ishin para tyre. Edhe fenë të cilën Ai e pëlqeu për ta, Ai do ta forcojë, e në vend të frikës, Ai do t'u dhurojë siguri. Ata më adhurojnë Mua e nuk më shoqërojnë asgjë. Ndërsa ata që mohojnë edhe pas kësaj, ata janë më të prishurit. Faleni namazin, jepeni zekatin dhe bindjuni të Dërguarit, që të mëshiroheni." [Nur 55, 56]. Pra, besimi dhe veprat e mira janë faktorë shumë të fuqishëm të marrjes së pushtetit.

I Madhërishmi thotë gjithashtu: "O ju që keni besuar! Kur të përballeni me ndonjë grup, përqendrohuni dhe përmendeni vazhdimisht Allahun, që ta arrini fitoren e dëshiruar. Bindjuni Allahut e të Dërguarit të Tij, e mos u përçani mes njëri-tjetrit që të dobësoheni e ta humbni fuqinë tuaj. Jini të durueshëm, se Allahu është me durimtarët".

[Enfal 45. 46]. Siç shihet, Allahu i Madhëruar na tregon se afrimi mes zemrave të besimtarëve, qëndrueshmëria e tyre në rrugën e drejtë, mospërçarja dhe bashkimi i tyre si një trup i vetëm, janë faktorë që sjellin fitoren mbi armiqtë e tyre.

Nëse studion mbretëritë e muslimanëve, do të shohësh se shkaku i dobësimit dhe i rrëzimit të tyre ka qenë gjithnjë largimi nga feja e Zotit. Largimi nga besimi dhe nga veprat e mira ka sjellë përçarjen dhe armiqësinë e muslimanëve mes njëri-tjetrit, gjë të cilën e synojnë aq shumë armiqtë e Islamit.

- "Ti e lartëson atë që do, dhe e poshtëron atë që do!" - Ti, o Zot, lartëson e nderon atë që Ti do, duke i dhënë sukses që të besojë të vërtetën dhe t'i nënshtrohet me bindje asaj! O Zot, me drejtësinë dhe urtësinë Tënde, Ti poshtëron atë që do, për shkak të poshtërsive dhe mosbindjes ndaj Teje!

- "Vetëm në dorën Tënde është çdo e mirë! Vërtet, Ti je i Fuqishëm për gjithçka!" - Asgjë nuk del jashtë pushtetit Tënd! Çdo gjë i nënshtrohet pushtetit dhe dëshirës së Tij, duke u bazuar mbi drejtësinë, urtësinë dhe mëshirën e Tij.

- "Ti e fut natën në ditë dhe e fut ditën në natë." - Në këtë mënyrë kalojnë ditët dhe vitet. Herë zvogëlohet nata e herë dita, dhe kështu krijohen stinët, errësira, drita, lëvizja, aktiviteti, pushimi dhe qetësia. Këto janë ndër argumentet më të mëdha, që vërtetojnë dhe tregojnë për pushtetin madhështor të Allahut të Lartësuar, bashkë me urtësinë dhe mëshirën e Tij.

- "Ti nxjerr nga i vdekuri të gjallin dhe nga i gjalli të vdekurin!" - Ai nxjerr të gjallin prej të vdekurit, si për shembull, kur nxjerr zogun prej vezës, pemën e madhe plot fruta prej një fare të vogël, bimët prej filizave etj. Ai nxjerr gjithashtu, të vdekurin nga i gjalli, si për shembull, kur nxjerr vezën nga zogu, farën nga pema, kokrrat nga bimët, mohuesin nga besimtari.

Këto janë shenja shumë të mëdha për pushtetin absolut të Allahut. Çdo gjë tjetër është e nënshtruar ndaj pushtetit dhe përcaktimit të Allahut të Lartësuar. Krijesat nuk kanë asnjë lloj pushteti dhe mundësie. Allahu i Lartësuar i ka bërë krijesat në çifte. Kjo tregon që çdo krijesë mposhtet shpesh nga e kundërta e saj, duke iu nënshtruar ligjit gjithëpërfshirës të të Plotpushtetshmit, që rregullon forcat e të kundërtave.

- "Ti e begaton pa masë atë që do!" – Allahu e furnizon me bollëk atë që Ai dëshiron. Ai furnizon me një mënyrë që krijesës nuk i shkon mendja dhe, ndonjëherë, pa qenë e nevojshme që krijesa të lodhet shumë për ta mbledhur dhe fituar atë bollëk.

Ajeti 28

28. Besimtarët nuk duhet t'i miqësojnë kurrë jobesimtarët, e të lënë anash besimtarët. Kush e bën këtë, ai nuk ka asgjë nga feja e Allahut, veç nëse është për qëllim ruajtja prej të keqes së tyre. Allahu ju paralajmëron që të ruheni prej Tij, sepse vetëm tek Allahu do të ktheheni.

Shpjegimi i ajetit

- "Besimtarët nuk duhet t'i miqësojnë kurrë jobesimtarët, e të lënë anash besimtarët." - Allahu i Lartësuar i ndalon rreptësisht besimtarët që të miqësohen dhe të bëhen palë me qafirët, duke u dhënë atyre dashuri, ndihmë dhe mbështetje kundër besimtarëve, për çfarëdolloj çështjeje. Madje, Allahu i Lartësuar ka bërë një kërcënim të hapur për cilindo që vepron ashtu, duke thënë:

- "Kush e bën këtë, ai nuk ka asgjë nga feja e Allahut" – Domethënë që, kush vepron ashtu, i ka ndërprerë marrëdhëniet me Allahun e Lartësuar. Njerëz të tillë nuk kanë pjesë në fenë e Zotit, sepse miqësia dhe

bashkëpunimi me qafirët kundër besimtarëve janë vepra që nuk përputhen kurrë me imanin; ato nuk bashkohen kurrë me imanin në të njëjtën zemër.

Imani e udhëzon besimtarin që të dojë më shumë Allahun dhe që të miqësohet e të ndihmojë të dashurit e Allahut, pra, besimtarët e sinqertë. Imani e udhëzon muslimanin që të dojë, të miqësojë e të ndihmojë besimtarët e drejtë, të cilët bashkëpunojnë që feja Islame të ngadhënjejë. Imani urdhëron që t'i duash dhe t'i ndihmosh besimtarët që luftojnë në rrugën e Allahut, kundër armiqve të Tij, dhe nuk të urdhëron të duash dhe të miqësohesh me armiqtë e Allahut dhe të besimtarëve. Kështu, Allahu i Lartësuar thotë: "Besimtarët dhe besimtaret janë miq të dashur me njëri-tjetrin. Ata urdhërojnë për të mirë, ndalojnë nga e keqja, falin namazin, japin zekatin, i binden Allahut dhe të Dërguarit të Tij. Të tillët do të mëshirohen nga Allahu. Allahu është Ngadhënjyes, i Urtë". [Teube, 71].

Ndërsa ata që miqësohen me qafirët dhe i ndihmojnë ata kundër muslimanëve, duke bashkëpunuar me ata që duan ta shuajnë dritën e Allahut, që duan të devijojnë dhe të sprovojnë të dashurit e Zotit, ata janë jashtë grupit të besimtarëve. Kështu, ata janë bërë palë me qafirët. I Lartësuari: "O ju që keni besuar! Mos zini miq as çifutët e as të krishterët. Ata janë miq të njëri-tjetrit. Ai njeri prej jush që miqësohet me ata, ai është prej tyre. Vërtet, Allahu nuk e udhëzon në rrugë të drejtë një popull të padrejtë". [Maide 51].

Ky ajet urdhëron që të largohemi nga qafirët dhe të mos përzihemi dhe miqësohemi me ta. Nuk duhet kurrsesi që të mbështetemi sadopak tek ata dhe të kërkojmë ndihmën e tyre. Nuk lejohet, gjithashtu, që të lihet në gjykimin e qafirit ndonjë çështje që ka të bëjë me muslimanët. Nuk lejohet të kërkohet ndihmë e mbështetje tek ata për çështje që kanë të bëjnë me sigurinë dhe dobinë në përgjithësi të muslimanëve. Pastaj i Lartësuari thotë:

- "...veç nëse është për qëllim ruajtja prej të keqes së tyre." - Përjashtim nga gjykimi i mësipërm bëjnë vetëm rastet e jashtëzakonshme, kur kërcënohet jeta e muslimanëve. Kështu, nëse keni frikë për jetën tuaj, atëherë ju lejohet që të bëni diçka për t'u mbrojtur. Por kjo "diçka" që lejohet është e sqaruar dhe me kriter. Për shembull, në të tilla raste lejohet fshehja e besimit, por duhet pasur kujdes që të mos teprohet në përzierjet me ta. Gjithashtu, nuk është e nevojshme që të shfaqim kufër dhe miratim të tyre, në kësi rastesh. [14]

---

[14] Në një kopje tjetër të këtij libri, shejh Sadi shkruan në futnotë për këtë çështje: "Në librin e tij "*Minhaxh Sunetin-Nebeuijeh*", shejhu i Islamit Ibn Tejmije thotë: "Për sa i përket fjalës së Allahut të Lartësuar: "...veç nëse është për qëllim ruajtja prej të keqes së tyre.", Muxhahidi ka thënë: "Kjo nuk do të thotë që, duke u shtirur, të pajtohesh dhe të përzihesh plotëisht me ta. Kjo nuk do të thotë që të thuash me fjalë atë që nuk e ke në zemrën tënde, sepse një gjë e tillë quhet shtirje ose hipokrizi. Përkundrazi, ti duhet të bësh maksimumin për ndryshimin e së keqes dhe për të luftuar kufrin, sikurse ka thënë Profeti (a.s.) në një hadith të saktë: "Kushdo prej jush që shikon ndonjë të keqe, le ta ndryshojë atë me dorën e tij; nëse nuk mundet, le ta ndryshojë atë me fjalë, dhe nëse as për këtë nuk mundet, le ta ndryshojë atë të keqe me zemrën e tij".

Kështu, nëse një musliman jeton dhe gjendet mes qafirëve, nuk e ka për detyrë dhe nuk i takon që t'i luftojë ata me dorën e tij, pra, me forcë. Por, nëse mundet, le ta ndryshojë këtë të keqe me fjalë, duke i sqaruar të vërtetën me argumente bindëse. Por nëse as për këtë nuk ka mundësi, atëherë le ta ndryshojë të keqen me zemrën e tij, domethënë, duke e urryer dhe duke u distancuar prej saj.

Në këtë proces, ai nuk duhet të mashtrojë e të shtiret duke thënë me gojë gjëra që nuk ia beson zemra e tij. Ai ka vetëm dy zgjidhje: ose ta shfaqë hapur fenë e tij, ose ta fshehë atë, por kurrsesi të mos i miratojë ata për fenë e tyre. E shumta që mund t'i lejohet këtij njeriu është ajo që bënin besimtari dhe gruaja e Faraonit në shtëpinë e këtij të fundit. Ata të dy nuk i miratonin veprat e tyre (jobesimtarëve), kur ishte fjala për çështjet e besimit të tyre. Ata, gjithashtu, nuk shprehnin me vepra dhe as me fjalë atë gjë që nuk e kishin në zemër. Ata thjesht e fshihnin besimin e tyre. Fshehja e besimit është diçka, dhe shfaqja e kufrit ose miratimi i fesë së të humburve është diçka tjetër. Shfaqja ose miratimi i ndonjë feje të kotë nuk është i lejuar, përveç ndonjë rasti të

- "Allahu ju paralajmëron që të ruheni prej Tij" - Allahu ju kërcënon me madhështinë e Tij, prandaj mos lejoni që të meritoni zemërimin e Tij duke mos iu bindur dhe duke kryer poshtërsi, sepse këto gjëra e bëjnë të merituesshëm për ju ndëshkimin nga i Drejti dhe i Urti.

- "...sepse vetëm tek Allahu do të ktheheni." - Krijesat do të kthehen tek Allahu Ditën e Llogarisë. Ai i ka shënuar veprat e tyre, të cilat Ai do t'ua llogarisë me drejtësi dhe po me drejtësi do t'i shpërblejë ata.

Kujdes, pra, nga veprat e shëmtuara, që të mos ju godasë ndëshkimi i të Drejtit e të Urtit. Përpiquni maksimalisht për veprat që sjellin shpërblimin dhe kënaqësinë e Zotit tuaj.

Ajetet 29 – 30

29. Thuaj: "Edhe nëse e fshihni atë që keni në zemrat tuaja, edhe nëse e publikoni, Allahu e di atë, Ai di çfarë ka në qiej dhe çfarë ka në tokë. Allahu është i Plotfuqishëm për çdo gjë.
30. Atë ditë, çdo njeri do të gjejë pranë vetes ato vepra të mira që vetë ka bërë. Ndërsa për të këqijat që ka bërë, do të dëshirojë që, në mes tij dhe tyre, të jetë një distancë shumë e madhe. Allahu ju paralajmëron me dënimin që vjen prej Tij. Por Allahu është shumë i Mëshirshëm ndaj robërve.

Shpjegimi i ajeteve

- "Thuaj: "Edhe nëse e fshihni atë që keni në zemrat tuaja, edhe nëse e publikoni, Allahu e di atë, Ai di çfarë ka në qiej dhe çfarë ka në tokë. Allahu është i Plotfuqishëm për çdo gjë." - Këtu, Allahu i Lartësuar na tregon për dijen e Tij të gjerë dhe absolute. Ai di në hollësi gjithçka që ndodh, qoftë brenda shpirtit tonë, qoftë në hapësirën e madhe të gjithësisë që Ai ka krijuar dhe përsosur. Allahu na tregon edhe për pushtetin e Tij absolut mbi gjithçka që ka krijuar dhe që e njeh në hollësi. Sigurisht që të tilla cilësi të të Madhëruarit na nxisin për vepra të mira.

Nga ky ajet nxjerrim shumë mësime e dobi. Ai na nxit që ta pastrojmë zemrën tonë nga çdo cilësi dhe mendim i keq, sepse duke përkujtuar vazhdimisht dijen dhe mbikëqyrjen absolute të Allahut të Lartësuar mbi të, me siguri që do të ndiesh turp nëse Ai do të shohë në zemrën tënde mendime e ndjenja të shëmtuara. Një njeri që e ndien mbikëqyrjen e Allahut do t'i ketë edhe mendimet e tij për të fituar kënaqësinë e të Adhuruarit të tij. Zemra e tij do të jetë gjithnjë duke meditуar mbi Librin e Allahut të Lartësuar ose për Traditën e Profetit (s.a.u.s.). Ajo do të jetë gjithnjë e angazhuar që të përfitojë çdo lloj dijeje të dobishme. Atë do ta shohësh gjithmonë duke përsiatur mbi krijesat e mrekullueshme të të Madhërishmit dhe mbi mirësitë e pafundme që Ai u dhuron krijesave të Tij. Atë do ta gjesh, gjithashtu, duke këshilluar njerëzit për të kryer vepra të mira e për t'u larguar nga të këqijat.

Duke përmendur cilësitë madhështore të Allahut në aspektin e dijes dhe pushtetit të Tij absolut, ky ajet na kujton se ne do të japim llogari dhe do të shpërblehemi për veprat që kryejmë, të mira apo të këqija qofshin ato. Kjo do të ndodhë Ditën e Kijametit, Ditën e Llogarisë, kur çdokush do të shpërblehet për veprat që ka bërë. Prandaj thotë i Lartësuari më tej:

- "Atë ditë, çdo njeri do të gjejë pranë vetes ato vepra të mira që vetë ka bërë." - Çdokush do ta gjejë të plotë atë të mirë që ka bërë. Në një ajet tjetër, i Lartësuari thotë: "Çdokush që bën një të mirë, sado e vogël ajo, ka për ta parë atë."

Fjala *'ħajrun'* (e mirë), e përdorur në ajet, ka një kuptim të gjerë. *Ħajrun* quhet çdo vepër që të afron tek Allahu i Lartësuar, e vogël apo e madhe qoftë ajo.

---

jashtëzakonshëm, kur të detyrojnë ose të kërcënojnë seriozisht."


Edhe *'sũun'* (e keqe) ka një kuptim të gjerë. Ajo është e kundërta e fjalës *"ħajrun"* dhe, si e tillë, ajo përfshin në kuptimin e saj çdo lloj vepre a fjale, e vogël apo e madhe qoftë, që shkakton zemërimin e Allahut.

- "Ndërsa për të këqijat që ka bërë, do të dëshirojë që, në mes tij dhe tyre, të jetë një distancë shumë e madhe." - Ai do të dëshironte që, mes tij dhe veprave të këqija, të ishte një distancë shumë e largët, sepse çdo vepër dhe fjalë e keqe do të shkaktojë dëshpërim dhe frikë të madhe atë ditë.

Për këtë arsye, njeriu duhet të jetë shumë i kujdesshëm në fjalët dhe veprat që kryen në këtë jetë, sepse prej tyre pritet dëshpërim dhe frikë e madhe Ditën e Gjykimit. Le t'u largohet atyre që në këtë jetë, sepse tani është e mundur një gjë e tillë. Le të jetë i kujdesshëm, para se të vijë dita kur, i tmerruar dhe i dëshpëruar, të thotë pastaj: "O i mjeri unë, që shpërfilla adhurimin dhe bindjen ndaj Allahut, që isha prej atyre që talleshin!"Ose të thotë: "Ah, sikur të më kishte udhëzuar Allahu e të kisha qenë prej atyre që ruheshin!" Apo, kur ta shohë dënimin, të thotë: "Sikur të isha kthyer edhe një herë e të isha bërë prej bamirësve!" Jo, ty të erdhën argumentet e Mia, por ti i mohove ato, u bëre kryeneç dhe ishe prej atyre që nuk besonin." [Zumer 56-59].

I Lartësuari thotë gjithashtu: "Si do të jetë gjendja e këtyre *(që nuk besuan)*, kur Ne të sjellim dëshmitar për çdo popull, e ty do të sjellim dëshmitar mbi këta *(që nuk të besuan)*? Atë ditë ata që nuk besuan dhe kundërshtuan të dërguarin, do të dëshironin *(të varroseshin, të mos rringjalleshin)* të rrafshohej mbi ta toka, sepse ata nuk mund t'i fshehin Allahut asgjë *(nga padrejtësitë dhe poshtërsitë e tyre)*. [Nisa 41, 42].

"Atë ditë, sundimi i vërtetë është në dorën e të Gjithëmëshirshmit. Për jobesimtarët, ajo do të jetë ditë e vështirë. Atë ditë, zullumqari do të kafshojë duart e veta dhe do të thotë: "Oh, i mjeri unë, ta kisha pasuar udhëzimin së bashku me


الجزء الثالث
سورة آل عمران
يَوْمَ تَجِدُ كُلُّ نَفْسٍ مَّا عَمِلَتْ مِنْ خَيْرٍ مُّحْضَرًا وَمَا عَمِلَتْ
مِن سُوٓءٍ تَوَدُّ لَوْ أَنَّ بَيْنَهَا وَبَيْنَهُۥٓ أَمَدًۢا بَعِيدًا ۗ وَيُحَذِّرُكُمُ ٱللَّهُ
نَفْسَهُۥ ۗ وَٱللَّهُ رَءُوفٌۢ بِٱلْعِبَادِ ﴿٣٠﴾ قُلْ إِن كُنتُمْ تُحِبُّونَ ٱللَّهَ
فَٱتَّبِعُونِى يُحْبِبْكُمُ ٱللَّهُ وَيَغْفِرْ لَكُمْ ذُنُوبَكُمْ ۗ وَٱللَّهُ غَفُورٌ
رَّحِيمٌ ﴿٣١﴾ قُلْ أَطِيعُوا۟ ٱللَّهَ وَٱلرَّسُولَ ۖ فَإِن تَوَلَّوْا۟ فَإِنَّ ٱللَّهَ لَا يُحِبُّ
ٱلْكَٰفِرِينَ ﴿٣٢﴾ ۞ إِنَّ ٱللَّهَ ٱصْطَفَىٰٓ ءَادَمَ وَنُوحًا وَءَالَ إِبْرَٰهِيمَ
وَءَالَ عِمْرَٰنَ عَلَى ٱلْعَٰلَمِينَ ﴿٣٣﴾ ذُرِّيَّةًۢ بَعْضُهَا مِنۢ بَعْضٍ ۗ وَٱللَّهُ
سَمِيعٌ عَلِيمٌ ﴿٣٤﴾ إِذْ قَالَتِ ٱمْرَأَتُ عِمْرَٰنَ رَبِّ إِنِّى نَذَرْتُ لَكَ
مَا فِى بَطْنِى مُحَرَّرًا فَتَقَبَّلْ مِنِّىٓ ۖ إِنَّكَ أَنتَ ٱلسَّمِيعُ ٱلْعَلِيمُ ﴿٣٥﴾
فَلَمَّا وَضَعَتْهَا قَالَتْ رَبِّ إِنِّى وَضَعْتُهَآ أُنثَىٰ وَٱللَّهُ أَعْلَمُ بِمَا وَضَعَتْ
وَلَيْسَ ٱلذَّكَرُ كَٱلْأُنثَىٰ ۖ وَإِنِّى سَمَّيْتُهَا مَرْيَمَ وَإِنِّىٓ أُعِيذُهَا بِكَ
وَذُرِّيَّتَهَا مِنَ ٱلشَّيْطَٰنِ ٱلرَّجِيمِ ﴿٣٦﴾ فَتَقَبَّلَهَا رَبُّهَا بِقَبُولٍ
حَسَنٍ وَأَنۢبَتَهَا نَبَاتًا حَسَنًا وَكَفَّلَهَا زَكَرِيَّا ۖ كُلَّمَا دَخَلَ عَلَيْهَا
زَكَرِيَّا ٱلْمِحْرَابَ وَجَدَ عِندَهَا رِزْقًا ۖ قَالَ يَٰمَرْيَمُ أَنَّىٰ لَكِ هَٰذَا ۖ
قَالَتْ هُوَ مِنْ عِندِ ٱللَّهِ ۖ إِنَّ ٱللَّهَ يَرْزُقُ مَن يَشَآءُ بِغَيْرِ حِسَابٍ ﴿٣٧﴾
٥٤

Profetin! O shkatërrimi im! Oh, i mjeri unë, të mos e kisha bërë filanin mik! Vërtet, ai më largoi mua prej udhëzimit, pasi ai m'u bë i njohur. Shejtani është ai që e humb njeriun dhe e lë të vetmuar." [Furkan 26-30].

"Atyre që mbyllin sytë para këshillave të Zotit i shoqërojmë nga një shejtan, që nuk u ndahet kurrë. Ata *(shejtanët)* i shmangin nga rruga e drejtë, kurse ata *(jobesimtarët)* mendojnë se janë të udhëzuar. Kur të vijë ai *(jobesimtari)* para Nesh, do të thotë: "Oh, mjerë për mua! Ah, sikur mes meje dhe teje *(shejtanit)* të ishte një largësi e madhe sa lindja nga perëndimi! Sa shok i keq je ti!" Për shkak se bënit padrejtësi, sot juve nuk do t'ju lehtësojë aspak fakti që nuk jeni të vetmit që ndëshkoheni dhe vuani." [Zuhruf 36-39].

Për Allah! Lënia e çfarëdolloj dëshire apo kënaqësie të kësaj jete është krejt e papërfillshme, në krahasim me vështirësinë që i duhet të përballë njeriu atë ditë të madhe e të frikshme. Porse njeriu, për shkak të injorancës dhe padrejtësisë së tij, vështron

veçse gjendjen e tanishme, të afërt. Ai tregohet i pakujdesshëm, mospërfillës dhe nuk denjon të mendohet thellë për të parë përfundimin e çështjeve. Nëse mendohet më gjatë, me siguri që do t'u japë rëndësi gjërave që i sigurojnë lumturinë në këtë jetë dhe në jetën tjetër. Po të tregohet më i kujdesshëm, ai do të largohet nga çdo vepër e fjalë që shkakton trishtim, dënim, frikë e ankth në këtë jetë dhe në jetën tjetër.

Më pas, Allahu i Lartësuar i rikthehet edhe një herë paralajmërimit ndaj nesh, që t'i ruhemi zemërimit të Tij, duke thënë:

- "Allahu ju paralajmëron me dënimin që vjen prej Tij. Por Allahu është shumë i mëshirshëm ndaj robërve." - Ajeti na këshillon që t'i ruhemi ndëshkimit të të Madhërishmit. Kjo tregon mëshirën dhe butësinë e Tij ndaj nesh, sepse kështu Ai na mbron që të mos të zhytemi në gjynahe aq sa të na ngurtësohen zemrat. Ai na këshillon që të ruhemi dhe të shpresojmë njëkohësisht, në mënyrë që të kryejmë vepra të mira dhe të largohemi nga të këqijat.

Në fund, e lusim Allahun e Lartësuar që të jemi të kujdesshëm dhe të druhemi vazhdimisht prej Tij, që të mos veprojmë apo flasim gjëra që sjellin pakënaqësinë dhe zemërimin e Tij!

Ajetet 31 – 32

31. Thuaj: "Nëse e doni Allahun, atëherë më pasoni mua, që Allahu t'ju dojë dhe t'ju falë mëkatet tuaja." Allahu është Falës e Mëshirues.
32. Thuaj: "Bindjuni Allahut dhe të Dërguarit!" Nëse ata refuzojnë, atëherë ta dinë se Allahu nuk i do jobesimtarët!

Shpjegimi i ajeteve

- "Thuaj: "Nëse e doni Allahun..." - Ky ajet tregon se dashuria për Allahun është detyrim. Në ajet shpjegohen, gjithashtu, se cilat janë shenjat që tregojnë se robi e do vërtet Allahun, si edhe frytet e mrekullueshme që sjell kjo dashuri.

"Nëse e doni Allahun", pra, nëse pretendoni se e keni arritur këtë gradë të lartë, dijeni se nuk mjafton vetëm ta pretendoni atë, por është i domosdoshëm sinqeriteti ose vërtetësia, në mënyrë që ai të merret në konsideratë nga i Dituri dhe i Urti. Si shenjë të vërtetësisë të këtij pretendimi, Allahu i Lartësuar ka bërë pasimin e Profetit të Tij. Me fjalë të tjera, të duash Allahun do të thotë që të pasosh Profetin e mëshirës, Muhamedin (a.s.) në fjalët dhe në veprat e tij, të pasosh udhëzimin e sjellë prej tij, që sqaron themelet e besimit dhe dispozitat ligjore në çdo fushë të jetës njerëzore. Ky pasim duhet të jetë i tërësishëm, me trup dhe me shpirt. Vetëm ata që e pasojnë rigorozisht udhëzimin e Zotit, siç është sjellë me saktësi prej Profetit (a.s.), vetëm ata e kanë të vërtetuar pretendimin se e duan Zotin e gjithësisë, Allahun e Lartësuar. Madje, në këtë mënyrë, ata i kanë mundësuar vetes së tyre privilegjin më të madh që mund të gëzojnë krijesat në këtë jetë dhe në jetën tjetër: ata kanë merituar dashurinë e Allahut për ta dhe mbulimin e të metave të tyre.

- "...atëherë më pasoni mua, që Allahu t'ju dojë dhe t'ju falë mëkatet tuaja." Allahu është Falës e Mëshirues." - Nëse robi e pason udhëzimin e sjellë nga Profeti, ai ka bërë të mundur që Allahu i Lartësuar ta dojë atë, t'ia falë dhe mbulojë gjynahet, ta mëshirojë, ta udhëzojë dhe t'i japë sukses që të gjejë çdo të mirë dhe të ruhet nga çdo e keqe. Ai do të jetë i ruajtur në çdo veprim apo mosveprim të tijin nga Allahu i Lartësuar, që e do, e mëshiron dhe përkujdeset për të në mënyrë të posaçme.

Ndërsa ata që nuk e ndjekin udhëzimin e Profetit, nuk e duan Allahun, sepse dashuria për Allahun lidhet me pasimin e udhëzimit të Profetit dhe me nënshtrimin e bindjen ndaj tij. Nëse mungon respektimi i rrugës së Profetit dhe bindja ndaj tij, atëherë mungon

edhe dashuria për Allahun e Lartësuar. Kjo tregon se ata janë të gënjeshtërt në pretendimin e tyre që e duan Allahun e Lartësuar. Edhe sikur të mendohej se në zemrën e tyre do të ekzistonte ndonjëfarë dashurie për Allahun, ajo do të ishte e pavlefshme për robin, nëse nuk plotëson kushtin që e bën atë të pranueshme e të shpërblyeshme. Ky kusht është pasimi i udhëzimit të Profetit dhe bindja ndaj tij, i shtyrë nga dashuria për Allahun dhe madhërimi i Tij.

Ky ajet bën dallimin e njerëzve nga njëri tjetri. Grada e besimit dhe e dashurisë për Allahun e Lartësuar është në varësi të ndjekjes së udhëzimit të Profetit (s.a.u.s.). Mangësia në njërën anë tregon mangësi në anën tjetër.

- "Thuaj: "Bindjuni Allahut dhe të Dërguarit!" - Ky është urdhri më i madh dhe më gjithëpërfshirës i Allahut të Lartësuar ndaj krijesave dhe adhuruesve të Tij. Ai na urdhëron për bindje ndaj Tij dhe ndaj Profetit të Tij.

Bindja duhet të tregohet me besim, ndjenja, fjalë dhe vepra. Më konkretisht, ajo nënkupton:

- Besimin e plotë te gjithçka për të cilën Allahu i Lartësuar dhe Profeti i Tij kanë urdhëruar që të besohet dhe të pranohet.

- Njësimin e Allahut të Lartësuar në aspektin e veprave unike të Tij, në meritën e Tij për t'u adhuruar i Vetëm dhe në emrat e cilësitë e Tij të larta.

- Bindje ndaj Tij konsiderohen të gjitha ato vepra, fjalë dhe ndjenja që rrjedhin prej dy pikave të mësipërme.

- Bindje ndaj Allahut konsiderohet edhe bindja ndaj Profetit të Tij, që konsiston në zbatimin rigoroz të urdhrave dhe në largimin prej të gjitha harameve të qartësuara prej tij. Bindja ndaj urdhrave të Profetit konsiderohet si bindje ndaj urdhrave të Allahut, dhe kush i bindet Allahut dhe Profetit të Tij është vërtet i fituar. Allahu i Lartësuar thotë: "Kush i bindet Profetit, ai i është bindur Allahut. Por kush e refuzon, *(dije se)* Ne nuk të kemi dërguar si roje kundër tyre." [Nisa 80]. "Këta janë kufijtë e Allahut. Atë që i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij, Ai do ta fusë në Xhenete, në të cilët burojnë lumenj, dhe aty do të jetë përgjithmonë; kjo është fitorja e madhe. Ndërsa atë që kundërshton Allahun dhe të Dërguarin e Tij dhe që shkel kufijtë e Tij, Ai do ta fusë në Zjarr, ku do të jetë përjetësisht. Për të është përgatitur një dënim i rëndë." [Nisa 13, 14].

- "Nëse ata refuzojnë, atëherë ta dinë se Allahu nuk i do jobesimtarët!" - Por nëse krijesat e shpërfillin bindjen ndaj Allahut dhe Profetit të Tij, atyre nuk u mbetet rrugë tjetër, por veçse t'i binden çdo shejtani të shfrenuar dhe armiqësor. Allahu i Lartësuar na tregon se sa i pamëshirshëm është shejtani ndaj atyre që i binden dhe që ndjekin hapat e tij: "Atij *(shejtanit)* i është dhënë liri që, atë që i bëhet mik, ta humbë dhe ta çojë drejt vuajtjes në Zjarrin e ndezur fort". [Haxh 4].

Për këtë arsye, Allahu i Lartësuar tregon se robi që e refuzon t'i bindet Atij dhe Profetit, e ka humbur privilegjin dhe shpresën e vetme për shpëtim, e ka humbur dashurinë e Allahut për të. Allahu i Lartësuar e ka përforcuar këtë fakt, kur thotë: "Nëse ata refuzojnë, atëherë ta dinë se Allahu nuk i do jobesimtarët!" Allahu nuk i do mohuesit dhe refuzuesit e urdhrave të Tij, të cilët meritojnë veçse zemërimin dhe ndëshkimin e Tij.

Ky ajet duket sikur është shpjegim më i hollësishëm i ajetit para tij, ku tregohet rëndësia e pasimit të udhëzimit të Profetit. Ky, pra, është udhëzimi i drejtë, i vërtetë dhe i saktë.

Ajetet 33 – 37

33. Allahu zgjodhi Ademin, Nuhun, familjen e Ibrahimit dhe familjen e Imranit mbi popujt e tjerë *(të asaj kohe).*
34. Ata ishin pasardhës, njëri prej tjetrit. Allahu është Dëgjues dhe i Gjithëditur.

35. Kur gruaja e Imranit tha: "Zoti im! Këtë *(fëmijë)* që është në barkun tim, unë vendosa që të ta kushtoj vetëm Ty! Pranoje këtë prej meje! Vërtet, Ti je Dëgjuesi dhe i Dituri!"
36. Kur ajo lindi, tha: "Zoti im! Unë e linda femër!" Allahu ishte më i ditur për atë që ajo lindi dhe se mashkulli nuk është si femra. "Unë i vura emrin Merjeme. Atë dhe pasardhësit e saj po t'i lë Ty në mbrojtje prej shejtanit të mallkuar".
37. Zoti i saj e pranoi përkushtimin e saj, ashtu si qe më e mira. Ai e rriti atë *(vajzën)* me një edukatë të mirë e të plotë, dhe e vuri nën kujdesin e Zekerias. Sa herë që hynte Zekeria në dhomën e faljes së saj, gjente atje ushqim, prandaj e pyeti: "O Merjeme! Nga të vjen ky ushqim?" Ajo i tha: "Nga Allahu. Vërtet, Allahu e furnizon pa masë atë që do!"

Shpjegimi i ajeteve

- "Allahu zgjodhi Ademin, Nuhun, familjen e Ibrahimit dhe familjen e Imranit mbi popujt e tjerë." - Allahu i Lartësuar na tregon se Ai i dalloi këta njerëz dhe fëmijët e tyre mbi njerëzit e tjerë të atyre kohërave. Ai i përzgjodhi ata ndër njerëz, si të dashurit e Tij.

Allahu e zgjodhi Ademin (a.s.) mbi të gjithë krijesat e tjera, sepse e krijoi me duart e Tij dhe fryu në të prej shpirtit të *(krijuar prej)* Tij. Allahu i urdhëroi melekët që të bien në sexhde para Ademit. Ai e vendosi Ademin në Xhenetin e Tij. Allahu i Lartësuar i dhuroi Ademit dije, butësi, mëshirë dhe shumë dhunti, me të cilat u dallua mbi krijesat e tjera. Madje, si nderim për Ademin, Allahu i Lartësuar privilegjoi edhe pasardhësit e tij, siç thotë në këtë ajet: "Ne vërtet i kemi nderuar pasardhësit e Ademit, duke u mundësuar të udhëtojnë hipur në tokë e në det e duke i begatuar me ushqime të mira. Ne i kemi ngritur ata mbi shumë prej atyre që kemi krijuar". [Isra 70].

Allahu dalloi e nderoi edhe Nuhun (a.s.). Ai ishte i pari Profet që u dërgua te banorët e tokës, pasi ata filluan të adhuronin idhujt. Allahu e nderoi Nuhun duke i dhuruar cilësi të vyera si: durimin, përballimin e sprovave, mirënjohjen për Allahun e Lartësuar dhe qëndrueshmërinë në rrugën e thirrjes për të adhuruar Allahun si të Vetëm dhe të Pashoq. Me durim të jashtëzakonshëm, ai i ftoi njerëzit në adhurimin e Zotit Një, në çdo çast dhe gjendje që ishte, për një periudhë kohore tepër të gjatë (gati 10 shekuj). Kjo qëndrueshmëri e tij bëri që Allahu i Lartësuar ta donte dhe ta dallonte atë mbi njerëzit e tjerë. Vetëm me një lutje të Nuhut (s.a), Allahu i Lartësuar i përmbyti të gjithë banorët e tokës, duke shpëtuar vetëm ata që pasuan udhëzimin dhe urdhrat e tij. Allahu i shpëtoi të gjithë ata që ndodheshin në anijen e mbushur plot, dhe kështu, pasardhësit e tij u bënë paraardhësit e botës së sotme. Kujtimi i tij i mirë ndër njerëz u bë i përjetshëm. Ai do të kujtohet për mirë, në çdo kohë dhe në çdo vend. I Lartësuari thotë: "...Ne e shpëtuam atë dhe familjen e tij prej tmerrit të madh, ndërsa pasardhësit e tij i bëmë ata që vazhduan jetën. Ne ua lamë atë *(histori)* si kujtim për njerëzit e ardhshëm. Selami *(paqja)* qoftë mbi Nuhun në mbarë botën. Kështu i shpërblejmë Ne të mirët. Vërtet, ai ishte prej adhuruesve tanë besimtarë." [Safat 75 – 81].

Allahu dalloi mbi të tjerët edhe familjen e Ibrahimit (a.s.). Ibrahimi (a.s.) i dashuri i Mëshiruesit. Allahu i Lartësuar e dalloi Ibrahimin (a.s.) duke i dhënë dashurinë më të madhe që Ai mund t'u japë krijesave, dhe kjo dashuri quhet *ħul-letun*. Ibrahimi pranoi të digjej në zjarr veç për hir të Zotit të tij. Ai pranoi që të bënte kurban të vetmin djalë, aq të dashur dhe të shumëpritur prej tij, Ismailin (a.s.), vetëm që të kënaqte dhe të përmbushte urdhrin e Allahut të Lartësuar. Pasurinë e tij e shpenzonte duke nderuar miqtë me një mikpritje të pakrahasueshme. Ai e kaloi jetën duke adhuruar Allahun dhe duke ftuar njerëzit në teuhid. Ai i ftonte ata natën dhe ditën, haptazi dhe fshehtazi. Allahu i Lartësuar e bëri atë shembull të

njerëzimit për të gjitha kohërat. Ai ia bëri detyrë njerëzimit që të jetë pasues i rrugës së Ibrahimit dhe i fesë së tij të drejtë. Po ashtu, Ibrahimi nuk ka qenë kurrë idhujtar, por adhuronte një Zot të vetëm, Allahun, dhe vetëm udhëzimeve të Tij u bindej dhe u nënshtrohej.

Më tej, Allahu i Lartësuar e kufizoi profetësinë vetëm te pasardhësit e Ibrahimit. Vetëm atyre u dha profetësi dhe libra hyjnorë si udhëzim për njerëzimin. Të gjithë profetët që kanë ardhur pas Ibrahimit kanë qenë pinjollë të tij. Edhe këta pasardhës Zoti i nderoi dhe i dalloi mbi të gjithë botën me shumë dhunti e veçori. Mes tyre qëndron më i zgjedhuri, më i dashuri dhe më i madhi i gjithë profetëve, Muhamedi (a.s.). Tek ky pasardhës i Ibrahimit, Allahu i Lartësuar vendosi çdo mirësi dhe dhunti që gjendej e shpërndarë tek të tjerët, madje edhe disa dhunti të posaçme për të, me të cilat u lartësua mbi të parët dhe të fundit. Ai ishte i zgjedhuri, zotëria i profetëve të njerëzimit, më i dalluari ndër pasardhësit e Ibrahimit (a.s.).

Por Allahu dalloi mbi njerëzit e tjerë edhe familjen e Imranit. Këtu hyn babai i Musait dhe i Harunit. Këtu përfshihet edhe babai i Merjemes, nënës së Isait (a.s.). Këto familje ishin ajka e botës.

Mirësitë e Allahut dhe suksesi i dhënë prej Tij kanë shkuar varg tek të gjithë pasardhësit e këtyre familjeve, prandaj i Lartësuari thotë:

- "Ata ishin pasardhës, njëri prej tjetrit." - Ata erdhën njëri pas tjetrit, të ngjashëm në cilësitë dhe vetitë e tyre të çmuara. Allahu i Lartësuar tregon se përzgjodhi këta profetë dhe të afërmit e tyre, duke i udhëzuar ata në rrugën e drejtë.

- "Allahu është Dëgjues dhe i Gjithëditur." - Allahu e di më së miri se cili e meriton që të përzgjidhet dhe të dallohet mbi të tjerët me të tilla dhunti. Kjo tregon se Allahu i Lartësuar i përzgjodhi ata që u përmendën në këtë ajet, për shkak të diçkaje që gjendej tek ata dhe që e bënte të merituesshme një nderim të tillë, si dhuratë dhe bujari nga i Dijshmi e i Urti.

Përshkrimi i madhështisë dhe i rëndësisë së këtyre të përzgjedhurve dhe të dalluarve nga Allahu i Lartësuar bëhet për disa qëllime, si për shembull:

- Ai na nxit që ne t'i duam dhe t'i respektojmë të gjithë profetët e Zotit. Ne duhet të pajisemi me cilësitë e tyre dhe duhet t'i zbatojmë udhëzimet e tyre të drejta.
- Kështu nxitemi që ta lusim Allahun e Lartësuar, të na japë sukses edhe neve, ashtu sikurse u dha atyre.
- Këto përshkrime na bëjnë të ndihemi keq për gjendjen dhe cilësitë tona, që janë aq larg madhështisë së atyre njerëzve, por, nga ana tjetër, ato na nxisin dëshirën për të punuar dhe për të adhuruar më tepër Allahun e Lartësuar, që edhe ne t'u afrohemi të përzgjedhurve të Tij. Në këtë mënyrë, edhe ne do të na mundësohet që Allahu i Lartësuar të na falë nga mëshira dhe dashuria e Tij e pakufishme.
- Këto fjalë na tregojnë qartë dashurinë dhe butësinë e madhe të Zotit ndaj atyre të përzgjedhurve, duke bërë që fama e tyre të jetë e vazhdueshme ndër njerëz, gjatë gjithë kohërave.
- Në ajet bëhet shumë e prekshme bamirësia dhe mëshira e madhe e Zotit. Ne kuptojmë se sa i dobishëm është adhurimi i Allahut me dashuri, madhërim dhe bindje totale ndaj Tij.
- Për ata, do të mjaftonte si nderim vetëm fakti që do të përkujtohen gjithmonë për mirë dhe do të jenë në çdo kohë shembull për mbarë njerëzimin.

Pasi përmend mirësitë e Tij mbi njerëzit e nderuar e të përzgjedhur, Allahu i Lartësuar vijon të përshkruajë më hollësisht nderimin e madh për Merjemen, nënën e Isait (a.s.).

- "Kur gruaja e Imranit tha: "Zoti im! Këtë *(fëmijë)* që është në barkun tim, unë vendosa që të ta kushtoj vetëm Ty!" - Në

kohën e shtatzënisë me Merjemen, nëna e Merjemes i tha Zotit se ajo ia kishte përkushtuar Atij frytin që gjendej në barkun e saj. Ajo kishte vendosur që fryti i barkut të saj të ishte i përkushtuar vetëm ndaj Zotit dhe në shërbim të Shtëpisë së Tij. Ky është kuptimi i fjalës "*muĥar-raran*".

Pastaj ajo u lut që Allahu i Lartësuar t'ia pranonte përkushtimin e saj modest, duke thënë:

- "Pranoje këtë prej meje! Vërtet, Ti je Dëgjuesi dhe i Dituri!" – Kuptimi: "Pranoje, o Zot, prej meje këtë kushtim dhe bëje të frytshëm! Ti e dëgjon lutjen time dhe e di shumë mirë qëllimin që më shtyn të veproj kështu!"

Këto fjalë, nëna e Merjemes i tha gjatë kohës së shtatzënisë së saj me Merjemen. Por, më pas:

- "Kur ajo lindi, tha: "Zoti im! Unë e linda femër!" - Me sa duket, ajo dëshironte shumë që fëmija të ishte mashkull, sepse ashtu do të ishte më i dobishëm në shërbim të shtëpisë së Zotit dhe më i plotë si përkushtim. Në fjalët e saj dallohet një shenjë keqardhjeje para Zotit të saj. Por i Urti e i Dituri thotë:

- "Allahu ishte më i ditur për atë që ajo lindi dhe se mashkulli nuk është si femra." - Allahu e dinte shumë mirë se çfarë lindi ajo dhe nuk kishte nevojë për lajmërimin e saj. Madje, Ai e dinte gjendjen e frytit të barkut të saj para se të dilte në dritë.

Ky ajet tregon, gjithashtu, se mashkulli është më i vlefshëm se femra.

- "Unë i vura emrin Merjeme. Atë dhe pasardhësit e saj po t'i lë Ty në mbrojtje prej shejtanit të mallkuar". – Nga këtu mësojmë se është e lejueshme që emri i fëmijës të vendoset nga nëna, nëse babai nuk e ndalon një gjë të tillë.

Kjo është një lutje që nëna e Merjemes ia drejtoi Allahut të Lartësuar për Merjemen dhe pasardhësit e saj. Ajo e luti Allahun që ta ruajë Merjemen dhe pasardhësit e saj, prej shejtanit të mallkuar.

- "Zoti i saj e pranoi përkushtimin e saj, ashtu si qe më e mira. Ai e rriti atë *(vajzën)* me një edukatë të mirë e të plotë, dhe e vuri nën kujdesin e Zekerias." – Pra, Allahu i Lartësuar e pranoi keqardhjen e saj që fryti ishte femër dhe e ruajti atë dhe pasardhësit e saj prej shejtanit. Allahu i Lartësuar u përkujdes për të, që ajo të rritej e rregullt dhe e shëndetshme fizikisht dhe moralisht.

Allahu i Lartësuar bëri që për Merjemen të përkujdesej Zekeria (a.s.), sepse "*keffelehâ Zekerijâ*", domethënë: "e ngarkoi Zekerian" me përgjegjësinë që të kujdesej për Merjemen. Kjo tregon butësinë dhe mëshirën e Allahut të Lartësuar mbi Merjemen, tregon përkujdesjen e madhe të Tij që Merjemja të rritej dhe të formohej me moralin më të mirë. Ajo u rrit duke adhuruar Allahun dhe u ngrit mbi të gjitha gratë e kohës së saj. Ajo qëndronte vetëm në faltoren e saj, duke adhuruar Allahun pandërprerë.

- "Sa herë që hynte Zekeria në dhomën e faljes së saj, gjente atje ushqim..." - Ky furnizim me shumëllojshmëri frutash i dhurohej Merjemes drejtpërdrejt nga Zoti i saj, pa qenë e nevojshme që ajo të punonte. Kjo qe pa dyshim një mrekulli (keramet)[15], me të cilën Zoti e dalloi Merjemen nga të tjerët. Ndërsa Zekeria, që e pa këtë mrekulli me sytë e tij, pyeti:

- "...prandaj e pyeti: "O Merjeme! Nga të vjen ky ushqim?" Ajo i tha: "Nga Allahu. Vërtet, Allahu e furnizon pa masë atë që do!" – Ajo iu përgjigj se ushqimi ishte dhuratë prej Zotit. Ajo i kujtoi Zekerias se Allahu i Lartësuar e furnizon atë që do pa

[15] Ngjarjet dhe ndodhitë e jashtëzakonshme që u ndodhin dhe u dhurohen profetëve quhen mrekulli, ndërsa të tilla ndodhi që u dhurohen besimtarëve dhe besimtareve të sinqerta quhen keramete.

llogari dhe pa qenë e nevojshme që ai të lodhet që ta fitojë. Allahu i Lartësuar thotë në një ajet tjetër: "Kështu këshillohet ai që i beson Allahut dhe Ditës së Fundit. Atij që u përmbahet dispozitave të Allahut, Ai i jep rrugëzgjidhje për gjithçka dhe e furnizon prej nga ai nuk mendon." [Talak 2, 3].

Ky ajet dëshmon vërtetësinë e mrekullive (kerameteve) me të cilat Allahu i Lartësuar veçon disa nga të dashurit e Tij të sinqertë. Ato janë të sakta, të vërteta e të padiskutueshme, edhe pse disa mundohen t'i mohojnë.


Kur Zekeria (a.s) pa atë mrekulli (keramet) mbi Merjemen, atij i lindi dëshira që t'i kërkonte Allahut të Lartësuar një fëmijë, edhe pse gruaja e tij ishte sterile kurse ai vetë në moshë të thyer.

Ajetet 38 – 41

38. Atëherë, Zekeria e luti Zotin e tij duke thënë: "O Zoti im! Më dhuro edhe mua një pasardhës të mirë. Vërtet, Ti je dëgjues i lutjes!"
39. Kur qëndronte në këmbë, duke u falur në faltore, atë e thirrën engjëjt: "Allahu të përgëzon ty me Jahjan, i cili do të besojë Fjalën e ardhur nga Allahu. Ai do të jetë zotëri, i përkorë dhe Profet nga më të mirët!"
40. Ai *(Zekeria)* tha: "O Zoti im! Si mund të kem unë djalë, kur mua më ka kapur pleqëria dhe shoqja ime është sterile?!" Tha *(Allahu)*: "Allahu bën çfarë dëshiron!"
41. Ai *(Zekeria)* tha: "O Zoti im! Më shfaq mua një shenjë!" Ai *(Allahu)* tha: "Shenja është që ti, për tri ditë, nuk do të mund t'u flasësh njerëzve, përveçse me gjeste. Përmende shumë Zotin tënd dhe madhëroje Atë, çdo mbrëmje e mëngjes!"

Shpjegimi i ajeteve

- "Atëherë, Zekeria e luti Zotin e tij duke thënë: "O Zoti im! Më dhuro edhe mua një pasardhës të mirë. Vërtet, Ti je dëgjues i lutjes!" - Ai e luti Zotin e tij që t'i dhuronte


الجزء الثالث سورة آل عمران
هُنَالِكَ دَعَا زَكَرِيَّا رَبَّهُۥ ۖ قَالَ رَبِّ هَبْ لِى مِن لَّدُنكَ ذُرِّيَّةً
طَيِّبَةً ۖ إِنَّكَ سَمِيعُ ٱلدُّعَآءِ ﴿٣٨﴾ فَنَادَتْهُ ٱلْمَلَٰٓئِكَةُ وَهُوَ قَآئِمٌ
يُصَلِّى فِى ٱلْمِحْرَابِ أَنَّ ٱللَّهَ يُبَشِّرُكَ بِيَحْيَىٰ مُصَدِّقًۢا بِكَلِمَةٍ
مِّنَ ٱللَّهِ وَسَيِّدًا وَحَصُورًا وَنَبِيًّا مِّنَ ٱلصَّٰلِحِينَ ﴿٣٩﴾ قَالَ رَبِّ
أَنَّىٰ يَكُونُ لِى غُلَٰمٌ وَقَدْ بَلَغَنِىَ ٱلْكِبَرُ وَٱمْرَأَتِى عَاقِرٌ ۖ قَالَ
كَذَٰلِكَ ٱللَّهُ يَفْعَلُ مَا يَشَآءُ ﴿٤٠﴾ قَالَ رَبِّ ٱجْعَل لِّىٓ ءَايَةً ۚ
قَالَ ءَايَتُكَ أَلَّا تُكَلِّمَ ٱلنَّاسَ ثَلَٰثَةَ أَيَّامٍ إِلَّا رَمْزًا ۗ وَٱذْكُر
رَّبَّكَ كَثِيرًا وَسَبِّحْ بِٱلْعَشِىِّ وَٱلْإِبْكَٰرِ ﴿٤١﴾ وَإِذْ قَالَتِ
ٱلْمَلَٰٓئِكَةُ يَٰمَرْيَمُ إِنَّ ٱللَّهَ ٱصْطَفَىٰكِ وَطَهَّرَكِ وَٱصْطَفَىٰكِ
عَلَىٰ نِسَآءِ ٱلْعَٰلَمِينَ ﴿٤٢﴾ يَٰمَرْيَمُ ٱقْنُتِى لِرَبِّكِ وَٱسْجُدِى
وَٱرْكَعِى مَعَ ٱلرَّٰكِعِينَ ﴿٤٣﴾ ذَٰلِكَ مِنْ أَنۢبَآءِ ٱلْغَيْبِ نُوحِيهِ إِلَيْكَ ۖ
وَمَا كُنتَ لَدَيْهِمْ إِذْ يُلْقُونَ أَقْلَٰمَهُمْ أَيُّهُمْ يَكْفُلُ مَرْيَمَ
وَمَا كُنتَ لَدَيْهِمْ إِذْ يَخْتَصِمُونَ ﴿٤٤﴾ إِذْ قَالَتِ ٱلْمَلَٰٓئِكَةُ
يَٰمَرْيَمُ إِنَّ ٱللَّهَ يُبَشِّرُكِ بِكَلِمَةٍ مِّنْهُ ٱسْمُهُ ٱلْمَسِيحُ عِيسَى
ٱبْنُ مَرْيَمَ وَجِيهًا فِى ٱلدُّنْيَا وَٱلْءَاخِرَةِ وَمِنَ ٱلْمُقَرَّبِينَ ﴿٤٥﴾
٥٥

atij pasardhës të mirë dhe të pastër në cilësi, edukatë dhe në fe. Ai i kërkoi Allahut që t'i dhuronte pasardhësit të tij mirësi si në aspektin e dynjasë, ashtu edhe në atë të besimit në Zotin.

- "Kur qëndronte në këmbë, duke u falur në faltore, atë e thirrën engjëjt:.." – Kështu, Allahu i Lartësuar iu përgjigj kësaj kërkese, gjatë kohës kur Zekeria (a.s) lutej dhe përgjërohej në faltoren e tij.

- "Allahu të përgëzon ty me Jahjan, i cili do të besojë Fjalën e ardhur nga Allahu. Ai do të jetë zotëri, i përkorë..." - Allahu i Lartësuar e përgëzoi me një djalë të quajtur Jahja, i cili do të përcillte tek njerëzit lajmin e mirë për ardhjen në botë të Fjalës së Zotit, pra, të Isait (a.s.), sepse Isai u krijua me fjalën e Zotit "*Kun*" (Bëhu).

Jahja do të ishte, gjithashtu, *sejjiden* (zotëri), tek i cili do të shkonin njerëzit për zgjidhjen e çështjeve të tyre, për shkak të cilësive të tij të mira dhe vlerave të larta.

Cilësi tjetër e Jahjas ishte edhe "*Ĥaŝûran*" (i përkorë), domethënë që nuk ishte i dhënë pas femrave. Ai nuk tundohej prej tyre, sepse ishte shumë i angazhuar me shërbimin dhe adhurimet ndaj Zotit të tij.

Allahu i Lartësuar përmend edhe një cilësi tjetër të Jahjas:

- "...dhe Profet nga më të mirët!" - Ku ka lajm më të mirë për një prind që merr vesh se do të gëzohet me një fëmijë, i cili do të ketë cilësi të shkëlqyera dhe që do të bëhet një Profet i dalluar dhe vepërmirë?!

E kështu, nga gëzimi i madh, Zekeria nisi të fliste:

- "Ai tha: "O Zoti im! Si mund të kem unë djalë, kur mua më ka kapur pleqëria dhe shoqja ime është sterile?!" - Si mund të kem unë fëmijë, kur janë dy shkaqe që e bëjnë të pamundur një gjë të tillë?! Vetëm njëri prej tyre do të mjaftonte që lindja e fëmijës të ishte e pamundur. Po kur janë dy të tillë?!

Por Allahu i Lartësuar i tha se këtu bëhej fjalë për një mrekulli, e cila është jashtë mundësive njerëzore:

- "Tha *(Allahu):* "Allahu bën çfarë dëshiron!" - Allahu i Lartësuar është Ai që e ka përcaktuar që fëmijët të krijohen e të lindin sipas ligjeve natyrore të vendosura prej Tij. Nëpërmjet këtyre ligjeve mundësohet vazhdimësia e jetës së njerëzimit. Megjithatë, Ai që i ka krijuar mënyrat natyrore të lindjes është i Plotfuqishëm që ta bëjë të lindë një fëmijë edhe jashtë këtyre ligjeve normale. Allahu është i Gjithëpushtetshëm dhe ligjet i janë nënshtruar pushtetit të Tij.

Kur dëgjoi këto fjalë, Zekeria, i nxituar tashmë, kërkoi ndonjë shenjë për ardhjen e fëmijës, me qëllim që t'i qetësohej zemra më shumë, prandaj tha:

- "Ai *(Zekeria)* tha: "O Zoti im! Më shfaq mua një shenjë!" – Kuptimi: O Zot, më jep një shenjë që të më tregojë se fëmija vërtet do të më dhurohet.

- "Ai *(Allahu)* tha: "Shenja është që ti, për tri ditë, nuk do të mund t'u flasësh njerëzve, përveçse me gjeste." – Atëherë, Allahu i Lartësuar e njoftoi se shenja do të ishte një paaftësi për të folur me njerëzit, pa pasur asnjë defekt fizik tek ai. Ai, thjesht, nuk do të mund t'u fliste njerëzve me gojë, por do të komunikonte veç me gjeste.

Nëse një njeri i aftë për të folur nuk është në gjendje të thotë asnjë fjalë, kjo është vërtet një shenjë e madhe, e cila përshtatet shumë me përgëzimin për fëmijë. Me këtë shenjë, sikur na jepet të kuptojmë se shkaqet dhe mundësitë, edhe nëse ekzistojnë, mund të bëhen të pavlefshme dhe jo ndikuese për të sjellë pasojat e tyre, ashtu sikurse edhe pasojat mund të ekzistojnë pa qenë e nevojshme të ekzistojnë shkaqet e tyre. Në përfundim, kjo tregon se, si shkaqet, ashtu edhe aftësia e tyre vepruese për të sjellë pasojat, të gjitha janë të nënshtruara ndaj vullnetit dhe përcaktimit të Allahut të Urtë e të Plotpushtetshëm.

Dhe vërtet ashtu ndodhi. Zekeria nuk foli për tri ditë rresht.

- "Përmende shumë Zotin tënd dhe madhëroje Atë, çdo mbrëmje e mëngjes!" - Allahu i Lartësuar e urdhëroi Zekerian që, gjatë kësaj kohe, të përkujtonte Allahun e Lartësuar dhe ta madhëronte Atë shumë, mëngjes e mbrëmje. E kështu, Zekeria dilte para popullit dhe nuk fliste dot, por u komunikonte me shenja atyre që ta madhëronin dhe ta përkujtonin shumë Allahun e Lartësuar. Në një ajet tjetër të Kur'ânit thuhet: "Ai *(Zekeria)* tha: "O Zoti im! Më jep mua një shenjë!" Ai *(Allahu)* tha: "Shenja për ty është që ti nuk do të mund t'u flasësh njerëzve tri net". Dhe ai doli prej faltores, para popullit të vet dhe u komunikoi me shenja: "Bëni adhurime *(për Allahun)* mëngjes e mbrëmje"." [Merjem 10, 11]. Pra, Zekeria i kështilloi ata që ta

përkujtonin dhe ta madhëronin sa më shumë Allahun e Lartësuar, në mëngjes dhe në mbrëmje.

Ajetet 42 – 44

42. Përkujto kur engjëjt i thanë: "O Merjeme! Allahu të dalloi ty nga të tjerët, të pastroi dhe të veçoi mbi gratë e botës".
43. "O Merjeme! Vazhdo gjithmonë me adhurimin ndaj Zotit tënd! Bëj sexhde dhe falu për Zotin tënd, bashkë me të tjerët që falen!"
44. Këto janë disa nga historitë e panjohura që po t'i përcjellim ty *(o Muhamed)*. Ti nuk ishe atje, kur ata hidhnin short se cili prej tyre do të bëhej kujdestar i Merjemes. Ti nuk ishe pranë tyre as kur ata grindeshin me njëri-tjetrin.

Shpjegimi i ajeteve

- "Përkujto kur engjëjt i thanë: "O Merjeme! Allahu të dalloi ty nga të tjerët, të pastroi dhe të veçoi mbi gratë e botës". - Allahu i Lartësuar na tregon kështu për vlerat e larta të kësaj gruaje. Melekët iu drejtuan asaj me këto fjalë të mrekullueshme, të cilat ia mbushën zemrën. E si të mos kënaqesh, kur dëgjon prej melekëve se Allahu i Lartësuar të ka zgjedhur e të ka dalluar mbi të tjerët?! Jo vetëm kaq, por madje të ka pastruar edhe nga çdo cilësi e mangët dhe e ulët.

Allahu i Lartësuar e ka përdorur dy herë fjalën '*iṣṭafâki*' – të dalloi, të veçoi. Herën e parë, kur thuhet: "*In-nell-llâhe-ṣṭafâki*", ajo ka kuptimin: "Allahu të dalloi ty, duke të dhuruar cilësi të mrekullueshme dhe duke të pajisur me vlera të larta, në krahasim me njerëzit e tjerë".

Në rastin e dytë, Allahu thotë: "*Ue-ṣṭafâki alâ nisâil-âlemîn*", domethënë: "të veçoi mbi gratë e botës". Ky lloj veçimi mund të jetë bërë ndër të gjitha gratë e botës të kohës së saj, ose edhe ndër gratë e botës të të gjitha kohërave. Ky prestigj nuk cenohet aspak nga fakti që atë e kanë merituar edhe gra të tjera, siç ishin dy nga bashkëshortet e Profetit, Hadixhja dhe Aishja, dhe vajza e tij, Fatimja. Të gjitha këto kanë qenë gra të shkëlqyera, të përzgjedhura dhe të dalluara nga të tjerat, mbështetur kjo në dëshminë e vetë Zotit të botëve.

Vetë melekët e njoftuan atë se Allahu i Lartësuar e kishte dalluar mbi të gjitha gratë e botës, dhe kjo ishte një mrekulli e madhe, ose një dhuratë që meritonte një mirënjohje të thellë për dhuruesin e saj. Për këtë arsye, menjëherë pas përgëzimit, erdhi ky udhëzim:

- "O Merjeme! Vazhdo gjithmonë me adhurimin ndaj Zotit tënd! Bëj *sexhde* dhe *ruku* për Zotin tënd, bashkë me të tjerët që bëjnë *ruku*!" - Pas mirësisë që i dhuroi, Allahu i Lartësuar e urdhëroi Merjemen, së pari, për adhurim të vazhdueshëm, duke qenë gjithnjë e bindur ndaj Tij, e motivuar nga dashuria dhe e mbushur me përulësi. Së dyti, Allahu e urdhëroi Merjemen për të falur namaz. Është përmendur në mënyrë të veçantë sexhdeja dhe rukuja, sepse ato janë shprehje të nënshtrimit dhe përuljes së thellë ndaj Allahut të Lartësuar.

Në të vërtetë, Merjemeja i kreu të gjitha porositë e Zotit, duke treguar qartë bindjen e saj të plotë dhe adhurimin e sinqertë për Krijuesin e saj, për Allahun e Lartësuar.

Ishte Allahu i Lartësuar që i tregoi Profetit të Tij të mëshirës, Muhamedit (a.s.), rreth këtyre ngjarjeve të hershme e të panjohura asokohe. Profeti (a.s.) nuk kishte asnjë mënyrë e mundësi për të njohur ato ngjarje të vërteta, prandaj i Lartësuari thotë:

- "Këto janë disa nga historitë e panjohura që po t'i përcjellim ty *(o Muhamed)*." – Kuptimi: Këto janë histori që vijnë vetëm me shpallje nga Zoti i botëve, i Cili di gjithçka, dhe nuk janë fjalë nga mendja e Muhamedit (a.s.) dhe as të huazuara nga të tjerë. Allahu i Lartësuar e përforcon këtë të vërtetë me fjalët:

- "Ti nuk ishe atje, kur ata hidhnin short se cili prej tyre do të bëhej kujdestar i Merjemes. Ti nuk ishe pranë tyre as kur ata grindeshin me njëri-tjetrin." - Nëna e Merjemes, kur lindi Merjemen, shkoi te kujdestarët që shërbenin në Shtëpinë e Shenjtë, për t'u dhuruar vajzën, që edhe ajo të ishte shërbyese e shtëpisë së Zotit, ashtu sikurse bëri premtimin.

Por ata filluan të grindeshin me njëri-tjetrin se cili do të ishte kujdestari i saj. Atëherë, ata vendosën që të hidhnin short se kujt do t'i takonte detyra e kujdestarisë së Merjemes. Ata duhet të hidhnin kalema druri në lumë. Ai njeri, kalemi i të cilit nuk do të ecte me rrjedhën, por do të qëndronte në vend, do të fitonte të drejtën e kujdestarisë së Merjemes, dhe ky qe më i miri i tyre, Zekeria, Profeti i Allahut.

Kështu, kuptimi i ajetit është: Duke qenë se ti, o Muhamed, nuk ishe mes tyre dhe as ti e as populli yt nuk keni dije rreth këtyre ngjarjeve të vërteta, që edhe ata (ithtarët e Librit) i pranojnë dhe i dinë imtësisht, atëherë kuptohet lehtësisht se ti je Profet i Zotit, sepse rruga e vetme e informacionit mbetet shpallja hyjnore. Nuk ka asnjë mënyrë tjetër për të ditur këto histori të largëta, përveç shpalljes nga Zoti i Gjithëditur. Atëherë, është e detyrueshme për të gjithë ithtarët e Librit që të pranojnë se ti je Profeti i Zotit dhe që të pasojnë udhëzimin e sjellë prej teje. Ti je Profet i vërtetë, i dërguar prej Allahut, Zotit të gjithësisë. Ata janë të detyruar që të të binden për të zbatuar udhëzimet e tua, nëse duan shpëtimin.

Allahu i Lartësuar përdor të njëjtën mënyrë argumentimi në disa ajete të tjera, si për shembull, kur thotë:

"Ti *(o Muhamed)* nuk ishe në anën perëndimore *(të malit Tur)*, kur Ne i besuam Shpalljen Musait, e as nuk ishe dëshmitar në këtë ngjarje. Pastaj, Ne krijuam brezni të tjera që jetuan shumë gjatë. Ti nuk ke banuar mes banorëve të Medjenit, që t'iu lexosh këtyre argumentet Tona , por Ne të dërguam ty si Profet. Ti nuk ke qenë as pranë kodrës Tur, kur Ne e thirrëm atë *(Musain)*. Kjo *(Shpallja hyjnore)* është mëshirë nga Zoti yt, për t'i tërhequr vërejtjen një populli, të cilit nuk i kishte ardhur ndonjë profet para teje, që të merrte mësim." [Kasas 44-46].

Ose: "S'ka dyshim se Ai që ta bëri detyrë Kur'ânin, Ai do të të kthejë ty në vendin e premtuar. Thuaj: "Zoti im e di më mirë kush vjen me udhëzim të drejtë dhe kush është në humbje të sigurt".Ti as nuk e kishe çuar ndër mend ndonjëherë se do të të shpallej Libri *(Kur'âni)*, por kjo qe mëshira e Zotit tënd. Asnjëherë mos i ndihmo jobesimtarët." [Kasas 86].

Ose: "Po kështu, Ne të shpallëm edhe ty Shpirtin *(Kur'ânin)*. Ti nuk e dije se çfarë qe Libri *(Kur'âni)* apo besimi, por Ne e bëmë atë *(Kur'ânin)* dritë, me të cilën udhëzojmë në rrugë të drejtë ata robër Tanë që dëshirojmë. Pa dyshim, edhe ti udhëzon në rrugën e drejtë, në rrugën e Allahut, të Cilit i takon ç'ka në qiej dhe ç'ka në tokë. Ta dini se tek Allahu kthehen të gjitha çështjet." [Shura 52-53].

Ajetet 45 – 47

45. Përkujto *(o Muhamed)* kur engjëjt i thanë: "O Merjeme! Allahu të përgëzon me "Fjalën" e Vet, emri i të cilit është Mesih, Isa, biri i Merjemes. Ai do të jetë i famshëm në këtë botë dhe në ahiret. Ai do të jetë një nga të afërmit *(të përzgjedhurit e Zotit)*.

46. Ai do t'u flasë njerëzve që në djep, por dhe kur të rritet. Ai do të jetë prej të mirëve.

47. Ajo tha: "O Zoti im! Si mund të kem unë djalë, kur s'më ka prekur njeri?!" Ai *(Allahu)* tha: "Ja, kështu, Allahu krijon çfarë të dojë. Kur Ai vendos për një çështje, vetëm i thotë: "Bëhu!" e ajo menjëherë bëhet".

Shpjegimi i ajeteve

- "Përkujto *(o Muhamed)* kur engjëjt i thanë: "O Merjeme! Allahu të përgëzon me "Fjalën" e Vet, emri i të cilit është Mesih,

Isa, biri i Merjemes...” – Ndër shumë sihariqe të tjera, melekët i dhanë Merjemes lajmin më të mrekullueshëm prej Zotit të tyre. Ata e përgëzuan se Allahu do t’i dhuronte asaj Isain (a.s.), një fëmijë të krijuar nga Fjala e Tij “Bëhu!” e që do të ishte profet dhe adhurues i madh i Zotit të gjithësisë.


Isai (a.s.) u quajt “Fjala e Allahut”, sepse ai erdhi në ekzistencë me fjalën e Zotit “*Kun*” – (Bëhu), dhe jo nga shkaqet e njohura njerëzore për sjelljen e fëmijëve në jetë. Allahu i Lartësuar e bëri Isain një nga çudirat e krijimit të Tij. Allahu i Lartësuar dërgoi te Merjemja Xhibrilin (a.s.), melekun madhështor dhe të pastër, duke e urdhëruar që të frynte prej shpirtit të tij të pastër në të çarën e këmishës së saj.

Kështu e krijoi Allahu i Lartësuar shpirtin e Isait. Ai ishte një krijesë, një shpirt, i krijuar nga Allahu i Lartësuar në një mënyrë të jashtëzakonshme, prandaj u quajt “*Rûhull-llâh*”, domethënë: “Shpirt prej Zotit”.

Përveç mënyrës së krijimit të tij, ky Profet do të dallohej edhe me cilësi të tjera të mrekullueshme.

- “Ai do të jetë i famshëm në këtë botë dhe në ahiret. Ai do të jetë një nga të afërmit *(të përzgjedhurit e Zotit)*” – Kështu, ai do të ketë famë të madhe në këtë jetë. Ai do të jetë një nga profetët më të shquar të kohërave. Ai do të sjellë një ligj jete dhe do të ketë shumë pasues, që do të ndjekin udhëzimin për të adhuruar një Zot të vetëm, Allahun e Lartësuar, i Cili do ta ngrejë famën e tij nga lindja në perëndim. Edhe në botën tjetër ai do të jetë i famshëm dhe i afruar tek Zoti i gjithësisë. Isai (a.s.) do të jetë, në fakt, një prej më të shquarve të afruar tek Allahu i Lartësuar.

- “Ai do t'u flasë njerëzve që në djep, por dhe kur të rritet.” - Kjo qe një mrekulli e Allahut: një foshnjë që u fliste njerëzve. Jo thjesht u fliste, por u thoshte fjalë të urta, që i udhëzonin ata në gjithçka të mirë dhe të dobishme për jetën e tyre. Ato ishin fjalë që


الجزء الثالث — سورة آل عمران

وَيُكَلِّمُ ٱلنَّاسَ فِى ٱلْمَهْدِ وَكَهْلًا وَمِنَ ٱلصَّٰلِحِينَ ﴿٤٦﴾
قَالَتْ رَبِّ أَنَّىٰ يَكُونُ لِى وَلَدٌ وَلَمْ يَمْسَسْنِى بَشَرٌ ۖ قَالَ كَذَٰلِكِ
ٱللَّهُ يَخْلُقُ مَا يَشَآءُ ۚ إِذَا قَضَىٰٓ أَمْرًا فَإِنَّمَا يَقُولُ لَهُۥ كُن فَيَكُونُ
﴿٤٧﴾ وَيُعَلِّمُهُ ٱلْكِتَٰبَ وَٱلْحِكْمَةَ وَٱلتَّوْرَىٰةَ وَٱلْإِنجِيلَ
﴿٤٨﴾ وَرَسُولًا إِلَىٰ بَنِىٓ إِسْرَٰٓءِيلَ أَنِّى قَدْ جِئْتُكُم بِـَٔايَةٍ مِّن
رَّبِّكُمْ أَنِّىٓ أَخْلُقُ لَكُم مِّنَ ٱلطِّينِ كَهَيْـَٔةِ ٱلطَّيْرِ فَأَنفُخُ
فِيهِ فَيَكُونُ طَيْرًۢا بِإِذْنِ ٱللَّهِ ۖ وَأُبْرِئُ ٱلْأَكْمَهَ وَٱلْأَبْرَصَ
وَأُحْىِ ٱلْمَوْتَىٰ بِإِذْنِ ٱللَّهِ ۖ وَأُنَبِّئُكُم بِمَا تَأْكُلُونَ وَمَا تَدَّخِرُونَ
فِى بُيُوتِكُمْ ۚ إِنَّ فِى ذَٰلِكَ لَـَٔايَةً لَّكُمْ إِن كُنتُم مُّؤْمِنِينَ ﴿٤٩﴾
وَمُصَدِّقًا لِّمَا بَيْنَ يَدَىَّ مِنَ ٱلتَّوْرَىٰةِ وَلِأُحِلَّ لَكُم
بَعْضَ ٱلَّذِى حُرِّمَ عَلَيْكُمْ ۚ وَجِئْتُكُم بِـَٔايَةٍ مِّن رَّبِّكُمْ
فَٱتَّقُوا۟ ٱللَّهَ وَأَطِيعُونِ ﴿٥٠﴾ إِنَّ ٱللَّهَ رَبِّى وَرَبُّكُمْ فَٱعْبُدُوهُ ۗ
هَٰذَا صِرَٰطٌ مُّسْتَقِيمٌ ﴿٥١﴾ * فَلَمَّآ أَحَسَّ عِيسَىٰ مِنْهُمُ
ٱلْكُفْرَ قَالَ مَنْ أَنصَارِىٓ إِلَى ٱللَّهِ ۖ قَالَ ٱلْحَوَارِيُّونَ نَحْنُ
أَنصَارُ ٱللَّهِ ءَامَنَّا بِٱللَّهِ ۖ وَٱشْهَدْ بِأَنَّا مُسْلِمُونَ ﴿٥٢﴾

٥٦

tregonin shpëtimin dhe suksesin në të dyja jetët, domethënë fjalë tipike për profetët e Zotit.

Kjo qe shenjë se ai do të ishte një profet, që do t’i drejtonte njerëzit në adhurimin dhe përkushtimin ndaj Zotit të tyre të vetëm, Allahut të Lartësuar. E folura e tij në djep qe një mrekulli, me anë të së cilës forcohej besimi dhe siguria e besimtarëve të sinqertë dhe, në të njëjtën kohë, humbte çdo mundësi justifikimi e mohuesve dhe e atyre që refuzonin të adhuronin Zotin e botëve, Allahun e Lartësuar. Kjo mrekulli tregonte se Isai (a.s.) ishte profet i vërtetë, i zgjedhur nga Zoti i botëve, dhe adhurues i sinqertë i Tij. Ajo vinte si mirësi dhe si tregues i pastërtisë së Merjemes, nënës së Isait (a.s.). Ajo ishte e pastër dhe e ruajtur nga çdo e keqe, ndryshe nga çfarë shpifin për të armiqtë e Zotit.

- “Ai do të jetë prej të mirëve.” - Ky ishte një përgëzim, se Allahu do t’i falte Isait (a.s.) dhunti të jashtëzakonshme, sikurse ka bërë

me të gjithë profetët e Tij. Isai (a.s.) do të ishte një prej profetëve më të mëdhenj.

Të gjitha këto ishin përgëzime të njëpasnjëshme për Merjemen dhe tregime për Isain, Profetin e Zotit të gjithësisë. Më pas:

- "Ajo tha: "O Zoti im! Si mund të kem unë djalë, kur s'më ka prekur njeri?!" – Në rrugë të zakonshme natyrale, fëmija nuk mund të vijë në jetë pa u hedhur disa hapa paraprakë. Për këtë arsye, Merjemeja pyet: 'Kur mua nuk më ka prekur asnjë burrë me dorë, si do të kem fëmijë?!' Kjo qe një habi nga ana e saj dhe aspak shenjë dyshimi a mosbesimi. Ajo nuk kishte asnjë dyshim në fuqinë absolute të Allahut të Lartësuar për të bërë gjithçka.

- "Ai *(Allahu)* tha: "Ja, kështu, Allahu krijon çfarë të dojë. Kur Ai vendos për një çështje, vetëm i thotë: "Bëhu!" e ajo menjëherë bëhet". - Melekët e lajmëruan atë që edhe kjo, si shumë mirësi të tjera të dhëna nga Zoti i saj, do të ishte një mrekulli.

Nëse Allahu i Gjithëpushtetshëm dëshiron diçka, thjesht i thotë "Bëhu", dhe ajo bëhet. Mjafton ky fakt i madhështisë së të Gjithëpushtetshmit, dhe çdo gjë bëhet e qartë dhe e kuptueshme për t'u pranuar dhe besuar.

Këtu nuk mund të lihet pa u përmendur edhe diçka shumë e bukur. Nëpërmjet këtyre ngjarjeve që Allahu i Lartësuar u sjell krijesave me kaq vërtetësi, kuptohet urtësia absolute e Tij, e pikërisht nga mënyra e përshkallëzuar me të cilën Ai na i rrëfen ato. Fillimisht, Allahu i Lartësuar tregon disa ngjarje të çuditshme, pastaj sjell të tjera që janë edhe më të çuditshme se ato të parat. Kështu, për shembull, në fillim, tregohet për ushqimin që i sillej Merjemes, pa mund e pa lodhje nga ana e saj, si dhuratë prej Zotit dhe drejtpërdrejt nga Ai. Pastaj tregohet për lindjen e Jahjas, babai i të cilit ishte i thyer në moshë, ndërsa nëna e tij ishte sterile. Më tej, vijohet me lindjen e Isait (a.s.) pa baba, pa ndërhyrjen e mashkullit.

Kjo, pa dyshim, është urtësia madhështore e Krijuesit në përkujdesjen e Tij ndaj njerëzve, që ata të besojnë dhe të binden plotësisht se Allahu është i Plotfuqishëm. Ai vepron atë që dëshiron. Nëse dëshiron që diçka të ekzistojë, ajo vjen në ekzistencë. Nëse dëshiron që diçka të mos jetë, ajo kurrë nuk ka për të ekzistuar.

Më pas, Allahu i Lartësuar na tregon më hollësisht rreth adhuruesit dhe Profetit të Tij, Isait (a.s.).

Ajetet 48 – 51

48. Ai *(Allahu)* do t'i mësojë atij Librin, Urtësinë, Teuratin dhe Ungjillin,
49. do ta çojë si profet te bijtë e Israilit *(që t'u thotë)*: "Unë kam ardhur nga Zoti juaj me argumente. Unë do të bëj nga balta diçka në formën e shpendit. Pasi t'i fryj atij, ai, me lejen e Allahut, do të bëhet shpend i vërtetë. Unë shëroj të verbërit dhe të sëmurët me lebër. Unë, me lejen e Allahut, i ngjall të vdekurit. Unë ju tregoj për atë që e hani dhe për atë që e depozitoni në shtëpitë tuaja. Vërtet, këto janë fakte të pakundërshtueshme për ju, nëse jeni besimtarë.
50. Unë do t'ju vërtetoj Teuratin, që e keni në duart tuaja, dhe do t'ju lejoj diçka që ju ishte ndaluar. Kam ardhur me argumente nga Zoti juaj, prandaj kini drojë Allahun dhe më dëgjoni mua!
51. Allahu është Zoti im dhe Zoti juaj. Atë adhurojeni, se kjo është rruga e drejtë!

Shpjegimi i ajeteve

- "Ai *(Allahu)* do t'i mësojë atij Librin, Urtësinë, Teuratin dhe Ungjillin..." - Allahu i Lartësuar na tregon se Ai do t'i mësonte Isait Librin.

Fjala 'libër' mund të kuptohet këtu në dy mënyra:

1. Librat e shenjtë hyjnorë, dhe në mënyrë të veçantë Teuratin dhe Ungjillin, për shkak të madhështisë së përmbajtjes së tyre. Ata ishin

burim drite, udhëzimi dhe ligjesh, të tillë që bijtë e Israilit të gjykonin me drejtësi. Allahu i Lartësuar do t'i mësonte Isait leximin e teksteve të shenjta, por edhe kuptimet e tyre të thella dhe të urta. Ndërsa kuptimi i dytë i fjalës 'libër' është: :

2. Shkrimi. Pra, Allahu i Lartësuar do t'i mësonte Isait aftësinë për të shkruar. Të shkruarit është nga mirësitë më të mëdha me të cilën Allahu i Lartësuar e ka privilegjuar njeriun. Për këtë arsye, Allahu i Lartësuar e përdor këtë mirësi ndaj njerëzve, si argument për të treguar mëshirën dhe përkujdesjen e Tij të madhe ndaj tyre, siç thotë në ajetet e para të shpallura nga Kur'âni madhështor: "Lexo me emrin e Zotit tënd, i Cili krijoi. Ai e krijoi njeriun prej një gjaku të ngjizur. Lexo, se Zoti yt është më bujari! Ai që e mësoi *(njeriun)* të shkruajë me pendë. Ai i mësoi njeriut atë që nuk e dinte." [Alak 1-5].

Allahu i Lartësuar i mësoi Isait edhe urtësinë. Urtësia është njohja e thellë e ligjit të Zotit. Urtësi quhet edhe vendosja e çdo gjëje në vendin që i takon. Pra, urtësia është aftësia për të gjykuar me dije dhe drejtësi. Ajo është një nga mirësitë më të mëdha që mund t'i jepet njeriut.

Më pas, Allahu i Lartësuar tregon se do ta nderonte Isain me një cilësi më të lartë se këto që u përmendën. Ai do ta dallonte atë me gradën e profetit:

- "...do ta çojë si profet te bijtë e Israilit..." - Allahu i Lartësuar e përzgjodhi Isain që të ishte Profet i Tij në atë popull të zgjedhur mbi të gjitha kombet e tjera të asaj kohe. Profeti u dërgua që t'i ftonte ata në adhurimin e një Zoti të vetëm, Allahut të Lartësuar, dhe në zbatimin e plotë të ligjeve të Zotit, të shkruar në librat e shenjtë. Allahu i Lartësuar e pajisi Isain (a.s.) me shenja dhe mrekulli të shumta, që tregonin dhe vërtetonin se ai ishte Profet i Zotit të botëve.

Prandaj Isai (a.s.) i drejtohet popullit dhe i thotë:

- "Unë kam ardhur nga Zoti juaj me argumente." – Kuptimi: Unë kam ardhur me argumente dhe mrekulli prej Zotit tuaj, që dëshmojnë se unë jam Profet i Tij dhe them të vërtetën, të cilën ju duhet të pasoni dhe t'i nënshtroheni.

Më tej përmenden disa mrekulli të Isait (a.s.), me dhuntinë e falur prej Zotit të tij.

- "Unë do të bëj nga balta diçka në formën e shpendit. Pasi t'i fryj atij, ai, me lejen e Allahut, do të bëhet shpend i vërtetë." - Kuptimi: Unë do të formoj me baltë figurën e një zogu, e cila, pasi unë t'i fryj, do të shndërrohet në një zog të vërtetë, të gjallë, që fluturon dhe jeton. E gjithë kjo do të ndodhë me lejen dhe fuqinë e Zotit tim.

- "Unë shëroj të verbërit dhe të sëmurët me lebër. Unë, me lejen e Allahut, i ngjall të vdekurit." - Me lejen dhe dhuntinë e dhënë nga Zoti im, unë shëroj ata që lindin të verbër dhe lebrozët. Unë, gjithashtu, ringjall edhe të vdekurit.

Sa herë që përmendte këto mrekulli, Isai (a.s.) nuk harronte të thoshte se gjithçka ndodhte me lejen dhe fuqinë e Allahut. Të gjitha këto mrekulli ishin dhuratë e Zotit, si shenja që vërtetonin se ai ishte Profet i vërtetë i Tij.

- "Unë ju tregoj për atë që e hani dhe për atë që e depozitoni në shtëpitë tuaja." – Pra, di gjëra të fshehta, sepse është Allahu i Lartësuar që më mundëson t'i di.

- "Vërtet, këto janë fakte të pakundërshtueshme për ju, nëse jeni besimtarë." - Të gjitha janë argumente, që ju të besoni se unë vërtet jam Profet i zgjedhur i Allahut ndër ju.

A ka shenjë më të madhe sesa të shohësh para syve që një send i pajetë të shndërrohet në një qenie të gjallë?! Po shërimi i sëmundjeve të pashërueshme?! Po ringjallja e të vdekurve dhe rrëfimet për gjërat e fshehta? Do të mjaftonte vetëm një prej këtyre mrekullive për ta besuar atë Profet.

Po kur vijnë të gjitha bashkë?! Pa dyshim që të tilla shenja duhet të të bëjnë të besosh dhe t'i nënshtrohesh udhëzimeve të Profetit.

- "Unë do t'ju vërtetoj Teuratin, që e keni në duart tuaja, dhe do t'ju lejoj diçka që ju ishte ndaluar!" - Isai (a.s.) i bën të qartë popullit të tij se ai ishte miratues dhe përforcues i ligjit të sjellë më parë prej Musait (a.s.). Pra, libri hyjnor që po i shpallej atij (Ungjilli), ishte i të njëjtit burim me Teuratin.

E përbashkëta e shpalljeve hyjnore është se të gjitha ato përmbajnë kumte të vërteta e të sigurta dhe sjellin dispozita të drejta. Ato nuk kanë asnjë kundërthënie mes njëra tjetrës. Nëse do të dallosh sharlatanët dhe shpalljet e rreme, shiko përmbajtjen e tyre dhe se për ku i ftojnë njerëzit. Ata do të jenë në kundërshtim me linjën e profetëve të Zotit dhe të shpalljeve të Tij. Mashtruesve gjithmonë u del fytyra, sepse ata bien ndesh me lajmet e vërteta dhe me shumë ligje të pandryshueshme të Zotit. Ky është tregues i mëshirës së madhe të Allahut të Lartësuar dhe i përkujdesjes së Tij për udhëzimin e krijesave, duke u mundësuar atyre dallimin e së vërtetës nga e kota. Nëse përdorin kriteret e mësipërme, krijesat nuk do të bien kurrë pre e sharlatanëve dhe profetëve të rremë. Është e vërtetë që disa çështje dytësore mund të ngatërrohen dhe njeriu mund të gabojë, por kjo është e pamundur nëse bëhet fjalë për të dalluar profetin e vërtetë nga i gënjeshtërti. Kriteret dalluese për këtë çështje janë shumë të qarta dhe të kuptueshme për këdo, dhe të tilla duhet të jenë, nëse njohim urtësinë dhe mëshirën e Allahut për krijesat. Nëse nuk do të ishte kështu, të gjitha krijesat do të devijonin. Është e pamundur që Zoti të vështirësonte dallimin e profetëve të vërtetë, ndërkohë që prej kësaj zgjedhjeje varet lumturia apo ndëshkimi i përjetshëm, Xheneti apo Xhehenemi.

Profeti i vërtetë është shumë thjesht i dallueshëm nga sharlatani. Profeti i vërtetë është një nga krijesat më të mira, ndërsa profeti i rremë është nga njerëzit më të ulët dhe më të fëlliqur. Me urtësinë dhe mëshirën e Tij, Allahu i Lartësuar ka bërë të mundur që mes tyre të ketë dallime të dukshme, në mënyrë që mund t'i kuptojë çdokush që ka logjikë e di të mendojë.

Pastaj Isai (a.s.) e mëson popullin e tij se Ungjilli përmban një ligj, i cili ka lehtësime:

- "Kam ardhur me argumente nga Zoti juaj.." – Kuptimi: Unë erdha me mrekulli nga Zoti juaj, që dëshmojnë se unë jam vërtet Profet i Allahut. Këto shenja të qarta e bëjnë të detyrueshme për ju të pasoni rrugën time dhe t'u bindeni udhëzimeve të mia, që unë i sjell prej Zotit tim. Të gjitha këto shenja kanë qëllim të kuptueshëm.

Kjo kështillë ka qenë fjala e Allahut të Lartësuar për të gjithë profetët, që ata t'ua përcillnin popujve të tyre:

- "...prandaj kini drojë Allahun..." - Pajisuni me devotshmëri ndaj Allahut, duke zbatuar urdhëresat dhe duke iu larguar ndalesave.

- "...dhe më dëgjoni mua" – M'u bindni mua në çdo porosi që ju jap, sepse bindja ndaj Profetit është bindje ndaj Allahut.

- "Allahu është Zoti im dhe Zoti juaj. Atë adhurojeni, se kjo është rruga e drejtë!" - Isai (a.s.) e provoi njëshmërinë e Allahut të Lartësuar në meritën e adhurimit me faktin se Allahu është Zoti, Krijuesi, Sunduesi i botës. Pra, ai u argumentoi atyre një të vërtetë që ata e mohohin me një fakt që ata e pranonin. Të gjithë e pranojnë se Allahu është Absolut dhe i Vetëm në aspektin e zotërimit, krijimit, furnizimit, sundimit dhe përkujdesjes ndaj krijesave.


Atëherë, fjala e Isait (a.s.) kuptohet kështu: Ashtu sikurse e pranojmë dhe e pohojmë faktin që Allahu i Lartësuar është Ai që na krijoi, që na furnizon dhe që përkujdeset për ne, duke na dhuruar shumë mirësi, po ashtu le të besojmë dhe të

pohojmë natyrshëm që Ai duhet të jetë i vetmi që të meritojë adhurimet tona. Vetëm Atij le t'ia përkushtojmë adhurimet tona. Dashuria e plotë le të jetë për Të. Të shpresojmë për faljen dhe shpërblimet e Tij të pakufishme. Frikërespekti për Të të jetë i plotë. Lutjet, mbështetja dhe kërkimi i ndihmës le t'i drejtohen vetëm Atij. Të gjitha mënyrat e adhurimit duhet t'i kushtohen vetëm Allahut.

Në ajet gjejmë një argument kundër të krishterëve, të cilët pretendojnë padrejtësisht se Isai (a.s.) është Zoti i tyre, e disa thonë që është biri i Zotit. Këto pretendime boshe dhe të padrejta hidhen poshtë nga vetë dëshmia e Isait (a.s.), që deklaronte se ishte rob, krijesë, adhurues i Zotit të tij. Vetë ai dëshmonte se ishte i nënshtruar e i krijuar, si gjithë krijesat e tjera.

Allahu i Lartësuar na e sjell dëshminë e Isait (a.s.) për veten e tij në një vend tjetër në Kur'ân: "Ai (Isai) tha: "Unë jam rob i Allahut. Ai më ka dhënë mua Librin dhe më ka bërë Profet. Ai më ka bërë dobiprurës kudo që të jem dhe më ka porositur për kryerjen e namazit dhe për zekatin për sa kohë që të jem gjallë! Ai më ka bërë të sjellshëm ndaj nënës sime, e nuk më ka bërë kryelartë as të padëgjueshëm! Selami është me mua që ditën kur u linda, ditën kur të vdes dhe ditën kur të dal *(prej varrit)* i gjallë!" Kjo është e vërteta rreth Isait, birit të Merjemes, rreth të cilit ata ngjallin dyshime. Nuk i takon Allahut që të ketë fëmijë. I pastër është Ai nga çdo e metë! Kur Ai dëshiron diçka, vetëm i thotë: "Bëhu!", dhe ajo bëhet. (*Isai i tha popullit të vet:)* Allahu është Zoti im dhe Zoti juaj, prandaj adhurojeni Atë! Kjo është rrugë e drejtë. Por grupet u kundërshtuan mes njëri-tjetrit *(rreth Isait).* Të mjerët ata që nuk besojnë, se ç'kanë për të parë Ditën e Madhe!" [Merjem 30-37].

Ose: "Kur Allahu tha: "O Isa, biri i Merjemes! Vallë, ti u the njerëzve: "Më besoni mua dhe nënën time si dy zota veç Allahut!?" Ai *(Isai)* tha: "Larg asaj të mete je Ti *(o Zoti im)!* Nuk më takon mua ta them atë


الجزء الثالث سورة آل عمران

رَبَّنَآ ءَامَنَّا بِمَآ أَنزَلْتَ وَٱتَّبَعْنَا ٱلرَّسُولَ فَٱكْتُبْنَا مَعَ
ٱلشَّٰهِدِينَ ﴿٥٣﴾ وَمَكَرُوا۟ وَمَكَرَ ٱللَّهُ ۖ وَٱللَّهُ خَيْرُ ٱلْمَٰكِرِينَ
﴿٥٤﴾ إِذْ قَالَ ٱللَّهُ يَٰعِيسَىٰٓ إِنِّى مُتَوَفِّيكَ وَرَافِعُكَ إِلَىَّ وَمُطَهِّرُكَ
مِنَ ٱلَّذِينَ كَفَرُوا۟ وَجَاعِلُ ٱلَّذِينَ ٱتَّبَعُوكَ فَوْقَ ٱلَّذِينَ
كَفَرُوٓا۟ إِلَىٰ يَوْمِ ٱلْقِيَٰمَةِ ۖ ثُمَّ إِلَىَّ مَرْجِعُكُمْ فَأَحْكُمُ
بَيْنَكُمْ فِيمَا كُنتُمْ فِيهِ تَخْتَلِفُونَ ﴿٥٥﴾ فَأَمَّا ٱلَّذِينَ كَفَرُوا۟
فَأُعَذِّبُهُمْ عَذَابًا شَدِيدًا فِى ٱلدُّنْيَا وَٱلْءَاخِرَةِ وَمَا لَهُم
مِّن نَّٰصِرِينَ ﴿٥٦﴾ وَأَمَّا ٱلَّذِينَ ءَامَنُوا۟ وَعَمِلُوا۟ ٱلصَّٰلِحَٰتِ
فَيُوَفِّيهِمْ أُجُورَهُمْ ۗ وَٱللَّهُ لَا يُحِبُّ ٱلظَّٰلِمِينَ ﴿٥٧﴾ ذَٰلِكَ نَتْلُوهُ
عَلَيْكَ مِنَ ٱلْءَايَٰتِ وَٱلذِّكْرِ ٱلْحَكِيمِ ﴿٥٨﴾ إِنَّ مَثَلَ
عِيسَىٰ عِندَ ٱللَّهِ كَمَثَلِ ءَادَمَ ۖ خَلَقَهُۥ مِن تُرَابٍ ثُمَّ قَالَ لَهُۥ
كُن فَيَكُونُ ﴿٥٩﴾ ٱلْحَقُّ مِن رَّبِّكَ فَلَا تَكُن مِّنَ ٱلْمُمْتَرِينَ
﴿٦٠﴾ فَمَنْ حَآجَّكَ فِيهِ مِنۢ بَعْدِ مَا جَآءَكَ مِنَ ٱلْعِلْمِ فَقُلْ تَعَالَوْا۟
نَدْعُ أَبْنَآءَنَا وَأَبْنَآءَكُمْ وَنِسَآءَنَا وَنِسَآءَكُمْ وَأَنفُسَنَا
وَأَنفُسَكُمْ ثُمَّ نَبْتَهِلْ فَنَجْعَل لَّعْنَتَ ٱللَّهِ عَلَى ٱلْكَٰذِبِينَ ﴿٦١﴾

٥٧

që s'është e vërtetë. Po ta kisha thënë atë, ti do ta dije. Ti e di se çfarë ka në shpirtin tim, ndërsa unë nuk e di atë që është tek Ty. Ti je Njohësi i të fshehtave!" Unë nuk u kam thënë atyre asgjë tjetër, veç asaj që Ti më urdhërove: "Ta adhuroni Allahun, Zotin tim dhe Zotin tuaj!" Unë isha dëshmues i tyre, sa isha ndër ta. Por pasi më more mua, Ti ishe mbikëqyrës i tyre . Ti je dëshmues i çdo gjëje!" Nëse i dënon ata, në të vërtetë ata janë robërit e Tu. E nëse i fal ata, Ti je Krenari, i Urti." [Maide 116-120].

- "...kjo është rruga e drejtë!" - Adhurimi i Allahut si një i vetëm, devotshmëria ndaj Tij, bindja e plotë ndaj Tij dhe Profetit të Tij, të gjitha këto janë rruga e drejtë dhe e vetmja që të mundëson të arrish tek Allahu i Lartësuar. Çdo rrugë tjetër të çon veçse në zjarrin e Xhehenemit.

Ajetet 52 – 54

52. Kur e kuptoi Isai vendosmërinë e tyre në mosbesim, tha: "Kush do të jetë ndihmësi im në rrugën e Allahut?" Dishepujt e tij thanë: "Ne do të jemi ndihmëtarë të Allahut. Ne e besojmë Allahun, ndaj ti dëshmo për ne që jemi muslimanë!"
53. Zoti ynë, ne e besojmë atë që ke shpallur dhe e pasojmë të Dërguarin *(Isain)*. Na bashko me ata që dëshmojnë!"
54. Ata përgatitën një kurth, por edhe Allahu përgatiti një kurth. Allahu është planifikuesi më i mirë.

Shpjegimi i ajeteve

- "Kur e kuptoi Isai vendosmërinë e tyre në mosbesim, tha: "Kush do të jetë ndihmësi im në rrugën e Allahut?" – Kështu, Isai (a.s.) vuri re tek ata mosbindje. Jo vetëm kaq, por ata lëshuan edhe shpifje e fyerje kundër tij, duke thënë që mrekullitë që ai shfaqte ishin magji. Madje, ata u përpoqën edhe që ta vrisnin. Kur Isai (a.s.) vërejti një sjellje të tillë, tha: "Kush do të jenë ndihmëtarët e mi për të vazhduar në rrugën e Zotit? Kush do të më ndihmojë mua që të përhapim fenë e Zotit?"

- "Dishepujt e tij thanë: "Ne do të jemi ndihmëtarë të Allahut. Ne e besojmë Allahun, ndaj ti dëshmo për ne që jemi muslimanë!" - Dishepujt, pra, nxënësit e Isait (a.s.) thanë: "Ne do të jemi ndihmësit e (rrugës së) Allahut". Dhe, vërtet, ata ia përkushtuan jetën e tyre këtij misioni. Ata thanë:

- "Zoti ynë, ne e besojmë atë që ke shpallur dhe e pasojmë të Dërguarin *(Isain)*. Na bashko me ata që dëshmojnë!" - Ne e besojmë të vërtetën që Ti ke shpallur dhe e pasojmë me besnikëri Profetin Tënd, prandaj na shkruaj edhe neve mes atyre që quhen dëshmues të drejtë.

Asnjë dëshmi nuk mund të jetë më e drejtë dhe më e dobishme, sesa dëshmia për njëshmërinë e Allahut në meritën e adhurimit dhe dëshmia për besim të plotë ndaj Profetit dhe për të vepruarit sipas këtij besimi. Kjo ishte dëshmia e tyre e madhe, prej së cilës merituan që Allahu i Lartësuar t'i nxirrte faqebardhë dhe triumfues mbi ata që nuk pranonin të besonin dhe të pasonin rrugën e Profetit të tyre.

Më tej, i Madhëruari thotë:

- "Ata përgatitën një kurth, por edhe Allahu përgatiti një kurth. Allahu është planifikuesi më i mirë." - Mohuesit dhe refuzuesit e udhëzimit të Allahut bënë plane dhe ngritën kurthe për të vrarë Profetin dhe për të shuar dritën e Allahut, por Allahu është planifikuesi më i mirë, prandaj ua ktheu kurthet që ata ngritën me kurthe kundër vetë tyre.

Ajetet 55 – 58

55. Kur Allahu tha: "O Isa! Unë po të marr ty, po të ngre tek Unë dhe po të shpëtoj prej sherrit të atyre që nuk besojnë. Kurse ata që të besojnë ty do t'i lartësoj mbi ata që mohojnë, deri në Ditën e Kijametit. Pastaj, vetëm tek Unë është kthimi juaj, dhe Unë do të gjykoj mes jush për ato çështje që ju keni patur mosmarrëveshje".
56. Për sa u përket atyre që nuk besojnë, Unë do t'i ndëshkoj ashpër në këtë botë dhe në botën tjetër, dhe ata nuk do të kenë ndihmësa.
57. E për sa u përket atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, atyre do t'ua jap shpërblimin të plotë. Allahu nuk i do të padrejtët.
58. Këto që po të lexojmë ty janë ajete dhe përkujtim i urtë.

Shpjegimi i ajeteve

- "Kur Allahu tha: "O Isa! Unë po të marr ty, po të ngre tek Unë dhe po të shpëtoj prej sherrit të atyre që nuk besojnë." –

Kështu, Allahu i Lartësuar e ngriti Isain (a.s.), Profetin dhe adhuruesin e Tij të sinqertë, pranë Vetes. Allahu i Lartësuar bëri që pamja ose shëmbëlltyra e Isait (a.s.) t'i vihej dikujt tjetër. Në këtë mënyrë, armiqtë e Profetit morën atë tjetrin, që mori pamjen e Isait (a.s.), e vranë dhe pastaj e mbërthyen. Megjithatë, ndëshkimi që i pret ata do të jetë shumë i rëndë, sepse ata patën si qëllim vrasjen e Profetit dhe për atë gjë do të shpaguhen.

Allahu i Lartësuar thotë në një ajet tjetër: "Unë po të ngre pranë Meje" [Nisa 157,158]. Kjo fjali tregon se Allahu është lart, mbi Fron. Qëndrimi i Tij mbi Fron është diçka e vërtetë dhe nuk ka nevojë për interpretime e devijime. Këtë fakt e konfirmojnë shumë tekste të sigurta e të sakta nga Kur'âni dhe Suneti.

Allahu i Lartësuar është Krenar, i Plotfuqishëm dhe Sunduesi i gjithçkaje. Ishte Ai që ua mbajti dorën, ua prishi planet bijve të Israilit, që donin të vrisnin profetin Isa, të zgjedhurin e Tij. Asgjë nuk mund t'i pengonte ata nga vrasja e Isait, veç të Madhërishmit e Krenarit. Allahu i Lartësuar thotë: "Allahu i Lartësuar është i Urtë. Ishte urtësia e Tij që vuri shëmbëllimin e Isait mbi dikë tjetër dhe i la bijtë e Israilit të mashtroheshin, duke menduar se vranë Profetin." [Maide 110]. Ose: "Përkundrazi, Allahu e ngriti atë pranë Vetes. Allahu është Krenar, i Urtë." [Nisa 158].

Pastaj thotë Allahu i Lartësuar

- "Kurse ata që të besojnë ty do t'i lartësoj mbi ata që mohojnë, deri në Ditën e Kijametit". - Sikurse u tha më lart, Allahu i Lartësuar i ndihmoi pasuesit e vërtetë të Isait për të qëndruar në fenë e Tij. Dëshmi tjetër që tregon se Allahu i ndihmoi pasuesit e Isait kundër çifutëve është edhe fakti që të krishterët kanë qëndruar gjithmonë mbi çifutët dhe i kanë shtypur ata. Megjithatë, kur ata devijuan të gjithë nga rruga e drejtë e Isait (a.s.), Allahu i Lartësuar dërgoi Profetin e mëshirës, Muhamedin (a.s.), i cili, bashkë me pasuesit e tij të denjë, do të bëheshin pasuesit e vërtetë të udhëzimit të sjellë nga Isai (a.s.). Dhe, vërtet, ndihma e Allahut ka qenë gjithmonë e dukshme për këtë bashkësi kundër çdo ngjyre të kufrit. Muslimanët kanë triumfuar gjithmonë kundër çifutëve, të krishterëve dhe të gjithë llojeve të mohuesve të Zotit. Edhe nëse në ndonjë periudhë të shkurtër mund të vërejmë se mohuesit, qofshin ata të krishterë, çifutë etj., fitojnë mbi muslimanët, kjo ndodh me lejen e Zotit dhe urtësinë e Tij, për të udhëzuar muslimanët që t'i kthehen fesë së tyre, sepse pikërisht për shkak të devijimit dhe lëshimit të fesë së Zotit vjen humbja dhe dështimi.

- "Pastaj, vetëm tek Unë është kthimi juaj, dhe Unë do të gjykoj mes jush për ato çështje që ju keni patur mosmarrëveshje". - Të gjithë pretendojnë se e vërteta është me ta. Të gjithë pretendojnë se kanë të drejtë dhe se të tjerët janë të gabuar. Por asnjë pretendim nuk mund të pranohet pa u provuar dhe argumentuar. I vetmi pretendim i pranuar është ai që argumentohet qartë dhe saktë, dhe i vetmi që do të gjykojë për këtë çështje është Allahu i Urtë dhe i Drejtë.

- "Për sa u përket atyre që nuk besojnë, Unë do t'i ndëshkoj ashpër në këtë botë dhe në botën tjetër, ..." - Për sa i përket ndëshkimit në jetën e dynjasë, ai është shumë i dukshëm dhe çdokush e vëren atë, në çdo kohë. Ai shfaqet me shkatërrime e fatkeqësi të mëdha, të cilat quhen rëndom "fatkeqësi natyrore". Ai shfaqet edhe në formën e poshtërsive apo shfarosjes së njerëzve nëpërmjet luftrave. Të gjitha këto janë shumë pak, në krahasim me ndëshkimin që i pret ata në jetën tjetër të pasosur. Ai është tmerri, fatkeqësia dhe dëshpërimi më i madh. Ai është zjarri i Xhehenemit dhe zemërimi i Krenarit, të Plotfuqishmit, të Pamposhturit. Ai është humbja e përjetshme e mundësisë për të shijuar mirësitë e besimtarëve dhe

shpërblimin e mrekullueshëm të Allahut të Lartësuar.

- "...dhe ata nuk do të kenë ndihmësa" - Askush nuk do t'i ndihmojë ata që të shpëtojnë prej ndëshkimit të merituar. Madje, edhe ata që në këtë jetë i mendojnë si ndërmjetësues tek Allahu, nuk do të mund t'u bëjnë aspak dobi. Të pafuqishëm do të jenë edhe miqtë dhe të dashurit e tyre, të cilët i adhurojnë përveç Allahut. Të gjithë janë të pafuqishëm për të ndihmuar ndonjë, madje as veten e tyre.

- "E për sa u përket atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, atyre do t'ua jap shpërblimin të plotë." - Tjetër gjykim kanë pjesa tjetër, të cilët plotësojnë disa kushte:
1. Ata besojnë gjithçka që duhet besuar, që Zoti dhe Profeti i Tij kanë urdhëruar të besohet. Pra, ata besojnë Allahun, të gjithë profetët, shpalljet hyjnore, Ditën e Ringjalljes etj.
2. Ata bëjnë vepra të mira. Dihet që veprat mund të quhen "të mira" vetëm nëse plotësojnë dy kushte: së pari, të kryen me sinqeritet për Allahun e Lartësuar, pra, vetëm për të kënaqur Atë dhe, së dyti, të jenë sipas mësimeve dhe udhëzimeve të sjella nga Profeti (a.s). Ato duhet t'i ketë porositur dhe përshkruar Profeti plotësisht dhe saktësisht, dhe të jetë transmetuar deri tek ne në mënyrë të sigurt dhe të qartë. Kështu, fatlumët që besuan të vërtetën që u erdhi nga Zoti i tyre dhe punuan sipas saj, ata do të kenë tjetër shpërblim, ndryshe nga të parët. Allahu i Lartësuar, për të përshkruar shpërblimin e tyre, thotë: "*ju-uef-fîhim uxhûrahum*" – "...ua jap shpërblimin të plotë". Kjo tregon se ata do ta shijojnë që në dynja shpërblimin e veprave të mira, i cili shfaqet në shumë forma. Krenaria, lumturia, fama, nderimi e respekti ndër njerëz janë shenja të shpërblimit të Allahut për veprat e mira që në këtë jetë. Ndihma e Allahut, suksesi dhe fitorja mbi armiqtë janë gjithashtu shenja të shpërblimit. Jeta e këndshme, e lumtur, e gëzuar, larg brengave e anktheve janë tregues të tjerë të shpërblimit të Allahut. Megjithatë, shpërblimi i plotë për veprat e mira do të jetë në jetën tjetër, në Ditën e Gjykimit. Për çdo të mirë që bëhet me sinqeritet për Allahun e Lartësuar dhe sipas mësimeve dhe udhëzimeve të Profetit, do të jepet shpërblimi më i plotë dhe më i bukur, ashtu siç di të shpërblejë i Mëshirshmi, Bamirësi, Mirënjohësi e Bujari. Madje, përveç shpërblimit të merituar, do të jepet edhe shtesë mbi të, sepse shpërblyesi është Allahu Bujar dhe i Mëshirshëm.

- "Allahu nuk i do të padrejtët." – Madje, Allahu i Lartësuar e urren padrejtësinë dhe të padrejtët dhe për ta ka përgatitur ndëshkimin e Tij të drejtë. Mbi ta do të godasë me drejtësi zemërimi i Tij.

- "Këto që po të lexojmë ty janë ajete dhe përkujtim i urtë" - Shpallja e këtyre ajeteve është një mirësi e jashtëzakonshme që iu dhurua Muhamedit (a.s.) nga Zoti i botëve. Këto ajete janë një mirësi e madhe edhe për këtë popull të zgjedhur, që ndjek rrugën e Profetit të mëshirës.

Allahu i Lartësuar e ka quajtur këtë Shpallje me një fjalë madhështore: "*Dhikrul Hakîm*" – "përkujtim i urtë". Kur'âni është absolutisht i urtë, i saktë, i sigurt dhe i vërtetë në gjithçka që përmban. Ligjet e tij, që tregojnë kufijtë e Zotit, janë të sqaruara me hollësi. Ngjarjet e shkuara dhe të ardhme vijnë me vërtetësi dhe saktësi. Në të rrëfehen historitë e profetëve të Zotit dhe popujve të tyre. Aty tregohen mrekullitë e profetëve, të cilat Zoti ua dha atyre, që popujt të besonin dhe t'u bindeshin urdhrave e udhëzimeve të tyre. Me pak fjalë, Kur'âni na tregon gjithçka që kemi nevojë të dimë, qoftë nga ngjarjet e së shkuarës dhe të së ardhmes, qoftë nga ligjet dhe dispozitat e domosdoshme për njerëzit, për të qenë të lumtur dhe në paqe me Krijuesin, me veten dhe me të tjerët. Nga Kur'âni përfitohen mësime, merret përvojë

dhe forcohet besimi në zemrat e krijesave, prandaj ai është mirësia më e madhe e Zotit të botëve mbi krijesat e Tij.

Ajetet 59 – 60

59. Vërtet, çështja e Isait *(të lindur pa baba)* për Allahun, është sikurse çështja e Ademit, të cilin Ai e krijoi nga dheu, e pastaj i tha: "Bëhu!" dhe ai u bë.
60. E vërteta e sigurt është nga Zoti yt, e ti mos u bëj kurrë nga ata që dyshojnë.

Shpjegimi i ajeteve

- "Vërtet, çështja e Isait *(të lindur pa baba)* për Allahun, është sikurse çështja e Ademit, të cilin Ai e krijoi nga dheu, e pastaj i tha: "Bëhu!" dhe ai u bë." - Allahu i Lartësuar sjell një argument shumë të thjeshtë dhe të kuptueshëm për t'u qartësuar të krishterëve gabimin e tyre trashanik dhe të papranueshëm. Ata thonë për Isain (a.s.) diçka të pavërtetë, duke mos pasur asnjë argument ku mund të mbështeten, madje atyre nuk u lejohet as ta mendojnë një gjë të tillë.

Shikoni se çfarë argumentimi qesharak bëjnë të krishterët për të vërtetuar se Isai (a.s.) është "bir" i Zotit. Sipas tyre, meqë Isai (a.s.) nuk pati baba biologjik, atëherë ai ishte biri i Zotit dhe, si i tillë, ai ka cilësi të njëjta me Atin. *Subhanallah*! Ky nuk vlen të quhet as keqkuptim, jo më të jetë një argument i mirëfilltë për një temë kaq delikate.

Ne mund të themi të njëjtën gjë edhe për krijesat e tjera të Zotit. Ato janë thjesht krijesa të të Plotfuqishmit. Ato tregojnë se i vetmi Krijues e Furnizues, që përkujdeset për ta dhe administron çështjet e tyre është Allahu Absolut e Madhështor. Të gjitha shkaqet dhe pasojat i nënshtrohen dëshirës dhe vullnetit të Tij të padiskutueshëm. Asgjë nuk del jashtë vullnetit të Tij.

Të krishterët mendojnë se lindja e Isait (a.s.) pa baba biologjik është argument mbështetës i tezës së tyre të çmendur, ndërkohë që, faktikisht, ai është argument kundër tyre. Ai tregon se Allahu i Lartësuar dhe i Gjithëpushtetshëm është aq i Madhërishëm në pushtetin dhe mbretërimin e Tij saqë askush nuk mund t'i afrohet në emrat, cilësitë dhe veprat e Tij. Them nuk mund t'i afrohet, e jo më të jetë i njëjtë me Të!

Allahu i Lartësuar ka krijuar diçka më të çuditshme sesa Isain. Ai e krijoi Ademin (a.s.) prej dheu, pa nënë dhe pa baba. Atëherë, nëse Ademi nuk mund të jetë fëmijë i Zotit dhe i barabartë me Të, pse duhet që të jetë Isai (a.s.)?! Duke përdorur logjikën e tyre foshnjore, duhet ta pranonim Ademin si fëmijë të Zotit dhe të barabartë me Të. Por nëse nuk e pranojmë një gjë të tillë për Ademin (a.s.), atëherë për Isain nuk duhet të kenë diskutime, sepse ai të paktën e kishte një nënë. Prandaj thotë i Lartësuari:

- "E vërteta e sigurt është nga Zoti yt" - E vërteta në të tilla raste mund të sqarohet veçse me argumente të sigurta nga Allahu i Lartësuar, që di gjithçka. Kumti i sigurt që na ka ardhur prej Allahut të Lartësuar, është e vërteta e padiskutueshme, sepse ajo është shpallje e Zotit të gjithësisë. Kjo shpallje e sigurt dhe e ruajtur bën pjesë në ato mirësi dhe dhurata të shumta të Allahut të Lartësuar, që tregojnë përkujdesjen e veçantë për Profetin e Tij të zgjedhur dhe pasuesit e tij të denjë. Të tilla janë të gjitha rrëfimet rreth profetëve të Zotit në kohëra. Duke marë parasysh këto, nuk ka asnjë arsye për të dyshuar në vërtetësinë e tyre. Megjithatë, Allahu i Lartësuar e përforcon një gjykim të tillë, kur thotë:

- "...e ti mos u bëj kurrë nga ata që dyshojnë." – Pra, asnjëherë mos ki dyshime rreth saktësisë së Shpalljes nga Zoti yt. Të jesh i sigurt se vetëm ajo është e vërteta, ndërsa gjithçka tjetër është mashtrim.

Ky ajet dhe të tjerë si ai vërtetojnë rregullin e mrekullueshëm, që thotë: Nëse argumentet e sakta vërtetojnë se një çështje apo një mendim i caktuar është i vërtetë,

qoftë në temat e besimit, qoftë në temat e tjera, atëherë është detyrë për njeriun që, çdo mendim tjetër që bie ndesh me këtë mendim të saktë dhe të argumentuar ai ta refuzojë dhe ta gjykojë si të gabuar dhe të papranueshëm. Çfarëdo dyshimi që mund të hidhet rreth asaj çështjeje është i padrejtë dhe i pavlefshëm. Po ashtu, pamundësia e dikujt për të hedhur poshtë dyshimet mbi një çështje të argumentuar saktë, të cilën ai e mbron, nuk tregon se ajo çështje nuk qëndron. Një gjë është e sigurt: gjithçka që kundërshton të vërtetën e sigurt është e kotë dhe e gënjeshtërt (edhe nëse nuk je në gjendje të argumentosh kotësinë e saj). I Lartësuari thotë: "E çfarë pret të gjesh pas të vërtetës?!" [Junus 32].

Me këtë rregull të mrekullueshëm, besimtari gjen prehje dhe qetësi nga shumë dyshime të ngritura nga filozofët. Njeriu nuk është i detyruar që t'u japë përgjigje dhe të zgjidhë çdo dyshim që ata shfaqin. Nëse njeriu u jep përgjigje të gjitha dyshimeve të tyre, kjo tregon për mjeshtërinë e tij në argumentim, por ai nuk e ka detyrë një gjë të tillë. E domosdoshme për njeriun është që të njohë të vërtetën dhe ta sqarojë atë me argumente bindëse dhe të kuptueshme. Po ashtu, ai duhet t'i ftojë të tjerët që ta pasojnë këtë të vërtetë, të mbështetur në argumente të sigurta dhe të qarta.

Ajetet 61 – 63

61. Atyre që të kundërshtojnë ty në çështjen e tij *(Isait)*, pasi iu është bërë e ditur e vërteta, thuaju: "Ejani t'i thërrasim bijtë tanë dhe bijtë tuaj, gratë tona dhe gratë tuaja, vetë ne dhe vetë ju, dhe sinqerisht të lutemi për mallkim. Le të bjerë mallkimi i Allahut kundër gënjeshtarëve!".
62. S'ka dyshim se kjo është e vërteta. Nuk ka asnjë zot tjetër përveç Allahut. Allahu është i Plotfuqishmi dhe i Urti
63. E nëse ata refuzojnë, atëherë Allahu di gjithçka për të padrejtët.

Shpjegimi i ajeteve

- "Atyre që të kundërshtojnë ty në çështjen e tij *(Isait)*, pasi iu është bërë e ditur e vërteta..." - Allahu i Lartësuar i bën të ditur Pejgamberit (a.s.) se, pas ardhjes së argumenteve të qarta, çdokush që polemizonte me të rreth çështjes së Isait (a.s.), duke pretenduar se ai *(Isai)* ishte i barabartë me vetë Allahun, është i padrejtë dhe kryeneç, që mohon të vërtetën. Allahu na ka treguar se Isai (a.s.) ishte një prej krijesave të Tij, adhurues i sinqertë dhe Profet nga më të nderuarit dhe të zgjedhurit. Me njerëzit të cilët e shpërfillin të vërtetën e ardhur prej Zotit nuk vlen më diskutimi dhe argumentimi, sepse ata nuk diskutojnë për të arritur të vërtetën, por thjesht për të kundërshtuar e për të treguar veten. Nga diskutime të tilla nuk përfiton askush, prandaj Allahu i Lartësuar na ka udhëzuar që të ndjekim një tjetër rrugë me kësi njerëzish.

- "...thuaju: "Ejani t'i thërrasim bijtë tanë dhe bijtë tuaj, gratë tona dhe gratë tuaja, vetë ne dhe vetë ju..." - Allahu i Lartësuar e urdhëroi Profetin e Tij që t'i ftonte ata arrogantë në një sfidë të hapur, që quhet *mubâheleh*.

Mubâheleh do të thotë: grumbullimi i dy grupeve kundërshtare në një vend, që të lusin Allahun e Lartësuar që ta mallkojë dhe ta ndëshkojë atë grup që është gënjeshtar në pretendimin e tij. Të dyja palët duhet të marrin me vete fëmijët, gratë dhe njerëzit më të dashur të tyre.

- "...dhe sinqerisht të lutemi për mallkim. Le të bjerë mallkimi i Allahut kundër gënjeshtarëve!" - Profeti (a.s.) i ftoi ata në një procedurë të tillë, pasi ata nuk pranuan argumentimin dhe faktet e qarta të sjella prej tij. Por ata nuk e pranuan këtë sfidë të Profetit (a.s.). E si mund të pranonin një sfidë të tillë, kur e dinin se kjo do të thoshte që të shfaroseshin totalisht me gjithë familjet

e tyre, duke u ndëshkuar kështu që në këtë jetë!

Ata pranuan që të qëndronin në fenë e tyre, edhe pse ishin të sigurt për kotësinë e saj. Një sjellje e tillë dëshmon për poshtërsinë dhe motivin e sëmurë që fshihej brenda zemrave të tyre. Për këtë arsye, i Madhëruari thotë:

- "E nëse ata refuzojnë, atëherë Allahu di gjithçka për të padrejtët..." - Allahu e dinte shumë mirë se çfarë fshihnin në zemër ata përhapës të shkatërrimit në tokë, prandaj do t'i ndëshkojë ata ashtu sikurse e meritojnë.

- "S'ka dyshim se kjo është e vërteta." - Kjo është e vërteta e padiskutueshme. Çdo gjë tjetër që bie ndesh me të është shpifje dhe gënjeshtër.


- "Nuk ka asnjë zot tjetër përveç Allahut." - Ai është Zoti që meriton të gjitha adhurimet tona. Allahu është i vetmi që meriton të adhurohet me dashuri, me durim dhe nënshtrim total. Askush tjetër nuk meriton asnjë grimcë adhurimi, përkushtimi e bindjeje totale, sepse:

- "Allahu është i Plotfuqishmi dhe i Urti" - Allahu është *El Azîz*, Krenar, i Plotfuqishëm, i Pamposhtur. Çdo gjë i është nënshtruar madhështisë dhe krenarisë së Tij.

Allahu është *El Hakîm*, i Urtë. Ai vendos gjithçka në vendin që i takon. Me urtësinë e Tij të madhe, Ai sprovon besimtarët me jobesimtarët, sepse kështu shfaqet dashuria dhe sakrifica e besimtarëve për Zotin e tyre. Për hir të Zotit të tyre, ata luftojnë dhe polemizojnë me qafirët me argumente dhe me Librin e ndritur të dhuruar nga Zoti i gjithësisë.

Ajeti 64

64. Thuaju *(o i Dërguar)*: "O ithtarë të Librit! Ejani *(të bashkohemi)* në një fjalë të vetme, mes nesh dhe mes jush: "Të mos adhurojmë asnjë tjetër, veç Allahut. Le të mos i bëjmë pjesë askujt në adhurimet që


الجزء الثالث سورة آل عمران

إِنَّ هَٰذَا لَهُوَ ٱلْقَصَصُ ٱلْحَقُّ ۚ وَمَا مِنْ إِلَٰهٍ إِلَّا ٱللَّهُ ۚ وَإِنَّ ٱللَّهَ لَهُوَ
ٱلْعَزِيزُ ٱلْحَكِيمُ ﴿٦٢﴾ فَإِن تَوَلَّوْا۟ فَإِنَّ ٱللَّهَ عَلِيمٌۢ بِٱلْمُفْسِدِينَ
﴿٦٣﴾ قُلْ يَٰٓأَهْلَ ٱلْكِتَٰبِ تَعَالَوْا۟ إِلَىٰ كَلِمَةٍ سَوَآءٍۭ بَيْنَنَا
وَبَيْنَكُمْ أَلَّا نَعْبُدَ إِلَّا ٱللَّهَ وَلَا نُشْرِكَ بِهِۦ شَيْـًٔا وَلَا يَتَّخِذَ
بَعْضُنَا بَعْضًا أَرْبَابًا مِّن دُونِ ٱللَّهِ ۚ فَإِن تَوَلَّوْا۟ فَقُولُوا۟ ٱشْهَدُوا۟
بِأَنَّا مُسْلِمُونَ ﴿٦٤﴾ يَٰٓأَهْلَ ٱلْكِتَٰبِ لِمَ تُحَآجُّونَ فِىٓ إِبْرَٰهِيمَ
وَمَآ أُنزِلَتِ ٱلتَّوْرَىٰةُ وَٱلْإِنجِيلُ إِلَّا مِنۢ بَعْدِهِۦٓ ۚ أَفَلَا تَعْقِلُونَ
﴿٦٥﴾ هَٰٓأَنتُمْ هَٰٓؤُلَآءِ حَٰجَجْتُمْ فِيمَا لَكُم بِهِۦ عِلْمٌ فَلِمَ
تُحَآجُّونَ فِيمَا لَيْسَ لَكُم بِهِۦ عِلْمٌ ۚ وَٱللَّهُ يَعْلَمُ وَأَنتُمْ
لَا تَعْلَمُونَ ﴿٦٦﴾ مَا كَانَ إِبْرَٰهِيمُ يَهُودِيًّا وَلَا نَصْرَانِيًّا
وَلَٰكِن كَانَ حَنِيفًا مُّسْلِمًا وَمَا كَانَ مِنَ ٱلْمُشْرِكِينَ ﴿٦٧﴾
إِنَّ أَوْلَى ٱلنَّاسِ بِإِبْرَٰهِيمَ لَلَّذِينَ ٱتَّبَعُوهُ وَهَٰذَا ٱلنَّبِىُّ وَٱلَّذِينَ
ءَامَنُوا۟ ۗ وَٱللَّهُ وَلِىُّ ٱلْمُؤْمِنِينَ ﴿٦٨﴾ وَدَّت طَّآئِفَةٌ مِّنْ أَهْلِ ٱلْكِتَٰبِ
لَوْ يُضِلُّونَكُمْ ۖ وَمَا يُضِلُّونَ إِلَّآ أَنفُسَهُمْ وَمَا يَشْعُرُونَ ﴿٦٩﴾ يَٰٓأَهْلَ
ٱلْكِتَٰبِ لِمَ تَكْفُرُونَ بِـَٔايَٰتِ ٱللَّهِ وَأَنتُمْ تَشْهَدُونَ ﴿٧٠﴾
٥٨

ia përkushtojmë Atij. Le të mos e konsiderojmë njëri-tjetrin si zota përveç Allahut!" E në qoftë se ata refuzojnë, thoni: "Dëshmoni se ne jemi muslimanë!"

Shpjegimi i ajetit

- "Thuaju *(o i Dërguar)*: "O ithtarë të Librit! Ejani *(të bashkohemi)* në një fjalë të vetme, mes nesh dhe mes jush" - Allahu i Lartësuar na mëson që t'i ftojmë ithtarët e Librit të bashkohen në një fjalë të vetme, për të cilën kanë rënë dakord të gjithë profetët e Zotit. Këtë fjalë e kanë kundërshtuar veçse armiqtë e Zotit, arrogantët e humbur. Ajo është e përbashkët për të gjithë ne, dhe askush nga ne nuk duhet ta kundërshtojë.

E tillë është metoda që duhet të ndiqet në mënyrën e debatit me të tjerët: fillimisht, le të biem dakord për pikat e përbashkëta, të pranuara nga të gjithë.

Kjo fjalë e përbashkët, pra, e cila pranohet nga të gjithë është pohimi që: askush nuk meriton të adhurohet veç Allahut, të Vetmit,

Absolutit, Zotit të botëve, siç thuhet në vijim:

- "Të mos adhurojmë asnjë tjetër, veç Allahut. Le të mos i bëjmë pjesë askujt në adhurimet që ia përkushtojmë Atij." – Ejani, pra, që të adhurojmë vetëm Allahun dhe vetëm Atij t'i përkushtohemi, duke i shprehur dashurinë, nënshtrimin e bindjen tonë të plotë ndaj Tij. Vetëm Atij t'i shprehim frikërespektin, vetëm prej Tij të shpresojmë dhe të kërkojmë ndihmë, mbështetje dhe udhëzim. Adhurimi, dashuria, madhërimi, frika, shpresa, duhet t'i përkushtohen vetëm Atij, e asgjëje tjetër.

- "Le të mos e konsiderojmë njëri-tjetrin si zota përveç Allahut!" - Asnjë e asgjë tjetër, përveç Allahut, të mos e pranojmë si Zotin tonë. Bindja dhe nënshtrimi duhet të jenë vetëm për Allahun e Lartësuar dhe udhëzimet e sjella prej Profetit (a.s.). Të mos pranojmë t'u bindemi krijesave duke kundërshtuar Krijuesin, sepse kjo do të thotë që krijesave t'u japësh gradën e Krijuesit, kur dihet që Allahu është i Vetëm e i Pashoq në zotërimin e Tij. Vetëm Ai është i Pushtetshmi, i Cili urdhëron dhe ndalon, shpërblen dhe ndëshkon me drejtësi. Vetëm Ai është Sunduesi, të Cilit i takon bindja dhe nënshtrimi i plotë.

Nëse ithtarët e Librit e pranojnë këtë ftesë tuajën, atëherë ata janë si ju dhe kanë të njëjtat përgjegjësi dhe të drejta si ju. Por nëse nuk i pranojnë këto parime të drejta, të sjella nga të gjithë profetët, atëherë dijeni se ata janë arrogantë e të pabindur.

- "E në qoftë se ata refuzojnë, thoni: "Dëshmoni se ne jemi muslimanë!" - Të tillëve mjafton t'u dëshmoni se ju jeni muslimanë (të dorëzuar dhe të nënshtruar ndaj një Zoti të vetëm).

Dobia e ftesës së tyre në pranimin e parimeve të tilla themelore, ndoshta është një qartësim më i madh për ta dhe nxitje e tyre për të menduar më thellë. Ndoshta ata do të përfitojnë nga dija e sigurt e muslimanëve rreth parimeve të të gjithë profetëve. E nëse nuk përfitojnë, atëherë ajo e hedh poshtë justifikimin e arrogantëve para Zotit. Pas një sqarimi të tillë, në fakt, atyre nuk u mbetet asnjë justifikim për të shpëtuar nga ndëshkimi i merituar që do t'u japë Allahu.

Pastaj, kur ju që e dini të vërtetën, dëshmoni se jeni bërë muslimanë, pra, jeni dorëzuar dhe jeni të nënshtruar ndaj një Zoti të vetëm, të tjerët janë të parëndësishëm, refuzimi i të cilëve dëmton veçse ata. Allahu i Lartësuar thotë në një ajet tjetër: "Thuaj: "I besoni ju atij apo nuk i besoni, ata që u është dhënë dija para tij bëjnë sexhde me fytyra përtokë, kur ai u lexohet, dhe thonë: "I Lartësuar është Zoti ynë! Premtimi i Zotit tonë është realizuar." Ata bëjnë sexhde me fytyra përtokë duke qarë *(kur dëgjojnë Kur'ânin),* dhe ai ua shton edhe më tepër përuljen *(ndaj Allahut)."* [Isra 107-109].

Një dobi tjetër që përfitohet nga debatet me mohuesit është edhe fakti që, duke respektuar argumentimin e qartë e të saktë, besimtari përtërin besimin dhe bindjen e tij. Ai e shfaq hapur dhe me krenari Islamin, sepse besimi i tij është i ndërtuar mbi një siguri të plotë. Në këtë mënyrë, ai tregon, gjithashtu, mirënjohje për mirësitë e Zotit të tij.

Ajetet 65 – 68

65. ***(Thuaju:)*** **O ithtarë të Librit! Pse po polemizoni me ne rreth Ibrahimit, kur Teurati dhe Ungjilli janë shpallur pas tij?! A nuk e kuptoni?**
66. Ju jeni ata që polemizoni për atë që kishit dijeni. Po përse polemizoni për atë që s'keni kurrfarë dijenie? Allahu e di të vërtetën, kurse ju nuk dini.
67. Ibrahimi nuk ka qenë as çifut, as i krishterë, por ai ishte larg besimeve të kota. Ai ishte musliman dhe nuk ishte idhujtar.
68. Njerëzit më të afërt me Ibrahimin janë ata që e pasuan atë dhe ky Pejgamber së

bashku me ata që e kanë besuar. Allahu është mbrojtës *(e kujdestar)* i besimtarëve.

Shpjegimi i ajeteve

Çifutët dhe krishterët pretendojnë secili se Ibrahimi (a.s.) ishte i fesë së tyre, dhe për këtë çështje diskutonin me muslimanët. Por Allahu i Lartësuar ua hodhi poshtë pretendimet e tyre me tri argumente:

- "O ithtarë të Librit! Pse po polemizoni me ne rreth Ibrahimit, kur Teurati dhe Ungjilli janë shpallur pas tij?!" - Çifutët pasojnë dhe zbatojnë ligjet e Teuratit, ndërsa të krishterët zbatojnë ligjet e Ungjillit, sikurse pretendojnë. Por që të dy këta libra, Teurati dhe Ungjilli, janë shpallur shumë kohë pas Ibrahimit (a.s.). Atëherë, përse pretendojnë se ai ka qenë çifut ose i krishterë? Këto dy emërtime fetare u shfaqën shumë vonë pas Ibrahimit, prandaj thotë i Lartësuari:

- "A nuk e kuptoni?" – Pra, nëse do të mendoheshit pak më thellë dhe të logjikonit, nuk do ta thonit një gjë të tillë.

- "Ju jeni ata që polemizoni për atë që keni dijeni. Po përse polemizoni për atë që s'keni kurrfarë dijenie? Allahu e di të vërtetën, kurse ju nuk dini." – Ky është argumenti i dytë i Allahut të Lartësuar, që hedh poshtë pretendimet e çifutëve dhe të krishterëve për Ibrahimin (a.s.). Kështu, Allahu i Lartësuar u tregon çifutëve dhe të krishterëve se nuk lejohet të diskutosh rreth një çështjeje për të cilën nuk ke dije. Ata mund të diskutojnë për ndonjë çështje që mund të dinë diçka, po për çështjen e Ibrahimit, për të cilën nuk dinë asgjë, ata duhet të heshtin. Prandaj u thuhet: Ju duhet ta pranoni që nuk dini asgjë të saktë rreth Ibrahimit, prandaj nuk ju lejohet të hapni gojë dhe të diskutoni për diçka që nuk keni njohuri.

Pastaj i Madhëruari sjell argumentin e tretë, që hedh poshtë pretendimet e tyre: dëshmia e Tij se Ibrahimi ishte besimdrejtë, që adhuronte një Zot të vetëm dhe i dorëzuar plotësisht Allahut të Lartësuar.

- "Ibrahimi nuk ka qenë as çifut, as i krishterë, por ai ishte larg besimeve të kota. Ai ishte musliman dhe nuk ishte idhujtar." - Ky ajet është argumenti i tretë që hedh poshtë pretendimet e tyre. Allahu, Krijuesi i Ibrahimit (a.s), dëshmon se Ibrahimi nuk ishte as çifut, as i krishterë e as idhujtar, por ishte besimdrejtë (*ĥanîfen*), që adhuronte një Zot të vetëm, Allahun e Lartësuar, Krijuesin e gjithësisë. Ai ishte *musliman*, pra, i dorëzuar, i përkushtuar dhe i nënshtruar vetëm ndaj një Zoti të Pashoq në çdo aspekt. Ai ishte i dorëzuar dhe i përkushtuar vetëm ndaj Allahut të Lartësuar. Kjo është dëshmi e bazuar në dije absolute, të padiskutueshme.

Pastaj vazhdon i Madhëruari të tregojë se njerëzit që kanë më shumë meritë për t'u quajtur "të fesë Ibrahimit" janë besimtarët e kohës së tij, që ndoqën rrugën e Ibrahimit, dhe pastaj profeti Muhamed (a.s.) me pasuesit e tij. Kështu, thotë i Lartësuari:

- "Njerëzit më të afërt me Ibrahimin janë ata që e pasuan atë dhe ky Pejgamber së bashku me ata që e kanë besuar." - Këta janë pasuesit dhe pasardhësit e denjë të Ibrahimit dhe të rrugës së tij. Ata e ndoqën rigorozisht udhëzimin e Ibrahimit. Për këta, Allahu i Lartësuar ka bërë një premtim madhështor, duke thënë:

- "Allahu është mbrojtës *(e kujdestar)* i besimtarëve." – Pra, Allahu është *Uelijju* i besimtarëve. *Uelijj* i dikujt quhet i dashuri, miku ose kujdestari i tij, që e ndihmon dhe përkujdeset vazhdimisht për të. Ndërsa çifutët, të krishterët e idhujtarët, të cilët e braktisën fenë, besimin dhe ligjin e sjellë nga Ibrahimi (a.s.), ata janë shumë larg nga Ibrahimi, por dhe Ibrahimi është larg tyre. Pretendimet e tyre të pabaza janë të pavlefshme.

Këto ajete tregojnë se ndalohet të diskutojmë për çështje të cilat nuk i njohim. Për ato gjëra që nuk i dimë, më mirë të heshtim sesa të flasim.

Këto ajete tregojnë, gjithashtu, se njohja e historisë njerëzore është diçka e mirë, prandaj jemi të nxitur që të hulumtojmë në këtë drejtim. Nëpërmjet kësaj dijeje, ne mund të gjykojmë dhe argumentojmë saktë për shumë çështje, sikurse shtjelluam çështjen e përkatësisë fetare të Ibrahimit (a.s.). Pastaj i Urti thotë:

Ajetet 69 – 74

69. Disa nga ithtarët e Librit dëshirojnë t'ju shtyjnë në rrugë të gabuar. Por ata nuk devijojnë tjetër njeri veç vetes së tyre, por këtë nuk e vërejnë.
70. O ithtarë të Librit! Përse nuk i besoni ajetet e Allahut *(Kur'ânin)*, duke e ditur të vërtetën?
71. O ithtarë të Librit! Përse e ngatërroni të vërtetën me të pavërtetën! Në këtë mënyrë, ju po e fshihni të vërtetën, edhe pse e dini.
72. Disa nga ithtarët e Librit thonë: "Besojeni paradite atë që u është shpallur atyre që kanë besuar, dhe mohojeni pasdite. Ndoshta kështu edhe ata do të tërhiqen".
73. Po ashtu: "Mos i besoni askujt, përveç atyre që janë të fesë suaj!" Thuaju *(o i Dërguar)*: "I vetmi udhëzim është udhëzimi i Allahut!" *(Ata i thonin njëri-tjetrit)*: "Kurrë mos besoni se ndokujt po i jepet *(profecia, dija urtësia dhe mirësitë e mëdha)*, sikurse u është dhënë juve, përndryshe, *(ditën e gjykimit)*, do të polemizojnë kundër jush para Zotit tuaj! Thuaju: "E gjithë mirësia është në duar të Allahut! Ai ia jep atë kujt të dëshirojë. Allahu është Dhurues i gjerë, i Gjithëdijshëm".
74. Ai dallon kë të dojë me mëshirën e Vet. Allahu është Zotërues i mirësisë së madhe.


Shpjegimi i ajeteve

- "Disa nga ithtarët e Librit dëshirojnë t'ju shtyjnë në rrugë të gabuar. ..." - Allahu i Lartësuar na tregon rreth një grupi njerëzish, që gjithmonë do të ekzistojnë mes ithtarëve të Librit. Poshtërsia e këtyre ka arritur kulmin. Ata nuk mjaftohen me faktin që janë të humbur dhe po shkojnë drejt zjarrit të Xhehenemit, por dëshirojnë dhe përpiqen që të humbasin edhe muslimanët nga rruga e drejtë. Në ajetin 109 të sures Bekare, i Lartësuari thotë: "Shumë ithtarë të Librit do të dëshironin që, pas besimit tuaj, t'ju kthejnë në jobesimtarë, të shtyrë nga zilia e tyre personale, edhe pasi u është bërë e qartë e vërteta. Falini dhe tolerojini ata, derisa Allahu ta sjellë urdhrin e Vet. Allahu ka pushtet për gjithçka." Dihet shumë mirë se ai që e dëshiron fort një gjë, përpiqet që t'ia arrijë qëllimit me çdo mënyrë e rrugë që mundet. Kështu veprojnë ata të mallkuar. Ata mundohen që t'i devijojnë muslimanët nga rruga e tyre, duke u futur dyshime.

Por Allahu i Lartësuar është i mëshirshëm me adhuruesit e Tij të sinqertë dhe përkujdeset për ta. Kurthet godasin veçse ata që i kurdisin ato. Për këtë arsye, i Lartësuari thotë:

- "Por ata nuk devijojnë tjetër njeri veç vetes së tyre, por këtë nuk e vërejnë." - Përpjekjet e tyre për të devijuar dhe çoroditur muslimanët nuk janë gjë tjetër veçse përpjekje për t'u zhytur edhe më thellë në humbjen e tyre. Me këtë veprim, ata ia shtojnë edhe më shumë vuajtjet vetes së tyre. Thotë i Lartësuari në një ajet tjetër: "Atyre që nuk besojnë dhe pengojnë nga rruga e Allahut, Ne u shtojmë dënim mbi dënim, për shkak se bëjnë shkatërrime." [Nahl 88].

Ata janë aq fatkeqë në këto përpjekje të dështpëruara për të kënaqur smirën dhe armiqësinë e tyre, saqë nuk e ndiejnë se po dëmtojnë vetveten. Ata janë aq të verbuar nga zilia dhe urrejtja për të zgjedhurit dhe të dashurit e Zotit, saqë nuk e shikojnë se përpjekjet e tyre nuk dëmtojnë asnjë tjetër, veçse ata vetë.


الجزء الثالث سورة آل عمران
يَٰٓأَهۡلَ ٱلۡكِتَٰبِ لِمَ تَلۡبِسُونَ ٱلۡحَقَّ بِٱلۡبَٰطِلِ وَتَكۡتُمُونَ ٱلۡحَقَّ
وَأَنتُمۡ تَعۡلَمُونَ ٧١ وَقَالَت طَّآئِفَةٞ مِّنۡ أَهۡلِ ٱلۡكِتَٰبِ ءَامِنُواْ
بِٱلَّذِيٓ أُنزِلَ عَلَى ٱلَّذِينَ ءَامَنُواْ وَجۡهَ ٱلنَّهَارِ وَٱكۡفُرُوٓاْ ءَاخِرَهُۥ
لَعَلَّهُمۡ يَرۡجِعُونَ ٧٢ وَلَا تُؤۡمِنُوٓاْ إِلَّا لِمَن تَبِعَ دِينَكُمۡ قُلۡ إِنَّ
ٱلۡهُدَىٰ هُدَى ٱللَّهِ أَن يُؤۡتَىٰٓ أَحَدٞ مِّثۡلَ مَآ أُوتِيتُمۡ أَوۡ يُحَآجُّوكُمۡ
عِندَ رَبِّكُمۡۗ قُلۡ إِنَّ ٱلۡفَضۡلَ بِيَدِ ٱللَّهِ يُؤۡتِيهِ مَن يَشَآءُۗ وَٱللَّهُ
وَٰسِعٌ عَلِيمٞ ٧٣ يَخۡتَصُّ بِرَحۡمَتِهِۦ مَن يَشَآءُۚ وَٱللَّهُ ذُو ٱلۡفَضۡلِ
ٱلۡعَظِيمِ ٧٤ * وَمِنۡ أَهۡلِ ٱلۡكِتَٰبِ مَنۡ إِن تَأۡمَنۡهُ بِقِنطَارٖ
يُؤَدِّهِۦٓ إِلَيۡكَ وَمِنۡهُم مَّنۡ إِن تَأۡمَنۡهُ بِدِينَارٖ لَّا يُؤَدِّهِۦٓ إِلَيۡكَ
إِلَّا مَا دُمۡتَ عَلَيۡهِ قَآئِمٗاۚ ذَٰلِكَ بِأَنَّهُمۡ قَالُواْ لَيۡسَ عَلَيۡنَا فِي
ٱلۡأُمِّيِّـۧنَ سَبِيلٞ وَيَقُولُونَ عَلَى ٱللَّهِ ٱلۡكَذِبَ وَهُمۡ يَعۡلَمُونَ
٧٥ بَلَىٰ مَنۡ أَوۡفَىٰ بِعَهۡدِهِۦ وَٱتَّقَىٰ فَإِنَّ ٱللَّهَ يُحِبُّ ٱلۡمُتَّقِينَ
٧٦ إِنَّ ٱلَّذِينَ يَشۡتَرُونَ بِعَهۡدِ ٱللَّهِ وَأَيۡمَٰنِهِمۡ ثَمَنٗا قَلِيلًا
أُوْلَٰٓئِكَ لَا خَلَٰقَ لَهُمۡ فِي ٱلۡأٓخِرَةِ وَلَا يُكَلِّمُهُمُ ٱللَّهُ وَلَا يَنظُرُ
إِلَيۡهِمۡ يَوۡمَ ٱلۡقِيَٰمَةِ وَلَا يُزَكِّيهِمۡ وَلَهُمۡ عَذَابٌ أَلِيمٞ ٧٧
٥٩

- "O ithtarë të Librit! Përse nuk i besoni ajetet e Allahut *(Kuranin)*, duke e ditur të vërtetën?" - Allahu i Lartësuar u flet zemrave të këtyre njerëzve: Çfarë ju shtyn që t'i mohoni këto argumente të sakta prej Zotit të botëve, kur ju jeni të sigurt se pretendimi juaj është i kotë?! Si është e mundur ta refuzoni udhëzimin e mrekullueshëm të sjellë prej Muhamedit (a.s.) nga Zoti i tij, kur jeni të sigurt se ai është Profet i madh?! Madje, ju e pohoni mes jush vërtetësinë e tij, nga një anë, dhe ua fshihni të tjerëve, nga ana tjetër.

Me këto fjalë, Allahu i Lartësuar i qorton dhe i këshillon ata që të heqin dorë nga egoizmi dhe arroganca e tyre e tepruar. Ai i këshillon ata që ta lënë këmbënguljen e kotë në rrugën e gabuar dhe t'i kthehen së vërtetës, të cilën e dëshmojnë edhe vetë.

Më pas, Allahu i Lartësuar vijon t'i qortojë dhe t'i këshillojë ata që të mos pengojnë të tjerët, që e duan udhëzimin, nga rruga e lumturisë:

- "O ithtarë të Librit! Përse e ngatërroni të vërtetën me të pavërtetën! Në këtë mënyrë, ju po e fshihni të vërtetën, edhe pse e dini." - Allahu i Lartësuar i qorton ata për dy gjëra:

1. Për pështjellim të së vërtetës me të kotën, që ajo të bëhet e pakuptueshme dhe e papranueshme për njerëzit, e si rrjedhojë ata të ndjekin të kotën.
2. Për fshehjen e të vërtetës që ndodhet në mes tyre.

Me këto dy mënyra, ata kontrollojnë mendjet dhe besimin e ithtarëve të vet, sepse njerëzit janë pasues të dijetarëve të tyre. Nëse dijetarët e një kombi nuk e ndajnë të vërtetën nga e kota, duke i lënë çështjet të mjegullta, kështu ata i çorodisin njerëzit e thjeshtë dhe mund t'i kontrollojnë ata lehtësisht. Nëse dijetarët e fshehin të vërtetën, të cilën e kanë detyrë ta shfaqin, kështu ata i lënë njerëzit të verbër dhe mund t'i drejtojnë nga të duan. Në të tilla kushte, me njerëz të çoroditur dhe të verbër, sigurisht që e kota do të pranohet si e drejtë dhe e vërteta do të sulmohet dhe do të urrehet. Njerëzit e thjeshtë, nëse lihen të çoroditur dhe të verbër, nuk mund ta gjejnë kurrë të vërtetën. Ata nuk mund ta mësojnë kurrë të gabuarën, që të mund t'i ruhen dhe të distancohen prej saj. Të çoroditurit dhe të verbërit janë veçse kukulla në duart e të tjerëve.

Roli i dijetarëve është tepër i rëndësishëm dhe fisnik. Janë ata që qartësojnë të vërtetën dhe japin kriteret dalluese mes asaj dhe të kotës. Ata, me ndihmën e Zotit, u hapin sytë njerëzve, që të shohin të vërtetën si të vërtetë dhe ta pasojnë atë. Ata u mundësojnë njerëzve që të shohin të kotën si të kotë dhe t'i largohen asaj. Dijetarët u sqarojnë njerëzve hallallin dhe haramin, urdhrat dhe ndalesat, besimin e drejtë të mbështetur me argumente të sigurta prej Zotit të gjithësisë, nga besimi i gabuar dhe i shtrembëruar, që nuk bazohet në argumente të sakta. Nëpërmjet dijetarëve, udhëzohen ata që

duan udhëzimin, drejtohen të gabuarit dhe zhvlerësohet justifikimi i arrogantëve mosmirënjohës. Allahu i Lartësuar thotë: "Kur Allahu mori zotimin nga ata që iu ishte dhënë Libri: "Do t'ua përcillni atë njerëzve, dhe nuk do ta fshihni." Por ata e lanë pas dore atë amanet për një çmim të ulët të kësaj jete. Sa e keqe është ajo që ata blenë. [Al Imran 187].

Pastaj Allahu i Lartësuar na rrëfen se çfarë synon të bëjë ky grup i fëlliqur i njerëzve:

- "Disa nga ithtarët e Librit thonë: "Besojeni paradite atë që u është shpallur atyre që kanë besuar, dhe mohojeni pasdite. Ndoshta kështu edhe ata do të tërhiqen". - Pra, hyni në fenë e tyre dhe shfaquni sikur pranuat Islamin, në fillim të ditës. Pastaj, në fund të ditës, lëreni, braktiseni fenë e tyre, që kjo t'i nxisë ta braktisin Islamin. Bëjeni këtë, në mënyrë që braktisja e Islamit të duket diçka normale. Kur njerëzit të shohin dijetarët apo klerikët që e pranojnë Islamin dhe pastaj e braktisin atë, do të mendojnë se kjo fe është jo e drejtë, përderisa atë e braktisin të diturit dhe ata që kanë përvojë në fe.

Por të tilla plane mund të funksionojnë vetëm në mendjet e prishura. Aq shumë u pëlqen vetja atyre, sa mendojnë se njerëzit do t'i pasojnë gjithmonë në rrugën e tyre. Porse ata harrojnë diçka shumë të rëndësishme: ata harrojnë që Allahu i Lartësuar do ta përsosë dhe do ta plotësojë Dritën e Tij, edhe nëse këtë e urrejnë mohuesit e të vërtetës.

- "Po ashtu: "Mos i besoni askujt, përveç atyre që janë të fesë suaj!" - Ata porosisin njëri-tjetrin që të mos i besojnë askujt, përveç atyre që janë të fesë së tyre. Kështu, ata thonë: "Mbajeni të fshehtë atë që dini dhe mos ia shfaqni askujt tjetër, veç atyre që janë pasues të fesë tuaj, sepse po ta përhapni dijen tuaj tek të tjerët, atëherë edhe ata do të bëhen të barabartë me ju. Në këtë mënyrë, ata do të mund t'ju demaskojnë ju para Zotit, duke përdorur dijen tuaj, ndërsa ju nuk do të keni asnjë lloj justifikimi para Zotit tuaj. Ata do të dëshmojnë kundër jush, duke thënë se ju e njohët të vërtetën, por nuk e pasuat atë."

Kjo është arsyeja që ata e fshehin dijen e tyre rreth të vërtetës dhe nuk ua shfaqin besimtarëve. Sipas tyre, dija është monopol që e kanë vetëm ata. Në këtë mënyrë, ata pandehin se do të jenë të justifikuar për mospranimin e të vërtetës, por Allahu i Lartësuar ua hedh poshtë iluzione të tilla të pavlefshme.

- "Thuaj ***(o i Dërguar):*** **"I vetmi udhëzim është udhëzimi i Allahut!"** ***(Ata i thonin njëri-tjetrit):*** **"Kurrë mos besoni se ndokujt po i jepet** ***(profecia, dija urtësia dhe mirësitë e mëdha)*****, sikurse u është dhënë juve, përndryshe,** ***(ditën e gjykimit)*****, do të polemizojnë kundër jush para Zotit tuaj! -** Udhëzimi është dhuratë prej Allahut të Lartësuar, që ia jep çdokujt që e kërkon atë ashtu si duhet kërkuar. Udhëzimi nuk mund të gjendet pa patur dije të saktë dhe të sigurt. Por dija është e saktë dhe e sigurt veçse nëse vjen prej Allahut të Lartësuar dhe prej profetëve të Tij. Po ashtu, askush nuk mund të ketë sukses për t'u pajisur me dije të tillë dhe për të punuar me sinqeritet sipas saj, veç atij që Allahu e do dhe i jep sukses.

Ithtarët e Librit zotërojnë shumë pak dituri, ndërsa suksesi i Allahut është shumë larg tyre, për shkak të qëllimeve të poshtra që ata fshehin. Nga ana tjetër, nëse shohim dhuntitë e Allahut për umetin musliman, këtë popull të zgjedhur ndër njerëz, do të shohim një ndryshim shumë të madh. Udhëzimi i Allahut është shumë i dukshëm dhe i qartë për ta. Ai u ka dhuruar atyre dituri të madhe dhe u ka dhënë sukses që të punojnë sipas asaj diturie me sinqeritet për Të. Këto dhunti i dallojnë dhe i lartësojnë ata në mesin e njerëzve. Ata janë të udhëzuarit, të cilët udhëzojnë të tjerët në rrugën e drejtë të Zotit, me argumente të qarta nga Ai. Kjo

është bujaria dhe bamirësia e Tij ndaj tyre, prandaj i Lartësuari thotë:

- "Thuaju: "E gjithë mirësia është në duar të Allahut! Ai ia jep atë kujt të dëshirojë. Allahu është Bujar i madh, i Gjithëdijshëm"." - Mirësia është vetëm në dorën e Allahut, i Cili ua dhuron atë krijesave që Ai dëshiron. Allahu i Lartësuar ua jep mirësinë atyre që përpiqen maksimalisht për ta merituar atë, duke ruajtur kufijtë e Tij.

Për ata që përpiqen dhe sakrifikojnë për hir të Tij, Allahu i Lartësuar është Bujar i madh me mirësitë që u dhuron. Por Ai është edhe i Gjithëdijshëm për ata që i meritojnë ose jo mirësitë e Tij. Ai e di shumë mirë se cilët e meritojnë suksesin, prandaj, me mëshirën e Tij, Ai u jep udhëzimin. Ai e di, gjithashtu, se cilët nuk e meritojnë suksesin dhe udhëzimin e Tij, prandaj, me drejtësinë dhe urtësinë e Tij, Ai nuk ua jep.

- "Ai dallon kë të dojë me mëshirën e Vet." - Allahu i Lartësuar dallon me mëshirën e Tij atë që Ai dëshiron, pra, atë që plotëson kushtet për t'u lumturuar me mëshirën e Tij të posaçme.

Mëshira e veçantë është ajo që sjell me vete mirësitë e dynjasë dhe të ahiretit, dhe ajo është vetëm për të zgjedhurit e Tij të dashur.

- "Allahu është Zotërues i mirësisë së madhe." - Allahu i Lartësuar është Zotërues dhe Dhurues i madh i mirësisë. Mirësinë e Tij nuk mund ta përshkruajë dhe imagjinojë askush. E si mund ta përkufizosh mirësinë e Atij që është absolut në dijen dhe në mëshirën e Tij. Mirësia e Tij është aq e gjerë, sa është edhe dija e Tij. Allahu i Lartësuar thotë në një ajet: "Ndërsa ata *(engjëjt)* që e bartin Fronin dhe ata që janë përreth e tij e lartësojnë me falënderime Zotin e tyre, i besojnë Atij dhe i luten që t'i falë besimtarët *(duke thënë):* "Zoti ynë, Ti ke përfshirë me mëshirën dhe me diturinë Tënde çdo gjë, prandaj fali ata që pendohen dhe ndjekin rrugën Tënde, dhe ruaji ata nga dënimi i Xhehenemit! Zoti ynë, futi në Kopshtet e Adnit, të cilat ua ke premtuar, ata vetë dhe ata etër, gra dhe pasardhës të tyre që ishin të mirë. Vërtet, Ti je Ngadhënjyesi, i Urti! Ruaji ata prej të këqijave, sepse atë që Ti e mbron prej të këqijave atë ditë, vërtet e ke mëshiruar, dhe ky është shpëtimi i madh". [Gafir 7,8,9].

Ajetet 75 – 77

75. Ndër ithtarë të Librit, ka të tillë që, po u besove një sasi të madhe *(ari)*, ata ta kthejnë atë. Por ka edhe të tillë që, po u besove *(sikur edhe)* një dinar, ata nuk ta kthejnë atë, veç nëse u rri te koka *(duke ua kërkuar vazhdimisht)*, duke u justifikuar me fjalët: "Ne nuk kemi përgjegjësi ndaj injorantëve". Ata trillojnë për Allahun, edhe pse e dinë.
76. Jo, nuk është ashtu, por kush e përmbush amanetin e vet dhe ruhet nga gynahet, ta dijë se Allahu i do ata që ruhen.
77. Ata të cilët e shesin besën e dhënë Allahut dhe ndryshojnë zotimet e tyre për hir të një vlere shumë të vogël *(të kësaj bote)*, nuk do të kenë pjesë në botën tjetër. Allahu nuk do t'u flasë dhe nuk do t'i shohë ata Ditën e Kijametit dhe nuk do t'i pastrojë, por ata do të kenë një dënim të dhembshëm.

Shpjegimi i ajeteve

Në këto ajete, Allahu i Lartësuar na përshkruan sjelljen e ithtarëve të Librit në marrëdhëniet ndërnjerëzore. Kështu, pasi foli për tradhtinë dhe mashtrimin e tyre rreth Librit të Tij dhe për fshehjen e të vërtetës nga ana e tyre, Allahu i Lartësuar vijon të tregojë për mashtrimet e tyre në një aspekt tjetër të jetës: në tregti dhe në marrëdhëniet ndërnjerëzore në përgjithësi. Më konkretisht, disa prej tyre u qëndrojnë besnikë marrëveshjeve të lidhura, por ka edhe të tjerë që i shkelin ato.

- "Ndër ithtarë të Librit, ka të tillë që, po u besove një sasi të madhe *(ari)*, ata ta kthejnë atë." - Disa prej tyre, edhe nëse u beson pasuri të madhe, ata ta kthejnë, duke u treguar korrektë. Kështu, kur tregohen besnikë në kthimin e pasurive të mëdha, atëherë për gjëra më të vogla, sigurisht që janë më të rregullt.

- "Por ka edhe të tillë që, po u besove *(sikur edhe)* një dinar, ata nuk ta kthejnë atë, veç nëse u rri te koka *(duke ua kërkuar vazhdimisht)*" – Por ka edhe të tjerë ndër ta që, edhe nëse u beson një dinar të vetëm, nuk ta kthejnë atë, derisa t'ua kërkosh me ngulm. Kur ata sillen kështu vetëm për një dinar, atëherë si do të bëjnë po t'u besosh pasuri të mëdha?! Me siguri që do të jenë më tepër mashtrues.

Pastaj Allahu i Lartësuar na tregon arsyen që ata ia lejojnë vetes një poshtërsi të tillë:

- "...duke u justifikuar me fjalët: "Ne nuk kemi përgjegjësi ndaj injorantëve". - Ata pretendojnë me paturpësi se nuk marrin gjynah kur ua mbajnë pasurinë të tjerëve, sepse mendojnë që janë vetë njerëz të lartë dhe fisnikë, ndërsa të tjerët janë të ulët, skllevër të pavlefshëm, që meritojnë t'u marrësh gjithçka. Por nuk e kuptojnë të mjerët se më të poshtrit dhe më të ulëtit janë pikërisht ata të dëshpëruarit.

Për ata, njerëzit e thjeshtë, që nuk janë të sërës së tyre, nuk kanë asnjë vlerë dhe rëndësi, prandaj mund t'ua marrësh pasurinë, nderin dhe jetën pa problem. Kështu, ata bëjnë dy të këqija: grabitin pasuritë e njerëzve dhe e konsiderojnë këtë veprim si të ligjshëm. Por, në këtë mënyrë, ata shpifin për Zotin, i Cili thotë:

- "Ata trillojnë për Allahun, edhe pse e dinë." - Ky është vërtet një veprim shumë i shëmtuar nga këta njerëz të ulët. Ata trillojnë gënjeshtra ndaj Allahut duke pretenduar se Ai ua ka lejuar grabitjen e pasurive të të tjerëve, që nuk janë si ata. Ata guxojnë të mashtrojnë, duke qenë të vetëdijshëm se kjo është një shpifje e shëmtuar dhe shumë e ndëshkueshme. Sigurisht që një krim i tillë është shumë më i rëndë sesa të thuash në emër të Allahut gjëra të gabuara, duke mos patur dije.

Por Allahu i Lartësuar ua hedh poshtë këtë pretendim, me të cilin ata mundohen të justifikojnë poshtërsitë e tyre, dhe thotë:

- "Jo, nuk është ashtu, por kush e përmbush amanetin e vet dhe ruhet nga gynahet, ta dijë se Allahu i do ata që ruhen." – Pra, përkundrazi, çështja nuk qëndron siç thonë ata të dëshpëruarit, por gjithësecili mban përgjegjësi për veten, prandaj duhet që t'i plotësojë detyrimet. Çdokush do të pyetet për përgjegjësitë që duhet të mbajë. Çdo njeri duhet të pajiset me devotshmëri, duke ruajtur dhe respektuar të drejtat në përgjithësi, qofshin ato të Zotit apo të krijesave.

Kështu, çdokush që i plotëson detyrimet e veta dhe ruhet që të mos i shkelë të drejtat e të tjerëve, me siguri që është i devotshëm, dhe Allahu i Lartësuar i do të devotshmit, të cilësdo shtrese apo populli qofshin ata. Ky është kushti që Allahu ta dojë robin e Tij; devotshmëria sjell dashurinë e Allahut. Kurse ata që thonë se nuk mbajnë përgjegjësi për pasuritë e grabitura nga të tjerët, ata kështu nuk i përmbushin detyrimet ndaj Allahut dhe ndaj krijesave. Me këto veprime, ata tregojnë se nuk kanë devotshmëri, pra, nuk i ruajnë dhe nuk kujdesen për kufijtë e Allahut. Të tillët nuk mund ta kenë kurrë dashurinë e Allahut, madje Allahu është i zemëruar me ta.

Duke qenë se muslimanët janë të njohur për besnikërinë e tyre dhe për respektimin e të drejtave të të tjerëve, duke qenë se ata kurrë nuk e marrin guximin që të marrin pasuritë e të tjerëve padrejtësisht, se i druhen Allahut të Lartësuar, kuptohet se ata e meritojnë dashurinë e Allahut. Ata, pra të devotshmit, janë të dashurit e Zotit dhe për ta është përgatitur Xheneti i mirësive të


pafundme. Ata janë krijesat më të mira dhe më të nderuara tek Allahu i Lartësuar.

- "...ta dijë se Allahu i do ata që ruhen" - Allahu i Lartësuar i do të devotshmit, që i ruajnë kufijtë dhe dispozitat e Tij, duke zbatuar urdhrat dhe duke iu larguar ndalesave. Ata nuk mund të konsiderohen kurrsesi të njëjtë me ata të pafytyrë që shpifin dhe trillojnë gënjeshtra ndaj Zotit të botëve, por kanë tjetër gjykim.

- "Ata të cilët e shesin besën e dhënë Allahut dhe ndryshojnë zotimet e tyre për hir të një vlere shumë të vogël..." - Allahu i Lartësuar i ka përshkruar këta njerëz me cilësi tepër të ulëta: së pari, ata e shesin premtimin e dhënë Allahut dhe, së dyti, ata shkelin zotimet dhe marrëveshjet e tyre me njerëzit, e këtë e bëjnë thjesht për të fituar diçka shumë të vogël nga kjo dynja.

Në këtë kategori futen ata njerëz që marrin ndonjë shpërblim për lënien e detyrimeve ndaj Allahut dhe ndaj njerëzve. Pra, çdokush që lë bindjen ndaj Zotit dhe të drejtat e njerëzve, për të arritur ndonjë qëllim të tijin prej kësaj dynjaje konsiderohet i tillë. Po ashtu, çdokush që bën betim të rremë për të përfituar nga pasuritë dhe të drejtat e të tjerëve hyn në këtë kategori. Të gjithë këta dhe të tjerët që u përngjajnë atyre kanë një kërcënim nga Allahu i Lartësuar:

- "...nuk do të kenë pjesë në botën tjetër. Allahu nuk do t'u flasë dhe nuk do t'i shohë ata Ditën e Kijametit dhe nuk do t'i pastrojë, por ata do të kenë një dënim të dhembshëm." – Ky është ndëshkimi i merituar për këta të padrejtë. Ata nuk do të kenë pjesë prej së mirës në ahiret. Allahu nuk do t'u flasë dhe nuk do t'i shikojë ata Ditën e Gjykimit, sepse Ai do të jetë i zemëruar me ta. Allahu do të jetë i zemëruar, sepse ata i japin përparësi plotësimit të pasioneve dhe dëshirave të tyre të sëmura, kundrejt kënaqësisë së Tij. Për këtë arsye, Allahu nuk do t'i pastrojë ata nga


الجزء الثالث سورة آل عمران
وَإِنَّ مِنْهُمْ لَفَرِيقًا يَلْوُۥنَ أَلْسِنَتَهُم بِٱلْكِتَٰبِ لِتَحْسَبُوهُ
مِنَ ٱلْكِتَٰبِ وَمَا هُوَ مِنَ ٱلْكِتَٰبِ وَيَقُولُونَ هُوَ مِنْ
عِندِ ٱللَّهِ وَمَا هُوَ مِنْ عِندِ ٱللَّهِ وَيَقُولُونَ عَلَى ٱللَّهِ ٱلْكَذِبَ
وَهُمْ يَعْلَمُونَ ﴿٧٨﴾ مَا كَانَ لِبَشَرٍ أَن يُؤْتِيَهُ ٱللَّهُ ٱلْكِتَٰبَ
وَٱلْحُكْمَ وَٱلنُّبُوَّةَ ثُمَّ يَقُولَ لِلنَّاسِ كُونُوا۟ عِبَادًا لِّى مِن
دُونِ ٱللَّهِ وَلَٰكِن كُونُوا۟ رَبَّٰنِيِّۧنَ بِمَا كُنتُمْ تُعَلِّمُونَ
ٱلْكِتَٰبَ وَبِمَا كُنتُمْ تَدْرُسُونَ ﴿٧٩﴾ وَلَا يَأْمُرَكُمْ أَن
تَتَّخِذُوا۟ ٱلْمَلَٰٓئِكَةَ وَٱلنَّبِيِّۧنَ أَرْبَابًا ۚ أَيَأْمُرُكُم بِٱلْكُفْرِ بَعْدَ
إِذْ أَنتُم مُّسْلِمُونَ ﴿٨٠﴾ وَإِذْ أَخَذَ ٱللَّهُ مِيثَٰقَ ٱلنَّبِيِّۧنَ لَمَآ ءَاتَيْتُكُم
مِّن كِتَٰبٍ وَحِكْمَةٍ ثُمَّ جَآءَكُمْ رَسُولٌ مُّصَدِّقٌ لِّمَا
مَعَكُمْ لَتُؤْمِنُنَّ بِهِۦ وَلَتَنصُرُنَّهُۥ ۚ قَالَ ءَأَقْرَرْتُمْ وَأَخَذْتُمْ
عَلَىٰ ذَٰلِكُمْ إِصْرِى ۖ قَالُوٓا۟ أَقْرَرْنَا ۚ قَالَ فَٱشْهَدُوا۟ وَأَنَا۠ مَعَكُم
مِّنَ ٱلشَّٰهِدِينَ ﴿٨١﴾ فَمَن تَوَلَّىٰ بَعْدَ ذَٰلِكَ فَأُو۟لَٰٓئِكَ هُمُ
ٱلْفَٰسِقُونَ ﴿٨٢﴾ أَفَغَيْرَ دِينِ ٱللَّهِ يَبْغُونَ وَلَهُۥٓ أَسْلَمَ مَن فِى
ٱلسَّمَٰوَٰتِ وَٱلْأَرْضِ طَوْعًا وَكَرْهًا وَإِلَيْهِ يُرْجَعُونَ ﴿٨٣﴾
٦٠

gjynahet e tyre, nuk do t'ua fshehë të metat e tyre dhe nuk do t'ua mbulojë padrejtësitë që kanë bërë. Si pasojë, ata do të kenë ndëshkim të dhembshëm, që do ta vuajnë trupat dhe zemrat e tyre.

Sa i hidhur dhe dëshpërues mund të jetë zemërimi i Allahut ndaj tyre, që të mund të shprehej me fjalë?! Po fakti që ata nuk do ta shohin kurrë Zotin e gjithësisë?! Po ndëshkimi dhe vuajtja e përjetshme në Xhehenem?! Allahu na ruajt dhe na mëshiroftë, se Ai është Mëshirues i madh.

Ajeti 78

78. Me të vërtetë, një grup prej tyre e shtrembërojnë gjuhën e tyre kur lexojnë Librin, që ju të mendoni se ato *(fjalë)* janë prej Librit, por ato nuk janë prej Librit. Ata thonë: "Këto *(fjalë)* janë prej Allahut". Por ato nuk janë prej Allahut. Ata thonë gënjeshtra për Allahun, duke e ditur.

Shpjegimi i ajetit

- "Me të vërtetë, një grup prej tyre e shtrembërojnë gjuhën e tyre kur lexojnë Librin..." - Allahu i Lartësuar na tregon se prej ithtarëve të Librit ka nga ata që i shtrembërojnë e i ndryshojnë fjalët e Librit hyjnor me gjuhën e tyre, duke u dhënë fjalëve tjetër kuptim nga ai i vërteti. Pra, këtu nënkuptohet tjetërsimi i vetë fjalëve të Librit dhe i kuptimit të tyre.

Qëllimi i një libri është ruajtja në origjinalitet i fjalëve që gjenden në të, pa i ndryshuar ato dhe kuptimin e saktë të tyre, si dhe mësimi i të tjerëve dhe njohja e tyre me këto kuptime. Por ky grup prej ithtarëve të Librit veprojnë krejt ndryshe. Ata u japin njerëzve të kuptojnë prej Librit jo atë që duhet kuptuar prej tij. Ata e ndryshojnë përmbajtjen e tij ose duke ndryshuar fjalët, ose duke ndryshuar kuptimin e tyre.

- "...që ju të mendoni se ato *(fjalë)* janë prej Librit, por ato nuk janë prej Librit." - Ata i shtrembërojnë gjuhët e tyre në mënyrë të tillë, që ju të kuptoni prej Librit diçka të pavërtetë. Kështu, tërthorazi, ata iu bëjnë të mendoni se kuptimi i Librit është ai që thonë ata, por, në të vërtetë, ai nuk është aspak kuptimi i saktë i Librit të Zotit, por është mashtrim nga ana e tyre, është ajo çka ata duan që të kuptojnë dhe të japin të kuptohet.

- "Ata thonë: "Këto *(fjalë)* janë prej Allahut". Por ato nuk janë prej Allahut." - Kjo është ndërhyrje e drejtpërdrejtë te Libri i Zotit. Ata thonë fjalë nga vetja e tyre dhe ua përcjellin të tjerëve si të ishin fjalë të Zotit ose pjesë të Librit të Zotit.

- "Ata thonë gënjeshtra për Allahun, duke e ditur." - Ata trillojnë gjithçka për Allahun dhe janë të vetëdijshëm për këtë padrejtësi. Ata e dinë shumë mirë që ky është mashtrim.

Kjo vepër, në fakt, është shumë më e keqe sesa të flasësh rreth Allahut dhe Librit të tij pa patur dije. Kështu, ata mbledhin shumë të këqija në veprat e tyre, si:

- ata fshehin dhe mohojnë kuptimin e vërtetë të Librit të Zotit;
- ata i japin Librit të Zotit kuptime të gënjeshtërta e të pabaza;
- tekstet që tregojnë kuptime të vërteta dhe të drejta ata i përdorin për të argumentuar kuptimet e tyre të kota dhe të padrejta.

Më e keqja nga të gjitha është se këto veprime ata i kryejnë me vetëdije të plotë.

Ajetet 79 – 80

79. Nuk është e drejtë dhe as nuk ka ndodhur ndonjëherë që Allahu t'i ketë dhënë dikujt Librin, urtësinë dhe profetësinë, dhe pastaj ai t'u thotë njerëzve: "Bëhuni adhurues të mi e jo të Allahut!" Përkundrazi, u thotë: "Bëhuni dijetarë dhe edukatorë, duke u mësuar njerëzve Librin dhe duke e studiuar vetë atë"..."

80. Ai nuk ju urdhëron kurrë që t'i konsideroni engjëjt dhe profetët si zota. E si mund t'ju urdhërojë për mosbesim, pasi jeni bërë muslimanë?!

Shpjegimi i ajeteve

Profeti (a.s.) i urdhëroi ithtarët e Librit që ta besonin atë si Profet dhe t'i bindeshin atij plotësisht në udhëzimet e sjella prej Zotit. Por ata e shpërfillën dhe e keqpërdorën këtë ftesë bujare. Ata i thanë atij: "O Muhamed, a mos do që ne të të adhurojmë edhe ty bashkë me Allahun?" Atëherë, Allahu i Lartësuar zbriti këto ajete, për të hedhur poshtë fjalët e tyre:

- "Nuk është e drejtë dhe as nuk ka ndodhur ndonjëherë që Allahu t'i ketë dhënë dikujt Librin, urtësinë dhe profetësinë, dhe pastaj ai t'u thotë njerëzve: "Bëhuni adhurues të mi e jo të Allahut!" - Pra, është e pamundur që një njeri, të cilit Allahu i Lartësuar i ka bërë mirësi duke i dhuruar një Libër hyjnor, urtësi dhe profetësi, që t'u thotë njerëzve: "Bëhuni

adhurues të mi e jo të Allahut!". Kjo nuk mund të mendohet kurrsesi se mund të kryhet nga ndonjë profet i Allahut. Një urdhër i tillë konsiderohet si nga më të shëmtuarit, ndërsa profetët janë njerëzit më të zgjedhur dhe më të përkryer. E si mund të mendohet që urdhri më i shëmtuar të jepet nga njerëzit më të shkëlqyer?! Pa dyshim që urdhrat kanë të njëjtën natyrë me urdhëruesit e tyre.

Kështu, profetët urdhëronin veçse për çështje të larta dhe të mira, siç thotë Allahu i Lartësuar:

- "Përkundrazi, u thotë: "Bëhuni dijetarë dhe edukatorë..." - Pra, profetët nuk ju urdhërojnë kurrë për vepra të shëmtuara e të ulta, porse ata ju urdhërojnë që të jeni dijetarë të urtë e të butë dhe edukatorë të mirë. Ju duhet t'u mësoni njerëzve dije të drejtë dhe të pastër. Ju duhet t'i edukoni ata gradualisht, duke filluar me gjërat të vogla, para të mëdhave. Megjithatë, ju kurrë nuk mund të jeni edukatorë të mirë, nëse nuk e jetësoni dijen që keni marë. Profetët ju urdhërojnë për dije të dobishme, të saktë dhe të drejtë, dhe për të punuar sinqerisht sipas saj. Pastaj, ju duhet të ftoni edhe të tjerët që të punojnë sipas këtij udhëzimi madhështor, të dhuruar nga Zoti i gjithësisë. Me këto tri mënyra mund të arrihet lumturia në të dyja jetët. Dija e saktë dhe e vërtetë, puna sipas saj dhe edukimi i njerëzve me të përbëjnë rrugën e vetme që siguron lumturinë e robit në këtë jetë dhe në jetën tjetër. Çrregullimet dhe defektet në jetën e njeriut varen nga mangësitë që ai ka në këto tri aspekte.

Pastaj Allahu i Lartësuar tregon mënyrën se si të bëhesh edukator dhe se çfarë e ndihmon njeriun për t'u bërë i tillë. Pra, Allahu i Lartësuar jo vetëm që na urdhëron të jemi edukatorë të njerëzimit, por na tregon edhe mënyrën për të qenë të tillë. Ai thotë:

- "..."Bëhuni dijetarë dhe edukatorë, duke u mësuar njerëzve Librin dhe duke e studiuar vetë atë".. - Jini edukatorë të njerëzimit, dhe të tillë mund të jeni veçse duke u mësuar njerëzve Librin, pasi ta keni mësuar vetë, dhe jo vetëm ta keni mësuar, por ta keni studiuar me kujdes, sepse nëse studion me kujdes e përqendrim, dija zë rrënjë të thella në zemër dhe jep frytet e saj në fjalët dhe në veprat që kryhen. Pastaj, pasi ta keni mësuar dhe studiuar dijen, dhe pasi të keni punuar sinqerisht me të, atëherë mësojani atë të tjerëve. Vetëm kështu mund të jeni edukatorë të njerëzimit, dhe kjo është ajo që kanë urdhëruar profetët e Zotit.

- "Ai nuk ju urdhëron kurrë që t'i konsideroni engjëjt dhe profetët si zota." - Ky është një përshkrim më i gjerë rreth natyrës së urdhrave që jepnin profetët. Një profet nuk mund t'i urdhëronte kurrë njerëzit që ata të adhuronin atë, por as që të adhuronin ndonjë engjëll, kushdo qoftë ai, sepse adhurimi, bindja, përkushtimi dhe nënshtrimi janë vetëm për Allahun e Lartësuar.

- "E si mund t'ju urdhërojë për mosbesim, pasi jeni bërë muslimanë?!" - Kjo është e pamundur që të ndodhë. As që mund të përfytyrohet se një profet mund të urdhërojë për gjëra të tilla. Ata të cilëve Allahu u ka dhuruar mirësi janë shumë larg krimeve të tilla të rënda. Madje, nëse dikush trillon të tilla gënjeshtra dhe ia atribuon ato ndonjë profeti, ai ka kryer kufër, pra, një krim të rëndë e të shëmtuar.

Ajetet 81 – 82

81. Përkujtoni kur Allahu mori zotimin e profetëve *(dhe u tha)*: "Për shkak të asaj që ju dhurova, duke ju shpallur Libër e Urtësi, ju patjetër që do ta besoni dhe ndihmoni profetin që do të vijë pas jush e që vërteton atë që ju është shpallur juve. Ai *(Allahu)* tha: "A e pranoni dhe a e merrni përsipër detyrën Time?" Ata thanë: "Po, e

pranojmë"! Ai *(Allahu)* tha: "Dëshmoni pra, se edhe Unë jam dëshmitar, bashkë me ju!"
82. E kush e shkel këtë pakt më pas, ai është i prishur.

Shpjegimi i ajeteve

- "Përkujtoni kur Allahu mori zotimin e profetëve *(dhe u tha):* "Për shkak të asaj që ju dhurova, duke ju shpallur Libër e Urtësi, ju patjetër që do ta besoni dhe ndihmoni profetin që do të vijë pas jush e që vërteton atë që ju është shpallur juve." - Allahu i Lartësuar na tregon se Ai u ka marrë besën dhe fjalën e nderit profetëve për një çështje shumë të rëndësishme. Ai u mori besën, për shkak se Ai u dha atyre libër të ndritur dhe urtësi të madhe për të dalluar mes të vërtetës dhe të gabuarës, mes rrugës së drejtë dhe humbjes. Allahu u mori besën atyre që, nëse Ai do dërgonte pas tyre ndonjë profet që vërtetonte shpalljet e mëparshme të Tij, ata do ta besonin, mbështesnin dhe ndihmonin atë. Madje, çdo profet duhej ta urdhëronte popullin e tij që, nëse vinte profeti pasardhës, populli ta besonte, ta mbështeste dhe ta ndihmonte atë. Çdo profet duhej që ta besonte dhe ta mbështeste profetin tjetër. Po kështu duhej të vepronin edhe popujt e tyre.

Ky është një rregull i pandryshueshëm, nga i cili nuk përjashtohet askush, sepse të gjithë profetët e vërtetë flasin të frymëzuar nga Zoti dhe sjellin të vërtetën e sigurt, që duhet besuar. Ata janë si një trup i vetëm. Ndërsa Muhamedi (a.s.) ishte vula e tyre. Por nëse profetët e tjerë do të arrinin kohën e tij, ata do të ishin të detyruar që ta besonin dhe ta ndihmonin, duke e mbështetur në rrugën e tij. Për ta do të ishte detyrë pasimi i udhëzimeve të sjella prej tij nga Zoti i gjithësisë. Ai do të ishte imami, udhëheqësi i tyre, në gjurmët e të cilit do të duhet të ecnin.

Siç shihet, ky ajet i mrekullueshëm dëshmon për gradën dhe vlerat e larta të profetit Muhamed (a.s.). Ai tregon se Muhamedi ishte më i zgjedhuri i profetëve, sepse Allahu ka marrë besën e të gjithë profetëve dhe të popujve të tyre që ata do ta besojnë dhe pasojnë udhëzimin dhe dritën e sjellë prej tij. Allahu i Lartësuar i ka bërë të gjithë profetët që ta pohojnë dhe deklarojnë me gojën e tyre përgjegjësinë për këtë besë të dhënë para Allahut:

- "Ai *(Allahu)* tha: "A e pranoni dhe a e merrni përsipër detyrën Time?" Ata thanë: "Po, e pranojmë"! Ai *(Allahu)* tha: "Dëshmoni pra, se edhe Unë jam dëshmitar, bashkë me ju!" - Profetët deklaruan: "E pranuam urdhrin Tënd, dhe për këtë jemi dëshmitarë. Ky urdhër do të jetë gjithmonë në zemrat tona dhe para syve tanë!"

Allahu i Lartësuar, në përforcim të kësaj dëshmie, thotë: "Dëshmoni për këtë përgjegjësi që keni marrë ju dhe popujt tuaj, dhe dijeni se edhe unë jam dëshmitar i këtij premtimi!"

- "E kush e shkel këtë pakt më pas, ai është i prishur." - Ata të cilët e shpërfillin dhe nuk e zbatojnë këtë besëlidhje të dëshmuar nga Allahu i Lartësuar dhe profetët e tij, Allahu i Lartësuar i ka quajtur: "*fâsiḳûn*" – të prishur, të dalë jashtë rruge. Kjo tregon, gjithashtu, se të gjithë ata që pretendojnë se janë pasues të profetëve të ndryshëm: çifutë, të krishterë etj., nëse nuk e besojnë Profetin e fundit, Muhamedin (a.s.), ata janë jashtë rrugës së drejtë dhe po ecin drejt Xhehenemit, ku do të jenë përjetësisht, për të vuajtur ndëshkimin e hidhur.

Ajeti 83

83. A mos kërkojnë ata fe tjetër, veç fesë së shpallur nga Allahu, ndërkohë që Atij i është nënshtruar gjithçka që gjendet në qiej e gjithçka që gjendet në tokë, me vullnet apo me detyrim, dhe tek Ai të gjithë do të kthehen?!

Shpjegimi i ajetit

- "A mos kërkojnë ata fe tjetër, veç fesë së shpallur nga Allahu..." - A është e mundur që kërkuesit e kënaqësisë së Zotit të mashtrohen dhe të kërkojnë fe tjetër veç fesë së Tij, që është Islami?! Jo, është e pamundur. Nuk ka fe më të sigurt, më të plotë, më të saktë e më të bazuar sesa Islami. Islam do të thotë: dorëzim i plotë tek i vetmi i Plotfuqishëm, tek Allahu i Lartësuar.

- "...ndërkohë që Atij i është nënshtruar gjithçka që gjendet në qiej e gjithçka që gjendet në tokë, me vullnet apo me detyrim, dhe tek Ai të gjithë do të kthehen" - Të gjitha krijesat janë të nënshtruara dhe të nevojshme për përkujdesjen dhe mëshirën e Allahut. Të gjithë i janë dorëzuar Atij për përmbushjen e nevojave të tyre jetike.


Nënshtrimi i krijesave është dy llojesh:

1. Nënshtrim me vullnet të lirë, me motivim, me bindje. Këtë e kanë besimtarët muslimanë, të cilët i janë nënshtruar Allahut të Lartësuar, duke e adhuruar Atë me dashuri, madhërim, përkushtim dhe bindje.

2. Nënshtrim i detyruar. Ky lloj nënshtrimi i përfshin të gjitha krijesat. Edhe qafirët janë të nënshtruar në atë mënyrë që nuk mund t'i shpëtojnë dot përcaktimit dhe gjykimit të Zotit të gjithësisë. Nëse Allahu ka vendosur për diçka, ata nuk mund ta ndryshojnë caktimin e Tij. Askush nuk mund të mbrohet dhe ta ndalojë atë që cakton dhe dëshiron i Plotpushtetshmi, sipas dijes, urtësisë, drejtësisë dhe mëshirës së Tij. Të gjitha krijesat kthehen tek Ai për nevojat e tyre dhe tek Ai do të kthehen edhe për t'u llogaritur për veprat e tyre. Është Ai që do t'i gjykojë ata, sipas drejtësisë dhe bamirësisë së Tij.

Ajetet 84 – 85

84. Thuaj: "Ne i kemi besuar Allahut, asaj që na u shpall neve, asaj që iu shpall Ibrahimit, Ismailit, Is'hakut, Jakubit dhe pasardhësve, asaj që iu dha Musait dhe



Isait dhe të gjithë profetëve nga Zoti i tyre. Ne nuk bëjmë kurrfarë dallimi në mes tyre dhe ne vetëm Atij i jemi dorëzuar."

85. E kush kërkon fe tjetër përveç fesë Islame, atij kurrsesi nuk do t'i pranohet, ndërsa në botën tjetër ai do të jetë nga të dështpëruarit.

Shpjegimi i ajeteve

- "Thuaj: "Ne i kemi besuar Allahut, asaj që na u shpall neve, asaj që iu shpall Ibrahimit, Ismailit, Is'hakut, Jakubit dhe pasardhësve, asaj që iu dha Musait dhe Isait dhe të gjithë profetëve nga Zoti i tyre. Ne nuk bëjmë kurrfarë dallimi në mes tyre dhe ne vetëm Atij i jemi dorëzuar."" – Një ajet i ngjashëm me këtë u shpjegua në suren Bekare. [16] Pastaj thotë i Lartësuari:

- "E kush kërkon fe tjetër përveç fesë Islame, atij kurrsesi nuk do t'i pranohet..."

[16] Shih në suren Bekare, ajeti 136.

– Pra, çdokush që pranon dhe ndjek fe tjetër veç Islamit, do të jetë i refuzuar nga Allahu i Lartësuar. Islami është feja të cilën e ka zgjedhur Allahu që të jetë sistem jete dhe adhurimi për njerëzimin. Nëse dikush kërkon të adhurojë Allahun me mënyrë tjetër, atëherë çdo vepër e tij do të jetë e papranuar nga i Madhëruari.

- "...ndërsa në botën tjetër ai do të jetë nga të dëshpëruarit." - Vetëm feja Islame është dorëzim i plotë me dashuri, madhërim, nënshtrim dhe bindje ndaj Allahut të Lartësuar. Vetëm Islami, me sigurinë dhe bazat e tij të forta, të udhëzon në rrugën e drejtë të diktuar prej profetëve. Vetëm nëpërmjet kësaj feje, njeriu zbaton atë që Zoti dhe profetët kanë urdhëruar, duke qenë i sigurt dhe i qartë në çdo adhurim që ia përkushton.

Kështu pra, vetëm muslimanët janë të shpëtuarit nga ndëshkimi i Allahut, sepse vetëm ata zbatojnë fenë që të çon te shpëtimi i vetëm. Vetëm ata e meritojnë shpërblimin dhe mëshirën e plotë të Zotit të tyre, sepse vetëm ata e ndjekin me përpikmëri udhëzimin autentik të Allahut dhe të Profetit të Tij. Ndërsa të tjerët janë larg të vërtetës. Këta do të meritojnë ndëshkimin e Allahut, sepse vetë e zgjodhën rrugën e humbjes, duke i kthyer shpinën Islamit dhe ftesës së Tij.

Ajetet 86 – 89

86. E si ta udhëzojë Allahu një popull që mohon pasi ka besuar njëherë dhe ka dëshmuar se Pejgamberi është i vërtetë, dhe ndërkohë që i kanë ardhur argumente të qarta?! Allahu nuk e udhëzon në rrugën e drejtë një popull të padrejtë.
87. Ndëshkimi i tyre është i pashmangshëm dhe mbi ta do të godasë mallkimi i Allahut, i engjëjve dhe i mbarë njerëzimit.
88. Ata do të jenë përgjithmonë në këtë gjendje. Atyre as nuk do t'u lehtësohet dënimi dhe as nuk do t'u jepet ndonjë moment pushimi,
89. përveç atyre që pendohen më pas dhe përmirësohen. Vërtet, Allahu është Falës e Mëshirues.

Shpjegimi i ajeteve

- "E si ta udhëzojë Allahu një popull që mohon pasi ka besuar njëherë dhe ka dëshmuar se Pejgamberi është i vërtetë, dhe ndërkohë që i kanë ardhur argumente të qarta?!" - Kjo është vërtet e pamundur. Allahu nuk do ta udhëzonte kurrë një popull me të tilla cilësi e vepra.

Allahu i Lartësuar i përshkruan kështu cilësitë e të dëshpëruarve, të cilët nuk i kap mëshira dhe udhëzimi i Tij:
1. Ata mohojnë, pasi kanë besuar njëherë. Kështu, ata mohojnë duke parapëlqyer mohimin mbi besimin.
2. Ata kanë dëshmuar në fillim se Profeti është i vërtetë. Pra, ata mohojnë pasi kanë dëshmuar me dije dhe bindje se Profeti është vërtet prej Allahut.
3. Atyre u kanë ardhur njëherë argumente të qarta. Kështu, ata mohojnë pasi i kanë parë argumentet dhe mrekullitë e qarta me të cilat Allahu e pajisi Profetin e Tij.

- "Allahu nuk e udhëzon në rrugën e drejtë një popull të padrejtë." - Këta e meritojnë të quhen "të padrejtë", sepse padrejtësia e tyre është kulmore. Ata e mohojnë të vërtetën pasi e kanë njohur dhe besuar atë. Ata ndjekin rrugën e humbjes, duke qenë të bindur për kotësinë e saj. Kështu, ata tregohen të padrejtë, arrogantë dhe pasues të epsheve të tyre në përzgjedhjen që bëjnë. E si mund t'u jepet sukses të tillëve që të pasojnë udhën e drejtë?! Të vetmit për të cilët mund të shpresohet udhëzimi janë ata që nuk e njohin të vërtetën dhe përpiqen sinqerisht për ta gjetur atë. Pa dyshim që, të tillë njerëzve, Allahu i Lartësuar do t'ua lehtësojë rrugën e udhëzimit dhe do t'i ruajë nga çdo gjë që i pengon prej saj.

Pastaj Allahu i Lartësuar na tregon rreth ndëshkimeve që i presin të padrejtët në këtë jetë dhe në jetën tjetër:

- "Ndëshkimi i tyre është i pashmangshëm dhe mbi ta do të godasë mallkimi i Allahut, i engjëjve dhe i mbarë njerëzimit." - Ata do të vuajnë përjetësisht dhe pandërprerë mallkimin dhe ndëshkimin. Atyre nuk do t'u lehtësohet apo ndërpritet ndëshkimi për asnjë moment.

- "Ata do të jenë përgjithmonë në këtë gjendje. Atyre as nuk do t'u lehtësohet dënimi dhe as nuk do t'u jepet ndonjë moment pushimi..." - Pas vdekjes, atyre nuk do t'u jepet më afat që të pendohen, të mendohen dhe të kthehen, sepse afatizimi përfundon me vdekjen. Allahu i Lartësuar i afatizon dhe u jep kohë mjaftueshëm që të mendohen dhe të përkujtojnë. Nëse do të kishte ndonjë të mirë tek ata, ajo do të shfaqej dhe do të bënte dobi brenda afatit. Megjithatë, edhe nëse do të riktheheshin në këtë jetë, ata do të shkonin përsëri në humbje.

- "...përveç atyre që pendohen më pas dhe përmirësohen. Vërtet, Allahu është Falës e Mëshirues." - Kushtet e pendimit janë të njohura për këtë kategori njerëzish. (Shih komentin e ajeteve 159-162, në suren Bekare).

Ajetet 90 - 91

90. Atyre që mohojnë, pasi kanë besuar më parë, dhe pastaj e shtojnë mosbesimin e tyre, atyre nuk do t'u pranohet kurrsesi pendimi; pikërisht ata janë të humburit.
91. Asnjërit prej atyre që nuk besojnë dhe që vdesin si jobesimtarë nuk do t'i pranohet për kompensim qoftë edhe e tërë faqja e dheut me flori. Ata i pret një dënim i dhembshëm dhe për ta nuk ka ndihmëtarë.


Shpjegimi i ajeteve

Allahu i Lartësuar na përshkruan disa cilësi të njerëzve më të trishtuar e më fatzinj, të cilëve Ai nuk u jepet sukses që të pendohen dhe të bëjnë kthesë nga rruga e humbjes:

- "Atyre që mohojnë, pasi kanë besuar më parë, dhe pastaj e shtojnë mosbesimin e tyre, atyre nuk do t'u pranohet kurrsesi pendimi." – Kështu, të tillë janë ata që e mohojnë të vërtetën e sigurt, pasi e kanë njohur fillimisht dhe pasi e kanë besuar njëherë atë. Jo vetëm kaq, por ata thellohen edhe më shumë në mohimin dhe mospërfilljen e tyre ndaj udhëzimeve dhe porosive të Zotit dhe Profetit (a.s.). Pra, në vend që të pendohen dhe t'i kthehen rrugës së besimit dhe të bindjes ndaj Allahut, që dikur ia kanë provuar ëmbëlsinë dhe mirësinë asaj, ata thellohen edhe më tepër në shthurjen dhe mosbindjen e tyre. Këta njerëz, të cilët as nuk mendohen për t'u kthyer në besim dhe në udhën e drejtë, Allahu i Lartësuar i lë në humbje dhe nuk u jep sukses që ta rigjejnë rrugën e drejtë, sepse ata vetë e kanë zgjedhur një rrugë të tillë për veten e tyre. Ata enden në padrejtësi dhe në shkeljen e kufijve. Për këta, Allahu i Lartësuar thotë: "Ne ua rrotullojmë zemrat dhe vështrimet e tyre, ashtu sikurse ata nuk e besuan atë *(Kur'ânin)* për herë të parë, dhe i lëmë ata të bredhin të hutuar në shfrenimin e tyre për të bërë gjynahe. Edhe sikur t'u dërgonim atyre engjëjt, t'i bënim të vdekurit t'u flisnin atyre dhe t'i tubonim të gjitha gjërat para tyre, ata përsëri nuk do të besonin, nëse Allahu nuk do të donte; por shumica e tyre janë të paditur." [En'am, 110, 111].

Dhe thotë: "...dhe kur ata u shmangën *(nga e vërteta)*, Allahu ua largoi zemrat e tyre *(nga besimi)*. Allahu nuk e udhëzon në rrugë të drejtë një popull që kalon kufijtë." [Saf, 5].

Dhe thotë: "Ka nga ata *(hipokritë)* që i premtojnë Allahut, duke thënë: "Nëse Ai na jep nga mirësitë e Tij, sigurisht që do të japim lëmoshë dhe sigurisht që do të bëhemi njerëz të mirë!" Por kur Ai u jep atyre nga mirësitë e veta, ata bëhen koprracë dhe kthejnë shpinën, duke u larguar. Prandaj, Ai ua lidh hipokrizinë në zemrat e tyre, deri ditën kur ata do të dalin para Tij, sepse ata e



shkelin premtimin e dhënë Allahut. Ata e kanë zakon gënjeshtrën. Vallë, a nuk e dinë ata se Allahu i di të fshehtat e tyre, edhe bisedat e fshehta?! Në të vërtetë, Allahu është Ai që i di të gjitha fshehtësitë." [Teube, 75 -78].

Kështu, veprat e këqija sjellin e shkaktojnë njëra-tjetrën, sidomos tek ata njerëz të cilët i përkushtohen mohimit të të Madhërishmit dhe janë të vazhdueshëm në shpërfilljen dhe braktisjen e rrugës së drejtë, edhe pasi u është qartësuar e vërteta plotësisht, si drita e diellit. Këtyre të dëshpëruarve u janë treguar qartë shenjat dalluese të rrugës së drejtë, por ata vetë i shpërfillin dhe i braktisin ato. Këta nxitojnë dhe punojnë pareshtur për të këputur çdo mundësi dhe shkak që sjell mëshirën e Zotit. Janë vetë ata që nuk e pranojnë mëshirën e Krijuesit të tyre. Janë vetë ata që ia kanë mbyllur vetvetes portën e pendimit. Për këtë arsye, Allahu i Lartësuar thotë:

- "Pikërisht ata janë të humburit." - Pikërisht ata dhe vetëm ata janë të humburit e sigurt, pa shpëtim.

Siç shihet, Allahu e ka posaçëruar humbjen tek ata. A thua se vetëm ata janë të humbur! Por vërtet, a ka më të madhe sesa humbja e atyre që e kanë parë shumë qartë të vërtetën. Ata e kanë braktisur me vetëdije të vërtetën e sigurt. Nëse ata fatkeqë vazhdojnë në këtë drejtim, deri sa t'i befasojë vdekja, atëherë do të jenë përjetësisht në dënim dhe dëshpërim. Atyre nuk do t'u hyjë më në punë asnjë mundësi shpëtimi që e zotërojnë tashmë në dynja, siç thotë i Lartësuari:

- "Asnjërit prej atyre që nuk besojnë dhe që vdesin si jobesimtarë nuk do t'i pranohet për kompensim qoftë edhe e tërë faqja e dheut me flori." - Çfarëdo që të shpenzojnë dhe të ofrojnë si kompensim, ai nuk do t'u pranohet.

- "Ata i pret një dënim i dhembshëm dhe për ta nuk ka ndihmëtarë." - Ata do të vuajnë pandërprerë ndëshkimin e dhimbshëm. Askush nuk do mund të ndërmjetësojë për ta, t'i ndihmojë apo t'i strehojë, që t'i fshihen ndëshkimit të pashmangshëm, sepse ata e kanë braktisur vetë mundësinë për të kryer vepra të mira dhe për të fituar shpërblime, dhe i janë përkushtuar me këmbëngulje humbjes dhe ndëshkimit të përjetshëm. Ata e kanë zgjedhur vetë Zjarrin dhe zemërimin e të Madhërishmit. Allahu na ruajtë nga gjendja e këtyre të dëshpëruarve!

Ajeti 92

92. Kurrë nuk do ta arrini sinqeritetin e plotë në besim, derisa të jepni prej pasurisë më të shtrenjtë për ju. Çfarëdo që ju jepni, Allahu pa dyshim që e di.

Shpjegimi i ajetit

- "Kurrë nuk do ta arrini sinqeritetin e plotë në besim, derisa të jepni prej pasurisë më të shtrenjtë për ju." - Kjo është një nxitje që Allahu i Lartësuar u bën adhuruesve të Tij për të shpenzuar në bamirësi. Ai thotë që kurrë nuk keni për ta arritur atë që quhet "*el bir-ra*". Kështu quhen të gjitha ato vepra të mira dhe shpërblimet e premtuara për to nga Allahu i Lartësuar. Këto vepra të mira bëhen shkak që vepruesi i tyre të hyjë në Xhenetin e mirësisë së përjetshme. Pra, kurrë nuk mund ta arrini këtë pozicion, derisa të shpenzoni prej pasurisë më të shtrenjtë që zotëroni, të cilën e doni shumë fort. Nuk do ta arrini gradën e bamirësisë, shpërblimi i së cilës është Xheneti, derisa të shpenzoni për hir të Allahut pasuritë dhe mirësitë më të vyera dhe më të dashura që keni. Nëse ju do t'i jepni përparësi dashurisë për Allahun kundrejt çdo dashurie tjetër dhe, për hir të kësaj dashurie, do të shpenzoni gjërat më të vyera që zotëroni, atëherë kjo është tregues për sinqeritetin e imanit tuaj, për bamirësinë e zemrës suaj, për sigurinë tuaj të plotë në ndjekjen e udhëzimit dhe për devotshmërinë ndaj Zotit tuaj.

Por çfarë nënkupton "*dhënia prej pasurisë më të shtrenjtë për ju*", siç e cilëson Allahu? Ky kategorizim përfshin disa nocione, si për shembull:

- Shpenzimin për hir të Allahut të pasurive më të mira e më të vyera që zotëron njeriu.
- Shpenzimin e pasurive dhe mirësive që zotëron njeriu, në momentet a situatat që ai i dëshiron ato më së shumti për vete, madje edhe kur është në nevojë tepër të madhe për to.
- Shpenzimin në një kohë kur njeriu është i shëndetshëm dhe i ka mundësitë që të shpenzojë.

Ajeti tregon se grada e bamirësisë (*el bir-ra*) së robit varet nga shkalla e shpenzimit të pasurive dhe mirësive më të mira që ai zotëron. Kështu, sa më i vogël e i mangët të jetë shpenzimi, aq më e ulët është grada e bamirësisë që adhuruesi kërkon ta arrijë.

Ndoshta ky ajet i Allahut të Lartësuar mund të keqkuptohet nga ndonjë, duke menduar se adhuruesi do të shpërblehet veçse nëse jep prej pasurisë më të shtrenjtë që ai zotëron. Por kjo nuk është e vërtetë dhe nuk ka lidhje aspak me bujarinë e Mëshirëplotit. Allahu i Lartësuar do t'i shpërblejë të gjithë ata që japin prej pasurive dhe mirësive që zotërojnë, qofshin ato të pakta apo të shumta, qofshin ato të dashura për shpirtin e tyre apo jo. Për çdo shpenzim të dhënë për të arritur kënaqësinë e Allahut, robi do të shpërblehet. E pikërisht për të larguar këtë keqkuptim, Allahu i Lartësuar thotë:

- "Çfarëdo që ju jepni, Allahu pa dyshim që e di." – Pra, Allahu i Lartësuar nuk humbet asnjë vepër të kryer nga robi. Në varësi të qëllimit të robit dhe dobisë së arritur, Allahu i Lartësuar do të dhurojë shpërblimin e Tij, siç i takon të Drejtit, të Urtit dhe Bamirësit me krijesat.

Ajetet 93 – 95

93. Të gjitha llojet e ushqimeve ishin të lejuara për bijtë e Israilit, përveç atij që Israili ia ndaloi vetvetes, para se të zbriste Teurati. Thuaju: "Silleni, pra, Teuratin dhe lexojeni atë, nëse jeni të saktë!"
94. Çdokush që, edhe pas kësaj, shpif gënjeshtra kundër Allahut, është me të vërtetë i padrejtë.
95. Thuaj: "Allahu thotë të vërtetën. Ndiqeni atëherë fenë e pastër të Ibrahimit, i cili kurrë nuk ishte prej idhujtarëve".

Shpjegimi i ajeteve

- "Të gjitha llojet e ushqimeve ishin të lejuara për bijtë e Israilit, përveç atij që Israili ia ndaloi vetvetes, para se të zbriste Teurati." - Çifutët pretendonin se shfuqizimi i një norme është diçka e papranueshme kur bëhet fjalë për normat e caktuara dhe të

sjella nga Zoti i gjithësisë. Për hir të këtij "parimi" të tyre, që në fakt edhe ata vetë nuk e pranojnë dhe zbatojnë plotësisht, ata mohuan Isain dhe Muhamedin (a.s.) si profetë, sepse këta të dy, me ligjin hyjnor që sollën, shfuqizuan disa dispozita të përcaktuara në Teurat. Pra, judejtë e justifikuan mospranimin e dy profetëve të mëdhenj nga ana e tyre me faktin që ata anuluan disa norma të përcaktuara prej Zotit në Teurat. Por Allahu i Lartësuar ua hodhi poshtë këtë pretendim të tyre për të justifikuar refuzimin e dy profetëve të mëdhenj.

Mënyra më e mirë për të hedhur poshtë pretendimin e kundërshtarit është që të përdorësh të njëjtat kritere dhe rrugë argumentimi që përdor ai. Me këtë mënyrë, Allahu i Lartësuar sjell një pjesë nga historia e Jakubit (ose Israilit) (a.s.). Allahu i Lartësuar na tregon se për bijtë e Israilit ishin të lejuara të gjitha ushqimet deri në momentin kur Jakubi (a.s.) ia ndaloi vetvetes mishin e devesë dhe qumështin e saj. Shkak për këtë vendim të Jakubit u bë një sëmundje që atij iu shkaktua nga mishi dhe qumështi i devesë. Gjatë kësaj sëmundjeje, Jakubi iu betua Zotit se do t'ia ndalonte vetes këtë ushqim dhe pije, të cilat ishin nga më të dashurat për të, dhe ashtu veproi. Edhe pasardhësit e tij e pasuan atë në këtë ligj, të cilin ai ia imponoi vetvetes. E gjithë kjo ndodhi para shpalljes së Teuratit. Pastaj, pas shpalljes së Teuratit në kohën e Musait (pra, shumë vjet pas Jakubit), u ndaluan edhe shumë gjëra të tjera, të cilat më parë kishin qenë të lejuara për bijtë e Israilit. Për këtë, Allahu i Lartësuar thotë: "Për shkak të padrejtësisë së judejve dhe për shkak se ata pengonin shumë nga rruga e Allahut, Ne ua ndaluam disa të mira, që i kishin të lejuara më parë. Kjo, edhe për shkak të fitimit nga kamata, ndërkohë që e kishin të ndaluar atë, dhe për shkak të ngrënies së pasurisë së njerëzve në mënyrë të padrejtë. Ne kemi përgatitur një dënim të mundimshëm për atë pjesë të tyre që nuk besuan." [Nisa 160, 161].

Atëherë, kuptimi i ajetit është: A nuk është ky një shembull i mirë që tregon se shfuqizimi i disa dispozitave të Zotit është diçka e pranueshme edhe nga vetë ju? Atëherë, përse sillni si justifikim për të mohuar dy profetë të mëdhenj faktin se ata kanë bërë shfuqizime të disa normave të mëparshme, ndërkohë që kjo pranohet edhe në librat që ju i besoni?!

Nëse e kundërshtojnë një fakt të tillë, atëherë i Madhëruari thotë:

- **"Thuaju: "Silleni, pra, Teuratin dhe lexojeni atë, nëse jeni të saktë!""** - Por ata vazhduan me arrogancë e kokëfortësi në qëndrimin e tyre, edhe pse e vërteta ishte shumë e qartë. Prandaj Allahu i Lartësuar kërcënon dhe thotë:

- "Çdokush që, edhe pas kësaj, shpif gënjeshtra kundër Allahut, është me të vërtetë i padrejtë." - Vërtet ky është një krim dhe padrejtësi e pashembullt. Të ftohesh për të gjetur të vërtetën, duke u bazuar në Librin e Zotit, dhe të mos e pranosh një gjë të tillë?! Kjo vërtet tregon arrogancë, kokëfortësi dhe padrejtësi të pamatë.

Nga ana tjetër, kjo është një dëshmi tepër bindëse për profetësinë dhe vërtetësinë e Muhamedit (a.s.). Ai ishte Profet i Zotit, të cilit i shpallej e vërteta. Ose, në të kundërt, si mund të shpjegohet që ai dinte imtësi të tilla, të cilat nuk mund t'i dinte askush tjetër, veç atij që Zoti ia zbulon e tregon?! Prandaj thotë i Lartësuari:

- "Thuaj: "Allahu thotë të vërtetën." – Pra, Allahu i Lartësuar është i saktë dhe i vërtetë në gjithçka që lajmëron dhe që gjykon. Këtu urdhërohet Profeti (a.s.) dhe besimtarët që të deklarojnë me gojë se Allahu i Lartësuar e thotë të vërtetën qartë dhe bindshëm. Por kjo deklaratë duhet të shoqërohet me besim dhe siguri në zemër. Ajo duhet të jetë e bazuar në dije dhe argumente të sakta, sepse

vetëm në këtë mënyrë ajo do të zërë vendin që duhet në polemikat kundër mohuesve të Zotit. Madje, është detyrë për adhuruesit e Allahut të Lartësuar që t'i argumentojnë fjalët e drejta të Allahut dhe t'ua paraqesin ato qartë dhe shkoqur refuzuesve të së vërtetës.

Nga ky ajet kuptohet se njerëzit më të mëdhenj në besimin dhe dashurinë për Allahun, janë ata më të diturit, që kanë siguri më të plotë në argumentet fetare dhe logjike, të cilat vërtetojnë imanin dhe udhëzimet e Allahut. Për këtë arsye, njeriu duhet të synojë që ta përsosë dijen dhe sigurinë e tij, në aspektet e besimit dhe të udhëzimeve të Allahut të Lartësuar, për të qenë nga njerëzit më të dashur dhe më të afruar tek Ai.

Pastaj Allahu i Lartësuar i urdhëron ata që të pasojnë fenë dhe udhëzimin e sjellë prej Ibrahimit (a.s.):

- "Ndiqeni atëherë fenë e pastër të Ibrahimit, i cili kurrë nuk ishte prej idhujtarëve". - Ibrahimi (a.s.) ishte *ĥanîf* ose besimdrejtë. *Ĥanîf* është ai që adhuron një Zot të vetëm me dashuri, madhërim, nënshtrim dhe bindje totale, duke u larguar nga adhurimi i çdo gjëje tjetër veç Allahut. Njësimi me adhurim i Allahut të Lartësuar dhe largimi nga çdo formë e politeizmit janë rruga e vetme për të arritur lumturinë në të dyja jetët. Me lënien dhe shpërfilljen e kësaj rruge, është i pashmangshëm dëshpërimi në të dyja jetët. Ky ajet tregon, gjithashtu, se çifutët dhe të tjerët, të cilët nuk e pasojnë fenë dhe udhëzimin e Ibrahimit, nuk janë njësues të Allahut në adhurim.

Pasi i urdhëroi që të pasonin fenë dhe udhëzimin e Ibrahimit, që do të thotë *teuhid* dhe largim nga shirku, Allahu i Lartësuar vijon t'i nxisë adhuruesit e Tij që të madhërojnë dhe respektojnë një nga shenjtëritë më të mëdha të Zotit në tokë, Qaben, duke urdhëruar që ta vizitojmë atë për umra dhe për haxh.

Ajetet 96 – 97

96. Shtëpia e parë e ndërtuar për njerëzit është ajo në Bekë *(Mekë)*, e begatshme dhe udhëzuese për mbarë njerëzimin.
97. Atje ka shenja të qarta, siç është Vendi i Ibrahimit, dhe kush hyn në të, ai është i sigurt. Për hir të Allahut, është detyrë për njerëzit vizita e Shtëpisë, për atë që ka mundësi të shkojë tek ajo. Kush nuk e beson këtë, le ta dijë se, vërtet, Allahu nuk ka nevojë për ibadetin që ia përkushtojnë njerëzit.

Shpjegimi i ajeteve

- "Shtëpia e parë e ndërtuar për njerëzit është ajo në Bekë *(Mekë)*, e begatshme dhe udhëzuese për mbarë njerëzimin." - Allahu i Lartësuar na tregon këtu për madhështinë dhe mirësinë e Shtëpisë së Shenjtë në Mekë. Ajo është e para ndërtesë që Allahu i Lartësuar e përcaktoi për njerëzit si vend ku të kryejnë adhurimet e tyre për Krijuesin e dashur dhe të mëshirshëm.

Gjithashtu, në këtë faltore adhurohet Zoti, falen gjynahet, mbulohen të metat, justifikohen lëshimet dhe mangësitë. Tek ajo kryhen shumë lloje adhurimesh dhe përkushtimesh, nëpërmjet të cilave krijesat afrohen tek Allahu dhe fitojnë kënaqësinë e Tij ndaj tyre. Atje fitohet shpërblimi i Allahut dhe shpëtohet prej ndëshkimit të Tij, prandaj Allahu i Lartësuar e ka cilësuar si "*mubaraken*" - të begatshme.

Allahu i Lartësuar e ka përshkruar këtë shtëpi edhe me një cilësi tjetër: "udhëzuese për mbarë njerëzimin". Ka dy forma udhëzuesish: udhëzues drejt dijeve të vlefshme dhe udhëzues drejt veprave të mira. Sigurisht, Shtëpia e Shenjtë është udhëzuese për njerëzimin me të dyja format e lartpërmendura.

Për sa u përket udhëzuesve që gjenden në këtë Shtëpi dhe në rrethinat e saj, çdo gjë është shumë e qartë. Atje janë shumë të qarta dhe të dukshme vendet ku duhet të kryhen ritet dhe përkushtimet e caktuara për Zotin e gjithësisë. Ndërsa për sa u përket

udhëzuesve drejt dijeve të vlefshme, mund të themi se Qabja dhe rrethinat e saj të bukura janë të mbushura plot shenja dhe mrekulli të qarta. Atje ndodhen plot shenja, të cilat dëshmojnë për madhështinë, urtësinë, dijen dhe mëshirën e gjerë të Krijuesit të tyre. Prej tyre, ne kuptojmë qëllimet e larta dhe të urta të Krijuesit dhe Mëshiruesit të dashur. Në Shtëpinë e Shenjtë gjen shenja që flasin për njëshmërinë e Allahut në meritën e adhurimit. Atje gjen argumente rreth mëshirës, urtësisë dhe madhështisë së Absolutit. Ato dëshmojnë për gjerësinë e dijes së Tij dhe për bamirësinë e pakufishme të Allahut për adhuruesit e Tij. Ato tregojnë, gjithashtu, për mirësitë e shumta që Ai u ka dhuruar të dashurve dhe profetëve të Tij.

Ndër shenjat dhe argumentet që na udhëzojnë drejt dijeve të vlefshme, Allahu i Lartësuar përmend:

- **"Atje ka shenja të qarta, siç është Vendi i Ibrahimit"** - Allahu i Lartësuar e ka konsideruar "*Mekamu Ibrahim*" – Vendin e Ibrahimit, si shenjë që të udhëzon në shumë dije të vërteta.

Po çfarë nënkupton "*Mekamu Ibrahim*"? Çfarë është ajo shenjë a mrekulli që Zoti ka vendosur në të?! Dijetarët kanë mendime të ndryshme për këto çështje:

Kështu, disa mendojnë se këtu flitet për gurin e njohur, mbi të cilin hipte Ibrahimi (a.s.) për të ndërtuar muret e Qabes. Ky gur ka qëndruar ngjitur pranë Qabes deri në kohën e Omer Ibn Hatabit, i cili e zhvendosi atë në pikën ku ndodhet edhe sot. Shenjat e Zotit që ndodhen në këtë gur janë pikërisht gjurmët e këmbëve të Ibrahimit (a.s.), të cilat mrekullisht i kanë rezistuar kohës deri më sot. Është vërtet e jashtëzakonshme ruajtja me shekuj e këtyre gjurmëve.

Disa thonë se mrekullia qëndron në respektin dhe dashurinë e madhe që Allahu ka vendosur në zemrat e njerëzve për Ibrahimin (a.s.). Sipas tyre, "*Meḳâmu Ibrâhîm*" do të thotë "Pozicioni i lartë i Ibrahimit". Të gjithë njerëzit e duan, e respektojnë dhe e nderojnë figurën dhe gradën e lartë të Ibrahimit (a.s.).

Megjithatë, të tjerë mendojnë se "*Meḳâmu Ibrâhîm*" ka kuptimin: "Vendadhurimi i Ibrahimit". Kështu, përderisa ky grup emëror është i formës pronë - pronar, sipas rregullave gjuhësore të arabishtes, ai përfshin në kuptimin e tij të gjitha vendadhurimet e Ibrahimit (a.s.) në Qabe dhe rreth saj, ku Ibrahimi kreu adhurimet dhe përkushtimet e Tij ndaj Allahut të Lartësuar. Nën dritën e këtij kuptimi, të gjitha adhurimet që kryen në Qabe dhe rreth saj, si tavafi, saji, namazi, qëndrimi në Muzdelife etj., janë argumente të madhështisë së kësaj Shtëpie dhe të adhurimeve të kryera në të ndër shekuj, që prej kohës së Ibrahimit (a.s.) e deri tani. Të gjitha këto rite, që nuk reshtin në këtë vend të bekuar çdo vit, çdo muaj e çdo ditë nga miliona njerëz, dëshmojnë për qëllimet e larta të Krijuesit kundrejt kësaj toke të begatë dhe kundrejt popullit që e adhuron Zotin Një në të.

Një shenjë e madhe dhe argument i mrekullueshëm është edhe dashuria e malli që Allahu i Lartësuar ka futur në zemrat e njerëzve për të vizituar këtë Shtëpi të Shenjtë. Ata durojnë shumë vështirësi e mundime, janë gati të shpenzojnë gjithçka prej jetës dhe pasurisë së tyre vetëm për ta vizituar dhe për të shprehur në të adhurimin dhe dashurinë e tyre ndaj Zotit të saj, ndaj Allahut të Lartësuar.

Në të gjitha ritet e përkushtimet që kryhen në Qabe ka urtësi të mrekullueshme dhe qëllime shumë të larta. Adhurimet e lidhura me atë vend janë aq dobiprurëse dhe të mrekullueshme saqë njerëzit nuk mund të përkufizojnë edhe një pjesë të vogël të tyre.

Një mrekulli tjetër e Xhamisë të Shenjtë, që dëshmon për pushtetin dhe vërtetësinë absolute të Allahut të Lartësuar është edhe një fakt tjetër, që tregohet në këtë ajet:

- "...dhe kush hyn në të, ai është i sigurt." - Çdokush që hyn në Mekë është i sigurt nga çdo e keqe, ligjërisht dhe realisht. Themi ligjërisht, sepse nëpërmjet profetit Ibrahim (a.s.) e më pas edhe nëpërmjet Muhamedit (a.s.), Allahu i Lartësuar ka caktuar dispozita sigurie, të cilat mundësojnë që ai vend të madhërohet dhe të nderohet. Kështu, çdokush që hyn në Vendin e Shenjtë duhet të jetë i sigurt dhe i ruajtur nga çdo e keqe. Madje, atje është ndaluar edhe vrasja e kafshëve të gjuetisë apo prerja e pemëve dhe e bimësisë së saj. Lidhur me çështjen, disa dijetarë mbështeten në këtë ajet e thonë se kush bën një krim jashtë Vendit të Shenjtë dhe më pas hyn në të, ai është i sigurt dhe nuk dënohet, derisa të dalë prej atij vendi.

Ndërsa për sa i përket sigurisë reale të këtij vendi, mund të themi se Allahu i Lartësuar, me urtësinë dhe pushtetin e Tij absolut mbi gjithçka, ka përcaktuar dhe vendosur që Qabja të ketë një nderim dhe vend të veçantë në zemrat e të gjithë njerëzve. Madje edhe idhujtarët apo qafirët (kur Vendi i Shenjtë ende nuk ishte pastruar prej tyre) e nderonin dhe e respektonin shenjtërinë dhe sigurinë e atij vendi. Kështu, për shembull, edhe pse ata ishin në përgjithësi të papërmbajtur, nëse ndonjëri prej tyre shihte vrasësin e babait të vet në Qabe, nuk e ngacmonte apo dëmtonte atë.

Një tjetër shenjë e mrekullueshme që tregon për pushtetin absolut të Allahut dhe për faktin se Ai e ka përcaktuar këtë vend që të jetë i shenjtë e i sigurt, është edhe mbrojtja që Zoti i ka siguruar Qabes gjatë kohërave. Çdokush që ka dashur të bëjë diçka të keqe në të apo, aq më keq, ta shembë e shkatërrojë atë vend të shenjtë, e ka vuajtur ndëshkimin e hidhur që në këtë jetë, para atij të ahiretit. Kështu ndodhi me të ashtuquajturën "Ushtria e Elefantit", por edhe me të tjerë.

- "Për hir të Allahut, është detyrë për njerëzit vizita e Shtëpisë..." - Rreth këtij ajeti ka folur shumë bukur Ibn Kajjimi, të cilin unë do të doja ta citoja këtu. Kështu, pasi i bën një analizë gjuhësore kësaj fjalie, duke shfaqur disa dobi që fshihen pas formulimit të saj, Imam Ibn Kajjimi tregon se ajo përcjell tre mesazhe njëri pas tjetrit, të cilët janë renditur sipas rëndësisë së secilit. Renditja e tyre në fjali është në këtë mënyrë:

Së pari: "*Për hir të Allahut*". Ky është qëllimi që duhet të ketë njeriu në kryerjen e kësaj detyre. Në fakt, çdo adhurim duhet kryer për hir të Allahut, për të arritur kënaqësinë e Tij. Kështu, fjalia nis duke treguar së pari qëllimin e veprës dhe duke përmendur emrin e Tij të mrekullueshëm, Allah. Përmendja e këtij emri në fillim bëhet edhe për të treguar rëndësinë e madhe të kësaj detyre, madje përmban në vetvete edhe një lloj kërcënimi për ata që nuk e përfillin atë.

Vërtet, kjo detyrë është një nga shtyllat e Islamit. Vizita e Shtëpisë së Zotit është një detyrë e madhe për njeriun, sikurse namazi, agjërimi etj. Ajo dispozitë që është bërë e detyrueshme nga vetë Allahu i Lartësuar, nuk është njëlloj si dispozitat e tjera, të ligjëruara për qëllime të tjera.

Së dyti: "*është detyrë për njerëzit*". Pra, më pas përmenden ata mbi të cilët rëndon kjo detyrë, që janë të gjithë njerëzit.

Së treti: "*vizita e Shtëpisë*". Në rend të tretë tregohet vetë detyra që rëndon mbi tërë njerëzimin në përgjithësi, dhe që duhet kryer me qëllim që të arrihet kënaqësia e Allahut të Lartësuar. Kjo detyrë kaq e rëndësishme është, pra: "vizita e Shtëpisë së Shenjtë".

Pastaj Allahu i Lartësuar tregon një hollësi tjetër:

- "...për atë që ka mundësi të shkojë tek ajo." - Në shpjegimin e kësaj pjese, imam Ibn Kajjimi ka analizuar fjalinë nga ana gjuhësore dhe ka thënë se vizita e Shtëpisë së Shenjtë është detyrim për të gjithë njerëzit në përgjithësi, ndërsa përjashtimi që bëhet në fjalinë e fundit tregon se ata që nuk kanë mundësi që ta kryejnë këtë vizitë, Allahu i Lartësuar nuk do t'i marrë në llogari.

Përgjegjësinë e kanë vetëm ata të cilët e kanë mundësinë që ta kryejnë një detyrë të tillë.

Pra, analiza gjuhësore që i është bërë kësaj fjalie tregon saktësinë e qëndrimit të mësipërm, sepse dikush mund të mendojë gabimisht se vizita e Shtëpisë së Shenjtë është thjesht një detyrim kolektiv (*farz kifaje*) që, po të përmbushet nga një individ i bashkësisë, hiqet përgjegjësia nga të tjerët, dhe jo detyrim individual (*farz ajn*). Shikoni me kujdes fjalinë!

Fragmenti: "...për atë që ka mundësi të shkojë tek ajo" tregon që përgjegjësia për kryerjen apo jo të kësaj detyre është lidhur ngushtë me mundësinë për ta kryer atë. Pra, njeriu nuk do të merret në përgjegjësi tek Allahu i Lartësuar për kryerjen apo jo të saj, derisa të ketë mundësinë që ta kryejë. Nëse i krijohet mundësia dhe nuk e kryen, atëherë ai do të jetë përgjegjës. Ky është kuptimi i saktë i këtij ajeti.

Një përfitim tjetër nga ky ajet është edhe mënyra e formulimit të dispozitave të Allahut të Lartësuar për adhuruesit e Tij. Për të përforcuar rëndësinë e një dispozite të caktuar, Ai përdor stile të ndryshme gjuhësore. Për shembull, kur Allahu i Lartësuar bën të detyrueshme diçka ose kërkon diçka të caktuar, Ai përdor forma të tillla si: "*Kutibe alejkumus-sijamu*" (Është shkruar për ju (si detyrë) agjërimi), ose: "*Hur-rimet alejkumul mejtetu*" (Është bërë haram për ju e ngordhura), ose: "*Kul teâleu etlu mâ ĥar-rame rab-bukum alejkum*" (Thuaj: "Ejani t'ju lexoj se çfarë ka bërë haram Zoti juaj për ju..).

Por kur sjell ligjin për detyrimin e kryerjes së haxhit, Allahu përdor disa elementë gjuhësorë përforcues, për të treguar rëndësinë e madhe të këtij adhurimi. Disa nga këta elementë janë:

1. Shprehja hyrëse: "*Për hir të Allahut*". Pra, kjo detyrë është vetëm për hir të Allahut, prandaj merreni atë në konsideratë në mënyrë të veçantë.

2. Shprehja: "*(detyrë) për njerëzit*". Kjo është një nga mënyrat më të forta (në arabisht) të ligjërimit të urdhërave.

3. Përsëritja e pohimit të këtij detyrimi, duke u rikujtuar njerëzve se kanë përgjegjësi të madhe për kryerjen e tij, kur thotë: "*...për atë që ka mundësi*". Pra, Allahu u rikujton njerëzve se kjo është një përgjegjësi që rëndon mbi ta, sidomos kur ata e kanë mundësinë për ta kryer atë. Kjo është një nxitje për të qenë më shumë të kujdesshëm ndaj këtij detyrimi.

4. Në shprehjen: "*...për atë që ka mundësi*", fjala "*sebîlâ*" (mundësi, rrugë) është (në arabisht) në trajtën e pashquar, në një fjali kushtore. Si e tillë, ajo jep kuptimin që: duhet kërkuar çdo rrugë e mundësi për ta kryer këtë detyrim. Pra, haxhi është i detyrueshëm të kryhet, duke kërkuar e gjetur çdo mënyrë që ta mundësojë atë.

Një formë tjetër përforcimi është edhe kërcënimi vijues:

- "Kush nuk e beson këtë, le ta dijë se, vërtet, Allahu nuk ka nevojë për ibadetin që ia përkushtojnë njerëzit." - Ky vërtet konsiderohet si kërcënim, sepse Allahu i Lartësuar e ka konsideruar mohimin e kësaj detyre si kufër (mohim të Zotit), dhe ky është, gjithashtu, përforcues i kësaj detyre.

Allahu i Lartësuar ka deklaruar diçka, që vërtet konsiderohet si qortim, kështillë e kërcënim për njerëzit. Ai ka thënë që: "Allahu nuk ka nevojë për ibadetin që ia përkushtojnë njerëzit". Pra, Allahu i Lartësuar është i Pasur e Jonevojtar për adhurimet që kryejnë krijesat. Allahu nuk ka nevojë për adhurimin e askujt. Ai është i Lavdëruar dhe i Madhëruar në Veten e Tij. Çdo adhurim që Ai ka ligjëruar e ka bërë me mëshirën e Tij për lumturinë e njeriut. Kush e pranon ftesën, fiton kënaqësinë e Zotit, e kush e refuzon, dëmton veçse vetveten, duke merituar zemërimin dhe ndëshkimin e Zotit të tij. Siç kuptohet, kërcënimi është shumë i fortë dhe tregon rëndësinë e këtij urdhri.

Për ta theksuar kërcënimin, Allahu i Lartësuar ka thënë se është Jonevojtar ndaj të gjithë botës, e nuk ka thënë që është Jonevojtar ndaj adhurimit të njërit apo tjetrit, që nuk dëshiron ta bëjë atë adhurim. Ky është element më i fuqishëm që tregon se Ai është i Pasur e i Lavdëruar, që nuk ka nevojë për asnjë dhe për asgjë, në çdo aspekt. Kështu përforcohet edhe kërcënimi ndaj atyre që e shpërfillin këtë detyrë.

Element tjetër është pjesëza "*inne*" (vërtet) që përdoret në gjuhën arabe për të përforcuar kumtin e fjalisë. Edhe kjo është bërë, pra, në funksion të përforcimit të kësaj detyre, që quhet "vizita te Shtëpia e Zotit". Të gjithë elementët përforcues tregojnë së bashku rëndësinë e madhe të këtij riti.

Medito pak se si Allahu i Lartësuar e ka përsëritur dy herë që ky adhurim është detyrë: një herë për njerëzit në përgjithësi, dhe pastaj për ata që kanë mundësi dhe gjejnë rrugë dhe mjete për kryerjen e kësaj detyre, në veçanti. Përsëritja e një urdhri tregon për rëndësinë e tij.

Pastaj medito pak edhe për faktin që Allahu i Lartësuar, para se të sjellë urdhrin e përforcuar për kryerjen e këtij adhurimi, përmend shumë vlera e mirësi të Shtëpisë së Shenjtë. Pa dyshim që ky stil është i mrekullueshëm për të nxitur shpirtrat dhe zemrat e njerëzve që ta vizitojnë atë vend të begatë. *Subhanallah*! Allahu i Lartësuar i bën shpirtrat që të përmallohen dhe ta duan fort vizitën e Qabes, që ata të shkojnë atje, edhe nëse nuk do të ishte detyrim për ta. Në ajetet e mësipërme numërohen shumë mirësi, që tregojnë madhështinë e Shtëpisë së Lashtë. Më konkretisht, Allahu i Lartësuar e ka përshkruar këtë shtëpi me pesë cilësi:

1. Ajo është e para Shtëpi adhurimi e vendosur në faqen e dheut për njerëzimin.

2. Ajo është '*mubâreken*', e bekuar. Nuk ka ndërtesë në faqen e dheut që të jetë e bekuar me mirësi dhe begati të shumta, sikurse kjo Shtëpi e Lashtë. Mirësitë dhe begatitë e saj janë të shumta, të larmishme dhe të vazhdueshme për krijesat.

3. Qabja është udhëzuese për njerëzit. Allahu i Lartësuar ka përdorur fjalën "*hudâ*", që është një emër foljor e jo një folje. Kjo bëhet për të treguar peshën dhe fushën e gjerë të udhëzimit që përmban kjo Shtëpi. Ajo është udhëzuese, me të dyja kuptimet e udhëzimit, që i përmendëm më sipër. Pra, Allahu nuk ka thënë që ajo Shtëpi të udhëzon në këtë apo atë të mirë, por ka thënë se ajo është "udhëzuese". Pra, a thua se ajo është vetë udhëzimi, e jo një mjet që të ndihmon të gjesh rrugën e drejtë.

4. Në atë Shtëpi ka shenja e mrekulli të shumta, sikurse u tha më lart, që tregojnë madhështinë e Krijuesit dhe qëllimin e Tij me njerëzit.

5. Kush hyn në Qabe është i sigurt. Edhe kjo është një cilësi e mrekullueshme e kësaj shtëpie, që ia ka dhënë Allahu.

Të tilla cilësi të shkëlqyera janë një nxitje e madhe për të vizituar Xhaminë e Shenjtë, edhe nëse nuk do të kishte urdhër për ta bërë këtë. Ato e shkurtojnë rrugën drejt saj dhe mundimet për të shkuar atje bëhen të papërfillshme.

Më tej, pas përshkrimit të cilësive të Qabes, i Madhëruari e sjell urdhrin për ta kryer atë detyrim, të përforcuar me shumë elementë të tjerë. Kjo tregon për kujdesin e veçantë që Allahu i Lartësuar i ka kushtuar kësaj faltoreje dhe për gradën e lartë të saj.

Po ashtu, sikur të mos ishte asnjë fjalë tjetër për të treguar madhështinë dhe shenjtërinë e Qabes, por vetëm fakti që Allahu e ka quajtur atë "Shtëpia Ime", kaq do të mjaftonte. Allahu i Lartësuar ka thënë për të: "Pastroje Shtëpinë Time". Kjo është një shenjë e madhe për famën, shenjtërinë dhe madhështinë e saj. Kësisoj, është normale që zemrat dhe shpirtrat e krijesave të nxitojnë të përmalluara drejt kësaj faltoreje, që Allahu e ka quajtur "Shtëpia Ime". Aq e dashur është ajo për shpirtin e atyre që e duan Zotin, saqë kurrë nuk u shuhet malli për të, qoftë edhe kur e vizitojnë vazhdimisht. Madje, sa më shumë e vizitojnë, aq më shumë shtohet dëshira për

ta parë e vizituar edhe një herë. As prania afër saj nuk ua shuan mallin, e as largësia prej saj nuk i ngushëllon dhe i lë të qetë, siç thuhet në një vjershë:

Sillem rreth saj, por prapë e dëshiroj,
Më pranë se kaq, a mund t'i qëndroj?!

Ajetet 98 – 101

98. Thuaj: "O ithtarë të Librit, përse i mohoni ajetet e Allahut, kur dihet se Allahu ju dëshmon se çfarë veproni?!"
99. Thuaj: "O ithtarë të Librit, përse e pengoni nga rruga e Allahut atë që beson, duke u angazhuar që ta paraqitni atë të shtrembër, ndërkohë që vetë ju jeni dëshmitarë! Allahu nuk është aspak i pavëmendshëm ndaj asaj që ju veproni."
100. O ju që besoni! Në qoftë se ju i bindeni një grupi të atyre që u është dhënë Libri më parë, ata do t'ju kthejnë në jobesimtarë, pasi keni besuar njëherë.
101. Si mund të mos besoni, kur juve po ju lexohen ajetet e Allahut, dhe ndërkohë që në mesin tuaj gjendet i Dërguari i Tij?! E kush i përmbahet fesë së Allahut, ai është udhëzuar në rrugën e drejtë.

Shpjegimi i ajeteve

- "Thuaj: "O ithtarë të Librit, përse i mohoni ajetet e Allahut, kur dihet se Allahu ju dëshmon se çfarë veproni?!" Thuaj: "O ithtarë të Librit, përse e pengoni nga rruga e Allahut atë që beson, duke u angazhuar që ta paraqitni atë të shtrembër, ndërkohë që vetë ju jeni dëshmitarë!"" - Allahu i Lartësuar u shpalli profetëve libra të ndritur e të shenjtë. Ata janë mëshirë për krijesat. Vetëm nëpërmjet tyre udhëzohen krijesat për të shkuar te Krijuesi i tyre. Nëpërmjet këtyre librave madhështorë, ata njohin qëllimet e jetës dhe përfitojnë dije të dobishme. Por ata që Zoti iu dha Libër, domethënë çifutët e të krishterët, nuk i trajtuan si duhet librat e Tij. Ata i mohuan dhe i shpërfillën argumentet e qarta dhe rrugën e drejtë, të sjellë si mëshirë nga Zoti i gjithësisë. Prandaj, në këtë ajet, Allahu i Lartësuar i qorton ata për këto padrejtësi.

Çifutët e të krishterët bënë shumë të këqija njëherazi. Ata refuzuan udhëzimin e drejtë, të sjellë prej Allahut dhe Profetit të Tij. Jo vetëm kaq, por ata penguan besimtarët që ta pasonin rrugën e drejtë dhe të jetonin sipas saj. Çifutët dhe të krishterët e shtrembëruan të vërtetën, duke i dhënë asaj pamje dhe drejtim tjetër nga autentikja. E keqja më e madhe është që, këto të këqija dhe padrejtësi, ata i kryenin me vetëdije të plotë. Ata ishin të ndërgjegjshëm për kufrin e madh që po kryenin, i cili meriton ndëshkimin e madh dhe me të cilin ata do të përballen një ditë. Prandaj i Madhëruari i kërcënon ata me fjalët:


- "Allahu nuk është aspak i pavëmendshëm ndaj asaj që ju veproni." – Madje, Allahu është i Gjithëditur rreth asaj që ju punoni. Ai i di shumë mirë qëllimet dhe kurthet tuaja të zeza. Por, sigurisht, Ai ka për t'ju shpaguar me drejtësi për çdo gjë që keni bërë.

Pas këtij kërcënimi të frikshëm, Allahu i Lartësuar flet për mëshirën dhe bamirësinë e Tij ndaj adhuruesve të sinqertë, që ata të mos mashtrohen dhe të mos bien viktima të kurtheve të mohuesve të Zotit. Thotë i Lartësuari:

- "O ju që besoni! Në qoftë se ju i bindeni një grupi të atyre që u është dhënë Libri më parë, ata do t'ju kthejnë në jobesimtarë, pasi keni besuar njëherë." - E çfarë mund të pritet tjetër prej smirëzinjve të mbushur plot urrejtje dhe armiqësi ndaj jush?! Ata janë të paduruar dhe ngulmues për t'ju devijuar nga rruga e drejtë ku ju ecni. Ata mezi presin që ju të braktisni udhëzimin hyjnor, me dritën e të cilit ecni të sigurt drejt kënaqësisë së Zotit tuaj, sikurse thotë i Madhëruari: "Shumë ithtarë të Librit do dëshironin, të shtyrë nga zilia e tyre personale, që, pasi ju keni besuar, t'ju kthenin në jobesimtarë, edhe pasi u është

bërë e qartë e vërteta. Falini dhe tolerojini ata, derisa Allahu ta sjellë urdhrin e Vet. Allahu është i Fuqishëm për gjithçka." [Bekare 109].

Pastaj, Allahu i Lartësuar dhe Mëshirues, me butësinë dhe përkujdesin e Tij të pamatë, i udhëzon besimtarët, adhuruesit e Tij të sinqertë, në disa mënyra, nëpërmjet të cilave ata do të jenë të patundur në besimin e tyre dhe në ndjekjen e udhës të drejtë, që të çon drejt kënaqësisë së Tij. Nëse ata i shfrytëzojnë këto mënyra, atëherë devijimi dhe humbja e tyre nga rruga e drejtë do të ishte e pamundur. Prandaj thotë i Lartësuari:


الجزء الرابع سورة آل عمران
وَكَيْفَ تَكْفُرُونَ وَأَنتُمْ تُتْلَىٰ عَلَيْكُمْ ءَايَٰتُ ٱللَّهِ وَفِيكُمْ
رَسُولُهُۥ ۗ وَمَن يَعْتَصِم بِٱللَّهِ فَقَدْ هُدِىَ إِلَىٰ صِرَٰطٍ مُّسْتَقِيمٍ ﴿١٠١﴾
يَٰٓأَيُّهَا ٱلَّذِينَ ءَامَنُوا۟ ٱتَّقُوا۟ ٱللَّهَ حَقَّ تُقَاتِهِۦ وَلَا تَمُوتُنَّ إِلَّا وَأَنتُم
مُّسْلِمُونَ ﴿١٠٢﴾ وَٱعْتَصِمُوا۟ بِحَبْلِ ٱللَّهِ جَمِيعًا وَلَا تَفَرَّقُوا۟ ۚ وَٱذْكُرُوا۟
نِعْمَتَ ٱللَّهِ عَلَيْكُمْ إِذْ كُنتُمْ أَعْدَآءً فَأَلَّفَ بَيْنَ قُلُوبِكُمْ
فَأَصْبَحْتُم بِنِعْمَتِهِۦٓ إِخْوَٰنًا وَكُنتُمْ عَلَىٰ شَفَا حُفْرَةٍ مِّنَ
ٱلنَّارِ فَأَنقَذَكُم مِّنْهَا ۗ كَذَٰلِكَ يُبَيِّنُ ٱللَّهُ لَكُمْ ءَايَٰتِهِۦ لَعَلَّكُمْ
تَهْتَدُونَ ﴿١٠٣﴾ وَلْتَكُن مِّنكُمْ أُمَّةٌ يَدْعُونَ إِلَى ٱلْخَيْرِ وَيَأْمُرُونَ
بِٱلْمَعْرُوفِ وَيَنْهَوْنَ عَنِ ٱلْمُنكَرِ ۚ وَأُو۟لَٰٓئِكَ هُمُ ٱلْمُفْلِحُونَ ﴿١٠٤﴾
وَلَا تَكُونُوا۟ كَٱلَّذِينَ تَفَرَّقُوا۟ وَٱخْتَلَفُوا۟ مِنۢ بَعْدِ مَا جَآءَهُمُ ٱلْبَيِّنَٰتُ ۚ
وَأُو۟لَٰٓئِكَ لَهُمْ عَذَابٌ عَظِيمٌ ﴿١٠٥﴾ يَوْمَ تَبْيَضُّ وُجُوهٌ وَتَسْوَدُّ
وُجُوهٌ ۚ فَأَمَّا ٱلَّذِينَ ٱسْوَدَّتْ وُجُوهُهُمْ أَكَفَرْتُم بَعْدَ إِيمَٰنِكُمْ
فَذُوقُوا۟ ٱلْعَذَابَ بِمَا كُنتُمْ تَكْفُرُونَ ﴿١٠٦﴾ وَأَمَّا ٱلَّذِينَ ٱبْيَضَّتْ
وُجُوهُهُمْ فَفِى رَحْمَةِ ٱللَّهِ ۖ هُمْ فِيهَا خَٰلِدُونَ ﴿١٠٧﴾ تِلْكَ ءَايَٰتُ
ٱللَّهِ نَتْلُوهَا عَلَيْكَ بِٱلْحَقِّ ۗ وَمَا ٱللَّهُ يُرِيدُ ظُلْمًا لِّلْعَٰلَمِينَ ﴿١٠٨﴾
٦٣

- "Si mund të mos besoni, kur juve po ju lexohen ajetet e Allahut, dhe ndërkohë që në mesin tuaj gjendet i Dërguari i Tij?!" - Profeti (a.s.) ju lexon juve ajetet e udhëzimet e Zotit tuaj vazhdimisht dhe është ende mes jush. Ajetet e sjella prej Tij janë shumë të qarta, prandaj duhet t'i besoni ato. Ju duhet, gjithashtu, të zbatoni çdo mësim të nxjerrë prej tyre. Nëpërmjet udhëzimit dhe dritës së sjellë prej Profetit tuaj nga Zoti i gjithësisë, ju keni marrë dijen e sigurt, që nuk pranon asnjë lloj dyshimi në asnjë aspekt të saj. Origjinalitetin dhe sigurinë e këtij udhëzimi ia shton fakti që transmetuesi dhe qartësuesi i saj është më i miri i krijesave dhe më i dituri i tyre rreth Zotit të gjithësisë, si edhe më oratori dhe më i afti mes tyre në qartësimin e çështjeve. Ai është vërtet njeriu më i butë, më i dashur dhe më i mëshirshëm me besimtarët, që e dëshiron udhëzimin dhe të mirën e adhuruesve të Zotit më shumë se çdo krijesë tjetër. Ai përpiqet me çdo mënyrë për të qartësuar dhe për të udhëzuar krijesat drejt adhurimit të Zotit të tyre.

Paqja, mëshira dhe gjithë begatitë e Allahut qofshin mbi Muhamedin (a.s.)! Me të vërtetë, ai i dha njerëzimit këshillën më të qartë dhe e përcolli mesazhin e Zotit të tij te njerëzit me mënyrën më të bukur dhe më të ëmbël. Pas qartësimit të tij të plotë, nuk mbeti më vend për asnjë që të flasë dhe të kundërshtojë, ndërsa kërkuesve të rrugës së mirësisë nuk u mbeti gjë pa iu treguar dhe pa iu shpjeguar.

- "E kush i përmbahet fesë së Allahut, ai është udhëzuar në rrugën e drejtë." - Allahu i Lartësuar na mëson të përdorim këto armë të mrekullueshme, që të ruajmë besimin dhe udhëzimin e drejtë. Çdokush që kërkon ndihmë, strehim dhe mbrojtje tek Allahu i Lartësuar, çdokush që i mbështetet plotësisht të Plotpushtetshmit, çdokush që kërkon mbrojtje nga çdo e keqe tek i Plotfuqishmi dhe i Mëshirshmi, pa dyshim që është i udhëzuar në rrugën e drejtë. Mundësia më e madhe që ka njeriu për të arritur qëllimet e tij është pajisja me këto dy armë të mrekullueshme:

1. Mbështjetja e plotë tek Allahu i Lartësuar, duke e kërkuar ndihmën, mbrojtjen dhe suksesin prej Tij.

2. Ndjekja e përpiktë e Profetit (a.s.) në fjalët, veprat dhe në të gjitha gjendjet e tij.

Ajetet 102 – 103

102. O ju që keni besuar! Pajisuni me devotshmëri ndaj Allahut me një sinqeritet të vërtetë, dhe mos vdisni ndryshe, por vetëm duke qenë muslimanë!
103. Gjithashtu, kapuni që të gjithë pas "litarit" *(fesë)* të Allahut e mos u përçani! Përkujtojeni mirësinë e Allahut ndaj jush, kur ju ishit të armiqësuar me njëri-tjetrin, ndërsa Ai i bashkoi zemrat tuaja, dhe kështu, me mirësinë e Tij, ju aguat të vëllazëruar. Ju ishit në buzë të greminës së Xhehenemit, ndërsa Ai ju shpëtoi prej tij. Kështu jua sqaron Allahu argumentet e Veta, që ju ta gjeni udhëzimin e sigurt.

Shpjegimi i ajeteve

- "O ju që keni besuar! Pajisuni me devotshmëri ndaj Allahut me një sinqeritet të vërtetë, dhe mos vdisni ndryshe, por vetëm duke qenë muslimanë!" - Ky është një urdhër nga Allahu i Lartësuar drejtuar besimtarëve, që ata t'i frikësohen dhe ta respektojnë Atë me një devotshmëri (*taḳuâ*) të vërtetë. Ai i këshillon ata që të jenë të vazhdueshëm në këtë rrugë dhe të jenë të përqendruar në ruajtjen e kufijve të Tij deri në vdekje, sepse çdokush që jeton në një gjendje të caktuar, do të vdesë po në atë gjendje. Për shembull, një njeri që në kohën e rinisë, fuqisë dhe shëndetit të plotë tregon devotshmëri të vazhdueshme ndaj Zotit të tij, duke iu bindur urdhrave të Tij dhe duke u kthyer gjithmonë tek Ai për gjithçka e në çdo gjendje, pa dyshim që Allahu i Lartësuar ka për ta forcuar atë në momentin e vdekjes dhe ka për t'ia mundësuar atij një mbyllje të mirë.

Por çfarë do të thotë që t'i frikësohesh Zotit me një devotshmëri të vërtetë?! Ibn Mesudi shpjegon: "Kjo do të thotë që t'i bindesh Allahut dhe të mos e kundërshtosh Atë, ta përkujtosh dhe të mos e harrosh Atë, ta falënderosh e të mos e mohosh Atë."

Ky ajet flet për devotshmërinë, që Allahu i Lartësuar e meriton t'ia përkushtosh. Ndërsa për sa i përket masës së devotshmërisë që adhuruesi e ka të detyrueshme ta ketë, atë e sqaron ajeti tjetër kur'ânor, që thotë: "Kini *taḳuâ* ndaj Allahut aq sa të mundeni!"

Për *taḳuâ*-n ka shumë shpjegime, që janë të lidhura me veprat e zemrës dhe të gjymtyrëve, por më bukur i përmbledh përkufizimi se: "*Taḳuâ* është kryerja e urdhrave të Allahut dhe largimi nga ndalesat e Tij."

Pastaj Allahu i Lartësuar urdhëron besimtarët për diçka, që është një ndihmë e domosdoshme për të ruajtur devotshmërinë. Kështu, devotshmëria e tyre do të jetë gjithmonë e paluhatshme nëse ata i përmbahen kësaj këshille të Zotit të tyre:

- "Gjithashtu, kapuni që të gjithë pas "litarit" *(fesë)* të Allahut e mos u përçani!" – Pra, i Lartësuari na urdhëron që të mblidhemi të gjithë rreth fesë së Tij, duke zbatuar porositë dhe udhëzimet e Tij. Ne duhet të njësojmë radhët tona, duke u bashkuar dhe duke iu larguar përçarjes mes nesh.

Nëse ndjekim udhëzimet dhe fenë e Zotit të gjithësisë dhe nëse ndihmojmë e mbështesim njëri-tjetrin, sigurisht që do të rregullohen çështjet e dynjasë dhe të fesë tonë. Suksesi i shumë çështjeve është i lidhur ngushtë me bashkimin e zemrave të këtij umeti. Për t'i qëndruar sfidave të kësaj bote, është e domosdoshme që ne të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin për të kryer vepra të mira dhe për devotshmëri ndaj Zotit. Vetëm duke mbështetur dhe mbajtur njëri-tjetrin mund të ecim të sigurt dhe të bëjmë hapa të mëdha në rrugën e Zotit. Por nëse përçahemi dhe braktisim njëri-tjetrin, duke shfaqur armiqësi dhe urrejtje, atëherë çdokush do të punojë sipas qejfit dhe, sigurisht, sistemi ynë do të shkatërrohet. Kështu do të jemi të pafuqishëm në përballjen me armiqtë tanë, që janë aq të shumtë dhe të pamëshirshëm.

Pastaj Allahu i Lartësuar u përkujton besimtarëve mirësinë e Tij ndaj tyre dhe i urdhëron ata që gjithmonë ta përmendin dhe ta çmojnë këtë mirësi të mrekullueshme që u ka dhurar:

- "Përkujtojeni mirësinë e Allahut ndaj jush, kur ju ishit të armiqësuar me njëri-tjetrin, ndërsa Ai i bashkoi zemrat tuaja..." – Kuptimi: Dikur, ju vrisnit dhe plaçkisnit njëri-tjetrin. Brenda fiseve, qyteteve e fshatrave tuaja kishte luftëra të ashpra e të përhershme. Vërtet, ju ishit në një gjendje tepër të rëndë para shfaqjes së Profetit të mëshirës. Pasi Allahu i Lartësuar e dërgoi Profetin tek ju, Ai ju dha sukses që ta besoni dhe të bashkoheni të gjithë rreth Islamit, rreth fesë së paqes. Kështu, ju u bëtë si një trup i vetëm, që e doni dhe e ndihmoni njëri-tjetrin. Më pas, thotë i Lartësuari:

- "...dhe kështu, me mirësinë e Tij, ju aguat të vëllazëruar." - Mirësia e Tij është besimi. Pra, me mirësinë e Zotit tuaj, ju u bëtë vëllezër për hir të Tij dhe të bashkuar, sikur të kishit një zemër të vetme.

- "Ju ishit në buzë të greminës së Xhehenemit, ndërsa Ai ju shpëtoi prej tij." - Me gjendjen tuaj para besimit, ju ishit gati për të rënë në zjarrin e Xhehenemit. Asgjë nuk qëndronte mes jush dhe Xhehenemit, veçse vdekja. Pra, nëse do të vdisnit në atë gjendje, pa besim dhe me armiqësi me njëri-tjetrin, ju do të hynit pashmangshmërisht në Zjarr. Porse Allahu i Lartësuar ju shpëtoi prej Zjarrit, duke ju dhënë sukses që të besoni dhe të pasoni udhëzimin e qartë dhe të sigurt, të sjellë nëpërmjet Muhamedit (s.a.u.s.).

- "Kështu jua sqaron Allahu argumentet e Veta, që ju ta gjeni udhëzimin e sigurt." – Kuptimi: Allahu i Lartësuar jua sqaron juve të vërtetën nga e gabuara, udhëzimin e drejtë nga rruga e shtrembër, me argumente të kuptueshme, që ju të gjeni rrugën dhe ta shihni qartë atë.

Allahu i Lartësuar na i qartëson të vërtetën, që ne ta njohim atë, të krijojmë siguri të plotë rreth saj dhe të punojmë me sinqeritet për ta kënaqur Atë, Zotin tonë, sipas ligjeve të Tij.

Ky ajet tregon se Allahu i Lartësuar e dëshiron dhe kënaqet që adhuruesit e Tij të përkujtojnë dhe t'i përmendin me zemër dhe me fjalë mirësitë që Ai u ka dhuruar. Duke i përkujtuar ato vazhdimisht, besimtarët do ta shtojnë mirënjohjen dhe dashurinë për Allahun. Pastaj, duke qenë mirënjohës ndaj Tij dhe duke e dashur Atë, atëherë, sikurse ka premtuar vetë Allahu, Ai do t'ua shtojë edhe më shumë mirësitë atyre.

Pa dyshim që nga mirësitë më të mëdha që duhen përkujtuar është mirësia e udhëzimit në rrugën e drejtë, në fenë Islame, është ndjekja e udhëzimeve të sakta e të qarta të Profetit (s.a.u.s.), është bashkimi i zemrave dhe i radhëve tona dhe mospërçarja midis nesh.

Ajetet 104 – 105

104. Le të dalë nga ju një grup që fton në të mirën, që urdhëron për vepra të mira dhe ndalon nga e keqja. Këta janë të shpëtuarit.
105. E mos u bëni si ata që janë përçarë dhe që kundërshtohen mes njëri-tjetrit, pasi u kanë zbritur argumentet, se ata do të kenë një dënim të madh.

Shpjegimi i ajeteve

- "Le të dalë nga ju një grup që fton në të mirën..." - Allahu i Lartësuar u drejtohet besimtarëve të cilëve u bëri mirësi, duke i udhëzuar që të kapen fort pas "litarit" të Tij, dhe i nxit që një grup prej tyre të ftojnë njerëzit tek e mira. "E mira" është një nocion që përfshin të gjitha ato fjalë dhe vepra që të afrojnë tek Allahu dhe të largojnë e të ruajnë prej zemërimit të Tij.

- "...që urdhëron për vepra të mira dhe ndalon nga e keqja." - Ata duhet të urdhërojnë për të mirën, që ligji hyjnor dhe

logjika e shëndoshë e pranon si të tillë, dhe të ndalojnë nga e keqja, e cila është konsideruar si e tillë përsëri nga ligji hyjnor dhe logjika e shëndoshë. Kjo, pra, është një nxitje nga Allahu i Lartësuar që një grup besimtarësh të marrin përsipër përgjegjësinë e thirrjes së njerëzve në rrugën e Tij dhe të sqarimit të kësaj feje madhështore. Te ky grup futen disa kategori të përzgjedhurish, si:

- Dijetarët, që u mësojnë njerëzve fenë e Zotit.
- Hatibët dhe vaizët, të cilët, me stilin e tyre të lartë të ligjërimit, i ftojnë njerëzit e të gjitha feve që të pranojnë Islamin. Ata ftojnë, gjithashtu, të devijuarit dhe të larguarit nga rruga e drejtë, që t'i kthehen asaj rruge dhe të përqendrohen në rrugën e shpëtimit.
- Luftëtarët në rrugën e Allahut, që luftojnë për t'u lartësuar feja e Tij.
- Çdokush që kujdeset për njerëzit, duke i kontrolluar dhe duke i nxitur ata që të jenë të rregullt me ritet e Islamit, si me namazin, zekatin, agjërimin, haxhin etj.
- Çdokush që këshillon njerëzit për të peshuar e matur drejt, për t'ju larguar mashtrimeve dhe padrejtësive të ndryshme në tregti apo në fusha të tjera të marrëdhënieve ndërnjerëzore.

Thirrja në rrugën e Zotit është përgjegjësi e të gjithë umetit, derisa një grup prej tyre ta kryejë një gjë të tillë; vetëm atëherë hiqet përgjegjësia nga të tjerët. Kjo duket nga fjala e Allahut: "Le të dalë nga ju një grup...".

Dihet mirë se urdhri për të realizuar një objektiv është urdhër edhe për çdo gjë tjetër pa të cilën ai objektiv nuk mund të arrihet. Kështu, është detyrë që gjithmonë një grup besimtarësh të përpiqen që të mundësojnë dhe të krijojnë mënyrat dhe mjetet pa të cilat nuk mund të arrihet objektivi i mësipërm, që është thirrja në rrugën e Allahut. Ndër to, mund të përmendim:

- Përgatitjen për xhihad me të gjitha format e saj, nëpërmjet të cilave arrihet qëllimi i xhihadit dhe kryerja e tij.
- Mësimi i dijes së dobishme, pa të cilën nuk mund të mendohet ftesa e të tjerëve në veprat e mira. Është detyrë, gjithashtu, që të krijohen mjetet dhe mundësitë për kryerjen e një detyre të tillë, për shembull, duke ndërtuar shkolla, ku të studiohet dhe të përhapet e vërteta dhe dija e dobishme.
- Është detyrë e popullit, gjithashtu, që të ndihmojë udhëheqësit dhe punonjësit e shtetit që të zbatojnë ligjin dhe drejtësinë. Ndihma e tyre ndaj shtetit mund të bëhet me fjalë, me vepra, me mbështetje financiare etj.; pra, me çdo lloj mënyre për të cilën shteti i drejtë, që gjykon me ligjin e Zotit, ka nevojë.

Për sa i përket grupit që ka marë përsipër përgjegjësinë e urdhërimit të njerëzve për të mirë dhe të ndalimit nga të këqijat, ata janë më të zgjedhurit mes besimtarëve. Prandaj Allahu i Lartësuar thotë për ta:

- "Këta janë të shpëtuarit." - Këtyre u është dhënë suksesi që të arrijnë çdo të mirë dhe të shpëtojnë nga çdo e keqe.

Pastaj Allahu i Lartësuar na këshillon që të mos bëhemi si çifutët e të krishterët, të cilët u përçanë dhe u kundërshtuan mes njëri-tjetrit:

- "E mos u bëni si ata që janë përçarë dhe që kundërshtohen mes njëri-tjetrit, pasi u kanë zbritur argumentet." - Është e çuditshme se përçarja e tyre erdhi pasi iu ishte bërë e qartë e vërteta.

Ishin shumë porosi dhe urdhra të Zotit që i ndalonin ata të përçaheshin mes njëri-tjetrit. Kështu, ata duhej të ishin ndër të parët që do t'i përkushtoheshin plotësimit dhe zbatimit të fesë së Zotit. Megjithatë, edhe pse të bindur se po kundërshtonin të vërtetën e sjellë nga Zoti, ata bënë të kundërtën e asaj që Zoti i urdhëroi, duke merituar në këtë mënyrë ndëshkimin e madh, siç thotë i Lartësuari:

- "Ata do të kenë një dënim të madh."

Ajetet 106 – 108

106. Ditën kur do të ketë fytyra që zbardhen dhe fytyra që nxihen, atyre të cilëve u janë nxirë fytyrat u thuhet: "A mohuat edhe pasi kishit besuar njëherë?! Atëherë, vuajeni dënimin, për shkak të mohimit tuaj!"
107. Ndërsa ata të cilëve u janë zbardhur fytyrat, ata janë në mëshirën e Allahut, ku do të jenë përjetësisht.
108. Këto janë argumentet e drejta të Allahut, që po t'i lexojmë ty. Allahu nuk e do kurrë padrejtësinë për njerëzit.

Shpjegimi i ajeteve

- "Ditën kur do të ketë fytyra që zbardhen dhe fytyra që nxihen..." - Në këto ajete, Allahu i Lartësuar na tregon rreth gjendjes së njerëzve në Ditën e Gjykimit. Atë ditë, gjykimi i Zotit, i bazuar në drejtësinë dhe bamirësinë e Tij absolute, do të lërë gjurmët e tij te krijesat. Kjo, sigurisht, është një mënyrë kërcënimi dhe përgëzimi, që nxit frikën dhe shpresën ndaj Zotit të Drejtë dhe Bamirës.

I Lartësuari thotë se atë ditë do të zbardhen disa fytyra. Ato do të jenë fytyrat e atyre që pasojnë Librin e Allahut dhe që qëndrojnë të bashkuar me njëri-tjetrin.

Atë ditë do të ketë edhe fytyra që nxihen, të cilat do të jenë fytyrat e atyre që do të meritojnë ndëshkimin dhe dëshpërimin e përjetshëm. Arsyeja është se ata bëjnë fjalë e vepra të këqija dhe nxisin kundërshtimet dhe përçarjen, prandaj poshtërimi që do të ndiejnë brenda zemrave të tyre do t'ua nxijë fytyrat atë ditë. Ndërsa të lumturve, për shkak të mirësisë dhe lumturisë që u gjenden në zemër, do t'u zbardhen fytyrat e tyre, sepse është lumturia që do të përjetojnë atë ditë, e cila do të lërë gjurmë edhe në fytyrat e tyre, sikurse thotë i Lartësuari në suren Insan, ajeti 11: "...e do t'i stolisë ata me ndriçim *(në fytyrë)* dhe me gëzim *(në zemër)*." Ose në një ajet tjetër: "Atyre që bëjnë vepra të mira u takon e mira, por edhe më tepër. Fytyrat e tyre nuk do t'i mbulojë pluhuri i zi e as nënçmimi. Ata do të jenë banorë të Xhenetit, ku do të jenë përjetësisht. Ndërsa ata që bëjnë të këqija, *(le ta dinë se)* dënimi i së keqes është vetëm aq sa është ajo *(e keqja)*. Ata do t'i mbulojë poshtërimi. Ata nuk do mund t'i mbrojë kush nga Allahu. Fytyrat e tyre do të jenë sikur t'i ketë mbuluar errësira e natës. Ata do të jenë banorë të Zjarrit, ku do të jenë përjetësisht." [Junus 26, 27].


- "...atyre të cilëve u janë nxirë fytyrat..." – Për shkak të padrejtësisë që kanë bërë këta, do t'u thuhen disa fjalë, të cilat shprehin habi dhe qortim të rëndë njëkohësisht:

- "A mohuat edhe pasi kishit besuar njëherë?!" – Kuptimi: Si është e mundur që ju i dhatë përparësi kufrit dhe rrugës së humbjes kundrejt besimit dhe udhëzimit në rrugën e drejtë?! Si është e mundur që e braktisët rrugën e drejtë të lumturisë dhe ndoqët rrugën e humbjes drejt dëshpërimit?! Për shkak të kësaj zgjedhjeje të keqe nga ana juaj, ju meritoni veçse Zjarrin. Ai është vendi i vetëm ku meritoni të hyni:

- "Atëherë, vuajeni dënimin, për shkak të mohimit tuaj!" - Vuajeni poshtërimin, dëshpërimin dhe ndëshkimin, që i fituat vetë me kufrin tuaj!

- "Ndërsa ata të cilëve u janë zbardhur fytyrat, ata janë në mëshirën e Allahut, ku do të jenë përjetësisht." - Nëse ata do të jenë përjetësisht në mëshirën e Allahut, kjo do të thotë se ata do të gëzojnë përjetësisht mirësitë e Xhenetit, sepse Xheneti është një shenjë e mëshirës së Allahut të Lartësuar. Ata do të kënaqen dhe lumturohen përjetësisht me mirësitë e pafundme, pranë më të Mëshirshmit të të mëshirshmëve.

Pas sqarimit të rregullave që lidhen me urdhrat dhe ndalesat e Tij, si edhe të çështjes së shpërblimit me drejtësi, Allahu i Lartësuar thotë:



- "Këto janë argumentet e drejta të Allahut, që po t'i lexojmë ty." - Këto rregulla e ligje janë cilësuar si "argumente të drejta", sepse urdhrat dhe ndalesat e Allahut të Lartësuar përmbajnë urtësinë dhe mëshirën e Tij. Ato janë përcaktuese të shpërblimit dhe të ndëshkimit të Tij. Po kështu, edhe ligjet dhe dispozitat e shpërblimit dhe të ndëshkimit përmbajnë mëshirën dhe urtësinë absolute të të Lartësuarit, prandaj janë larg çdo padrejtësie. Allahu i Lartësuar e përforcon këtë fakt me fjalët vijuese:

- "Allahu nuk e do kurrë padrejtësinë për njerëzit." - Allahu i Lartësuar thotë se nuk e dëshiron padrejtësinë për botën, e jo më ta ushtrojë atë. Askujt nuk do t'i pakësohet gjë prej mirësive që ka bërë, ashtu si asnjë i padrejtë nuk do të ndëshkohet më tepër sesa padrejtësitë e tij. Çdokush do të shpërblehet vetëm për aq sa ka bërë.

Ajeti 109

109. Të Allahut janë çfarë ka në qiej dhe çfarë ka në tokë dhe vetëm tek Allahu kthehen çështjet.

Shpjegimi i ajetit

Allahu është *Malik*, Sunduesi dhe Pronari i gjithçkaje që gjendet në qiell dhe në tokë. Ai i ka krijuar ato dhe Ai i furnizon dhe përkujdeset për to. Ai vepron në mbretërinë e Tij sikurse e kërkon dija dhe urtësia e Tij. Me dije dhe urtësi, Allahu ka përcaktuar dhe ligjëruar gjithçka në këtë ekzistencë. Ai ka vendosur ligjin, që duhet të zbatohet dhe respektohet, dhe për këtë ligj, Allahu do t'i marrë krijesat në llogari Ditën e Gjykimit. Kush kryen vepra të mira sipas ligjit të Tij, ka për të gjetur të mirën, e kush bën të këqija, ka për të gjetur të keqen.

Ajetet 110 – 112

110. Ju jeni populli më i dobishëm, i ardhur për të mirën e njerëzve. Ju urdhëroni për mirë, ndaloni nga e keqja dhe besoni Allahun. Sikur ithtarët e Librit të besonin drejt, do të ishte shumë më mirë për ta. Disa prej tyre janë besimtarë, po shumica e tyre janë larg rrugës së Zotit.
111. Ata nuk mund t'ju sjellin kurrë ndonjë dëm, përveç ndonjë shqetësimi. Por, edhe në ju luftofshin, ata do të sprapsen prej jush. Ata kurrë nuk do të ndihmohen.
112. Për ata është shkruar e caktuar poshtërimi kudo që të gjenden, veç nëse kapen pas "litarit" të Allahut ose nëse hyjnë në besën e njerëzve. Ata kanë shkaktuar kundër vetes zemërimin e Allahut dhe për ta është shkruar shtypja dhe mjerimi. Këtë, për shkak se ata kanë mohuar argumentet e Allahut, kanë vrarë padrejtësisht profetët, se kanë kundërshtuar dhe tejkaluar kufijtë, me armiqësi e dhunë.

Shpjegimi i ajeteve

- "Ju jeni populli më i dobishëm, i ardhur për të mirën e njerëzve. Ju urdhëroni për

mirë, ndaloni nga e keqja dhe besoni Allahun." - Allahu i Lartësuar e lëvdon këtë umet, duke na treguar se është populli më i mirë që Ai ka nxjerrë në jetën e njerëzimit.

Por a ka një shkak që i bën ata të tillë? Po, ata e meritojnë këtë gradë, sepse plotësojnë disa kushte mjaft të rëndësishme. Kështu, ata e përsosin veten e vet duke u pajisur me besim të sinqertë, që i shtyn ata të zbatojnë çdo gjë për të cilën i urdhëron Allahu i Lartësuar dhe Profeti i Tij. Ata punojnë, gjithashtu, që të përmirësojnë edhe të tjerët, duke i urdhëruar për të mira dhe duke i ndaluar nga të këqijat. Ata bëjnë të gjitha përpjekjet për t'i ftuar krijesat në rrugën e mëshirës dhe për t'i larguar ata nga rruga e mosbindjes dhe mashtrimit. Me këtë pikësynim, ata luftojnë në rrugën e Allahut me të gjitha mënyrat që mund të luftohet. Për të gjitha këto cilësi, ata janë populli më i mirë që ka dalë ndonjëherë për të mirën e njerëzimit.

Disa ajete më lart, Allahu i Lartësuar i urdhëronte muslimanët që t'i thërrasin të tjerët për tek e mira dhe të ndalojnë nga të këqijat: "Le të dalë nga ju një grup që fton në të mirën, që urdhëron për vepra të mira dhe ndalon nga e keqja. Këta janë të shpëtuarit." Por i urdhëruari mund ta zbatojë urdhrin ose mund ta shpërfillë dhe braktisë atë! Por në këtë ajet Allahu i Lartësuar na tregon se ky popull e zbaton plotësisht këtë detyrë. Ata e përmbushin urdhrin e Zotit të tyre, prandaj e meritojnë nderimin mbi të gjithë popujt.

- "Sikur ithtarët e Librit të besonin drejt, do të ishte shumë më mirë për ta." - Kjo është një ftesë e bukur dhe me një stil shumë të butë, që ithtarët e Librit të besojnë të vërtetën e sjellë prej Zotit nëpërmjet Muhamedit (s.a.u.s.). Por jo të gjithë e pranuan këtë ftesë nga i Mëshirshmi:

- "Disa prej tyre janë besimtarë, po shumica e tyre janë larg rrugës së Zotit." – Në fakt, të paktë janë ata që e pranojnë ftesën. Shumica e tyre preferojnë të qëndrojnë në zullumin e tyre, jashtë kufijve dhe urdhrave të Zotit. Ata parapëlqejnë mosbindjen ndaj Profetit të mëshirës dhe armiqësinë me të dashurit e Zotit dhe të zgjedhurit e Tij. Ata përpiqen me të gjitha mënyrat për të dëmtuar të dashurit e Zotit të bindurit ndaj Tij.

Por Allahu i Lartësuar është shumë më i dashur dhe i mëshirshëm me të dashurit e Tij, prandaj kurrë nuk do t'i braktisë e t'i lërë viktima të armiqve të tyre. Kurthet e tyre tinzare nuk do t'i dëmtojnë kurrë besimtarët, siç thotë i Lartësuari:

- "Ata nuk mund t'ju sjellin kurrë ndonjë dëm, përveç ndonjë shqetësimi." - Me kurthet e tyre, ata nuk do t'ia arrijnë kurrë që t'i dëmtojnë muslimanët, qoftë fizikisht apo fetarisht. E shumta që mund të arrijnë është thjesht lëndimi me fjalët e tyre. Nëse ata guxojnë që të fillojnë luftën kundër të dashurve të Allahut dhe të përzgjedhurve të tij, do të ndodhë sikurse e ka përshkruar i Madhëruari:

- "Por, edhe në ju luftofshin, ata do të sprapsen prej jush. Ata kurrë nuk do të ndihmohen." – Sa herë që të përpiqen të hapin luftë me besimtarët, do ta kthejnë shpinën të poshtëruar, dhe ky poshtërim do t'i ndjekë gjithmonë nga pas. Ata nuk kanë për t'u ndihmuar asnjëherë, përkundrazi:

- "Për ata është shkruar e caktuar poshtërimi kudo që të gjenden..." – Pra, ata janë të poshtëruar në shpirtin e tyre. Ndërsa fjala "*el meskeneh*" tregon që edhe pamja e jashtme e tyre do të jetë e përvuajtur dhe e poshtëruar.

- "...veç nëse kapen pas "litarit" të Allahut ose nëse hyjnë në besën e njerëzve." - Çifutët nuk do të mund të gjejnë kurrë stabilitet, përveçse në këto dy raste:

Së pari, kur i mbron shteti Islam. Nëse ata paguajnë xhizjen në shtetin Islam, ata kanë

të siguruar jetën, nderin dhe pasurinë e tyre. Ky është kuptimi i thënies së Allahut të Lartësuar: *"il-lâ bi ĥablim-minell-llâhi"* veç nëse kapen pas "litarit" të Allahut.

Mundësia e dytë për ta që të gjejnë stabilitet dhe qetësi është pakti që mund të bëjnë me të krishterët. Edhe në këtë rast ata mund ta arrijnë qëllimin e tyre, por, sikurse thotë Allahu i Lartësuar:

- "Ata kanë shkaktuar kundër vetes zemërimin e Allahut dhe për ta është shkruar shtypja dhe mjerimi." – Pra, ata meritojnë zemërimin e Allahut të Lartësuar, dhe ky është ndëshkimi më i rëndë për ta. Shkakun e këtij ndëshkimi, Allahu i Lartësuar e tregon në vijim:

- "Këtë, për shkak se ata kanë mohuar argumentet e Allahut..." – Pra, ata mohojnë ajetet e Allahut, të cilat Ai ia shpalli Profetit të mëshirës, Muhamedit (a.s.). Ata mohojnë Librin e ndritur, Kur'ânin, që përmban të vërtetën e padiskutueshme dhe që është i vetmi burim dhe kultivues i imanit. Këtë gjë e bëjnë të nxitur nga urrejtja dhe armiqësia, të cilat kanë pushtuar zemrat e tyre.

- "...kanë vrarë padrejtësisht profetët, se kanë kundërshtuar dhe tejkaluar kufijtë, me armiqësi e dhunë." – Me profetët, të cilët i sollën njerëzimit mirësinë më të madhe prej Zotit, ata u sollën në mënyrën më brutale e më kriminale të mundshme, pra, duke i vrarë ata. A ka ndonjë krim më të madh se ky?! Gjithçka qe pasojë e armiqësisë, poshtërsisë dhe mosbindjes së tyre.

Ajetet 113 – 115

113. Ata nuk janë të njëjtë. Disa nga ithtarët e Librit janë në rrugë të drejtë. Ata lexojnë ajetet e Allahut gjatë natës dhe bien në sexhde duke u lutur.
114. Ata besojnë Allahun dhe Ditën e Gjykimit, kështillojnë për të mirë, ndalojnë nga e keqja dhe garojnë për vepra të mira. Ata janë prej të mirëve.
115. Çfarëdo e mire që ata bëjnë, nuk do t'u mohohet. Allahu i di mirë të devotshmit.

Shpjegimi i ajeteve

Pasi na përshkroi shumë qartë gjendjen e shumicës së ithtarëve të Librit, të cilët janë jashtë rrugës së drejtë, dhe pasi na foli për veprat e tyre të këqija dhe ndëshkimet që ata meritojnë, Allahu i Lartësuar vijon të na tregojë edhe për një pjesë shumë të vogël mes tyre, të cilët janë të udhëzuar drejt. Në këto ajete, Allahu i Lartësuar përshkruan veprat që kryen ky grup i shpëtuar dhe shpërblimin që i pret ata. Kështu, Ai thotë:

- "Ata nuk janë të njëjtë." – Kuptimi: Ata të grupit të parë, që ishin të pabindur ndaj Zotit dhe profetëve të Tij dhe që bënin ato vepra aq të këqija, kurrsesi nuk mund të jenë të njëjtë me disa të tjerë, që janë një grup i dytë me disa cilësi të tjera, që Allahu i Lartësuar do t'i përmendë në vazhdim:

- "Disa nga ithtarët e Librit janë në rrugë të drejtë." - Këtë grup prej ithtarëve të Librit, të vetmit të shpëtuar prej tyre, Allahu i Lartësuar i cilëson si: *"ḳâimetun"*, pra, të patundur nga rruga e drejtë e Zotit të tyre. Ata janë të përqendruar në zbatimin e fesë së Zotit. Ata janë të kujdesshëm për zbatimin e urdhrit më të madh për adhurimin e Zotit të tyre, për faljen e namazit.

- "Ata lexojnë ajetet e Allahut gjatë natës dhe bien në sexhde duke u lutur." - I tillë është namazi i tyre i natës. Ata e zgjasin namazin për Allahun e Lartësuar, duke lexuar ajetet e Kur'ânit dhe duke u përulur në ruku dhe në sexhde.

- "Ata besojnë Allahun dhe Ditën e Gjykimit..." - Ata e besojnë Allahun ashtu sikurse besimtarët e vërtetë. Ata i besojnë të gjithë profetët dhe shpalljet që Allahu u zbriti atyre.

Allahu i Lartësuar e ka veçuar besimin e tyre rreth Ditës së Gjykimit, sepse është

pikërisht ky besim që i nxit besimtarët të afrohen tek Zoti i tyre me fjalë e vepra të mira. Ajo është dita e shpërblimit apo e shpagimit me drejtësi për veprat e bëra në këtë jetë. Ajo ditë e nxit besimtarin që të zbatojë çdo urdhër për të cilin do të shpërblehet dhe t'i largohet çdo ndalese, që t'i ruhet kërcënimit të të Drejtit.


- "...këshillojnë për të mirë, ndalojnë nga e keqja..." - Pasi e kanë plotësuar veten me besim të sinqertë ndaj Allahut dhe Profetit të mëshirës, besim ky i cili përmirëson edhe veprat e tyre, ata përpiqen për të ftuar edhe të tjerët në rrugën e drejtë. Ata urdhërojnë për çdo vepër të mirë dhe ndalojnë nga çdo vepër e keqe. Ata nxisin edhe të tjerët prej ithtarëve të Librit që ta besojnë Profetin e mëshirës, Muhamedin (a.s.).

Pastaj Allahu i Lartësuar i cilëson ata si njerëz me vullnet dhe ambicie të larta:

- "...dhe garojnë për vepra të mira." – Pra, ata nxitojnë që të kryejnë çdo vepër të mirë që Allahu dhe Profeti i Tij i urdhëron. Ata nuk e vonojnë aspak çdo punë të mirë që i afron tek Zoti. Ata shfrytëzojnë çdo rrugë, mënyrë dhe kohë për të kryer adhurime ndaj Allahut të Lartësuar. Kjo etje e tyre për të kryer vepra të mira e ka një shkak: ata e dëshirojnë shumë shpërblimin dhe dashurinë e Allahut për ta. Ata janë shumë të vetëdijshëm për mirësitë që sjell adhurimi i Allahut dhe bindja ndaj Tij, e pikërisht ata i quan Allahu i Lartësuar si "*sâlihîn*" - të mirë:

- "Ata janë prej të mirëve." - Dihet shumë mirë se Allahu i Lartësuari do t'i përfshijë *sâlihîn*-ët në mëshirën e Tij dhe do t'i trajtojë ata me butësinë dhe faljen e Tij të gjerë. Ai do t'i nderojë duke u dhuruar nga mirësitë e Tij të mrekullueshme.

Më pas, Allahu i Lartësuar tregon se asnjë vepër e tyre nuk do të shpërfillet, e vogël apo e madhe qoftë ajo, por do të shpërblehet me formën më të mirë:


الجزء الرابع سورة آل عمران

إِنَّ ٱلَّذِينَ كَفَرُوا۟ لَن تُغْنِىَ عَنْهُمْ أَمْوَٰلُهُمْ وَلَآ أَوْلَٰدُهُم مِّنَ
ٱللَّهِ شَيْـًٔا ۖ وَأُو۟لَٰٓئِكَ أَصْحَٰبُ ٱلنَّارِ ۖ هُمْ فِيهَا خَٰلِدُونَ ﴿١١٦﴾
مَثَلُ مَا يُنفِقُونَ فِى هَٰذِهِ ٱلْحَيَوٰةِ ٱلدُّنْيَا كَمَثَلِ رِيحٍ فِيهَا
صِرٌّ أَصَابَتْ حَرْثَ قَوْمٍ ظَلَمُوٓا۟ أَنفُسَهُمْ فَأَهْلَكَتْهُ ۚ وَمَا
ظَلَمَهُمُ ٱللَّهُ وَلَٰكِنْ أَنفُسَهُمْ يَظْلِمُونَ ﴿١١٧﴾ يَٰٓأَيُّهَا ٱلَّذِينَ
ءَامَنُوا۟ لَا تَتَّخِذُوا۟ بِطَانَةً مِّن دُونِكُمْ لَا يَأْلُونَكُمْ خَبَالًا
وَدُّوا۟ مَا عَنِتُّمْ ۖ قَدْ بَدَتِ ٱلْبَغْضَآءُ مِنْ أَفْوَٰهِهِمْ ۖ وَمَا تُخْفِى
صُدُورُهُمْ أَكْبَرُ ۚ قَدْ بَيَّنَّا لَكُمُ ٱلْءَايَٰتِ ۖ إِن كُنتُمْ تَعْقِلُونَ
﴿١١٨﴾ هَٰٓأَنتُمْ أُو۟لَآءِ تُحِبُّونَهُمْ وَلَا يُحِبُّونَكُمْ وَتُؤْمِنُونَ بِٱلْكِتَٰبِ
كُلِّهِۦ ۖ وَإِذَا لَقُوكُمْ قَالُوٓا۟ ءَامَنَّا وَإِذَا خَلَوْا۟ عَضُّوا۟ عَلَيْكُمُ
ٱلْأَنَامِلَ مِنَ ٱلْغَيْظِ ۚ قُلْ مُوتُوا۟ بِغَيْظِكُمْ ۗ إِنَّ ٱللَّهَ عَلِيمٌۢ بِذَاتِ
ٱلصُّدُورِ ﴿١١٩﴾ إِن تَمْسَسْكُمْ حَسَنَةٌ تَسُؤْهُمْ ۖ وَإِن تُصِبْكُمْ
سَيِّئَةٌ يَفْرَحُوا۟ بِهَا ۖ وَإِن تَصْبِرُوا۟ وَتَتَّقُوا۟ لَا يَضُرُّكُمْ كَيْدُهُمْ
شَيْـًٔا ۗ إِنَّ ٱللَّهَ بِمَا يَعْمَلُونَ مُحِيطٌ ﴿١٢٠﴾ وَإِذْ غَدَوْتَ مِنْ أَهْلِكَ
تُبَوِّئُ ٱلْمُؤْمِنِينَ مَقَٰعِدَ لِلْقِتَالِ ۗ وَٱللَّهُ سَمِيعٌ عَلِيمٌ ﴿١٢١﴾
٦٥

- "Çfarëdo e mire që ata bëjnë, nuk do t'u mohohet." – Pra, kurrë nuk do të shpërfillet apo të lihet pa shpërblim, por do t'i jepet shpërblimi më bujar.

Dihet shumë mirë që masa e shpërblimit është në varësi të devotshmërisë dhe qëllimit të robit, prandaj Allahu i Lartësuar u rikujton njerëzve që të nxitojnë të futen në mëshirën e Tij. Kjo është shumë e rëndësishme për pranimin e veprave dhe për shpërblimin e tyre.

- "Allahu i di mirë të devotshmit." – Pra, Ai i di se cilët janë ata që meritojnë emrin "*muttekîn*" – të devotshëm. Ai e di kush i ruhet ndëshkimit dhe zemërimit të Tij, duke zbatuar porositë e Tij dhe të Profetit (a.s.). Vetëm këtyre Allahu do t'u pranojë veprat e mira dhe do t'ua shpërblejë ato, sikurse thotë Ai në suren Maide: "Pa dyshim, Allahu i pranon veprat e mira veçse prej të devotshmëve."

Ajetet 116 – 117

116. S'ka dyshim se atyre që nuk besojnë nuk do t'u bëjnë dobi tek Allahu as pasuria e as fëmijët e tyre. Ata do të jenë banorë të Zjarrit dhe aty do të qëndrojnë përgjithmonë.
117. Ajo gjë që ata e japin në këtë jetë përngjan me erën e akullt, e cila godet të mbjellat e një populli që e ka dëmtuar vetveten me padrejtësitë e tij, dhe i shkatërron ato. Allahu nuk u bën padrejtësi atyre, por janë ata që i bëjnë padrejtësi vetes së vet.

Shpjegimi i ajeteve

- "S'ka dyshim se atyre që nuk besojnë nuk do t'u bëjnë dobi tek Allahu as pasuria e as fëmijët e tyre." - Allahu i Lartësuar na tregon se qafirëve nuk do t'u vlejnë aspak as pasuria dhe as fëmijët e tyre. Fëmijët dhe pasuria nuk mund ta largojnë ndëshkimin e Allahut dhe as afrojnë shpërblimin e Tij, sikurse thotë Allahu i Lartësuar në një ajet tjetër: "As pasuria dhe as fëmijët tuaj nuk janë ata që ju afrojnë tek Ne. I afruar është vetëm ai që beson dhe bën vepra të mira. Të tillët do të shpërblehen shumëfish për veprat që kanë bërë dhe do të jenë të sigurt në dhoma të larta." [Sebe, 37].

Madje, pasuritë dhe fëmijët e qafirëve do të jenë shkak që ata të hyjnë në Zjarr, do të jenë argument kundër tyre dhe për to do të merren në përgjegjësi. Ato janë mirësi të mëdha, me të cilat njeriu testohet: a do të jetë mirënjohës apo jo. Nëse nuk tregohet mirënjohës ndaj Dhuruesit të tyre, ai do të mbajë përgjegjësi Ditën e Gjykimit, siç thotë i Lartësuari: "Pastaj, atë ditë do të pyeteni për të mirat...". [Tekathur 5].

Më tej, i Lartësuari thotë:

- "Ata do të jenë banorë të Zjarrit dhe aty do të qëndrojnë përgjithmonë." – Kjo do të ndodhë për shkak të mohimit të Zotit dhe mosmirënjohjes ndaj Tij.

- "Ajo gjë që ata e japin në këtë jetë përngjan me erën e akullt, e cila godet të mbjellat e një populli që e ka dëmtuar vetveten me padrejtësitë e tij, dhe i shkatërron ato." - Këtu tregohet se si është shembulli i pasurisë që qafirët e shpenzojnë për të penguar njerëzit nga rruga e Zotit dhe nëpërmjet të cilës kërkojnë të shuajnë dritën e Tij. Allahu i Lartësuar na tregon se përpjekjet e tyre do të shkojnë kot, pa ia arritur qëllimit, ashtu sikurse ndodh me dikë që mbjell një arë dhe shpreson shumë të arrijë prodhime të larta, por në momentin që ai pret frytet aq shumë të ëndërruara, vjen një stuhi me erë të fortë dhe të acartë. Kjo "furtunë" u shkakton të padrejtëve veçse lodhje të kotë dhe dëshpërim të madh. E tillë është, pra, edhe gjendja mohuesve të Zotit.

Në një ajet tjetër, Allahu i Lartësuar thotë: "Jobesimtarët e shpenzojnë pasurinë e tyre për të penguar nga rruga e Allahut. Ata do ta shpenzojnë atë, por ajo do të bëhet dëshpërimi i tyre dhe ata do të mposhten. Mohuesit, në Xhehenem do të grumbullohen." [Enfalë 36].

Ose: "Ata duan ta shuajnë dritën e Allahut me gojën e tyre. Por Allahu do veçse ta forcojë dritën e Tij, ndonëse jobesimtarët e urrejnë këtë. Është Ai që e dërgoi Pejgamberin e Tij me udhëzim të drejtë e fe të vërtetë, për ta bërë që të dominojë mbi të gjitha fetë, edhe pse këtë gjë e urrejnë idhujtarët." [Teube 32, 33].

- "Allahu nuk u bën padrejtësi atyre, por janë ata që i bëjnë padrejtësi vetes së vet." - Kur ata mohojnë dhe nuk pranojnë t'u binden librave të Zotit, kur refuzojnë të binden dhe të pasojnë profetët e Tij, kur punojnë dhe përpiqen për të shuar dritën e Allahut, ata dëshmojnë se janë mosmirënjohës dhe dëmtues të vetvetes. Me këtë sjellje, ata i shkatërrojnë dhe asgjësojnë të gjitha veprat e tyre. Pastaj thotë i Lartësuari:

Ajetet 118 – 120

118. O ju besimtarë! Mos i zini për miq të ngushtë të tjerët jashtë mesit tuaj, se ata nuk pushojnë së vepruari në dëmin tuaj. Ata dëshirojnë atë çka ju mundon ju. Urrejtja kundër jush duket nga goja e tyre, por ajo që fshehin në gjokset e tyre është edhe më e madhe. Ne, pa dyshim, jua kemi sqaruar dispozitat, që ju t'i kuptoni.
119. Ja, ju i doni ata, ndërsa ata nuk ju duan ju, dhe ju i besoni librat hyjnorë në tërësi *(kurse ata jo)*. **Kur ju takojnë, thonë: "Ne kemi besuar!" Por kur veçohen, ata kafshojnë majat e gishtërinjve, nga mllefi kundër jush. Thuaju: "Vdekshi prej mllefit tuaj!" Allahu e di shumë mirë se çfarë mbajnë ata në zemrat e tyre.**
120. Nëse ju gëzoni ndonjë të mirë, kjo i dëshpëron ata, e nëse ju godet ndonjë e keqe, ata gëzohen me këtë. Po në qoftë se ju bëheni të durueshëm dhe ruheni, dinakëria e tyre nuk do t'ju dëmtojë aspak. Është e sigurt se Allahu përfshin me dijen dhe pushtetin e Tij gjithçka që ata punojnë.

Shpjegimi i ajeteve

- "O ju besimtarë! Mos i zini për miq të ngushtë të tjerët jashtë mesit tuaj, se ata nuk pushojnë së vepruari në dëmin tuaj. Ata dëshirojnë atë çka ju mundon ju." - Allahu i Lartësuar na ndalon që të bëjmë si miq të ngushtë dhe të afërt të tjerë veç muslimanëve. Nuk u lejohet muslimanëve që të miqësohen dhe afrohen me jomuslimanët, qofshin ata idhujtarë, ithtarë të Librit apo të tjerë, deri në atë gradë sa t'u besojnë atyre sekretet e veta. Nuk lejohet që atyre t'u lihen në dorë vepra të ndryshme që lidhen me çështjen islame. E si mund t'u besosh atyre çështje të tilla të rëndësishme, kur Allahu i Lartësuar thotë se ata nuk dëshirojnë kurrë të mirën dhe përparimin tonë, madje gjithmonë dëshirojnë gjithçka që ne na dëmton?!

Allahu thotë se: "...ata nuk pushojnë së vepruari në dëmin tuaj". Pra, ata janë aq të angazhuar që t'ju dëmtojnë, saqë nuk lejojnë t'u shpëtojë asnjë rast që u jepet për t'ju dëmtuar. Ata janë të papërtuar në çdo punë që ju shkakton dëmtime dhe gjithmonë ndihmojnë armiqtë tuaj kundër jush. E si mund t'u besosh të tillëve sekretet e tua dhe veprat e tjera më të rëndësishme?!

Allahu i Lartësuar i përshkruan ata me një cilësi mjaft të ulët:

- "Urrejtja kundër jush duket nga goja e tyre, por ajo që fshehin në gjokset e tyre është edhe më e madhe." – Kuptimi: Zemrat e tyre janë aq të mbushura me armiqësi dhe urrejtje kundër jush, saqë kjo shfaqet edhe në fjalët që thonë me gojën e tyre. Megjithatë, ajo çfarë ata e mbajnë të fshehur në gjoks është edhe më e madhe sesa ajo që shprehin me fjalë.

- "Ne, pa dyshim, jua kemi sqaruar dispozitat, që ju t'i kuptoni." - Allahu i Lartësuar na i qartëson dispozitat e Tij, të cilat ruajnë të mirat e dynjasë dhe të ahiretit tonë. Dispozitat e Allahut i ruajnë të paprekshme mirësitë e muslimanit, qofshin ato mirësi të kësaj bote qofshin mirësi që lidhen me fenë dhe jetën tjetër. Këto dispozita, Allahu i Lartësuar i ka shpallur që ne t'i kuptojmë, dhe jo që t'i lëmë mënjanë dhe t'i shpërfillim. Ai i ka shpallur dispozitat e Tij që ne, në fillim, t'i kuptojmë e të meditojmë rreth tyre, dhe pastaj të jemi në gjendje të dallojmë të mirën nga e keqja, mikun nga armiku, kujt t'i besojmë e kujt jo, sepse jo çdokujt lejohet t'i besosh për çështjet e tua të rëndësishme. Nëse muslimani është i detyruar që të jetojë mes mohuesve dhe idhujtarëve, nuk lejohet t'u hapet atyre për çështjet e tij të brendshme, edhe nëse ata shfaqen sikur janë miqtë e tij më të ngushtë. Për t'i paralajmëruar besimtarët rreth rrezikut të këtij veprimi, Allahu i Lartësuar tregon disa detaje rreth këtyre armiqve të poshtër dhe tinzarë. Ai thotë:

- "Ja, ju i doni ata, ndërsa ata nuk ju duan ju, dhe ju i besoni librat hyjnorë në tërësi *(kurse ata jo)*." – Kuptimi: Ju, me pastërtinë tuaj, tregoni mëshirë dhe dashuri për ta, ndërsa ata kurrë nuk mund t'ju duan. Ju i besoni të gjithë librat e shpallur nga Zoti, ndërsa ata nuk e besojnë dhe nuk e respektojnë Librin e zbritur nga Zoti juaj, edhe nëse shfaqen se e besojnë atë para jush.

- "Kur ju takojnë, thonë: "Ne kemi besuar!" Por kur veçohen, ata kafshojnë majat e gishtave, nga mllefi kundër jush." – Kuptimi: Ata janë aq të poshtër, saqë para jush shtiren sikur e besojnë Shpalljen tuaj, por kur veçohen me njëri-tjetrin, nga marazi dhe urrejtja e madhe për ju, ata kafshojnë mollëzat e gishtërinjve.

- "Thuaju: "Vdekshi prej mllefit tuaj!" Allahu e di shumë mirë se çfarë mbajnë ata në zemrat e tyre." - Ky ishte një përgëzim për besimtarët: çdokush që do të mundohet t'i dëmtojë ata, do t'ia bëjë të keqen vetes së tij.

Kështu, kuptimi i ajetit është: Me marazin që ata kanë në shpirtin e tyre, kurrë nuk do të jenë në gjendje që t'ju dëmtojnë ju. Mllefi i tyre do të vazhdojë gjithmonë t'i trazojë dhe torturojë zemrat e tyre, derisa t'u vijë vdekja e hidhur, dhe pastaj të kalojnë për të vuajtur të plotë edhe ndëshkimin e përjetshëm të ahiretit.

- "Nëse ju gëzoni ndonjë të mirë, kjo i dëshpëron ata, e nëse ju godet ndonjë e keqe, ata gëzohen me këtë." - Nëse besimtarëve u zbret ndonjë e mirë, siç janë fitoret kundër armiqve apo suksese të tjera në jetë, ata trishtohen. Ndërsa kur ndodh e kundërta, ata gëzohen. Megjithatë, Allahu i Lartësuar na mëson diçka shumë të rëndësishme :

- "Po në qoftë se ju bëheni të durueshëm dhe ruheni, dinakëria e tyre nuk do t'ju dëmtojë aspak. Është e sigurt se Allahu përfshin me dijen dhe pushtetin e Tij gjithçka që ata punojnë." – Pra, nëse ne do të bëjmë përpjekjet tona, për të cilat Allahu ka premtuar fitoren dhe suksesin, ne do të jemi të sigurt prej kurtheve të tyre.

Por cilat janë ato shkaqe për të cilat Zoti ka premtuar fitoren dhe suksesin?! Ato janë durimi dhe devotshmëria. Pra, nëse jemi të durueshëm dhe nëse kemi devotshmëri, kurthet e tyre nuk do të na dëmtojnë aspak, përkundrazi, ato do të godasin vetë thurësit e tyre.

Ajetet 121 – 122

121. Përkujto kur dole nga familja jote, që t'u përcaktoje besimtarëve pozicionet e luftës! Allahu është Dëgjues dhe i Ditur.
122. Dy grupe prej jush gati u sprapsën, por ishte Allahu Kujdestari i tyre, prandaj vetëm Allahut le t'i mbështeten besimtarët.

Shpjegimi i ajeteve

Këto ajete flasin rreth betejës së Uhudit. Kjo histori është shumë e njohur dhe e trajtuar në librat e historisë dhe kronikave. Urtësia e përmendjes së saj në këtë vend, bashkë me ngjarjen e betejës së Bedrit, ndoshta mund të jetë vërtetimi i premtimit të Allahut të Lartësuar që, nëse besimtarët bëjnë durim dhe ruhen prej të këqijave, gjithmonë do të dalin të fituar dhe do të shpëtojnë nga kurthet dhe intrigat e armiqve të tyre. Ky është një rregull i padiskutueshëm, nëse plotësohen kushtet për realizimin e tij.

Kështu, në betejën e Bedrit, kur besimtarët treguan durim, qëndrueshmëri dhe devotshmëri të plotë, Allahu i Lartësuar u dhuroi fitoren e madhe, edhe pse ishin të pakët në numër dhe përgatitje. Ndërsa në luftën e Uhudit, kur ata cenuan devotshmërinë, duke bërë lëshime në disa urdhra të Profetit (s.a.u.s.), ata provuan disfatën, trishtimin dhe dhimbjen.

Allahu i Lartësuar i ka përmendur pranë njëra tjetrës këto dy ngjarje të mëdha edhe për një urtësi tjetër. Allahu i Lartësuar dëshiron prej adhuruesve të Tij që, kur t'i

godasë ndonjë e keqe, ata të rikujtojnë të mirat e shumta që Ai u dhuron vazhdimisht. Kjo sigurisht që do t'ua lehtësojë atyre dhimbjen. Nëse ata kujtojnë të mirat e pakufishme që Allahu i Lartësuar u dhuron të dashurve të Tij, atëherë sprovat që kalojnë, që, në të vërtetë, përsëri sjellin mirësi për ta, do t'u duken shumë të vogla. Kjo jo vetëm që do t'ua lehtësojë dhimbjet dhe trishtimin për të keqen që i ka prekur, por do të nxisë tek ta ndjenjën e fortë të mirënjohjes dhe falënderimit për Allahun e Urtë dhe Bujar.

Kjo është urtësia e Allahut të Lartësuar kur thotë: "Në qoftë se ju përjetuat dhimbje *(në Uhud)*, edhe populli tjetër *(armik)* provoi dhimbje si kjo e juaja *(në Bedër)*. Ne i këmbejmë këto ditë mes njerëzve, për t'u dalluar qartë tek Allahu ata që besojnë dhe për t'i zgjedhur disa prej jush si dëshmorë. Allahu nuk i do të padrejtët. Kështu Allahu i pastron besimtarët dhe, gradualisht, i shkatërron jobesimtarët. A mos menduat ju se do të hyni në Xhenet pa u dalluar tek Allahu ata që luftojnë prej jush dhe pa u dalluar të durueshmit?!" [Al Imran 140, 141, 142].

Ose në ajetet e tjera: "Kur ju kaluat një disfatë *(në Uhud)*, të cilën ju ia patët shkaktuar dyfish armikut tuaj *(në Bedër)*, thatë: "Si ndodhi kjo *(humbje)*?" Thuaj: "Ajo ndodhi nga vetë ju!" S'ka dyshim se Allahu është i Plotfuqishëm për gjithçka. Ajo që ju goditi ju ditën e ballafaqimit të dy grupeve ndodhi me lejen e Allahut, për t'u dalluar besimtarët e sinqertë." [Al Imran 165, 166].

Lufta e Uhudit erdhi si dëshirë e idhujtarëve për hakmarrje. Pasi u kthyen nga beteja e Bedrit të dërrmuar e të shpartalluar, ata nisën që të përgatiteshin fort për të marrë hak për të vrarët në Bedër, ngjarje kjo që kishte ndodhur në vitin e dytë të hixhretit. Kështu, ata mblodhën të gjitha forcat për të arritur atë që donin: shërimin e plagës dhe dhimbjes për të humburit në Bedër. Me një ushtri prej 3000 luftëtarësh, ata u nisën prej Mekës dhe u vendosën pranë Medinës.

Profeti (a.s.), nga ana e tij, pas këshillimit me sahabët, doli nga Medina me 1000 luftëtarë për t'u ballafaquar me armikun. Por, gjatë rrugës për në sheshbetejë, në Uhud, një e treta e ushtrisë, e cila përbëhej nga munafikë, me në krye Ibn Ubej Ibn Selulin, u kthye mbrapsht në Medinë. Madje, kthimin e tentuan edhe dy grupe besimtarësh të sinqertë: fisi Benu Seleme dhe fisi Benu Harithe. Por Allahu i Lartësuar i forcoi dhe përqëndroi zemrat e tyre dhe, përfundimisht, ata nuk iu larguan luftës.


Pasi mbërritën në Uhud, Profeti (a.s.) i rreshtoi besimtarët në formacione lufte. Ata u vendosën në një pozicion të tillë që malin e Uhudit ta kishin pas shpine dhe armikun para tyre. Për të ruajtur shpinën e ushtrisë, Profeti (a.s.) vendosi mbi Uhud një skuadër prej 50 harkëtarësh dhe i urdhëroi që të mos e linin pozicionin e tyre në asnjë rast.

Në fillim të betejës, u duk se muslimanët po arrinin një fitore të habitshme dhe të rrufeshme kundër idhujtarëve. Ata depërtuan deri në prapavijën e armikut dhe vazhduan të korrnin me shpatat e tyre idhujtarët dhe të robëronin shumë prej tyre.

Në këto çaste, kur harkëtarët mbi Uhud po shihin fitoren e rrufeshme të muslimanëve, i thanë njëri-tjetrit: "Filloi plaçka e luftës, vëllezër! Përse të qëndrojmë këtu, kur idhujtarët u mundën tashmë?!" Komandanti i kësaj skuadre, Abdullah Ibn Xhubejri u kujtoi urdhrin e Profetit (a.s.) që të mos lëviznin prej vendit, por ata nuk e dëgjuan fjalën e tij.

Kështu, pasi shumica e tyre u largua dhe kur në pozicion mbeti veçse një grup i vogël, filloi disfata. Kalorësit idhujtarë u lëshuan mbi muslimanët pa mëshirë. Muslimanët, të çoroditur, filluan të shpërndaheshin dhe të largoheshin.

Në përfundim, muslimanët pësuan një humbje shumë të rëndë, me të cilën Allahu i Lartësuar ua fali gabimin e mosbindjes dhe i bëri që të nxirrnin mësime. Ai i bëri kështu



të provonin shijen e hidhur të mosbindjes ndaj Tij dhe ndaj Profetit (a.s.).

Pastaj besimtarët u tërhoqën diku në majë të malit të Uhudit. Allahu i Lartësuar i pengoi idhujtarët që të vazhdonin luftën më tej dhe, më pas, të dyja palët u kthyen në vendet e tyre përkatëse. Kështu, Profeti (a.s.) dhe shokët e tij u kthyen në Medinë.

Thotë i Madhëruari në ajet:

- "Përkujto kur dole nga familja jote, që t'u përcaktoje besimtarëve pozicionet e luftës!" - Profeti (a.s.) u nis për në Uhud, pasi fali njëherë namazin e xhumasë, dhe u përcaktoi atje ushtarëve pozicionet e tyre të luftës.

Angazhimi personal i vetë Profetit (a.s.) në marrjen e masave për luftë tregon për dijen dhe aftësitë e tij në organizimin e të gjitha çështjeve. Ai tregon, gjithashtu, guximin e tij të madh – paqja e Zotit qoftë mbi të!

- "Allahu është Dëgjues dhe i Ditur." - Allahu dëgjon gjithçka. Ai dëgjon fjalët e besimtarëve, edhe fjalët e munafikëve. Të gjithë ata flasin dhe tregojnë atë që mbajnë në zemrat e tyre. Por Allahu i di edhe qëllimet e njerëzve, të cilët Ai do t'i shpërblejë me drejtësi. Allahu i Lartësuar është Dëgjues, i Ditur dhe përkujdeset për çështjet e besimtarëve. Është Ai që i ndihmon ata për të patur sukses. Në ajete të tjera, në suret Ta Ha, Murselat etj., Allahu i Lartësuar thotë: "Unë jam me ju të dy, dëgjoj dhe shikoj.".

Allahu i Lartësuar është i Dashur, i Mëshirshëm dhe i Butë me besimtarët. Kjo del shumë qartë kur Ai thotë:

- "Dy grupe prej jush gati u sprapsën..." - Kur dy grupet e besimtarëve, përkatësisht nga fiset Benu Seleme dhe Benu Harithe, gati sa nuk dezertuan, Allahu i Lartësuar i forcoi ata dhe iu dha durim. Kjo ishte një mirësi e madhe e dhuruar prej Tij. Ajo ishte një mirësi për ato dy fise dhe për të gjithë besimtarët e tjerë, gjë kjo që tregonte përkujdesjen e Tij të posaçme për ta. Prandaj Allahu e thekson këtë fakt shumë të rëndësishëm kur thotë:

- "...por ishte Allahu Kujdestari i tyre..." – Pra, është Allahu Ai që, me butësinë dhe mëshirën e Tij, tregon përkujdesje të veçantë ndaj tyre, duke u dhënë sukses për arritjen e çdo të mire dhe për ruajtjen nga çdo e keqe.

Edhe në këtë rast u shfaq qartë përkujdesja e Tij ndaj besimtarëve. Kur ata donin të linin fushëbetejën dhe të braktisnin Profetin (a.s.), Allahu i Lartësuar i ruajti ata nga kjo poshtërsi e madhe, sepse në zemrat e tyre kishte iman të fortë dhe Allahu përkujdeset për ata që besojnë, siç thotë në një ajet tjetër: "Allahu është i dashuri i atyre që besojnë dhe i nxjerr ata prej errësirave në dritë. Ndërsa kujdestarë të atyre që nuk besojnë janë shejtanët, të cilët i nxjerrin ata prej drite për t'i futur në errësira. Këta janë

banorë të Zjarrit, ku do të qëndrojnë përjetësisht." [Bekare, 257].

Pastaj Allahu i Lartësuar vijon të jap një urdhër shumë të rëndësishëm.

- "...prandaj vetëm Allahut le t'i mbështeten besimtarët." - Në këtë ajet, Allahu i Lartësuar na urdhëron për një vepër të zemrës, që quhet '*teuekkul*', mbështetje. *Teuekkul* do të thotë: mbështetja e zemrës tek Allahu i Lartësuar për të arritur të mirën dhe për t'i shpëtuar të këqijave dhe çdo gjëje të dëmshme, duke pasur besim të plotë dhe të palëkundur në ndihmën dhe suksesin e dhënë prej Allahut. Mbështetja e adhuruesve tek Allahu i Lartësuar është në varësi të besimit të tyre tek Ai.

Besimtarët janë njerëzit më të denjë që t'i mbështeten Allahut të Lartësuar. Kjo del më e qartë në momentet e vështirësisë ose gjatë luftës, kur ata e ndiejnë më tepër nevojën që t'i mbështeten Zotit të tyre për çlirimin nga e keqja dhe për arritjen e fitores. Besimtarët i mbështeten vetëm Atij, dhe jo tek forca e tyre, që Ai t'u dhurojë fitoren. Ata vërtet japin maksimumin e tyre, por mbështetja dhe shpresa e zemrave të tyre lidhet vetëm me Allahun e Lartësuar, me forcën, pushtetin dhe suksesin e dhuruar prej Tij. Me këtë mbështetje të sinqertë, ata e meritojnë përkujdesjen e Allahut dhe suksesin e dhuruar prej Tij. Kështu largohen fatkeqësitë dhe kështu vjen çlirimi dhe mirësia.

Ajetet 123 – 126

123. Allahu ju ndihmoi në Bedër, kur ju ishit të pakët në numër. Frikësojuni Zotit, për të qenë mirënjohës ndaj Tij.
124. Ti u thoshe besimtarëve: "A nuk ju mjafton që Zoti juaj t'ju vazhdojë ndihmën e Tij me tre mijë engjëj të zbritur?"
125. Por nëse jeni të qëndrueshëm e të devotshëm dhe sikur ata t'ju sulmojnë në këtë moment, Zoti juaj do t'jua vazhdojë juve ndihmën me pesë mijë engjëj të tjerë të dalluar."
126. Allahu e solli atë *(ndihmë)* veçse si përgëzim për ju dhe që zemrat tuaja të qetësoheshin. Ndihma vjen veçse prej Allahut, Ngadhënjyesit, të Urtit.

Shpjegimi i ajeteve

- "Allahu ju ndihmoi në Bedër, kur ju ishit të pakët në numër." - Kjo ishte një shprehje e bamirësisë së Allahut ndaj adhuruesve të Tij, por ajo ishte edhe një kujtesë shumë e rëndësishme për besimtarët, që ata të analizonin shkaqet e fitores dhe të humbjes. Allahu u rikujton atyre që Ai është i Plotpushtetshëm t'i ndihmojë dhe t'u dhurojë fitoren, edhe nëse janë të pakët në numër dhe të dobët në mjete ushtarake, sikurse veproi në luftën e Bedrit, ku Ai u dha fitoren, edhe pse armiku ishte i madh në numër dhe i përgatitur mirë ushtarakisht.

Beteja e Bedrit ndodhi në vitin e dytë të hixhretit. Profeti (a.s.) doli nga Medina në krye të 320 e ca luftëtarëve. Me vete kishin vetëm 70 deve dhe dy kuaj. Në fakt, ata nuk dolën për luftë, por në kërkim të një karvani të kurejshve që do të kalonte në ato vise gjatë kthimit nga tregtia e Shamit. Kur idhujtarët e Mekës dëgjuan për synimin e Profetit (a.s.) drejt karvanit, ata u përgatitën mirë ushtarakisht dhe u nisën për të mbrojtur karvanin e tyre. Ishin më tepër se 1000 luftëtarë të armatosur plotësisht dhe një numër i madh kuajsh. Palët u takuan në një burim të quajtur Bedër, mes Mekës dhe Medinës. Aty u zhvillua dhe beteja e ashpër dhe e madhe, që mbahet mend në historinë e Islamit. Fitorja e dhuruar nga Allahu i Lartësuar ishte e jashtëzakonshme. Atje u vranë shtatëdhjetë vetë nga krerët dhe më trimat e idhujtarëve. Shtatëdhjetë të tjerë u kapën rob, ndërkohë që i gjithë kampi i tyre u rrethua nga muslimanët. Megjithatë, kjo ngjarje do të shtjellohet më tej në suren Enfal.

Allahu i Lartësuar e sjell këtë ilustrim të suksesit të dhuruar prej Tij që ne të meditojmë rreth shkaqeve të fitores dhe ndihmës së Tij. Ai e ka bërë këtë, gjithashtu,

që ne të ruhemi dhe të jemi mirënjohës për mirësitë e Tij, siç thotë më pas:

- "Frikësojuni Zotit, për të qenë mirënjohës ndaj Tij." – Ata që mvishen me devotshmëri janë treguar falënderues dhe mirënjohës ndaj Zotit të tyre, ndërsa ata që i shpërfillin urdhrat dhe ndalesat e Tij nuk janë treguar falënderues dhe nuk mund të quhen mirënjohës ndaj Zotit të tyre.

- "Ti u thoshe besimtarëve..." – Këtu, Allahu i Lartësuar i drejtohet Muhamedit (a.s.) që t'u kujtojë besimtarëve momentin kur ai u jepte lajmin e mirë për ndihmën dhe fitoren e premtuar nga Allahu në luftën e Bedrit. Ja fjalët përgëzuese:

- "A nuk ju mjafton që Zoti juaj t'ju vazhdojë ndihmën e Tij me tre mijë engjëj të zbritur?"

- "Por nëse jeni të qëndrueshëm e të devotshëm..." – Kuptimi: Nëse ju realizoni shkaqet e ndihmës dhe të fitores prej Allahut, pra, nëse tregoni durim dhe devotshmëri, ju do të ndihmoheni me një tjetër kontigjent nga Zoti i gjithësisë:

- "...dhe sikur ata t'ju sulmojnë në këtë moment, Zoti juaj do t'jua vazhdojë juve ndihmën me pesë mijë engjëj të tjerë të dalluar." – Pesë mijë engjëjt e zbritur në atë betejë madhështore janë cilësuar si '*museuuimîn*', domethënë të dalluar për guxim e trimëri.

Kështu, Allahu i Lartësuar e kushtëzoi zbritjen e ndihmës së Tij dhe të fitores së muslimanëve me tri faktorë: 1. durimi; 2. devotshmëria ndaj Allahut dhe Profetit të Tij, duke kryer çdo urdhër dhe duke u larguar nga ndalesat, në shenjë madhërimi dhe dashurie për Allahun; 3. ardhja e shpejtë e idhujtarëve për luftë kundër muslimanëve.

Ndërsa për të dhuruar fitoren dhe për të shkatërruar kurthet e idhujtarëve dhe qafirëve, Allahu i Lartësuar na ka porositur që të plotësojmë dy kushte të rëndësishme, që u përmendën edhe më sipër: "Po në qoftë se ju bëheni të durueshëm dhe ruheni, dinakëria e tyre nuk do t'ju dëmtojë aspak." Pra, nëse tregohet durim dhe devotshmëri, kurthet e qafirëve dhe armiqve të Islamit nuk do t'i dëmtojnë aspak besimtarët.

- "Allahu e solli atë *(ndihmë)* veçse si përgëzim për ju dhe që zemrat tuaja të qetësoheshin." - Allahu i Madhëruar tregon se ndihmën madhështore me anë të engjëjve Ai e dha për të sjellë gëzim dhe qetësi në zemrat e besimtarëve.

Kjo ngjarje ishte, gjithashtu, një mësim i pashlyeshëm nga kujtesa për besimtarët, të cilëve, në këtë mënyrë, iu tha: Qetësia juaj mund të vijë si rezultat i masave të ndërmarra prej jush. Megjithatë, për të arritur fitoren mbi armikun, nuk duhet të mbështeteni në forcën tuaj apo në masat që keni marë. Ato thjesht mund të sjellin një lloj qetësie, por fitorja e vërtetë mund të vijë veçse nëse e lejon Allahu i Lartësuar, i Cili thotë më tej:

- "Ndihma vjen veçse prej Allahut, Ngadhënjyesit, të Urtit." – Pra, ndihmën dhe fitoren e vërtetë mund ta japë veçse Allahu i Lartësuar për kë dëshiron Ai prej robërve të Tij. Nëse dëshiron Ai, ua jep fitoren atyre që janë përgatitur mirë për arritjen e fitores, sikurse ndodh zakonisht te njerëzit. Por nëse Ai dëshiron, mund t'ua dhurojë fitoren edhe atyre adhuruesve të Tij që janë të dobët e të pafuqishëm, për t'u qartësuar atyre se fitorja dhe ndihma është vetëm në dorën e Tij, për t'u treguar se Atij i takon pushteti dhe mbretërimi mbi gjithçka.

Prandaj Allahu i Lartësuar përmend dy cilësi të Tij në këtë kontekst:

1. *Aziz* – Ngadhënyes, i Pamposhtur, domethënë asnjë krijesë nuk mund të dalë mbi Të, por të gjithë i janë nënshtruar madhështisë së Tij, sepse të gjithë janë nevojtarë për përkujdesjen e Ngadhënyesit, Sunduesit dhe të Madhërishmit.

2. *El Hakim* - i Urtë, domethënë Ai që i vendos gjërat në vendin e tyre të duhur. Edhe në ato raste kur qafirët fitojnë mbi muslimanët, është pikërisht urtësia e Tij e madhe që e lejon një gjendje të tillë të përkohshme. Thotë i Lartësuari: "Pra, kur të ndesheni me jobesimtarët, goditini ata në qafë *(vritini)*, derisa t'i dërrmoni. Më pas lidhini, e pastaj: ose lirojini falas, ose kërkoni shpagim, përderisa gjendja e luftës nuk ka përfunduar. Kështu, sikur të dojë Allahu, Ai mund hakmerret ndaj tyre, por Ai dëshiron t'ju sprovojë ju njërin me tjetrin. Ndërsa atyre që ranë dëshmorë në rrugën e Allahut, atyre kurrsesi nuk ua humb veprat". [Muhamed 4].

Ajeti 127

127. "Kjo, që ta rrënojë një grup të atyre që nuk besojnë, ose për t'i turpëruar ata, që të kthehen pas të dëshpëruar."

Shpjegimi i ajetit

Allahu i Lartësuar na tregon se ndihma e Tij për besimtarët vjen me dy objektiva:
1. Për të rrënuar bazat ose shtyllat më të forta të qafirëve, duke i vrarë, robëruar apo duke nënshtruar dhe marrë pasuritë e tyre. Në këtë mënyrë, forcohen muslimanët dhe dobësohen qafirët. Dihet, gjithashtu, që lufta e tyre kundër Islamit mbështetet te numri i forcave ushtarake, armatimi, pasuria dhe fuqia ekonomike dhe epërsia territoriale. Kësisoj, duke shkatërruar një pjesë të këtyre faktorëve që u përmendën, është shuar një pjesë e fuqisë së tyre kundër Islamit dhe muslimanëve.
2. Objektivi i dytë është turpërimi i qafirëve dhe i synimeve të tyre kundër muslimanëve, duke i kthyer ata të poshtëruar, me gjithë forcën dhe potencialin e tyre të madh. Ata shpenzojnë të gjitha energjitë e tyre për të goditur muslimanët, por Allahu i Lartësuar ua jep fitoren muslimanëve, për t'i kthyer qafirët të dëshpëruar dhe të dështuar në përpjekjet dhe pikësynimet e tyre.

Nëse sheh realitetin, do të vëresh se ndihma e Allahut për besimtarët synon dy objektivat e lartpërmendura, pra: ose fitoren mbi ta, ose sprapsjen e tyre me poshtërim.

Ajetet 128 – 129

128. Ti nuk ke asgjë në dorë, në do t'ua pranojë Ai pendimin, apo do t'i dënojë ata. Në të vërtetë, ata janë zullumqarë.
129. Vetëm e Allahut është gjithçka, ç'ndodhet në qiej e në tokë. Ai fal atë që do dhe e dënon atë që do. Allahu është Falës e Mëshirues.

Shpjegimi i ajeteve

Kur gjatë luftës së Uhudit ndodhi ajo që ndodhi dhe Allahu i Lartësuar deshi ta lartësonte gradën e Profetit të Tij, Muhamedi (a.s.) u sprovua tek njerëzit e dashur, madje u plagos rëndë në kokë dhe iu thyen disa dhëmbë. Në këtë gjendje, i gjakosur, ai filloi të mallkonte krerët e idhujtarëve si Ebu Sufjanin, Ibn Haibin, Safuan Ibn Umejen, Suhejl Ibn Amrin, Harith Ibn Hishamin e të tjerë. Ai thoshte nën zë: "E si mund të shpëtojë një popull që plagos Profetin e tij?!" Por Allahu i Lartësuar zbriti këto ajete, që e ndaluan Profetin t'i mallkonte ata:

- "Ti nuk ke asgjë në dorë, në do t'ua pranojë Ai pendimin, apo do t'i dënojë ata. Në të vërtetë, ata janë zullumqarë." – Kuptimi: E vetmja detyrë e jotja është përcjellja e qartë e mesazhit të Zotit. Detyra jote është vetëm edukimi dhe mësimi i krijesave. Ti duhet të kujdesesh që t'i udhëzosh krijesat të arrijnë çdo të mirë dhe të largohen nga të këqijat. Pas këtyre, çështja i takon vetëm Allahut të Lartësuar. Është Ai që administron çështjet e krijesave të Tij. Është Ai që udhëzon në rrugën e drejtë e që jep suksesin për ta ndjekur atë dhe punuar sipas saj. Është Allahu që i lë në humbje ata që nuk meritojnë suksesin e dhënë prej Tij dhe mëshirën e Tij. Prandaj ti nuk duhet të lutesh kundër tyre dhe t'i mallkosh, sepse çështja e tyre është vetëm në dorën e Zotit të

tyre. Nëse urtësia dhe mëshira e Zotit të tyre e ka përcaktuar që t'ua hapë zemrën për të pranuar Islamin, ata do të udhëzohen. Por nëse urtësia e Tij përcakton lënien e tyre në humbje dhe mohim, janë pikërisht ata, me padrejtësinë e tyre, shkaku i këtij përfundimi të hidhur dhe të frikshëm. Dhe, vërtet, disa prej tyre Allahu i Lartësuar i udhëzoi në Islam.

Ky ajet tregon se përzgjedhja e Allahut dhe përcaktimi i Tij qëndrojnë mbi përzgjedhjen e robit dhe janë më të mira për të. Njeriu, sado gradë të lartë të ketë arritur, mund të zgjedhë dhe të gjykojë për diçka, por ndodh që diçka tjetër të jetë edhe më e dobishme dhe më e mirë se ajo që ai ka menduar. Nga ajeti kuptojmë se Profeti (a.s.) nuk ka patur asgjë në dorë për të falur apo udhëzuar ndonjë, apo për t'i sjellë ndokujt dëm apo dobi. Çdo gjë është në dorën e Zotit.

Lind pyetja: Nëse për Profetin (a.s.) është ky gjykim, po për të tjerët çfarë mund të thuhet?! Sigurisht që të tjerët janë shumë herë më larg mundësisë për të sjellë dëm apo dobi. Ky ajet është një argument shumë i qartë dhe i fortë që hedh poshtë besimin e atyre që janë lidhur pas profetëve dhe njerëzve të mirë, me mendimin e gabuar se ata mund t'u sjellin dobi dhe t'i ruajnë nga të këqijat. Madje, kjo vepër e tyre konsiderohet si *shirk* në adhurim, si mangësi e të menduarit. Ata braktisin adhurimin e Allahut, në dorën e të Cilit është i gjithë pushteti, dhe i përkushtohen atyre që nuk kanë asnjë grimcë pushteti e mundësie për t'iu përgjigjur lutjeve dhe nevojave të lutësve. Kjo, pa dyshim, është një humbje dhe devijim shumë i qartë dhe i largët nga e vërteta.

Këtu nuk mund të lëmë pa përmendur edhe një detaj mjaft interesant. Kur Allahu i Lartësuar thotë se Ai mund t'u japë sukses për t'u penduar dhe t'ua pranojë pendimin, ia atribuon këtë dhunti Vetes së Tij. Pra, Allahu nuk përmend ndonjë shkak që mund ta bëjë robin t'i pranohet pendimi nga Ai. Kjo tregon se mirësitë dhe suksesi për të bërë vepra të mira dhe për t'u larguar nga të këqijat është thjesht dhuratë nga Bamirësi dhe i Mëshirshmi, pa qenë e nevojshme që vetë robi të bëjë ndonjë gjë për ta "merituar" atë dhuratë. Ndërsa kur Allahu i Lartësuar thotë se është në dorën e Tij që t'i ndëshkojë ata, menjëherë më pas thotë se shkak i ndëshkimit është zullumi i tyre. Kjo tregon se Allahu i Lartësuar është Absolut në drejtësinë dhe në urtësinë e Tij. Urtësia dhe drejtësia e Tij ia japin ndëshkimin atij që e meriton. Ai kurrë nuk i bën padrejtësi robit të Tij, por është vetë robi që i bën padrejtësi vetes. Më pas, Allahu i Lartësuar vijon që të ritheksojë pushtetin dhe mbretërimin e Tij mbi gjithçka:

- **"Vetëm e Allahut është gjithçka, ç'ndodhet në qiej e në tokë."** – Pra, gjithçka në qiell dhe në tokë, engjëj, njerëz, xhindë, kafshë, sende, trupa qiellorë etj., janë pronë e Allahut të Lartësuar. Ata janë të krijuar, të nënshtruar, të përulur dhe nevojtarë për përkujdesjen e Zotit të tyre. Të gjitha çështjet e tyre janë në dorë të Zotit të tyre, ndërsa ata nuk kanë asnjë thërrmijë pushteti dhe pronësie në ndonjë pjesë të kësaj gjithësie.

Duke qenë se çështja qëndron kështu, atëherë të gjithë krijesat janë të barabarta para mëshirës apo ndëshkimit të Tij:

- "Ai fal atë që do..." - Është Allahu që mëshiron atë që Ai do dhe ndëshkon atë që Ai do. Allahu fal atë që Ai do dhe i jep sukses që të udhëzohet dhe të pranojë fenë Islame. Duke e udhëzuar në këtë fe madhështore, Ai ia mbulon idhujtarinë e kryer para Islamit. Pastaj, me mëshirën e Tij, Allahu e udhëzon robin te veprat e mira dhe ia fal e mbulon gjynahet që bën.

- "...dhe e dënon atë që do." - Allahu ndëshkon atë që Ai dëshiron, duke e lënë të mbështetet në forcat e veta, në injorancë të thellë dhe në padrejtësinë e tij të skajshme. Nëse robi lihet në këtë gjendje të mjerë,

sigurisht që do të kryejë vepra të poshtra dhe larg mëshirës së Zotit të tij. Por Allahu i Lartësuar e ka përcaktuar këtë normë në bazë të urtësisë, dijes dhe drejtësisë së Tij, dhe po me urtësinë dhe drejtësinë e Tij, Ai i ndëshkon ata për veprat e tyre të këqija. Pastaj, Allahu i Lartësuar e mbyll ajetin duke përmendur dy emra të Tij të mrekullueshëm dhe shpresëdhënës:

- "Allahu është Falës e Mëshirues." - Ky është përgëzimi më i madh, që tregon se mëshira e Allahut është më e madhe se zemërimi i Tij. Falja e Tij është më e gjerë sesa kërkesa e llogarisë për çdo vepër të kryer.

Duke iu referuar krijesave në përgjithësi, Allahu i Lartësuar na tregon se ka prej tyre të cilët Ai do t'i ndëshkojë. Por, megjithatë, Ai nuk e mbyll ajetin duke përmendur një emër të Tij që tregon mëshirë dhe falje dhe një emër tjetër të Tij që tregon ndëshkim të merituesheëm. Përkundrazi, Allahu e mbyll ajetin me dy emra të Tij që tregojnë vetëm falje dhe mëshirë të madhe. E pra, mirësia dhe mëshira e Allahut të Lartësuar janë shumë të mëdha. Ai i mëshiron krijesat e Tij aq shumë, saqë askush nuk mund ta përshkruajë dhe shpjegojë.

Në fund, e lusim Allahun e Lartësuar që të na përfshijë edhe ne në mëshirën e Tij të pakufishme dhe të na fusë mes adhuruesve të Tij vepërmirë!

Ajetet 130 – 136

130. O ju që keni besuar! Mos e hani kamatën disa herë të shumëfishuar. Kini frikë Allahun, që të gjeni shpëtim dhe të fitoni!
131. Ruajuni Zjarrit, që është përgatitur për jobesimtarët!
132. Bindjuni Allahut dhe të Dërguarit, që të mëshiroheni!
133. Nxitoni për faljen e gjynaheve nga Zoti juaj dhe për një Xhenet, gjerësia e të cilit është sa gjerësia e qiejve dhe e tokës! Ai është përgatitur për të devotshmit,
134. të cilët japin kur janë në bollëk dhe kur janë në vështirësi. Ata e frenojnë inatin dhe janë falës ndaj njerëzve. Allahu i do bamirësit,
135. edhe ata të cilët, kur bëjnë ndonjë gjë të shëmtuar, ose kur i bëjnë padrejtësi vetvetes, e përmendin Allahun dhe kërkojnë falje për gjynahet e tyre. E kush i fal tjetër gjynahet, përveç Allahut?! Ata nuk vazhdojnë më me atë gjë që kanë bërë më parë, sepse e dinë.
136. Shpërblimi i të tillëve është falja nga Zoti i tyre dhe Xhenetet, nëpër të cilët rrjedhin lumenj dhe ku ata do të jenë përjetësisht. Sa i mirë është shpërblimi i atyre që punojnë!

Shpjegimi i ajeteve

Është përmendur shumë herë në këtë tefsir se adhuruesi duhet patjetër që t'i kushtojë rëndësi të madhe urdhrave dhe ndalesave të Allahut të Lartësuar, që kanë lidhje me Allahun vetë, por edhe me krijesat. Nëse Allahu i Lartësuar jep një urdhër të caktuar, adhuruesi ka detyrë parësore që ta njohë hollësisht dhe ta kuptojë mirë atë për të cilën urdhërohet. Pasi ta njohë dhe kuptojë mirë urdhrin, besimtari përpiqet maksimalisht dhe kërkon ndihmën e Allahut që ta plotësojë sa më mirë detyrimin. Përveç kësaj, ai përpiqet me të gjitha mënyrat që edhe të tjerët ta zbatojnë urdhrin e të Adhuruarit.

Në të njëjtën mënyrë vepron besimtari edhe me ndalesat e përcaktuara nga Allahu i Lartësuar. Fillimisht, ai përpiqet që ta kuptojë qartë atë për të cilën ndalohet. Ai mundohet ta përkufizojë saktë të ndaluarën dhe përpiqet të kuptojë se çfarë bën pjesë në atë ndalesë, prej të cilës duhet të largohet në shenjë adhurimi për Allahun e Lartësuar. Besimtari nuk e tepron dhe të fusë në rrethin e të ndaluarave atë që nuk është e tillë, por edhe është i kujdesshëm që të mos neglizhojë asgjë që hyn tek të ndaluarat dhe të mos e konsiderojë si të tillë. Pas qartësimit, ai përpiqet që, jo vetëm ai, por

edhe të tjerët të distancohen nga ato gjëra që i Adhuruari i ka ndaluar. Edhe kësaj here, ai kurrë nuk harron që të kërkojë ndihmën dhe mbështetjen e plotë të të Adhuruarit, që ta ndihmojë dhe t'ia lehtësojë largimin nga haramet. Kështu duhet vepruar me të gjitha urdhrat dhe ndalesat e ligjëruara nga Allahu i Lartësuar. Asnjë nga ato nuk duhet neglizhuar.

Këto ajete të mrekullueshme përmbajnë këshilla të çmuara dhe nxisin adhuruesit që t'i zbatojnë ato. Këtu përmendet edhe shpërblimi i njerëzve që përpiqen sinqerisht t'i zbatojnë porositë e Zotit të tyre. Ajetet përmbajnë edhe ndalesa nga disa vepra të këqija, duke i nxitur adhuruesit që të largohen prej tyre.

Ndërfutja në historinë e Uhudit e ajeteve të mbushura me urdhra dhe ndalesa ka urtësinë e saj. Ndoshta qëllimi është pikërisht përforcimi i atyre mësimeve të vyera që Allahu i Lartësuar u dha besimtarëve në luftën e Uhudit. Sikurse u përmend më parë, Allahu i Lartësuar u premtoi adhuruesve të Tij të sinqertë se, nëse do të tregohen gjithmonë të duruar e të qëndrueshëm, nëse do të jenë të pajisur me devotshmëri dhe nëse do të kenë sistematikisht këto cilësi, Ai do t'i ndihmojë kundër armiqve të tyre dhe do t'u falë fitoren. Nëse ata i përmbushin porositë e Tij, Ai do t'i poshtërojë dhe shpartallojë armiqtë e tyre. Kështu, me sa duket, pas përmendjes së devotshmërisë, nëpërmjet së cilës zbret ndihma, suksesi, lumturia dhe mirësia nga Zoti, shpirtrat duan të dëgjojnë me shumë kureshtje se cilat janë ato cilësi kaq të mrekullueshme, që të bëjnë të jesh i devotshëm. Për këtë arsye, Allahu i Lartësuar përmend në vijim cilësitë më të rëndësishme të devotshmërisë. Nëse adhuruesi pajiset me to, atëherë ai duhet t'i ketë edhe cilësitë e tjera plotësuese, që nuk janë përmendur, por që janë pjesë e atyre të përmendurave.

Për rëndësinë e madhe të devotshmërisë tregon fakti që Allahu i Lartësuar e ka përsëritur tri herë gjatë këtyre ajeteve porosinë për të qenë të devotshëm.

- "O ju që keni besuar!" - Dijeni se çdo ajet në Kur'ân që fillon me thirrjen: "O ju që keni besuar" tregon se është pikërisht besimi forca shtytëse e kryerjes së urdhrit apo ndalesës që vijon më pas. Të besosh do të thotë të pohosh dhe të pranosh sinqerisht, pa dyshime, gjithçka që duhet besuar dhe pranuar. Ky besim është nxitës për të kryer veprat që e konkretizojnë dhe e shprehin hapur atë.

Në vazhdim, Allahu i Lartësuar i ndalon besimtarët që të merren me fajde ose me kamatë. Pasuria e mbledhur me fajde është haram të hahet. Allahu i Lartësuar përmend në këtë ajet një lloj fajdeje që përdorej shumë në kohën e injorancës paraislamike, kur njerëzit nuk shqetësoheshin aspak për dispozitat dhe porositë e Zotit. Asokohe, nëse dikujt i afrohej koha e shlyerjes së borxhit dhe ai nuk ishte në gjendje ta shlyente atë, huadhënësi i jepte atij dy mundësi: ose ta shlyente borxhin në afatin e caktuar, ose ta shlyente më vonë, por shuma e borxhit do të shtohej. Pra, po të zgjatej afati, shtohej shuma për të shlyer. I varfëri i shkretë, për t'i shpëtuar situatës së ngushtë të momentit, detyrohej që të pranonte mundësinë e dytë, të shlyerjes së borxhit bashkë me fajdenë.

Kur na ka udhëzuar nga ndalimi i fajdeve ka thënë:

- "Mos e hani kamatën disa herë të shumëfishuar." – Pra, mos hani fajdetë, që janë disa herë të shumëfishuara.

Nga cilësimi: "*eđ'âfem-muđâ'afeh*" - "disa herë të shumëfishuar" kuptojmë se sa i shëmtuar dhe i padrejtë është ky veprim. Ne kuptojmë nga ky cilësim edhe urtësinë e ligjërimit të kësaj ndalese nga Allahu i Lartësuar e i Mëshirshëm. Kjo ndalesë shërben që t'i mbyllet porta kësaj vepre të ulët, të pamëshirshme dhe të padrejtë ndaj krijesave. Allahu i Lartësuar e ka bërë të

detyrueshme afatizimin e atij që është ngushtë dhe nuk ka mundësi që ta lajë borxhin, por e ka ndaluar rreptësisht që, për shkak të zgjatjes së afatit, të rritet edhe masa e borxhit. Këtë shtesë mbi shumën e borxhit Allahu i Lartësuar e ka konsideruar si padrejtësi të shumëfishtë.

Për besimtarin e devotshëm nuk duhet të ketë mëdyshje për largimin nga një vepër e tillë e shëmtuar dhe e poshtër. Largimi nga padrejtësitë është kusht për të qenë i devotshëm. Nuk ka mundësi që të jesh i devotshëm, pa u larguar nga padrejtësitë e çdo lloji. Qëllimi i çdo njeriu është arritja e gjithçkaje të mirë e të dobishme dhe ruajtja nga çdo gjë e keqe dhe e dëmshme. Por ky sukses është i pamundur nëse mungon devotshmëria. Prandaj i Lartësuari thotë:

- "Kini frikë Allahun, që të gjeni shpëtim dhe të fitoni!" - Është shumë e kuptueshme se arritja e suksesit kërkon devotshmëri. Edhe urdhri për t'u larguar nga fajdetë, është në kuadër të udhëzimit të adhuruesve për të arritur suksesin.

Pastaj Allahu i Lartësuar na sjell edhe një arsye më shumë për t'u pajisur me devotshmëri:

- "Ruajuni Zjarrit, që është përgatitur për jobesimtarët!" – Pra, kur Allahu i Lartësuar na porosit që t'i ruheni Zjarrit që është përgatitur për mohuesit, kjo nënkupton që, fillimisht, ne duhet të besojmë, dhe pastaj të largohemi nga gjithçka që të fut në Zjarr.


Veprat që çojnë në Xhehenem janë të shumta dhe të larmishme, duke filluar nga kufri e shirku, dhe duke vazhduar me gjynahet dhe padrejtësitë e të gjitha llojeve. Të gjitha gjynahet pa përjashtim, sidomos ato të mëdhatë, të çojnë drejt kufrit. Ato janë tipare dalluese ose elementë të kufrit, dhe Zjarri është përgatitur për ata që kanë cilësitë e kufrit. Ata që kryejnë gjynahe afrohen ngadalë-ngadalë drejt Zjarrit, që është përgatitur për qafirët. Ndërsa largimi nga gjynahet të shpëton nga Xhehenemi dhe të ruan nga zemërimi i të Plotfuqishmit Madhështor dhe Krenar.

Veprat e mira dhe bindja ndaj Allahut të Lartësuar sjellin kënaqësinë e Tij dhe hyrjen në Xhenetin e përjetësisë dhe të mëshirës. Prandaj i Lartësuari, menjëherë pas kërcënimit me Zjarr, sjell një përgëzim dhe shkakun e tij:

- "Bindjuni Allahut dhe të Dërguarit, që të mëshiroheni!" - Kështu, bindja ndaj Allahut të Lartësuar dhe bindja ndaj Profetit të Tij përbëjnë shkaqet që të çojnë drejt mëshirës së Rrahmanit, i Cili thotë në disa ajete të tjera: ""Cakto për ne të mira në dunja dhe të mira në botën tjetër, sepse ne jemi kthyer vërtet tek Ti!" Ai *(Zoti)* tha: "Me dënimin Tim Unë godas atë që dëshiroj, ndërsa mëshira Ime ka përfshirë çdo gjë. Atë *(mëshirën)* do ta caktoj për ata të cilët ruhen, që japin zekatin, që i besojnë argumentet Tona, që pranojnë të Dërguarin, Profetin arab, të cilin e gjejnë të përshkruar në Teurat dhe në Ungjill, që i urdhëron ata për çdo të mirë dhe i ndalon nga çdo e keqe, u lejon ushqimet e këndshme dhe u ndalon ato të neveritshmet, që heq nga ata barrën e rëndë të tyre dhe prangat që ishin mbi ta. Pra, ata të cilët e besojnë, e nderojnë dhe e ndihmojnë atë, ata që veprojnë me dritën që u zbrit me të, ata janë të shpëtuarit. Thuaj *(Muhamed)*: "O njerëz! Unë jam i dërguari i Allahut tek të gjithë ju; i Allahut, në dorën e të Cilit është sundimi i qiejve e i tokës. Nuk ka të adhuruar tjetër veç Tij. Ai jep jetë dhe Ai jep vdekje. Pra, besoni Allahun dhe të Dërguarin e Tij, Profetin që nuk shkruan e që nuk lexon, që beson Allahun dhe shpalljet e Tij! Ndiqeni rrugën e tij, që ta gjeni të vërtetën!" [Araf 156-158].

Më pas, Allahu i Lartësuar vazhdon me porosi të mrekullueshme për të arritur devotshmërinë dhe suksesin:

- "Nxitoni për faljen e gjynaheve nga Zoti juaj dhe për një Xhenet, gjerësia e të cilit është sa gjerësia e qiejve dhe e tokës!" - I


الجزء الرابع سورة آل عمران
وَسَارِعُوٓا۟ إِلَىٰ مَغْفِرَةٍ مِّن رَّبِّكُمْ وَجَنَّةٍ عَرْضُهَا
ٱلسَّمَٰوَٰتُ وَٱلْأَرْضُ أُعِدَّتْ لِلْمُتَّقِينَ ﴿١٣٣﴾ ٱلَّذِينَ يُنفِقُونَ
فِى ٱلسَّرَّآءِ وَٱلضَّرَّآءِ وَٱلْكَٰظِمِينَ ٱلْغَيْظَ وَٱلْعَافِينَ
عَنِ ٱلنَّاسِ ۗ وَٱللَّهُ يُحِبُّ ٱلْمُحْسِنِينَ ﴿١٣٤﴾ وَٱلَّذِينَ إِذَا فَعَلُوا۟
فَٰحِشَةً أَوْ ظَلَمُوٓا۟ أَنفُسَهُمْ ذَكَرُوا۟ ٱللَّهَ فَٱسْتَغْفَرُوا۟
لِذُنُوبِهِمْ وَمَن يَغْفِرُ ٱلذُّنُوبَ إِلَّا ٱللَّهُ وَلَمْ يُصِرُّوا۟ عَلَىٰ مَا
فَعَلُوا۟ وَهُمْ يَعْلَمُونَ ﴿١٣٥﴾ أُو۟لَٰٓئِكَ جَزَآؤُهُم مَّغْفِرَةٌ مِّن
رَّبِّهِمْ وَجَنَّٰتٌ تَجْرِى مِن تَحْتِهَا ٱلْأَنْهَٰرُ خَٰلِدِينَ فِيهَا ۚ وَنِعْمَ
أَجْرُ ٱلْعَٰمِلِينَ ﴿١٣٦﴾ قَدْ خَلَتْ مِن قَبْلِكُمْ سُنَنٌ فَسِيرُوا۟
فِى ٱلْأَرْضِ فَٱنظُرُوا۟ كَيْفَ كَانَ عَٰقِبَةُ ٱلْمُكَذِّبِينَ
﴿١٣٧﴾ هَٰذَا بَيَانٌ لِّلنَّاسِ وَهُدًى وَمَوْعِظَةٌ لِّلْمُتَّقِينَ ﴿١٣٨﴾
وَلَا تَهِنُوا۟ وَلَا تَحْزَنُوا۟ وَأَنتُمُ ٱلْأَعْلَوْنَ إِن كُنتُم مُّؤْمِنِينَ
﴿١٣٩﴾ إِن يَمْسَسْكُمْ قَرْحٌ فَقَدْ مَسَّ ٱلْقَوْمَ قَرْحٌ مِّثْلُهُۥ ۚ وَتِلْكَ
ٱلْأَيَّامُ نُدَاوِلُهَا بَيْنَ ٱلنَّاسِ وَلِيَعْلَمَ ٱللَّهُ ٱلَّذِينَ ءَامَنُوا۟
وَيَتَّخِذَ مِنكُمْ شُهَدَآءَ ۗ وَٱللَّهُ لَا يُحِبُّ ٱلظَّٰلِمِينَ ﴿١٤٠﴾
٦٧

Lartësuari na udhëzon që të nxitojmë pa vonesë në kërkimin e faljes prej Allahut të Lartësuar dhe drejt Xhenetit të Tij të mirësisë dhe bujarisë. Për ta bërë sa më të dashur dhe të dëshirueshëm këtë nxitim, Allahu i Lartësuar na tregon për gjerësinë e madhe të Xhenetit. Kur gjerësia e tij është sa ajo e qiejve dhe e tokës, atëherë po gjatësia e tij, sa do të jetë?!

Pastaj i Lartësuari sjell përsëri një nxitës shumë të fortë për t'u pajisur me devotshmëri, kur na tregon se Xheneti dhe falja e Tij është për të devotshmit:

- "Ai është përgatitur për të devotshmit" – Pra, për të devotshmit, që i zbatojnë urdhrat e Zotit të tyre dhe iu largohen ndalesave të Tij, është gati falja dhe mëshira e Tij në Xhenetin e përjetësisë.

Më poshtë, Allahu i Lartësuar vijon me disa cilësi dalluese të të devotshmëve, për ata që dëshirojnë suksesin.

- "...të cilët japin kur janë në bollëk dhe kur janë në vështirësi." – Pra, ata shpenzojnë, në çdo gjendje qofshin: në gjendje të mirë apo në gjendje të vështirë. Nëse janë në kohë bollëku, ata japin shumë për fenë e Allahut nga pasuria e tyre. E nëse janë në kohë vështirësie, ata përsëri dinë të jenë bamirës, qoftë edhe me gjëra shumë të vogla. Ata nuk nënvleftësojnë asnjë lloj bamirësie, sado e vogël qoftë ajo.

- "Ata e frenojnë inatin..." - Nëse dikush u bën ndonjë padrejtësi dhe i mbush zemrat e tyre me zemërim e urrejtje, ata nuk nxitohen që të veprojnë dhe të hakmerren kundër tij, sikurse të shtyn nefsi. Por ata dinë ta shtypin zemërimin e ndezur në kraharor, ata dinë ta nënshtrojnë veten, për të qenë të durueshëm dhe tolerantë, për të mos e kthyer të keqen nxitimthi dhe me ashpërsi. Madje, cilësia e tyre mbizotëruese është:

- "...dhe janë falës ndaj njerëzve." - Ata janë falës ndaj njerëzve, falës ndaj fjalëve dhe veprave të tyre.

Falja është më e çmuar dhe më e vështirë sesa thjesht frenimi i zemërimit. Falja është largim nga hakmarrja kundrejt atij që të ka bërë keq. Sigurisht, kjo pritet veçse nga njerëzit me moral të lartë, që janë larg cilësive të ulëta. Kjo është veti e atyre që kanë bërë 'tregti' me Allahun, prandaj i falin adhuruesit e Allahut, të motivuar nga mëshira dhe bamirësia ndaj tyre. Ata përpiqen që të mos i dëmtojnë të tjerët me zjarrin që ndez hakmarrja dhe urrejtja, dhe kështu kërkojnë dhe shpresojnë faljen e Allahut. Ata shpresojnë që Allahu i Lartësuar t'i falë dhe t'u dhurojë shpërblim të madh nga bujaria e Tij. Ata nuk presin shpërblime nga krijesat, të cilat janë të vogla, të dobëta dhe të pamundura, por e presin shpërblimin vetëm nga Allahu i Pasur, Bujar dhe Dhurues i madh. Ata kujtojnë gjithmonë fjalën e Allahut të Lartësuar: "Ai që fal dhe rregullon çështjet e ka shpërblimin tek Allahu i Lartësuar."

Pastaj Allahu i Lartësuar përmend një gradë më të lartë të besimit dhe të edukatës me njerëzit, që është bamirësia, ose *iĥsân*-i. Thotë i Lartësuari:

- "Allahu i do bamirësit" - Bamirësia është dy llojesh: bamirësi në adhurimin ndaj Krijuesit dhe bamirësi ndaj krijesave.

Bamirësia në adhurim është shpjeguar nga Profeti (a.s.) në një hadith të saktë, që thotë: *"Bamirësia në adhurim është: Ta adhurosh Allahun sikur ta shihje Atë. Nëse nuk e sheh Atë, Ai pa dyshim që të sheh ty"*. Ndërsa bamirësia ndaj krijesave bëhet duke u dhuruar atyre të mira, që kanë të bëjnë me fenë dhe dynjanë, dhe përpjekja për largimin e të këqijave prej tyre, qoftë në aspektin e fesë, qoftë në atë të dynjasë.

Kështu, koncepti i bamirësisë ndaj krijesave është tepër i gjerë, ku futen shumë fjalë dhe vepra, si për shembull: t'i urdhërosh për vepra të mira dhe t'i ndalosh nga veprat e këqija, t'u mësosh se çfarë është e mira dhe të largosh prej tyre injorancën, t'i përkujtosh vazhdimisht dhe t'i përmendësh nga pakujdesia, që aq shpesh i kaplon; t'i këshillosh ata vazhdimisht, qoftë njerëzit e thjeshtë, qoftë ata me pozitë; të përpiqesh të bashkosh radhët e tyre, ta shpërndash sadakanë dhe zekatin atje ku nevojitet, të shpenzosh në dobi të tyre çfarëdolloj të mire, sado e vogël qoftë ajo, apo edhe sikur thjesht të mos i dëmtosh dhe të largosh të këqijat prej tyre, qofshin ato fjalë apo vepra. Madje edhe të tregohesh i durueshëm ndaj injorancës dhe ashpërsisë së krijesave, është bamirësi ndaj tyre, dhe kjo shpërblehet nga Allahu i Lartësuar.

Kështu i përshkruan Allahu i Lartësuar të devotshmit në këtë ajet. Kush i ka të tilla cilësi, e ka respektuar dhe plotësuar të drejtën e Allahut dhe të drejtat e krijesave ndaj tij.

Pastaj Allahu i Lartësuar thotë se të devotshmit i kërkojnë falje vazhdimisht Allahut të Lartësuar për gabimet dhe mangësitë e tyre:

- "...edhe ata të cilët, kur bëjnë ndonjë gjë të shëmtuar, ose kur i bëjnë padrejtësi vetvetes, e përmendin Allahun dhe kërkojnë falje për gjynahet e tyre. E kush i fal tjetër gjynahet, përveç Allahut?!" - Sa herë që ata bëjnë ndonjë gabim të madh apo dëmtojnë veten me pakujdesinë e tyre, shpejtojnë të pendohen dhe t'i kërkojnë Allahut falje dhe mëshirë. Ata i kërkojnë Atij që t'ua mbulojë të metat e tyre dhe gabimet që kanë bërë. Ata nxitojnë të pendohen dhe të kërkojnë falje, sepse ata kujtojnë Allahun e Lartësuar që sheh dhe di gjithçka, kujtojnë kërcënimin e Tij të hapur dhe të qartë për ata që thyejnë porositë e Tij dhe shkelin kufijtë e Tij, kujtojnë premtimet e dashura që Allahu i Lartësuar u ka dhënë të devotshmëve, të cilët i ruajnë kufijtë e Tij. Të gjitha këto përkujtime bëjnë që ata, me të shpejtë, t'i kërkojnë Allahut falje për gabimet e tyre dhe që t'ua mbulojë të metat dhe turpet e tyre. Ata heqin dorë menjëherë nga ato vepra të këqija, pendohen dhe trishtohen sinqerisht për gjynahet që kanë bërë. Prandaj Allahu i Lartësuar thotë:

- "Ata nuk vazhdojnë më me atë gjë që kanë bërë më parë, sepse e dinë." – Pra, nuk vazhdojnë sërish me një gjynah, pasi e kanë mësuar se çfarë gabimi kanë bërë, por vazhdimisht kthehen të penduar tek Allahu dhe i kërkojnë Atij falje dhe udhëzim.

- "Shpërblimi i të tillëve është falja nga Zoti i tyre..." Të përshkruarit me këto cilësi do të kenë si shpërblim *'maĝfiratun'*, pra, mbulimin e të metave dhe faljen e gjynaheve të tyre, që do të thotë se ata do të shpëtojnë nga çdo e keqe që i druhen.

Përveçse janë të sigurt nga çdo e keqe, prej faljes nga Zoti i tyre, ata kanë edhe shpërblime të tjera:

- "...dhe Xhenetet, nëpër të cilët rrjedhin lumenj..." - Në Xhenet ka mirësi të shumta e të përhershme, ka gëzim e lumturi, kështjella madhështore, ndërtesa të pastra

dhe të larta, pemë e fruta të mrekullueshme, lumenj që rrjedhin vazhdimisht mes vendbanimeve etj. Të gjithë kësaj panorame ia shton bukurinë fakti që ata do të jenë përjetësisht në këtë vend, siç thotë i Lartësuari:

- "...dhe ku ata do të jenë përjetësisht." - Ata do të jenë përgjithmonë në këtë vend të mrekullueshëm. Ata kurrë nuk do të dëshirojnë të largohen nga ato mirësi dhe kurrë nuk do të velen a mërziten prej tyre e të kërkojnë të tjera. Mirësitë do të jenë gjithmonë në rritje dhe kurrë nuk do të largohen apo pakësohen.

- "Sa i mirë është shpërblimi i atyre që punojnë!" - Ata punuan pak për hir të Allahut të Lartësuar, por u shpërblyen shumë. Siç ka thënë dikush: në kohën e agimit, kur drita u shkëlqen në fytyrë, udhëtarët e natës kënaqen, edhe pse rruga e natës ka qenë e lodhshme. Në momentet e shpërblimit, punëtori ndien gëzim të plotë për punën që ka bërë.

Këto ajete të mrekullueshme janë argument shumë i fortë për Ehli Sunetin, të cilët besojnë se veprat bëjnë pjesë në *iman*, ndryshe nga qëndrimi i *murxhi*-ve. Ky qëndrim përforcohet në një ajet tjetër shumë të ngjashëm në suren Hadidë: "Shpejtoni drejt faljes prej Zotit tuaj dhe drejt Xhenetit, gjerësia e të cilit është si gjerësia e qiellit dhe e tokës dhe që u përgatit për ata që i besojnë Allahut dhe profetëve të Tij. Kjo është mirësia e Allahut, që ia jep kujt të dojë. Allahu është Dhurues i madh." [Hadidë 21]. Në këtë ajet përmendet si shkak për futjen në Xhenet besimi tek Allahu dhe te Profeti i Tij. Ndërsa në ajetin e sures Al Imran, që po komentojmë, thuhet se Xheneti është përgatitur për të devotshmit, dhe më pas tregohen cilësitë, veprat dhe fjalët e këtyre të devotshmëve. Nëse i vendos paralel të dy ajetet, kupton se besimtarët e pajisur me iman janë ata që quhen '*muttekin*' - të devotshëm, të cilët bëjnë edhe ato vepra të mrekullueshme. Mendo pak dhe gjyko!

Ajetet 137 – 138

137. Përpara jush kanë kaluar shumë popuj, ndaj të cilëve janë zbatuar ligjet. Udhëtoni nëpër tokë dhe shikoni se si qe përfundimi i atyre që mohuan.
138. Këto janë sqarime për njerëzit, janë udhëzuese dhe këshilla për të devotshmit.

Shpjegimi i ajeteve

Këto ajete dhe ato që vijnë pas tyre flasin për luftën e Uhudit. Nëpërmjet tyre, Allahu i Lartësuar ngushëllon adhuruesit e Tij besimtarë. Ai u tregon se ka patur shumë popuj të tjerë që kanë kaluar para tyre dhe të gjithë janë sprovuar me luftë kundër qafirëve, me beteja tepër të ashpra mes tyre. Besimtarët kanë provuar fitoren dhe humbjen, por përfundimi i mirë u takon gjithmonë besimtarëve dhe të devotshmëve. Allahu i Lartësuar ka qenë gjithmonë në ndihmë të adhuruesve të Tij të sinqertë, të besimtarëve që pasuan Profetin e Tij.

Thotë i Lartësuari:

- "Përpara jush kanë kaluar shumë popuj, ndaj të cilëve janë zbatuar ligjet. Udhëtoni nëpër tokë dhe shikoni se si qe përfundimi i atyre që mohuan." – Kuptimi: Lëvizni nëpër tokë fizikisht dhe shpirtërisht, dhe vështroni me kujdes se si ishte përfundimi i atyre që mohuan të vërtetën e sjellë prej profetëve (a.s.). Shihni me kujdes ndëshkimin dhe shkatërrimin total që ata i zuri.

Të shumta dhe të larmishme kanë qenë llojet e ndëshkimeve që janë derdhur mbi vendbanimet e jobesimtarëve. Këto ndëshkime e zhdukën pushtetin dhe krenarinë e atyre popujve. Mendjemadhësia e tyre humbi nëpër kohëra dhe u harrua.

A nuk konsiderohen të tilla ngjarje si argumentet më të mira dhe më të forta për vërtetësinë e fjalëve të profetëve?! A nuk

tregojnë këto urtësinë e madhe të të Lartësuarit, me të cilën Ai i sprovon njerëzit, për t'u dalluar qartë i sinqerti nga mashtruesi. Prandaj i Lartësuari thotë:

- "Këto janë sqarime për njerëzit..." – Pra, këto shenja e ngjarje në tokë janë argumente sqaruese për njerëzit. Ato shpjegojnë të vërtetën nga e kota, cilësitë dhe përfundimin e fatlumëve dhe cilësitë e fatzinjve të trishtuar. Në to ka shenja treguese për ndëshkimet me të cilat Allahu i Lartësuar i ka goditur gjithmonë mashtruesit dhe jobesimtarët. Këto shenja shërbejnë edhe si:

- "...janë udhëzuese dhe këshilla për të devotshmit" – Pra, ato janë edhe udhëzim i qartë, dhe këshillë për *muttekin*-ët, sepse të vetmit që përfitojnë nga udhëzimi i qartë dhe këshillat e Zotit të tyre janë *muttekin*-ët. Këto udhëzime i drejtojnë ata në rrugën e mirësive dhe të drejtësisë. Ato janë qortim dhe këshillë shumë e fortë, që i pengon ata nga çdo rrugë e keqe dhe poshtërsi e padrejtësi.

Ndërsa për njerëzit e tjerë, Kur'âni është thjesht një qartësim i të vërtetave të pamohueshme dhe këputje e çdo justifikimi që mund të parashtrohet prej tyre, që çdokush të jetë i qartë dhe i sigurt për rrugën që po zgjedh. Nëse zgjedhin rrugën e shkatërrimit, e kanë zgjedhur atë me vetëdije dhe plotësisht të bindur për gabimin e tyre. Kur'âni nuk ka lënë asnjë mundësi justifikimi për ta.

Pra, ka shumë mundësi që këtu të bëhet fjalë për Kur'ânin dhe Urtësinë, dhe jo thjesht për shenjat e mbetura nëpër tokë, sepse ai është udhëzim i përgjithshëm, për të gjithë njerëzit, dhe këshillë dhe udhëzim i veçantë për të devotshmit. Të dyja kuptimet janë të pranueshme.

Ajetet 139 – 143

139. Mos u dobësoni dhe mos u dëshpëroni, përderisa ju jeni më të lartit, nëse jeni besimtarë të sinqertë.

140. Në qoftë se ju përjetuat dhimbje *(në Uhud)*, edhe populli tjetër *(armik)* provoi dhimbje si kjo e juaja *(në Bedër)*. Ne i këmbejmë këto ditë mes njerëzve, për t'u dalluar qartë tek Allahu ata që besojnë dhe për t'i zgjedhur disa prej jush si dëshmorë. Allahu nuk i do të padrejtët.

141. Kështu Allahu i pastron besimtarët dhe, gradualisht, i shkatërron jobesimtarët.

142. A mos menduat ju se do të hyni në Xhenet pa u dalluar tek Allahu ata që luftojnë prej jush dhe pa u dalluar të durueshmit?!


143. Ju ishit ata që dëshironit vdekjen para se të ballafaqoheshit me ta. Ja, pra, atë e ndiet dhe e vështruat me sytë tuaj!

Shpjegimi i ajeteve

Allahu i Lartësuar i inkurajon adhuruesit e tij të sinqertë të forcojnë ambiciet dhe vullnetin e tyre, duke u thënë:

- "Mos u dobësoni dhe mos u dëshpëroni..." – Kuptimi: Mos u lëshoni, duke u dobësuar fizikisht dhe mos u trishtoni, duke u dobësuar shpirtërisht gjatë sprovave, fatkeqësive dhe disfatave. Pa dyshim që trishtimi në zemër edhe lëshimi i trupit janë sprova më vete, prandaj mos e dënoni dhe rëndoni veten tuaj më shumë me sprova të tjera. Dobësia juaj veçse i ndihmon armiqtë kundërshtarë, prandaj mos pranoni që t'ju pushtojë ajo. Përkundrazi, inkurajojeni veten dhe nxitni vullnetin dhe ambiciet tuaja drejt të mirës. Ushqeni durimin dhe trimërohuni, duke luftuar armikun tuaj. Largojini trishtimet dhe ankesat, se janë të padobishme, madje paralizuese.

Trishtimi dhe shkurajimi nuk duhet të kenë lidhje me besimtarët e sinqertë, sepse imani i tyre i mban shumë më lart ata. Ata shpresojnë ndihmën, suksesin dhe fitoren prej të Plotfuqishmit, që kujdeset për ta veçanërisht. Ata shpresojnë shpërblimin e Bujarit, Bamirësit dhe të Mëshirshmit. E si mund të ulet kaq poshtë një besimtar, i cili


الجزء الرابع سورة آل عمران

وَلِيُمَحِّصَ ٱللَّهُ ٱلَّذِينَ ءَامَنُوا۟ وَيَمْحَقَ ٱلْكَٰفِرِينَ ﴿١٤١﴾ أَمْ
حَسِبْتُمْ أَن تَدْخُلُوا۟ ٱلْجَنَّةَ وَلَمَّا يَعْلَمِ ٱللَّهُ ٱلَّذِينَ جَٰهَدُوا۟
مِنكُمْ وَيَعْلَمَ ٱلصَّٰبِرِينَ ﴿١٤٢﴾ وَلَقَدْ كُنتُمْ تَمَنَّوْنَ ٱلْمَوْتَ مِن
قَبْلِ أَن تَلْقَوْهُ فَقَدْ رَأَيْتُمُوهُ وَأَنتُمْ تَنظُرُونَ ﴿١٤٣﴾ وَمَا مُحَمَّدٌ
إِلَّا رَسُولٌ قَدْ خَلَتْ مِن قَبْلِهِ ٱلرُّسُلُ ۚ أَفَإِي۟ن مَّاتَ أَوْ قُتِلَ
ٱنقَلَبْتُمْ عَلَىٰٓ أَعْقَٰبِكُمْ ۚ وَمَن يَنقَلِبْ عَلَىٰ عَقِبَيْهِ فَلَن يَضُرَّ
ٱللَّهَ شَيْـًٔا ۗ وَسَيَجْزِى ٱللَّهُ ٱلشَّٰكِرِينَ ﴿١٤٤﴾ وَمَا كَانَ
لِنَفْسٍ أَن تَمُوتَ إِلَّا بِإِذْنِ ٱللَّهِ كِتَٰبًا مُّؤَجَّلًا ۗ وَمَن يُرِدْ
ثَوَابَ ٱلدُّنْيَا نُؤْتِهِۦ مِنْهَا وَمَن يُرِدْ ثَوَابَ ٱلْءَاخِرَةِ نُؤْتِهِۦ مِنْهَا
وَسَنَجْزِى ٱلشَّٰكِرِينَ ﴿١٤٥﴾ وَكَأَيِّن مِّن نَّبِىٍّ قَٰتَلَ مَعَهُۥ
رِبِّيُّونَ كَثِيرٌ ۚ فَمَا وَهَنُوا۟ لِمَآ أَصَابَهُمْ فِى سَبِيلِ ٱللَّهِ وَمَا ضَعُفُوا۟
وَمَا ٱسْتَكَانُوا۟ ۗ وَٱللَّهُ يُحِبُّ ٱلصَّٰبِرِينَ ﴿١٤٦﴾ وَمَا كَانَ قَوْلَهُمْ إِلَّآ أَن
قَالُوا۟ رَبَّنَا ٱغْفِرْ لَنَا ذُنُوبَنَا وَإِسْرَافَنَا فِىٓ أَمْرِنَا وَثَبِّتْ أَقْدَامَنَا
وَٱنصُرْنَا عَلَى ٱلْقَوْمِ ٱلْكَٰفِرِينَ ﴿١٤٧﴾ فَـَٔاتَىٰهُمُ ٱللَّهُ ثَوَابَ
ٱلدُّنْيَا وَحُسْنَ ثَوَابِ ٱلْءَاخِرَةِ ۗ وَٱللَّهُ يُحِبُّ ٱلْمُحْسِنِينَ ﴿١٤٨﴾

٦٨

ka siguri të plotë për premtimin e Allahut dhe shpërblimin e Tij të madh në këtë jetë dhe në jetën tjetër?! Kjo nuk duhet të ndodhë me besimtarin e sinqertë. Prandaj i Madhëruari thotë:

- "...përderisa ju jeni më të lartit, nëse jeni besimtarë të sinqertë."

Pas kësaj, Allahu i Lartësuar i qetëson zemrat e tyre të tronditura nga disfata, duke u përmendur urtësitë që fshihen pas të tilla humbjesh dhe sprovash. Ai thotë:

- "Në qoftë se ju përjetuat dhimbje *(në Uhud)*, edhe populli tjetër *(armik)* provoi dhimbje si kjo e juaja *(në Bedër)*." – Pra, ashtu si ju, edhe ata kanë ndier dhimbje dhe vuajtje. Porse mes jush ka një ndryshim të madh: ju shpresoni prej Allahut diçka që ata nuk e shpresojnë, sikurse thotë i Lartësuari: "Mos u tregoni të dobët në ndjekjen e armikut, sepse nëse ju ndieni dhimbje, edhe ata ndiejnë dhimbje, sikurse ju. Por ju shpresoni nga Allahu çka ata nuk e shpresojnë. Allahu është i Dijshëm, i Urtë". [Nisa 104].

- "Ne i këmbejmë këto ditë mes njerëzve..." - Prej urtësive të kuptuara nga këto ajete është edhe fakti se, kur është fjala për mirësitë e kësaj jete, Allahu i Lartësuar ua jep ato edhe besimtarëve, edhe qafirëve, edhe të mirëve, edhe të këqijve. Kështu i ndërron ditët mes njerëzve Allahu i Lartësuar: sot u jep disave një gjë, nesër ua jep atë të tjerëve. Kështu ndodh në këtë jetë, sepse kjo dynja është e parëndësishme dhe do të zhduket. Ndërsa në jetën e përjetshme çështja ndryshon, sepse mirësitë atje janë të posaçme vetëm për besimtarët.

- "...për t'u dalluar qartë tek Allahu ata që besojnë..." - Edhe kjo është një nga urtësitë që fshihen pas sprovave që godasin besimtarët: të dalin në pah besimtarët dhe e munafikët. Nëse fitorja do t'u takonte gjithmonë besimtarëve, atëherë Islamin do ta pranonin të gjithë, edhe ata që në të vërtetë nuk e dëshirojnë atë. Prandaj, duke ndodhur sprova të tilla, del në pah besimtari i vërtetë, që e dëshiron fort dhe e zbaton Islamin qoftë në kohë mirësie, qoftë në kohë fatkeqësie, qoftë kur i vjen lehtë, qoftë kur i duket i vështirë, dhe kështu del në pah edhe ai që nuk është i tillë.

- "...dhe për t'i zgjedhur disa prej jush si dëshmorë." - Ja edhe një urtësi tjetër që zbulohet nëpërmjet sprovave të mëdha. Allahu i Lartësuar i zgjedh disa njerëz si dëshmorë. Martirizimi në rrugën e Allahut është nga gradat më të larta të besimatrit, dhe kjo gradë mund të arrihet veçse nëpërmjet të tilla situatash. Është shprehje e mëshirës së të Urtit, që u ka lënë adhuruesve këtë rrugë të dhimbshme dhe të vështirë për të arritur gradat e larta dhe mirësinë e përjetshme.

- "Allahu nuk i do të padrejtët." - Allahu i Lartësuar nuk i do ata të cilët tregohen të

padrejtë ndaj vetes së tyre, duke mos luftuar dhe përpjekur në rrugën e Allahut. Me këto fjalë, Allahu i Lartësuar tregon cilësitë e poshtra të munafikëve. Ata e urrejnë Allahun dhe luftën në rrugën e Tij dhe, për këtë arsye, Allahu i Lartësuar nuk ua dha mundësinë dhe nderin të merrnin pjesë në betejën e Uhudit. Në një ajet tjetër, i Lartësuari thotë: "Nëse vërtet do të dëshironin të dilnin për të luftuar me ty, do të bënin ndonjë përgatitje për këtë gjë. Por Allahu nuk e pëlqeu angazhimin e tyre, prandaj i sprapsi dhe atyre iu tha: "Rrini *(në shtëpi)* me të paaftit!" [Teube 46].

- "Kështu Allahu i pastron besimtarët dhe, gradualisht, i shkatërron jobesimtarët." - Edhe kjo është një urtësi tjetër e sprovave. Nëpërmjet tyre, Allahu i Lartësuar pastron besimtarët nga gjynahet dhe u mbulon mangësitë e tyre. Kjo tregon se lufta në rrugën e Allahut i fshin gjynahet dhe i fsheh turpet dhe mangësit e robit. Gjithashtu, Allahu i Lartësuar i pastron në këtë mënyrë radhët e besimtarëve, duke u dhënë atyre një qartësi të plotë për të dalluar munafikët. Vetëm në të tilla sprova ndahen besimtarët nga munafikët.

Urtësi tjetër e sprovave është edhe shkatërrimi i kufrit dhe i qafirëve. Kur qafirët vrasin dhe dëmtojnë muslimanët, kanë bërë një shkak të mjaftueshëm për të marrë ndëshkimin e Allahut. Gjithmonë ndodh që qafirët, nëse fitojnë në luftë, ata i kalojnë kufijtë, dhe kjo e përshpejton ndëshkimin e tyre që në këtë jetë. Edhe ky fakt tregon, pra, për mëshirën dhe dashurinë e Allahut të Lartësuar për adhuruesit e Tij të sinqertë. Pastaj i Madhëruari thotë:

- "A mos menduat ju se do të hyni në Xhenet pa u dalluar tek Allahu ata që luftojnë prej jush dhe pa u dalluar të durueshmit?!" - Kjo është një pyetje retorike. Pra, kuptimi i saj është: As të mos ju shkojë nëpër mend se do të hyni në Xhenet pa kaluar vështirësi dhe pa duruar sprovat në rrugën e Zotit, për të kërkuar kënaqësinë e Tij. Të jeni të sigurt se Xheneti është mirësia dhe qëllimi më i madh, për të cilin mund të garojnë ata që e duan. Sa më i lartë të jetë qëllimi, aq më të mëdha duhet të jenë rrugët, mjetet dhe veprat me të cilat duhet të arrihet ai. Nuk mund ta arrini prehjen e plotë pa e prishur qetësinë fillimisht.

Megjithatë, nëse shpirti i besimtarit tregon durim dhe e ushqen veten e vet me shpresë për shpërblimin e madh që e pret, sprovat e kësaj dynjaje kthehen në mirësi dhe shkak për lumturi dhe gëzim, dhe jo për trishtim e frikë. Ai nuk tronditet kurrë nga çdo fatkeqësi që e godet, dhe kjo është mirësi e Allahut, të cilën Ai ia jep kujt të dëshirojë.

Më pas, Allahu i Lartësuar i qorton besimtarët për dobësinë e treguar në durim kundrejt një çështjeje që vetë e kishin kërkuar të ndodhte. Thotë i Lartësuari:

- "Ju ishit ata që dëshironit vdekjen para se të ballafaqoheshit me ta." - Shumë sahabë që nuk morën dot pjesë në luftën e Bedrit dëshironin që Allahu i Lartësuar t'u mundësonte ndonjë tjetër ballafaqim me armikun, ku ata të shfaqnin trimërinë dhe luftën e tyre për hir të Allahut të Lartësuar.

Kështu, Allahu i Lartësuar u thotë atyre:

- "Ja, pra, atë e ndiet dhe e vështruat me sytë tuaj!" – Kuptimi: Ç'po ndodh me ju?! Pse po tregoni mungesë durimi? Kjo gjendje është e papranueshme dhe nuk ju shkon për shtat juve, e sidomos atyre që vetë e kërkuan një gjë të tillë. Ju vetë e kërkuat këtë luftë. Kështu që, nëse e kërkuat, është detyrë për ju tani t'i bëni ballë dhe t'i qëndroni si burrat kësaj sprove. Ju duhet të jepni maksimumin në qëndresën tuaj.

Nga ky ajet mësojmë se nuk është e papëlqyeshme të shpresosh martirizimin në rrugën e Allahut të Lartësuar, pasi Ai i ka miratuar të tilla dëshira dhe nuk i ka ndaluar. E vërteta është që Allahu i Lartësuar i qortoi besimtarët për faktin që

ata nuk iu përmbajtën asaj që vetë kishin premtuar dhe kërkuar. Në fund, Allahu i Lartësuar e di më mirë.

Ajetet 144 – 145

144. Muhamedi është vetëm se një i dërguar. Edhe përpara tij pati të dërguar. E nëse ai vdes ose vritet, a do të ktheheshit ju prapa? Kushdo që kthehet prapa, ai nuk i bën aspak dëm Allahut. Allahu, do t'i shpërblejë mirënjohësit.
145. Askush nuk vdes pa vullnetin dhe lejen e Allahut. Ai e ka shënuar afatin e caktuar. Kush e dëshiron shpërblimin e kësaj bote, Ne do t'i japim prej saj, e kush dëshiron shpërblimin e botës tjetër, edhe atij do t'i japim prej saj. Ne do t'i shpërblejmë mirënjohësit.

Shpjegimi i ajeteve

- "Muhamedi është vetëm se një i dërguar. Edhe përpara tij pati të dërguar." – Kuptimi: Ai nuk është i pari apo i vetmi profet që i ka ardhur njerëzimit. Ai është i njëjtë me të gjithë profetët e tjerë, për sa i përket cilësive të tij si njeri dhe me detyrën që mbart. Detyra e tij dhe e të gjithë profetëve ka qenë gjithmonë e njëjtë: përçimi i qartë i mesazheve të Zotit të tyre për tek njerëzimi dhe zbatimi me përpikmëri i të gjitha urdhrave dhe porosive të Tij. Askush prej tyre nuk u krijua që të jetë i përjetshëm në dynja. Po ashtu, prania apo mosprania e tyre nuk mund dhe nuk duhet të jetë kusht për plotësimin e urdhrave dhe porosive të Zotit nga ana e njerëzve. Përkundrazi, për njerëzimin është detyrë adhurimi i Zotit të tyre në çdo kohë dhe në çdo gjendje. Për këtë arsye, i Lartësuari thotë:

- "E nëse ai vdes ose vritet, a do të ktheheshit ju prapa?" - Mos vallë, me vdekjen apo vrasjen e Profetit, ju do të ktheheni pas në kufër, duke braktisur çdo porosi të tij?! Mos vallë, ju do ta braktisni besimin dhe xhihadin në rrugën e Zotit?! Mos vallë, do ta braktisni adhurimin e Zotit tuaj? Më pas Allahu i Lartësuar thotë:

- "Kushdo që kthehet prapa, ai nuk i bën aspak dëm Allahut." – Kuptimi: Kush bën një veprim të tillë dëmton veçse vetveten. Allahu i Lartësuar është Jonevojtar për adhurimet dhe bindjen tuaj. Me ju apo pa ju, Allahu i Lartësuar do ta lartësojë dhe plotësojë fenë e Tij. Është Allahu i Lartësuar Ai që do t'i lartësojë adhuruesit e Tij, besimtarët e sinqertë.

Pasi paralajmëron ata që e braktisin fenë, Allahu i Lartësuar lëvdon ata që qëndrojnë me trimëri për të mbështetur Profetin dhe fenë e Tij:

- "Allahu, do t'i shpërblejë mirënjohësit." - Mirënjohja mund të arrihet veçse duke u përpjekur për kryerjen e adhurimeve të Allahut të Lartësuar në çdo gjendje.

Ky ajet madhështor është një këshillë shumë e qartë nga Allahu i Lartësuar për adhuruesit e Tij, që ata të jenë gjithmonë të fortë dhe të qëndrueshëm në imanin e tyre, si edhe në veprat që ai reflekton. Allahu këshillon ata që të mos tronditen dhe dobësohen, qoftë edhe në momente delikate, sikurse është humbja e një udhëheqësi, sado i madh qoftë ai.

Një qëndrueshmëri e tillë është e mundur veçse duke marrë masa serioze që, për çdo çështje të rëndësishme të fesë dhe jetës, të përgatiten njerëz të aftë, të cilët në çdo situatë të jenë gati të marrin drejtimin dhe të udhëheqin popullin në rrugën e përcaktuar qartë nga i Madhëruari. Umeti duhet të kujdeset për përgatitjen e njerëzve të tillë, në mënyrë që, nëse vdes njëri, përgjegjësinë ta marrë tjetri.

Po ashtu, të gjithë besimtarët duhet të mbështesin këtë fe dhe adhurimin e Zotit të Lartësuar. Të gjithë duhet të sakrifikojnë pasurinë më të shtrenjtë të tyre për të ndihmuar Islamin. Qëllimi final dhe i vetëm i të gjithëve duhet të jetë shërbimi ndaj fesë së Zotit, në të gjitha aspektet e saj. Për ta nuk

duhet të jetë qëllim një udhëheqës apo tjetri. Lufta nuk bëhet për udhëheqësin, por për Allahun e Lartësuar. Vetëm me këtë qëllim të lartë normalizohet, udhëzohet dhe arrin të mirën ky umet. Vetëm në këtë mënyrë rregullohen çështjet e tij.

Ky ajet dëshmon, gjithashtu, për vlerat dhe gradën e lartë të Ebu Bekër es Sidikut dhe shokëve të tij, të cilët qëndruan të patundur dhe luftuan me vendosmëri kundër tradhtarëve të fesë së Zotit pasi Profeti (a.s.) ndërroi jetë. Pikërisht ata janë krerët dhe më të mëdhenjtë e adhuruesve të Allahut të Lartësuar.

- "Askush nuk vdes pa vullnetin dhe lejen e Allahut. Ai e ka shënuar afatin e caktuar." – Kështu, Allahu i Lartësuar na tregon se jeta e të gjithë njerëzve varet nga afati i përcaktuar i vdekjes, e cila mund të vijë edhe pa shkak. Nëse Allahu dëshiron që një njeri të jetojë, edhe sikur ai të kërkojë çdo shkak për të vdekur, njeriu nuk mund t'i bëjë asgjë vetes, para se të plotësohet afati i tij. Ky është ligj i patjetërsueshëm, sepse Allahu i Lartësuar e ka përcaktuar dhe shkruar afatin e caktuar për çdo njeri, siç thuhet në një ajet tjetër: "Dhe kur atyre t'u plotësohet afati i vdekjes, ata nuk kanë për ta vonuar atë asnjë çast, por as nuk mund ta përshpejtojnë atë."

Pastaj Allahu i Lartësuar na tregon se do t'i japë gjithësecilit atë që kërkon dhe synon, shpërblimin e dynjasë apo shpërblimin e ahiretit.

- "Kush e dëshiron shpërblimin e kësaj bote, Ne do t'i japim prej saj, e kush dëshiron shpërblimin e botës tjetër, edhe atij do t'i japim prej saj." – Pra, çdokush do të marrë atë që ka patur për qëllim të marrë dhe së cilës i është përkushtuar. Ndërsa në disa ajete të tjera kur'ânore, i Lartësuari thotë: "Prej atyre që kanë qëllim vetëm këtë botë, atyre që Ne duam u japim në të aq sa Ne duam, e pastaj i fusim në Xhehenem të nënçmuar e të përbuzur. Ndërsa kush ka për qëllim botën tjetër, duke qenë besimtar dhe duke u përpjekur për të ashtu si i takon asaj, kjo përpjekje e tij do të paraqitet *(tek Allahu)*. Ne i japim secilit prej tyre nga të mirat e Zotit tënd, dhe dhënia e Zotit tënd nuk është e kufizuar. Shiko se si i kemi dalluar Ne disa prej të tjerëve, por dallimi në botën tjetër është më i madh dhe është përparësi më e madhe". [Isra 18-21]. Pastaj i Lartësuari thotë:

- "Ne do t'i shpërblejmë mirënjohësit." - Allahu i Lartësuar nuk e ka përmendur konkretisht shpërblimin e tyre, për të nënkuptuar sasinë e madhe të tij dhe për të mësuar se shpërblimi është në varësi të mirënjohjes së treguar ndaj Tij.

Ajetet 146 – 148

146. Sa e sa profetë ka patur me të cilët kanë luftuar së bashku ushtri të mëdha besimtarësh, por që edhe pse janë sprovuar në rrugën e Allahut, ata nuk janë dobësuar dhe as nuk janë përulur. Allahu i do durimtarët.
147. Ata nuk kishin fjalë tjetër për të thënë, veç: "O Zoti ynë! Na i fal mëkatet tona dhe lëshimet në veprat tona! Na forco këmbët tona *(në luftë)* dhe na ndihmo kundër popullit jobesimtar!"
148. Allahu u dha atyre shpërblimin e kësaj bote dhe shpërblimin më të mirë të botës tjetër. Allahu i do punëmirët.

Shpjegimi i ajeteve

Këto ajete janë ngushëllim për besimtarët, sidomos për ata që marrin si shembull brezat më të hershëm të besimtarëve, për të vepruar ashtu sikurse ata. Allahu i Lartësuar u tregon besimtarëve se të tilla ngjarje kanë ndodhur vazhdimisht, domethënë që të tilla sprova i kanë kaluar besimtarët e të gjitha kohërave. Ky është një ligj i pandryshueshëm i Allahut të Lartësuar, i Cili thotë:

- "Sa e sa profetë ka patur, me të cilët kanë luftuar së bashku ushtri të mëdha besimtarësh..." - Sa e sa profetë, gjatë gjithë kohërave, janë ndihmuar nga grupe të mëdha besimtarësh, nga ata besimtarë, të cilët u edukuan nga profetët e tyre për besim të sinqertë dhe për vepra të mira. Ata duruan shumë plagë dhe dhimbje në emër të besimit. Megjithatë, Allahu thotë:

"...por që edhe pse janë sprovuar në rrugën e Allahut, ata nuk janë dobësuar dhe as nuk janë përulur." – Pra, zemrat dhe trupat e tyre nuk u dobësuan kurrë. Ato nuk u poshtëruan asnjëherë para armikut të tyre. Përkundrazi, ata bënë durim, qëndruan me trimëri dhe i jepnin zemër e mbështetnin njëri-tjetrin. Më tej, i Madhëruari thotë:

- "Allahu i do durimtarët."

Pastaj Allahu i Lartësuar përmend se si ata i kërkonin me përgjërim Zotit të tyre ndihmën dhe fitoren në luftën e tyre. Thotë i Lartësuar:

- "Ata nuk kishin fjalë tjetër për të thënë, veç: "O Zoti ynë! Na i fal mëkatet tona dhe lëshimet në veprat tona! Na forco këmbët tona *(në luftë)* dhe na ndihmo kundër popullit jobesimtar!" - Shihni me kujdes edukatën e tyre në mënyrën se si i luten dhe i kërkojnë Zotit të tyre. Fillimisht, ata i kërkojnë falje për gabimet dhe për gjynahet e tyre. Ata ishin aq të ditur, sa e kuptuan dhe ishin shumë të sigurt se gabimet dhe gjynahet janë nga shkaqet më të mëdha të dështimit dhe dëshpërimit. Ato janë nga shkaqet më të mëdha që njeriu të meritojë braktisjen dhe ndërprerjen e ndihmës nga Allahu i Urtë dhe i Ditur. Ata e kuptuan se, nëse ruhen nga cilësitë cënuese të devotshmërisë, ky do të ishte një shkak shumë i madh për zbritjen e fitores, ndihmës dhe suksesit. Për këtë arsye, fillimisht, ata i kërkuan Allahut të Lartësuar që t'ua falte ato gabime dhe t'ua mbulonte me mëshirën e Tij. Ata i kërkuan Allahut që ata të mos bëheshin shkak për humbje dhe dështim.

Pastaj, ata nuk u mbështetën thjesht në durimin, forcën, përgatitjen dhe mundin e tyre për të arritur fitoren kundër armikut, por i kërkuan me përgjërim Allahut të Lartësuar që Ai t'u jepte mbështetje dhe fuqi në momentet e takimit të tyre me armikun jobesimtar. Ata e lutën, gjithashtu, Allahun që t'u falte fitoren.

Këto kanë qenë armët e besimtarëve të çdo epoke. Ata kanë ditur të gërshejtojnë durimin dhe qëndrueshmërinë, pendimin e sinqertë dhe kërkimin e faljes, kërkimin e ndihmës dhe lutjen ndaj Allahut për fitoren. Të paktën, ata e kanë ditur që duhet t'i sjellin këto vepra në formën më të bukur, të dashur për Allahun e Lartësuar. Pa dyshim, të tillëve Allahu i Lartësuar u ka rezervuar fitore, ndihmë dhe sukses në të dy jetët. Përfundimi i mirë ka qenë gjithmonë për ta, prandaj thotë i Lartësuari:


- "Allahu u dha atyre shpërblimin e kësaj bote dhe shpërblimin më të mirë të botës tjetër." - Në dynja, Ai u ka dhuruar atyre fitoren, ndihmën dhe pasuri të shumta në luftë e jashtë saj. Ndërsa në ahiret, ata do të fitojnë, duke arritur kënaqësinë e Zotit ndaj tyre. Ata do të jenë mes mirësish, që kurrë nuk do të kërkojnë lodhje e mund për t'u arritur. Të gjitha këto ndodhin sepse ata dinë t'i rregullojnë veprat që do t'i paraqiten Allahut të Lartësuar. Veprat e tyre janë të mira, dhe po kështu është shpërblimi për ta.

Më tej, Allahu i Lartësuar thotë:

- **"Allahu i do punëmirët."** - Allahu i Lartësuar i do ata që janë të pajisur me bamirësi *(iḥsân)* dhe të cilët i kanë të dyja llojet e iḥsânit. Një nga veprat më të mëdha të iḥsânit është lufta kundër armiqve të fesë.

Ajetet 149 – 151

149. O ju që keni besuar! Nëse ju u bindeni jobesimtarëve, ata do t'ju kthejnë prapa, aty ku ishit më parë, dhe atëherë do të jeni të humbur.
150. Allahu është Kujdestari juaj dhe Ai është Ndihmuesi më i mirë.
151. Ne do të mbjellim frikën në zemrat e jobesimtarëve, sepse ata adhurojnë zota të tjerë, veç Allahut, pa pasur asnjë fakt. Vendbanimi i tyre do të jetë Zjarri. Sa i shëmtuar është vendi i zullumqarëve!



Shpjegimi i ajeteve

- "O ju që keni besuar! Nëse ju u bindeni jobesimtarëve, ata do t'ju kthejnë prapa, aty ku ishit më parë, dhe atëherë do të jeni të humbur." - Në këto ajete, Allahu i Lartësuar i ndalon besimtarët që t'u binden qafirëve, të çdo ngjyre e kategorie qofshin ata, idhujtarë apo munafikë. Ai u sqaron atyre se, nëse u binden, le ta dinë se ata synojnë veçse sulmin, shkatërrimin dhe dëmtimin e muslimanëve. Qëllimi final i tyre është kthimi i besimtarëve në qafirë, përfundim ky tejet poshtërues dhe shkak i ndëshkimit të përjetshëm.

Pastaj i Madhëruari tregon se Ai është Ndihmuesi, që kujdeset dhe i ruan besimtarët nga çdo e keqe:

- "Allahu është Kujdestari juaj dhe Ai është Ndihmuesi më i mirë." - Allahu bën të ditur se Ai është Kujdestari dhe Ndihmuesi i vetëm i besimtarëve, me qëllim që ata të mos e kërkojnë ndihmën askund tjetër, por veçse tek Ai. Vetëm Atij duhet t'i drejtohen besimtarët për ndihmë dhe për sukses.

Ky ajet është edhe një përgëzim për ta, që, nëse veprojnë kështu, ndihma dhe përkujdesi i Allahut të Lartësuar do të jetë gjithmonë pranë tyre, me butësi dhe mëshirë. Bujaria e Tij është gjithmonë pranë atyre që i mbështeten dhe që vetëm Atë adhurojnë.

Përkujdesja e Tij nënkupton dhënien e çdo të mire dhe ruajtjen nga çdo e keqe. Sigurisht që kjo është një nxitje e qartë dhe e fortë për ta konsideruar Allahun e Lartësuar si të vetmin të Adhuruar me dashuri, madhërim, bindje dhe përkushtim. Vetëm prej Tij duhet të kërkohet ndihma dhe fitorja. Askush tjetër nuk mund të ofrojë sukses dhe askush nuk mund të ruajë nga dështimi dhe dëshpërimi, përveç Allahut të Lartësuar dhe të Vetëm.

Më pas, i Lartësuari sjell një shembull të përkujdesjes së Tij bujare dhe të posaçme për të zgjedhurit e Tij:

- "Ne do të mbjellim frikën në zemrat e jobesimtarëve..." – Pra, Allahu i Lartësuar përkujdeset për besimtarët e Tij të sinqertë që t'u dhurojë fitoren në luftë, duke futur tmerrin në zemrat e armiqve të tyre. Kjo frikë e madhe i pengon shpesh qafirët të ndërmarrin shumë veprime, që ata synojnë ndaj muslimanëve. Dhe, vërtet, Allahu i Lartësuar e ka dëshmuar këtë të vërtetë gjatë

gjithë kohërave. Për shembull, pasi u larguan nga fushëbeteja e Uhudit, idhujtarët u këshilluan me njëri tjetrin e thanë: "Si po tërhiqemi pas gjithë atyre të vrarëve që u shkaktuam?! Ne nuk duhet të largohemi pa i shfarosur ata plotësisht. Ne duhet të kthehemi sërish!" Kështu, ata e synuan fillimisht një veprim të tillë, por Allahu i Lartësuar futi frikën në zemrat e tyre, prandaj ata nuk guxuan më të vepronin, por u larguan të poshtëruar. Kjo konsiderohet, pa dyshim, një nga ndihmat më të mëdha dhe më të rëndësishme nga Allahu i Lartësuar. Sikurse e kemi thënë edhe më parë, ndihma dhe fitorja që Allahu i Lartësuar u ofron besimtarëve është njëra nga këto dy alternativa: "Kjo, që ta rrënojë një grup të atyre që nuk besojnë, ose për t'i turpëruar ata, që të kthehen pas të dështuar." [Al imran 127]. Në këtë rast, atyre u është dhuruar e dyta.

Pastaj Allahu i Lartësuar na tregon shkakun pse kjo frikë i pushton zemrat e mohuesve të Tij:

- "...sepse ata adhurojnë zota të tjerë, veç Allahut, pa pasur asnjë fakt." - Zemrat e tyre mbushen me frikë, për shkak se ato mbështeten dhe kërkojnë ndihmë nga idhujt e tyre. Ata mbështeten dhe kërkojnë ndihmë e sukses nga gjëra që edhe vetë nuk janë të sigurt për vërtetësinë e tyre, dhe nuk e shpresojnë ndihmën e Mëshiruesit, të Plotpushtetshmit dhe Njëshit në sundimin e Tij. Duke qenë se mbështeten në gjëra të paqena, ata tmerrohen shumë nga besimtarët, sepse forca e tyre buron nga lidhja e ngushtë që ata kanë me Zotin e tyre të vetëm në pushtetin dhe sundimin e Tij. Idhujtarët nuk i mbështet askush, ndërsa besimtarët kanë mbështetjen e Zotit dhe sunduesit të gjithçkaje. Idhujtarët nuk gjejnë mbështetje dhe shpresë në momentet e vështira të jetës së tyre, por gjithmonë janë të mbushur me ankth dhe dëshpërim. Kjo është një nga format e ndëshkimit të tyre që në dynja, ndërsa në ahiret, thotë i Lartësuari:

- "Vendbanimi i tyre do të jetë Zjarri." – Pra, vendi ku do të gjejnë "strehim" dhe nga ku nuk do të dalin më është Zjarri.

- "Sa i shëmtuar është vendi i zullumqarëve!" - Për shkak të padrejtësisë së tyre në të gjitha fushat, Zjarri është qëndrimi dhe "shpërblimi" i tyre i merituesheëm. Për shkak të armiqësisë së tyre ndaj Allahut, Profetit dhe besimtarëve, ata do të jenë në vendin më të keq dhe trishtues.

Ajeti 152

152. Allahu e përmbushi premtimin e Vet ndaj jush, kur, me vullnetin e Tij, ju po i korrnit ata. Por kur ju u dobësuat dhe u përçatë me njëri-tjetrin për çështjen e urdhrit, ju e thyet atë urdhër pasi patë atë që e dëshironit. Pati prej jush që iu pëlqeu kjo jetë, por pati edhe të tjerë prej jush që parapëlqyen botën tjetër. Pastaj, Ai ju bëri të provoni humbjen ndaj tyre, për t'ju sprovuar. Por Allahu, pa dyshim, ju fali ju. Allahu ka mirësi të mëdha për besimtarët.

Shpjegimi i ajetit

- "Allahu e përmbushi premtimin e Vet ndaj jush, kur, me vullnetin e Tij, ju po i korrnit ata..." – Kuptimi: Ai ju ndihmoi që në fillim, duke ju dhënë epërsi të dukshme kundër tyre. Ju filluat t'i korrnit ata me shpatat tuaja. Por kjo ndihmë u ndërpre atëherë kur ju vetë e kërkuat dhe e shkaktuat atë me veprat tuaja.

- "Por kur ju u dobësuat..." – Pra, ishit ju vetë që e shkaktuat humbjen tuaj dhe që e ndihmuat armikun kundër vetes suaj. Me dobësinë tuaj në zbatimin e urdhrit të Profetit dhe në largimin nga harami, ju ulët qëndrueshmërinë tuaj përpara armikut.

- "...dhe u përçatë me njëri-tjetrin për çështjen e urdhrit" - Ata u grindën dhe u përçanë me njëri-tjetrin për një çështje tepër

të rëndësishme, në vend që të ishin të bashkuar. Kështu, disa prej tyre thanë: "Duhet të qëndrojmë në pozicionin ku na vendosi Profeti (a.s.) dhe të mos lëvizim prej tij, sikurse u urdhëruam!" Të tjerët thanë: "Nuk kemi pse të rrimë më këtu, sepse armiku ynë tashmë u mund." Por ky qëndrim i dytë ishte thyerje e një urdhri të rëndësishëm – ashtu siç e konsideron Allahu i Lartësuar – të dhënë nga Profeti (a.s.).

Më tej, Allahu i Lartësuar thotë:

- "...ju e thyet atë urdhër pasi patë atë që e dëshironit." – Kuptimi: Ju e thyet urdhrin, pasi patë atë që e dëshironit (fitoren), ndërkohë që përgjegjësia juaj pas mirësisë së dhuruar nga Allahu i Lartësuar duhej të ishte më e madhe, sepse mirënjohësi duhet të jetë më i bindur se çdokush tjetër.

Mesazhi është shumë i qartë. Për të arritur fitoren dhe për ta ruajtur atë, detyra është gjithmonë e njëjta: Zbatimi i urdhrave të Allahut të Lartësuar dhe të Profetit të Tij ose, me fjalë të tjera, ruajtja e devotshmërisë.

- "Pati prej jush që iu pëlqeu kjo jetë, por pati edhe të tjerë prej jush që parapëlqyen botën tjetër." - Kuptimi: Disa prej jush pëlqyen dynjanë dhe të mirat e saj (plaçkën e luftës). Këta ishin ata që thyen urdhrin e Profetit (a.s.), dhe kjo u solli pasojat që dihen. Megjithatë, pati edhe të tjerë prej jush që dëshiruan ahiretin, pra, shpërblimin e Allahut të Lartësuar të rezervuar për ata që i binden Atij dhe Profetit të Tij, ose për ata që e ruajtën të pacenuar devotshmërinë. Këta ishin ata që iu përmbajtën deri në fund urdhrit të Profetit (a.s.), duke qëndruar të patundur nga pozicionet e tyre, derisa u vranë.

- "Pastaj, Ai ju bëri të provoni humbjen ndaj tyre, për t'ju sprovuar." – Pra, pasi ju vepruat në atë mënyrë, Allahu i Lartësuar e shndërroi epërsinë tuaj në disfatë. Armiqtë filluan të fitonin dhimbshëm kundër jush. Allahu i Lartësuar e bëri këtë si sprovë për ju, që të dallohet qartë besimtari nga qafiri, i binduri nga i pabinduri. Allahu i Lartësuar e bëri, gjithashtu, që t'ju falë gjynahet dhe t'ju mbulojë të metat e gabimet që ju vepruat.


Prandaj thotë i Lartësuari më tej:

- "Por Allahu, pa dyshim, ju fali ju. Allahu ka mirësi të mëdha për besimtarët." - Mirësia e Allahut ndaj tyre ishte shumë e madhe. Së pari, Ai i udhëzoi ata në Islam. Ai i udhëzoi ata të kuptonin dhe të jetonin sipas dispozitave të Tij. Allahu ua mbuloi të metat dhe ua fali gabimet. Ai i shpërbleu ata për veprat e mira, madje edhe për sprovën që i goditi.

Nga mirësitë e mëdha të Allahut të Lartësuar për besimtarët është edhe fakti që të gjitha përcaktimet e Tij për ta janë mirësi dhe në dobi të tyre. Çdo mirësi apo sprovë që i godet besimtarët është në të mirë dhe në dobi të tyre. Nëse u vijnë të mirat, ata, me mirësinë dhe suksesin e dhënë prej Zotit të tyre, tregohen mirënjohës ndaj Tij, dhe kështu fitojnë shpërblimin e madh që Allahu i Lartësuar ka rezervuar për mirënjohësit dhe falënderuesit. E nëse i godet ndonjë sprovë apo fatkeqësi, ata, me suksesin e dhënë prej Zotit të tyre, tregohen të durueshëm, dhe në këtë mënyrë fitojnë shpërblimin që Zoti i tyre ka rezervuar për durimtarët.

Ajetet 153 – 154

153. Kur ju largoheshit e nuk përfillnit asnjë, ndërsa i Dërguari ju thërriste mbrapa, atëherë Allahu ju goditi me dëshpërim pas dëshpërimit, që të mos pikëlloheshit më as për atë që ju shpëtoi e as për atë që ju goditi. Allahu di me hollësi gjithçka që ju veproni.
154. Më tej, pas asaj tronditjeje të rëndë, Ai zbriti mbi ju, sa për qetësim, një dremitje, e cila kaploi një grup prej jush. Kurse një grup tjetër ishte i shqetësuar vetëm për vetveten. Këta menduan ndaj Allahut diçka të padrejtë, mendime injorante. Ata thonin: "Ne nuk kemi në dorë asgjë nga kjo çështje!" Thuaju: "E tërë çështja është


الجزء الرابع سورة آل عمران
ثُمَّ أَنزَلَ عَلَيْكُم مِّنۢ بَعْدِ ٱلْغَمِّ أَمَنَةً نُّعَاسًا يَغْشَىٰ طَآئِفَةً
مِّنكُمْ ۖ وَطَآئِفَةٌ قَدْ أَهَمَّتْهُمْ أَنفُسُهُمْ يَظُنُّونَ بِٱللَّهِ غَيْرَ
ٱلْحَقِّ ظَنَّ ٱلْجَٰهِلِيَّةِ ۖ يَقُولُونَ هَل لَّنَا مِنَ ٱلْأَمْرِ مِن شَىْءٍ ۗ
قُلْ إِنَّ ٱلْأَمْرَ كُلَّهُۥ لِلَّهِ ۗ يُخْفُونَ فِىٓ أَنفُسِهِم مَّا لَا يُبْدُونَ لَكَ ۖ
يَقُولُونَ لَوْ كَانَ لَنَا مِنَ ٱلْأَمْرِ شَىْءٌ مَّا قُتِلْنَا هَٰهُنَا ۗ قُل لَّوْ كُنتُمْ
فِى بُيُوتِكُمْ لَبَرَزَ ٱلَّذِينَ كُتِبَ عَلَيْهِمُ ٱلْقَتْلُ إِلَىٰ مَضَاجِعِهِمْ ۖ
وَلِيَبْتَلِىَ ٱللَّهُ مَا فِى صُدُورِكُمْ وَلِيُمَحِّصَ مَا فِى قُلُوبِكُمْ ۗ
وَٱللَّهُ عَلِيمٌۢ بِذَاتِ ٱلصُّدُورِ ﴿١٥٤﴾ إِنَّ ٱلَّذِينَ تَوَلَّوْا۟ مِنكُمْ
يَوْمَ ٱلْتَقَى ٱلْجَمْعَانِ إِنَّمَا ٱسْتَزَلَّهُمُ ٱلشَّيْطَٰنُ بِبَعْضِ
مَا كَسَبُوا۟ ۖ وَلَقَدْ عَفَا ٱللَّهُ عَنْهُمْ ۗ إِنَّ ٱللَّهَ غَفُورٌ حَلِيمٌ ﴿١٥٥﴾ يَٰٓأَيُّهَا
ٱلَّذِينَ ءَامَنُوا۟ لَا تَكُونُوا۟ كَٱلَّذِينَ كَفَرُوا۟ وَقَالُوا۟ لِإِخْوَٰنِهِمْ إِذَا
ضَرَبُوا۟ فِى ٱلْأَرْضِ أَوْ كَانُوا۟ غُزًّى لَّوْ كَانُوا۟ عِندَنَا مَا مَاتُوا۟
وَمَا قُتِلُوا۟ لِيَجْعَلَ ٱللَّهُ ذَٰلِكَ حَسْرَةً فِى قُلُوبِهِمْ ۗ وَٱللَّهُ يُحْىِۦ
وَيُمِيتُ ۗ وَٱللَّهُ بِمَا تَعْمَلُونَ بَصِيرٌ ﴿١٥٦﴾ وَلَئِن قُتِلْتُمْ فِى سَبِيلِ
ٱللَّهِ أَوْ مُتُّمْ لَمَغْفِرَةٌ مِّنَ ٱللَّهِ وَرَحْمَةٌ خَيْرٌ مِّمَّا يَجْمَعُونَ ﴿١٥٧﴾
٧٠

vetëm në dorë të Allahut!" Ata fshehin në vetvete diçka që ty nuk ta shprehnin. Ata thonin: "Sikur ne të kishim diçka në dorë në këtë çështje, ne nuk do të vriteshim këtu!" Thuaju: "Edhe sikur të ishit në shtëpitë tuaja, ata që do të ishin caktuar të vriteshin, do të shkonin patjetër në vendin ku do të vriteshin." Allahu e bëri këtë që të provonte atë që gjendet në gjoksin tuaj dhe që të shfaqë hapur atë që fshihet në zemrën tuaj. Allahu i di të fshehtat e zemrës.

Shpjegimi i ajeteve

Siç shihet, Allahu i Lartësuar përkujton momentin e humbjes, çastin kur ata shfaqën atë anë të errët të tyre. Allahu i Lartësuar i qorton ata për dobësinë, e cila prej tyre nuk duhej të shfaqej kurrsesi. Kështu, thotë i Lartësuari:

- "Kur ju largoheshit e nuk përfillnit asnjë..." – Kuptimi: Përkujtoni ato momente dobësie kur askush nuk pyeste për asnjë, kur nuk ia hidhnit vështrimin askujt. I vetmi merak i juaji ishte t'ia mbathnit dhe t'i shpëtonit luftës dhe vdekjes. Ndërkohë, në realitet, gjendja nuk ishte kaq e rrezikshme, sepse ju nuk ishit njerëzit më pranë armikut, që të kishit aq frikë. Përkundrazi, më pranë armikut ishte Profeti i Allahut, i cili ju ftoi të ktheheshit në rrugën që ju jep jetë.

- "...ndërsa i Dërguari ju thërriste mbrapa..." - Profeti (a.s.) ju ftonte, duke ju thënë me trimëri dhe vendosmëri: *"Ejani tek unë, o adhuruesit e Allahut!"* Por ju as që e përfillët këtë thirrje, edhe pse e kishit plotësisht mundësinë për t'u përgjigjur. Vetëm largimi juaj nga fushëbeteja do të mjaftonte si gabim i madh. Po të llogarisim edhe thirrjen e Profetit (a.s.), së cilës duhet t'i jepnit përparësi mbi vetet tuaja, atëherë gabimi juaj bëhet edhe më i rëndë.

Prandaj thotë i Lartësuari më tej:

- "...atëherë Allahu ju goditi me dëshpërim pas dëshpërimit..." – Domethënë, që t'ju "shpërblente" për veprën tuaj, Allahu i Lartësuar ju goditi me dëshpërim pas dëshpërimi: dëshpërim për humbjen e luftës, dëshpërim për humbjen e plaçkës së luftës, dëshpërim për dështimin tuaj në qëndresë dhe, në fund, ju goditi me një dëshpërim, që ju bëri të harronit çdo dëshpërim tjetër: dëshpërimin kur dëgjuat se Muhamedi (a.s.) u vra.

Por Allahu i Lartësuar, me butësinë dhe mëshirën e Tij për adhuruesit e Tij besimtarë, të gjitha këto sprova i solli si mirësi për ta, sepse me çdo përcaktim të Tij për besimtarët, Ai synon të mirën e tyre, siç thotë më pas:

- "...që të mos pikëlloheshit më as për atë që ju shpëtoi e as për atë që ju goditi." - Kuptimi: Që të mos trishtoheni për pasuritë dhe fitoren, që ju shpëtuan nga duart. Gjithashtu, të mos trishtoheni për humbjen e thellë, vrasjet dhe plagët e shumta. Kur ju u siguruat që Profeti (a.s.) nuk ishte vrarë, të

gjitha plagët dhe dhimbjet tuaja u qetësuan. Për çdo sprovë dhe fatkeqësi që kaluat, ju u ngushëlluat me praninë e tij (a.s.).

Subhanallah! Sa të shumta janë urtësitë që fshihen në përcaktimin e fatkeqësive dhe sprovave nga Allahu i Lartësuar. Pa dyshim, të gjitha këto urtësi burojnë nga dija absolute e Tij mbi gjithçka. Ai di gjithçka me hollësi për veprat e njerëzve. Ai i njeh të fshehtat dhe të dukshmet e krijesave të Tij, siç thotë më pas:

- "Allahu di me hollësi gjithçka që ju veproni." - Po ashtu, është e mundur që ajeti: "që të mos pikëlloheshit më as për atë që ju shpëtoi e as për atë që ju goditi", të ketë kuptimin se: kjo ngjarje ndodhi që ju të përgatitni dhe stërvitni shpirtrat tuaj për të qenë të durueshëm në çdo fatkeqësi dhe sprovë. Ju kaliteni me anë të sprovave, sepse kështu çdo vështirësi do t'ju duket e përballueshme.

- "Më tej, pas asaj tronditjeje të rëndë, Ai zbriti mbi ju, sa për qetësim, një dremitje, e cila kaploi një grup prej jush." - Pa dyshim, kjo ishte mëshirë e Allahut të Lartësuar për ata, një mirësi e madhe dhe përforcim për zemrat e tyre, sepse dremitja ua shtoi prehjen atyre. Kur njeriu është i frikësuar, atë nuk mund ta zërë gjumi, sepse zemra e tij është e mbushur me frikë, por kur i largohet frika nga zemra, atëherë i vjen gjumi dhe e qetëson.

Njerëzit që Allahu i Lartësuar u bëri mirësi duke u sjellë gjumë çlodhës, ishin pikërisht adhuruesit e Tij të sinqertë, të cilët kishin si të vetmin shqetësim të ndihmonin fenë e Allahut të Lartësuar. Qëllimi i tyre i vetëm ishte kënaqësia e Allahut të Lartësuar dhe bindja ndaj Profetit të Tij. Ata ishin të shqetësuar për çështjen e muslimanëve në tërësi, prandaj nuk mund të qëndronin indiferentë.

- "Kurse një grup tjetër ishte i shqetësuar vetëm për vetveten. Këta menduan ndaj Allahut diçka të padrejtë, mendime injorante." - Ndërsa grupi tjetër mendonte dhe shqetësohej veçse për vetveten. Shkak për këtë ishte ose hipokrizia, ose besimi i dobët i tyre, prandaj ata nuk i zuri ai gjumë i ëmbël dhe qetësues, sikurse ndodhi me grupin e parë. Ata menduan lloj-lloj gjërash për Allahun e Madhëruar dhe nxorën gjithfarë justifikimesh për veten e tyre. Ata thoshin:

- "Ne nuk kemi në dorë asgjë nga kjo çështje!" – Ky qe një lloj justifikimi për dobësinë dhe largimin e tyre nga lufta. Me fjalë të tjera, ata thanë: "Ne nuk mund të bëjmë gjë për të ndihmuar muslimanët të fitojnë." Pra, në këtë mënyrë, ata thjesht treguan mendimin e tyre të keq për Allahun e Lartësuar, për fenë dhe Profetin e Tij. Ata menduan padrejtësisht se Allahu i Lartësuar nuk do ta ndihmonte çështjen e Profetit të Tij. Nën trysninë e frikës, ata menduan se kjo do të ishte goditja përfundimtare kundër fesë së Allahut.

Në përgjigje të tyre, Allahu i Lartësuar thotë:

- "Thuaju: "E tërë çështja është vetëm në dorë të Allahut!"" – Pra, në dorë të Allahut janë të gjitha çështjet, pa përjashtim: çështjet e krijimit dhe përcaktimit të ekzistencës së gjërave, dhe çështjet e dispozitave dhe të ligjeve të Tij për njerëzit. Çdo gjë në këtë ekzistencë ndodh me përcaktimin dhe urtësinë e Allahut. Në ligjet e Tij të padiskutueshme dhe të patjetërsueshme bën pjesë edhe ky ligj madhështor: Fitorja dhe përfundimi i mirë gjithmonë ka për të qenë në anën e të zgjedhurve dhe të të dashurve të Tij, në anën e të bindurve dhe adhuruesve të sinqertë, edhe nëse mund të goditen nga sprova të mëdha.

- "Ata fshehin në vetvete diçka që ty nuk ta shprehnin." – Kuptimi: Munafikët fshehin në zemrat e tyre diçka që nuk ta shfaqin ty.

Pastaj Allahu i Lartësuar na tregon se çfarë mbanin të fshehtë ata në zemrat e tyre:

- "Ata thonin: "Sikur ne të kishim diçka në dorë në këtë çështje, ne nuk do të vriteshim këtu!"" - Kuptimi: Nëse çështja do të na lihej në dorën tonë, pra, nëse do të na merrej mendimi, ne nuk do të vriteshim këtu.

Ky pohim i tyre tregon shumë gjëra. Së pari, ai është refuzim i përcaktimit të urtë të Allahut të Lartësuar, duke menduar që mund ta ndryshonin këtë përcaktim. Së dyti, ata fajësonin dhe nënçmonin vendimin e Profetit (a.s.) dhe të sahabëve për të luftuar në Uhud. Së treti, ai ishte lavdërim për veten e tyre dhe përpjekje për t'i shpëtuar përgjegjësisë. Por Allahu i Lartësuar u ktheu një përgjigje të plotë:

- "Thuaju: "Edhe sikur të ishit në shtëpitë tuaja, ata që do të ishin caktuar të vriteshin, do të shkonin patjetër në vendin ku do të vriteshin."" - Kuptimi: Edhe sikur të ishit në shtëpitë tuaja, shumë larg nga fushëbeteja, ju nuk do mund t'i shpëtoni përcaktimit të të Urtit, sepse asgjë nuk mund ta ndalë dhe ndryshojë përcaktimin e Tij. Vërtet ekziston një lidhje mes shkakut dhe pasojës, por sado i madh të jetë shkaku, nëse bie ndesh me caktimin e Zotit, të shkruar në Leuhi Mahfudh, ai kurrë nuk mund ta sjellë pasojën. Ajo që do të ndodhë ka për të ndodhur sikurse është caktuar nga Allahu i Lartësuar, i Ditur, i Urtë dhe i Drejtë. Jeta dhe vdekja janë të pandashme nga caktimi i Zotit.

Ky përcaktim i të Lartësuarit kishte urtësi të shumta, ndër të cilat:

- "Allahu e bëri këtë që të provonte atë që gjendet në gjoksin tuaj..." – Pra, që Allahu i Lartësuar të provonte besimin, hipokrizinë apo dobësinë e besimit të tyre. Me të tilla përcaktime, del sheshazi besimi i të sinqertëve, hipokrizia e munafikëve dhe dobësia e besimit të disa të tjerëve.

Një urtësi është edhe ajo që tregon vetë Allahu kur thotë:

- "...dhe që të shfaqë hapur atë që fshihet në zemrën tuaj..." - Për të shfaqur qartë vesveset e Shejtanit dhe ndikimin e keq që ato sjellin në personalitetin dhe sjelljet e njerëzve. Në të tilla situata shfaqet gjithçka, madje, çdo aspekt i karakterit dhe i hileve të armikut.

- "Allahu i di të fshehtat e zemrës." - Allahu di gjithçka që qëndron e fshehur në gjoks. Megjithatë, urtësia dhe dija e Tij ka përcaktuar të tilla shkaqe, të cilat nxjerrin në pah çdo të fshehtë që rri në kraharor.

Ajeti 155

155. Vërtet, për sa u përket atyre që u sprapsën prej jush ditën e ndeshjes së dy ushtrive, ishte Shejtani ai që i shtyu të devijonin, po për shkak të disa veprave të tyre. Megjithatë, Allahu ua fali atyre gabimin. Allahu është Falës dhe i Butë.

Shpjegimi i ajetit

- "Vërtet, për sa u përket atyre që u sprapsën prej jush ditën e ndeshjes së dy ushtrive, ishte Shejtani ai që i shtyu të devijonin, po për shkak të disa veprave të tyre." - Allahu i Lartësuar na përshkruan gjendjen e atyre që u mundën në betejën e Uhudit, duke na treguar shkaqet që sollën atë humbje dhe shkaqet që ata u larguan nga fushëbeteja.

Kështu, shkaku i parë për atë humbje ishte Shejtani i mallkuar, i cili arriti të ndikonte mbi ta me mashtrimet e tij. Megjithatë, kjo ndodhi përsëri për shkak të disa gjynaheve të tyre. Pra, ishin vetë ata që, me gjynahet dhe lëshimet e tyre, i krijuan mundësinë të Mallkuarit të ndikonte dhe t'i dëmtonte ata. Duke cenuar *takua*-n, ata i hapën rrugë Shejtanit që të vepronte kundër tyre.

Pa dyshim, gjynahet dhe thyerja e urdhrave që bëjnë ndonjëherë besimtarët janë arma kryesore që Shejtani shfrytëzon kundër tyre. Në të kundërt, nëse adhuruesit do të armatoseshin me bindje të plotë ndaj Allahut, Zotit të gjithësisë, atëherë ai do të ishte i pafuqishëm mbi ta, siç thotë i Lartësuari: "...se ti ndaj robërve të Mi të sinqertë nuk ke kurrfarë fuqie, përveç atyre të humburve që vijnë pas teje. E s'ka dyshim që Xhehenemi është vendi i premtuar për të gjithë ata." [Hixhr 42, 43].

Pastaj i Lartësuari na tregon se Ai i fali besimtarët e sinqertë, pas atij veprimi që meritonte ndëshkim. Nëse do t'i ndëshkonte për atë gjynah, Ai do t'i shfaroste rrënjësisht.

- "Megjithatë, Allahu ua fali atyre gabimin. Allahu është Falës dhe i Butë." - Ai është Falës dhe Mbulues i gjynaheve të robërve të Tij. Prej faljes së Tij, atyre u jepet mundësia të pendohen sinqerisht dhe të kërkojnë falje. Prej kësaj cilësie të Allahut ndodhin edhe fatkeqësitë, që për besimtarin janë falje gjynahesh dhe përmirësim i gjendjes së tij.

Allahu është gjithashtu i Butë. Ai nuk nxitohet të ndëshkojë atë që nuk i bindet, por e afatizon butësisht dhe me mëshirë, duke e nxitur vazhdimisht të pendohet dhe t'i kthehet devotshmërisë. Më pas, nëse robi pendohet dhe ndërron rrugë, Allahu ia pranon pendimin e tij, madje e konsinderon atë sikur të mos kishte gabuar kurrë.

I lavdëruar qoftë i Mëshirshmi, për bujarinë dhe bamirësinë e Tij të pafundme!

Ajetet 156 – 158

156. O ju që keni besuar! Mos u bëni si ata që mohojnë dhe që thonë për vëllezërit e tyre që nisen për rrugë ose për luftë: "Sikur të kishin ndenjur pranë nesh, ata nuk do të vdisnin ose nuk do të vriteshin", që Allahu ta bëjë këtë dëshpërim për zemrat e tyre. Allahu është Ai që jep jetë dhe jep vdekje. Allahu vështron gjithçka që ju bëni.
157. Nëse vriteni ose vdisni në rrugën e Allahut, atëherë falja dhe mëshira prej Allahut janë shumë më të dobishme se ajo që grumbullojnë ata.
158. Nëse vdisni apo vriteni, patjetër që tek Allahu do të mblidheni.

Shpjegimi i ajeteve


- "O ju që keni besuar! Mos u bëni si ata që mohojnë..." - Allahu i Lartësuar i ndalon adhuruesit e tij besimtarë që t'u përgjasojnë mohuesve të Tij, të cilët nuk e besojnë dhe as adhurojnë Zotin e gjithësisë, të cilët nuk e besojnë kaderin e Tij, munafikë qofshin apo të tjerë. Ky ndalim është gjithëpërfshirës, por në mënyrë të veçantë në aspektin vijues:

- "...dhe që thonë për vëllezërit e tyre që nisen për rrugë ose për luftë: "Sikur të kishin ndenjur pranë nesh, ata nuk do të vdisnin ose nuk do të vriteshin" – Kështu thonin ata për vëllezërit e tyre të gjakut apo të fesë, kur niseshin në udhëtim për tregti ose për të luftuar.

- "...që Allahu ta bëjë këtë dëshpërim për zemrat e tyre." – Ata kundërshtonin caktimin e Allahut, a thua se kishin ndonjë mundësi për t'i shpëtuar atij! Ky qe një vetëmashtrim i qartë i tyre, sepse i Lartësuari thotë: "Edhe sikur të ishit në shtëpitë tuaja, ata që do të ishin caktuar të vriteshin, do të shkonin patjetër në vendin ku do të vriteshin!" [Al Imran 154]. Ose: "Kudo që të jeni, vdekja do t'ju kapë, edhe në qofshi në kështjella të fortifikuara mirë." [Nisa 78].

Të mjerët! Nuk donin ta pranonin se ky vetëmashtrim nuk do t'i ndihmonte aspak të shpëtonin nga caktimi dhe gjykimi i drejtë i të Urtit, të Gjithëdijshmit. Të tilla fjalë ishin thjesht burim i dëshpërimit në shpirtin e tyre. Ato e thellonin edhe më shumë fatkeqësinë e tyre.

Ndërsa besimtarët e sinqertë të Allahut e dinë me siguri dhe e pranojnë se çdo gjë vjen veçse me caktimin e Allahut. Ata e dinë se detyra e tyre e vetme është të besojnë dhe ta pranojnë me kënaqësi caktimin e Allahut të



Lartësuar, sepse vetëm në këtë mënyrë Ai do t'i ndriçojë dhe udhëzojë zemrat e tyre dhe do t'i forcojë ata të përballojnë çdo situatë dhe sprovë, sado të rënda qofshin ato.

Pastaj Allahu i Lartësuar i qorton ata duke përmendur disa fakte të padiskutueshme të madhështisë dhe pushtetit të Tij absolut.

- "Allahu është Ai që jep jetë dhe jep vdekje." - Allahu është i vetmi që ka fuqi për një gjë të tillë, ndërkohë që kujdesi i njeriut nuk mund ta ndryshojë aspak kaderin.

- "Allahu vështron gjithçka që ju bëni." - Ai do t'ju shpërblejë sipas punëve apo mohimit tuaj.

Pastaj Allahu i Lartësuar na tregon se martirizimi në rrugën e Tij nuk është diçka negative. Përkundrazi, ai është një gradë e lartë për të cilin duhet garuar, sepse është një shkak për faljen dhe mëshirën e Allahut. Martirizimi në rrugën e Tij është shumë herë më i mirë se ajo që grumbullojnë adhuruesit e dynjasë prej saj, siç thotë i Lartësuari:

- "Nëse vriteni ose vdisni në rrugën e Allahut, atëherë falja dhe mëshira prej Allahut janë shumë më të dobishme se ajo që grumbullojnë ata."

- "Nëse vdisni apo vriteni, patjetër që tek Allahu do të mblidheni." - Pastaj krijesat, në çfarëdo lloj mënyre të vdesin, kthimin e tyre do ta kenë gjithmonë tek Allahu i Lartësuar. U vrave në luftë apo vdiqe në shtrat, tek Allahu i Lartësuar do të shkosh dhe Ai do të të llogarisë për veprat që ke bërë. Si mund të shpëtosh a të fshihesh prej Allahut? E pra, për krijesat nuk ka shpëtim tjetër, por veçse të kapen fort për litarin e Allahut të Lartësuar dhe të qëndrojnë palëkundur në rrugën e Tij.

Ajeti 159

159. Me mëshirën që të dhuroi Zoti yt, ti ishe i butë ndaj atyre. Sikur të ishe i vrazhdë e zemërgur, ata do largoheshin prej teje. Fali ata dhe kërko ndjesë për ta! Konsultohu me ta për të gjitha çështjet, e kur të vendosësh, atëherë mbështetju Allahut! Allahu, pa dyshim, i do ata që i mbështeten Atij.

Shpjegimi i ajetit

- "Me mëshirën që të dhuroi Zoti yt, ti ishe i butë ndaj atyre." – Kuptimi: Nga mëshira e Allahut të Lartësuar për ty dhe për shokët e tu, është edhe butësia që Ai të dhuroi ty. Me mëshirën e Zotit tënd, ti, o Muhamed, u pajise me virtytet më të mira, dhe për këtë shkak, njerëzit të duan, janë mbledhur të gjithë rreth teje dhe zbatojnë gjithçka që ti u urdhëron.

- "Sikur të ishe i vrazhdë e zemërgur, ata do largoheshin prej teje." – Pra, nëse do të ishe me moral të ulët dhe i ashpër, ata do të largoheshin prej teje, sepse është normale që

njerëzit të largohen për shkak të cilësive të tilla.

Morali i keq i largon njerëzit dhe ngjall urrejtjen e tyre. Morali i mirë i udhëheqësit të fesë është një faktor shumë i fortë që tërheq njerëzit në fenë e Allahut të Lartësuar dhe ua bën atë të dashur, pa përmendur këtu gradën e lartë tek Allahu i Lartësuar. Ndërsa morali i keq, nga ana tjetër, i udhëheqësit të fesë është shkak shumë i fortë që i largon njerëzit nga feja e Allahut të Lartësuar dhe ua bën atë shumë të urryer, pa përmendur ndëshkimin e merituar që e pret atë personalisht prej Allahut të Drejtë dhe Madhështor.

Mendoje pak mirë! Kur Allahu i Lartësuar i drejtohet në këtë mënyrë Profetit të Tij, që ishte i ruajtur nga çdo cilësi e ulët, çfarë mund të thuash për të tjerët?! A nuk del si detyra më urgjente që ne të pajisemi me moral të lartë, që t'i trajtojmë njerëzit me mënyrën më të bukur, siç na ka mësuar Profeti i Zotit, mësuesi ynë më i madh?! Pa dyshim, butësia, toleranca, falja, morali i mirë, bashkimi i radhëve dhe afrimi i zemrave, duke zbatuar urdhrat dhe porositë e Allahut të Lartësuar, si edhe afrimi i njerëzve në fenë e Allahut të Lartësuar, duhet të jenë synimet tona më të rëndësishme.

Pastaj Allahu i Lartësuar e urdhëron Profetin e Tij që të jetë falës dhe tolerant ndaj besimtarëve:

- "Fali dhe kërko ndjesë për ta!" - Tregohu falës dhe tolerant ndaj mangësive dhe dobësive të tyre në adhurimet ndaj Allahut të Lartësuar.

Kjo është një porosi e vyer për të patur dy cilësi të mrekullueshme: faljen dhe bamirësinë.

- "Konsultohu me ta për të gjitha çështjet..." - Këshillohu me ata për çështjet që kërkojnë mendim më të gjerë.

Këshillimi me të tjerët ka dobi të mëdha, qoftë për çështjet e fesë, qoftë për çështjet e dynjasë. Së pari, ai është respekt i ndjenjave dhe personalitetit të tyre. Së dyti, ai largon dilemat ku zakonisht bien njerëzit, kur janë në situata të vështira. Nëse në gjendjet e jashtëzakonshme, udhëheqësi mbledh elitën e vendit dhe fillon me ta një diskutim dhe këshillim të sinqertë, kjo do të qetësojë dhe kënaqë zemrat e tyre dhe, rrjedhimisht, ata do ta duan dhe respektojnë atë. Ky gjest tregon se ai nuk është një tiran apo sundimtar arrogant dhe egoist, por tregon se ai shqetësohet dhe interesohet për dobinë e përgjithshme dhe zgjidhjen më të mirë të mundshme. Rezultat tjetër është që ata, me bindje dhe respekt, do të shpenzojnë të gjitha energjitë dhe vlerat e tyre për të ekzekutuar urdhrat e tij, sepse e shohin që ai synon dobinë dhe rregullimin e përgjithshëm. Ndërsa kur udhëheqësi nuk është i tillë, nuk mund të shpresojë se do të gëzojë dashurinë e pastër dhe bindjen e plotë të vartësve të tij.

Duke u këshilluar, ndriçohet mendja, sepse kështu përdoret pikërisht në fushën për të cilën është krijuar. Sa më shumë mendje dhe aftësi gjykuese të hyjnë në përdorim, aq më e mirë është zgjidhja që jepet. Këshillimi sjell zgjidhje më të sigurta dhe më të pranueshme për çështjet e rëndësishme dhe të koklavitura. Duke këqyrur të gjitha aspektet e çështjes, njeriu që kërkon këshillë nuk del kurrë i i humbur. Ai rrallë mund të gabojë në veprat e tij. Por edhe nëse dështon apo gabon, ai nuk do të qortohet nga populli dhe inteligjenca e vendit, sepse vendimet janë marrë bashkarisht dhe të diskutuara hollësisht mes tyre.

Nëse Allahu i Lartësuari i drejtohet me një porosi të tillë Profetit të Tij, njeriut me dijen më të gjerë, me gjykimin më të plotë dhe me zgjedhjen më të saktë, atëherë ç'mund të mendohet për të tjerët poshtë tij? Porosia: "Konsultohu me ta për të gjitha çështjet" duhet të qëndrojë para çdo udhëheqësi si detyra më kryesore.

Pastaj i Lartësuari thotë:

- "...e kur të vendosësh, atëherë mbështetju Allahut! Allahu, pa dyshim, i do ata që i mbështeten Atij." – Kuptimi: Kur të marrësh vendimin përfundimtar, pas këshillimit me këshilltarët, atëherë mbështetju Allahut për realizimin e vendimit. Mbështetu plotësisht në ndihmën dhe suksesin e Allahut, duke u distancuar plotësisht nga mundësitë dhe forcat e tua. Pra, kërkoje suksesin veç nga Allahu i Plotpushtetshëm, që është i Vetmi në dorën e të Cilit është ndihma dhe suksesi. Aq më tepër që Allahu i Lartësuar i do ata të cilët i mbështeten Atij dhe drejtohen tek Ai për të gjitha çështjet e tyre.

Ajeti 160

160. Nëse ju ndihmon Allahu, atëherë nuk ka kush që mund t'ju mposhtë. Por nëse Ai ju lë pa ndihmë, atëherë kush është ai që mund t'ju ndihmojë? Pra, vetëm Allahut le t'i mbështeten besimtarët!

Shpjegimi i ajetit

- "Nëse ju ndihmon Allahu, atëherë nuk ka kush që mund t'ju mposhtë. Por nëse Ai ju lë pa ndihmë, atëherë kush është ai që mund t'ju ndihmojë?" – Kuptimi: Nëse Allahu i Lartësuar ju jep fitoren dhe ndihmën e Tij, atëherë askush nuk mund t'ju mposhtë, edhe sikur të mblidheshin kundër jush të gjithë njerëzit, nga të gjitha skajet e globit, me të gjitha përgatitjet dhe arsenalin e tyre ushtarak, mendor, fizik etj., sepse askush nuk mund ta mposhtë Zotin e gjithësisë. Si mund të mendohet diçka e tillë, kur Ai është Sunduesi i botëve dhe të gjitha krijesat janë në dorë të Tij. Asnjë krijesë nuk mund të lëvizë dhe nuk mund të rrijë në prehje pa lejen e Tij. Nëse Allahu ju braktis dhe ju mbështeteni thjesht në forcat tuaja, dështimi është i padiskutueshëm, edhe nëse ju ndihmojnë të gjitha krijesat.

- "Pra, vetëm Allahut le t'i mbështeten besimtarët!" – Këtu urdhërohet që, ndihmën, fitoren dhe mbështetjen ta kërkojmë vetëm tek Allahu i Lartësuar, duke u larguar nga mbështetja thjesht në forcat dhe aftësitë tona. Sigurisht që duhet të japim maksimumin e vlerave dhe mundësive tona, por ndihmën dhe fitoren ta kërkojmë prej të Diturit, të Urtit, Krenarit, të Plotpushtetshit, prej Allahut të Lartësuar. Pra, vetëm Allahut të Lartësuar t'i mbështetemi dhe t'i kërkojmë ndihmë, fitore dhe sukses, e askujt tjetër, sepse dihet shumë mirë se, Ndihmuesi, Dhuruesi i fitores dhe suksesit është Allahu i Vetëm dhe i Pashoq në pushtetin dhe sundimin e Tij. Vetëm me *teuhid* mund të arrihet qëllimi. Mbështetja te dikush tjetër veç Allahut konsiderohet *shirk,* i cili nuk i sjell asnjë dobi atij që e vepron, përkundrazi, vetëm e dëmton.

Nga ky ajet kuptohet, gjithashtu, se në varësi të gjendjes së besimit tek Allahu i Lartësuar, do të jetë edhe shkalla e mbështetjes tek Ai.

Ajeti 161

161. Nuk mund të ndodhë që një profet të bëjë përvetësim me anë të mashtrimit (*el ĝulûlu*). Kush bën përvetësim me anë të mashtrimit, Ditën e Kijametit do të vijë i ngarkuar me atë që ka bërë. Çdo njeriu do t'i jepet ajo që vetë e ka fituar, pa iu bërë asnjë lloj padrejtësie.

Shpjegimi i ajetit

El ĝulûlu quhet fshehja e një sendi prej plaçkës së luftës, me qëllim për ta përvetësuar atë, ose përvetësim i çdo lloji pasurie me anë të mashtrimit. Kjo vepër është haram, dhe për këtë nuk ka asnjë kundërshtim, madje konsiderohet si një prej gjynaheve të mëdha, sikurse dëshmon ky ajet dhe tekste të tjera.

Këtu Allahu i Lartësuar na tregon se përvetësimi i pasurisë me anë të mashtrimit nuk mund të jetë kurrë vepër e profetëve. Kurrë nuk mund të mendohet se një profet mund t'i afrohej një vepre të tillë, e cila – siç

u tha – konsiderohet një nga gjynahet e mëdha dhe të turpshme. Allahu i Lartësuar i ruajti profetët e Tij nga çdo ves që cenonte personalitetin e tyre dhe i bëri ata njerëzit me moralin më të mirë e me shpirtin më të pastër. Ata ishin të ruajtur nga çdo mangësi. E si të mos ndodhte kështu, kur ata ishin mbartësit e shpalljeve të Zotit të gjithësisë?! Profetët ishin thesare të mbushur me urtësitë e Zotit të gjithësisë.

Në një ajet kur'ânor thuhet: "Allahu e di shumë mirë se kujt ia jep profetësinë." Nuk ka nevojë për shumë argumente për të hedhur poshtë shpifjet që armiqtë e profetëve trillojnë kundër tyre, por mjafton vetëm fakti se Ai që i zgjodhi ata ishte vetë Zoti i Plotfuqishëm, i Gjithëditur dhe i Urtë. Mjafton, gjithashtu, që të njohësh diçka të vërtetë rreth virtyteve të profetëve, për të gjykuar rreth pastërtisë së tyre në çdo aspekt tjetër. Për këtë arsye, kur flet për pacenueshmërinë e tyre, Allahu i Lartësuar përdor një formulim gjuhësor që tregon se është e pamundur që veprime të tilla t'i bëjë një profet i Zotit. Ai thotë:

- "Nuk mund të ndodhë që një profet të përvetësojë diçka me anë të mashtrimit." – Pra, është e pamundur që një profet të bëjë *ĝulûl*, sepse Ai që e zgjodhi për të qenë profet është Allahu i Lartësuar.

Pastaj Allahu i Lartësuar tregon ndëshkimin për ata që e kryejnë një veprim të tillë:

- "Kush përvetëson diçka me anë të mashtrimit, Ditën e Kijametit do të vijë i ngarkuar me atë që ka bërë." – Domethënë, do të vijë Ditën e Gjykimit i ngarkuar në shpinën e tij me plaçkën që ka marrë pa të drejtë, çfarëdo qoftë ajo: kafshë, send etj. Ky do të jetë ndëshkim dhe vuajtje për të në Ditën e Gjykimit.

- "Çdo njeriu do t'i jepet ajo që vetë e ka fituar..." - Çdokush do të shpërblehet për gjërat që ka kryer, të mira apo të këqija qofshin ato; do të 'shpërblehet' edhe ai që ka bërë *gulul*. Secili do të marrë shpërblimin ose ndëshkimin e merituar. Askujt nuk do t'i bëhet padrejtësi. Askujt nuk do t'i shtohen të këqijat dhe askujt nuk do t'i pakësohen të mirat që i meriton.

Shihni se sa i kujdesshëm është formulimi i këtij ajeti, me kuptim aq të qartë. Kur Allahu i Lartësuar foli për ata që përvetësojnë pasuri me anë të mashtrimit, tha se ata do të ndëshkohen me drejtësi Ditën e Gjykimit për gjynahun e tyre, por kjo mund të kuptohej gabimisht se vetëm ata do ta 'paguajnë' me drejtësi atë që kanë bërë, ndërsa të tjerët jo. Pra, për të larguar këtë keqkuptim, Allahu i Lartësuar sjell një gjykim më të përgjithshëm, që tregon se kjo llogaridhënie e drejtë, një për një, është e vlefshme dhe do të zbatohet për të gjithë, domethënë:

- "...pa iu bërë asnjë lloj padrejtësie."

Ajetet 162 – 163

162. A është i njëjtë ai që i bindet Allahut dhe që kërkon kënaqësinë e Tij, me atë që meriton veç zemërimin e Allahut dhe që e ka të ardhmen në Xhehenem, i cili është përfundimi më i keq?!
163. Ata kanë dallim tek Allahu. Allahu sheh se çfarë veprojnë.

Shpjegimi i ajeteve

- "A është i njëjtë ai që i bindet Allahut dhe që kërkon kënaqësinë e Tij, me atë që meriton veç zemërimin e Allahut dhe që e ka të ardhmen në Xhehenem, i cili është përfundimi më i keq?!" - Allahu i Lartësuar na tregon se tek Ai nuk konsiderohen njëlloj, si ai që synon kënaqësinë e Tij dhe punon për këtë qëllim, edhe ai që është zhytur në gjynahe dhe bën vepra që e zemërojnë të Madhëruarin. Këta nuk mund të jenë të barabartë në gjykimin e Allahut. Urtësia dhe drejtësia e Allahut të Lartësuar nuk e lejon që ata të konsiderohen dhe të

shpërblehen njëlloj. Madje edhe logjika e shëndoshë njerëzore nuk e pranon shenjën e barazimit mes këtyre dy kategorive në gjykim dhe shpërblim.

Ja se si thotë i Lartësuari në disa ajete të tjera kur'ânore:

"A mos është një besimtar njëlloj me atë që ndodhet jashtë rrugës? Jo, këta nuk janë të barabartë. Për sa u përket atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, ata, për hir të veprave që bëjnë, kanë si vendpritje Xhenetin. Ndërsa ata që nuk e respektojnë Allahun, kanë si skutë të tyre Zjarrin. Sa herë që do të tentojnë të dalin nga ai, do të kthehen sërish brenda dhe do t'u thuhet: "Shijojeni dënimin e Zjarrit, që ju e konsideronit gënjeshtër". [Sexhde 18 -20].

"Mos vallë, Ne do t'i konsiderojmë zullumqarët të barabartë me muslimanët?! Ç'është kështu me ju? Si gjykoni në këtë mënyrë?! A mos keni ndonjë libër *(prej Zotit),* nga ku mësoni se ju do të keni atje çfarë të dëshironi?! A mos keni marrë ndonjë zotim prej Nesh deri në Kijamet, se ju do ta arrini atë që mendoni dhe dëshironi?!" [Kalem 35-39].

"Ne nuk e krijuam qiellin, tokën dhe çfarë gjendet mes tyre pa një qëllim. Kështu mendojnë ata që nuk besojnë. Mjerë për jobesimtarët në Zjarr! Vallë, a mos do t'i barazojmë ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira me ata që bëjnë shkatërrime në tokë, apo, vallë, do t'i konsiderojmë njësoj, si të ruajturit prej të këqijave, si ata që bëjnë gjynahe?!" [Sad 27, 28].

Pastaj thotë i Lartësuari:

- "Ata kanë dallim tek Allahu." - Të gjithë këta janë me grada të ndryshme tek Allahu i Lartësuar, në varësi të punëve që bëjnë. Ata që ndjekin udhëzimin e drejtë, për kënaqësinë e Allahut të Lartësuar, dhe që rendin të arrijnë gradat e larta dhe shtëpitë e mrekullueshme në Xhenet, ata kanë për të marrë si dhuratë nga Allahu i Lartësuar shumë mirësi të Tij, në varësi të veprave që kryejnë në këtë dynja. Ndërsa ata që ndjekin rrugët të cilat zemërojnë Allahun e Lartësuar, ata janë duke rendur drejt shtresave më të ulëta të Xhehenemit, në varësi të veprave që po kryejnë.

Këtu duhet kujtuar vazhdimisht se Ai që i vështron, regjistron dhe i gjykon veprat e njerëzve është Allahu i Lartësuar, i Gjithëditur dhe i Drejtë:

- "Allahu sheh se çfarë veprojnë." - Ai vështron gjithçka që bëjnë ata. Atij nuk i fshihet asgjë nga veprat e tyre. Allahu është i Gjithëdituri, i Cili i di ato imtësisht dhe i ka shkruar në *Leuhi Mahfudh*. Përveç kësaj, Ai ka ngarkuar disa nga engjëjt e Tij, të cilët janë besnikë në detyrën e ngarkuar, që të shkruajnë me përpikmëri çdo vepër të robërve të Tij.

Ajeti 164

164. Është e vërtetë se Allahu u ka falur besimtarëve një mirësi të madhe, kur ndër ta dhe nga mesi i tyre, ai dërgoi një Pejgamber, që t'u lexonte argumentet e Tij, që t'i dëlirësonte dhe që t'u mësonte Librin dhe Urtësinë, ndërkohë që më parë ata ishin krejtësisht të humbur.

Shpjegimi i ajetit

- "Është e vërtetë se Allahu u ka falur besimtarëve një mirësi të madhe, kur ndër ta dhe nga mesi i tyre, ai dërgoi një Pejgamber..." - Kjo është mirësia më e madhe që Allahu i Lartësuar u ka dhuruar adhuruesve të Tij. Me dërgimin e Pejgamberit, Allahu i Lartësuar i shpëtoi ata nga humbja dhe shkatërrimi. Ata e njihnin shumë mirë prejardhjen, cilësitë dhe gjuhën e tij. Ai ishte nga populli i tyre, madje nga fisi më i nderuar ndër ta. Ai synonte të mirën dhe ishte i butë me ta.

- "...që t'u lexonte argumentet e Tij, që t'i dëlirësonte..." - Pejgamberi u lexonte me besnikëri ajetet e Allahut, u mësonte leximin e fjalëve të Kur'ânit dhe u sqaronte kuptimin e tyre. Veç kësaj, Pejgamberi i largonte e i

pastronte ata nga idhujtaria, gjynahet, mosbindja, injoranca dhe nga cilësitë e këqija.

- "...dhe që t'u mësonte Librin dhe Urtësinë..." - Pejgamberi u mësoi atyre Librin. Fjala 'libër' këtu mund të nënkuptojë Kur'ânin ose aftësinë e të shkruarit.

Nëse nënkupton Kur'ânin, atëherë shprehja "argumentet e Tij" në ajet iu referohet shenjave dhe argumenteve të Allahut të Lartësuar, që gjenden në gjithësinë e krijuar nga Ai.

Por fjala 'libër' (*kitab*) mund të ketë edhe kuptimin "shkrim". Nëse ka këtë kuptim, atëherë Allahu i Lartësuar u kujton besimtarëve mirësinë që u ka bërë duke u mësuar atyre shkrimin, nëpërmjet të cilit ruhen dhe transmetohen të gjitha njohuritë.

Pejgamberi u mësoi gjithashtu Urtësinë (*el ĥikmete*). Edhe kjo fjalë ka dy kuptime:

1. Suneti ose Tradita profetike, nëpërmjet së cilës kuptohet dhe qartësohet Kur'âni. Pra, 'Urtësi' quhet në këtë rast çdo gjë që i është shpallur Profetit (a.s.), përveç Kur'ânit.

2. Urtësia ose aftësia për të gjykuar drejt dhe për të vendosur çdo gjë në vendin që i takon. Kjo aftësi mund të arrihet veçse duke njohur fshehtësitë dhe hollësitë e Sheriatit.

Pra, Pejgamberi u mësoi besimtarëve ligjet e Zotit, tekstet prej të cilave nxirren ligjet e Zotit dhe Urtësia, nëpërmjet së cilës kuptohen mësimet e fjalëve të Zotit.

Pa dyshim, brezi i parë në mënyrë të veçantë dhe i tërë umeti në përgjithësi, arritën gradat më të larta të urtësisë. Ata u ngritën mbi të gjitha krijesat dhe meritojnë të quhen dijetarë dhe edukatorë të njerëzimit. Sigurisht që ky ishte sukses i dhuruar nga Allahu i Lartësuar, sidomos kur mendon se si ishin përpara Islamit, sikurse thotë i Lartësuari:

- "...ndërkohë që më parë ata ishin krejtësisht të humbur." – Pra, para shfaqjes së Profetit, ata ishin në humbje të qartë. Ata nuk e njihnin rrugën e Zotit të tyre. Ata nuk dinin se çfarë i pastronte shpirtrat e tyre dhe çfarë i lartësonte ata. Ata bënin thjesht vepra që ua kërkonte e zbukuronte nefsi dhe dëshirat e tyre të çekuilibruara. Çfarë u shkonte pas oreksit, ata e kryenin, edhe nëse ishte kundër logjikës së të gjithë botës.


Ajetet 165 – 168

165. "Kur ju kaluat një disfatë, të cilën ju ia patët shkaktuar më parë dyfish armikut tuaj, thatë: "Si ndodhi kjo?" Thuaj: "Ajo ndodhi nga vetë ju!" S'ka dyshim se Allahu është i Plotfuqishëm për gjithçka.
166. Ajo që ju goditi ditën e ballafaqimit të dy grupeve ndodhi me lejen e Allahut, për t'u dalluar besimtarët e sinqertë
167. dhe për t'u bërë e qartë se cilët ishin munafikët, të cilëve iu tha: "Ejani e luftoni në rrugën e Allahut ose për të mbrojtur veten!" Por ata thanë: "Sikur ta dinim se do të bëhej luftë, ne do të vinim pas jush!" Në atë moment, ata ishin më afër mosbesimit se besimit. Ata thonin me gojën e tyre gjëra që nuk i kishin në zemrën e tyre, por Allahu e di shumë mirë se çfarë fshehin në kraharorët e tyre.
168. Atyre që nuk luftuan dhe që u thanë vëllezërve të tyre: "Sikur ata të na dëgjonin ne, nuk do të vriteshin", thuaju: "Largojeni vdekjen prej vetes suaj, nëse qenkeni kaq të sigurt?"

Shpjegimi i ajeteve

- "Kur ju kaluat një disfatë, të cilën ju ia patët shkaktuar më parë dyfish armikut tuaj..." - Ky qe një ngushëllim nga Allahu i Lartësuar për të qetësuar adhuruesit e Tij të sinqertë, pas humbjes së dhimbshme në Uhud, ku u vranë rreth shtatëdhjetë vetë prej tyre. Për këtë arsye, Allahu i Lartësuar u kujtoi besimtarëve dhimbjet që ata u kishin shkaktuar armiqve të tyre në Bedër, ku vranë shtatëdhjetë vetë prej krerëve të kufrit dhe robëruan shtatëdhjetë të tjerë.

Kështu, kuptimi i ajetit është: Le të qetësohen zemrat tuaja dhe të mos ju duket shumë e rëndë kjo fatkeqësi. Pastaj, kujtoni



edhe diçka tjetër, që duhet t'ju lehtësojë krejt: ju dhe ata nuk jeni kurrë njëlloj në humbjet që ju godasin, sepse të vrarët tuaj janë tashmë në Xhenet, ndërsa të vrarët e tyre përfundojnë në Zjarr.

- "...thatë: "Si ndodhi kjo?" Thuaj: "Ajo ndodhi nga vetë ju!"" – Ata pyetën se nga u erdhi ajo goditje. Përse kjo humbje e tillë? Allahu i Lartësuar u dha përgjigjen dhe u qartësoi se shkaku ishin ata vetë dhe veprat e tyre. Humbja filloi kur ata nisën të diskutonin dhe kundërshtonin urdhrin e Profetit (a.s.), edhe pse po e shihnin me sy atë që aq shumë e dëshironin (fitoren).

Pra, Allahu u thotë: Kthejuni vetes suaj me autokritikë dhe me kërkesë llogarie të imët. Jini të kujdesshëm nga çdo gjë që shkakton humbje dhe shkatërrim. Për asnjë moment mos harroni se:

- "S'ka dyshim se Allahu është i Plotfuqishëm për gjithçka." – Kini kujdes që kurrë të mos mendoni për Allahun e Lartësuar ndonjë gjë të keqe. Të jeni të sigurt se Ai është i Plotfuqishëm për t'ju ndihmuar dhe për t'ju dhuruar fitoren. Por Ai është Absolut në urtësinë e Tij të madhe për gjithçka që përcakton t'ju godasë. Pas çdo sprovë dhe fatkeqësie, fshihet urtësia e Tij madhështore. Kështu, në një sure tjetër, i Plotpushtetshmi thotë: "Kur të ndesheni me jobesimtarët, goditini në qafë derisa t'i shkatërroni, dhe pastaj lidhini fort. E më pas, ose lirojini falas ose kundrejt pagesës, për aq kohë sa lufta vazhdon. Kështu bëni! Por sikur të dëshironte Allahu, do t'ju dhuronte fitoren ndaj tyre, por Ai deshi t'ju sprovonte njëri me tjetrin. Atyre që ranë dëshmorë në rrugën e Allahut, Ai nuk ua humb kurrsesi veprat. Ai do t'i udhëzojë ata dhe do t'ua përmirësojë gjendjen." [Muhamed 4, 5].

- "Ajo që ju goditi ditën e ballafaqimit të dy grupeve ndodhi me lejen e Allahut..." – Kështu, i Lartësuari tregon se humbja e madhe që i goditi besimtarët në luftën e Uhudit ndodhi me vullnetin dhe përcaktimin e Tij. Përcaktimi i Zotit është i padiskutueshëm dhe i pakthyeshëm, pandaj nuk mbetet gjë tjetër, por veçse t'i dorëzohesh dhe ta pranosh atë i kënaqur. Besimtarët duhet ta dinin se pas ngjarjes fshiheshin urtësi dhe dobi të shumta, ndër të cilat:

- "...për t'u dalluar besimtarët e sinqertë dhe për t'u bërë e qartë se cilët ishin munafikët" – Pra, për t'u dalluar qartë besimtarët e sinqertë nga munafikët shtiracakë, sepse në të tilla sprova, munafikët shfaqin fytyrën e tyre të vërtetë.

- "...të cilëve iu tha: "Ejani e luftoni në rrugën e Allahut ose për të mbrojtur veten!"" - Atyre iu tha: "Ejani të luftoni në rrugën e Zotit, për të mbrojtur fenë dhe për të kërkuar kënaqësinë e Tij! Ose, së paku, ejani dhe mbroni familjet, pasurinë dhe vendin tuaj, nëse nuk keni ndonjë qëllim më

të lartë!" Por ata e hodhën poshtë këtë ftesë, duke thënë:

- "Sikur ta dinim se do të bëhej luftë, ne do të vinim pas jush!" – Pra, thanë: "Nëse do ta dinim se do të zhvillohej luftë mes jush, me siguri që do të vinim, por ne menduam se nuk do të bëhej luftë". Ata sigurisht që gënjenin, sepse e dinin mirë që do të bëhej luftë, madje luftë e ashpër. Idhujtarët ishin të mbushur plot urrejtje dhe dëshirë për hakmarrje kundër muslimanëve, për humbjen që kishin pësuar në Bedër. Ata kishin shpenzuar të gjitha forcat njerëzore dhe financiare që zotëronin. Atëherë, si mund të mendohej se mes tyre nuk do të zhvillohej luftë?! Aq më tepër që besimtarët dolën në pritje të tyre. Ky justifikim i sjellë nga munafikët ishte qesharak, dhe të mjerët menduan se ai do të ishte i pranueshëm për besimtarët.

Por çfarë thotë i Gjithëdijshmi për ta?!

- "Në atë moment, ata ishin më afër mosbesimit se besimit." – Pra, në atë gjendje, kur nuk dolën me besimtarët, ata ishin më pranë kufrit se besimit.

- "Ata thonin me gojën e tyre gjëra që nuk i kishin në zemrën e tyre..." - Kjo është cilësi e përhershme e munafikëve. Ata gjithmonë thonë me gojë gjëra që nuk i kanë në zemër. Fjalët dhe veprat e tyre, në dukje, janë të bukura dhe tërheqëse për zemrat, por ato që fshehin brenda janë ndryshe. E tillë konsiderohet edhe thënia e tyre: "Sikur ta dinim se do të bëhej luftë, ne do të vinim pas jush!", sepse ata e dinin shumë mirë që lufta ishte e pashmangshme

Ky ajet mbështet saktësinë e parimit në Islam, që thotë: "Lejohet të kryhet një vepër me dëm më të vogël, për t'ju ruajtur një dëmi më të madh. Po ashtu, është detyrë të kryesh punën me dobi më të vogël, nëse nuk mundesh të kryesh atë me dobi më të madhe." Arsyeja është se munafikët u urdhëruan fillimisht që të luftonin për të mbrojtur fenë, por kur nuk e bënë këtë, atëherë u urdhëruan që të luftonin për të mbrojtur familjet, pasurinë dhe vendin e tyre.

- "...por Allahu e di shumë mirë se çfarë fshehin në kraharorët e tyre." - I Gjithëdituri ua shfaq këto të fshehta adhuruesve të Tij besimtarë, ndërsa për munafikët ka përgatitur një dënim të dhembshëm.

Pastaj i Madhëruari thotë:

- "Atyre që nuk luftuan dhe që u thanë vëllezërve të tyre: "Sikur ata të na dëgjonin ne, nuk do të vriteshin"" – Kështu, munafikët kryen njëherazi dy vepra të këqija: së pari, ata dezertuan, duke refuzuar luftën në rrugë të Allahut dhe, së dyti, kundërshtuan gjykimin e Allahut të Lartësuar dhe mohuan përcaktimin e Tij. Këtyre, Allahu i Lartësuar u ktheu si përgjigje një kërcënim të ashpër:

- "...thuaju: "Largojeni vdekjen prej vetes suaj, nëse qenkeni kaq të sigurt?" – Kuptimi: Nëse jeni të sigurt se mund t'i shpëtoni vdekjes me masat që mund të ndërmerrni, atëherë ndalojeni vdekjen kur ajo t'ju gllabërojë. Pa dyshim që ju jeni të pafuqishëm për diçka të tillë.

Këto ajete dëshmojnë se tek një njeri mund të rrinë bashkë cilësi të besimit me cilësi të kufrit, dhe është e mundur që ai të jetë me pranë njërës cilësi sesa tjetrës.

Ajetet 169 – 171

169. Kurrë mos thoni: "janë të vdekur" për ata që bien dëshmorë në rrugën e Allahut. Përkundrazi, ata janë të gjallë tek Zoti i tyre, duke u ushqyer.
170. Ata janë të gëzuar me atë që u ka dhënë Allahu nga të mirat e Tij. Ata përgëzojnë të tjerët, që ende nuk u janë bashkuar radhëve të tyre, se për ta nuk do

të ketë as frikë dhe as nuk kanë pse të brengosen.
171. Ata janë të gëzuar me mirësitë dhe begatitë e Allahut. S'ka dyshim se Allahu nuk ua humb shpërblimin besimtarëve.

Shpjegimi i ajeteve

Këto ajete të mrekullueshme janë një përgëzim i madh, që flasin për gradën e lartë të dëshmorëve në rrugën e Zotit. Ato tregojnë nderimin e madh dhe mirësitë që janë përgatitur për ta. Këto ajete janë, gjithashtu, edhe një ngushëllim për të gjallët, që të mos trishtohen për ata që kanë dhënë jetën për hir të fesë së Allahut. Ato shërbejnë edhe si nxitëse të dëshirës për të bërë luftë dhe për të rënë dëshmor në rrugën e Allahut.

- "Kurrë mos thoni: "janë të vdekur" për ata që bien dëshmorë në rrugën e Allahut." - Kuptimi: Ata që kanë rënë në luftë kundër armiqve të Zotit dhe duke synuar lartësimin e fjalës së Zotit, mos i konsideroni asnjëherë si të vdekur. Pra, kurrë, mos ju shkojë ndër mend se dëshmorët në rrugën e Zotit u asgjësuan dhe humbën çdo mirësi. Mos mendoni se duke u larguar nga kjo dynja dhe duke lënë kënaqësitë e kësaj jete, për hir të së cilës frikacakët i shmangen luftës, atyre do t'u mungojnë përgjithmonë kënaqësitë. Përkundrazi, ata tashmë janë duke shijuar mrekulli të vërteta, jo më të dynjasë, por të Xhenetit. Thotë i Lartësuari:

- "Përkundrazi, ata janë të gjallë te Zoti i tyre, duke u ushqyer." - Pra, me rënien e tyre si dëshmorë në rrugën e Zotit, ata kanë fituar mirësinë më të madhe, për të cilën garojnë ambiciozët. Ata janë të gjallë te Zoti i tyre, në Xhenetin e mirësive.

Shprehja: "*te Zoti i tyre*" tregon gradën e lartë dhe afrimitetin te Krijuesi i tyre. Ata furnizohen me shumëllojshmëri të mirash, vlerën e të cilave mund ta shpjegojë veçse Ai që ua dhuron. Përveç këtyre:

- "Ata janë të gëzuar me atë që u ka dhënë Allahu nga të mirat e Tij." – Domethënë, janë të lumturuar dhe plotësisht të kënaqur me dhuratën e Zotit të tyre. Sytë dhe shpirtrat e tyre janë të gëzuar, të ngazëllyer me bukuritë e atjeshme. Kënaqësia që ndiejnë ata është e plotë, e pacunguar në asnjë aspekt. Allahu i Lartësuar u ka dhuruar kënaqësi për trupin dhe lumturi për shpirtin e tyre. Ata lumturohen me mirësitë e përjetshme, me të cilat do të jetojnë përgjithmonë. Për këtë arsye, ata përgëzojnë njëri-tjetrin për vëllezërit e tyre, që ende nuk kanë rënë në luftë në rrugën e Zotit.

- "Ata përgëzojnë njëri-tjetrin për të tjerët, që ende nuk u janë bashkuar radhëve të tyre, se për ta nuk do të ketë as frikë dhe as nuk kanë pse të brengosen." – Pra, ata përgëzojnë edhe njëri-tjetrin me lajmin e gëzueshëm që, edhe vëllezërit e tyre, sikurse ata, nuk do të kenë frikë dhe as brenga. Ky është një plotësim i mirësisë dhe lumturisë së tyre.

- "Ata janë të gëzuar me mirësitë dhe begatitë e Allahut." - Ata urojnë njëri-tjetrin për suksesin më të madh që mund të urohet ndonjëherë: për mirësinë e Zotit të tyre dhe bujarinë e Tij me ta. Por edhe për diçka tjetër shumë të bukur:

- "S'ka dyshim se Allahu nuk ua humb shpërblimin besimtarëve." – Përkundrazi, Allahu ua shumëfishon shpërblimin me bujarinë e Tij. Ai u dhuron shumë më tepër sesa ata arrijnë me përpjekjet e tyre.

Në këto ajete dëshmohet vërtetësia e mirësive që përjetohen gjatë jetës së varrit. Dëshmorët qëndrojnë në gradat më të larta, pranë Zotit të tyre. Ky ajet tregon, gjithashtu, se shpirtrat e vepërmirëve bashkohen dhe takohen me njëri-tjetrin, duke i përcjellë njëri-tjetrit lajme të gëzueshme.

Ajetet 172 – 175

172. Për ata që iu përgjigjën Allahut dhe të Dërguarit, edhe pse me plagë të rënda, dhe për ata që bënë mirë dhe u ruajtën, është një shpërblim i madh.
173. Edhe për ata të cilët, kur njerëzit u thanë: "Shumë njerëz janë mbledhur që t'ju sulmojnë, prandaj kini frikë!", kjo vetëm sa ua shtoi edhe më shumë besimin, prandaj thanë: "Neve na mjafton Allahu! Ai është Mbrojtësi më i mirë!"
174. Ata, pa i gjetur asnjë e keqe, fituan begati e mirësi të mëdha nga Allahu dhe arritën kënaqësinë e Tij. Allahu është Dhurues i madh.
175. Ishte Shejtani që deshte t'ju frikësonte me miqtë e vet. Por ju mos u frikësoni prej tyre, por frikësohuni prej Meje, nëse jeni besimtarë!


Shpjegimi i ajeteve

- "Për ata që iu përgjigjën Allahut dhe të Dërguarit, edhe pse me plagë të rënda..." - Pasi u kthye nga Uhudi në Medinë, Profeti (a.s.) dëgjoi se Ebu Sufjani së bashku me idhujtarët që e shoqëronin po bënin plan të shkonin deri në Medinë. Atëherë, ai u bëri thirrje shokëve të tij që të ktheheshin sërish në luftë. Ata, edhe pse të dërrmuar nga plagët, iu përgjigjën thirrjes dhe urdhrit të Allahut dhe të Profetit të Tij. E kështu marshuan përpara, derisa mbërritën te vendi i quajtur *Hamraul Esued*. Atje shkuan disa korrierë, të cilët u thoshin:

- "Edhe për ata të cilët, kur njerëzit u thanë: "Shumë njerëz janë mbledhur që t'ju sulmojnë, prandaj kini frikë!" – Pra, ata sillnin informacione frikësuese, të tilla si: Armiku është përgatitur që t'ju zhdukë të gjithëve, prandaj ikni e shpëtoni kokën tuaj!

Megjithatë, të gjitha këto kërcënime nuk bënë gjë tjetër, por veçse ua shtuan edhe më tepër besimin muslimanëve:

- "...kjo vetëm sa ua shtoi edhe më shumë besimin, prandaj thanë: "Neve na mjafton


الجزء الرابع سورة آل عمران
فَٱنقَلَبُواْ بِنِعْمَةٍ مِّنَ ٱللَّهِ وَفَضْلٍ لَّمْ يَمْسَسْهُمْ سُوٓءٌ وَٱتَّبَعُواْ
رِضْوَٰنَ ٱللَّهِ ۗ وَٱللَّهُ ذُو فَضْلٍ عَظِيمٍ ﴿١٧٤﴾ إِنَّمَا ذَٰلِكُمُ ٱلشَّيْطَٰنُ
يُخَوِّفُ أَوْلِيَآءَهُۥ فَلَا تَخَافُوهُمْ وَخَافُونِ إِن كُنتُم مُّؤْمِنِينَ ﴿١٧٥﴾
وَلَا يَحْزُنكَ ٱلَّذِينَ يُسَٰرِعُونَ فِى ٱلْكُفْرِ ۚ إِنَّهُمْ لَن يَضُرُّواْ ٱللَّهَ
شَيْـًٔا ۗ يُرِيدُ ٱللَّهُ أَلَّا يَجْعَلَ لَهُمْ حَظًّا فِى ٱلْءَاخِرَةِ ۖ وَلَهُمْ عَذَابٌ
عَظِيمٌ ﴿١٧٦﴾ إِنَّ ٱلَّذِينَ ٱشْتَرَوُاْ ٱلْكُفْرَ بِٱلْإِيمَٰنِ لَن يَضُرُّواْ ٱللَّهَ
شَيْـًٔا ۖ وَلَهُمْ عَذَابٌ أَلِيمٌ ﴿١٧٧﴾ وَلَا يَحْسَبَنَّ ٱلَّذِينَ كَفَرُوٓاْ أَنَّمَا
نُمْلِى لَهُمْ خَيْرٌ لِّأَنفُسِهِمْ ۚ إِنَّمَا نُمْلِى لَهُمْ لِيَزْدَادُوٓاْ إِثْمًا ۚ وَلَهُمْ
عَذَابٌ مُّهِينٌ ﴿١٧٨﴾ مَّا كَانَ ٱللَّهُ لِيَذَرَ ٱلْمُؤْمِنِينَ عَلَىٰ مَآ أَنتُمْ
عَلَيْهِ حَتَّىٰ يَمِيزَ ٱلْخَبِيثَ مِنَ ٱلطَّيِّبِ ۗ وَمَا كَانَ ٱللَّهُ لِيُطْلِعَكُمْ
عَلَى ٱلْغَيْبِ وَلَٰكِنَّ ٱللَّهَ يَجْتَبِى مِن رُّسُلِهِۦ مَن يَشَآءُ ۖ فَـَٔامِنُواْ بِٱللَّهِ
وَرُسُلِهِۦ ۚ وَإِن تُؤْمِنُواْ وَتَتَّقُواْ فَلَكُمْ أَجْرٌ عَظِيمٌ ﴿١٧٩﴾ وَلَا يَحْسَبَنَّ
ٱلَّذِينَ يَبْخَلُونَ بِمَآ ءَاتَىٰهُمُ ٱللَّهُ مِن فَضْلِهِۦ هُوَ خَيْرًا لَّهُم ۖ
بَلْ هُوَ شَرٌّ لَّهُمْ ۖ سَيُطَوَّقُونَ مَا بَخِلُواْ بِهِۦ يَوْمَ ٱلْقِيَٰمَةِ ۗ وَلِلَّهِ
مِيرَٰثُ ٱلسَّمَٰوَٰتِ وَٱلْأَرْضِ ۗ وَٱللَّهُ بِمَا تَعْمَلُونَ خَبِيرٌ ﴿١٨٠﴾
٧٣

Allahu! Ai është Mbrojtësi më i mirë!"" - Mbështetja tek Allahu u bë më e fortë. Ata thanë: "Na mjafton Allahu, Sundimtari dhe Mbrojtësi ynë! Allahun kemi lënë të kujdeset për gjithçka që na shqetëson, dhe sa Kujdestar i mirë është Ai! Ai përkujdeset për rregullimin e çështjeve të adhuruesve të Tij. Ai bën të mundur që të zbresin mirësitë dhe të largohen fatkeqësitë. Askush nuk mund ta pengojë përkujdesjen dhe mëshirën e Tij.

Dhe, ja përfundimi:

- "Ata, pa i gjetur asnjë e keqe, fituan begati e mirësi të mëdha nga Allahu" - Kur idhujtarët mësuan se Profeti (a.s.) dhe ushtria e tij – madje edhe ata që nuk morën pjesë fillimisht në betejë – kishin dalë në kërkim të tyre, në zemrat e tyre hyri tmerri. Allahu i Lartësuar futi frikë në zemrat e tyre, prandaj ata u larguan për në Mekë.

Kështu, besimtarët u kthyen me fitore, me mirësinë dhe gradën e lartë te Zoti i tyre. Vërtet, përgjigjja e tyre ndaj thirrjes së

Allahut dhe Profetit të Tij edhe në atë gjendje, si edhe mbështetja e tyre e plotë tek i Gjithëfuqishmi ishte një sukses i dhuruar prej Tij.

- dhe për ata që bënë mirë dhe u ruajtën, është një shpërblim i madh. – Pra, me veprat e tyre të mira, duke iu përgjigjur urdhrit të Allahut dhe Profetit (a.s.), dhe me ruajtjen nga të këqijat, duke mos thyer asnjë urdhër, ata merituan shpërblimin e Allahut të Lartësuar. Me plotësimin e devotshmërisë, çdokush mund të arrijë kënaqësinë e Allahut të Lartësuar.

- "...dhe arritën kënaqësinë e Tij. Allahu është Dhurues i madh." – Pra, duke qenë se ata u përpoqën për kënaqësinë e Tij, Allahu i Lartësuar ua shtoi shpërblimin e luftës edhe më tepër. Dhe, sigurisht, shpërblimi i Allahut është i madh!

- "Ishte Shejtani që deshte t'ju frikësonte me miqtë e vet." - Ata të cilët ju frikësonin dhe ju kërcënonin me idhujtarët ishin veçse zëdhënës të Shejtanit, që do t'ju frikësojë me ushtritë e tij.

- "Por ju mos u frikësoni prej tyre, por frikësohuni prej Meje, nëse jeni besimtarë!" - Mos kini frikë idhujtarët dhe ushtrinë e Shejtanit, por frikësojuni Allahut, sepse gjithçka është në dorën e Tij. Ata nuk mund të arrijnë asgjë pa lejen e të Plotfuqishmit. Vetëm Allahut frikësojuni, i Cili përkujdeset për të zgjedhurit dhe të dashurit e Tij. Ai është pranë atyre që i frikësohen dhe i përgjigjen urdhrave të Tij.

Ky ajet tregon se frika vetëm ndaj Allahut të Lartësuar është detyrë. Madje, kjo konsiderohet si domosdoshmëri e besimit të drejtë. Në varësi të imanit është edhe frika ndaj Allahut. Frikë e dobishme dhe e shpërblyeshme është ajo që e ndalon robin nga shkelja e kufijve të Allahut.

Ajetet 176 – 177

176. Mos u brengos për ata që rendin në mosbesimin e tyre! Ata nuk mund ta dëmtojnë Allahun aspak. Allahu, me urtësinë e Vet, dëshiron që atyre të mos u takojë asnjë e mirë në botën tjetër. Gjithashtu, ata do të kenë një dënim të rëndë.
177. Ata që, në vend të besimit, parapëlqyen kufrin, nuk i bëjnë asnjë dëm Allahut. Ata vetë i pret një dënim i dhimbshëm.

Shpjegimi i ajeteve

Profeti (a.s.) ishte shumë i përkushtuar për udhëzimin e krijesave të Zotit. Ai përpiqej dhe shqetësohej që ata të udhëzoheshin. Kur ata nuk përgjigjeshin, ai trishtohej dhe shqetësohej shumë, prandaj i Lartësuari i thotë:

- "Mos u brengos për ata që rendin në mosbesimin e tyre!" – Kuptimi: Mos u shqetëso për ata që, nga dëshira për shthurje, nxitojnë në vepra të këqija dhe në mohimin e Zotit. Ata e dëshirojnë shumë mohimin e Zotit të tyre dhe shfrenimin, por:

- "Ata nuk mund ta dëmtojnë Allahun aspak." - Allahu i Lartësuar do ta ndihmojë fenë e Tij, do ta mbështesë Profetin e Tij dhe do ta shpjerë deri në fund kauzën e Tij, edhe pse ata e mohojnë, prandaj mos u kushto shumë rëndësi mohimit të tyre! Ata po punojnë veçse në dëm të vetes së tyre. A ka fatkeqësi më të madhe sesa të jesh bosh nga imani në jetën e kësaj dynjaje dhe i ndëshkuar përjetësisht në jetën tjetër?! Me zgjedhjen e tyre të keqe, ata janë të pavlerë dhe të papërfillshëm tek i Gjithmëshirshmi. Ata janë kaq të papërfillshëm, saqë Allahu i Lartësuar thotë:

- "Allahu, me urtësinë e Vet, dëshiron që atyre të mos u takojë asnjë e mirë në botën tjetër. Gjithashtu, ata do të kenë një dënim të rëndë." – Ata që braktisen nga Allahu i

Lartësuar janë të ulët, të parëndësishëm, prandaj e meritojnë këtë trajtim nga i Drejti dhe i Urti. Ata nuk mund të meritojnë shpërblimin e ahiretit. Allahu nuk u dha sukses atyre në veprat dhe fjalët e mira, me të cilat fitohet mirësia dhe mëshira e Tij. Pa dyshim, Ai është i Drejti dhe i Urti. Allahu është i Gjithëdituri, që e di shumë mirë se kush e meriton udhëzimin dhe dritën e Tij. Ndërsa mohuesit, të cilëve Ai nuk u dhuron udhëzim dhe dritë, nuk i meritojnë këto mirësi sepse ata parapëlqejnë kufrin kundrejt imanit, sikurse ai tregtari që paguan me pasurinë më të shtrenjtë për të arritur atë që do. Të tillët nuk mund ta dëmtojnë aspak Zotin e botëve.

- "Ata që, në vend të besimit, parapëlqyen kufrin, nuk i bëjnë asnjë dëm Allahut." – Madje, dëmi do të kthehet mbi ta, siç thotë i Lartësuari:

- "Ata vetë i pret një dënim i dhimbshëm." - E si mund ta dëmtojnë ata Allahun e Madhëruar?! Mos vallë, duke u treguar shpërfillës ndaj besimit tek Ai dhe duke parapëlqyer mohimin e Mëshiruesit?! Le të kujtojnë ata se Allahu i Lartësuar është i Lavdëruar në qiej dhe në tokë dhe se nuk ka nevojë për adhurimin e askujt, aq më pak të tyre. Allahu i Lartësuar ka adhurues të pastër dhe të sinqertë, të cilët e adhurojnë me dashuri, madhërim, bindje dhe përkushtim të plotë. Ai ka krijuar adhurues e dijetarë të mëdhenj, që të sqarojnë dhe transmetojnë këtë fe, duke kënaqur Atë. Ai ka zgjedhur njerëz të lartë, të ditur dhe të urtë për të ndihmuar dhe lartësuar këtë fe. Allahu i Lartësuar thotë në një ajet: "Thuaj: "I besoni ju atij apo nuk i besoni, ata që u është dhënë dija para tij bëjnë sexhde me fytyra përtokë, kur ai u lexohet, dhe thonë: "I Lartësuar është Zoti ynë! Premtimi i Zotit tonë është realizuar." Ata bëjnë sexhde me fytyra përtokë duke qarë *(kur dëgjojnë Kur'ânin)*, dhe ai ua shton edhe më tepër përuljen *(ndaj Allahut)*." [Isra 107-109].

Ajeti 178

178. Të mos mendojnë jobesimtarët se afatin që Ne u kemi dhënë të jetojnë është në dobi të tyre. Ne i lëmë të jetojnë veç që të shtojnë edhe më tepër gjynahet e tyre, dhe pastaj i pret dënimi nënçmues.

Shpjegimi i ajetit

- "Të mos mendojnë jobesimtarët se afatin që Ne u kemi dhënë të jetojnë është në dobi të tyre." - Ata që e mohojnë Zotin e tyre, që e flakin pas shpine fenë e Tij dhe që e luftojnë Profetin e Tij, të mos mendojnë se është në të mirë të tyre që Zoti vazhdon i lë të jetojnë në këtë dynja, duke i afatizuar dhe duke mos i shfarosur menjëherë. Kjo nuk tregon aspak dashurinë e Zotit për ta. Jo, kurrsesi! Çështja nuk është ashtu si mendojnë ata. Me afatizimin dhe mosndëshkimin e shpejtë të tyre, Allahu i Lartësuar do veçse një ndëshkim më të ashpër për ta. Duke i afatizuar ata do t'i shtojnë edhe më tepër zullumet, për të cilat do të merren në llogari nga i Drejti dhe i Plotpushtetshmi.

- "Ne i lëmë të jetojnë veç që të shtojnë edhe më tepër gjynahet e tyre, dhe pastaj i pret dënimi nënçmues." - Allahu i Lartësuar i afatizon kriminelët ose të prishurit që padrejtësitë e tyre të shtohen aq shumë, saqë pastaj Ai t'i ndëshkojë ata sikurse ndëshkon Krenari, i Plotpushtetshmi.

Le të kenë kujdes të padrejtët për çdo afatizim që vërejnë se po iu jepet, dhe kurrë të mos mendojnë se po i shpëtojnë ndëshkimit të Allahut të Madhërishëm e të Lartësuar!

Ajeti 179

179. Allahu nuk do t'i linte kurrë besimtarët ashtu siç jeni ju, pa dalluar të keqin nga i miri. Allahu nuk ju zbulon juve të fshehtat, por Allahu është Ai që nga të dërguarit e vet zgjedh atë që do. Prandaj,

besojini Allahut dhe të dërguarve të Tij. Nëse besoni dhe ruheni, do të keni një shpërblim të madh.

Shpjegimi i ajetit

- "Allahu nuk do t'i linte kurrë besimtarët ashtu siç jeni ju, pa dalluar të keqin nga i miri." - Nuk i takon urtësisë së Allahut të Gjithëditur që t'i lërë muslimanët në atë gjendje, pa u dalluar qartë i keqi nga i miri, besimtari nga munafiku, i sinqerti nga gënjeshtari.

- "Allahu nuk ju zbulon juve të fshehtat, por Allahu është Ai që nga të dërguarit e vet zgjedh atë që do. Prandaj, besojini Allahut dhe të dërguarve të Tij. Nëse besoni dhe ruheni, do të keni një shpërblim të madh." - Nuk i takon urtësisë së Tij që t'i lejojë krijesat të shohin dhe të njohin të fshehtën. Vetëm profetëve iu lejua diçka nga kjo. Nga ana tjetër, është Allahu që zgjedh prej njerëzve se cilët do të bëhen profetë, për t'u përcjellë Shpalljen hyjnore, që sjell jetë, lumturi, dritë dhe udhëzim. Urtësia e Allahut kërkon që krijesat e Tij të sprovohen dhe të dallohen në besimin e tyre, sepse nëpërmjet sprovave dalin në pah e keqja dhe e mira. Sprovat e Tij janë të shumta dhe të gjitha shërbejnë për sigurinë e besimit dhe sinqeritetit.

Allahu i dërgoi profetët dhe na urdhëroi që t'u bindemi dhe t'i pasojmë ata në rrugën e tyre. Ai na urdhëroi që t'i besojmë se flasin të vërtetën dhe urdhërojnë në emër të Zotit. Nëse i besojmë dhe u bindemi urdhrave të tyre, Ai na ka premtuar shpërblim të madh. Me besim të sinqertë dhe me devotshmëri fiton premtimin e Bujarit të Mëshirshëm.

Në varësi të bindjes dhe pasimit të profetëve, njerëzit janë ndarë në dy grupe: të bindur dhe të pabindur, besimtarë të sinqertë dhe munafikë, të dorëzuar ndaj Krijuesit të gjithësisë dhe shpërfillës ndaj fesë së Tij. Çdo njeri meriton shpërblimin ose ndëshkimin. Kështu del në pah drejtësia, bamirësia, mëshira dhe urtësia madhështore e Allahut në krijimin e Tij.

Ajeti 180

180. Ata që bëjnë koprraci me të mirat që u ka dhënë Allahu, të mos mendojnë se ajo është në dobi të tyre. Jo, ajo është në dëm të tyre. Ajo e mirë me të cilën bëhen koprracë, në Ditën e Kijametit do t'u mbështillet në qafën e tyre. Allahut i mbesin trashëgim qiejt dhe toka. Allahu është i njohur mirë më atë që ju veproni.

Shpjegimi i ajetit

- "Ata që bëjnë koprraci me të mirat që u ka dhënë Allahu, të mos mendojnë se ajo është në dobi të tyre. Jo, ajo është në dëm të tyre." – Ata që tregohen koprracë me mirësitë që iu ka falur Allahu, qoftshin ato pasuri, pushtet, famë, dituri etj., të mos mendojnë se, meqë po marrin dhurata nga Allahu, kjo është gjithmonë në të mirë të tyre. Allahu i Lartësuar u ka falur mirësi shumë njerëzve, duke u treguar bamirës i madh me ta, por Ai njëkohësisht i ka urdhëruar që të shpenzojnë prej këtyre të mirave, për të qenë në ndihmë të krijesave të tjera. Ai i ka urdhëruar që ata të tregohen bamirës vetëm me një pjesëz të mirësive të tyre, aq sa të mos dëmtohen ata vetë. Por nëse ata nuk shpenzojnë dhe tregohen koprracë, duke i privuar robërit e tjerë të Allahut të përfitojnë prej këtyre mirësive, le ta dinë se ky veprim është në dëm të tyre dhe nuk ua ruan aspak ato mirësi që të mos pakësohen. Koprracia është në dëm të fesë, besimit, dynjasë dhe të të gjitha çështjeve të tyre të tashme dhe të ardhme. Ajo, gjithashtu, nuk mund të mos ndëshkohet nga i Drejti dhe i Urti:

- "Ajo e mirë me të cilën bëhen koprracë, në Ditën e Kijametit do t'u mbështillet në qafën e tyre." – Kuptimi: Mirësitë që nuk i shfrytëzojnë, atyre do t'u mbështillen në qafë Ditën e Gjykimit. Ky do të jetë si ndëshkim

për ta. Në një hadith të saktë thuhet: "Ditën e Gjykimit, koprracit do t'i shfaqet pasuria e tij si një gjarpër *akra*, që ka dy pulla në ballë, i cili do ta mbështjellë atë mes dy dhëmbëve të tij dhe do të thotë: *"Unë jam pasuria jote, unë jam thesari yt!"* Pastaj Profeti (a.s.) lexoi këtë ajet, si vërtetues të kësaj fjale."

Ata njerëz mendojnë se koprracia është në dobi të tyre, sepse kështu fitojnë pushtet dhe sukses, por ajo do të kthehet plotësisht në të kundërt të tyre. Pasuria që ata ruajnë me koprraci do të bëhet shkak i vuajtjes së tyre.

- "Allahut i mbesin trashëgim qiejt dhe toka..." - Allahu i Lartësuar është Pronari i pasurive dhe pushtetit absolut. Të gjitha pasuritë, atë ditë do t'i kthehen Pronarit të tyre të vetëm e të vërtetë, Allahut të Lartësuar. Ndërsa krijesat nuk do të kenë me vete as flori, as argjend, e as ndonjë pasuri tjetër, me të cilën do të mund të blejnë shpëtimin dhe lumturinë. Thotë i Lartësuari: "Ne do ta trashëgojmë tokën dhe ata që janë mbi të, ndërsa ju do të ktheheni tek Ne." [Merjem 40].

Vëreni me kujdes dy faktet që tregon Allahu i Lartësuar, për të cilët Ai i fton njerëzit të meditojnë dhe të mësojnë që të mos tregohen koprracë me mirësitë që u ka dhuruar Ai, por të jenë bujarë e dorëdhënës:

Së pari, Allahu i Lartësuar na mëson se çdo mirësi që njeriu gëzon vjen prej bujarisë së Tij, dhe nuk është pronë e vërtetë e robit. Nëse nuk do të ishte bujaria e Allahut të Lartësuar, në dorën e robit nuk do të vinte asnjë mirësi. Kështu, kur ai tregohet koprrac me të mirat e dhuruara nga Allahu i Lartësuar, ai bëhet prej atyre që pengojnë dhe ndalojnë mirësitë e Allahut për të tjerët. Bamirësia e Allahut e bën të detyrueshme për robin që edhe ai të tregohet bamirës ndaj të tjerëve, sikurse thotë i Lartësuari në Kur'ân: "...tregohu bamirës, sikurse Allahu është treguar Bamirës ndaj teje." [Kasas]. Njeriu që ndihet i sigurt se të mirat që gëzon janë thjesht dhuratë prej Allahut të Lartësuar, nuk mund të tregohet kurrë koprrac, sidomos me diçka që as nuk e dëmton e as nuk e pakëson pasurinë e tij. Përkundrazi, bujaria i sjell njeriut dobi të pallogaritshme qoftë për ndreqjen e zemrës së tij, qoftë për shtimin e pasurisë së tij. Ajo ia shton besimin dhe e ruan atë nga çdo e keqe dhe fatkeqësi.


Së dyti, Allahu i Lartësuar thotë se pasuria që ka robi në zotërim do t'i kthehet Allahut të Lartësuar, Pronarit të tyre të vërtetë dhe të vetëm, që është trashëguesi i gjithçkaje. Atëherë, çfarë kuptimi ka koprracia me një pasuri që do të të ikë nga duart dhe do t'i shkojë dikujt tjetër?

Allahu thotë edhe diçka tjetër shumë të rëndësishme, që të nxit të jesh bamirës dhe të ruhesh nga koprracia:

- "Allahu është i njohur mirë më atë që ju veproni." - Meqenëse Allahu di gjithçka që njerëzit bëjnë, Ai nuk do të lërë asnjë vepër të mirë pa e shpërblyer me bujarinë e Tij, dhe asnjë vepër të keqe pa e dënuar me drejtësinë dhe urtësinë e Tij. Atëherë, duke qenë se është kështu, çdokush që ka sadopak besim në zemër, nuk do t'ia lejonte vetes që të mos shpenzonte prej mirësive të dhuruara prej Bujarit e Bamirësit, sepse shpërblimi për këtë vepër është shumë i madh për t'u shpërfillur. Nga ana tjetër, një besimtar nuk do të kënaqej kurrë me koprracinë, sepse ndëshkimi i premtuar për të është shumë i ashpër për t'u lënë në harresë dhe për të qenë i pakujdesshëm.

Ajetet 181 – 182

181. Allahu i dëgjoi fjalët e atyre që thanë: "Allahu është i varfër, kurse ne jemi të pasur!" Ne do ta shkruajmë atë që thanë ata, edhe vrasjen e padrejtë që u bënë profetëve, dhe pastaj do t'u themi: "Vuajeni dënimin e djegies në Zjarr.
182. Kjo është meritë e duarve tuaja, se Allahu nuk është i padrejtë ndaj krijesave".



Shpjegimi i ajeteve

- "Allahu i dëgjoi fjalët e atyre që thanë: "Allahu është i varfër, kurse ne jemi të pasur!" Ne do ta shkruajmë atë që thanë ata, edhe vrasjen e padrejtë që u bënë profetëve..." - Allahu i Lartësuar na tregon rreth disa kryeneçëve, që thanë fjalët më të shëmtuara dhe më të pista. Ai i kërcënon shumë frikshëm ata, kur thotë se i dëgjoi fjalët e tyre dhe i ka ruajtur me përpikmëri, së bashku me veprat e tjera të këqija që ata kanë bërë, dhe do të përdoren në gjyqin kundër tyre. Ata njihen gjithashtu si vrasës dhe torturues të profetëve dhe këshilluesve, që ftonin në udhën e drejtë të Allahut të Lartësuar. Ai do t'i ndëshkojë ata me dënimin më të ashpër. Për thënien e tyre të pistë: "Allahu është i varfër, kurse ne jemi të pasur!", ata do të dëgjojnë të dëshpëruar fjalët që do u këpusin çdo shpresë:

- "...dhe pastaj do t'u themi: "Vuajeni dënimin e djegies në Zjarr." – Dënimi *el muhriḳ*, domethënë, me djegie që fillon nga jashtë trupit e depërton deri në brendësi të tij, deri në zemër. Ky ndëshkim nuk është aspak padrejtësi për ta. Ai është zgjedhur dhe arritur nga vetë ata, prandaj thotë i Drejti dhe i Lartësuari:

- "Kjo është meritë e duarve tuaja, se Allahu nuk është i padrejtë ndaj krijesave". - Janë poshtërsitë dhe paturpësitë e tyre ato që e bëjnë të merituesheëm këtë dënim të dhënë nga i Drejti dhe i Lartësuari. Janë fjalët dhe veprat e tyre të shëmtuara që sjellin ndëshkimin dhe vuajtjet dhe që largojnë shpërblimin dhe lumturinë.

Studiuesit dhe shpjeguesit e Kur'ânit kanë thënë se ky ajet është shpallur për një grup çifutësh, që nxorën nga goja këto fjalë të shëmtuara. Njëri prej tyre ishte Finhas Ibn Azura, i cili njihej si një ndër dijetarët çifutë më kryesorë të Medinës. Ky i poshtër, kur dëgjoi ajetin: "Kush është ai që do t'i japë Allahut një "hua" të mirë, që Ai t'ia shtojë atë shumëfish?" [Bekare 245] dhe ajetin: "Kush është ai që i 'jep' Allahut një hua të mirë, në mënyrë që Ai t'ia shumëfishojë atë dhe që të ketë një shpërblim të mirë?" [Hadid 11], tha ato fjalë të çmendura.

Allahu i Lartësuar na tregon, gjithashtu, se kjo nuk është diçka e papritur prej tyre, sepse janë pikërisht ata që kanë vrarë deri edhe profetë të Tij. Allahu i Lartësuar, për të treguar që vrasjet nuk kryheshin pa vetëdije nga ata, por me bindje dhe vullnet të plotë, e cilëson dhe thotë që ato ishin të padrejta. Nga ana tjetër, dihet që vrasja e një profeti nuk mund të jetë kurrë e drejtë. Kjo dëshmon se ata ishin aq të poshtër, saqë vrisnin e torturonin edhe profetët e tyre me vetëdije të plotë. Çfarë nuk mund të presësh nga një popull rebel dhe i fëlliqur si ata!

Ajetet 183 – 184

183. Janë pikërisht ata që thanë: "Allahu na ka porositur që të mos besojmë asnjë të dërguar, derisa ai të na sjellë një kurban që ta hajë zjarri." Thuaju: "Para meje, juve ju erdhën të dërguar me argumente të qarta, edhe me atë që thatë. Përse, pra, i vratë ata, nëse thoni të vërtetën?"
184. Po nëse ata të mohojnë, atëherë të jesh i sigurt se, edhe para teje janë mohuar të dërguar, që erdhën me argumente të qarta, me shkrime qiellore dhe me libër të ndritshëm.

Shpjegimi i ajeteve

- "...Janë pikërisht ata që thanë: "Allahu na ka porositur që të mos besojmë asnjë të dërguar, derisa ai të na sjellë një kurban që ta hajë zjarri."" – Në këto ajete flitet rreth atyre mashtruesve që shpifën dhe thanë se Allahu i Lartësuar i kishte porositur që të mos besonin asnjë profet, derisa t'u sillte një shenjë. Shenja ishte: derisa i dërguari t'u sillte një kurban që ta hante zjarri. Kështu, ata bënë dy padrejtësi: mashtruan për Allahun e Lartësuar dhe kufizuan mrekullitë e profetëve vetëm me shenjën e mësipërme.

Me këtë shpifje, ata pretendonin se, edhe nëse nuk e besonin profetin, ata e bënin këtë që t'i bindeshin Zotit të tyre dhe zbatonin porositë e Tij për pranimin ose jo të profetëve. Por dihet shumë mirë se Allahu i Lartësuar e mbështet me argumente dhe shenja të jashtëzakonshme çdo profet që e dërgon, të cilat janë të mjaftueshme që njerëzit t'i besojnë. Nga ana tjetër, Allahu i Lartësuar nuk i ka kufizuar mrekullitë e profetëve me atë që pretendonin këta trillues dhe fshehës të së vërtetës.

Megjithatë, edhe me këtë kusht, ata nuk janë treguar kurrë besnikë dhe të kujdesshëm. Për këtë arsye, Allahu i Lartësuar e urdhëron Profetin e Tij që të thotë:

- "Thuaju: "Para meje, juve ju erdhën të dërguar me argumente të qarta..."" – Pra, shumë profetë kanë ardhur para meje, me shenja dhe argumente të mjaftueshme për të besuar. Madje, mes tyre pati edhe nga ata që sollën atë mrekulli që ju kërkoni.

- "...edhe me atë që thatë." – Pra, disa prej tyre sollën kurbane, që i hëngri një zjarr i zbritur nga qielli, si mrekulli prej Zotit. Pra, ju keni vepruar njëlloj me të gjithë profetët. Pyetja është e njëjtë:

- "Përse, pra, i vratë ata, nëse thoni të vërtetën?" – Kuptimi: Nëse jeni të sinqertë në pretendimin tuaj se Zoti ju ka porositur të mos besoni asnjë profet, veçse kur ai t'ju sjellë një kurban që ta hajë zjarri, atëherë si i përgjigjeni vrasjes së profetëve, mes të cilëve janë edhe ata që e sollën mrekullinë të cilën ju kërkoni?! Kjo tregon se ju veçse po gënjeni dhe po trilloni të pavërteta.

Pastaj Allahu i Lartësuar e ngushëllon dhe qetëson Profetin e Tij, duke i thënë:

- "Po nëse ata të mohojnë, atëherë të jesh i sigurt se, edhe para teje janë mohuar të dërguar..." – Pra, ky është zakoni i pandryshueshëm i kriminelëve dhe i të padrejtëve. Ata dinë veçse të mohojnë Zotin dhe të refuzojnë profetët e Tij. Mohimi i profetëve prej tyre nuk ndodh për shkak të mungesës së mrekullive dhe as për shkak të mosqartësimit të argumenteve. Përkundrazi, siç thotë i Madhëruari, ata:

- "...erdhën me argumente të qarta, me shkrime qiellore dhe me libër të ndritshëm." - Profetët sollën plot arsyetime logjike dhe argumente të qarta tekstuale nga Zoti. Ata sollën libra të shpallur nga Zoti i gjithësisë, që nuk mund t'i sillte askush prej njerëzve. Me të tillë libra, Zoti nderoi vetëm profetët. Ata sollën libra ndriçues, që ndriçojnë dispozitat ligjore, mënyrat e arsyetimit të qartë, çdo rrugë të mirë dhe virtyt të lartë. Në këta libra ndriçohen ngjarjet e së shkuarës dhe të së ardhmes.

Atëherë, nëse ata sillen kështu përkundër profetëve, ti nuk duhet të shqetësohesh shumë për çështjen e tyre.

Ajeti 185

185. Çdo njeri do ta shijojë vdekjen. Pastaj, shpërblimet tuaja do t'ju jepen të plota veçse Ditën e Kijametit. Kush i shpëton Zjarrit e futet në Xhenet, ai vërtet ka fituar. Jeta e kësaj bote nuk është gjë tjetër, por veçse një përjetim mashtrues.

Shpjegimi i ajetit

- "Çdo njeri do ta shijojë vdekjen. Pastaj, shpërblimet tuaja do t'ju jepen të plota veçse Ditën e Kijametit." - Në këtë ajet, Allahu i Lartësuar na nxit që të tregohemi të përmbajtur kundrejt kësaj dynjaje, duke na kujtuar se ajo një ditë do të fanitet e do të zhduket. Kënaqësitë dhe joshjet e saj janë veçse një përjetim i shkurtër dhe mashtrues. Çdokush që sprovohet me stolitë e saj, bie pre e kurtheve të saj dhe verbohet nga bukuritë e saj, harron që ajo do të largohet prej tij dhe ai do të largohet prej saj, për të shkuar në destinacionin përfundimtar të tij.

Më pas, Allahu i Lartësuar na kujton ditën e vështirë dhe plot ankth të Kijametit, ditë kur do të jepet i plotë dhe me drejtësi shpërblimi i veprave të kryera në këtë jetë: o i mirë, o i keq, sipas meritës!

- "Kush i shpëton Zjarrit e futet në Xhenet, ai vërtet ka fituar. Jeta e kësaj bote nuk është gjë tjetër, por veçse një përjetim mashtrues." – Domethënë, ka shpëtuar nga ndëshkimi i dhimbshëm dhe ka për të hyrë në Xhenetin e mirësive të pafundme. Ka fituar të drejtën për të jetuar në vendet e stolisura me bukuri, që as syri nuk i ka parë, as veshi nuk i ka dëgjuar dhe asnjë zemër nuk i ka përfytyruar. I kuptuar nga ana e kundërt, ajeti tregon se kush nuk shpëton prej Zjarrit dhe nuk futet në Xhenet, nuk ka dalë aspak i fituar. Kjo do të thotë se ai do të jetë i dëshpëruar dhe i dënuar përjetësisht.

Ky ajet përmban një argument të bukur rreth vërtetësisë së shpërblimit në jetën e varrit (*berzah*). Çdokush do të shpërblehet pjesërisht gjatë jetës në varr për veprat që ka bërë. Kjo kuptohet nga fragmenti: "Pastaj, shpërblimet tuaja do t'ju jepen të plota veçse Ditën e Kijametit." Pra, Allahu i Lartësuar na tregon se shpërblimi i plotë do të jetë vetëm Ditën e Gjykimit. Ndërsa një shpërblim i pjesshëm, kuptohet nga ajeti, do të jetë gjatë jetës së varrit. Jo vetëm kaq, por një pjesë të shpërblimeve, i Drejti dhe Bamirësi ua dhuron njerëzve që në këtë jetë, para vdekjes, sikurse thotë i Lartësuari në një ajet tjetër: "Ne do t'i bëjmë ata të 'shijojnë' dënimin më të shpejtë *(në dynja)*, para dënimit të madh *(në ahiret)*...". [Sexhde 21].

Ajeti 186

186. Ju patjetër do të sprovoheni në pasuritë dhe në veten tuaj. Ju do të dëgjoni ofendime të shumta prej atyre që u është dhënë Libri para jush dhe prej idhujtarëve. Por në qoftë se duroni dhe ruheni, kjo është vërtet më kryesorja.

Shpjegimi i ajetit

- "Ju patjetër do të sprovoheni në pasuritë dhe në veten tuaj." - Allahu i Lartësuar u drejtohet besimtarëve, për t'i bërë me dije se do të sprovohen në pasuritë e tyre. Sprovë në pasuri janë shpenzimet apo dhëniet e detyrueshme dhe të pëlqyeshme, që robi duhet t'i bëjë për hir të Allahut. Shpesh, për hir të Allahut të Lartësuar, ai do të duhet të sakrifikojë apo ndoshta edhe ta humbasë pasurinë e tij.

I Urti tregon, gjithashtu, se do të sprovohemi edhe në vetet tona. Këtu hyjnë detyrimet dhe dispozitat e ndryshme të kësaj feje madhështore, të cilat janë shpeshherë të vështira për t'u mbajtur dhe për t'u përmbushur, si lufta në rrugën e Allahut etj., kur rrezikohet jeta e pasuria, kur kërcënohemi me vrasje, burgim, tortura,

diskriminim, plagosje, robërim etj. Sprova në vetet tona janë edhe sëmundjet e ndryshme, që na mundojnë, frikësojnë, të cilat na godasin vetë ne ose të afërmit e të dashurit tanë etj.

- "Ju do të dëgjoni ofendime të shumta prej atyre që u është dhënë Libri para jush dhe prej idhujtarëve." - Fjala 'ofendim' përfshin të gjitha fyerjet kundrejt besimtarëve, si për shembull, fyerjet për Kur'ânin, Profetin dhe fenë Islame.

Në këtë paralajmërim që Allahu i Urtë dhe i Dashur u drejton besimtarëve, ka dobi e urtësi të shumta. Ndër to mund të themi se sprova bëhet për t'u dalluar qartë besimtarët e sinqertë nga gënjeshtarët dhe shtirakët. Allahu i Urtë dhe i Lartësuar i përcakton sprovat edhe për t'u krijuar adhuruesve të Tij të sinqertë mundësi të mrekullueshme për t'i pastruar nga gjynahet, për t'ua mbuluar mangësitë dhe gabimet, për t'ua shtuar besimin, si edhe për t'u forcuar sigurinë rreth vërtetësisë së Kur'ânit dhe Profetit të Tij. Atyre do t'u shtohet siguria, sepse do të shohin të zbatohet në realitet ato çka Zoti i tyre i vetëm i ka paralajmëruar para se të ndodhin. Ata me siguri do të thonë sikurse na tregon i Madhëruari: "E kur muslimanët i panë ushtritë armike, thanë: "Ky është premtimi që na dha Allahu dhe i Dërguari i Tij. Allahu dhe i Dërguari i Tij e thanë të vërtetën". Ajo *(ushtria e armikut)* vetëm se ua shtoi atyre edhe më tepër besimin dhe mbështetjen *(tek Allahu)*". [Ahzab 22].

Allahu i Lartësuar i paralajmëron besimtarët për të tilla sprova, me qëllim që zemrat e tyre të jenë gati kur ato të ndodhin realisht dhe që ata të jenë të durueshëm në momentin e duhur. Nëse ata përgatiten shpirtërisht dhe psikologjikisht për të tilla vështirësi, pa dyshim që do të jenë më të qëndrueshëm, pa dyshim që do të nxitojnë drejt dyerve të durimit dhe devotshmërisë, për t'u strehuar në kështjellën e pathyeshme të besimtarit. Edhe i Madhëruari na udhëzon drejt kësaj kështjelle, kur thotë:


- "Por në qoftë se duroni dhe ruheni..." - Pra, duhet të bëni durim në të gjitha këto sprova që u përmendën: në pasurinë dhe në jetën tuaj, si edhe në mundimet me fjalë e vepra që pësoni prej të padrejtëve.

Megjithatë, përveç durimit, duhet pajiseni me devotshmëri ndaj Allahut.

Durimi i duhur është ai me të cilin kërkohet kënaqësia e Allahut dhe që është brenda kufijve të Sheriatit. Nuk lejohet të bësh durim atëherë kur situata kërkon zbatim të dispozitave të Zotit. Madje, ka raste kur i duhet treguar vendi armiqve të Allahut dhe të fesë së Tij, sikurse e përcakton Sheriati i drejtë.

Më pas, Allahu i Lartësuar na thotë se, po të jemi të duruar dhe pajisemi me devotshmëri, brenda kritereve të vendosura nga Sheriati, atëherë:

- "...kjo është vërtet më kryesorja." - Kjo është arritja më e madhe. Pra, durimi dhe devotshmëria janë nga ato veti, për të cilat duhet të garosh dhe të përkushtohesh seriozisht për t'i arritur. Ato janë maja që i arrijnë veçse ambiciozët me vullnet të çeliktë, që vështrojnë dhe qëndrojnë shumë më lart nga të tjerët, sikurse thotë i Lartësuari: "E kush është në rrugë më të mirë se ai që thërret në rrugën e Allahut, që bën vepra të mira dhe që thotë: "Unë jam prej muslimanëve?" Nuk është e barabartë e mira dhe e keqja. Andaj, ktheje *(të keqen)* në mënyrën më të mirë, se atëherë ai, me të cilin kishe njëfarë armiqësie, do të bëhet mik i afërt. Mirëpo këtë nuk mund ta arrijë kush, përveç atyre që janë të durueshëm; dhe nuk mund ta arrijë kush, përveç atyre që kanë moral të lartë." [Fusilet 33-35].



Ajetet 187 – 188

187. Kur Allahu mori zotimin nga ata të cilëve u ishte dhënë Libri: "Do t'ua përcillni atë njerëzve dhe nuk do ta fshihni!" Por ata e lanë pas dore atë amanet për një çmim të ulët të kësaj jete. Sa e keqe është ajo që blenë!

188. Mos mendo se janë të shpëtuar ata që gëzohen për atë që bënë dhe që dëshirojnë të jenë të lavdëruar për atë që nuk e kanë bërë! Mos i konsidero ata si të shpëtuar prej ndëshkimit, se ata do të kenë një dënim të dhembshëm.

Shpjegimi i ajeteve

- "Kur Allahu mori zotimin (*el mîthâḳ*) nga ata të cilëve u ishte dhënë Libri: "Do t'ua përcillni atë njerëzve dhe nuk do ta fshihni!" Por ata e lanë pas dore atë amanet për një çmim të ulët të kësaj jete. – *'El mîthâḳ'* quhet një zotim i rëndësishëm, i vështirë dhe i përforcuar. Allahu i Lartësuar e ka marrë këtë zotim prej të gjithë atyre që Ai u ka dhënë libër hyjnor dhe dije të ndritshme, me qëllim që ata t'ua përcjellin dhe sqarojnë të tjerëve. Ata duhet t'u sqarojnë njerëzve dijen që Allahu i Lartësuar u ka dhënë, sepse ata kanë nevojë për të. Ai u mori premtimin që të mos fshihnin asgjë që është detyrë të sqarohet për të tjerët. Nuk lejohet në asnjë mënyrë që ata të tregohen 'koprracë' me dijen që Allahu i Lartësuar u ka falur, sidomos kur atyre u kërkohet dija apo kur ndodh diçka që e bën të detyrueshme që të sqarohet e vërteta. Ata duhet ta bëjnë të dallueshme të vërtetën nga e kota dhe t'ua tregojnë këtë njerëzve.

Ata, të cilëve Allahu i Lartësuar u ka dhënë sukses, e kanë plotësuar më së miri këtë zotim të vështirë. Ata u mësojnë njerëzve dijen, me të cilën Allahu i Lartësuar i ka privilegjuar. Ata shpenzojnë të gjitha energjitë e tyre për t'u mësuar të tjerëve të mirën, dhe këtë e bëjnë të motivuar nga dashuria për Allahun dhe për të arritur kënaqësinë e Tij. Ata përpiqen pa pushim të kënaqin Allahun e Lartësuar dhe tregohen të mëshirshëm me krijesat. Ata gjithmonë druhen që të mos fshehin asgjë nga dija që duhet ta përcjellin qartë dhe me përpikmëri.

Ndërsa ithtarët e Librit, qofshin ata çifutë apo krishterë, apo të tjerë si ata, e kanë hedhur pas shpine këtë përgjegjësi që rëndon mbi supet e tyre. Ata fshehin të vërtetën dhe shfaqin e përhapin të kotën. Ata guxojnë të shkelin kufijtë e Allahut dhe dispozitat e Tij. Ata shpërfillin të drejtat e Krijuesit dhe të drejtat e krijesave, dhe këtë e bëjnë thjesht për një përfitim të pakët. Ky është një turp i madh për ta. Për hir të pushtetit, ofiqeve e të ndonjë pasurie të ofruar nga servilët e tyre injorantë dhe të shfrenuar, ata e shesin të vërtetën për të blerë ndëshkimin! Për ta, i Madhëruari thotë:

- "Sa e keqe është ajo që blenë!" - Kjo tregti është shumë e keqe, sepse ata, për të blerë gjënë më të ndyrë, kanë ofruar pozitën më të

nderuar që mund të arrijë një njeri. Ata kanë ofruar si çmim postin fisnik të dijetarit, që sqaron të vërtetën nga e kota. Ata i kanë mohuar vetvetes të drejtën për t'u bërë mbrojtës dhe qartësues të së vërtetës, e cila sjell të gjitha mirësitë e dynjasë dhe të ahiretit. Këtë zgjedhje të keqe e kanë bërë veçse për shkak të nivelit të ulët të dëshirave dhe qëllimive të tyre. Ata nuk e meritojnë që Allahu i Gjithëdijshëm, i Urtë dhe i Drejtë t'u japë sukses për të arritur një gradë të tillë.

Pastaj i Madhëruari thotë:

- "Mos mendo se janë të shpëtuar ata që gëzohen për atë që bënë..." - Kuptimi: Mos mendoni se i kanë shpëtuar ndëshkimit ata që gëzohen me dijen e tyre të shëmtuar, të pabazë dhe me veprat të pabazuara në tekste hyjnore.

- "...dhe që dëshirojnë të jenë të lavdëruar për atë që nuk e kanë bërë!" – Pra, ata që dëshirojnë të lëvdohen për të mirat që, në fakt, nuk i kanë bërë. Normalisht, ata duhet të sqarojnë të vërtetën dhe të punojnë sipas saj, që të meritojnë lëvdatat.

- "Mos i konsidero ata si të shpëtuar prej ndëshkimit..." - Kuptimi: Mos mendo se këta do t'i shpëtojnë dënimit dhe do të jenë të ruajtur prej tij. Përkundrazi, ata janë duke rendur drejt tij, siç thotë i Lartësuari:

- "...se ata do të kenë një dënim të dhembshëm."

Ky ajet flet për disa kategori njerëzish. Ai flet, së pari, për ithtarët e Librit, që nuk iu nënshtruan dhe nuk e ndoqën udhëzimin e sjellë nga Muhamedi (a.s.), por u vetëkënaqën me dijen që zotëronin, duke e mbrojtur atë me fanatizëm të pabazuar. Ata pretendonin se dija e tyre ishte më e rëndësishme për t'u pasuar.

Ajeti flet edhe për ata që sajojnë bidate në fjalë dhe vepra dhe gëzohen që i ftojnë njerëzit në to, duke pretenduar se janë në të vërtetën dhe të tjerët janë në humbje. Të gjithë sektet e grupet e bidatit të njëjtën gjë pretendojnë.

Sidoqoftë, nga ajeti kuptohet se ai që dëshiron apo i pëlqen që ta lëvdojnë për ndonjë fjalë apo vepër të mirë, të cilën ai e ka thënë apo e ka vepruar, nuk është aspak i qortuar, nëse atë e ka bërë me sinqeritet për Allahun, dhe jo për famë dhe syfaqësi. Përkundrazi, ai nxitet nga Sheriati që të bëjë vepra të mira me sinqeritet për Allahun, i Cili i shpërblen bamirësit në fjalë dhe në vepra. Allahu i ka shpërblyer edhe krijesat më të zgjedhura të Tij, profetët, të cilët i janë lutur Atij për t'ua plotësuar një kënaqësi të tillë. Kështu, për shembull, Ibrahimi (a.s.) është lutur: "...bëj për mua një përkujtim të mirë ndër njerëz." Ndërsa për Nuhun (a.s.), Allahu thotë: "Paqja qoftë për Nuhun në gjithë botën. Kështu i shpërblejmë Ne vepërmirët." Një nga lutjet më të rëndësishme të adhuruesve të Mëshiruesit, është: "Na bëj prijës të të devotshmëve!". Të gjitha këto janë mirësi të Allahut të Lartësuar, që kërkojnë mirënjohje të thellë ndaj Tij.

Ajeti 189

189. Vetëm Allahut i takon sundimi i qiejve dhe i tokës dhe Allahu është i Fuqishëm për gjithçka.

Shpjegimi i ajetit

Allahu është Pronari dhe Sunduesi i qiejve, i tokës dhe i gjithçkaje mes tyre. Ai vepron, rregullon dhe administron çështjet e krijesave me pushtetin e Tij të plotë e absolut mbi gjithçka në këtë ekzistencë. Veprat dhe përcaktimet e Tij janë të mrekullueshme. Askush nuk mund t'i fshihet shikimit, dëgjimit, dijes dhe pushtetitit të Tij. Askush nuk mund t'i shpëtojë gjykimit të Sunduesit.

Ajetet 190 – 194

190. Në krijimin e qiejve dhe të tokës dhe në ndryshimin e natës e të ditës ka

argumente të qarta për ata që kanë dije dhe urtësi.

191. Janë ata që e përmendin Allahun, kur janë në këmbë, kur janë ulur dhe kur janë shtrirë. Ata thellohen në mendime rreth krijimit të qiejve dhe të tokës *(duke thënë):* "Zoti ynë! Këtë nuk e ke krijuar kot. Larg çdo të mete je Ti! Na ruaj prej dënimit të Zjarrit!

192. Zoti ynë! Pa dyshim, atë që Ti e fut në Zjarr, e ke poshtëruar. Për zullumqarët nuk ka asnjë ndihmues.

193. Zoti ynë, ne dëgjuam një thirrës që ftonte për besim *(e që thoshte):* "Të besoni Zotin tuaj!" E ne besuam! Zoti ynë, na i fal gjynahet tona, na i mbulo të metat, ndërsa pas vdekjes na bashko me të mirët!

194. Zoti ynë, na e dhuro atë që na e ke premtuar nëpërmjet të dërguarve të Tu, dhe mos na turpëro në Ditën e Kijametit! Vërtet Ti nuk e shkel premtimin!"

Shpjegimi i ajeteve

in-ne fi ẖalḳis-semâuâti uel erḍi ue-ẖtilâfil-lejli uen-nehâri

- "Në krijimin e qiejve dhe të tokës dhe në ndryshimin e natës e të ditës..." - Ky ajet është nxitje për adhuruesit, që ata të mendojnë thellë rreth këtyre shenjave madhështore, siç është krijimi i qiejve dhe i tokës dhe shenja të tjera.

Në këtë ajet, fjala *'âjât'* - argumente është në trajtën e pashquar, domethënë, nuk është përcaktuar se për çfarë drejtimi shërbejnë këto argumente. Kjo është bërë, së pari, për të treguar se argumentet e përfituara nga vrojtimi dhe meditimi mbi krijimin e qiejve dhe tokës janë të shumta dhe, së dyti, për të treguar se ato argumente janë gjithëpërfshirëse e jo vetëm për një lëmë të caktuar dijesh.

Është e vërtetë se shenjat që shfaqen në qiej dhe në tokë mrekullojnë çdo vështrues. Ato janë shumë bindëse për ata që mendojnë thellë rreth tyre dhe janë tërheqëse e lumturuese për zemrën e çdo njeriu të sinqertë. Ato udhëzojnë mendjet e ndritura rreth qëllimeve dhe të vërtetave hyjnore. Krijesat mund të shohin në këto shenja aq sa u ka mundësuar i Urti, ndërsa për sa u përket imtësive që fshihen brenda tyre, krijesat nuk mund ta konceptojnë plotësisht, pasi të kuptuarit dhe njohuritë e tyre janë shumë të kufizuara. Megjithatë, diçka është shumë qartë: madhësia dhe gjerësia e qiejve dhe e tokës, rregulli i përpiktë i çdo lëvizjeje të vendosur në të, dëshmojnë fort për madhështinë e Krijuesit të tyre dhe të pushtetit të Tij. Përpikmëria dhe rregulli fantastik që ekziston në qiej dhe në tokë, bukuria e krijimit dhe detajet e mrekullueshme që shfaqen në çdo lëvizje brenda tyre janë dëshmues të padiskutueshëm për urtësinë e të Gjithëdijshmit, që vendos gjithçka në vendin që i takon, për dijen e Tij të pakufishme për gjithçka që ka krijuar. Çdo gjë e dobishme për krijesat që ndodhet në qiej në tokë dhe mes tyre, tregon për mëshirën dhe bujarinë e madhe të Mëshiruesit, si edhe për detyrën e falënderimit dhe të mirënjohjes ndaj Tij.

Pa dyshim, të tilla përsiatje bëjnë që zemra e njeriut të lidhet ngushtë me Krijuesin e këtyre mrekullive, me Atë që i solli në ekzistencë pas inekzistencës, pa pasur nevojë për ndonjë shembull të mëparshëm. Këto shenja madhështore nxisin këdo që mendon drejt dhe me qetësi që të përpiqet maksimalisht për të kënaqur Allahun e Lartësuar, duke e adhuruar Atë si Një, të Vetëm e të Pashoq në çdo aspekt. Ato nxisin që robi t'i përkushtohet Allahut me dashuri, madhërim, frikërespekt, shpresë dhe bindje të plotë, duke iu larguar adhurimit dhe bindjes ndaj çdo krijese, e cila nuk ka asnjë pushtet dhe mundësi në qiej dhe në tokë. Çdo i krijuar është i varfër, i dobët dhe i pafuqishëm kundrejt Zotit të qiejve dhe të tokës.

le âjâtil-li ulil elbâb

- "...ka argumente të qarta për ata që kanë dije dhe urtësi." - Allahu i Lartësuar na thotë në këtë ajet se këto shenja ndikojnë

vetëm tek të mençurit, të urtët e të maturit. Ata që përfitojnë vërtet prej shenjave të Zotit janë njerëzit që vështrojnë drejt tyre me sytë e mendjes, jo vetëm me sytë e ballit.

Pastaj Allahu i Lartësuar na përshkruan gjendjen e këtyre fatlumëve:

El-ledhîne jedhkurûnell-llâhe ḳijâmeu-ue ḳû'ûdeu-ue alâ xhunûbihim

- "Janë ata që e përmendin Allahun, kur janë në këmbë, kur janë ulur dhe kur janë shtrirë." – Ata e përkujtojnë Allahun në çdo gjendje: kur janë në këmbë, kur janë ulur, kur janë shtrirë apo të mbështetur. Këtu bëhet fjalë edhe për namazin, pra, ata e falin namazin në këmbë, e nëse nuk munden, e falin ulur, e nëse nuk munden as ulur, e falin shtrirë.

ue jetefek-kerûne fî ẖalḳis-semâuâti uel erḍi

- "Ata thellohen në mendime rreth krijimit të qiejve dhe të tokës" – Ata meditojnë rreth qëllimit të krijimit të tyre dhe i shohin si argumente të qarta. Kjo tregon se meditimi për nxjerrjen e urtësive apo dobive të krijimit konsiderohet si adhurim, madje si një nga cilësitë më të spikatura të të dashurve të Allahut. Kur meditojnë rreth këtyre shenjave, ata dalin në përfundimin se çdo gjë nuk është krijuar kot e pa qëllim, prandaj thonë:

rab-benâ mâ ẖaleḳ'te hâdhâ bâṭilen sub'ĥâneke

- "Zoti ynë! Këtë nuk e ke krijuar kot. Larg çdo të mete je Ti!" – Kuptimi: Mangësia në emrat, cilësitë dhe veprat e Allahut është e pamundur.

fe ḳinâ adhâben-nâr

- "Na ruaj prej dënimit të Zjarrit!" - Kuptimi: Na ruaj nga dënimi i Zjarrit, duke na ruajtur në këtë jetë nga mendimet, fjalët dhe veprat e këqija, si dhe duke na dhënë sukses për vepra të mira. Vetëm me suksesin dhe mëshirën e dhuruar prej Teje mund të shpëtojmë nga Zjarri.

Kërkesa për të shpëtuar nga Zjarri është në vetvete edhe lutje për t'u futur në Xhenet. Kështu, frikërespekti në zemrat e medituesve i shtyn ata që të luten për gjërat më të rëndësishme.

rab-benâ in-neke men tud'ẖilin-nâra fe ḳad aẖzejtehû

- "Zoti ynë! Pa dyshim, atë që Ti e fut në Zjarr, e ke poshtëruar." - Atë që i Gjithëdituri, i Urti e i Drejti e fut në Zjarr, ai do të jetë i poshtëruar, sepse meriton zemërimin dhe dënimin e Gjithëmëshiruesit. Ai do të jetë i poshtëruar, për shkak të zemërimit të Allahut, të engjëjve dhe të të dashurve të Allahut. Ata do të turpërohen përpara gjithë krijesave dhe kurrë nuk mund t'i shmangen këtij poshtërimi. Askush nuk do të mund t'i shpëtojë ata nga ky turp. I Madhëruari ua përkujton atyre këtë fakt, kur thotë:

ue mâ liḍh-ḍhâlimîne min enṣâr

- "Për zullumqarët nuk ka asnjë ndihmues." - E kush mund t'i shpëtojë ata nga ndëshkimi i të Urtit, të Drejtit?! Fjala 'zullumqar' tregon se ata do të hyjnë në Zjarr për shkak të padrejtësisë së tyre.


rab-benâ in-nenâ semi'nâ munâdijej-junâdî lil îmâni en âminû bi rab-bikum

- "Zoti ynë, ne dëgjuam një thirrës që ftonte për besim *(e që thoshte):* "Të besoni Zotin tuaj!"" - Këtu është fjala për Muhamedin (a.s.), sepse ai i ftoi njerëzit në *iman* dhe i nxiti ata që ta pasojnë rrugën e shpëtimit. Ai i tregoi të gjitha piketat e kësaj rruge. Pejgamberi (a.s.) sqaroi themelet e besimit dhe degëzimet e tij.

fe âmen-nâ

- "E ne besuam!" – Kuptimi: Ne iu përgjigjëm thirrjes së tij dhe shpejtuam drejt udhës së treguar prej tij.

Në këtë lutje të mrekullueshme që këta fatlumë i drejtojnë Allahut të Lartësuar ka ngjyra të forta mirënjohjeje dhe dashurie për


الجزء الرابع سورة آل عمران
فَٱسْتَجَابَ لَهُمْ رَبُّهُمْ أَنِّي لَآ أُضِيعُ عَمَلَ عَٰمِلٍ مِّنكُم مِّن
ذَكَرٍ أَوْ أُنثَىٰ ۖ بَعْضُكُم مِّنۢ بَعْضٍ ۖ فَٱلَّذِينَ هَاجَرُوا۟ وَأُخْرِجُوا۟
مِن دِيَٰرِهِمْ وَأُوذُوا۟ فِى سَبِيلِى وَقَٰتَلُوا۟ وَقُتِلُوا۟ لَأُكَفِّرَنَّ
عَنْهُمْ سَيِّـَٔاتِهِمْ وَلَأُدْخِلَنَّهُمْ جَنَّٰتٍ تَجْرِى مِن تَحْتِهَا
ٱلْأَنْهَٰرُ ثَوَابًا مِّنْ عِندِ ٱللَّهِ ۗ وَٱللَّهُ عِندَهُۥ حُسْنُ ٱلثَّوَابِ ﴿١٩٥﴾
لَا يَغُرَّنَّكَ تَقَلُّبُ ٱلَّذِينَ كَفَرُوا۟ فِى ٱلْبِلَٰدِ ﴿١٩٦﴾ مَتَٰعٌ قَلِيلٌ
ثُمَّ مَأْوَىٰهُمْ جَهَنَّمُ ۚ وَبِئْسَ ٱلْمِهَادُ ﴿١٩٧﴾ لَٰكِنِ ٱلَّذِينَ ٱتَّقَوْا۟
رَبَّهُمْ لَهُمْ جَنَّٰتٌ تَجْرِى مِن تَحْتِهَا ٱلْأَنْهَٰرُ خَٰلِدِينَ فِيهَا
نُزُلًا مِّنْ عِندِ ٱللَّهِ ۗ وَمَا عِندَ ٱللَّهِ خَيْرٌ لِّلْأَبْرَارِ ﴿١٩٨﴾ وَإِنَّ مِنْ
أَهْلِ ٱلْكِتَٰبِ لَمَن يُؤْمِنُ بِٱللَّهِ وَمَآ أُنزِلَ إِلَيْكُمْ
وَمَآ أُنزِلَ إِلَيْهِمْ خَٰشِعِينَ لِلَّهِ لَا يَشْتَرُونَ بِـَٔايَٰتِ ٱللَّهِ
ثَمَنًا قَلِيلًا ۚ أُو۟لَٰٓئِكَ لَهُمْ أَجْرُهُمْ عِندَ رَبِّهِمْ ۗ إِنَّ ٱللَّهَ
سَرِيعُ ٱلْحِسَابِ ﴿١٩٩﴾ يَٰٓأَيُّهَا ٱلَّذِينَ ءَامَنُوا۟ ٱصْبِرُوا۟
وَصَابِرُوا۟ وَرَابِطُوا۟ وَٱتَّقُوا۟ ٱللَّهَ لَعَلَّكُمْ تُفْلِحُونَ ﴿٢٠٠﴾
سورة النساء
٧٦

Atë që u dhuroi besimin. Ajo është gjithashtu një kërkesë me edukatë, përgjërim dhe përulje, që Allahu t'ua vazhdojë dritën që ua ka dhënë fillimisht. Ky është një ndërmjetësim i mrekullueshëm tek i Madhëruari me një nga mënyrat më të bukura të ndërmjetësimit: me veprat e mira. Është vetëm suksesi i falur nga Bujari, që i bëri këta njerëz që të luten me të tilla fjalë.

rab-benâ fe-gfir lenâ dhunûbenâ ue kef-fir an-nâ sej-ji'âtinâ

- "Zoti ynë, na i fal gjynahet tona, na i mbulo të metat" - Pra, pas kësaj hyrjeje me edukatë, vjen lutja për falje e mbulim gjynahesh dhe lutja për sukses në kryerjen e veprave të mira, të cilat i fshijnë të këqijat. Kjo është shprehje e bindjes së patundur se Ai që u dhuroi mirësinë e besimit, po Ai do t'ua japë shpëtimin e përjetshëm.

ue teuef-fenâ meal eb'râr

- "...ndërsa pas vdekjes na bashko me të mirët!" - Ata i luten Allahut që t'u japë sukses në kryerjen e të mirave dhe në lënien e të këqijave, sepse vetëm në këtë mënyrë robi mund të quhet 'vepërmirë'. Kjo është, gjithashtu, lutje për të qenë i vazhdueshëm e sistematik në këtë rrugë të mirë, deri në vdekje.

rab-benâ ue âtinâ mâ ueadt-tenâ alâ rusulike ue lâ tuħzinâ jeumel ḳijâmeti in-neke lâ tuħliful mîâd!

- "Zoti ynë, na e dhuro atë që na e ke premtuar nëpërmjet të dërguarve të Tu, dhe mos na turpëro në Ditën e Kijametit! Vërtet Ti nuk e shkel premtimin!" - Këta fatlumë, pasi përkujtojnë me falënderim dhe mirënjohje të thellë suksesin që Allahu i Lartësuar u ka dhënë me udhëzimin në besim, dhe pasi i luten që t'ua plotësojë deri në fund këtë mirësi, ata kërkojnë shpërblimin që Allahu u ka premtuar nëpërmjet profetëve të Tij: që t'i ndihmojë dhe t'i bëjë fitues në këtë jetë, ndërsa në jetën tjetër t'i shpëtojë nga çdo e keqe dhe t'u japë mirësitë e pafundme në Xhenet. Dhe Allahu i Lartësuar nuk e shkel kurrë premtimin, prandaj Ai i përgjigjet lutjes së tyre dhe i mëshiron ata.

Ajeti 195

195. Zoti i tyre iu përgjigj lutjes së tyre *(e tha)*: 'Unë nuk ia humb mundin asnjërit prej jush, mashkull qoftë apo femër. Ju jeni prej njëri-tjetrit.' Atyre që u dëbuan prej shtëpive të tyre dhe emigruan, që u munduan vetëm pse ishin në rrugën Time, që luftuan dhe u vranë, atyre patjetër do t'ua shlyej gjynahet dhe do t'i fus në Xhenete, në të cilët burojnë lumenj. Ky shpërblim është prej Allahut. Tek Allahu është shpërblimi më i mirë.

Shpjegimi i ajetit

fe-stexhâbe lehum rab-buhum en-nî lâ uđîu amele âmilim-minkum-min dhekerin eu unthâ

- "Zoti i tyre iu përgjigj lutjes së tyre *(e tha)*: 'Unë nuk ia humb mundin asnjërit prej jush, mashkull qoftë apo femër." - Allahu i Lartësuar iu përgjigj dhe i pranoi lutjet dhe adhurimet e tyre. Ai i pranoi të dyja llojet e duave që ata i drejtuan: duanë e adhurimit dhe duanë e kërkesave. Allahu i Lartësuar premtoi se nuk do të humbasë çdo vepër të kryer nga adhuruesit dhe adhurueset e Tij. Çdokush do ta marrë të plotë e të pacunguar shpërblimin e punëve të veta.

ba'ðukum-min bea'ð

- "Ju jeni prej njëri-tjetrit." – Kuptimi: Të gjithë jeni të barabartë përballë shpërblimit dhe ndëshkimit që meritoni. Të gjithë do të llogariten dhe shpërblehen me drejtësi.

fel-ledhîne hâxherû ue uħrixhû min dijârihim ue ûdhû fî sebîlî ue ḳâtelû ue ḳutilû

- "Atyre që u dëbuan prej shtëpive të tyre dhe emigruan, që u munduan vetëm pse ishin në rrugën Time, që luftuan dhe u vranë..." - Këtu flitet për ata të cilët i bashkoi feja dhe emigrimi për hir të Zotit dhe që, për hir të kësaj feje, ata braktisën çdo gjë të dashur të tyre: atdheun, pasurinë dhe gjithçka që zotëronin. Ata lanë gjithçka, vetëm për hir të besimit dhe kënaqësisë së Allahut, të Adhuruarit të tyre të vetëm. Ata duruan gjithçka për hir të besimit dhe për hir të tij luftuan me gjithçka që zotëronin, madje edhe me jetën e tyre. Për këtë arsye, ata meritonin një shpërblim të madh nga i Urti, i Mëshirshmi, Bamirësi e Bujari, që thotë:

le ukef-firan-ne anhum sej-jiâtihim ue le ud'ĥilen-nehum xhen-nâtin texh'rî min taĥtihal enhâru theuâbem-min indil-lâhi

- "...atyre patjetër do t'ua shlyej gjynahet dhe do t'i fus në Xhenete, në të cilët burojnë lumenj. Ky shpërblim është prej Allahut." - Është qartësisht i kuptueshëm dhe i gëzueshëm ky premtim i mrekullueshëm. Allahu i Lartësuar është Ai që jep shpërblim të madh edhe për vepra të vogla. Shpërblimi i Tij është shumë i madh dhe Ai na nxit që ta kërkojmë atë me këmbëngulje, kur thotë:

uell-llâhu indehû ĥusnuth-theuâb

- "Tek Allahu është shpërblimi më i mirë." – Pra, vetëm tek Allahu mund të shpresohet shpërblimi më i mirë. Atje ka mirësi e mrekulli që as syri nuk i ka parë, as veshi nuk i ka dëgjuar dhe as zemra nuk i ka imagjinuar. E pra, kjo është një ftesë për këdo që e kërkon dhe e synon këtë mirësi. Çdokush që do këtë nderim, le ta ndihmojë veten me vepra e fjalë të mira në bindje ndaj Allahut të Lartësuar dhe duke u afruar drejt Tij me çdo rrugë të ligjëruar nga Ai vetë, nëpërmjet Profetit të Tij.

Ajetet 196 – 198

196. Mos të të mashtrojë bredhja nëpër qytete e atyre që nuk besojnë.
197. Ajo është një kënaqësi e vogël, se pastaj fundi i tyre do të jetë Xhehenemi, që është vend mjerimi.
198. Ndërsa ata që i druhen Zotit të tyre, ata do të kenë Xhenete, nëpër të cilët rrjedhin lumenj dhe në të cilët do të jenë përgjithmonë. Kjo është pritje nga Allahu. Ajo çka gjendet tek Allahu është më e mirë për të mirët.

Shpjegimi i ajeteve

lâ jeġur-ran-neke teḳal-lubul-ledhîne keferû fil bilâd

- "Mos të të mashtrojë bredhja nëpër qytete e atyre që nuk besojnë." - Këto ajete janë një ngushëllim për besimtarët, një qetësim i zemrave të tyre, nëse shohin mohuesit që shijojnë kënaqësitë e kësaj bote.

Mohuesit e Zotit kënaqen të shfrenuar me bukuritë e kësaj bote. Ata vërtiten nëpër tokë, duke përvetësuar të mirat e saj materiale dhe duke përjetuar kënaqësi të shumta. Në disa momente, atyre u jepet mundësi të zotërojnë dhe të shfaqin krenari

dhe epërsi në aspekte të caktuara të kësaj jete.

Sigurisht, këto pamje ndikojnë në zemrën e muslimanit dhe mund të bëhen shkak për t'u joshur dhe për t'u mashtruar prej tyre. Për këtë arsye, i Urti dhe i Madhëruari na tërheq vërejtjen dhe na qetëson zemrën njëkohësisht, që të mos mashtrohemi dhe të joshemi nga jeta dhe përjetimet e tyre të përkohshme, sepse vështrimi ynë duhet të shkojë më larg, llogaritë tona duhet të bëhen me urtësi. Allahu na rikujton se është një jetë tjetër e pafundme, e cila meriton çdo sakrificë. Kjo jetë dhe këto përjetime janë të shkurtra, ndërsa përjetësia është në ahiret.

metâun ḳalîlun thum-me me'uâhum xhehen-nemu ue bi'sel mihâd

- "Ajo është një kënaqësi e vogël, se pastaj fundi i tyre do të jetë Xhehenemi, që është vend mjerimi." – Kënaqësitë e dynjasë janë cilësuar si 'të vogla', që nuk kanë vazhdimësi. Pas përjetimit të shkurtër të tyre, ata do të ndëshkohen pafundësisht. Kjo është e vetmja shpresë e mohuesve të Zotit. Kënaqësitë e tyre e kanë përfundimin të hidhur.

lâkinil-ledhînet-teḳau rab-behum

- "Ndërsa ata që i druhen Zotit të tyre..." - *Muteḳin*-ët, pra, të devotshmit, ata me besim të pastër e të sinqertë, do të gëzojnë krenarinë dhe kënaqësitë në këtë jetë, por shpresojnë edhe një premtim të sigurt nga i Adhuruari i tyre i Vetëm, që thotë:

lehum xhen-nâtun texhrî mintaĥtihâl enhâru ħalidîne fîhâ nuzulem-min indil-lâhi

- "...ata do të kenë Xhenete, nëpër të cilët rrjedhin lumenj dhe në të cilët do të jenë përgjithmonë. Kjo është pritje nga Allahu." - Edhe sikur ata të kishin vetëm vuajtje, dhimbje e vështirësi në këtë dynja, të gjitha do të ishin të papërfillshme sapo thjesht të përkujtonin premtimin e madh të të Lavdëruarit, Bamirësit e Bujarit. Mirësitë dhe kënaqësitë në Xhenet janë të pasosura, atje nuk njihet lodhja, vështirësia dhe vuajtja. Atje ka vend veçse për gëzimin, lumturinë, kënaqësinë dhe prehjen. Përpara këtij premtimi, pra, çdo vështirësi kthehet në kënaqësi. Kështu, besimtarët, përveç mirësive që shijojnë në këtë dynja, do të përjetojnë atë që është më mirë tek Allahu i Lartësuar. Prandaj thotë i Mëshirshmi:

ue mâ indell-llahi ħajrul-lil ebrâr.

- "Ajo çka gjendet tek Allahu është më e mirë për të mirët." - Zemrat e besimtarëve janë të pastra, prandaj edhe ndjenjat, fjalët dhe veprat e tyre janë të mira. Për këtë arsye, Bamirësi, Mirënjohësi dhe i Lavdëruari u jep atyre, me mëshirën e Tij, një shpërblim të madh, dhurata të shumta e të mrekullueshme dhe një fitore të përhershme.

Ajetet 199 – 200

199. Edhe nga ithtarët e Librit ka të tillë që besojnë Allahun, që besojnë edhe atë që ju është shpallur juve, edhe atë që u është shpallur atyre. Ata janë të druajtur ndaj Allahut, dhe argumentet e Allahut në Shpallje nuk i shesin për gjëra të vogla të kësaj jete. Të tillët kanë shpërblimin e vet te Zoti i tyre. Allahu është i shpejtë në llogarinë e Tij.

200. O ju që keni besuar, bëni durim, bëhuni të qëndrueshëm kundër armikut, rrini vigjilentë dhe ruajuni dënimit të Allahut, që të shpëtoni.

Shpjegimi i ajeteve

ue in-ne min ehlil kitâbi le mej-ju'minu bil-lâhi ue mâ unzile ilejkum ue mâ unzile ilejhim

- "Edhe nga ithtarët e Librit ka të tillë që besojnë Allahun, që besojnë edhe atë që ju është shpallur juve, edhe atë që u është shpallur atyre." - Nga ithtarët e Librit ka edhe prej atyre që Allahu i Lartësuar u ka dhënë sukses për të pranuar udhëzimin e vërtetë. Ata kanë disa cilësi: ata besojnë Allahun e Lartësuar, ata besojnë Kur'ânin dhe Sunetin, ata besojnë edhe Shpalljen që u

është dhënë atyre. I tillë është besimi i drejtë, ndryshe nga ata të cilët disa shpallje hyjnore i besojnë dhe disa i mohojnë.

Duke qenë se besimi i tyre është i drejtë dhe i plotë, në zemrat e tyre lind droja ndaj Allahut të Lartësuar.

ħâshi'îne lil-lâhi

- "Ata janë të druajtur ndaj Allahut..." - Ky besim i sinqertë bëri që ata të nënshtrohen të bindur para madhështisë së Allahut të Lartësuar dhe të jenë të kujdesshëm në zbatimin e çdo urdhri dhe largimin nga çdo ndalesë që sqarohet në Librin e Allahut dhe nga Profeti i Tij. Këta e meritojnë të quhen 'ithtarë të Librit' dhe përqafues të dijes dhe të së vërtetës, sikurse thotë i Lartësuari: "Prej robërve të Tij, Allahut i frikësohen veçse dijetarët".

Shenjë e drojës së vërtetë të tyre ndaj Allahut të Lartësuar është edhe një fakt i rëndësishëm, siç thotë i Lartësuari:

lâ jeshterûne bi âjâtil-lâhi themenen ḳalîlâ

- "...dhe argumentet e Allahut në Shpallje nuk i shesin për gjëra të vogla të kësaj jete." – Ata nuk e preferojnë kurrë këtë jetë dhe përjetimet e saj mashtruese kundrejt të vërtetës së pakundërshtueshme, sikundër veprojnë të devijuarit, të prishurit e të humburit, të cilët e fshehin të vërtetën e zbritur nga Zoti për hir të një çmimi të vogël. Të sinqertët janë shumë të dashuruar pas të vërtetës, prandaj nuk mund ta shesin aq lehtë. Ata e dinë se kjo tregti është gjithnjë e humbur. E si mund të kënaqen me humbjen të diturit, të urtët, të mençurit dhe të sinqertët?! Dëshirat dhe qëllimet vetjake nuk janë kurrë arsye për ata që jetojnë për të vërtetën. Ata e ndiejnë kënaqësinë që të ofron e vërteta dhe jeta sipas saj. Pa dyshim, kjo është fitorja më e madhe që mund të arrijë njeriu në këtë jetë dhe në tjetrën. Për këtë arsye, ata i japin përparësi të vërtetës dhe qartësimit të saj ndër njerëz. Ata jetojnë për të ftuar dhe inkurajuar njerëzit që ta pranojnë të vetmen mundësi për të qenë të lumtur. Ata qortojnë dhe këshillojnë njerëzit që t'i largohen të kotës. Për këtë arsye, Allahu i Lartësuar i shpërblen ata shumëfish:

ûlãike lehum exh'ruhum inder-rab-bihim

- "Të tillët kanë shpërblimin e vet te Zoti i tyre." - Ky është premtim për një shpërblim të madh. Më tej, Allahu i përgëzon me diçka tjetër:

in-nell-llâhe serîul hisâb

- "Allahu është i shpejtë në llogarinë Tij." – Pra, mos e mendo si të largët shpërblimin e mrekullueshëm të Allahut të Lartësuar, sepse ai është shumë afër. Allahu i Lartësuar llogarit dhe shpërblen shpejt.


Më pas, Allahu i Lartësuar u drejtohet të gjithë besimtarëve me një këshillë, e cila është shumë të vlefshme për këdo që synon suksesin e vërtetë, fitoren, lumturinë dhe shpërblimin:

jã ej-juhel-ledhîne âmenu-sbirû ue sâbirû ue râbiṭû uet-teḳûll-llâhe leal-lekum tufliĥûn

- "O ju që keni besuar, bëni durim, bëhuni të qëndrueshëm kundër armikut, qëndroni vigjilentë dhe ruajuni dënimit të Allahut, që të shpëtoni." - Rruga drejt suksesit kalon, së pari, përmes durimit. Është e domosdoshme të mos largohesh asnjë çast nga rruga e durimit. Durim do të thotë të nënshtrosh vetveten për të kryer detyrimet dhe veprat e mira, edhe nëse është e vështirë për ta bërë këtë, do të thotë të lësh gjynahet dhe mosbindjen ndaj Allahut, do të thotë të pranosh me kënaqësi caktimin e Allahut gjatë sprovave e fatkeqësive, do të thotë, pra, të zbatosh të gjitha këto detyrime, që janë të vështira për nefsin.

Së dyti, Allahu na urdhëron për të qenë sistematikë e të vazhdueshëm në durim dhe në luftën kundër armiqve, në çdo kohë e gjendje.

Së treti, Allahu urdhëron për vigjilencë ndaj armikut. Pra, të ruhemi nga qëllimet dhe sulmet e armikut, t'ia zëmë atij çdo



shteg e mundësi për të na sulmuar e dëmtuar. Të mos e lejojmë atë të godasë qëllimet tona. Vetëm në këtë mënyrë mund të shpresohet për suksesin, që të fitojmë çdo të mirë të dynjasë dhe të ahiretit dhe që të shpëtojmë nga çdo e keqe e dynjasë dhe e ahiretit.

Me pak fjalë, suksesi i vërtetë arrihet veçse me durim, qëndrueshmëri sistematike, vigjilencë ndaj planeve të armikut dhe, sigurisht, me devotshmëri. Megjithatë, Allahu është i vetmi që jep sukses. Nuk ka forcë e ndryshim të gjendjes me mënyrë tjetër, por veçse me ndihmën e Allahut të Lartësuar.

Këtu përfundon dhe tefsiri i sures Al Imran. I lavdëruar qoftë Allahu për çdo mirësi të dhuruar prej Tij. E lusim Atë që ta plotësojë dhe përsosë mirësinë e Tij ndaj nesh.

Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve!

Surja 4 – El nisa (Sure medinase)
176 ajete

Me emrin e Allahut, të gjithmëshirshmit, Mëshirëplotit!

Ajetet 1 – 2

1. O njerëz! Kini drojë prej Zotit tuaj, i Cili ju krijoi prej një njeriu të vetëm, ndërsa prej tij krijoi bashkëshorten, e prej atyre të dyve u shtuan shumë meshkuj e femra. Kini drojë prej Allahut, me emrin e të Cilit përbetoheni dhe ruajini lidhjet farefisnore! Vërtet, Allahu është Mbikëqyrësi juaj i përhershëm.

2. Jepuani pasurinë jetimëve dhe mos e përzieni pasurinë e pastër me të ndyrën. Mos e hani pasurinë e tyre duke e përzier me pasurinë tuaj, se ky është një gjynah i madh.

Shpjegimi i ajeteve

- "O njerëz! Kini drojë prej Zotit tuaj, i Cili ju krijoi prej një njeriu të vetëm, ndërsa prej tij krijoi bashkëshorten, e prej atyre të dyve u shtuan shumë meshkuj e femra." - Allahu i Lartësuar e ka filluar këtë sure me një urdhër për devotshmëri dhe bindje ndaj Tij, si dhe ka nxitur për të ruajtur lidhjet farefisnore. Ai e qartëson arsyen pse duhen zbatuar këto urdhra dhe pse duhet të pajisemi me devotshmëri: Allahu është Krijuesi juaj, që ju furnizon dhe përkujdeset për ju, duke ju dhënë çdo gjë të nevojshme.

Një nga mirësitë e mëdha të Allahut ndaj nesh është fakti që Ai na krijoi prej një njeriu të vetëm, Ademit (a.s.), prej të cilit krijoi palën tjetër, gruan, që të jetë prehje dhe qetësim për burrin. Kështu Allahu i Lartësuar e ka plotësuar mirësinë e Tij ndaj robërve, duke u falur atyre gëzim, kënaqësi dhe lumturi, prandaj devotshmëria e tyre ndaj Tij është vërtet e merituesshme.

Më pas, Allahu i Lartësuar sjell edhe një arsye tjetër për të qenë të devotshëm ndaj Tij:

- "Kini drojë prej Allahut, me emrin e të Cilit përbetoheni dhe ruajini lidhjet farefisnore!" - Është pikërisht Allahu, me emrin e të Cilit betohemi për të arritur qëllimet tona, Ai ndaj të Cilit urdhërohemi të jemi të devotshëm dhe të bindur. Kur duam të arrijmë qëllimet tona, ne betohemi në emër të Allahut, sepse kështu realizimi është më i sigurt. Dihet shumë mirë se kur i lutesh dikujt për diçka, duke i thënë: "Të kërkoj ta bësh këtë gjë për hir të Allahut!", ai nuk të refuzon, sepse madhërimi i Allahut në zemër nuk e lejon një gjë të tillë. Kështu, ne urdhërohemi për devotshmëri dhe bindje ndaj Zotit, dhe kjo nuk është diçka e panatyrshme për ne.

Arsyeja për të qenë të devotshëm e të bindur ndaj Allahut bëhet edhe më e fortë kur kujtojmë se Ai është Mbikëqyrësi ynë, që dëshmon gjithçka që ne veprojmë:

- "Vërtet, Allahu është Mbikëqyrësi juaj i përhershëm." - Ai është mbikëqyrës i robërve. Ai i vështron ata në çdo gjendje, gjatë lëvizjes dhe qetësisë, kur janë mes njerëzve dhe larg syve të tyre. Nëse jemi të vetëdijshëm për këtë mbikëqyrje, ajo do të kultivojë në shpirtin tonë drojën ndaj Allahun, turpin, devotshmërinë dhe bindjen e vazhdueshme ndaj Tij.

Allahu i Lartësuar na nxit që të meditojmë mbi faktet e krijimit të Tij. Ai na ka shpërndarë nëpër tokë, edhe pse origjina jonë është e njëjtë dhe e përbashkët. Pikërisht për shkak të kësaj origjine të njëjtë, njerëzit duhet të jenë të butë dhe të mëshirshëm me njëri-tjetrin. Për të përforcuar këtë ndjenjë në zemrat e tyre, Allahu i Lartësuar, menjëherë pasi i urdhëron ata që të jenë njësues në adhurimin ndaj Tij, i urdhëron për bamirësi dhe mëshirë ndaj njëri-tjetrit dhe i ndalon nga ndarja, largimi dhe armiqësia mes tyre. Ashtu sikurse është detyrë përmbushja e detyrimeve ndaj Zotit, duke e adhuruar Atë si Një të Vetëm, ashtu duhen plotësuar edhe detyrimet ndaj krijesave, sidomos ndaj të afërmve, madje respektimi i të drejtave të tyre është pjesë përbërëse dhe e pandashme e respektimit të të drejtave të Zotit mbi krijesat e Tij, për të cilat Ai ka urdhëruar të plotësohen dhe për to do t'i marrë në përgjegjësi Ditën e Llogarisë.

Shihni se si Allahu e fillon këtë sure me urdhrin për devotshmëri ndaj Tij dhe për bamirësi ndaj prindërve, grave, jetimëve dhe njerëzve në përgjithësi, për të vazhduar pastaj me një shpjegim të hollësishëm të këtyre të drejtave gjatë gjithë sures. Kështu, fillimisht, Allahu përshkruan të drejtat që njeriu duhet të plotësojë, dhe pastaj, në vijim të sures, i shpjegon ato me imtësi e mjaft bukur.

Në këtë ajet, Allahu i Lartësuar thotë: "…ndërsa prej tij *(burrit)* krijoi bashkëshorten". Kjo kuptohet edhe si një këshillë për t'u përpjekur maksimalisht për plotësimin e të drejtave të grave, sepse Allahu i Lartësuar i ka krijuar ato nga një pjesë e burrit (nga brinja e Ademit a.s.). Kjo është arsyeja përse mes burrit dhe gruas ekziston një lidhje dhe afrimitet shumë i fortë. Pra, ajeti sikur thotë: "Kujtojeni këtë fakt, prandaj ndërtojeni jetën tuaj mbi dashurinë dhe mëshirën e ndërsjelltë. Ju jeni bërë për të qenë shumë të afërt me njëri-tjetrin." Allahu i Lartësuar thotë:

- "Jepuani pasurinë jetimëve..." - Kur shtjellon imtësisht të drejtat njerëzore që ne duhet të përmbushim, Allahu i Lartësuar e fillon me të drejtat e jetimëve. 'Jetimë' quhen fëmijët që janë nën moshën e pjekurisë e të pafuqishëm për të përballuar jetën, të cilët kanë humbur prindërit e tyre që përkujdesen për ta.

Kështu, i Gjithëmëshirshmi dhe i Dashuri i urdhëron robërit e Tij që të jenë bamirës me këtë kategori njerëzish.

Allahu i Lartësuar e ka ndaluar që t'i afrohemi pasurisë së jetimëve, përveçse po ta bëjmë këtë në mënyrën më të mirë dhe më dobiprurëse për ta. Ai ka urdhëruar që, kur ata të arrijnë moshën e pjekurisë dhe kur të

shihet qartë tek ata aftësia për të administruar drejt pasurinë, atëherë t'u dorëzohet pasuria e tyre.

Allahu i Lartësuar thotë:

- "...dhe mos e përzieni pasurinë e pastër me të ndyrën." - Ky është një urdhër për ta trajtuar pasurinë e jetimëve veçse në mënyrë të lejuar. Ne duhet të jemi të kujdesshëm që pasurinë tonë të pastër të mos e përziejmë me pasuri të papastër, haram, që është marrë padrejtësisht nga pasuria e jetimëve ose me rrugë jo të lejuara. Nga ana tjetër, nëse e shfrytëzojmë pasurinë e tyre në mënyrë të drejtë dhe brenda kufijve të caktuar nga Allahu, atëherë ajo është hallall.

- "Mos e hani pasurinë e tyre duke e përzier me pasurinë tuaj, se ky është një gjynah i madh." – Kuptimi: Mos e përzieni pasurinë e tyre me tuajën, për të përfituar prej saj. Mjaftohuni me pasurinë tuaj, të cilën Allahu jua ka dhuruar dhe mos shpenzoni prej pasurisë së jetimëve për veten tuaj. Ai që merr guximin të bëjë një vepër të tillë të ulët, le ta dijë se ky është një gjynah shumë i madh. Kjo është një përgjegjësi shumë e madhe para Zotit tuaj.

Përzierja e pasurisë së pastër me të papastër bëhet me forma të ndryshme, për shembull, kur kujdestari ligjor i jetimit merr prej pasurisë së jetimit mallin e mirë dhe e zëvendëson atë me mall të keq.

Nga ky ajet kuptohet edhe ligjshmëria e kujdestarisë mbi jetimin, e pikërisht kur flitet për detyrimin që pasuria t'i kthehet jetimit, sepse ai që detyrohet nga ligji për t'i kthyer pasurinë jetimit është vetëm ai që ligji i ka dhënë të drejtën e kujdestarisë ligjore mbi të.

Ajeti udhëzon për bamirësi dhe mirëadministrim të pasurisë së jetimit. Pasuria e jetimit duhet të ruhet, të kultivohet dhe të përmirësohet.

Ajetet 3 – 4

3. Në qoftë se druheni se nuk do të jeni të drejtë ndaj jetimeve, atëherë martohuni me gra të mira që ju pëlqejnë: me dy, tri apo me katër, por nëse druheni se nuk do t'i përmbaheni drejtësisë ndaj tyre (*grave*), atëherë (*martohuni*) vetëm me një grua, ose me ato që keni në pronësinë tuaj (*robëreshat*). Kjo do ta bëjë më të lehtë, që të mos bini në padrejtësi.
4. Jepuni grave mehrin e tyre, në shenjë bindjeje ndaj Zotit. Në qoftë se ato, me dëshirën e tyre, ju falin diçka nga ai (*mehri*), atëherë përdoreni atë, se tashmë ai është hallall dhe i mirë për ju.

Shpjegimi i ajeteve

- "Në qoftë se druheni se nuk do të jeni të drejtë ndaj jetimëve, atëherë martohuni me gra të mira që ju pëlqejnë: me dy, tri apo me katër..." – Kuptimi: Nëse druheni se do të jeni të padrejtë dhe nuk do të plotësoni si duhet detyrimet ligjore ndaj femrave jetime që ndodhen nën përkujdesin tuaj, sepse nuk do t'i donit sa duhet si bashkëshorte, atëherë mos u martoni me to, por martohuni me gra të tjera, që ju pëlqejnë dhe janë të mira për ju në drejtim të fesë, pasurisë, bukurisë, fisnikërisë së tyre apo në cilësi të tjera që ju nxisin të martoheni me to.

Megjithatë, dijeni se cilësia më e mirë që duhet të synoni te bashkëshortet tuaja është besimi dhe feja e tyre, sikurse ka thënë Pejgamberi (a.s.): *"Me një grua martohesh për katër gjëra të saj: për pasurinë, për bukurinë, për fisin dhe për fenë e saj. Zgjidh atë fetaren, të lumshin duart!"*

Nga ky ajet kuptojmë që është detyrë për njeriun që të kujdeset dhe të zgjedhë mirë para martesës. Madje, Sheriati e ka lejuar burrin që edhe ta shohë gruan me të cilën synon që të martohet, në mënyrë që të jetë i sigurt për zgjedhjen e tij.

Më pas, Allahu i Lartësuar përmend numrin e grave të lejuar nga Sheriati për t'u martuar: "...me dy, tri apo me katër". Pra, ai që dëshiron të martohet me dy, le ta bëjë, ai që dëshiron të martohet me tre, le ta bëjë, ai

që dëshiron të martohet me katër, le ta bëjë, por më shumë nuk lejohet më. Ajeti vjen në një mënyrë të tillë që tregon mirësinë e Zotit me ligjin që ka vendosur për ne, prandaj nuk lejohet që ta tejkalojmë atë. Ky është një mendim unanim i dijetarëve.

Allahu i Gjithëdijshëm dhe i Gjithëmëshirshëm e ka bërë këtë ligj, sepse, shpesh, dëshirat seksuale të mashkullit nuk mund të plotësohen vetëm me një grua, prandaj kërkon të dytën. Për këtë arsye, Ai ua lejoi robërve të Tij që të kenë deri në katër gra njëherësh. Ky numër është mëse i mjaftueshëm për çdo burrë, përveç rasteve të rralla, të cilat gjithsesi nuk meren si bazë në ligjërimin e dispozitave. Ato kanë udhëzime të veçanta dhe sheriati ka përcaktuar zgjidhje të caktuara.

Megjithatë, Allahu i Lartësuar e ka lejuar martesën me më shumë se një grua, por me kusht që burri të jetë i sigurt në vete se nuk i kalon kufijtë dhe nuk bëhet i padrejtë ndaj grave. Me fjalë të tjera, është kusht mbajtja e drejtësisë mes grave, nëse dëshiron të martohesh me më shumë se një. Nëse burri druhet se nuk e mban drejtësinë mes tyre, atëherë le të kufizohet me një, ose le të përmbushë kërkesat e tij me skllavet që i ka në pronësinë e tij. Ai nuk e ka detyrë që t'i ndajë netët me skllavet në mënyrë të barabartë. Pra, nëse nuk është i sigurt se mund ta mbajë drejtësinë mes bashkëshorteve, atëherë duhet të martohet vetëm me një grua, siç thotë i Lartësuari më pas:

- "...por nëse druheni se nuk do t'i përmbaheni drejtësisë ndaj tyre *(grave)*, atëherë *(martohuni)* vetëm me një grua, ose me ato që keni në pronësinë tuaj *(robëreshat)*. Kjo do ta bëjë më të lehtë, që të mos bini në padrejtësi." – Pra, kufizimi i martesës vetëm me një grua është më i sigurt për t'u ruajtur nga padrejtësia.

Nga ky ajet mësojmë se njeriu duhet të jetë i kujdesshëm dhe të mos i hyjë një pune, gjatë së cilës nuk ka siguri prej vetes se do të mbajë drejtësinë apo se do t'i japë hakun. Ai nuk duhet të marrë një përgjegjësi të cilën nuk e mban dot apo që nuk i jep hakun, edhe nëse në vetvete kjo punë mund të jetë e lejueshme. Pra, robi le të jetë i kujdesshëm, që t'u shmanget çështjeve të cilat sjellin padrejtësi dhe vuajtje. Qetësia dhe ruajtja nga padrejtësitë janë nga mirësitë më të mira që mund t'i dhurohen një njeriu.

Duke qenë se shumë njerëz u bëjnë padrejtësi grave dhe ua mohojnë të drejtat e tyre, e sidomos në drejtim të mehrit që ato meritojnë të marrin nga burrat e tyre, Allahu i Lartësuar ka dhënë urdhër për plotësimin e këtij detyrimi. Kjo shkelje ndodh zakonisht kur masa e mehrit është e madhe dhe burri ia kërkon sërish gruas që t'ia kthejë mbrapsht atë që i ka dhënë. Për këtë arsye, i Lartësuari thotë:

- "Jepuni grave mehrin e tyre, në shenjë bindjeje ndaj Zotit." – Pra, jo vetëm që t'u jepni mehrin, gjë që e keni të detyrueshme, por edhe që dhënia të bëhet me kënaqësi dhe dashamirësi nga ana juaj. Jepeni atë në shenjë bindjeje ndaj Zotit tuaj, me qetësi, dashuri dhe kënaqësi. Kurrsesi mos ua vononi mehrin, kur jeni në gjendje ta përmbushni këtë detyrim dhe as mos ua cungoni atë, por jepuani të plotë dhe me kënaqësi, dëshirë dhe dashamirësi.

Nga ky ajet kuptojmë se mehri i jepet gruas, e cila bëhet pronarja e kësaj pasurie që në momentin e lidhjes së aktit martesor, sepse Allahu i Lartësuar e ka përcaktuar "*mehrin e tyre*".

- "Në qoftë se ato, me dëshirën e tyre, ju falin diçka nga ai *(mehri)*, atëherë përdoreni atë, se tashmë ai është hallall dhe i mirë për ju." – Kuptimi: Nëse ato ju lejojnë me kënaqësi dhe dashamirësi që të merrni diçka prej hakut të tyre, atëherë kjo është e lejueshme dhe e mirë për ju. Po kështu, edhe nëse ju lejojnë që ta vononi përmbushjen e detyrimit tuaj jashtë afatit të përcaktuar në akt-martesë, apo ju lejojnë që,

në vend të mehrit të përcaktuar, të jepni diçka tjetër zëvendësuese, e të tjera si këto, atëherë të gjitha janë të lejueshme. Nuk ka gjynah për ju që të përfitoni nga të tilla lëshime me dashamirësi, që i bëni njëri-tjetrit.

Nga ky ajet kuptojmë se gruaja ka të drejtë të japë sadaka apo të bëjë vepra bamirësie me pasurinë e saj, nëse është e përgjegjshme ligjërisht, por me kusht që edhe të jetë e aftë për të administruar mirë pasurinë e saj. Nëse nuk i përmbush këto kushte, çdo akt i saj në këtë drejtim është i pavlefshëm.

Gjithashtu, ne mësojmë nga ajeti se kujdestari ligjor i gruas nuk ka të drejtë mbi këtë pasuri të sajën, përveç nëse e lejon ajo vetë. Allahu i Lartësuar thotë: **ma tâbe lekum minen-nisâ / me gra të mira që ju pëlqejnë.** Pra, ato që janë të mira për ju, jo të këqijat. Pra, martesa me gra të mira, të ndershme e të dëlira është e urdhëruar, ndërsa martesa me gra që nuk e kanë cilësinë "të mira" nuk është e urdhëruar, siç janë, për shembull, idhujtaret, imoralet etj., sikurse thotë i Lartësuari në një ajet tjetër: "Mos u martoni me idhujtare, derisa ato të besojnë. Një robëreshë besimtare është më e vlefshme se një idhujtare, edhe nëse ajo *(idhujtarja)* ju mahnit. Mos i martoni ato *(femrat tuaja)* me idhujtarët, derisa ata të besojnë. Një rob besimtar është më i vlefshëm se një idhujtar, edhe nëse ky ju mahnit. Ata ju ftojnë për në Zjarr, kurse Allahu, me mëshirën e Vet, ju fton për në Xhenet dhe për t'ju mbuluar gabimet tuaja. Ai ua sqaron njerëzve argumentet e Veta, që ata të përkujtojnë." [Bekare 221]. Ose: "Laviri martohet veçse me ndonjë lavire ose idhujtare. Me laviren nuk do martohet kush, veçse ndonjë lavir ose idhujtar. Ajo (*kurvëria ose martesa me ta)* është e ndaluar për besimtarët." [Nur 3]. Ose: "Të këqijat *(gra ose fjalë)* janë për të këqijtë, edhe të këqijtë janë për të këqijat. Ndërsa të ndershmet janë për të ndershmit, edhe të ndershmit janë për të ndershmet. Ata janë të pafajshëm nga ajo që thonë të tjerët për ta. Ata kanë falje të madhe dhe furnizim të begatshëm." [Nur 3, 26].

Ajeti 5

5. Mos u jepni të papjekurve pasurinë tuaj, me të cilën Allahu ju ka begatuar, por ushqejini ata nga ajo pasuri, vishini dhe u thoni fjalë të mira.

Shpjegimi i ajetit

- "Mos u jepni të papjekurve (*es-sufehâ*) pasurinë tuaj, me të cilën Allahu ju ka begatuar..." – "*Es-sufehâ*" quhen ata që nuk janë të aftë ose që nuk kanë zotësinë e mjaftueshme për të vepruar me pasurinë e tyre ose për shkak se janë të sëmurë mendorë apo të vonuar, ose për shkak të moshës së vogël. Kështu, Allahu i Lartësuar ua ka ndaluar kujdestarëve ligjorë të kësaj kategorie njerëzish që t'ua lënë në dorë atyre pasurinë, dhe kjo bëhet me qëllimin për ta ruajtur pasurinë e tyre nga shpërdorimi dhe prishja. Allahu i Lartësuar e ka bërë pasurinë si mbështetëse dhe ndihmuese për njerëzit, në mënyrë që ata të arrijnë mirësitë e fesë dhe dynjasë së tyre, por duke qenë se kjo kategori njerëzish nuk e ka aftësinë për ta shfrytëzuar drejt pasurinë, atëherë Allahu i Lartësuar udhëzon, së pari, që ata të zbatojnë kujdestarinë ligjore dhe, së dyti, që çdo veprim i tyre në kuadër të kujdestarisë të jetë në qëllim të dobisë dhe mirësisë për "të papjekurit".

- "...por ushqejini ata nga ajo pasuri, vishini dhe u thoni fjalë të mira." - Kujdestarët ligjorë e kanë për detyrë që të kujdesen për ushqimin, veshmbathjen dhe për çdo shërbim tjetër të nevojshëm për të papjekurit, qoftë në aspektin e fesë apo të dynjasë së tyre. Jo vetëm kaq, por ata duhet t'i trajtojnë edhe me dashurinë dhe butësinë e nevojshme, duke i qetësuar e duke u thënë, për shembull, që nuk do ta humbasin pasurinë e tyre, apo që së shpejti do ta

marrin vetë në përdorim atë, sa të bëhen të aftë për të vepruar" etj.

Kur flet për pasurinë e "të papjekurve", Allahu i Lartësuar u drejtohet kujdestarëve të tyre ligjorë e u thotë: "Mos u jepni të papjekurve pasurinë tuaj...". Pra, edhe pse bëhet fjalë për pasurinë e *sufeha*-ve, Allahu i Lartësuar thotë: "pasurinë tuaj". Ky është një udhëzim për kujdestarët ligjorë që, pasurinë e individëve të cilët i kanë nën kujdestarinë e tyre, ta trajtojnë me të njëjtin kujdes, sikurse do të vepronin me pasurinë e tyre personale. Ashtu siç kujdesen për pasurinë e tyre, të cilën përpiqen ta shtojnë dhe ta ruajnë nga rreziqet, po ashtu duhet të veprojnë edhe me pasurinë e atyre që kanë nën kujdestari.

Ajeti në fjalë dëshmon se për shpenzimet e domosdoshme të *sufeha*-ve shfrytëzohet pasuria e tyre, nëse e kanë këtë pasuri, sepse Allahu i Lartësuar thotë: "...por ushqejini ata nga ajo pasuri, vishini dhe u thoni fjalë të mira."

Gjithashtu, ky ajet tregon se pretendimi i kujdestarit ligjor rreth shumës se sa shpenzon për individin që ndodhet nën kujdestarinë e tij, nga pasuria e këtij individi, është e pranueshme dhe e besueshme, nëse nuk i kalon kufijtë e normales dhe të zakonshmes. Pra, fjala e tij është e besueshme dhe e pranueshme ligjërisht.

Ajeti 6

6. Vërini në provë jetimët, derisa të bëhen për t'u martuar, e nëse vëreni tek ata pjekuri, atëherë jepuani pasurinë e tyre. Mos e hani pasurinë e tyre duke e shpërdoruar dhe duke u ngutur para se të rriten. Kush është i pasur, le të ruhet, e kush është i varfër, le të hajë me maturi. Kur t'ua dorëzoni jetimëve pasurinë e vet, bëjeni këtë në prani të dëshmitarëve. Allahu mjafton si Llogaritës.


Shpjegimi i ajetit

- "Vërini në provë jetimët, derisa të bëhen për t'u martuar, e nëse vëreni tek ata pjekuri, atëherë jepuani pasurinë e tyre." - Është e domosdoshme të provosh aftësinë e jetimëve para se t'u dorëzosh pasurinë e tyre. Prova bëhet duke i dhënë jetimit, të cilit i është afruar koha e pjekurisë, një pjesë nga pasuria e tij, për ta vëzhguar se si do ta shpenzojë dhe si do të veprojë me të. Nëse vepron ashtu si i takon normalisht moshës së tij dhe nëse dallohet qartë përgjegjshmëria e tij, atëherë, me të mbushur moshën, i jepet pasuria. Por nëse ai vazhdon të veprojë me mendjelehtësi, duke treguar pakujdesi dhe shpërdorim të pasurisë, atëherë nuk i jepet pasuria, derisa të piqet dhe të fitojë aftësinë e nevojshme për të vepruar, edhe nëse e kalon moshën kur zakonisht njerëzit e fitojnë këtë aftësi.

- "Mos e hani pasurinë e tyre duke e shpërdoruar dhe duke u ngutur para se të rriten. Kush është i pasur, le të ruhet, e kush është i varfër, le të hajë me maturi." – Pra, mos e kaloni masën e lejuar nga Sheriati të përfitimit prej pasurisë së jetimëve, duke marrë prej tyre atë që Zoti e ka ndaluar. Gjithashtu, gjatë kohës kur ata janë të vegjël, mos nxitoni që të shpenzoni prej pasurisë së tyre, me qëllimin që të përfitoni sa të mundni prej tyre, para se ata të rriten dhe ju të jeni të detyruar t'u ktheni pasurinë.

Këto këshilla vlejnë për shumë kujdestarë, që i bëjnë këto shkelje. Pa dyshim, ata veprojnë kështu sepse në zemrat e tyre nuk ekziston frika prej Zotit dhe as dhembshuria për jetimin. Këta të mjerë i shohin këto si raste të volitshme për të përfituar sa më shumë, edhe pse Allahu i Lartësuar ua ka ndaluar një gjë të tillë.

- "Kur t'ua dorëzoni jetimëve pasurinë e vet, bëjeni këtë në prani të dëshmitarëve. Allahu mjafton si Llogaritës." – Ajeti është shumë i qartë. Kur atyre tu dorëzoni pasurinë e vet le të jenë të pranishëm një grup dëshmitarësh, edhe pse mjafton që



Allahu është dëshmitar. Kjo për të qenë më transparentë dhe larg çdo keqkuptimi e paragjykimi.

Ajeti 7

7. Meshkujve u takon pjesë nga pasuria që kanë lënë prindërit dhe të afërmit e tyre. Edhe femrave u takon pjesë nga ajo që kanë lënë prindërit dhe të afërmit, qoftë pak apo shumë. Këto janë pjesë të përcaktuara.

Shpjegimi i ajetit

Në kohën e injorancës paraislamike, arabët, për shkak të paditurisë dhe ashpërsisë së tyre, nuk u bënin pjesë në trashëgimi të dobtëve, siç janë gratë dhe fëmijët. Trashëgiminë ata e ndanin vetëm mes burrave të fortë, sepse - sikurse justifikoheshin – vetëm ata ishin krah për luftë, grabitje e plaçkitje. Për këtë arsye, Zoti i Gjithëmëshirshëm dhe i Urtë caktoi këto dispozita për robërit e Tij, që të vendosej barazpeshë mes të drejtave të burrave dhe grave, të të fortëve dhe të dobtëve.

Fillimisht, Zoti i Gjithëmëshirshëm u bëri një parapërgatitje të përgjithshme shpirtrave, që ata të ishin gati të pranonin dispozitat e Tij. Më pas, Ai solli urdhrat e detajuar, të cilët do të gjenin terren të përshtatshëm në shpirtrat e përmalluar për t'i zbatuar ato urdhra dhe për të flakur tutje zakonet e ulta të injorancës.

- "Meshkujve u takon pjesë nga pasuria që kanë lënë prindërit dhe të afërmit e tyre. Edhe femrave u takon pjesë nga ajo që kanë lënë prindërit dhe të afërmit..." - Si burrave, edhe grave u takon me ligj pjesa e përcaktuar nga trashëgimia që lënë pas prindërit ose të afërmit.

Në ajet vjen, fjala e përgjithshme "të afërmit" vjen pas kategorisë së veçantë, që janë prindërit, për të treguar rëndësinë e këtyre të fundit.

Dikush mund të pyesë: Pjesa për secilin grup, a përcaktohet sipas traditës së popullit, apo është e përcaktuar nga ligji i Zotit? Përgjigjja vjen nga i Lartësuari, që thotë:

- "Këto janë pjesë të përcaktuara." – Pra, këto janë pjesë të përcaktuara dhe të detyrueshme nga ligji i Zotit. Është Allahu i Gjithëdijshëm e i Urtë Ai që i ka përcaktuar pjesët, të cilat do të shtjellohen më poshtë, inshallah.

Dikush mund të pretendojë e të thotë se gratë dhe fëmijët mund të përfitojnë vetëm në raste kur pasuria që ndahet është e madhe, por edhe ky pretendim merr përgjigje nga i Gjithëdijshmi, kur thotë: "...qoftë pak apo shumë.". Pra, grave u takon pjesë nga trashëgimia, qoftë ajo trashëgimi e madhe apo e vogël.

I Lartësuar dhe i Lavdëruar qoftë Allahu!

Ajeti 8

8. Nëse gjatë ndarjes së trashëgimisë janë të pranishëm farefisi i largët, jetimët dhe të varfërit, u dhuroni edhe atyre diçka e u thoni fjalë të mira.

Shpjegimi i ajetit

Edhe këtu kemi të bëjmë me një prej ligjeve të mrekullueshme të Allahut të Mëshirshëm, të cilët kënaqin dhe qetësojnë çdo zemër dhe shpirt.

Kështu, gjatë ndarjes së trashëgimisë mund të jenë të pranishëm edhe të afërm të të ndjerit, të cilët nuk meritojnë pjesë sipas ligjit të trashëgimisë, por që janë pjesë e atyre grupeve të shoqërisë që mund të përfitojnë nga sadakatë. Për këta, Allahu i Lartësuar na udhëzon që të jemi të mëshirshëm dhe bujar ndaj tyre, duke u dhënë diçka, qoftë edhe pak, nga ajo pasuri që merret pa lodhje e mund. Në ato çaste, sytë dhe zemrat e këtyre njerëzve janë të drejtuara drejt nesh dhe dëshirojnë diçka, prandaj Allahu i Lartësuar na porosit që t'i qetësojmë zemrat e tyre dhe t'ua kënaqim syrin duke u dhuruar ndonjë send prej pasurisë, pa u dëmtuar vetë.

Nga ky ajet kuptojmë se, jo vetëm në rastin e ndarjes së trashëgimisë, por në çdo rast të ngjashëm, është mirë që njeriu t'u japë të tjerëve nga mirësitë me të cilat Zoti e ka begatuar, kur ata janë të pranishëm. Pejgamberi (a.s.) na ka porositur: *"Nëse dikujt prej jush shërbëtori i sjell ushqimin, le ta ulë edhe atë në tavolinë, që të ushqehet së bashku me të. Nëse nuk e ul në të, le t'i japë një kafshatë ose dy."* Sahabët (Allahu qoftë i kënaqur prej tyre!) kur fillonin vjeljen e prodhimeve të tyre, e dërgonin fillimisht prodhimin te Pejgamberi (a.s.), që ai ta provonte dhe të lutej për ta që Zoti t'i begatonte. Por Pejgamberi (a.s.), para se të fillonte vetë, shikonte më të vegjlit dhe u jepte atyre, sepse e dinte dhe e ndiente dëshirën e tyre të fortë për t'i provuar ato prodhime.

Kjo është një këshillë e mrekullueshme, tepër e vlefshme atëherë kur është e mundur, kur nuk prek të drejtat e të tjerëve apo kur nuk ka diçka më të rëndësishme për t'u përmbushur.

Po ashtu, në raste të tilla, të paktën nevojtarëve u thuhen fjalë të ngrohta dhe të buta, duke i larguar me respekt dhe edukatë. Pra, gjithmonë me fjalë të mira e të buta, jo me fjalë të vrazhda.

Ajetet 9 – 10

9. Le të jenë të kujdesshëm ata, ashtu sikur do të vepronin po të linin pas pasardhës të paaftë, për të cilët do të druheshin. Le t'i frikësohen Allahut dhe le të thonë fjalë të drejta.
10. Ata që e hanë pa të drejtë pasurinë e jetimëve, në të vërtetë hanë atë që ua mbush barkun e tyre me Zjarr; ata do të hidhen në Zjarrin e ndezur fort.

Shpjegimi i ajeteve

- "Le të jenë të kujdesshëm ata, ashtu sikur do të vepronin po të linin pas pasardhës të paaftë, për të cilët do të druheshin." - Disa janë të mendimit se kjo këshillë u drejtohet të pranishmëve në momentet kur të sëmurit po i afrohet vdekja dhe i cili mund të tregohet i padrejtë ndaj trashëgimtarëve, duke ua lënë pasurinë të tjerëve, në dëm të trashëgimtarëve të ligjshëm. Pra, Allahu i Lartësuar i porosit të pranishmit që ta këshillojnë të sëmurin që të jetë i drejtë me trashëgiminë, duke mos i kaluar kufijtë e vendosura nga Sheriati.

Argument që kjo fjalë u drejtohet njerëzve pranë të sëmurit, dhe jo vetë të sëmurit, është fjala e Allahut të Lartësuar: "...le të thonë fjalë të drejta...", domethënë, të thonë fjalë që ruajnë drejtësinë, që janë në përputhje me ligjin e Zotit dhe që nuk bien ndesh me zakonet e përgjithshme. Pra, Allahu i Lartësuar i këshillon njerëzit që ndodhen pranë të sëmurit që, nëse shohin se ky i fundit mund të dëmtojë ndonjë nga

trashëgimtarët e tij të ligjshëm, t'i kujtojnë atij që të jetë i drejtë dhe të ketë frikë Zotin, sepse kujdesi ndaj fëmijëve dhe trashëgimtarëve të ligjshëm është më i rëndësishëm.

Disa janë të mendimit se këto porosi u drejtohen në mënyrë të veçantë njerëzve që u ka ardhur vdekja dhe të cilët kanë në kujdestarinë e tyre jetimë, të paaftë mendërisht,të vegjël apo të tjerë të papërgjegjshëm ligjërisht. Këta këshillohen që të jenë të mëshirshëm dhe të kenë parasysh në lënien e trashëgimisë edhe të dobëtit që kanë nën kujdestari. Kujdesi për ta duhet të jetë në drejtim të çështjeve të dynjasë dhe të fesë së tyre, njëlloj siç do të dëshironin të veprohej nga të tjerët me fëmijët e tyre. Normalisht, kjo ndarje e pasurisë duhet të jetë sipas drejtësisë së Sheriatit dhe jo në kurriz të trashëgimtarëve të tjerë të ligjshëm, pra, të paktën, jo jashtë masës së lejuar nga Sheriati (domethënë, jo më shumë se 1/3 e pasurisë).

Çdo veprim duhet të jetë në kuadër të devotshmërisë ndaj Allahut të Lartësuar, prandaj Ai e përforcon dhe e zbukuron porosinë e Tij me fjalët:

- "Le t'i frikësohen Allahut dhe le të thonë fjalë të drejta." – Pra, le të kenë frikë Allahun dhe të synojnë plotësimin e porosive të Tij në çdo ndarje pasurie. Ata nuk duhet të cenojnë të drejtën e trashëgimtarëve të ligjshëm, nga njëra anë, dhe të tregojnë mëshirë e mbështetje për të dobëtit që janë nën kujdestarinë e tyre, nga ana tjetër. Të dobëtit nuk duhen shpërfillur, sepse kjo cenon devotshmërinë, por edhe të drejtat e trashëgimtarëve të ligjshëm nuk duhen shkelur, pasi edhe kjo cenon devotshmërinë ndaj Zotit.

Pas këtyre porosive të vyera në çështjen e trashëgimisë, Allahu i Lartësuar i kthehet edhe njëherë paralajmërimit për ata që marrin pasurinë e jetimëve pa patur të drejtë. Ai i kërcënon këta njerëz mjaft ashpër, duke thënë:

- "Ata që e hanë pa të drejtë pasurinë e jetimëve, në të vërtetë hanë atë që ua mbush barkun e tyre me Zjarr; ata do të hidhen në Zjarrin e ndezur fort." - Të kërcënuar janë ata që përfitojnë padrejtësisht nga pasuria e jetimëve. Kështu, janë përjashtuar ata që u përmendën më sipër. Me fjalë të tjera, çdokush që merr pasurinë e jetimit jashtë kufijve të Sheriatit, ka bërë padrejtësi, e nëse merr diçka brenda kufijve të Sheriatit, kjo është e tolerueshme. Për shembull, nëse kujdestari ligjor i jetimit është i varfër, i lejohet të hajë së bashku me jetimin nga pasuria e jetimit, por me masë dhe jo duke e tepruar apo duke u ngutur që të përfitojë prej asaj pasurie para se jetimi të arrijë moshën e aftësisë së plotë vepruese me pasurinë e tij. E lejuar është, gjithashtu, që kujdestari ligjor i jetimit ta përziejë ushqimin e tij me atë të jetimit. Ky lehtësim nuk përbën ndonjë shkelje, por gjithmonë brenda kufijve të lejuar, dhe jo me tendencë për të abuzuar. Allahu i Lartësuar i di mirë ata që duan të abuzojnë dhe për ta ka përgatitur dënim shumë të dhimbshëm.

Allahu i Lartësuar na tregon se këta të padrejtë do të flaken në Zjarrin përvëlues dhe të ndezur fort. Ky është kërcënimi më i frikshëm që është thënë për gjynahqarët. Ai tregon se sa i shëmtuar dhe i madh është gjynahu i ngrënies së pasurisë së jetimëve padrejtësisht. Ajeti dëshmon se ky është një nga gjynahet e mëdha, prandaj e lusim Allahun të na ruajë nga të tilla gjynahe!

Ajetet 11 – 12

11. Allahu ju urdhëron kështu për fëmijët tuaj: mashkullit i takojnë sa për dy femra. Nëse *(trashëgimtarët)* janë vetëm femra dhe më shumë se dy, atyre u takojnë dy të tretat e pasurisë që ai lë pas, e nëse është vetëm një femër, asaj i takon gjysma. Për prindërit, për secilin prej tyre, jepet një e gjashta nga ajo që ka lënë *(i vdekuri)*, nëse ka fëmijë. Në qoftë se *(i vdekuri)* nuk ka

fëmijë e atë e trashëgojnë prindërit, atëherë nënës së tij i takon një e treta. Por në qoftë se ai *(i vdekuri)* ka vëllezër, nënës së tij i takon vetëm një e gjashta. Kjo bëhet pas zbatimit të porosisë së lënë nga ai (*vasijet*) dhe pasi të lahen borxhet e tyre. Ju nuk e dini se cilët janë më të dobishëm për ju: prindërit tuaj apo fëmijët tuaj. Ky është urdhër nga Allahu. Vërtet Allahu është i Gjithëdijshmi, i Urti.

12. Juve ju takon gjysma e pasurisë që lënë bashkëshortet tuaja, nëse ato nuk kanë fëmijë. Por nëse ato kanë fëmijë, juve ju takon një e katërta e pasurisë që lënë ato, pasi të zbatohet porosia e tyre (*vasijet*) dhe pasi të lahen borxhet e tyre. Atyre *(grave)* ju takon një e katërta nga ajo që lini ju, nëse nuk keni fëmijë. Por nëse keni fëmijë, atyre ju takon një e teta nga ajo që lini, pasi të zbatohet porosia juaj (*vasijet*) dhe pasi të lahen borxhet tuaja. Në qoftë se i vdekuri, qoftë mashkull ose femër, është pa prindër dhe fëmijë, por ka vëlla ose motër *(nga nëna)*, atëherë çdonjërit prej tyre u takon një e gjashta. E nëse ka më shumë nga ata *(vëlla e motër)*, ata janë pjesëmarrës të barabartë në një të tretën e pasurisë, pasi të zbatohet porosia (*vasijet*) dhe pasi të lahen borxhet, duke mos dëmtuar asnjë. Ky është urdhri Allahut. Allahu është i Gjithëdijshëm e Durues.

Shpjegimi i ajeteve

Allahu i Lartësuar i ka qartësuar plotësisht dispozitat për trashëgiminë, në Kur'ân dhe në Sunetin e Profetit të Tij. Tekstet themelore ku mbështeten këto dispozita janë:

1. Ajetet 11, 12 të kësaj sureje, që tashmë po shpjegohen.

2. Ajeti i fundit i po kësaj sureje, pra, ajeti 176.

3. Hadithi i Abdullah Ibn Abasit, i sjellë nga Buhariu: *"Jepuni trashëgiminë atyre që u takon. Ajo që mbetet, le t'i jepet mashkullit më të afërt (të të ndjerit)."*

Këto tekste përfshijnë të gjitha argumentet që rregullojnë dispozitat për trashëgiminë, sikurse do të shtjellohet më poshtë.

Përjashtim bën vetëm rasti i trashëgimisë që meritojnë gjyshet, për të cilin shërben si mbështetje hadithi që ndodhet në "*Sunen*", i përcjellë prej Mugira Ibn Shubas dhe Muhamed Ibn Meslemes, të cilët tregojnë se Pejgamberi (a.s.) ka përcaktuar që gjysheve t'u jepet një e gjashta e pasurisë së lënë, dhe dijetarët janë në konsensus për këtë çështje.

Kështu, Allahu i Lartësuar thotë:

- "Allahu ju urdhëron kështu për fëmijët tuaj:" - Allahu i Lartësuar ua drejton këtë porosi të mrekullueshme të gjithë atyre që janë prindër, të cilët Ai i ka begatuar me fëmijë: Allahu i Lartësuar ju ka dhuruar këtë mirësi (fëmijët), por ju ka ngarkuar edhe me përgjegjësi për ta. Ai jua ka lënë fëmijët në kujdesin tuaj, ndërkohë që ju keni detyrime kundrejt tyre. Ju duhet të kujdeseni si për fenë, ashtu edhe për çështjet e dynjasë së tyre. Ju duhet t'i mësoni dhe t'u jepni edukatën më të mirë. Ju duhet t'i ndaloni ata nga çdo gjë që dëmton besimin dhe dynjanë e tyre. Ju duhet t'i brumosni me dashurinë për Allahun dhe me bindjen ndaj urdhrave të Tij. Ju duhet t'i edukoni që gjithmonë dhe në çdo situatë të jenë të devotshëm dhe të përkushtuar ndaj Allahut të Lartësuar, sikurse thotë Ai në një ajet tjetër: "O ju që keni besuar, ruajeni veten dhe familjen tuaj prej një Zjarri, lëndë djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët. Atë *(Zjarrin)* e mbikëqyrin engjëjt e rreptë e të ashpër, që nuk e kundërshtojnë Allahun për asgjë që Ai i urdhëron, por veprojnë ashtu si janë të urdhëruar." [Tahrim 6].

Kështu, Allahu i Lartësuar na ka porositur për t'u kujdesur në mënyrë të veçantë për fëmijët. Ne duhet ta plotësojmë dhe ta çojmë në vend këtë porosi; në të kundërt, nëse e shpërfillim, do të meritojmë ndëshkimin e rëndë.

Ajeti tregon, gjithashtu, se Allahu i Lartësuar është më i mëshirshëm sesa prindi

me fëmijët e tij, sepse Ai i porosit prindërit për të plotësuar detyrimet ndaj fëmijve, edhe pse prindërit, për nga natyra, janë të kujdesshëm ndaj tyre.[17]

Më pas, Allahu i Lartësuar tregon mënyrën e shpërndarjes së pasurisë:

- "...mashkullit i takojnë sa për dy femra." - Këtu bëhet fjalë për fëmijët (bijtë dhe bijat) dhe për fëmijët e djemve (domethënë, nipat dhe mbesat), nëse babai i tyre nuk është gjallë, sepse, në të kundërt, është babai i tyre që përfiton nga trashëgimia dhe jo ata. Gjithashtu, këta përfitojnë në pjesën e mbetur nga ndarja mes trashëgimtarëve parësorë (që meritojnë *furud*-et). Kjo pjesë e mbetur ndahet mes tyre po me të njëjtin raport, pra, për mashkullin sa për dy femra. Ky është mendimi unanim i dijetarëve. Me fjalë të tjera, nëse fëmijët e lindur nga i ndjeri janë gjallë, trashëgimia u takon atyre, ndërsa fëmijët e tyre (d.m.th., nipërit dhe mbesat e të ndjerit) nuk përfitojnë gjë. Kështu veprohet kur fëmijët (e lindur nga i ndjeri) janë meshkuj dhe femra.

Por kemi edhe dy raste të tjera që duhen sqaruar:

1. Nëse fëmijët trashëgimtarë janë vetëm meshkuj. Ky rast do të shpjegohet më pas.

2. Nëse fëmijët trashëgimtarë janë vetëm femra. Këtë Allahu i Lartësuar e ka sqaruar në vijim të këtij ajeti, kur thotë:

- "Nëse *(trashëgimtarët)* janë vetëm femra dhe më shumë se dy, atyre u takojnë dy të tretat e pasurisë që ai lë pas..." – Pra, nëse janë vetëm femra, qofshin ato bija apo mbesa (vajza të djemve), tri në numër a më shumë, atyre u takojnë dy të tretat e pasurisë, të cilën e ndajnë në mënyrë të barabartë mes tyre.

- "...e nëse është vetëm një femër, asaj i takon gjysma." - Por nëse është një femër e vetme, qoftë bijë apo mbesë (vajza e djalit), asaj i takon gjysma e pasurisë. Kjo është e pranuar në mënyrë konsensuale nga dijetarët, pa ndonjë kundërshtim mes tyre.

Lind pyetja: Gjykimi për rastin kur janë tri femra e më shumë dhe për rastin kur është një e vetme është i përcaktuar qartë me unanimitet. Po kur janë dy pasardhëse, cili është argumenti që edhe në këtë rast ato përfitojnë dy të tretat e pasurisë?

Përgjigjja është te thënia e Allahut të Lartësuar: "...e nëse është vetëm një femër, asaj i takon gjysma." Pra, duke qenë se kur është një, asaj i takon një e dyta, atëherë, nëse janë dy, gjykimi zbret në masën që vijon pas një të dytës. Pas një të dytës, prej pjesëve të përcaktuara nga Sheriati, vjen pjesa dy të tretat.[18] Gjithashtu, këtë gjykim e përforcon edhe fjala e Allahut të Lartësuar: "...mashkullit i takojnë sa për dy femra".

Nëse trashëgimtarët janë një djalë dhe një vajzë, atëherë, sipas këtij ajeti, djalit duhet t'i takojë dyfishi i pjesës së vajzës. Por dihet dhe është i pakundërshtueshëm fakti që djalit në këtë rast i takojnë dy të tretat. Atëherë, sipas ajetit, dy vajzave u takojnë dy të tretat.

Po kështu, në rastin në fjalë, kur trashëgimtarët janë një djalë dhe një vajzë, kësaj të fundit i takon një e treta, pra, sa gjysma e pjesës së vëllait të saj. Dihet se kur rival është vëllai i saj, kjo e cenon pjesën e saj më shumë sesa në rastin kur rivale është motra. Atëherë, sipas logjikës, themi: nëse ajo meriton një të tretën kur rival është vëllai, kjo tregon se në rastin kur rivale është

[17] Ky fakt dëshmohet qartë në hadithin që e ka përnxjerrë imam Muslimi në "*Sahih*"-un e tij, në kapitullin "Pendimi", me numër 22, ku thuhet se Profeti (a.s.), pas një beteje, pa mes njerëzve një grua që nuk po gjente fëmijën e saj. Ajo kërkonte mes njerëzve dhe, kur e gjeti, e pushtoi fort dhe filloi t'i jepte gji. Atëherë, Profeti (a.s.) tha: "*A mendoni se kjo grua mund ta flakë foshnjën e saj në Zjarr?!*" - "*Jo, o i Dërguari i Allahut!*" – *thanë të pranishmit. Ndërsa Profeti (a.s.) vazhdoi: "E pra, betohem në Allahun, se Allahu është më i Mëshirshëm me robërit e Tij, sesa kjo nënë me foshnjën e saj!*"

[18] Pjesët e përcaktuara nga Sheriati në ndarjen e trashëgimisë janë gjashtë: 1/2, 1/4, 1/8, 1/3, 1/6 dhe 2/3. Për secilën masë janë përcaktuar përfituesit e saj.

motra e saj, ajo e meriton më tepër një të tretën.

Po kështu, Allahu i Lartësuar ka përcaktuar që, nëse trashëgimtare janë vetëm dy motrat e të ndjerit, atyre u takojnë dy të tretat. Në ajetin e fundit të kësaj sureje, i Lartësuari thotë: "Në qoftë se ato *(trashëgimtaret)* janë dy *(motrat e të ndjerit)*, të dyjave u takojnë dy të tretat që lë ai." Duke qenë se dy motrat, të cilat për nga afërsia dhe merita për trashëgiminë qëndrojnë më larg sesa bijat, meritojnë dy të tretat, atëherë është më e pranueshme që edhe dy vajzat të meritojnë dy të tretat. Po kështu ka vepruar Pejgamberi (a.s.), i cili dy vajzave të Sadit u dha dy të tretat e pasurisë së tij, sipas një hadithi *sahih*.

Në përfundim, del edhe një pyetje tjetër: Çfarë dobie synohet kur thuhet shprehimisht: "Nëse *(trashëgimtarët)* janë vetëm femra dhe më shumë se dy..."? A nuk kuptohet kjo thjesht nga fakti që, nëse janë më shumë se një, ato kanë gjykimin e shumësit?

Allahu e di më mirë, por, ndoshta, qëllimi këtu është për të treguar se pjesa e përcaktuar nga Sheriati si "dy të tretat" nuk shtohet me rritjen e numrit të femrave trashëgimtare, por, nga dy e sipër, ato të gjitha janë pjesëmarrëse në dy të tretat.

Nëse trashëgimtarët janë një vajzë dhe një mbesë (vajzë djali) apo më shumë mbesa, atëherë ato janë pjesëtare në 2/3-at. Ndarja bëhet kështu: vajzës i takon 1/2 e trashëgimisë së lënë, ndërsa mbesave (vajzave të djalit), prej dy të tretave që është përcaktuar nga Sheriati për to (vajzat dhe vajzat e djemve) që të marrin, u mbetet një e gjashta. Pra, atyre u jepet një e gjashta, e cila është quajtur ndryshe "plotësuesja e dy të tretave".

Po kështu gjykohet edhe në rastin kur trashëgimtare janë vajza e djalit (të të ndjerit) me vajzat e djalit të saj (pra, stërmbesat e të ndjerit).

Ajeti tregon se nëse vajzat dhe vajzat e djalit (pra, mbesat) marrin dy të tretat, atëherë vajzat e djemve (stërmbesat) poshtë tyre nuk marrin gjë, sepse ashtu del që pjesa e tyre të jetë më e madhe se dy të tretat. Pra, nëse dy të tretat plotësohen, atëherë nuk lejohet të shtohet mbi të, sepse kjo do të kundërshtonte tekstin kur'ânor.

Të gjitha këto rregulla janë të pranuara unanimisht nga dijetarët dhe, për këtë, falënderimi i plotë i takon vetëm Allahut të Lartësuar.

Allahu i Lartësuar duke treguar se nga çfarë pasurie përfitojnë trashëgimtarët, thotë: "Nëse *(trashëgimtarët)* janë vetëm femra dhe më shumë se dy, atyre u takojnë dy të tretat e pasurisë që ai lë pas." Te pasuria që i vdekuri lë pas hyjnë pronat e paluajtshme si tokat, shtëpitë etj., por edhe pasuritë e luajtshme me të gjitha llojet e tyre, si: floriri, argjendi, madje edhe rrobat. Madje, edhe "shpagimi për vrasjen" (*ed-dijetu*), të cilin i ndjeri e 'përfiton' veçse pas vdekjes, hyn në pasurinë që ndahet si trashëgimi. Si pasuri e tij llogariten edhe borxhet që të tjerët ende nuk ia kanë shlyer atij etj. Të gjitha këto, pra, llogariten si pasuri që duhet të ndahet mes trashëgimtarëve.

Më pas, Allahu përmend pjesën e prindërve të të ndjerit në trashëgimi:

- "Për prindërit, për secilin prej tyre, jepet një e gjashta nga ajo që ka lënë *(i vdekuri)*, nëse ka fëmijë." - Pra, nënës dhe babait, domethënë secilit prej tyre, i takon një e gjashta e trashëgimisë, nëse i vdekuri ka lënë pas fëmijë ose fëmijë fëmijësh, meshkuj apo femra qofshin, një apo shumë. Nëna nuk merr më shumë se një e gjashta nëse i vdekuri ka lënë pas një fëmijë. Babai nuk merr më shumë se një e gjashta nëse i vdekuri ka lënë pas fëmijë meshkuj. Por nëse fëmijët janë një vajzë ose shumë vajza, dhe mbetet diçka pas shpërndarjes së pjesëve të secilit, për shembull, kur trashëgimtarë janë babai nëna dhe dy vajza, ajo mbetje i takon babait (*tea'sîb*). Nëse nuk mbetet gjë, atëherë atij i takon vetëm pjesa e përcaktuar e tij,

pra, një e gjashta. Kjo sepse, pasi i është dhënë secilit prej trashëgimtarëve pjesa e përcaktuar me ligj (*farḍ*), ajo që mbetet i takon mashkullit më të afërt, dhe babai është më i afërt se vëllai, xhaxhai e kështu me radhë.

- "Në qoftë se *(i vdekuri)* nuk ka fëmijë e atë e trashëgojnë prindërit, atëherë nënës së tij i takon një e treta." - Ndërsa babait i takon ajo që mbetet, sepse vetëm babai dhe nëna janë trashëguesit. Nga kjo kuptohet se, nëse i vdekuri nuk ka lënë pas fëmijë, nëna merr pjesën e saj, ndërsa babai merr gjithë pjesën e mbetur ose atë që lënë trashëgimtarët e tjerë, nëse ka. Por nëse veç prindërve, e vdekura ka lënë pas bashkëshortin, atëherë ky i fundit merr pjesën e tij, pastaj nëna merr një të tretën e asaj që mbetet pas heqjes së pjesës së bashkëshortit, dhe ajo që mbetet është për babain. Për këtë tregon edhe fjala e Allahut të Lartësuar: "..në qoftë se *(i vdekuri)* nuk ka fëmijë e atë e trashëgojnë *(vetëm)* prindërit, atëherë nënës së tij i takon një e treta." Domethënë, një e treta e asaj që mbetet si pjesë për prindërit.

Pra, nëse përveç dy prindërve, është edhe bashkëshorti, atëherë ndodhemi përpara dy rasteve:

1. Kur trashëgimtarë janë burri, nëna dhe babai.

Në këtë rast, burrit i takon gjysma, sepse e vdekura nuk ka lënë fëmijë. Pjesa e nënës është një e gjashta, dhe ç'mbetet është për babain.

2. Kur trashëgimtarë janë gruaja (kur i vdekuri është burri), nëna dhe babai.

Në këtë rast, gruas i takon një e katërta, sepse i vdekuri (d.m.th. burri) nuk ka lënë fëmijë. Pjesa e nënës është një e katërta, dhe ç'mbetet është për babain.

Në të dyja këto raste, pjesët e burrit apo të gruas hiqen fillimisht nga e gjithë pasuria, nëna merr një të tretën e pasurisë që mbetet për t'u ndarë mes prindërve, ndërsa babait i takon ajo që mbetet. Pra, nëna nuk merr një të tretën e gjithë pasurisë, por një të tretën e asaj që mbetet pas ndarjes së pjesës së bashkëshortit.

Me fjalë të tjera, nëse i vdekuri ka borxhe apo detyrime të tjera për të larë si gjoba, shërbimet e varrimit etj., fillimisht i hiqen nga e gjithë pasuria këto detyrime, e më pas bëhet ndarja e saj sipas pjesëve të përcaktuara. Edhe në rastin e mësipërm, pjesa e bashkëshortit trajtohet si detyrim parësor për t'u shlyer, prandaj fillohet me të. Ndërsa pjesa e prindërve është ajo që mbetet pas dhënies së pjesës së bashkëshortit.

Po ashtu, nëse nëna do të merrte një të tretën nga e gjithë pasuria, atëherë, kur së bashku me prindërit, është trashëgimtar edhe burri, nënës i takon të marrë më shumë sesa babait.

Ndërsa në rastin kur, së bashku me prindërit, trashëgimtare është edhe gruaja, babait i takon të marrë "gjysmën e një të gjashtës" më shumë se nëna, dhe kjo nuk është një pjesë e përcaktuar konkretisht. Ajo që njihet është se nëna mund të marrë njëlloj si babai, ose babai mund të marrë dyfishin e asaj që merr nëna. Këto janë rastet e njohura dhe të përcaktuara.

- "Por në qoftë se ai *(i vdekuri)* ka vëllezër, nënës së tij i takon vetëm një e gjashta." - Këtu e ka fjalën për çdo lloj vëllai apo motre: vëlla a motër nga babai dhe nëna, vëlla a motër vetëm nga babai, vëlla a motër vetëm nga nëna, pavarësisht a meritojnë pjesë apo privohen nga ajo për shkak të pranisë së babait ose të gjyshit.[19] Pra, në rast se i vdekuri ka lënë pas një nga këta të përmendur, nënës i takon vetëm një e gjashta.

Disa janë të mendimit se fjala "vëllezër" nuk përfshin ata që janë të privuar nga trashëgimia për shkak të pranisë së babait apo gjyshit, por vetëm ata vëllezër a motra

[19] Dihet që, nëse është i pranishëm babai apo gjyshi i të vdekurit, ata që janë në shkallë më poshtë privohen nga trashëgimia.

që meritojnë trashëgimi dhe nuk janë të privuar. Në fakt, ky mendim është më i pranueshëm, sepse edhe reduktimi i pasurisë së nënës nga "një e treta" në "një të gjashtën" synon pikërisht që t'i mundësojë kësaj kategorie – vëllezërve e motrave trashëgues dhe jo të privuar – që të marrin pjesë nga trashëgimia. Sipas këtij mendimi, pjesa e nënës reduktohet nga një e treta në një të gjashtën vetëm në rastin kur i vdekuri ka lënë pas "vëllezër" që meritojnë pjesë dhe jo "vëllezër" të privuar nga prania e babait apo gjyshit. E gjithë kjo funksionon me kusht që ata të jenë më shumë se dy persona, pra, dy e lart.

Dikush mund të pyesë: Përse fjala "vëllezër" është përdorur në shumës dhe jo në dyjës?

Përgjigje: Ky është një stil që haset në Kur'ân, domethënë që edhe kur flitet për dy persona, përdoret numri shumës, sikurse thotë i Lartësuari kur flet për dy profetët e Tij Daudin dhe Sulejmanin: "....dhe Ne ishim dëshmues të gjykimit të tyre". Këtu nuk është për qëllim të tregohet numri specifik i tyre, por thjesht të tregohet se ishin më shumë se një. I njëjti stil përdoret edhe në ajetin, kur i Lartësuari thotë: "Në qoftë se i vdekuri, qoftë mashkull ose femër, është pa prindër dhe fëmijë, por ka vëlla ose motër (nga nëna), atëherë çdonjërit prej tyre u takon një e gjashta. E nëse ka më shumë nga ata (vëlla e motër), ata janë pjesëmarrës të barabartë në një të tretën e pasurisë, pasi zbatohet porosia (*vasijet*) dhe pasi të lahen borxhet, duke mos dëmtuar asnjë." Pra, nëse janë më shumë se një, ata janë pjesëmarrës në një të tretën.

Atëherë, sipas mendimit të parë - kur me fjalën "vëllezër" janë për qëllim të gjithë llojet e vëllezërve, pavarësisht a meritojnë pjesë apo privohen nga ajo për shkak të prezencës së babait apo të gjyshit, - nëse i vdekuri lë pas nënën, babain dhe vëllezër (më shumë se një), nënës i takon një e gjashta, dhe pjesa tjetër i takon babait, ndërkohë që vëllezërit dhe motrat nuk marrin gjë, sepse janë të privuar nga prezenca e babait. Ndërsa sipas mendimit të dytë – kur me fjalën "vëllezër" janë për qëllim vetëm vëllezërit trashëgues e jo të privuarit – nënës i takon një e treta dhe babait pjesa që mbetet. Pastaj i Lartësuari thotë:

- "Kjo bëhet pas zbatimit të porosisë së lënë *(vasijet)* nga ai dhe pasi të lahen borxhet e tyre..." – Kështu, këto pjesë trashëgimie të përcaktuara nga Zoti shpërndahen vetëm pasi të jenë plotësuar detyrimet e të vdekurit. Detyrimet e tij financiare mund të jenë ose ndaj njerëzve, ose ndaj Zotit,[20] ose testament që ai ka lënë për t'u zbatuar pas vdekjes.[21] Pasi plotësohen këto detyrime, ajo që mbetet duhet të shpërndahet mes trashëgimtarëve, sipas përcaktimit të Allahut të Lartësuar.


Në këtë ajet, Allahu i Lartësuar ka përmendur *vasijet*-in (porosinë e veçantë) para borxhit, edhe pse ky i fundit duhet të plotësohet i pari. Kjo është bërë për t'i dhënë rëndësi plotësimit të tij, sepse shpesh trashëgimtarët e kanë të vështirë që ta zbatojnë atë. Sidoqoftë, plotësimi i borxhit është më parësor dhe ai duhet të jepet nga kreu i mallit, ndërsa për (vasijetin) porosinë e veçantë mund jepet deri te një e treta e pasurisë ose më pak se aq.

Prej porosisë së veçantë mund t'u jepet nga pasuria e të vdekurit vetëm atyre njerëzve që nuk kanë pjesë të përcaktuar nga Sheriati në trashëgiminë e të ndjerit. Ndërsa jashtë këtyre kushteve, pra, që vasijeti të jetë më shumë se një e treta, mund të lejohet veçse me lejen e trashëgimtarëve të përcaktuar me ligj. Më tej, i Lartësuari thotë:

---

[20] Si, për shembull, kur i ndjeri ka thyer ndonjë betim, që duhet të kompensonte, apo kur nuk ka dhënë zekatin brenda kohës së përcaktuar etj.

[21] Këtu hyjnë edhe shpenzimet për varrimin apo për shërbime të tjera të ngjashme, të cilat merren nga pasuria e të ndjerit, para se të fillojë ndarja e trashëgimisë.


الجزء الرابع سورة النساء
* ولكم نصف ما ترك أزواجكم إن لم يكن
لهن ولد فإن كان لهن ولد فلكم الربع مما
تركن من بعد وصية يوصين بها أو دين
ولهن الربع مما تركتم إن لم يكن لكم ولد
فإن كان لكم ولد فلهن الثمن مما تركتم
من بعد وصية توصون بها أو دين وإن كان
رجل يورث كلالة أو امرأة وله أخ أو أخت فلكل
واحد منهما السدس فإن كانوا أكثر من ذلك
فهم شركاء في الثلث من بعد وصية يوصى
بها أو دين غير مضار وصية من الله والله
عليم حليم ﴿١٢﴾ تلك حدود الله ومن يطع الله
ورسوله يدخله جنات تجري من تحتها
الأنهر خالدين فيها وذلك الفوز العظيم
﴿١٣﴾ ومن يعص الله ورسوله ويتعد حدوده
يدخله نارا خالدا فيها وله عذاب مهين
﴿١٤﴾
٧٩

- "Ju nuk e dini se cilët janë më të dobishëm për ju: prindërit tuaj apo fëmijët tuaj." - Nëse përcaktimi i masës së trashëgimisë do të lihej në dorën tonë, do të kishte patur padrejtësi dhe pasoja, që vetëm Zoti i di, sepse mendjet tona janë të mangëta, injorante dhe të prirura drejt padrejtësisë. Pa ndihmën dhe udhëzimin e Zotit, ato nuk mund ta njohin se çfarë është më e mira dhe më e drejta në çështjet e dynjasë dhe të fesë. Ne nuk mund ta dinim se cilët trashëgimtarë, prindërit apo fëmijët, janë më të dobishëm për ne, që të mund të gjykojmë se cilëve u duhet dhënë më shumë e cilëve më pak. Islami është rregulluesi i vetëm i të gjitha çështjeve, në çdo kohë, vend dhe gjendje.

- "Ky është urdhër nga Allahu. Vërtet Allahu është i Gjithëdijshmi, i Urti." – Kuptimi: Këto përcaktime janë detyrime për ju. Ky është i vetmi gjykim që ju duhet të zbatoni, sepse është vendosur prej të Gjithëditurit e të Urtit, që e ka përcaktuar çdo gjë me përpikmëri dhe në mënyrën më të mirë. Mendjet njerëzore nuk mund të sjellin kurrë diçka më të mirë dhe më të plotë se ligji i Zotit.

- "Juve ju takon gjysma e pasurisë që lënë bashkëshortet tuaja, nëse ato nuk kanë fëmijë." - Me fjalën "fëmijë" këtu kuptohen fëmijët biologjikë (jo të birësuar), djemtë apo vajzat e djalit të saj, një apo shumë qofshin, qofshin fëmijë nga burri apo nga burra të tjerë (nëse ka qenë e martuar më parë). Këtu nuk hyjnë djemtë dhe vajzat e vajzës së saj, dhe ky është një mendim konsensual i dijetarëve. Pra, nëse gruaja e vdekur nuk ka lënë pas fëmijë (sipas kësaj që u përmend), burrit i takon gjysma e pasurisë së saj. Në të kundërt:

- "Por nëse ato kanë fëmijë, juve ju takon një e katërta e pasurisë që lënë ato, pasi të zbatohet porosia e tyre dhe pasi të lahen borxhet e tyre."

- "Atyre *(grave)* ju takon një e katërta nga ajo që lini ju, nëse nuk keni fëmijë. Por nëse keni fëmijë, atyre ju takon një e teta nga ajo që lini, pasi zbatohet porosia juaj dhe pasi të lahen borxhet tuaja."

- "Në qoftë se i vdekuri, qoftë mashkull ose femër, është pa prindër dhe fëmijë, por ka vëlla ose motër *(nga nëna)*, atëherë çdonjërit prej tyre u takon një e gjashta." - Fjalët "vëlla" e "motër" tregojnë vëllain e motrën nga nëna, sikurse është përcjellë në disa variante të këndimeve të Kur'ânit. Edhe dijetarët janë të një mendimi se këtu bëhet fjalë për vëllezërit dhe motrat vetëm nga nëna.

Rasti el kelaleh

Sikurse ka thënë Ebu Bekri (Allahu qoftë i kënaqur me të!), rasti "*el kelaleh*" ndodh kur i vdekuri nuk lë pas as baba, as gjysh, as djalë, as djalë djali, as vajzë, as vajzë djali e ç'ka poshtë tyre. Në këtë rast, nëse ai ka lënë

pas veç një vëlla ose një motër vetëm nga nëna, atëherë secilit prej tyre i takon një e gjashta e trashëgimisë.

Megjithatë, sikur i vdekuri të ketë lënë pas qoftë edhe një fëmijë e ç'ka poshtë tyre (nipër e stërnipër) apo baba e ç'ka sipër tyre (gjyshër e stërgjyshër), kjo i përjashton nga trashëgimia vëllezërit dhe motrat e tij vetëm prej nëne. Ky është mendimi konsensual i dijetarëve.

- "E nëse ka më shumë nga ata *(vëlla e motër)*, ata janë pjesëmarrës të barabartë në një të tretën e pasurisë, pasi zbatohet porosia dhe pasi të lahen borxhet, duke mos dëmtuar asnjë. Kjo është porosi e Allahut. Allahu është i Gjithëdijshëm e shumë Durues." – Nëse janë disa (më shumë se një) vëllezër dhe motra nga nëna,[22] atëherë ata janë pjesëmarrës të barabartë në një të tretën e trashëgimisë. Pra, këtu nuk është i vlefshëm rregulli: "mashkulli merr sa për dy femra", pasi Allahu i Lartësuar ka thënë ata janë "*shurekae*", domethënë, pjesëmarrës të barabartë në një të tretën.

Nga ky ajet përfitojmë edhe një gjykim tjetër, atë për çështjen "*el Ĥimarijeh*". Kështu, nëse një grua lë pas vetes: bashkëshortin, nënën, vëllezër e motra nëne, vëllezër dhe motra nga nëna e babai, atëherë ndarja e trashëgimisë bëhet në këtë mënyrë: bashkëshorti i saj merr gjysmën, sepse e ndjera nuk ka lënë pas fëmijë. Nëna merr një të gjashtën, sepse e ndjera ka lënë vëllezër dhe motra. Vëllezërit dhe motrat nga nëna janë pjesëtarë të barabartë në një të tretën. Ndërsa vëllezërit dhe motrat nga nëna e babai nuk marrin gjë, sepse Allahu i Lartësuar ua ka lënë një të tretën vëllezërve dhe motrave nga nëna, kështu që përzierja e tyre me vëllezërit nga babai e nëna do të ishte një veprim që Allahu nuk e ka përmendur në ajet. Këtë e përforcon edhe fakti që vëllezërit dhe motrat nga nëna e babai nuk hyjnë në mesin e atyre trashëgimtarëve që meritojnë pjesë (*furuđ*) të përcaktuar nga Sheriati, por hyjnë tek ata që përfitojnë si "*aŝabe*", pra, nga ajo që mbetet pasi trashëgimtarët e *furuđ*-eve marrin pjesën e tyre. Ndërsa vëllezërit vetëm nga nëna janë vetë trashëgimtarë të *furuđ*-eve, domethënë ata kanë pjesë të përcaktuar nga Sheriati. Në rastin tonë, meqë nuk mbetet gjë, vëllezërit nga nëna e babai nuk marrin gjë. Ky është mendimi më i saktë mbi këtë çështje.

Ndërsa për sa i përket pjesës që meritojnë vëllezërit dhe motrat nga babai dhe nëna apo vetëm nga babai, kjo është sqaruar në ajetin 176 të kësaj sureje, ku i Lartësuari thotë: "Ata kërkojnë përgjigjen tënde. Thuaju: "Allahu ju përgjigjet për çështjen e atij që nuk ka lënë baba e as fëmijë që e trashëgojnë. Kështu, nëse vdes një njeri që nuk ka fëmijë, por ka motër, atëherë asaj *(motrës)* i takon gjysma e pasurisë së lënë. Ndërsa ai *(vëllai)* e trashëgon atë *(motrën)*, nëse ajo nuk ka fëmijë. Në qoftë se janë dy *(motra që trashëgojnë)*, atyre të dyjave u takojnë dy të tretat që lë ai. Në qoftë se janë disa vëllezër e motra, atëherë mashkullit i takon pjesë dyfish më shumë sesa femrës. Kështu jua sqaron Allahu dispozitat, që të mos humbni rrugën e drejtë. Allahu është i Dijshëm për çdo gjë."

Kështu, sipas ajetit, nëse ajo që trashëgon është një motër prej babe e nëne apo vetëm prej babe, asaj i takon gjysma e pasurisë së lënë. Nëse ato që trashëgojnë janë dy motra prej babe e nëne apo vetëm prej babe, atyre u takojnë dy të tretat e pasurisë së lënë. Nëse ato që trashëgojnë janë një motër prej babe e nëne dhe një motër ose disa motra vetëm nga baba, ndarja bëhet në këtë mënyrë: motra prej babe e nëne merr gjysmën, ndërsa motrat vetëm nga babai marrin një të gjashtën, apo siç quhet ndryshe "plotësuesen e 2/3 (dy të tretave)". Por nëse motrat prej babe e nëne janë më shumë se një, ato marrin dy të tretat, dhe motrave vetëm prej babe nuk u mbetet gjë prej

[22] Për shembull, një vëlla e një motër, dy vëllezër, dy motra, dy vëllezër e një motër, dy motra e një vëlla, etj, të gjithë nga nëna.

pasurisë, sikurse e përmendëm një gjë të tillë kur folëm për pjesën e vajzave dhe të vajzave të djalit. Nëse trashëgimtarë janë vëllezër e motra të përzierë, atëherë këtu vlen fjala e Allahut të Lartësuar: mashkullit i takon pjesë dyfish më shumë sesa femrës.

Dikush mund të pyesë: Po për rastet e tjera të trashëgimisë, a kuptohet gjë nga ajeti? Përgjigjja është po. Në ajet ka disa shenja udhëzuese për çështje të tjera, të cilat vetëm një i pavëmendshëm nuk mund t'i vërejë. Kështu, për shembull, shkaqet privuese të trashëgimisë janë: skllavëria, vrasja e trashëgim-lënësit dhe ndryshimi i përkatësisë fetare. Por si kuptohet kjo nga ajeti?

Allahu i Lartësuar thotë: "Ju nuk e dini se cilët janë më të dobishëm për ju: prindërit tuaj apo fëmijët tuaj". Pa ndihmën dhe udhëzimin e Zotit, ne nuk mund ta njohim se çfarë është më e mira dhe më e drejta në çështjet e dynjasë dhe të fesë. Ne nuk mund ta dinim se cilët trashëgimtarë, prindërit apo fëmijët, janë më të dobishëm për ne, që të mund të gjykojmë se cilëve u duhet dhënë më shumë e cilëve më pak. Ky është një tregues i urtësisë së Allahut të Lartësuar, që dëshiron të plotësojë mirësinë e Tij ndaj nesh në ndarjen e pasurisë mes trashëgimtarëve, në varësi të aftësisë dhe të dobisë që ofron secili në aspektin e dynjasë dhe të fesë tonë.

Kështu, po të shohim në këtë drejtim, do të kuptojmë se vrasësi dhe jomuslimani e cenojnë këtë urtësi të Allahut të Lartësuar në shpërndarjen e trashëgimisë. Vrasësi i ka shkaktuar trashëgim-lënësit dëmin më të madh, i ka marrë jetën. Për këtë arsye, atij nuk duhet t'i takojë kurrsesi pjesë nga trashëgimia, e cila është përcaktuar në varësi të dobisë që ofron trashëgimtari për trashëgim-lënësin. Gjithashtu, është e njohur edhe norma ligjore që thotë: "Ai që synon përshpejtimin e një gjykimi para kohës së përcaktuar nga Sheriati për të, ndëshkohet duke u privuar prej tij". Kështu, vrasësi i trashëgim-lënësit synon të përshpejtojë marrjen e trashëgimisë nga i vrari, prandaj edhe ndëshkohet duke u privuar nga pjesa e tij (përveç ndëshkimit për vrasjen, sigurisht).

Ndërsa jomuslimani, edhe pse mund të jetë i aftë i trashëgimlënësit, nuk meriton pjesë prej tij. Ai mund ta meritojë trashëgiminë për shkak të aftësisë farefisnore, por është kufri i tij që e privon prej saj. Nuk ka dyshim se mosbesimi në fe është një ndasi shumë e madhe mes trashëgim-lënësit dhe trashëgimtarit. Ata nuk i sjellin asnjë dobi njëri-tjetrit. Shkaku i privimit nga trashëgimia është më i fortë se shkaku i meritimit të saj. Po ashtu, të drejtat e muslimanëve janë më parësore për t'u plotësuar sesa të drejtat e të afërmve jobesimtarë.

Është e vërtetë që Allahu i Lartësuar thotë në suren Enfalë: "Anëtarët e një farefisi janë më parësorë ndaj njëri-tjetrit, sipas Librit të Zotit. Me të vërtetë, Allahu është i Dijshëm për gjithçka." Në fillim, në Medinë, Pejgamberi (a.s.) bëri një vëllazërim të veçantë mes muhaxhirve (emigrantëve mekas) dhe ensarëve (vendasve medinas), përveç vëllazërisë së përgjithshme që ekziston në Islam mes besimtarëve, aq sa ata u bënë pjesëtarë në trashëgiminë e njëri-tjetrit. Por Allahu i Lartësuar shpalli më pas dispozitat për trashëgiminë, sipas të cilave, vëllazëria në Islam nuk të jep të drejtë në trashëgimi, por është lidhja e gjakut faktor kryesor për përfitimin nga trashëgimia. Megjithatë, jo çdo lloj farefisnie është përfituese, prandaj ajeti duhet kuptuar saktë. Qëllimi këtu është për pjesëtarët muslimanë të farefisit, jo për ata që janë qafirë. Nëse një farefis është jomusliman, atëherë është më parësore vëllazëria në Islam.

Ibn Kajjimi, në librin e tij "*Xhelâul Efhâm*", thotë: "Shih me vëmendje se si Allahu i Lartësuar e ka lidhur ngushtë meritën për trashëgimi mes burrit dhe gruas me të qenurit e tyre bashkëshortë të njëri-tjetrit. Ai ka thënë: "Juve ju takon gjysma e asaj që kanë lënë bashkëshortet tuaja, nëse ato nuk kanë lënë fëmijë". Pra, nuk ka thënë "gratë tuaja", por ka përdorur fjalën

"bashkëshortet", për të treguar se shkak i meritës së trashëgimisë është një lidhje më e ngushtë mes atyre të dyve, dhe jo thjesht lidhja mes një burri dhe një gruaje. Pa dyshim, edhe mes qafirit dhe muslimanit nuk ekziston ndonjë lidhje e tillë e ngushtë dhe, si rrjedhojë, ata nuk mund të jenë trashëgimtarë të njëri-tjetrit. Të fshehtat e termave të përdorura në Kur'ân qëndrojnë shumë më lart se mendjet dhe arsyetimet e njerëzve."

Për sa i përket skllavit, ai as trashëgohet dhe as trashëgon gjë. Ai nuk trashëgohet, sepse nuk zotëron pasuri. Ai dhe pasuria e tij janë pronë e padronit të tij. Po ashtu, ai nuk trashëgon, sepse edhe nëse merr pasuri në formë trashëgimie, ajo automatikisht i takon zotërisë së tij.

Për sa i përket atij që është gjysëm skllav dhe gjysëm i lirë, gjykimi për të është në varësi të secilës pjesë. Kjo çështje gjendet e sqaruar në librat e *fikh*-ut.

Për sa i përket hermafroditit (deledashit), ekzistojnë dy raste:

1. Kur është më e theksuar njëra gjini e tij. Për shembull, nëse anon më tepër nga mashkulli, atij i takon pjesa si trashëgimtar mashkull. Por nëse anon më tepër nga seksi femër, atëherë i takon pjesa si trashëgimtare femër.

2. Kur nuk ka asnjë gjini të theksuar. Edhe në këtë rast paraqiten dy mundësi:

a. Nëse pjesa e tij në trashëgimi është e njëjtë si të ishte mashkull, si femër, çështja është e thjeshtë dhe e qartë. Kjo ndodh, për shembull, kur janë shumë vëllezër e motra, që përfitojnë nga trashëgimia në mënyrë të barabartë.

b. Nëse pjesa e tij në trashëgimi ndryshon po të trajtohet si mashkull apo si femër. Kështu, nëse i japim pjesë si mashkull, do t'u bënim padrejtësi trashëgimtarëve të tjerë, por nëse i japim pjesë si femër, do t'i bënim padrejtësi atij, se mund të meritojë pjesë mashkulli. Atëherë, në një rast të tillë, gjejmë rrugën e mesme, duke i dhënë diçka më shumë se një pjesë femre dhe diçka më pak se një pjesë mashkulli. Kështu na urdhëron i Lartësuari, kur thotë: "Mbani drejtësinë, se ajo është më pranë devotshmërisë!". Më shumë se kaq nuk mund ta mbajmë drejtësinë. Kaq e kemi mundësinë dhe Allahu i Lartësuar nuk ngarkon asnjë tej mundësive, siç thotë në një ajet: "Allahu nuk e ngarkon asnjë më shumë sesa ai ka mundësi." Apo: "Frikësojuni Allahut aq sa të keni mundësi!"

A trashëgojnë apo jo vëllezërit nga babai e nëna apo vetëm nga babai, nëse është edhe gjyshi? A përmendet në Kur'ân dispozita për këtë çështje? Është i pranuar fakti që prania e babait i përjashton vëllezërit nga babai e nëna apo vetëm nga njëra palë. Por a gjykohet njëlloj edhe prania e gjyshit? A ka ai të njëjtën gradë si babai?

Përgjigja për këtë pyetje është dhënë në pjesë të tjera të Kur'ânit, ku Allahu i Lartësuar e ka quajtur gjyshin "baba", si për shembull: "A ishit ju të pranishëm, kur Jakubi, në momentin e vdekjes, u tha bijve të vet: "Çfarë do të adhuroni pas meje?" Ata thanë: "Do të adhurojmë Zotin tënd dhe Zotin e etërve të tu: Ibrahimit, Ismailit, Is'hakut; një Zot të vetëm. Vetëm Atij i nënshtrohemi!" [Bekare 133]. Ose kur Jusufi thotë: "Unë ndjek fenë e etërve të mi: Ibrahimit, Is'hakut, Jakubit." [Jusuf 38]. Pra, Allahu i Lartësuar i ka quajtur "etër" edhe gjyshërit, edhe stërgjyshërit. Kjo tregon se gjyshi gëzon të njëjtin status si babai dhe ka të njëjtin rol si ai. Pra, ai trashëgon si babai dhe privon nga trashëgimia njëlloj siç privon babai. I tillë ka qenë edhe gjykimi i Ebu Bekrit (Allahu qoftë i kënaqur me të!). Dijetarët janë të një mendimi që gjyshi gëzon të njëjtin status si babai (kur babai mungon), në lidhje me trashëgimtarët e tjerë, si fëmijët, fëmijët e vëllezërve, xhaxhallarët dhe fëmijët e tyre etj.

Por a ka gjyshi të njëjtin ndikim edhe në lidhje me vëllezërit jo nga ana e nënës? Edhe në këtë rast ai duhet të gëzojë të njëjtin status. Duke qenë se ai e gëzon këtë status në rastet e lartpërmendura, nuk ka arsye që

në këtë rast të jetë ndryshe. Këtë e përforcon edhe fakti që biri i djalit (nipi) gëzon të njëjtin status si biri. Pra, pse të mos jetë ky vlerësim edhe për rastin e babait të babait. Me fjalë të tjera, duke qenë se nipi konsiderohet njëlloj si djali, pse të mos konsiderohet edhe gjyshi njëlloj si babai? Dijetarët janë unanimë në faktin që gjyshi i babait (të të ndjerit) privon nga trashëgimia djalin e vëllait (të të ndjerit). Atëherë, pse të mos e privojë gjyshi i të ndjerit, vëllanë e të ndjerit?! Ata që u bëjnë pjesë vëllezërve edhe kur gjyshi është i pranishëm, nuk kanë argument apo tekst ku të mbështeten.

Po çështjet e quajtura "*el aul*" dhe "*el redd*", a janë përmendur në Kur'ân? Përgjigjja është po. Por le të kuptojmë fillimisht se çfarë janë këto dy çështje, dhe pastaj të vërtetojmë përgjigjen e mësipërme.

Allahu i Lartësuari ka përcaktuar trashëgimtarët si dhe pjesët e tyre, qofshin ato meritues me *furud*, qofshin meritues me *teasib*. Trashëgimtarët janë të tillë që ose e privojnë njëri-tjetrin, ose që nuk e privojnë njëri-tjetrin nga trashëgimia. Në rastin e parë, të privuarit nuk meritojnë gjë, dhe çështja është e qartë. Ndërsa në rastin e dytë shfaqen tri mundësi:

1. Pasi trashëgimtarët e *furud*-eve marrin pjesën e tyre, nga trashëgimia mbetet sërish diçka.

2. Pasi trashëgimtarët e *furud*-eve marrin pjesën e tyre, nga trashëgimia nuk mbetet asgjë.

3. Nga ndarja e trashëgimisë, mbetet ndonjë trashëgimtar i *furud*-eve pa pjesë.

Në dy rastet e para nuk ka ndonjë problem, sepse secili e merr pjesën e vet të plotë. Ndërsa për rastin e tretë ka dy mundësi:

a. T'ia pakësojmë ndonjë trashëgimtari pjesën e tij, për t'ia dhënë tjetrit të plotë. Në fakt, kjo do të ishte padrejtësi, sepse askush prej tyre nuk e meriton më shumë se tjetri për ta marrë pjesën e vet të plotë. Po ashtu, një gjykim i tillë është i pabazuar. Atëherë mbetet mundësia e dytë.

b. T'i japim secilit nga pjesa e tij aq sa mundemi, dhe pastaj, për të plotësuar pjesët e të gjithëve, veprojmë me përqindje, sikurse bëhet në rastin e shlyerjes së borxhit të të ndjerit, ku secili jep sipas pjesës që meriton prej trashëgimisë. Kështu, nëse dikush meriton 20% të trashëgimisë, ai do të mbulojë 20% të borxhit, e kështu me radhë. Kjo çështje dhe mënyrë zgjidhjeje quhet "*el aul*".

Ndërsa rasti i kundërt i saj quhet *el redd*. Pra, nëse trashëgimtarët marrin pjesët e tyre të plota dhe prej trashëgimisë tepron ende pjesë, ndërkohë që nuk ka meritues të saj të përcaktuar nga Sheriati, atëherë edhe pjesën e mbetur ua ndajmë trashëgimtarëve, në bazë të përqindjes që meritojnë. Nëse dikush, për shembull, meriton 30% të trashëgimisë, merr 30% të kësaj shtese, e kështu me radhë. Në të kundërt, nëse do t'ia jepnim vetëm njërit prej trashëgimtarëve, kjo do të ishte padrejtësi. Edhe nëse do t'ia jepnim dikujt tjetër jashtë kategorive të përcaktuara, përsëri do të ishte padrejtësi dhe thyerje e fjalës së Allahut të Lartësuar: "Anëtarët e një farefisi janë më parësorë ndaj njëri-tjetrit, sipas Librit të Zotit. Me të vërtetë, Allahu është i Dijshëm për gjithçka.". Prandaj, si rruga më e e mirë mbetet ajo që u përshkrua më lart.

Duke qenë se bashkëshortet nuk hyjnë në farefisni, ato nuk meritojnë shtesë prej *el redd*-it. Të këtij mendimi janë shumica e dijetarëve që e pranojnë ushrimin e *el redd*-it. Si fakt mbështetës, ata përdorin ajetin e Allahut të Lartësuar: "Anëtarët e një farefisi janë më parësorë ndaj njëri-tjetrit, sipas Librit të Zotit."

Ndërsa të tjerët janë të mendimit se edhe bashkëshortet përfitojnë prej *el redd*-it, pasi shkaku i përfitimit është thjesht statusi i tyre si trashëgimtarë të *furud*-eve, pavarësisht në janë farefis apo bashkëshortë. Këta arsyetojnë e thonë: Duke qenë se, në rastin e *el aul*-it, edhe bashkëshorti jep prej pjesës së tij për të plotësuar pjesët e merituesve të *furud*-eve, nuk ka arsye që në rastin e *el redd*-

it të mos trajtohen njëlloj. Këtë e dëshmon Libri (Kur'âni), Suneti dhe analogjia e saktë dhe e drejtë. Megjithatë, Allahu është më i ditur për gjithçka.

Nga ajetet kur'ânore kuptojmë se, nëse i vdekuri nuk ka lënë pas asnjë prej trashëgimtarëve që përfitojnë me ligj, ndërkohë që ata të cilët mund të përfitojnë janë vetëm Rezervat e shtetit ose ndonjë farefis i largët, ai që përfiton nga pasuria është ky pjesëtar i farefisit, sado i largët qoftë, sepse Allahu i Lartësuar thotë: "Anëtarët e një farefisi janë më parësorë ndaj njëri-tjetrit, sipas Librit të Zotit.". Nëse do t'ua jepnim të tjerëve, kjo do të ishte një vepër në kundërshtim me ajetin, që udhëzon qartë për të kundërtën. Edhe pse Allahu i Lartësuar nuk ka përcaktuar konkretisht pjesë në trashëgimi për një farefis të largët, ai përsëri përfiton prej trashëgimisë, duke qenë se ka lidhje me të vdekurin. Allahu i Lartësuar është më i ditur për gjithçka.

Për sa i përket trashëgimisë që meritojnë të afërmit *el asabe*, pra, ata që trashëgojnë nëpërmjet *teasib*-it, Pejgamberi (a.s.) ka thënë: "Jepuni trashëgiminë atyre që u takon. Ajo që mbetet, le t'i jepet mashkullit më të afërt (të të ndjerit)." Allahu i Lartësuar e përforcon këtë qëndrim kur thotë: "Ne i kemi caktuar secilit prej jush të afërm nga prindërit ose farefisi. Edhe atyre me të cilët keni pakt jepuni pjesën e tyre. Allahu është dëshmitar për çdo gjë." Nëse shpërndajmë pjesët për trashëgimtarët e *furud*-eve dhe nuk mbetet gjë, atëherë të afërmit *el asabe* nuk marrin gjë. Por nëse mbetet diçka, ai që përfiton është mashkulli më i afërt, sipas anës dhe nivelit të tij.

Anët e afërsisë, sipas rëndësisë së tyre, janë pesë:

1. Birësia.
2. Atësia
3. Vëllazëria dhe fëmijët e tyre.
4. Xhaxhallarët me fëmijët e tyre.
5. Çliruesi nga skllavëria (*el uela*).

Kështu, fillimisht i jepet përparësi anës më të afërt. Nëse për nga ana e afërsisë palët janë njëlloj, atëherë i jepet përparësi nivelit më të afërt. Për shembull, nëse janë fëmijët e vëllezërve dhe fëmijët e fëmijëve të vëllezërve, atëherë u jepet përparësi fëmijëve të vëllezërve, sepse janë një nivel më lart. Nëse palët janë të një ane dhe të një niveli (si p.sh., janë të dy prej vëllezërve), atëherë i jepet përparësi atij që është vëlla nga babai e nëna, kundrejt atij që është vetëm nga njëra palë. Nëse janë njëlloj në çdo drejtim, atëherë ata janë pjesëmarrës të barabartë në trashëgimi. Allahu është më i ditur.

Pyetje: Si veprohet nëse pas ndarjes së pasurisë mes trashëgimtarëve të *furud*-eve mbetet diçka dhe prej *el asabe*-s ndodhen vetëm motra jo nga nëna dhe vajza ose vajza djali? A ka ndonjë argument që të tregojë se prania e vajzave dhe e vajzave të djalit përjashtojnë motrat jo nga nëna nga trashëgimia?

Përgjigja është jo. Nuk ka argument nga Kur'âni që të tregojë për këtë gjë. Nëse çështja është kështu, atëherë pasi vajzat marrin pjesën e tyre të *furud*-eve dhe mbetet diçka prej pasurisë, atëherë ajo u jepet motrave dhe nuk u jepet atyre që janë më larg se ato, si djali i vëllait apo xhaxhai e më larg se ata. Allahu është më i ditur për gjithçka.

Ajetet 13 – 14

13. Këta janë kufijtë e Allahut. Ata që i binden Allahut dhe të Dërguarit të Tij, Ai do t'i fusë në kopshte, nëpër të cilët burojnë lumenj e ku do të jenë përgjithmonë. Ky është suksesi i madh.
14. Ndërsa ata që e kundërshtojnë Allahun dhe të Dërguarin e Tij dhe i shkelin kufijtë e Tij, do të futen në Zjarr, ku do të jenë përjetësisht. Për ta është përgatitur një dënim i rëndë.

Shpjegimi i ajeteve

- "Këta janë kufijtë e Allahut." - Pra, dispozitat e mësipërme të trashëgimisë janë

kufijtë e vendosur nga Zoti, të cilët nuk duhet t'i shkelim, por duhet t'i zbatojmë me korrektësi. Nuk lejohet shkelja apo tjetërsimi i tyre.

Ky ajet dëshmon, gjithashtu, që trashëgimtarët nuk mund të përfitojnë edhe nga porosia e veçantë e të ndjerit, sepse do të konsiderohej si kalim i kufijve të vendosur nga Allahu i Lartësuar në përcaktimin e pjesës së secilit prej trashëgimtarëve. Këtë e përforcon edhe thënia e Profetit (a.s.): *"Nuk ka porosi të veçantë (vasijet) për trashëgimtarët e përcaktuar"*. Pra, nuk lejohet që ai i cili ka pjesë në trashëgimi të përfitojë edhe nga porosia e veçantë e të ndjerit.

Më pas, Allahu i Lartësuar urdhëron për bindje ndaj Tij dhe ndaj të Dërguarit të Tij, ku përfshihet edhe bindja për dispozitat e trashëgimisë, duke e përforcuar mirë këtë porosi. I Lartësuari thotë:

- "Ata që i binden Allahut dhe të Dërguarit të Tij..." - Bindja ndaj Allahut të Lartësuar dhe Profetit (a.s.) ka format e saj se si duhet të shprehet. Më e pakta është zbatimi i urdhrave dhe largimi prej ndalesave të Tij.

Urdhri më i rëndësishëm është njësimi i Zotit në adhurim, dhe pastaj vijnë të tjerët. Ndalesa më e madhe së cilës duhet t'i largohemi është idhujtaria, pra, përkushtimi i adhurimeve dikujt tjetër, veç Allahut të Lartësuar. Pastaj vijnë gjynahet e niveleve të tjera. Si urdhrat, ashtu edhe ndalesat, Allahu i Lartësuar ua ka sqaruar krijesave plotësisht nëpërmjet Kur'ânit dhe Traditës së Profetit të Tij. Detyra e robit është që, fillimisht, t'i njohë ato dhe ta lusë Zotin që ta ndihmojë në zbatimin dhe qëndrimin brenda tyre. Atë që Zoti e ka begatuar me këtë dituri dhe e udhëzon që të punojë me të, ai është në rrugë të mbarë dhe atë e pret një premtim madhështor, siç thotë i Lartësuari:

- "Ai do t'i fusë në kopshte, nëpër të cilët burojnë lumenj e ku do të jenë përgjithmonë." - Ai që kryen urdhëresat e Zotit me sinqeritet, sipas porosive të Tij, dhe që i largohet harameve, patjetër që do të hyjë në Xhenet dhe do të jetë i shpëtuar nga Zjarri. Pikërisht ai e ka arritur suksesin e madh, siç thotë i Lartësuari:

- "Ky është suksesi i madh." – Suksesi i madh është kur ke shpëtuar nga zemërimi e ndëshkimi i Allahut dhe kur je i lumtur në bujarinë dhe kënaqësinë e Allahut, në Xhenetin e mirësisë, që Ai e ka përgatitur për besimtarët e Tij të bindur dhe që asnjë krijesë nuk mund ta përshkruajë ashtu si është në realitet.

- "Ndërsa ata që e kundërshtojnë Allahun dhe të Dërguarin e Tij dhe i shkelin kufijtë e Tij, do të futen në Zjarr, ku do të jenë përjetësisht. Për ta është përgatitur një dënim i rëndë." – Te "kundërshtimi" përfshihen gjynahet më të mëdha, që janë kufri dhe idhujtaria, duke vazhduar pastaj me gjynahet e tjera. Megjithatë, *hauarixh*-ët nuk mund të përdorin vetëm këtë ajet si mbështetës të tezës së tyre të gabuar se çdokush që "kundërshton" ka bërë kufër dhe meriton përjetësinë në Xhehenem. Arsyeja është se fjala "*mea'sije*" (kundërshtim) përdoret jo vetëm për kufrin, por edhe për gjynahet poshtë tij. Kur Allahu i Lartësuar thotë se ata që bëjnë "*mea'ŝije*" do të jenë në Zjarr përjetësisht, kjo nuk duhet kuptuar se çdo lloj *mea'ŝije* e meriton këtë ndëshkim. Kjo thënie është e përgjithshme dhe duhet parë bashkë me të gjitha tekstet e tjera të Sheriatit, për të dhënë një gjykim të drejtë mbi të.

Allahu i Lartësuar e ka lidhur ngushtë futjen në Xhenet me bindjen ndaj Tij dhe ndaj Profetit të Tij, ndërsa futjen në Zjarr e ka lidhur ngushtë me kundërshtimi ndaj Tij dhe ndaj Profetit të Tij. Ata që i binden Zotit plotësisht do të hyjnë në Xhenet dhe kurrë nuk do të ndëshkohen në Zjarr. Ndërsa ata që nuk i binden aspak Allahut dhe Profetit, por që bëjnë idhujtari, kufër dhe gjynahe të tjera, ata do të hyjnë në Zjarr dhe atje do të jenë përjetësisht. Ndërsa ata që tregojnë

edhe bindje ndaj Zotit e Profetit, edhe mosbindje ndonjëherë, atëherë sipas shkallës së bindjes apo mosbindjes, do të shpërblehen apo do të ndëshkohen. Tekstet e sakta të Sheriatit tregojnë se ata që e njësojnë Allahun e Lartësuar dhe nuk bëjnë idhujtari, ata kurrsesi nuk do të qëndrojnë përjetësisht në Zjarr, çfarëdo gjynahu poshtë kufrit dhe idhujtarisë të kenë bërë. Monoteizmi i tyre nuk e lejon përjetësinë në zjarrin e Xhehenemit. Kështu duhen trajtuar tekstet e Sheriatit, të cilët duhen parë gjithmonë nën dritën e njëri-tjetrit.

Ajetet 15 - 16

15. Për ato gra tuaja që bëjnë imoralitet, kërkoni që kjo *(vepër)* të dëshmohet nga katër vetë *(burra)* prej jush. Nëse këta dëshmojnë, atëherë ato *(gratë)* mbyllini në shtëpi, derisa t'u vijë vdekja ose derisa Allahu të përcaktojë ndonjë zgjidhje tjetër për to.


16. Nëse një çift prej jush kryejnë këtë vepër të poshtër, ju ndëshkojini që të dy. Por nëse ata pendohen dhe përmirësohen, atëherë hiqjani dënimin, se Allahu e pranon pendimin dhe është Mëshirëplotë.

Shpjegimi i ajeteve

- "Për ato gra tuaja që bëjnë imoralitet, kërkoni që kjo *(vepër)* të dëshmohet nga katër vetë *(burra)* prej jush." - Këtu është fjala për marrëdhëniet seksuale të jashtëligjshme. Allahu i Lartësuar e ka cilësuar imoralitetin më poshtë si "vepër e poshtër" (*fâhîsheh*), për të treguar se sa i shëmtuar është ai.

Por që të pranohet kjo akuzë, duhet të dëshmojnë katër burra "nga mesi juaj", domethënë besimtarë të drejtë dhe të besueshëm, se e kanë parë qartësisht.

- "Nëse këta dëshmojnë, atëherë ato *(gratë)* mbyllini në shtëpi, derisa t'u vijë vdekja ose derisa Allahu të përcaktojë ndonjë zgjidhje tjetër për to." - Nëse dëshmia e tyre


الجزء الرابع سورة النساء
وَٱلَّٰتِي يَأۡتِينَ ٱلۡفَٰحِشَةَ مِن نِّسَآئِكُمۡ فَٱسۡتَشۡهِدُواْ عَلَيۡهِنَّ
أَرۡبَعٗا مِّنكُمۡۖ فَإِن شَهِدُواْ فَأَمۡسِكُوهُنَّ فِي ٱلۡبُيُوتِ
حَتَّىٰ يَتَوَفَّىٰهُنَّ ٱلۡمَوۡتُ أَوۡ يَجۡعَلَ ٱللَّهُ لَهُنَّ سَبِيلٗا ١٥
وَٱلَّذَانِ يَأۡتِيَٰنِهَا مِنكُمۡ فَـَٔاذُوهُمَاۖ فَإِن تَابَا وَأَصۡلَحَا
فَأَعۡرِضُواْ عَنۡهُمَآۗ إِنَّ ٱللَّهَ كَانَ تَوَّابٗا رَّحِيمًا ١٦
إِنَّمَا ٱلتَّوۡبَةُ عَلَى ٱللَّهِ لِلَّذِينَ يَعۡمَلُونَ ٱلسُّوٓءَ بِجَهَٰلَةٖ
ثُمَّ يَتُوبُونَ مِن قَرِيبٖ فَأُوْلَٰٓئِكَ يَتُوبُ ٱللَّهُ عَلَيۡهِمۡۗ
وَكَانَ ٱللَّهُ عَلِيمًا حَكِيمٗا ١٧ وَلَيۡسَتِ ٱلتَّوۡبَةُ لِلَّذِينَ
يَعۡمَلُونَ ٱلسَّيِّـَٔاتِ حَتَّىٰٓ إِذَا حَضَرَ أَحَدَهُمُ ٱلۡمَوۡتُ
قَالَ إِنِّي تُبۡتُ ٱلۡـَٰٔنَ وَلَا ٱلَّذِينَ يَمُوتُونَ وَهُمۡ كُفَّارٌۚ
أُوْلَٰٓئِكَ أَعۡتَدۡنَا لَهُمۡ عَذَابًا أَلِيمٗا ١٨ يَٰٓأَيُّهَا ٱلَّذِينَ
ءَامَنُواْ لَا يَحِلُّ لَكُمۡ أَن تَرِثُواْ ٱلنِّسَآءَ كَرۡهٗاۖ وَلَا تَعۡضُلُوهُنَّ
لِتَذۡهَبُواْ بِبَعۡضِ مَآ ءَاتَيۡتُمُوهُنَّ إِلَّآ أَن يَأۡتِينَ بِفَٰحِشَةٖ
مُّبَيِّنَةٖۚ وَعَاشِرُوهُنَّ بِٱلۡمَعۡرُوفِۚ فَإِن كَرِهۡتُمُوهُنَّ فَعَسَىٰٓ
أَن تَكۡرَهُواْ شَيۡـٔٗا وَيَجۡعَلَ ٱللَّهُ فِيهِ خَيۡرٗا كَثِيرٗا ١٩
٨٠

pranohej dhe gjykohej si e vërtetë, atëherë gruaja imorale mbyllej në shtëpi.

Izolimi është një lloj dënimi. Gruaja imorale izolohej në shtëpi deri në vdekje, ose derisa Zoti të sillte një zgjidhje apo mënyrë tjetër dënimi për të.

Ky gjykim nuk është i shfuqizuar, por është i afatizuar deri në kohën e një gjykimi tjetër. Pra, në fillimet e Islamit, ky ishte gjykimi për marrëdhëniet seksuale të jashtëligjshme, deri në kohën kur hyri në fuqi ligji i gurëzimit për të martuarit dhe i goditjes me kamxhik për të pamartuarit, i vendosur nga ajetet e tjera për këtë çështje.

- "Nëse një çift prej jush kryejnë këtë vepër të poshtër, ju ndëshkojini që të dy." – Kuptimi: Nëse një çift, një burrë dhe një grua, kryejnë marrëdhënie seksuale të jashtëligjshme, atëherë ndëshkojini që të dy me fyerje e me rrahje, të cilat të shërbejnë si mësim edhe për të tjerët, për t'u larguar nga kjo poshtërsi.

Kështu, në fillim kishte dy lloje ndëshkimesh: për burrat ishte ndëshkimi me fyerje dhe me rrahje, ndërsa për gratë ishte ndëshkimi me fyerje, rrahje dhe izolim. Kjo mënyrë zgjati deri në hyrjen në fuqi të ligjit për imoralitetin.

Por nëse izolimi vazhdonte deri në vdekje, mundimi me fjalë dhe rrahje vazhdonte derisa palët të pendoheshin dhe të vërehej qartë rregullimi i gjendjes së tyre, siç thotë Allahu i Lartësuar:

- "Por nëse ata pendohen dhe përmirësohen, atëherë hiqjani dënimin, se Allahu e pranon pendimin dhe është Mëshirëplotë." – Pra, nëse ata pendohen dhe këtë e vërtetojnë duke kryer vepra të mira, atëherë u rrëzohet dënimi me fjalë dhe rrahje, sepse Allahu është Pranues i pendimit dhe Mëshirues i madh. Prej mëshirës së Tij të madhe është edhe suksesi që Ai u dhuron njerëzve për t'u penduar, edhe pranimi i këtij pendimi, duke ua falur gabimet.

Nga ky ajet kuptojmë që akuza se dikush ka bërë imoralitet duhet të mbështetet dhe të faktohet me dëshminë e katër burrave besimtarë, të drejtë dhe të besueshëm, që nuk janë të akuzuar asnjëherë për mashtrim.

Allahu i Lartësuar e ka shtrënguar shumë trajtimin e këtij krimi. Vërtet, Ai ka caktuar një ndëshkim të fortë për të, por edhe dëshmia për faktimin e tij duhet të jetë shumë e bazuar, me qëllim që njerëzit të mos akuzohen asnjëherë kot për një vepër kaq të rëndë, e cila është shkatërruese e familjes dhe e shoqërisë. Për këtë rast nuk pranohet dëshmia e grave, qofshin ato të vetme, qofshin së bashku me burrat. Gjithashtu, nuk pranohet dëshmia e më pak se katër burrave. Kusht tjetër është që dëshmia të shprehet shkoqur e kuptueshëm. Dëshmitari duhet të dëshmojë se e ka parë qartësisht dhe pa asnjë dyshim se të akuzuarit kanë bërë imoralitet me kuptimin e plotë të marrëdhënieve seksuale. Allahu i Lartësuar e ka përsëritur çështjen e të dëshmuarit, duke përforcuar atë, kur thotë: "...kërkoni që kjo *(vepër)* të dëshmohet nga katër vetë *(burra)* prej jush. Nëse këta dëshmojnë, atëherë ato *(gratë)* mbyllini në shtëpi...". Qëllimi është që çdo gjë të jetë e sigurt.

Në këtë ajet kuptohet që izolimi apo dënimi me fjalë dhe veprime kundër gjynahqarëve janë mënyra të lejueshme, nëse nëpërmjet tyre mund të arrihet riedukimi.

Ajetet 17 – 18

17. Pendim i pranueshëm tek Allahu është vetëm pendimi i atyre që e bëjnë të keqen nga padituria dhe pendohen menjëherë. Këtyre ua pranon pendimin Allahu. Allahu është më i Dijshmi e më i Urti.
18. Nuk është i pranueshëm pendimi i atyre që vazhdimisht bëjnë vepra të këqija dhe vetëm atëherë kur ndonjërit prej tyre i vjen vdekja, thotë: "Unë tani me të vërtetë u pendova!"; e as pendimi i atyre që vdesin duke qenë jobesimtarë. Ndaj tyre kemi përgatitur dënim të ashpër.

Shpjegimi i ajeteve

Allahu i Lartësuar ua mundëson pendimin robërve të Tij, së pari, duke i udhëzuar dhe duke ua bërë të dashur pendimin dhe, së dyti, duke ua pranuar pendimin e tyre, pasi i ka ndihmuar të arrijnë atje.

Në këtë ajet Allahu i Lartësuar na tregon se Ai, me bujarinë dhe mirësinë e Tij, ia ka bërë detyrë Vetes që t'ia pranojë pendimin një kategorie gabimtarësh, të cilët i karakterizon një cilësi e veçantë:

- "Pendim i pranueshëm tek Allahu është vetëm pendimi i atyre që e bëjnë të keqen nga padituria dhe pendohen menjëherë. Këtyre ua pranon pendimin Allahu." – Pra, kushti i parë është se: gabimin e bëjnë nga padituria.

Por për çfarë padituri bëhet fjalë këtu. Mos vallë, kur nuk e dinë se veprimi në fjalë

është gabim? Jo, kurrsesi. Ata janë të vetëdijshëm se kjo vepër është haram dhe e veprojnë atë. Prandaj u quhet se bëjnë gjynah, sepse në të kundërt, nëse ata nuk do ta dinin se është haram, atëherë nuk do t'u shkruhej si gjynah. Këtu bëhet fjalë për tjetër lloj padituri: ata nuk e dinë fundin e saj të hidhur dhe të dhimbshëm, nuk e dinë se ajo shkakton zemërimin e Allahut të Lartësuar dhe ndëshkimin e Tij. Ata nuk e kuptojnë siç duhet mbikëqyrjen e Allahut. Gjynahet e dobësojnë besimin, madje edhe mund ta zhdukin atë fare. Çdo gjynahqar është i paditur nga ky këndvështrim, edhe nëse është i vetëdijshëm se vepra është e ndaluar, dhe meriton ndëshkim. Madje, që një vepër të konsiderohet si gjynah për një njeri, duhet që ai të jetë në dijeni të këtij fakti.

Kushti i dytë i pranimit të pendimit është që gjynahqarët të pendohen menjëherë, pa u vonuar. Disa janë të mendimit se kjo nënkupton që ata duhet të pendohen para se t'u vijë vdekja. Allahu i Lartësuar e pranon pendimin e robit para se të vijë vdekja dhe para se të zbresë ndëshkimi. Ndërsa në momentin kur vdekja po e gllabëron, atëherë nuk pranohet më pendimi, ashtu si nuk pranohet më besimi prej mohuesve, sikurse ka thënë Allahu i Lartësuar në suren Junus, ajeti 90: "Ne i mbartëm bijt e Izraelit përtej detit ndërsa faraoni dhe ushtria e tij i ndoqi për shkak të mizorisë dhe armiqësisë kundër tyre. Por kur atë *(Faraonin)* e përfshiu përmbytja, ai tha: "Besova se nuk ka Zot tjetër veç Atij që i besuan beni israilët; edhe unë jam nga muslimanët!"

Ose në suren Gafir, në ajetet 84, 85: "E kur e panë dënimin tonë, thanë: "Ne i kemi besuar vetëm Allahut dhe i kemi mohuar ata që adhuronim veç Tij". Por besimi i tyre, kur e vërejtën dënimin tonë, nuk u bëri dobi. Ky është ligj i Allahut ndaj robërve të Tij. Ai çast do të jetë dëshpërim për jobesimtarët." Ndërsa në ajetin vijues të kësaj sureje, Allahu i Lartësuar thotë:

- "Nuk është i pranueshëm pendimi i atyre që vazhdimisht bëjnë vepra të këqija dhe vetëm atëherë kur ndonjërit prej tyre i vjen vdekja, thotë: "Unë tani me të vërtetë u pendova!"; e as pendimi i atyre që vdesin duke qenë jobesimtarë. Ndaj tyre kemi përgatitur dënim të ashpër." - Kjo sepse pendimi në të tilla raste është i detyruar. Pendim i vlefshëm është ai që bëhet me zgjedhje të lirë nga personi.

Thënia e Allahut: "...dhe pendohen menjëherë" mund të ketë edhe kuptimin: menjëherë pas kryerjes së gjynaheve. Pra, në këtë rast kuptimi i ajetit është: atyre që, menjëherë pas gjynahut, pendohen dhe përpiqen që kurrë të mos i kthehet atij gabimi, atyre Zoti ua pranon pendimin. Ndërsa ata që vazhdojnë në gjynahet e tyre dhe nuk kthejnë rrugë, nuk shqetësohen dhe nuk përpiqen të largohen prej gjynaheve, ata nuk janë penduar shpejt.

Ata që i kanë bërë gjynahet cilësi të pandashme të tyre është vështirë që të pendohen plotësisht. Kryesisht këtyre njerëzve nuk u jepet sukses që të pendohen dhe nuk u lehtësohen rrugët e pendimit. Të tillë janë ata që e kryejnë të keqen me dije të plotë, me vetëdije dhe siguri për dëmin që ajo sjell dhe duke shpërfillur vështrimin e Allahut mbi ta. Këta ia kanë mbyllur vetes dyert e mëshirës së Allahut.

Megjithatë, nuk është e pamundur që edhe një njeriu i cili vazhdon me gjynahe me vetëdije të plotë për dëmin që ato sjellin, t'i jepet mundësia që të pendohet plotësisht dhe sinqerisht, duke iu fshirë të gjitha gjynahet e kaluara. Por, sidoqoftë, mëshira dhe bamirësia e Zotit është më pranë atyre të parëve.

Allahu i Lartësuar e mbyll ajetin me fjalët:

- "Allahu është më i Dijshmi e më i Urti." - Allahu i Lartësuar është i Gjithëdijshëm për atë që pendohet sinqerisht dhe për atë që është gënjeshtar. Secilin nga këta, Allahu do ta shpërblejë sipas asaj që meriton, me urtësinë e Tij absolute. Po me urtësinë e Tij,

Ai i jep sukses që të pendohet atij që e meriton këtë mirësi, ndërsa me drejtësinë e Tij, Ai e privon nga pendimi atë që në të vërtetë nuk e do pendimin. Allahu është më i ditur për gjithçka.

Ajetet 19 – 21

19. O besimtarë! Nuk është lejuar për ju të trashëgoni gratë në mënyrë të dhunshme, e as t'i pengoni ato me qëllim që t'u merrni një pjesë nga ajo që u keni dhënë atyre, përveç nëse ato bëjnë imoralitet të hapur. Jetoni dhe silluni mirë me to! Nëse nuk i pëlqeni aq shumë ato, bëni durim, sepse ndodh që ju ta urreni diçka dhe Allahu nëpërmjet saj të japë mirësi të shumta.
20. Në qoftë se dëshironi të ndërroni grua, duke e lëshuar njërën për të marrë tjetrën, kur asaj të parës i keni dhënë plaçkë të madhe, mos merrni prej asaj pasurie asgjë. A do ta merrnit atë padrejtësisht, duke bërë gjynah të qartë?!
21. Si mund t'ua merrni atë plaçkë , kur ju i jeni dhënë njëri-tjetrit dhe kur ato kanë marrë prej jush një premtim të fortë?!

Shpjegimi i ajeteve

- "O besimtarë! Nuk është lejuar për ju të trashëgoni gratë në mënyrë të dhunshme, e as t'i pengoni ato me qëllim që t'u merrni një pjesë nga ajo që u keni dhënë atyre, përveç nëse ato bëjnë imoralitet të hapur." - Në kohën e injorancës paraislamike, nëse dikush vdiste dhe linte pas gruan e tij, të afërmit e të vdekurit, si vëllai apo djali i xhaxhait, e konsideronin veten si më parësorët për t'u martuar me vejushën e të afërmit të tyre dhe nuk e linin të martohej me të tjerë, pavarësisht dëshirës së saj. Nëse ndonjë nga ata e pëlqente, martohej me të me një mehër që e përcaktonte vetë ai, donte apo nuk donte ajo. Nëse ajo nuk e pëlqente, ata e ndalonin gruan që të martohej me dikë tjetër, veç nëse ishte dikush që e pranonin ata. Shpesh, ata e zvarrisnin martesën e saj, derisa ajo të hiqte dorë nga një pjesë e trashëgimisë së përfituar nga bashkëshorti i saj i vdekur apo nga mehri i saj. Po kështu vepronin edhe ata burra që nuk i donin gratë e tyre, por ua zvarrisnin divorcin, me qëllim që ato të hiqnin dorë nga një pjesë e mehrit të dhuruar.

Në këto ajete, Allahu i Lartësuar i ndalon besimtarët nga vepra të tilla të ulëta dhe të padrejta. Këto praktika janë plotësisht të ndaluara, përveç dy rasteve:
1. Nëse ajo vetë është e kënaqur të martohet me të afërmin e burrit të saj të vdekur. Kjo kuptohet nga fjalia: "Nuk është lejuar për ju të trashëgoni gratë në mënyrë të dhunshme". Pra, nëse ato janë dakord për diçka të tillë, atëherë lejohet.
2. Nëse kryejnë ndonjë vepër të ulët, si tradhti apo shpifje e fyerje ndaj burrit. Në të tilla raste, burrit i lejohet që ta zvarrisë divorcin e saj, si ndëshkim për të dhe që të marrë prej saj një pjesë të mehrit që i ka dhënë. Pastaj i Lartësuari tha:

- "Jetoni dhe silluni mirë me to!" - Sjellja e mirë duhet të jetë me vepra dhe me fjalë. Burri duhet ta trajtojë gruan e tij me dashuri e ngrohtësi, larg padrejtësive dhe dhimbjeve. Në trajtimin e mirë hyjnë edhe shpenzimet jetësore për të, veshja, ushqimi etj. Përkujdesja duhet të jetë ashtu si është zakon në kohën dhe vendin ku njerëzit jetojnë.

- "Nëse nuk i pëlqeni aq shumë ato, bëni durim, sepse ndodh që ju ta urreni diçka dhe Allahu nëpërmjet saj të japë mirësi të shumta." - Kjo është një këshillë për burrat. Kështu, edhe nëse ndodh që t'i urrejnë gratë në ndonjë aspekt, duhet të bëjnë durim e të mos i divorcojnë ato, sepse mirësitë e këtij durimi janë të shumta. Së pari, kështu plotësohet porosia e Zotit për bashkëshortet e tyre, gjë e cila sjell lumturinë e dynjasë dhe të ahiretit. Së dyti, duke detyruar veten që ta mbajnë gruan, ata luftojnë që të cilësohen me virtytet më të larta dhe që ta mbajnë


gjallë çerdhen e tyre. Po ashtu, mund të ndodhë që urrejtja të largohet me kalimin e kohës dhe vendin e saj ta zërë dashuria, respekti, mëshira dhe ngrohtësia, sikurse ka ndodhur dhe ndodh shpesh. Ndoshta nga ajo grua Zoti mund t'u dhurojë një fëmijë të mirë, që të jetë shkaktar mirësish për dynjanë dhe ahiretin.

Megjithatë, nëse ndarja është e domosdoshme dhe nuk ka asnjë mundësi për ta mbajtur çerdhen të bashkuar, atëherë divorci është veprim i lejueshëm. Madje, Allahu i Lartësuar thotë:

- "Në qoftë se dëshironi të ndërroni grua, duke e lëshuar njërën për të marrë tjetrën, kur asaj të parës i keni dhënë plaçkë të madhe, mos merrni prej asaj pasurie asgjë." – Kuptimi: Nëse dëshironi të divorconi një grua dhe të martoheni me një tjetër, kjo nuk përbën asnjë gjynah për ju, por nëse gruas që do të divorconi i keni dhënë si mehër pasuri shumë të madhe, ju mos kërkoni të merrni prej saj asnjë qindarkë.

Këtu ka dy këshilla: për gruan që do të divorcohet dhe për gruan tjetër me të cilën burri do të martohet. Për të parën, duhet që asaj të mos i merret asgjë nga mehri i dhënë. Madje, nëse burri ende nuk ia ka dhënë, duhet që t'ia japë menjëherë. Ndërsa për gruan tjetër, këshilla është që, nëse është caktuar mehër i madh për të, burri të mos ia vonojë pa arsye. Nëse nuk ka mundësi, atëherë le të përpiqet që ta plotësojë sa më shpejt këtë detyrim.

Ky ajet tregon se përcaktimi i mehrit në masë të madhe nuk është i ndaluar, por më e mira është që të zbatohet tradita e Profetit (a.s.), i cili ka këshilluar që mehri të jetë sa më i përballueshëm dhe i lehtë. Kjo duket në ajet pikërisht te pjesa ku Allahu i Lartësuar na mëson si të veprojmë nëse kemi përcaktuar "mehër të madh". Kështu, Ai tregon se kjo mund të ndodhë mes nesh dhe nuk na qorton apo të na thotë që është e ndaluar. Nëse do të ishte e ndaluar, Allahu



do ta qartësonte një gjë të tillë. Megjithatë, nëse ky veprim sjell dëme në aspektin fetar, ndonjëherë mund të jetë edhe i ndaluar.

Pastaj i Lartësuari thotë:

- "A do ta merrnit atë padrejtësisht, duke bërë gjynah të qartë?!" – Kjo vepër është e palejueshme, edhe nëse bëni dredhira e mashtrime.

Pastaj Allahu i Lartësuar na shpjegon arsyen pse nuk lejohet kjo gjë, kur thotë:

- "Si mund t'ua merrni atë plaçkë , kur ju i jeni dhënë njëri-tjetrit dhe kur ato kanë marrë prej jush një premtim të fortë?!" - Për ta qartësuar më shumë, themi se kontakti seksual me gruan është haram para aktit të martesës. Marrëdhëniet me të lejohen veçse pas aktit të rregullt martesor dhe pasi ajo kërkon mehrin e saj. Pasi është rënë dakord për gjithçka dhe pasi burri e ka "shijuar" mirë gruan, ndërkohë që më parë e kishte të ndaluar, atëherë mospërmbushja e

kushtit të mehrit është një padrejtësi e madhe ndaj saj, sepse burri e ka marrë atë që ka kërkuar, ndërkohë që nuk po plotëson kushtin e saj. Gjithashtu, ai i ka premtuar asaj para Zotit se do të plotësojë detyrimet dhe përgjegjësitë që parashtron akti martesor. Atëherë, si mund ta shkelë ai një premtim të tillë?

Ajeti 22

22. Mos u martoni me ato gra me të cilat kanë qenë të martuar etërit tuaj, me përjashtim të atyre që kanë kaluar *(para Islamit)*. Kjo ka qenë vërtet poshtërsi e madhe, vepër e përbuzur dhe traditë e shëmtuar.

Shpjegimi i ajetit

Kuptimi: Mos u martoni me ato gra me të cilat kanë qenë martuar etërit (babai, gjyshi e lart) tuaj. Kjo është një vepër shumë e shëmtuar dhe e neveritshme jo vetëm për Zotin, por edhe për njerëzit. Për shkak të kësaj vepre të ulët, futet urrejtja mes prindit dhe fëmijës, ndërkohë që marrëdhëniet mes tyre duhet të jenë të ndërtuara mbi bamirësinë, mëshirën dhe respektin. Kjo është një rrugë e keqe për ata që e ndjekin. Ajo është prej sjelljeve të injorancës, të cilat Islami i lufton, që t'i pastrojë shpirtrat e njerëzve.

Ajeti 23

23. Ju është ndaluar martesa me nënat tuaja, me bijat tuaja, me motrat tuaja, me hallat tuaja, me tezet tuaja, me bijat e vëllait, me bijat e motrës, me mëndeshat që ju kanë dhënë gji, me motrat nga gjiri, me nënat e grave tuaja *(vjehrrat)* dhe me vajzat që janë nën kujdesin tuaj e të lindura *(prej tjetër babai)* nga gratë tuaja, me të cilat keni kryer kontakt; por nëse nuk keni pasur kontakt me to *(me gratë)*, atëherë s'ka pengesë. Ju është ndaluar martesa edhe me gratë e bijve tuaj, që janë të lindur nga ju *(jo të bijve të adoptuar)*, dhe të jini të martuar njëherazi me dy motra, përveç rasteve që tashmë kanë kaluar. Vërtet, Allahu është Falës e Mëshirues.

Shpjegimi i ajetit

Ky ajet i mrekullueshëm tregon shkoqur për gratë me të cilat një burrë e ka të ndaluar të martohet. Kategoritë e ndaluara janë të klasifikuara sipas shkaqeve të tyre:

1. Të ndaluara për shkak të lidhjes farefisnore.
2. Të ndaluara për shkak të gjidhënies.
3. Të ndaluara për shkak të lidhjeve martesore.
4. Të ndaluara për shkak të bashkimit në një kurorë të kategorive të caktuara.

1. Të ndaluarat për shkak të lidhjes farefisnore.

Thotë i Lartësuari:

- "Ju është ndaluar martesa me nënat tuaja, me bijat tuaja, me motrat tuaja, me hallat tuaja, me tezet tuaja, me bijat e vëllait, me bijat e motrës..." – Në radhë të parë përmenden nënat. Termi 'nënat' nënkupton çdo femër me të cilën burri ka lidhje lindjeje, duke përfshir nënën biologjike, gjyshen (nënën e nënës), stërgjyshen e më lart. Këtu nuk përfshihen gjyshet nga gjidhënia.

Fjala "bijat" nënkupton çdo femër të lindur prej teje e poshtë saj, pra, mbesat, stërmbesat etj., të lindura nga bija jote.

Fjala "motrat" përfshin si motrat nga nëna e babai, edhe ato vetëm nga njëri prej tyre.

Fjala 'hallat' nënkupton çdo motër të babait tënd, të gjyshit tënd e kështu me radhë.

Në termin "tezet" hyn çdo motër e nënës tënde apo e gjyshes, apo e stërgjyshes e çfarë ka lart tyre, pavarësisht në meritojnë trashëgimi apo jo.

Te "bijat e vëllait" hyjnë vajzat e vëllait dhe të gjitha femrat e lindura poshtë tyre prej vajzave.

Te 'bijat e motrës' hyjnë vajzat e motrës dhe tërë femrat e lindura poshtë tyre prej vajzave.

Këto kategori – siç e thamë - janë të ndaluara për shkak të lidhjes së gjakut, dhe të këtij mendimi janë të gjithë dijetarët muslimanë. Ato i tregon tekstualisht ajeti kur'ânor. Ndërsa femrat e tjera, si vajzat e xhaxhait, të dajës, të tezes, të hallës, janë të lejuara, sepse Allahu i Lartësuar thotë: "Veç këtyre *(që u përmendën),* për ju janë të lejuara të gjitha gratë e tjera që t'i merrni me pasurinë tuaj *(me nikah të rregullt),* duke pasur për qëllim martesën, jo prostitucionin".

2. Të ndaluarat për shkak të gjidhënies.
Allahu i Lartësuar thotë:

- "...me mëndeshat që ju kanë dhënë gji, me motrat nga gjiri..." – Mëndesha është gruaja (jo nëna) që të ka dhënë gji. Motrat prej gjiri janë ato të cilave u ka dhënë gji e njëjta grua prej së cilës ke pirë gji ti. Pra, janë dy mundësi: ose ti ke pirë gji nga nëna e tyre, ose ato kanë pirë gji nga nëna jote.

Allahu i Lartësuar ka bërë të ndaluar për martesë mëndeshën, që i ka dhënë gji personit kur ka qenë foshnjë. Por duke qenë se qumështi nuk prodhohet vetëm prej gruas, por edhe prej burrit të saj, atëherë edhe bashkëshorti i saj konsiderohet si babai i këtij fëmije, për shkak të qumështit. Për këtë arsye, personit që ka pirë gji te një mëndeshë i bëhen të ndaluara të njëjtat gjëra që do të ishin të ndaluara për të nëse do të ishte i lindur prej asaj nëne dhe atij babai, ashtu sikurse ka thënë Pejgamberi (a.s.): *"Gjidhënia bën të ndaluara të njëjtat gjëra që bën të ndaluara lidhja e gjakut (farefisnia)."* Megjithatë, kjo ka vlerë vetëm për personin që ka pirë gji dhe fëmijët e tij, dhe jo me pjesëtarët e tjerë të gjakut të tij (si vëllai, motra etj).


Që gjidhënia të konsiderohet si shkak për ndalimin e martesës, është kusht që fëmija të ketë pirë pesë herë të plota dhe të ngopet. Gjithashtu, kjo gjidhënie duhet të jetë bërë brenda dyvjeçarit të parë të jetës së tij, sikurse është sqaruar në Traditën e Profetit (s.a.u.s.).

3. Të ndaluara për shkak të lidhjeve martesore.

Të tilla janë katër kategori, siç thotë i Lartësuari:

- "...me nënat e grave tuaja *(vjehrrat)* dhe me vajzat që janë nën kujdesin tuaj e të lindura *(prej tjetër babai)* nga gratë tuaja, me të cilat keni kryer kontakt; por nëse nuk keni pasur kontakt me to *(me gratë)*, atëherë s'ka pengesë. Ju është ndaluar martesa edhe me gratë e bijve tuaj, që janë të lindur nga ju" – Pra, këto kategori janë:
- Bashkëshortet e babait, gjyshit, stërgjyshit e ç'ka sipër tyre. Kjo u tregua edhe në ajetin 22.
- Bashkëshortet e djemve të lindur nga ju e ç'ka poshtë tyre (nipër, stërnipër etj.), pavarësisht në janë trashëgues apo jo.
- Nëna e gruas, pra, vjehrra e ç'ka sipër tyre (pra, gjyshja e gruas, stërgjyshja etj.). Këto bëhen të ndaluara që në momentin e lidhjes së aktit martesor me to (edhe nëse nuk janë kryer marrëdhënie).
- Vajzat e grave tuaja (nga burra të tjerë) e ç'ka poshtë tyre (mbesa, stërmbesa etj.). Por këto bëhen të ndaluara veçse pasi është kryer kontakt me nënën e tyre. Pra, nëse është lidhur akti martesor me nënën e tyre, por ende nuk është kryer kontakt me të, vajza është e lejuar dhe mund të lidhësh kurorë me të, nëse dëshiron, sepse Allahu i Lartësuar thotë që martesa është e ndaluar: "...me vajzat që janë nën kujdesin tuaj e të lindura (prej tjetër babai) nga gratë tuaja, me të cilat keni kryer kontakt."

Për sa i përket cilësimit tjetër të përmendur në ajet, pra, që vajzat të jenë nën kujdesin e atij burri, shumica e dijetarëve janë të mendimit se nuk ka ndonjë qëllim të veçantë, por është përmendur thjesht sepse zakonisht kështu ndodh. I rëndësishëm



është kushti i parë: pra, kryerja e kontaktit me nënat e tyre.

Megjithatë, cilësimi: "...që janë nën kujdesin tuaj..." ka dy urtësi të tjera:

1. Ai na tregon shkakun pse është e ndaluar që të martohesh edhe me vajzën e bashkëshortes. Ato vajza që burri i ka nën kujdestari duhet t'i trajtojë njëlloj si bijat e tij. Është gjë e shëmtuar që ai të martohet me to, pasi është martuar e ka kryer marrëdhënie me nënat e tyre.

2. Ai tregon, gjithashtu, se burrit i lejohet veçimi me bijat e bashkëshortes, sepse ato janë njëlloj si bijat e tij.

Allahu është më i Ditur për gjithçka.

4. Të ndaluara për shkak të bashkimit në një kurorë të kategorive të caktuara.

- "...dhe të jini të martuar njëherazi me dy motra, përveç rasteve që tashmë kanë kaluar. Vërtet, Allahu është Falës e Mëshirues." – Pra, burrit nuk i lejohet të martohet me motrën e bashkëshortes. Ndërsa sipas një hadithi të saktë, Pejgamberi (a.s.) e ka ndaluar edhe martesën e burrit me tezen apo hallën e bashkëshortes. Me fjalë të tjera, çdo grua që ka lidhje farefisnore me bashkëshorten është e ndaluar ta bashkosh në të njëjtën kurorë. Kjo është bërë me qëllim që të mos prishen lidhjet farefisnore.

Më pas, i Lartësuari thotë:

Ajeti 24

24. Edhe me gra që janë tashmë të martuara, përveç atyre që i zini robëresha. Ky është urdhri i Allahut për ju. Veç këtyre, për ju janë të lejuara të gjitha gratë e tjera që t'i merrni me pasurinë tuaj, duke pasur për qëllim bashkëshortësinë, jo prostitucionin. Jepjani mehrin e caktuar bashkëshorteve tuaja, të cilat i keni "shijuar". Nuk ka gjynah për ju nëse, me mirëkuptim të dyanshëm, e shtoni a e pakësoni mehrin. Allahu është i Gjithëdijshmi e i Urti.

Shpjegimi i ajetit

- "Edhe me gra që janë tashmë të martuara, përveç atyre që i zini robëresha." - Nuk lejohet martesa me një grua, për sa kohë ajo është e martuar me një burrë tjetër. Me të mund të martohesh vetëm nëse divorcohet dhe pasi të ketë përfunduar periudhën e pritjes.

Përjashtim bëjnë vetëm robëreshat e zëna në luftë, sepse i Lartësuari thotë: "...përveç atyre që i zini robëresha". Pra, nëse një grua është zënë robinjë në një luftë, muslimani e ka të lejuar të martohet me të, edhe nëse ajo është e martuar, sepse me kapjen e saj si robinjë, akti i saj martesor prishet, kështu që i vetmi kusht mbetet pritja e kohës së pastrimit, që të vërtetohet se nuk është shtatzënë.

Po kur një skllave e martuar blihet apo i dhurohet një burri? Në këtë rast, ajo konsiderohet ende si e martuar. Argument për këtë rast është edhe ngjarja e Beriras, së

cilës Pejgamberi (a.s.) i dha mundësinë për të zgjedhur: ose të qëndronte me burrin e saj, Mugithin, ose të prishte martesën me të, pasi Aishja i dha asaj lirinë. Ajo zgjodhi shkëputjen e lidhjes me Mugithin. Nëse thjesht me shitjen e saj akti martesor do të prishej, atëherë Pejgamberi (a.s.) nuk do t'ia linte asaj në dorë shkëputjen apo vazhdimin e lidhjes bashkëshortore.[23]

- "Ky është urdhri i Allahut për ju." - Këto janë dispozitat e Allahut për ju, prandaj përqendrohuni në to, udhëzohuni dhe përmbajuni atyre me përpikmëri. Këto ligje janë zgjidhja e problemeve tuaja dhe çelësi për të bërë një jetë të lumtur. Në këto dispozita tregohet hallalli dhe harami.

- "Veç këtyre, për ju janë të lejuara të gjitha gratë e tjera që t'i merrni me pasurinë tuaj, duke pasur për qëllim bashkëshortësinë, jo prostitucionin." – Kuptimi: Të gjitha kategoritë e tjera, që nuk janë përmendur në ajet, janë të lejueshme për ju që të martoheni. Harami është i kufizuar, ndërsa hallalli është i gjerë dhe i pakufizuar. Kjo është mirësi, mëshirë, butësi dhe lehtësim nga Allahu i Lartësuar për robërit e Tij.

Është e lejuar për ju që, me pasurinë tuaj, të zgjidhni çfarë të dëshironi prej kategorive të lejuara, por me kusht që qëllimi të jetë ruajtja nga imoraliteti e vetes suaj dhe e gruas me të cilën do të martoheni. Gjithashtu, hedhja e farës duhet të bëhet në hallall dhe jo në haram. Ata që i shfryjnë epshet e tyre në haram nuk janë ruajtës të vetes dhe të grave të tyre nga imoraliteti, sepse duke e harxhuar epshin në harame, aftësia për ta përdorur atë në hallall do të dobësohet.

Po ashtu, ky ajet ka shenja që tregojnë se personi i pandershëm nuk duhet të zgjidhet dhe as pranohet për martesë. Bashkëshorti duhet të jenë *muĥsin*, pra, që e ruan nderin e vet dhe të bashkëshortes së tij, dhe që epshin e shpenzon në rrugët hallall, jo në ato haram. Kështu thuhet edhe në suren Nur, ajeti 3: "Laviri nuk martohet me tjetër, por veçse me ndonjë lavire ose idhujtare. Me laviren nuk do martohet kush, veçse ndonjë lavir ose idhujtar; ajo është e ndaluar për besimtarët". Më tej, i Lartësuari thotë:

- "Jepjani mehrin e caktuar bashkëshorteve tuaja, të cilat i keni "shijuar." – Kuptimi: Jepjani dhuratën e përcaktuar martesore atyre grave me të cilat jeni kënaqur duke kryer marrëdhënie seksuale.

Nëse burri kontakton me gruan e tij, e ka detyrë që t'ia japë asaj mehrin, sepse është '*feridah*' - detyrim i përcaktuar që të jepet. Ky është njëri kuptim i fjalës '*feridah*', ndërsa kuptimi tjetër është: "i përcaktuar sipas marrëveshjes". Pra, jepjani masën e paracaktuar në marrëveshjen mes jush, pa e cenuar atë aspak.

- "Nuk ka gjynah për ju nëse, me mirëkuptim të dyanshëm, e shtoni a e pakësoni mehrin." - Për çdo ndryshim të mehrit me mirëkuptim të dyanshëm nuk ka gjynah. Me fjalë të tjera, shtimi i masës së mehrit nga ana e burrit mbi masën e përcaktuar apo edhe heqja dorë e gruas nga një pjesë e masës së përcaktuar, janë veprime të lejueshme.

- "Allahu është i Gjithëdijshmi e i Urti." - Dija e Allahut është e plotë, e gjerë dhe gjithëpërfshirse. Po kështu është edhe Urtësia e Tij. Prej dijes dhe urtësisë së Tij janë edhe këto ligje, që bëjnë të qartë hallallin dhe haramin.

Ajeti 25

25. Ai i cili nuk ka mundësi materiale që të martohet me femra të lira besimtare, le të martohet me besimtaret që i keni nën pushtetin tuaj *(robëreshat)*. Allahu e di më së miri besimin tuaj. Ju jeni nga njëri-tjetri. Martohuni me to me lejen e pronarëve të

[23] Hadithi është në dy '*Sahih*'-ët.

tyre dhe jepjani mehrin sipas normave. Ato të jenë të ndershme, e jo imorale të hapura apo të fshehta, që jetojnë me dashnorë. Pasi jeni martuar, nëse ato bëjnë kurvëri, ndëshkimi ndaj tyre është sa gjysma e ndëshkimit të përcaktuar për gratë e lira. Kjo është e lejueshme për ata që i frikësohen imoralitetit. Megjithatë, nëse përmbaheni, kjo është më mirë për ju. Allahu është Falës e Mëshirëplotë.

Shpjegimi i ajetit

- "Ai i cili nuk ka mundësi materiale që të martohet me femra të lira besimtare, le të martohet me besimtaret që i keni nën pushtetin tuaj *(robëreshat)*. Allahu e di më së miri besimin tuaj. Ju jeni nga njëri-tjetri." – Kuptimi: Çdokush nga ju që nuk ka mundësi të gjejë masën e mehrit për t'u martuar me besimtare të lira dhe frikësohet se do të bjerë në imoralitet dhe vështirësi për jetën e tij, atëherë le të martohet me skllave besimtare, me aq sa duket, sepse Allahu e di se cila është besimtare e cila jo. Çështjet e dynjasë ndërtohen mbi dukshmërinë e jo mbi atë që fshihet në zemër. Ndërsa në ahiret, për bazë merret ajo që gjendet në zemër.

- "Martohuni me to me lejen e pronarëve të tyre dhe jepjani mehrin sipas normave. Ato të jenë të ndershme, e jo imorale të hapura apo të fshehta, që jetojnë me dashnorë." - Kuptimi: Martohuni me to duke marrë leje nga padronët e tyre, një apo shumë qofshin ata. Edhe atyre u jepni mehër, sepse edhe ato e meritojnë mehrin, sikurse gratë e tjera.

Megjithatë, për t'u martuar me skllave, kusht tjetër është që ato të jenë të ndershme, sepse Allahu i Lartësuar thotë më pas:

- "Ato të jenë të ndershme, e jo imorale të hapura apo të fshehta, që jetojnë me dashnorë. Kjo është e lejueshme për ata që i frikësohen imoralitetit." - Pra, ato duhet të mos jenë lavire të hapura apo të fshehura, por duhet të jenë të ruajtura dhe të mos kenë dashnorë.

Kështu, një muslimani të lirë i lejohet të martohet me një skllave veçse nëse ajo plotëson katër kushte:

1. Të jetë besimtare.
2. Të jetë e ndershme, në mënyrë të hapur dhe të fshehur.
3. Ai (burri) të mos ketë mundësi për të paguar mehrin për një grua të lirë.
4. Ai të druhet se mos bie në imoralitet.

Nëse plotësohen këto kushte, atëherë atij i lejohet që të martohet me të.

- "Megjithatë, nëse përmbaheni, kjo është më mirë për ju." – Sidoqoftë, durimi është më i mirë. Përndryshe, nga njëra anë, ekziston rreziku që fëmijët të lindin skllevër, dhe, nga ana tjetër, martesa me të tilla gra shihet si e përçmueshme nga njerëzit. Nëse burri arrin të bëjë durim, kjo është gjë më e mirë. Por nëse ai nuk mund të ruhet nga harami, atëherë është detyrë martesa me to.

- "Pasi jeni martuar, nëse ato bëjnë kurvëri, ndëshkimi ndaj tyre është sa gjysma e ndëshkimit të përcaktuar për gratë e lira." - Nëse skllavet martohen dhe më pas bëjnë kurvëri, atëherë ato nuk trajtohen njëlloj si të lirat. Ato meritojnë gjysmën e dënimit të të lirave, në rastet kur është e mundur të përcaktohet kjo gjysmë. Pra, në rastin kur gratë e lira (që kryejnë imoralitet) meritojnë 100 kamxhikë, skllavet meritojnë 50 kamxhikë. Ndërsa gurëzimi nuk ekziston për skllavet, sepse ky lloj dënimi nuk mund të përgjysmohet. Pra, skllavja që bën kurvëri nuk gurëzohet.

Në këtë ajet, Allahu i Lartësuar përmend dy emra të mrekullueshëm të Tij:

- "Allahu është Falës e Mëshirëplotë." - Kjo do të thotë që këto ligje janë mëshirë, bujari e bamirësi për njerëzit. Allahu i Lartësuar nuk ua ka vështirësuar çështjet atyre, por ua ka lehtësuar në maksimum.

Përmendja e faljes pas përmendjes së ndëshkimit është një shenjë që tregon se ligjet për dënimet e vendosura nga Zoti janë falje gjynahesh për të dënuarit. Kështu ata pastrohen nga gjynahet, para se të dalin para Zotit dhe askush të mos i ndihmojë. Fakti që dispozitat ndëshkuese janë falje gjynahesh është sqaruar edhe në hadithe.

Gjithashtu, duhet thënë se për skllavin mashkullin vlejnë të njëjtat dispozita si për femrën, sepse nuk ka asnjë ndryshim mes tyre.

Ajetet 26 – 28

26. Allahu dëshiron t'ju sqarojë çështjet, t'ju drejtojë në rrugën e atyre që ishin para jush dhe t'ju pranojë pendimin. Allahu është i Gjithëdijshëm e i Urtë.
27. Allahu dëshiron t'ju pranojë pendimin, ndërsa ata që jepen pas epsheve, dëshirojnë që ju të devijoni tërësisht nga rruga e drejtë.
28. Allahu dëshiron t'ju lehtësojë, pasi njeriu është krijuar si një qenie e dobët.

Shpjegimi i ajeteve

Këtu, Allahu i Lartësuar na tregon për mirësinë dhe bujarinë e Tij të gjerë, për kujdesin e Tij të veçantë për besimtarët dhe për thjeshtësinë e fesë së Tij. Ai thotë:

- "Allahu dëshiron t'ju sqarojë çështjet, t'ju drejtojë në rrugën e atyre që ishin para jush dhe t'ju pranojë pendimin." – Kuptimi: Allahu i Lartësuar dëshiron t'ju sqarojë juve gjithçka që keni nevojë, për të dalluar të vërtetën nga e kota, hallallin nga harami.


Me Kur'ânin dhe me Traditën e Profetit, Allahu i Lartësuar dëshiron të na udhëzojë në rrugën e atyre fatlumëve që shkuan para nesh, në rrugën e atyre që i begatoi me të mira, siç ishin profetët dhe pasuesit e tyre të çmuar. Ashtu sikurse i udhëzoi ata për bindje ndaj Tij, ashtu siç i ndihmoi të bëjnë vepra të mira që e kënaqin Atë, ashtu siç i stolisi me cilësi të mira, që Ai i pëlqen, ashtu siç u dha sukses të plotë për të arritur çdo të mirë dhe për t'u larguar nga çdo e keqe, po ashtu dëshiron të kujdeset edhe për ne. Për ne Ai ka rezervuar një përkujdesje më të madhe dhe një ligj të mrekullueshëm, që i sqaron çështjet në atë mënyrë që asnjë prej popujve të shkuar nuk e ka patur privilegj. Për ne ka rezervuar dijen më të plotë dhe suksesin për të kryer veprat më të mira dhe më të shpërblyeshme. Përveç këtyre, Ai, nga butësia dhe mëshira e Tij, na ka treguar se çdo gabim dhe mangësi në adhurimin tonë ndaj Tij, Ai e fal dhe gjithmonë e pranon pendimin tonë.

Duke e ditur dobësinë tonë, Allahu i Lartësuar është treguar i mëshirshëm me ne dhe na ka bërë lehtësime në fe. Kështu, ligjet e Tij nuk e shpërfillin dobësinë tonë, por na ndihmojnë që të largohemi nga harami dhe të mjaftohemi me hallallin. Me lehtësimet e Tij për ne, na ka mundësuar që t'i pakësojmë gjynahet tona duke shfrytëzuar vetëm gjërat e lejuara. Kjo është pjesë e lehtësimit të pendimit për këtë umet.

Sa herë që ne gabojmë, Ai hap portën e mëshirës dhe hedh në zemrat tona pendimin, keqardhjen për gjynahet që bëjmë, në mënyrë që të kthehemi tek Ai kokulur dhe duke kërkuar falje. Pasi na fal këto ndjenja të mrekullueshme në zemrat tona, Ai na e pranon pendimin dhe na fal, duke na mundësuar një fillim të ri.

I lavdëruar qoftë Allahu për të tilla mirësi!

- "Allahu është i Gjithëdijshëm e i Urtë." – Kuptimi: Allahu ka dituri dhe urtësi absolute. Është Ai që, prej diturisë së Tij, ju mësoi atë që ju nuk e dinit. Prej kësaj diturie të rëndësishme janë edhe këto dispozita. Në bazë të urtësisë dhe mëshirës së Tij, Ai iu mundëson dhe ua pranon pendimin atyre që e meritojnë. Po ashtu, me dijen, drejtësinë dhe urtësinë e Tij, Ai i privon nga pendimi ata që nuk e meritojnë.



- "Allahu dëshiron t'ju pranojë pendimin, ndërsa ata që jepen pas epsheve, dëshirojnë që ju të devijoni tërësisht nga rruga e drejtë." – Kuptimi: Nëpërmjet pendimit, Allahu rregullon punët tuaja, iu lehtëson çdo vështirësi, e shton atë që është pak dhe e grumbullon atë që është e shpërndarë.

Ndërsa nga ana tjetër qëndrojnë ata që iu binden vetëm epsheve dhe dëshirave të tyre të shfrenuara. Ata dëshirojnë t'ju devijojnë dhe largojnë nga rruga e drejtë, ashtu sikurse kanë humbur vetë. Ata i japin përparësi plotësimit të epsheve të tyre, me çfarëdolloj kostoje qoftë kjo. Ata janë adhurues të vërtetë të epsheve. Gjynahqarët e të gjitha kategorive, të cilët parapëlqejnë plotësimin e dëshirave të tyre kundrejt bindjes ndaj Zotit dhe Profetit të Tij, dëshirojnë që edhe ju të devijoni dhe të largoheni nga rruga e drejtë, për të shkuar ose në rrugën e atyre që merituan zemërimin e Zotit [24], ose në rrugën e të humburve [25]. Ata dëshirojnë që ju, nga bindja e plotë ndaj Rrahmanit, të ktheheni pas e t'i bindeni Shejtanit të mallkuar; nga qëndrimi brenda kufijve të Zotit, gjë e cila siguron lumturinë në të dyja jetët, të ktheheni në shkeljen e kufijve të Tij, gjë e cila sjell trishtimin dhe vuajtjen në të dy jetët.

Allahu i Lartësuar e ka lidhur lumturinë e njerëzve pikërisht me qëndrimin brenda kufijve të Tij, duke zbatuar urdhrat dhe duke iu larguar ndalesave të Tij, në shenjë dashurie, madhërimi dhe nënshtrimi për Të. Ndërsa trishtimi dhe vuajtjet janë të lidhura me cenimin e devotshmërisë.

Kështu, pasuesit dhe adhuruesit e epsheve dëshirojnë që ju të prishni lumturinë tuaj dhe të humbisni thellë në errësirën e gjynaheve dhe të mosbindjes ndaj Zotit. Zgjidhni, pra, për veten tuaj më të mirën, që të gjeni lumturinë, dhe dijeni se Allahu i Lartësuar dëshiron lehtësimin për ju, siç thotë më pas:

- "Allahu dëshiron t'ju lehtësojë, pasi njeriu është krijuar si një qenie e dobët." - Kuptimi: Çdo gjë për të cilën ju ka urdhëruar Allahu është e thjeshtë, e mirë, e këndshme dhe e dobishme për ju. Çdo gjë nga e cila ju ndalon Ai është e keqe, e shëmtuar, e pisët dhe e dëmshme për ju, por gjithsesi, e thjeshtë për ta lënë.

Nëse ndieni vështirësi për të respektuar ndonjë ndalesë të Allahut, dijeni se Ai ka bërë të lejueshme shumëfishin e asaj që e ka ndaluar. Të lejuarat e Tij janë gjithmonë të mjaftueshme kundrejt harameve, që janë të kufizuara dhe të pakta. Madje, në raste të jashtëzakonshme, kur cenohet jeta apo nderi juaj, Ai ju ka lejuar që ta përdorni edhe të ndaluarën.

Përfundimisht, ata të cilët kanë frikë se mund të bien në imoralitet, mund të martohen edhe me skllave, me kushtet e

[24] Të cilët e njohën të vërtetën dhe nuk punuan me të.
[25] Që punuan pa dituri dhe libër të ndritur nga Zoti

përmendura më sipër. Kjo tregon mëshirën dhe bamirësinë e pakufishme të Allahut të Lartësuar, tregon dijen e Tij të plotë dhe urtësinë e Tij absolute. Ai përkujdeset për njerëzit që janë të dobët fizikisht, financiarisht, por edhe moralisht. Allahu gjithmonë dëshiron të na i lehtësojë çështjet kur forca, durimi dhe imani ynë janë në shkallë të ulët.

Ajetet 29 – 31

29. O besimtarë, mos e konsumoni pasurinë e njëri-tjetrit me mënyra të palejueshme, përveç rastit kur është tregti me pëlqim të dyanshëm, dhe mos i vrisni vetet. Vërtet, Allahu është i Mëshirshëm me ju.
30. Këdo prej jush që i bën këto gjëra padrejtësisht, Ne do ta hedhim në Zjarr, dhe kjo është shumë e lehtë për Allahun.
31. Nëse largoheni prej gjynaheve të mëdha, që ju janë ndaluar, Ne do t'ju falim gjynahet e vogla dhe do t'ju shpiem në një vend të nderuar.

Shpjegimi i ajeteve

- "O besimtarë, mos e konsumoni pasurinë e njëri-tjetrit me mënyra të palejueshme..." - Allahu i Lartësuar i ndalon robërit e Tij që ta konsumojnë pasurinë e njëri-tjetrit me mënyra të palejueshme.

Te "mënyrat e palejueshme" përfshihet vjedhja e grabitja, bixhozi, kamata e forma të tjera të ndaluara të fitimit të pasurisë. Këtu hyn edhe pasuria e shpenzuar apo e shpërdoruar me mendjemadhësi, sepse edhe kjo është një mënyrë e padrejtë e konsumimit të pasurisë.

Allahu i Lartësuar vërtet i ka ndaluar këto rrugë të konsumimit të pasurisë, por, nga ana tjetër, ka lejuar mënyra të tjera të pastra dhe të mira, si tregtia e ndershme dhe çdo akt që plotëson kushtet dhe sjell kënaqësinë e palëve. Ai thotë:

- "...përveç rastit kur është tregti me pëlqim të dyanshëm" – Pra, kontratat e lidhura me pëlqim të ndërsjelltë dhe me kushtet e një tregtie të ndershme janë të lejueshme.

Kur thuhet: "me pëlqim të dyanshëm", përjashtohen kontratat e fajdesë, sepse fajdeja nuk është tregti dhe nuk është një marrëveshje e lejueshme. Po ashtu, ajo kurrsesi nuk mund të kënaqë të dyja palët. Përveç kësaj, palët duhet të jenë të njohura me kushtet dhe përfitimin e tregtisë. Nuk mund të ketë pëlqim të dyanshëm nëse fitimi është i panjohur dhe nëse nuk është e mundur të merret në dorë apo të arrihet. Rrjedhimisht, një kontratë e tillë është e ndaluar.

Nga ajeti kuptohet se aktet mund të lidhen nëpërmjet fjalëve ose veprave, sepse nëpërmjet tyre shprehet pranimi dhe pëlqimi.

Ajeti mbyllet me fjalët: "Vërtet, Allahu është i Mëshirshëm me ju." Prej mëshirës së Tij është ruajtja e pasurisë dhe e jetës sonë nëpërmjet këtyre ligjeve, siç përforcohet më pas ky fakt:

- "...dhe mos i vrisni vetet. Vërtet, Allahu është i Mëshirshëm me ju." – Kuptimi: Mos e vrisni veten dhe as njëri-tjetrin.

Të njëjtin gjykim ka edhe të çosh veten drejt shkatërrimit dhe rreziqeve të rënda, që mund të të gjymtojnë apo të të marrin edhe jetën. Pra, Allahu i Lartësuar na ndalon nga dëmtimi i vetes dhe i të tjerëve dhe nga çdo rrugë që të çon në këto përfundime, dhe kjo ndodh prej mëshirës së Tij.

Me mëshirën e Tij, Allahu ka bërë ligje, nëpërmjet të cilëve synon të na ruajë besimin, jetën, mendjen, nderin dhe pasurinë që janë pesë domosdoshmëritë e njeriut. Ne jemi të ndaluar që t'i shpërdorojmë apo humbasim jetën dhe pasurinë (po kështu edhe fenë, nderin dhe mendjen).

Vëreni me kujdes fjalët e Allahut të Lartësuar: "...mos e konsumoni pasurinë e njëri-tjetrit me mënyra të palejueshme" dhe: "mos i vrisni vetet". Në të dyja rastet, Ai na është drejtuar në shumës, që të kuptojmë se

pasuria dhe jeta e të tjerëve duhen trajtuar njëlloj si të ishin tonat, duke i ruajtur ato në formën më të mirë. Po ashtu, këto fjalë dëshmojnë për themelin e shoqërisë islame, e cila duhet të ndërtohet duke patur dashamirësi dhe përkujdesje të ndërsjelltë mes muslimanëve. Besimtarët duhet të jenë për njëri-tjetrin ashtu sikurse ka thënë Pejgamberi (a.s.): si një ndërtesë e vetme, ose si një trup i vetëm, i tillë që, nëse njëra pjesë e tij vuan, të gjithë të tjerët kujdesen dhe përpiqen ta shërojnë dhe rregullojnë atë. Kjo përkujdesje duhet të jetë në të gjitha aspektet e jetës, në aspektet e fesë dhe besimit, por edhe në ato të kësaj dynjaje, për nevojat e ndryshme të saj.

- "Këdo prej jush që i bën këto gjëra padrejtësisht, Ne do ta hedhim në Zjarr, dhe kjo është shumë e lehtë për Allahun." - Ata që cenojnë dhe rrezikojnë jetën dhe pasurinë e tjetrit pa të drejtë dhe me vetëdije të pastër, ata janë të kërcënuar. Kush bën të tilla gjëra jo nga padituria apo nga harresa, Allahu i Lartësuar ka për ta hedhur në një Zjarr të madh, dhe kjo është shumë e thjeshtë për Allahun.

- "Nëse largoheni prej gjynaheve të mëdha, që ju janë ndaluar, Ne do t'ju falim gjynahet e vogla dhe do t'ju shpiem në një vend të nderuar." - Nga bujaria, mëshira dhe bamirësia e Allahut të Lartësuar për robërit e Tij besimtarë, Ai u premtoi se, nëse ata u largohen gabimeve të mëdha, Ai do t'ua mbulojë dhe falë gabimet më të vogla, do t'i fusë në Xhenet, ku ka mirësi që as syri nuk i ka parë, as veshi nuk i ka dëgjuar dhe asnjë zemër nuk i ka imagjinuar.

Pra, Allahu i Lartësuar na porosit që t'u largohemi gjynaheve të mëdha. Prej gjynaheve të mëdha është edhe mos kryerja e detyrimeve të Zotit, lënia e të cilave konsiderohet si gjynah i madh, si moskryerja e pesë kohëve të namazit, e namazit të xhumasë, agjërimit të Ramazanit etj., sikurse thotë edhe Pejgamberi (a.s.): *"Pesë namazet, xhumaja deri në xhuma dhe Ramazani deri në Ramazan fshijnë gjynahet mes tyre, nëse robi u largohet gjynaheve të mëdha."*

Por çfarë është gjynahu i madh? Përkufizimi më i mirë i dhënë është: Çdo gjynah për të cilin Sheriati ka përcaktuar dënim penal në këtë dynja ose kërcënim në ahiret, ose çdo gjynah që asgjëson imanin, ose që sjell mallkim apo zemërim të Allahut ndaj vepruesit të tij.

Ajetet 32 – 33

32. Mos lakmoni ato gjëra me të cilat Allahu ka dalluar disa prej jush mbi disa të tjerë. Meshkujt meritojnë aq sa kanë punuar; po ashtu edhe femrat meritojnë aq sa kanë punuar. Kërkoni prej Allahut nga mirësitë e Tij! Allahu është i Dijshëm për çdo gjë.
33. Ne i kemi caktuar secilit prej jush të afërm, prindër ose farefis. Jepuni pjesën e vet edhe atyre me të cilët keni marrëveshje. Allahu është Dëshmitar për çdo gjë.

Shpjegimi i ajeteve

- "Mos lakmoni ato gjëra me të cilat Allahu ka dalluar disa prej jush mbi disa të tjerë." - Allahu i Lartësuar i ndalon besimtarët që të lakmojnë ato veçori me të cilat Ai ka dalluar disa njerëz a kategori mbi disa të tjerë, qofshin këto gjëra të mundshme apo të pamundshme. Kështu, për shembull, gratë nuk duhet të synojnë të kenë veçoritë e burrave, të varfërit nuk duhet të kenë smirë të pasurit etj.

Allahu i Lartësuar na ka ndaluar që të kemi smirë për ato gjëra me të cilat Ai i ka dalluar të tjerët, sepse ky është tregues i pakënaqësisë me kaderin e Tij dhe të çon në përtaci dhe ëndrra të kota. Këto ëndërra nuk nxisin për punë dhe për fitim të të mirave në mënyrë të lejuar.

Kështu që, këshillat për njeriun janë: së pari, të përpiqet dhe të punojë maksimalisht për të arritur gjithçka të dobishme për fenë dhe jetën e tij dhe, së dyti, të lusë Allahun e

Lartësuar që t'i dhurojë nga bujaria dhe mirësitë e Tij. Njeriu duhet të mbështetet vetëm te Zoti i tij, e te askush tjetër, as te vetvetja. Më pas, Allahu i Lartësuar thotë:

- **"Meshkujt meritojnë aq sa kanë punuar; po ashtu edhe femrat meritojnë aq sa kanë punuar."** – Secili meriton aq sa punon dhe është përpjekur. Të gjithë do të marrin veçse atë për të cilën janë lodhur e përpjekur. Megjithatë, bujaria e Allahut të Lartësuar është vendimtare për gjithçka.

- **"Kërkoni prej Allahut nga mirësitë e Tij!"** - Kërkojini Allahut t'ju dhurojë nga mirësitë e Tij, që rregullojnë çështjet e besimit dhe të jetës suaj. Kjo kështillë e vyer sjell lumturinë e njeriut dhe përsosmërinë e tij. Ata që i lënë përpjekjet dhe nuk mbështeten tek Allahu, ata janë gjithmonë të dështuar.

- **"Allahu është i Dijshëm për çdo gjë."** - Kjo tregon se Allahu i Lartësuar i jep atij që meriton t'i jepet dhe e privon atë që meriton të privohet. E gjithë kjo bazohet në dijen e Tij absolute për gjithçka.

- **"Ne i kemi caktuar secilit prej jush të afërm, prindër ose farefis."** - Allahu i Lartësuar i ka mundësuar çdokujt të ketë mbështetës ose ndihmës prej të afërmve ose farefisit. Këtu hyjnë të gjithë të afërmit: rrënjët, trungu dhe degët e fisit.

Pastaj i Lartësuari përmend një lloj tjetër mbështetësish:

- **"Jepuni pjesën e vet edhe atyre me të cilët keni marrëveshje."** – Pra, janë ata me të cilët është lidhur pakt për ndihmë, për bashkëpunim dhe mbështetje.

Edhe kjo është mirësi e Zotit për krijesat e Tij. Ai i udhëzon dhe i ndihmon për të tilla aleanca dhe bashkëpunime, pa të cilat njerëzit nuk do të arrinin shumë mirësi.

I Lartësuari thotë: "Jepuni pjesën e vet edhe atyre...". Domethënë, jepuni hakun atyre, sipas marrëveshjes që kini me ta, por, sigurisht, ajo të mos jetë në kundërshtim me Zotin. Ndihma dhe mbështetja duhet të jetë për bindje e devotshmëri ndaj Zotit, për vepra të mira e të lejuara. Ndërsa për sa i përket trashëgimisë, ajo u takon të afërmve të fisit, sipas përcaktimit dhe ligjeve të vendosura nga Zoti i botëve.

- **"Allahu është Dëshmitar për çdo gjë."** - Allahu i Lartësuar është Vështrues dhe Dëshmues për gjithçka. Dija e Tij është e plotë për çdo çështje. Ai shikon të gjitha lëvizjet e robërve dhe i dëgjon të gjithë zërat e tyre.


Ajetet 34 – 35

34. Meshkujt kanë autoritet mbi gratë, për shkak të dallimit që Allahu u ka bërë disave mbi disa të tjerë dhe për shkak të shpenzimeve që ata bëjnë nga pasuria e tyre. Gra të mira janë ato të dëgjueshmet, që ruajnë fshehtësitë që ka urdhëruar Allahu. Gratë të cilave iu druheni mosbindjes dhe sjelljes së keqe të tyre, këshillojini, largojini nga shtrati ose edhe rrihini lehtë. Por nëse ju respektojnë, atëherë mos u sillni keq ndaj tyre. Allahu është më i Larti, më i Madhi.

35. Nëse i druheni ndarjes midis burrit e gruas, dërgoni një ndërmjetës të urtë nga familja e tij dhe një ndërmjetës të urtë nga familja e saj. Nëse ata të dy kanë për qëllim pajtimin, Allahu e mundëson afrimin mes tyre *(çiftit)*. Allahu është i Gjithëdijshëm e Zbulues i gjithçkaje.

Shpjegimi i ajeteve

- **"Meshkujt kanë autoritet mbi gratë, për shkak të dallimit që Allahu u ka bërë disave mbi disa të tjerë dhe për shkak të shpenzimeve që ata bëjnë nga pasuria e tyre."** - Allahu i Lartësuar na tregon se Ai i ka vendosur burrat si përgjegjës dhe kujdestar për gratë. Ata duhet të kujdesen për gratë, që ato t'u përmbahen dispozitave të Allahut të Lartësuar, duke kryer urdhrat dhe duke iu larguar ndalesave dhe punëve



të ulta. Pra, është detyrë e burrave që të kujdesen që gratë të qëndrojnë brenda kufijve të Allahut.

Gjithashtu, burrat e kanë detyrë të përkujdesen edhe duke shpenzuar për plotësimin e nevojave të tyre.

Allahu i Lartësuar tregon edhe shkakun tjetër pse burrat e meritojnë këtë status mbi gratë: "...për shkak të dallimit që Allahu u ka bërë disave mbi disa të tjerë". Dallimi i burrave mbi gratë është në shumë drejtime. Për shembull, e drejta e kujdestarisë ligjore është e drejtë vetëm e burrave, dhe jo e grave. Pra, një grua nuk mund të jetë kujdestare ligjore. Po kështu edhe profetësia ka qenë cilësi vetëm e burrave. Kurrë nuk ka patur e s'mund të ketë grua profete.

Allahu i Lartësuar i ka veçuar burrat me disa lloje adhurimesh, që nuk i bëjnë dot gratë dhe që nuk është detyrë për to, siç janë xhihadi, namazi i bajrameve apo namazi i xhumave. Allahu i Lartësuar i ka dalluar burrat me një nivel të logjikës, arsyetimit, durimit e qëndrueshmërisë, që gratë nuk mund ta arrijnë.

Allahu i Lartësuar i ka ngarkuar burrat me detyrën e shpenzimit për përmbushjen e nevojave të grave. Shumë shpenzime janë detyrë vetëm e burrave, jo e grave. Ndoshta ky është mesazhi i ajetit, kur i Lartësuari thotë: "...për shkak të shpenzimeve që ata bëjnë nga pasuria e tyre." Çdo lloj shpenzimi që i nevojitet gruas është përgjegjësi dhe detyrë ligjore e burrit. Ai e ka detyrë që t'i përmbushë këto detyrime për gruan e tij. Ai është për gruan si udhëheqësi dhe zotëria i saj.

Ndërsa gruaja është kujdestare dhe zonjë në shtëpinë e burrit, e cila kënaq zemrën dhe syrin e tij. Ajo ka detyrë t'i bindet së pari Zotit të saj, i Cili e krijoi, duke e adhuruar si Një të vetëm, dhe pastaj e ka detyrë t'i bindet dhe të kënaqë burrin e saj. Kështu, Allahu i Lartësuar na tregon se cilat janë gra të mira:

- "Gra të mira janë ato të dëgjueshmet, që ruajnë fshehtësitë që ka urdhëruar Allahu." – Pra, gra të mira janë ato që janë të bindura ndaj Zotit dhe të vazhdueshme në adhurimin e Tij me drojë, shpresë dhe dashuri. Gratë e mira duhet t'u binden edhe burrit të tyre, ashtu si duhet të ruajnë nderin dhe pasurinë e tij. Por këtë ato arrijnë ta bëjnë vetëm me ndihmën dhe suksesin e dhënë prej Zotit. Është Zoti i Lartësuar që i ndihmon dhe i udhëzon ato të jenë të tilla, për shkak të adhurimit të tyre përkushtuar Atij. Egoja urdhëron për të këqija, por kush e adhuron Zotin me sinqeritet dhe i mbështetet plotësisht Atij, mjaftohet me Zotin për çdo gjë që e shqetëson nga çështjet e fesë dhe nga çështjet e dynjasë.

Pastaj Allahu i Lartësuar thotë:

- "Gratë të cilave iu druheni mosbindjes dhe sjelljes së keqe të tyre, këshillojini, largojini nga shtrati ose edhe goditini lehtë." - Ato të cilat tregojnë arrogancë dhe mosbindje ndaj burrit, me fjalë dhe me

veprime, duhen edukuar duke filluar me mënyrat më të buta. Hapi i parë është këshilla, duke i sqaruar dhe kujtuar se çfarë gjykimi ka ligji i Zotit për bindjen ndaj burrit dhe për mosbindjen ndaj tij. Atyre u duhet kujtuar shpërblimi që i pret nëse janë të bindura, por edhe ndëshkimi nëse janë të pabindura.

Nëse ato ndreqen pas këshillave, atëherë është arritur rezultati i kërkuar, por nëse jo, atëherë kalohet në hapin e dytë: largimin e tyre nga shtrati. Pra, burri nuk fle dhe nuk kontakton me gruan, derisa ajo të bindet.

Nëse edhe me hapin e dytë nuk arrihet edukimi i tyre, atëherë kalohet në hapin e tretë: goditini lehtë! Goditja duhet të ketë karakter edukues dhe jo dëmtues.

Nëse arrihet qëllimi me njërën nga këto mënyra, atëherë:

- "Por nëse ju respektojnë, atëherë mos u sillni keq ndaj tyre." – Kuptimi: Përderisa ju e arritët atë që dëshironi, domethënë, bindjen e grave tuaja, atëherë duhet të mjaftoheni me kaq.

Kjo do të thotë që burri nuk duhet t'u kthehet më kohëve të këqija dhe t'i kujtojë gruas mosbindjen e saj të dikurshme, sepse përkujtimi i të tilla gjërave është i dëmshëm.

- "Allahu është më i Larti, më i Madhi." - Ai është absolut në lartësinë e Tij, në të gjitha aspektet. Ai është i Lartësuar në Qenien e Tij. Allahu është i Madh dhe asgjë nuk mund të jetë më e madhe dhe më e lartë se Ai. Allahu është Madhështor në Qenien dhe cilësitë e Tij.

- "Nëse i druheni ndarjes midis burrit e gruas, dërgoni një ndërmjetës të urtë nga familja e tij dhe një ndërmjetës të urtë nga familja e saj." - Nëse i druheni divorcit të bashkëshortëve, atëherë dërgoni nga secila palë dy burra muslimanë të mençur e të drejtë, të cilët i njohin të dyja palët dhe të dinë të gjykojnë drejt për bashkimin apo ndarjen e tyre. Këto cilësi të përmendura janë përftuar nga kuptimi i fjalës "*hakemun*".

Kështu, këta burra duhet të shohin se çfarë urren secila palë tek pala tjetër, dhe pastaj të përcaktojnë përgjegjësitë dhe detyrimet e secilës palë për të pasur një jetë të denjë bashkëshortore. Nëse ndonjëri prej tyre nuk i përmbahet plotësisht këtyre përgjegjësive, atëherë punohet me palën tjetër që të jetë tolerante dhe të kënaqet me nivelin e palës tjetër aq sa të jetë e mundur. Kështu vazhdohet me harmonizimin dhe rregullimin.

Megjithatë, nëse gjendja e çiftit ka arritur aq sa nuk bëhet i mundur rregullimi i marrëdhënieve të tyre dhe të dy të urtët e shohin se ndarja e tyre është më e dobishme, sepse përndryshe do ketë padrejtësi, atëherë çifti ndahet. Në një rast të tillë nuk është kusht që burri të pranojë apo jo ndarjen, Ata që vendosin për ndarjen janë dy të urtët dhe jo burri, sepse Allahu i Lartësuar i ka quajtur ata "*hakemen*", domethënë ata që duhet të gjykojnë dhe vendosin, edhe nëse dikujt mund të mos i pëlqejë gjykimi.

- "Nëse ata të dy kanë për qëllim pajtimin, Allahu e mundëson afrimin mes tyre *(çiftit).*" - Pas ndërhyrjeve dhe urtësisë së burrave, pas fjalëve të mira dhe nxitëse për një jetë të denjë bashkëshortore, nëse palët vërtet do të duan bashkimin dhe të mirën, Allahu i Lartësuar do t'i bashkojë ata. Me fjalë të tjera, nëse ndodh ndarja, atëherë kjo, në njëfarë mënyre, tregon mungesën e dëshirës për të vazhduar.

- "Allahu është i Gjithëdijshëm e Zbulues i gjithçkaje." - Allahu i Lartësuar është i Gjithëdijshëm, për çfarë duket dhe çfarë mbahet fshehur. Allahu i Lartësuar është Mbikëqyrës i çdo imtësie, në çdo çështje në këtë botë. Prej dijes së Tij të madhe dhe mirësive të Tij të mrekullueshme janë edhe këto ligje të drejta dhe të bukura, që rregullojnë jetën e njerëzve dhe marrëdhëniet e tyre me Atë dhe me të tjerët.

Ajeti 36

36. Adhuroni Allahun e mos adhuroni asgjë tjetër përveç Tij! Silluni mirë ndaj prindërve, të afërmve, jetimëve, të varfërve, fqinjëve të afërt dhe të largët, ndaj atij që keni pranë, udhëtarit dhe ndaj atyre që janë robër nën pushtetin tuaj! Me të vërtetë, Allahu nuk i do njerëzit arrogantë dhe mburravecë...

Shpjegimi i ajetit

- "Adhuroni Allahun e mos adhuroni asgjë tjetër përveç Tij!" - Allahu i Lartësuar i urdhëron adhuruesit e Tij që ta njësojnë Atë me përkushtimin e adhurimeve, duke iu nënshtruar urdhrave dhe ndalesave të Tij, duke i shprehur vetëm Atij dashurinë, nënshtrimin dhe sinqeritetin, pra, duke i kushtuar të gjitha llojet e adhurimeve: të jashtme dhe të brendshme, të dukshme dhe të padukshme qofshin ato. Nga ana tjetër, Allahu ndalon nga idhujtaria dhe nga adhurimi i çdo gjëje tjetër veç Tij. Ai ndalon nga *shirk*-u i madh dhe *shirk*-u i vogël.

Askush tjetër nuk e meriton që të adhurohet, duke zbatuar urdhrat dhe duke iu larguar ndalesave të Tij në shenjë adhurimi, dashurie, shprese dhe nënshtrimi, por veç Allahu i Vetëm e i Pashoq. Ai është i Adhuruari i vërtetë dhe me meritë, ndërsa çdo gjë tjetër është krijesë e dobët, nevojtare, e pafuqishme, qoftë edhe engjëll apo profet. Të gjithë janë të pafuqishëm dhe të papushtetshëm. Të gjithë nuk kanë asnjë fuqi reale për të bërë dobi apo dëm. Krijesat nuk mund të japin jetë apo ta marrin atë. Vetëm Zoti është Ai që ka në dorë jetën, vdekjen, ringjalljen, llogarinë dhe shpërblimin me drejtësi. Është detyrë e padiskutueshme për krijesat që të njësojnë me adhurim të Vetmin që është absolut në pushtetin dhe mbretërimin e Tij, Allahun e Lartësuar. Vetëm Ai e meriton të adhurohet duke iu bindur me përunjësi, madhërim dhe dashuri në zbatimin e urdhrave dhe largimin nga ndalesat. Vetëm Ai i Cili ka në dorën e Tij gjithçka dhe përkujdeset për krijesat e Tij, pa pasur nevojë për ndihmën e askujt, vetëm Ai meriton të njësohet me adhurim.

Allahu i Lartësuar, pasi i urdhëron robërit të plotësojnë të drejtën e Tij, duke e adhuruar si Një të vetëm, vijon t'i urdhërojë ata për të plotësuar të drejtat mes tyre, duke nisur nga më të afërmit, e pastaj me radhë:

- "Silluni mirë ndaj prindërve, të afërmve, jetimëve, të varfërve, fqinjëve të afërt dhe të largët, ndaj atij që keni pranë, udhëtarit dhe ndaj atyre që janë robër nën pushtetin tuaj!" – Fillimisht, Allahu i Lartësuar na urdhëron të jemi bamirës ndaj prindërve. Bamirësia ndaj tyre tregohet me fjalë të ngrohta dhe të buta, me edukatë e dhembshuri, me vepra të mira e bamirësi. Kjo bëhet duke zbatuar urdhrat dhe duke respektuar porositë e tyre, duke shpenzuar për të kënaqur ata dhe këdo që ka lidhje me ta.

Bamirësia ndaj tyre shkelet me dy veprime të kundërta: duke u sjellë keq me ta ose duke mos u bërë mirë atyre; pra, që të dyja janë të ndaluara.

Pastaj i Lartësuari na urdhëron për bamirësi ndaj të afërmve. Këtu hyn i gjithë farefisi, i afërt apo i largët qoftë. Ne jemi urdhëruar që të jemi bamirës ndaj tyre me fjalë dhe me vepra. Po ashtu, nuk duhet të bëhemi kurrsesi shkak që, me fjalët dhe veprat tona, të shkaktojmë ndarjen farefisnore.

Allahu i Lartësuar na urdhëron të jemi bamirës edhe ndaj jetimëve. 'Jetimë' quhen minorenët që kanë humbur babain. Kjo kategori njerëzish ka të drejta te muslimanët. Ne duhet të përkujdesemi për ta pa bërë dallim mes tyre, janë apo jo farefisi ynë. Ne jemi urdhëruar që t'u ofrojmë atyre ndihmën e nevojshme për të jetuar, t'i ngushëllojmë me fjalë të buta dhe të ngrohta, të kujdesemi për rritjen dhe edukimin e tyre, për t'i plotësuar dhe aftësuar ata në çështjet e besimit dhe të jetës së tyre të përditshme.

Më pas, Allahu i Lartësuar na urdhëron të jemi bamirës ndaj '*mesakin*'-ëve. Kështu quhen ata që i ka zënë varfëria e që nuk përmbushin dot nevojat e veta dhe të atyre që i kanë nën përgjegjësi. Allahu i Lartësuar na urdhëron që të jemi bamirës ndaj tyre, duke u lehtësuar vështirësitë e duke i ndihmuar të përmbushin nevojat e tyre. Ai na urdhëron të nxisim njëri-tjetrin për të ndihmuar këtë shtresë dhe të bëjmë maksimumin në plotësimin e kësaj detyre.

Allahu i Lartësuar na urdhëron të jemi bamirës edhe ndaj fqinjëve. Së pari, duhet të jemi bamirës ndaj atyre që i kemi edhe farefis. Ndaj tyre duhet të jemi dyfish bamirës: një herë për shkak të fqinjësisë dhe një herë për shkak të farefisnisë. Bamirësia ndaj fqinjësisë përcaktohet sipas traditës së popullit.

Por Allahu i Lartësuar na urdhëron të jemi bamirës edhe ndaj fqinjëve që nuk i kemi farefis. Sa më afër të jetë porta e fqinjit, aq më e madhe duhet të jetë bamirësia ndaj tij. Fqinjët duhet ta kujtojnë njëri-tjetrin herë pas here me dhurata, sadaka e ftesa. Mes tyre duhet të ketë fjalë të ngrohta dhe vepra të mira, larg sjelljes së keqe e shqetësuese.

Më pas, Allahu i Lartësuar urdhëron për bamirësi "ndaj atij që keni pranë". Janë dhënë mendime të ndryshme për kuptimin e këtij përcaktimi. Disa thonë se bëhet fjalë për bashkëudhëtarin, disa thonë për bashkëshortin, disa thonë për shoqërinë në përgjithësi. Ndoshta kjo e fundit është më e pranueshme, sepse i përfshin edhe dy të parat.

Muslimani e ka detyrë që ta ndihmojë muslimanin në çështjet e fesë dhe të jetës së tij, ta këshillojë për të mirë, ta mbështesë në kohë të mira dhe të liga, të dojë për të atë që dëshiron për veten, të urrejë për të atë që e urren për veten, ta ruajë atë nga ajo që ruan dhe veten. Por me shokun e ngushtë këto detyrime janë edhe më të forta. Sa më e afërt të jetë shoqëria, aq më të forta janë detyrimet.

Allahu i Lartësuar urdhëron të jemi bamirës gjithashtu ndaj udhëtarit, i cili mund të jetë ose jo në nevojë. Muslimanët e kanë detyrë ta ndihmojnë udhëtarin për të arritur në destinacionin e tij, ose së paku ta qetësojnë dhe ngushëllojnë me fjalë dhe sjellje të mira.

Në fund, Allahu i Lartësuar na urdhëron të jemi bamirës ndaj atyre që i kemi nën pronësinë tonë, njerëz apo kafshë qofshin. Ne duhet t'u plotësojmë robërve dhe shërbëtorëve nevojat e tyre e të mos i ngarkojmë më shumë sesa përballojnë. Po ashtu, ne duhet t'u mësojmë çdo gjë të dobishme për jetën dhe fenë e tyre.

Ai që i zbaton sinqerisht këto porosi, ai është vërtet i nënshtruar ndaj Zotit të tij dhe bamirës ndaj robërve të Zotit. Ai meriton shpërblimin e madh dhe emrin e mirë ndër njerëz. Ndërsa ai që i shpërfill këto porosi, ai është kryeneç ndaj Zotit dhe i pabindur ndaj urdhrave të Tij. Ai është arrogant e i zhytur në vetëkënaqësi. Por i Lartësuari thotë:

- **"Me të vërtetë, Allahu nuk i do njerëzit arrogantë dhe mburravecë..."** - Allahu i Lartësuar nuk i do ata që u pëlqen vetja dhe tregohen mendjemëdhenj. Allahu i Lartësuar nuk i do as ata që mburren dhe shesin mend, sepse këto dy cilësi i pengojnë njerëzit që të plotësojnë detyrimet dhe përgjegjësitë e tyre.


Më pas, i Lartësuari i qorton dhe i ul ata, duke i përshkruar veprimet e tyre si koprraci:

Ajetet 37 – 39

37. ...ata që janë koprracë dhe urdhërojnë njerëzit për koprraci, ata që e fshehin atë që u ka dhënë Allahu nga mirësitë e Veta. Ne kemi përgatitur për mohuesit dënim poshtërues.

38. Ata që ndajnë nga pasuria e tyre sa për sy e faqe të botës dhe që nuk e besojnë Allahun e as Ditën e Fundit. Ai që e bën shok Shejtanin, *(le ta dijë se)* ai është shok shumë i keq.

39. E ç'dëm do të kishin ata sikur ta besonin Allahun, Ditën e Gjykimit dhe të


الجزء الخامس سورة النساء

وَٱلَّذِينَ يُنفِقُونَ أَمْوَٰلَهُمْ رِئَآءَ ٱلنَّاسِ وَلَا يُؤْمِنُونَ بِٱللَّهِ
وَلَا بِٱلْيَوْمِ ٱلْءَاخِرِ ۗ وَمَن يَكُنِ ٱلشَّيْطَٰنُ لَهُۥ قَرِينًا فَسَآءَ
قَرِينًا ﴿٣٨﴾ وَمَاذَا عَلَيْهِمْ لَوْ ءَامَنُوا۟ بِٱللَّهِ وَٱلْيَوْمِ ٱلْءَاخِرِ وَأَنفَقُوا۟
مِمَّا رَزَقَهُمُ ٱللَّهُ ۚ وَكَانَ ٱللَّهُ بِهِمْ عَلِيمًا ﴿٣٩﴾ إِنَّ ٱللَّهَ لَا يَظْلِمُ
مِثْقَالَ ذَرَّةٍ ۖ وَإِن تَكُ حَسَنَةً يُضَٰعِفْهَا وَيُؤْتِ مِن لَّدُنْهُ
أَجْرًا عَظِيمًا ﴿٤٠﴾ فَكَيْفَ إِذَا جِئْنَا مِن كُلِّ أُمَّةٍۭ بِشَهِيدٍ
وَجِئْنَا بِكَ عَلَىٰ هَٰٓؤُلَآءِ شَهِيدًا ﴿٤١﴾ يَوْمَئِذٍ يَوَدُّ ٱلَّذِينَ
كَفَرُوا۟ وَعَصَوُا۟ ٱلرَّسُولَ لَوْ تُسَوَّىٰ بِهِمُ ٱلْأَرْضُ ۚ وَلَا يَكْتُمُونَ
ٱللَّهَ حَدِيثًا ﴿٤٢﴾ يَٰٓأَيُّهَا ٱلَّذِينَ ءَامَنُوا۟ لَا تَقْرَبُوا۟ ٱلصَّلَوٰةَ وَأَنتُمْ
سُكَٰرَىٰ حَتَّىٰ تَعْلَمُوا۟ مَا تَقُولُونَ وَلَا جُنُبًا إِلَّا عَابِرِى
سَبِيلٍ حَتَّىٰ تَغْتَسِلُوا۟ ۚ وَإِن كُنتُم مَّرْضَىٰٓ أَوْ عَلَىٰ سَفَرٍ أَوْ جَآءَ
أَحَدٌ مِّنكُم مِّنَ ٱلْغَآئِطِ أَوْ لَٰمَسْتُمُ ٱلنِّسَآءَ فَلَمْ تَجِدُوا۟ مَآءً
فَتَيَمَّمُوا۟ صَعِيدًا طَيِّبًا فَٱمْسَحُوا۟ بِوُجُوهِكُمْ وَأَيْدِيكُمْ ۗ
إِنَّ ٱللَّهَ كَانَ عَفُوًّا غَفُورًا ﴿٤٣﴾ أَلَمْ تَرَ إِلَى ٱلَّذِينَ أُوتُوا۟ نَصِيبًا مِّنَ
ٱلْكِتَٰبِ يَشْتَرُونَ ٱلضَّلَٰلَةَ وَيُرِيدُونَ أَن تَضِلُّوا۟ ٱلسَّبِيلَ ﴿٤٤﴾
٨٥

jepnin nga ajo që Allahu u ka dhënë? Allahu di gjithçka rreth tyre.

Shpjegimi i ajeteve

- "...ata që janë koprracë dhe urdhërojnë njerëzit për koprraci, ata që e fshehin atë që u ka dhënë Allahu nga mirësitë e Veta." - Ata tregojnë koprraci dhe nuk u japin njerëzve atë që e kanë detyrë t'ua japin, madje i urdhërojnë ata për koprraci. Ata i nxisin edhe të tjerët, me fjalë dhe me vepra, për të qënë koprracë, duke u bërë vetë si shembulli i tyre i keq.

Këta e fshehin prej njerëzve diturinë që u ka falur Zoti. Ata fshehin dijen nëpërmjet së cilës mund të udhëzohen të humburit, dijen nga e cila mund të mësojnë të paditurit. Madje, jo vetëm që e fshehin të vërtetën dhe dijen e dobishme, por ata u shfaqin dhe ua zbukurojnë të kotën njerëzve, duke i penguar ata nga e drejta dhe e vërteta.

Kështu, të tillë njerëz kanë këto cilësi të ulta:

1. Ata janë koprracë me pasurinë e tyre dhe nuk i plotësojnë detyrimet ndaj të tjerëve.
2. Ata janë koprracë me dijen e tyre, duke mos e përcjellë dijen nëpërmjet së cilës njerëzit mund të udhëzohen në rrugën e drejtë.
3. Ata e kanë çuar veten drejt shkatërrimit dhe punojnë për devijimin dhe shkatërrimin edhe të të tjerëve.

Këto janë cilësi të mohuesve, prandaj Allahu i Lartësuar i quan ata "mohues" kur thotë:

- "Ne kemi përgatitur për mohuesit dënim poshtërues." - Ata tregohen arrogantë me njerëzit, ata nuk plotësojnë detyrimet ndaj Zotit, ata madje pengojnë edhe të tjerët të plotësojnë detyrimet, prandaj, për të gjitha këto arsye, ata meritojnë dënim poshtërues. E lus Allahun e Madhëruar të na ruajë nga çdo e keqe!

Më pas, Allahu i Lartësuar flet për ata që japin nga pasuria e vet me mendjemadhësi dhe për t'u dukur, jo të nxitur prej besimit të sinqertë:

- "Ata që ndajnë nga pasuria e tyre sa për sy e faqe të botës dhe që nuk e besojnë Allahun e as Ditën e Fundit." – Pra, ata që e shpenzojnë pasurinë me qëllim që njerëzit t'i shohin, t'i lavdërojnë dhe t'i respektojnë; ata që nuk e besojnë Allahun dhe Ditën e Gjykimit, pra, që shpenzimet dhe sadakatë e tyre nuk burojnë nga besimi në Zotin dhe nuk nxiten nga shpresa për shpërblimin e Tij.

Këta janë pikërisht hapat e Shejtanit, në të cilët ai i fton pasuesit e tij. Ai nxit për shtirje dhe mendjemadhësi, për mosbesim dhe mungesë sinqeriteti, për mohim të Ditës së Llogarisë dhe Shpërblimit, që pasuesit e tij të bëhen banorë të Zjarrit. Kështu, ata që veprojnë të tilla gjëra janë të nxitur nga i mallkuari, të cilit ata i binden. Ai qëndron gjithmonë pranë tyre dhe i shtyn për vepra të këqija dhe arrogancë.

Shejtani është vërtet një shok shumë i keq, siç thotë i Lartësuari:

- "Ai që e bën shok Shejtanin, ***(le ta dijë se)*** **ai është shok shumë i keq."** - Nuk ka mik më të keq sesa ai që dëshiron të shkatërrojë pasuesit e vet dhe që përpiqet pa pushim për këtë qëllim.

Kështu, ata që meritojnë ndëshkimin janë ata që tregohen koprracë me pasurinë, begatitë dhe diturinë që u ka falur Zoti, si dhe ata që e shpenzojnë këtë pasuri, dije ose energji për hir të idhujve të tyre. Të gjithë këta janë gjynaqarë, të pabindur ndaj Zotit, prandaj meritojnë ndëshkimin e Tij.

Allahu i Lartësuar na ka urdhëruar t'i bindemi dhe t'i plotësojmë porositë e Tij me sinqeritet për Të, sikurse thuhet në këtë ajet: "Ata nuk ishin të urdhëruar për gjë tjetër, por veç që t'i kushtonin Allahut një adhurim të sinqertë, larg çdo forme idhujtarie, të falnin namazin e të jepnin zekatin, sepse kjo është feja e drejtë." [Bejjine, 3].

Kushtet që një vepër apo adhurim të pranohet nga Zoti janë: sinqeriteti në adhurim dhe pasimi rigoroz i porosive të Zotit. Prandaj i Lartësuari na nxit pikërisht për këto kushte, duke thënë:

- "E ç'dëm do të kishin ata sikur ta besonin Allahun, Ditën e Gjykimit dhe të jepnin nga ajo që Allahu u ka dhënë?" – Ç'të keqe do të kishin ata nëse do të besonin Allahun dhe Ditën e Gjykimit?! Kjo është një ftesë për sinqeritet në adhurimin e përkushtuar Zotit, duke patur frikë nga ndëshkimi i Tij dhe shpresë për shpërblimin Tij.

Po ashtu, ç'të keqe do të kishin ata nëse do të shpenzonin nga pasuritë dhe begatitë që u ka falur Zoti?! Pra, sinqeritetin në adhurim duhet ta shoqërojmë me shpenzime për hir të Zotit.

Duke qenë se sinqeriteti është diçka që mbetet mes robit dhe Zotit të tij dhe diçka që e vështron dhe e vlerëson veçse Zoti i Lartësuar, ky ajet mbyllet me fjalët:

- "Allahu di gjithçka rreth tyre." - Allahu i Lartësuar na tregon për dijen e Tij absolute, që ne të përpiqemi të jemi të sinqertë ndaj Tij në adhurim dhe të përgatitemi për Ditën e Takimit me Të me vepra të mira dhe devotshmëri, sipas porosive të Tij dhe të Profetit të Tij.

Ajetet 40 – 42

40. S'ka dyshim se Allahu nuk bën padrejtësi as sa një grimcë. Nëse është vepër e mirë, Ai e shumëfishon atë dhe dhuron shpërblim të madh nga ana e Tij.
41. Si do të bëhet kur, për çdo popull Ne do të sjellim dëshmitarë, ndërsa ty ***(O Muhamed)*** **do të sjellim dëshmitar për të gjithë ata?**
42. Atë ditë, ata që nuk kanë besuar dhe që kanë kundërshtuar të Dërguarin, do të dëshironin të rrafshohej toka mbi ta, sepse ata nuk do mund t'i fshehin Allahut asgjë.

Shpjegimi i ajeteve

Allahu i Lartësuar na tregon se Ai është i Plotë dhe Absolut në drejtësinë dhe bamirësinë e Tij. Ai është i Pastër nga çdo e metë dhe kurrë nuk bën padrejtësi, as edhe sa një grimcë.

- "S'ka dyshim se Allahu nuk bën padrejtësi as sa një grimcë." - Allahu i Gjithëmëshirshëm nuk ia pakëson kurrë të mirat robit dhe as nuk ia shton gjynahet. Allahu i Lartësuar thotë: "Atë ditë, njerëzit do shfaqen të ndarë në grupe, që të shpërblehen për veprat e tyre. Kush ka bërë ndonjë të mirë që peshon sa një grimcë, atë do ta gjejë, dhe kush ka bërë ndonjë të keqe që peshon sa një grimcë, atë do ta gjejë." [Zelzele 6-8].

Allahu i Lartësuar është shumë më Bujar se mund ta mendojmë ne. Ai thotë:

- "Nëse është vepër e mirë, Ai e shumëfishon atë..." - Allahu e shumëfishon

atë nga dhjetëfish e lart, [26] në varësi të sinqeritetit, të rëndësisë së veprës dhe dobisë së saj, në varësi të dashurisë për Zotin, si edhe në varësi të zbatimit të porosive të Profetit (a.s.).

- "...dhe dhuron shpërblim të madh nga ana e Tij." - Përveç shumëfishimit të veprës, Allahu i Lartësuar jep edhe shpërblim shtesë, për shembull, bën të dashur dhe e zbukuron besimin në zemër, jep sukses për të punuar me dituri e sinqeritet, i mundëson njeriut të jetë bamirës dhe plot mirësi të tjera. Pastaj Allahu i Lartësuar thotë:

- "Si do të bëhet kur, për çdo popull Ne do të sjellim dëshmitarë, ndërsa ty *(O Muhamed)* do të sjellim dëshmitar për të gjithë ata?" - Si do të jetë gjendja e njerëzve atë ditë, kur të gjykohen me drejtësi nga Gjykatësi më i drejtë dhe më bamirës? Atë ditë, Gjykatësi i vetëm është Allahu i Lartësuar, ndërsa dëshmitarë do të jenë krijesat më të zgjedhura të Tij, profetët, të cilët do të dëshmojnë me drejtësi.

Si do të jetë gjendja atë ditë, kur të gjykuarve nuk do t'u mbetet gjë tjetër veçse të pranojnë gjykimin e të Drejtit, të Urtit, të Gjithëdituritit e të Gjithëmëshirshmit?! Për Allah, ai do të jetë gjykimi më i drejtë, më gjithëpërfshirës dhe më i madh. Të gjithë do ta pranojnë gjykimin e më të Drejtit, i Cili meriton lavdinë dhe lavdërimet.

Atë ditë do të ketë njerëz që do të lumturohen kur të fitojnë faljen dhe Xhenetin e përjetësisë, por do të ketë edhe të tjerë që do të dëshpërohen kur të ndëshkohen me turp. Thotë i Lartësuari:

- "...Atë ditë, ata që nuk kanë besuar dhe që kanë kundërshtuar të Dërguarin, do të dëshironin të rrafshohej toka mbi ta..." - Çdokush që ka mohuar Zotin dhe Profetin e Tij do të dëshirojë atë ditë që ta gëlltisë toka, të humbasë e të tretet në të dhe të mos kthehet më në jetë.

- "...sepse ata nuk do mund t'i fshehin Allahut asgjë." - Ata nuk do të mund t'i fshehin Allahut të Lartësuar asgjë. Përkundrazi, ata do të pohojnë dhe pranojnë çdo krim e padrejtësi që kanë kryer. Atë ditë do të dëshmojë gjuha e tyre, duart e tyre dhe këmbët e tyre për gjithçka që kanë bërë. Atë ditë, Allahu i Lartësuar do t'u japë atë që meritojnë dhe çdokush do të bindet se Allahu është e Vërteta.

Për sa u përket transmetimeve ku thuhet se, Ditën e Gjykimit, qafirët do të mundohen të fshehin faktin se ishin mohues të së vërtetës, është e vërtetë që kjo do të ndodhë në disa momente të asaj dite. Ata do të pandehin se, duke u shtirur sikur nuk kanë qënë mohues, do të shpëtojnë nga ndëshkimi i Zotit. Por kur e vërteta të dalë në shesh dhe vetë gjymtyrët e tyre të dëshmojnë kundër, atëherë çdo gjë do të shkojë në vendin që i takon dhe çdo çështje do të qartësohet. Në atë kohë, shtirja nuk ka asnjë dobi.

Ajeti 43

43. O ju që keni besuar, mos iu afroni namazit duke qenë të dehur, derisa të dini se ç'flisni, e as duke qenë xhunubë, derisa të laheni, përveç nëse jeni udhëtarë. Nëse jeni të sëmurë, nëse jeni udhëtarë, nëse keni kryer nevojën natyrore apo nëse keni kontaktuar me gratë, e nuk gjeni ujë, atëherë merrni *tejemum* duke prekur dheun dhe fërkoni me të fytyrat dhe duart tuaja. Allahu është gjithmonë Falës e Mbulues i të metave.

[26] Ebu Abbas Abdullah Ibn Abbas Ibn Abdul-Mutalibi (r.a.) përcjell nga i Pejgamberi (a.s.): "Vërtet Allahu i ka shkruar *(e përcaktuar)* cilat janë veprat e mira e cilat të këqijat". Pastaj e sqaroi këtë: "Kush dëshiron me zemër të bëjë një vepër të mirë, por nuk mund ta kryejë, Allahu do t'ia shkruajë atë si vepër të mirë e të plotë. Atij që dëshiron të bëjë një vepër të mirë dhe e kryen atë, Allahu do t'i shkruajë dhjetë të mira, shtatëqind të mira, e më tepër. Atij që dëshiron të bëjë ndonjë vepër të keqe, por nuk e kryen atë, Allahu do t'ia shkruajë si një vepër të mirë të plotë. Atij që dëshiron dhe e kryen një vepër të keqe, Allahu i shënon si vetëm një vepër të keqe." (*Muttefekun alejhi*).

Shpjegimi i ajetit

- "O ju që keni besuar, mos iu afroni namazit duke qenë të dehur, derisa të dini se ç'flisni..." - Allahu i Lartësuar i ndalon adhuruesit e Tij që t'i afrohen namazit të dehur, derisa të jenë në gjendje të kuptojnë se çfarë thonë. Në fakt, kjo është një porosi që edhe xhamive nuk lejohet t'i afrohesh i dehur. Të dehurit nuk i lejohet të falë namaz dhe as të kryejë ndonjë ibadet tjetër, sepse ai nuk është i vetëdijshëm për ato gjëra që bën.

Gjithsesi ky është një ajet i shfuqizuar dhe duhet parë si kontekst i ajetit të ndalimit përfundimtar të pijeve dehëse, pasi, në fillim, pijet dehëse ende nuk ishin bërë haram. Kështu, Allahu i Lartësuar dha shenjën e parë se ato shpejt do të bëheshin të ndaluara, kur tha: "Të pyesin ty për verën dhe bixhozin. Thuaju: "Ato sjellin të këqija të mëdha, por edhe dobi për njerëzit. Megjithatë, e keqja e tyre është më e madhe sesa dobia." [Bekare 219]. Më pas, kjo shenjë u bë më e qartë, kur Ai, me ajetin që po trajtojmë, i ndaloi besimtarët që t'i afroheshin namazit të dehur. Përfundimisht, Allahu i Lartësuar e ndaloi rreptësisht përdorimin e pijeve dehëse, kur tha: "O ju që keni besuar, s'ka dyshim se vera, bixhozi, idhujt dhe hedhja e shigjetës për fall janë vepra të ndyra nga Shejtani, prandaj largohuni prej tyre, që të jeni të shpëtuar." [Maide 90].

Sidoqoftë, ndalesa e pijeve dehëse është më e fortë në kohën e faljes së namazit, sepse dëmi i tyre në këtë kohë është shumë herë më i madh. Dehja e pengon njeriun nga shpirti i namazit, që është përqendrimi i thellë te fjalët dhe veprimet e tij. Trullosja e mendjes dhe e zemrës e cenon rëndë saktësinë e namazit.

Nga ky ajet nxjerrim si mësim se të njëjtin gjykim ka edhe falja e namazit në gjendje përgjumjeje të tillë që njeriu nuk ndien se çfarë flet dhe vepron. Madje, ndoshta nga ajeti mund të nxjerrim si rregull se njeriu duhet të shmangë çdo gjë që e shpërqendron gjatë namazit, siç janë, për shembull, mbajtja me zor e nevojës natyrore apo mbajtja e mendjes te ushqimi e pija, sikurse janë sqaruar në një hadith të saktë.

- "...e as duke qenë xhunubë, derisa të laheni, përveç nëse jeni udhëtarë." – Kuptimi: Mos iu afroni namazit kur jeni xhunubë. Ju thjesht mund të kaloni në xhami në një gjendje të tillë, por jo të qëndroni në të. Këto janë të ndaluara derisa të merrni *gusël*.[27]

- "Nëse jeni të sëmurë, nëse jeni udhëtarë, nëse keni kryer nevojën natyrore apo nëse keni kontaktuar me gratë, e nuk gjeni ujë, atëherë merrni *tejemum* duke prekur dheun..." - Allahu i Lartësuar ia ka lejuar të sëmurit të marrë *tejemum*, ka apo s'ka ujë, nëse sëmundja e ndalon nga përdorimi i ujit apo nëse përdorimi i tij e rëndon ose e zgjat më tepër sëmundjen.

Allahu i Lartësuar e ka lejuar *tejemum*-in edhe për udhëtarin, i cili zakonisht mund të hasë vështirësi në gjetjen e ujit apo nuk mund ta përdorë atë për shkak të një nevoje tjetër më të madhe, domethënë për ta pirë.

Po kështu, nëse njeriu kryen nevojën fiziologjike apo kryen marrëdhënie seksuale dhe nuk gjen ujë, i lejohet të marrë tejemum, vendali apo udhëtar qoftë. Ajeti i përfshin të gjitha këto raste.

Shkurtimisht, mund themi se Allahu i Lartësuar e ka lejuar tejemumin në dy raste:
1. Kur nuk gjendet uji, dhe kjo vlen për të gjitha rastet, për udhëtarët ose jo-udhëtarët.

---

[27] **Pyetje:** A lejohet qëndrimi në xhami për njeriun xhunub? Po prekja dhe leximi i Kur'ânit?
Përgjigje: Jo, këto gjëra nuk lejohen për të. Megjithatë, nëse ai merr abdes, ato i lejohen, sipas Ahmedit dhe disa dijetarëve të tjerë. Hisham Ibn Sadi dëshmon se shokët e Profetit (a.s.), kur ishin xhunub, merrnin abdes dhe uleshin në xhami. Po ashtu, nëse dijetarët nuk janë të një mendimi për lejueshmërinë e futjes së një jomuslimani në xhami, atëherë futja e një besimtari xhunub në xhami është më e pranueshme. Akoma më mirë, futja e tij me abdes është edhe më e pranueshme. [Shih "*Mexhmuatul Fetaua*", 11/191].

2. Kur uji nuk mund të përdoret për abdes ose gusël, për shkak të sëmundjes së njeriut apo për shkak të domosdoshmërisë së përdorimit të tij për të pirë e raste të ngjashme.

Dijetarët kanë dhënë mendime të ndryshme për pjesën e ajetit: "...nëse keni kontaktuar me gratë". Cili është kuptimi? A flitet për kontaktin seksual, që e prish guslin? Nëse është kështu, atëherë ajeti e lejon tejemumin për xhunubin, sikurse dëshmojnë hadithe të shumta e të sakta. Apo qëllimi është thjesht prekja me dorë e gruas? Nëse është kështu, atëherë duke patur parasysh edhe dëshmi të tjera specifikuese, mund të kuptojmë se këtu është për qëllim ajo lloj prekjeje që shkakton nxjerrje të lëngut të epshit dhe prishje të abdesit. Nëse është fjala për prekjen me epsh, në këtë mënyrë ajeti përdoret si argument që tregon se prekja me epsh e prish abdesin.

Mbështetur në fragmentin: "...e nuk gjeni ujë", dijetarët kanë thënë që kërkimi i ujit është i detyrueshëm para se t'i drejtohemi tejemumit, pas hyrjes së kohës së namazit. Ata arsyetojnë dhe shprehen se për dikë mund të thuhet që: "nuk gjeti ujë", veçse nëse ai e ka kërkuar atë ujë.

Ajeti tregon, gjithashtu, se uji i cili ka ndryshuar pak për shkak të përzierjes me ndonjë lëndë të pastër, mund të përdoret për pastrimin ritual, për sa kohë që ai vazhdon të quhet "ujë". Disa janë të mendimit se ai nuk mund të quhet ujë, sepse cilësitë e tij kanë ndryshuar disi, por ky qëndrim duhet parë dhe gjykuar më mirë.

Në këtë ajet ligjërohet një normë e mrekullueshme, e cila dëshmon qartë përkujdesjen dhe bamirësinë e Zotit për besimtarët e Tij, e kjo është norma për lejimin e tejemumit. Të gjithë dijetarët muslimanë pajtohen për lejimin e tejemumit, dhe për këtë lavdia e plotë i takon vetëm Allahut të Madhëruar.

Nga ajeti kuptojmë se tejemumi bëhet me dhé të pastër. Ai bëhet me çdo lloj dhéu që ndodhet në sipërfaqen e tokës, pluhur apo jo qoftë ai. Megjithatë, ka mundësi që të jetë për qëllim dhéu pluhur, sepse Allahu i Lartësuar thotë: '...fërkoni me të fytyrat dhe duart tuaja", dhe fytyrën e duart nuk mund t'i fërkosh me dhé që nuk është pluhur.[28]

- "...dhe fërkoni me të fytyrat dhe duart tuaja." - Kjo është mënyra se si merret tejemumi. Pra, me dheun fshihet e gjithë fytyra dhe duart deri te kyçet, sikurse tregojnë edhe hadithet e sakta. Është e pëlqyeshme që këto dy fërkime të kryhen me një prekje të dheut, pa qenë e nevojshme të prekësh atë dy herë, sikurse dëshmon hadithi i Amarit. Po ashtu, forma e tejemumit për xhunubin është e njëjtë me atë që zëvendëson abdesin.

***

Përfitime të tjera nga ajeti.

Objektivat e mjekësisë janë tre:
1. mbrojtja paraprake e shëndetit;
2. largimi nga trupi i çdo lënde të dëmshme që gjendet në të;
3. ruajtja dhe mbrojtja nga gjërat e dëmshme.

Për sa i përket të parit, Allahu i Lartësuar na tregon se e ka lejuar mosagjërimin për të sëmurin, për shkak të sëmundjes së tij, si dhe për udhëtarin, për të ruajtur shëndetin dhe forcën e tij. Dihet që agjërimi e dobëson fuqinë trupore. Por në rastin e udhëtimit, kur kemi të bëjmë me lëvizje të shumta dhe harxhim energjish që nuk zëvendësohen, ky dobësim bëhet edhe më i dukshëm. Kështu, Allahu i Mëshirshëm kujdeset për shëndetin

[28] Në gjuhën arabe, fjala "*saîd*" do të thotë 'tokë'. Disa thonë se kuptimi i saj është "tokë e mirë, e pastër". Disa të tjerë thonë se ashtu quhet "dhéu i mirë e i pastër". Në ajet thuhet: "*fe tejem-mumû saîden tajjibâ*", pra: "Merrni tejemum me dhé të mirë".

Ebu Is'haku thotë: "*Saîd* quhet sipërfaqja e tokës. Kështu, njeriu duhet të godasë me pëllëmbët e tij tokën, e nuk ka rëndësi a ka dhé në të apo jo, sepse *saîd* nuk është dhéu, por është sipërfaqa e tokës, sido që të jetë ajo. Nëse në një vend ka vetëm tokë shkëmbore dhe gurë, atij që merr tejemum i mjafton që të vendosë duart e tij mbi shkëmb dhe të fërkojë me të fytyrën e tij. Ky do të ishte një tejemum i rregullt".

e udhëtarit, duke e lejuar atë që të mos agjërojë.

Për sa i përket objektivit të dytë, për atë që është i sëmurë apo ka probleme në kokë nga parazitët, zbokthi, me kruajtjen apo ka sëmundje të lëkurës së kokës, Allahu i Lartësuar e bëri të lejuar që ta rruajë kokën para çlirimit nga *ihram*-i, por duke e kompensuar këtë thyerje të rregullave të *ihram*-it me agjërim, sadaka apo kurban. Rruajtja e flokëve u lejua për të bërë të mundur largimin nga lëkura të djersës e të substancave të tjera që grumbullohen tek ajo, të cilat sjellin kruajtje të kokës, parazitë, zbokth etj.

Për sa i përket objektivit të tretë, Allahu i Lartësuar dhe Mëshirëplotë gjithashtu ia ka lejuar të sëmurit që të mos marrë abdes, por të marrë tejemum. Kjo është një përkujdesje e mrekullueshme për shëndetin e njeriut dhe një udhëzim i shkëlqyer, që na mëson se si të ruhemi nga çdo gjë që e dëmton shëndetin, qoftë ajo e brendshme apo e jashtme. Kështu i udhëzon Allahu i Lartësuar adhuruesit e Tij, që të kuptojnë objektivat kryesorë të mjekësisë.

Këto përfitime janë nxjerrë nga imam Ibn Kajjimi.

***

Nga ajeti kuptohet se është e detyrueshme fshirja e gjithë fytyrës dhe e duarve. Ajeti tregon gjithashtu se tejemumi është i lejuar edhe nëse koha e namazit është në të mbaruar. Po ashtu, njeriu e ka detyrë të kërkojë ujë për abdes vetëm nëse ekziston mundësia e gjetjes së tij. Në të kundërt, ai nuk kërkon, por merr tejemum. Allahu e di më së miri. Më pas, ajeti mbyllet me fjalët:

- "Allahu është gjithmonë Falës e Mbulues i të metave." - Allahu i Lartësuar fal shumë dhe ua mbulon gabimet robërve të Tij besimtarë. Ai ua lehtëson atyre kryerjen e riteve dhe të porosive të Tij, aq sa ata nuk e ndiejnë aspak si rëndesë. Butësia, falja dhe mëshira e madhe e Allahut për këtë umet duken qartë edhe në ligjërimin e tejemumit, kur përdorimi i ujit është i pamundur. Është butësia, falja dhe mëshira e Tij që u hapin gjynahqarëve portat e pendimit tek Ai, ku ftohen vazhdimisht. Falja, mëshira dhe butësia e Zotit duken qartë edhe në faktin që, nëse besimtari paraqitet para Zotit me gjynahe që mbulojnë krejt tokën, por pa bërë idhujtari, Ai përsëri ka për ta falur plotësisht.

Ajetet 44 – 46


44. A nuk i sheh ti *(o Muhamed)* ata që iu është dhënë një pjesë prej Librit? Ata blejnë rrugën e gabuar dhe dëshirojnë që edhe ju ta humbisni rrugën e drejtë.
45. Allahu është më i Dituri për armiqtë tuaj. Por mjafton që Allahu kujdeset për ju dhe mjafton që Allahu është Ndihmësi juaj!
46. Në mesin e çifutëve ka nga ata që i nxjerrin fjalët nga konteksti i tyre dhe i thonë Profetit: "Dëgjuam, por nuk bindemi!", ose thonë: "Dëgjo, mos dëgjofsh!", ose: "*Raina*", duke i shtrembëruar me gjuhët e tyre dhe duke trilluar për fenë. Megjithatë, sikur ata të kishin thënë: "Dëgjuam dhe u bindëm", "Dëgjo!" ose "Na shiko!", do të ishte më mirë dhe më e drejtë nga ana e tyre. Por Allahu i mallkoi për shkak të mohimit të tyre, prandaj veç një pakicë e tyre besojnë.

Shpjegimi i ajeteve

- "A nuk i sheh ti *(o Muhamed)* ata që iu është dhënë një pjesë prej Librit?" - Ky është qortim për të gjithë ata të cilëve u është dhënë Libri dhe dituria. Gjithashtu, kjo është edhe një këshillë për njerëzit e tjerë, që të jenë të kujdesshëm dhe të mos mashtrohen nga këta të mjerë.

Allahu i Lartësuar na i përshkruan kështu ata që e shpërfillin rrugën e drejtë dhe punojnë për devijimin e të tjerëve:

- "Ata blejnë rrugën e gabuar..." - Ata e blejnë humbjen dhe devijimin. Aq shumë e duan humbjen, saqë japin çmimin më të


الجزء الخامس سورة النساء
وَٱللَّهُ أَعۡلَمُ بِأَعۡدَآئِكُمۡۚ وَكَفَىٰ بِٱللَّهِ وَلِيّٗا وَكَفَىٰ بِٱللَّهِ نَصِيرٗا ٤٥
مِّنَ ٱلَّذِينَ هَادُواْ يُحَرِّفُونَ ٱلۡكَلِمَ عَن مَّوَاضِعِهِۦ وَيَقُولُونَ
سَمِعۡنَا وَعَصَيۡنَا وَٱسۡمَعۡ غَيۡرَ مُسۡمَعٖ وَرَٰعِنَا لَيَّۢا بِأَلۡسِنَتِهِمۡ
وَطَعۡنٗا فِي ٱلدِّينِۚ وَلَوۡ أَنَّهُمۡ قَالُواْ سَمِعۡنَا وَأَطَعۡنَا وَٱسۡمَعۡ وَٱنظُرۡنَا
لَكَانَ خَيۡرٗا لَّهُمۡ وَأَقۡوَمَ وَلَٰكِن لَّعَنَهُمُ ٱللَّهُ بِكُفۡرِهِمۡ فَلَا يُؤۡمِنُونَ
إِلَّا قَلِيلٗا ٤٦ يَٰٓأَيُّهَا ٱلَّذِينَ أُوتُواْ ٱلۡكِتَٰبَ ءَامِنُواْ بِمَا نَزَّلۡنَا
مُصَدِّقٗا لِّمَا مَعَكُم مِّن قَبۡلِ أَن نَّطۡمِسَ وُجُوهٗا فَنَرُدَّهَا
عَلَىٰٓ أَدۡبَارِهَآ أَوۡ نَلۡعَنَهُمۡ كَمَا لَعَنَّآ أَصۡحَٰبَ ٱلسَّبۡتِۚ وَكَانَ أَمۡرُ
ٱللَّهِ مَفۡعُولًا ٤٧ إِنَّ ٱللَّهَ لَا يَغۡفِرُ أَن يُشۡرَكَ بِهِۦ وَيَغۡفِرُ مَا دُونَ
ذَٰلِكَ لِمَن يَشَآءُۚ وَمَن يُشۡرِكۡ بِٱللَّهِ فَقَدِ ٱفۡتَرَىٰٓ إِثۡمًا عَظِيمًا
٤٨ أَلَمۡ تَرَ إِلَى ٱلَّذِينَ يُزَكُّونَ أَنفُسَهُمۚ بَلِ ٱللَّهُ يُزَكِّي مَن يَشَآءُ
وَلَا يُظۡلَمُونَ فَتِيلًا ٤٩ ٱنظُرۡ كَيۡفَ يَفۡتَرُونَ عَلَى ٱللَّهِ ٱلۡكَذِبَۖ
وَكَفَىٰ بِهِۦٓ إِثۡمٗا مُّبِينًا ٥٠ أَلَمۡ تَرَ إِلَى ٱلَّذِينَ أُوتُواْ نَصِيبٗا
مِّنَ ٱلۡكِتَٰبِ يُؤۡمِنُونَ بِٱلۡجِبۡتِ وَٱلطَّٰغُوتِ وَيَقُولُونَ
لِلَّذِينَ كَفَرُواْ هَٰٓؤُلَآءِ أَهۡدَىٰ مِنَ ٱلَّذِينَ ءَامَنُواْ سَبِيلًا ٥١
٨٦

lartë për ta arritur. Ata parapëlqejnë humbjen kundrejt udhëzimit, mohimin kundrejt besimit, dëshpërimin kundrejt lumturisë në të dyja jetët. Përveç këtyre:

- "...dhe dëshirojnë që edhe ju ta humbisni rrugën e drejtë." – Pra, ata punojnë dhe janë të angazhuar maksimalisht për devijimin e besimtarëve nga rruga e drejtë.

Por duke qenë se Allahu i Lartësuar është Miku i dashur dhe Ndihmuesi i besimtarëve, Ai ua qartëson atyre të vërtetën që fshehin armiqtë e tyre, dhe pikërisht faktin që ata dëshirojnë devijimin e besimtarëve dhe luftën kundër tyre. Allahu i Lartësuar tregon se ata janë të devijuar vetë, por dëshirojnë e punojnë edhe për devijimin e besimtarëve. Kësisoj, besimtarët kanë nevojë të përkujtojnë dhe të dinë se i vetmi Ndihmues dhe Shpëtimtar i tyre nga çdo rrezik dhe armik është Allahu i Lartësuar:

- "Allahu është më i Dituri për armiqtë tuaj. Por mjafton që Allahu kujdeset për ju dhe mjafton që Allahu është Ndihmësi (*El Nasir*) juaj!" - Allahu është *El Uelij*, Miku, i Dashuri, Kujdestari, që merr përsipër t'i ruajë dhe t'i ndihmojë besimtarët në çdo gjendje. Ai tregohet i butë dhe i mëshirshëm me ta në çdo çështje të jetës dhe fesë së tyre. Ai ua lehtëson besimtarëve të ndjekin udhën e lumturisë dhe të fitores së madhe. Ai i ndihmon ata të fitojnë kundër armiqve të tyre. Është prej diturisë së Allahut që Ai u qartëson besimtarëve çdo gjë nga e cila duhet të ruhen dhe çdo gjë që i ndihmon të fitojnë kundër armiqve të tyre.

Me cilësimin *El Uelij*, Allahu i Lartësuar tregon se është Ai që u jep të mirat besimtarëve, ndërsa me cilësimin "*El Nasir*" tregon se është Ai që i ruan besimtarët nga rreziqet që atyre u kanosen.

Më pas, Allahu i Lartësuar tregon rrugët e humbjes që ata ndjekin, si dhe përparësinë që ata i japin të kotës dhe të pavërtetës, kundrejt të drejtës dhe të vërtetës:

- "Në mesin e çifutëve ka nga ata që i nxjerrin fjalët nga konteksti i tyre..." – Kuptimi: Prej dijetarëve çifutë ka të poshtër që dëshirojnë t'ju devijojnë me mënyra të shumta: ose duke ndryshuar tekstet hyjnore, ose duke ndryshuar kuptimin e tyre, ose duke i ndryshuar të dyja bashkë. Për shembull, ata thonë se cilësitë e Profetit të fundit, të përmendura në librat e tyre, nuk janë për Muhamedin dhe nuk i përshtaten atij, ndonëse, në realitet, ai është i vetmi të cilit i përshtaten këto cilësi. Ata ose i fshehin dhe nuk i tregojnë fare këto fakte, ose i shtrembërojnë dhe keqinterpretojnë ato.

Ndërsa për sa i përket qëndrimit të tyre ndaj porosive të Zotit dhe nënshtrimit ndaj Tij:

- "...i thonë Profetit: "Dëgjuam, por nuk bindemi!"" – Pra, të dëgjuam, por nuk e zbatojmë urdhrin e Zotit! Kjo dëshmon për mohimin, inatin dhe armiqësinë e madhe në zemrat e tyre ndaj porosive të Zotit.

Për sa i përket qëndrimit të tyre kundrejt Profetit (a.s.):

- "...thonë: "Dëgjo, mos dëgjofsh!", ose: "*Raina*", duke i shtrembëruar me gjuhët e tyre dhe duke trilluar për fenë." – Pra, ata i drejtoheshin Profetit (a.s.) me formën më të ulët dhe më të paedukuar, duke i thënë: "Dëgjo, mos dëgjofsh!".

Ata thanë edhe "*Raina*", duke patur për qëllim kuptimin e keq të kësaj fjale. Duke qenë se kjo fjalë përmban dy kuptime, ata të mjerë menduan se mund ta përdornin me Allahun dhe Profetin e Tij pa i ndëshkuar kush për qëllimin e tyre të keq. Ata pandehën se mund të shanin dhe të talleshin me fenë e Zotit dhe me Profetin e tij dhe të mos merreshin në përgjegjësi.

Por Allahu i Lartësuar i porositi ata për diçka më të mirë:

- "Megjithatë, sikur ata të kishin thënë: "Dëgjuam dhe u bindëm", "Dëgjo!" ose "Na shiko!", do të ishte më mirë dhe më e drejtë nga ana e tyre." - Allahu i Lartësuar i mësoi mënyrën si t'i drejtoheshin Profetit (a.s.) dhe si t'u bindeshin urdhrave të Tij. Ai i porositi të ishin të edukuar dhe të butë në kërkimin e dijes dhe në mënyrën e drejtimit të pyetjeve.

Por duke qenë se ata kishin një natyrë jo të pastër, i kthyen shpinën këtyre porosive, dhe për këtë arsye, Allahu i Lartësuar i dëboi nga mëshira e tyre, pra, i mallkoi:

- "Por Allahu i mallkoi për shkak të mohimit të tyre, prandaj veç një pakicë e tyre besojnë."

Ajeti 47

47. O ju të cilëve ju është dhënë Libri! Besojeni atë *(Kur'ânin)* që e shpallëm si vërtetues të atij që keni në duar *(Teuratit)*, para se të fshijmë fytyra dhe t'i kthejmë ato prapa, ose t'ju mallkojmë siç i mallkuam ata *(shkelësit e ligjit)* të së shtunës. Urdhri i Allahut është i pakthyeshëm.

Shpjegimi i ajetit

Allahu i Lartësuar i urdhëron ithtarët e Librit, çifutët e të krishterët, që të besojnë Profetin e fundit, Muhamedin (a.s.) dhe të pasojnë Kur'ânin që iu dha atij, i cili është vërtetues i shpalljeve hyjnore të mëparshme dhe garantues i të vërtetës që gjendet në to. Për këtë libër të mrekullueshëm kanë lajmëruar dhe dëshmuar edhe librat e mëparshëm hyjnorë.

Kur'âni është vërtetuesi i shpalljeve të mëparshme, prandaj nëse ata e mohojnë dhe nuk e zbatojnë atë, atëherë ata kështu hedhin poshtë edhe librat e tyre, që pretendojnë se besojnë dhe ndjekin. Shpalljet e Zotit vërtetojnë njëra-tjetrën. Pretendimi se mund të jesh besimtar duke besuar një pjesë të tyre dhe duke mohuar një pjesë tjetër, është i pavlerë; ose duhet t'i besosh të gjitha, ose në të kundërt je mohues i të gjithave.

Allahu i Lartësuar u thotë atyre:

- "O ju të cilëve ju është dhënë Libri! Besojeni atë *(Kur'ânin)* që e shpallëm si vërtetues të atij që keni në duar *(Teuratit)*..." - Kjo është kështillë e mrekullueshme drejtuar ithtarëve të Librit. Ata duhet të jenë të parët që duhet të pranojnë shpalljet e Zotit, për shkak të dijes dhe mirësive me të cilat Zoti i begatoi dhe i dalloi mbi shumë të tjerë. Duke qenë se Zoti u dhuroi atyre një libër qiellor, ata duhet të jenë më të kujdesshëm dhe më të përgjegjshëm se të tjerët në përgjigjen e thirrjes së Zotit për të besuar dhe pasuar Kur'ânin dhe Profetin e fundit të Tij. Ata e dinë shumë mirë rëndësinë e një çështjeje të tillë dhe rrezikshmërinë e shpërfilljes së saj, prandaj Allahu i Lartësuar u bën një paralajmërim shumë të frikshëm.

- "...para se të fshijmë fytyra dhe t'i kthejmë ato prapa, ose t'ju mallkojmë siç i mallkuam ata *(shkelësit e ligjit)* të Sabatit." - Ky është dënimi i merituesëm për këtë vepër. Shkelësit e ligjit të Sabatit (judejtë) e braktisën të vërtetën dhe parapëlqyen të

kotën duke e tjetërsuar realitetin. Ata e bënë të rremen të vërtetë dhe të vërtetën të rreme, prandaj dhe u "shpërblyen" me kthimin e fytyrave pas, domethënë duke ua fshirë tiparet nga fytyra dhe duke ua kthyer ato pas koke. Ky qe një ndëshkim poshtërues, por përveç tij, ishte edhe mallkimi, pra, dëbimi nga mëshira e Zotit, i Cili, disa prej tyre i dëboi nga mëshira e Tij, ndërsa të tjerë i shndërroi në majmunë dhe në derra.

Ky është kërcënim për ata që nuk e besojnë Shpalljen e fundit, Kur'ânin.

- "Urdhri i Allahut është i pakthyeshëm." - Pra, kjo nuk është e vështirë për Allahun e Lartësuar, që thotë në një ajet tjetër: "Kur Ai dëshiron diçka, mjafton vetëm t'i thotë: "Bëhu!", e ajo menjëherë bëhet." [Jasin 82].

Ajeti 48

48. Vërtet, Allahu nuk fal që të adhurohet dikush a diçka tjetër veç Tij, ndërsa gjynahet e tjera ia fal kujt të dojë. Kush adhuron diçka tjetër veç Allahut, ka bërë një gjynah të madh.

Shpjegimi i ajetit

- "Vërtet, Allahu nuk fal që të adhurohet dikush a diçka tjetër veç Tij, ndërsa gjynahet e tjera ia fal kujt të dojë."..." - Allahu i Lartësuar na bën të ditur se Ai nuk e fal që robi të adhurojë dikë a diçka tjetër veç Tij, kushdo dhe çfarëdo gjëje qoftë ajo. Adhurimi i takon vetëm Zotit dhe idhujtaria është e pafalshme para Tij. Ndërsa kur flitet për gjynahet e tjera, Ai ia fal ato kujt të dëshirojë, sipas urtësisë së Tij.

Për gjynahet poshtë idhujtarisë (*shirk*) Allahu i Lartësuar ka vendosur shkaqe për faljen e tyre, si: veprat e mira, fatkeqësitë dhe vuajtjet në jetën e dynjasë, vuajtjet në jetën e varrit dhe në Ditën e Gjykimit, lutjet e besimtarëve për njëri-tjetrin apo ndërmjetësimi në ahiret. Nëse me gjithë këto shkaqe, gjynahet ende nuk fshihen, se janë të shumta, atëherë mbetet mëshira e Allahut, që Ai e ka veçuar për ata të cilët e kanë besuar pa bërë *shirk*.

Ndërsa idhujtari ia ka mbyllur vetes portat e faljes dhe të mëshirës së Zotit. Çdo punë e mirë apo adhurim është i pavlefshëm nëse njeriu nuk distancohet nga çdo lloj idhujtarie. Njeriu është i ngarkuar pikësëpari të dëshmojë njësimin e Allahut në meritën e adhurimit, pra, është urdhëruar për teuhid, dhe pastaj i llogariten veprat e mira apo adhurimet, nëse ka bërë. Nëse nuk ka dëshmuar dhe nuk ka besuar njëshmërinë e Zotit në meritën e adhurimit dhe nuk është distancuar nga idhujtaria, atëherë prej tij nuk pranohet asgjë. Atë nuk e pastrojnë nga gjynahet as fatkeqësitë në jetën e dynjasë, as vuajtjet në varr dhe as vuajtjet në Ditën e Gjykimit. Për atë nuk do të ketë as ndërmjetësim, që të mund ta ndihmojë dhe shpëtojë nga ndëshkimi. Kështu, idhujtaria është krim i madh dhe i pafalshëm.

- "Kush adhuron diçka tjetër veç Allahut, ka bërë një gjynah të madh." – Pra, ka bërë faj të rëndë. E ku ka padrejtësi më të madhe që një krijesë të dobët, të krijuar nga dheu, të varfër, të varur dhe nevojtare për kujdesin e Zotit, të mangët në çdo aspekt, e paaftë t'i bëjë vetes mirë apo keq, e pamundur që të japë apo ta marrë jetë, ta krahasosh me Krijuesin e gjithçkaje, të Plotin dhe Absolutin në çdo drejtim, të Pasurin, që nuk ka nevojë për asnjë krijesë të Tij, me Atë në dorën e të Cilit është e mira dhe e keqja, dhënia dhe privimi, me Atë prej të Cilit vjen çdo mirësi që kanë krijesat? E pra, nuk ka padrejtësi më të madhe se kjo. Për këtë arsye, ai që bën këtë krim dënohet përjetësisht në Zjarrin e Xhehenemit, duke u privuar plotësisht nga mirësitë e Zotit.

Në një ajet tjetër thotë i Lartësuari: "Mohuan të vërtetën ata që thanë: "Allahu është Mesihu, biri i Merjemes". Por Mesihu *(Isai)* tha: "O bijtë e Israilit, adhurojeni Allahun, Zotin tim dhe Zotin tuaj, sepse atij që adhuron dikë a diçka tjetër veç Allahut, Ai *(Allahu)* ia ka ndaluar Xhenetin dhe vendi

i tij do të jetë Zjarri. Për zullumqarët nuk ka ndihmës." [Maide 72].

Por, sigurisht, kjo vlen për ata që nuk pendohen derisa i kap vdekja. Ndërsa për sa u përket atyre që pendohen para këtij çasti, atyre iu falet idhujtaria dhe çdo lloj gjynahu tjetër, sikurse thotë i Lartësuari: "O robërit e Mi, të cilët e keni ngarkuar veten tuaj me shumë gabime, mos e humbni shpresën ndaj mëshirës së Allahut, sepse vërtet Allahu i fal të gjitha gjynahet. Ai është Falësi e Mëshiruesi!" Kthehuni te Zoti juaj dhe nënshtrojuni Atij, para se t'ju vijë dënimi, se pastaj nuk do të ketë kush t'ju ndihmojë. Përmbajuni më të mirës që ju është shpallur nga Zoti juaj, para se t'ju vijë dënimi befas, pa e kuptuar. Dhe pastaj të mos thotë kush: "O i mjeri unë, që kam shpërfillur adhurimin dhe bindjen ndaj Allahut e që isha prej atyre që talleshin!" Ose të thotë: "Ah, sikur të më kishte udhëzuar Allahu e të kisha qenë i devotshëm!" Apo, kur ta shohë dënimin, të thotë: "Sikur të isha kthyer edhe një herë e të isha bërë vepërmirë!" Jo, ty të patën ardhur argumentet e Mia, kurse ti i mohove ato, u bëre arrogant dhe jobesimtar." [Zumer 53-59].

Përfundimisht, Allahu i Lartësuar i fal të gjitha gjynahet e atyre që pendohen dhe kthehen tek Ai të nënshtruar.

Ajetet 49 – 50

49. A nuk i sheh ata që e vlerësojnë veten si të pastër?! Është Allahu Ai që pastron nga të këqijat atë që Ai dëshiron, pa i bërë padrejtësi askujt.
50. Shiko se si trillojnë shpifje kundër Allahut, dhe kaq mjafton si gjynah i qartë!

Shpjegimi i ajeteve

- "A nuk i sheh ata që e vlerësojnë veten si të pastër?!" - Kjo është pyetje që përmban në vetvete një habi. Ajo është njëkohësisht një qortim i hapur për të gjithë ata të cilët lëvdojnë veten dhe pretendojnë se janë të pastër dhe të pafajshëm. Të tillë janë judejtë, të krishterët dhe të gjithë ata që ecin në rrugën e tyre. Ata pretendojnë dhe thonë: "Ne jemi bijtë e Zotit dhe të dashurit e Tij". Ata thonë gjithashtu: "Nuk ka për të hyrë në Xhenet askush tjetër, përveç atyre që janë çifutë ose të krishterë! Por këto janë thjesht trille të tyre!" [Bekare 111]. Pra, të gjitha këto janë pretendime të pabaza dhe të pavlera. E vërtetë është ajo që ka thënë Allahu i Lartësuar në Kur'ân: "Përkundrazi, ata që i janë dorëzuar Allahut dhe janë bamirës, ata e kanë shpërblimin te Zoti i tyre. Për ata nuk ka frikë, as nuk kanë pse të mërziten." [Bekare 112]. Kështu pra, këta janë ata të cilët Zoti i ka bërë të pastër dhe i ka begatuar me cilësi të mrekullueshme; këta janë të shpëtuarit. Më pas, i Lartësuari thotë:

- "Është Allahu Ai që pastron nga të këqijat atë që Ai dëshiron, pa i bërë padrejtësi askujt." – Pra, është Allahu i Lartësuar që i stolis ata me besim të bazuar në dije të sigurt nga Zoti dhe me vepra të mira e të sinqerta për të. Ai i pastron ata nga çdo cilësi e keqe, për t'i pajisur me virtyte të larta.

Ndërsa ata të mjerë që lëvdohen dhe thonë se janë të përsosur, edhe pse pretendojnë se bazohen diku, ata thjesht trillojnë. Ata nuk kanë asnjë lidhje me të pastërtit dhe të zgjedhurit e Zotit dhe qëndrojnë shumë larg tyre. Kjo ndodh për shkak të mohimit të tyre, sepse Zoti nuk u bën padrejtësi, siç thotë Ai: "...pa i bërë padrejtësi askujt". Ky është një përforcim i faktit që Allahu i Lartësuar nuk bën kurrë padrejtësi, madje as sa një *fetil*, që është një membranë e hollë në bërthamën e hurmës.

- "Shiko se si trillojnë shpifje kundër Allahut, dhe kaq mjafton si gjynah i qartë!" - Duke lavdëruar veten dhe duke pretenduar pastërtinë, ata thjesht shpifin. Kjo konsiderohet si shpifje ndaj Zotit të Lartësuar, sepse ata pretendojnë se rruga që ndjekin është e vërteta e Zotit, ndërsa rruga e besimtarëve është e gabuar. Ky është synimi i tyre kur lëvdojnë vetveten, por ky

është shtrembërim i realitetit. Kjo do të thotë që të vërtetën ta paraqesësh si të gënjeshtërt dhe të gënjeshtërtën ta paraqesësh si të vërtetë. Për këtë arsye, i Lartësuari e ka konsideruar këtë veprim të tyre si gjynah të hapur, që meriton një ndëshkim të ashpër e poshtërues.

Ajetet 51 – 55

51. A nuk i ke parë ata që u është dhënë pjesë nga Libri? Ata besojnë në idhuj dhe zota të trilluar dhe thonë për jobesimtarët: "Këta janë në rrugë më të drejtë se ata besimtarët!"
52. Këta janë ata të cilët Allahu i ka mallkuar, dhe atij që e mallkon Allahu nuk i gjendet kurrë ndihmues.
53. A mos kanë ata ndonjë pjesë të pushtetit? Nëse do të ishte kështu, ata nuk do t'u jepnin njerëzve as sa cipa mbështjellëse e bërthamës së hurmës.
54. A mos i kanë zili njerëzit për çfarë u ka dhuruar Allahu nga mirësitë e Tij? Ne u dhamë pasardhësve të Ibrahimit Librin e urtësinë, si edhe pushtet të madh.
55. Disa prej tyre e besuan atë *(Muhamedin a.s.)*, e disa e mohuan. Mjafton për këta të fundit zjarri i Xhehenemit i ndezur fort.

Shpjegimi i ajeteve

- "A nuk i ke parë ata që u është dhënë pjesë nga Libri? Ata besojnë në idhuj dhe zota të trilluar." - Këto janë disa cilësi të shëmtuara dhe të turpshme të çifutëve. Ato janë tregues të qartë të smirës së tyre ndaj Profetit (a.s.) dhe besimtarëve. Cilësitë e tyre të ulta dhe natyra e tyre e pisët i shtynë që të braktisnin besimin në Zotin dhe në Profetin e Tij, për të përqafuar besimin në *tagut*. Fjala '*tagut*' përfshin shumë padrejtësi dhe krime siç janë: magjia, falli, idhujtaria, bindja ndaj shejtanit etj.

Kufri dhe smira e tyre i çoi deri atje sa të thonë që rruga e adhuruesve të idhujve është më e mirë se rruga e njësuesve të Zotit, pra, e muslimanëve të sinqertë:

- "...dhe thonë për jobesimtarët: "Këta janë në rrugë më të drejtë se ata besimtarët!" - Ata thanë të tilla fjalë, për shkak të urrejtjes së tyre ndaj besimit të drejtë dhe besimtarëve, prandaj u bënë aleatë me idhujtarët.

Subhanallah, sa e madhe ka qenë smira dhe mendjelehtësia e tyre! Sa e vogël ka qenë mendja e tyre! Si është e mundur që ndoqën këtë rrëpirë të errët dhe këtë arsye të vdekur! Vallë, mos menduan se kjo do të ishte e pranueshme për të mençurit? Apo mos menduan se mund të kishte rezultat me injorantët? Si arritën të parapëlqenin një fe të ndërtuar mbi adhurimin e idhujve, që i ndalonte njerëzit nga çdo gjë e mirë dhe e pastër e u bënte të lejueshme çdo gjë të pisët dhe të dëmshme, që marrëdhëniet ndërnjerëzore i ndërtonte mbi padrejtësinë dhe paturpësisht vendoste shenjën e barazimit mes krijesës dhe Krijuesit, një fe kjo e ndërtuar mbi mohimin e Zotit dhe të profetëve të Tij! Si mund të parapëlqesh një fe të tillë kundrejt adhurimit të Rrahmanit, kundrejt sinqeritetit të plotë me Allahun dhe mohimit të çdo lloj adhurimi tjetër?! Si mund të parapëlqesh një besim të tillë kundrejt një feje që urdhëron për ruajtjen e lidhjeve farefisnore dhe për bamirësi ndaj krijesave, madje edhe ndaj kafshëve dhe bimëve, kundrejt një feje që urdhëron për drejtësi e barazi të njerëzve para ligjit dhe ndalon nga çdo ligësi dhe padrejtësi, kundrejt një feje që urdhëron për sinqeritet dhe vërtetësi në çdo fjalë e vepër?! Si mund të gabosh në një përzgjedhje të tillë?! Kush e bën një zgjidhje të tillë është ose njeriu më injorant dhe i mangët në logjikën e tij, ose njeriu më armiqësor, rebel dhe urryes i së vërtetës. Me sa duket, kjo e dyta është e vërteta. Më tej, i Lartësuari thotë:

- "Këta janë ata të cilët Allahu i ka mallkuar, dhe atij që e mallkon Allahu nuk i gjendet kurrë ndihmues." - Allahu i Lartësuar i ka dëbuar ata nga mëshira e Tij, për të lëshuar mbi ta zemërimin e Tij. Për ata


që i ka mallkuar Zoti, nuk ka më ndihmës që mund t'i lehtësojë të arrijnë ndonjë mirësi apo që ta ruajnë nga ndonjë fatkeqësi. Ky është një poshtërim tepër i madh.

- "A mos kanë ata ndonjë pjesë të pushtetit? Nëse do të ishte kështu, ata nuk do t'u jepnin njerëzve as sa cipa mbështjellëse e bërthamës së hurmës." - Mos vallë, ata kanë pjesë në sundimin dhe pushtetin e Zotit dhe, në këtë mënyrë, të mund të japin dhe privojnë nga mirësitë e Zotit, sipas dëshirave të tyre?!

Kjo është një pyetje së cilës i dihet përgjigjja. Ata sigurisht që nuk kanë pjesë në pushtetin dhe sundimin e Zotit, sepse i gjithë pushteti dhe sundimi i takon vetëm Atij dhe askush nuk vepron në mbretërinë e Zotit pa lejen e Tij. Por Allahu i Lartësuar na tregon se, nëse do të ishte ashtu, me ngushtësinë e shpirtrave të tyre, ata nuk do t'u jepnin njerëzve as edhe gjënë më të vogël. Aq e madhe është koprrracia e tyre, saqë edhe po të kishin pjesë në sundimin e Zotit, përsëri nuk do të jepnin gjë!

- "A mos i kanë zili njerëzit për çfarë u ka dhuruar Allahu nga mirësitë e Tij?" - Çifutët dhe të krishterët e mohuan Muhamedin (a.s.) dhe nuk e pranuan që Zoti i dhuroi edhe atij profetësinë, sikurse të gjithë vëllezërve të tij profetë. Vallë, a mos i shtyu pretendimi se ata janë pjesëtarë në pushtetin e Zotit, dhe prandaj mirësitë u jepen vetëm atyre që ata i mendojnë si të denjë?! Apo kjo ishte thjesht një smirë nga ana e tyre për faktin që Allahu i Lartësuar zgjedh kë të dëshirojë prej krijesave të Tij për ta nderuar me profetësi?! Sigurisht që qëndron e dyta, dhe kjo nuk ishte hera e parë që ata shfaqnin të tilla cilësi të dënueshme.

Po përse duhej të kishin smirë ndaj përzgjedhjes së Zotit? A nuk e dinin ata se nuk ishte hera e parë që Zoti shquante disa njerëz mbi disa të tjerë? I Lartësuari thotë:


الجزء الخامس سورة النساء

أُولَٰئِكَ الَّذِينَ لَعَنَهُمُ اللَّهُ ۖ وَمَن يَلْعَنِ اللَّهُ فَلَن تَجِدَ لَهُ نَصِيرًا ﴿٥٢﴾
أَمْ لَهُمْ نَصِيبٌ مِّنَ الْمُلْكِ فَإِذًا لَّا يُؤْتُونَ النَّاسَ نَقِيرًا ﴿٥٣﴾ أَمْ
يَحْسُدُونَ النَّاسَ عَلَىٰ مَا آتَاهُمُ اللَّهُ مِن فَضْلِهِ ۖ فَقَدْ آتَيْنَا
آلَ إِبْرَاهِيمَ الْكِتَابَ وَالْحِكْمَةَ وَآتَيْنَاهُم مُّلْكًا عَظِيمًا ﴿٥٤﴾
فَمِنْهُم مَّنْ آمَنَ بِهِ وَمِنْهُم مَّن صَدَّ عَنْهُ ۚ وَكَفَىٰ بِجَهَنَّمَ سَعِيرًا ﴿٥٥﴾
إِنَّ الَّذِينَ كَفَرُوا بِآيَاتِنَا سَوْفَ نُصْلِيهِمْ نَارًا كُلَّمَا نَضِجَتْ
جُلُودُهُم بَدَّلْنَاهُمْ جُلُودًا غَيْرَهَا لِيَذُوقُوا الْعَذَابَ ۗ إِنَّ اللَّهَ كَانَ
عَزِيزًا حَكِيمًا ﴿٥٦﴾ وَالَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ سَنُدْخِلُهُمْ
جَنَّاتٍ تَجْرِي مِن تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ خَالِدِينَ فِيهَا أَبَدًا ۖ لَّهُمْ فِيهَا
أَزْوَاجٌ مُّطَهَّرَةٌ ۖ وَنُدْخِلُهُمْ ظِلًّا ظَلِيلًا ﴿٥٧﴾ * إِنَّ اللَّهَ يَأْمُرُكُمْ
أَن تُؤَدُّوا الْأَمَانَاتِ إِلَىٰ أَهْلِهَا وَإِذَا حَكَمْتُم بَيْنَ النَّاسِ أَن
تَحْكُمُوا بِالْعَدْلِ ۚ إِنَّ اللَّهَ نِعِمَّا يَعِظُكُم بِهِ ۗ إِنَّ اللَّهَ كَانَ سَمِيعًا
بَصِيرًا ﴿٥٨﴾ يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا أَطِيعُوا اللَّهَ وَأَطِيعُوا الرَّسُولَ وَأُولِي
الْأَمْرِ مِنكُمْ ۖ فَإِن تَنَازَعْتُمْ فِي شَيْءٍ فَرُدُّوهُ إِلَى اللَّهِ وَالرَّسُولِ إِن كُنتُمْ
تُؤْمِنُونَ بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ الْآخِرِ ۚ ذَٰلِكَ خَيْرٌ وَأَحْسَنُ تَأْوِيلًا ﴿٥٩﴾

٨٧

- "Ne u dhamë pasardhësve të Ibrahimit Librin e urtësinë, si edhe pushtet të madh." - Allahu i Lartësuar i dhuroi Ibrahimit (a.s.) dhe pasardhësve të tij shumë mirësi, më të mëdhatë e të cilave ishin profetësia, Shpallja hyjnore, urtësia dhe pushteti. Prej Ibrahimit (a.s.) rodhën profetët e botës dhe sunduesit e saj, siç ishin Daudi dhe Sulejmani. Megjithatë, mirësitë e Zotit janë ende të vazhdueshme për robërit e Tij besimtarë.

Si mund të mohohet mirësia e Zotit, pra, Muhamedi (a.s.), si dhe ndihma e pushteti që Zoti i dhuroi atij. Muhamedi ishte krijesa më e mirë që zgjodhi Zoti për Shpalljen e fundit. Ai mbetet njeriu më i madh dhe më i ditur rreth Zotit dhe adhuruesi më i përulur i Tij.

- "Disa prej tyre e besuan atë *(Muhamedin a.s.)*, e disa e mohuan." - Në raport me Profetin e fundit, njerëzit u ndanë në dy grupe: disa i besuan Muhamedit (a.s.) dhe ndoqën Shpalljen e tij, për të fituar në këtë mënyrë lumturinë e vërtetë në dynja dhe në

ahiret, dhe disa e mohuan Muhamedin (a.s.) dhe refuzuan të pasonin Shpalljen që Zoti i dhuroi atij, nga armiqësia, urrejtja dhe smira që kishin. Këta të mjerë merituan dëshpërimin që në këtë jetë, para atij që nuk do të ketë fund. Dënimi që i pret është i dhembshëm. Allahu i Lartësuar thotë:

- "Mjafton për këta të fundit zjarri i Xhehenemit i ndezur fort." - Zjarri do përpijë brenda tij të gjithë ata që e kanë mohuar Zotin dhe s'kanë pranuar të pasojnë profetët e Tij.

Ky është një kërcënim i hapur për çifutët, të krishterët dhe të gjithë ata që mohojnë Shpalljen e fundit, Shpalljen që Zoti i zbriti Muhamedit (a.s.). Kjo përforcohet më tepër në ajetin vijues:

Ajetet 56 – 57

56. Nuk ka dyshim se ata që kanë mohuar argumentet Tona, do t'i flakim në Zjarr. Sa herë që do t'u digjet një lëkurë, Ne do t'ua zëvendësojmë me lëkurë tjetër, që ta 'shijojnë' mirë dënimin. Me të vërtetë, Allahu është i Plotfuqishëm e i Urtë.
57. Nuk ka dyshim se ata që kanë besuar dhe kanë bërë vepra të mira, Ne do t'i fusim në Kopshte, nëpër të cilët rrjedhin lumenj, ku do të jenë të përjetshëm. Atje do të kenë edhe bashkëshorte të pastra e hije të mrekullueshme.

Shpjegimi i ajeteve

- "Nuk ka dyshim se ata që kanë mohuar argumentet Tona, do t'i flakim në Zjarr. Sa herë që do t'u digjet një lëkurë, Ne do t'ua zëvendësojmë me lëkurë tjetër, që ta 'shijojnë' mirë dënimin." - Allahu i Plotfuqishëm dhe i Drejtë i kërcënon me një zjarr të madh dhe të ndezur fort ata që shpërfillin dhe i refuzojnë Shpalljet e Tij.

Në atë zjarr, sa herë që lëkura e tyre të digjet, Allahu i Plotpushtetshëm do t'ua zëvendësojë me lëkurë tjetër, me qëllim që ta ndiejnë dhimbjen pa ndërprerje. Ashtu sikurse ata refuzojnë vazhdimisht, me inat dhe kokëfortësi, ftesën e Allahut për besim dhe për bindje ndaj Profetit të Tij në këtë dynja, ashtu Allahu i bën të shijojnë pandërprerë dënimin e hidhur. Ata e meritojnë këtë ndëshkim, se Zoti nuk i bën padrejtësi askujt. Më pas, i Lartësuari thotë:

- "Me të vërtetë, Allahu është i Plotfuqishëm e i Urtë." - Ai është i Plotfuqishmi, të Cilit duhet t'i frikësohesh dhe të respektosh urdhrat dhe ndalesat e Tij. Ai është i Urti në çdo gjë që ka krijuar e urdhëruar, në çdo shpërblim dhe ndëshkim që jep për krijesat e Tij. Askush nuk mund të kundërshtojë apo të vërë në dyshim urtësinë e Tij.

- "Nuk ka dyshim se ata që kanë besuar dhe kanë bërë vepra të mira, Ne do t'i fusim në Kopshte, nëpër të cilët rrjedhin lumenj, ku do të jenë të përjetshëm." - Për ata që besojnë Allahun dhe që bëjnë vepra të mira sipas këtij besimi të drejtë, për ata ka një tjetër premtim.

- "Atje do të kenë edhe bashkëshorte të pastra e hije të mrekullueshme." - Ato janë gra të pastra nga çdo cilësi e keqe, larg çdo shëmtie dhe mangësie. Ato janë të ruajtura nga çdo papastërti që kanë zakonisht gratë e dynjasë. Besimtarët do të jenë të qetë, të lumtur dhe të përjetshëm, nën hije të këndshme.

Ajetet 58 – 59

58. Allahu ju urdhëron që amanetet t'ua ktheni atyre që u përkasin dhe, kur të gjykoni midis njerëzve, të gjykoni me drejtësi. Vërtet, urdhrat që u jep Allahu janë të mrekullueshëm. Allahu dëgjon dhe sheh si veproni.
59. O ju që keni besuar! Bindjuni Allahut, bindjuni të Dërguarit dhe përgjegjësve nga ju! Nëse nuk pajtoheni për ndonjë çështje, atëherë parashtrojeni atë tek Allahu dhe tek i Dërguari, nëse vërtet e besoni Allahun

dhe Ditën e Fundit. Kjo është më e dobishmja dhe përfundimi më i mirë.

Shpjegimi i ajeteve

- "Allahu ju urdhëron që amanetet t'ua ktheni atyre që u përkasin..." - 'Amanet' quhet çdo punë dhe përgjegjësi me të cilën njeriu ngarkohet për ta kryer dhe për ta plotësuar. Kështu, Allahu i Lartësuar na urdhëron që t'i plotësojmë detyrat me të cilat jemi ngarkuar; pra, t'i kryejmë ato në formën më të plotë dhe më të mirë, pa cenuar gjë dhe pa i vonuar nga koha e tyre.

Amanetet që merr njeriu përsipër janë të natyrave të ndryshme, por ne jemi të urdhëruar që të gjitha ato t'i çojmë në vend, ashtu sikurse na është ngarkuar. Edhe nëse nuk na sheh kush, të jemi të sigurt që Zoti na sheh dhe do të na marrë në përgjegjësi për to.

Dijetarët thonë se, nëse dikujt i lihet një amanet për ta ruajtur, ai e ka detyrë ta ruajë atë, duke marrë masat e nevojshme, që merren zakonisht në të tilla raste. Veçse në këtë mënyrë mund të thuhet se e kemi kryer detyrën.

"...dhe, kur të gjykoni midis njerëzve, të gjykoni me drejtësi." - Por me çfarë drejtësie jemi urdhëruar që të gjykojmë? Vallë, a mos caktohet ajo nga oreksi dhe arsyetimi i njerëzve? Jo! Drejtësi është vetëm ajo që Zoti e ka përcaktuar si të tillë në Shpalljen e sjellë nëpërmjet Profetit të Tij.

Në Kur'ân dhe në Traditën e Profetit të Tij, Allahu i Lartësuar ka vendosur ligjet që mbrojnë pesë domosdoshmëritë: fenë, jetën, mendjen, nderin dhe pasurinë. Por që të gjykojmë me drejtësi, duhet që fillimisht t'i njohim këto ligje të Zotit. Pra, ajeti është së pari një nxitje për njohjen e ligjeve të Zotit, që pastaj të bëhet i mundur gjykimi i drejtë. Nuk mund të ketë drejtësi pa dije dhe pa frikë ndaj Zotit.


Urdhrat dhe ligjet e Zotit janë të mrekullueshëm, siç thotë Ai:

- "Vërtet, urdhrat që u jep Allahu janë të mrekullueshëm. Allahu dëgjon dhe sheh si veproni." - Allahu i Lartësuar lëvdon urdhrat dhe ndalesat e Tij, sepse ato përmbajnë udhëzimin e plotë dhe të vetmin që u siguron njerëzve lumturinë dhe që i ruan ata nga çdo e keqe në të dyja jetët. E si të jetë ndryshe, kur Ai që i caktoi ato është Gjithëdëgjuesi, Gjithëshikuesi, të Cilit nuk i fshihet asgjë dhe i Cili e di shumë mirë se cila është e mira dhe e keqja për krijesat?! Ai di atë që ata nuk e dinë.

- "O ju që keni besuar! Bindjuni Allahut, bindjuni të Dërguarit dhe përgjegjësve tuaj!" - Allahu i Lartësuar na urdhëron që t'i bindemi dhe t'i nënshtrohemi, duke zbatuar porositë e Tij dhe të Profetit të Tij.

Gjithashtu, Allahu i Lartësuar na urdhëron që të jemi të bindur edhe ndaj udhëheqësve. Këtu bëhet fjalë për udhëheqës shteti dhe udhëheqës feje. Që çështjet e kësaj bote dhe feja e njerëzve të jenë të stabilizuara dhe të rregullta, njerëzit duhet të tregojnë bindje ndaj udhëheqësve të tyre, në emër të bindjes ndaj Allahut dhe për shpërblimin që Ai premton.

Megjithatë, bindja ndaj udhëheqësve ka si kusht që ata të mos urdhërojnë për gjynahe dhe mosbindje ndaj Allahut. Nëse ata urdhërojnë për diçka që Zoti e ka ndaluar, atëherë thuhet se nuk ka bindje ndaj krijesës duke kundërshtuar Krijuesin. Ndoshta pikërisht për këtë arsye, Allahu i Lartësuar nuk e përsërit foljen "bindjuni" për herë të tretë, por thotë: "Bindjuni Allahut, bindjuni të Dërguarit dhe përgjegjësve tuaj!" Profeti ka urdhëruar veçse për drejtësi dhe bindje ndaj Allahut të Lartësuar, prandaj ai që i bindet Profetit i është bindur Allahut. Ndërsa ndaj një udhëheqësi, për sa kohë që ai i bindet Allahut dhe Profetit dhe urdhëron për bindje ndaj Allahut dhe Profetit, është detyrë që të tregojmë bindje. Në të kundërt, nëse urdhrat e tij cenojnë bindjen ndaj Allahut dhe Profetit, atëherë nuk ka bindje ndaj tij.


الجزء الخامس سورة النساء

أَلَمْ تَرَ إِلَى ٱلَّذِينَ يَزْعُمُونَ أَنَّهُمْ ءَامَنُوا۟ بِمَآ أُنزِلَ إِلَيْكَ
وَمَآ أُنزِلَ مِن قَبْلِكَ يُرِيدُونَ أَن يَتَحَاكَمُوٓا۟ إِلَى ٱلطَّٰغُوتِ
وَقَدْ أُمِرُوٓا۟ أَن يَكْفُرُوا۟ بِهِۦ وَيُرِيدُ ٱلشَّيْطَٰنُ أَن يُضِلَّهُمْ
ضَلَٰلًۢا بَعِيدًا ﴿٦٠﴾ وَإِذَا قِيلَ لَهُمْ تَعَالَوْا۟ إِلَىٰ مَآ أَنزَلَ
ٱللَّهُ وَإِلَى ٱلرَّسُولِ رَأَيْتَ ٱلْمُنَٰفِقِينَ يَصُدُّونَ عَنكَ
صُدُودًا ﴿٦١﴾ فَكَيْفَ إِذَآ أَصَٰبَتْهُم مُّصِيبَةٌۢ بِمَا
قَدَّمَتْ أَيْدِيهِمْ ثُمَّ جَآءُوكَ يَحْلِفُونَ بِٱللَّهِ إِنْ أَرَدْنَآ إِلَّآ
إِحْسَٰنًا وَتَوْفِيقًا ﴿٦٢﴾ أُو۟لَٰٓئِكَ ٱلَّذِينَ يَعْلَمُ ٱللَّهُ مَا
فِى قُلُوبِهِمْ فَأَعْرِضْ عَنْهُمْ وَعِظْهُمْ وَقُل لَّهُمْ فِىٓ
أَنفُسِهِمْ قَوْلًۢا بَلِيغًا ﴿٦٣﴾ وَمَآ أَرْسَلْنَا مِن رَّسُولٍ إِلَّا
لِيُطَاعَ بِإِذْنِ ٱللَّهِ ۚ وَلَوْ أَنَّهُمْ إِذ ظَّلَمُوٓا۟ أَنفُسَهُمْ
جَآءُوكَ فَٱسْتَغْفَرُوا۟ ٱللَّهَ وَٱسْتَغْفَرَ لَهُمُ ٱلرَّسُولُ
لَوَجَدُوا۟ ٱللَّهَ تَوَّابًا رَّحِيمًا ﴿٦٤﴾ فَلَا وَرَبِّكَ لَا يُؤْمِنُونَ
حَتَّىٰ يُحَكِّمُوكَ فِيمَا شَجَرَ بَيْنَهُمْ ثُمَّ لَا يَجِدُوا۟ فِىٓ
أَنفُسِهِمْ حَرَجًا مِّمَّا قَضَيْتَ وَيُسَلِّمُوا۟ تَسْلِيمًا ﴿٦٥﴾
٨٨

- **"Nëse nuk pajtoheni për ndonjë çështje, atëherë parashtrojeni atë tek Allahu dhe tek i Dërguari, nëse vërtet e besoni Allahun dhe Ditën e Fundit. Kjo është më e dobishmja dhe përfundimi më i mirë." -** Allahu i Lartësuar na udhëzon se si të veprojmë në raste polemikash dhe kundërshtish për çështjet themelore apo dytësore të fesë. Në të tilla raste, pra, është detyrë që ne t'i kthehemi Librit të Allahut dhe Traditës së Profetit (a.s.)

Në Kur'ân dhe në Sunet gjenden udhëzimet e qarta për çdo mospajtim. Në fakt, udhëzimet në këto dy burime janë të natyrave të ndryshme. Ato mund të jenë krejt të kuptueshme, por ndonjëherë mund të jenë në mënyrë përgjithësuese, ndonjëherë si shenja që na drejtojnë drejt së mirës, ndonjëherë si krahasime për të gjetur gjykimin në raste të ngjashme etj.

Libri i Zotit dhe Tradita e Profetit të Tij janë themelet e fesë së Zotit, pa të cilët nuk mund të thuhet se jemi në rrugë të drejtë. Mbështetja në Librin e Zotit dhe në Traditën e Profetit (a.s.) është kusht i domosdoshëm për besimin, prandaj Allahu i Lartësuar thotë në përfundim të urdhërit: "...nëse vërtet e besoni Allahun dhe Ditën e Fundit". Kjo tregon se ai që, në rastet e kundërshtimit, nuk gjykon sipas Librit të Zotit dhe Traditës së Profetit, nuk është besimtar i vërtetë, por i është nënshtruar *tagut*-it (çdo gjëje që adhurohet veç Zotit), sikurse thuhet në ajetin më poshtë. Mbështetja te Libri i Zotit dhe te Tradita e Profetit është rruga më e mirë dhe sqarimi më i saktë, sepse gjykimi i Zotit dhe i Profetit të Tij është gjykimi më i drejtë dhe më i mirë për njerëzit, për çështjet e fesë, dynjasë dhe të ardhmërisë së tyre.

Ajetet 60 – 63

60. A nuk i ke parë ata që pohojnë se e besojnë Shpalljen që të është dhënë ty *(o Muhamed)* dhe Shpalljet e ardhura para teje, por që dëshirojnë që mes tyre të gjykojë *tagut*-i, ndërkohë që janë urdhëruar ta mohojnë atë. Shejtani dëshiron t'i çojë ata shumë larg nga e vërteta.
61. Kur u thuhet atyre: "Ejani tek Shpallja që ka sjellë Allahu dhe tek i Dërguari!", munafikët të kthejnë shpinën.
62. Si do të jetë gjendja e tyre kur t'i godasë gjëma, për shkak të veprave që kanë bërë vetë, me duart e tyre, e të vinë te ti, *(e të thonë)* duke u betuar në Allahun: "Ne kemi dëshiruar veçse bamirësi e pajtim"?!
63. Këta janë ata të cilëve Allahu ua di çfarë kanë në zemrat e tyre. Por ti distancohu prej tyre, qortoji dhe thuaju fjalë që prekin zemrat.

Shpjegimi i ajeteve

- "A nuk i ke parë ata që pohojnë se e besojnë Shpalljen që të është dhënë ty *(o Muhamed)* dhe Shpalljet e ardhura para teje, por që dëshirojnë që mes tyre të

gjykojë *tagut*-i, ndërkohë që janë urdhëruar ta mohojnë atë?" - Allahu i Lartësuar sjell një pyetje, që shpreh habi njëkohësisht dhe që tregon për gjendjen e çuditshme të munafikëve, të cilët, edhe pse pretendojnë se e besojnë Shpalljen që iu dha Profetit (a.s.), përsëri kërkojnë të gjykohen tek *tagut*-i. Çdokush që gjykon jo me ligjin e Zotit është *tagut*. Pra, ata e kryejnë një krim të tillë, ndërkohë që janë urdhëruar për të kundërtën: që ta mohojnë dhe të distancohen nga *tagut*-i. Si mund të ndodhen në të njëjtën zemër besimi te *tagut*-i me besimin te Zoti i Lartësuar?! Besimi i vërtetë kërkon që t'i nënshtrohesh ligjit të Zotit, ta zbatosh dhe ta marrësh për bazë atë në çdo lloj çështjeje. Çdokush që pretendon se është besimtar dhe pastaj parapëlqen gjykimin e *tagut*-it kundrejt gjykimit të Zotit, ai është gënjeshtar. Ky nuk është gjë tjetër, por veçse një devijim i madh, që Shejtani u ka shkaktuar atyre. Për këtë arsye, i Lartësuari thotë:

- "Shejtani dëshiron t'i çojë ata shumë larg nga e vërteta." – Pra, ai i mallkuari dëshiron t'i largojë shumë nga e vërteta e Zotit dhe që të bëhen banorë të Zjarrit.

- "Kur u thuhet atyre: "Ejani tek Shpallja që ka sjellë Allahu dhe tek i Dërguari!", munafikët të kthejnë shpinën." – pra nuk pranojnë që të gjykojnë me ligjin e Zotit dhe traditën e Profetit të Tij.

- "Si do të jetë gjendja e tyre kur t'i godasë gjëma, për shkak të veprave që kanë bërë vetë, me duart e tyre, e të vinë te ti, *(e të thonë)* duke u betuar në Allahun: "Ne kemi dëshiruar veçse bamirësi e pajtim"?!" – Kuptimi: Mos do t'u bëjë dobi, vallë, fakti që vijnë tek ti dhe betohen se dëshirojnë veçse të mirën?! Patjetër që kjo është një gënjeshtër e pacipë e tyre, sepse e mira dhe e drejta gjenden vetëm në gjykimin me ligjin e Zotit dhe në nënshtrimin ndaj tij. E vetmja rrugë për të arritur mirësinë dhe drejtësinë është zbatimi i porosive të Zotit dhe të Profetit, e jo gjykimi sipas *tagut*-it. I Lartësuari thotë në një ajet tjetër: "E cili është më i mirë se Allahu në gjykim, për një popull besimtar?"

Por Allahu i Lartësuar, edhe pse ata shfajësohen dhe justifikohen me lloj-lloj arsyetimesh, e di se çfarë fshehin zemrat e tyre, prandaj thotë:

- "Këta janë ata të cilëve Allahu ua di çfarë kanë në zemrat e tyre. Por ti distancohu prej tyre, qortoji dhe thuaju fjalë që prekin zemrat." – Pra, i Gjithëdijshmi ua di qëllimet e zeza që fshehin në shpirt dhe hipokrizinë me të cilën janë mbushur. Ai na këshillon që të distancohemi prej tyre. Thjesht, mos u kushto rëndësi dhe shpërfilli ata! Megjithatë, përsëri këshilloji dhe qortoji, duke u treguar gjykimin e Zotit të Lartësuar, dhe nxiti për të punuar dhe për t'iu nënshtruar Atij. Gjithashtu, paralajmëroji për ndëshkimin që i pret nëse e braktisin gjykimin e Zotit. Ndoshta këshilloji veçmas për të vërtetën, se kështu është më mirë dhe ka më tepër mundësi të dalë me sukses.

Ky ajet dëshmon se, edhe pse duhet të distancohesh prej atyre që bëjnë vepra të rënda, ata përsëri duhen këshilluar e qortuar fshehtas, që të arrihet qëllimi kryesor, pra, ndreqja dhe kthimi i tyre në rrugën e drejtë.

Ajetet 64 – 65

64. Të gjithë profetët i kemi sjellë veçse që ju t'u bindeni, me lejen e Allahut. E sikur ata, pas padrejtësive që i bënë vetes së tyre, të vinin tek ti e t'i kërkonin falje Allahut, dhe i Dërguari të kërkonte falje *(tek Allahu)* për ta, ata do ta njihnin Allahun si Pranues të pendimit dhe Mëshirues.
65. Për Zotin tënd, jo, ata nuk janë besimtarë, përderisa nuk të zgjedhin ty për të gjykuar në konfliktet mes tyre, dhe përderisa më pas të mos ndiejnë pakënaqësi nga gjykimi yt, por të të binden sinqerisht.

Shpjegimi i ajeteve

- "Të gjithë profetët i kemi sjellë veçse që ju t'u bindeni, me lejen e Allahut." – Ky kumt i Allahut të Lartësuar përmban në vetvete edhe porosinë për bindje ndaj Profetit të Zotit dhe pranim e zbatim të mësimeve të tij. Qëllimi i dërgimit të një profeti është që njerëzit t'i binden duke zbatuar porositë e Zotit. Njerëzit duhet të zbatojnë çdo urdhër të tijin, t'i largohen çdo ndalese të deklaruar nga ai, të jenë respektues dhe ta ndihmojnë rrugën e tij.

Ky ajet tregon se profetët kanë qenë të ruajtur, prandaj kurrë nuk mund të gabonin në lidhje me Shpalljen hyjnore dhe përcjelljen e plotë dhe të saktë të saj, Ata kurrë nuk mund të gabonin me urdhrat dhe ndalesat e përcjella, sepse Allahu i Lartësuar na ka urdhëruar që t'u bindemi atyre. Nëse ata nuk do të ishin të ruajtur nga këto gabime dhe nëse do të kishte mundësi që ata të urdhëronin diçka të gabuar, atëherë Allahu i Lartësuar nuk do të na urdhëronte për t'iu bindur atyre.

Për sa i përket shprehjes: "me lejen e Allahut", ajo dëshmon se çdo gjë ndodh me gjykimin dhe caktimin e Allahut. Ata që iu bindën profetëve, iu bindën sepse kështu qe gjykimi dhe caktimi i Allahut.

Ky ajet është gjithashtu një nxitje për të kërkuar gjithmonë ndihmën e Allahut, që të na bëjë të bindur ndaj Profetit dhe pasues të rrugës së tij. Vetëm nëse Allahu të ndihmon, mund t'i bindesh Profetit dhe të pasosh rrugën e drejtë.

Pastaj Allahu i Lartësuar flet për bujarinë, mirësinë dhe mëshirën e Tij të madhe ndaj atyre që kanë bërë gjynahe, nëse ata pendohen dhe nëse i kërkojnë falje Atij. Ai thotë:

- "E sikur ata, pas padrejtësive që i bënë vetes së tyre, të vinin tek ti e t'i kërkonin falje Allahut, dhe i Dërguari të kërkonte falje *(tek Allahu)* për ta, ata do ta njihnin Allahun si Pranues të pendimit dhe Mëshirues." – Pra, nëse ata i pranojnë gjynahet e tyre dhe u vjen keq për to, dhe pastaj i kërkojnë falje Allahut të Lartësuar, Ai do t'ua pranojë pendimin, duke ua falur dhe mbuluar gabimet. Kështu, Ai i mëshiron fillimisht me suksesin që u jep për t'u penduar dhe, së dyti, duke ua pranuar pendimin dhe duke iu dhuruar shpërblim.

Ndërsa për sa i përket vajtjes te Pejgamberi (a.s.), që ai t'i kërkojë falje Allahut të Lartësuar për gjynahet e tua, kjo ishte e lejueshme atëherë kur ai ishte në këtë dynja. Këtë e tregon qartë konteksti i ajetit. Pra, të shkosh e t'i kërkosh Profetit (a.s.) që ai t'i lutet Allahut për faljen e gjynaheve të tua është një veprim që mund të mendohej veçse gjatë kohës kur Pejgamberi (a.s.) ishte gjallë, sepse tani që ai nuk është më në këtë botë nuk lejohet të kërkosh asgjë prej tij. Madje, ky veprim është një formë *shirk*-u, pasi ti i je lutur dikujt tjetër veç Allahut.

- "Për Zotin tënd, jo, ata nuk janë besimtarë, përderisa nuk të zgjedhin ty për të gjykuar në konfliktet mes tyre..." - Allahu i Lartësuar betohet në Veten e Vet, se njerëzit nuk do të jenë kurrë besimtarë derisa për çdo çështje të tyre të gjykojnë me ligjin e Tij, të sjellë prej Profetit (a.s.). Pra, për çdo rast kundërshtish, është detyrë që ne t'i kthehemi Librit të Zotit dhe Traditës së Profetit (a.s.).

- "...dhe përderisa më pas të mos ndiejnë pakënaqësi nga gjykimi yt, por të të binden sinqerisht." – Pra, përveç që duhet të mbështetemi në gjykimin e Zotit dhe të Profetit (a.s.), ne nuk duhet që të ndiejmë pakënaqësi më mbrapa. Me fjalë të tjera, jo vetëm që duhet të gjykojmë me ligjin e Zotit, por edhe duhet të kënaqemi plotësisht me të. Në fakt, këtu kemi të bëjmë me tri grada të besimit:

1. Kur gjykojmë me ligjin e Zotit, jemi në gradën e *islamit*.
2. Kur nuk ndiejmë pakënaqësi pas këtij gjykimi, tregon se jemi në gradë të *imanit*.
3. Gjetja e qetësisë, prehjes dhe kënaqësisë me ligjin e Zotit dhe zbatimi haptaz i tij tregon se jemi në gradën e *ihsanit*.

Kush i arrin të tria gradat, e ka besimin të plotë. Kush e braktis gjykimin e Zotit dhe nuk e pranon atë, ai është qafir. Ndërsa kush nuk e zbaton atë, por e pranon si ligj të Zotit dhe e njeh detyrimin për zbatimin e tij, ai është gjynahqar.


Ajetet 66 – 70

66. Sikur Ne t'i urdhëronim ata: "Vritni veten!", apo: "Largohuni prej atdheut tuaj!", ata nuk do ta zbatonin, përveç ndonjë pakicë e tyre. Nëse ata do t'i zbatonin porositë e dhëna, kjo do të ishte më mirë për ta dhe do t'i forconte më shumë.
67. Atëherë, Ne, pa dyshim, do t'u jepnim atyre shpërblim të madh nga ana Jonë...
68. dhe do t'i udhëzonim në rrugë të drejtë.
69. Kushdo që i bindet Allahut dhe të Dërguarit, do të jetë me ata të cilëve Allahu u ka dhuruar mirësi të shumta: me profetët, me të sinqertët, me dëshmorët dhe me vepërmirët. Sa shokë të mirë janë ata!
70. Ky shpërblim i madh është prej Allahut. Mjafton që Allahu është i Gjithëdijshëm!

Shpjegimi i ajeteve

- "Sikur Ne t'i urdhëronim ata: "Vritni veten!", apo: "Largohuni prej atdheut tuaj!", ata nuk do ta zbatonin, përveç ndonjë pakicë e tyre." - Allahu i Lartësuar na tregon se, nëse do të na ngarkonte me përgjegjësi të vështira, siç janë lufta apo lënia e pasurive dhe e vendeve tona, atëherë, përveç një pakice, askush nuk do t'i bindej dhe nuk do të arrinte t'i kryente këto detyrime. Kështu, kjo është një nxitje për të falënderuar, lavdëruar dhe treguar mirënjohje ndaj Allahut të Lartësuar për lehtësimin e fesë, të cilën na e ka ngarkuar ta zbatojmë. Kjo është një fe e thjeshtë dhe e mundshme të zbatohet nga çdokush.

Ky ajet tregon se, kur besimtari sheh gjendjen e tij të mirë dhe veprat e tij prej adhuruesi, dhe pastaj sheh veprat dhe


الجزء الخامس سورة النساء
وَلَوْ أَنَّا كَتَبْنَا عَلَيْهِمْ أَنِ اقْتُلُوٓا۟ أَنفُسَكُمْ أَوِ اخْرُجُوا۟ مِن
دِيَٰرِكُم مَّا فَعَلُوهُ إِلَّا قَلِيلٌ مِّنْهُمْ ۖ وَلَوْ أَنَّهُمْ فَعَلُوا۟ مَا يُوعَظُونَ
بِهِۦ لَكَانَ خَيْرًا لَّهُمْ وَأَشَدَّ تَثْبِيتًا ﴿٦٦﴾ وَإِذًا لَّـَٔاتَيْنَٰهُم
مِّن لَّدُنَّآ أَجْرًا عَظِيمًا ﴿٦٧﴾ وَلَهَدَيْنَٰهُمْ صِرَٰطًا مُّسْتَقِيمًا
﴿٦٨﴾ وَمَن يُطِعِ ٱللَّهَ وَٱلرَّسُولَ فَأُو۟لَٰٓئِكَ مَعَ ٱلَّذِينَ أَنْعَمَ ٱللَّهُ
عَلَيْهِم مِّنَ ٱلنَّبِيِّـۧنَ وَٱلصِّدِّيقِينَ وَٱلشُّهَدَآءِ وَٱلصَّٰلِحِينَ ۚ
وَحَسُنَ أُو۟لَٰٓئِكَ رَفِيقًا ﴿٦٩﴾ ذَٰلِكَ ٱلْفَضْلُ مِنَ ٱللَّهِ ۚ وَكَفَىٰ
بِٱللَّهِ عَلِيمًا ﴿٧٠﴾ يَٰٓأَيُّهَا ٱلَّذِينَ ءَامَنُوا۟ خُذُوا۟ حِذْرَكُمْ
فَٱنفِرُوا۟ ثُبَاتٍ أَوِ ٱنفِرُوا۟ جَمِيعًا ﴿٧١﴾ وَإِنَّ مِنكُمْ لَمَن لَّيُبَطِّئَنَّ
فَإِنْ أَصَٰبَتْكُم مُّصِيبَةٌ قَالَ قَدْ أَنْعَمَ ٱللَّهُ عَلَىَّ إِذْ لَمْ أَكُن
مَّعَهُمْ شَهِيدًا ﴿٧٢﴾ وَلَئِنْ أَصَٰبَكُمْ فَضْلٌ مِّنَ ٱللَّهِ لَيَقُولَنَّ كَأَن
لَّمْ تَكُۢنۢ بَيْنَكُمْ وَبَيْنَهُۥ مَوَدَّةٌ يَٰلَيْتَنِى كُنتُ مَعَهُمْ
فَأَفُوزَ فَوْزًا عَظِيمًا ﴿٧٣﴾ * فَلْيُقَٰتِلْ فِى سَبِيلِ ٱللَّهِ ٱلَّذِينَ
يَشْرُونَ ٱلْحَيَوٰةَ ٱلدُّنْيَا بِٱلْءَاخِرَةِ ۚ وَمَن يُقَٰتِلْ فِى سَبِيلِ
ٱللَّهِ فَيُقْتَلْ أَوْ يَغْلِبْ فَسَوْفَ نُؤْتِيهِ أَجْرًا عَظِيمًا ﴿٧٤﴾
٨٩

gjendjen e të humburve, që janë jashtë rruge, ai duhet t'i jetë mirënjohës për këtë Zotit të Lartësuar.

- "Nëse ata do t'i zbatonin porositë e dhëna, kjo do të ishte më mirë për ta dhe do t'i forconte më shumë." – Pra, nëse njerëzit do të zbatonin porositë e Zotit, në çdo kohë e gjendje dhe me vullnet të plotë e dëshirë për t'i kryer në formën më të plotë të mundshme, atëherë shpirtrat e tyre do të ishin të sigurt.

Njeriu duhet të përqendrohet tërësisht në çështjet e rëndësishme nëpërmjet të cilave kryhet dhe arrihet adhurimi i Zotit dhe zbatimi i porosive të Tij, si dhe të shpenzojë të gjitha aftësitë e veta për t'i përkryer ato, sepse në varësi të përpjekjeve të sinqerta në këto drejtime, atij i janë premtuar shumë mirësi. Mirësitë e Zotit nuk mund të arrihen me dembelizëm.

Shih se çfarë u premtohet të sinqertëve dhe punëtorëve të palodhur, që përpiqen

maksimalisht për të plotësuar porositë e Zotit të tyre:

Së pari, "kjo do të ishte më mirë për ta", domethënë, do të jenë prej vepërmirëve, sepse kanë cilësitë, fjalët dhe veprat që i karakterizojnë të mirët, të cilët u binden urdhrave dhe u largohen ndalesave. Po ashtu, ata nuk kanë cilësitë e të këqijve, sepse kur dikush ka cilësi të mira, kjo tregon se është i ruajtur nga të kundërtat e tyre.

Së dyti, "do t'i forconte më shumë". Pra, për ta premtohet përqendrim dhe forcim në fenë e Zotit. Për shkak të veprave të mira, Allahu i Lartësuar ua përforcon edhe më shumë besimin dhe i ndihmon që të jenë të përqendruar në rrugën e drejtë. Besimtarët i zbatojnë porositë e Zotit dhe të Profetit të Tij, prandaj ata forcohen në jetën e kësaj bote që të jenë të qëndrueshëm në besim edhe kur goditen nga sprovat. Në çdo kohë dhe çdo gjendje, me ndihmën e Zotit të tyre, ata do të jenë plotësisht të durueshëm për të zbatuar urdhrat, për t'iu larguar ndalesave, si dhe për t'i qëndruar si besimtarë në momente sprovash. Edhe në fatkeqësi, ata shprehin kënaqësinë me caktimin e Zotit. Ata i ndihmon Zoti që të vazhdojnë në këtë rrugë, e pastaj të shpërblehen me të mira e të shpëtojnë nga të këqijat, për shkak të besimit dhe përpjekjeve të tyre për të punuar dhe jetuar sipas këtij besimi. Madje, kjo ndihmë nuk vjen vetëm në jetën e dynjasë. Ajo do t'u jepet besimtarëve edhe në momentin e vdekjes, por edhe në varr, kur të merret në pyetje.

Gjithashtu, nëse robi përpiqet vazhdimisht që të jetojë dhe punojë sipas porosive të Zotit të tij, kjo sjellje do t'i bëhet natyrë e tij, dhe kështu ai do të ndiejë mall dhe kënaqësi me adhurimet dhe me mënyrën e jetesës si besimtar. Pra, edhe në këtë këndvështrim, ata që jetojnë dhe punojnë për të zbatuar porositë e Allahut të Lartësuar do të jenë të përqendruar dhe të patundur në bindjen ndaj Tij.

- "Atëherë, Ne, pa dyshim, do t'u jepnim atyre shpërblim të madh nga ana Jonë..." - Allahu i Lartësuar premton për ata që punojnë maksimalisht dhe sinqerisht për të plotësuar porositë e Tij se do t'u japë një shpërblim të madh. Ky shpërblim do t'u jepet në dynja dhe në ahiret, i tillë që të kënaqet jo vetëm trupi, por edhe shpirti. Sigurisht që shpërblimi në Xhenetin e përjetësisë është më i mrekullueshëm. Atje ka gjëra që syri nuk i ka parë, që veshi nuk i ka dëgjuar dhe që zemra nuk i ka menduar e ëndërruar.

- "...dhe do t'i udhëzonim në rrugë të drejtë." – Këtu Allahu i Lartësuar thekson edhe një herë se atyre që punojnë dhe përpiqen për të zbatuar porositë e Tij, Ai do t'ua forcojë udhëzimin në rrugën e drejtë. Kjo tregon se sa rëndësi ka të jesh i udhëzuar në rrugën e drejtë.

Për Zotin, kjo është mirësia më e madhe që Ai u ka dhuruar besimtarëve. Nuk ka mirësi më të madhe sesa Zoti të të udhëzojë në rrugën e drejtë, që ta adhurosh sipas mënyrës që Ai e dëshiron dhe kënaqet. Kjo rrugë e drejtë është e ndërtuar mbi dije të saktë, të vërtetë e të sigurt, mbi dashurinë për Allahun e Lartësuar dhe për adhurimin e Tij. Pasuesit e kësaj rruge ndihmohen nga Allahu i Lartësuar për t'i dhënë përparësi çdo gjëje që e kënaq Atë. Lumturia dhe shpëtimi nga çdo e keqe janë të kushtëzuara vetëm me pasimin e kësaj rruge të drejtë. Kush është udhëzuar në rrugën e drejtë, atij i është dhënë e gjithë mirësia dhe është shpëtuar nga çdo e keqe.

Në përfundim, e lus Allahun të na ndihmojë që t'i bindemi dhe që të zbatojmë porositë e Tij!

- "Kushdo që i bindet Allahut dhe të Dërguarit, do të jetë me ata të cilëve Allahu u ka dhuruar mirësi të shumta: me profetët, me të sinqertët, me dëshmorët dhe me vepërmirët. Sa shokë të mirë janë ata!" - Çdokush që i bindet Allahut dhe Profetit të Tij, qoftë mashkull apo femër, do të jetë së

bashku me ata të cilët Allahu i begatoi me plot të mira.

Por cilët janë ata që Zoti i ka begatuar me shumë të mira?

Ata janë, së pari, profetët, të cilët Zoti i privilegjoi me Shpalljen, duke i bërë udhërrëfyes të njerëzimit për në rrugën e Zotit.

Pastaj janë *siddikun*-ët, domethënë të sinqertët ose të vërtetët, të cilët kanë besuar plotësisht, pa as më të voglin dyshim, gjithçka që kanë predikuar profetët. Ata e kanë njohur të vërtetën, e kanë pranuar, pohuar dhe besuar atë, kanë punuar dhe jetuar sipas këtij besimi dhe, pasi e kanë plotësuar veten, kanë ftuar edhe të tjerët në rrugën e lumturisë.

Më pas vijnë dëshmorët, ata të cilët kanë luftuar dhe janë përpjekur në rrugën e Zotit, që të lartësohet fjala dhe feja e Tij, dhe që kanë dhënë jetën për këtë kauzë të lartë.

Të tjerët janë vepërmirët, pra, ata të cilët kanë punuar në zbatim të porosive të Zotit dhe të Profetit. Fjalët dhe veprat e tyre janë të mira sepse bazohen në këto porosi dhe kryen me sinqeritet vetëm për të kënaqur Zotin.

Si përfundim, çdokush që i bindet Allahut dhe Profetit në kryerjen e urdhrave dhe largimin nga ndalesat, ka premtimin se do të jetë i nderuar duke qenë bashkë me të gjithë të lartpërmendurit.

- "Ky shpërblim i madh është prej Allahut." – Pra, shoqërimi me ta në Xhenet do të jetë një lumturi e madhe. Atje do të qëndrojnë përjetësisht pranë Zotit të botëve. Kjo është një dhuratë pikërisht nga Zoti i Lartësuar. Është Ai që u jep sukses dhe i ndihmon që të jenë të tillë dhe, pas kësaj, u dhuron shpërblim të shumëfishuar nga bujaria dhe mëshira e Tij, shpërblim të cilin kurrë nuk do ta arrinin me punën e tyre.

- "Mjafton që Allahu është i Gjithëdijshëm!" - Kjo është një këshillë dhe nxitje që të përpiqemi maksimalisht për plotësimin e porosive të Zotit, në mënyrë që Ai të na përforcojë në këtë rrugë. Allahu i Lartësuar është i Gjithëdijshëm dhe i Urtë. Ai e di se cilët meritojnë shpërblim të madh, domethënë se cilët punojnë të mbështetur në dije dhe në fe të saktë dhe cilët punojnë me sinqeritet, për të kënaqur Krijuesin e tyre.

Ajetet 71 – 74

71. O ju që keni besuar, rrini në gatishmëri dhe dilni *(në luftë)* grup pas grupi ose të gjithë së bashku.
72. Me të vërtetë, ka disa prej jush që bishtnojnë. Nëse juve ju godet ndonjë fatkeqësi, ata thonë: "Zoti më favorizoi që nuk isha bashkë me ta!".
73. Por nëse juve ju vjen ndonjë e mirë nga Allahu, ata, – a thua se mes jush dhe atyre nuk ekziston ndonjë lloj dashurie – me siguri do të thoshin: "Ah, sikur të kisha qenë së bashku me ta e të kisha arritur një fitim të madh!"
74. Le të luftojnë në rrugën e Allahut ata që e japin jetën e kësaj bote për botën tjetër. Kush lufton në rrugën e Allahut e vritet ose fiton, Ne, me siguri, do t'i japim atij shpërblim të madh.

Shpjegimi i ajeteve

Allahu i Lartësuar i urdhëron adhuruesit e Tij besimdrejtë që të ruhen dhe të jenë vigjilentë ndaj qafirëve. Kjo është porosi për të marrë të gjitha masat e mundshme për t'u ruajtur prej të keqes së tyre. Duhen shfrytëzuar të gjitha mënyrat për të qenë plotësisht në gjendje që t'i luftosh qafirët dhe që të mbrohesh nga të gjitha anët prej tyre. Në përgatitje hyjnë fortifikimi i vendit, mësimi i artit luftarak, mësimi i të gjitha mënyrave të mbrojtjes, njohja dhe zbulimi i çdo gjëje që ka lidhje me armikun, gatishmëria për të luftuar në rrugën e Zotit etj. Kështu, Zotit thotë:

- "O ju që keni besuar, rrini në gatishmëri dhe dilni *(në luftë)* grup pas grupi ose të

gjithë së bashku." – Kuptimi: Jini të gatshëm që të nisni luftën, qoftë në formë skuadrash të vogla, qoftë të gjithë së bashku, në varësi të nevojës dhe dobisë së Islamit dhe muslimanëve.

Ky ajet është i ngjashëm me një ajet tjetër, ku thuhet: "Përgatituni kundër tyre sa të keni mundësi, duke shtuar fuqinë e kuajt të caktuar për betejë, në mënyrë që ta frikësoni armikun e Allahut dhe armikun tuaj, si dhe të tjerë, për të cilët ju nuk dini gjë, por Allahu di për ata. Çfarëdo që të shpenzoni për rrugën e Allahut, ajo do t'ju kompensohet dhe nuk do t'ju bëhet padrejtësi."

Pastaj Allahu i Lartësuar na flet rreth atyre që kanë iman të dobët e të cilët tregohen të plogësht ndaj luftës në rrugën e Tij. Ai thotë:

- "Me të vërtetë, ka disa prej jush që bishtnojnë." – Kuptimi: Janë disa prej jush, o besimtarë, të cilët tregohen të dobët, frikacakë dhe i bëjnë bisht xhihadit në rrugën e Zotit.

Pra, sipas nesh, këtu bëhet fjalë për besimtarët me besim të dobët. Disa janë të mendimit se këtu flitet për ata që i nxisin të tjerët të mos luftojnë, domethënë për munafikët. Por shpjegimi i parë është më i saktë, për dy arsye:

Së pari, Allahu i Lartësuar thotë: "ka disa prej jush...", pra, Ai u drejtohet besimtarëve.

Së dyti, Allahu i Lartësuar thotë: "...a thua se mes jush dhe atyre nuk ekziston ndonjë lloj dashurie." Dhe dihet se Allahu i Lartësuar e ka larguar nga besimtarët dashurinë për qafirët dhe munafikët afërsinë me ta. Kësisoj, në këtë ajet nuk flitet për jobesimtarët dhe hipokritët.

Pastaj, këtë fakt e vërteton edhe realiteti, sepse besimtarët ndahen në dy kategori:

1. Besimtarë të fortë, me besim të sinqertë dhe të plotë, që i bën ata të punojnë e luftojnë në rrugën e Zotit.

2. Besimtarë të dobët, që e kanë pranuar Islamin, por që kanë në zemër besim të vagët dhe të pamjaftueshëm për të luftuar në rrugën e Zotit. Ja si thotë i Lartësuari në një ajet: "Beduinët thanë: "Ne kemi besuar!" Thuaju: "Ju nuk keni besuar ende, por thoni: "Ne jemi dorëzuar", se besimi nuk ka hyrë ende në zemrat tuaja".

Pastaj Allahu i Lartësuar na tregon arsyen e këtyre njerëzve me besim të dobët, duke na qartësuar se qëllimi i tyre i vërtetë është dynjaja dhe pasuritë e saj:

- "Nëse juve ju godet ndonjë fatkeqësi, ata thonë: "Zoti më favorizoi që nuk isha bashkë me ta!"" – Pra, nëse besimtarët humbasin, lëndohen apo vriten në luftë, gjëra që ndodhin vetëm me lejen dhe urtësinë e Zotit, ata thonë: "Zoti na privilegjoi, që nuk ishim atje në luftë bashkë me ta.".

Për shkak të imanit të tyre të dobët, ata mendojnë se mosmarrja pjesë e tyre në xhihad, – në të cilin mund të pësohet edhe disfatë, – është një mirësi nga Zoti. Ata nuk arrijnë ta kuptojnë se mirësia e vërtetë është pikërisht suksesi që të jep Zoti të marrësh pjesë në xhihad, në këtë adhurim kaq të madh, në të cilin kalitet imani i sinqertë dhe për shkak të të cilit njeriu sigurohet dhe shpëton njëherë e mirë nga ndëshkimi, dëshpërimi dhe humbja. Atij që i jepet shansi të marrë pjesë në një adhurim të tillë, me të vërtetë i është hapur një rrugë drejt shpërblimit të madh dhe kënaqësisë së Allahut të Lartësuar, Bujarit, Dhuruesit të çdo mirësie. Mosmarrja pjesë në xhihad, edhe pse mund t'i ofrojë njeriut një rehati të përkohshme, pas saj atë e pret një lodhje e gjatë, dhimbje të shumta e vuajtje të rënda dhe, veç këtyre, ai është i privuar nga ato mirësi që i janë premtuar vetëm luftëtarëve në rrugën e Zotit. Pastaj i Lartësuari thotë:

- "Por nëse juve ju vjen ndonjë e mirë nga Allahu, ata, – a thua se mes jush dhe atyre nuk ekziston ndonjë lloj dashurie – me siguri do të thoshin: "Ah, sikur të kisha qenë së bashku me ta e të kisha arritur një fitim të madh!"" – Pra, nëse besimtarët

fitojnë në ndonjë luftë, atëherë edhe ata do të dëshironin të kishin marrë pjesë në atë luftë, me qëllim që të kishin përfituar edhe ata prej plaçkës së kapur. Kështu, ata synojnë veç fitimin material të kësaj bote.

- "a thua se mes jush dhe atyre nuk ekziston ndonjë lloj dashurie" – Pra, ata shprehen ashtu, sikur të mos ekzistonte mes tyre dhe besimtarëve ndonjë lidhje, siç është lidhja e besimit.

Dihet se besimtarët janë si një trup i vetëm, që kujdesen për t'i mundësuar njëri-tjetrit çdo të mirë dhe për t'u ruajtur nga çdo e keqe. Ata gëzohen me të mirat që i mundësojnë bashkësisë së tyre dhe trishtohen për problemet që mund të kenë të tjerët. Të gjithë përpiqen që të arrijnë çdo gjë që rregullon çështjet e fesë dhe të jetës së tyre. Atëherë, ata të cilët dëshirojnë veç dynjanë nuk e kanë këtë solidaritet dhe dashuri të ndërsjelltë që duhet të kenë besimtarët e vërtetë.


Megjithatë, Allahu i Lartësuar është shumë i Butë, i Dashur dhe i Mëshirshëm me robërit e Tij. Ai kurrë nuk ua këput shpresën dhe kurrë nuk ua mbyll portat e kthimit dhe afrimit tek Ai. Për këtë arsye, ata që bëjnë diçka jo të denjë për një besimtar, Ai i fton dhe i ndihmon që të plotësojnë dhe ndreqin mangësitë e tyre dhe ta përsosin veten me cilësitë e duhura për një besimtar. Kështu, i Lartësuari i urdhëron këta njerëz për sinqeritet dhe i nxit që të dalin e të luftojnë në rrugën e Tij:

- "Le të luftojnë në rrugën e Allahut ata që e japin jetën e kësaj bote për botën tjetër. Kush lufton në rrugën e Allahut e vritet ose fiton, Ne, me siguri, do t'i japim atij shpërblim të madh." - Ky është njëri nga kuptimet dhe shpjegimet e ajetit. Pra, Allahu i Lartësuar i fton të gjithë besimtarët, mes të cilëve edhe ata me iman të dobët, që të përpiqen të plotësojnë vetveten, të ndreqin gabimet dhe mangësitë e tyre, të kultivojnë sinqeritetin, si dhe të përpiqen e të luftojnë në rrugën e Tij.

Kuptimi i dytë i ajetit është: Le të luftojnë në rrugën e Zotit besimtarët që kanë iman të plotë dhe të sinqertë, të cilët e shesin dynjanë, duke treguar mosinteresim për të, dhe kërkojnë ahiretin, për rëndësinë e madhe që ka ai në zemrat e tyre. Pra, vetëm atyre u drejtohet ky urdhër, sepse vetëm ata e përgatisin shpirtin e tyre për xhihad, ndërsa nxitësi është imani i tyre i plotë.

Ndërsa ata që e kanë imanin e dobët dhe ngurrojnë që të luftojnë në rrugën e Zotit, ata nuk kanë ndonjë peshë: me ta është njëlloj, dalin apo jo në luftë, sepse nuk luajnë ndonjë rol, siç thotë Allahu i Lartësuar në një ajet tjetër: "Thuaju: "E besoni ju atë *(Kur'ânin)* apo nuk e besoni, kur ai u lexohet atyre që u është dhënë dituria para se vinte ai *(Kur'âni)*, ata bien me fytyrë përdhe duke bërë sexhde dhe thonë: "I Lartësuar është Zoti ynë! Premtimi i Zotit tonë është realizuar." Duke qarë, ata bien me fytyrë përdhe, ndërkohë që ai *(Kur'âni)* ua shton edhe më shumë përuljen atyre." [Isra 107-109].

Disa të tjerë thonë se kuptimi i ajetit është: Le të luftojnë muxhahidët në rrugën e Allahut, ata të cilët e blejnë ahiretin duke shitur jetën e dynjasë. Pra, bëhet fjalë për të gjithë ata që luftojnë dhe përpiqen në rrugën e Zotit, duke zbatuar urdhrin e Tij dhe të Profetit të Tij, me sinqeritet të plotë vetëm për të kënaqur dhe adhuruar Atë, Zotin e gjithësisë. Pra, kësaj kategorie luftëtarësh, nëse vriten ose nëse fitojnë betejat, Allahu i Lartësuar u premton shpërblim të madh. Nëse fitojnë luftën dhe shpëtojnë gjallë, atyre do t'u shtohet dhe do t'u plotësohet besimi, do të fitojnë plaçkë lufte, si edhe do të kenë emër të mirë mes njerëzve. Ndërsa në jetën tjetër, Zoti ka rezervuar për ta mirësi që syri nuk i ka parë, veshi nuk i ka dëgjuar dhe zemra e askujt nuk i ka menduar e përfytyruar.


الجزء الخامس سورة النساء

وَمَا لَكُمْ لَا تُقَٰتِلُونَ فِى سَبِيلِ ٱللَّهِ وَٱلْمُسْتَضْعَفِينَ مِنَ ٱلرِّجَالِ
وَٱلنِّسَآءِ وَٱلْوِلْدَٰنِ ٱلَّذِينَ يَقُولُونَ رَبَّنَآ أَخْرِجْنَا مِنْ هَٰذِهِ ٱلْقَرْيَةِ
ٱلظَّالِمِ أَهْلُهَا وَٱجْعَل لَّنَا مِن لَّدُنكَ وَلِيًّا وَٱجْعَل لَّنَا مِن لَّدُنكَ نَصِيرًا
٧٥ ٱلَّذِينَ ءَامَنُوا۟ يُقَٰتِلُونَ فِى سَبِيلِ ٱللَّهِ ۖ وَٱلَّذِينَ كَفَرُوا۟ يُقَٰتِلُونَ فِى
سَبِيلِ ٱلطَّٰغُوتِ فَقَٰتِلُوٓا۟ أَوْلِيَآءَ ٱلشَّيْطَٰنِ ۖ إِنَّ كَيْدَ ٱلشَّيْطَٰنِ
كَانَ ضَعِيفًا ٧٦ أَلَمْ تَرَ إِلَى ٱلَّذِينَ قِيلَ لَهُمْ كُفُّوٓا۟ أَيْدِيَكُمْ وَأَقِيمُوا۟
ٱلصَّلَوٰةَ وَءَاتُوا۟ ٱلزَّكَوٰةَ فَلَمَّا كُتِبَ عَلَيْهِمُ ٱلْقِتَالُ إِذَا فَرِيقٌ مِّنْهُمْ
يَخْشَوْنَ ٱلنَّاسَ كَخَشْيَةِ ٱللَّهِ أَوْ أَشَدَّ خَشْيَةً ۚ وَقَالُوا۟ رَبَّنَا لِمَ كَتَبْتَ
عَلَيْنَا ٱلْقِتَالَ لَوْلَآ أَخَّرْتَنَآ إِلَىٰٓ أَجَلٍ قَرِيبٍ ۗ قُلْ مَتَٰعُ ٱلدُّنْيَا قَلِيلٌ
وَٱلْءَاخِرَةُ خَيْرٌ لِّمَنِ ٱتَّقَىٰ وَلَا تُظْلَمُونَ فَتِيلًا ٧٧ أَيْنَمَا تَكُونُوا۟
يُدْرِككُّمُ ٱلْمَوْتُ وَلَوْ كُنتُمْ فِى بُرُوجٍ مُّشَيَّدَةٍ ۗ وَإِن تُصِبْهُمْ حَسَنَةٌ
يَقُولُوا۟ هَٰذِهِۦ مِنْ عِندِ ٱللَّهِ ۖ وَإِن تُصِبْهُمْ سَيِّئَةٌ يَقُولُوا۟ هَٰذِهِۦ مِنْ
عِندِكَ ۚ قُلْ كُلٌّ مِّنْ عِندِ ٱللَّهِ ۖ فَمَالِ هَٰٓؤُلَآءِ ٱلْقَوْمِ لَا يَكَادُونَ يَفْقَهُونَ
حَدِيثًا ٧٨ مَّآ أَصَابَكَ مِنْ حَسَنَةٍ فَمِنَ ٱللَّهِ ۖ وَمَآ أَصَابَكَ مِن سَيِّئَةٍ
فَمِن نَّفْسِكَ ۚ وَأَرْسَلْنَٰكَ لِلنَّاسِ رَسُولًا ۚ وَكَفَىٰ بِٱللَّهِ شَهِيدًا ٧٩
٩٠

Ajeti 75

75. Ç'keni ju që nuk luftoni në rrugën e Zotit dhe për shpëtimin e të shtypurve: për meshkujt e pafuqishëm, gratë dhe fëmijët, të cilët luten: "Zoti ynë! Nxirrna nga ky vend, banorët e të cilit janë mizorë! Cakto për ne nga ana Jote një mbrojtës dhe na jep ndihmë!"

Shpjegimi i ajetit

Ky ajet është nxitje prej Allahut të Lartësuar për besimtarët, që ata të luftojnë në rrugën e Tij, sidomos kur lufta është detyrë e pashmangshme për ta. Madje, ajeti përmban edhe një qortim shumë të rëndë për braktisjen e xhihadit në të tilla kushte. Allahu i Lartësuar thotë:

- "Ç'keni ju që nuk luftoni në rrugën e Zotit dhe për shpëtimin e të shtypurve: për meshkujt e pafuqishëm, gratë dhe fëmijët, të cilët luten..." – Kuptimi: Ç'ndodh me ju që nuk luftoni në rrugën e Zotit, ndërkohë që të dobëtit, gratë e fëmijët, të cilët nuk i kanë mundësitë t'u shmangen vështirësive, nuk kanë asnjë mbështetje dhe nuk arrijnë të gjejnë rrugëzgjidhje?! Ata vuajnë nën shtypjen e armikut dhe kalojnë padrejtësitë më të mëdha mbi kurrizin e tyre. Aq e madhe është dhimbja e tyre, saqë ata luten e thonë:

- "Zoti ynë! Nxirrna nga ky vend, banorët e të cilit janë mizorë! Cakto për ne nga ana Jote një mbrojtës dhe na jep ndihmë!" – Pra, ata i luten Zotit që t'i largojë dhe shpëtojë ata nga ai vend, banorët e të cilit janë të padrejtë ndaj vetes me idhujtarinë e tyre, si dhe të padrejtë ndaj besimtarëve, duke i torturuar e duke i penguar nga feja e vërtetë dhe nga ftesa drejtuar të tjerëve për adhurimin e një Zot të vetëm. Ata janë të padrejtë ndaj tyre edhe duke i penguar nga emigrimi në rrugën e Zotit.

Të dobëtit dhe të pafuqishmit e lusin Allahun e Lartësuar që t'u dhurojë një udhëheqës, i cili të shqetësohet dhe përpiqet për të zgjidhur hallet e tyre, që lufton për t'i shpëtuar nga ai vend, banorët e të cilit janë të padrejtë.

Pra, në një rast të tillë, lufta ka karakter mbrojtës, për të ruajtur jetën, nderin pasurinë, e nuk është mësymëse.[29] Edhe kjo

[29] Në një hadith thuhet: "Nëse ju kërkohet të dilni në luftë, përgjigjuni!", me kuptimin: Nëse udhëheqësi ju kërkon të dilni në luftë në rrugën e Zotit, atëherë e keni detyrë që të përgjigjeni, sepse në një rast të tillë xhihadi është *farz ajn* për secilin që i plotëson kushtet. Në një rast të tillë, askujt nuk i lejohet që të qëndrojë në shtëpi, përveç nëse ka justifikim të pranuar nga Sheriati i Zotit. Allahu i Lartësuar thotë: "O ju që keni besuar, ç'është me ju që, kur ju thuhet: "Dilni në rrugën e Allahut!", ju rëndoheni në vend?! A mos jeni më të kënaqur me jetën e kësaj bote, sesa me atë të ardhmen? Përjetimi i jetës së kësaj bote, ndaj asaj të ardhmes, nuk është asgjë. Nëse nuk dilni *(në luftë)*, Ai do t'ju ndëshkojë me një dënim të rëndë dhe do t'ju zëvendësojë me një popull tjetër, ndëkohë që Atij nuk i bëhet aspak dëm. Allahu është i Plotpushtetshëm për gjithçka." [Teube 38, 39].

Ky, pra, është njëri nga rastet kur xhihadi është *farz ajn*. Rasti i dytë është xhihadi mbrojtës, kur armiku ka rrethuar vendin tënd islam. Rasti i tretë është kur dy ushtritë, ajo muslimane dhe ajo qafire, janë vendosur

e fundit ka shpërblim shumë të madh, dhe ai që i bën bisht është i qortuar, por lloji i parë i luftës, ajo për të mbrojtur të dobëtit, është me shpërblim më të madh, më e dobishme dhe më fort e detyrueshme se kjo e dyta. Pastaj i Lartësuari thotë:

Ajeti 76

76. Ata që besojnë, luftojnë në rrugën e Allahut. Ndërsa ata që nuk besojnë luftojnë në rrugën e Shejtanit. Luftoni kundër ithtarëve të Shejtanit, sepse, vërtet, intriga e Shejtanit është e dobët.

Shpjegimi i ajetit

- "Ata që besojnë, luftojnë në rrugën e Allahut. Ndërsa ata që nuk besojnë luftojnë në rrugën e Shejtanit." - Allahu i Lartësuar na tregon se besimtarët luftojnë veçse në rrugën e Tij, ndërsa qafirët luftojnë në rrugën e *tagut*-it, Shejtanit.

Nga ky pohim dalin shumë mësime. Së pari, kuptojmë që, në varësi të besimit të njeriut, të sinqeritetit të tij dhe korrektësisë në pasimin e traditës së Profetit (a.s.), do të jetë edhe lufta ose përpjekja e tij në rrugën e Allahut. Lufta në rrugën e Zotit është një nga shenjat e besimit. Është besimi që nxit për luftë dhe përpjekje në rrugën e Zotit. Ndërsa lufta dhe përpjekja në rrugën e *tagut*-it është një nga treguesit e kufrit.

Po ashtu, ata që luftojnë në rrugën e Zotit e kanë të detyrueshme të pajisen më durim, qëndrueshmëri dhe guxim të niveleve që të tjerët nuk mund t'i arrijnë. Pasuesit e Shejtanit durojnë dhe luftojnë në rrugën e tyre të kotë, kështu që pasuesit e së vërtetës dhe së drejtës e kanë më të domosdoshme të pajisen me durim e qëndrueshmëri, pasi nëse vuajtja mund të jetë e njëjtë, shpërblimet e premtuara për secilën palë nuk kanë të krahasuar. I Lartësuari thotë: "Mos u dobësoni dhe mos u dëshpëroni, përderisa ju jeni më të lartit, nëse jeni besimtarë të sinqertë. Në qoftë se ju përjetuat dhimbje *(në Uhud)*, edhe populli tjetër *(armik)* provoi dhimbje si kjo e juaja *(në Bedër)*. Ne i këmbejmë këto ditë mes njerëzve, për t'u dalluar qartë tek Allahu ata që besojnë dhe për t'i zgjedhur disa prej jush si dëshmorë. Allahu nuk i do të padrejtët. Kështu Allahu i pastron besimtarët dhe, gradualisht, i shkatërron jobesimtarët.– A mos menduat ju se do të hyni në Xhenet pa u dalluar tek Allahu ata që luftojnë prej jush dhe pa u dalluar të durueshmit?!" [Al Imran 139-142]. Në një ajet tjetër më poshtë thotë: "Mos u tregoni të dobët në ndjekjen e armikut, sepse nëse ju ndieni dhimbje, edhe ata, sikurse ju, ndiejnë dhimbje, por ju shpresoni nga Allahu atë çka ata nuk e shpresojnë. Allahu është i Dijshëm e i Urtë". [Nisa 104].

Kush lufton dhe përpiqet në rrugën e Zotit qëndron mbi truallin më të fortë, sepse ka me vete të vërtetën hyjnore dhe i është mbështetur plotësisht Atij që është i Gjallë e nuk vdes kurrë. Ky luftëtar ka vullnetin, durimin dhe qëndrueshmërinë që nuk mund të krahasohen kurrsesi me ato të ushtarëve të së kotës, të cilët pasojnë diçka të pabazë dhe që kurrë nuk do të kenë një përfundim të mirë. Më pas, i Lartësuari thotë:

- "Luftoni kundër ithtarëve të Shejtanit, sepse, vërtet, intriga e Shejtanit është e

---

përballë njëra-tjetrës. Edhe në këtë rast, lufta është detyrë për pjesëmarrësit dhe nuk lejohet largimi prej saj, sepse Allahu i Lartësuar thotë: "O ju që keni besuar! Kur të ndesheni me ushtrinë e mohuesve, mos ua ktheni shpinën! Askush të mos ua kthejë atyre shpinën në atë moment, veç atij që kthehet për të luftuar ose për t'iu bashkangjitur një grupi tjetër. Kush tërhiqet, ai ka tërhequr kundër vetes zemërimin e Allahut dhe vendi i tij është Xhehenemi, e ai është një përfundim i keq!" [Enfal 15, 16]. Profeti (a.s.) na ka njoftuar, gjithashtu, se largimi nga fushëbeteja është një nga shtatë gjynahet e mëdha dhe shkatërruese.

Rasti i katërt kur xhihadi është *farz ajn* është atëherë kur një person njeh përdorimin e një arme që askush tjetër nuk e njeh dhe është i domosdoshëm përdorimi i saj. Atëherë, për këtë njeri, xhihadi është *farz ajn,* edhe nëse udhëheqësi nuk e ka thirrur për mobilizim.

Këto janë katër rastet kur xhihadi është *farz ajn*. Ndërsa çdo rast tjetër është *farz kifaje*. [Shih "*Rijad es-Salihin*" shpjegimin e Shejh Ibn Uthejmin].

dobët." - Sado të mëdha dhe të fshehta që të jenë kurthet dhe intrigat e Shejtanit të mallkuar, ato përsëri mbeten të dobëta. Ato kurrsesi nuk mund të mposhtin të vërtetën e Allahut. Ato nuk mund të qëndrojnë përballë mbrojtjes dhe përkujdesjes së Allahut të Lartësuar për robërit e Tij besimtarë.

Ajeti 77

77. A nuk i ke parë *(o Muhamed)* ata të cilët u porositën: "Largohuni prej luftës, faleni namazin dhe jepeni zekatin!", e që kur iu bë detyrim lufta, një grup prej tyre iu frikësuan njerëzve ashtu si duhet t'i frikësohesh Allahut, madje edhe më shumë. Ata thanë: "O Zoti ynë! Pse na e bëre detyrim luftën? Sikur të na e kishe shtyrë pak më vonë!" Thuaju: "Kënaqësitë e kësaj bote janë të pakta, ndërsa bota tjetër është shumë më e dobishme për ata që janë të devotshëm. Juve nuk do t'ju bëhet padrejtësi aspak.

Shpjegimi i ajetit

- "A nuk i ke parë *(o Muhamed)* ata të cilët u porositën: "Largohuni prej luftës, faleni namazin dhe jepeni zekatin!"" - Kur ishin në Mekë, para hixhretit, besimtarët ishin të urdhëruar vetëm për namaz e zekat, me kuptimin e përgjithshëm të fjalës "zekat", pra, për të ndihmuar të varfërit, jo për zekatin e njohur në Islam, që ka kushtet dhe rregullat e caktuara e i cili u bë i detyrueshëm pas emigrimit në Medine.

Kështu, në fillim, besimtarët nuk ishin urdhëruar për xhihad, për arsye e urtësi të shumta. Allahu, me urtësinë e Tij, i ka sjellë ligjet gradualisht, në atë mënyrë që njerëzve të mos u bien rëndë. Ai ka filluar së pari me rregullat më të rëndësishme e më të thjeshta. Nëse Allahu i Lartësuar do t'i urdhëronte besimtarët për luftë, ndërkohë që numri i tyre ishte shumë i vogël dhe mundësitë e tyre të pakta, ndërsa armiqtë ishin të shumtë në numër, atëherë kjo do të shkaktonte tretjen dhe zhdukjen e Islamit. Pra, iu dha përparësi dobisë më të madhe, kundrejt asaj më të vogël. Përveç kësaj, ka edhe urtësi të tjera.

Disa besimtarë dëshironin të luftonin që në fillim, por ai nuk ishte momenti për luftë. Së pari, ata duhet të përpiqeshin të plotësonin më së miri detyrimet që kishin, si: teuhidin, faljen e namazit, dhënien e zekatit etj., siç thotë i Lartësuari disa ajete më lart: "Nëse ata do t'i zbatonin porositë e dhëna, kjo do të ishte më mirë për ta dhe do t'i forconte më shumë. Atëherë, Ne, pa dyshim, do t'u jepnim atyre shpërblim të madh nga ana Jonë dhe do t'i udhëzonim në rrugë të drejtë." [Nisa 66-68].

Por pas emigrimit në Medinë, kur Islami u fuqizua dhe kur atyre iu bë detyrë lufta, atëherë:

- "...e që kur iu bë detyrim lufta, një grup prej tyre iu frikësuan njerëzve ashtu si duhet t'i frikësohesh Allahut, madje edhe më shumë." – Pra, disa prej atyre që më përpara e kërkonin me ngulm luftën, filluan të thonë nga frika e dobësia: "O Zoti ynë, pse na e bëre detyrim luftën?"

Kjo tregonte pakënaqësinë e tyre ndaj vendimit të Zotit, ndërkohë që detyrë për ta ishte e kundërta. Për besimtarët është detyrë që t'u dorëzohen dhe t'u nënshtrohen urdhrave të Zotit, duke qenë të durueshëm, korrektë dhe të sinqertë në zbatimin e tyre. Por ata vepruan të kundërtën, duke thënë:

- "Ata thanë: "O Zoti ynë! Pse na e bëre detyrim luftën? Sikur të na e kishe shtyrë pak më vonë!"" - Kështu ka ndodhur në të shumtën e rasteve me ata që kanë kërkuar nga Zoti diçka para kohës së vet. Në momentin kur Zoti ua ka bërë detyrë atë që e kërkonin me ngut, ata janë sprapsur dhe nuk e kanë patur vullnetin për ta plotësuar. Prandaj Zoti i Lartësuar i ka paralajmëruar këta njerëz që të ruhen nga të tilla sjellje, të cilat të bëjnë të mos kesh durim dhe qëndrueshmëri në rrugën e Tij.

- "Thuaju: "Kënaqësitë e kësaj bote janë të pakta, ndërsa bota tjetër është shumë më e dobishme për ata që janë të devotshëm. Juve nuk do t'ju bëhet padrejtësi aspak." - Kënaqësitë e kësaj bote janë të vogla dhe të shkurtra. Nga ana tjetër, vështirësitë në rrugën e Zotit janë mëse të përballueshme për njeriun, sidomos kur kujton se ato nuk kanë për të zgjatur shumë.

Ahireti është i pakrahasueshëm me dynjanë në kënaqësitë që ofron dhe në çdo aspekt tjetër. Vlera e ahiretit është ashtu sikurse e ka përshkruar Pejgamberi (a.s.): "*Një copë vend në Xhenet sa gjurma që lë një shkop në tokë është më e mirë sesa gjithë dynjaja dhe ç'ka në të*". Kënaqësitë e Xhenetit janë të plota dhe për t'i arritur ato nuk nevojitet lodhje. Në fakt, ato as që mund të përfytyrohen. Çdo kënaqësi e përfytyruar ndonjëherë nuk mund as t'i përafrohet kënaqësive të Xhenetit, sikurse ka thënë i Lartësuari: "Askush nuk e ka idenë për ato kënaqësi që u është caktuar atyre si shpërblim për ato gjëra që kanë bërë *(në dynja)."* [Sexhde 17]. Gjithashtu, Allahu i Lartësuar, nëpërmjet Profetit të Tij, na ka njoftuar se ka thënë: "*Unë kam përgatitur për adhuruesit e Mi punëmirë atë që syri nuk e ka parë, veshi nuk e ka dëgjuar dhe që zemra e njeriut nuk e ka ëndërruar*".

Ndërsa kënaqësitë e dynjasë arrihen veçse me vështirësi dhe lodhje. Po ashtu, nëse krahasojmë çastet e kënaqësisë së dynjasë me momentet e ankthit, trishtimit, lodhjes dhe mërzitisë në të, do të vërejmë se çastet e kënaqësisë janë shumë herë më të pakta. Kjo botë vetë është e përkohshme dhe jeta e njeriut në të është akoma më e shkurtër. Ndërsa mirësitë e ahiretit janë të përjetshme dhe banorët e tij janë të përjetshëm atje.

Kështu, nëse njeriu do të gjykonte qetësisht për të krahasuar mes dynjasë dhe ahiretit, do të bënte patjetër zgjedhjen e duhur. Ai do t'i jepte përparësi ahiretit dhe do të luftonte për të arritur shpërblimin e atjeshëm. Kjo është arsyeja që edhe i Lartësuari na nxit që të punojmë për arritjen e atij duke u bërë të devotshëm: "...ndërsa bota tjetër është shumë më e dobishme për ata që janë të devotshëm. Juve nuk do t'ju bëhet padrejtësi aspak." Pra, nëse ruhemi nga *shirk*-u dhe çdo gjynah tjetër dhe zbatojmë porositë e Tij, atëherë kemi pa dyshim premtimin për Xhenetin, pa na u bërë asnjë padrejtësi. Çdo përpjekje që bëjmë për ahiretin do ta gjejmë të plotë atje.

Ajetet 78 – 79

78. Kudo që të jeni, vdekja do t'ju arrijë, edhe në qofshi në kështjellat më të forta. Sa herë që u vjen ndonjë e mirë, ata thonë: "Kjo është nga Allahu!". Por nëse i godet ndonjë e keqe, thonë: "Kjo është nga ti!". Thuaju: "Të gjitha janë nga Allahu!" Ç'është me këta njerëz që nuk kuptojnë gati asgjë?
79. Çdo e mirë që të vjen është nga Allahu, ndërsa çdo e keqe që të godet është nga vetja jote. Ne të dërguam ty si Profet për mbarë botën. Mjafton që Allahu është dëshmues për këtë!

Shpjegimi i ajeteve

Zoti i Lartësuar na kujton se mosmarrja pjesë në luftë nuk të mbron aspak nga caktimi i Tij. Ajo që Zoti ka përcaktuar të ndodhë nuk mund të kthehet pas. Ne thjesht jemi në sprovë për t'iu bindur urdhrave të Tij dhe për këtë do të shpërblehemi me drejtësi. Kështu, i Lartësuari thotë:

- "Kudo që të jeni, vdekja do t'ju arrijë, edhe në qofshi në kështjellat më të forta." – Kuptimi: Në çdo kohë dhe vend që të jeni, vdekja ka për t'ju kapur, edhe sikur të fshiheni në kështjella të forta dhe të larta. Pra, mos kujtoni se mosmarrja pjesë në luftë do t'ju bëjë të jetoni më gjatë!

Kjo është nxitje për të marrë pjesë në luftë, nxitje e cila bëhet me disa mënyra në Kur'ân:

- duke treguar shpërblimin e premtuar për të;

- duke përmendur dënimin për mosmarrjen pjesë në të;
- duke kujtuar faktin se mosmarrja pjesë në luftë nuk ndryshon gjë nga caktimi i Zotit për vdekjen.
- duke treguar mirësitë e jetës tjetër, në krahasim me vështirësitë e kësaj jete etj.

Më pas, Allahu i Lartësuar na tregon se çfarë thonë ata që i kthejnë shpinën Shpalljes së Tij:

- "Sa herë që u vjen ndonjë e mirë, ata thonë: "Kjo është nga Allahu!". Por nëse i godet ndonjë e keqe, thonë: "Kjo është nga ti!"." - Kur atyre u vjen nga Zoti begati, shëndet, pasuri e fëmijë, thonë: "Këto janë nga Allahu!". Ndërsa kur goditen nga fatkeqësitë, thatësia, uria, skamja, sëmundjet, vdekja e fëmijëve dhe të dashurve thonë; "Kjo ndodhi prej teje, o Muhamed, për shkak të asaj që na solle ti!"

Pra, ashtu sikurse shumë popuj para tyre, ata e quajtën Profetin fatkeqësi ose shkaktar fatkeqësie. Allahu i Lartësuar na tregon për Faraonin se ka bërë të njëjtën gjë me Musain: "Kur u vinte e mira, ata thonin: "Kjo është thjesht merita jonë". E kur i godiste ndonjë e keqe, atë e konsideronin si ogur të zi të shkaktuar nga prania e Musait dhe atyre *(besimtarëve)* që ishin me të. E pra, fati i tyre i zi ishte nga Allahu, por shumica e tyre nuk e dinin." [A'raf 131].

Edhe populli i Salihut tha të njëjtën gjë për Profetin e tij: "Ata thanë: "Ne parandiejmë keq prej teje dhe prej atyre që janë me ty!" Ai tha: "E mira dhe e keqja është prej Allahut, por ju jeni një popull që jeni vënë në provë!" [Neml 47].

Po kështu, populli i përmendur në suren Jasin u tha profetëve të vet: "Ata *(fshatarët)* thanë: "Ne parandiejmë keq me ju dhe, nëse nuk tërhiqeni, ne do t'ju gurëzojmë. Do të vuani ndëshkim të rëndë prej nesh!". Ata *(të dërguarit)* thanë: "E keqja shkaktohet vetëm prej jush. Vallë, për shkak se u këshilluat, po na kërcënoni?! Ju jeni popull i prishur!" [Jasin 18, 19].

Zemrat e tyre kanë qenë të mbushura me kufër, prandaj edhe fjalët e veprat e tyre ishin të tilla. Çdokush që i lidh fatkeqësitë apo largimin e të mirave me Shpalljet hyjnore që sollën profetët, duke pretenduar dhe shpifur se shkaku i të këqijave janë pikërisht ato, meriton të njëjtin paralajmërim dhe kërcënim.

Më pas, Allahu i Lartësuar u përgjigjet:

- "Thuaju: "Të gjitha janë nga Allahu!"" - Të mirat dhe të këqijat, begatia dhe fatkeqësia ndodhin me lejen, caktimin dhe krijimin e Zotit të Urtë dhe të Mëshirshëm.

- "Ç'është me këta njerëz që nuk kuptojnë gati asgjë?" – Ç'është me këta njerëz që pretendojnë të tilla gjëra të kota, të cilët nuk kuptojnë asgjë, ose të cilët kuptojnë shumë pak?!

Ky është një qortim për ata të cilët nuk kuptojnë dhe nuk përpiqen të kuptojnë mesazhin nga Allahu dhe Profeti i Tij, dhe kjo ndodh për shkak të mohimit dhe kundërshtimit të tyre të së vërtetës. Nga kjo kuptohet se janë të lëvduar dhe të shpërblyer ata që kuptojnë dhe përpiqen të kuptojnë Shpalljen e Zotit. Është e shpërblyeshme nëse marrim të gjitha masat për të kuptuar atë që ka thënë Zoti dhe Profeti i Tij, duke dëgjuar me kujdes fjalët dhe porositë e tyre e duke medituar rreth tyre. Nëse vërtetë do të kuptonim Shpalljen e Zotit, do të ishim të bindur se çdo gjë që ndodh në gjithësi, e mirë apo e keqe, ndodh me përcaktimin dhe dijen e Allahut të Lartësuar dhe të Urtë; asgjë nuk del jashtë caktimit të Tij. Ne do të kuptonim dhe do të bindeshim se Profeti dhe Shpallja nuk mund të jenë asnjëherë shkaktarë të së keqes. Përkundrazi, profetët dhe shpalljet hyjnore erdhën për të sjellë mirësinë dhe rregullin në jetën e kësaj bote dhe lumturinë në jetën tjetër. Pastaj i Lartësuari thotë:

- "Çdo e mirë që të vjen është nga Allahu, ndërsa çdo e keqe që të godet është nga vetja jote." – Pra, çdo e mirë e kësaj dynjaje dhe çdo e mirë e fesë vjen vetëm prej Zotit. Është Ai që na i dhuron me bujarinë e Tij dhe i lehtëson shkaqet për t'i arritur ato. Ndërkohë, çdo e keqe që na godet, ndodh sepse e meritojmë, prej gjynaheve dhe padrejtësive që i bëjmë me duart tona dhe me zgjedhjen tonë të lirë.


Megjithatë, falja e Zotit është shumë herë më e madhe se ndëshkimi i Tij. Allahu i Lartësuar u ka hapur krijesave portat e mirësisë dhe i ka porositur që të hyjnë në to, që të përfitojnë nga mirësia dhe bujaria e Tij. Ai, gjithashtu, u ka treguar atyre se gjynahet janë pengesa që të privojnë nga mirësitë dhe bujaria e Tij. Nëse njerëzit i veprojnë ato, atëherë të qortojnë veçse vetveten, sepse vetëm ata janë shkaku i privimit nga mirësia dhe bujaria e Zotit të tyre.

Pastaj Allahu i Lartësuar na tregon për gjithëpërfshirjen e Shpalljes së dhënë Profetit të Tij, Muhamedit (a.s.):

- "Ne të dërguam ty si Profet për mbarë botën. Mjafton që Allahu është dëshmues për këtë!" - Mjafton që Allahu është dëshmues për këtë fakt. Është Ai që e ndihmoi dhe mbështeti Profetin (a.s.) me mrekulli.

Në një ajet tjetër, i Lartësuari thotë: "Thuaju: "Kush është Ai që e ka dëshminë më të fortë?" Thuaju: "Allahu është dëshmues mes meje dhe jush! Mua më është shpallur ky Kur'ân, që me të t'ju tërheq vërejtjen juve dhe çdokujt që i përcillet. Vallë, ju po dëshmoni se, veç Allahut, ka edhe zota të tjerë?!" Thuaju: "Unë nuk dëshmoj!" Ai është një Zot i vetëm, dhe unë distancohem nga ato që ju adhuroni!" [En'am 19].

Duke qenë se Allahu është Absolut, i Plotë, Gjithëpërfshirës dhe i Madhërishëm në dijen, pushtetin dhe urtësinë e Tij, duke vërejtur gjithashtu se Ai e ka ndihmuar dhe mbështetur shumë Muhamedin (a.s.),


الجزء الخامس سورة النساء

مَّن يُطِعِ ٱلرَّسُولَ فَقَدْ أَطَاعَ ٱللَّهَ ۖ وَمَن تَوَلَّىٰ فَمَآ أَرْسَلْنَٰكَ
عَلَيْهِمْ حَفِيظًا ﴿٨٠﴾ وَيَقُولُونَ طَاعَةٌ فَإِذَا بَرَزُوا۟ مِنْ عِندِكَ
بَيَّتَ طَآئِفَةٌ مِّنْهُمْ غَيْرَ ٱلَّذِى تَقُولُ ۖ وَٱللَّهُ يَكْتُبُ مَا يُبَيِّتُونَ ۖ
فَأَعْرِضْ عَنْهُمْ وَتَوَكَّلْ عَلَى ٱللَّهِ ۚ وَكَفَىٰ بِٱللَّهِ وَكِيلًا
﴿٨١﴾ أَفَلَا يَتَدَبَّرُونَ ٱلْقُرْءَانَ ۚ وَلَوْ كَانَ مِنْ عِندِ غَيْرِ ٱللَّهِ
لَوَجَدُوا۟ فِيهِ ٱخْتِلَٰفًا كَثِيرًا ﴿٨٢﴾ وَإِذَا جَآءَهُمْ أَمْرٌ مِّنَ ٱلْأَمْنِ
أَوِ ٱلْخَوْفِ أَذَاعُوا۟ بِهِۦ ۖ وَلَوْ رَدُّوهُ إِلَى ٱلرَّسُولِ وَإِلَىٰٓ أُو۟لِى ٱلْأَمْرِ
مِنْهُمْ لَعَلِمَهُ ٱلَّذِينَ يَسْتَنۢبِطُونَهُۥ مِنْهُمْ ۗ وَلَوْلَا فَضْلُ ٱللَّهِ
عَلَيْكُمْ وَرَحْمَتُهُۥ لَٱتَّبَعْتُمُ ٱلشَّيْطَٰنَ إِلَّا قَلِيلًا ﴿٨٣﴾
فَقَٰتِلْ فِى سَبِيلِ ٱللَّهِ ۚ لَا تُكَلَّفُ إِلَّا نَفْسَكَ ۚ وَحَرِّضِ ٱلْمُؤْمِنِينَ ۖ
عَسَى ٱللَّهُ أَن يَكُفَّ بَأْسَ ٱلَّذِينَ كَفَرُوا۟ ۗ وَٱللَّهُ أَشَدُّ بَأْسًا
وَأَشَدُّ تَنكِيلًا ﴿٨٤﴾ مَّن يَشْفَعْ شَفَٰعَةً حَسَنَةً يَكُن لَّهُۥ
نَصِيبٌ مِّنْهَا ۖ وَمَن يَشْفَعْ شَفَٰعَةً سَيِّئَةً يَكُن لَّهُۥ كِفْلٌ مِّنْهَا ۗ
وَكَانَ ٱللَّهُ عَلَىٰ كُلِّ شَىْءٍ مُّقِيتًا ﴿٨٥﴾ وَإِذَا حُيِّيتُم بِتَحِيَّةٍ فَحَيُّوا۟
بِأَحْسَنَ مِنْهَآ أَوْ رُدُّوهَا ۗ إِنَّ ٱللَّهَ كَانَ عَلَىٰ كُلِّ شَىْءٍ حَسِيبًا ﴿٨٦﴾

٩١

atëherë lehtësisht dilet në përfundimin se ai ishte Profeti i vërtetë i Allahut. Nëse Muhamedi (a.s.) do të trillonte ndonjë fjalë të paqenë për Allahun e Madhërishëm, Ai do t'ia këputste arterien e zemrës, siç thotë vetë i Lartësuari: "Sikur ai *(Muhamedi)* të trillonte për Ne ndonjë fjalë, Ne do ta kapnim atë me fuqinë Tonë, do t'ia këputnim arterien e zemrës, e askush prej jush nuk do të mund të ndërhynte për mbrojtjen e tij. Ai *(Kur'âni)* është këshillë për të devotshmit. S'ka dyshim se Ne dimë që prej jush ka edhe mohues. Ai *(Kur'âni)* padyshim do të jetë dëshpërim për jobesimtarët. Ai është e vërteta e sigurt! Andaj, ti lartësoje nga të metat Zotin tënd të Madhëruar!" [Hakka 44-52].

Ajetet 80 – 81

80. Kush i bindet Profetit, ai i është bindur Allahut. Por kush e refuzon, *(dije se)* Ne nuk të dërguam ty si roje të tyre.

81. Ata thonë: "Të jemi bindur", por kur largohen prej teje, një grup prej tyre shtjellojnë diçka tjetër nga ajo që u thua ti. Por Allahu e shënon atë që ata shtjellojnë. Largoju atyre e mbështetju Allahut! Allahu të mjafton si Mbrojtës!

Shpjegimi i ajeteve

- "Kush i bindet Profetit, ai i është bindur Allahut." – Pra, çdokush që i bindet Profetit në zbatimin e urdhrave dhe largimin nga ndalesat, në të vërtetë i është bindur Zotit, sepse Pejgamberi (a.s.) ka urdhëruar dhe ndaluar veçse me urdhrin e Zotit dhe porosinë e Tij. Ai nuk ka folur nga mendja, por nga Shpallja e Zotit.

Kjo tregon se Pejgamberi (a.s.) ka qenë i pagabueshëm në përcjelljen e Shpalljes hyjnore, sepse, në të kundërt, Allahu i Lartësuar nuk do të na urdhëronte që t'i bindeshim Profetit dhe të premtonte shpërblim për këtë.

Të drejtat e Zotit dhe të Profetit (a.s.) janë tri llojesh:

1. Të drejtat e Zotit, që janë të posaçme vetëm për Të. Të tilla janë adhurimi i Zotit si një i Vetëm dhe synimi i afrimit tek Ai me çdo vepër të mirë.

2. Të drejtat e Profetit, që janë të posaçme vetëm për të. Këtu hyn respektimi i Profetit dhe mbështetja e rrugës së tij.

3. Të drejtat e përbashkëta dhe të ndërthurura. Këtu hyn besimi në Zotin dhe Profetin, dashuria për ta dhe bindja ndaj tyre. Zoti i Lartësuar i përmend të ndërthurura këto të drejta në ajetin: "Të Allahut janë ushtritë e qiejve dhe të tokës. Allahu është i Fuqishëm e i Urtë. Ne të dërguam ty si dëshmitar, si përgëzues dhe qortues, që ju t'i besoni Allahut dhe të Dërguarit të Tij, që ta përkrahni e ta respektoni atë *(Profetin)* dhe ta madhëroni Atë *(Allahun)* çdo mëngjes e mbrëmje." [Fet'h 7-9].

Ata që i binden Profetit (a.s.), në të vërtetë i janë bindur Allahut dhe meritojnë shpërblimin për bindjen ndaj Allahut të Lartësuar. Ndërsa ata që i kthejnë shpinën Profetit (a.s.), ata dëmtojnë veç vetveten, sepse nuk mund të dëmtojnë Allahun e Plotfuqishëm dhe të Lartësuar.

- "Por kush e refuzon, *(dije se)* Ne nuk të dërguam ty si roje të tyre." - Kuptimi: Allahu nuk të ka dërguar që të shënosh dhe të llogarisësh veprat e tyre. Ne të dërguam vetëm si përçues të qartë të Mesazhit hyjnor dhe shpjegues të tij. Ne të dërguam si këshillues e qortues, dhe ti e ke kryer plotësisht këtë detyrë, prandaj edhe shpërblimi i Zotit është i madh për ty, pavarësisht në e pranojnë apo jo udhëzimin tënd.

Në një ajet tjetër, i Lartësuari thotë: "E ti këshillo, se je veçse përkujtues. Ti nuk i ke në dorë ata! Ata që shmangen e nuk besojnë, Allahu me ndëshkim të madh do t'i dënojë. Sigurisht që vetëm tek Ne është kthimi i tyre dhe detyrë vetëm e Jona është llogaria e tyre." [Gashije 21-26].

Bindja ndaj Allahut dhe Profetit duhet të jetë haptazi dhe fshehurazi. Ajo duhet të shfaqet te fjalët dhe te veprat. Ndërsa ata që haptazi shfaqen si të bindur ndaj Allahut dhe Profetit (a.s.), ndërsa kur veçohen dhe janë vetëm, bëjnë të kundërtën, ajo bindje nuk do t'u bëjë dobi. Për ata, Allahu i Lartësuar thotë:

- "Ata thonë: "Të jemi bindur", por kur largohen prej teje, një grup prej tyre shtjellojnë diçka tjetër nga ajo që u thua ti." – Kur veçohen, ata veprojnë të kundërtën. Ata vendosin të sigurt për të mos iu bindur Zotit dhe Profetit.

Këtë kuptim ka fjala *'bejjete'* në ajet: "planifikon dhe vendos me bindje për diçka". Domethënë, ata vendosën me bindje për të mos zbatuar porositë e Allahut dhe të Profetit (a.s.), por Allahu i Lartësuar i kërcënon për këtë dhe thotë:

- "Por Allahu e shënon atë që ata shtjellojnë." – Ai do t'ua shkruajë veprat e

tyre dhe do t'u japë shpërblimin e duhur. Ky, sigurisht, është një kërcënim për ta. Pastaj i Lartësuari e urdhëron Profetin e Tij që t'u kthejë shpinën dhe të distancohet prej tyre. Kështu, Profeti këshillohet që të mos zemërohet, sepse ata nuk mund ta dëmtojnë nëse ai i mbështetet Allahut dhe kërkon ndihmën e Tij:

- "Largoju atyre e mbështetju Allahut! Allahu të mjafton si Mbrojtës!"

Ajeti 82

82. A nuk meditojnë ata rreth Kur'ânit? Sikur të ishte prej dikujt tjetër, e jo prej Allahut, do të kishin gjetur në të shumë kundërthënie.

Shpjegimi i ajetit

- "A nuk meditojnë ata rreth Kur'ânit?" - Allahu i Lartësuar na urdhëron që të meditojmë thellë rreth Librit të Tij, që të kuptojmë qartë ajetet e Tij, mesazhin e tyre nga fillimi në mbarim dhe detyrat që dalin.

Studimi i Librit të Allahut të Lartësuar është çelësi i shumë njohurive. Prej tij nxirret çdo e mirë dhe përftohet çdo lloj njohurie. Nëpërmjet Kur'ânit shtohet besimi dhe rrënjët e tij ngulen në zemër. Nëpërmjet Kur'ânit njihet Zoti i Lartësuar, i vetmi i Adhuruar me meritë, njihen emrat dhe cilësitë e pranueshme për Të dhe ato nga të cilat Ai është i pastër. Në Kur'ân është treguar qartë rruga që të çon te Zoti dhe cilësitë e atyre që ndjekin këtë rrugë. Aty është treguar shpërblimi që i pret besimtarët kur të mbërrijnë te Zoti i tyre. Në Kur'ân zbulohet se cili është armiku yt i vërtetë, me të gjitha intrigat dhe kurthet që ai përgatit kundra teje. Në Kur'ân tregohen rrugët që të çojnë drejt ndëshkimit dhe mënyra si të mbrohesh prej tyre dhe të shpëtosh. Ai përshkruan cilësitë e atyre që ndjekin rrugën drejt ndëshkimit dhe vuajtjes. Kur'âni tregon se çfarë i pret ata të cilët kryejnë gjynahe dhe çdo gjë që të shpie drejt ndëshkimit. Sa më shumë të studiohet Kur'âni, aq më shumë shtohet dija e dobishme, qartësia në besim dhe veprat e mira që sjellin lumturinë në të dyja jetët. Kjo është arsyeja që Allahu i Lartësuar ka urdhëruar për këtë gjë. Madje, Ai na ka njoftuar se Kur'âni është zbritur veçse që të meditojmë rreth tij, siç thotë në ajetet: "Libër i begatshëm, të cilin Ne ta shpallëm që t'ia studiojnë ajetet dhe që të marrin mësim prej tij ata që kanë mend". [Sad 29]. "A nuk e studiojnë me vëmendje Kur'ânin? Jo, ato janë zemra të kyçura me dryna!" [Muhamed 24].

Ndër dobitë më të rëndësishme të meditimit rreth Kur'ânit është se, nëpërmjet tij, njeriu arrin siguri të plotë se ky libër është vërtet shpallje e Zotit të Lartësuar. Pra, Kur'âni vërteton dhe verifikon vetveten. Në të përmenden dhe përsëriten histori të shumta, por ato janë plotësisht në përputhje dhe harmoni të plotë me njëra-tjetrën. Mes tyre nuk ka asnjë kundërthënie. Nga kjo kuptohet se Kur'âni është fjala e vërtetë e Zotit, i Cili është Gjithëpërfshirës dhe Absolut në dijen e Tij:

- "Sikur të ishte prej dikujt tjetër, e jo prej Allahut, do të kishin gjetur në të shumë kundërthënie." – Pra, duke qenë se Kur'âni është prej Allahut të Lartësuar, në të nuk mund të gjesh kurrë kundërthënie.

Ajeti 83

83. Kur u vjen ndonjë lajm qetësues ose shqetësues, ata e përhapin menjëherë atë. Por nëse këtë lajm do t'ia përcillnin Pejgamberit dhe parisë së tyre, hulumtuesit do të dinin të nxirrnin përfundime. Sikur të mos ishte mirësia e Allahut ndaj jush dhe mëshira e Tij, atëherë ju do të ndiqnit rrugën e Shejtanit, përveç një pakice.

Shpjegimi i ajetit

- "Kur u vjen ndonjë lajm qetësues ose shqetësues, ata e përhapin menjëherë atë." - Kjo është një këshillë nga Allahu i Lartësuar, me të cilën Ai edukon adhuruesit

e Tij që të largohen prej cilësive dhe sjelljeve jo të mira, që nuk iu shkojnë besimtarëve. Kështu, nëse ata dëgjojnë ndonjë lajm të rëndësishëm, që ka të bëjë me interesin e besimtarëve, sigurinë dhe ruajtjen e tyre, apo ndonjë lajm që ka të bëjë me ndonjë kërcënim kundër muslimanëve, fillimisht duhet ta verifikojnë dhe të mos nxitojnë në përhapjen e tij. Ata duhet të njoftojnë Profetin (a.s.) (kur ishte gjallë) apo udhëheqësit dhe dijetarët e tyre. Ata duhet të njoftojnë njerëzit e mençur dhe specialistët, që i njohin mirë çështjet dhe dinë të japin gjykim të drejtë rreth anëve pozitive dhe negative, si dhe dinë të përcaktojnë drejt përparësitë. Nëse përhapja e tyre është e dobishme dhe sjell gëzim për besimtarët, apo i bën ata më të përgjegjshëm dhe të kujdesshëm për t'iu ruajtur rreziqeve, ata e përhapin lajmin, e nëse jo, ata e fshehin dhe nuk e përhapin atë, siç thotë i Lartësuari:

- "Por nëse këtë lajm do t'ia përcillnin Pejgamberit dhe parisë së tyre, hulumtuesit do të dinin të nxirrnin përfundime." – Nëpërmjet logjikës së mprehtë dhe njohurive të mëdha, dijetarët do të japin një gjykim më të drejtë rreth atyre çështjeve.

Ky është një rregull i rëndësishëm: nëse shtrohet nevoja për trajtimin e një çështjeje, ajo duhet t'u lihet atyre që janë specialistë të saj. Askush nuk duhet të flasë para tyre. Kjo bën të mundur që t'i afrohesh më shumë të vërtetës dhe të jesh më pak i rrezikuar nga gabimi.

Gjithashtu ky ajet na porosit që të mos jemi të nxituar dhe të papërmbajtur në reagimet ndaj lajmeve që na vijnë apo ndaj situatave të ndryshme me të cilat përballemi. Përkundrazi, ne duhet të mendohemi mirë dhe gjatë para se të veprojmë. Pastaj i Lartësuari thotë:

- "Sikur të mos ishte mirësia e Allahut ndaj jush dhe mëshira e Tij, atëherë ju do të ndiqnit rrugën e Shejtanit, përveç një pakice." - Mirësia e Allahut është suksesi i dhuruar prej Tij për të ndjekur udhën e drejtë, është feja që solli për ne, janë porositë e vyera për çdo fushë dhe çështje, është dija e vlefshme që Ai na dhuroi, dije që ne nuk e kishim. Pra, nëse nuk do të ishin këto mirësi të dhuruara nga Zoti, ne do të mashtroheshim nga Shejtani i mallkuar, përveç një pakice të vogël. Arsyeja është se njeriu është i prirur drejt injorancës dhe padrejtësisë. Egoja e tij e urdhëron veçse për të këqija, por nëse ai i drejtohet me përgjërim dhe përunjësi Zotit të tij dhe kërkon strehim tek Ai, duke dhënë maksimumin e tij në këtë drejtim, Zoti i tij me siguri do ta ndihmojë për arritjen e çdo të mire dhe për të shpëtuar nga çdo e keqe; Ai do ta ruajë nga Shejtani i mallkuar dhe kurthet e tij.

Ajeti 84

84. Lufto në rrugën e Allahut! Ti je përgjegjës veçse për veten tënde! Nxiti besimtarët! Allahu do ta sprapsë fuqinë e të pafeve, se Allahu është më i fuqishmi e më i ashpri në dënime!

Shpjegimi i ajetit

Kjo është sjellja më e mirë e njeriut: të përpiqet e të luftojë me vetveten dhe me armikun për plotësimin e urdhrave të Allahut, si edhe të nxisë të tjerët në këtë drejtim. Megjithatë, mund të ndodhë që njeriu të mos ketë asnjëren nga këto veti ose të ketë veç njërën prej tyre. Prandaj Allahu i Lartësuar i thotë Profetit të Tij:

- "Lufto në rrugën e Allahut! Ti je përgjegjës veçse për veten tënde!" – Kuptimi: Ti nuk ke pushtet mbi të tjerët. Ti nuk do të merresh në përgjegjësi për çfarë bëjnë të tjerët, por vetëm për veprat e tua.

- "Nxiti besimtarët!" - Inkurajimi i besimtarëve përfshin gjithçka që u jep forcë atyre dhe që i ndihmon ata të jenë të shkathët, të gjallë e me moral të ngritur. Kjo

mund të arrihet me disa mënyra: herë duke përmendur dobësinë dhe dështimet e qafirëve, e herë duke përmendur shpërblimin e madh që Allahu i Lartësuar ka përgatitur për luftëtarët dhe për ata që përpiqen në rrugën e Tij si dhe ndëshkimin që ka përgatitur për armiqtë e besimtarëve. Pra, këto dhe shumë mënyra të tjera janë nxitje e besimtarëve për të luftuar dhe për t'u përpjekur në rrugën e Zotit.

- "Allahu do ta sprapsë fuqinë e të pafeve, se Allahu është më i fuqishmi e më i ashpri në dënime!" - Nëpërmjet luftës dhe përpjekjeve në rrugën e Allahut dhe nëpërmjet nxitjes së njëri-tjetrit për këtë çështje, Allahu i Lartësuar e ndalon padrejtësinë e qafirëve dhe shkatërrimin që ata përhapin. Allahu i Lartësuar është më i Forti dhe Ndëshkuesi më i drejtë për këdo që bën padrejtësi. Nëpërmjet ndëshkimit të Tij të drejtë dhe të urtë, Ai i jep atë që meriton të padrejtit, por u jep një mësim të mirë edhe të tjerëve, që të mos bien në të njëjtin gabim.

Nëse do të dëshironte Allahu i Lartësuar, Ai do t'i mposhte qafirët vetë dhe nuk do të linte gjallë asnjë prej tyre. Por me urtësinë e Tij, Ai i sprovon njerëzit me njëri-tjetrin. Kështu dallohen besimtarët e vërtetë, të cilët besojnë dhe bëjnë me dëshirë punë të mira, nga ata që shtiren si besimtarë, por që besimi i tyre nuk i sjell asnjë dobi.

Ajeti 85

85. Kush ofron ndihmë për të mirë, do të ketë pjesë nga ajo, dhe kush ofron ndihmë për të keq, do të ngarkohet me të. Allahu është Dëshmues i drejtë për gjithçka.

Shpjegimi i ajetit

- "Kush ofron ndihmë për të mirë, do të ketë pjesë nga ajo, dhe kush ofron ndihmë për të keq, do të ngarkohet me të. - Këtu bëhet fjalë për ndihmën që njeriu mund t'i japë dikujt tjetër për punë a çështje të ndryshme. Pra, nëse ai ndihmon dhe përpiqet së bashku me dikë tjetër për arritjen dhe plotësimin e një pune të mirë, siç është, për shembull, ndihma për të larguar një padrejtësi, ai do të marrë shpërblim në varësi të mundit të ofruar, por pa iu zvogëluar aspak shpërblimi vepruesit kryesor të tij. Po kështu edhe ata që ofrojnë ndihmë dhe mbështetje për vepra të këqija do të kenë përgjegjësi në varësi të ndihmës së ofruar dhe dëmit që sjellin.

Kjo është një porosi e mrekullueshme nga Allahu, që ne të bashkëpunojmë dhe të ndihmojmë njëri-tjetrin për vepra të mira, për devotshmëri dhe t'iu ruajtur armiqësisë dhe urrejtjes mes nesh. Allahu i Lartësuar e përforcon këtë porosi, duke thënë:

- "Allahu është Dëshmues i drejtë për gjithçka." – Pra, Allahu i Lavdëruar është Dëshmuesi, që shikon dhe di gjithçka, Ai i ka regjistruar të gjitha veprat e njeriut dhe do ta marrë atë në llogari për çdo gjë që ka bërë, duke i dhënë shpërblimin apo ndëshkimin e merituar.

Ajeti 86

86. Kur t'ju përshëndesin, ju kthejani me një përshëndetje më të mirë ose me të njëjtën formë. Allahu është Llogaritës i drejtë për gjithçka.

Shpjegimi i ajetit

- "Kur t'ju përshëndesin, ju kthejani me një përshëndetje më të mirë ose me të njëjtën formë." - Përshëndetja është një fjalë ose shprehje e ngrohtë e dashamirëse në formë lutjeje, që thuhet nga dy persona kur takohen me njëri-tjetrin. Përshëndetje quhet edhe një veprim që shpreh respekt e dashuri, si një buzëqeshje etj. Një ndër mënyrat e përshëndetjes, e cila ka bazë në Sheriat është dhënia e selamit.

Kështu Allahu i Lartësuar i ka urdhëruar besimtarët që, nëse përshëndeten nga dikush, me çfarëdolloj përshëndetjeje, ta

kthejnë atë me një përshëndetje më të mirë se ajo, qoftë në fjalët e përzgjedhura, qoftë në mënyrën e dhënies së saj, ose ta kthejnë njëlloj me përshëndetjen e marrë. Kjo tregon që moskthimi i përshëndetjes është haram, ashtu si edhe kthimi i saj me një formë më të ulët se e para.

Nga ajeti kuptohet, gjithashtu, se është e pëlqyeshme që të jemi të parët që përshëndesim. Kjo kuptohet në këto dy aspekte:

1. Allahu i Lartësuar na ka urdhëruar që përshëndetjen ta kthejmë me një formë më të mirë se ajo ose të njëjtë me të. Kjo tregon se Sheriati e nxit të përshëndeturit dhe, si i tillë, garimi për këtë veprim është po ashtu i inkurajuar.

2. Thënia: "...kthejani me një përshëndetje më të mirë..." nxit për të qenë i pari që përshëndet, sepse ky është tregues tjetër i "përshëndetjes më të mirë", për të cilën na ka urdhëruar Sheriati.

Megjithatë, nga fusha e këtij urdhri përjashtohen disa raste, siç është, për shembull, rasti i njeriut që është duke lexuar Kur'ân, apo duke dëgjuar hytben, duke falur namaz etj. Pra, në këto raste, nuk është detyrë kthimi i përshëndetjes apo selamit. Gjithashtu, rast përjashtues është edhe me ata individë të cilët Sheriati urdhëron që të bojkotohen dhe të mos përshëndeten e as t'u kthehet përshëndetja, siç ndodh me gjynahqarët që i bëjnë haramet haptazi dhe nuk pendohen. Sidoqoftë, është kusht që mospërshëndetja e tyre të ketë efekt pozitiv dhe t'i bëjë ata të kthejnë rrugë, pasi nëse nuk ndodh kjo, atëherë me ta veprohet ndryshe.

Detyrimi i kthimit të përshëndetjes vlen edhe për ato përshëndetje që njerëzit i kanë zakon dhe që nuk bien ndesh me Sheriatin. Pra, muslimani është i urdhëruar që t'i kthejë me formë më të mirë ose të njëjtë edhe të tilla përshëndetje.

Pastaj Allahu i Lartësuar na kujton se ai është Llogaritës i drejtë i të gjitha veprave tona të mira apo të këqija, dhe do të na shpërblejë me drejtësi për to:

- "Allahu është Llogaritës i drejtë për gjithçka." - Çdo fjalë e vepër e njeriut, e mirë apo e keqe qoftë, e madhe apo e vogël, e dukshme apo e fshehur, është e regjistruar korrektësisht, dhe do të vijë dita që njeriu do të shpërblehet për to, me bujarinë, drejtësinë, urtësinë dhe gjykimin e drejtë të Allahut të Lartësuar.

Ajeti 87

87. Allahu! Nuk ka të adhuruar tjetër me meritë veç Tij! Pa dyshim, Ai do t'ju tubojë Ditën e Gjykimit, për të cilën nuk ka dyshim. E cili mund të jetë në fjalë më i vërtetë se Allahu?!

Shpjegimi i ajetit

- "Allahu! Nuk ka të adhuruar tjetër me meritë veç Tij!" - Allahu i Lartësuar na tregon për njëshmërinë e Tij në merituesmërinë e adhurimit. Ai është Zoti i vetëm që meriton t'i përkushtohesh me madhërimin, nënshtrimin, bindjen dhe dashurinë tënde. Vetëm Ai është i Adhuruari me meritë në gjithësi, sepse vetëm Ai është Absoluti në Qenien dhe në cilësitë e Tij. Vetëm në dorën e Tij është krijimi, sundimi, mbretërimi dhe përkujdesja për krijesat dhe çështjet e tyre. Ai është Zotëruesi dhe Dhuruesi i të gjitha mirësive të dukshme dhe të fshehta.

Ky përshkrim është, gjithashtu, një urdhër për ta njësuar Allahun në adhurim. Vetëm Ai duhet të jetë i Adhuruari, të Cilin duhet ta duam me gjithë qenien tonë, ta madhërojmë, t'i bindemi e nënshtrohemi me drojë. Ne duhet të përpiqemi të afrohemi tek Allahu me të gjitha llojet e adhurimeve të cilat Ai i ka përcaktuar si të tilla në Librin e Tij dhe në Traditën e Profetit të Tij.

Vetëm Ai do t'i shpërblejë krijesat për gjithçka që bëjnë në këtë jetë, për adhurimet apo për shpërfilljen e tyre, prandaj i

Lartësuari betohet për vërtetësinë e Ditës së madhe të Shpërblimit me drejtësi dhe urtësi:

- "Pa dyshim, Ai do t'ju tubojë Ditën e Gjykimit, për të cilën nuk ka dyshim." – Kuptimi: Ditën e Gjykimit, Allahu ka për t'iu grumbulluar të gjithëve, nga i pari deri tek i fundit, në të njëjtin vend. Ajo është dita që nuk ka dyshim për vërtetësinë e saj.

Argumentet logjike dhe fetare për atë ditë janë të shumta, si për shembull:


- Ringjallja e tokës së vdekur nëpërmjet ujit të zbritur nga qielli, si mëshirë prej Zotit.

- Krijimi i parë nga hiçi dëshmon se rikrijimi dhe rikthimi në jetë i krijesave pas vdekjes është më i pranueshëm dhe më i thjeshtë.

- Nëse Zoti është i Urtë, kjo e bën të detyrueshme që të ketë ringjallje, llogari dhe shpërblim me drejtësi të krijesave, sepse Ai nuk do t'i krijonte kurrë krijesat pa një qëllim, që thjesht të jetonin e të vdisnin, e kështu të vazhdonin në pafundësi. Drejtësia, urtësia dhe mëshira e Tij duhet t'i gjykojë dhe shpërblejë ato ashtu si e meritojnë.

- Ndërsa argumentet fetare të ardhura nga Pejgamberi (a.s.) janë të shumta, siç është ky ajet dhe të tjerë të ngjashëm. I Lartësuari thotë më pas: "E cili mund të jetë në fjalë më i vërtetë se Allahu?!". Pra, Allahu i Lartësuar betohet për vërtetësinë e kësaj dite, ashtu siç ka urdhëruar Profetin e Tij në disa raste në Kur'ân që të betohet për këtë të vërtetë. Në fakt, të gjithë profetët kanë folur për këtë të vërtetë të madhe dhe kanë këshilluar për t'u përgatitur për të.

- "E cili mund të jetë në fjalë më i vërtetë se Allahu?!" - Kjo tregon se fjala e Zotit dhe rrëfimet e Tij janë në shkallën më të lartë të vërtetësisë. Çdo gjë që thuhet në drejtim të besimit, fesë dhe riteve e që bie ndesh me fjalët dhe porositë e Zotit, ajo është e gabuar dhe e gënjeshtërt. Ajo nuk ka se si të jetë e vërtetë, sepse bie ndesh me fjalën absolutisht të vërtetë të Allahut të Lartësuar.



Ajetet 88 – 91

88. Ç'është me ju, që për çështjen e munafikëve ndaheni në dy grupe, ndërkohë që Allahu i ka zhytur ata në mohim për shkak të asaj që bëjnë?! A mos doni të udhëzoni në rrugë të drejtë atë që Allahu e ka lënë të humbur?! Për atë që Allahu e ka lënë të humbur, ju nuk keni për të gjetur rrugëdalje!

89. Ata dëshirojnë që edhe ju të mos besoni, sikurse nuk besojnë vetë, dhe kështu të bëheni të njëjtë. Mos zini miq prej tyre, derisa ata të shpëngulen për hir të Allahut, e nëse refuzojnë, atëherë, kudo që t'i gjeni, kapini dhe vritini e, gjithashtu, mos i zini as si miq e as si mbështetës,

90. përveç atyre që strehohen te një popull me të cilin ju keni marrëveshje, e përveç atyre që vijnë te ju, se u vjen rëndë të luftojnë kundër jush ose të luftojnë kundër popullit të vet. Sikur të donte Allahu, Ai do t'ju jepte atyre fuqi e pushtet mbi ju, dhe kështu ata do t'ju luftonin. Në qoftë se ata

tërhiqen, nuk ju luftojnë dhe ju ofrojnë paqe, atëherë Allahu nuk ju jep të drejtë kundër tyre.

91. Ju do të hasni në të tjerë, që duan të sigurohen nga ju dhe nga populli i tyre, por që sa herë që thirren kundër jush, ata shkojnë atje. Kështu, në qoftë se këta nuk largohen prej jush, nuk ju ofrojnë paqe dhe nuk heqin dorë nga lufta kundër jush, atëherë kapini dhe vritni kudo që t'i ndeshni! Ju kemi dhënë fakte të qarta kundër tyre!

Shpjegimi i ajeteve

- "Ç'është me ju, që për çështjen e munafikëve ndaheni në dy grupe, ndërkohë që Allahu i ka zhytur ata në mohim për shkak të asaj që bënë?! A mos doni të udhëzoni në rrugë të drejtë atë që Allahu e ka lënë të humbur?! Për atë që Allahu e ka lënë të humbur, ju nuk keni për të gjetur rrugëdalje!" – Munafikët, për të cilët aludohet në këtë ajet, ishin ata që në dukje shfaqeshin si muslimanë. Ata, përveçse nuk kishin hequr dorë nga kufri i tyre, nuk emigruan për hir të Zotit. Kështu që, sahabët ishin të paqartë dhe kishin qëndrime të ndryshme ndaj kësaj kategorie. Disa prej tyre ndiheshin ngushtë dhe hezitonin për vrasjen dhe luftën kundër tyre, qoftë edhe për ndërprerjen e marrëdhënieve me ta. Kjo ndodhte për shkak të atyre veprave që ata i shfaqnin si muslimanë. Ndërsa sahabët e tjerë gjykonin për ta duke u nisur nga veprat që tregonin se ata ende ishin në kufër dhe larg Islamit. Atëherë, Allahu i Lartësuar shpalli këto ajete, në të cilat dha urdhrin e prerë, që ne të mos ngurrojmë në lidhje me qëndrimin që duhet të mbajmë ndaj të tillëve. Ne duhet të kemi veç një qëndrim ndaj munafikëve, sepse shenjat e tyre të kufrit janë të përsëritura, madje:

- "Ata dëshirojnë që edhe ju të mos besoni, sikurse nuk besojnë vetë, dhe kështu të bëheni të njëjtë." - Kjo është dëshira e tyre: që ju të mohoni dhe të bëheni si ata.

- "Mos zini miq prej tyre, derisa ata të shpëngulen për hir të Allahut..." - Ata nuk duhen dashur dhe mbështetur, sepse miqësia është shprehje e dashurisë dhe e vlerësimit për ta. Por kjo nënkupton edhe urrejtjen për ta, sepse urdhri për të bërë diçka nënkupton edhe ndalimin nga e kundërta e saj.

Megjithatë, ky qëndrim është i kushtëzuar: derisa edhe ata të emigrojnë në rrugën e Zotit. Nëse emigrojnë si muslimanët, edhe atyre u takon i njëjti trajtim me muslimanët. Kështu i trajtonte Pejgamberi (a.s.) ata që emigruan në Medinë, pavarësisht a ishin besimtarë të vërtetë apo të shtirur.

Nëse ata nuk emigrojnë drejt shtetit Islam dhe refuzojnë një gjë të tillë, atëherë:

- "...e nëse refuzojnë, atëherë, kudo që t'i gjeni, kapini dhe vritini e, gjithashtu, mos i zini as si miq e as si mbështetës..." – Pra, në çdo kohë, vend e rrethanë ata vriten dhe luftohen.

Ky ajet është një nga argumentet që tregojnë se dispozita për ndalesën e luftës gjatë muajve të shenjtë është e shfuqizuar. Ky është mendimi i shumicës së dijetarëve. Ndërsa të tjerë thonë se tekstet fetare që tregojnë për luftë të pakufizuar ndaj mohuesve duhen parë në kontekstin reduktues dhe përjashtues të teksteve që tregojnë për respektimin e muajve të shenjtë dhe ndalimin e luftës në to.

Pastaj Allahu i Lartësuar përjashton nga urdhri për t'u luftuar tri kategori njerëzish, dhe e para e tyre është:

- "...përveç atyre që strehohen te një popull me të cilin ju keni marrëveshje..." - Ata të cilët kanë bërë pakt me shtetin që ka marrëveshje paqeje me muslimanët. Pra, edhe këta kanë të njëjtin gjykim me popullin që ka pakt paqeje me muslimanët: pasuria dhe jeta e tyre janë të ruajtura dhe të sigurta.

Kategoria e dytë janë ata për të cilët Zoti thotë:

- "...e përveç atyre që vijnë te ju, se u vjen rëndë të luftojnë kundër jush ose të luftojnë kundër popullit të vet." - Ata të cilët nuk ua lejon shpirti që të luftojnë muslimanët, por as popullin e vet, prandaj si rrugë të mesme zgjedhin neutralitetin mes dy palëve. Pra, edhe për këtë kategori Zoti ka urdhëruar që të mos i luftojmë. Ky qëndrim ka urtësi të shumta. Ja si thotë Allahu i Lartësuar:

- "Sikur të donte Allahu, Ai do t'ju jepte atyre fuqi e pushtet mbi ju, dhe kështu ata do t'ju luftonin. Në qoftë se ata tërhiqen, nuk ju luftojnë dhe ju ofrojnë paqe, atëherë Allahu nuk ju jep të drejtë kundër tyre." – Kuptimi: Mundësitë e veprimit të tyre janë tre:
1. Të bashkohen me ju e të luftojnë kundër armiqve tuaj, mes të cilëve është edhe populli i tyre. Por kjo është thuajse e pamundur për t'u pranuar prej tyre.
2. Të bashkohen me armiqtë tuaj dhe t'ju luftojnë juve, dhe kjo do të ishte një vështirësi e madhe.
3. Të mos luftojnë as kundër jush, as kundër popullit të tyre, dhe kjo është zgjidhja e mesme dhe më e thjeshtë.

Ju, o muslimanë, pranojeni këtë zgjidhje të tretë, që është e pranueshme dhe më e lehtë për ju. Allahu i Lartësuar është i Plotpushtetshëm që t'u mundësojë atyre edhe që t'ju luftojnë së bashku, prandaj pranojeni lehtësimin e ofruar prej Tij dhe falënderojeni Atë, që i ndaloi duart e tyre kundër jush.

Ndërsa kategoria e tretë janë ata që synojnë thjesht të arrijnë qëllimet e popullit të vet, pa shfaqur mbështetje për muslimanët. Allahu i Lartësuar thotë për ta:


- "Ju do të hasni në të tjerë, që duan të sigurohen nga ju dhe nga populli i tyre, por që sa herë që thirren kundër jush, ata shkojnë atje." – Kuptimi: Nga mesi i munafikëve, me të cilët keni të bëni, do të gjeni të tillë që thjesht synojnë mbrojtjen e popullit të tyre. Por në ndryshim nga kategoria e dytë, të cilët i largohen luftës kundër muslimanëve për shkak të respektimit dhe vlerësimit për ta, këta, sa herë shohin ndonjë mundësi për të dëmtuar muslimanët, kthehen në origjinën e tyre armiqësore kundër Islamit. Megjithatë, kur shohin se fuqia e Islamit është e madhe, ata nuk e marrin guximin që t'i luftojnë muslimanët apo të bëhen palë me aleatët kundër tyre.

Kështu, kategoria e dytë heq dorë nga lufta kundër muslimanëve, për shkak të respektit dhe vlerësimit për ta, e jo për shkak të frikës për veten e vet. Ndërsa kategoria e tretë e bën këtë nga frika, e jo nga respekti dhe vlerësimi për muslimanët, madje, nëse do të kishin mundësi për t'i luftuar muslimanët, do ta bënin atë. Prandaj dhe i Lartësuari thotë:

- "Kështu, në qoftë se këta nuk largohen prej jush, nuk ju ofrojnë paqe dhe nuk heqin dorë nga lufta kundër jush, atëherë kapini dhe vritni kudo që t'i ndeshni! Ju kemi dhënë fakte të qarta kundër tyre!" – Kuptimi: Nëse ata sillen kështu, atëherë ju keni një argument të qartë kundër tyre dhe leje për t'i luftuar dhe vrarë kudo që t'i gjeni. Ata janë vetëshpallur si armiqtë tuaj dhe kanë shkelur paqen, prandaj le ta mbajnë përgjegjësinë.

Ajeti 92

92. Asnjë besimtar nuk mund të vrasë një besimtar tjetër, përveçse gabimisht. Kushdo që vret gabimisht një besimtar, ai është i detyruar të lirojë një skllav besimtar dhe shpagimin *(e gjakut)* t'ia dorëzojë familjes së tij, veç në qoftë se ata ia falin *(gjakun)*. Në qoftë se ai *(i vrari gabimisht)* është besimtar, por i takon një populli armik, atëherë është detyrim vetëm lirimi i një skllavi besimtar. Në qoftë se ai *(i vrari)* është nga një popull me të cilin ju keni marrëveshje, atëherë është detyrim që



familjes së tij t'i dorëzohet shpagimi *(i gjakut)* dhe që të lirohet një skllav besimtar. E kush nuk ka mundësi *(të lirojë një skllav)*, le të agjërojë dy muaj rresht, si formë pendese para Allahut. Allahu është i Gjithëdijshëm e i Urtë.

Shpjegimi i ajetit

- "Asnjë besimtar nuk mund të vrasë një besimtar tjetër, përveçse gabimisht." – Këtu kemi të bëjmë me një stil shumë të veçantë për të treguar se diçka është e ndaluar dhe kurrë nuk duhet të ndodhë. Pra, është e pamundur që një besimtar të vrasë me qëllim një besimtar tjetër. Kjo tregon se ndalesa e këtij krimi është shumë e madhe dhe e përforcuar. Ai është një nga krimet më të rënda, që bien ndesh me imanin dhe atë që imani nënkupton.

Kjo vepër mund të pritet nga një jobesimtar ose nga një kriminel, që ka iman shumë të dobët, por jo nga një besimtar i vërtetë, sepse besimi i saktë e ndalon njeriun nga vrasja e vëllait të tij besimtar. Besimi është një akt vëllazërimi mes besimtarëve, akt i cili e shton dashurinë, mbështetjen mëshirën dhe faljen mes tyre. Besimtari e ruan vëllain e tij nga çdo dëm dhe rrezik. Por, a ka dëmtim më të madh sesa marrja e jetës?! Këtë e vërteton edhe thënia e Profetit (a.s.): *"Mos u ktheni pas meje si mohues e të vrisni njëri tjetrin!"*. Kjo tregon se vrasja e besimtarit është vepër kufri dhe konsiderohet si një nga gjynahet më të mëdha pas *shirk*-ut dhe idhujtarisë.

Nga fjala e Allahut të Lartësuar kuptohet se ky është krim i rëndë në çdo lloj gjendjeje e situate, përveç rastit kur bëhet pa dashje. Pra, ai që vret pa qëllim ose pa dashje nuk merr gjynah për vrasjen dhe nuk gjykohet si shkelës i kufijve të Zotit.

Megjithatë, duke qenë se vepra në vetvete është shumë e rëndë, Allahu i Lartësuar ka urdhëruar që të bëhet kompensim për të:

- "Kushdo që vret gabimisht një besimtar, ai është i detyruar të lirojë një skllav besimtar dhe shpagimin *(e gjakut)* t'ia dorëzojë familjes së tij, veç në qoftë se ata ia falin *(gjakun)*." – Pra, nuk ka ndryshim dhe rëndësi a është vrasësi mashkull apo femër, i lirë apo skllav, minoren apo në moshë madhore, i aftë mendërisht apo i sëmurë, musliman apo jomusliman. Kjo kuptohet nga fjala '*men*' - kushdo, e cila është gjithëpërfshirse.

Gjithashtu, nuk përbën ndonjë ndryshim fakti që i vrari është mashkull apo femër, i vogël apo i madh. Kjo kuptohet nga përdorimi i një emri të pashquar në kontekstin e një fjalie kushtore, dhe në gjuhën arabe kjo rrethanë e bën emrin gjithëpërfshirës.

Për vrasësin është detyrë çlirimi i një skllavi besimtar, dhe nuk është përcaktuar se si duhet të jetë ky skllav: mashkull apo femër, i vogël a i madh, i saktë apo i sëmurë dhe me mangësi. Megjithatë, po të shohësh urtësinë e këtij lloji kompensimi, del se lirimi i një skllavi të mangët mendërisht është i

pavlefshëm, sepse qëllimi i lirimit nga skllavëria është dobia e të liruarit, e pasurisë dhe interesave të tij. Kësisoj, nëse këto dobi nuk arrihen me lirimin e tij apo ndodh e kundërta, atëherë lënia e skllavit në zotërimin e pronarit të tij është më e dobishme për të, prandaj çlirimi i tij nuk vlen si mënyrë kompensimi për rastin në fjalë. Madje, po të shihet më thellë në kuptimin e shprehjes "*tahrir el rakabeh*" - "çlirimi i një skllavi", do të arrihet në të njëjtin përfundim të thënë më sipër. Fjala "çliroj" do të thotë: "të lësh të lirë dikë që t'i shfrytëzojë vetë dobitë dhe aftësitë e tij, që më përpara ishin nën pronësinë e dikujt tjetër". Por nëse ai nuk është në gjendje të bëjë një gjë të tillë, atëherë çlirimi i tij nuk ka vlerë. Mendohu pak për këtë, sepse është shumë e qartë dhe e kuptueshme!

Për sa i përket kompensimit financiar (*el dijeh*), ai është i detyrueshëm për rastin e vrasjes gabimisht, ose të vrasjes jo me paramendim. Kompensimi i dorëzohet familjes së viktimës, pra, atyre që e trashëgojnë atë. Kur trashëgimtarët ndajnë mes tyre pasurinë e tij, kjo pagesë futet gjithashtu te kjo pasuri.

Nëse trashëgimtarët e viktimës e falin vrasësin, ai çlirohet nga ky detyrim. Kjo është një nxitje për të falur dhe toleruar, sepse Allahu i Lartësuar e ka quajtur si "sadaka", dhe sadakaja është e inkurajuar në çdo kohë dhe gjendje.

- "Në qoftë se ai *(i vrari gabimisht)* është besimtar, por i takon një populli armik, atëherë është detyrim vetëm lirimi i një skllavi besimtar."

- "Në qoftë se ai *(i vrari)* është nga një popull me të cilin ju keni marrëveshje, atëherë është detyrim që familjes së tij t'i dorëzohet shpagimi *(i gjakut)* dhe që të lirohet një skllav besimtar." – Pra, kur viktima është nga një popull me të cilin muslimanët kanë lidhur marrëveshje për paqe, atëherë është detyrë dhënia e kompensimit financiar. Kjo bëhet për të respektuar familjen e viktimës, me të cilën është lidhur marrëveshja e paqes.

- "E kush nuk ka mundësi *(të lirojë një skllav)*, le të agjërojë dy muaj rresht, si formë pendese para Allahut." - Ai që nuk ka skllevër për të liruar apo nuk ka pasuri për ta bërë një gjë të tillë, atëherë e ka detyrë të agjërojë dy muaj të njëpasnjëshëm, pa ndërprerje. Pra, gjatë këtyre dy muajve, nuk i lejohet ta ndërpresë agjërimin pa arsye të pranueshme nga Sheriati, si për shembull, kur sëmuret apo, në rastin e gruas, kur është me menstruacione etj. Nëse e prish agjërimin pa asnjë arsye të tillë, atëherë vijueshmëria e agjërimit konsiderohet e thyer dhe agjërimi i dy muajve duhet nisur nga e para.

Ky lloj agjërimi që Allahu i Lartësuar e ka bërë detyrë për vrasësin, është një mundësi që atij i jepet për t'u penduar dhe një mëshirë e madhe për të. Ai është një shans për faljen e gjynaheve dhe një edukim për njeriun që të mos jetë më i nxituar dhe i papërmbajtur, ashtu siç ndodh shpesh në vrasjet pa dashje.

- "Allahu është i Gjithëdijshëm e i Urtë." - Allahu i Lartësuar është i Plotë dhe Absolut në dijen dhe në urtësinë e Tij. Atij nuk i fshihet asgjë: as në qiell, as në tokë, e madhe apo e vogël qoftë, në çdo kohë e çdo vend. Asgjë nuk del jashtë urtësisë së Tij, krijesë qoftë apo vendim i Tij, ligj apo dispozitë.

Në këtë kuadër, edhe ligji mbi kompensimin për vrasjen është tejet i përshtatshëm për krimin e kryer. Vrasësi largon nga jeta një njeri, i cili është i ndaluar që të vritet. Për këtë arsye, është shumë me vend që ai të nxjerrë nga skllavëria një skllav. Nëse nuk gjen skllav për të liruar dhe nuk ka pasuri, atëherë agjëron dy muaj rresht, duke çliruar kështu veten e vet nga skllavëria ndaj epshit dhe pasioneve të kësaj jete të shkurtër dhe mashtruese, që e pengojnë nga qëllimi final i jetës dhe nga rruga drejt lumturisë së përjetshme, pra, nga adhurimi i Zotit.

Ajeti 93

93. Kush vret një besimtar qëllimisht, dënimi i tij është Xhehenemi, në të cilin do të jetë përgjithmonë. Allahu është zemëruar ndaj tij, e ka mallkuar dhe ka përgatitur për të dënim të rëndë.

Shpjegimi i ajetit

Kemi thënë më lart se Allahu i Lartësuar na ka njoftuar se besimtari nuk lejohet të vrasë një besimtar tjetër dhe se ky krim konsiderohet si kufër, pra, si mohim i Zotit nëpërmjet një vepre. Në këtë ajet, Allahu i Lartësuar sjell një kërcënim, nga i cili dridhen zemrat dhe tmerrohen shpirtrat dhe i cili bën të mendohen të mençurit. Ndëshkimi i atij që vret një besimtar me qëllim është Xhehenemi. Ky gjynah është i mjaftueshëm që njeriu të ndëshkohet në Xhehenem, me gjithë ndëshkimet që gjenden në të. Në Xhehenem, ai do të vuajë ndëshkimin e rëndë, poshtërimin, zemërimin e të Plotfuqishmit dhe humbjen e mirësive të Xhenetit. Ai do të jetojë me trishtimin për humbjen e mirësive dhe për ndëshkimin e përjetshëm. E lusim Allahun e Lartësuar që të na ruajë nga çdo rrugë dhe shkak që të largon nga mëshira e Tij!

Edhe ky kërcënim shihet njëlloj si kërcënimet e tjera të këtij lloji në Kur'ân për ata që kryejnë gjynahe të mëdha, për të cilët thuhet se do të jenë përjetësisht në Xhehenem dhe do të privohen përfundimisht nga Xheneti. Pra, si duhen kuptuar këto kërcënime? A kanë ato kuptim të drejtpërdrejtë apo ndonjë kuptim tjetër, që shihet i harmonizuar me tekstet e tjera? Dijetarët kanë dhënë mendime të ndryshme për këtë çështje, edhe pse të gjithë janë të një mendimi se shpjegimi dhe besimi i *havarixh*-ëve dhe *mu'tezil*-ëve është i gabuar. Këto sekte të humbura besojnë se gjynahqarët do të jenë përjetësisht në zjarrin e Xhehenemit, edhe nëse janë njësues të Allahut.

Megjithatë, mendimi i saktë në këtë çështje është ai të cilin e ka shtjelluar aq bukur imam Ibn Kajjim (Allahu e mëshiroftë!) në librin e tij "*Medarixhus-Salikin*". Ai, pasi përmend mendimet e dijetarëve për kuptimin e këtij ajeti, thotë:

"Një grup dijetarësh thonë se në të tilla tekste të ngjashme thjesht thuhet se këto vepra sjellin atë ndëshkim. Por dihet që të thuash se një vepër e caktuar meriton një dënim të caktuar, nuk tregon domosdoshmërisht se ai dënim do të ekzekutohet patjetër, sepse që të ekzekutohet një dënim duhet që, përveç shkakut që e bën të merituesshëm atë, të jenë larguar edhe pengesat për një vendim të tillë. E shumta që tregojnë këto tekste është fakti se të tilla vepra bëjnë të merituesshëm një lloj ndëshkimi. Por, nga ana tjetër, në fenë tonë janë bërë të ditur edhe faktorët që shërbejnë si pengesë për ekzekutimin e këtij ndëshkimi. Disa prej këtyre faktorëve pengues kanë ardhur deri tek ne nëpërmjet mendimit konsensual të dijetarëve muslimanë (*ixhma*), e disa të tjerë nëpërmjet teksteve të Sheriatit (Kur'âni dhe Suneti). Kështu, për shembull:

- Pendimi nga ato gjynahe konsiderohet si pengesë për realizimin e ndëshkimit, sipas mendimit konsensual të dijetarëve.

- Teuhidi, pra, kur njeriu është njësues i Zotit, është një pengesë tjetër e fortë për realizimin e ndëshkimit. Edhe ky qëndrim është përcjellë me saktësi përmes teksteve të shumta dhe të sigurta të Sheriatit, të cilat nuk mund të kundërshtohen.

- Veprat e mira janë fshirse dhe pastruese të gjynaheve, prandaj ato bëhen pengesë për zbatimin e dënimit në ahiret për veprat e këqija.

- Fatkeqësitë e mëdha, që e godasin njësuesin e Zotit, janë fshirse dhe pastruese të gjynaheve, e si rrjedhojë, pengesë për zbatimin e dënimit në ahiret për veprat e këqija.

- Ekzekutimi i dënimeve që në këtë jetë dhe masat ndëshkuese të vendosura nga Sheriati janë pastruese nga gjynahet dhe pengesa që

nuk lejojnë realizimin e kërcënimit dhe ndëshkimit në ahiret.

Siç vihet re, gjithë këto fakte nuk mund të shpërfillen dhe të lihen mënjanë. Është e detyrueshme që tekstet fetare të shihen të gjitha në harmoni me njëra-tjetrën dhe të shpjegohen nën dritën e njëra-tjetrës.

Allahu i Lartësuar për çdo gjë ka bërë një palë të kundërt, që e ndalon dhe e kundërshton të parën, ndërkohë që pushteti do t'i takojë palës më të fortë. Kështu, për shembull, luftojnë me njëra tjetrën forca e sëmundjes me forcën e trupit dhe të ilaçit. Secila palë ndikon dhe dobëson forcën e palës tjetër. Ajo që fiton, ajo do të sundojë.

Në këtë kontekst shihet edhe ndarja e krijesave në:

1. Ata që do të hyjnë në Xhenet dhe nuk do të hyjnë në Zjarr.

2. Ata që do të hyjnë në Zjarr dhe nuk do të hyjnë në Xhenet.

3. Ata që do të hyjnë në Zjarr, dhe pastaj do të dalin prej tij. Qëndrimi i tyre në Zjarr do të varet nga veprat e tyre të këqija, që e mbajnë në Zjarr, dhe nga veprat e tyre të mira, që e nxjerrin prej Zjarrit.

Ai që është i ndriçuar dhe e kupton këtë parim, i sheh shumë qartë tekstet ku Zoti ka bërë kërcënime për ndëshkim apo premtime për shpërblim në ahiret. Këtë nënkupton fakti që Allahu i Lartësuar është i vetmi që meriton adhurimin, i vetmi që është Zot, Krijues, Sundues, i Plotpushtetshëm dhe i Urtë. Është e pamundur që të mendojmë për Allahun të kundërtën e kësaj. Kush beson në këtë mënyrë, ka arritur sigurinë e plotë në besimin e tij. Ky lloj besimi i djeg veprat e këqija ashtu sikurse zjarri i djeg drutë e thatë. Ai që ka arritur këtë gradë të besimit është e pamundur që të vazhdojë me kokëfortësi në kryerjen e gjynaheve, sepse drita e besimit që ndodhet brenda tij e detyron që të kthehet i penduar te Zoti i tij, të Cilin e beson si Një, të Vetëm dhe të Pashoq në meritën e adhurimit. Sa herë që gabon, ai di të kthehet i penduar dhe gjithmonë e gjen Zotin e tij Falës dhe Mëshirues. Ky njeri, pa dyshim, është një nga krijesat më të mira të Allahut të Lartësuar." Këtu, me pak shkurtime, përfundon citimi nga Ibn Kajjimi, Allahu e mëshiroftë!

Ajeti 94


94. O ju që besoni, kur marshoni në rrugën e Allahut, të jeni të matur dhe të mos u thoni atyre që ju përshëndesin me selam: "Nuk jeni besimtarë!", për të arritur me këtë ndonjë fitim në jetën e kësaj bote! Tek Allahu ka begati më të mëdha. Ashtu ishit edhe ju më parë, por ishte Allahu që ju bëri mirësi! Pra, matuni mirë! Sigurisht, Allahu di gjithçka që ju bëni.

Shpjegimi i ajetit

- "O ju që besoni, kur marshoni në rrugën e Allahut, të jeni të matur..." - Allahu i Lartësuar i urdhëron besimtarët që të jenë shumë të kujdesshëm kur të dalin në xhihad për hir të Tij. Ata duhet të jenë të përmbajtur në çdo çështje që nuk është e sigurt.

Çështjet me të cilat ballafaqohen njerëzit janë dy llojesh: të qarta dhe jo të qarta. Çështjet e qarta nuk kanë nevojë për hetim dhe shqyrtim, sepse nuk kanë nevojë të qartësohen. Ndërsa çështjet jo të qarta kanë nevojë për shqyrtim dhe hetim të kujdesshëm, para se të ndërmarrësh një veprim apo qëndrim të caktuar. Shqyrtimi i tyre i mundëson njeriut të përfitojë shumë të mira dhe të ruhet nga shumë të këqija. Aftësia për të hetuar dhe gjykuar drejt këto çështje varet nga logjika, morali dhe feja e sejcilit.

Ndryshe ndodh me ata që nxitohen dhe nuk përmbahen, sepse ata gjithmonë do të gabojnë. Si pasojë, përfundimi i tyre do të jetë jo i kënaqshëm, madje edhe më keq. Atyre do t'u ndodhë ashtu siç u ndodhi gabimtarëve që përmenden në këtë ajet, të cilët Zoti i qortoi. Ata i morën jetën një grupi njerëzish që i përshëndetën me selam, vetëm sepse mund t'u merrnin pasurinë si plaçkë lufte. Allahu i Lartësuar thotë:



- "...dhe të mos u thoni atyre që ju përshëndesin me selam: "Nuk jeni besimtarë!", për të arritur me këtë ndonjë fitim në jetën e kësaj bote! Tek Allahu ka begati më të mëdha." – Kuptimi: Të mos ju shtyjë në gjynah pasuria e vogël e kësaj dynjaje, e cila shpejt do të zhduket, sepse kështu do të humbisni shpërblimin dhe mirësitë e përjetshme të premtuara nga Allahu i Lartësuar. Ato që ka premtuar Allahu i Lartësuar janë më të mira dhe të përjetshme.

Ky ajet na jep një mësim të vyer. Nëse njeriu e ndien në vetvete se po anon drejt dëshirave personale, që janë të dëmshme, menjëherë duhet të kujtojë gjithë ato mirësi të cilat Zoti i ka përgatitur për ata që e frenojnë veten nga dëshirat e shfrenuara dhe i japin përparësi kënaqësisë së Allahut dhe shpërblimit të Tij. Nëse vepron kështu, do të jetë më e lehtë për të që të kthehet e të zbatojë porositë e Zotit dhe të ruajë kufijtë e Tij.

Pastaj Allahu i Lartësuar i përkujton ata që u nxituan në veprimin e tyre me gjendjen ku ndodheshin para udhëzimit në Islam:

- "Ashtu ishit edhe ju më parë, por ishte Allahu që ju bëri mirësi! Pra, matuni mirë!" – Pra, ashtu sikurse ju udhëzoi ju pasi ishit në humbje, po kështu Zoti mund të udhëzojë edhe të tjerët.

Kështu, ftuesi i njerëzve në besim duhet të kujtojë gjithmonë gjendjen e tij të mëparshme, para se të besonte, dhe t'i trajtojë njerëzit ashtu si do të dëshironte ta trajtonin atë. Ky është një nga çelësat e suksesit në ftesën e njerëzve në Islam. Prandaj Allahu i Lartësuar na mëson si të sillemi me fillestarët në besim, duke na thënë: "Matuni mirë!".

Shihni me kujdes! Allahu i Lartësuar na ka urdhëruar që të jemi të vetëpërmbajtur dhe të kujdesshëm edhe në kohë lufte, kur mundësitë për të gabuar janë më të mëdha, edhe kur dikush mund të përshëndesë me selam thjesht për të ruajtur jetën dhe pasurinë e tij. Kjo tregon se vetëpërmbajtja dhe siguria në qëndrimet që mban është e domosdoshme në çdo kohë dhe situatë, me qëllim që ai të gjykojë e të veprojë me drejtësi.

- "Sigurisht, Allahu di gjithçka që ju bëni." - Cilido do të shpërblehet sipas punës dhe qëllimit të tij. Allahu i Lartësuar di dhe vështron çdo veprim dhe qëllim të robit, dhe gjykimi i Tij është i drejtë e i urtë.

Ajetet 95 – 96

95. Nuk janë të njëjtë ata besimtarë që rrinë në shtëpitë e tyre, përveç të paaftëve, me ata që luftojnë në rrugën e Allahut me pasurinë dhe me jetën e tyre. Ata që luftojnë me pasurinë dhe me jetën e tyre, Allahu i ngre në një shkallë më lart se ata që rrinë në shtëpi ***(me arsye)*****. Të gjithëve u ka premtuar shpërblim Allahu, por Ai i ngre luftëtarët mbi ata që nuk luftojnë, me një shpërblim të madh,**

96. **me grada të larta nga Ai, me falje gjynahesh dhe mëshirë. Allahu është Falës e Mëshirëplotë**.

Shpjegimi i ajeteve

- "Nuk janë të njëjtë ata besimtarë që rrinë në shtëpitë e tyre, përveç të paaftëve, me ata që luftojnë në rrugën e Allahut me pasurinë dhe me jetën e tyre." - Kuptimi: Nuk janë njëlloj ata që luftojnë dhe përpiqen në rrugën e Zotit me veten dhe pasurinë e tyre, me ata që nuk luftojnë kundër armiqve të Zotit.

Ky ajet nxit për të luftuar dhe për t'u përpjekur në rrugën e Zotit. Ai kërcënon ata që tregohen të plogësht dhe i largohen këtij detyrimi pa qenë të justifikuar nga Sheriati. Të paaftët, si të sëmurët, të verbërit, të gjymtuarit apo ata që nuk kanë pajime apo pasuri të mjaftueshme për të dalë në luftë, ata nuk janë të qortuar, sepse janë të justifikuar. Por edhe këto kategori, nëse janë të kënaqur që nuk shkojnë në luftë apo nëse iu mungon dëshira për të dalë në rrugën e Zotit, atëherë edhe ata janë të qortuar, njëlloj si ata që i bëjnë bisht luftës pa justifikim. Nga ana tjetër, nëse këta dëshirojnë shumë që të dalin në rrugën e Zotit, por ajo që i pengon nuk është në dorën e tyre, atëherë ata e kanë shpërblimin njëlloj sikurse ata që vërtet luftojnë. Qëllimi për të kryer një punë, i shoqëruar me ato fjalë dhe vepra që njeriu ka mundësi t'i kryejë, bën që ai ta marrë shpërblimin e plotë për punën e nisur.

- "Ata që luftojnë me pasurinë dhe me jetën e tyre, Allahu i ngre në një shkallë më lart se ata që rrinë në shtëpi *(me arsye)*. Të gjithëve u ka premtuar shpërblim Allahu, - Këtu Allahu i Lartësuar na tregon për gradën e lartë të luftëtarëve mbi ata që nuk përpiqen në këtë rrugë. Ky është dallim i shprehur në mënyrë të përgjithshme.

- "...por Ai i ngre luftëtarët mbi ata që nuk luftojnë, me një shpërblim të madh, me grada të larta nga Ai, me falje gjynahesh dhe mëshirë. Allahu është Falës e Mëshirëplotë." – Pra, më pas, Allahu i Lartësuar bën një përshkrim më të hollësishëm të këtij dallimi, duke u premtuar muxhahidëve falje gjynahesh e mbulim të metash, ashtu siç di të falë Allahu, Zoti i gjithësisë. Ai premton mëshirë, e cila është burimi i çdo të mire dhe shpëtim nga çdo e keqe.

Gradat e atyre që luftojnë në rrugën e Allahut janë të shumta, të larta dhe të mrekullueshme, sikurse ka rrëfyer Pejgamberi (a.s.) në një hadith të saktë: *"Me të vërtetë, në Xhenet janë njëqind grada. Niveli ndërmjet tyre është sa largësia mes qiellit e tokës. Zoti i ka përgatitur për ata që luftojnë në rrugën e Tij."* Ky premtim i Allahut të Lartësuar për luftëtarët në rrugën e Tij është i ngjashëm me atë në ajetet e mëposhtme:

"O ju që keni besuar, a t'ju tregoj për një tregti, e cila ju shpëton prej një dënimi të dhembshëm? Besoni Allahun dhe të Dërguarin e Tij, dhe luftoni në rrugën e Allahut me pasurinë dhe veten tuaj! Kjo është shumë herë më e mirë për ju, nëse doni ta dini. Ai *(Allahu)* ju fal gjynahet tuaja, ju fut në Xhenete, nëpër të cilët rrjedhin lumenj, dhe në pallate të bukura në Xhenetin e Adnit. Ky është suksesi më i madh. Ai do t'ju falë edhe gjëra të tjera, që ju i dëshironi: ndihmën e Allahut dhe fitoren e afërt. E pra, përgëzoji besimtarët! O ju që besuat, bëhuni ndihmës të *(fesë së)* Allahut, sikurse Isai, Biri i Merjemes, u tha dishepujve të tij: "Kush do të jetë ndihmësi im në rrugën e Allahut?" Dishepujt i thanë: "Ne do të jemi ndihmësit në rrugën e Allahut!" Kështu, disa prej bijve të Israilit besuan, e disa kundërshtuan. Ata që besuan, Ne i ndihmuam kundër armiqve të tyre dhe ata dolën fitimtarë." [Saff, 10-14].

Vini re krahasimin e shkallëzuar që bëhet në ajet mes atyre që luftojnë në rrugën e Zotit dhe të tjerëve që nuk luftojnë. Fillimisht thuhet thjesht që ata nuk janë të barabartë në vlerat e tyre dhe në shpërblimin që do marrin. Më pas deklarohet se ata që luftojnë janë më të mirë,

ndërsa në fund përmendet konkretisht se ku qëndron ky dallim: në faljen e gjynaheve, në mëshirën e madhe ndaj tyre dhe në gradat e larta në shpërblim. Ky është, sigurisht, një stil i mrekullueshëm dhe tepër efikas për shpirtin e njeriut.

Gjithashtu, kur Allahu i Lartësuar thotë se mes dy kategorive ka dallim në nivele, Ai bën një sqarim plotësues: "Të gjithëve u ka premtuar shpërblim Allahu", në mënyrë që dëgjuesi të mos mendojë se këtu synohet qortimi i kategorisë më pak të lavdëruar. Pra, vërtet lavdërohet njëra kategori, por kjo nuk duhet të kuptohet si ulje për tjetrën. Thjesht e mira ka disa nivele, prandaj dhe të mirët nuk do të jenë në njëjtin nivel.

Ajetet 97 – 99

97. Kur engjëjt u marrin shpirtin atyre që janë treguar të padrejtë ndaj vetes, i pyesin: "Ku ishit *(në lidhje me adhurimin e Zotit)* ?" Ata thonë: "Ne ishim të dobët në tokë!" Do t'i pyesin *(engjëjt)*: "A nuk ishte e gjerë toka e Allahut, që të shpërnguleshit?!". Këta janë ata, vendbanimi i të cilëve është Xhehenemi. Sa i keq është ai vendbanim!
98. Përveç atyre që janë të paaftë, qofshin burra, gra e fëmijë, të cilët nuk kanë mundësi të gjejnë as mënyrën se si, e as rrugën nga ku.
99. Për ta shpresohet që Allahu t'i falë. Allahu është Shlyes dhe Falës i gjynaheve!

Shpjegimi i ajeteve

- "Kur engjëjt u marrin shpirtin atyre që janë treguar të padrejtë ndaj vetes, i pyesin: "Ku ishit *(në lidhje me adhurimin e Zotit)*?"" - Ky kërcënim i ashpër u drejtohet atyre që nuk emigrojnë për hir të fesë së vet, edhe pse i kanë të gjitha mundësitë për ta bërë. Kur melekët t'u marrin shpirtin, do t'i qortojnë rëndë dhe do t'u thonë: "Ku ishit? Çfarë ndryshimi kishte mes jush dhe jobesimtarëve? Asnjë ndryshim! Ju u përziet me ta dhe thjesht shtuat numrin e tyre, madje ndoshta edhe bashkëpunuat me ata kundër besimtarëve. Por kështu ju e privuat veten nga mirësitë e shumta që sjell hixhreti në ndihmë të Profetit (a.s.) dhe fesë së tij dhe mbështetja e besimtarëve kundër armiqve të tyre. Ata të mjerë do të përgjigjen:

- "Ata thonë: "Ne ishim të dobët në tokë!"" – Do të ankohen dhe justifikohen se ishin të dobët, të shtypur, të pafuqishëm në tokë. Ky do të jetë pretendimi i tyre, i cili është pa vend dhe jo i drejtë. Këtë e tregon fakti që Allahu i Lartësuar i ka kërcënuar me ndëshkim, si dhe fakti që Ai nuk ngarkon asnjë njeri tej mundësive të veta. Allahu i Lartësuar i ka përjashtuar nga ky kërcënim të dobëtit, domethënë ata që vërtetë janë të pafuqishëm. Melekët u thonë atyre:

- "Do t'i pyesin *(engjëjt)*: "A nuk ishte e gjerë toka e Allahut, që të shpërnguleshit?!"" - Kjo është një pyetje retorike, sepse çdokush e di që toka e Allahut është e gjerë dhe çdokush që ndodhet në një vend ku nuk mund ta shfaqë dhe ushtrojë besimin e tij, e ka mundësinë që të largohet në një vend tjetër, ku mundet që ta adhurojë Zotin e tij, i Cili thotë në një ajet tjetër: "O robërit e Mi, të cilët keni besuar! Vërtet toka Ime është e gjerë, prandaj vetëm Mua më adhuroni!" [Ankebut, 56].

Pastaj Allahu i Lartësuar thotë për këta njerëz, të cilët nuk kanë justifikim për moslargimin nga vendi ku ndalohet besimi:

- "Këta janë ata, vendbanimi i të cilëve është Xhehenemi. Sa i keq është ai vendbanim!" - Edhe ky kërcënim shihet ashtu sikurse të gjitha tekstet e tjera kërcënuese. Pra, kjo lloj vepre është e dënueshme, por kërcënimi mund të realizohet ose jo, në varësi të plotësimit të kushteve dhe largimit të pengesave. Me fjalë të tjera, nëse kushtet nuk plotësohen dhe pengesat nuk largohen, atëherë ai nuk realizohet.

Ky ajet dëshmon se hixhreti është një nga detyrimet më të mëdha që duhet zbatuar,

ndërsa braktisja e tij konsiderohet haram, madje gjynah i madh.

Ajeti tregon gjithashtu se çdokush që vdes e ka plotësuar gjithçka të përcaktuar për të, për sa i përket afatit të jetës, veprave të kryera etj. Kjo kuptohet nga shprehja në ajet "*teueffa*". Nëse mbi të nuk do të plotësohej tërësisht kaderi i Zotit, ai nuk do të largohej nga kjo jetë.

Në këtë ajet shfaqet rëndësia e besimit rreth melekëve. Allahu i Lartësuar i lëvdon ata, duke treguar se ata janë robër të bindur të Tij, që ekzekutojnë përpikmërisht urdhrat e Tij.

- "Përveç atyre që janë të paaftë, qofshin burra, gra e fëmijë, të cilët nuk kanë mundësi të gjejnë as mënyrën se si, e as rrugën nga ku." - Kështu, Allahu i Lartësuar përjashton nga ky gjykim ata që vërtetë janë të dobët e të pafuqishëm, të cilët nuk kanë mundësi të gjejnë mënyrën se si dhe rrugën nga ku mund të bëhet shpërngulja.

- "Për ta shpresohet që Allahu t'i falë. Allahu është Shlyes dhe Falës i gjynaheve!" – Kur thuhet "shpresohet që Allahu", kuptohet: "sigurisht që Allahu". Pra, kuptimi i ajetit është: "Ata sigurisht që Allahu do t'i falë. Allahu është Shlyes dhe Falës i gjynaheve".

"Shpresohet" përdoret me qëllimin që ne të nxitemi të plotësojmë kushtet për realizimin e premtimit të Zotit. Me fjalë të tjera, nëse nuk plotësohen kushtet për zbatimin e këtij premtimi, ai mund të mos ndodhë. Pra, jini të kujdesshëm në marrëdhëniet me Zotin tuaj, që shpresa të bëhet realitet. Sa më të vërtetë të jeni në marrëdhëniet tuaja me Të, aq më e sigurt është shpresa për zbatimin e premtimit të Tij. Allahu është më i Dituri!

Nga ajeti kuptohet që çdokush që nuk ka mundësi të plotësojë ndonjë detyrim është i justifikuar tek Zoti, ashtu sikurse thotë i Lartësuari: "Nuk është gjynah *(mosdalja në luftë)* për të verbërin, për të çalin, e as për të sëmurin. Kush i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij, Ai do ta fusë në Xhenete, ku rrjedhin lumenj. E kush mbetet prapa, Ai do ta ndëshkojë me një dënim të dhembshëm." [Fet'h 17]. Këtu flitet për ata që nuk kanë mundësi të bëjnë xhihad. Gjithashtu, kur urdhëron për bindje ndaj Tij, i Lartësuari thotë: "Bindjuni Zotit aq sa të mundeni!" Ndërsa Pejgamberi (a.s.) ka thënë: "*Kur t'ju urdhëroj për diçka, zbatojeni atë aq sa të mundeni...*". Pra, njeriu nuk ka justifikim, derisa të japë maksimumin e tij dhe derisa të mos i ketë mbetur më asnjë alternativë.

Nga ajeti kuptohet se gjetja e udhërrëfyesit për atë që do të kryejë haxhin apo umren, konsiderohet si një nga kushtet e pelegrinazhit, nëse njeriu nuk e kryen dot haxhin pa një udhërrëfyes. Me fjalë të tjera, nëse ky njeri nuk e gjen dot një udhërrëfyes, atëherë ai konsiderohet prej atyre që "nuk kanë mundësi" të kryejnë haxhin, dhe kështu është i justifikuar.

Ajeti 100

100. Kush shpërngulet për hir të Allahut, ai ka për të gjetur mundësi të mëdha dhe begati në tokë. Kush del prej shtëpisë si emigrues për tek Allahu dhe i Dërguari i Tij, dhe e zë vdekja, Allahu me siguri do ta shpërblejë atë. Allahu është Falës e Mëshirëplotë.

Shpjegimi i ajetit

- "Kush shpërngulet për hir të Allahut, ai ka për të gjetur mundësi të mëdha dhe begati në tokë." - Duke treguar shpërblimin e madh të premtuar për këtë adhurim, ajeti është një nxitje për të kryer hixhret. Allahu i Lartësuar është mbajtësi më i mirë i premtimit, dhe Ai premton se cilido që bën hixhret në rrugën e Tij, duke synuar kënaqësinë e tij, patjetër do të gjejë "*murâgamen*" dhe "*siaten*" në tokë. '*Murâgamen*' është fjalë që përfshin mirësitë e fesë e të besimit, ndërsa "*siaten*" tregon mirësitë e dynjasë.

Shumë njerëz mendojnë se hixhreti shkakton veç ndarje nga njerëzit e dashur, varfëri pas pasurie, poshtërim pas krenarie dhe vuajtje pas lumturisë që e gëzoje në vendin tënd. Por e vërteta nuk është aspak kështu. Përkundrazi, besimtari, për sa kohë qëndron mes idhujtarëve, feja dhe besimi i tij janë në rrezik dhe të mangëta, qoftë në aspektin e riteve individuale, si namazi e të tjera si ai, qoftë në adhurimet me dobi më të gjerë, si xhihadi me fjalë dhe me vepra e çdo gjë që ka lidhje me të. Këto adhurime do të jenë të cunguara, sepse ai nuk i ka kushtet, mundësitë dhe mjetet për t'i zhvilluar ato në formën e tyre të plotë. Ai është i predispozuar të cenohet në besimin e tij, sidomos kur është i dobët e i pafuqishëm për t'u përballuar me sprovat. Ndërsa kur emigron për hir të Allahut në një vend tjetër, atij i mundësohet që të plotësojë fenë e tij, të luftojë armiqtë e Zotit, të fuqizojë besimin në Zotin me fjalët e veprat që do të ketë mundësi t'i kryejë. Jo vetëm kaq, por atij do t'i dhurohet edhe furnizim i bollshëm.

Dhe vërtetë ka ndodhur ashtu sikurse ka thënë i Madhëruari. Le të shohim se çfarë ndodhi me sahabët, pasi emigruan për hir të Zotit. Kur ata ikën dhe lanë pas shtëpi e pasuri, ata përmirësuan dhe përsosën imanin e tyre. Besimi i tyre i lartë, lufta dhe përpjekja për të ndihmuar fenë e Zotit i ngritën ata në grada të tilla, që i bënë prijës të çdokujt që do të vinte pas tyre. Nga lufta e tyre u çliruan shumë vende dhe iu shtuan begatitë. Ata u bënë njerëzit më të pasur dhe më të pushtetshëm të kohës. Sigurisht që kështu do të ndodhë me këdo që pason gjurmët e tyre, deri në Ditën e Gjykimit.

- "Kush del prej shtëpisë si emigrues për tek Allahu dhe i Dërguari i Tij, dhe e zë vdekja, Allahu me siguri do ta shpërblejë atë..." - Çdokush që largohet nga shtëpia si muhaxhir, duke synuar të kënaqë Zotin, në emër të dashurisë për Profetin apo në ndihmë të fesë së Tij, dhe rrugës e gjen vdekja, duke u vrarë apo për shkaqe të tjera, ky njeri do ta marrë shpërblimin e plotë te Zoti, edhe pse nuk ka arritur në destinacion. Arsyeja qëndron te qëllimi i tij, madje edhe te nisja e veprimit. Allahu ia jep shpërblimin të plotë atij dhe të gjithë atyre që veprojnë në mënyrë të ngjashme, sepse Ai është Bamirës e Bujar. Të gjithëve Ai u ka premtuar shpërblim të plotë dhe falje gjynahesh e gabimesh në veprat e tyre. Prandaj Allahu i Lartësuar e mbyll këtë ajet me dy emrat e Tij të bukur:

- "Allahu është Falës e Mëshirëplotë." - Ai është Falës për besimtarët, sidomos për ata që vazhdimisht pendohen dhe kthehen tek Ai me vepra të mira dhe bindje.

Allahu është edhe *Rrahim* – Mëshirëplotë, i Mëshirshëm për të gjitha krijesat. Me mëshirën e Tij, Ai i bëri ato të ekzistojnë dhe me mëshirën e Tij Ai i ruan në vazhdimësi. Me mëshirën e Tij, Ai i furnizon ato me pasuri dhe fuqi. Çdo mirësi prej mëshirës së Tij gjithëpërfshirëse.

Megjithatë, mëshira e Tij për besimtarët është e veçantë. Nëpërmjet kësaj mëshire, Ai i bën besimtarët të jenë të suksesshëm në fe e u jep diturinë e dobishme, e cila sjell bindjen e plotë. Kjo mëshirë u lehtëson atyre çdo mjet dhe rrugë që të çon drejt lumturisë. Vetëm prej saj ata janë të aftë të arrijnë çdo fitore dhe mirësi në këtë dynja. Po me mëshirën e Tij, ata do të shohin atë që syri nuk e ka parë, veshi s'e ka dëgjuar dhe zemra e njeriut nuk e ka përfytyruar ndonjëherë. E lusim të Mëshirshmin që të mos na privojë, për shkak të së keqes që gjendet tek ne, nga mirësitë që Ai dhuron!

Ajetet 101 – 102

101. Kur të jeni në udhëtim, nuk është gjynah për ju të shkurtoni një pjesë namazi, nëse frikësoheni se jobesimtarët mund t'ju bëjnë ndonjë të keqe. Me të vërtetë, jobesimtarët janë armiqtë tuaj të hapur.

102. Kur të jesh mes tyre *(o Muhamed)* e dëshiron t'u prish në faljen e namazit *(në*

***luftë*), atëherë disa prej tyre, le të vijnë e të falen me ty dhe le t'i mbajnë pranë edhe armët e veta. Kur të mbarojnë sexhden, këta le të qëndrojnë mbrapa jush *(në roje)* e le të vijnë ata të tjerët, që ende nuk janë falur, e le të falen me ty. Le të jenë në gjendje gatishmërie duke mbajtur armët e veta! Jobesimtarët dëshirojnë që ju të jeni të pakujdesshëm ndaj armëve e pajimeve tuaja, me qëllim që t'ju sulmojnë me tërë fuqitë. Nëse jeni të lodhur nga ndonjë shi ose jeni të sëmurë, nuk është gjynah për ju që t'i lini armët, por edhe atëherë jini syçelë! Allahu vërtet ka përgatitur dënim poshtërues për jobesimtarët.**

Shpjegimi i ajeteve

Këto dy ajete janë faktet kryesore për lejimin e shkurtimit të namazit dhe për namazin e frikës. Allahu i Lartësuar thotë:

- "Kur të jeni në udhëtim, nuk është gjynah për ju të shkurtoni një pjesë namazi, nëse frikësoheni se jobesimtarët mund t'ju bëjnë ndonjë të keqe. Me të vërtetë, jobesimtarët janë armiqtë tuaj të hapur!" - Ajeti tregon se ky është lehtësim që përfshin të gjitha llojet e udhëtimit, madje edhe nëse është për qëllime të këqija dhe të palejueshme nga Sheriati. Ky është mendimi i imam Ebu Hanifes (Allahu e mëshiroftë!), sepse shumica e dijetarëve, ku futen edhe tre imamët e tjerë kryesorë (Imam Maliku, imam Shafiu dhe imam Ahmedi), mendojnë ndryshe. Ata nuk e lejojnë lehtësimin për udhëtimet që kanë si qëllim gjynahet. Sipas tyre, ky ajet gjithëpërfshirës duhet kuptuar si i posaçëruar vetëm për udhëtimet e lejuara. Shkurtimi i namazit gjatë udhëtimit është një lehtësim nga Zoti për adhuruesit e Tij, por nga ky lehtësim nuk mund të përfitojnë ata që me këtë udhëtim synojnë mosbindjen ndaj Zotit.

Në ajet thuhet: "Kur të jeni në udhëtim, nuk është gjynah për ju të shkurtoni një pjesë namazi...". Kur thuhet se "nuk është gjynah për ju që të shkurtoni namazin", nuk duhet të kuptojmë që mosshkurtimi i namazit është më i mirë se shkurtimi i tij. Kjo shprehje nuk bie ndesh as me faktin që shkurtimi duhet kryer në rastin e caktuar. Kjo çështje është e ngjashme me atë në ajetin 158 të sures Bekare. Namazi është përcaktuar që të falet i plotë dhe dikush mund të ndihet keq po ta shkurtojë atë, prandaj kjo mënyrë e të shprehurit shërben për të qetësuar shpirtrat se nuk ka asnjë gjynah në një veprim të tillë, përderisa është i ligjëruar nga Zoti.

Faktet që tregojnë se falja e namazit të shkurtuar është më e mirë për udhëtarin sesa falja e tij e plotë janë dy:

Së pari, Pejgamberi (a.s.) vazhdimisht e ka shkurtuar namazin në udhëtimet e tij.


Së dyti, ajo është prej mëshirës, lehtësimit dhe butësisë së Allahut të Lartësuar për krijesat e Tij dhe, si e tillë, ajo duhet të pranohet duke shprehur mirënjohje për Të. Allahu i Lartësuar kënaqet kur i pranohen lehtësimet e Tij, ashtu sikundër e urren kur kryhen gjynahe.

Vini re se si Allahu i Lartësuar ka thënë: "*shkurtoni një pjesë namazi*" dhe nuk ka thënë: "*shkurtoni namazin*". Nga kjo mënyrë të shprehuri dalin dy përfitime:

1. Nëse do të thoshte "*shkurtoni namazin*", masa e shkurtimit do të ishte krejt e papërcaktuar dhe dikush do mund ta shkurtonte më tepër se ç'duhet, duke falur, për shembull, vetëm një rekat e duke menduar se kjo është e lejueshme. Por duke thënë: "*shkurtoni një pjesë namazi*" aludohet se ky shkurtim është i përcaktuar, ashtu siç dëshmohet nga Tradita e Profetit dhe e shokëve të tij.

2. Kur thuhet: "*një pjesë namazi*" , nënkuptohet gjithashtu se jo të gjitha namazet shkurtohen, dhe dihet që vetëm namazet katër-rekatësh shkurtohen, ndërsa namazi i sabahut dhe ai i akshamit nuk shkurtohen.

Në ajet bëhet edhe një kufizim tjetër: "...nëse frikësoheni se jobesimtarët do t'ju bëjnë ndonjë dëm". Dijetarët e tefsirit kanë dhënë



mendime të ndryshme lidhur me këtë kusht. I parë në kuptimin e drejtpërdrejtë, duket sikur namazi duhet të shkurtohet nëse jemi në udhëtim dhe kemi frikë nga ndonjë rrezik. Pra, në këtë këndvështrim, shkurtimi lejohet veçse kur plotësohen dy kushtet e mësipërme. Po nëse kushti i dytë nuk plotësohet, domethënë kur nuk ekziston frika, a lejohet shkurtimi i namazit? Kjo është një pyetje që ka shqetësuar edhe Omer Ibn Hatabin, i cili e pyeti Profetin (a.s.): " O i Dërguari i Allahut, përse vazhdojmë të shkurtojmë namazin (gjatë udhëtimit) tani që jemi në paqe dhe të sigurt? A nuk thotë Allahu: "Kur të jeni në udhëtim, nuk është gjynah për ju të shkurtoni një pjesë namazi, nëse frikësoheni se jobesimtarët mund t'ju bëjnë ndonjë të keqe"?" Pejgamberi (a.s.) i tha: "*Kjo është një sadaka që Zoti ju fali me bujari, prandaj pranojeni sadakanë e Tij!*"

Atëherë mund të themi se ky kusht është përmendur për arsye se kështu ndodhte zakonisht me Profetin (a.s.) dhe sahabët gjatë udhëtimeve të tyre. Ato ishin kryesisht udhëtime ushtarake dhe gjithmonë shoqëroheshin me rreziqe.

Këtu shfaqet edhe një dobi tjetër, që duhet përmendur, duke zbuluar urtësinë e shkurtimit të namazit. Namazi është lejuar që të shkurtohet për shkak të vështirësive që zakonisht shoqërojnë udhëtimet. Përmendja e frikës së bashku me udhëtimin mund të kuptohet sikur shkurtimi lejohet veçse në raste udhëtimi të shoqëruara nga frika. Por kjo nuk është e saktë, siç e shpjeguam edhe më lart. Shkurtimi i namazit bëhet në dy mënyra: në formë dhe në numër rekatësh. Kur udhëtimi shoqërohet me frikë, namazi reduktohet në formë dhe në numër rekatësh. Kur udhëtimi nuk shoqërohet me frikë, namazi nuk reduktohet në formë, por në numër rekatësh. Ndërsa kur ekziston frika dhe nuk ndodhesh në udhëtim, lejohet reduktimi vetëm në formë.

Më poshtë Allahu i Lartësuar shpjegon formën e namazit të frikës:

- "Kur të jesh mes tyre *(o Muhamed)* e dëshiron t'u prish në faljen e namazit *(në luftë)*, atëherë disa prej tyre, le të vijnë e të falen me ty dhe le t'i mbajnë pranë edhe armët e veta. Kur të mbarojnë sexhden, këta le të qëndrojnë mbrapa jush *(në roje)* e le të vijnë ata të tjerët, që ende nuk janë falur, e le të falen me ty. Le të jenë në gjendje gatishmërie duke mbajtur armët e veta!" – Kuptimi: Kur të falësh së bashku me ta namazin, duke e kryer atë në formën që duhet, ti u sqaron atyre rregullat dhe gjithçka duhet rreth namazit.

Pastaj shtjellohet forma e namazit: Disa prej besimtarëve shkojnë e falen me Profetin (a.s.). Ndërkohë, grupi tjetër qëndon në rojë dhe gatishmëri kundër armikut. Menjëherë sa grupi i parë mbarojnë sexhden, domethënë namazin, ata largohen dhe, pas tyre, shkojnë ata që vigjilonin dhe falin namazin me Profetin (a.s.).

Në ajet thuhet "Kur të mbarojnë *sexhden*", në vend të: "Kur të mbarojnë *namazin*", për të treguar rëndësinë e sexhdes dhe faktin që

ajo është një nga shtyllat e domosdoshme të namazit.

Ajeti tregon se imami, pas përfundimit të namazit nga grupi i parë, vazhdon të qëndojë në namaz për të pritur grupin e dytë. Ai vazhdon të falë me grupin e dytë pjesën e mbetur të namazit dhe pret derisa ata të plotësojnë faljen e tyre. Përfundimisht, imami jep selam së bashku me ta. Kjo është njëra nga mënyrat e faljes së namazit të frikës, e transmetuar saktësisht edhe si praktikë e Profetit (a.s.), bashkë me mënyrat e tjera.

Ky ajet tregon, gjithashtu, se falja e namazit me xhemat është detyrim individual. Kjo kuptohet nga dy momente të ajetit. Së pari, Allahu i Lartësuar e bëri detyrë të falemi me xhemat edhe gjatë luftës, kur frika dhe rreziku është aq i madh, e kjo tregon se në kushte të tjera më komode, ajo është edhe më tepër e detyrueshme. Së dyti, gjatë namazit të frikës, tolerohen shumë mangësi të tij, vetëm e vetëm që të bëhet e mundur falja e namazit me xhemat.

Kjo tregon rëndësinë e madhe të xhematit. Sikur të mos ishte i detyrueshëm namazi me xhemat, nuk do të lejohej lënia e disa veprave të tjera, që në kushte normale nuk do të liheshin.

Ajeti, gjithashtu, tregon se më e mira dhe më e drejta është falja me xhemat vetëm pas një imami, jo pas disa imamëve. Duke qenë se atëherë ekzistonte mundësia që besimtarët të faleshin me disa imamë, por ata u urdhëruan të faleshin vetëm me një imam, kjo tregon rëndësinë e madhe të kësaj çështjeje. Përçarja në grupe nuk është e lejuar, ndërsa bashkimi rreth një imami të vetëm tregon unitet, krenari dhe forcë kundrejt armikut.

Allahu i Lartësuar urdhëroi secilin grup që të mbajnë me vete dhe gati armët dhe të jenë të vëmendshëm e të kujdesshëm gjatë namazit të frikës. Edhe pse kjo mund të çojë në disa lëvizje dhe veprime të palejueshme gjatë namazit, ato konsiderohen të tolerueshme, për shkak të dobisë dhe nevojës. Dobia në këtë rast është kryerja njëkohësisht edhe e namazit, edhe e xhihadit. Nevoja është ruajtja nga qafirët, të cilët në çdo moment synojnë dëmtimin e muslimanëve dhe grabitjen e të mirave të tyre. Prandaj Allahu i Lartësuar thotë:

- "Jobesimtarët dëshirojnë që ju të jeni të pakujdesshëm ndaj armëve e pajimeve tuaja, me qëllim që t'ju sulmojnë me tërë fuqitë."

Pastaj Allahu i Lartësuar ua lejon atyre që janë të sëmurë apo kur është mot me shi, që të mos i mbajnë armatimet, por gjithmonë duke qenë të kujdesshëm dhe të vëmendshëm:

- "Nëse jeni të lodhur nga ndonjë shi ose jeni të sëmurë, nuk është gjynah për ju që t'i lini armët, por edhe atëherë jini syçelë! Allahu vërtet ka përgatitur dënim poshtërues për jobesimtarët." - Pjesë e ndëshkimit poshtërues është edhe urdhri i Zotit për besimtarët, për t'i vrarë armiqtë e tyre kudo që t'i zënë dhe për të qenë gjithmonë vigjilentë, që armiqtë të mos ia arrijnë kurrë qëllimit të tyre të zi.

Allahu qoftë i Lavdëruar dhe i Lartësuar për mirësitë e shumta me të cilat Ai i ka dalluar besimtarët e Tij mbi të tjerët! Ndër mirësitë më të mëdha janë këto lehtësime, me të cilat Ai i ka ngritur ata në gradat e larta të përsosmërisë dhe krenarisë. Me të tilla dhunti, ata nuk do të mposhten kurrë.

Ajeti 103

103. Pasi të falni namazin *(e frikës)*, përmendeni Allahun kur jeni në këmbë, ulur apo të mbështetur. E kur të jeni të qetë *(nga lufta)*, atëherë faleni namazin në mënyrë të rregullt, sepse namazi është detyrim i përcaktuar për besimtarët.

Shpjegimi i ajetit

- "Pasi të falni namazin *(e frikës)*, përmendeni Allahun kur jeni në këmbë,

ulur apo të mbështetur." – Kuptimi: Pasi të përfundoni namazin e frikës apo namazet normale, përmendeni Allahun e Lartësuar në të gjitha gjendjet dhe situatat tuaja.

Allahu i Lartësuar përmend namazin e frikës në mënyrë të veçantë, për arsye të veçanta:

1. Përmirësimi i zemrës dhe lumturia e saj arrihet veçse nëpërmjet kthimit tek Allahu i Lartësuar me pendesë, bindje, përulje, dashuri dhe drojë ndaj Tij, me përkujtim të Tij dhe me lavdërime për Të. Sigurisht, në momente frike, nevoje apo lufte, njeriu ka më tepër nevojë për këto ndjenja, që sjellin forcë, lumturi dhe qëndrueshmëri.

2. Nuk ka dyshim se namazi është vepra më e mirë, përmes të cilit arrihen këto qëllime të larta, sepse namazi është lidhja e robit me Zotin e tij. Namazi është vepra më e rëndësishme që vërteton besimin dhe sigurinë në të, prandaj dhe Allahu i Lartësuar e ka bërë detyrim për adhuruesit e Tij që të falen gjatë natës dhe ditës.

3. Përgjatë namazit të frikës, shumë nga elementët e tij, që shkaktojnë ndjenja të fuqishme tek adhuruesi, nuk realizohen plotësisht, prandaj dhe urdhri për ta përkujtuar Allahun pas këtij namazi është me shumë vend. Kjo bëhet, pra, për të përmbushur edhe ndonjë boshllëk a mangësi të mbetur.

4. Frika shkakton dobësimin e zemrës dhe të trupit, dhe kështu ajo sjell dobësi në përballjen me armikun. Prandaj vjen urdhri për të përmendur sa më shpesh Allahun, sepse dhikri është një nga forcuesit dhe qetësuesit më të mëdhenj të zemrës.

5. Përmendja e Zotit, e shoqëruar me durimin dhe qëndrueshmërinë, është një nga faktorët më vendimtarë për arritjen e suksesit dhe fitores. I Lartësuari thotë: "O ju që keni besuar, kur të ndesheni me ndonjë ushtri, përqendrohuni dhe përmendni vazhdimisht Allahun, që ta arrini fitoren e dëshiruar. Bindjuni Allahut e të Dërguarit të Tij, e mos u përçani mes njëri-tjetrit, se kështu do të dobësoheni e do ta humbni fuqinë tuaj. Jini të durueshëm, se Allahu është me të durueshmit." [Enfal 45]. Kështu, nxitja për përkujtimin e Zotit në gjendje të tilla të vështira është shumë e vlefshme dhe me vend.

- "E kur të jeni të qetë *(nga lufta)*, atëherë faleni namazin në mënyrë të rregullt..." - Nëse mbaron gjendja e luftës ose largohet rreziku dhe ju qetësoheni, atëherë kryejeni namazin në formën më të plotë, qoftë me veprimet e tij të jashtme, qoftë me veprimet e brendshme të zemrës.

- "...sepse namazi është detyrim i përcaktuar për besimtarët." - Namazi është bërë detyrë për besimtarët që ta kryejnë në kohët e përcaktuara nga Zoti, prandaj nuk lejohet të neglizhohet ky kusht. Këto kohë u janë qartësuar muslimanëve të vegjël dhe të mëdhenj, të diturve dhe të paditurve. Të gjithë i kanë mësuar këto kohë nga Profeti i tyre, Muhamedi (a.s.), i cili i porositi: *"Faluni ashtu siç më keni parë mua të falem!"*

Shprehja: "...për besimtarët" tregon se falja e namazit është matës dhe tregues i besimit. Në varësi të besimit, do të jetë edhe kryerja e namazit në sasi dhe cilësi. Ajo tregon, gjithashtu, se jomuslimanët që jetojnë në shtetin islam, edhe pse janë të detyruar që të respektojnë ligjet e tij, ata nuk urdhërohen që të ushtrojnë ritet fetare islame, siç është falja e namazit. Madje, namazi i tyre është i pavlefshëm, përderisa ata vazhdojnë të jenë në kufër. Ndërsa në ahiret, ata do të ndëshkohen për lënien e adhurimeve.

Ajeti 104

104. "Mos u tregoni të dobët në ndjekjen e armikut, sepse nëse ju ndieni dhimbje, edhe ata, sikurse ju, ndiejnë dhimbje, por ju shpresoni nga Allahu atë çka ata nuk e shpresojnë. Allahu është i Ditur e i Urtë".

Shpjegimi i ajetit

- "Mos u tregoni të dobët në ndjekjen e armikut..." – Pra, mos tregoni dobësi e plogështi në ndjekjen dhe sulmin kundër armiqve jobesimtarë. Mos tregoni dobësi e plogështi në zhvillimin e luftës në rrugën e Zotit dhe gjithmonë qëndroni syçelë e në gatishmëri. Dijeni se dobësia e zemrës sjell dobësimin trupor, dhe kjo dëmton qëndrueshmërinë në luftën kundër qafirëve. Pra, jini të fuqishëm dhe aktivë në luftë!

Pastaj Allahu i Lartësuar thotë diçka që i forcon zemrat e besimtarëve:

- "...sepse nëse ju ndieni dhimbje, edhe ata, sikurse ju, ndiejnë dhimbje, por ju shpresoni nga Allahu atë çka ata nuk e shpresojnë." – Kuptimi: Nëse ju ndieni dhimbje e lodhje, ta dini se nuk jeni të vetmit që i provoni. Edhe qafirët i vuajnë ato, dhe në këtë aspekt jeni të barabartë, prandaj nuk ju takon juve të shkurajoheni për hir të këtyre dhimbjeve e plagëve. Dinjiteti juaj nuk duhet t'ju lejojë që të përuleni përpara të tilla vështirësish. Është e pranueshme që herë të mundesh e herë të fitosh mbi armiqtë, por që të shkurajohesh para tyre tregon dobësi nga ana juaj. Ju shpresoni prej Allahut atë që ata nuk e shpresojnë. Ju shpresoni të gëzoni mirësitë e Tij të mrekullueshme dhe të shpëtoni nga ndëshkimi i Tij. Madje, besimtarët e zgjedhur kanë qëllime më të larta. Ata synojnë dhe punojnë për të ndihmuar fenë e Allahut, për të zbatuar Sheriatin dhe për të përhapur më gjerë Islamin. Ata përpiqen për udhëzimin e të humburve dhe për mposhtjen e armiqve të besimit. Këto objektiva të larta i motivojnë besimtarët e sinqertë dhe iu japin atyre forcë dhe guxim të vazhdueshëm. Nuk ka të krahasuar mes atyre që synojnë vetëm krenarinë e kënaqësinë në këtë botë, që edhe mund të mos e arrijnë, dhe atyre që synojnë dhe luftojnë për arritjen e lumturisë së dynjasë dhe të ahiretit, për fitoren e kënaqësisë së Zotit dhe për Xhenetin e premtuar nga Ai, dhe që sigurisht do t'i arrijnë.

I Lartësuar dhe i Lavdëruar qoftë Allahu i Madhërishëm, që i dalloi robërit e Tij të sinqertë me mirësi të shumta mbi robërit e tjerë. Dallimi i tyre është bërë prej diturisë dhe urtësisë së Tij të madhe dhe absolute. Prandaj i Lartësuari thotë në fund të këtij ajeti:

- "Allahu është i Ditur e i Urtë." - Pra, Allahu është i plotë në dijen e Tij dhe në urtësinë e Tij.

Ajetet 105 – 113

105. Ne të zbritëm ty *(Muhamed)* Librin *(Kur'ânin)* me plot të vërteta, që të gjykosh mes njerëzve me atë që të mësoi Allahu. Mos u dil në krah tradhtarëve!
106. Kërkoji falje Allahut, se Allahu është Falës e Mëshirues.
107. Mos polemizo për ata që tradhtojnë vetveten! Allahu nuk i do ata që janë tradhtarë e gjynahqarë.
108. Ata fshihen prej njerëzve e nuk ruhen prej Allahut, ndërkohë që Ai është afër tyre edhe kur thurin plane, me të cilat Ai nuk është i kënaqur. Allahu i përfshin të gjitha veprimet e tyre.
109. Ju polemizoni për t'i mbrojtur ata në jetën e kësaj bote. Por kush do të polemizojë me Allahun për ta Ditën e Gjykimit dhe kush do të bëhet përfaqësuesi i tyre?!
110. Kush bën ndonjë të keqe ose e ngarkon veten me padrejtësi, pastaj kërkon falje tek Allahu, do ta gjejë Allahun Falës e Mëshirues.
111. Kush bën gjynah, ka ngarkuar veç vetveten! Allahu është i Gjithëdijshëm e i Urtë.
112. Kush bën ndonjë gabim ose gjynah, e pastaj atë ia hedh një të pafajshmi, në të vërtetë ai është ngarkuar me fajin e shpifjes dhe me një gjynah të qartë.
113. Po të mos ishte mirësia e Allahut dhe mëshira e Tij ndaj teje, një grup prej tyre do të tentonin të të devijonin ty, por ata nuk devijojnë asnjë, veç vetes së tyre, dhe nuk mund të të dëmtojnë aspak! Allahu të

shpalli ty Librin dhe Urtësinë e të mësoi atë çka nuk dije. Mirësia e Allahut ndaj teje është shumë e madhe.

Shpjegimi i ajeteve

- "Ne të zbritëm ty *(Muhamed)* Librin *(Kur'ânin)* me plot të vërteta, që të gjykosh mes njerëzve me atë që të mësoi Allahu." - Allahu i Lartësuar tregon se ia shpalli Kur'ânin robit të Tij, Muhamedit (a.s.), me vërtetësi, të ruajtur dhe të sigurt nga ndikimi i Shejtanit të mallkuar, si edhe të ruajtur nga devijimet dhe shtrembërimet. Ai është një libër i vërtetë, ashtu si ka dashur Zoti i Lartësuar. Kumtet e tij janë të vërteta, ndërsa urdhrat dhe ndalesat e përcaktuara në të janë të drejta. Thotë i Lartësuari në një ajet tjetër: "Fjalët e Zotit janë të plota në vërtetësinë dhe drejtësinë e tyre."

Allahu i Lartësuar na tregon se e shpalli Kur'ânin që njerëzit të gjykojnë me të. Në një ajet tjetër, Ai thotë: "Ne dërguam edhe para teje burra, të cilëve u dhamë Shpallje. Pyetni, pra *(o idhujtarë),* dijetarët e Librit, nëse ju vetë nuk dini. Me argumente *(i dërguam)* e me libra të shenjtë. Ndërsa ty ta shpallëm Përkujtimin *(Kur'ânin),* që t'u shpjegosh njerëzve atë që u është shpallur atyre dhe që ata të mendojnë." [Nahl 44]. Ka mundësi që ky ajet t'i referohet gjykimit të atyre çështjeve për të cilat njerëzit kanë mosmarrëveshje, ndërsa ajeti i sures Nisa, të cilin po komentojmë, t'i referohet sqarimit të çështjeve fetare në tërësi, kryesore qofshin apo degëzime të saj. Megjithatë, ka mundësi që të dy ajetet të kenë të njëjtin kuptim: të pohojnë se Kur'âni është shpallur për t'u dhënë gjykim të drejtë të gjitha çështjeve, pa përjashtim. Allahu i Lartësuar e dërgoi Profetin (a.s.) për të gjykuar me drejtësi mes njerëzve, për çdo lloj çështjeje.

Allahu i Lartësuar ka thënë diçka në këtë ajet, që na jep të kuptojmë shumë. Ai thotë: "...të gjykosh mes njerëzve me atë që të mësoi Allahu". Pra, jo sipas dëshirës së Profetit (a.s.), por duke u bazuar në dijen që i mësoi Zoti. Kjo do të thotë që Pejgamberi (a.s.) gjykonte vetëm i bazuar në dijen dhe udhëzimin që i jepte Zoti, sikurse thotë i Lartësuari në një ajet tjetër: "Ai *(Profeti)* nuk flet nga mendja e tij. Ai *(Kur'âni)* është veç Shpallje që i zbulohet atij." [Nexhm 3, 4]. Siç kuptohet, Pejgamberi (a.s.) ishte i ruajtur nga gabimet në drejtim të përcjelljes së Shpalljes hyjnore dhe nga gabimet në gjykimet fetare.

Gjithashtu, ajeti tregon se një gjykim i drejtë duhet të jetë i bazuar në dije dhe në drejtësi. Allahu i Lartësuar thotë: "me atë që të mësoi Allahu", dhe nuk thotë: "*sipas dëshirës tënde*". Kështu, për të gjykuar drejt mes njerëzve, duhet të njohim Kur'ânin.

Duke na urdhëruar që të gjykojmë mes njerëzve me drejtësi dhe paanshmëri, Allahu i Lartësuar na ka ndaluar në të njëjtën kohë edhe nga padrejtësia, e cila është e kundërta e drejtësisë:

- "Mos u dil në krah tradhtarëve!" – Pra, kurrë mos polemizo për të mbrojtur një njeri tradhtia e të cilit të është bërë e qartë dhe e ditur, ose një njeri që pretendon të marrë diçka që nuk i takon, ose atë që mohon përgjegjësitë e veta me ndërgjegje të plotë!

Ky ajet tregon për ndalimin e polemikës për çështje të pabaza, si dhe ndalimin e mbështetjes së të padrejtëve, qoftë në polemikat fetare, qoftë në ato për çështjet e kësaj bote.

Në vështrim të anasjelltë, ajeti tregon se lejohet të mbështesësh një njeri, për të cilin nuk dihet të ketë bërë padrejtësi.

- "Kërkoji falje Allahut, se Allahu është Falës e Mëshirues." - Kërkoji falje Allahut, nëse ke bërë ndonjë gabim në raste të tilla ose në raste të tjera, se Ai është Falës i gjynaheve. Allahu fal edhe gjynahet e mëdha, nëse njeriu pendohet dhe kthehet tek Ai me përunjësi, i bindur dhe i nënshtruar. Madje, jo vetëm që ia pranon pendimin dhe ia mbulon gabimet, por i jep forcë dhe sukses që të vazhdojë adhurimin


me vepra të mira, për të cilat Allahu ka premtuar shpërblim të madh.

- "Mos polemizo për ata që tradhtojnë vetveten!" - Fjala: "*jahtanune*" vjen nga "*el hijanetu*", e cila ka kuptimin: krim, tradhti, padrejtësi, gjynah etj. Pra, Allahu i Lartësuar na ndalon të mbështesim ata që i bëjnë padrejtësi vetes dhe të tjerëve me gjynahet dhe pabesitë e tyre. Më kryesorët janë ata që bëjnë gjynahe për të cilat Sheriati ka vendosur masa ndëshkimore. Është e palejueshme që një besimtar të dalë në mbrojtje të këtyre lloj njerëzve, për t'i shpëtuar ata prej ndëshkimit të përcaktuar në Sheriat. E si mund të dalësh në mbrojtje të dikujt që Zoti nuk e do?!

- "Allahu nuk i do ata që janë tradhtarë e gjynahqarë." - Allahu i Lartësuar nuk i do ata që bëjnë padrejtësi, gjynahe e tradhti. Nëse Ai thotë se nuk i do, kjo nënkupton se i urren ata. Kështu kuptojmë shkakun dhe urtësinë e ndalesës së mësipërme. Pra, ne nuk duhet të ndihmojmë ata që bëjnë tradhti dhe padrejtësi, sepse Allahu i urren ata.

Më poshtë, Allahu i Lartësuar përshkruan gjendjen e këtyre të pabesëve dhe të padrejtëve, kur thotë:

- "Ata fshihen prej njerëzve e nuk ruhen prej Allahut, ndërkohë që Ai është afër tyre edhe kur thurin plane, me të cilat Ai nuk është i kënaqur." - Kjo vjen nga dobësia e imanit të tyre. Pra, duke qenë se kanë besim të dobët, ata kanë më shumë frikë nga njerëzit sesa nga Allahu i Madhërishëm, prandaj përpiqen me çdo mënyrë, e lejuar apo e palejuar qoftë, që t'i shpëtojnë demaskimit para njerëzve, për padrejtësitë e tyre të dënueshme. Ndërkohë, ata harrojnë që Allahu i Madhërishëm i ka parë dhe i ka dëshmuar padrejtësitë e tyre të mëdha. Allahu i Gjithëdijshëm dhe i Plotpushtetshëm është gjithmonë pranë tyre me dijen e Tij, në çdo gjendje, sidomos kur


الجزء الخامس سورة النساء
وَٱسْتَغْفِرِ ٱللَّهَ إِنَّ ٱللَّهَ كَانَ غَفُورًا رَّحِيمًا ﴿١٠٦﴾ وَلَا تُجَٰدِلْ
عَنِ ٱلَّذِينَ يَخْتَانُونَ أَنفُسَهُمْ ۚ إِنَّ ٱللَّهَ لَا يُحِبُّ مَن كَانَ
خَوَّانًا أَثِيمًا ﴿١٠٧﴾ يَسْتَخْفُونَ مِنَ ٱلنَّاسِ وَلَا يَسْتَخْفُونَ
مِنَ ٱللَّهِ وَهُوَ مَعَهُمْ إِذْ يُبَيِّتُونَ مَا لَا يَرْضَىٰ مِنَ ٱلْقَوْلِ ۚ
وَكَانَ ٱللَّهُ بِمَا يَعْمَلُونَ مُحِيطًا ﴿١٠٨﴾ هَٰٓأَنتُمْ هَٰٓؤُلَآءِ
جَٰدَلْتُمْ عَنْهُمْ فِى ٱلْحَيَوٰةِ ٱلدُّنْيَا فَمَن يُجَٰدِلُ ٱللَّهَ عَنْهُمْ
يَوْمَ ٱلْقِيَٰمَةِ أَم مَّن يَكُونُ عَلَيْهِ وَكِيلًا ﴿١٠٩﴾ وَمَن يَعْمَلْ
سُوٓءًا أَوْ يَظْلِمْ نَفْسَهُۥ ثُمَّ يَسْتَغْفِرِ ٱللَّهَ يَجِدِ ٱللَّهَ غَفُورًا
رَّحِيمًا ﴿١١٠﴾ وَمَن يَكْسِبْ إِثْمًا فَإِنَّمَا يَكْسِبُهُۥ عَلَىٰ نَفْسِهِۦ ۚ
وَكَانَ ٱللَّهُ عَلِيمًا حَكِيمًا ﴿١١١﴾ وَمَن يَكْسِبْ خَطِيٓـَٔةً
أَوْ إِثْمًا ثُمَّ يَرْمِ بِهِۦ بَرِيٓـًٔا فَقَدِ ٱحْتَمَلَ بُهْتَٰنًا وَإِثْمًا مُّبِينًا
﴿١١٢﴾ وَلَوْلَا فَضْلُ ٱللَّهِ عَلَيْكَ وَرَحْمَتُهُۥ لَهَمَّت طَّآئِفَةٌ مِّنْهُمْ
أَن يُضِلُّوكَ وَمَا يُضِلُّونَ إِلَّآ أَنفُسَهُمْ ۖ وَمَا يَضُرُّونَكَ
مِن شَىْءٍ ۚ وَأَنزَلَ ٱللَّهُ عَلَيْكَ ٱلْكِتَٰبَ وَٱلْحِكْمَةَ وَعَلَّمَكَ
مَا لَمْ تَكُن تَعْلَمُ ۚ وَكَانَ فَضْلُ ٱللَّهِ عَلَيْكَ عَظِيمًا ﴿١١٣﴾
٩٦

ata thonë fjalë e thurin kurthe të cilat i Gjithëmëshirshmi nuk i do.

Ata bënin plane si të nxirrnin të pafajshëm kriminelin dhe si të fajësonin një të pafajshëm, dhe për këtë qëllim argumentonin para Profetit (a.s.). Kështu ata bënin disa padrejtësi, pa e përfillur mbikëqyrjen e Zotit të qiejve dhe të tokës, i Cili e dinte dhe e shihte se çfarë fshihnin brenda shpirtrave. Prandaj i Madhëruari i kërcënoi ata, duke u përmendur këtë fakt:

- "Allahu i përfshin të gjitha veprimet e tyre." - Allahu i Lartësuar përfshin gjithçka me dijen dhe pushtetin e Tij. Megjithatë, Ai nuk nxitohet për t'i ndëshkuar të padrejtët. Ai i afatizon dhe vazhdimisht i fton për t'u penduar dhe për të mos vazhduar me gjynahet e tyre. Ai u tërheq vazhdimisht vëretjen, sepse ndëshkimi i Tij është i drejtë dhe i rreptë.

- "Ju polemizoni për t'i mbrojtur ata në jetën e kësaj bote. Por kush do të

polemizojë me Allahun për ta Ditën e Gjykimit dhe kush do të bëhet përfaqësuesi i tyre?!" – Kuptimi: Le ta supozojmë se i shpëtuat ata nga turpërimi para njerëzve në këtë botë. Po sa do t'u vlejë atyre kjo Ditën e Gjykimit?! Kush mund të polemizojë me Allahun për t'i mbrojtur atë ditë, kur e vërteta do të shpallet para fytyrave të tyre?! Atë ditë, gjuha, duart dhe këmbët e tyre do të dëshmojnë me vërtetësi se çfarë kanë bërë ata. Në suren Nur, ajeti 25, i Lartësuari thotë: "Atë ditë, Allahu ua jep të plotë shpërblimin e merituar. Ata e dinë se Allahu është e Vërteta e qartë".

E kush mund të polemizojë me Atë që njeh të fshehtat vetë dhe të fshehtat e të fshehtave, aq më tepër atë ditë kur Ai do të sjellë dëshmi të pamohueshme dhe dëshmitarë të pakundërshtueshëm?

Në këtë ajet, Allahu i Lartësuar na jep një porosi shumë të rëndësishme. Ai na nxit që të meditojmë dhe të krahasojmë mirësitë e dynjasë me mirësitë e ahiretit, të cilat varen nga zbatimi i urdhrave të Tij. Pra, Ai sikur na thotë: "Kur nefsi ju nxit për të mos zbatuar ndonjë urdhër të Zotit, me pretendimin e arritjes së ndonjë të mirë në këtë dynja, shqyrtojeni me kujdes këtë ftesë tinzare e thuajini vetes: "Ja, e le pa zbatuar këtë urdhër të Zotit tënd, por çfarë përfitove nga kjo dynja? Po në jetën tjetër, çfarë shpërblimi të Zotit ke për të humbur?" Kujto, gjithashtu, dëshpërimin dhe ndëshkimin që mund të vuash, për shkak të shpërfilljes së urdhrit të Zotit!"

Gjithashtu, nëse nefsi ju nxit drejt dëshirave të shfrenuara, të cilat Zoti i ka ndaluar, thuajini atij: "Edhe nëse ti arrin ta plotësosh një dëshirë të shfrenuar, që Zoti e ka ndaluar, dije se ajo është një kënaqësi e shkurtër dhe e përkohshme. Kur ajo të mbarojë, vendin e saj do ta zërë dëshpërimi, mërzitia, ankthi dhe trishtimi për shpërblimet e humbura dhe për ndëshkimin që e pret." Vetëm një pjesë e hidhërimit të këtyre që përmendëm do të ishte e mjaftueshme që njeriu të largohej prej këtyre "ftesave" dashakeqe.

Vërtet, meditimi i sjell robit dobi të shumta, sidomos kur peshon drejt të mirat dhe të këqijat. Ata që pretendojnë se janë të logjikshëm, por që i japin përparësi kënaqësive të përkohshme të kësaj jete, ata nuk janë të tillë, por janë veç injorantë dhe të padrejtë. Allahu na ndihmoftë!

- "Kush bën ndonjë të keqe ose e ngarkon veten me padrejtësi, pastaj kërkon falje tek Allahu, do ta gjejë Allahun Falës e Mëshirues." - Çdokush që merr guximin e bën gjynahe, por më pas i kërkon falje Allahut të Madhëruar, ai ka për ta gjetur Allahun Falës dhe Mëshirues.

Kërkimi i plotë i faljes nënkupton që ai të pranojë gabimin, të ndiejë keqardhje për veprimin e tij, të largohet nga ai dhe të jetë i vendosur që të mos kthehet më në të. Atyre që plotësojnë këto kushte, Allahu u ka premtuar falje dhe mëshirë, dhe Ai nuk e thyen kurrë premtimin. Ai ua fal gjynahet, ua mbulon dhe plotëson të metat që lënë gjynahet dhe ua rikthen të plotë shpërblimin. Përveç kësaj, Ai u jep forcë dhe sukses që, në pjesën e mbetur të jetës së tyre, ata të vazhdojnë të adhurojnë, duke mos lejuar që gjynahet të bëhen pengesë për në rrugën e drejtë. Kur Allahu i Madhërishëm e fal dikë, Ai ia mbulon të metat dhe ia fshin pasojat që gjynahet lënë në jetën e njeriut.

Allahu i Lartësuar në ajet thotë: "*Kush bën ndonjë të keqe...*". Fjala "*suuen*" - "e keqe", nëse përdoret si e papërcaktuar në fjali, i përfshin të gjitha llojet e gjynaheve, të mëdha dhe të vogla. Kjo fjalë e ka prejardhjen nga "*sâe jesû'u*", që do të thotë "trishtuese, dëshpëruese". Pra, gjynahet janë quajtur kështu, sepse ato sjellin ndëshkim dhe dëshpërim për vepruesit e tyre, dhe sepse ato në vetvete nuk janë të mira.

Edhe në fjalinë: "*...e ngarkon veten me padrejtësi*", fjala "padrejtësi" është e papërcaktuar, prandaj ajo i përfshin të gjitha

llojet e padrejtësive, duke filluar nga padrejtësia më e madhe, që është idhujtaria, dhe duke vazhduar me të tjerat poshtë saj.

Por kur këto dy fjalë përdoren të shoqëruara me njëra-tjetrën, domethënë "e keqe dhe padrejtësi", secila prej tyre ka një kuptim më specifik, të përshtatshëm me kontekstin. Kështu, në rastin tonë, fjala "e keqe" ka për qëllim padrejtësitë ndaj njerëzve, që cenojnë jetën, pasurinë dhe nderin e tyre. Ndërsa "padrejtësia ndaj vetes" nënkupton padrejtësinë ndaj Zotit, domethënë gjynahet që cenojnë të drejtat e Zotit.

Allahu i Lartësuar ka thënë: "*...e ngarkon veten me padrejtësi*", sepse vetja jote nuk është prona jote, me të cilën mund të veprosh si të duash. Ajo është pronë e Allahut të Madhërishëm, të cilën ta ka lënë amanet për ta mbajtur në rrugën e drejtë dhe që ta nënshtrosh të ruajë drejtësinë. Ai të ka urdhëruar që ta ushqesh veten tënde me dituri të vlefshme dhe që ta nënshtrosh atë për të vepruar sipas kësaj dijeje, me sinqeritet vetëm për Të, Zotin e vetëm, Allahun e Madhërishëm. Njeriu duhet të mësojë porositë që i janë dhënë dhe duhet të punojë sipas tyre. Çdo rrugë tjetër e ndryshme është dhunë ndaj vetvetes, tradhti ndaj saj dhe largim nga drejtësia.

- "Kush bën gjynah, ka ngarkuar veç vetveten!" - Kjo përfshin çdo lloj vepre që të ngarkon me gjynah, e madhe apo e vogël qoftë. Pra, kushdo që bën ndonjë të keqe, ta dijë se pasojat e saj në dynja dhe në ahiret do të rëndojnë veçse mbi atë vetë, që e bëri të keqen, e mbi asnjë tjetër. Kështu thotë Allahu i Madhërishëm në një ajet tjetër: "Thuaj: "A të kërkoj zot tjetër veç Allahut, kur Ai është Zot i gjithçkaje?! Çdokush që bën një të keqe, ajo do t'i rëndojë mbi vetveten dhe askush nuk do të bartë barrën e tjetrit. Pastaj të gjithë do të ktheheni te Zoti juaj, i Cili do t'ju sqarojë gjërat për të cilat ju kishit kundërshtime mes njëri-tjetrit." [En'am 164].

Por çfarë ndodh nëse gjynahet shtohen dhe askush nuk urdhëron për të mirë dhe nuk ndalon nga e keqja? Në të tilla raste, ndëshkimi është gjithëpërfshirës; ai rëndon mbi të gjithë njerëzit. Kur njerëzit nuk urdhërojnë për të mira dhe nuk ndalojnë nga e keqja, edhe kjo është një e keqe në vetvete, prandaj meriton ndëshkimin. Pra, ajeti i mësipërm e përfshin edhe këtë rast.

Ky ajet tregon qartë drejtësinë dhe urtësinë e Allahut të Madhërishëm, i Cili nuk ndëshkon asnjë për faj të dikujt tjetër dhe nuk ndëshkon asnjë më shumë sesa e meriton për gjynahet që ka bërë. Prandaj Allahu i Lartësuar e mbyll ajetin duke thënë:

- "Allahu është i Gjithëdijshëm e i Urtë." – Allahut i takon dija absolute dhe urtësia e plotë. Ai e di shumë mirë se çfarë gjynahesh bën robi dhe gjithçka tjetër. Ai i di edhe shkaqet që e kanë shtyrë dikë për të bërë një gjynah, ashtu siç di edhe ndëshkimin që është përcaktuar për atë gjynah. Ai e di shumë mirë gjendjen e gjynahqarit, prandaj, nëse ai e ka kryer gabimin i mposhtur nga vetvetja, e cila e urdhëron për keq, por që është kthyer tek Allahu i Madhërishëm me pendim, i nënshtruar dhe i bindur, Ai pa dyshim që do ta falë, do t'ia mbulojë të metat dhe do t'ia pranojë pendimin. Por nëse ai vazhdimisht bën gjynahe, duke shpërfillur mbikëqyrjen e Allahut e duke mos marrë në konsideratë ndëshkimin e Tij, atëherë ai është shumë larg faljes dhe vështirë se i jepet sukses për t'u penduar.

Pastaj Allahu i Lartësuar thotë:

- "Kush bën ndonjë gabim ose gjynah, e pastaj atë ia hedh një të pafajshmi, në të vërtetë ai është ngarkuar me fajin e shpifjes dhe me një gjynah të qartë." - Kushdo që bën një gabim të madh apo të vogël, dhe pastaj akuzon për këtë faj dikë tjetër, që është i pafajshëm, ai është ngarkuar me fajin e shpifjes e me gjynah të qartë. Ai e ka ngarkuar veten me gjynahun e shpifjes kundër një të pafajshmi dhe ka bërë një

vepër të rëndë për të merituar ndëshkimin. Kjo tregon se një vepër e tillë konsiderohet si një nga gjynahet e mëdha dhe shkatërruese. Ajo përmban në vetvete disa të këqija, si: kryerja e gjynahut, akuzimi i një të pafajshmi, mashtrimi, pretendimi i pafajësisë në mënyrë të padrejtë dhe ndëshkimi i padrejtë i një të pafajshmi. Përveç kësaj, është edhe cënim i figurës së të pafajshmit në shoqëri. Këto janë padrejtësi të shëmtuara, që sjellin probleme të mëdha në shoqëri. E lusim Allahun të na ruajë nga çdo e keqe!

Më pas, Allahu i Lartësuar tregon mirësinë e madhe me të cilën Ai e dalloi Profetin e Tij, duke e ruajtur nga çdo devijim e padrejtësi të provokuar nga zullumqarët. Ai thotë:

- "Po të mos ishte mirësia e Allahut dhe mëshira e Tij ndaj teje, një grup prej tyre do të tentonin të të devijonin ty..." - Dijetarët e tefsirit kanë treguar shkakun e shpalljes së këtyre ajeteve. Kështu, dikush kreu një vjedhje në Medinë. Më pas, kur dyshoi se mund të ishte pikasur nga njerëzit, ai, prej frikës nga demaskimi, e hodhi sendin e vjedhur në oborrin e një shtëpie tjetër, që nuk kishte lidhje me vjedhjen. Fisi i hajdutit shkuan te Profeti dhe kërkuan prej tij që të shpallte publikisht pafajësinë e tyre dhe se vjedhësi ishte ai në shtëpinë e të cilit u gjend sendi i vjedhur. Pejgamberi (a.s.) gati e plotësoi kërkesën e tyre, por ajetet nuk vonuan të shpallnin të vërtetën. Në këtë mënyrë, Allahu i Lartësuar e ruajti Profetin e Tij të mos bëhej mbështetës i padrejtësisë dhe të mos largohej nga e vërteta.

Devijimi nga e vërteta është dy llojesh: devijim në dituri, duke mos e njohur të vërtetën, dhe devijim në veprimtari, duke punuar pa patur dije nga Zoti. Allahu i Lartësuar e ruajti Profetin (a.s.) nga të dyja këto lloje të devijimit. Ai na njoftoi se kurthet e tyre goditën dhe dëmtuan vetëm ata, ashtu sikurse ndodh me çdo intrigant e tradhtar. I Lartësuari thotë:

- "...por ata nuk devijojnë asnjë, veç vetes së tyre, dhe nuk mund të të dëmtojnë aspak!" - Nëpërmjet kësaj intrige, ata nuk mundën t'ia arrinin qëllimit të tyre. Përkundrazi, ata dështuan, u turpëruan, u mbushën me gjynahe dhe u privuan nga mirësitë.

Ruajtja dhe përkujdesja e Allahut të Lartësuar për Profetin (a.s.) ishte një mrekulli. Ai jo vetëm që i dhuroi dije e urtësi të Dërguarit të Vet (a.s.), por edhe e udhëzoi dhe e ndihmoi që të punonte me atë dije madhështore, duke zbatuar urdhrat e Tij.

Për mirësinë e diturisë dhe të urtësisë, i Lartësuari thotë:

- "Allahu të shpalli ty Librin dhe Urtësinë e të mësoi atë çka nuk dije." – Kuptimi: Ai të shpalli ty Kur'ânin dhe Urtësinë, që sqarojnë çdo gjë dhe ku ndodhen njohuritë e të parëve dhe të fundit.

Për kuptimin e fjalës "Urtësi" janë dhënë dy mendime:

1. Ajo nënkupton Sunetin, Traditën e Profetit (a.s.). Disa *selefë* kanë thënë: "Profetit (a.s.) i shpallej Suneti ashtu sikurse i shpallej Kur'âni.

2. Ajo nënkupton urtësitë dhe zbërthimet e Sheriati. Pra, është diçka më shumë se thjesht njohja e ligjeve të tij. Urtësi do të thotë t'i vendosësh gjërat në vendin që u takon.

Allahu i Lartësuar thotë: ...e të mësoi çka nuk dije". Gjithashtu, Ai thotë: "Ti nuk e dije se ç'është Libri dhe as imani...". Ose një ajet tjetër: "...të gjeti të humbur, e të udhëzoi në rrugën e drejtë". [Duha, 7].

Kështu vazhdoi pandërprerë mirësia e Zotit mbi profetin Muhamed (s.a.u.s.), duke i mësuar atij dituri dhe urtësi, që askush prej të parëve dhe të fundit nuk i kanë arritur e nuk do t'i arrijnë. Ai mbetet krijesa më e ditur, në mënyrë të padiskutueshme, dhe më i kompletuari me cilësitë më të larta. I Lartësuari thotë:

- "Mirësia e Allahut ndaj teje është shumë e madhe." - Mirësitë që Allahu i Lartësuar i fali Muhamedit (s.a.u.s.) janë më të mëdha se çdo mirësi tjetër që Ai u ka dhënë krijesave. Ato janë vërtet të panumërta.

Ajeti 114

114. Në shumë biseda të tyre të fshehta nuk ka kurrfarë dobie, përveç atyre që këshillojnë për sadaka, për ndonjë të mirë ose për pajtim mes njerëzve. E kush i bën këto duke pasur për qëllim vetëm kënaqësinë e Allahut, Ne do t'i japim shpërblim të madh.


Shpjegimi i ajetit

- "Në shumë biseda të tyre të fshehta nuk ka kurrfarë dobie..." - Nuk ka hajër në shumë biseda të fshehta që bëhen mes njerëzve. Ato ose janë biseda thjesht të padobishme, ose janë të dëmshme, sikurse janë fjalët e këqija.

Pastaj i Lartësuari ka përjashtuar nga ky gjykim një lloj të caktuar bisedash:

- "...përveç atyre që këshillojnë për sadaka, për ndonjë të mirë ose për pajtim mes njerëzve." - Sadakaja mund të jetë me pasuri, dituri apo me çfarëdolloj mirësie qoftë. Madje, sadaka konsiderohen edhe adhurimet, si për shembull: të thuash *subhânallâh*, të thuash *elhamdulil-lâh* etj., sikurse ka thënë Pejgamberi (s.a.u.s.): *"Për çdo tesbih (shprehje subhânallâh) shënohet një sadaka, për çdo tekbir (Allâhu Ekber) një sadaka, për çdo tehlil (lâ ilâhe il-lall-llâh) një sadaka, urdhërimi për të mirë shënohet sadaka, ndalimi nga të këqijat shënohet sadaka, madje edhe shijimi i kënaqësive trupore të lejuara (me bashkëshorten) shënohet sadaka".*

- "..për ndonjë të mirë..." – Pra, përveç atyre që urdhërojnë për të mira. "E mira" nënkupton bamirësinë ndaj krijesave dhe bindjen ndaj Zotit dhe Profetit, ose, thënë ndryshe, çdo vepër që Sheriati e ka


الجزء الخامس سورة النساء
لَّا خَيْرَ فِي كَثِيرٍ مِّن نَّجْوَاهُمْ إِلَّا مَنْ أَمَرَ بِصَدَقَةٍ
أَوْ مَعْرُوفٍ أَوْ إِصْلَاحٍ بَيْنَ النَّاسِ ۚ وَمَن يَفْعَلْ ذَٰلِكَ
ابْتِغَاءَ مَرْضَاتِ اللَّهِ فَسَوْفَ نُؤْتِيهِ أَجْرًا عَظِيمًا ﴿١١٤﴾ وَمَن
يُشَاقِقِ الرَّسُولَ مِن بَعْدِ مَا تَبَيَّنَ لَهُ الْهُدَىٰ وَيَتَّبِعْ غَيْرَ
سَبِيلِ الْمُؤْمِنِينَ نُوَلِّهِ مَا تَوَلَّىٰ وَنُصْلِهِ جَهَنَّمَ ۖ وَسَاءَتْ
مَصِيرًا ﴿١١٥﴾ إِنَّ اللَّهَ لَا يَغْفِرُ أَن يُشْرَكَ بِهِ وَيَغْفِرُ مَا دُونَ
ذَٰلِكَ لِمَن يَشَاءُ ۚ وَمَن يُشْرِكْ بِاللَّهِ فَقَدْ ضَلَّ ضَلَالًا
بَعِيدًا ﴿١١٦﴾ إِن يَدْعُونَ مِن دُونِهِ إِلَّا إِنَاثًا وَإِن يَدْعُونَ
إِلَّا شَيْطَانًا مَّرِيدًا ﴿١١٧﴾ لَّعَنَهُ اللَّهُ ۘ وَقَالَ لَأَتَّخِذَنَّ مِنْ
عِبَادِكَ نَصِيبًا مَّفْرُوضًا ﴿١١٨﴾ وَلَأُضِلَّنَّهُمْ وَلَأُمَنِّيَنَّهُمْ
وَلَآمُرَنَّهُمْ فَلَيُبَتِّكُنَّ آذَانَ الْأَنْعَامِ وَلَآمُرَنَّهُمْ
فَلَيُغَيِّرُنَّ خَلْقَ اللَّهِ ۚ وَمَن يَتَّخِذِ الشَّيْطَانَ وَلِيًّا مِّن
دُونِ اللَّهِ فَقَدْ خَسِرَ خُسْرَانًا مُّبِينًا ﴿١١٩﴾ يَعِدُهُمْ
وَيُمَنِّيهِمْ ۖ وَمَا يَعِدُهُمُ الشَّيْطَانُ إِلَّا غُرُورًا ﴿١٢٠﴾ أُولَٰئِكَ
مَأْوَاهُمْ جَهَنَّمُ وَلَا يَجِدُونَ عَنْهَا مَحِيصًا ﴿١٢١﴾
٩٧

konsideruar si të mirë dhe që logjika e pranon si të tillë.

Këtu është përmendur urdhërimi për të mira dhe jo ndalimi nga të këqijat. Megjithatë, nëse përmendet vetëm urdhërimi për të mira, ai nënkupton edhe ndalimin nga të këqijat, sepse moskryerja e haramit konsiderohet gjithashtu si punë e mirë. Po ashtu, e mira nuk mund të konsiderohet e plotë pa e lënë të keqen. Sidoqoftë, nëse përmenden bashkë urdhërimi për të mira dhe ndalimi nga të këqijat, secili prej tyre merr kuptimin e vet specifik: urdhërimi për të mirë nënkupton kryerjen e të mirave, ndërsa ndalimi nga të këqijat nënkupton lënien e ndalesave.

- "...ose për pajtim mes njerëzve..." – Pajtimi vlen për rastet kur ka grindje dhe konflikte. Urrejtja, armiqësia dhe zemërimi gjatë konflikteve sjell, pa dyshim, përçarje dhe një të keqe të paimagjinueshme. Për këtë arsye, Sheriati ka urdhëruar dhe ka nxitur për pajtim mes njerëzve, në rastet e

gjakmarrjes, të cenimit të pasurisë dhe të nderit, madje edhe në çështjet e fesë, sikurse thotë i Lartësuari: "Kapuni fort pas litarit të Allahut dhe mos u përçani!". Ai thotë gjithashtu: "Nëse dy grupe besimtarësh luftojnë midis tyre, ju pajtojini ata. Nëse njëra palë sulmon tjetrën, atëherë luftoni ata që sulmojnë, derisa ata të kthehen në kufijtë e Allahut. E nëse kthehen, atëherë pajtojini dy grupet, me drejtësi dhe paanësi, sepse Allahu i do ata që veprojnë me drejtësi." [Huxhuratë, 9]. Ose: "Pajtimi është më i mirë" [El nisa].

Ai që punon për pajtimin është më i mirë se ai që qëndron duke u falur, agjëruar e dhënë sadaka. Pa dyshim që Allahu i Madhëruar ka për t'ia rregulluar çështjet dhe gjendjen e atij që sjell pajtimin e njerëzve. E kundërta ndodh me atë që punon për të futur përçarjen dhe urrejtjen mes njerëzve. Allahu i Lartësuar kurrë nuk ka për t'ia rregulluar punët dhe gjendjen e tij, sikurse thotë Ai në një ajet: "Allahu nuk e rregullon punën e prishësve."

Kështu, këto vepra të mira përjashtohen nga gjykimi i mësipërm. Ato janë mirësi dhe sjellin mirësi. Megjithatë, duhet të kujtojmë se shpërblimi i plotë arrihet nëpërmjet nijetit të mirë dhe sinqeritetit, prandaj i Lartësuari e thekson këtë fakt kur thotë:

- "E kush i bën këto duke pasur për qëllim vetëm kënaqësinë e Allahut, Ne do t'i japim shpërblim të madh." - Është detyrë për robin që, si qëllim të tijin, të ketë kënaqësinë e Allahut të Madhërishëm dhe çdo punë të mirë t'ia përkushtojë Atij, në çdo kohë dhe gjendje. Në këtë mënyrë, ai do të arrijë shpërblimin e madh dhe do të arrijë të bëhet prej të sinqertëve. Ai do ta fitojë shpërblimin, e përfundon punën apo jo, sepse nijeti është vendimtar në plotësimin e shpërblimit, nëse robi jep gjithçka që mundet për të kryer një vepër.

Ajetet 115 – 116

115. Kush i kundërvihet të Dërguarit, pasi i është bërë e qartë e vërteta, dhe ndjek tjetër rrugë nga ajo e besimtarëve, Ne e lëmë në zgjedhjen e tij dhe e fusim në Xhehenem. Ky është një përfundim i keq.

116. Me të vërtetë, Allahu nuk fal t'i shoqërohet Atij shok, ndërsa të tjerat, përveç këtij (*gjynahu*), ia fal atij që Ai dëshiron. Ai që i përshkruan Allahut shok, ai ka shkuar në humbje të largët.

Shpjegimi i ajeteve

- "Kush i kundërvihet të Dërguarit, pasi i është bërë e qartë e vërteta..." - Këtu bëhet fjalë për këdo që kundërshton Pejgamberin (s.a.u.s.) me arrogancë, pasi i është bërë e qartë e vërteta. Pejgamberi (a.s.) e qartësoi të vërtetën e Zotit të Lartësuar nëpërmjet Kur'ânit dhe Traditës së tij. Është detyrë për çdo njeri që të pasojë rigorozisht udhëzimin e tij (a.s.), të përcjellë deri tek ne me saktësi nga besimtarët e parë të këtij umeti, që ishin sahabët, më pas tabiinët dhe nxënësit e tyre. Allahu i Lartësuar thotë:

"...dhe ndjek tjetër rrugë nga ajo e besimtarëve..." - Ata që kundërshtojnë këtë udhëzim dhe rrugën e besimtarëve të sinqertë, në mënyrën si besojnë, kuptojnë dhe zbatojnë Kur'ânin dhe Sunetin, ata do të kenë dënimin, të cilin Zoti i Lartësuar e ka përmendur më pas:

- "Ne e lëmë në zgjedhjen e tij dhe e fusim në Xhehenem. Ky është një përfundim i keq." - Allahu i Lartësuar do t'i lërë në zgjedhjen e tyre, duke mos i dhënë sukses që të pasojnë të të vërtetën.

Ky është një ndëshkim tërësisht i merituar, sepse këta lloj njerëzish e kanë mësuar qartë të vërtetën, por e kanë braktisur duke e shpërfillur atë. Drejtësia e Allahut të Lartësuar i shpërblen ata duke i lënë të enden në humbjen e tyre dhe të zhyten thellë e më thellë në të. Në një ajet tjetër, i Lartësuari thotë: "Por kur ata devijuan, Allahu ua largoi zemrat e tyre *(nga*

besimi). Allahu nuk e udhëzon në rrugë të drejtë një popull që kalon kufijtë." [Saf, 5]. Ai thotë gjithashtu: "Ne ua largojmë zemrat dhe vështrimet e tyre *(prej besimit)*, ashtu sikurse ata nuk e besuan atë *(Kur'ânin)* për herë të parë *(kur iu paraqit)*, dhe i lëmë ata të bredhin të hutuar në shfrenimin e tyre për të kaluar kufijtë. Edhe sikur t'u dërgonim engjëj, apo t'i bënim të vdekurit t'u flisnin atyre, apo të grumbullonim gjithçka para tyre, ata përsëri nuk do të besonin, nëse Allahu nuk do të donte; por shumica e tyre janë të paditur." [En'am 110, 111].

Po ta shohim ajetin anasjelltas, do të kuptojmë se çdokush që nuk kundërshton udhëzimin e Profetit (s.a.u.s.) dhe nuk ndahet nga rruga e besimtarëve të sinqertë, Zoti i Lartësuar nuk do ta ndëshkojë me dënimin e përmendur më sipër. Me fjalë të tjera, çdokush që përpiqet të bëjë vepra të mira, duke pasur si qëllim vetëm kënaqësinë e Allahut, pasimin e rrugës dhe traditës së Profetit të Tij, duke qëndruar gjithmonë pranë xhematit të muslimanëve, edhe nëse mund të bëjë gjynahe apo të anojë drejt tyre, karakteristikë kjo e shpirtit njerëzor, Allahu i Lartësuar nuk ka për ta braktisur kurrë atë dhe nuk do ta lërë të nënshtrohet përfundimisht përballë nefsit dhe shejtanit. Allahu i Lartësuar, me butësinë, bujarinë dhe mëshirën e Tij, do të kujdeset për të, duke e ruajtur dhe mbrojtur nga e keqja dhe duke i mundësuar të vazhdojë rrugën drejt Tij, sikurse Ai thotë për Jusufin (a.s.): "...Ne larguam prej tij çdo të keqe dhe poshtërsi, se ai ishte vërtet prej adhuruesve Tanë të sinqertë.". [Jusuf 24]. Kuptimi është shumë i qartë: Për shkak të sinqeritetit të tij, Ne larguam prej tij çdo të keqe. Kështu vepron Allahu i Lartësuar me të sinqertët.

Duke treguar ndëshkimin e atyre që kundërshtojnë profetët dhe rrugën e besimtarëve të drejtë dhe të sinqertë, Allahu i Lartësuar thotë: "...e fusim në Xhehenem. Ky është një përfundim i keq...". Pra, Ai ka përgatitur për të tillët një ndëshkim të rëndë në Xhehenem, dhe nuk ka ndëshkim më të keq sesa ky.

Ndëshkimi që Allahu i Lartësuar e ka përcaktuar për ata që kundërshtojnë profetët dhe rrugën e besimtarëve të sinqertë, është i gradave të ndryshme, të cilat i di vetëm Ai. Ato janë përcaktuar në varësi të gradës së gjynahut, të madhësisë apo vogëlsisë së tij. Disa prej tyre do të dënohen përjetësisht në Zjarrin e Xhehenemit, duke merituar të gjithë poshtërimin. Por do të ketë edhe të tjerë, që nuk do të jenë në këtë gradë. Ndoshta ajeti vijues është pikërisht një shpjegim më i hollësishëm për këtë çështje. I Lartësuari thotë:

- "Me të vërtetë, Allahu nuk fal t'i shoqërohet Atij shok, ndërsa të tjerat, përveç këtij *(gjynahu)*, ia fal atij që Ai dëshiron. Ai që i përshkruan Allahut shok, ai ka shkuar në humbje të largët." - Allahu i Lartësuar nuk e fal idhujtarinë, sepse ajo cenon drejtpërdrejt autoritetin dhe madhështinë e Tij, të Zotit të botërave, si dhe njëshmërinë e Tij në meritën e adhurimit që krijesat duhet t'i përkushtojnë. Idhujtari do të thotë të barazosh krijesën, – e cila nuk ka asnjë lloj pushteti dhe që nuk mund t'i bëjë as vetes mirë apo keq, – me Mbretëruesin, Sundimtarin dhe Zotëruesin e të mirës dhe të keqes, në dorën e të Cilit është, pra, çdo mirësi dhe i Cili është i vetmi që mund të largojë brengat dhe fatkeqësitë. Ai është absolut në çdo aspekt. Ai është i Pasur dhe kurrë nevojtar. Për këto arsye, është padrejtësia më e madhe dhe humbja më e qartë që të mos e njësosh Allahun në adhurim me sinqeritet të plotë. Është paturpësi që t'i kushtosh adhurimin më të vogël një krijese, që nuk ka asnjë cilësi të përsosmërisë dhe madhështisë. Krijesat janë nevojtare. Ato nuk kanë ekzistuar dikur, u mungon përsosmëria dhe janë nevojtare në të gjitha drejtimet.

Për sa u përket gjynaheve poshtë *shirk*-ut, ato varen nga dëshira e Allahut të Lartësuar. Nëse do, Ai i fal, me mëshirën dhe urtësinë e

Tij, e nëse dëshiron t'i ndëshkojë, Ai i ndëshkon, me drejtësinë dhe urtësinë e Tij.

Ky ajet është provë që tregon se mendimi konsensual i këtij umeti konsiderohet si dëshmi e qëndrimit të drejtë. Ai tregon gjithashtu se ky umet, në tërësinë e tij, është i ruajtur nga gabimi. Allahu i Lartësuar kërcënon me humbje dhe me përfundim në Zjarr këdo që kundërshton rrugën e besimtarëve të sinqertë. "Rruga e besimtarëve" është besimi, fjalët, veprat dhe sjellja e tyre. Nëse ky umet bie dakord në tërësi që diçka është e detyrueshme, apo e pëlqyeshme, apo e ndaluar, apo e papëlqyeshme, apo e lejuar, atëherë themi se kjo është "rruga e tyre". Çdokush që e kundërshton këtë konsensus quhet se ka zgjedhur rrugë tjetër nga ajo e besimtarëve.

Të njëjtin mesazh përcjell edhe ajeti: "Ju jeni populli më i dobishëm, i ardhur për të mirën e njerëzve. Ju urdhëroni për mirë, ndaloni nga veprat e këqija dhe e besoni Allahun." [Al Imran 110]. Allahu i Lartësuar na tregon se besimtarët e këtij umeti urdhërojnë veçse për të mirë. Nëse ata në tërësi janë dakord për detyrueshmërinë apo pëlqyeshmërinë e diçkaje, ajo është pikërisht ashtu si e kanë gjykuar ata, dhe është e pamundur që të jetë ndryshe. Gjithashtu, nëse ata janë dakord për diçka se është e ndaluar, ajo është pikërisht ashtu, dhe kurrsesi nuk mund të jetë e mirë.

Një tregues tjetër është edhe ajeti i Allahut të Lartësuar, që thotë: "Dhe kështu, Ne ju bëmë një popull të ekuilibruar, për të qenë dëshmitarë ndaj njerëzve." [Bekare 143]. Allahu i Lartësuar na tregon se e bëri këtë umet një popull të drejtë e të ekuilibruar, që ata të jenë dëshmues ndaj njerëzve për gjithçka. Nëse ata gjykojnë dhe dëshmojnë për një çështje të caktuar se Allahu i Lartësuar e ka urdhëruar atë, apo e ka ndaluar, apo e ka bërë të lejueshme, dëshmia e tyre është e pagabueshme dhe e pakontenstueshme. Është e tillë, sepse ata janë të dijshëm për atë që dëshmojnë dhe janë të drejtë dhe të vërtetë në dëshminë e tyre. Nëse nuk do të ishin të tillë, nuk do të ishte e drejtë që ata të konsideroheshin të drejtë dhe të pranueshëm në dëshminë dhe gjykimin e tyre.

E njëjta gjë kuptohet edhe nga thënia tjetër e Allahut të Lartësuar: "O ju që keni besuar! Bindjuni Allahut, bindjuni të Dërguarit dhe përgjegjësve nga ju! Nëse nuk pajtoheni për ndonjë çështje, atëherë parashtrojeni atë tek Allahu dhe tek i Dërguari, nëse vërtet e besoni Allahun dhe Ditën e Fundit. Kjo është më e dobishmja dhe përfundimi më i mirë." [Nisa 59]. Domethënë, për çështjet që ata nuk kanë mospajtime, por janë të një mendimi, ata nuk janë të urdhëruar që, për të dhënë gjykimin e tyre, të kthehen në Kur'ân apo në Sunet, sepse vetvetiu gjykimi i tyre konsensual është sipas Kur'ânit dhe Sunetit.

Këto dhe fakte të tjera dëshmojnë qartë se mendimi konsensual i umetit musliman konsiderohet qëndrim i padiskutueshëm dhe mbi të mund të ngrihen gjykime dhe dispozita ligjore.

Më pas, për të treguar se sa e shëmtuar është humbja në të cilën janë zhytur idhujtarët, Allahu i Lartësuar thotë:

Ajetet 117 – 121

117. Ata lusin vetëm idhuj femërorë, dhe i drejtohen veç Shejtanit plot sherr,
118. që e mallkoi Allahu e që ka thënë: "Unë do të përfitoj një pjesë të caktuar të robërve të Tu,
119. do t'i devijoj, do t'i bëj të shpresojnë në gjëra të kota, do t'i urdhëroj dhe ata do të shqyejnë veshët e bagëtive, do t'i urdhëroj dhe ata do të shëmtojnë krijesat e Allahut". E kush bën mik Shejtanin, e jo Allahun, ai ka dështuar qartë.
120. Ai u premton atyre dhe i bën të shpresojnë, por Shejtani premton veçse mashtrim.
121. Ata *(që ndjekin Shejtanin)* e kanë vendin në Xhehenem, prej të cilit nuk kanë shpëtim.

Shpjegimi i ajeteve

- "Ata lusin vetëm idhuj femërorë, dhe i drejtohen veç Shejtanit plot sherr..." - Idhujtarët u luteshin idhujve të sajuar dhe të emërtuar nga të parët e tyre me emra femrash, si Uzaja apo Menata. Duke qenë se emrat e tyre ishin të gjinisë femërore, kjo tregonte edhe mangësinë e vetë të emërtuarave me to.

Ato ishin idhuj të kotë, pa asnjë cilësi përsosmërie, sikurse i përshkruan Allahu i Lartësuar në shumë ajete kur'ânore. Ai na tregon se ato nuk mund të krijonin, nuk mund të furnizonin dhe nuk mund t'i mbrojnë adhuruesit e tyre, madje as veten e tyre. Ato nuk kishin në dorë as të bënin mirë e as keq dhe nuk mund të ndihmonin as vetveten për të shpëtuar nga ndonjë e keqe. Allahu i Lartësuar na tregon se idhujt as nuk dëgjojnë, as nuk shikojnë dhe as nuk mendojnë a ndiejnë. Atëherë, si mund të adhurohet diçka që ka cilësi të tilla dhe të lihet mënjanë përkushtimi me sinqeritet ndaj Allahut, të Cilit i takojnë emrat më të bukur, cilësitë më të larta, lavdia e plotë, madhështia, lartësia, fuqia, bukuria, mëshira, mirësia dhe bujaria e plotë?! Ai është i Vetmi, që nuk ka të dytë, në dorën e të Cilit është pushteti për të krijuar dhe për t'u kujdesur e administruar çështjet e krijesave të Tij. Vetëm Ai ka të drejtën që, me urtësinë e Tij të madhe, të sundojë dhe të përcaktojë çdo çështje dhe ligj. Domethënë, një këmbim i tillë është vepra më e shëmtuar, që tregon për mangësinë e atyre që e kryejnë, për nivelin e ulët ku kanë rënë, nivel që nuk mund të përshkruhet dhe përfytyrohet.

Në fakt, adhurimi i idhujve është thjesht në dukje, sepse në të vërtetë ata adhurojnë veçse Shejtanin e mallkuar, armikun e tyre, i cili synon t'i shkatërrojë me çdo mënyrë të mundshme. Shejtani është krijesa më e largët nga mëshira e Allahut, sepse është Ai që e ka dëbuar dhe larguar nga mëshira e Vet.

- "...që e mallkoi Allahu e që ka thënë: "Unë do të përfitoj një pjesë të caktuar të robërve të Tu..." - Duke qenë se Allahu i Lartësuar e mallkoi dhe largoi nga mëshira e Vet, Shejtani lufton gjithnjë për t'i larguar edhe njerëzit nga mëshira e Allahut të Lartësuar, siç thuhet në një ajet tjetër: "Shejtani është armiku juaji, prandaj edhe ju konsiderojeni si armik. Ai i thërret pasuesit e vet vetëm për t'i bërë banues të Zjarrit.". [Fatir, 6]. Allahu i Lartësuar na tregon për përpjekjet e këtij armiku në devijimin e njerëzve, duke ua zbukuruar atyre të keqen.

Shejtani është përbetuar e i ka thënë Zotit: "Unë do të përfitoj një pjesë të caktuar të robërve të Tu". I Mallkuari e di mirë se ai nuk mund të devijojë të gjithë robërit e Zotit. Ai e di shumë mirë se nuk ka asnjë lloj fuqie mbi adhuruesit e sinqertë të Allahut dhe se pushteti i tij është i kufizuar vetëm mbi ata që i ofrojnë miqësi dhe i japin përparësi bindjes ndaj tij kundrejt bindjes ndaj Allahut të Lartësuar. Në një ajet tjetër kur'ânor, ai është betuar se do t'i mashtrojë robërit e Zotit, duke thënë: "Zoti im, për shkak se më dëbove, unë do t'ua zbukuroj të këqijat atyre sa të jenë në tokë *(në këtë botë)* dhe do t'i largoj të gjithë nga rruga e drejtë, përveç robërve të Tu të sinqertë." [Hixhr 39, 40]. Allahu i Lartësuar na tregon se ky synim i këtij të mallkuari të poshtëruar do të plotësohet: "Në të vërtetë, Shejtani e realizoi synimin e vet ndaj tyre, të cilët e dëgjuan atë, përveç një grupi besimtarësh." [Sebe 20].

Më poshtë, Allahu i Lartësuar na qartëson se në ç'mënyrë do ta devijojë i Mallkuari prenë e tij:

"...do t'i devijoj, do t'i bëj të shpresojnë në gjëra të kota, do t'i urdhëroj dhe ata do të shqyejnë veshët e bagëtive, do t'i urdhëroj dhe ata do të shëmtojnë krijesat e Allahut". – Fillimisht, ai thotë: "*...do t'i devijoj*", pra, do t'i devijoj nga rruga e drejtë. Shejtani devijon në dy drejtime: nga dija e vërtetë e sjellë prej Zotit të Lartësuar dhe nëpërmjet profetëve të Tij, dhe nga puna me këtë dije.

Së dyti, ai thotë: "do t'i bëj të shpresojnë në gjëra të kota...". Pra, edhe pse të zhytur në humbje, ai do t'i bëjë që të besojnë se kanë për të fituar atë që, në fakt, u premtohet vetëm të udhëzuarve. Ky është një mashtrim i qartë. I Mallkuari, nuk mjaftohet thjesht me devijimin dhe humbjen e tyre, por ua zbukuron këtë rrugë, për t'ua bërë të dashur në zemrat e tyre. Kjo është një e keqe e papërshkrueshme. Ata të mjerë bëjnë veprat e banorëve të Zjarrit, ndërkohë që shpresojnë se, nëpërmjet tyre, do të fitojnë Xhenetin.

Shiko çifutët dhe të krishterët apo të tjerët si ata, sikurse na i tregon Allahu i Lartësuar: "Ata *(ithtarët e Librit)* thonë: "Nuk ka për të hyrë në Xhenet askush, përveç aty që është çifut ose i krishterë!" Këto janë trille të tyre! Thuaju: "Sillni provat tuaja, nëse keni të drejtë!". Përkundrazi, ai që i është dorëzuar Allahut dhe është bamirës, e ka shpërblimin e vet te Zoti i tij. Për ata nuk ka frikë, as nuk kanë pse të mërziten." [Bekare 111, 112]. Ose: "Kështu, çdo populli, Ne ia kemi zbukuruar punët e veta, më pas te Zoti është kthimi i tyre, i Cili do t'i shpërblejë për veprat që kanë bërë." [En'âm 108]. Ose: "Thuaj: "A t'ju tregojmë për më të dëshpëruarit me veprat e tyre? Janë ata, veprat e të cilëve do të asgjësohen në jetën e kësaj bote, ndërkohë që ata mendojnë se janë duke bërë mirë." [Kehf 103, 104].

Po kështu, Allahu i Lartësuar na tregon për munafikët se, Ditën e Gjykimit, ata do t'u thonë besimtarëve: "Na prisni edhe ne, që të ndriçohemi prej dritës suaj!" Por atyre do t'u thuhet: "Kthehuni pas e kërkoni dritë!" Atëherë, ndërmjet tyre vendoset një mur, që ka një derë. Ana e brendshme e tij është mëshirë *(Xheneti)*, ndërsa nga ana e jashtme e tij është dënim *(Zjarri)*. Ata *(munafikët e mbetur në errësirë)* do t'u thërrasin atyre *(besimtarëve):* "A nuk kemi qenë edhe ne bashkë me ju?" – "Po, por ju e shkatërruat veten! Ju prisnit fat të zi për besimtarët, dyshonit në çështjet e fesë dhe u mashtruat nga jeta e dynjasë, deri kur ju erdhi caktimi i Allahut *(vdekja)*. Mashtruesi *(Shejtani)* ju mashtroi ju rreth Allahut. Ndërsa sot prej jush nuk pranohet asnjë lloj kompensimi, e as prej atyre që nuk besuan. Zjarri është vendi juaj; atë meritoni ju! Sa përfundim i keq është ai" [Hadid 12 – 15].

Së treti, ai thotë: "...do t'i urdhëroj dhe ata do të shqyejnë veshët e bagëtive". Allahu i Lartësuar sjell një shembull në suren En'am për këtë vepër. Ai na tregon se idhujtarët i shqyenin veshët e bagëtive dhe më pas i veçonin ato, duke i përcaktuar si të shenjta e të paprekshme. I Lartësuari thotë: "Allahu nuk e veçoi *(si të shenjtë)* Behirën, as Saibën, as Vesilën dhe as Hamën. Ata që nuk besojnë trillojnë gënjeshtra për Allahun, por shumica e tyre nuk e kuptojnë".

Ky lloj devijimi synon që njerëzit të bëjnë të ndaluara ato që Zoti i ka lejuar, apo që të bëjnë të lejuara ato që Zoti i ka ndaluar. Si devijim konsiderohet çdo besim i keq dhe çdo gjykim i padrejtë, që i Mallkuari nxit te njerëzit. Edhe ky lloj devijimi është shumë i madh dhe i frikshëm.

Së katërti, i Lartësuari thotë: "...do t'i urdhëroj dhe ata do të shëmtojnë krijesat e Allahut...". Fjala është për ndryshimet që njerëzit bëjnë në pamjet e tyre të jashtme, si tatuazhet, ndarja e dhëmbëve për zbukurim, heqja e vetullave etj. Nëpërmjet këtij mashtrimi, i Mallkuari i josh njerëzit për të tjetërsuar krijimin e Allahut. Këto veprime tregojnë në vetvete pakënaqësi me krijimin e Allahut dhe cenim të urtësisë së Tij. Kështu ata pretendojnë se ajo që ata bëjnë me duart e tyre është më e mirë se ajo që Zoti ka krijuar.

Ajeti bën fjalë edhe për tjetërsimet e brendshme. Allahu i Lartësuar i ka krijuar robërit e Tij që të jenë adhurues të një Zoti të vetëm. Ai u ka dhënë atyre një natyrë që e pranon të vërtetën dhe që i ka mundësitë ta pasojë atë, por pas ndërhyrjes dhe ndikimit të shejtanëve në këtë natyrë të pastër, ata i largohen adhurimit të Tij. Nuk ka dyshim se çdo fëmijë lind me natyrë të pastër islame,

por prindërit e tij e kthejnë atë në çifut, të krishterë, adhurues zjarri etj.


Nëse njeriu do të lihej i lirë, me siguri ai do ta besonte Allahun si Një të vetëm, do ta donte Atë dhe do të dëshironte ta njihte realisht. Por Shejtani i mallkuar vërsulet i tërbuar për ta devijuar njeriun, ashtu sikurse vërsulet ujku mbi delet e vetmuara. Sikur të mos ishte butësia, mëshira dhe bujaria e Allahut të Lartësuar me adhuruesit e Tij të sinqertë, edhe me ta do të ndodhte ajo që ndodh me këta të sprovuar. Në fakt, shkak për sprovimin e tyre janë vetë veprat e tyre. Ata i kthejnë shpinën Zotit dhe Krijuesit të tyre dhe miqësohen me armikun e tyre, i cili synon veçse të keqen për ta. Për këtë arsye, ata humbin dynjanë dhe ahiretin. Allahu i Lartësuar thotë:

- "E kush bën mik Shejtanin, e jo Allahun, ai ka dështuar qartë." - E ku ka humbës më të madh sesa ai që humbet fenë dhe dynjanë e tij dhe i mbetet vetëm mohimi i Zotit, gjynahet dhe gabimet. Ky i mjerë do të ndëshkohet përjetësisht dhe nuk do të shijojë kurrë kënaqësinë e amshuar të Xhenetit.

E kundërta ndodh me atë që i afrohet Allahut të Lartësuar dhe i jep përparësi kënaqësisë së Tij. Ky ka fituar çdo mirësi, ka shpëtuar nga çdo fatkeqësi dhe do të jetë i lumtur në të dyja jetët. Ai do të jetë vazhdimisht i qetë, sepse askush nuk mund ta pengojë atë nga mirësia që i jep Zoti dhe askush nuk mund t'i japë atë që Zoti ia ndalon.

O Zoti ynë! Kujdesu për ne, ashtu siç kujdesesh për të dashurit e Tu dhe na shpëto nga çdo e keqe, ashtu siç ke shpëtuar të dashurit e Tu! Pastaj i Lartësuari thotë:

- "Ai u premton atyre dhe i bën të shpresojnë..." - Shejtani i mallkuar i përdor të dyja mënyrat me ata që kërkon të devijojë: edhe premtimin, edhe frikësimin. Ai i bën të shpresojnë te premtimet e tij mashtruese, por edhe i tremb me varfëri, sikurse thotë Allahu i Lartësuar: "Shejtani ju frikëson me


الجزء الخامس سورة النساء
وَٱلَّذِينَ ءَامَنُوا۟ وَعَمِلُوا۟ ٱلصَّٰلِحَٰتِ سَنُدْخِلُهُمْ جَنَّٰتٍ
تَجْرِى مِن تَحْتِهَا ٱلْأَنْهَٰرُ خَٰلِدِينَ فِيهَآ أَبَدًا ۖ وَعْدَ ٱللَّهِ
حَقًّا ۚ وَمَنْ أَصْدَقُ مِنَ ٱللَّهِ قِيلًا ﴿١٢٢﴾ لَّيْسَ بِأَمَانِيِّكُمْ
وَلَآ أَمَانِىِّ أَهْلِ ٱلْكِتَٰبِ ۗ مَن يَعْمَلْ سُوٓءًا يُجْزَ بِهِۦ
وَلَا يَجِدْ لَهُۥ مِن دُونِ ٱللَّهِ وَلِيًّا وَلَا نَصِيرًا ﴿١٢٣﴾ وَمَن
يَعْمَلْ مِنَ ٱلصَّٰلِحَٰتِ مِن ذَكَرٍ أَوْ أُنثَىٰ وَهُوَ مُؤْمِنٌ
فَأُو۟لَٰٓئِكَ يَدْخُلُونَ ٱلْجَنَّةَ وَلَا يُظْلَمُونَ نَقِيرًا ﴿١٢٤﴾ وَمَنْ
أَحْسَنُ دِينًا مِّمَّنْ أَسْلَمَ وَجْهَهُۥ لِلَّهِ وَهُوَ مُحْسِنٌ وَٱتَّبَعَ
مِلَّةَ إِبْرَٰهِيمَ حَنِيفًا ۗ وَٱتَّخَذَ ٱللَّهُ إِبْرَٰهِيمَ خَلِيلًا ﴿١٢٥﴾ وَلِلَّهِ
مَا فِى ٱلسَّمَٰوَٰتِ وَمَا فِى ٱلْأَرْضِ ۚ وَكَانَ ٱللَّهُ بِكُلِّ شَىْءٍ
مُّحِيطًا ﴿١٢٦﴾ وَيَسْتَفْتُونَكَ فِى ٱلنِّسَآءِ ۖ قُلِ ٱللَّهُ يُفْتِيكُمْ
فِيهِنَّ وَمَا يُتْلَىٰ عَلَيْكُمْ فِى ٱلْكِتَٰبِ فِى يَتَٰمَى ٱلنِّسَآءِ
ٱلَّٰتِى لَا تُؤْتُونَهُنَّ مَا كُتِبَ لَهُنَّ وَتَرْغَبُونَ أَن تَنكِحُوهُنَّ
وَٱلْمُسْتَضْعَفِينَ مِنَ ٱلْوِلْدَٰنِ وَأَن تَقُومُوا۟ لِلْيَتَٰمَىٰ بِٱلْقِسْطِ ۚ
وَمَا تَفْعَلُوا۟ مِنْ خَيْرٍ فَإِنَّ ٱللَّهَ كَانَ بِهِۦ عَلِيمًا ﴿١٢٧﴾
٩٨

varfëri dhe ju urdhëron për të këqija, ndërsa Allahu ju garanton falje e begati. Allahu është Bujar i madh e i Gjithëdijshëm". [Bekare 268]. Për t'i penguar ata nga shpenzimi në rrugën e Zotit, i tremb me varfëri, për t'i penguar nga xhihadi në rrugën e Zotit, i tremb me tortura, vuajtje dhe vrasje, sikurse thuhet në ajet: "Ishte shejtani që dëshironte t'ju trembte me miqtë e vet, por ju mos kini frikë prej tyre. Ruhuni vetëm prej Meje, nëse jeni besimtarë!" [Al Imran 175].

Kur njerëzit kërkojnë t'i japin përparësi kënaqësisë së Allahut, Shejtani i mallkuar i tremb me çdo mënyrë, për t'i penguar. Me kurthet dhe intrigat e tij, ai i frikëson ata, i dembelos dhe ua pret krahët, që të mos kryejnë vepra të mira. Nga ana tjetër, ai iu ushqen ëndrra boshe, të cilat, nëse njerëzit i peshojnë me kujdes e qetësi, do të kuptojnë se janë thjesht iluzione. Më pas, Allahu i Lartësuar e përforcon këtë fakt, duke thënë:

- "...por Shejtani premton veçse gënjeshtra." - Premtim i vërtetë është vetëm ai i Allahut të Lartësuar dhe vetëm kërcënimeve të Tij duhet t'u frikësohesh.

Më poshtë, Allahu i Lartësuar tregon shpagimin për këdo që miqësohet me Shejtanin dhe që i nënshtrohet atij:

- "Ata *(që ndjekin Shejtanin)* e kanë vendin në Xhehenem, prej të cilit nuk kanë shpëtim." - Të gjithë ata që, duke i kthyer shpinën Zotit, i nënshtrohen Shejtanit e bëhen pasues të tij, do të kenë si vendqëndrim të tyre zjarrin e Xhehenemit. Askush nuk do të mund t'i shpëtojë prej andej dhe në atë vend do të jenë përgjithmonë.

Ajeti 122

122. Ndërsa ata të cilët besojnë dhe bëjnë vepra të mira, Ne do t'i vendosim në kopshte, ku rrjedhin lumenj e ku do jenë përgjithmonë. Ky është premtimi i Allahut. E kush mund të jetë më i vërtetë në fjalë sesa Allahu?

Shpjegimi i ajetit

- "Ndërsa ata të cilët besojnë dhe bëjnë vepra të mira" - Allahu i Lartësuar i përshkruan me dy cilësi ata që meritojnë shpërblimin e Tij të madh.

Së pari, ata besojnë. Por çfarë besojnë? Ata besojnë Allahun, engjëjt, librat e Tij, profetët dhe Ditën e Gjykimit. Ata besojnë edhe kaderin, domethënë në caktimin e të mirës dhe të keqes nga Allahu i Lartësuar. Ky besim i tyre është ashtu siç i ka urdhëruar Allahu i Lartësuar që të besojnë. Besimi i tyre ndërtohet mbi dijen e saktë dhe të sigurt të sjellë nga Zoti dhe Profeti i Tij, mbi pohimin dhe pranimin pa mëdyshje të gjithçkaje që duhet pranuar dhe pohuar.

Së dyti, ata bëjnë vepra të mira. Këtu përfshihen të gjitha llojet e punëve të mira të cilat Allahu i Lartësuar dhe Pejgamberi (a.s.) i kanë urdhëruar dhe na kanë nxitur që t'i kryejmë, qofshin këto punë zemre, që nuk duken me sy, qofshin fjalë apo punë të dukshme.

Çdo njeri do të meritojë shpërblimin e Allahut në varësi të shkallës së besimit dhe të veprave të mira të ndërtuara mbi të. Asgjë nga këto nuk ndodh jashtë urtësisë dhe mëshirës së Allahut të Lartësuar.

Premtimi i Allahut të Madhërishëm është i pakthyeshëm. Këto ishin dy kushtet për të përfituar nga premtimi i mrekullueshëm i Allahut të Lartësuar, i Cili thotë:

- "Ne do t'i vendosim në kopshte, ku rrjedhin lumenj e ku do jenë përgjithmonë." - Në këto kopshte të Xhenetit ka mirësi, të cilat syri nuk i ka parë, veshi nuk i ka dëgjuar dhe mendja e njeriut nuk i ka përfytyruar.

Besimtari do të shijojë në Xhenet lloje të shumta ushqimesh dhe pijesh, do të kënaqet me pamje të çuditshme dhe me gra të bukura. Ata do të shëtisin plot gëzim në kështjella të larta dhe nëpër dhomat e zbukuruara, do të pushojnë të kënaqur poshtë pemëve të dendura, plot fruta të panjohura, duke dëgjuar me ëndje zërat e bukur që këndojnë. Ata do të vizitojnë njëri-tjetrin mes mirësive të papërshkrueshme të Xhenetit dhe do të përkujtojnë ditët e tyre në këtë dynja. Por mbi të gjitha këto kënaqësi e shumë e shumë të tjera, që njeriu nuk mundet t'i përshkruajë me fjalë, qëndron kënaqësia e Allahut të Lartësuar me ta dhe lumturia që të jep qëndrimi pranë Allahut të Lartësuar, shikimi i Tij dhe dëgjimi i fjalës së Tij të dashur. Kjo lloj kënaqësie i bën ata që të harrojnë çdo lloj mirësie tjetër që gëzojnë në Xhenet. Sikur Allahu i Lartësuar të mos i bënte ata të aftë për të përballuar këtë mirësi, ata do të vdisnin nga gëzimi.

Subhanallah! Çfarë mrekullish! Sa të larta janë gradat dhe sa të shumta janë begatitë që dhuron Zoti Bujar. Këto mirësi bëhen akoma më të mëdha kur kujton se ato do të jenë të përjetshme, prandaj i Lartësuari thotë: "...ku do jenë përgjithmonë."

- "Ky është premtimi i Allahut. E kush mund të jetë më i vërtetë në fjalë sesa Allahu?" - Të vërtetën ka thënë Allahu i Madhërishëm. Fjalët e askujt nuk mund t'u afrohen fjalëve të Allahut të Lartësuar, për sa i përket vërtetësisë së tyre. Fjalët e Tij janë të vërteta në mesazhin që përçojnë, në mësimet që sjellin dhe në atë çka nënkuptojnë. Të tilla janë edhe fjalët e Profetit (a.s.), sepse ai fliste dhe urdhëronte veçse me shpallje nga Alllahu i Lartësuar.

Ajetet 123 – 124

123. Nuk është as sipas dëshirave tuaja e as sipas dëshirave të ithtarëve të Librit. Kushdo që bën keq, do të ndëshkohet me të dhe, përveç Allahut, nuk ka për t'i gjetur vetes as mbrojtës e as ndihmës.
124. Kush bën ndonjë nga punët e mira, qoftë mashkull ose femër, duke qenë besimtar, do të hyjë në Xhenet dhe nuk do t'i bëhet asnjë padrejtësi.

Shpjegimi i ajeteve

- "Nuk është as sipas dëshirave tuaja e as sipas dëshirave të ithtarëve të Librit." – Kuptimi: Shpëtimi nuk arrihet duke pretenduar e ëndërruar. Ëndrrat dhe pretendimet boshe nuk e pastrojnë njeriun nga gjynahet dhe as nuk i japin shpërblim.

"*El emânij*" quhet pretendimi për të arritur një qëllim të caktuar, por pa bërë as më të voglin mundim për arritjen e tij. Çdokush që synon të arrijë diçka pa shpenzuar mundin që i takon asaj, nuk ka bërë gjë tjetër, por veçse ka ëndërruar me sy hapur. Çdokush mund të pretendojë çfarë të dojë, por, pa punuar e lëvizur, të gjitha pretendimet janë njëlloj. Kjo mund të thuhet për çdo çështje të kësaj dynjaje. Atëherë, si mendon se qëndron çështja kur bëhet fjalë për besimin dhe rrugën e arritjes së lumturisë së përjetshme?!

Në ajete të tjera, Allahu i Lartësuar na ka folur rreth pretendimeve boshe të ithtarëve të Librit: "Ata *(ithtarët e Librit)* thonë: "Nuk ka për të hyrë në Xhenet askush tjetër, përveç atyre që janë çifutë ose të krishterë!" Por këto janë thjesht trille të tyre! Përkundrazi, ata që i janë dorëzuar Allahut dhe janë bamirës, ata e kanë shpërblimin te Zoti i tyre. Për ata nuk ka frikë, as nuk kanë pse të mërziten." [Bekare 111, 112]. Kur gjykimi është i tillë për pretendimet e ithtarëve të Librit, çfarë mund të thuhet për ata që nuk ndjekin as libër hyjnor dhe as ndonjë profet? Sigurisht që pretendimet e tyre janë edhe më të pabazuara.

Allahu i Madhëruar, duke qenë i Drejtë, ka dhënë të njëjtin gjykim edhe për ata muslimanë që bien në të njëjtin gabim. Të gjithë duhet ta dinë se përkatësia në çfarëdolloj feje qoftë, nuk i bën domosdoshmërisht të pranueshme pretendimet e ithtarëve të saj, nëse ato nuk argumentohen qartë dhe saktë. Janë veprat ato që vërtetojnë vërtetësinë apo pavërtetësinë e pretendimeve. Prandaj Allahu i Lartësuar e përforcon këtë rregull, kur thotë:

- "Kushdo që bën keq, do të ndëshkohet me të dhe, përveç Allahut, nuk ka për t'i gjetur vetes as mbrojtës e as ndihmës." - Ajeti është gjithëpërfshirës. Ai nuk përjashton as vepruesin e të keqes, as vetë të keqen. Çdokush që bën një të keqe, do të shpërblehet sipas saj. Gjithashtu, çdo e keqe, e madhe apo e vogël qoftë, e ka të përcaktuar dënimin e saj, i madh apo i vogël qoftë ai. Ky dënim mund të jepet në dynja dhe në ahiret.

Në varësi të gjynaheve që bëjnë dhe të ndëshkimeve që meritojnë, njerëzit janë të gradave të ndryshme. Vetëm Allahu i Madhëruar e di se çfarë meritojnë ata. Ata që bëjnë vetëm të këqija, - dhe të tillë janë qafirët, - nëse vdesin pa u penduar, do të ndëshkohen përjetësisht. Ndërsa atyre që bëjnë vepra të mira në përgjithësi, edhe pse ndonjëherë bëjnë ndonjë gjynah të vogël, Allahu i Lartësuar u mundëson me mënyra të ndryshme që t'u fshihen dhe t'u falen këto

gjynahe. Të tilla janë trishtimet, ankthet, vuajtjet, dhimbjet në trup dhe shpirt, fatkeqësitë mbi të afërmit dhe pasurinë e të tjera. Të gjitha këto janë mënyra për fshirje gjynahesh dhe shpagim për punët e këqija. Pa dyshim, ky është tregues i qartë i mëshirës dhe bamirësisë së Allahut të Lartësuar ndaj adhuruesve të Tij. Duhet të themi se nga ky gjykim përjashtohen të penduarit, sepse ata janë njëlloj sikur nuk kanë bërë fare gjynah, sikurse dëshmojnë tekste të shumta fetare.

Ndokush mund të mendojë se ka mundësi shpëtimi nga ndëshkimi i merituar, nëpërmjet ndërmjetësuesve dhe miqve, por Allahu i Lartësuar e mohon një mundësi të tillë. Ai thotë: "...përveç Allahut, nuk ka për t'i gjetur vetes as mbrojtës e as ndihmës.". Pra, askush nuk do të mund të përfitojë nga ndonjë mik dhe askush nuk do ta ndihmojë që t'i shpëtojë dënimit që e ka frikë. I vetmi shpëtimtar dhe ndihmëtar është Zoti dhe Sunduesi i Ditës së Gjykimit.

Pastaj i Lartësuari thotë:

- "Kush bën ndonjë nga punët e mira, qoftë mashkull ose femër, duke qenë besimtar, do të hyjë në Xhenet dhe nuk do t'i bëhet asnjë padrejtësi." - Këtu bëhet fjalë për të gjitha llojet e të mirave, qofshin ato që bëhen me zemër, qofshin ato me gjymtyrë. Këtu bëhet fjalë edhe për çdonjë që bën vepra të mira, qoftë njeri apo xhin, i vogël apo i madh, mashkull apo femër. Por Allahu i Lartësuar ka përmendur një kusht për pranimin e këtyre punëve: ai është besimi. Pra, asnjë vepër nuk konsiderohet e mirë, nuk pranohet, nuk ka shpërblim dhe nuk të largon nga ndëshkimi nëse nuk nxitet dhe nuk buron nga besimi. Punët pa besim janë si degët e një peme, së cilës i është prerë trungu, apo si një ndërtesë pa themele. Imani është themeli, trungu, baza mbi të cilën ndërtohet çdo gjë. Me fjalë të tjera, çdo vepër e mirë, për të cilën është përmendur shpërblim në Kur'ân, ka si kusht imanin, edhe nëse mund të mos jetë thënë shprehimisht në çdo rast.

Allahu i Lartësuar thotë: "...do të hyjë në Xhenet dhe nuk do t'i bëhet asnjë padrejtësi". Ata që kanë besimin dhe veprat e mira do të hyjnë në Xhenet, ku do të kënaqen me gjithçka që ua dëshiron shpirti. Atyre nuk do t'u bëhet asnjë lloj padrejtësie, as e madhe e as e vogël, nuk do t'u mohohet asnjë punë e mirë që kanë kryer, sado e vogël qoftë ajo. Përkundrazi, shpërblimi do të jetë i shumëfishuar nga bujaria dhe mëshira e Allahut të Lartësuar.

Ajeti 125

125. Kush ka fe më të mirë se ai që sinqerisht i është dorëzuar Allahut dhe, duke qenë bamirës, pason fenë e drejtë të Ibrahimit? Allahu e zgjodhi Ibrahimin si të dashurin e Tij më të ngushtë.

Shpjegimi i ajetit

- "Kush ka fe më të mirë se ai që sinqerisht i është dorëzuar Allahut..." - Nuk ka besim dhe fe më të mirë sesa feja e atij që ka edhe sinqeritetin në adhurimin ndaj Allahut të Lartësuar, edhe dorëzimin e plotë ndaj Tij.

Sinqeriteti ndaj Allahut është dorëzimi i plotë i zemrës ndaj Tij, është drejtimi i plotë për nga Ai, me pendim, bindje dhe nënshtrim; pra, është kthimi tërësisht tek Allahu i Lartësuar. Por, përveç sinqeritetit, është dhe dorëzimi i plotë ndaj Allahut të Lartësuar:

- "...dhe, duke qenë bamirës..." – Domethënë, duke qenë zbatues i ligjit të Zotit, për kumtimin e të cilit Allahu i Lartësuar dërgoi profetët dhe shpalli librat e Tij, duke e bërë atë rrugë nëpër të cilën të zgjedhurit e Tij afrohen dhe kërkojnë kënaqësinë e Tij. Bamirës mund të quhet veçse ai që pason dhe zbaton rigorozisht ligjin e Zotit, duke e adhuruar të Lartësuarin me mënyrën që Ai e ka përcaktuar.

Dy cilësitë e fesë më të mirë ishin: sinqeriteti në adhurim, duke iu përkushtuar vetëm Allahut të Lartësuar, dhe zbatimi i ligjit të sjellë prej Tij, duke e adhuruar Atë ashtu sikurse Ai na ka mësuar ta adhurojmë. Por në përshkrimin e fesë më të mirë, Allahu i Madhëruar sjell më poshtë edhe një kusht tjetër:

- "...pason fenë e drejtë të Ibrahimit" – Domethënë, të besojmë ashtu siç besonte Ibrahimi (a.s.) dhe të zbatojmë ligjin e Zotit ashtu sikurse e zbatonte ai.

Allahu i Lartësuar përdor fjalën "*hanifâ*", që do të thotë: " i larguar tërësisht nga *shirk*-u, për t'iu përkushtuar vetëm Allahut të Lartësuar, i larguar nga nënshtrimi ndaj krijesave dhe i përkushtuar tërësisht ndaj Krijuesit". Më pas, i Lartësuari thotë:

- "Allahu e zgjodhi Ibrahimin si të dashurin (*khalil*) e Tij më të ngushtë." - "*Khalil*" vjen nga fjala "*el khul-leh*", që tregon gradën më të lartë të dashurisë. Kjo dashuri e madhe e Allahut i është falur vetëm dy prej robërve të Tij, Muhamedit (a.s.) dhe Ibrahimit (a.s.). Kjo është një dashuri e veçantë e Allahut të Lartësuar vetëm për këta të dy. Sidoqoftë, në mënyrë të përgjithshme, Allahu i Lartësuar i do të gjithë besimtarët.

Allahu i Madhëruar e përzgjodhi Ibrahimin (a.s.), sepse ai plotësoi me përpikmëri çdo gjë për të cilën u urdhërua dhe qëndroi i fortë dhe i paepur kundrejt çdo sprove që i erdhi. Për këto arsye, Allahu i Lartësuar e bëri atë imam të të gjithë njerëzve, i fali dashurinë e Tij të madhe dhe e përhapi famën e tij në mbarë botën.

Ajeti 126

126. Vetëm të Allahut janë ç'ka në qiej dhe ç'ka në tokë. Allahu përfshin gjithçka.

Shpjegimi i ajetit

Ajeti flet për gjithëpërfshirjen e pushtetit dhe dijes së Allahut të Lartësuar. Gjithçka është pronë e Allahut dhe të gjithë janë robër të Tij. Allahu përkujdeset për pronën e Tij dhe administron çështjet e tyre. Dija e Tij është absolute dhe përfshin çdo njohuri. Shikimi i Tij është absolut dhe Ai përfshin gjithçka me shikimin e Tij. Dëgjimi i Tij është absolut dhe Ai përfshin gjithçka me dëgjimin e Tij. Dëshira, pushteti dhe mbretërimi i Tij ekzekutohen mbi çdo gjë që ekziston. Mëshira e Tij përfshin banorët e tokës dhe të qiejve. Përballë krenarisë dhe madhështisë së Tij janë nënshtruar të gjitha krijesat.

Ajeti 127

127. Ata kërkojnë prej teje *(o Muhamed)* që t'i sqarosh lidhur me çështjet e grave. Thuaju se për çështjet e tyre, ju sqaron Allahu dhe këto që po ju lexohen nga Libri, si për vajzat jetime, me të cilat lakmoni të martoheni, por nuk u jepni atë *(mehrin)* që është caktuar për to, edhe për fëmijët e mitur. Allahu ju udhëzon që të mbani drejtësi ndaj jetimëve! Çfarëdo të mire që bëni, Allahu e di shumë mirë atë.

Shpjegimi i ajetit

- "Ata kërkojnë prej teje *(o Muhamed)* që t'i sqarosh lidhur me çështjet e grave." - Allahu i Lartësuar na tregon se besimtarët i kërkonin Profetit (a.s.) fetva rreth çështjeve të grave. Atëherë, Allahu i Lartësuar iu përgjigj vetë besimtarëve, duke thënë:

- "...Thuaju se për çështjet e tyre, ju sqaron Allahu..." – Pra, punoni dhe vini në zbatim porositë e Allahut të Lartësuar për të gjitha çështjet që kanë lidhje me gratë, duke përmbushur të drejtat dhe detyrimet ndaj tyre dhe duke iu larguar padrejtësive ndaj tyre.

Ky është një urdhër i përgjithshëm, i cili na jep një mësim të rëndësishëm: porositë e Zotit, urdhra apo ndalesa qofshin, duhet të çohen në vend, duke iu dhënë haku që u

takon. Kështu duhet të trajtohen dispozitat që kanë të bëjnë me gratë apo me burrat, me të miturit apo me të rriturit.

Më pas, për shkak të rëndësisë së madhe të çështjes, Allahu i Lartësuar ka dhënë një porosi të veçantë për kujdesin ndaj të dobtëve, siç janë jetimët. Ajeti tregon rëndësinë e madhe që Allahu i kushton kësaj kategorie dhe kërcënimin që i pret ata të cilët shkelin të drejtat e tyre. I Lartësuari thotë:

- "...dhe këto që po ju lexohen nga Libri..." - Allahu i Lartësuar ju tregon në këtë libër dispozitat rreth vajzave jetime.

- "...si për vajzat jetime, me të cilat lakmoni të martoheni, por nuk u jepni atë *(mehrin)* që është caktuar për to..." – Në ato kohë, kur është bërë edhe pyetja, shpesh kujdestarët ligjorë të vajzave jetime u bënin padrejtësi atyre në shumë forma, si: duke mos iu dhënë të drejtat e tyre, duke ngrënë tërë pasurinë e tyre ose një pjesë të saj, duke i penguar që të martoheshin me dikë tjetër, sepse në këtë mënyrë do t'iu hiqej pasuria e tyre, duke marrë padrejtësisht nga mehri që ato meritonin ose duke mos iu dhënë të plotë mehrin që u takonte. Të gjitha këto ishin padrejtësi, nga të cilat na ndalon ky ajet.

- "...edhe për fëmijët e mitur..." - Allahu i Lartësuar ju sqaron rreth fëmijëve të vegjël dhe pa mbështetje. Ai ju porosit që t'u jepni të drejtat e tyre të plota, si në çështjen e trashëgimisë, ashtu edhe në çështje të tjera. Ai ju ndalon që t'i shfrytëzoni padrejtësisht pasuritë e tyre.

- "Allahu ju udhëzon që të mbani drejtësi ndaj jetimëve!" – Kuptimi: Mbani drejtësi të plotë dhe përkujdesuni për ta, në të gjitha aspektet. Edukojini ata që të jenë të bindur dhe të nënshtruar ndaj Allahut të Lartësuar. Urdhërojini që të zbatojnë detyrat dhe porositë e Zotit. Kujdesuni edhe për çështjet e tyre të dynjasë, duke ndihmuar në shtimin e pasurisë së tyre dhe duke zgjedhur mënyrat më të mira për këtë gjë. Mos cenoni të drejtat e tyre për hir të miqësive me të tjerët.

Ky është treguesi i mëshirës së Allahut të Lartësuar për robërit e Tij, të cilët Ai i këshillon vazhdimisht që të përkujdesen për njerëzit që nuk kanë mundësi të kujdesen për veten e vet, për shkak të paaftësisë apo mungesës së prindërve.

Më pas, Allahu i Lartësuar na urdhëron që të jemi bamirës në çdo drejtim:

- "Çfarëdo të mire që bëni, Allahu e di shumë mirë atë." – Kuptimi: Çfarëdo të mire që të bëni, qoftë për jetimët, qoftë dhe për të tjerët, qoftë e mirë personale, qoftë e mirë e përgjithshme, Allahu i Lartësuar e di mirë atë. Allahu i Madhëruar ka përfshirë me dijen e Tij çdo punë që kryejnë krijesat, të mirë apo të keqe, të vogël apo të madhe, dhe për secilin ka përgatitur shpërblimin që meriton.

Ajeti 128

128. Nëse ndonjë grua i frikësohet largimit ose ftohjes së burrit të vet ndaj asaj, atëherë ata nuk gabojnë nëse pajtohen me njëri-tjetrin. Pajtimi është më i mirë. Njerëzit janë të prirur nga koprracia. Nëse ju bëni mirë dhe tregoheni të devotshëm, s'ka dyshim se Allahu di gjithçka që ju veproni.

Shpjegimi i ajetit


- "Nëse ndonjë grua i frikësohet largimit ose ftohjes së burrit të vet ndaj asaj, atëherë ata nuk gabojnë nëse pajtohen me njëri-tjetrin." - Nëse gruaja i druhet largimit dhe ftohjes së burrit të vet ndaj saj, më e mira në të tilla raste është që ata të pajtohen mes njëri-tjetrit. Kështu, gruaja ose burri mund të tolerojnë dhe të heqin dorë nga disa prej të drejtave të tyre, me qëllim që të vazhdojnë lidhjen martesore, dhe këtu nuk ka asnjë gjynah. Përkundrazi, pajtimi është më i mirë sesa ndarja, siç thotë Allahu i Lartësuar:

- "Pajtimi është më i mirë." - Marrëveshja ose pajtimi është më i mirë sesa këmbëngulja e secilës palë për të marrë tërësisht hakun e vet, në rastet kur ata kërkojnë të drejtat nga njëri-tjetri. Pra, është mirë që secila palë t'i bëjë lëshime palës tjetër.

Pajtimi mundëson që afrimiteti të jetë i vazhdueshëm dhe kultivon te njeriu virtytet e faljes, tolerancës dhe bamirësisë. Marrëveshjet janë të lejuara në çdo çështje, me kusht që të mos bëhet haram diçka që Zoti e ka lejuar dhe të mos bëhet e lejuar diçka që Zoti e ka ndaluar. Në këto raste, marrëveshjet janë të padrejta dhe të palejueshme. Dije se asnjë gjykim nuk hyn në fuqi derisa të plotësohen kushtet dhe të hiqen pengesat e zbatimit të tij. Në rastin tonë, kur kemi të bëjmë me gjykimin për pajtim, Allahu i Lartësuar ka thënë se ky është një veprim i mirë dhe i drejtë. Gjithashtu, çdo njeri i logjikshëm i konsideron të mira të tilla ndërmarrje dhe nxit për plotësimin e tyre. Megjithatë, kur mëson që Allahu i Lartësuar ka urdhëruar për të tilla marrëveshje, besimtari motivohet edhe më tepër për kryerjen e tyre.

- "Njerëzit janë të prirur nga koprracia." – Njerëzit janë të prirur që të mos i shpenzojnë të mirat që zotërojnë. Ata janë të prirur, gjithashtu, që ta kërkojnë hakun e tyre të plotë, pa asnjë mangësi. Këto prirje i kanë rrënjët në natyrën e njeriut.

Duket sikur ky ajet urdhëron dhe thotë: "Është detyrë për ju që të përpiqeni shumë për ta shkulur nga shpirti këtë cilësi të ulët dhe, në vend të saj, të kultivoni faljen, tolerancën dhe bujarinë. Toleranca ose lëshimi që njeriu bën në të drejtat e tij, në emër të faljes dhe bujarisë, është një virtyt shumë i lartë dhe i rëndësishëm. Nëse njeriu e kultivon te vetja këtë cilësi të lartë, ai e ka më të thjeshtë të arrijë pajtimin me të tjerët. Ndërsa ai që nuk e ka edukuar veten dhe nuk e mjekon sëmundjen e koprracisë, ai e ka shumë të vështirë që të bëjë konpromise dhe të tolerojë të tjerët, por kërkon me


الجزء الخامس سورة النساء

وَإِنِ ٱمۡرَأَةٌ خَافَتۡ مِنۢ بَعۡلِهَا نُشُوزًا أَوۡ إِعۡرَاضٗا فَلَا جُنَاحَ
عَلَيۡهِمَآ أَن يُصۡلِحَا بَيۡنَهُمَا صُلۡحٗاۚ وَٱلصُّلۡحُ خَيۡرٞۗ
وَأُحۡضِرَتِ ٱلۡأَنفُسُ ٱلشُّحَّۚ وَإِن تُحۡسِنُواْ وَتَتَّقُواْ فَإِنَّ ٱللَّهَ
كَانَ بِمَا تَعۡمَلُونَ خَبِيرٗا ١٢٨ وَلَن تَسۡتَطِيعُوٓاْ أَن تَعۡدِلُواْ
بَيۡنَ ٱلنِّسَآءِ وَلَوۡ حَرَصۡتُمۡۖ فَلَا تَمِيلُواْ كُلَّ ٱلۡمَيۡلِ فَتَذَرُوهَا
كَٱلۡمُعَلَّقَةِۚ وَإِن تُصۡلِحُواْ وَتَتَّقُواْ فَإِنَّ ٱللَّهَ كَانَ
غَفُورٗا رَّحِيمٗا ١٢٩ وَإِن يَتَفَرَّقَا يُغۡنِ ٱللَّهُ كُلّٗا مِّن سَعَتِهِۦۚ
وَكَانَ ٱللَّهُ وَٰسِعًا حَكِيمٗا ١٣٠ وَلِلَّهِ مَا فِي ٱلسَّمَٰوَٰتِ
وَمَا فِي ٱلۡأَرۡضِۗ وَلَقَدۡ وَصَّيۡنَا ٱلَّذِينَ أُوتُواْ ٱلۡكِتَٰبَ مِن
قَبۡلِكُمۡ وَإِيَّاكُمۡ أَنِ ٱتَّقُواْ ٱللَّهَۚ وَإِن تَكۡفُرُواْ فَإِنَّ لِلَّهِ
مَا فِي ٱلسَّمَٰوَٰتِ وَمَا فِي ٱلۡأَرۡضِۚ وَكَانَ ٱللَّهُ غَنِيّٗا حَمِيدٗا
١٣١ وَلِلَّهِ مَا فِي ٱلسَّمَٰوَٰتِ وَمَا فِي ٱلۡأَرۡضِۚ وَكَفَىٰ بِٱللَّهِ وَكِيلًا
١٣٢ إِن يَشَأۡ يُذۡهِبۡكُمۡ أَيُّهَا ٱلنَّاسُ وَيَأۡتِ بِـَٔاخَرِينَۚ وَكَانَ
ٱللَّهُ عَلَىٰ ذَٰلِكَ قَدِيرٗا ١٣٣ مَّن كَانَ يُرِيدُ ثَوَابَ ٱلدُّنۡيَا فَعِندَ ٱللَّهِ
ثَوَابُ ٱلدُّنۡيَا وَٱلۡأٓخِرَةِۚ وَكَانَ ٱللَّهُ سَمِيعَۢا بَصِيرٗا ١٣٤
٩٩

ngulm hakun e vet, pa asnjë tolerim dhe lëshim. Në këtë rast, nëse edhe kundërshtari i tij është me të njëjtat prirje, çështja vështirësohet shumë dhe bëhet e rrezikshme. Më pas, Allahu i Lartësuar thotë:

- "Nëse ju bëni mirë dhe tregoheni të devotshëm, s'ka dyshim se Allahu di gjithçka që ju veproni." - Këtu Allahu i Lartësuar jep dy porosi. Porosia e parë është: të bësh mirë. Bamirësia (*ihsan*) tregohet në dy drejtime:

1. Bamirësi në drejtim të adhurimit të Zotit të Lartësuar, e cila, siç e ka shpjeguar Pejgamberi (a.s.), arrihet duke adhuruar Zotin sikurse ti e sheh Atë, sepse, edhe nëse ti nuk e sheh Atë, Ai të sheh ty.

2. Bamirësi ndaj krijesave, me të gjitha rrugët dhe mënyrat e saj të larmishme, si nëpërmjet pasurisë, dijes, famës, pushtetit, njohjeve dhe miqësive etj.

Porosia e dytë është devotshmëria. Devotshmëri do të thotë të ruhesh nga

ndëshkimi i Zotit të Lartësuar. Ajo arrihet duke kryer të gjitha urdhëresat e Zotit dhe duke iu larguar të gjitha ndalesave të Tij.

Megjithatë, ka mundësi që shprehja: "*bëni mirë*" të ketë si qëllim kryerjen e urdhrave, ndërsa: "*tregoheni të devotshëm*" të nënkuptojë largimin nga haramet.

Pra, nëse plotësoni këto dy kushte, atëherë: "...s'ka dyshim se Allahu di gjithçka që ju veproni". Allahu i Lartësuar njeh të dukshmen dhe të fshehtën. Ai i ka regjistruar veprat tuaja dhe do t'ju japë për to shpërblimin e merituar.

Ajeti 129

129. Ju nuk do mund të mbani drejtësi të plotë mes grave, edhe nëse përpiqeni, por mos anoni tërësisht nga njëra, e të lini tjetrën pezull. Nëse ju i përmirësoni marrëdhëniet dhe ruheni nga padrejtësitë, pa dyshim Allahu është Falës e Mëshirëplotë.

Shpjegimi i ajetit

- "Ju nuk do mund të mbani drejtësi të plotë mes grave, edhe nëse përpiqeni..." - Allahu i Lartësuar na tregon se është jashtë mundësive të burrit që të mbajë drejtësi të plotë mes grave (kur është i martuar me më shumë se një grua), në aspektin e dashurisë që duhet të ndiejë për to, dhe, rrjedhimisht edhe në mënyrën e sjelljes me to. Është e pamundur që burri ta arrijë këtë drejtësi të plotë, por Allahu i Lartësuar i fal gabimet që janë jashtë mundësive të njeriut për t'i përballuar.

Sidoqoftë, Allahu i Lartësuar na ndalon nga padrejtësia, nëse kjo është brenda mundësive tona. Ai thotë:

- "...por mos anoni tërësisht nga njëra, e të lini tjetrën pezull." - Mos anoni tërësisht nga njëra duke mos i dhënë hakun që i takon tjetrës. Bëni gjithçka që është brenda mundësive tuaja, për të mbajtur drejtësinë mes tyre.

Shpenzimet jetësore për ushqim e veshmbathje, strehimi dhe numri i ditëve të qëndrimit me bashkëshortet janë të drejta që duhet të ndahen në mënyrë të barabartë mes tyre. Ndërsa për sa u përket ndjenjave, preferencave, dashurisë apo marrëdhënieve intime me to, në të tilla çështje nuk mund të pretendohet se mund të mbahet drejtësia.

Megjithatë, një grua nuk duhet lënë mënjanë, tërësisht si e varur: as me burrë, që të plotësojë nevojat e saj, e as pa burrë, që të mund të martohet me dikë tjetër.

- "Nëse ju i përmirësoni marrëdhëniet dhe ruheni nga padrejtësitë, pa dyshim Allahu është Falës e Mëshirëplotë." - Për të na falur dhe mëshiruar, Allahu i Lartësuar na jep dy porosi:

1. Përmirësoni marrëdhëniet me gratë dhe mbani drejtësi, duke shpresuar shpërblimin e Zotit. Përmbushni detyrimet ndaj tyre, përmirësoni lidhjet me të tjerët, pajtoni njerëzit që ndodhen në konflikte, duke përdorur çdo mënyrë të lejuar.

2. Pajisuni me devotshmëri, duke kryer urdhëresat, duke iu larguar harameve dhe duke bërë durim ndaj caktimit të Zotit.

Nëse i zbatoni këto porosi, do ta gjeni Allahun e Lartësuar Falës e Mëshirues. Ai do t'ju falë për gjynahet tuaja dhe për mangësitë në kryerjen e detyrimeve. Ai do t'ju mëshirojë, ashtu sikurse ju tregoheni tolerues ndaj grave tuaja.

Ajeti 130

130. Nëse ndahen prej njëri tjetrit, Allahu do të begatojë secilin prej tyre me mirësitë e Tij. Allahu është Bujar dhe i Urtë.

Shpjegimi i ajetit

Nëse është e pamundur marrëveshja dhe pajtimi mes bashkëshortëve, atëherë nuk është gabim që ata të ndahen. Nëse ata arrijnë në divorc, është Allahu i Lartësuar që do t'i furnizojë të dyja palët me bujarinë e Tij gjithëpërfshirëse. Ai do t'i mundësojë burrit

të martohet me një grua më të mirë se ajo nga e cila është ndarë. Po ashtu, Ai do ta ndihmojë gruan e divorcuar me mirësinë e Tij, duke e furnizuar dhe duke e bërë të mjaftohet me mirësinë e Tij. Allahu i Lartësuar është Ai që ka në dorë furnizimin e krijesave dhe që kujdeset për to. Allahu i Lartësuar ndoshta i mundëson gruas që të martohet me një burrë më të mirë sesa ai nga i cili ajo është ndarë. Allahu i Madhëruar është Bujar me mirësitë e Tij. Bujaria e Tij përputhet me dijen e Tij.

Përveç kësaj, Allahu është edhe i Urtë. Ai jep me urtësi dhe privon po me urtësi. Nëse urtësia e Tij kërkon që, për shkak të gjynaheve të tyre, Ai t'i privojë njerëzit nga disa mirësi, Ai i privon ata. Kjo është drejtësia dhe urtësia e Tij.

Ajetet 131 – 132

131. Vetëm të Allahut janë ç'ka në qiej e ç'ka në tokë. Ne i porositëm ata që iu dha Libri para jush, ashtu si edhe ju, që të keni frikë nga Allahu. Por nëse mohoni, *(ta dini se)* të Allahut janë ç'ka në qiej e ç'ka në tokë. Allahu është Jonevojtar e i Lavdëruar.
132. Të Allahut janë ç'ka në qiej e ç'ka në tokë. Mjafton që Allahu është Mbrojtësi juaj!

Shpjegimi i ajeteve

- "Vetëm të Allahut janë ç'ka në qiej e ç'ka në tokë." - Allahu i Lartësuar na tregon rreth gjithëpërfshirjes së pushtetit dhe mbretërimit të Tij. Ky pushtet i jep të drejtën Atij që të veprojë dhe të administojë të gjitha çështjet në gjithësinë, që Vetë e ka krijuar. Është Ai që vendos ligjet, qofshin ato në lidhje me funksionimin e kësaj gjithësie, qofshin në lidhje me Sheriatin. Ndër ligjet që kanë të bëjnë me Sheriatin, është edhe porosia për t'u pajisur me devotshmëri:

- "Ne i porositëm ata që iu dha Libri para jush, ashtu si edhe ju, që të keni frikë nga Allahu." - Allahu i Lartësuar i ka urdhëruar të parët dhe të fundit njerëz, nëpërmjet librave hyjnorë, që të jenë të devotshëm dhe t'i frikësohen Atij.

Ky urdhër për devotshmëri sigurisht që është shoqëruar me shumë ligje e norma, që rregullojnë marrëdhëniet e robërve me Zotin dhe mes njëri-tjetrit. Ai është shoqëruar edhe me përgëzim për shpërblim të përjetshëm dhe të pamasë për ata që iu përmbahen këtyre ligjeve e normave, dhe me paralajmërim për ndëshkim dhe vuajtje të përjetshme për ata që i shpërfillin dhe nuk iu përmbahen atyre. Më pas, i Lartësuari thotë:

- "Por nëse mohoni, *(ta dini se)* të Allahut janë ç'ka në qiej e ç'ka në tokë. Allahu është Jonevojtar e i Lavdëruar. - Nëse ju mohoni Zotin dhe e shpërfillni porosinë e Tij për të qenë të devotshëm, nëse ju i konsideroni idhujt si të barabartë me Zotin, gjë për të cilën nuk keni asnjë provë nga Zoti, atëherë ju, në këtë mënyrë, dëmtoni veçse veten tuaj, dhe kurrsesi Zotin. Mosbesimi, idhujtaria dhe mosbindja juaj nuk e pakësojnë aspak pushtetin dhe mbretërimin e Tij. Nëse ju e mohoni, dijeni se Atë e adhurojnë me përkushtim dhe bindje të plotë adhurues që janë më të mirë dhe më të mëdhenj se ju.

El Ganij është një nga emrat e Allahut të Lartësuar, që do të thotë: Jonevojtar, i Pasur i tillë që nuk ka nevojë për asgjë, por gjithçka ka nevojë për Të. Ai është Bujari e Bamirësi absolut. Bujaria dhe bamirësia e Allahut të Lartësuar burojnë nga mëshira e Tij, të cilën kurrë nuk mund ta shterojnë shpenzimet dhe dhuratat që Ai jep natë e ditë. Sikur të gjithë banorët e qiejve dhe të tokës, të parët dhe të fundit, njerëzit dhe xhinët, të mblidheshin së bashku dhe secili prej tyre të kërkonte çdo gjë që të dëshironte, kjo nuk do ta pakësonte aspak pasurinë e Tij, sepse Ai është *Xheu-uâd* (Bamirës), I pasur dhe i plotpushtetshëm. Mirësia që Allahu i Lartësuar dëshiron për krijesat bëhet thjesht me një fjalë. Edhe kur dëshiron të godasë me ndëshkimin e Tij, kjo bëhet veç me një fjalë.

Çdo gjë që Ai dëshiron bëhet me fjalën e Tij: "*Kun*!" -"Bëhu!".

Allahu i Lartësuar s'ka nevojë për adhurimet tona, sepse Ai është absolut në të gjitha cilësitë dhe atributet e Tij. Të qenurit i varfër dhe nevojtar janë cilësi mangësie, prandaj nuk kanë lidhje me të Madhërishmin. Atij i takon çdo cilësi dhe përshkrim i plotë, prandaj dhe është i Pashoq dhe i Pakrahasueshëm. Asnjë krijesë nuk i ngjan Atij. Duke qenë Jonevojtar, Allahu i Lartësuar nuk ka grua apo fëmijë, nuk ka partner a bashkëpunëtor në pushtetin dhe mbretërimin e Tij. Ai nuk ka nevojë për ndihmës në mbretërimin e Tij. Ai është i Pasuri Jonevojtar, për mëshirën, furnizimin dhe përkujdesjen e të Cilit kanë nevojë bota qiellore dhe ajo tokësore. Të gjithë i drejtohen vetëm Allahut të Lartësuar për çdo kërkesë, e madhe apo e vogël qoftë ajo, ndërsa Ai i plotëson këto kërkesa, duke i kënaqur dhe qetësuar ata, duke i udhëzuar ata në mirësi dhe mbarësi.

El Hamid është një emër tjetër i Allahut të Lartësuar, që do të thotë: i Lavdëruari. Ky emër tregon që Allahu meriton çdo lavdërim, dashuri e mirënjohje. Atij i takon lavdia e plotë, sepse Ai i ka të gjitha cilësitë e bukurisë dhe madhështisë. Për të gjitha mirësitë e mëdha dhe kujdesin gjithëpërfshirës që Ai u kushton krijesave të Tij, Ai meriton lavdinë e plotë në çdo gjendje.

Sa e bukur është përmendja e këtyre dy emrave së bashku me njëri-tjetrin. Allahu është Absolut për faktin se është Jonevojtar, është Absolut sepse është i Lavdëruar. Ai është Absolut edhe për të dyja cilësitë bashkë.

- "Të Allahut janë ç'ka në qiej e ç'ka në tokë. Mjafton që Allahu është Mbrojtësi juaj!" - Këtu i Lartësuari flet për përfshirjen në pushtetin e Tij të gjithçkaje në qiell dhe në tokë dhe për faktin se Ai është Mbrojtësi e Kujdestari, që kujdeset për çdo çështje, me dijen dhe urtësinë e Tij absolute. Kujdestari i një çështjeje duhet të jetë i ditur për atë çështje dhe të ketë fuqinë e pushtetin për ta përmbushur atë në formën e duhur dhe me urtësi. Çdo mangësi në dije, pushtet dhe urtësi është dobësi e kujdestarit, ndërsa Allahu është i pastër nga çdo mangësi.

Ajetet 133 – 134

133. Nëse Ai dëshiron, ju zhduk ju, o njerëz, e sjell të tjerë, dhe është fuqiplotë ta bëjë këtë.
134. Kush dëshiron shpërblimin e kësaj bote, *(le ta dijë se)* tek Allahu është shpërblimi i kësaj bote dhe i botës tjetër. Allahu është Gjithëdëgjues e Gjithëshikues.

Shpjegimi i ajeteve

- "Nëse Ai dëshiron, ju zhduk ju, o njerëz, e sjell të tjerë, dhe është fuqiplotë ta bëjë këtë." – Kuptimi: Allahu është i Pasuri, që nuk ka nevojë për ju. Ai është i Lavdëruari. Ai është i Plotpushtetshmi, që, nëse dëshiron t'ju zhdukë dhe të sjellë të tjerë, askush nuk mund ta kundërshtojë vendimin e Tij. Nëse Ai dëshiron, ju zhduk ju dhe sjell njerëz të tjerë, që të jenë të bindur dhe më të mirë se ju.


Ky është një kërcënim i hapur për njerëzit që vazhdojnë të enden në kufër, duke i kthyer shpinën Zotit të tyre. Asgjë nuk e ndalon Zotin që t'i ndëshkojë ata, nëse vazhdojnë të mos i binden dhe ta mohojnë, por Ai i afatizon ata; i afatizon, por nuk i harron.

- "Kush dëshiron shpërblimin e kësaj bote, *(le ta dijë se)* tek Allahu është shpërblimi i kësaj bote dhe i botës tjetër." - Allahu i Lartësuar na tregon se ata që kanë si qëllim vetëm arritjen e mirësive të kësaj dynjaje, duke mos i dhënë asnjë rëndësi ahiretit, ata me të vërtetë kanë një qëllim dritëshkurtër dhe fatkeq. Për më tepër që, edhe pse i përkushtohen tërësisht kësaj dynjaje, ata do

të arrijnë prej saj veçse atë që Zoti u ka bërë për pjesë.

Allahu i Lartësuar është Sunduesi dhe Mbretëruesi i vetëm i kësaj gjithësie dhe vetëm në dorën e Tij janë mirësitë e dynjasë dhe të ahiretit, prandaj njeriu duhet t'i lutet vetëm Atij dhe vetëm tek Ai duhet të mbështetet dhe të kërkojë ndihmë për t'i arritur qëllimet e dynjasë dhe të ahiretit. Njeriu duhet ta dijë mirë se mirësitë e Allahut, në të dyja jetët, arrihen veçse nëpërmjet bindjes dhe nënshtrimit ndaj Tij. Ai duhet të bindet se çelësi i suksesit në çështjet e dynjasë dhe të ahiretit është mbështetja e plotë vetëm tek Allahu, duke i shprehur pamundësinë dhe nevojën Atij në mënyrë të vazhdueshme.

Allahu i Madhërishëm është i Gjithëdijshëm dhe i Urtë në përcaktimin e Tij. Ai i jep sukses atij që e meriton atë dhe privon atë që e meriton të privohet. Allahu është i Urtë kur jep dhe kur nuk jep, prandaj thotë:


الجزء الخامس سورة النساء
الحزب ١٠
يَٰٓأَيُّهَا ٱلَّذِينَ ءَامَنُواْ كُونُواْ قَوَّٰمِينَ بِٱلْقِسْطِ شُهَدَآءَ لِلَّهِ وَلَوْ
عَلَىٰٓ أَنفُسِكُمْ أَوِ ٱلْوَٰلِدَيْنِ وَٱلْأَقْرَبِينَ ۚ إِن يَكُنْ غَنِيًّا أَوْ فَقِيرًا
فَٱللَّهُ أَوْلَىٰ بِهِمَا ۖ فَلَا تَتَّبِعُواْ ٱلْهَوَىٰٓ أَن تَعْدِلُواْ ۚ وَإِن تَلْوُۥٓاْ
أَوْ تُعْرِضُواْ فَإِنَّ ٱللَّهَ كَانَ بِمَا تَعْمَلُونَ خَبِيرًا ﴿١٣٥﴾ يَٰٓأَيُّهَا
ٱلَّذِينَ ءَامَنُوٓاْ ءَامِنُواْ بِٱللَّهِ وَرَسُولِهِۦ وَٱلْكِتَٰبِ ٱلَّذِى نَزَّلَ
عَلَىٰ رَسُولِهِۦ وَٱلْكِتَٰبِ ٱلَّذِىٓ أَنزَلَ مِن قَبْلُ ۚ وَمَن يَكْفُرْ
بِٱللَّهِ وَمَلَٰٓئِكَتِهِۦ وَكُتُبِهِۦ وَرُسُلِهِۦ وَٱلْيَوْمِ ٱلْءَاخِرِ فَقَدْ ضَلَّ
ضَلَٰلًۢا بَعِيدًا ﴿١٣٦﴾ إِنَّ ٱلَّذِينَ ءَامَنُواْ ثُمَّ كَفَرُواْ ثُمَّ ءَامَنُواْ ثُمَّ
كَفَرُواْ ثُمَّ ٱزْدَادُواْ كُفْرًا لَّمْ يَكُنِ ٱللَّهُ لِيَغْفِرَ لَهُمْ وَلَا لِيَهْدِيَهُمْ
سَبِيلًۢا ﴿١٣٧﴾ بَشِّرِ ٱلْمُنَٰفِقِينَ بِأَنَّ لَهُمْ عَذَابًا أَلِيمًا ﴿١٣٨﴾ ٱلَّذِينَ
يَتَّخِذُونَ ٱلْكَٰفِرِينَ أَوْلِيَآءَ مِن دُونِ ٱلْمُؤْمِنِينَ ۚ أَيَبْتَغُونَ
عِندَهُمُ ٱلْعِزَّةَ فَإِنَّ ٱلْعِزَّةَ لِلَّهِ جَمِيعًا ﴿١٣٩﴾ وَقَدْ نَزَّلَ عَلَيْكُمْ فِى
ٱلْكِتَٰبِ أَنْ إِذَا سَمِعْتُمْ ءَايَٰتِ ٱللَّهِ يُكْفَرُ بِهَا وَيُسْتَهْزَأُ بِهَا فَلَا
تَقْعُدُواْ مَعَهُمْ حَتَّىٰ يَخُوضُواْ فِى حَدِيثٍ غَيْرِهِۦٓ ۚ إِنَّكُمْ إِذًا مِّثْلُهُمْ ۗ
إِنَّ ٱللَّهَ جَامِعُ ٱلْمُنَٰفِقِينَ وَٱلْكَٰفِرِينَ فِى جَهَنَّمَ جَمِيعًا ﴿١٤٠﴾
١٠٠

- "Allahu është Gjithëdëgjues e Gjithëshikues." – i veprave të robërve dhe synimeve të tyre. Prandaj udhëzon në rrugë të drejtë atë që dëshiron. Ai do të shpërblejë me drejtësinë dhe bamirësinë e tij të gjithë sipas asaj që kanë paraqitur dhe e meritojnë.

Ajeti 135

135. O ju që keni besuar, të jeni përherë dëshmues të së drejtës për hir të Allahut, edhe nëse kjo është kundër vetes suaj, kundër prindërve ose kundër të afërmve tuaj, qoftë ai *(për të cilin dëshmohet)* pasanik ose varfanjak, sepse Allahu është më i ditur rreth tyre. Mos ndiqni emocionet e t'i shmangeni drejtësisë! Nëse shtrëmbëroni faktet ose tërhiqeni, *(dijeni se)* Allahu është i Gjithëditur për çka ju veproni.

Shpjegimi i ajetit

- "O ju që keni besuar, të jeni përherë dëshmues të së drejtës për hir të Allahut..." - Allahu i Lartësuar i urdhëron adhuruesit e Tij besimtarë që të jenë vazhdimisht dëshmues të së drejtës, për hir të Allahut. Pra, nuk thotë thjesht: "Jini dëshmues të së drejtës", por: "jini gjithmonë, në çdo rast dhe gjendje, në anën e të drejtës".

Drejtësia është plotësimi i hakut të Zotit dhe i hakut të krijesave. Por çdo të thotë të jesh i drejtë në plotësimin e hakut të Zotit? Do të thotë që mirësitë e dhuruara prej Tij, - dhe të gjitha mirësitë janë prej Tij - të mos i shfrytëzosh duke bërë poshtërsi ndaj Tij. Përkundrazi, ato duhet të jenë ndihmëse dhe nxitëse për ta adhuruar Allahun sa më mirë dhe për t'iu nënshtruar Atij, në shenjë mirënjohjeje dhe përunjësie për mirësitë e Tij.

Ndërsa drejtësia në dhënien e hakut të krijesave arrihet duke plotësuar detyrimet dhe përgjegjësitë kundrejt tyre, ashtu sikurse kërkon prej tyre të përmbushin detyrimet kundrejt teje. Për shembull, të plotësosh shpenzimet e detyrueshme, të lash borxhet dhe t'i trajtosh njerëzit sikurse dëshiron të të

trajtojnë ty, me edukatë dhe moral të pranueshëm, etj.

Një nga aspektet më të rëndësishme të mbajtjes së drejtësisë është ajo në dëshmi. Nuk lejohet që të gjykojmë në favor të një dëshmie thjesht se ashtu na pëlqen apo se ashtu e ndiejmë. Gjykimi duhet të ndërtohet mbi të vërtetën dhe faktet. Drejtësia kërkon që të mos e fshehësh dëshminë, qoftë ajo edhe kundër të dashurve të tu. I Lartësuari thotë:

- "...edhe nëse kjo është kundër vetes suaj, kundër prindërve ose kundër të afërmve tuaj, qoftë ai *(për të cilin dëshmohet)* pasanik ose varfanjak, sepse Allahu është më i ditur rreth tyre." - Mos mbani anën e pasanikut, për shkak të pasurisë së tij, dhe as anën e fakirit, për hir të dhembshurisë për të, por thjesht dëshmoni të vërtetën, në anën e kujtdo qoftë ajo.

Dëshmia e të vërtetës dhe qëndrimi gjithmonë në anën e saj janë ndër cilësitë më të mëdha treguese të besimit të njeriut dhe të gradës së tij në Islam. Kushdo që synon të shpëtojë dhe ta lartësojë veten, le të kujdeset që gjithmonë të jetë në anën e së vërtetës. Le të jetë ky qëllim i përhershëm, duke larguar prej vetes çdo gjë që pengon për të qenë i drejtë dhe për të vepruar sipas saj.

Duke qenë se penguesi më i madh nga drejtësia është pasimi i epsheve dhe i dëshirave, Allahu i Lartësuar na këshillon dhe thotë:

- "Mos ndiqni emocionet e t'i shmangeni drejtësisë!" - Mos pasoni ato dëshira tuaja që kundërshtojnë të vërtetën, sepse kështu do të largoheni shumë nga e drejta dhe nuk do t'ju jepet mundësi për të gjetur udhëzimin. Dëshirat e pakontrolluara ose të verbojnë, duke bërë që ta shohësh të vërtetën si të gabuar dhe të gabuarën si të vërtetë, ose do ta njohësh të vërtetën, por do ta braktisësh atë, për shkak të këtyre dëshirave. Pra, ai që disiplinon dëshirat dhe pasionet e tij, do të ketë sukses në gjetjen e së vërtetës dhe do të udhëzohet në të rrugën e drejtë.

Pasi na qartëson se është detyrë për ne që t'i përmbahemi të vërtetës dhe të drejtës, Allahu na ndaloi edhe nga e kundërta e kësaj:

- "Nëse shtrembëroni faktet ose tërhiqeni..." - Ai na ndalon nga të shprehurit me paqartësi, me qëllim për të shtrembëruar të vërtetën gjatë dëshmive apo në çdo rast tjetër. Ai na ndalon nga fshehja e së vërtetës, qoftë kjo e plotë apo e pjesshme. Këty hyn edhe shtrembërimi i dëshmive apo dhënia e tyre jo e plotë, ose shpjegimi jo i saktë i tyre nga dëshmuesi. Të gjitha këto konsiderohen si deklarata të paqarta dhe devijim nga e vërteta.

Nëse tërhiqeni nga e vërteta, të cilën është detyrë ta shfaqni, ta mbroni dhe ta përkrahni, si p.sh. mosdhënia e dëshmisë nga dëshmitari, apo mosgjykimi me drejtësi nga gjykatësi; atëherë kujtojeni mirë një fakt shumë të rëndësishëm:

- "....*(dijeni se)* Allahu është i Gjithëditur për çka ju veproni." - Ai përfshin me dijen e Tij të gjerë gjithçka që ju veproni. Ai i di ato të gjitha, të fshehtat dhe të dukshmet.

Ky është një kërcënim shumë i rëndë për ata që shtrembërojnë dhe tërhiqen nga e vërteta. Sigurisht që ky kërcënim bie më tepër mbi ata që gjykojnë padrejtësisht dhe dëshmojnë rrejshëm, sepse ky është një krim më i madh. Nëse të parët thjesht e lënë të vërtetën apo nuk e shfaqin atë tërësisht, këta të fundit e lënë të vërtetën tërësisht dhe merren me gënjeshtrën dhe padrejtësinë.

Ajeti 136

136. O ju që keni besuar, besoni vazhdimisht Allahut, të dërguarit të Tij, Librit, që gradualisht ia shpalli të Dërguarit të Tij dhe Librit që ka zbritur më parë. Kush nuk i beson Allahut, engjëjve të Tij, librave të Tij, të dërguarve të Tij dhe botës tjetër, ai ka humbur tepër larg.

Shpjegimi i ajetit

Mësoje se urdhri për të besuar mund t'u drejtohet ose atyre që ende nuk e kanë atë, ose atyre që e kanë atë. Në rastin e parë, urdhri është fillimisht për të besuar, sikurse është urdhri që u drejtohet jobesimtarëve: "O ju të cilëve ju është dhënë Libri! Besojeni atë *(Kur'ânin)* që e shpallëm si vërtetues të atij që keni në duar *(Teuratit)*, para se të fshijmë fytyra dhe t'i kthejmë ato prapa, ose t'ju mallkojmë siç i mallkuam ata *(shkelësit e ligjit)* të së shtunës. Urdhri i Allahut është i pakthyeshëm.". [Nisa 47].

Ndërsa në rastin e dytë, kur u drejtohet atyre që e kanë tashmë besimin, ai është urdhër për të rregulluar dhe plotësuar besimin që gjendet në zemrën e tyre. Kështu ndodh edhe në këtë ajet, ku Allahu i Lartësuar i urdhëron besimtarët për të besuar. Pra, Ai i urdhëron ata që të përmirësojnë dhe plotësojnë besimin e tyre, duke kultivuar sinqeritetin e vërtetësinë, duke u larguar nga çdo gjë që e prish dhe cenon këtë besim, si edhe duke u penduar apo duke forcuar lidhjet me Zotin e tyre. Gjithashtu, ky është urdhër për të shtuar ato elementë të imanit, që ende nuk gjenden te besimtari, duke thelluar njohuritë rreth tyre dhe veprave që përfaqësojnë.

Kur besimtari mëson diçka të re nga Shpallja e Zotit, mediton rreth saj dhe e kupton qartë, atëherë ai arrin në një tjetër nivel të imanit të urdhëruar. Kështu ndodh me të gjitha veprat e tjera, të dukshme apo të fshehta. Sa më shumë bën vepra të mira, të urdhëruara nga Zoti, aq më i fortë i bëhet besimi. Të gjitha ato janë prej imanit dhe kultivuese të tij, sikurse dëshmojnë shumë tekstet të Sheriatit dhe konsensusi i brezave të parë të këtij umeti.

Ky ajet është edhe një urdhër për të qenë të vazhdueshëm dhe të pathyeshëm në këtë rrugë, deri në vdekje, sikurse thotë i Lartësuari në një ajet tjetër: "O ju që keni besuar! Pajisuni me devotshmëri ndaj Allahut me një sinqeritet të vërtetë, dhe mos vdisni ndryshe, por vetëm duke qenë muslimanë!!" [Al Imran 102].

Kështu, Allahu i Lartësuar thotë:

- "O ju që keni besuar, besoni vazhdimisht Allahut, të dërguarit të Tij, Librit, që gradualisht ia shpalli të Dërguarit të Tij dhe Librit që ka zbritur më parë." - Në këtë ajet, Allahu i Lartësuar na urdhëron për t'i besuar Atij dhe të dërguarve të Tij, të besojmë Kur'ânin dhe librat e shenjtë që janë shpallur më parë. Të gjitha këto janë pjesë të imanit të detyrueshëm për çdo njeri që hyn në fe. Askush nuk quhet besimtar nëse nuk ka qoftë edhe një prej këtyre besimeve.

Njeriu e ka detyrë që t'i besojë këto çështje, qoftë edhe në mënyrë të përgjithshme, për sa kohë nuk ka mundur t'i marrë ato të shtjelluara. Ndërsa ato çështje për të cilat ka marrë shpjegim të shtjelluar dhe të mjaftueshëm duhet t'i besojë më hollësisht, ashtu sikurse i ka mësuar nëpërmjet Shpalljes. Çdokush që e ka këtë iman të detyrueshëm, është i shpëtuar dhe i udhëzuar në rrugën e drejtë.

- "Kush nuk i beson Allahut, engjëjve të Tij, librave të Tij, të dërguarve të Tij dhe botës tjetër, ai ka humbur tepër larg." - E ku ka humbje më të largët se ajo e atij që braktis rrugën e drejtë të treguar nga Zoti nëpërmjet profetëve të Tij, për të shkuar drejt ndëshkimit të dhimbshëm?!

Dije se mohimi qoftë edhe i një çështjeje të vetme nga këto të përmendura konsiderohet si mohim i të gjitha atyre, sepse ato nënkuptojnë njëra-tjetrën. Nuk mund të besosh njërën prej tyre dhe të mohosh pjesën tjetër. Më tej, i Madhëruari thotë:

Ajeti 137

137. Vërtet, ata që besojnë e pastaj mohojnë, përsëri besojnë e pastaj mohojnë dhe e shtojnë mosbesimin, Allahu nuk i fal ata dhe as nuk i udhëzon në rrugë të drejtë.

Shpjegimi i ajetit

Çdokush që mohon pasi është udhëzuar njëherë, pastaj sërish mohon pasi udhëzohet përsëri, domethënë që preferon verbërinë pasi ka parë qartë të vërtetën, ai është shumë larg mundësisë për të gjetur udhëzimin në rrugën e drejtë të Zotit. Ai është larg faljes, sepse ka kryer një vepër, që konsiderohet si pengesa më e madhe për arritjen e faljes dhe të udhëzimit të Zotit. Mohimi i të tillë njerëzve vjen prej karakterit të tyre të pabesë dhe prej ndëshkimit të drejtë të Allahut të Lartësuar për veprat e tyre, sikurse thotë i Lartësuari në suren Saf, ajeti 5: "Por kur ata shmangen *(nga e vërteta)*, Allahu ua largon zemrat *(nga besimi)*. Allahu nuk e udhëzon në rrugë të drejtë një popull që kalon kufijtë." Ai thotë gjithashtu: "Ne ua largojmë zemrat dhe vështrimet e tyre *(prej besimit)*, ashtu sikurse ata nuk e besojnë atë *(Kur'ânin)* për herë të parë, dhe i lëmë ata të bredhin të hutuar në shfrenimin e tyre për të kaluar kufijtë". [En'am 110, 111].

Ajeti tregon se nëse ata nuk do ta shtonin dhe nuk do të thelloheshin më shumë në kufër, por do të ktheheshin në besim të penduar, Allahu i Lartësuar do t'i falte ata, edhe sikur një gjë e tillë të përsëritej e të përsëritej prej tyre. Kur një premtim i tillë vjen për përsëritjen e kufrit, atëherë kur bëhet fjalë për gjynahet poshtë tij, shpresa për falje është akoma edhe më e madhe, edhe nëse ato përsëriten. Sa herë që robi kthehet i penduar, Allahu i Lartësuar i kthehet atij gjithmonë me falje.

Ajetet 138 – 139

138. Paralajmëroji munafikët *(o Muhamed)* se, me të vërtetë, ata i pret një dënim të dhembshëm!
139. Ata që miqësohen me mohuesit, jo me besimtarët, vallë, a mos e kërkojnë krenarinë tek ata? Pa dyshim që e tërë krenaria i takon vetëm Allahut!

Shpjegimi i ajeteve

Allahu i Lartësuar thotë: "Paralajmëroji munafikët", pra, ata të cilët shfaqen si muslimanë, por që janë qafirë. Jepu atyre lajmin më të rëndë, atë për ndëshkimin e dhembshëm!

Ky kërcënim vjen për shkak të aleancës, miqësisë dhe dashurisë që ata tregojnë ndaj qafirëve, duke lënë mënjanë miqësinë me besimtarët. Por cili është shkaku që i shtyn ata në këtë përzgjedhje? Mos, vallë, në këtë mënyrë, ata shpresojnë që të arrijnë krenari dhe famë? Po, kjo është e vërteta. Kështu ëndërrojnë ata.

Mendimi i munafikëve për Allahun është i keq. Siguria e tyre për ndihmën e Allahut ndaj robërve të Tij besimtarë është e dobët. Ata magjepsen dhe mashtrohen nga mjetet dhe mundësitë në duart e qafirëve, prandaj priren që të miqësohen me ta. Por ky gjykim i tyre është shumë i mangët. E si mund të mashtrohesh, kur e gjithë krenaria dhe pushteti i takon vetëm Allahut të Lartësuar? Të gjitha krijesat dhe çështjet e tyre janë në dorë të Allahut. Çdo gjë që ndodh është ajo që Zoti ka dëshiruar të ndodhë.

Allahu i Lartësuar ka premtuar se do ta ndihmojë fenë e Tij dhe robërit e Tij besimtarë, edhe nëse herë pas here i sprovon ata, duke iu dhënë armiqve të tyre ndonjë mundësi dhe forcë. Por, pa dyshim, fitorja e fundit dhe triumfi është gjithnjë për besimtarët.

Ky ajet është një kërcënim i ashpër, që na ndalon të miqësohemi dhe të lidhim aleanca me qafirët, duke lënë mënjanë miqësinë dhe lidhjet me besimtarët, sepse kjo është cilësi e munafikëve. Imani nënkupton dashuri, miqësi dhe bashkëpunim të plotë me besimtarët, sikundër nënkupton urrejtje dhe armiqësi me qafirët, derisa ata të besojnë Zotin Një dhe Profetin e Tij.

Ajetet 140 – 141

140. Juve ju është shpallur në Libër *(Kur'ân)* që, kur të dëgjoni se mohohen shenjat e Allahut dhe po bëhet tallje me to, mos rrini me ata, derisa të hyjnë në bisedë

tjetër. Përndryshe, ju do të jeni si ata. Allahu do t'i tubojë në Xhehenem të gjithë munafikët dhe mohuesit.

141. Ata presin se çfarë do të bëhet me ju. Nëse, me ndihmën e Allahut, ju ngadhënjeni, ata thonë: "A nuk ishim edhe ne me ju?" E nëse jobesimtarët arrijnë ndonjë fitore, munafikët u thonë atyre: "A nuk ju ndihmuam në fitoren tuaj dhe a nuk ju mbrojtëm prej besimtarëve?!" Allahu do t'ju gjykojë ju Ditën e Gjykimit. Allahu nuk do t'u mundësojë kurrë jobesimtarëve epërsi të plotë mbi besimtarët.

Shpjegimi i ajeteve

Nëpërmjet Shpalljes, Allahu i Lartësuar tregon gjykimin e Tij për mënyrën e sjelljes së një besimtari kur ndodhet mes qafirëve dhe gjynahqarëve. Ai thotë:

- "Juve ju është shpallur në Libër *(Kur'ân)* që, kur të dëgjoni se mohohen shenjat e Allahut dhe po bëhet tallje me to, mos rrini me ata, derisa të hyjnë në bisedë tjetër." - Është detyrë për çdo të përgjegjshëm ligjërisht që t'i besojë, respektojë, madhërojë dhe shenjtërojë simbolet e Allahut dhe të fesë së Tij. Shenjat e Allahut dhe të fesë së Tij janë vendosur në tokë pikërisht që të respektohen, madhërohen dhe shenjtërohen. Ai i krijoi njerëzit dhe xhindet që ta adhurojnë Atë nëpërmjet respektimit dhe zbatimit të ligjit të Tij, prandaj mohimi dhe shpërfillja e këtyre porosive bie ndesh me besimin. Tallja me shenjat e Allahut dhe fjalët e Tij bie ndesh me madhërimin dhe respektin e tyre.

Tallje konsiderohet edhe polemika që mohuesit ose munafikët bëjnë për të hedhur poshtë argumentet e Allahut të Madhërishëm dhe për të arsyetuar kufrin e tyre. Po kështu, edhe çdo arsyetim dhe polemikë që bidatçinjtë bëjnë për të mbrojtur kotësitë e tyre konsiderohet si tallje dhe nënvlerësim i ajeteve të Allahut, që tregojnë veçse të vërtetën dhe të drejtën. Gjithashtu, tallje konsiderohet edhe pjesëmarrja në vendet ku kryhen gjynahe, fliten poshtërsira dhe shkelen urdhrat e Allahut. Ne jemi të ndaluar që të marrim pjesë në të tilla vende, derisa njerëzit aty të ndalen dhe të kalojnë në tjetër bisedë.

- "Përndryshe, ju do të jeni si ata." – Kuptimi: Nëse ju uleni dhe rrini së bashku me ta në të tilla gjendje, atëherë ju do të konsideroheni si ata, sepse tregoni pëlqim të kufrit dhe talljes së tyre. Bashkëjetesa me gjynahet është njëlloj si kryerja e tyre. Për këtë arsye, kush merr pjesë në të tilla vende, e ka detyrë që ta ndryshojë të keqen nëse ka mundësi, dhe nëse jo, atëherë të largohet prej andej.

- "Allahu do t'i tubojë në Xhehenem të gjithë munafikët dhe mohuesit." - Ashtu sikurse munafikët bashkohen me qafirët në dynja, ashtu do t'i bashkojë Zoti në ndëshkim në ahiret. Munafikëve nuk do t'u bëjë dobi fakti që në dynja shtiren si besimtarë, sikurse thotë i Lartësuari në suren Hadid 13 - 15: "Ditën kur munafikët dhe hipokritet do t'u thonë atyre që besuan: "Na prisni, që të ndriçohemi prej dritës suaj!" Por do t'u jepet përgjigjja: "Kthehuni pas (në dunja) dhe kërkojeni dritën!" Atëherë, ndërmjet tyre vendoset një mur, që ka një derë. Nga ana e brendshme e tij është mëshira *(Xheneti)*, ndërsa nga ana e jashtme është dënimi *(Zjarri)*. Ata do t'u thërrasin: "A nuk kemi qenë edhe ne së bashku me ju?!" - "Po, por ju e shkatërruat vetveten! Ju prisnit fat të zi për besimtarët, dyshonit në çështjet e fesë dhe u mashtruat nga jeta e dynjasë, deri kur ju erdhi caktimi i Allahut *(vdekja)*. Mashtruesi *(Shejtani)* ju mashtroi juve rreth Allahut. Kështu që sot nuk pranohet asnjë lloj kompensimi prej jush, e as prej atyre që nuk besuan. Zjarri është vendi juaj! Atë meritoni! Sa përfundim i keq është ai!" [Hadid 12 – 15].

Më pas, Allahu i Lartësuar përshkruan më hollësisht armiqësinë dhe pabesinë e munafikëve ndaj besimtarëve:

- "Ata presin se çfarë do të bëhet me ju." - Munafikët shohin me vëmendje ecurinë e ngjarjeve dhe perspektivën që i pret besimtarët, për të përgatitur përgjigjen, si munafikë që janë, për çdo rast, për mirë apo për keq.

- "Nëse, me ndihmën e Allahut, ju ngadhënjeni, ata thonë: "A nuk ishim edhe ne me ju?"" - Kur ndihma vjen për besimtarët, atëherë munafikët shfaqen sikur janë me ta, që të ruhen nga qortimet dhe marrja në përgjegjësi, si edhe për të marrë pjesë në plaçkën e luftës. Gjithashtu, ata shtiren si miq, që të përfitojnë nga aleanca me muslimanët nëse kanë nevojë.

- "E nëse jobesimtarët arrijnë ndonjë fitore..." – Këtu Allahu i Lartësuar nuk thotë siç tha për besimtarët "ndihmë nga Allahu", por thotë: "ndonjë fitore", domethënë fitore të përkohshme. Kjo sepse, edhe nëse Zoti, me urtësinë e Tij, u mundëson qafirëve ndonjë fitore, kjo nuk mund të jetë e vazhdueshme për ta, sikurse ndodh me besimtarët, por e përkohshme dhe e paqëndrueshme. Kur ndodh kjo, munafikët u thonë qafirëve:

- "...munafikët u thonë atyre: "A nuk ju ndihmuam në fitoren tuaj dhe a nuk ju mbrojtëm prej besimtarëve?!"" – Pra, a nuk ju kemi mbështetur dhe ndihmuar me të gjitha mënyrat e mundshme kundër besimtarëve, duke ndërmjetësuar tek ata për ju, madje edhe duke i penguar ata që t'ju luftojnë.

- "Allahu do t'ju gjykojë ju Ditën e Gjykimit." - Ai do t'i shpërblejë besimtarët me Xhenet, ndërsa munafikët, qafirët dhe idhujtarët do t'i ndëshkojë me Xhehenem.

- "Allahu nuk do t'u mundësojë kurrë jobesimtarëve epërsi të plotë mbi besimtarët." - Ata kurrë nuk mund t'i nënshtrojnë besimtarët tërësisht dhe përfundimisht. Gjithmonë do të jetë një grup besimtarësh që do të shfaqin të vërtetën dhe të cilët do të jenë të ndihmuar nga Allahu i Lartësuar. Ata nuk mund të dëmtohen as nga munafikët e pabesë dhe as nga ata që e kundërshtojnë rrugën e tyre.

Allahu i Madhërishëm gjithmonë hap mundësi të reja për të ndihmuar besimtarët dhe për të poshtëruar qafirët. Madje, ka shumë besimtarë në shtete qafirësh, që jetojnë me krenari dhe aspak të poshtëruar. Kjo është një mirësi dhe përkujdesje e madhe nga i Gjithmëshirshmi për robërit e Tij të bindur. Falënderimi i qoftë Allahut të Lartësuar për të gjitha mirësitë e Tij!

Ajetet 142 – 143

142. Munafikët përpiqen të mashtrojnë Allahun, por Ai i zhgënjen ata. Ata, kur ngrihen për namaz, ngrihen me përtesë, vetëm sa për t'u dukur para botës, ndërsa Allahun e përmendin fare pak.
143. Ata luhaten në mëdyshje: nuk janë as me këta, as me ata. Për këdo që Allahu e shpie në humbje, ti *(O Muhamed!)* nuk mund të gjesh shpëtim.

Shpjegimi i ajeteve

- "Munafikët përpiqen të mashtrojnë Allahun, por Ai i zhgënjen ata." - Allahu i Lartësuar na flet rreth munafikëve dhe cilësive të tyre të ndyra. Ata përpiqen të mashtrojnë Allahun dhe besimtarët, duke u hequr si muslimanë dhe duke fshehur kufrin e tyre. Ata mendojnë se kështu do të shpëtojnë nga Allahu i Madhërishëm. Por është Allahu i Lartësuar Ai që i lë ata të mashtrojnë vetveten dhe të mos e kuptojnë këtë gjë. Që në momentin kur ata synojnë të mashtrojnë Allahun dhe besimtarët, ata, në të vërtetë, janë duke mashtruar vetveten.

E ku ka njeri më të mashtruar se ai që dëmton vetveten, që e poshtëron dhe e privon atë nga mirësitë e dynjasë dhe të ahiretit?! Madje, kjo tregon edhe për mangësi në mendjen e tij. Ai jo vetëm që kryen një poshtërsi të madhe, por e sheh atë


si të mirë dhe pandeh se tregohet i zgjuar. *Subhanallah*, çfarë bën injoranca me ata që i ka vënë poshtë vetes!

Kështu i zhgënjen ata i Madhërishmi në këtë dynja, ndërsa në Ditën e Gjykimit, zhgënjimi që ata do të përjetojnë do të jetë shumë herë më i dhimbshëm: "Ditën kur munafikët dhe hipokritet do t'u thonë atyre që besuan: "Na prisni, që të ndriçohemi prej dritës suaj!" Por do t'u jepet përgjigjja: "Kthehuni pas *(në dunja)* dhe kërkojeni dritën!" Atëherë, ndërmjet tyre vendoset një mur, që ka një derë. Nga ana e brendshme e tij është mëshira *(Xheneti)*, ndërsa nga ana e jashtme është dënimi *(Zjarri)*. Ata do t'u thërrasin: "A nuk kemi qenë edhe ne së bashku me ju?!" - "Po, por ju e shkatërruat vetveten! Ju prisnit fat të zi për besimtarët, dyshonit në çështjet e fesë dhe u mashtruat nga jeta e dynjasë, deri kur ju erdhi caktimi i Allahut *(vdekja)*. Mashtruesi *(Shejtani)* ju mashtroi juve rreth Allahut. Kështu që sot nuk pranohet asnjë lloj kompensimi prej jush, e as prej atyre që nuk besuan. Zjarri është vendi juaj! Atë meritoni! Sa përfundim i keq është ai!" [Hadid 12 – 15].

Disa nga cilësitë e tyre që përmend Allahu i Lartësuar janë:

- "Ata, kur ngrihen për namaz, ngrihen me përtesë..." – Pra, edhe në kryerjen e namazit, që është adhurimi më i rëndësishëm, ata shfaqin dembelizëm dhe plogështi. Kjo ndodh veçse për shkak të mungesës së dëshirës së tyre për të kryer këtë adhurim. Zemrat e tyre janë të zbrazëta nga imani dhe shpresa për shpërblimin e Allahut të Madhërishëm, madje edhe kur bëhet fjalë për një adhurim kaq të rëndësishëm dhe të shpërblyeshëm, siç është falja e namazit. Nëse në zemrat e tyre do të kishte iman dhe shpresë për shpërblimin e Zotit, ata nuk do të shfaqnin kurrë përtaci.

- "...vetëm sa për t'u dukur para botës..." – Vetëm syfaqësia i shtyn që të bëjnë ndonjë vepër që duket. Ata duan që të shihen dhe të


الجزء الخامس سورة النساء

الَّذِينَ يَتَرَبَّصُونَ بِكُمْ فَإِن كَانَ لَكُمْ فَتْحٌ مِّنَ اللَّهِ قَالُوا
أَلَمْ نَكُن مَّعَكُمْ وَإِن كَانَ لِلْكَافِرِينَ نَصِيبٌ قَالُوا
أَلَمْ نَسْتَحْوِذْ عَلَيْكُمْ وَنَمْنَعْكُم مِّنَ الْمُؤْمِنِينَ فَاللَّهُ يَحْكُمُ
بَيْنَكُمْ يَوْمَ الْقِيَامَةِ وَلَن يَجْعَلَ اللَّهُ لِلْكَافِرِينَ عَلَى الْمُؤْمِنِينَ
سَبِيلًا ﴿١٤١﴾ إِنَّ الْمُنَافِقِينَ يُخَادِعُونَ اللَّهَ وَهُوَ خَادِعُهُمْ وَإِذَا
قَامُوا إِلَى الصَّلَاةِ قَامُوا كُسَالَىٰ يُرَاءُونَ النَّاسَ وَلَا يَذْكُرُونَ
اللَّهَ إِلَّا قَلِيلًا ﴿١٤٢﴾ مُّذَبْذَبِينَ بَيْنَ ذَٰلِكَ لَا إِلَىٰ هَٰؤُلَاءِ وَلَا إِلَىٰ
هَٰؤُلَاءِ وَمَن يُضْلِلِ اللَّهُ فَلَن تَجِدَ لَهُ سَبِيلًا ﴿١٤٣﴾ يَا أَيُّهَا الَّذِينَ
آمَنُوا لَا تَتَّخِذُوا الْكَافِرِينَ أَوْلِيَاءَ مِن دُونِ الْمُؤْمِنِينَ
أَتُرِيدُونَ أَن تَجْعَلُوا لِلَّهِ عَلَيْكُمْ سُلْطَانًا مُّبِينًا ﴿١٤٤﴾ إِنَّ
الْمُنَافِقِينَ فِي الدَّرْكِ الْأَسْفَلِ مِنَ النَّارِ وَلَن تَجِدَ لَهُمْ نَصِيرًا
﴿١٤٥﴾ إِلَّا الَّذِينَ تَابُوا وَأَصْلَحُوا وَاعْتَصَمُوا بِاللَّهِ وَأَخْلَصُوا
دِينَهُمْ لِلَّهِ فَأُولَٰئِكَ مَعَ الْمُؤْمِنِينَ ۖ وَسَوْفَ يُؤْتِ اللَّهُ
الْمُؤْمِنِينَ أَجْرًا عَظِيمًا ﴿١٤٦﴾ مَّا يَفْعَلُ اللَّهُ بِعَذَابِكُمْ
إِن شَكَرْتُمْ وَآمَنتُمْ ۚ وَكَانَ اللَّهُ شَاكِرًا عَلِيمًا ﴿١٤٧﴾
١٠١

lëvdohen nga njerëzit për punët që kryejnë. Pra, qëllimi i tyre nuk është që të kënaqin Allahun e Lartësuar.

- "...ndërsa Allahun e përmendin fare pak." - Zemrat e tyre janë të mbushura me hipokrizi, prandaj nuk kanë vend për dashurinë dhe madhërimin e Allahut të Lartësuar. Përkujtimi i Allahut të Lartësuar në mënyrë të vazhdueshme mund të bëhet veçse nga një besimtar, zemra e të cilit është e mbushur me dashuri dhe madhërim për Allahun, si edhe me shpresë për shpërblimin e Tij bujar.

- "Ata luhaten në mëdyshje: nuk janë as me këta, as me ata..." - Ata luhaten sa nga ana e besimtarëve, sa nga ana e qafirëve. Me shpirt e trup njëkohësiht, ata nuk janë as me qafirët, as me besimtarët. Ata janë me trup dhe nga ana e dukshme me besimtarët, por nga ana e brendshme shpirtërore janë me qafirët. Ky është devijimi më i madh, prandaj i Lartësuari thotë:

- **"Për këdo që Allahu e shpie në humbje, ti *(O Muhamed!)* nuk mund të gjesh shpëtim."** – Pra, nuk do të gjesh asnjë mundësi për ta udhëzuar në rrugën e drejtë dhe për ta shpëtuar nga humbja, sepse për të është mbyllur porta e mëshirës dhe është hapur dera e ndëshkimit.

Rrjedhimisht, kuptohet se besimtarët nuk i kanë këto cilësi të ulëta, por kanë të kundërtat e tyre. Ata i karakterizon vërtetësia në fjalë dhe në punë. Ata, gjithashtu, janë plot energji dhe aktivë në kryerjen e adhurimeve, sidomos të namazit. Ata e përkujtojnë shumë Allahun e Madhërishëm. Ata janë të udhëzuar nga Allahu i Lartësuar në rrugën e drejtë dhe të vazhdueshëm në të.

Le të krahasojë secili veten e vet me të dyja këto grupe dhe le të gjykojë se cilëve iu përket. Allahu është i vetmi Ndihmues dhe Udhëzues!

Ajeti 144

144. O ju që keni besuar! Mos i zgjidhni jobesimtarët për miq, në vend të besimtarëve! A mos, vallë, doni t'i sillni Allahut dëshmi të qartë kundër vetes?!

Shpjegimi i ajetit

- **"O ju që keni besuar! Mos i zgjidhni jobesimtarët për miq, në vend të besimtarëve!"** - Allahu i Lartësuar pasi tregoi që munafikët miqësojnë qafirët dhe lënë anash besimtarët, tani i urdhëron adhuruesit e Tij besimtarë që të largohen nga ky veprim i shëmtuar. Ai i ndalon besimtarët që t'u përngjajnë munafikëve në veprat dhe fjalët e tyre:

- **"A mos, vallë, doni t'i sillni Allahut dëshmi të qartë kundër vetes?!"** - Kjo vepër e shëmtuar është provë e qartë dhe mëse e mjaftueshme që Allahu i Madhërishëm t'i ndëshkojë. Ai na paralajmëron dhe na tregon pasojat e këtij veprimi, prandaj, nëse ne përsëri e bëjmë këtë gabim, kjo është provë e qartë dhe e mjaftueshme për t'u ndëshkuar.

Ky ajet është tregues i drejtësisë së plotë të Alahut të Madhërishëm. Ai nuk ndëshkon asnjë para se t'ia sqarojë argumentet.

Ky ajet është, gjithashtu, një paralajmërim për t'u larguar nga haramet. Kush i vepron ato, e ka bërë hak ndëshkimin e Allahut të Lartësuar.

Ajetet 145 – 147

145. Pa dyshim që munafikët do të jenë në shtresën më të ulët të Zjarrit, ndërkohë që për ta nuk do të gjendet mbrojtës.
146. Përveç atyre që u penduan, u përmirësuan, iu përmbajtën porosive të Allahut dhe besimin e tyre e patën sinqerisht vetëm për Allahun, se këta do të jenë bashkë me besimtarët. Allahu ka për t'iu dhënë besimtarëve shpërblim të madh.
147. Përse t'ju ndëshkojë Allahu, nëse ju jeni mirënjohës dhe besoni Atë?! Allahu është Mirënjohës dhe i Gjithëdijshëm.

Shpjegimi i ajeteve

- **"Pa dyshim që munafikët do të jenë në shtresën më të ulët të Zjarrit, ndërkohë që për ta nuk do të gjendet mbrojtës."** - Allahu i Madhërishëm na tregon se si munafikët do të jenë në nivelin më të thellë të Zjarrit, ku do të përjetojnë ndëshkimin dhe dhimbjet më poshtëruese.

Munafikët do të jenë edhe më thellë se qafirët, sepse ata jo vetëm që kanë mohuar Zotin dhe janë bërë armiq me Profetin dhe me besimtarët, por ata shtiren si muslimanë dhe fusin konflikte në radhët e besimtarëve. Ata janë më të rrezikshëm për besimtarët edhe se vetë qafirët, sepse qëndrojnë mes radhëve të tyre dhe i kanë më të shumta mundësitë për t'i dëmtuar ata, pa u dalluar dhe kuptuar. Madje, ata trajtohen si muslimanë në mesin e muslimanëve dhe përfitojnë gjithçka që përfitojnë muslimanët, pa e merituar. Për këto arsye dhe të tjera, ata meritojnë ndëshkimin më të rreptë dhe poshtërues. Askush nuk mund t'i shpëtojë

ata nga ky përfundim i tmerrshëm dhe i përjetshëm.

Ky është një paralajmërim për çdo munafik, përveç atyre që Allahu Bujar dhe i Gjithëmëshirshëm u mundëson, me mëshirën e Tij, që të pendohen dhe të kthehen në rrugën e drejtë. Ai thotë:

- **"Përveç atyre që u penduan, u përmirësuan, iu përmbajtën porosive të Allahut dhe besimin e tyre e patën sinqerisht vetëm për Allahun..."** – Pra, përveç atyre të cilët pendohen sinqerisht dhe angazhohen seriozisht për të bërë disa gjëra të rëndësishme.

Kështu, së pari, ata duhet të përpiqen sinqerisht për t'u korrigjuar në të gjitha drejtimet. Ata duhet të rregullojnë sjelljen e tyre të jashtme, por edhe besimin e brendshëm, duke treguar sinqeritet në marrëdhëniet me Zotin dhe me besimtarët.

Së dyti, ata duhet të tregohen të vendosur për t'iu përmbajtur porosive të Allahut dhe Profetit. Ata duhet të kapen fort pas litarit të Allahut, duke kërkuar të mirat dhe shpëtimin nga e keqja vetëm prej Tij.

Së treti, ata duhet t'ia përkushtojnë të gjitha adhurimet e tyre vetëm Allahut të Lartësuar, duke u përpjekur të kompletojnë veten me të gjitha nivelet e besimit: *islamin*, *imanin* dhe *ihsanin*. [30]

Me fjalë të tjera, ata duhet të japin maksimumin e tyre që çdo vepër të mirë të jashtme dhe të brendshme t'ia përkushtojnë vetëm Allahut të Madhërishëm, duke u pastruar nga syfaqësia dhe hipokrizia. Kështu, ata që vishen me këto cilësi:

- **"...do të jenë bashkë me besimtarët. Allahu ka për t'iu dhënë besimtarëve shpërblim të madh."** – Pra, këta do të trajtohen njëlloj si besimtarët, në dynja, në jetën e varrit dhe në Ditën e Gjykimit. Allahu i Gjithëmëshirshëm do t'u dhurojë atyre shpërblim shumë të madh, të cilin askush tjetër nuk mund ta përkufizojë dhe dijë, veçse Atij që ua jep. Atje do të kenë gjëra që syri nuk i ka parë, veshi nuk i ka dëgjuar dhe mendja nuk ka arritur t'i mendojë.

Vini re! Allahu i Madhërishëm ka vënë si kushte për faljen e munafikëve vendosmërinë për t'iu përmbajtur mësimeve të Tij, mbështetjen tërësisht tek Ai për çdo çështje dhe kryerjen e të gjitha adhurimeve vetëm për Allahun e Madhëruar, edhe pse këto bëjnë pjesë në pikën e parë, pra, në urdhrin për t'u rregulluar dhe përmirësuar në të gjitha drejtimet. Kështu kuptojmë se sa të nevojshme janë këto porosi, kur duam të pastrohemi nga *nifak*-u ose hipokrizia. Ato zemra ku ka depërtuar dhe ka zënë rrënjë hipokrizia kërkojnë doza të mëdha nga ky "ilaç": përkushtim i madh ndaj Allahut dhe mbështetje e plotë tek Ai, zbatim rigoroz i udhëzimeve të Tij, vazhdimësi dhe këmbëngulje në adhurimin e Tij, duke treguar përunjësi dhe nevojë për mëshirën e Tij, për të shpëtuar nga kjo sëmundje shkatërruese. Sinqeriteti dhe përkushtimi ndaj porosive të Zotit, pastrojnë zemrën nga *nifak*-u nga njëra anë dhe, nga ana tjetër, i bëjnë punët e kryera të pranueshme te Zoti.

[30] Këto nivele të besimit janë përmendur në *hadithin e Xhibrilit* (a.s.) ku thuhet: "Një ditë, kur ne ishim me Profetin (a.s.), u shfaq mes nesh një burrë me rroba shumë të bardha dhe me flokë shumë të zinj. Nuk shiheshin mbi të gjurmët e udhëtimit dhe askush prej nesh nuk e njihte atë. Ai u ul pranë Profetit (a.s.), i vendosi dy gjunjët e tij te dy gjunjët e Profetit (a.s.), vendosi dy pëllëmbët e tij mbi kofshët e tij dhe tha: "O Muhamed, më trego se ç'është Islami!" Profeti i Allahut tha: "Islami është: "Të dëshmosh se nuk ka Zot të adhuruar me të vërtetë veç Allahut dhe se Muhamedi është Profeti i Allahut, të falësh namazin, të japësh zekatin, të agjërosh Ramazanin dhe të kryesh haxhin në Shtëpinë e Shenjtë *(Qabe)*, nëse ke mundësi të shkosh atje". Ai tha: "Të vërtetën e ke thënë". Ne u çuditëm me të *(thotë Umeri)*. E pyeti, pastaj e miratoi! Më pas, ai tha: "Më trego se ç'është *imani*!" Profeti (a.s.) tha: "Imani është: Të besosh Allahun, engjëjt e Tij, librat e Tij, profetët e Tij, Ditën e Fundit dhe të besosh në caktimin e Allahut, të mirën e tij dhe të keqen e Tij". Ai tha: "Të vërtetën ke thënë". Pastaj, sërish tha: "Më trego se ç'është *ihsani*!" Profeti (a.s.) tha: "Ta adhurosh Allahun sikur ti e sheh Atë, sepse edhe nëse nuk e sheh Atë, Ai të sheh ty." [Muslimi].

Kjo është arsyeja që këto dy porosi janë theksuar më tepër.

Shihni edhe diçka! Nëse ata i kryejnë këto porosi, atëherë nuk thuhet që: "Allahu ka për t'iu dhënë shpërblim të madh atyre që u penduan nga nifaku, por thuhet: "Allahu ka për t'iu dhënë shpërblim të madh besimtarëve.". Këtu kemi të bëjmë me një stil mahnitës, të cilin Allahu i Urtë e përsërit disa herë në Kur'ân. Nëse Allahu i Lartësuar premton që do të japë shpërblim ose ndëshkim për një kategori të veçantë, që është pjesë e një kategorie më të përgjithshme, atëherë Ai e lidh ngushtë shpërblimin ose ndëshkimin me cilësinë e përbashkët të kategorisë së përgjithshme, në të cilën bën pjesë edhe kategoria e veçantë e përmendur. Kjo bëhet që askush të mos mendojë që gjykimi në fjalë është specifik vetëm për pjesën e veçuar nga tërësia. Kjo është madhështia e Kur'ânit.

Kësisoj, i penduari nga hipokrizia do të jetë së bashku me besimtarët, si të gjithë të penduarit e tjerë. Ai nuk trajtohet veçmas nga të penduarit e tjerë. Ata i bashkon pendimi i sinqertë dhe plotësimi i porosive të mësipërme. Të gjithë të penduarit do të jenë së bashku me besimtarët dhe do të shpërblehen ashtu siç i shpërblen Zoti besimtarët.

Pastaj Allahu i Lartësuar na tregon se Ai është i Pasur dhe asnjëherë nevojtar, është i Gjerë në butësinë dhe faljen e Tij, është Gjithëpërfshirës në mëshirën dhe bamirësinë e Tij. Ai thotë:

- "Përse t'ju ndëshkojë Allahu, nëse ju jeni mirënjohës dhe besoni Atë?! Allahu është Mirënjohës dhe i Gjithëdijshëm." - Pra, si t'ju ndëshkojë Allahu, kur dihet se Ai është i Gjithëdijshëm dhe Mirënjohës, qoftë edhe për veprat tuaja më të vogla? Me bujarinë e Tij, Ai shpërblen shumë edhe për punët më të pakëta. Atyre që tregohen të duruar në adhurim, Ai u premton begati e mirësi. Atyre që tregohen të duruar në lënien e të këqijave, Ai u premton se do t'ua zëvendësojë me gjëra më të mira se ato që kanë lënë për hir të Tij.

Mos harroni për asnjë çast që Ai është i Dijshëm për gjithçka që ju bëni, vepra të dukshme e të fshehta, të sinqerta dhe jo të tilla. Ai dëshiron prej jush që gjithmonë të pendoheni dhe të ktheheni tek Ai të përulur dhe të bindur. Nëse ju veproni kështu, atëherë pse mendoni se Zoti do t'ju ndëshkojë? Ai nuk ka nevojë dhe as qëllim që t'ju ndëshkojë. Ai as nuk përfiton gjë nga kjo. Të pabindurit dëmtojnë veç vetveten, ashtu sikurse edhe të bindurit punojnë veç për veten e vet.

Mirënjohja është: përulësia e zemrës kur kujton mirësitë e Zotit, lavdërimi i Tij me fjalë, veprimi në bindje ndaj Tij dhe mosshfrytëzimi i mirësive për gjynahe.

Ajetet 148 – 149

148. Allahu nuk e do thënien hapur të shprehjeve të këqija, përveçse nga të dëmtuarit. Allahu është Dëgjues dhe i Dijshëm.
149. Nëse ju bëni ndonjë punë të mirë haptazi ose fshehtazi, ose falni dikë për ndonjë vepër të keqe, Allahu është Falës i madh e i Plotfuqishëm.

Shpjegimi i ajeteve

- "Allahu nuk e do thënien hapur të shprehjeve të këqija..." - Allahu i Lartësuar na tregon se Ai nuk i do fjalët e këqija, kur thuhen hapur. Ai i urren dhe ndëshkon për to.

Këtu përfshihen të gjitha llojet e fjalëve të këqija, të cilat njerëzit i njohin si të tilla. Fjalë të këqija janë ato që të bëjnë të ndihesh keq, të shqetësojnë, të mërzisin dhe trishtojnë, si sharjet, shpifjet, gënjeshtrat etj. Të gjitha këto janë të ndaluara dhe të urryera nga Allahu i Lartësuar.

Kuptimi i ajetit tregon, gjithashtu, se fjalët e mira janë të dashura për Allahun dhe të shpërblyeshme prej Tij. Të tilla janë, për

shembull: dhikri, fjalët e ngrohta dhe të buta etj. Pastaj i Lartësuari thotë:

- "...përveçse nga të dëmtuarit." – Pra, të dëmtuarve u lejohet që të luten dhe të ankohen kundër atyre që i kanë bërë padrejtësi. U lejohet edhe që të shajnë dhe të flasin keq kundër atyre që i kanë sharë e ofenduar, por pa thënë gënjeshtra e shpifje. Gjithashtu, ata nuk duhet ta teprojnë e të fyejnë edhe të tjerët që nuk janë të përzier.


Megjithatë, fakti që ky veprim është i lejuar nuk do të thotë që është zgjedhja më e mirë. Sigurisht, falja dhe toleranca është rruga më e mirë, sikurse thotë i Lartësuari: "Ai që fal dhe përmirëson e ka shpërblimin tek Allahu.".

- "Allahu është Dëgjues dhe i Dijshëm." - Pasi ajeti na mësoi rreth fjalëve të lejuara, fjalëve të këqija dhe fjalëve të mira, Allahu i Lartësuar na kujton një fakt shumë të rëndësishëm, që të shërbejë si këshillë për fjalët që themi dhe veprimet që kryejmë. Kështu, Ai është *El Semiu* - Dëgjuesi. Ai dëgjon të gjitha fjalët që ne themi, prandaj duhet të jemi shumë të kujdesshëm, në mënyrë që të mos nxjerrim nga goja fjalë me të cilat zemërohet Allahu, sepse Ai do t'i ndëshkojë njerëzit për to. I parë ndryshe, ajeti nxit për të thënë fjalë të mira dhe të dobishme.

Allahu është gjithashtu *El Alim* - i Dijshëm. Ai i njeh mirë qëllimet që fshihen brenda shpirtit tonë dhe shkakun e fjalëve tona. Pastaj i Lartësuari thotë:

- "Nëse ju bëni ndonjë punë të mirë haptazi ose fshehtazi" - Këtu bëhet fjalë për çdo lloj të mire, me fjalë a me vepra, punë të shfaquara a të fshehta, punë të detyrueshme a të pëlqyeshme.

- "...ose falni dikë për ndonjë vepër të keqe..." – Pra, tregohuni falës dhe tolerantë ndaj atyre që ju kanë dëmtuar në trup, në pasuri, në nder apo në dinjitetin tuaj, sepse


الجزء السادس سورة النساء
الجزء ٦ الجزء ١١
لَا يُحِبُّ ٱللَّهُ ٱلْجَهْرَ بِٱلسُّوٓءِ مِنَ ٱلْقَوْلِ إِلَّا مَن ظُلِمَ ۚ وَكَانَ
ٱللَّهُ سَمِيعًا عَلِيمًا ﴿١٤٨﴾ إِن تُبْدُوا۟ خَيْرًا أَوْ تُخْفُوهُ أَوْ تَعْفُوا۟ عَن
سُوٓءٍ فَإِنَّ ٱللَّهَ كَانَ عَفُوًّا قَدِيرًا ﴿١٤٩﴾ إِنَّ ٱلَّذِينَ يَكْفُرُونَ
بِٱللَّهِ وَرُسُلِهِۦ وَيُرِيدُونَ أَن يُفَرِّقُوا۟ بَيْنَ ٱللَّهِ وَرُسُلِهِۦ وَيَقُولُونَ
نُؤْمِنُ بِبَعْضٍ وَنَكْفُرُ بِبَعْضٍ وَيُرِيدُونَ أَن يَتَّخِذُوا۟
بَيْنَ ذَٰلِكَ سَبِيلًا ﴿١٥٠﴾ أُو۟لَٰٓئِكَ هُمُ ٱلْكَٰفِرُونَ حَقًّا ۚ وَأَعْتَدْنَا
لِلْكَٰفِرِينَ عَذَابًا مُّهِينًا ﴿١٥١﴾ وَٱلَّذِينَ ءَامَنُوا۟ بِٱللَّهِ وَرُسُلِهِۦ
وَلَمْ يُفَرِّقُوا۟ بَيْنَ أَحَدٍ مِّنْهُمْ أُو۟لَٰٓئِكَ سَوْفَ يُؤْتِيهِمْ
أُجُورَهُمْ ۗ وَكَانَ ٱللَّهُ غَفُورًا رَّحِيمًا ﴿١٥٢﴾ يَسْـَٔلُكَ أَهْلُ ٱلْكِتَٰبِ
أَن تُنَزِّلَ عَلَيْهِمْ كِتَٰبًا مِّنَ ٱلسَّمَآءِ ۚ فَقَدْ سَأَلُوا۟ مُوسَىٰٓ أَكْبَرَ
مِن ذَٰلِكَ فَقَالُوٓا۟ أَرِنَا ٱللَّهَ جَهْرَةً فَأَخَذَتْهُمُ ٱلصَّٰعِقَةُ بِظُلْمِهِمْ ۚ
ثُمَّ ٱتَّخَذُوا۟ ٱلْعِجْلَ مِنۢ بَعْدِ مَا جَآءَتْهُمُ ٱلْبَيِّنَٰتُ فَعَفَوْنَا
عَن ذَٰلِكَ ۚ وَءَاتَيْنَا مُوسَىٰ سُلْطَٰنًا مُّبِينًا ﴿١٥٣﴾ وَرَفَعْنَا فَوْقَهُمُ
ٱلطُّورَ بِمِيثَٰقِهِمْ وَقُلْنَا لَهُمُ ٱدْخُلُوا۟ ٱلْبَابَ سُجَّدًا وَقُلْنَا
لَهُمْ لَا تَعْدُوا۟ فِى ٱلسَّبْتِ وَأَخَذْنَا مِنْهُم مِّيثَٰقًا غَلِيظًا ﴿١٥٤﴾
١٠٢

shpërblimi do të jepet sipas veprave që ju bëni. Kush tregohet falës dhe tolerant, ta dijë se edhe Allahu i Madhërishëm do të tregohet falës dhe mëshirues ndaj tij. Kush tregohet bamirës, ta dijë se Allahu do të jetë bamirës me të.

- "Allahu është Falës i madh e i Plotfuqishëm." – Allahu i fal gabimet dhe gjynahet e mëdha të robërve të Tij. Ai ua mbulon mangësitë dhe i trajton me faljen dhe mëshirën e Tij të madhe, që burojnë nga pushteti i Tij absolut.

Ky ajet është nxitje për t'u thelluar në kuptimin e emrave dhe cilësive të Allahut të Madhërishëm. Krijimi dhe pushteti janë vetëm në dorën e Tij, dhe kjo tregohet nga emrat dhe cilësitë e Tij.

Atëherë, përse duhet të jemi falës dhe tolerantë ndaj të tjerëve? Sepse Allahu i Madhërishëm është Falës i madh dhe i Plotpushtetshëm, i Cili i shpërblen ata që falin të tjerët me të njëjtën mënyrë. Ky shpërblim nuk është përmendur konkretisht,

por është nënkuptuar duke përmendur emrat dhe cilësitë e Tij të mësipërme. Për ata që mendojnë, kaq mjafton si nxitje për të bërë punë të mira.

Ajetet 150 – 152

150. Vërtet, ata që e mohojnë Allahun dhe të Dërguarin e Tij dhe dëshirojnë të ndajnë *(besimin në)*Allahun nga *(besimin në)* profetët e Tij, duke thënë: "Disa i besojmë e disa nuk i besojmë" e duke pretenduar se po zgjedhin një rrugë të ndërmjetme,
151. pikërisht ata janë mohuesit e vërtetë. Ne kemi përgatitur për mohuesit një dënim poshtërues.
152. Ndërsa atyre që besojnë Allahun dhe profetët e Tij, pa bërë asnjë dallim mes tyre, Ai do t'u japë shpërblimet. Allahu është Falës dhe Mëshirëplotë.

Shpjegimi i ajeteve

- "Vërtet, ata që e mohojnë Allahun dhe të Dërguarin e Tij dhe dëshirojnë të ndajnë *(besimin në)*Allahun nga *(besimin në)* profetët e Tij, duke thënë: "Disa i besojmë e disa nuk i besojmë" e duke pretenduar se po zgjedhin një rrugë të ndërmjetme..." - Këtu janë përmendur dy grupe, me cilësi të qarta për këdo. Njëri grup beson në Allahun, në të gjithë profetët dhe librat e Tij, ndërsa grupi tjetër mohon gjithçka nga këto. Megjithatë, mbetet edhe një grup i tretë, i cili pretendon se u beson disa profetëve, por mohon disa të tjerë, duke pretenduar se në këtë mënyrë do të shpëtojnë nga ndëshkimi i Zotit. Por kjo është thjesht ëndërr me sy hapur nga ana e tyre. Ata dëshirojnë të ndajnë besimin në Allahun nga besimi në profetët e Tij. Në të vërtetë, ai që e do Allahun e Madhërishëm duhet të dojë të gjithë profetët e Tij. Dashuria për të gjithë profetët e Zotit është plotësuese dhe shenjë treguese e dashurisë për Zotin. Armiqësia qoftë edhe ndaj njërit prej profetëve të Tij, konsiderohet si armiqësi ndaj Allahut dhe ndaj të gjithë profetëve të Tij, sikurse thotë i Madhëruari: "Kush është armik i Allahut, i engjëjve të Tij, i të dërguarve të Tij, i Xhibrilit dhe i Mikailit, *(ta dijë se)* Allahu është pa dyshim armik i jobesimtarëve." [Bekare 98]. Kështu, çdokush që mohon një profet, ka mohuar të gjithë profetët, madje edhe Profetin të cilin pretendon se e beson. Për këtë arsye, i Lartësuari thotë:

- "...pikërisht ata janë mohuesit e vërtetë." - Allahu i Lartësuar deklaron gjykimin për të tillë njerëz, me qëllim që askush të mos mendojë se ata qëndrojnë mes dy grupeve të para, pra, mes besimit dhe kufrit. Ata janë qafirë të vërtetë, sepse çdo argument nëpërmjet të cilit ata kanë besuar, - siç pretendojnë, - Profetin e tyre, nuk është më i fortë se argumenti që u sillet për të besuar edhe profetët e tjerë. Argumentet e vërtetësisë së profetëve të tjerë janë po aq të fortë dhe të qartë apo ndoshta edhe më të fortë se argumentet për Profetin e tyre. Çdo pretendim dhe dyshim që hedhin kundra profetëve që i mohojnë, mund të pretendohet padrejtësisht edhe kundra Profetit që ata pandehin se e besojnë. Kështu, arsyeja e vetme që mbetet është thjesht pretendimi i pabazuar, përballë së cilit çdokush mund të sjellë një të ngjashëm me të.

Pasi deklaroi se të tillët janë qafirë të vërtetë, i Lartësuari tregon ndëshkimin e dhimbshëm për ta dhe për çdo qafir tjetër:

- "Ne kemi përgatitur për mohuesit një dënim poshtërues." - Për shkak të mendjemadhësisë që ata tregojnë ndaj besimit, Allahu i Madhërishëm do t'i poshtërojë me dënim të dhimbshëm dhe të turpshëm.


- "Ndërsa atyre që besojnë Allahun dhe profetët e Tij, pa bërë asnjë dallim mes tyre" – Pra, së pari, ata besojnë Allahun dhe të dërguarit e Tij. Kjo nënkupton besimin në të gjithë emrat dhe cilësitë e Tij, që vetë Allahu na i ka treguar, si edhe besimin në

çdo lajm dhe gjykim të sjellë prej profetëve të Tij. Ndërsa, së dyti, ata nuk bëjnë dallim mes asnjërit prej tyre. Ata i besojnë të gjithë profetët, pa përjashtim, dhe ky është imani i vërtetë, i ndërtuar mbi themele të drejta.

- **"Ai do t'u japë shpërblimet."** – Ai do t'u japë shpërblimin për imanin e tyre dhe për veprat, fjalët dhe moralin e tyre të mirë, të ndërtuar mbi këtë iman. Secili do të shpërblehet sipas gradës së vet.

- **"Allahu është Falës dhe Mëshirëplotë."** – Allahu i mbulon gabimet dhe i pranon e shpërblen punët e mira.

Ajetet 153 – 161



153. Ithtarët e Librit kërkojnë prej teje *(o Muhamed)* t'u zbresësh një libër nga qielli. Në fakt, ata i kërkuan Musait diçka edhe më të madhe: "Na trego Allahun haptazi!" Atëherë, ata i shkatërroi rrufeja, për shkak të poshtërsisë që bënë. Pastaj zgjodhën viçin, pas shenjave të qarta që u patën ardhur. Ne ua falëm këtë veprim dhe i dhamë Musait pushtet të qartë.
154. Ne ngritëm mbi ta malin Tur, që ata t'i përmbaheshin besës. Ne u thamë: "Hyni te porta të përulur!" Gjithashtu, u thamë: "Mos e përdhosni të shtunën!", duke marrë prej tyre një besë të fortë.
155. Për shkak të shkeljes së besëlidhjes nga ana e tyre, për shkak të mohimit të shpalljeve të Allahut, për shkak të vrasjes së pejgamberëve pa kurrfarë të drejtë dhe për thënien e tyre: "Zemrat tona janë të mbyllura në këllëf", pra, për shkak të mohimit të tyre, Allahu ua vulosi ato *(zemrat)*, prandaj vetëm pak prej tyre besojnë.
156. Edhe për shkak të mosbesimit të tyre dhe të shpifjes së tyre kundër Merjemes,
157. edhe për shkak të thënies së tyre: "Ne e vramë Mesihun – Isain, të birin e Merjemes, të Dërguarin e Allahut". Në fakt, ata as e vranë, as e kryqëzuan, por ashtu iu duk. Ata që nuk janë pajtuar për çështjen e tij sigurisht që janë në dyshim për të. Ata nuk kanë për të kurrfarë dije të saktë, por veç hamendësime. Në të vërtetë, ata nuk e vranë.
158. Përkundrazi, Allahu e ngriti atë pranë Vetes. Allahu është i Plotfuqishëm e i Urtë.
159. Çdo ithtar i Librit ka për t'i besuar Isait para vdekjes së tij, por Ditën e Kiametit, ai do të dëshmojë kundër tyre.
160. Për shkak të mizorisë së atyre që ishin çifutë dhe për shkak se ata penguan shumë nga rruga e Allahut, Ne ua bëmë haram disa të mira, që më parë ishin të lejuara.
161. Edhe për shkak të përfitimit nga kamata, ndërkohë që e kishin të ndaluar atë, si dhe për shkak të ngrënies së pasurisë së njerëzve në mënyrë të padrejtë. Ne kemi përgatitur dënim të dhimbshëm për ata që nuk besuan prej tyre.

Shpjegimi i ajeteve

Kjo kërkesë që ithtarët e Librit i drejtuan Profetit (a.s.) buronte nga inati dhe ngaqë

nuk e pranonin si profet të Zotit. Ata e bënë këtë kërkesë, duke e caktuar si të vetmin kusht për të besuar Muhamedin (a.s.) si profet të Zotit. Kështu, ata i kërkuan Profetit (a.s.) që Allahu t'ua zbriste Kur'ânin atyre njëherësh, ashtu sikurse zbriti Teuratin dhe Ungjillin. Kjo ishte padrejtësia dhe injoranca më e madhe, sepse profetët janë thjesht njerëz të udhëzuar dhe të nënshtruar ndaj Zotit, që nuk kanë asnjë çështje në dorën e tyre. Çdo çështje është tërësisht në dorën e Zotit dhe është vetëm Ai që i dërgon profetët dhe u shpall atyre çfarë të dëshirojë. Si mund të kërkohet prej profetëve diçka të cilën e ka në dorë vetëm Zoti? Prandaj, kur mohuesit kërkuan mrekulli prej Profetit, i Lartësuari e urdhëroi këtë të fundit që t'u kujtonte atyre faktin që ai ishte veçse një njeri. Tregon i Lartësuari në suren Isra, ajete 88 - 93: "Thuaj: "Edhe sikur të bashkoheshin njerëzit dhe xhinët për të sjellë një shembull si ky Kur'ân, ata nuk do të mund të bënin një shembull si ai, sado që do ta ndihmonin njëri-tjetrin". Ne u sqaruam njerëzve në këtë Kur'ân shembuj *(argumente)* të çdo lloji, por shumica e njerëzve nuk deshi tjetër, veçse mohimin. Ata thanë: "Ne nuk të besojmë ty, derisa të na nxjerrësh burime prej tokës; ose të kesh kopshte me hurma e me rrush, e të bësh që mes tyre të rrjedhin vazhdimisht lumenj; ose, ashtu sikurse pretendon ti *(se do të na dënojë Zoti)*, le të bjerë mbi ne qielli copa-copa; ose derisa të na sjellësh Allahun dhe engjëjt pranë nesh *(t'i shohim haptazi)*; ose të kesh një shtëpi prej ari, apo të ngjitesh lart në qiell. Madje, edhe sikur të ngjitesh lart në qiell, ne nuk të besojmë, derisa të na sjellësh një libër që ta lexojmë?!" Thuaj: "*Subhanallah*!" A mos jam unë gjë tjetër, përveçse një njeri profet?!"

Përcaktimi i kësaj kërkese si i vetmi kusht për vërtetësinë apo jo të profetësisë së Muhamedit (a.s.), ishte thjesht një pretendim bosh, pa asnjë lidhje me realitetin. Ku është parë e dëgjuar që, nëse një profeti nuk i shpallet Libri i plotë dhe menjëherë, ai nuk duhet besuar?! Përkundrazi, pikërisht zbritja pjesë-pjesë e Kur'ânit është argument shumë i qartë, që tregon përkujdesjen e plotë dhe të madhe të Zotit për profetin Muhamed (a.s.) dhe për popullin pasues të tij. I Lartësuari ka thënë: "Ata që nuk besojnë thonë: "Përse të mos i zbritej Kur'âni atij *(Muhamedit)* i gjithi përnjëherë?!" Ne e shpallëm ashtu *(pjesë-pjesë)*, në mënyrë që të forcojmë zemrën tënde nëpërmjet tij. Ne ta sollëm atë qartësisht, ajet pas ajeti. Ata nuk të sjellin ndonjë shembull që Ne të mos ta tregojmë të vërtetën *(rreth tij)*, duke të ofruar shpjegimin më të qartë e më të plotë." [Furkan, 32, 33].

Pasi përmendi arsyetimin e tyre të mbrapshtë dhe të kotë, Allahu i Madhërishëm na tregon se kjo lloj sjellje e tyre nuk është e huaj dhe e papritur, sepse ata janë treguar edhe më të ndyrë më parë, me qëndrimet e shëmtuara që kanë mbajtur, madje edhe ndaj profetëve që pretendojnë se i besojnë. Kështu, ata kanë kërkuar që ta shohin Zotin haptazi ose kanë adhuruar si Zot viçin, pas gjithë atyre shenjave dhe mrekullive që i dëshmuan dhe i jetuan, shenja që askush tjetër nuk e pati mundësinë që t'i shohë.

Aq të prirur kanë qenë për të mos i pranuar ligjet e Librit të tyre, pra, të Teuratit, saqë u nënshtruan veçse prej kërcënimit me kodrën Tur mbi kokat e tyre, që ishte gati të binte mbi ta, nëse nuk do të pranonin të nënshtroheshin. Kështu, ata u bindën vetëm të detyruar, domethënë gati pa vetëdije.

Ata, paturpësisht, e shpërfillën edhe ftesën e Zotit për t'ua falur gjynahet dhe vepruan në kundërshtim me urdhrin që morën. Nga "bëmat" e tyre ishte, gjithashtu, edhe mosrespektimi i rregullit të së shtunës, kur nuk duhej të peshkonin, por ata bën hile, prandaj Zoti iu dha atë ndëshkim poshtërues e shëmtues.

Çdo premtim që jepnin, shoqërohej shpejt me shkeljen e tij, mohimin e Shpalljes së Zotit dhe deri me vrasjen e padrejtë të profetëve. Pastaj, si për t'u justifikuar, erdhi pretendimi i tyre i thatë dhe i paarsyeshëm: "Zemrat tona janë të mbyllura në këllëf",

prandaj gjoja nuk kuptonin. Jo, ata e kuptonin shumë mirë mesazhin e profetëve, por, për shkak të mohimit dhe kundërshtimit të tyre, ata merituan që Zoti t'ua vuloste zemrat, për t'i bërë që të mos nënshtroheshin. Rrjedhimisht, vetëm një pakicë e tyre e besoi të vërtetën.

Të zeza ishin fjalët dhe veprat e tyre. Ata jo vetëm që tregoheshin të pabindur dhe të panënshtruar, por edhe shpifnin për njerëzit e mirë dhe për profetët. Ata pretenduan se e vranë dhe e kryqëzuan Isain, të birin e Merjemes. Por e vërteta është se ata as e vranë, as e kryqëzuan atë, por atyre iu duk ashtu, ndërkohë që vranë dikë tjetër në vend të tij, që u përngjau si ai.

Ata jo vetëm që nuk besuan, por pengonin edhe të tjerët nga rruga e Zotit, madje i ftonin për t'u bërë si ata, të pabindur, të devijuar nga udha e Zotit, marrës të rryshfetit e të fajdesë, edhe pse Zoti i ndaloi rreptësisht nga këto vepra, duke i kërcënuar me ndëshkim të madh. E pra, nuk është çudi që të tillë njerëz t'i kërkonin profetit Muhamed (a.s.) që të zbriste nga qielli një libër, si kusht të domosdoshëm për ta besuar atë si profet.

Kjo është një nga mënyrat më të mira për të polemizuar me të tillë njerëz, të cilët nuk kërkojnë të vërtetën, por thjesht arsyetojnë për të justifikuar veten. Kështu, kur ata nxjerrin dyshime dhe pretendime për të refuzuar të vërtetën, duke e bërë këtë edhe si justifikim për të tjerët, që edhe ata të mohojnë, atëherë le t'u përmendet atyre çdo cilësi e turpshme dhe punë e keqe që i karakterizon. Në këtë mënyrë, njerëzit do ta kuptojnë se pretendimet e tyre vijnë nga po i njëjti llum dhe pisllëk. Çdo argument që ata përdorin për mospranimin e profetësisë së Muhamedit (a.s.) mund të pretendohet gjithashtu edhe për Profetin që ata gjoja besojnë dhe e pasojnë. Me të tilla mënyra argumentimi kundër tyre, ndoshta ata do të reshtin dhe do të shpartallohen. Gjithashtu, të gjitha argumentet që përdorin për të arsyetuar pranimin dhe besimin e Profetit të tyre, të njëjtët - ndoshta edhe më fort - vërtetojnë edhe profetësinë e Muhamedit (s.a.u.s.).

Duke qenë se qëllimi këtu i përmendjes së poshtërsive të tyre ishte thjesht për t'i bërë që të ndalen nga shpifjet dhe trillimet, Allahu i Lartësuar nuk i përmendi ato në mënyrë të hollësishme, por vetëm shkurtimisht. Megjithatë, në vende të tjera në Kur'ân, Ai i ka treguar "bëmat" e tyre më gjerësisht. Le të qëndrojmë pak te fjala e Allahut të Lartësuar:

- "Çdo ithtar i Librit ka për t'i besuar Isait para vdekjes së tij, por Ditën e Kiametit, ai do të dëshmojë kundër tyre." – Cilit i referohet përemri pronor "*së tij*" në këtë fjali? Dy janë mundësitë:

1. Para vdekjes së çdo ithtari të Librit. Sipas kësaj, çdo ithtar i Librit ka për ta besuar Isain (a.s.) në çastet e agonisë së vdekjes ashtu si duhej ta besonte gjatë jetës,pra me besimin e saktë dhe të drejtë që ai është veç një profet i Zotit. Por ky besim nuk i sjell dobi atij, sepse është i detyruar, pa vullnetin e tij.

Sipas këtij kuptimi, ajeti është kërcënim për ithtarët e Librit, që të mos vazhdojnë në besimin e gabuar, por të ndalen para se t'u vijë momenti i vdekjes, në të cilin do të pendohen, por kjo do të jetë e padobishme atëherë. Dëshpërimi i atij momenti do të jetë shumë i madh, ndësa dëshpërimi i Ditës së Gjykimit do të jetë i papërshkrueshëm. Kjo ishte mundësia e parë.

2. Çdo ithtar i Librit ka për t'i besuar Isait, para vdekjes së Isait. Kjo do të ndodhë në kohën e shfaqjes së shenjave të mëdha të Kijametit. Hadithet e sakta që flasin për zbritjen e Isait (a.s.) përpara Kijametit janë të shumta. Në to tregohet që ai do të vrasë Dexhallin, do të zhvleftësojë xhizjen dhe ithtarët e Librit do ta besojnë atë ashtu sikurse e besojnë besimtarët e drejtë.

Ditën e Gjykimit, Isai (a.s.) do të dëshmojë për ta: a kanë punuar drejt apo në kundërshtim me ligjin e Zotit. Sigurisht që

atë ditë Isai (a.s.) do të dëshmojë për pasaktësinë e besimit të ithtarëve të Librit sot. Ai do të dëshmojë se besimi i tyre ka qenë i devijuar dhe në kundërshtim me ligjin e Zotit, të sjellë në Kur'ân dhe në të cilin ftoi Muhamedi (a.s.). Ne jemi të sigurt për këtë dëshmi, për shkak të njohjes që kemi rreth Isait (a.s.) dhe faktit se ai do dëshmojë veçse të drejtën. Shpallja e Zotit, e sjellë nëpërmjet Muhamedit (a.s.), është e vërteta e sigurt dhe çdo gjë veç saj është e kotë dhe devijim nga rruga e drejtë.

Më pas, Allahu i Lartësuar na tregon se Ai ua bëri haram ithtarëve të Librit shumë mirësi, të cilat më parë ishin të lejuara për ta. Ky ndalim u bë në formë ndëshkimi për ta, për shkak të padrejtësive dhe armiqësisë së tyre, të pengimit dhe devijimit të njerëzve nga rruga e Zotit, për shkak të ushtrimit të kamatës, edhe pse ishin ndaluar rreptësisht nga ajo. Ata i privonin të tjerët nga drejtësia dhe haku i tyre, prandaj dhe i Lartësuari i ndëshkoi ata sipas punës që kryen. Kështu, ato mirësi të cilat i kishin të lejuara, sepse ishin të mira dhe të dobishme, Ai ua bëri të ndaluara. Edhe një herë, ky ishte një ndalim ndëshkimor, ndërsa ndalimet në Sheriatin islam nuk janë ndëshkimore, por synojnë që t'i ruajnë muslimanët nga çdo gjë e pisët, e keqe dhe e dëmshme, që cenon dynjanë dhe fenë e tyre.

Ajeti 162

162. Mirëpo të thelluarit në dituri prej tyre dhe besimtarët besojnë në atë që të është shpallur ty dhe në atë që është shpallur para teje. Kështu besojnë edhe ata që falin rregullisht namazin, dhënësit e zekatit dhe besimtarët në Allahun dhe në Ditën e Kijametit. Të tillëve do t'u japim shpërblim të madh.

Shpjegimi i ajetit

Pasi tregoi të metat e ithtarëve të Librit, Allahu i Lartësuar përmend edhe cilësitë e pjesës së mirë të tyre:

- **"Mirëpo të thelluarit në dituri prej tyre dhe besimtarët besojnë në atë që të është shpallur ty dhe në atë që është shpallur para teje. Kështu besojnë edhe ata që falin rregullisht namazin, dhënësit e zekatit dhe besimtarët në Allahun dhe në Ditën e Kijametit."** – Pra, ata njerëz, në zemrat e të cilëve ka zënë vend dija dhe kanë siguri të plotë në vërtetësinë e fjalës së Allahut, që i besojnë plotësisht Shpalljes që iu zbrit Muhamedit (a.s.) dhe shpalljeve që zbritën para tij. Fryte të këtij besimi të saktë janë veprat e mira, si falja e rregullt e namazit dhe dhënia e zekatit, të cilat janë, në fakt, ndër veprat më të mira dhe më të dobishme. Ato janë të tilla, sepse nëpërmjet tyre kultivohet sinqeriteti ndaj Zotit dhe bamirësia ndaj krijesave. Ata gjithashtu besojnë në Ditën e Gjykimit, duke iu frikësuar kërcënimit të Zotit dhe duke shpresuar premtimet e Tij. Për këta, Allahu i Lartësuar thotë:

- **"Të tillëve do t'u japim shpërblim të madh."** - Ky shpërblim u premtohet atyre, sepse ata kanë dijen e saktë e të dobishme, besimin, punën e mirë në përputhje me këtë besim dhe besimin në të gjithë librat dhe profetët e Zotit, pa përjashtim.

Ajetet 163 – 165

163. Ne të frymëzuam ty *(O Muhamed)* me Shpallje, ashtu siç frymëzuam me Shpallje Nuhun dhe profetët pas tij; siç frymëzuam me shpallje edhe Ibrahimin, Ismailin, Is'hakun, Jakubin dhe pasardhësit e tij, Isain, Ejubin, Junusin, Harunin, Sulejmanin; edhe Davudit i dhamë Zeburin;
164. të dërguar për të cilët të kemi treguar më parë, dhe të dërguar të tjerë, për të cilët nuk të kemi treguar. Ndërsa Musait, Allahu i foli me fjalë.
165. Të dërguar, që të ishin përgëzues dhe paralajmërues, në mënyrë që njerëzit të mos kenë justifikim para Allahut, pas

ardhjes së të dërguarve. Allahu është Krenar dhe i Urtë.

Shpjegimi i ajeteve


Në këto ajete, Allahu i Lartësuar na tregon se Ai, ashtu sikurse veproi me të gjithë profetët e tjerë, i shpalli Muhamedit (a.s.), robit dhe Profetit të Tij të zgjedhur, Sheriatin madhështor dhe këto rrëfime të vërteta. Kështu ka vepruar me të gjithë profetët që ka dërguar: i ka pajisur ata me ligj dhe udhëzim të drejtë.

Në këto ajete ka shumë dobi. Kështu, ato dëshmojnë se Muhamedi (a.s.) nuk është i vetmi profet, sepse para tij janë dërguar shumë profetë të tjerë nga Zoti i Lartësuar. Për këtë arsye, është fare pa vend habia që mohuesit tregojnë për faktin se Zoti i shpalli atij ligj dhe udhëzim. Kjo habi nuk ka asnjë shpjegim, përveç injorancës dhe kryeneçësisë së tyre.

Allahu i Lartësuar i solli Muhamedit (a.s.) një Shpallje, që në themelet e saj është e njëjtë me shpalljet që u ka dhënë të dërguarve të tjerë. Të gjitha këto shpallje përmbajnë drejtësinë dhe vërtetojnë njëra-tjetrën.

Cilësitë e Muhamedit (a.s.) janë të njëjta me cilësitë e vëllezërve të tij të tjerë profetë. Ftesa që ai u drejtoi njerëzve është e njëjtë me ftesën e tyre, morali i tij i njëjtë me moralin e tyre, burimi i shpalljeve të tyre është i njëjtë dhe pikësynimi i tyre është po i njëjtë. Kushdo që bën një krahasim të tillë mes tij dhe profetëve të tjerë, me siguri do të arrijë në përfundimin që ai nuk qe kurrsesi një mashtrues apo një sundues zullumqar.

Përmendja e këtyre profetëve, duke i lëvduar dhe duke treguar vlerat e tyre, shtojnë imanin e besimtarit dhe dashurinë për ta. Kjo nxit për t'i marrë ata si shembull, për të pasuar traditën dhe rrugën e tyre. Gjithashtu, kjo nxit për të njohur sa më mirë të drejtat ndaj tyre, ashtu sikurse nxit Allahu i Lartësuar në disa ajete, si për shembull: "Selam për Ibrahimin!", ose: "Selam për


الجزء السادس سورة النساء
الحزب ١١
* إِنَّآ أَوۡحَيۡنَآ إِلَيۡكَ كَمَآ أَوۡحَيۡنَآ إِلَىٰ نُوحٖ وَٱلنَّبِيِّـۧنَ مِنۢ بَعۡدِهِۦۚ
وَأَوۡحَيۡنَآ إِلَىٰٓ إِبۡرَٰهِيمَ وَإِسۡمَٰعِيلَ وَإِسۡحَٰقَ وَيَعۡقُوبَ
وَٱلۡأَسۡبَاطِ وَعِيسَىٰ وَأَيُّوبَ وَيُونُسَ وَهَٰرُونَ وَسُلَيۡمَٰنَۚ
وَءَاتَيۡنَا دَاوُۥدَ زَبُورٗا ١٦٣ وَرُسُلٗا قَدۡ قَصَصۡنَٰهُمۡ عَلَيۡكَ
مِن قَبۡلُ وَرُسُلٗا لَّمۡ نَقۡصُصۡهُمۡ عَلَيۡكَۚ وَكَلَّمَ ٱللَّهُ مُوسَىٰ
تَكۡلِيمٗا ١٦٤ رُّسُلٗا مُّبَشِّرِينَ وَمُنذِرِينَ لِئَلَّا يَكُونَ
لِلنَّاسِ عَلَى ٱللَّهِ حُجَّةُۢ بَعۡدَ ٱلرُّسُلِۚ وَكَانَ ٱللَّهُ عَزِيزًا حَكِيمٗا
١٦٥ لَّٰكِنِ ٱللَّهُ يَشۡهَدُ بِمَآ أَنزَلَ إِلَيۡكَۖ أَنزَلَهُۥ بِعِلۡمِهِۦۖ وَٱلۡمَلَٰٓئِكَةُ
يَشۡهَدُونَۚ وَكَفَىٰ بِٱللَّهِ شَهِيدًا ١٦٦ إِنَّ ٱلَّذِينَ كَفَرُواْ
وَصَدُّواْ عَن سَبِيلِ ٱللَّهِ قَدۡ ضَلُّواْ ضَلَٰلَۢا بَعِيدًا ١٦٧ إِنَّ ٱلَّذِينَ
كَفَرُواْ وَظَلَمُواْ لَمۡ يَكُنِ ٱللَّهُ لِيَغۡفِرَ لَهُمۡ وَلَا لِيَهۡدِيَهُمۡ
طَرِيقًا ١٦٨ إِلَّا طَرِيقَ جَهَنَّمَ خَٰلِدِينَ فِيهَآ أَبَدٗاۚ وَكَانَ
ذَٰلِكَ عَلَى ٱللَّهِ يَسِيرٗا ١٦٩ يَٰٓأَيُّهَا ٱلنَّاسُ قَدۡ جَآءَكُمُ ٱلرَّسُولُ بِٱلۡحَقِّ
مِن رَّبِّكُمۡ فَـَٔامِنُواْ خَيۡرٗا لَّكُمۡۚ وَإِن تَكۡفُرُواْ فَإِنَّ لِلَّهِ
مَا فِي ٱلسَّمَٰوَٰتِ وَٱلۡأَرۡضِۚ وَكَانَ ٱللَّهُ عَلِيمًا حَكِيمٗا ١٧٠
١٠٤

Musain dhe Harunin!", ose: "Selam për Iljasin!" [Saffat 109, 120, 130]. Çdo bamirës meriton një përkujtim të mirë ndër njerëz, në varësi të gradës së bamirësisë së tij. Padyshim të gjithë profetët dhe në mënyrë të veçantë këta të përmendurit janë në gradën më të lartë të ihsanit bamirësisë.

Pasi tregoi se u ka dhënë Shpallje të gjithë profetëve, Allahu i Lartësuar përmend në mënyrë të veçantë disa profetë, për t'i dalluar ndër të tjerë. Kështu, Ai përmend Daudin (a.s.) dhe Librin që ju shpall atij, Zeburin, librin me të cilin Ai e dalloi nga profetët e tjerë. Ndërsa Musait, Allahu i Lartësuar i foli direkt me fjalë, pa ndërmjetës. Madje, Musai njihet gjerësisht si Profeti të cilit Mëshiruesi i foli drejtpërdrejt.

Në këto ajete, Allahu i Lartësuar na tregon se jo për të gjithë profetët i ka rrëfyer Profetit të Tij të fundit, Muhamedit (a.s.). Kjo tregon se numri i profetëve ka qenë shumë i madh. Megjithatë, një gjë është e sigurt: ata u dërguan si përgëzues për një lumturi të madhe në dynja dhe ahiret për të gjithë ata

që i binden Allahut dhe pasojnë rrugën dhe udhëzimet e tyre. Ata u dërguan edhe si paralajmërues të një ndëshkimi dhe dëshpërimi në të dyja jetët, për këdo që nuk i bindet Allahut dhe refuzon rrugën dhe udhëzimin e sjellë prej tyre.

Allahu i Lartësuar i dërgoi profetët edhe për një arsye tjetër: që askush të mos ketë justifikim para Allahut dhe të thotë: "Neve nuk na erdhi ndonjë i dërguar, që të na përgëzonte apo që të na tërhiqte vërejtjen". Pra, ja ku ju erdhi përgëzuesi dhe kërcënuesi. Allahu është i Plotpushtetshëm për gjithçka." [Maide 19].

Pas dërgimit të profetëve njëri pas tjetrit, askush nuk mund të justifikohet para Allahut se ishte i paditur. Profetët kishin si detyrë që t'u qartësonin njerëzve plotësisht çështjet e fesë së tyre, çdo gjë që e kënaq Zotin dhe çdo gjë që e zemëron Atë, rrugën që të çon në Xhenet dhe rrugët që të çojnë në Zjarr. Për këtë arsye, çdokush që i mohon dhe i kundërshton ata, pas këtij sqarimi, të qortojë veçse vetveten.

Dërgimi i profetëve dhe zbritja e librave për t'i udhëzuar njerëzit që të arrijnë mirësitë e dynjasë dhe të ahiretit tregon krenarinë dhe urtësinë e plotë të Allahut të Lartësuar, ashtu sikurse tregon edhe bamirësinë dhe mëshirën e Tij për ta. Allahu i Urtë dhe i Gjithëmëshirshëm nuk do ta linte kurrsesi njerëzimin pa i plotësuar nevojën e domosdoshme për profetët dhe mesazhin që ata sjellin. Ai e plotësoi këtë nevojë në mënyrën më të përkryer, dhe vetëm Atij i takon lavdia dhe mirënjohja e plotë.

E lusim Allahun e Lartësuar që, ashtu sikurse e filloi këtë mirësi, duke dërguar profetët dhe shpalljet, ta plotësojë atë mbi ne, duke na dhënë sukses dhe forcë për të ecur në rrugën e tyre! Pa dyshim, Allahu është Bamirës dhe Bujar i madh!

Ajeti 166

166. Por Allahu dëshmon se atë që t'u zbrit ty, ta zbriti sipas dijes së Vet; edhe engjëjt dëshmojnë. Por mjafton që Allahu është dëshmues!

Shpjegimi i ajetit

Pasi bëri të ditur se i solli Shpallje Profetit të Tij, Muhamedit (a.s.), ashtu sikurse u kishte sjellë vëllezërve të tij profetë më herët, Allahu i Lartësuar dëshmon Vetë për saktësinë dhe vërtetësinë e kësaj Shpalljeje.

Kështu, Allahu i Lartësuar dëshmon se e ka shpallur Kur'ânin "sipas dijes së Vet". Shprehja "sipas dijes së Vet" mund të kuptohet në dy mënyra:

1. "Ta zbriti sipas dijes së Vet", domethënë, kjo Shpallje, të cilën e ka zbritur Allahu i Lartësuar, përmban në vetvete dituri prej dijes së Zotit. Ajo përmban dituri hyjnore, dispozita ligjore dhe rrëfime të panjohura, të cilat janë një pjesë e dijes së Zotit dhe që Ai ua mëson robërve të Tij nëpërmjet kësaj Shpalljeje.

2. "Ta zbriti sipas dijes së Vet", domethënë, kjo Shpallje ka zbritur me djeninë e plotë të Allahut të Lartësuar, prandaj dhe Ai dëshmon për vërtetësinë e saj të padiskutueshme. Është Allahu i Lartësuar Ai që e shpalli Kur'ânin me urdhëresa, ndalesa dhe dispozita të rëndësishme, dhe këtë e bëri me dijen e Tij të plotë dhe absolute. Ai e di se çfarë përmban ky libër dhe e gjithë shpallja, të cilën ia përcolli Profetit të fundit, dhe e dinte shumë mirë gjendjen e atij të cilit ia shpalli këtë libër. Ai e dinte shumë mirë se Profeti i ftoi pa u lodhur njerëzit në adhurimin e Zotit të tyre, prandaj çdokush që e besoi dhe iu përgjigj ftesës së Profetit do të konsiderohet si miku i Zotit, ndërsa çdokush që e mohoi dhe shprehu armiqësi ndaj Profetit do të konsiderohet armiku i Zotit.

Allahu i Lartësuar e ndihmoi profetin Muhamed (a.s.), duke i dhuruar fitore pas fitoreje, duke iu përgjigjur lutjeve të tij, duke poshtëruar armiqtë e tij dhe ndihmuar miqtë e tij. E ku ka dëshmi më të madhe dhe më të

qartë për sinqeritetin dhe vërtetësinë e këtij Profeti, sesa këto që u përmendën.

Për çështjet e mëdha dhe të rëndësishme kërkohen dëshmi të forta, nga dëshmuesit më të rëndësishëm, sikurse ka thënë Allahu i Lartësuar: "Allahu dëshmoi se nuk ka të adhuruar tjetër përveç Tij; edhe engjëjt dhe dijetarët *(dëshmuan)*. Ai është Zbatues i drejtësisë. Nuk ka të adhuruar tjetër përveç Tij, Fuqiplotit e të Urtit." [Al imran 18]. Mjafton, pra, Allahu si dëshmues.

Ajetet 167 – 169

167. Me të vërtetë, ata që kanë mohuar dhe kanë penguar njerëzit nga rruga e Allahut, ata kanë humbur shumë larg prej udhës së drejtë.
168. Ata që nuk besojnë dhe bëjnë padrejtësi, Allahu as nuk ka për t'i falur e as nuk ka për t'i drejtuar në asnjë rrugë tjetër,
169. përveçse drejt rrugës së Xhehenemit, ku do të jenë përgjithmonë; dhe kjo për Allahun është e lehtë.

Shpjegimi i ajeteve

Në ajetet e mësipërme, Allahu i Lartësuar na tregoi rreth shpalljeve të profetëve dhe në mënyrë të veçantë për shpalljen dhuruar Profetit të fundit, Muhamedit (a.s.). Ai dëshmoi për saktësinë dhe vërtetësinë e tyre. Po kështu kanë dëshmuar edhe melekët e Tij. Kjo tregon se shpalljet janë të vërteta, prandaj është detyrë që të pohohen, të besohet gjithçka e sjellë në to dhe të punohet dhe jetohet sipas tyre.

Në ajetet në vijim, Allahu i Lartësuar kërcënon të gjithë ata që mohojnë shpalljet e Tij, duke thënë:

- "Me të vërtetë, ata që kanë mohuar dhe kanë penguar njerëzit nga rruga e Allahut, ata kanë humbur shumë larg prej udhës së drejtë." - Këta jo vetëm që e mohuan dhe refuzuan Shpalljen për veten e tyre, por penguan edhe të tjerët nga rruga e Zotit. Këta janë udhëheqësit e kufrit dhe ftuesit për në rrugën e humbjes. Në fakt, ata kanë humbur shumë larg prej udhës së drejtë. E kush mund të jetë më i humbur dhe devijuar sesa ai që ka humbur vetveten dhe devijon të tjerët, duke u ngarkuar me gjynahe të shumëfishuara?! Këta janë shumë larg nga e vërteta dhe nga falja e Zotit. Për ta, Ai thotë:

- "Ata që nuk besojnë dhe bëjnë padrejtësi, Allahu as nuk ka për t'i falur e as nuk ka për t'i drejtuar në asnjë rrugë tjetër, përveçse drejt rrugës së Xhehenemit, ku do të jenë përgjithmonë..." - Kufri është padrejtësia më e madhe, por, megjithatë, Allahu i Madhëruar ka shtuar e ka thënë: "...dhe bëjnë padrejtësi...". Kjo është bërë për të treguar se sa të thelluar dhe të shfrenuar kanë qenë në kufrin e tyre. Ata jo vetëm që kanë mohuar Zotin dhe gjithçka që duhej të besohej dhe të respektohej, por kanë bërë vepra të këqija dhe padrejtësi, të diktuara nga kufri i tyre, duke u zhytur thellë në të. Këta janë shumë larg faljes së Allahut të Lartësuar dhe udhëzimit në rrugën e drejtë, dhe kjo ndodh për shkak të veprave të tyre. Allahu i Lartësuar për ta thotë: "Allahu as nuk ka për t'i falur e as nuk ka për t'i drejtuar në asnjë rrugë tjetër, përveçse drejt rrugës së Xhehenemit, ku do të jenë përgjithmonë.". Falja e Zotit dhe udhëzimi i Tij janë shumë larg tyre. Shkak për këtë u bënë vazhdimësia e tyre në kalimin e kufijve të Zotit dhe thellimi në kufrin e tyre. Njerëzve me të tilla cilësi Allahu i Lartësuar ua vulos zemrat dhe ua mbyll dyert e udhëzimit, duke i shpërblyer pikërisht me atë që kanë fituar me duart e tyre. Allahu i Lartësuar nuk i bën padrejtësi asnjë njeriu. Ai thotë:

- "...dhe kjo për Allahun është e lehtë..." - Allahu i Lartësuar nuk u kushton asnjë lloj rëndësie atyre dhe as nuk i vështron, se ata nuk meritojnë të mirën. Ata meritojnë veçse atë që vetë e kanë zgjedhur.

Ajeti 170

170. O njerëz! Juve ju erdhi i Dërguari me të vërtetën nga Zoti juaj, prandaj besoni, se kjo është më mirë për ju! Por nëse ju nuk e besoni, ta dini se vetëm Allahut i përket gjithçka që gjendet në qiej dhe në tokë. Allahu është i Gjithëdijshëm e i Urtë.

Shpjegimi i ajetit

- "O njerëz! Juve ju erdhi i Dërguari me të vërtetën nga Zoti juaj, prandaj besoni, se kjo është më mirë për ju!" - Allahu i Lartësuar urdhëron të gjithë njerëzit që ta besojnë Atë dhe Profetin e Tij, Muhamedin (a.s.). Ai tregon edhe shkakun që duhet të na shtyjë për ta besuar Atë, dobinë e këtij besimi dhe dëmin e shpërfilljes dhe të mosbesimit tek Ai. Shkaku që duhet të na shtyjë ta besojmë Profetin është fakti se ai erdhi me të vërtetën e sigurt nga Zoti i tij. Vetë ardhja e tij ishte e drejtë, ligji që ai solli prej Zotit të tij është i drejtë. Çdo njeri i logjikshëm e di se lënia e krijesave në injorancë dhe në kufëri, pa u sjellë atyre një shpallje si udhëzim për ta, bie ndesh me urtësinë dhe mëshirën e Allahut të Lartësuar. Kështu, dërgimi i Profetit është shenjë e urtësisë dhe mëshirës së madhe të Allahut të Lartësuar, sepse nëpërmjet atij, krijesat arrijnë të dallojnë udhëzimin e drejtë nga humbja, të vërtetën nga e kota. Mjafton të shohësh në përmbajtjen e Shpalljes që ai solli nga Zoti i tij, për të gjykuar se ai ishte vërtet profet nga Zoti. Kjo siguri shtohet akoma më tepër nëse meditojmë thellë rreth Sheriatit dhe porosive të mrekullueshme të Profetit për njerëzimin. Në Shpalljen që ai solli prej Zotit të tij gjenden rrëfime të panjohura të së kaluarës dhe të së ardhmes, përshkrime rreth Allahut të Lartësuar dhe Ditës së Gjykimit etj., të cilat mund të njihen veçse nëpërmjet shpalljeve hyjnore. Ky Profet ka urdhëruar për çdo të mirë, për ndjekjen e rrugës së drejtë, për mbajtjen e drejtësisë, për sinqeritet dhe vërtetësi, për ruajtjen e lidhjeve që duhen ruajtur, për moral të mirë, fisnikëri dhe bujari. Ai ka ndaluar nga çdo e keqe, nga kalimi i kufijve dhe padrejtësia, nga morali i keq, nga gënjeshtrat dhe mashtrimet, nga shpërfillja dhe nëpërkëmbja e të drejtave të krijesave etj. Të tilla porosi të mrekullueshme dhe të domosdoshme për shoqërinë njerëzore, sidomos në atë kohë, nuk të lenë asnjë dyshim, por të japin bindjen e plotë se me të vërtetë ai ishte profet i dërguar nga Zoti. Sa më shumë ta njohë njeriu këtë Shpallje, aq më shumë i shtohet besimi dhe siguria për vërtetësinë e Profetit. Këto që përmendëm janë të gjitha shkaqe që duhet të na shtyjnë ta besojmë këtë Profet.

Për sa i përket dobisë dhe mirësisë që sjell besimi në profetin Muhamed (a.s.), Allahu i Lartësuar ka thënë se besimi tek ai është më mirë për ne. Kështu besimi është më mirë për besimtarët, është më i mirë për trupin, për zemrat dhe shpirtrat e tyre, më i mirë për dynjanë dhe ahiretin e tyre. Besimi te ky Profet është më i mirë për besimtarët, për shkak të mirësive dhe dobive që lidhen ngushtë me këtë besim. Çdo shpërblim, qoftë ai në këtë botë apo i premtuar për në ahiret, është fryt i imanit, fitore dhe ndihmë nga Zoti. Udhëzimi në rrugën e drejtë, dija e vërtetë, e sigurt dhe e dobishme, veprat e mira sipas kësaj dijeje, çdo lumturi dhe gëzim, madje edhe Xheneti e gjithçka që ai përmban, të gjitha këto vijnë nga besimi i drejtë dhe i saktë te profeti Muhamed (a.s.). Nga ana e kundërt, çdo vuajtje dhe dëshpërim i kësaj dynjaje dhe i ahiretit vjen nga mungesa e këtij imani ose nga mangësia e tij. Dëmet që sjell mosbesimi te profeti Muhamed (a.s.) janë pikërisht të kundërtat e mirësive që sjell ky besim.

Por le ta dijë çdokush se robi dëmton veçse veten e vet dhe se Allahu i Lartësuar është jonevojtar për të. Atë nuk e dëmton aspak mosbindja dhe mosbesimi i krijesave. Prandaj Allahu i Lartësuar thotë:

- "Por nëse ju nuk e besoni, ta dini se vetëm Allahut i përket gjithçka që gjendet

në qiej dhe në tokë. Allahu është i Gjithëdijshëm e i Urtë." - Gjithçka është krijesë dhe pronë e Tij dhe është e nënshtruar nën pushtetin dhe mbretërimin e Tij. Allahu i Lartësuar është i Gjithëdijshëm për çdo gjë që e ka krijuar dhe e sundon. Ai është i Urtë për çdo gjë që e ka krijuar dhe çdo urdhër që ka lëshuar. Ai është më i Dituri, si për ata që meritojnë udhëzimin, edhe për ata që meritojnë humbjen. Me urtësinë e Tij, Ai udhëzon ose lë në humbje ata që e meritojnë atë.


Ajeti 171

171. O ithtarët e Librit, mos e kaloni kufirin në fenë tuaj dhe për Allahun thoni vetëm të vërtetën. Mesihu - Isai, i biri i Merjemes, është vetëm i Dërguar i Allahut dhe Fjala e Tij *(Bëhu)* që ia drejtoi Merjemes, si dhe shpirt nga Ai. Besojini Allahut dhe të dërguarve të Tij dhe mos thoni: "Është Trini"! Hiqni dorë, se është më mirë për ju. Ai është Një Zot i vetëm! Qoftë i lavdëruar! Ai është i Lartësuar dhe i Pastër nga mangësitë, për të pasur fëmijë. E Tij është gjithçka që gjendet në qiej dhe në tokë. Mjafton Allahu si rregullues i çështjeve të gjithësisë.

Shpjegimi i ajetit

Allahu i Lartësuar i ndalon ithtarët e Librit nga teprimi me fenë dhe kalimi i kufijve të vendosur nga Ai. Ata largohen nga veprat që janë të ligjëruara dhe bëjnë ato gjëra që Zoti nuk i ka ligjëruar, madje i ka ndaluar. Kështu, mund të përmendim teprimin e të krishterëve në lidhje me Isain (a.s.), duke e ngritur atë mbi gradën e profetësisë dhe duke e përshkruar atë me cilësitë që i takojnë vetëm se Allahut të Lartësuar. Më tej, i Lartësuari thotë:

- "O ithtarët e Librit, mos e kaloni kufirin në fenë tuaj dhe për Allahun thoni vetëm të vërtetën." - Kjo fjali përmban dy ndalesa dhe një urdhër. Dy ndalesat janë:


الجزء السادس سورة النساء

يَٰٓأَهۡلَ ٱلۡكِتَٰبِ لَا تَغۡلُواْ فِي دِينِكُمۡ وَلَا تَقُولُواْ عَلَى
ٱللَّهِ إِلَّا ٱلۡحَقَّۚ إِنَّمَا ٱلۡمَسِيحُ عِيسَى ٱبۡنُ مَرۡيَمَ رَسُولُ ٱللَّهِ
وَكَلِمَتُهُۥٓۚ أَلۡقَىٰهَآ إِلَىٰ مَرۡيَمَ وَرُوحٞ مِّنۡهُۖ فَـَٔامِنُواْ بِٱللَّهِ
وَرُسُلِهِۦۖ وَلَا تَقُولُواْ ثَلَٰثَةٌۚ ٱنتَهُواْ خَيۡرٗا لَّكُمۡۚ إِنَّمَا ٱللَّهُ
إِلَٰهٞ وَٰحِدٞۖ سُبۡحَٰنَهُۥٓ أَن يَكُونَ لَهُۥ وَلَدٞۘ لَّهُۥ مَا فِي ٱلسَّمَٰوَٰتِ
وَمَا فِي ٱلۡأَرۡضِۗ وَكَفَىٰ بِٱللَّهِ وَكِيلٗا ١٧١ لَّن يَسۡتَنكِفَ
ٱلۡمَسِيحُ أَن يَكُونَ عَبۡدٗا لِّلَّهِ وَلَا ٱلۡمَلَٰٓئِكَةُ ٱلۡمُقَرَّبُونَۚ
وَمَن يَسۡتَنكِفۡ عَنۡ عِبَادَتِهِۦ وَيَسۡتَكۡبِرۡ فَسَيَحۡشُرُهُمۡ
إِلَيۡهِ جَمِيعٗا ١٧٢ فَأَمَّا ٱلَّذِينَ ءَامَنُواْ وَعَمِلُواْ ٱلصَّٰلِحَٰتِ
فَيُوَفِّيهِمۡ أُجُورَهُمۡ وَيَزِيدُهُم مِّن فَضۡلِهِۦۖ وَأَمَّا ٱلَّذِينَ
ٱسۡتَنكَفُواْ وَٱسۡتَكۡبَرُواْ فَيُعَذِّبُهُمۡ عَذَابًا أَلِيمٗا وَلَا
يَجِدُونَ لَهُم مِّن دُونِ ٱللَّهِ وَلِيّٗا وَلَا نَصِيرٗا ١٧٣ يَٰٓأَيُّهَا ٱلنَّاسُ
قَدۡ جَآءَكُم بُرۡهَٰنٞ مِّن رَّبِّكُمۡ وَأَنزَلۡنَآ إِلَيۡكُمۡ نُورٗا مُّبِينٗا
١٧٤ فَأَمَّا ٱلَّذِينَ ءَامَنُواْ بِٱللَّهِ وَٱعۡتَصَمُواْ بِهِۦ فَسَيُدۡخِلُهُمۡ فِي
رَحۡمَةٖ مِّنۡهُ وَفَضۡلٖ وَيَهۡدِيهِمۡ إِلَيۡهِ صِرَٰطٗا مُّسۡتَقِيمًا ١٧٥

١٠٥

1. Mos thoni gënjeshtra lidhur me Allahun e Lartësuar.

2. Mos flisni pa patur dije rreth emrave, cilësive dhe veprave të Allahut, si edhe për ligjet e profetët e Tij.

Ndërsa urdhri është: Thoni të vërtetën për këto çështje që u përmendën më lart. Këto rregulla janë të përgjithshme dhe duhet të zbatohen gjithmonë. Allahu i Lartësuar na urdhëron që t'i zbatojmë ato kur flasim për çështjen e Isait (a.s.), ndryshe nga ç'veprojnë çifutët dhe të krishterët. Allahu i Lartësuar thotë:

- "Mesihu - Isai, i biri i Merjemes, është vetëm i Dërguar i Allahut dhe Fjala e Tij *(Bëhu)*, që ia drejtoi Merjemes, si dhe shpirt nga Ai." – Fillimisht, thuhet se ai ishte "*Resulullah*" - i Dërguar i Allahut. Kjo është grada më e lartë që mund të arrijë një njeri.

Së dyti, Allahu i Lartësuar e ka përshkruar Isain (a.s.) si "Fjala e Tij, që ia drejtoi Merjemes...". Isai (a.s.) u krijua

nëpërmjet një fjale të thënë nga Allahu i Lartësuar. Kështu, Isai (a.s.) nuk ishte vetë fjala, porse ai erdhi në ekzistencë nëpërmjet saj.

Së treti, Allahu i Lartësuar e ka përshkruar Isain (a.s.) si "shpirt nga Ai." Pra, Isai (a.s.) ishte një shpirt i krijuar nga Allahu i Lartësuar, i pajisur me cilësi dhe virtyte të larta. Allahu i Lartësuar dërgoi Xhibrilin (a.s.), i cili fryu në trupin e Merjemes dhe, me lejen e Allahut, në barkun e saj u ngjiz Isai (a.s.).

- "Besojini Allahut dhe të dërguarve të Tij dhe mos thoni: "Është Trini"! Hiqni dorë, se është më mirë për ju." - Pasi qartësoi plotësisht të vërtetën rreth Isait (a.s.), Allahu i Lartësuar urdhëron ithtarët e Librit që të kenë besim të drejtë për Allahun dhe profetët e Tij. Ai urdhëron ata që të largohen nga koncepti i Trinisë dhe besimet e trilluara, sepse kështu është më mirë për ta dhe se kjo është e vetmja mundësi dhe rrugë për të shpëtuar. Çdo rrugë tjetër, që nuk është e bazuar në Shpalljen e Zotit, por thjesht në hamendësime, të çon në shkatërrim.

Më pas, Allahu i Lartësuar dëshmon se Ai është i Pastër nga të tilla shpifje dhe trillime, duke thënë:

- "Ai është Një Zot i vetëm! Qoftë i lavdëruar! Ai është i Lartësuar dhe i Pastër nga mangësitë, për të pasur fëmijë. E Tij është gjithçka që gjendet në qiej dhe në tokë." - Ai është i vetmi që meriton adhurimin, prandaj askush e asgjë tjetër nuk duhet të adhurohet së bashku me Të. Ai është i Pastër, i Lartësuar dhe i Madhërishëm që të ketë fëmijë, sepse gjithçka që gjendet në qiell dhe në tokë është krijesë dhe pronë e Tij. Të gjithë janë të nevojshëm, të varfër e të varur tërësisht nga Allahu i Lartësuar. Atëherë, si mund të mendohet që, mes krijesave, të gjendet ndonjë partner apo fëmijë për Të?!

- "Mjafton Allahu si rregullues i çështjeve të gjithësisë." - Pasi bëri të ditur se Ai është i Gjithëpushtetshmi dhe Mbretëruesi i botës qiellore dhe tokësore, Allahu i Lartësuar tregon se është pikërisht dhe vetëm Ai që kujdeset për çështjet e robërve, qofshin ato çështje të dynjasë apo të ahiretit. Ai i ka ruajtur me saktësi veprat e tyre dhe do ta shpërblejë secilin, sipas drejtësisë dhe bamirësisë së Tij.

Ajetet 172 – 173

172. Mesihu nuk do të refuzonte kurrë të ishte rob i Allahut, dhe as engjëjt më të zgjedhur. Ai që i largohet adhurimit ndaj Tij dhe bëhet mendjemadh, *(le ta dijë se)* Ai do t'i ringjallë të gjithë pranë Tij.
173. Atyre që besuan dhe bënë vepra të mira, Ai do t'ua përmbushë shpërblimin e merituar dhe do t'ua shtojë atë më tepër, prej mirësisë së Tij. Ndërsa ata që i largohen adhurimit të Tij dhe tregohen kryelartë, Ai do t'i ndëshkojë me një dënim të dhëmbshëm, ndërkohë që ata nuk do të gjejnë për veten e tyre asnjë mbrojtës apo ndihmës tjetër, veç Allahut.

Shpjegimi i ajeteve

Pasi foli për teprimin e krishterëve në çështjen e Isait (a.s.) dhe konfirmoi se ai ishte robi dhe i dërguari i Tij, Allahu i Lartësuar tregon në këto ajete një realitet, kuptimi i të cilit është shumë i rëndësishëm për të gjetur të vërtetën. Ai thotë:

- "Mesihu nuk do të refuzonte kurrë të ishte rob i Allahut, dhe as engjëjt më të zgjedhur." – Pra, as Isai (a.s.) dhe as melekët e afërt të Allahut të Madhërishëm nuk e konsiderojnë për ulje statusin si robër të Allahut. Ata nuk do të tregoheshin kurrsesi arrogantë e të refuzonin këtë pozitë.

Duke mohuar këtë cilësi për ta, Allahu i Lartësuar ka pohuar të kundërtën. Me fjalë të tjera, Isai (a.s.) dhe melekët e afërt të Zotit janë shumë të përkushtuar në adhurimin

ndaj Zotit të tyre. Sigurisht, ata e meritojnë këtë nderim të madh, sepse janë robër të nënshtruar dhe të sinqertë ndaj Allahut të Lartësuar, si në aspektin e *rububije*-s, ashtu edhe në atë të *uluhije*-s.

Askush të mos mendojë se ngritja e Isait (a.s.), apo e dikujt tjetër, sipër gradës së krijesës është përsosmëri. Po kështu, edhe sjellja arrogante dhe mosbindja për adhurimin e Zotit nuk mund të jetë përsosmëri. Përkundrazi, këto janë qëndrime të dënueshme për krijesat. Prandaj i Lartësuari thotë:

- "Ai që i largohet adhurimit ndaj Tij dhe bëhet mendjemadh, *(le ta dijë se)* Ai do t'i ringjallë të gjithë pranë Tij." – Allahu do t'i ringjallë të gjitha krijesat dhe do t'i tubojë përpara Tij, pa përjashtim, si kryeneçët dhe të pabindurit, ashtu edhe adhuruesit e Tij besimtarë. Ajo është dita kur Ai do të gjykojë me drejtësi dhe do të shpërblejë sipas meritës.

Pastaj i Lartësuari e shtjellon këtë gjykim të Tij kur thotë:

- "Atyre që besuan dhe bënë vepra të mira, Ai do t'ua përmbushë shpërblimin e merituar dhe do t'ua shtojë atë më tepër, prej mirësisë së Tij." – Për ata të cilët kanë edhe besimin e drejtë, edhe veprat e mira në përputhje me këtë besim, qofshin ato vepra të detyruara apo të pëlqyeshme, për ata që jetojnë me dinjitet, duke respektuar të drejtat e Zotit dhe të drejtat e krijesave, për të tillët, pra, Allahu i Lartësuar ka premtuar se do t'ua japë të plotë shpërblimin e premtuar. Por jo vetëm kaq: Ai premton se do t'ua shtojë edhe më tepër shpërblimin, prej bujarisë së Tij. Ai do t'u japë atyre të mira, që kurrë nuk do të mund t'i arrinin me punën e tyre dhe që kurrë nuk u ka shkuar në mend se ekzistonin apo që do të mund t'i arrinin. Ato janë mirësi të Xhenetit në ushqime, pije, pamje e marrëdhënie. Ato janë kënaqësi të zemrës, shpirtit dhe të trupit. Në këtë premtim të Allahut të Lartësuar hyjnë, gjithashtu, edhe mirësitë e dynjasë.

- "Ndërsa ata që i largohen adhurimit të Tij dhe tregohen kryelartë, Ai do t'i ndëshkojë me një dënim të dhëmbshëm..." - Të gjithë ata që tregohen kryeneçë dhe nuk nënshtrohen për të adhuruar Allahun e Lartësuar, Ai ka për t'i ndëshkuar me një dënim të dhimbshëm. Ky ndëshkim është zemërimi i Allahut dhe Zjarri i ndezur fort, që shkakton dhimbje të thella në trup e në shpirt.

- "...ndërkohë që ata nuk do të gjejnë për veten e tyre asnjë mbrojtës apo ndihmës tjetër, veç Allahut." - Asnjë krijesë nuk do të mund t'u dalë në ndihmë, që ata të mund të arrijnë ndonjë të mirë. Askush nuk do mund t'i ndihmojë për të shpëtuar nga e keqja dhe dënimi. E si mund të ndodhë kjo, kur ata i ka braktisur më i Mëshirshmi i të mëshirshmëve dhe i ka lënë të vuajnë ndëshkimin e përjetshëm?! Askush nuk mund të ndryshojë gjykimin dhe vendimin e drejtë të të Lartësuarit!

Ajetet 174 – 175

174. O njerëz! Me të vërtetë, juve ju ka ardhur një provë e madhe nga Zoti juaj dhe Ne ju kemi zbritur një dritë të qartë.
175. Ata që besojnë Allahun dhe i mbështeten tërësisht Atij, Ai do t'i fusë në mëshirën dhe mirësinë e Tij dhe do t'i udhëzojë drejt Vetes, përmes rrugës së drejtë.

Shpjegimi i ajeteve

Në këto ajete, Allahu i Lartësuar u kujton njerëzve mirësinë e Tij të madhe ndaj tyre me sjelljen e profetëve dhe shpalljeve të Tij, argumente këto të pakundërshtueshme dhe dritë e qartë. Nëpërmjet tyre, Allahu i Lartësuar e qartësoi plotësisht rrugën për tek Ai dhe e mbylli përfundimisht shtegun e justifikimit për kundërshtarët. Ai thotë:

- "O njerëz! Me të vërtetë, juve ju ka ardhur një provë e madhe nga Zoti juaj..." - Për të qartësuar të vërtetën, Allahu i Lartësuar solli argumente të pakundërshtueshme, që i hedhin poshtë të kundërtat e së vërtetës. Këtu përfshihen argumentet logjike dhe ato fetare të trashëguara, argumentet që lexohen në gjithësi dhe ato që mund t'i lexojmë në vetet tona, sikurse thotë i Lartësuari: "Ne do t'ua bëjmë atyre të mundshme që t'i shohin argumentet Tona në horizonte dhe në veten e tyre, derisa t'u bëhet e qartë që ai *(Kur'âni)* është i vërtetë. A nuk mjafton që Zoti yt është dëshmitar për çdo gjë?" [Fusilet 53].

Shprehja: "...nga Zoti juaj..." tregon rëndësinë e këtyre argumenteve. Ato janë nga Zoti ynë, që na krijoi dhe përkujdeset për ne, për çështjet e besimit dhe të dynjasë. Argumentet që na fusin në rrugën drejt Xhenetit, janë ndër mirësitë më të mëdha, për të cilat Ai meriton të lavdërohet dhe falënderohet. Ai thotë:

- "...dhe Ne ju kemi zbritur një dritë të qartë." - Kjo dritë e qartë është Kur'âni madhështor, i cili përmban dituritë e të parëve dhe të fundit, rrëfime dhe porosi të vërteta, të drejta dhe të dobishme. Kur'âni urdhëron për mirësi, drejtësi dhe mbarësi, dhe ndalon nga padrejtësia dhe e keqja. Njerëzimi do të ishte në errësirë të plotë, nëse nuk do të ndriçohej nga drita e tij. Nëse krijesat nuk përfitojnë nga mirësia e Kur'ânit, atëherë do të pushtohen nga dëshpërimi.

Në varësi të besimit në Kur'ân dhe përfitimit prej tij, njerëzit ndahen në dy grupe:

- **"Ata që besojnë Allahun dhe i mbështeten tërësisht Atij, Ai do t'i fusë në mëshirën dhe mirësinë e Tij dhe do t'i udhëzojë drejt Vetes, përmes rrugës së drejtë."** - Këta janë të shpëtuarit, që Allahu i Lartësuari i ka përshkruar me dy cilësi:

1. Ata besojnë Allahun, pra, besojnë në ekzistencën e Tij, besojnë që Ai ka cilësi të plota dhe është i pastër nga çdo mangësi dhe dobësi.

2. Ata i mbështeten tërësisht Allahut, duke iu dorëzuar Atij dhe duke shpresuar vetëm ndihmën e Tij. Ata nuk mbështeten asnjë çast në forcat dhe aftësitë e tyre, por i kërkojnë ndihmë vetëm Allahut të Lartësuar.

Të tillë njerëz do të përfshihen në mëshirën e Tij, i Cili do t'u japë sukses të kryejnë punë të mira, duke ua shtuar shpërblimin dhe duke larguar prej tyre fatkeqësitë dhe të këqijat. Ai do t'i udhëzojë ata në rrugën e drejtë, duke u mundësuar të marrin dije të dobishme dhe të saktë dhe të punojnë sipas kësaj dijeje, me sinqeritet për Allahun e Lartësuar. Ky ishte grupi i parë.

Ndërsa në grupin e dytë janë ata të cilët nuk i kanë cilësitë e të lartpërmendurve, domethënë ata që nuk e besojnë Allahun, nuk i mbështeten Atij dhe nuk e zbatojnë Librin e Tij. Këta do të jenë të privuar nga mëshira dhe mirësia e Tij. Ai do t'i lërë të mbështeten në veten e vet, prandaj ata kurrë nuk do të mund ta gjejnë udhëzimin, por do të jenë të humbur dhe shumë larg të vërtetës. Ky ndëshkim është plotësisht i drejtë, sepse ata nuk besojnë dhe nuk i kërkojnë ndihmë Allahut. E lusim Allahun të na ruajë, të na falë dhe të na ndihmojë!

Ajeti 176

176. Ata kërkojnë përgjigjen tënde. Thuaju: "Allahu ju përgjigjet për çështjen e atij që nuk ka lënë baba e as fëmijë që e trashëgojnë (*el kelale*). Nëse vdes një njeri që nuk ka fëmijë, por ka motër, atëherë asaj *(motrës)* i takon gjysma e pasurisë së lënë. Ai *(vëllai)* trashëgon atë *(motrën)*, nëse ajo nuk ka fëmijë. Në qoftë se janë dy *(motra që trashëgojnë)*, atyre të dyjave u takojnë dy të tretat që lë ai. Në qoftë se janë edhe vëllezër, edhe motra, atëherë mashkullit i takon pjesë sa dyfishi i pjesës së femrës. Kështu jua sqaron Allahu dispozitat, që ju të mos humbni rrugën e drejtë. Allahu është i Dijshëm për çdo gjë.

Shpjegimi i ajetit

- **"Ata kërkojnë përgjigjen tënde. Thuaju: "Allahu ju përgjigjet për çështjen e atij që nuk ka lënë baba e as fëmijë që e trashëgojnë (*el kelale*)."** - Allahu i Lartësuar na tregon se si disa njerëz i kërkuan njëherë Pejgamberit (a.s.) që t'i sqaronte çështjen e *el kelale*-s. *El kelale* quhet rasti kur një person, pas vdekjes së tij, nuk lë fëmijë të lindur prej tij dhe as fëmijë të fëmijëve të tij, nuk lë baba dhe as gjysh, por lë motër ose vëlla. Për këtë, Allahu i Lartësuar thotë:


- "Nëse vdes një njeri që nuk ka fëmijë..." – Domethënë, nuk ka lënë as djem, as vajza, nuk ka lënë as të lindur prej tij dhe as fëmijë nga fëmijët e tij. Gjithashtu, ky nuk ka lënë as baba dhe as gjysh, sepse Allahu i Lartësuar përmend mes trashëgimtarëve të pasurisë së këtij njeriu motrat dhe vëllezërit, dhe dihet gjerësisht se motrat dhe vëllezërit nuk marrin pjesë në trashëgimi, nëse është gjallë babai ose gjyshi.

- "...por ka motër, atëherë asaj *(motrës)* i takon gjysma e pasurisë së lënë." – Pra, nëse një mashkull me këto të dhëna vdes dhe lë pas vetes motër nga babai dhe nëna, ose vetëm nga babai, asaj i takon gjysma e pasurisë që ka lënë vëllai i saj, qofshin ato monedha ari e agjendi, toka, shtëpi, orendi etj. Sigurisht, kjo bëhet pasi të jenë larë borxhet dhe pasi të jetë plotësuar porosia e të vdekurit, sikurse është përmendur më parë.

Këtu nuk përfshihet motra vetëm nga nëna, për të cilën është folur më herët.

- "Ai *(vëllai)* trashëgon atë *(motrën)*, nëse ajo nuk ka fëmijë." - Nëse personi i vdekur është femër dhe lë pas vetëm një vëlla, ai trashëgon të gjithë pasurinë e saj, nëse ajo nuk ka lënë pas fëmijë.

Sheriati në këtë rast nuk ka përmendur masë të caktuar për vëllain, sepse ai e


الجزء السادس سورة المائدة
يَسْتَفْتُونَكَ قُلِ ٱللَّهُ يُفْتِيكُمْ فِى ٱلْكَلَٰلَةِ ۚ إِنِ ٱمْرُؤٌا۟ هَلَكَ
لَيْسَ لَهُۥ وَلَدٌ وَلَهُۥٓ أُخْتٌ فَلَهَا نِصْفُ مَا تَرَكَ ۚ وَهُوَ يَرِثُهَآ إِن
لَّمْ يَكُن لَّهَا وَلَدٌ ۚ فَإِن كَانَتَا ٱثْنَتَيْنِ فَلَهُمَا ٱلثُّلُثَانِ مِمَّا تَرَكَ ۚ
وَإِن كَانُوٓا۟ إِخْوَةً رِّجَالًا وَنِسَآءً فَلِلذَّكَرِ مِثْلُ حَظِّ ٱلْأُنثَيَيْنِ ۗ
يُبَيِّنُ ٱللَّهُ لَكُمْ أَن تَضِلُّوا۟ ۗ وَٱللَّهُ بِكُلِّ شَىْءٍ عَلِيمٌۢ ﴿١٧٦﴾
سورة المائدة
بِسْمِ ٱللَّهِ ٱلرَّحْمَٰنِ ٱلرَّحِيمِ
يَٰٓأَيُّهَا ٱلَّذِينَ ءَامَنُوٓا۟ أَوْفُوا۟ بِٱلْعُقُودِ ۚ أُحِلَّتْ لَكُم بَهِيمَةُ ٱلْأَنْعَٰمِ
إِلَّا مَا يُتْلَىٰ عَلَيْكُمْ غَيْرَ مُحِلِّى ٱلصَّيْدِ وَأَنتُمْ حُرُمٌ ۗ إِنَّ ٱللَّهَ
يَحْكُمُ مَا يُرِيدُ ﴿١﴾ يَٰٓأَيُّهَا ٱلَّذِينَ ءَامَنُوا۟ لَا تُحِلُّوا۟ شَعَٰٓئِرَ ٱللَّهِ
وَلَا ٱلشَّهْرَ ٱلْحَرَامَ وَلَا ٱلْهَدْىَ وَلَا ٱلْقَلَٰٓئِدَ وَلَآ ءَآمِّينَ ٱلْبَيْتَ
ٱلْحَرَامَ يَبْتَغُونَ فَضْلًا مِّن رَّبِّهِمْ وَرِضْوَٰنًا ۚ وَإِذَا حَلَلْتُمْ فَٱصْطَادُوا۟ ۚ
وَلَا يَجْرِمَنَّكُمْ شَنَـَٔانُ قَوْمٍ أَن صَدُّوكُمْ عَنِ ٱلْمَسْجِدِ ٱلْحَرَامِ أَن
تَعْتَدُوا۟ ۘ وَتَعَاوَنُوا۟ عَلَى ٱلْبِرِّ وَٱلتَّقْوَىٰ ۖ وَلَا تَعَاوَنُوا۟ عَلَى ٱلْإِثْمِ
وَٱلْعُدْوَٰنِ ۚ وَٱتَّقُوا۟ ٱللَّهَ ۖ إِنَّ ٱللَّهَ شَدِيدُ ٱلْعِقَابِ ﴿٢﴾
١٠٦

trashëgon të gjithë pasurinë e motrës kur ajo nuk ka lënë pas fëmijë apo trashëgimtarë të tjerë, për të cilët Sheriati e ka përcaktuar masën e trashëgimisë.

- "Në qoftë se janë dy *(motra që trashëgojnë)*, atyre të dyjave u takojnë dy të tretat që lë ai. Në qoftë se janë edhe vëllezër, edhe motra, atëherë mashkullit i takon pjesë sa dyfishi i pjesës së femrës." - Nëse trashëgimtarët janë dy motra e më shumë, atyre të dyjave u takojnë dy të tretat që ka lënë i vdekuri. Në qoftë se trashëgimtarët janë edhe vëllezër, edhe motra, atëherë një mashkulli i takon sa dyfishi i pjesës së një femre.

- "Kështu jua sqaron Allahu dispozitat, që ju të mos humbni rrugën e drejtë." – Kuptimi: Allahu i Lartësuar ju sqaron ligjet dhe dispozitat, që juve ju nevojiten shumë. Kjo është një mirësi e madhe që Zoti ju dhuron, sepse nëpërmjet saj ju nuk do ta humbisni rrugën e drejtë. Dituria sjell dritë

dhe udhëzim, kurse injoranca sjell humbje dhe padrejtësi.

- "Allahu është i Dijshëm për çdo gjë." - Ai është i Dijshëm për të fshehtat dhe për të dukshmet, për çështjet e shkuara dhe ato të ardhme. Ai e di për çfarë keni nevojë që të dini dhe ju mëson ju prej dijes së Tij, në mënyrë që ju të arrini çdo të mirë, në çdo kohë dhe në çdo vend.

Surja 5 - El maide (Sure medinase)
120 ajete

Ajeti 1

1. O ju që keni besuar! Plotësoni detyrimet! Bagëtitë janë të lejuara për ju, me përjashtim të atyre që do t'ju lexohen dhe përveç gjahut, që nuk është i lejuar përderisa gjendeni në ihram. Vërtet, Allahu vendos çfarë të dëshirojë.

Shpjegimi i ajetit

- "O ju që keni besuar! Plotësoni detyrimet!" - Ky është një urdhër nga Allahu i Lartësuar drejtuar adhuruesve të Tij besimtarë për të plotësuar detyrimet dhe marrëveshjet. Ai është urdhër për të zbatuar atë çka u dikton dhe nënkupton imani i tyre.

Kështu, i Madhëruari urdhëron për plotësimin e aktmarrëveshjeve dhe detyrimeve, pa i cenuar ato. Këtu bëhet fjalë për të gjitha llojet e detyrimeve, si më poshtë vijon:

1. Detyrimet e robit kundrejt Allahut të Lartësuar. Ndër detyrimet e robit kundrejt Allahut të Lartësuar është përkushtimi me sinqeritet në adhurimin vetëm ndaj Tij. Këto detyrime duhet të kryhen në formën më të plotë, pa lënë asgjë mangët.

2. Detyrimet e robit kundrejt Profetit (a.s.). Ndër detyrimet e robit kundrejt Profetit (a.s.) është bindja e plotë ndaj porosive të tij dhe pasimi rigoroz i Traditës së tij.

3. Detyrimet e robit kundrejt prindërve dhe të afërmve, siç është bamirësia ndaj tyre, ruajtja e lidhjeve me ta etj.

4. Detyrimet e robit kundrejt miqve dhe shokëve. Këto duhen plotësuar si në kohë pasurie dhe begatie, ashtu dhe në kohë varfërie dhe skamjeje, si në kohë lehtësie, ashtu dhe në kohë vështirësie.

5. Detyrimet e robit kundrejt krijesave në përgjithësi. Njeriu duhet t'i plotësojë të gjitha aktmarrëveshjet, tregtare apo të çfarëdo lloji qofshin, të lidhura mes tij dhe të tjerëve. Ai nuk duhet t'i cenojë aspak këto detyrime, por duhet t'i plotësojë ato me besnikëri dhe korrektësi.

6. Detyrimet e robit kundrejt të gjithë muslimanëve në përgjithësi, të cilat Zoti i Lartësuar i ka përmbledhur në fjalën e Tij: "Me të vërtetë besimtarët janë vëllezër.". Kështu, është detyrë për muslimanin që ta ndihmojë dhe të bashkëpunojë me vëllain e tij musliman për pasimin dhe përhapjen e të vërtetës. Është detyrë që të gjithë muslimanët të bashkohen dhe të forcojnë radhët e tyre rreth të vërtetës të sjellë nga Zoti dhe Profeti i Tij. Nga ana e kundërt, është e ndaluar përçarja në grupacione, duke u larguar nga e vërteta.

Ky është një urdhër që përfshin themelet e fesë dhe degëzimet e saj. Me fjalë të tjera, feja nuk është gjë tjetër, por veçse plotësim i detyrimeve dhe i marrëveshjeve që Allahu i Lartësuar ka urdhëruar të plotësohen dhe të çohen në vend.

Në vijim, Allahu i Lartësuar duke treguar mirësinë dhe bujarinë ndaj adhuruesve të Tij, thotë:

- "Bagëtitë janë të lejuara për ju..." - Domethënë, për hir tuaj dhe në shenjë mëshire ndaj jush, ju janë bërë të lejuara bagëtitë, pra, devetë, lopët dhe bagëtitë e

imta. Nën këtë gjykim hyjnë edhe kafshët e gjuetisë, si sorkadhet, zebrat etj.

Disa sahabë janë mbështetur në këtë ajet edhe për lejimin e konsumimit të mishit të këlyshëve që ngordhin në barkun e bagëtive pas therjes së tyre.

- "...me përjashtim të atyre që do t'ju lexohen..." - Pra, përveç atyre llojeve që do t'ju lexohen juve në ajetet vijuese, ku Allahu i Lartësuar thotë: "Janë haram për ju kafshët e ngordhura, gjaku, mishi i derrit, çfarë theret jo në emrin e Allahut, të mbyturat me lak në fyt, ..." e deri në fund. Këto kategori, edhe pse janë prej bagëtive apo kafshëve që përdoren për therje, janë haram.

Lejueshmëria e bagëtive që përmenden më sipër kufizohet me dispozitën e mëposhtme, ku Allahu i Lartësuar e ndalon përfitimin prej tyre me disa kohë dhe vende të caktuara:

- "...dhe përveç gjahut, që nuk është i lejuar përderisa gjendeni në ihram". - Për ju janë të lejuara bagëtitë dhe kafshët e gjuetisë në të gjitha gjendjet, përveç kur jeni në ihram. Në një rast të tillë, ju nuk duhet të guxoni që të gjuani, sepse kështu cenoni shenjtërinë e vendit në të cilin nuk lejohet gjuetia, si dhe gjendjen tuaj në ihram, gjatë së cilës gjithashtu nuk lejohet gjuetia.

"Gjah" konsiderohet çdo kafshë e egër që vritet e së cilës i hahet mishi.

- "Vërtet, Allahu vendos çfarë të dëshirojë". - Çdo urdhër dhe dispozitë që Allahu i Lartësuar ka ligjëruar për ju është, pa dyshim, prej urtësisë së Tij të madhe. Kështu, Ai ju urdhëron të plotësoni detyrimet dhe kontratat, sepse vetëm kështu arrihet begatia dhe mirësia dhe i pritet rruga çdo dëmtimi dhe armiqësie. Me urtësinë e Tij, Ai bëri të lejuara shumë e shumë lloje kafshësh dhe bagëtish, si mëshirë për ju. Po me urtësinë e Tij, Ai ju bëri të ndaluara veç një numër të vogël të llojeve të kafshëve, të cilat janë shumë pak në krahasim me të lejuarat, për t'ju ruajtur ju nga dëmi i tyre dhe për t'ju lartësuar juve në moral.

Edhe ndalimi i gjuetisë gjatë ihramit është bërë me urtësinë e të Lartësuarit, për të na mësuar si të respektojmë ihramin dhe vendet e shenjta.

Ajeti 2

2. O ju që keni besuar! Mos cenoni shenjtërinë e simboleve të Allahut, shenjtërinë e muajve të shenjtë, të kurbanit të Qabesë *(el hedij)*, as të kurbanëve *(el ḳalâid)* të shënuar me qafore, as ata të cilët, duke kërkuar begati nga Zoti i tyre dhe kënaqësinë e Tij, synojnë Shtëpinë e Shenjtë. E pasi të hiqni ihramin, atëherë gjahtoni! Urrejtja ndaj një populli, që iu pengoi nga Xhamia e Shenjtë, të mos ju shtyjë të silleni në mënyrë të padrejtë kundër tyre! Ndihmohuni mes jush në të mira dhe në devotshmëri, dhe mos ndihmoni në mëkate e armiqësi! Ruhuni prej dënimit të Allahut, se, me të vërtetë, Allahu është ndëshkues i fortë!

Shpjegimi i ajetit

- "O ju që keni besuar! Mos cenoni shenjtërinë e simboleve të Allahut..." - Kuptimi: Mos i përdhosni ato simbole të Allahut të Lartësuar, për të cilët Ai ju ka urdhëruar që t'i nderoni. Mos bëni vepra që Zoti i ka ndaluar të veprohen dhe që cenojnë shenjtërinë e simboleve që Zoti ka urdhëruar të respektohen.

Në këtë ajet jemi ndaluar nga, së pari, kryerja e veprave të shëmtuara dhe, së dyti, që të besojmë se ato janë të lejuesheme.

Kjo porosi përfshin ndalesat gjatë kohës së ihramit, si dhe ndalesat që kanë të bëjnë me Vendin e Shenjtë.

Në vijim, Allahu i Lartësuar përmend disa nga këto ndalesa:

- "...shenjtërinë e muajve të shenjtë..." - Kuptimi: Mos cenoni shenjtërinë e këtyre muajve të mëdhenj duke zhvilluar luftime në to apo duke kryer padrejtësi. Në një ajet

tjetër, Allahu i Lartësuar thotë: "Te Allahu, numri i muajve është dymbëdhjetë, ashtu si është në Librin e Allahut prej ditës kur krijoi qiejt dhe tokën. Prej tyre, katër janë të shenjtë. Kjo është fe e drejtë. Pra, mos e ngarkoni veten tuaj gjatë tyre *(këtyre katër muajve)*..." [Teube 36].

Megjithatë, shumica e dijetarëve janë të mendimit se ndalesa e luftimit në muajt e shenjtë është anuluar me dispozitën tjetër, që përmendet në vazhdim të të njëjtit ajet: "Luftojini të gjithë idhujtarët pa dallim, siç ju luftojnë ata ju pa dallim, e dijeni se Allahu është me ata që ruhen *(nga të këqijat)*." [Teube 36] apo në tekste të përgjithshme të Sheriatit, që urdhërojnë t'i luftojmë qafirët dhe që dënojnë braktisjen e luftës kundër tyre. Po ashtu, Profeti (a.s.) zhvilloi luftë me banorët e Taifit gjatë muajit *dhul-kide*, i cili është muaj i shenjtë.

Disa dijetarë të tjerë janë të mendimit se ndalesa e luftës gjatë muajve të shenjtë nuk është e anuluar me ajetet dhe faktet e tjera të lartpërmendura. Ato janë tekste përgjithësuese, ndërsa ajeti që ndalon nga luftimet përgjatë muajve të shenjtë është i posaçëm, që kufizon përgjithësimin e teksteve të tjera. Dhe pikërisht kështu veprohet në çdo rast të ngjashëm: ajetet përgjithësuese kuptohen duke u parë në kontekst me ajetet kufizuese.

Ndërsa disa të tjerë japin një shpjegim tjetër. Ata thonë se e lejueshme nuk është nisja e luftës në muajt e shenjtë. Në të kundërt, nëse lufta fillon jashtë muajve të shenjtë dhe vazhdon edhe përgjatë tyre, atëherë lejohet. Me të njëjtin arsyetim shpjegohet edhe lufta e Profetit (a.s.) zhvilluar në muajin e shenjtë të *dhul-kide*-s kundër banorëve të Taifit, luftë e cila nisi në Hunejn, në muajin *sheual*, i cili nuk është muaj i shenjtë.

Të gjitha këto qëndrime sigurisht që nuk bëjnë fjalë për luftën mbrojtëse, e cila është e lejuar në çdo rast. Nëse qafirët i sulmojnë muslimanët, pa dyshim që është e lejuar që muslimanët të mbrojnë veten, në muajt e shenjtë apo jashtë tyre qoftë. Për këtë çështje janë unanimë të gjithë dijetarët.

- "...të kurbanit të Qabesë (*el hedij*), as të kurbanëve (*el ḳalâid*) të shënuar me qafore..." - Kuptimi: Mos pengoni të bëhen këto kurbane për Allahun në Shtëpinë e Tij, për haxh apo për umre, apo t'i vidhni a dëmtoni ato, me çdo lloj dëmtimi, duke i lodhur e rraskapitur apo duke bërë që të mos arrijnë në vendin e tyre të caktuar. Përkundrazi, përkujdesuni dhe respektojini ata dhe njerëzit që i kanë sjellë për t'ia përkushtuar Allahut të Lartësuar.

Këtu Allahu i Lartësuar ka përmendur *"el hedij"* dhe *"el ḳalâid"*. *"El hedij"* quhen bagëtitë që përkushtohen për haxh dhe për umre. Ndërsa *"el ḳalâid"* janë një lloj i veçantë i *el hedij*-it, sepse në qafat e këtyre bagëtive vendosen shenja, për të treguar se ato janë bagëti të përcaktuara si kurban dhe madhërim për Allahun e Lartësuar, pikërisht ashtu sikurse ka vepruar Profeti i Tij i zgjedhur, Muhamedi (a.s.). Ato shërbejnë si shenja, me qëllim që të respektohen nga njerëzit.

- "...as ata të cilët, duke kërkuar begati nga Zoti i tyre dhe kënaqësinë e Tij, synojnë Shtëpinë e Shenjtë". - Pra, mos i cenoni dhe mos dëmtoni ata që synojnë të vizitojnë Shtëpinë e Shenjtë, qoftë për të kërkuar begatitë e Allahut të Lartësuar dhe mirësitë e Tij nëpërmjet tregtisë dhe mënyrave të lejuara të fitimit, qoftë për të kërkuar kënaqësinë e Allahut të Lartësuar duke kryer haxhin dhe umren. Por përkundrazi, nderojini dhe respektojini vizitorët e Shtëpisë së Zotit tuaj.

Ky ajet është urdhër për të siguruar të gjitha rrugët që çojnë drejt Shtëpisë së Allahut, për t'u mundësuar qetësi dhe rehati të plotë vizitorëve të saj, duke larguar çdo frikë për jetën dhe pasurinë e tyre.

Sidoqoftë, këtij ajeti gjithëpërfshirës i bëhet një kufizim me fjalën e Allahut të Lartësuar: "O besimtarë! Në të vërtetë,

idhujtarët janë ndyrësi, prandaj të mos i afrohen më Xhamisë së Shenjtë pas këtij viti. Dhe mos kini frikë nga varfëria, sepse, nëse dëshiron, Allahu ju bën të pasur me dhuntitë e Veta. Vërtet, Allahu është i Gjithëdijshëm dhe i Urtë." [Teube 28]. Pra, idhujtarët nuk lejohen të futen në Vendin e Shenjtë.

Gjithashtu, nga ajeti kuptohet se ata që synojnë të hyjnë në Vendin e Shenjtë për të kryer vepra të ulëta dhe padrejtësi duhet të pengohen nga hyrja në të. Lejimi i tyre bie ndesh me nderimin e Faltores dhe rrethinave të saj, sikurse thotë Allahu i Lartësuar në një ajet tjetër: "S'ka dyshim se ata të cilët nuk besojnë dhe pengojnë prej rrugës së Allahut dhe prej Xhamisë së Shenjtë, të cilën Ne e bëmë për të gjithë njerëzit pa dallim, qofshin vendas ose të ardhur; dhe kushdo që, në të, përpiqet të bëjë ndonjë të keqe a ndonjë padrejtësi, Ne kemi për t'i bërë të shijojnë një dënim të hidhur". [Haxh 25].

Pasi ndaloi nga gjuetia në kohën e ihramit, Allahu i Lartësuar thotë:

- "E pasi të hiqni ihramin, atëherë gjahtoni". - Kuptimi: Nëse keni dalë nga gjendja e ihramit të haxhit apo të umres dhe jeni jashtë Vendit të Shenjtë, atëherë ju lejohet që të gjuani.

Zakonisht, një urdhër nënkupton që ai duhet kryer si detyrim. Por është një rregull ligjor në Islam që thotë se: urdhërimi për kryerjen e diçkaje, e cila më parë ishte e ndaluar, bën që ajo të marrë të njëjtin gjykim që kishte para se të ndalohej. Kështu, ky urdhër për të bërë gjueti nuk do të thotë që është e detyrueshme për ne që, pas çlirimit nga ihrami, të dalim për gjah. Me fjalë të tjera, gjuetia është e lejuar, por ndalohet në rastet e caktuara me ligj.

- "Urrejtja ndaj një populli, që iu pengoi nga Xhamia e Shenjtë, të mos ju shtyjë të silleni në mënyrë të padrejtë kundër tyre!" - Kuptimi: Urrejtja ndaj një populli, për shkak të armiqësisë dhe luftës që ata bëjnë kundër jush për t'ju penguar nga Xhamia e Shenjtë, kurrsesi të mos ju shtyjë të bëheni të padrejtë dhe të kaloni kufijtë, thjesht për të shuar zemërimin tuaj. Adhuruesit e Zotit duhet t'u përmbahen porosive të Tij në çdo gjendje dhe situatë, duke ruajtur drejtësinë, qoftë edhe ndaj atyre që i luftojnë dhe i dhunojnë.


Rrjedhimisht, nuk lejohet, për shembull, të mashtrosh dikë me justifikimin se edhe ai të ka mashtruar, apo të tradhtosh dikë me pretekstin se edhe ai të ka tradhtuar. Pra, në çdo rast, besimtari tregohet i drejtë dhe kurrë nuk i shkel parimet e larta të Zotit të tij.

- "Ndihmohuni mes jush në të mira dhe në devotshmëri". - Allahu i Lartësuar na urdhëron që të bashkëpunojmë dhe të ndihmojmë njëri-tjetrin për dy qëllime:

Së pari, për bamirësi (*el birr*). *El birr* është një term përfshirës i gjithçkaje të cilën e do Allahu dhe është i kënaqur me të, qoftë vepër e dukshme apo e padukshme, që ka të bëjë me plotësimin e të drejtave të Allahut apo me të drejtat e krijesave .

Së dyti, për devotshmëri (*takua*), fjalë e cila përfshin në këtë ajet gjithçka që duhet lënë e braktisur, qoftë vepër e dukshme apo e padukshme, që është e urryer prej Allahut të Lartësuar.

Çdo punë të mirë, të cilën Allahu e do dhe është i kënaqur me të, dhe çdo vepër të keqe të cilën Ai e urren, Ai e ka sqaruar tërësisht nëpërmjet Librit të Tij dhe Profetit (a.s.). Njeriu është urdhëruar që të gjitha porositë e Allahut t'i zbatojë jo vetëm për veten e tij, por edhe të ndihmojë dhe bashkëpunojë me të tjerët për t'i realizuar dhe kryer ato në formën më të mirë dhe më të plotë. Besimtarët duhet të ndihmohen dhe bashkëpunojnë me njëri-tjetrin për të zbatuar porositë e Zotit dhe të Profetit të Tij në çdo mënyrë të lejuar dhe të mundshme: me fjalë nxitëse apo me vepra që ngjallin optimizëm dhe ambicie.


الجزء السادس سورة المائدة
حُرِّمَتْ عَلَيْكُمُ الْمَيْتَةُ وَالدَّمُ وَلَحْمُ الْخِنزِيرِ وَمَا أُهِلَّ لِغَيْرِ اللَّهِ بِهِ
وَالْمُنْخَنِقَةُ وَالْمَوْقُوذَةُ وَالْمُتَرَدِّيَةُ وَالنَّطِيحَةُ وَمَا أَكَلَ
السَّبُعُ إِلَّا مَا ذَكَّيْتُمْ وَمَا ذُبِحَ عَلَى النُّصُبِ وَأَن تَسْتَقْسِمُوا
بِالْأَزْلَامِ ذَٰلِكُمْ فِسْقٌ الْيَوْمَ يَئِسَ الَّذِينَ كَفَرُوا مِن دِينِكُمْ فَلَا
تَخْشَوْهُمْ وَاخْشَوْنِ الْيَوْمَ أَكْمَلْتُ لَكُمْ دِينَكُمْ وَأَتْمَمْتُ عَلَيْكُمْ
نِعْمَتِي وَرَضِيتُ لَكُمُ الْإِسْلَامَ دِينًا فَمَنِ اضْطُرَّ فِي مَخْمَصَةٍ
غَيْرَ مُتَجَانِفٍ لِّإِثْمٍ فَإِنَّ اللَّهَ غَفُورٌ رَّحِيمٌ ٣ يَسْأَلُونَكَ مَاذَا
أُحِلَّ لَهُمْ قُلْ أُحِلَّ لَكُمُ الطَّيِّبَاتُ وَمَا عَلَّمْتُم مِّنَ الْجَوَارِحِ
مُكَلِّبِينَ تُعَلِّمُونَهُنَّ مِمَّا عَلَّمَكُمُ اللَّهُ فَكُلُوا مِمَّا أَمْسَكْنَ عَلَيْكُمْ
وَاذْكُرُوا اسْمَ اللَّهِ عَلَيْهِ وَاتَّقُوا اللَّهَ إِنَّ اللَّهَ سَرِيعُ الْحِسَابِ ٤
الْيَوْمَ أُحِلَّ لَكُمُ الطَّيِّبَاتُ وَطَعَامُ الَّذِينَ أُوتُوا الْكِتَابَ حِلٌّ لَّكُمْ
وَطَعَامُكُمْ حِلٌّ لَّهُمْ وَالْمُحْصَنَاتُ مِنَ الْمُؤْمِنَاتِ وَالْمُحْصَنَاتُ
مِنَ الَّذِينَ أُوتُوا الْكِتَابَ مِن قَبْلِكُمْ إِذَا آتَيْتُمُوهُنَّ أُجُورَهُنَّ
مُحْصِنِينَ غَيْرَ مُسَافِحِينَ وَلَا مُتَّخِذِي أَخْدَانٍ وَمَن يَكْفُرْ
بِالْإِيمَانِ فَقَدْ حَبِطَ عَمَلُهُ وَهُوَ فِي الْآخِرَةِ مِنَ الْخَاسِرِينَ ٥
١٠٧

- "...dhe mos ndihmoni në mëkate e armiqësi!" - Allahu i Lartësuar na ndalon që të bashkëpunojmë dhe të ndihmojmë tjetrin për të kryer vepra të ulëta dhe të ndaluara, të cilat e ngarkojnë njeriun me gjynahe dhe e çojnë atë drejt ndëshkimit. Gjithashtu, Ai na ndalon nga armiqësia dhe padrejtësia ndaj krijesave, duke cenuar jetën, pasurinë dhe nderin e tyre. Kështu, robi duhet ta ndalojë veten prej harameve dhe padrejtësisë, por duhet të ndihmojë edhe të tjerët për t'iu larguar atyre.

- "Ruhuni prej dënimit të Allahut, se, me të vërtetë, Allahu është ndëshkues i fortë!" - Ai është ndëshkues i rreptë ndaj të gjithë atyre që nuk i binden dhe marrin guximin të shkelin kufijtë e Tij. Ruajini, pra, dhe mos i shkelni kufijtë e Zotit, që mbi ju të godasë i ashpër ndëshkimi i Tij në jetën e dynjasë dhe në ahiret!

Ajeti 3

3. Janë haram për ju: të ngordhurat, gjaku, mishi i derrit, ajo kafshë që theret jo në emrin e Allahut, ajo që është mbytur me lak në fyt, ajo që është vrarë me goditje, ajo që është rrëzuar nga lartësitë, ajo që është shpuar, ajo që është ngrënë nga egërsirat, përveç asaj që arrini ta therni, ajo që është therur për idhuj dhe që ta kërkoni fatin me short. Këto janë gjynahe tek Allahu. Sot u dëshpëruan ata që mohuan dhe humbën çdo shpresë që t'ju largojnë prej fesë suaj. Mos u frikësoni prej tyre, por vetëm Mua m'u frikësoni! Sot e përsosa për ju fenë tuaj, e plotësova dhuntinë Time ndaj jush dhe u kënaqa që Islami të jetë feja juaj. Kush detyrohet nga uria, duke mos tepruar dhe duke mos patur qëllim mëkatin, Allahu është Falës i Gjithëmëshirshëm.

Shpjegimi i ajetit

Ky është ajeti që sqaron kategoritë e ndaluara të kafshëve, për të cilat Allahu i Lartësuar aludoi në një ajet më sipër, kur tha: "Bagëtitë janë të lejuara për ju, me përjashtim të atyre që do t'ju lexohen".

Mësoje se Allahu i Lartësuar dhe i Madhërishëm nëse e bën haram diçka, e bën këtë për të ruajtur adhuruesit e Tij dhe për t'i mbrojtur ata nga e liga që gjendet në to. Por njerëzit jo gjithmonë arrijnë të kuptojnë dhe të dallojnë këtë të ligë ose urtësinë e Zotit në ndalimet dhe dispozitat e Tij.

Në këtë ajet, Allahu i Urtë dhe i Gjithëmëshirshëm na ndalon nga:

- "Janë haram për ju: të ngordhurat..." - E ngordhur (*el mejtetu*) quhet ajo kafshë që ka humbur jetën e saj jo me mënyrën e caktuar nga Sheriati për të qenë hallall për t'u konsumuar. Mënyra e përcaktuar nga Sheriati është ajo kur kafshës i priten damarët e qafës, me qëllim që prej saj të dalë gjaku. Kafsha që ngordh pa i dalë gjaku është e pisët dhe shumë e dëmshme, për shkak të gjakut të bllokuar brenda saj. Shpeshherë, kafshët ngordhin për shkak të ndonjë sëmundjeje, gjë e cila ia shton rrezikun. Megjithatë, nga ky gjykim

përjashtohen karkalecat e tokës dhe peshqit, të cilët nuk kanë nevojë për mënyrën e lartpërmendur të therjes, që të jenë hallall.

- "...gjaku..." - Këtu bëhet fjalë për gjakun venoz (*el demu*), i cili del me forcë gjatë therjes së kafshës, sikurse është shpjeguar kjo në ajetin tjetër ku thuhet: "Thuaj: "Në atë që më është shpallur mua *(në Kur'ân)* nuk po gjej të ndaluar nga ushqimi, veç nëse ai *(ushqimi)* është: e ngordhur, gjak i derdhur *(me forcë)* ..." deri në fund. El en'am 145.

- "mishi i derrit". - Ndalesa këtu përfshin të gjitha pjesët e derrit. Allahu i Lartësuar e ka veçuar këtë kafshë, ndonëse të gjitha llojet e kafshëve mishngrënëse janë si ai, sepse shumë prej ithtarëve të Librit pretendonin se Allahu i Madhëruar ua bëri atyre të lejuar konsumimin e mishit të derrit. Pra, kuptimi është: Kujdes dhe mos u mashtroni nga pretendimet e tyre, pasi kjo kafshë është e ndaluar për ju që ta konsumoni. Ajo është prej atyre gjërave të pista dhe të dëmshme, që Allahu i ndaloi për ju.

- "...ajo kafshë që theret jo në emrin e Allahut..." - Pra, të gjitha kafshët që janë therur duke iu përkushtuar dikujt a diçkaje tjetër veç Allahut të Madhërishëm, qoftë idhull, evlija, yll, xhind etj.

Kështu, gjatë therjes së kafshës duhet përmendur emri i Allahut, pasi ky veprim e bën atë të mirë të shëndetshme dhe hallall. Ndërsa mospërmendja e emrit të Allahut, por përmendja e emrit të dikujt a diçkaje tjetër veç Tij e bën atë kafshë të ndaluar dhe të papastërt. Në këtë rast kemi të bëjmë me një vepër idhujtarie, dhe idhujtaria është diçka e ndyrë dhe e ndaluar nga Zoti.

- "...ajo që është mbytur me lak në fyt, ajo që është vrarë me goditje, ajo që është rrëzuar nga lartësitë, ajo që është shpuar, ajo që është ngrënë nga egërsirat..." - Le t'i marrim me radhë:

1. Ajo që është mbytur me lak në fyt (*el munħaniķatu*) - Pra, kafsha që ka ngordhur për shkak të mbytjes dhe shtrëngimit me litar apo për shkak të ngecjes së kokës së saj në ndonjë vrimë të ngushtë, nga ku nuk ka arritur të dalë derisa ka ngordhur etj.

2. Ajo që është vrarë me goditje (*el meuķudhetu*) – Pra, e ngordhura për shkak të goditjes së saj me ndonjë send të fortë si gur, dru apo mbi të cilën është shembur një ndërtesë, me qëllim apo pa qëllim qoftë kjo.

3. Ajo që është rrëzuar nga lartësitë (*el muterad-dijetu*) – Domethënë, kafsha që është rrëzuar prej së larti: nga mali, nga tarraca etj., dhe ka ngordhur nga ky rrëzim.

4. Ajo që është shpuar (*en-natiĥatu*), - Domethënë, kafsha të cilën e ka shpuar një kafshë tjetër dhe ka ngordhur nga ky shkak.

5. Ajo që është ngrënë nga egërsirat, (*ue ma ekeles-seb'u*) – Pra, kafsha që është ngrënë nga egërsirat, si ujku, luani, tigri ose nga shpendët grabitqarë.

Pra, nëse kafsha ka ngordhur për këto shkaqe të mësipërme, ajo është e ndaluar të konsumohet.

- " ...përveç asaj që arrini ta therni,... - Ky përjashtim vlen për të gjitha rastet e lartpërmendura. Pra, nëse kafsha arrihet që të theret me mënyrën e lejuar të Sheriatit, për sa kohë është ende gjallë dhe kur është therja ajo që sjell ngordhjen e tyre, atëherë ajo është e lejuar.

Disa dijetarë kanë thënë që: nëse egërsira ia ka nxjerrë zorrët jashtë kafshës apo i ka këputur arteriet e qafës, atëherë therja sipas Sheriatit është e pavlefshme. Ndërsa disa të tjerë janë të mendimit se, nëse kafsha gjendet e gjallë, në çfarëdo gjendje qoftë ajo, mjafton që të jetë e gjallë, një therje e rregullt sipas Sheriatit është e vlefshme dhe e bën atë të lejuar për t'u konsumuar. Këtë mendim të dytë e përforcon edhe kuptimi i drejtpërdrejtë i ajetit, që thotë: nëse arrini ta therrni para se të ketë ngordhur, kjo e bën atë të lejuar. Ajeti nuk shtjellon që duhet të jetë në këtë apo atë gjendje.

- "...ajo që është therur për idhujt." – Domethënë, kafsha që është therur në formë adhurimi për idhujt.

"...ta kërkoni fatin me short" - Allahu i Lartësuar e ka bërë të ndaluar që të kërkosh fatin me short. Në kohën e injorancës përdoreshin tri shigjeta për short. Në njërën shkruhej "Bëje!", në të dytën shënohej "Mos e bëj!" dhe në tjetrën nuk shënohej gjë. Nëse dikush vendoste të nisej për ndonjë udhëtim apo për martesë apo për ndonjë çështje të rëndësishme, fillimisht duhej të zgjidhte një prej këtyre tri shigjetave, të servirura prej dikujt dhe të cilat ishin të ngjashme në përmasa dhe pamje. Nëse personi tërhiqte shigjetën mbi të cilën shkruhej "Bëje!" ai e ndërmerrte veprimin, nëse tërhiqte atë mbi të cilën shkruhej "Mos e bëj!" ai nuk e bënte, dhe nëse tërhiqte shigjetën mbi të cilën nuk shkruhej gjë, atëherë e përsëriste shortin, derisa të dilte njëra nga dy të parat. Por Allahu i Madhëruar e bëri të ndaluar këtë vepër dhe çdo mënyrë të ngjashme me të, duke e zëvendësuar atë me istiharen [31], pra, me kërkimin e ndihmës dhe rrugëzgjidhjes vetëm nga Allahu, nëpërmjet adhurimit përkushtuar Atij.

- "Këto janë gjynahe tek Allahu." – Këto, – domethënë, të gjitha haramet e përmendura në ajet, të cilat Allahu i Madhëruar i bëri të ndaluara për t'i ruajtur adhuruesit e Tij nga çdo gjë e dëmshme, e pisët dhe e ulët, – të gjitha janë *fisḳ* ose dalje nga kufijtë e Allahut. Konsumimi i tyre është shenjë e mosbindjes ndaj Allahut dhe bindjes ndaj Shejtanit.

Më pas, Allahu i Madhëruar përmend mirësinë e Tij të madhe ndaj besimtarëve, duke thënë:

- "Sot u dëshpëruan ata që mohuan dhe e humbën çdo shpresë, që t'ju largojnë prej fesë suaj." - Dita për të cilën aludohet është Dita e Arafatit, gjatë Haxhit të Lamtumirës të Profetit (a.s.), ditë në të cilën Allahu i Madhëruar e plotësoi fenë e Tij, e ndihmoi dhe e bëri ngadhënjimtar Profetin dhe adhuruesin e Tij të zgjedhur dhe i poshtëroi e nënshtroi totalisht idhujtarinë dhe idhujtarët. Këta të fundit, më herët, i luftonin me të gjitha mjetet për t'i kthyer besimtarët nga feja e tyre, por kur panë triumfin madhështor të Islamit dhe pasuesve të Tij, ata humbën çdo shpresë se mund t'i kthenin muslimanët nga besimi dhe feja e tyre e kompletuar dhe e mrekullueshme. Madje, zemrat e tyre u mbushën me frikë dhe ankth. Për këtë arsye, atë vit kur Profeti kreu haxhin e Tij, në Qabe nuk bëri tavaf asnjë idhujtar, e jo më të bënin tavaf të zhveshur, sikundër e kishin zakon në kohën e injorancës.

E tillë ishte gjendja e idhujtarëve. Ndërsa besimtarëve u takonte siguria, qetësia dhe gëzimi. Ata nuk duhet të frikësohen nga asgjë, veç Zotit të tyre. Prandaj i Madhëruari thotë më tej:

- "Mos u frikësoni prej tyre, por vetëm Mua m'u frikësoni!" - Kuptimi: Kurrë mos iu frikësoni idhujtarëve, por vetëm Allahut frikësojuni. Është Allahu Ai që ju dhuroi fitoren dhe i mundi e poshtëroi idhujtarinë dhe idhujtarët. Është Allahu Ai, i Cili, kurthet dhe intrigat e armiqve tuaj, ua ktheu mbi qafat e tyre.

- "Sot e përsosa për ju fenë tuaj..." - Kuptimi: E përsosa fenë tuaj me triumfin që ju dhurova dhe me plotësimin e të gjitha ligjeve që kanë lidhje me çështjet e jashtme dhe me çështjet shpirtërore, të cilat kanë

[31] "*El istihara*" quhet mënyra e kërkimit të ndihmës dhe gjykimit prej Allahut të Madhëruar, duke iu lutur Atij për udhëzim në rrugën më të mirë të veprimit në çështje të rëndësishme, për të cilat je në mëdyshje. Kështu, nëse je përpara një pune të rëndësishme dhe je në mëdyshje rreth zgjedhjes më të mirë, vendos për njërën nga ato dhe, para se t'ia nisësh punës për realizimin e saj, fal dy rekatë namaz, dhe më pas lutesh me duanë e istihares. Shih "Mburroja e muslimanit" fq 80.

lidhje me themelet e kësaj feje madhështore dhe imtësitë e saj.

Nëpërmjet Librit dhe Sunetit, i Madhëruari sqaroi gjithçka që ne duhet të dimë dhe të punojmë për të fituar kënaqësinë e Tij, na mësoi gjithçka nga e cila duhet të ruhemi për të mos na goditur zemërimi dhe ndëshkimi i Tij. Libri dhe Suneti janë të mjaftueshëm për të gjetur dhe arritur çdo të mirë dhe për të shpëtuar dhe ruajtur nga çdo e keqe. Madje, çdokush që pretendon se, për të njohur çështjet e besimit dhe të ligjit, duhet të njohësh dhe të kesh dituri të tjera veç diturisë së Kur'ânit dhe Sunetit, si për shembull filozofinë apo njohuri të tjera, ai është injorant dhe i dështuar, sepse kështu ai pretendon se feja plotësohet veçse nëse merret për bazë dija që ai pretendon. Por ky pretendim është nga padrejtësitë më të mëdha kundrejt Allahut dhe të Dërguarit të Tij.

- "...e plotësova dhuntinë Time ndaj jush dhe u kënaqa që Islami të jetë feja juaj". - Dhuratat e Zotit janë të shumta, të dukshme dhe të fshehta, ndërsa me plotësimin e kësaj feje, Ai i plotësoi begatitë e Tij mbi ne. Ai e përzgjodhi Islamin dhe u kënaq që kjo të jetë feja jonë, ashtu sikurse na përzgjodhi ne që të jemi pasues të kësaj feje. Për këtë arsye, ne duhet t'i përkushtohemi totalisht Zotit tonë Bujar dhe të Gjithëmëshirshëm, për t'i shprehur mirënjohjen për dhurimin e këtyre mirësive. Ne duhet ta lavdërojmë dhe falënderojmë Atë për fenë më të mrekullueshme që na dhuroi dhe që na zgjodhi për të qenë pasues të saj.

- "Kush detyrohet nga uria, duke mos tepruar dhe duke mos patur qëllim mëkatin...". - Çdokush që zihet i detyruar për të ngrënë diçka prej këtyre harameve të përmendura, është i justifikuar. Megjithatë, janë disa kushte, të cilat i Madhëruari i ka renditur:

- Së pari, nëse ka uri të madhe.

- Së dyti, të mos e teprojë dhe të mos anojë drejt mëkatit, por të hajë vetëm atëherë kur nevoja është jetësore dhe vetëm aq sa të thyejë nevojën e domosdoshme. Me të tilla kushte, Allahu i Madhërishëm është Falës i Gjithëmëshirshëm:

- "Allahu është Falës i Gjithëmëshirshëm". - Arsyeja: Sepse Ai e lejoi ngrënien e këtyre harameve në të tilla gjendje, duke i mundësuar robit të mbajë gjallë veten, pa dëmtuar dhe cenuar aspak besimin dhe fenë e tij.

Ajeti 4

4. Të pyesin ty *(Muhamed)*, çfarë u është bërë e lejuar? Thuaju: "Ju janë lejuar të gjitha ushqimet e mira dhe gjahu i shtazëve gjahtare të ushtruara, të cilat ju i keni mësuar ashtu si ju ka mësuar Allahu ju. Hani, pra, atë që ato e gjahtojnë për juve dhe përmendeni emrin e Allahut. Frikësojuni Allahut, se, me të vërtetë Allahu është i shpejtë në llogari!

Shpjegimi i ajetit

- "Të pyesin ty *(Muhamed)*, çfarë u është bërë e lejuar?" – Domethënë, çfarë lloje ushqimesh u janë lejuar.

- "Thuaju: "Ju janë lejuar të gjitha ushqimet e mira..." - Ushqime "të mira" janë të gjitha ato ushqime të shijshme, të këndshme, të dobishme dhe jo të dëmshme për trupin dhe mendjen e njeriut. Këtu hyjnë të gjitha llojet e farërave, frutave, perimeve dhe të gjitha bimët që kultivohen nëpër toka e male. Bëjnë pjesë, gjithashtu, të gjitha llojet e kafshëve të detit, të tokës dhe të qiellit, përveç atyre që ka përjashtuar Sheriati, përveç egërsirave mishngrënëse apo kafshëve të dëmshme.

Ajeti, me aspektin e nënkuptuar të tij, na tregon se ushqimet e dëmshme dhe të këqija janë të ndaluara. Megjithatë, në një ajet tjetër kur'ânor, kjo shprehet qartë: "…Ai *(Zoti)* tha: "Dënimi Im është ai me të cilin e godas

atë që dëshiroj. Ndërsa mëshira Ime ka përfshirë çdo gjë: atë *(mëshirën)* e jap për ata të cilët ruhen, japin zekatin, për ata që u besojnë shpalljeve Tona, që pranojnë të Dërguarin *(Muhamedin)*, Profetin arab, *(që nuk shkruan, as nuk lexon)*, të cilin e gjejnë të cilësuar tek ata në Teurat dhe në Ungjill, që i urdhëron ata për çdo të mirë dhe i ndalon nga çdo e keqe, u lejon ushqimet e këndshme dhe u ndalon ato të pakëndshmet, u heq barrën e rëndë të tyre dhe prangat që ishin mbi ta. Pra, ata të cilët e besojnë atë, e nderojnë dhe e ndihmojnë, ata që veprojnë me Dritën që u zbrit me të, të tillët janë të shpëtuarit." [A'raf 157.]

- "...dhe gjahu i shtazëve gjahtare të ushtruara, të cilat i keni mësuar ashtu si ju ka mësuar Allahu ju. Hani, pra, atë që ato e gjahtojnë për ju dhe përmendeni emrin e Allahut". - Ky ajet mëson për disa çështje:

1. Për butësinë dhe mëshirën e Allahut për adhuruesit e Tij, duke ua lehtësuar dhe zgjeruar mundësitë dhe rrugët për të gjetur hallallin. Kështu ai ua bëri të lejuar edhe ato kafshë që nuk janë therur me mënyrën e përcaktuar nga Sheriati, por që janë kapur nga shtazët e gjahut, si: qentë, leopardët, skifterët etj., që e mbërthejnë prenë me dhëmbët shqyes ose me kthetrat e tyre.

2. Është kusht që shtaza gjahtare të jetë e mësuar dhe e stërvitur mjaftueshëm, aq sa nga njerëzit të konsiderohet "e mësuar", për shembull, nëse qortohet, ajo tërhiqet, dhe nëse kap gjahun, nuk e ha atë, por ia sjell zotërisë së saj. Prandaj i Madhëruari thotë: "...dhe gjahu i shtazëve gjahtare të ushtruara, të cilat i keni mësuar, ashtu si ju ka mësuar Allahu ju."

3. Gjithashtu, kur na lejon që të hamë prej këtij gjahu, i Madhëruari sqaron më shumë, duke thënë: "...Hani, pra, atë që ato e gjahtojnë për ju...!" Domethënë, që e kapin për t'ju sjellë juve, e jo për ta ngrënë vetë. Kështu, nëse kafsha gjahtare ha prej gjahut, atëherë kjo është shenjë se ajo e ka kapur për vete, prandaj mishi i këtij gjahu nuk është i lejuar të hahet.

4. Është kusht që zagari apo skifteri ta shqyejë dhe t'i nxjerrë gjak kafshës së gjuajtur, nëse jemi të mendimit se emërtimi i këtyre kafshëve gjahtare: "*el xheuârihi mukel-libin*", ka kuptimin: "shtazët shqyese të gjahut". Pra, nëse kafsha gjahtare e mbyt prenë e saj, atëherë ky gjah futet në kategorinë e të ndaluarave që Zoti i përshkruan si "*el munhaniqatu*" – "të mbyturat me lak në fyt", pra, që kanë ngordhur për shkak të mbytjes dhe shtrëngimit me litar, apo për shkak të ngecjes së kokës në ndonjë vrimë të ngushtë e raste të ngjashme.

Megjithatë, mendimi më i njohur dhe më i përhapur është që emërtimi "*el xheuârihi mukel-libin*", ka kuptimin: "shtazët kapëse të gjahut". Pra, ato thjesht duhet ta kapin gjahun, dhe është gjahtari që nxjerr gjakun prej tyre nëpërmjet therjes apo armës së gjahut. Kësisoj, nuk mund të themi se ajeti e vë atë kusht. Allahu është më i ditur.

5. Lejohet mbajtja dhe përdorimi i qenit për gjueti, pasi nëse lejohet stërvitja dhe gjahu i tij, atëherë mbajtja dhe përdorimi i tij duhet të jetë gjithashtu e lejueshme.

6. Pjesa e mishit të gjahut ku e ka kapur shtaza gjahtare është e pastër, sepse Allahu i Madhëruar e ka konsideruar atë hallall, pa thënë ndonjë gjë për larjen apo pastrimin e saj.

7. Angazhimi me stërvitjen e qenve, skifterëve dhe kafshëve të tjera të gjahut nuk konsiderohet si i qortueshëm apo si kotje me gjëra të parëndësishme. Ai është i domosdoshëm, për të bërë që gjahu nëpërmjet të tilla kafshëve të jetë i lejuar.

8. Lejohet shitblerja e qenve të gjuetisë, sepse pasja e një qeni të tillë mund të arrihet ndoshta veçse duke e blerë.

9. Është kusht thënia "*Bismil-lâh*" para gjuajtjes dhe lëshimit të kafshës gjahtare. Nëse kjo nuk thuhet me qëllim, atëherë gjahu i kapur është haram.

10. Lejohet preja e kapur nga shtaza gjahtare, pavarësisht në është ajo që e vret dhe i nxjerr gjakun e saj apo jo. Nëse zotëria e arrin prenë ende të gjallë, le ta therë atë sipas mënyrës së përcaktuar nga Sheriati.

Në vijim, Allahu i Madhëruar na nxit për të qenë të devotshëm ndaj Tij, duke zbatuar porositë e Tij dhe duke qëndruar brenda kufijve të Tij. Për ta bërë këtë më të thjeshtë, Ai na përkujton Ditën e Llogarisë para Tij. Dita e Kijametit është e afërt dhe e pakthyeshme, prandaj:

- " Frikësojuni Allahut! Me të vërtetë, Allahu është i shpejtë në llogari."

Ajeti 5

5. Sot u lejuan për ju ushqimet e mira. Edhe ushqimet e ithtarëve të Librit janë të lejuara për ju, ashtu si ushqimet tuaja janë të lejuara për ta; edhe gratë e ndershme besimtare dhe të ndershmet nga ata të cilëve u është dhënë Libri para jush (*janë të lejuara për ju*), nëse u jepni atyre mehrin e caktuar, por duke pasur për qëllim martesën, e jo imoralitetin dhe as si dashnore. E kush e braktis besimin, pa dyshim që vepra e tij është asgjësuar dhe në botën tjetër do të jetë prej të shkatërruarve.

Shpjegimi i ajetit

- "Sot u lejuan për ju ushqimet e mira." - Lejimin e të mirave për ne Allahu i Lartësuar e ka bërë për të na mëshiruar dhe nderuar. Ai e përsërit shpalljen e kësaj dispozite, për të treguar mirësinë e Tij dhe për t'i ftuar adhuruesit që të jenë mirënjohës dhe ta përkujtojnë Atë sa më shpesh, ashtu siç i ka mësuar dhe udhëzuar. Është Allahu i Lartësuar Ai që bëri të lejueshme çdo gjë të mirë, të këndshme, të pastër dhe të dobishme. Të gjitha mirësitë e kanë pikënisjen nga bujaria dhe mëshira e Tij.

- "Edhe ushqimet e ithtarëve të Librit janë të lejuara për ju, ashtu si ushqimet tuaja janë të lejuara për ta". - Kuptimi: Kafshët e therura nga çifutët dhe krishterët janë hallall për ju, o besimtarë muslimanë!

Por nuk kanë të njëjtin gjykim kafshët e therura nga kategoritë e tjera të qafirëve, veç dy grupeve të mësipërme. Kafshët e therura nga të tjerët nuk janë të lejueshme për ne. Arsyeja e këtij dallimi është se ithtarët e Librit pretendojnë se pasojnë profet dhe libra qiellorë. Të gjithë profetët, pa përjashtim, i kanë konsideruar haram kafshët e therura për hir të dikujt tjetër veç Zotit, sepse kjo vepër është idhujtari. Çifutët dhe të krishterët e pranojnë dhe e besojnë faktin që flijimet për hir të dikujt tjetër veç Zotit janë të ndaluara. Për këtë arsye, të therurat e tyre janë lejuar, ndërsa të therurat e të tjerëve janë të ndaluara.

Në ajet thuhet: "Edhe ushqimet e ithtarëve të Librit janë të lejuara për ju…". Me "ushqimet e ithtarëve të Librit" pa dyshim që është për qëllim: "të therurat e tyre", sepse për sa u përket ushqimeve të tjera, si farëra, fruta, perime etj., ato sigurisht që janë të lejuara, qofshin nga ithtarët e Librit, qofshin nga të tjerë.

Po ashtu, ushqimet e muslimanëve janë të lejuara për ta dhe lejohet që t'u japim atyre prej ushqimeve tona.

- "Edhe gratë e ndershme besimtare dhe të ndershmet nga ata të cilëve u është dhënë Libri para jush…" - Kuptimi: Ju është lejuar të martoheni me gratë e lira (jo skllave) dhe të ndershme besimtare muslimane dhe me gratë e lira dhe të ndershme prej atyre që iu

është dhënë Libër hyjnor më parë, domethënë, që janë hebreje ose të krishtera.

Në suren Bekare, Allahu i Lartësuar thotë: "Mos u martoni me idhujtare, derisa ato të besojnë", kurse në këtë ajet, Allahu i Lartësuar e kufizon gjykimin përjashtues të ajetit të sures Bekare, duke na lejuar që të martohemi me një kategori të caktuar idhujtaresh, që janë gratë e lira (jo skllave) dhe të ndershme hebreje ose të krishtera.

Nga ajeti kuptohet që martesa me një skllave hebreje ose të krishterë është e palejueshme për një burrë të lirë besimtar, sepse Allahu i Lartësuar, kur e ka lejuar martesën e një të liri me një skllave, ka thënë: "Ai i cili nuk ka mundësi materiale që të martohet me femra të lira besimtare, le të martohet me besimtaret që i keni nën pushtetin tuaj *(robëreshat)*...". Pra, Allahu i Lartësuar ka vendosur si kusht që skllavja të jetë besimtare muslimane. Përfundimisht, nuk lejohet martesa e një burri të lirë musliman me një skllave prej ithtarëve të Librit.

Ndërsa për sa i përket martesës së një besimtari të lirë me një besimtare muslimane skllave, kjo është e lejueshme nëse plotësohen dy kushte:

1. Burri nuk ka mundësi për t'u martuar me një grua të lirë, jo skllave.

2. Burri e ka nevojë të domosdoshme martesën dhe frikësohet seriozisht se do të bjerë në imoralitet.

Ndërsa me gra jo të ndershme, që janë të papërmbajtura dhe nuk ruhen nga imoraliteti, martesa është e palejueshme, pavarësisht në janë muslimane, të krishtera apo çifute, sepse Allahu i Lartësuar thotë: Laviri nuk martohet veçse me ndonjë lavire ose idhujtare. Me laviren nuk do martohet kush, veçse ndonjë lavir ose idhujtar. Ajo *(martesa me ta)* është e ndaluar për besimtarët. [El Nur 3.] Dhe thotë gjithashtu: "Të këqijat janë për të këqinjtë edhe të këqinjtë janë për të këqijat, ndërsa të ndershmet janë për të ndershmit edhe të ndershmit janë për të ndershmet..." [El Nur 26.]

- "...nëse atyre u jepni mehrin e caktuar....". - Përveç kushteve të mësipërme, Allahu i Lartësuar tregon edhe një kusht tjetër, që martesat tona të jenë të lejueshme dhe të drejta, dhe ky është mehri. Pra, nëse një burrë është i vendosur paraprakisht se nuk do t'ia japë mehrin gruas, ajo është e palejueshme ose jo hallall për të.

Kështu, Allahu i Lartësuar na urdhëron që gruas t'i japim mehrin e saj. Sigurisht, në rast se ajo është e përgjegjshme dhe e aftë për të vepruar drejt dhe me maturi me këtë pasuri; në të kundërt, mehri i jepet kujdestarit ligjor të saj.


Ajeti tregon qartë se mehri është i tëri pasuri e gruas. Askujt nuk i lejohet që të marrë diçka prej tij, veç nëse vetë gruaja e lejon me kënaqësi dhe me dëshirën e saj.

- "...por duke pasur për qëllim martesën, e jo imoralitetin dhe as si dashnore....". - Kuptimi: Me martesën tuaj të keni për qëllim të ruani veten tuaj dhe gruan prej imoralitetit.

Në kohën e injorancës paraislamike, imoraliteti ishte i shfaqur në dy forma. Disa bënin imoralitet me çfarëdolloj gruaje dhe quheshin *musafih*, ndërsa një lloj tjetër ishin ata që përzgjidhnin e mbanin dashnore të rregullta. Që të dyja këto forma Allahu i Lartësuar i ndaloi dhe na urdhëroi që të martohemi me gra të ndershme e të pastra, për të qenë mburojë të njëri-tjetrit kundër asaj sëmundjeje të rëndë, që shkatërron familjen dhe shoqërinë. Ky është pikërisht një nga synimet dhe urtësitë e ligjërimit të martesës. Besimtarët duhet të martohen me qëllimin që, nëpërmjet martesës, të arrihet ruajtja dhe ndërtimi i një shoqërie të dëlirë, të pastër dhe të shëndetshme.

- "E kush e braktis besimin, pa dyshim vepra e Tij është asgjësuar dhe ai në botën tjetër është prej të shkatërruarve". - Çdokush që e mohon Zotin e Madhëruar, ose mohon ndonjë prej kushteve të imanit si: besimin në shpalljet e Zotit, besimin te profetët etj., ose mohon ndonjë nga dispozitat e Allahut të Lartësuar, dhe nëse vdes në këtë gjendje, pra, si jobesimtar, atëherë të gjitha veprat e tij kanë për t'u asgjësuar, sikurse thotë Allahu i Lartësuar në suren Bekare, ajeti 217: "E kush zbrapset nga feja e tij dhe vdes si jobesimtar, atij i zhduken veprat në këtë jetë dhe në jetën tjetër. Të tillët janë banorë të Zjarrit dhe në të do të jenë përjetësisht." Në këtë mënyrë, në ahiret ai do të jetë prej të shkatërruarve dhe të dëshpëruarve, të cilët do të kenë humbur dhe shkatërruar vetet e tyre, pasuritë e tyre, madje dhe familjet e tyre, duke u zhytur në ndëshkimin e përjetshëm.

Ajeti 6


الجزء السادس سورة المائدة

يَٰٓأَيُّهَا ٱلَّذِينَ ءَامَنُوٓا۟ إِذَا قُمْتُمْ إِلَى ٱلصَّلَوٰةِ فَٱغْسِلُوا۟
وُجُوهَكُمْ وَأَيْدِيَكُمْ إِلَى ٱلْمَرَافِقِ وَٱمْسَحُوا۟ بِرُءُوسِكُمْ
وَأَرْجُلَكُمْ إِلَى ٱلْكَعْبَيْنِ ۚ وَإِن كُنتُمْ جُنُبًا فَٱطَّهَّرُوا۟ ۚ
وَإِن كُنتُم مَّرْضَىٰٓ أَوْ عَلَىٰ سَفَرٍ أَوْ جَآءَ أَحَدٌ مِّنكُم مِّنَ
ٱلْغَآئِطِ أَوْ لَٰمَسْتُمُ ٱلنِّسَآءَ فَلَمْ تَجِدُوا۟ مَآءً فَتَيَمَّمُوا۟ صَعِيدًا
طَيِّبًا فَٱمْسَحُوا۟ بِوُجُوهِكُمْ وَأَيْدِيكُم مِّنْهُ ۚ مَا يُرِيدُ ٱللَّهُ
لِيَجْعَلَ عَلَيْكُم مِّنْ حَرَجٍ وَلَٰكِن يُرِيدُ لِيُطَهِّرَكُمْ
وَلِيُتِمَّ نِعْمَتَهُۥ عَلَيْكُمْ لَعَلَّكُمْ تَشْكُرُونَ ٦
وَٱذْكُرُوا۟ نِعْمَةَ ٱللَّهِ عَلَيْكُمْ وَمِيثَٰقَهُ ٱلَّذِى وَاثَقَكُم
بِهِۦٓ إِذْ قُلْتُمْ سَمِعْنَا وَأَطَعْنَا ۖ وَٱتَّقُوا۟ ٱللَّهَ ۚ إِنَّ ٱللَّهَ عَلِيمٌۢ
بِذَاتِ ٱلصُّدُورِ ٧ يَٰٓأَيُّهَا ٱلَّذِينَ ءَامَنُوا۟ كُونُوا۟ قَوَّٰمِينَ
لِلَّهِ شُهَدَآءَ بِٱلْقِسْطِ ۖ وَلَا يَجْرِمَنَّكُمْ شَنَـَٔانُ قَوْمٍ عَلَىٰٓ
أَلَّا تَعْدِلُوا۟ ۚ ٱعْدِلُوا۟ هُوَ أَقْرَبُ لِلتَّقْوَىٰ ۖ وَٱتَّقُوا۟ ٱللَّهَ ۚ إِنَّ
ٱللَّهَ خَبِيرٌۢ بِمَا تَعْمَلُونَ ٨ وَعَدَ ٱللَّهُ ٱلَّذِينَ ءَامَنُوا۟
وَعَمِلُوا۟ ٱلصَّٰلِحَٰتِ لَهُم مَّغْفِرَةٌ وَأَجْرٌ عَظِيمٌ ٩

١٠٨

6. O ju që keni besuar! Kur të ngriheni për të falur namaz, lani fytyrën dhe duart tuaja deri te bërrylat, fërkoni kokën edhe këmbët deri te kaviljet. Nëse jeni xhunubë, atëherë lani të gjithë trupin. Në qoftë se jeni të sëmurë ose në ndonjë udhëtim, ose ndonjëri prej jush vjen prej vendit të nevojës, ose keni kontaktuar me gratë, dhe nuk gjeni ujë, atëherë merrni *tejemum* me dhè të pastër e, me të, fërkoni fytyrën dhe duart tuaja. Allahu nuk dëshiron t'ju sjellë ndonjë vështirësi, por dëshiron t'ju pastrojë, ta plotësojë mirësinë e Tij ndaj jush dhe që ju të bëheni mirënjohës.

Shpjegimi i ajetit

Ky është një ajet madhështor dhe përmbledh shumë dispozita. Le të përmendim disa prej tyre, me ndihmën dhe lehtësimin e Allahut të Lartësuar.

1. Zbatimi i porosive të këtij ajeti konsiderohet si punë që rrjedhon dhe nxitet nga imani. Pa zbatimin e tyre, imani nuk është i plotë. Kjo kuptohet nga fakti se Allahu i Lartësuar e nis këtë ajet duke na u drejtuar me cilësinë tonë të besimit, duke thënë: "O ju që keni besuar!". Pra, sikur i Lartësuari na thotë: "O ju që keni besuar, kryeni ato vepra që i dikton imani juaj dhe të cilat Ne i caktuam për ju".

2. Ajeti përmban një urdhër për t'u ngritur dhe për t'u përpjekur për një falje sa më të mirë të namazit. Kjo kuptohet nga thënia e Allahut: "Kur të ngriheni për të falur namaz...".

3. Ajeti përmban urdhër për të patur nijet të qartë para namazit. Fragmenti: "Kur të ngriheni për të falur namaz..." sikur thotë: "Kur të ngriheni me qëllimin për të falur namaz".

4. Pastërtia rituale është kusht i domosdoshëm për saktësinë e namazit. Një namaz i falur pa qenë i pastër ritualisht është i pasaktë dhe i papranueshëm, prandaj duhet patjetër të përsëritet. Allahu i Lartësuar na urdhëron që të pastrohemi ritualisht kur të vendosim dhe të bëhemi gati për të falur namaz, dhe dihet se urdhri tregon detyrim.

5. Pastrimi ritual nuk bëhet i detyrueshëm në momentin kur hyn koha e namazit, por në kohën kur ne vendosim dhe bëhemi gati për të falur namaz.

6. Pastërtia rituale është detyrë dhe kusht për saktësinë e çdo adhurimi që quhet "namaz", qoftë ai namaz farz, qoftë nafile apo namaz xhenazeje. Në të gjitha rastet, namazi nuk konsiderohet i saktë dhe i pranueshëm pa pastërtinë rituale. Madje, sipas shumë dijetarëve, edhe kryerja e sexhdes së falënderimit apo e sexhdes së *tilaue*-s (gjatë leximit të Kur'ânit) është e pasaktë dhe e palejueshme pa patur pastërtinë rituale, sepse edhe sexhdja mund të quhet namaz.

7. Larja e fytyrës është nga farzet e abdesit, sepse Allahu i Lartësuar na urdhëron për larjen e saj. Fytyra është pjesa e kokës që fillon, për së gjati, nga kufiri i flokëve të ballit e deri te nofulla e poshtme dhe mjekra, dhe nga veshi në veshin tjetër, për së gjeri.

8. Në urdhrin e Allahut të Lartësuar për larjen e fytyrës bën pjesë edhe larja e gojës dhe e hundës. Kjo kuptohet dhe përforcohet nga hadithet e Profetit (a.s.). [32]

9. Duhet kujdes që, nëse mjekra është e rrallë, uji të depërtojë dhe të lagë lëkurën poshtë saj. Por nëse mjekra është e dendur, mjafton vetëm larja me ujë e saj dhe, në këtë mënyrë, konsiderohet se e kemi kryer urdhrin për larjen e fytyrës, pasi "fytyrë" është pjesa e përparme e kokës me të cilën përballesh me të tjerët, dhe këtu hyjnë edhe qimet e fytyrës.

10. Larja e dy duarve deri te bërrylat është prej farzeve të abdesit, sepse Allahu i Lartësuar na ka urdhëruar për larjen e tyre. Duhet pasur kujdes që, së bashku me pjesën e bërrylit, të lahet edhe një pjesë e krahut, në mënyrë që të mos mbetet asnjë pjesë e bërrylit pa u larë, sepse thënia e Allahut të Lartësuar: "...deri te bërrylat...", sipas shumicës së *mufesirin*-ëve (komentuesve të Kur'ânit) do të thotë: "së bashku me bërrylat". Edhe praktikisht, larja e plotë e parakrahut mund të arrihet veçse me larjen e plotë të bërrylit.

11. Fshirja e kokës me duar të lagura është nga farzet e abdesit, sepse Allahu i Lartësuar na ka urdhëruar për këtë. Po ashtu, është detyrë që me duart të lagura të fshihet e gjithë koka dhe jo vetëm një pjesë e saj. Kjo dispozitë përftohet nga analiza gjuhësore e

---

[32] Imam Maliku, Shafiiu dhe Ebu Hanifja kanë qenë të mendimit se larja e gojës dhe e hundës është sunet. Ndërsa dijetarë të tjerë janë të mendimit se kjo është detyrë, ashtu sikurse larja e fytyrës, për arsyet e mëposhtme:

- Së pari, Allahu i Lartësuar ka urdhëruar për larjen e fytyrës, por është transmetuar saktësisht vazhdimësia e Profetit (a.s.) në pastrimin e gojës dhe hundës në të gjitha rastet e marjes së abdesit. Këtë veprim e ka dëshmuar çdo përcjellës i mënyrës së abdesit të Profetit (a.s.).

- Së dyti, është transmetuar saktësisht se Profeti (a.s.) ka urdhëruar e ka thënë: "Nëse dikush prej jush merr abdes, le të fusë ujë në hundë, pastaj le ta nxjerrë atë (duke pastruar kështu hundën)." (Shih "*Sahihul Xhamiu*", nr. 443).

- Së treti, Profeti (a.s.) ka thënë: "Bëje sa më të thellë futjen e ujit në hundë, vetëm nëse je agjërueshëm".

- Së katërti, Profeti (a.s.) ka thënë gjithashtu: "Kur të marrësh abdes, bëj gargarë." (Shih '*Sahih Ebu Daud*' 129, 131).

fragmentit: "...fërkoni kokën...", që do të thotë: "fërkoni të gjithë kokën".

12. Fshirja e kokës mund të bëhet me një dorë të vetme, me të dyja duart, me një copë të lagur, me një send të lagur apo me çfarëdo mënyre dhe mjeti qoftë, sepse Allahu i Lartësuar nuk e ka përcaktuar se me çfarë mjeti e mënyre duhet të fshihet koka. Pra, mjafton që ajo "të fshihet" me ujë.

13. E detyrueshme është fshirja e kokës me ujë dhe jo larja e saj. Me fjalë të tjera, nëse dikush e lan kokën dhe nuk e fshin atë me dorë të lagur, abdesi i tij është i pasaktë, sepse ai nuk e ka kryer urdhrin e Allahut për fshirjen e kokës.

14. Larja e këmbëve deri te kaviljet është prej farzeve të abdesit, sepse Allahu i Lartësuar na ka urdhëruar për këtë gjë. Edhe këtu thuhet e njëjta si për larjen e duarve deri te bërrylat. Pra, duhet të kujdesemi që nyjet e këmbës të lahen tërësisht e, bashkë me to, edhe një pjesë e vogël e kërcirit. Vetëm kështu mund të jemi të sigurt se ato janë larë tërësisht.

15. Vëreni me kujdes ajetin! Në të thuhet: "...lani fytyrën dhe duart tuaja deri te bërrylat, fërkoni kokën, edhe këmbët deri te kaviljet". Pyetja që shtrohet është: Fragmenti: "edhe këmbët deri te kaviljet", a është i lidhur me pjesën: "fërkoni kokën", apo me pjesën: "lani fytyrën dhe duart tuaja deri te bërrylat"? Ky ajet është lexuar në dy mënyra:

a) Shumica e lexuesve të Kur'ânit e lexojnë këtë ajet në mënyrë të tillë që fragmenti: "…edhe këmbët deri te kaviljet", të lidhet me pjesën: "lani fytyrën dhe duart tuaja deri te bërrylat". Pra, ky është një urdhër për t'i larë edhe këmbët deri te nyjet. Me fjalë të tjera, kuptimi është: "...edhe këmbët lajini deri te nyjet".

b) Disa e lexojnë këtë ajet në mënyrë të tillë që fragmenti: "…edhe këmbët deri te kaviljet" të kuptohet si i lidhur me pjesën: "fërkoni kokën". Pra, në njëfarë mënyre, këtu kuptohet se edhe këmbët mund të fshihen me duar të lagura.

Megjithatë, po të shohim traditën e Profetit (a.s.) në dhënien *mes'h* të këmbëve, ai e ka bërë këtë kur i ka pasur këmbët të veshura dhe asnjëherë nuk i ka fshirë kur ka qenë zbathur. Nëse këmbët janë zbathur, është e detyrueshme larja e tyre, sikurse tregon ajeti kur'ânor dhe Tradita e Profetit (s.a.u.s.).

16. Urdhri për larjen e këmbëve hedh poshtë mendimin e gabuar të *rafidi*-ve (ose *shiit*-ëve) të cilët nuk i lajnë këmbët gjatë abdesit, por thjesht i fshijnë ato me duar të lagura. Kjo, sigurisht, është e gabuar dhe në kundështim me porositë e Zotit dhe të Profetit (a.s.). Është e vërtetë që këmbëve mund t'u jepet *mes'h* me duar të lagura, por kjo bëhet vetëm kur këmbët janë të veshura, me kushtet e përcaktuara qartë nga Profeti (s.a.u.s.). Dihet mirë se Profeti (a.s.) ka qenë dhe mbetet kuptuesi, sqaruesi dhe zbatuesi më i mirë i porosive të Kur'ânit.

17. Duke qenë se Allahu i Lartësuar i ka përmendur elementët e abdesit me një radhë të caktuar, kjo tregon se edhe radha e kryerjes së këtyre veprimeve konsiderohet si kusht i saktësisë së abdesit. Nëse shohim me kujdes ajetin, Allahu i Lartësuar, mes gjymtyrëve që duhet të lahen, ka ndërfutur një gjymtyrë e cila fshihet me duar të lagura, duke thënë: "...lani fytyrën dhe duart tuaja deri te bërrylat, fërkoni kokën edhe këmbët deri te kaviljet.". Qëllimi i kësaj ndërfutjeje është pikërisht ruajtja e renditjes.

18. Radhitja e cila është kusht për saktësinë e abdesit është ajo e veprimeve me katër gjymtyrët e përmendura në ajet, dhe jo e

veprimeve të tjera të abdesit. Kështu, për shembull, radha mes larjes së gojës, hundës dhe fytyrës, mes larjes së të djathtës dhe të majtës të duarve dhe të këmbëve etj., nuk janë të detyrueshme, por të pëlqyeshme. Kësisoj, është e pëlqyeshme që të lahet goja dhe hunda para larjes së fytyrës, të lahet e djathta prej duarve dhe këmbëve para të majtës, të fshihet me duar të lagura koka para fshirjes së veshëve.

19. Ajeti na urdhëron që të rinovojmë abdesin për çdo namaz.

20. Ajeti na urdhëron që për xhunubimin duhet të lahet i gjithë trupi (*gusl*). Gjatë këtij *gusl*-i, flokët duhet të njomen tërësisht, derisa uji të depërtojë në lëkurë, dhe kjo është e detyrueshme.

21. Mungesa e abdesit ndërfutet në papastërtinë e madhe, pra, te xhunubimi. Me fjalë të tjera, nëse pastrohemi për të larguar papastërtinë e madhe, xhunubimin, ne konsiderohemi se jemi pastruar edhe prej papastërtisë së vogël, pra, prej mungesës së abdesit, nëse kemi bërë nijet edhe këtë të fundit së bashku me nijetin për *gusl*, sepse Allahu i Lartësuar ka thënë thjesht "...lani të gjithë trupin...", dhe nuk ka thënë që pas guslit duhet të marrim abdes.

22. '*Xhunub*' quhet çdokush që ka ejakuluar në gjumë apo me vetëdije, si dhe çdokush që ka kryer marrëdhënie intime, edhe nëse nuk ka ejakuluar. Ai që shikon ndonjë ëndërr sikur kryen marrëdhënie, por nuk sheh lagështi dhe shenjë në rrobat e tij, ai nuk e ka detyrë guslin, sepse nuk është bërë xhunub.

23. Në ligjin lehtësues për tejemumin shfaqet bamirësia dhe përkujdesja e madhe e Allahut të Lartësuar për adhuruesit e Tij.

24. Ndër shkaqet që e bëjnë të lejueshëm tejemumin janë sëmundjet e tilla që, nëse lahesh me ujë, ato rëndohen më tepër.

25. Faktor që e bën të lejueshëm tejemumin është edhe të qenurit në udhëtim dhe mosgjetja e ujit kur kryen nevojat fiziologjike. Megjithatë, kur je i sëmurë, tejemumi lejohet edhe nëse gjendet ujë, për shkak të dëmit që shkakton përdorimi i ujit. Ndërsa për rastet e tjera, tejemumi lejohet vetëm kur nuk gjendet ujë, pavarësisht në je udhëtar apo jo.

26. Çdo gjë që del nga dy rrugët e jashtëqitjes, urinë apo nevojë, e prish abdesin.

27. Në këtë ajet mbështeten ata që janë të mendimit se abdesi prishet veçse prej daljeve që bëhen nga dy rrugët e jashtëqitjes. Pra, sipas këtyre, abdesin nuk e prish as prekja e organit me dorë e as ndonjë shkak tjetër.

28. Nga ajeti kuptojmë se është e pëlqyeshme që t'i përzgjedhim fjalët që nxjerrim nga goja dhe të ruhemi nga fjalët e pista. Në vend të tyre, kur është e nevojshme, le të përmendim sinonime ose forma të tjera më të buta, sikurse thuhet në ajet: "…nëse ndonjëri prej jush vjen prej '*el gait*'". '*El gait*', ose 'ultësira', është vendi ku kryhen nevojat personale.

29. Prekja e femrës me epsh e prish abdesin.

30. Për lejueshmërinë e abdesit është kusht mosgjetja e ujit (ose pamundësia e përdorimit të tij). Për këtë arsye, nëse gjendet uji, atëherë tejemumi i prishet edhe atij që është ndërkohë në namaz, pasi Allahu i Lartësuar e ka lejuar tejemumin vetëm kur mungon uji.

31. Pasi hyn koha e namazit, është detyrë për njeriun që të kërkojë ujë rreth e rrotull tij, sepse nëse nuk kërkon, atëherë nuk mund të thuhet për të që "nuk ka mundur të gjejë ujë".

32. Para kryerjes së tejemumit, është e detyrueshme të jetë nijeti, sepse Allahu i Lartësuar thotë: "*fe tejem-memu*", që do të thotë ta kesh qëllim kryerjen e tij.

33. Allahu i Lartësuar thotë: "…merrni *tejemum* me dhè të pastër e, me të, fërkoni fytyrën dhe duart tuaja". Nga ajeti kuptohet që fytyrat dhe duart duhet të fshihen me një pjesë nga dheu, dhe kjo ndodh atëherë kur dheu ka pluhur. Mund të themi se ka dy arsye që ajeti vjen në këtë formë: ose që të tregohet se dheu është zakonisht me pluhur, ose që të kuptohet se është më e mirë dhe më e saktë nëse përdoret dhè i pluhurosur. Megjithatë, kjo nuk do të thotë që tejemumi mund të kryhet veçse me këtë lloj dheu, pasi tejemumi është i saktë dhe i plotë me çfarëdo lloj dheu që gjendet në sipërfaqen e tokës.

34. Tejemumi me dhè të pisët është i papranueshëm dhe i pasaktë, sepse Allahu i Lartësuar thotë: "*saiden taiben*" – "dhè i pastër" .

35. Gjatë tejemumit fshihen vetëm fytyra dhe dy duart, jo gjymtyrët e tjera të abdesit.

36. Togu: "fërkoni fytyrën" na tregon se është detyrë që, gjatë tejemumit, të fshihet gjithë fytyra. Megjithatë, dheu nuk futet në gojë e në hundë ose në thellësi të mjekrës, edhe nëse kjo e fundit është e rrallë, ashtu sikurse veprohet me abdesin.

37. Dy duart fërkohen deri tek kyçet, jo më shumë, sepse fjala 'dorë' nënkupton pëllëmbët deri te kyçet. Nëse do të futeshin edhe llërët, Allahu i Lartësuar do ta përcaktonte atë, sikurse ka thënë për abdesin: "...lajini duart tuaja deri tek llërët...".

38. Ajeti është gjithëpërfshirës dhe tregon se tejemumi është zëvendësues i plotë si pastrues nga të gjitha llojet e papastërtive rituale (*ahdâth*). Pra, tejemumi vlen si pastrues si në rastin e gjendjes xhunub, ashtu edhe në rastin e mungesës së abdesit. Madje, mund të themi se ajeti tregon se tejemumi vlen si pastrues edhe për rastin e largimit të papastërtive fizike (*nexhaset*), [33] sepse Allahu i Lartësuar e ka bërë tejemumin si zëvendësues të plotë të ujit dhe funksioneve të tij, pa e kufizuar atë në një funksion të caktuar. Dikush mund të thotë se konteksti i ajetit tregon se tejemumi nuk përdoret për largimin e papastërtive fizike, sepse ai flet për papastërtitë rituale dhe largimin e tyre dhe jo për papastërtitë fizike dhe pastrimin prej tyre. Ky, madje, është mendimi i shumicës së dijetarëve. Qoftë për rastin e mungesës së guslit, qoftë për mungesën e abdesit, tejemumi merret njëlloj: duke fërkuar vetëm fytyrën dhe dy duart me dhè të pastër.

39. Nëse dikush, të cilit i mungon edhe gusli, edhe abdesi, bën nijet që të marrë *tejemum* për largimin e të dyja llojeve të papastërtive, kjo është e mjaftueshme dhe e plotë; pra, nuk ka nevojë që të marrë tejemum për secilin lloj papastërtie më vete. Ky gjykim përftohet nga fakti se Allahu i Lartësuar, sikurse e thamë më lart, e ka bërë tejemumin si zëvendësues të plotë të ujit, qoftë për mungesën e guslit, qoftë për mungesën e abdesit. Përveç kësaj, Allahu i Lartësuar nuk ka urdhëruar shprehimisht që të merret tejemum më vete për secilin lloj pastrimi. Në ajet thuhet: "Në qoftë se jeni të sëmurë ose në ndonjë udhëtim, ose ndonjëri prej jush vjen prej vendit të nevojës, ose keni

[33] Papastërtitë janë dy llojesh: "*ahadâth*" - papastërti rituale, si mungesa e guslit dhe mungesa e abdesit; dhe "*nexhâset*" - papastërti fizike, si urina, nevoja etj. Sipas autorit, ajeti tregon se *tejemum*-i mund të shfrytëzohet si pastrues dhe zëvendësues i ujit qoftë për largimin e *ahadâth*-it, qoftë për largimin e *nexhaset*-it.

kontaktuar me gratë, dhe nuk gjeni ujë, atëherë merrni *tejemum* me dhè të pastër e, me të, fërkoni fytyrën dhe duart tuaja."

40. Mjafton që fytyra dhe duart të fshihen me dhè të pastër, me çfarëdo mjeti të kryhet kjo fshirje, me dorë, leckë etj., sepse Allahu i Lartësuar ka urdhëruar që ta fshijmë fytyrën e duart me dhè, por nuk e ka përcaktuar se me çfarë të bëhet kjo fshirje. Kësisoj, kjo tregon se ajo mund të bëhet me gjithçka.

41. Kryerja me radhë e veprimeve të tejemumit është kusht i saktësisë së tij. Pra, në fillim kryhet fshirja e fytyrës, pastaj fshirja e duarve. Kjo është radha e treguar në ajet.

42. Në ajet del qartë mirësia dhe mëshira e madhe e Allahut të Lartësuar mbi këtë umet të begatshëm, sepse në fenë Islame nuk ka kurrfarë vështirësie dhe ngushtimi. Allahu i Lartësuar ka ligjëruar lehtësime dhe rrugëzgjidhje të shumta për çdo situatë të vështirë. Me këto ligje të mrekullueshme, Ai dëshiron që të na pastrojë dhe të plotësojë mirësinë e Tij mbi ne.

43. Pastrimi i jashtëm i trupit me ujë ose me tejemum është vazhdimësi dhe plotësim i pastërtisë së brendshme të shpirtit me teuhid dhe pendim të sinqertë nga çdo gjynah dhe mosbindje ndaj Allahut të Madhëruar.

44. Edhe pse nuk kryen pastrim të dukshëm, që të mund të vërehet nga ana e jashtme, tejemumi është një pastrim simbolik dhe figurativ, që buron nga bindja e plotë ndaj urdhrit të Allahut të Lartësuar.

45. Robi duhet të meditojë thellë dhe gjatë mbi ligjet e vendosura nga Zoti dhe urtësitë e tyre, qoftë në çështjet e pastrimit, qoftë në çështjet e tjera, sepse në këtë mënyrë shton diturinë e tij, por do të shtojë gjithashtu mirënjohjen dhe lavdërimin për Allahun e Madhëruar. Kështu, ai do ta dojë më shumë Allahun e Madhëruar, që, nëpërmjet këtyre ligjeve, i ngre robërit në grada të larta.

Ajeti 7

7. Përkujtoni mirësitë e Allahut ndaj jush dhe zotimin ndaj Tij, të cilin Ai e mori prej jush, kur thatë: "Dëgjuam e respektuam!". Frikësojuni Allahut! Me të vërtetë, Allahu është i Gjithëdijshëm për atë që fshihet në kraharorë.

Shpjegimi i ajetit

- **"Përkujtojni mirësitë e Allahut ndaj jush dhe zotimin ndaj Tij, të cilin Ai e mori prej jush, kur thatë: "Dëgjuam e respektuam!"."**

- Allahu i Lartësuar i urdhëron adhuruesit e Tij, që të përkujtojnë mirësitë që Ai u ka dhuruar, si mirësitë fetare, ashtu edhe mirësitë e kësaj dynjaje. Ata duhet t'i përkujtojnë këto mirësi me gojë dhe me zemër, sepse përkujtimi i vazhdueshëm i tyre kultivon mirënjohjen për Allahun e Madhëruar dhe dashurinë për Të. Në këtë mënyrë, zemra mbushet me bamirësi dhe pastrohet nga cilësi të ulëta, si vetëkënaqësia, mburrja a mendjemadhësia. Përkujtuesi i mirësive është mirënjohës për to dhe falënderon Dhuruesin. Rrjedhimisht, kjo sjell jo vetëm ruajtjen e mirësive të Allahut, por edhe shtimin e tyre.

Allahu i Lartësuar i urdhëron adhuruesit e Tij që të përkujtojnë, gjithashtu, edhe "zotimin ndaj Tij". Nga ajeti kuptohet se njerëzit janë zotuar shprehimisht, me fjalë, se do ta mbajnë besën që i kanë dhënë Allahut, se do të binden dhe të jenë të nënshtruar.

- **"Dëgjuam e respektuam"** – Kuptimi: E dëgjuam qartë mesazhin nëpërmjet ajeteve të Kur'ânit dhe shenjave të Tua, në gjithësinë që Ti ke krijuar. E dëgjuam mesazhin, e kuptuam qartë dhe iu bindëm atij me sinqeritet. U bindëm plotësisht dhe do t'i respektojmë ndalesat dhe kufijtë e Tua.

Pra, këtu flitet për të gjitha dispozitat e fesë dhe të besimit, të dukshme dhe të fshehura. Kjo do të thotë që besimtarët e kujtojnë vazhdimisht premtimin ndaj Zotit dhe përpiqen pandërprerë për ta zbatuar atë.

- "Frikësojuni Allahut! Me të vërtetë, Allahu është i Gjithëdijshëm për atë që fshihet në kraharorë." - Frikësojuni Allahut të Madhëruar në çdo gjendje qofshi, duke zbatuar urdhrat e Tij dhe duke ruajtur kufijtë e vendosur prej Tij. Të jeni të sigurt se Allahu i Madhëruar është i gjithëdijshëm për gjithçka që fshihet në gjoksin tuaj dhe për çdo mendim që kalon në zemrën tuaj. Ruajuni që Ai të mos vështrojë në zemrat tuaja ndonjë gjë që nuk e do dhe nuk është i kënaqur. Kujdesuni që prej jush të mos burojë asgjë që Zoti e urren. Mbushini zemrat tuaja vetëm me dituri të thellë rreth Zotit tuaj, me dashuri për Të dhe me dëshirën e mirë për të qenë të dobishëm për njerëzinë. Nëse do të veproni në këtë mënyrë, Ai do t'jua falë dhe mbulojë të këqijat, do t'jua shumëfishojë të mirat dhe shpërblimet, sepse ato vepra tregojnë për mirësinë që ndodhet në zemrat tuaja.

Ajeti 8

8. O ju që keni besuar! Bëhuni plotësisht të vendosur për hir të Allahut, duke dëshmuar të drejtën! Të mos ju shtyjë urrejtja ndaj një populli e t'i shmangeni drejtësisë. Bëhuni të drejtë, sepse kjo është më afër devotshmërisë. Kini frikë Allahun, se Allahu e di me hollësi se çfarë veproni.

Shpjegimi i ajetit


- "O ju që keni besuar!" - Allahu i Madhëruar u drejtohet me këto fjalë atyre që kanë besuar. Por çfarë besojnë dhe si besojnë? Ata besojnë atë që Zoti i ka urdhëruar të besojnë, me mënyrën që Ai e ka caktuar. Ky është besimi i saktë dhe i pranueshëm. Ky besim kërkon që të zbatosh gjithçka që të dikton ai.

Ndër veprat e diktuara nga imani është edhe dëshmia e drejtë për hir të Zotit:

- "Bëhuni plotësisht të vendosur për hir të Allahut, duke dëshmuar të drejtën!" - Kuptimi: Të gjitha forcat tuaja të brendshme dhe të jashtme të jenë të përkushtuara për çdo vepër që dikton imani i drejtë dhe i urdhëruar nga Zoti. Dëshmoni me drejtësi dhe çdo punë që kryeni le të jetë për hir të Allahut të Lartësuar dhe vetëm për hir të Tij, jo për hir të ndonjë interesi të kësaj dynjaje. Synimi juaj le të jetë vendosja dhe arritja e drejtësisë. Mos i kaloni kufijtë duke e tepruar apo duke shpërfillur të drejtat e të tjerëve. Mbani drejtësinë dhe jini me të drejtën në çdo rast, me të afërmit e me të largëtit, me miqtë e me armiqtë.

- "Të mos ju shtyjë urrejtja ndaj një populli e t'i shmangeni drejtësisë." - Urrejtja ndaj dikujt nuk duhet të bëhet shtysë për t'ju larguar drejtësisë, sikurse veprojnë ata që nuk pyesin për drejtësi. Ashtu sikurse dëshmoni në favor të miqve tuaj, ashtu dëshmoni edhe kundër tyre, nëse këtë e kërkon drejtësia. Ashtu sikurse dëshmoni kundër armiqve tuaj për të vendosur drejtësinë, ashtu dëshmoni edhe në favor të tyre, nëse kështu është drejtësia, edhe nëse janë jobesimtarë apo bidatçinj. Është detyrë, gjithashtu, që të pranosh çdo fjalë dhe dëshmi të drejtë të sjellë prej tyre. E vërteta dhe e drejta pranohen sepse janë të tilla, e jo sepse thuhen nga ky apo ai. E drejta nuk refuzohet sepse e ka thënë një i padrejtë, pasi kjo do të ishte padrejtësi ndaj të vërtetës. Përfundimisht, shmangia nga drejtësia është gjithmonë e palejueshme.

- "Bëhuni të drejtë, sepse kjo është më afër devotshmërisë." -Kuptimi: Sa më shumë të përkujdeseni për drejtësinë, aq më tepër do të forcohet devotshmëria në zemrat tuaja.



Nëse plotësohet drejtësia, është plotësuar devotshmëria.

- "Kini frikë Allahun, se Allahu di me hollësi se çfarë veproni." - Ky është përsëri një urdhër për të plotësuar devotshmërinë, duke kryer urdhëresat dhe duke ruajtur kufijtë e vendosur nga Allahu i Madhëruar. Të përpiqemi të plotësojmë devotshmërinë duke kujtuar një fakt të rëndësishëm: "Allahu di me hollësi se çfarë veproni." Allahu ka për të shpërblyer çdonjë për veprat e tij, të mira apo të këqija, të vogla a të mëdha qofshin. Shpërblimi dhe shpagimi i tij do të realizohet në këtë jetë dhe në jetën e pafundme të ahiretit.

Ajetet 9 – 10

9. Atyre që kanë besuar dhe bëjnë vepra të mira, Allahu u premton falje mëkatesh dhe shpërblim të madh.
10. Ndërsa ata që mohojnë argumentet Tona, ata do jenë banorë të Zjarrit.

Shpjegimi i ajeteve

Allahu i Madhëruar, i Cili është i Vërtetë në fjalët e Tij dhe kurrë nuk e thyen premtimin, u bën një premtim të mrekullueshëm atyre që e besojnë Atë, shpalljet e Tij, profetët e Tij dhe Ditën e Llogarisë, që kryejnë vepra të mira, të detyrueshme apo të pëlqyeshme. Ai u premton, së pari, mbulim të gjynaheve, falje të tyre dhe shpëtim nga ndëshkimi që vjen si pasojë e gjynaheve dhe, së dyti, shpërblim të madh dhe bujar, madhështinë e të cilit e di veçse Allahu i Madhëruar, sikurse thotë në Kur'ân: "Askush nuk di për atë kënaqësi që u është caktuar atyre si shpërblim për atë që kanë bërë." [Sexhde 17].

Ndërsa vendi i atyre që i konsiderojnë si gënjeshtra argumentet dhe shpalljet e Allahut të Madhëruar dhe që i mohojnë ato, pasi i kanë kuptuar qartësisht, do të jetë Zjarri. Ata do të jenë banorë të Xhehenemit dhe kurrë nuk do të shpëtojnë prej tij.

Ajeti 11

11. O ju që keni besuar! Përkujtojeni mirësinë e Allahut ndaj jush, kur një popull tentoi të zgjaste duart kundër jush, kurse Ai i sprapsi duart e tyre prej jush. Frikësojuni Allahut dhe vetëm Allahut le t'i mbështeten besimtarët.

Shpjegimi i ajetit

- "O ju që keni besuar! Përkujtojeni mirësinë e Allahut ndaj jush, kur një popull tentoi të zgjaste duart kundër jush, kurse Ai i sprapsi duart e tyre prej jush." - Allahu i Madhëruar u përkujton adhuruesve të Tij besimtarë mirësitë e mëdha me të cilat i ka begatuar dhe i nxit ata që t'i përkujtojnë shpesh ato, me zemër dhe me gojë. Ashtu sikurse fitorja mbi armiqtë është një mirësi e dhuruar prej Zotit, ashtu edhe mbrojtja ndaj qafirëve dhe kthimi i kurtheve kundër tyre duhet parë si mirësi prej Tij.

Armiqtë e Zotit planifikojnë vazhdimisht sulme dhe kurthe kundër besimtarëve dhe përpiqen shumë që t'ia arrijnë qëllimit, prandaj nëse ata nuk ia arrijnë dot qëllimit, kjo është një mirësi nga Allahu i Madhëruesheëm, mirësi që na kërkon të jemi mirënjohës. Ai e meriton që të adhurohet, të falënderohet dhe ta përkujtosh vazhdimisht për këto mirësi. Këtu bëhet fjalë për çdo rrezik që u kanoset besimtarëve, nga qafirët, munafikët apo agresorët e çdo lloji. Pra, sa herë ke shpëtuar nga një e keqe, kjo është një mirësi prej Allahu, për të cilën Ai duhet falënderuar e përkujtuar.

Më pas, Allahu i Lartësuar i urdhëron besimtarët për diçka, nëpërmjet së cilës do të mbrohen kundër jobesimtarëve dhe çdo lloj armiku tjetër. Ai i mëson ata si të arrijnë fitoren dhe suksesin në çdo punë dhe çështje:

- "Frikësojuni Allahut dhe vetëm Allahut le t'i mbështeten besimtarët." – Këto janë dy kështilla:

1. Devotshmëri ndaj Allahut, duke plotësuar urdhëresat dhe duke iu larguar harameve, në shenjë madhërimi dhe dashurie për Të.

2. Mbështetje e plotë tek Allahu i Madhëruar.

Vetëm tek Allahu i Lartësuar duhet të mbështeten dhe kërkojnë ndihmë besimtarët, për arritjen e çdo të mire të fesë, të besimit apo të dynjasë. Ata duhet të mbështeten totalisht tek Ai, duke u distancuar nga fuqitë e tyre. Njëkohësisht, ata duhet të kenë besim të plotë dhe të patundur tek Allahu i Lartësuar për arritjen e gjithçkaje që e duan dhe e synojnë.

Mbështetja e robit te Zoti është në varësi të imanit të tij. Ajo është një nga punët e domosdoshme të zemrës, është detyrë e besimtarit dhe tregues i besimit të tij.

Ajetet 12 – 13

12. Me të vërtetë, Allahu mori zotimin e bijve të Izraelit, duke caktuar dymbëdhjetë prijës nga mesi i tyre. Allahu tha: "Unë jam me ju! Në qoftë se falni namazin, jepni zekatin, u besoni të dërguarve të Mi, i ndihmoni e respektoni ata, si dhe shpenzoni për hir të Allahut hua të mirë, pa dyshim që Unë do t'jua fal të këqijat tuaja dhe do t'ju fus në kopshte, nëpër të cilët rrjedhin lumenj. Çdokush prej jush që kundërshton pas kësaj, e ka humbur rrugën e drejtë".

13. Për shkak se ata e thyen zotimin e dhënë, Ne i mallkuam dhe zemrat e tyre i bëmë të ashpra. Ata i ndryshuan fjalët *(në Teurat)* nga domethënia e tyre dhe e braktisën një pjesë të asaj Mirësie, me të cilën u ngarkuan. Ti vazhdimisht do të vëresh tradhtinë e një pjese të tyre, përveç një pakice nga ata. Fali ata dhe, me butësi, tolero! Allahu i do ata që bëjnë mirë.

Shpjegimi i ajeteve

Allahu i Lartësuar na njofton se Ai ka marrë prej bijve të Izraelit një premtim të përforcuar me shumë betime. Ai e përshkruan këtë premtim dhe tregon shpërblimin që ata do të kishin, nëse do t'i përmbaheshin atij. Allahu i Lartësuar bën të ditur, gjithashtu, edhe ndëshkimin për shpërfilljen e atij betimi. Më pas, Ai tregon se si ata nuk iu përmbajtën zotimit të tyre dhe se si ata u ndëshkuan për këtë gjë.

Kështu, i Lartësuari thotë:

- "Me të vërtetë, Allahu mori zotimin e bijve të Izraelit, duke caktuar dymbëdhjetë prijës nga mesi i tyre." - Ai mori prej tyre një premtim të rëndësishëm, të përforcuar me betime. Prej tyre, Allahu i Lartësuar përcaktoi 12 prijës, si përfaqësues të popullit të tyre dhe si përcjellës të urdhrave të Tij. Domethënë, ata do të ishin ftuesit në rrugën e Zotit.

- "Allahu tha: "Unë jam me ju!" - Allahu i Madhëruar iu drejtohet prijësve, që aq shumë hoqën dhe u përpoqën me fiset e tyre, me qëllimin e detyrën për t'i bindur ata. Ai u thotë: Unë jam me ju, duke ju

ndihmuar dhe duke ju dhënë sukses. Ndihma do t'ju jepet sipas përpjekjeve dhe mundit të shpenzuar.

Më pas, Allahu i Madhëruar tregon veprat që ata do të zotoheshin se do të kryenin:

- "Në qoftë se falni namazin, jepni zekatin, u besoni të dërguarve të Mi, i ndihmoni e respektoni ata, si dhe shpenzoni për hir të Allahut hua të mirë..." - Ajo që kërkohej ishte:

1. Të falnin namazin pra e përkryeni atë, duke kryer të gjitha veprat e tij të dukshme dhe të fshehura, të detyrueshme dhe të pëlqyeshme dhe vazhdimësia në këtë.

2. Të jepnin zekatin atyre që e meritojnë të përfitojnë nga zekati.

3. T'i besonin profetët dhe t'i ndihmonin e respektonin ata. Kjo do të thotë që t'i besonin të gjithë profetët e dërguar nga Allahu dhe, mes tyre, pa dyshim, të besonin më të mirin e profetëve dhe vulën e tyre, Muhamedin (a.s.). Përveç kësaj, duhet t'i respektonin dhe trajtonin ata si të mëdhenjtë e tyre, duke ua dëgjuar dhe zbatuar porositë.

Kështu, Allahu i Madhëruar na urdhëron për bamirësi, që është fryt i sinqeritetit në marrëdhëniet me Të dhe rezultat i një jete të rregullt e fitimi të ndershëm.

Nëse ata i kryejnë të gjitha këto që u kërkon Allahu i Madhëruar, atëherë kanë premtimin e mrekullueshëm, se:

- "...pa dyshim që Unë do t'jua fal të këqijat tuaja dhe do t'ju fus në kopshte, nëpër të cilët rrjedhin lumenj." – Kështu, Allahu i Madhëruar u premton atyre dy mirësi:

1. futjen në Xhenet, për të shijuar të gjitha mirësitë e Tij;

2. largimin e çdo të keqeje, duke ua falur gjynahet. Falja e gjynaheve largon çdo fatkeqësi dhe ndëshkimin që shkaktohet prej tyre.

- "Çdokush prej jush që kundërshton pas kësaj, e ka humbur rrugën e drejtë". - Pas atij premtimi të përforcuar me betime dhe pas gjithë atyre shpërblimeve të premtuara dhe kërcënimeve për thyerjen e tij, ata që mohojnë dhe e shpërfillin atë, vërtet kanë humbur thellë. Ata e kanë braktisur rrugën e Zotit me vetëdije dhe dijeni të plotë, prandaj meritojnë atë që meritojnë të humburit. Ata do të jenë të privuar nga shpërblimi dhe do të vuajnë ndëshkimin.

Kjo ndoshta të nxit të thuash: "Oh, të mjerët! Çfarë bënë kështu?! Vallë, a e përmbushën premtimin ndaj Zotit, apo jo?" Por Allahu i Madhëruar deklaron se ata e thyen betimin:

- "Për shkak se ata e thyen zotimin e dhënë, Ne i mallkuam dhe zemrat e tyre i bëmë të ashpra." - Kuptimi: Për shkak të shkeljes së besës nga ana e tyre, Ne u dhamë disa ndëshkime, si më poshtë:

1. "..i mallkuam", ose: "i larguam nga mëshira Jonë". Ishin vetë ata që ia mbyllën vetes portën e mëshirës së Zotit. Ata nuk e plotësuan premtimin që i dhanë Zotit, dhe ky ishte shkaku më i madh i ndëshkimit të tyre të merituar.

2. "...dhe zemrat e tyre i bëmë të ashpra", ose të ngurta, të tilla që nuk u bëjnë dobi këshillat dhe qortimet. Atyre nuk u bëjnë dobi ajetet dhe shenjat kërcënuese nga Zoti. Ata nuk mallëngjehen për shpërblimet që Ai ka përgatitur për të bindurit dhe besimtarët. Në zemrat e tyre nuk ka shpresë dhe as frikë. Zbrazja e zemrës nga të tilla ndjenja është nga ndëshkimet më të mëdha që mund ta godasin robin. Një zemër e zbrazur nga dashuria e malli për Zotin, nga shpresa për takimin me Të dhe për shpërblimin e Tij, nuk përfiton aspak nga udhëzimi i dhënë nga Zoti e nga mirësia e dhuruar prej Tij. Kjo lloj zemre thith vetëm ligësi dhe trishtim.

- "Ata i ndryshuan fjalët *(në Teurat)* nga domethënia e tyre..." - Ata u sprovuan dhe

filluan të ndryshonin dhe tjetërsonin fjalët e Zotit, duke i zëvendësuar ato me fjalë të tjera. Gjithashtu, ata u jepnin fjalëve të Zotit dhe Profetit shpjegime dhe kuptime që Zoti dhe Profeti i Tij kurrë nuk i dëshironin.

- "...dhe e braktisën një pjesë të asaj Mirësie, që iu bë detyrim." - Allahu i Lartësuar i udhëzoi me mësimet e Teuratit, që ia shpalli Musait (a.s.), por ata i harruan dhe shpërfillën ato. Harresa e tyre ishte në dy drejtime:

1. Harresë në drejtim të diturisë. Ata e harruan diturinë e Librit të Zotit, aq sa ajo humbi prej tyre. Shumë nga dituria që iu humbi nuk u gjend më, si ndëshkim nga Allahu i Drejtë dhe i Madhëruar kundër tyre.

2. Harresë në drejtim të punës me dijen. Ata harruan dhe e lanë zbatimin e dijes që e kishin. Atyre nuk iu dha sukses që të përmbushnin urdhrat hyjnorë. Kështu, është plotësisht e drejtë që, kur ithtarët e Librit të mohojnë ndonjë gjë që e kanë të shkruar në librat e tyre, t'u thuhet: Kjo është një formë ndëshkimi që ju ka goditur.

- "Ti vazhdimisht do të vëresh tradhtinë e një pjese të tyre, përveç një pakice nga ata." - Ata u sprovuan dhe morën një ves shumë të ulët, që ishte tradhtia ose pabesia. Tradhtia e tyre ishte kundër Zotit, profetit dhe besimtarëve. Pabesia më e madhe e tyre ishte fshehja e së vërtetës nga ata që i respektonin e vlerësonin, duke i lënë kështu të humbur në kufrin e tyre. Kjo është, sigurisht, një tradhti ndaj amanetit dhe pabesi e pashoqe.


Këto ishin cilësitë e ulta të atyre të mjerëve dhe të të gjithë atyre që u përngjajnë. Çdokush që nuk zbaton urdhrat e Zotit dhe besën që ka dhënë, do të goditet patjetër nga dënimet e lartpërmendura, pra: do të mallkohet, do t'i ngurtësohet zemra dhe shpirti, do të bëhet prej atyre që shtrembërojnë fjalët e Zotit dhe nuk do t'i jepet sukses të gjejë të vërtetën. Ai, gjithashtu, do të harrojë detyrimet hyjnore dhe do të bëhet njeri i pabesë, që nuk e mban amanetin. E lus Allahun të na ruajë nga këto fatkeqësi!

Kur flet për Shpalljen që ata të mjerë e harruan, Allahu i Lartësuar përdor fjalën '*Haḏh*' – "mirësi, fat", duke thënë: "dhe e braktisën një pjesë të asaj Mirësie, me të cilën u ngarkuan". Pa dyshim, Shpallja e Zotit është mirësia më e madhe që mund t'i dhurohet një njeriu. Të kuptuarit e Shpalljes së Zotit dhe të punuarit me të është fati më i madh që mund të ketë një njeri. Çdo mirësi tjetër është prej mirësive të dynjasë, të cilat sigurisht që lypin mirënjohje, sikurse thotë i Lartësuari: "Ai *(Karuni)* doli para popullit të tij me pasurinë e vet. Ata që kishin synim jetën e kësaj bote thanë: "Ah, të kishim edhe ne ato që i janë dhënë Karunit! Vërtet, ai është fatbardhë!" Por ata të cilëve u ishte dhuruar dituri thanë: "Të mjerët ju! Shpërblimi i Allahut është shumë më i mirë për ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira. Por këtë nuk mund ta arrijë kush, përveç të durueshmëve!"" [Kasas 79, 80].

Ndërsa kur bëhet fjalë për mirësinë e madhe të besimit, i Madhëruari thotë: "Nuk është e barabartë e mira dhe e keqja. Ktheje *(të keqen)* me mënyrën më të mirë, se atëherë ai, me të cilin kishit njëfarë armiqësie, do të bëhet mik i afërt. Mirëpo këtë nuk mund ta arrijë kush, përveç atyre që janë të durueshëm; dhe nuk mund ta arrijë kush, përveç atyre që kanë fat *(ose mirësi)* të madh." [Fusilet 34, 35].

Më tej, Allahu i Lartësuar thotë: "... përveç një pakice nga ata..." – Pra, këta të përzgjedhur e mbajtën premtimin e dhënë Zotit, dhe Ai u dha sukses në rrugën e drejtë.

- "Fali ata dhe, me butësi, tolero! Allahu i do ata që bëjnë mirë." - Mos i ndëshko për veprat e tyre dhe për mundimin që të sjellin, por toleroji. Kjo është vërtet shenjë



bamirësie, dhe Allahu i Lartësuar i do bamirësit.

Bamirësia është një nivel i lartë adhurimi, kur robi e adhuron Allahun sikurse ta shihte Atë haptazi, sepse është i bindur që, edhe pse nuk e sheh, Allahu pa dyshim e sheh atë. Kjo është grada e bamirësisë në lidhje me adhurimet e përkushtuara ndaj Allahut të Madhëruar. Ndërsa në lidhje me krijesat, bamirësia ndaj tyre shprehet duke u përpjekur t'i ndihmosh ata në drejtim të fesë e besimit dhe në drejtim të dynjasë së tyre.

Ajeti 14

14. Ne morëm zotimin edhe të atyre që thanë: "Ne jemi *nesara*", por edhe ata e harruan një pjesë të udhëzimit, prandaj Ne kemi ndërsyer ndërmjet tyre armiqësi dhe urrejtje, deri në Ditën e Kijametit. Më pas, Allahu do t'ua shpalosë se çfarë kanë bërë.

Shpjegimi i ajetit

Ashtu si me jehudët, të cilët u zotuan për zbatimin e porosive të Zotit, ashtu ndodhi edhe me ata që u quajtën "*nesara*", pra, ndihmësit e Isait, të birit të Merjemes. Ata u zotuan të besonin profetin Isa dhe të pastronin shpirtrat e tyre nëpërmjet besimit tek Allahu dhe zbatimit të porosive të profetëve dhe shpalljeve hyjnore. Por edhe ata e thyen premtimin dhe harruan një pjesë të udhëzimit të Allahut. Ata harruan diturinë dhe zbatimin e saj. Për këtë shkak, Allahu i Lartësuar u futi armiqësi kundër njëri-tjetrit, prandaj mes tyre ka patur dhe do të ketë përçarje dhe luftë, deri në Ditën e Gjykimit. Ky është një fakt i dukshëm dhe i vërtetuar në realitet.

Ajetet 15 – 16

15. O ithtarë të Librit, juve ju ka ardhur i Dërguari Ynë, që ju sqaron shumë gjëra që ju keni fshehur prej Librit, e që për shumë të tjera, ai fal. Juve ju erdhi nga Allahu dritë dhe libër i qartë.

16. Allahu udhëzon nëpërmjet tij në rrugët e shpëtimit ata që kërkojnë kënaqësinë e Tij dhe i nxjerr ata prej errësirave në dritë, me ndihmën e Tij. Ai i udhëzon ata në një rrugë, që është e drejtë.

Shpjegimi i ajeteve

- **"O ithtarë të Librit, juve ju ka ardhur i Dërguari Ynë, që ju sqaron shumë gjëra që ju keni fshehur prej Librit..."** - Pasi tregoi për premtimet dhe besën e pambajtur nga çifutët dhe të krishterët në përgjithësi, veç një pakice të tyre, Allahu i Lartësuar i urdhëron ata për të besuar Muhamedin (s.a.u.s.).

Allahu i Lartësuar u tregon një shenjë shumë të qartë, që tregon për vërtetësinë e profetësisë së Muhamedit (s.a.u.s.): ai bën të qarta shumë nga ato çështje që ata ua mbanin fshehur njerëzve, madje edhe njerëzve të thjeshtë të fesë së tyre.

Në atë kohë, i vetmi burim për të njohur librat e shenjtë dhe porositë e profetëve ishin

dijetarët çifutë e të krishterë, aq sa ata lejonin. Edhe vetë të përkushtuarit në dije nga njerëzit e thjeshtë mund të arrinin veçse aq sa u jepte kleri i tyre. Atëherë, në një situatë të tillë, u shfaq profeti i Zotit, Muhamedi (a.s.), dhe Kur'âni madhështor. Ai ishte një analfabet, që nuk dinte ç'ishte libri dhe as imani, e, megjithatë, në Kur'ân përmenden shumë çështje që ata, me aq kujdes, i fshihnin nga njerëzit. Atëherë, si e mori këtë njohuri të fshehtë? Pa dyshim kjo qe një provë shumë e fortë, që vërtetonte se Muhamedi (s.a.u.s.) ishte profeti i Zotit. Ndër faktet e fshehura prej dijetarëve çifutë e të krishterë ishin edhe shenjat dalluese të Profetit të Fundit në librat e tyre dhe njoftimi i profetëve për ardhjen e tij, ligji i gurëzimit në Teurat etj.

- "...e që për shumë të tjera, ai fal." - Disa çështje të tjera ai nuk i sqaroi, sepse kështu e kërkonte urtësia.

- "Juve ju erdhi nga Allahu dritë dhe libër i qartë." – Kuptimi: Juve ju erdhi Kur'âni prej Allahut, nëpërmjet të cilit ju ndriçoheni, për të gjetur rrugën në errësirat e paditurisë dhe humbjes. Ai është, sikurse ka thënë Allahu i Lartësuar: "*Kitabun mubin*" – "libër i qartë". Ai është qartësuesi i të gjitha çështjeve për të cilat keni nevojë, që kanë lidhje me fenë dhe dynjanë tuaj. Ai ju sqaron gjithçka në lidhje me njohuritë për Allahun, emrat, cilësitë dhe veprat e Tij; sqaron ligjet e vendosura prej Allahut, ashtu si edhe shpërblimin apo ndëshkimin e Tij.

Pastaj Allahu i Lartësuar na tregon se cilët janë ata që përfitojnë udhëzimin prej këtij libri dhe çfarë kushti duhet të përmbushet për t'u arritur ky udhëzim:

- Allahu udhëzon nëpërmjet tij në rrugët e shpëtimit ata që kërkojnë kënaqësinë e Tij - Nëpërmjet Kur'ânit, Allahu i Lartësuar udhëzon ata që përpiqen sinqerisht për të kënaqur Atë. Qëllimi i tyre është i mirë, prandaj Allahu i Lartësuar i udhëzon drejt së mirës dhe në rrugën e paqes. Kjo rrugë i siguron udhëtarët e saj nga ndëshkimi dhe i çon në vendin e lumturisë. Kjo është rruga e drejtë, e ndërtuar mbi dijen e saktë dhe punën e sinqertë në bazë të kësaj diturie, për të kënaqur Zotin. Sa më e gjerë dhe e hollësishme të jetë dituria dhe puna me të, aq më e lartë do të jetë grada e robit.

- "...dhe i nxjerr ata prej errësirave në dritë, me ndihmën e Tij. Ai i udhëzon ata në një rrugë, që është e drejtë" - Nëpërmjet Kur'ânit dhe mësimeve të Profetit të Tij, Allahu i nxjerr njerëzit nga errësira e kufrit, bidatit, poshtërsive, injorancës dhe pakujdesisë, në dritën e imanit të pastër, traditës profetike, bindjes ndaj Tij dhe Profetit, diturisë së gjerë dhe përkujtimit të Tij.


Allahu i Lartësuar thotë: "... me ndihmën e Tij ...". Pra, i gjithë ky udhëzim është dhuratë e Allahut. Ajo që Allahu ka dashur të jetë është, dhe ajo që Allahu nuk lejoi të jetë nuk është.

Ajetet 17 – 18

17. E kanë mohuar të vërtetën ata që thonë se: "Allahu është Mesihu, biri i Merjemes." Thuaju: "Kush mund ta pengojë Allahun, nëse Ai dëshiron ta vdesë Mesihun, birin e Merjemes, nënën e tij dhe gjithçka gjendet në tokë?" Vetëm Atij i takon pushteti i qiejve, i tokës dhe ç'ka mes tyre. Ai krijon çdo gjë që dëshiron. Pa dyshim, Allahu për çdo gjë është i Plotpushtetshëm.
18. Judejtë dhe të krishterët thanë: "Ne jemi bijtë e Allahut dhe të dashurit e Tij". Thuaju: "E pse, pra, Ai ju dënon për mëkatet tuaja? Jo, ju jeni thjesht njerëz, që Ai krijoi. Ai fal atë që do dhe dënon atë që do. Vetëm Allahut i takon sundimi i qiejve, i tokës dhe i gjithçka gjendet në mes tyre, dhe vetëm tek Ai është kthimi.

Shpjegimi i ajeteve

- "E kanë mohuar të vërtetën ata që thonë se: "Allahu është Mesihu, biri i Merjemes."


الجزء السادس سورة المائدة
وَقَالَتِ ٱلْيَهُودُ وَٱلنَّصَٰرَىٰ نَحْنُ أَبْنَٰٓؤُا۟ ٱللَّهِ وَأَحِبَّٰٓؤُهُۥ ۚ قُلْ
فَلِمَ يُعَذِّبُكُم بِذُنُوبِكُم ۖ بَلْ أَنتُم بَشَرٌ مِّمَّنْ خَلَقَ ۚ يَغْفِرُ لِمَن
يَشَآءُ وَيُعَذِّبُ مَن يَشَآءُ ۚ وَلِلَّهِ مُلْكُ ٱلسَّمَٰوَٰتِ وَٱلْأَرْضِ
وَمَا بَيْنَهُمَا ۖ وَإِلَيْهِ ٱلْمَصِيرُ ﴿١٨﴾ يَٰٓأَهْلَ ٱلْكِتَٰبِ قَدْ جَآءَكُمْ
رَسُولُنَا يُبَيِّنُ لَكُمْ عَلَىٰ فَتْرَةٍ مِّنَ ٱلرُّسُلِ أَن تَقُولُوا۟ مَا جَآءَنَا
مِنۢ بَشِيرٍ وَلَا نَذِيرٍ ۖ فَقَدْ جَآءَكُم بَشِيرٌ وَنَذِيرٌ ۗ وَٱللَّهُ عَلَىٰ كُلِّ
شَىْءٍ قَدِيرٌ ﴿١٩﴾ وَإِذْ قَالَ مُوسَىٰ لِقَوْمِهِۦ يَٰقَوْمِ ٱذْكُرُوا۟
نِعْمَةَ ٱللَّهِ عَلَيْكُمْ إِذْ جَعَلَ فِيكُمْ أَنۢبِيَآءَ وَجَعَلَكُم مُّلُوكًا
وَءَاتَىٰكُم مَّا لَمْ يُؤْتِ أَحَدًا مِّنَ ٱلْعَٰلَمِينَ ﴿٢٠﴾ يَٰقَوْمِ ٱدْخُلُوا۟
ٱلْأَرْضَ ٱلْمُقَدَّسَةَ ٱلَّتِى كَتَبَ ٱللَّهُ لَكُمْ وَلَا تَرْتَدُّوا۟
عَلَىٰٓ أَدْبَٰرِكُمْ فَتَنقَلِبُوا۟ خَٰسِرِينَ ﴿٢١﴾ قَالُوا۟ يَٰمُوسَىٰٓ إِنَّ
فِيهَا قَوْمًا جَبَّارِينَ وَإِنَّا لَن نَّدْخُلَهَا حَتَّىٰ يَخْرُجُوا۟ مِنْهَا ۖ فَإِن
يَخْرُجُوا۟ مِنْهَا فَإِنَّا دَٰخِلُونَ ﴿٢٢﴾ قَالَ رَجُلَانِ مِنَ ٱلَّذِينَ يَخَافُونَ
أَنْعَمَ ٱللَّهُ عَلَيْهِمَا ٱدْخُلُوا۟ عَلَيْهِمُ ٱلْبَابَ فَإِذَا دَخَلْتُمُوهُ فَإِنَّكُمْ
غَٰلِبُونَ ۚ وَعَلَى ٱللَّهِ فَتَوَكَّلُوٓا۟ إِن كُنتُم مُّؤْمِنِينَ ﴿٢٣﴾
١١١

- Pasi foli për besën dhe premtimin e thyer nga popujt e mëparshëm çifutë dhe të krishterë, Allahu i Lartësuar vijon të tregojë fjalët e tyre të shëmtuara dhe të poshtra në lidhje me Të. I tillë është deklarimi i të krishterëve, të cilin veç ata e kanë bërë. Ata thonë që Isai (a.s.), i biri i Merjemes, është bir i Zotit. Ata e keqkuptuan faktin që Isai (a.s.) lindi pa patur baba biologjik, prandaj ranë në këtë besim të shëmtuar. Por dihet se me rastin e tij ngjan edhe Havaja, e cila nuk pati nënë, por u krijua nga një brinjë e Ademit (a.s.). Madje, Ademi (a.s.) u krijua pa nënë e pa babë, kështu që, sipas logjikës së gabuar të tyre, ai e meriton më shumë për të qenë bir i Zotit. Kësisoj, ky deklarim i tyre nuk mbështetet në ndonjë argument hyjnor, por është thjesht pasim i mendjes së tyre.

Allahu i Madhëruar ua kthen atyre përgjigjen me një argumentim logjik të qartë dhe të kuptueshëm lehtësisht. Ai thotë:

- "Thuaju: "Kush mund ta pengojë Allahun, nëse Ai dëshiron ta vdesë Mesihun, birin e Merjemes, nënën e tij dhe gjithçka gjendet në tokë?" - Duke qenë se të përmendurit nuk kanë patur asnjë fuqi që të mbronin dhe shpëtonin vetveten nga vdekja, kjo tregon se ata nuk mund të ishin kurrsesi zota. Si mund të adhurohet dikush që nuk ka pushtet as për të mbrojtur vetveten?!

Tregues i kotësisë së besimit të tyre në zota të tjerë veç Allahut është edhe fakti që:

- "Vetëm Atij i takon pushteti i qiejve, i tokës dhe ç'ka mes tyre." - Allahu vepron në mbretërinë e Tij me urtësinë e Tij të madhe, me ligjin e Tij dhe me shpërblimin që është në dorën e Tij. Është Ai që vendos ligjet në ekzistencë dhe në çdo gjë që ka krijuar. Është Ai që ka vendosur rregullat, të cilat duhet të jenë sistem jete për krijesat, dhe është po Ai që do t'i marrë në përgjegjësi për zbatimin ose jo të këtyre rregullave. Çdo gjë në këtë gjithësi është pronë, krijesë dhe e nënshtruar ndaj Allahut të Madhëruar. Çdo krijesë nuk ka në dorë asnjë grimcë pushteti! Atëherë, si mund të mendohet që një rob i varfër e i pafuqishëm të konsiderohet si Zot që adhurohet. Kjo është pamundësia më e madhe.

Edhe çudia e tyre në lidhje me mënyrën e krijimit të Isait (a.s.) pa baba, është pa vend dhe jo e drejtë, sepse Allahu thotë:

- "Ai krijon çdo gjë që dëshiron. Pa dyshim, Allahu për çdo gjë është i Plotpushtetshëm" - Allahu i krijon njerëzit me nënë dhe me baba, sikurse janë gjithë njerëzia, por nëse Ai dëshiron, mund t'i krijojë ata edhe me baba e pa nënë, sikurse krijoi nënën e njerëzimit, Havanë. Nëse Allahu dëshiron, mund t'i krijojë edhe me nënë e pa baba, sikurse veproi me Isain (a.s.), por nëse përsëri dëshiron, Allahu mund t'i krijojë pa nënë e pa baba, sikurse krijoi Ademin (a.s.). Të gjithë krijesat dhe mënyrat e krijimit të tyre përcaktohen nga vullneti dhe dëshira e të Madhërishmit, e cila ekzekutohet dhe nuk mund të kthehet a të ndalet. Për këtë arsye, i Madhërishmi

thotë: "Allahu për çdo gjë është i Plotpushtetshëm".

Ndër pretendimet dhe fjalët boshe të të krishterëve dhe judejve është edhe thënia e tyre e njohur:

- "Ne jemi bijtë e Allahut dhe të dashurit e Tij". - Sipas shpjegimit dhe kuptimit të saktë, fjala "bir" ka kuptimin: "i dashur, i zgjedhur", dhe nuk nënkupton birësinë e lindjes. Ata që e kuptojnë birësinë me kuptimin e drejtpërdrejtë, pra të lindjes, janë të krishterët, të cilët pretendojnë për Isain (a.s.) se është biri i lindur nga Zoti.

Por Allahu i Madhëruar ua kthen atyre këtë pretendim të pabazë:

- "Thuaju: "E pse, pra, Ai ju dënon për mëkatet tuaja?" - Nëse do të ishit vërtet të dashurit dhe të zgjedhurit e Zotit, atëherë pse ju ndëshkon për gjynahet tuaja? Dihet mirë se Allahu i Madhërishëm përzgjedh veç ata që angazhohen maksimalisht për ta merituar statusin "të dashur të Zotit", duke bërë vepra të mira, që e kënaqin Zotin.

- "Jo, ju jeni thjesht njerëz, që Ai krijoi. Ai fal atë që do dhe dënon atë që do." – Kuptimi: Edhe ju jeni të nënshtruar, edhe mbi ju zbatohet drejtësia dhe bamirësia e Zotit, ashtu sikurse mbi të gjithë njerëzit e tjerë, sipas urtësisë së Tij. Është Ai që vendos, me urtësinë dhe diturinë e Tij, për ata që i fal apo i ndëshkon. Çdokush që e ka bërë hak shpërblimin, Zoti e shpërblen me bujarinë e Tij. Çdokush që e ka bërë hak ndëshkimin, Zoti e ndëshkon me drejtësinë e Tij.

- "Vetëm Allahut i takon sundimi i qiejve, i tokës dhe i gjithçka gjendet në mes tyre, dhe vetëm tek Ai është kthimi." - Gjithçka në qiej e në tokë është pasuri dhe pronë e Allahut të vetëm. Atij i takon pushteti mbi to. Çdo gjë është krijesë e të Madhërishmit, mbi të cilën zbatohen ligjet e Tij. Atëherë, çfarë të veçante keni ju, që të jeni të zgjedhurit dhe të dashurit e Allahut. Edhe ju, ashtu sikurse të gjithë të tjerët, do të ktheheni tek i Plotpushtetshmi i Vetëm, në Ditën e Fundit, dhe është Ai që çdokujt do t'i japë shpërblimin e merituar.


Ajeti 19

19. O ithtarë të Librit, ja ku ju erdhi i Dërguari Ynë, që ju sqaron, pas ndërprerjes së të dërguarve, në mënyrë që të mos thoni: "Neve nuk na erdhi i dërguar që të na përgëzonte e të na tërhiqte vërejtjen". Ja, pra, ku ju erdhi Përgëzuesi dhe Paralajmëruesi. Allahu është i Fuqishëm për gjithçka.

Shpjegimi i ajetit

- "O ithtarë të Librit, ja ku ju erdhi i Dërguari Ynë, që ju sqaron, pas ndërprerjes së të dërguarve, në mënyrë që të mos thoni: "Neve nuk na erdhi i dërguar që të na përgëzonte e të na tërhiqte vërejtjen"." - Allahu i Madhëruar i fton ithtarët e Librit, të cilëve u dhuroi mirësinë të kenë libër qiellor, që të besojnë Muhamedin (a.s.), të dërguarin e Tij të zgjedhur, dhe t'i shprehin mirënjohje të thellë Atij, që e dërgoi këtë profet të vyer, pas një ndërprerje të gjatë të vargut profetik, në një moment kur nevoja për të ishte urgjente. Dërgimi i një profeti të tillë, që të zbulojë të vërtetën e fshehur dhe të harruar ndër shekuj, pikërisht në kohën kur nevoja për të ishte e domosdoshme, duhet të jetë arsye e mjaftueshme për të treguar mirënjohje dhe falënderim për Zotin. Aq më tepër që ky profet mësoi gjithçka që njerëzit duhet të dinë për fenë dhe për ligjet që Zoti ka caktuar për ta. Ky do të jetë profeti i fundit për njerëzimin, prandaj dhe Zoti e pajisi me mrekullinë e përjetshme, Kur'ânin, që njerëzit të mos kenë më justifikim për mosbesimin e tyre, sikurse thotë i Lartësuari:

- "Ja, pra, ku ju erdhi Përgëzuesi dhe Paralajmëruesi." - Ai ju përgëzon për një shpërblim të madh në jetën e kësaj dynjaje dhe në ahiret. Ai ju mëson e shpjegon veprat


الجزء السادس سورة المائدة
قَالُوا۟ يَٰمُوسَىٰٓ إِنَّا لَن نَّدْخُلَهَآ أَبَدًا مَّا دَامُوا۟ فِيهَا فَٱذْهَبْ
أَنتَ وَرَبُّكَ فَقَٰتِلَآ إِنَّا هَٰهُنَا قَٰعِدُونَ ﴿٢٤﴾ قَالَ رَبِّ إِنِّى
لَآ أَمْلِكُ إِلَّا نَفْسِى وَأَخِى فَٱفْرُقْ بَيْنَنَا وَبَيْنَ ٱلْقَوْمِ
ٱلْفَٰسِقِينَ ﴿٢٥﴾ قَالَ فَإِنَّهَا مُحَرَّمَةٌ عَلَيْهِمْ أَرْبَعِينَ سَنَةً
يَتِيهُونَ فِى ٱلْأَرْضِ ۗ فَلَا تَأْسَ عَلَى ٱلْقَوْمِ ٱلْفَٰسِقِينَ
﴿٢٦﴾ ۞ وَٱتْلُ عَلَيْهِمْ نَبَأَ ٱبْنَىْ ءَادَمَ بِٱلْحَقِّ ۘ إِذْ قَرَّبَا قُرْبَانًا فَتُقُبِّلَ
مِنْ أَحَدِهِمَا وَلَمْ يُتَقَبَّلْ مِنَ ٱلْءَاخَرِ ۚ قَالَ لَأَقْتُلَنَّكَ ۖ
قَالَ إِنَّمَا يَتَقَبَّلُ ٱللَّهُ مِنَ ٱلْمُتَّقِينَ ﴿٢٧﴾ لَئِنۢ بَسَطتَ إِلَىَّ يَدَكَ
لِتَقْتُلَنِى مَآ أَنَا۠ بِبَٰسِطٍ يَدِىَ إِلَيْكَ لِأَقْتُلَكَ ۖ إِنِّىٓ أَخَافُ ٱللَّهَ
رَبَّ ٱلْعَٰلَمِينَ ﴿٢٨﴾ إِنِّىٓ أُرِيدُ أَن تَبُوٓأَ بِإِثْمِى وَإِثْمِكَ فَتَكُونَ
مِنْ أَصْحَٰبِ ٱلنَّارِ ۚ وَذَٰلِكَ جَزَٰٓؤُا۟ ٱلظَّٰلِمِينَ ﴿٢٩﴾ فَطَوَّعَتْ
لَهُۥ نَفْسُهُۥ قَتْلَ أَخِيهِ فَقَتَلَهُۥ فَأَصْبَحَ مِنَ ٱلْخَٰسِرِينَ ﴿٣٠﴾
فَبَعَثَ ٱللَّهُ غُرَابًا يَبْحَثُ فِى ٱلْأَرْضِ لِيُرِيَهُۥ كَيْفَ يُوَٰرِى
سَوْءَةَ أَخِيهِ ۚ قَالَ يَٰوَيْلَتَىٰٓ أَعَجَزْتُ أَنْ أَكُونَ مِثْلَ هَٰذَا
ٱلْغُرَابِ فَأُوَٰرِىَ سَوْءَةَ أَخِى ۖ فَأَصْبَحَ مِنَ ٱلنَّٰدِمِينَ ﴿٣١﴾
١١٢

që bëjnë të mundur arritjen e këtij shpërblimi, si dhe cilësitë e atyre që e meritojnë atë. Ai ju paralajmëron edhe për ndëshkimin në jetën e kësaj dynjaje dhe në ahiret, ashtu siç ju sqaron dhe ju ndalon nga veprat që e sjellin atë ndëshkim, si dhe cilësitë e njerëzve që e meritojnë atë.

- "Allahu është i Fuqishëm për gjithçka." - Çdo gjë i është nënshtruar pushtetit dhe sundimit të Tij. Nuk ka asgjë të vështirë për Të. Tregues të pushtetit dhe të sundimit të Tij absolut janë edhe dërgimi i profetëve, shpallja e librave, caktimi i ligjeve dhe marrja në përgjegjësi për zbatimin ose jo të tyre. Ai është i Plotpushtetshmi, që do t'i shpërblejë të gjithë, me drejtësinë dhe bamirësinë e Tij, secilin sipas meritave. Ata që iu bindën Allahut dhe profetëve dhe zbatuan porositë e Tij, Ai do t'i shpërblejë me bujarinë dhe mëshirën e Tij. Ndërsa ata që shpërfillën profetët dhe shpalljet e Tij, Ai do t'i ndëshkojë me drejtësinë dhe urtësinë e Tij.

Ajetet 20 – 26

20. Përkujto *(O i Dërguar)* kur Musai i tha popullit të vet: "O popull im, përkujtoni mirësinë e Allahut ndaj jush, kur, nga mesi juaj, nxori pejgamberë, që ju bëri të jeni sundues dhe ju dha çka nuk i kishte dhënë asnjë populli.
21. O populli im! Hyni në tokën e shenjtë, të cilën Allahu jua premtoi, dhe mos u ktheni prapa, që ashtu të bëheni të dëshpëruar!"
22. Ata *(populli i Musait)* thanë: "O Musa, aty është një popull i fuqishëm, prandaj ne nuk do të hyjmë aty kurrë, derisa ata të largohen vetë prej andej. Kur ata të largohen, ne do të hyjmë".
23. Dy burra, prej atyre të cilët Allahu i begatoi, thanë: "U hyni atyre nga portat! Vetëm nëse hyni që andej, ju do të ngadhënjeni! Dhe vetëm Allahut mbështetjuni, nëse jeni besimtarë të sinqertë".
24. Ata thanë: "O Musa, ne nuk hyjmë atje, përderisa ata të jenë aty, prandaj shko ti dhe Zoti yt e luftoni, se ne po rrimë këtu!"
25. Tha *(Musai)*: "Zoti im! Unë nuk kam fuqi mbi asnjë tjetër veç vetes dhe vëllait tim, ndaj na veço ne prej popullit të pabindur!"
26. Tha *(Allahu)*: "Ajo *(tokë)* është e ndaluar për ta. Për dyzet vjet, ata do të enden nëpër tokë. Por ti mos u ligështo për popullin e shfrenuar!

Shpjegimi i ajeteve

Pasi Allahu i Lartësuar, me mëshirën dhe mirësinë e Tij, i shpëtoi bijtë e Izraelit nga torturat e pamëshirshme të Faraonit dhe popullit të tij, nga robëria dhe poshtërimi që përjetonin nën sundimin tiranik të tij, ata u drejtuan për në tokën e tyre, pra, në Bejt el Makdes dhe rrethinat e saj. Kur ata iu afruan këtij vendi të bekuar, Allahu i Lartësuar ua bëri detyrë luftën, që t'i shporrnin armiqtë e tyre prej andej. Musai (a.s.) i nxiti ata që të përgatiteshin për luftë, duke u thënë:

- "Përkujto *(O i Dërguar)* kur Musai i tha popullit të vet: "O popull im, përkujtoni mirësinë e Allahut ndaj jush, kur, nga mesi juaj, nxori pejgamberë, që ju bëri të jeni sundues dhe ju dha çka nuk i kishte dhënë asnjë populli." – Kuptimi: Përkujtoni mirësitë e shumta të Allahut mbi ju, për të qenë mirënjohës. Përkujtojini ato me zemër dhe me gojë. Përkujtoni, sepse përkujtimi i mirësive kultivon dashurinë për Dhuruesin dhe nxit shtimin e adhurimeve, të shprehura me ndjenja, fjalë dhe vepra që e kënaqin Atë. Përkujtoni mirësinë më të madhe mbi ju, kur nga mesi juaj bëri profetë, të cilët ju kanë ftuar në rrugën e drejtë, ju kanë këshilluar që të ruheni nga çdo fjalë e vepër e keqe, ju kanë mësuar të ecni në rrugën e Zotit, për të arritur lumturinë e përjetshme. Ata ju kanë mësuar atë që ju nuk e keni ditur dhe për të cilën keni patur nevojë më shumë sesa për jetën tuaj.

Përkujtoni që Allahu i Madhërishëm ju bëri zotërues të çështjeve tuaja, ndryshe nga ç'ishit më parë, skllevër dhe të nënshtruar ndaj të tjerëve. Kështu, ju do të jeni të lirë të adhuroni Allahun, ashtu sikurse Ai kënaqet prej jush, dhe të zbatoni tërësisht fenë në të cilën ju udhëzoi.

Allahu i Madhëruar ju dha atë që nuk ia kishte dhënë askujt në botë. Ai ju dhuroi mirësi të kësaj dynjaje dhe mirësi fetare, çka nuk ia kishte dhënë askujt prej njerëzve të tjerë deri në atë kohë.

Kështu, Allahu i Madhëruar u përkujtoi atyre mirësitë e Tij të shumta materiale e fetare, që të shtonte tek ata forcën e imanit dhe qëndrueshmërinë e tij. Kjo u bë, me qëllim që ata t'i bindeshin urdhrit për luftë, duke iu bindur Zotit dhe profetit të Tij.

Pastaj Musai u tha:

- "O populli im! Hyni në tokën e shenjtë, të cilën Allahu jua premtoi..." - Kuptimi: Hyni në këtë tokë të dëlirë, të cilën Zoti e caktoi për ju.

Këto fjalë do duhej të qetësonin shpirtrat e tyre, duke u dhënë sigurinë dhe besimin e plotë në fitore, nëse do të bindeshin. Ato u përforcuan edhe më tej, me fjalët:

- "...dhe mos u ktheni prapa, që ashtu të bëheni të dëshpëruar!" - Nëse ktheni shpinën, atëherë do të dilni të humbur. Kështu do të humbni dynjanë tuaj, sepse nuk do të mund ta mposhtni armikun dhe as të çlironi atdheun tuaj. Por do të shkatërroni edhe ahiretin tuaj, sepse prej mosbindjes, do të humbni shpërblimin e pamasë të Allahut të Lartësuar dhe do të meritoni ndëshkimin.

Por pavarësisht nga këto fjalë inkurajuese për të filluar luftën, ata thanë diçka që dëshmonte dobësinë e imanit, frikën në zemër dhe mosinteresimin e plotë të tyre për urdhrat e Allahut dhe të Profetit të Tij:

- "Ata thanë: "O Musa, aty është një popull i fuqishëm, prandaj ne nuk do të hyjmë aty kurrë, derisa ata të largohen vetë prej andej. Kur ata të largohen, ne do të hyjmë". - Kuptimi: Atje ndodhet një popull i ashpër dhe guximtar dhe kjo është një pengesë për ne që të hyjmë në atë vend.

Këto fjalë tregojnë se ata ishin burracakë e frikacakë, që nuk kishin siguri dhe bindje në premtimin e Zotit. Nëse do të ishin të urtë dhe të mendonin drejt, do të kuptonin se të gjithë njerëzit janë bij dhe pasardhës të Ademit (a.s.), kështu që "i fortë" është ai të cilit Allahu i Lartësuar i jep forcë dhe fuqi. Nuk ka fuqi dhe nuk ka ndryshim të gjendjes pa ndihmën dhe suksesin e dhënë prej Allahut. Po të mendonin kështu, pa dyshim do të bindeshin se fitorja do të ishte në anën e tyre, aq më tepër që Allahu i Madhëruar ua premtoi këtë gjë.

- "Dy burra, prej atyre të cilët Allahu i begatoi, thanë: "U hyni atyre nga portat!" - Në këtë moment, ndërhyjnë dhe flasin dy burra, cilësi dalluese të të cilëve ishte frika ndaj Allahut të Madhërishëm. Ata i dhanë

kurajë popullit për të luftuar me trimëri dhe për të çliruar atdheun e tyre.

Allahu i Lartësuar thotë për ta: "...të cilët Allahu i begatoi", domethënë, u dha forcë që të thonin të vërtetën, në ato momente kur ajo ishte aq e nevojshme. Ishte mirësi prej Allahut që ata filluan të nxisnin dhe të zgjonin te populli ndjenjën e durimit dhe të sigurisë në ndihmën e Allahut.

- "Vetëm nëse hyni që andej, ju do të ngadhënjeni!" - Kuptimi: Mes jush dhe fitores qëndron vetëm një gjë: hyrja nga portat. Nëse e bëni këtë, ata do të munden.

Pastaj ata dhanë një këshillë, që është forca më e madhe me të cilën mund të armatoseshin:

- "Dhe vetëm Allahut mbështetjuni, nëse jeni besimtarë të sinqertë". - Mbështetja e plotë në Allahun, sidomos në të tilla situata, sjell lehtësim të çështjes dhe fitore mbi armiqtë. Kjo tregon, gjithashtu, se mbështetja tek Allahu është në varësi të imanit të robit.

Sidoqoftë, këto fjalë nuk ndikuan fare në shpirtrat e tyre, prandaj, të poshtëruar dhe të dështuar, thanë:

- "O Musa, ne nuk hyjmë atje, përderisa ata të jenë aty, prandaj shko ti dhe Zoti yt e luftoni, se ne po rrimë këtu!" - Sa të shëmtuara ishin këto fjalë të tyre! Sa e ulët ishte përgjigjja që i dhanë Profetit të tyre, pikërisht në ato momente ngushtie dhe nevoje për t'i dalë krah dhe për të luftuar përkrah tij, për ta nderuar atë, por edhe për dinjitetin e vetvetes.

Në këto raste del në pah dukshëm ndryshimi mes popujve të tjerë dhe shokëve të Muhamedit (a.s.) e umetit të tij. Kur profeti Muhamed (a.s.) u këshillua me ta në një rast të ngjashëm (para betejës së Bedrit), edhe pse ai nuk ua kërkoi me ngulm pjesëmarrjen në luftë, ata i thanë: " Për Allah! Nëse i hyn detit në këmbë, edhe ne do të hyjmë së bashku me ty! Edhe sikur të kërkosh që të shkojmë në vendin më të rrezikshëm, asnjëri prej nesh nuk do të të braktisë! Ne nuk do të themi kurrë ashtu si i thanë Musait (a.s.) shokët e tij: "Shko ti dhe Zoti yt dhe luftoni, se ne do rrimë këtu!" Por ne themi: "Shko ti dhe Zoti yt luftoni, sepse edhe ne do të vijmë së bashku me ju të luftojmë, para teje e pas teje, djathtas teje dhe majtas teje!"

Kur vërejti mosbindjen e tyre, Musai (a.s.) tha:

- "Zoti im! Unë nuk kam fuqi mbi asnjë tjetër veç vetes dhe vëllait tim..." – Kuptimi: Unë nuk kam ndihmës për të luftuar këta dhe as mundem që t'i detyroj të luftojnë.

Pastaj u lut dhe tha:

- "...ndaj na veço ne prej popullit të pabindur!" – Gjyko, o Zot, me drejtësinë dhe urtësinë Tënde, mes nesh dhe popullit të prishur! Zbrit mbi ta ndëshkimin, që e përcakton urtësia Jote.

Kjo tregon se fjalët dhe veprat e tyre ishin gjynahe të mëdha, që meritonin ndëshkim. Në përgjigje të lutjes së Musait (a.s.), Allahu i Lartësuar tha:

- "Ajo është e ndaluar për ta. Për dyzet vjet, ata do të enden nëpër tokë." - Kuptimi: Si ndëshkim, ata do të enden nëpër shkretëtirë dhe, për 40 vjet, nuk do të mund të hyjnë në tokën që Zoti u premtoi. Për 40 vjet nuk do të gjejnë më qetësi dhe prehje.

Ky ishte një ndëshkim që në këtë dynja, nëpërmjet të cilit, Allahu i Lartësuar ndoshta i pastroi nga gjynahu i mosbindjes. Nëpërmjet këtij ndëshkimi, Allahu i Madhëruar largoi një ndëshkim më të madh kundër tyre. Kjo tregon se ndëshkimi për gjynahet mund të vijë në forma dhe mënyra të ndryshme. Ai mund të vijë si largim i të mirave, por mund të vijë edhe në formën e një vonese të largimit të fatkeqësive apo të shtimit të tyre.

Ndoshta periudha dyzetvjeçare do të bënte që shumica e atyre që thanë ato fjalë të

vdisnin. Megjithatë, kjo periudhë do të shërbente që të ndryshonin ato zemra që nuk ishin mësuar me durim dhe qëndrueshmëri, por me nënshtrim e robëri. Ata nuk kishin ambicie dhe vullnet për t'u ngritur lart dhe për të fituar. Për këtë arsye, kjo kohë do të shërbente edhe për t'u edukuar një brez i ri, që do të rritej me dëshirën për të mposhtur armiqtë, me krenarinë për të mos qenë robër e të nënshtruar dhe me ambicien për të arritur lumturinë.

Por Allahu i Lartësuar e dinte shumë mirë që robin e Tij, Musain (a.s.), e spikaste një mëshirë dhe dhembshuri e madhe, sidomos për popullin e tij. Me gjithë lutjen që ai bëri kundër tyre, ai u prek dhe ndjeu keqardhje për atë vendim, që tashmë kishte marrë fund dhe ishte vulosur. Prandaj Allahu i Lartësuar i thotë:

- "Por ti mos u ligështo për popullin e shfrenuar!" – Pra, mos të të vijë keq dhe mos u trishto për atë popull, sepse ata i kaluan kufijtë. Shfrenimi dhe mospërfillja e tyre e bënë mëse të meritueshëm ndëshkimin që u vendos për ta. Ky vendim nuk është aspak një padrejtësi, por është ai çka e merituan me fjalët dhe veprat e tyre të ulta.

Ajetet 27 – 31

27. Lexoju *(o Muhamed!)* atyre me vërtetësi ngjarjen e dy djemve të Ademit, kur të dy flijuan nga një kurban. Njërit iu pranua kurbani, ndërsa tjetrit nuk iu pranua. Ai i tha tjetrit: "Unë do të të vras ty". Tjetri i tha: "Allahu pranon vetëm prej të devotshmëve!
28. Nëse ti e zgjat mbi mua dorën tënde për të më vrarë, unë kurrë nuk kam për ta zgjatur mbi ty dorën time për të të vrarë, se unë i frikësohem Allahut, Zotit të botëve!"
29. Unë dua që ti të bartësh barrën e gjynahut tim dhe të gjynahut tënd, e kështu të bëhesh prej banorëve të Zjarrit. Ai është dënimi i zullumqarëve".
30. Vetja e tij e nxiti atë për vrasjen e të vëllait, dhe e vrau atë. Kështu ai u bë prej të humburve.
31. Allahu dërgoi një sorrë, e cila gërmonte në dhé, për t'i treguar atij se si ta mbulonte trupin e të vëllait. Ai tha: "I mjeri unë! Nuk qeshë i aftë as sa kjo sorrë, e ta mbuloja trupin e vëllait tim!" Ashtu mbeti i dëshpëruar.

Shpjegimi i ajeteve

- "Lexoju *(o Muhamed!)* atyre me vërtetësi ngjarjen e dy djemve të Ademit..." - Tregoju me vërtetësi njerëzve ndodhinë mes bijve të Ademit. Lexojua atyre, që të nxjerrin mësime ata që dinë të nxjerrin mësime. Kjo është një histori e vërtetë, e jo gënjeshtër, është e rëndësishme, jo lojë.

Nga ajeti kuptohet se bëhet fjalë për dy djemtë e lindur drejtpërdrejt nga Ademi (a.s.). Ky është mendimi i shumicës së *mufesirin*-ëve.

Lexoju, pra, ngjarjen e atyre të dyve, kur ata afruan nga një kurban për Allahun e Lartësuar:

- "...kur të dy flijuan nga një kurban. Njërit iu pranua kurbani, ndërsa tjetrit nuk iu pranua. Ai i tha tjetrit: "Unë do të të vras ty"." - Pra, secili prej tyre nxori një pjesë të pasurisë së vet, me qëllimin për t'iu afruar Allahut të Lartësuar. Por me një shenjë nga qielli, u kuptua që prej njërit iu pranua kurbani, ndërsa tjetrit jo. Në popujt e parë, shenjë e pranimit të kurbanit ishte një zjarr që zbriste nga qielli dhe që e përpinte kurbanin.

Djali të cilit nuk iu pranua kurbani, i nxitur prej smirës, i tha atij që iu pranua: "Do të të vras!" Por tjetri iu përgjigj me butësi:

- "Allahu pranon vetëm prej të devotshmëve!" - Kuptimi: Çfarë gjynahu dhe padrejtësie kam bërë unë, që të më vrasësh? Unë thjesht tregohem i devotshëm ndaj Zotit tim, dhe devotshmëria ndaj Tij

është detyrë e imja, e jotja dhe e çdokujt. Allahu i Lartësuar i pranon punët e atyre që tregohen të devotshëm në kryerjen e tyre. Kusht i domosdoshëm që një vepër të pranohet nga Allahu i Madhëruar është të kryerit e saj me sinqeritet vetëm për Atë, me qëllimin për ta kënaqur Atë dhe kryerja e saj sipas porosive të Allahut dhe të Profetit të Tij. Ky është kuptimi i saktë i ajetit.

Më pas, ai i drejtohet vëllait të vet dhe i thotë se kurrë nuk do ta dëshironte vrasjen e tij, as edhe për vetëmbrojtje, madje:

- "Nëse ti e zgjat mbi mua dorën tënde për të më vrarë, unë kurrë nuk kam për ta zgjatur mbi ty dorën time për të të vrarë" - E gjitha kjo, jo sepse ishte frikacak apo i paaftë që të mbrohej, por për një arsye shumë të fortë:

- "...se unë i frikësohem Allahut, Zotit të botëve!" – Dhe, pa dyshim, ai që i frikësohet Allahut kurrësesi nuk i afrohet dhe as merr guximin të kryejë gjynahe ndaj Tij, e sidomos gjynahe të mëdha, sikurse është marrja e jetës së tjetrit pa të drejtë.

Ky ajet është një kërcënim i hapur për këdo që synon të kryejë vrasje. Ai është porosi që njeriu të ketë frikë Zotin në veprat e tij dhe të druhet nga ndëshkimi i Tij.

- "Unë dua që ti të bartësh barrën e gjynahut tim dhe të gjynahut tënd, e kështu të bëhesh prej banorëve të Zjarrit. Ai është dënimi i zullumqarëve". - Kuptimi: Nëse çështja shkon deri atje sa të kem vetëm dy mundësi: o të bëhem vrasës, o viktimë, unë zgjedh që të bëhem viktimë. Kështu, ti do të ngarkohesh edhe me gjynahun tim, përveç tëndit, dhe do të bëhesh nga banorët e Zjarrit. Ky është shpërblimi për zullumqarët.

Kjo tregon se vrasja është një nga gjynahet e mëdha dhe shkak për futjen në Zjarr.

Por as këto fjalë nuk e sprapsën tjetrin. Ai e ushqeu vazhdimisht dëshirën për vrasjen e vëllait, edhe pse ligji i Zotit dhe natyra e pastër njerëzore kërkon të kundërtën, pra, nderimin dhe mëshirën për të.

- "Vetja e tij e nxiti atë për vrasjen e të vëllait, dhe e vrau atë. Kështu ai u bë prej të humburve." – Domethënë, ai u bë prej njerëzve që shkatërruan dynjanë dhe ahiretin e tyre. Madje, ai u bë shembulli i keq për çdo vrasës që do të vinte më pas, dhe dihet shumë mirë se: çdokush që sjell një traditë të keqe, atij i takon gjynahu i asaj tradite dhe gjynahu i të gjithë atyre që punojnë sipas saj, deri në Ditën e Gjykimit. Është transmetuar një hadith i saktë, që thotë se: "Çdokush që vret padrejtësisht, një pjesë e gjynahut të tij do të rëndojë edhe mbi birin e parë të Ademit, sepse ai ishte i pari që kreu vrasjen."

Pasi vrau të vëllanë, ai nuk dinte si të vepronte me të, sepse ai ishte i pari prej fëmijëve të Ademit që pa vdekjen. Atëherë:

- "Allahu dërgoi një sorrë, e cila gërmonte në dhé, për t'i treguar atij se si ta mbulonte trupin e të vëllait." – Sorra gërmonte në tokë për të groposur një sorrë tjetër të ngordhur, për t'i treguar në këtë mënyrë atij se si ta varroste dhe mbulonte trupin e vëllait të tij të vdekur.

Kur flet për trupin e të vdekurit, Allahu i Lartësuar thotë: "për t'i treguar atij se si ta mbulojë trupin (*seuete*) e vëllait". Fjala '*seuete*' do të thotë 'vend i turpshëm'. Kjo tregon se trupi i vdekur është si *auret*, prandaj duhet mbuluar.

- "Ai tha: "I mjeri unë! Nuk qeshë i aftë as sa kjo sorrë, e ta mbuloja trupin e vëllait tim!" Ashtu mbeti i dëshpëruar." - Ky është gjithmonë fundi i krimeve: trishtim, dëshpërim dhe humbje.

Ajeti 32

32. Për këtë, Ne u shpallëm bijve të Izraelit se, kush vret një njeri që s'ka vrarë kënd dhe s'ka bërë shkatërrim në tokë, është sikur të ketë vrarë gjithë njerëzimin. Dhe

nëse dikush shpëton një jetë, është sikur të ketë shpëtuar gjithë njerëzimin. Të dërguarit Tanë u sollën atyre argumente të qarta, por edhe pas kësaj, shumë prej tyre i kalojnë kufijtë dhe e teprojnë në tokë.


Shpjegimi i ajetit

Për shkak të ndodhisë me bijtë e Ademit (a.s.), kur vëllai vrau vëllanë, duke lënë kështu një traditë të keqe për ata që do të vinin pas tyre, si dhe për shkak se përfundimi i vrasjes është i tmerrshëm si në dynja, edhe në ahiret, Allahu i Lartësuar vendosi ligje. Në librat e Tij, Ai vendosi se: "...kush vret një njeri që s'ka vrarë kënd dhe s'ka bërë shkatërrim në tokë, është sikur të ketë vrarë gjithë njerëzimin. Dhe nëse dikush shpëton një jetë, është sikur të ketë shpëtuar gjithë njerëzimin."

Vrasja nuk duhet të ndodhë kurrë, përveç rasteve që ka përcaktuar drejtësia e Allahut të Lartësuar. Ai që vret jashtë këtyre kufijve, nuk ka asnjë justifikim të pranueshëm te Zoti i tij për këtë krim. Kur dikush vritet pa të drejtë, nuk ka asnjë ndryshim mes viktimës dhe çdo njeriu tjetër në botë. Ai që vret një njeri do ta bënte këtë me të gjithë botën, prandaj konsiderohet sikur të kishte vrarë të gjithë njerëzit. Po kështu, ai që bëhet shkak që të shpëtojë dhe të jetojë një njeri, ose që nuk e vret, por, nga frika ndaj Zotit, e lë të jetojë, edhe nëse nefsi i thotë të kundërtën, pra, ky konsiderohet sikur i ka shpëtuar nga vdekja dhe i ka dhënë jetë të gjithë njerëzimit.

Ajeti tregon se vrasja lejohet në dy raste:

1. Kur dikush kryen vrasje të padrejtë me paramendim, ai meriton ndëshkimin me vrasje, nëse është i përgjegjshëm ligjërisht, i barabartë në status me viktimën [34] dhe nëse nuk është prindi i viktimës. [35]



مِنْ أَجْلِ ذَٰلِكَ كَتَبْنَا عَلَىٰ بَنِيٓ إِسْرَٰٓءِيلَ أَنَّهُۥ مَن قَتَلَ
نَفْسًۢا بِغَيْرِ نَفْسٍ أَوْ فَسَادٍ فِى ٱلْأَرْضِ فَكَأَنَّمَا قَتَلَ
ٱلنَّاسَ جَمِيعًا وَمَنْ أَحْيَاهَا فَكَأَنَّمَآ أَحْيَا ٱلنَّاسَ
جَمِيعًا ۚ وَلَقَدْ جَآءَتْهُمْ رُسُلُنَا بِٱلْبَيِّنَٰتِ ثُمَّ إِنَّ كَثِيرًا
مِّنْهُم بَعْدَ ذَٰلِكَ فِى ٱلْأَرْضِ لَمُسْرِفُونَ ﴿٣٢﴾ إِنَّمَا
جَزَٰٓؤُا۟ ٱلَّذِينَ يُحَارِبُونَ ٱللَّهَ وَرَسُولَهُۥ وَيَسْعَوْنَ فِى
ٱلْأَرْضِ فَسَادًا أَن يُقَتَّلُوٓا۟ أَوْ يُصَلَّبُوٓا۟ أَوْ تُقَطَّعَ أَيْدِيهِمْ
وَأَرْجُلُهُم مِّنْ خِلَٰفٍ أَوْ يُنفَوْا۟ مِنَ ٱلْأَرْضِ ۚ ذَٰلِكَ
لَهُمْ خِزْىٌ فِى ٱلدُّنْيَا ۖ وَلَهُمْ فِى ٱلْءَاخِرَةِ عَذَابٌ عَظِيمٌ
﴿٣٣﴾ إِلَّا ٱلَّذِينَ تَابُوا۟ مِن قَبْلِ أَن تَقْدِرُوا۟ عَلَيْهِمْ ۖ فَٱعْلَمُوٓا۟
أَنَّ ٱللَّهَ غَفُورٌ رَّحِيمٌ ﴿٣٤﴾ يَٰٓأَيُّهَا ٱلَّذِينَ ءَامَنُوا۟ ٱتَّقُوا۟
ٱللَّهَ وَٱبْتَغُوٓا۟ إِلَيْهِ ٱلْوَسِيلَةَ وَجَٰهِدُوا۟ فِى سَبِيلِهِۦ
لَعَلَّكُمْ تُفْلِحُونَ ﴿٣٥﴾ إِنَّ ٱلَّذِينَ كَفَرُوا۟ لَوْ أَنَّ لَهُم
مَّا فِى ٱلْأَرْضِ جَمِيعًا وَمِثْلَهُۥ مَعَهُۥ لِيَفْتَدُوا۟ بِهِۦ مِنْ
عَذَابِ يَوْمِ ٱلْقِيَٰمَةِ مَا تُقُبِّلَ مِنْهُمْ ۖ وَلَهُمْ عَذَابٌ أَلِيمٌ ﴿٣٦﴾

2. Kur personi është përhapës i shkatërrimit në tokë, që kërcënon besimin, jetën dhe pasurinë e të tjerëve, ai vritet ose dënohet me vdekje. Të tillë mund të jenë qafirët e ndryshëm, renegatët e fesë, bidatçinjtë që përhapin bidatin e tyre, e keqja e të cilëve mund të ndalet veçse me luftimin dhe me vrasjen e tyre. Po kështu trajtohen edhe banditët e rrugëve, që kërcënojnë jetën, pasurinë dhe nderin e njerëzve.

Profetët sollën argumente të qarta nga Zoti i tyre, argumente që nuk të linin asnjë hapësirë për justifikim para Zotit, por shumica e njerëzve, edhe pas këtij qartësimi të prerë, që e bën të detyrueshëm përqendrimin në rrugën e drejtë, e teprojnë në tokë me gjynahe dhe me mosbindje ndaj porosive të Zotit dhe profetëve.

[34] Kështu, besimtari nuk vritet për qafirin.
[35] Kështu, babai ose nëna nuk ndëshkohen me vdekje, nëse kanë vrarë fëmijën e tyre.

Ajetet 33 – 34

33. Dënimi i atyre që luftojnë Allahun dhe të Dërguarin e Tij dhe bëjnë shkatërrime në tokë, është që të vriten, ose të gozhdohen, ose t'u priten duart dhe këmbët në të kundërt, ose të dëbohen nga vendi. Kjo *(masë ndëshkuese)* le të jetë si poshtërim për ta në dynja, ndërsa në botën tjetër ata do të kenë dënim të madh.
34. Këtu përjashtohen ata që pendohen para se t'i kapni. Dijeni mirë se Allahu është Falës, Mëshirëplotë.

Shpjegimi i ajeteve

- "Dënimi i atyre që luftojnë Allahun dhe të Dërguarin e Tij dhe bëjnë shkatërrime në tokë, është që të vriten, ose të gozhdohen, ose t'u priten duart dhe këmbët në të kundërt, ose të dëbohen nga vendi. Kjo *(masë ndëshkuese)* le të jetë si poshtërim për ta në dynja, ndërsa në botën tjetër ata do të kenë dënim të madh." - Armiqtë e Allahut dhe të Profetit janë ata që i kanë shfaqur luftë dhe kundërshtim të hapur atyre dhe kryejnë shkatërrime në tokë me kufër, me vrasje, me grabitje, duke përhapur panik, frikë dhe pasiguri.

Është një mendim i përgjithshëm se ky ajet tregon dispozitën për banditët, të cilët sulmojnë njerëzit nëpër lugina dhe rrugë dhe u grabisin pasurinë, që i vrasin dhe frikësojnë ata. Kështu, Allahu i Madhëruar na mëson se si duhet të veprohet me të tillë njerëz.

Komentuesit e Kur'ânit janë të mendimeve të ndryshme kur vjen fjala për përgjigjen e pyetjes: A janë udhëheqësit dhe gjykatësit të lirë të përzgjedhin në dhënien e këtyre ndëshkimeve? Pra, a mund të zgjidhet secila formë prej tyre si ndëshkim për çdo lloj banditi? Kështu, disa janë të mendimit që po, sepse këtë e tregon qartë ajeti.

Megjithatë, dijetarë të tjerë janë të mendimit se ndëshkimi që zgjidhet varet nga lloji i krimit të kryer. Pra, çdo krim ka ndëshkimin që meriton. Urtësia e ajetit e përfshin edhe këtë mendim, që është në përputhje me urtësinë e Allahut të Madhëruar. Kësisoj, nëse banditi ka grabitur dhe ka vrarë, bëhet e pashmangshme vrasja dhe kryqëzimi i tij, në mënyrë që të tremben dhe të marrin mësim të tjerët. Por nëse ai vetëm ka vrarë dhe nuk ka kryer grabitje, atëherë ai vetëm vritet. Nëse banditi ka grabitur, por nuk ka vrarë, atëherë atij i priten duart dhe këmbët në të kundërt, por nuk vritet. Po ashtu, nëse ai thjesht ka frikësuar njerëzit, por nuk ka vrarë e grabitur, atëherë internohet. Atij nuk i jepet mundësia të stabilizohet në një vend, derisa të pendohet qartë dhe dukshëm. Ky ka qenë mendimi i Ibni Abasit dhe i disa imamëve të mëdhenj, me ndonjë ndryshim të vogël.

Sido që të jetë ndëshkimi, ai është poshtërim dhe turpërim për kriminelët në jetën e kësaj dynjaje, ndërsa në ahiret ndëshkimi i tyre do të jetë i madh. Kjo tregon se banditizmi në rrugë konsiderohet si gjynah i madh, që shkakton poshtërim në jetën e dynjasë dhe ndëshkim në ahiret. Madje, kryesit e kësaj vepre konsiderohen si armiq dhe luftues të Allahut dhe Profetit.

Duke parë se sa e shëmtuar dhe sa e dënueshme është kjo vepër, mund të themi se eliminimi i banditëve, sigurimi i rrugëve dhe vendit nga vrasjet, vjedhjet e çnderimet janë nga veprat më të mira dhe më të shpërblyeshme nga Allahu i Madhëruar. Ato konsiderohen si rregullim i rendit, ashtu si të kundërtat e tyre quhen "prishje e rendit në tokë".

- "Këtu përjashtohen ata që pendohen para se t'i kapni. Dijeni mirë se Allahu është Falës, Mëshirëplotë." – Kuptimi: Nëse banditët pendohen para se të kapen nga autoritetet, atëherë ata nuk ndëshkohen në lidhje me hakun e Zotit, e po kështu edhe në lidhje me hakun e njerëzve, nëse kanë qenë qafirë gjatë kohës së krimit dhe kanë pranuar Islamin para se t'i kapin. Pra, këta

nuk vriten, nuk u priten duar e këmbë e nuk internohen.

Por nëse banditi ka qenë musliman, atëherë haku i njerëzve nuk rrëzohet, pra, ai do të ndëshkohet për vrasjen dhe grabitjen e pasurive. Ajeti tregon se, nëse banditi pendohet pasi e kanë kapur, atëherë ky pendim nuk e rrëzon ndëshkimin e tij në çdo lloj rasti.

Urtësia është shumë e qartë në këto gjykime. Nëse pendimi para kapjes së banditit bën dobi në rastin e krimit të luftës kundër Allahut dhe Profetit, atëherë kur bëhet fjalë për vepra të tjera poshtë tyre, pa dyshim që pendimi duhet të ndikojë më shumë në gjykim.

Ajeti 35

35. O ju që keni besuar! Kini frikë Allahun, përpiquni të afroheni tek Ai dhe luftoni në rrugën e Tij, që të jeni fitimtarë.

Shpjegimi i ajetit

- "O ju që keni besuar! Kini frikë Allahun..." - Ky është një urdhër që Allahu i Lartësuar u drejton robërve të Tij besimtarë për të plotësuar atë çka nënkupton imani i vërtetë. Ai i urdhëron për devotshmëri dhe për të qenë të kujdesshëm që të mos e zemërojnë Atë. Kjo kërkon që robi të përpiqet me gjithçka që mundet që të largohet nga çdo gjë që shkakton zemërimin dhe pakënaqësinë e Allahut të Madhëruar, siç janë gjynahet e zemrës, gjuhës dhe gjymtyrëve, të shfaqura dhe të fshehura qofshin. Robi duhet t'i mbështetet dhe t'i kërkojë ndihmë Zotit për t'iu larguar gjynaheve, sepse kështu do të mund të shpëtojë nga zemërimi dhe ndëshkimi i Tij.

- "...përpiquni të afroheni tek Ai..." – Pra, kërkoni të afroheni tek Ai, të bëni hapa drejt Tij, të tregoni dashurinë tuaj për Të. Kjo arrihet duke plotësuar detyrat ndaj Tij, qofshin ato detyra zemre, si: dashuria për Të dhe për hir të Tij, droja ndaj Tij, shpresa tek Ai, kthimi tek Ai me pendesë, mbështetja e plotë tek Ai etj.; apo vepra të gjymtyrëve, si zekati, haxhi etj.; apo vepra të zemrës dhe trupit njëkohësisht, si: namazi, leximi i Kur'ânit, dhikri apo lloje të ndryshme të bamirësisë ndaj krijesave. Bamirësia ndaj tyre mund të kryhet me pasuri, dituri, autoritet, me forcën fizike, me këshillën e mirë, duke i ndihmuar për të arritur çdo të mirë dhe për të shpëtuar nga çdo e keqe. Të gjitha këto vepra të afrojnë tek Allahu.

Robi do të vazhdojë të afrohet tek Allahu me vepra të mira, derisa Allahu ta dojë atë. Dhe kur Allahu e do një rob, atëherë Ai bëhet dëgjimi me të cilin robi dëgjon, bëhet shikimi me të cilin robi sheh, bëhet dora e tij me të cilën ai vepron dhe këmba me të cilën ai ecën. Në përfundim, sigurisht që Allahu do t'i përgjigjet lutjeve të këtij robi. [36]


Më pas, Allahu i Lartësuar përmend në mënyrë të veçantë xhihadin në rrugën e Tij, si një nga adhurimet që të afrojnë tek Ai. Xhihad quhet shpenzimi i të gjitha mundësive për të luftuar armikun, qoftë kjo me pasurinë tënde, me jetën, me mendimet dhe intelektin tënd, me gjuhën dhe forcën e fjalës, dhe me çdo formë të lejuar për të ndihmuar fenë e Zotit. Pa dyshim, ky lloj adhurimi është më i mrekullueshmi dhe më i rëndësishmi. Ai që arrin të jetë i plotësuar me xhihadin, ka për të qenë i tillë edhe në vepra të tjera të mira.

- "...luftoni në rrugën e Tij, që të jeni fitimtarë" – Kuptimi: Ju do të arrini *felah*-un, nëse tregoheni të devotshëm, duke iu larguar harameve, duke kërkuar afrimin tek Allahu nëpërmjet veprave të mira në bindje ndaj Tij dhe duke luftuar në rrugën e Tij, me synim kënaqësinë e Tij.

El felah është fitorja dhe arritja e çdo synimi, kënaqësie dhe mirësie, si dhe shpëtimi nga çdo ligësi, së cilës i druhesh. Me fjalë të tjera, *el felah* është arritja e lumturisë të përjetshme dhe e mirësisë së pafundme.

---

[36] Kështu thuhet në një *hadith kudsij* të njohur.


الجزء السادس سورة المائدة
يُرِيدُونَ أَن يَخْرُجُوا۟ مِنَ ٱلنَّارِ وَمَا هُم بِخَٰرِجِينَ مِنْهَا ۖ
وَلَهُمْ عَذَابٌ مُّقِيمٌ ﴿٣٧﴾ وَٱلسَّارِقُ وَٱلسَّارِقَةُ فَٱقْطَعُوٓا۟
أَيْدِيَهُمَا جَزَآءًۢ بِمَا كَسَبَا نَكَٰلًا مِّنَ ٱللَّهِ ۗ وَٱللَّهُ عَزِيزٌ
حَكِيمٌ ﴿٣٨﴾ فَمَن تَابَ مِنۢ بَعْدِ ظُلْمِهِۦ وَأَصْلَحَ فَإِنَّ ٱللَّهَ
يَتُوبُ عَلَيْهِ ۗ إِنَّ ٱللَّهَ غَفُورٌ رَّحِيمٌ ﴿٣٩﴾ أَلَمْ تَعْلَمْ أَنَّ ٱللَّهَ
لَهُۥ مُلْكُ ٱلسَّمَٰوَٰتِ وَٱلْأَرْضِ يُعَذِّبُ مَن يَشَآءُ وَيَغْفِرُ
لِمَن يَشَآءُ ۗ وَٱللَّهُ عَلَىٰ كُلِّ شَىْءٍ قَدِيرٌ ﴿٤٠﴾ ۞ يَٰٓأَيُّهَا
ٱلرَّسُولُ لَا يَحْزُنكَ ٱلَّذِينَ يُسَٰرِعُونَ فِى ٱلْكُفْرِ مِنَ
ٱلَّذِينَ قَالُوٓا۟ ءَامَنَّا بِأَفْوَٰهِهِمْ وَلَمْ تُؤْمِن قُلُوبُهُمْ ۛ وَمِنَ
ٱلَّذِينَ هَادُوا۟ ۛ سَمَّٰعُونَ لِلْكَذِبِ سَمَّٰعُونَ لِقَوْمٍ
ءَاخَرِينَ لَمْ يَأْتُوكَ ۖ يُحَرِّفُونَ ٱلْكَلِمَ مِنۢ بَعْدِ مَوَاضِعِهِۦ ۖ
يَقُولُونَ إِنْ أُوتِيتُمْ هَٰذَا فَخُذُوهُ وَإِن لَّمْ تُؤْتَوْهُ
فَٱحْذَرُوا۟ ۚ وَمَن يُرِدِ ٱللَّهُ فِتْنَتَهُۥ فَلَن تَمْلِكَ لَهُۥ مِنَ ٱللَّهِ
شَيْـًٔا ۚ أُو۟لَٰٓئِكَ ٱلَّذِينَ لَمْ يُرِدِ ٱللَّهُ أَن يُطَهِّرَ قُلُوبَهُمْ ۚ لَهُمْ
فِى ٱلدُّنْيَا خِزْىٌ ۖ وَلَهُمْ فِى ٱلْءَاخِرَةِ عَذَابٌ عَظِيمٌ ﴿٤١﴾
١١٤

Ajetet 36 – 37

36. Atyre që mohuan, edhe sikur të jepnin gjithë ç'ka në tokë, madje edhe njëherë aq sa ajo, për ta dhënë si shpagim e shpëtim nga dënimi i Ditës së Kijametit, atyre nuk do t'u pranohet. Ata do të kenë një dënim të dhembshëm.

37. Ata do përpiqen të dalin nga Zjarri, por s'kanë për të dalë nga ai. Dënimi i tyre do të jetë i përhershëm.

Shpjegimi i ajeteve

Allahu i Madhëruar na tregon për gjendjen e keqe të qafirëve në Ditën e Gjykimit dhe për fundin e tyre të tmerrshëm. Edhe sikur të shpenzonin gjithë tokën të mbushur plot me ar, e bashkë me të edhe njëherë sa ajo, kjo nuk do të pranohej prej tyre dhe nuk do t'u sillte asnjë dobi e përfitim. Koha dhe vendi kur mund të pranoheshin kompensimet dhe pendimi, tashmë kanë kaluar me kohë. Tani ka mbetur veçse ndëshkimi i dhimbshëm, torturues dhe i përjetshëm, prej të cilit nuk kanë për të shpëtuar kurrë. Atje do të qëndrojnë në jetë të jetëve.

Ajetet 38 – 40

38. Vjedhësit dhe vjedhëses ua pritni duart, si ndëshkim për veprën e kryer dhe si dënim nga Allahu. Allahu është Krenar e i Urtë.

39. E kush pendohet pas padrejtësisë së tij dhe përmirësohet, nuk ka dyshim se Allahu ia pranon pendimin. Me të vërtetë, Allahu është Falës e Mëshirëplotë.

40. A nuk e di ti se vetëm Allahut i takon sundimi i qiejve dhe i tokës? Ai ndëshkon atë që do dhe e fal atë që do. Allahu është i Plotfuqishëm për çdo gjë.

Shpjegimi i ajeteve

- "Vjedhësit dhe vjedhëses ua pritni duart" – 'Vjedhës', që meriton këtë ndëshkim të përcaktuar në Sheriat, quhet ai që merr pasurinë e vlefshme të tjetrit fshehtazi dhe pa pëlqimin e pronarit të saj. Vjedhja është një gjynah i madh, që ka ndëshkim të ashpër dhe poshtërues, prerjen e dorës së djathtë, ashtu siç vjen në variantin e leximit të këtij ajeti nga disa sahabë.

Me fjalën "dorë", kur nuk përcaktohet, kuptohet gjymtyra e dorës deri te kyçi. Kështu, nëse dikush vjedh, atij i pritet dora deri te kyçi, si ndëshkim, dhe i zhytet në vaj të nxehtë, që të mbyllen damarët dhe të mos humbasë gjak.

Ky ajet përfshin në kuptimin e tij çdo rast vjedhjeje, por Suneti i Profetit (a.s.) e kufizon atë në disa aspekte, si dhe përcakton disa kushte shtesë, për ta bërë të meritueshëm prerjen e dorës së vjedhësit:

1. Ruajtja. Pra, pasuria e vjedhur duhet të ketë qenë e ruajtur dhe e fshehur mjaftueshëm nga pronari i saj. Nëse është

vjedhur diçka që nuk ka qenë e fshehur, por e thjeshtë për t'u gjetur, në një rast të tillë nuk ekzekutohet dënimi i prerjes së dorës.

2. Masa e pasurisë së vjedhur. Pra, jo për çdo masë pasurie të vjedhur meritohet prerja. Masa e përcaktuar nga Sheriati është një çerek dinari (floriri), ose 3 dirhemë (argjendi), ose masa e përafërt me to. Nëse dikush vjedh një masë pasurie më të vogël se kaq, atëherë nuk meriton prerjen e dorës.

Në fakt, edhe fjala 'vjedhje' në vetvete të jep të kuptosh se bëhet fjalë për marrje të një pasurie të fshehur ose, në të kundërt, ajo nuk quhet 'vjedhje' me kuptimin e përcaktuar nga Sheriati. Po kështu, urtësia tregon se dora nuk mund të pritet për diçka të parëndësishme dhe të pavlerë. Pra, edhe nëse nuk do të kishim argument nga Suneti i Profetit (a.s.), atëherë thjesht dhe vetëm urtësia dhe qëllimet e Sheriatit do të mjaftonin si kufizime të këtij ajeti të përgjithshëm.

Urtësia e ligjërimit të prerjes së dorës për krimin e vjedhjes është ruajtja e pasurisë së njeriut dhe sigurimi i saj. Kështu, gjymtyra me të cilin kryhet krimi duhet të pritet. Nëse ky kriminel vjedh përsëri, i pritet këmba e majtë. Nëse përsëri vjedh, atëherë për këtë ka dy mendime: ose i pritet dora e majtë, pastaj këmba e djathtë, ose burgoset derisa të vdesë. Allahu i Lartësuar thotë:

- "...si ndëshkim për veprën e kryer dhe si dënim nga Allahu." - Prerja e dorës është si ndëshkim për hajdutin, për krimin e vjedhjes së pasurisë së njerëzve, dhe si frikësim i hajdutit dhe i të tjerëve për t'u frenuar dhe larguar nga krimi. Nëse njerëzit shohin ndëshkimin e vjedhjes dhe sigurohen se ashtu do t'u ndodhë po e kryen ata, sigurisht do të frenohen dhe do të ndalen nga ky krim.


- "Allahu është Krenar e i Urtë" - I Madhëruari është Krenar dhe i Pamposhtur, prandaj askush nuk duhet t'i thyejë ligjet e Tij. Ai është i Urtë, dhe urtësia e Tij kërkon që dënimi i vjedhësit të jetë prerja e dorës.

- "E kush pendohet pas padrejtësisë së tij dhe përmirësohet, nuk ka dyshim se Allahu ia pranon pendimin. Me të vërtetë, Allahu është Falës e Mëshirëplotë." - Allahu i Madhëruar ia mbulon të metat dhe ia fal gabimet atij që pendohet sinqerisht dhe përpiqet t'i rregullojë të metat e tij. Allahu e ndihmon dhe ia lehtëson pendimin, dhe pastaj ia pranon atë, me mëshirën dhe faljen e Tij të gjerë.

- "A nuk e di ti se vetëm Allahut i takon sundimi i qiejve dhe i tokës? Ai ndëshkon atë që do dhe e fal atë që do. Allahu është i Plotfuqishëm për çdo gjë." - Allahu është Mbreti dhe Sunduesi i qiejve dhe i tokës. Ai vepron dhe përcakton në mbretërinë e Tij çfarë dëshiron, si prej ligjeve të ekzistencës dhe krijimit, ashtu edhe prej ligjeve të Sheriatit dhe fesë. Krijimi është krijimi i Tij dhe ligjet janë ligjet e Tij. Po kështu, edhe falja dhe ndëshkimi janë pushtet i Tij dhe vetëm të Tij. Ai i vendos ndëshkimin dhe shpërblimin, krijimin dhe ligjet, sipas urtësisë, mëshirës dhe faljes së Tij të gjerë dhe gjithëpërfshirëse.

Ajetet 41 – 44

41. O ti i Dërguar! Mos u brengos për ata që nguten për në mosbesim, të cilët me gojët e tyre thonë: "Kemi besuar", ndërsa zemrat e tyre ende nuk kanë besuar, e as për judejtë, të cilët aq shumë e pasojnë gënjeshtrën dhe i binden një populli që nuk vijnë te ti. Ata i ndryshojnë kuptimet e fjalëve dhe thonë: "Nëse ju jepet kështu, pranojeni, e nëse nuk ju jepet kështu, atëherë ruhuni dhe mos e pranoni!" Por atë që Allahu dëshiron ta lërë në humbje, ti nuk mund ta shpëtosh. Këta janë ata të cilëve Allahu nuk do t'ua pastrojë zemrat. Ata, në këtë jetë, kanë


الجزء السادس سورة المائدة
سَمَّٰعُونَ لِلْكَذِبِ أَكَّٰلُونَ لِلسُّحْتِ ۚ فَإِن جَآءُوكَ
فَٱحْكُم بَيْنَهُمْ أَوْ أَعْرِضْ عَنْهُمْ ۖ وَإِن تُعْرِضْ عَنْهُمْ فَلَن
يَضُرُّوكَ شَيْـًٔا ۖ وَإِنْ حَكَمْتَ فَٱحْكُم بَيْنَهُم بِٱلْقِسْطِ ۖ
إِنَّ ٱللَّهَ يُحِبُّ ٱلْمُقْسِطِينَ ﴿٤٢﴾ وَكَيْفَ يُحَكِّمُونَكَ
وَعِندَهُمُ ٱلتَّوْرَىٰةُ فِيهَا حُكْمُ ٱللَّهِ ثُمَّ يَتَوَلَّوْنَ مِنۢ بَعْدِ
ذَٰلِكَ ۚ وَمَآ أُو۟لَٰٓئِكَ بِٱلْمُؤْمِنِينَ ﴿٤٣﴾ إِنَّآ أَنزَلْنَا ٱلتَّوْرَىٰةَ
فِيهَا هُدًى وَنُورٌ ۚ يَحْكُمُ بِهَا ٱلنَّبِيُّونَ ٱلَّذِينَ أَسْلَمُوا۟
لِلَّذِينَ هَادُوا۟ وَٱلرَّبَّٰنِيُّونَ وَٱلْأَحْبَارُ بِمَا ٱسْتُحْفِظُوا۟ مِن
كِتَٰبِ ٱللَّهِ وَكَانُوا۟ عَلَيْهِ شُهَدَآءَ ۚ فَلَا تَخْشَوُا۟ ٱلنَّاسَ
وَٱخْشَوْنِ وَلَا تَشْتَرُوا۟ بِـَٔايَٰتِى ثَمَنًا قَلِيلًا ۚ وَمَن لَّمْ يَحْكُم
بِمَآ أَنزَلَ ٱللَّهُ فَأُو۟لَٰٓئِكَ هُمُ ٱلْكَٰفِرُونَ ﴿٤٤﴾ وَكَتَبْنَا
عَلَيْهِمْ فِيهَآ أَنَّ ٱلنَّفْسَ بِٱلنَّفْسِ وَٱلْعَيْنَ بِٱلْعَيْنِ وَٱلْأَنفَ
بِٱلْأَنفِ وَٱلْأُذُنَ بِٱلْأُذُنِ وَٱلسِّنَّ بِٱلسِّنِّ وَٱلْجُرُوحَ
قِصَاصٌ ۚ فَمَن تَصَدَّقَ بِهِۦ فَهُوَ كَفَّارَةٌ لَّهُۥ ۚ وَمَن
لَّمْ يَحْكُم بِمَآ أَنزَلَ ٱللَّهُ فَأُو۟لَٰٓئِكَ هُمُ ٱلظَّٰلِمُونَ ﴿٤٥﴾
١١٥

poshtërim, kurse në jetën tjetër kanë dënim të madh.

42. **Janë ata të cilët aq shumë e pasojnë gënjeshtrën dhe e hanë haramin. Në qoftë se vijnë te ti *(për ndonjë gjykim)*, gjyko mes tyre ose distancohu prej tyre. Nëse prapsesh prej tyre, ata nuk mund të të bëjnë ty asnjë të keqe. Por nëse gjykon mes tyre, gjyko me drejtësi, se, me të vërtetë, Allahu i do të drejtit.**

43. **E si e kërkojnë gjykimin tënd, kur ata kanë Teuratin, në të cilin është gjykimi i Allahut, e megjithatë e refuzojnë atë?! Ata nuk janë besimtarë.**

44. **Ne e zbritëm Teuratin, në të cilin është udhëzimi i drejtë dhe drita. Sipas tij gjykuan pejgamberët e bindur mes judejve. Me të gjykuan edhe dijetarët e devotshëm e paria fetare, të cilët ishin të obliguar ta ruanin Librin e Allahut, për të cilin ishin dëshmitarë. Prandaj, mos u frikësoni nga njerëzit, por vetëm Mua të më frikësoheni! Dhe mos i ndërroni argumentet e Mia me çmime aq të ulta! Kush nuk gjykon me ligjin që ka shpallur Allahu, ai është mohues.**

Shpjegimi i ajeteve

- "O ti i Dërguar! Mos u brengos për ata që nguten për në mosbesim..." - Profeti (a.s.) ishte tepër i angazhuar në udhëzimin e njerëzve dhe shqetësohej shumë për ta. Për këtë arsye, nëse ndonjëri prej atyre që, në fakt, thjesht sa shfaqej si besimtar, largohej, kthehej në kufër, Profeti (a.s.) trishtohej shumë. Por Allahu i Lartësuar e udhëzoi që të mos shqetësohej për ata lloj njerëzish, sepse ata ishin as mish e as peshk. Nëse ishin të pranishëm, nuk sillnin ndonjë dobi, e nëse mungonin, kjo mungesë e tyre nuk ndihej.

Pastaj i Madhëruari shpjegon shkakun pse Profeti (a.s.) nuk duhet të shqetësohej për këta:

- "...të cilët me gojët e tyre thonë: "Kemi besuar", ndërsa zemrat e tyre ende nuk kanë besuar..." - Ata për të cilët duhet të shqetësohesh janë besimtarët e vërtetë, me zemër dhe me trup. Allahu i Madhëruar është i pastër nga çdo e metë, që mund të lejojë që besimtarët e vërtetë të kthehen nga besimi i tyre dhe ta lëshojnë fenë e Tij. Nuk ka dyshim se, kur imani futet thellë në zemër, njeriu nuk e braktis kurrë atë dhe kurrë nuk kërkon ta zëvendësojë.

- "...e as për judejtë, të cilët aq shumë e pasojnë gënjeshtrën dhe i binden një populli që nuk vijnë te ti." – Kuptimi: Prej judejve ka të tillë që kurrë nuk të pranojnë, por thjesht pasojnë verbërisht krerët e tyre, të cilët çdo gjë e kanë ndërtuar mbi nënshtrimin, humbjen dhe devijimin. Këta krerë, që kanë hapur rrugët e humbjes, nuk erdhën kurrë tek ti për të dëgjuar dhe për të

mësuar të vërtetën. Ata të kthyen shpinën dhe u vetëkënaqën me gënjeshtrat e tyre.

- "Ata i ndryshojnë kuptimet e fjalëve…" - Ata kënaqeshin me tjetërsimin e kumtit të fjalëve, duke u dhënë atyre kuptime të pasakta e të pavërteta, kuptime që Allahu i Madhëruar kurrë nuk i ka synuar dhe dëshiruar. E gjitha kjo, për të devijuar njerëzinë dhe për të refuzuar të vërtetën.

Kështu, ata judej pasonin verbërisht ftuesit për në humbje; ata pasonin diçka të pamundur dhe të pavërtetë. Ata nuk e vinin në përdorim logjikën dhe nuk kishin as synimin më të vogël për të gjetur të vërtetën.

Për të tillë njerëz, - thotë ajeti, - mos u shqetëso dhe mos të të vijë keq, nëse nuk të pasojnë. Ata janë shumë të mangët, dhe për të mangëtit nuk duhet të brengosesh.

- "…dhe thonë: "Nëse ju jepet kështu, pranojeni, e nëse nuk ju jepet kështu, atëherë ruhuni dhe mos e pranoni!"" - Ata i thonin këto fjalë kur shkonin që të dëgjonin gjykimin e Profetit (a.s.) për ndonjë çështje të tyre. Por ata nuk kishin qëllim tjetër, veç pasimit të dëshirave të tyre. Kështu, ata i thonin njëri-tjetrit: "Nëse Muhamedi jep këtë lloj gjykimi, që ju vjen pas oreksit, atëherë pranojeni dhe zbatojeni atë. Por nëse ai nuk gjykon sipas dëshirave tuaja, atëherë kujdes dhe mos e pasoni!" Kjo ishte sigurisht një e keqe e madhe, sepse ishte thjesht pasim i dëshirave dhe pasioneve.

- "Por atë që Allahu dëshiron ta lërë në humbje, ti nuk mund ta shpëtosh." - Kjo i ngjan ajetit kur'ânor: "Ti nuk mund të udhëzosh atë që e do, por është Allahu Ai që udhëzon atë që dëshiron".

- "Këta janë ata të cilëve Allahu nuk do t'ua pastrojë zemrat." - Pikërisht për këtë arsye erdhi prej tyre ajo që erdhi. Ajeti tregon se, kur dikush gjykon dhe punon me Sheriat thjesht që të përmbushë dëshirat e veta, atëherë kjo është shenjë e papastërtisë së zemrës së tij. Ndryshe thuhet për atë që gjykon me Sheriat duke synuar zbulimin e së vërtetës dhe punën me të dhe, veç kësaj, kënaqet dhe tregon përunjësi në zbatimin e tij. Kjo, pa dyshim, është shenjë e pastërtisë së zemrës, e cila është shkak për arritjen e çdo të mire. Pastërtia e zemrës është faktori dhe burimi kryesor i çdo fjale të drejtë dhe pune të mirë e të pranueshme te Zoti.

- "Ata, në këtë jetë, kanë poshtërim, kurse në jetën tjetër kanë dënim të madh." - Në dynja, atyre të mjerëve, zemrat e të cilëve nuk u pastruan, u takon poshtërimi dhe turpi, ndërsa në ahiret i pret ndëshkimi i dhembshëm në Zjarr dhe zemërimi i të Pamposhturit, Ndëshkuesit të rreptë dhe Nënshtruesit të gjithçkaje.

- "Janë ata të cilët aq shumë e pasojnë gënjeshtrën dhe e hanë haramin." - Për shkak të mendjelehtësisë, ata dëgjonin dhe i bindeshin parisë së tyre, të cilët i ftonin në gënjeshtra dhe trillime. Përveç kësaj, ata ishin ngrënës të babëzitur të pasurisë haram.

- "Në qoftë se vijnë te ti *(për ndonjë gjykim)*, gjyko mes tyre ose distancohu prej tyre. Nëse prapsesh prej tyre, ata nuk mund të të bëjnë ty asnjë të keqe." – Kuptimi: Ti je i lirë në dhënien e gjykimit ose jo për këta lloj njerëzish, të cilët, në fakt, nuk synojnë të mësojnë gjykimin e Zotit.

Por, a është ky një gjykim i anuluar apo jo? Jo. Ky është një gjykim në fuqi edhe sot. Kësisoj, çdo njeri me të drejtë fetvaje, nëse sheh dhe gjykon se pyetësi apo kërkuesi i fetvasë nuk ka qëllim që të zbulojë të vërtetën dhe të punojë me të, ai është i lirë që të veprojë si ta shikojë më të arsyeshme dhe të urtë: ose të gjykojë dhe të japë përgjigje për pyetjen e drejtuar, ose të heshtë dhe të heqë dorë nga gjykimi. Pra, në një rast të tillë, nuk është detyrë për të që të përgjigjet dhe të gjykojë. Megjithatë, nëse vendos të gjykojë, duhet të gjykojë me drejtësi. Prandaj i Lartësuari i thotë:

- "Por nëse gjykon mes tyre, gjyko me drejtësi, se, me të vërtetë, Allahu i do të drejtit." - Edhe nëse pyetësit mund të jenë zullumqarë apo armiq, kjo nuk duhet të pengojë që gjykimi i tyre të bëhet me drejtësi dhe urtësi.

Kjo tregon për vlerën e madhe të gjykimit me drejtësi. Allahu i Madhëruar e do gjykimin me drejtësi dhe saktësi.

Më pas, Allahu i Madhëruar flet për veprat e tyre, të cilat janë të çuditshme:

- "E si e kërkojnë gjykimin tënd, kur ata kanë Teuratin, në të cilin është gjykimi i Allahut, e megjithatë e refuzojnë atë?! Ata nuk janë besimtarë." - Nëse ata do të ishin besimtarë të vërtetë dhe do të zbatonin gjithçka që kërkon besimi, atëherë kurrë nuk do të devijonin nga gjykimi i drejtë që gjendet në Teurat. Po të ishin vërtet të sinqertë, ata nuk do të vinin tek ti me shpresë se do të gjenin ndonjë gjykim tjetër, që do t'u shkonte pas oreksit. Edhe kur ti gjykove me drejtësi me ligjin e Zotit, që është plotësisht në përputhje me tekstet e tyre fetare, ata nuk e pranuan dhe nuk u kënaqën, por të kthyen shpinën.

Këta lloj njerëzish, sikurse thotë i Madhëruari: "nuk janë besimtarë", sepse nuk janë këto sjellje të besimtarëve. Të tilla sjellje nuk kanë lidhje me besimin dhe besimtarët. Këta nuk mund ta gëzojnë imanin, sepse ata adhurojnë epshin e tyre, të cilin e duan, i nënshtrohen dhe e pasojnë. Ligjet e imanit ata ia nënshtrojnë 'ligjeve' të dëshirave të tyre.

- "Ne e zbritëm Teuratin, në të cilin është udhëzimi i drejtë dhe drita." - Allahu i Lartësuar ia shpalli Teuratin Musait, të birit të Imranit (a.s.). Nëpërmjet Teuratit, Allahu i Lartësuar udhëzoi në fenë e drejtë dhe i ruajti besimtarët nga humbja dhe devijimi. Kështu, Teurati u bë dritë, nëpërmjet së cilës do të ndriçoheshin njerëzit nga errësirat e injorancës, dyshimeve dhe pasioneve të shfrenuara, sikurse thotë i Lartësuari: "Ne i patëm dhënë Musait e Harunit Furkanin *(dalluesin mes të vërtetës e të kotës - Tevratin)*, që ishte dritë e këshillë për të devotshmit. Të cilët ia kanë frikën Zotit të tyre edhe pse nuk e shohin dhe ata të cilët i druhen Kiametit. [El enbija 48, 49].

- "Sipas tij gjykuan pejgamberët e bindur mes judejve." - Profetët pas Musait (a.s.) i gjykonin judejtë nëpërmjet Teuratit, në çështjet që ndodhnin dhe hapeshin mes tyre. Këta profetë, të cilët, sikurse thotë i Madhëruari: "*eslemu*", pra, u ishin dorëzuar urdhëresave të Zotit dhe ky dorëzim i tyre ishte më i plotë sesa i të tjerëve. Ata ishin të zgjedhurit e Allahut dhe më të dalluarit në besim.

Kështu, nëse ata profetë të nderuar, që ishin krijesat më të zgjedhura dhe më të mira, iu nënshtruan urdhëresave të Teuratit, ecën sipas tyre dhe i zbatuan ato edhe në jetën e tyre, atëherë çfarë i pengoi ata judej të mjerë dhe të parëndësishëm që të nënshtroheshin dhe të jetonin sipas tij?! Çfarë i bëri ata të mohonin çështjen më të rëndësishme të besimit, pra, besimin në Muhamedin dhe në Shpalljen e tij, edhe pse pohohej në librat e tyre?! Aq më tepër kur dihet se asnjë vepër e jashtme apo e fshehur nuk pranohet nga Zoti pa besuar në Profetin e fundit, Profetin e mëshirës. Vallë, a kishin ndonjë justifikim për mosbesimin e tyre? A kishin ndonjë udhërrëfyes që u diktonte këtë rrugë? Po! Është e vërtetë që ata kishin udhërrëfyes, por edhe vetë këta udhërrëfyes e kishin në natyrën e tyre tjetërsimin dhe shtrembërimin e mesazheve të Zotit dhe profetëve. Qëllimi kryesor dhe i vetëm i tyre ishte thjesht qëndrimi në krye të posteve, ruajtja e ofiqeve dhe e interesave të tyre materiale, duke fshehur të vërtetën dhe duke reklamuar dhe ftuar në të kotën. Ata ishin udhëheqësit e humbjes dhe shkatërrimit, që ftonin për në zjarrin e Xhehenemit.

- "Me të gjykuan edhe dijetarët e devotshëm e paria fetare, të cilët ishin të obliguar ta ruanin Librin e Allahut, për të cilin ishin dëshmitarë." - Te judejtë, me Teurat gjykonin edhe kleri me dijetarët e vërtetë. Ata ishin udhëheqës të drejtë dhe edukatorë të mirë. Ata punonin me dijen e Zotit, ftonin popullin në të vërtetën dhe e edukonin me urtësi dhe besim të pastër. Ata punonin pa u lodhur për të ftuar njerëzit në njëshmërinë e Zotit. Ata ndiqnin rrugën e pastër dhe të sigurt të profetëve dhe karakterizoheshin nga një dhembshuri e madhe për popullin e tyre. Këta Zoti i quajti "*el rabbanijin*" - edukatorë. Ndërsa *el ahbaru*-t ishin dijetarët e mëdhenj, me urtësinë e të cilëve udhëzoheshin dhe merrnin shembull njerëzia. Ata ishin dijetarë, gjurmët dhe fama e të cilëve mbeti ndër popujt e tyre.

Gjykimet e *rabanijin*-ëve dhe *ahbar*-ëve bazoheshin tek e vërteta, te Shpallja e Zotit, të cilën ishin betuar dhe zotuar që ta ruanin të paprekur në origjinalitetin e saj. Allahu i Madhëruar e la në përgjegjësinë e tyre ruajtjen e Shpalljes të paprekur dhe të pacenuar. Ata do të ishin dëshmuesit, që do të dallonin dhe ndanin të vërtetën nga e pavërteta. Ata duhej të ishin besnikët dhe mbrojtësit e Shpalljes. Ishte detyrë dhe përgjegjësi e madhe për ta, që të mos i shtonin a pakësonin gjë Shpalljes dhe të mos e fshihnin atë nga të tjerët. Madje, për ta ishte detyrë që t'ua mësonin atë të tjerëve të pastër, ashtu sikurse Zoti e shpalli. Ata ishin dëshmues të së vërtetës dhe njerëzit duhet të ktheheshin tek ata për çdo paqartësi dhe shtjellim të nevojshëm.

Allahu i Lartësuar i ka ngarkuar dijetarët me përgjegjësi që nuk i kanë të paditurit. Prandaj është detyrë për dijetarët që t'i jepnin hakun kësaj përgjegjësie të ngarkuar nga i Madhërueshmi. Dijetarët nuk duhet të jenë dembelë, si injorantët, dhe as duhet të mjaftohen me nivelin e tyre të adhurimeve. Është e vërtetë që edhe ata mund të shpëtojnë, ashtu si dhe njerëzit e thjeshtë e të paditur, duke kryer vetëm disa adhurime kryesore, të përcaktuara nga Zoti si shpëtimtare, por niveli i lartë i dijetarëve kërkon adhurime më të shumta, më speciale e më të sinqerta, për të mbajtur me sukses përgjegjësinë e rëndë të ngarkuar nga Zoti. Për ta mbajtur me sukses këtë peshë, ata duhet të ngrihen lart me adhurime më të shumta, me dhikër e me namaz më të përkushtuar, me zekat, agjërime, haxh etj., etj. Përveç faktit se duhet të dallohen në veprat e mira që kryejnë si adhurim ndaj Zotit, dijetarëve u kërkohet edhe që t'u mësojnë njerëzve të vërtetën, dhe këtë ta bëjnë si edukatorë të urtë, të mëshirshëm dhe të dhembsur. Ata duhet t'u mësojnë njerëzve gjithçka që kanë nevojë të dinë për fenë e tyre, sidomos për çështjet themelore, të cilat duhet patjetër të dihen. Ata kurrë nuk duhet t'u frikësohen njerëzve dhe t'u vijnë pas oreksit në dijen që përhapin, por duhet t'i frikësohen Allahut të Lartësuar dhe përgjegjësisë para Tij. Prandaj i Lartësuar thotë:

- "Prandaj, mos u frikësoni nga njerëzit, por vetëm Mua të më frikësoheni! Dhe mos i ndërroni argumentet e Mia me çmime aq të ulta!" – Kuptimi: Nuk duhet që, për hir të një shpërblimi të vogël e të parëndësishëm të kësaj dynjaje, ju të fshihni të vërtetën dhe të reklamoni të gabuarën.

Nëse dijetari është i ruajtur dhe i kujdesshëm që të mos bjerë në të tilla gabime, kjo tregon se atij i është dhënë sukses. Ja disa shenja që tregojnë se dijetari është i vërtetë, i suksesshëm dhe i lumtur:

1. Nëse përpiqet në kërkimin e dijes dhe përhapjen e saj dhe është i ndërgjegjshëm që Allahu i Madhëruar i ka ngarkuar këtë amanet, duke e bërë dëshmues të drejtë të së të vërtetës.

2. Nëse i frikësohet Zotit dhe kurrë nuk e pengon frika ndaj njerëzve apo nga e keqja

që mund të vijë prej tyre, që ai t'i përmbushë me besnikëri përgjegjësitë e tij si dijetar.

3. Nëse nuk i jep përparësi dynjasë kundrejt ahiretit, por çështja që e shqetëson më shumë është korrektësia me detyrën e ngarkuar nga Zoti.

Ndërsa nga shenjat e dëshpërimit dhe dështimit të një dijetari, mund të përmendim:

1. Është i zhytur në kotësira e mungesë aktiviteti, duke mos u angazhuar për plotësimin e përgjegjësive të tij.

2. Nuk i jep rëndësi diturisë, të cilën Zoti ia ka dhënë për ta ruajtur, zbatuar dhe për të ftuar të tjerët në të, por e humbet, e shpërfill dhe e braktis atë.

3. E shet fenë, në këmbim të interesave të kësaj dynjaje.

4. Pranon rryshfet në këmbim të së vërtetës, ose pranon pasuri për të dhënë fetva sipas oreksit të njerëzve.

5. I mëson njerëzit veçse në këmbim të pasurisë dhe dhuratave.

Këta të mjerë shpërfillin një privilegj të jashtëzakonshëm, nga i cili privohen shumë të tjerë, duke mos i dhënë hakun që meriton.

O Zoti dhe i Adhuruari ynë! Të lutemi të na dhurosh dije të dobishme, punë të sinqerta dhe të pranuara prej Teje dhe të na ruash me faljen, butësinë, mëshirën dhe bujarinë Tënde nga një fatkeqësi e tillë! O Bujar e i Gjithëmëshirshëm! Na ruaj nga të tilla skuta të errëta dhe të frikshme!

- "Kush nuk gjykon me ligjin që ka shpallur Allahu, ai është mohues." - Ata të cilët nuk gjykojnë me të vërtetën e qartë që shpalli Zoti, por gjykojnë me të kotën, për kotësinë e së cilës janë të vetëdijshëm, ata janë qafirë, mohues.

Kështu, gjykimi jo me ligjin e Zotit është vepër e mohuesve. Kjo vepër mund të të nxjerrë nga Islami, në rast se beson se ajo është e lejueshme për t'u kryer. Por nëse e beson se ajo është vepër e ndaluar dhe se ligji i Zotit është i vetmi ligj që duhet besuar e zbatuar në gjykim, dhe, për shkaqe të tjera, gjykon jo me ligjin e Tij, kjo sigurisht konsiderohet si një nga gjynahet më të mëdha, si një prej veprave të kufrit, dhe ai që e kryen meriton ndëshkim të rëndë nga Allahu.

Ajeti 45

45. Ne u caktuam atyre në Teurat: jeta me jetë, syri me sy, hunda me hundë, veshi me vesh, dhëmbi me dhëmb dhe plaga me masë ndëshkimore. Për atë që fal, ka shlyerje gjynahesh. Ata që nuk gjykojnë me atë që ka shpallur Allahu, ata janë zullumqarë.

Shpjegimi i ajetit

- "Ne u caktuam atyre në Teurat: jeta me jetë, syri me sy, hunda me hundë, veshi me vesh, dhëmbi me dhëmb dhe plaga me masë ndëshkimore." - Këto janë disa ligje me të cilat gjykonin profetët dhe dijetarët e vjetër. Allahu i Madhëruar i urdhëroi ata që, nëse dikush vret dikë pa të drejtë, me paramendim dhe është *mukâfiun* [37], atëherë ai duhet të vritet. Gjithashtu, syri të nxirret për syrin e nxjerrë, veshi për veshin, dhëmbi për dhëmbin etj. Këtu janë përmendur disa organe për të cilat është i mundur shpagimi në të njëjtën masë, pa e tepruar. Edhe në rastin e plagëve, shpagimi bëhet me të njëjtën masë. Nëse dikush plagos dikë me qëllim, ai plagoset njëlloj dhe në të njëjtën masë, si në drejtim të gjatësisë së plagës, ashtu edhe në drejtim të gjerësisë, thellësisë, vendit të saj etj.

Le të mësohet se ligjet e popujve para nesh konsiderohen si ligje edhe për ne, nëse nuk ka argument në Sheriatin tonë që të zhvleftësojë dhe pengojë atë. [38]

---

[37] Pra i të njëjtit nivel me të vrarin. Kështu besimtari nuk vritet për qafirin

[38] Këto ligje bëhen argument për ne për shkak të pohimit dhe miratimit të tyre nga sherijati ynë.


- "Për atë që fal, ka shlyerje gjynahesh." – Pra, nëse dikush e fal gjakun, plagët ose dëmin që i kanë shkaktuar, pasi është vërtetuar e drejta e tij e plotë për të marrë shpagim, kjo konsiderohet si bamirësi kundrejt dëmtuesit. Nëse njeriu fal, edhe Allahu i Madhëruar, i Cili është Falësi më i madh dhe i Gjithëmëshirshëm, e fal dëmtuesin. Gjithashtu, Allahu i Madhëruar është Falës dhe i Mëshirshëm edhe për falësin e bamirësin: ashtu sikurse ai e fal dëmtuesin, ashtu edhe Allahu ia fal atij gabimet që mund të ketë kryer.

- "Ata që nuk gjykojnë me atë që ka shpallur Allahu, ata janë zullumqarë." - Ibn Abasi ka thënë: "Ka mohim e mohim, zullum e zullum, teprim e teprim!". Pra, jo të gjitha llojet e mohimit, zullumit dhe teprimit janë në të njëjtin nivel. Ato nuk janë në të gjitha rastet gjynahe që të nxjerrin nga Islami, ose që e bëjnë vepruesin e tyre të meritojë përjetësinë në Zjarr. Zullumi të nxjerr nga Islami nëse gjynahqari e konsideron dhe e beson një haram që e bën si diçka hallall dhe të lejuar. Ndërsa në të kundërt, nëse e beson dhe e pranon se veprimi është padrejtësi dhe i ndaluar, atëherë veprimi i tij quhet si gjynah i madh.

Ajetet 46 – 47

46. Ne vazhduam gjurmët e tyre *(të pejgamberëve)* me Isain, birin e Merjemes, vërtetues i Teuratit, që e kishin më pranë. Atij i dhamë Ungjillin, që ishte udhëzim dhe dritë, vërtetues i Teuratit që kishin pranë, si dhe udhëzues e këshillues për të devotshmit.

47. Le të gjykojnë ithtarët e Ungjillit sipas asaj që Allahu ka shpallur në të. E kush nuk gjykon sipas asaj që Allahu ka shpallur, të tillët janë gjynahqarë, të dalë jashtë rrugës së Zotit.



Shpjegimi i ajeteve

- "Ne vazhduam gjurmët e tyre *(të pejgamberëve)* me Isain, birin e Merjemes, vërtetues i Teuratit, që e kishin më pranë." – Kuptimi: Pas profetëve që u urdhëruan të gjykonin me Teurat, Ne dërguam robin dhe adhuruesin Tonë të sinqertë, Isain, birin e Merjemes. Ai ishte Shpirti i krijuar prej Allahut dhe Fjala e Tij (Bëhu), të cilën Ai e drejtoi mbi Merjemen.

Allahu i Lartësuar e dërgoi Isain (a.s.) si vërtetues dhe përforcues të urtësisë së Teuratit. Me fjalë të tjera, Isai dëshmoi për vërtetësinë e Teuratit dhe për vërtetësinë e Musait. Si profet i zgjedhur i Zotit, Isai do të ishte pohues e përforcues i shumicës së ligjeve të shpallura Musait dhe profetëve para tij. Megjithatë, ai solli lehtësime për bijtë e Israilit në disa dispozita, sikurse thuhet në suren Al Imran: "Unë do t'ju vërtetoj Teuratin, që e keni në duart tuaja, dhe do t'ju lejoj diçka që ju ishte ndaluar. Kam ardhur me argumente nga Zoti juaj, prandaj kini drojë Allahun dhe më dëgjoni

mua! Allahu është Zoti im dhe Zoti juaj. Atë adhurojeni, se kjo është rruga e drejtë!" [Al Imran 50, 51].

Më tej, Allahu i Madhëruar thotë:

- "Atij i dhamë Ungjillin, që ishte udhëzim dhe dritë..." - Ungjilli ishte libër madhështor, plotësues i Teuratit madhështor dhe shpalljeve hyjnore para tij.

Ai libër u bë udhëzim dhe dritë, që tregonte rrugën e drejtë për të fituar kënaqësinë e Allahut dhe që sqaronte të vërtetën nga e kota.

- "...vërtetues i Teuratit që kishin pranë..." - Ungjilli ishte vërtetues dhe përforcues i Teuratit. Ai dëshmonte për atë si një libër i Zotit dhe i përforconte ligjet e shpallura në të. Ungjilli gjithashtu ishte:

- "...udhëzues e këshillues për të devotshmit." - Ata të cilët ndriçoheshin nga udhëzimi i Ungjillit dhe nxirrnin mësime prej tij ishin vetëm të devotshmit. Ata qëndronin brendave kufijve të tij, zbatonin urdhëresat e tij, largoheshin nga ndalesat e tij dhe nga çdo cilësi e ulët dhe e padenjë.

- "Le të gjykojnë ithtarët e Ungjillit sipas asaj që Allahu ka shpallur në të." - Besimtarët e vërtetë të Ungjillit duhet të mos i kalonin kufijtë e vendosur në librin e tyre. Ata nuk duhet të mohonin dhe shpërfillnin porositë që Zoti shpalli në të. Në të kundërt:

- "E kush nuk gjykon sipas asaj që Allahu ka shpallur, të tillët janë gjynahqarë, të dalë jashtë rrugës së Zotit."

Ajetet 48 – 50

48. Ne edhe ty *(Muhamed)* ta zbritëm Librin me të vërtetën e sigurt. Ai është vërtetues i librave të mëparshëm dhe garantues i tyre. Gjyko mes tyre me atë që ka shpallur Allahu! Mos paso epshet e tyre e të largohesh nga e vërteta që të erdhi. Për secilin prej jush, Ne caktuam ligj e program. Sikur të donte Allahu, do t'ju bënte një popull *(në fe)*, por deshi t'ju sprovonte me atë që ju ka dhënë, prandaj përpiquni për punë të mira. Tek Allahu është kthimi i të gjithë juve, kur Ai do t'ju tregojë se për çfarë kishit kundërshtime.

49. Gjyko mes tyre me atë që ka shpallur Allahu! Mos ndiq dëshirat e tyre dhe ruaju rrezikut të tyre, që të mos të shmangin nga ndonjë pjesë e Shpalljes që të dha Allahu. Nëse ata refuzojnë, ti dije se Allahu ka për qëllim t'i ndëshkojë për disa nga gjynahet e tyre. Në të vërtetë, shumica e njerëzve janë jashtë rrugës.

50. Vallë, mos po kërkojnë gjykimin e kohës së injorancës? A ka gjykim më të mirë se ai i Allahut, për një popull që beson bindshëm?

Shpjegimi i ajeteve

- "Ne edhe ty *(Muhamed)* ta zbritëm Librin me të vërtetën e sigurt." - Kuptimi: Edhe ty, o Muhamed, të shpallëm Kur'ânin, Librin më të vyer, më të rëndësishëm, më të mrekullueshëm dhe më të ruajtur.

Allahu i Madhëruar e përshkruan Kur'ânin si një libër të shpallur "me të vërtetën e sigurt". Pra, Kur'âni u shpall me vërtetësi, besnikëri e saktësi. Ai është i vërtetë në kumtet e tij dhe ka drejtësi në urdhëresat e tij.

- "Ai është vërtetues i librave të mëparshëm dhe garantues i tyre." – Kur'âni dëshmon për vërtetësinë e shpalljeve të mëhershme, që Zoti u dhuroi profetëve. Kur'âni është në të njëjtën linjë me shpalljet e mëparshme hyjnore dhe i konfirmon ato. Ngjarjet e përmendura në të me ngjarjet e përmendura në librat e mëparshëm janë të njëjta. Të njëjtë janë edhe ligjet bazë të tij dhe të shpalljeve para tij. Madje, Kur'âni është

dëshmia më e sigurt për saktësinë e të dhënave në shpalljet e mëparshme.

Kur'âni është, gjithashtu: "...garantues i tyre...". Pra, ai jo vetëm që përmban dispozita madhore dhe rrëfime, që gjendeshin edhe në librat e tjerë, por ai është i kompletuar me dituri hyjnore, ku shtjellohen tërësisht detyrimet ndaj Zotit dhe mënyrat për të edukuar njerëzit me virtyte të larta. Ai është një libër i cili nuk ka lënë ndonjë urdhëresë të mëparshme pa e treguar, pa e kompletuar, si dhe pa treguar të gjitha rrugët e mundshme për ta zbatuar atë. Ai është libri ku rrëfehen ngjarjet e të parëve dhe të fundmëve, ku gjendet gjykimi i drejtë dhe vetë urtësia. Megjithatë, në Kur'ân ka edhe ligje që nuk janë përmendur në librat e shkuar. Gjithashtu, çdo e dhënë dhe gjykim në ata libra që Kur'âni i gjykon dhe i përcakton si të drejta dhe të pranueshme, ato janë të tilla. Ndërsa ato që ai i gjykon si të papranueshme, ato janë të papranueshme. Kur'âni konsiderohet si verifikues i tjetërsimeve dhe ndryshimeve të bëra nga njerëzit në shpalljet e shkuara.

- "Gjyko mes tyre me atë që ka shpallur Allahu! Mos paso epshet e tyre e të largohesh nga e vërteta që të erdhi." - Gjyko mes tyre me librin që Zoti të shpalli ty dhe mos paso orekset e tyre të prishura, që kundërshtojnë të vërtetën e shpallur nga Zoti. Kurrë mos prano të shkëmbesh të vërtetën me të kotën dhe të braktisësh mirësinë e dhuruar nga Zoti yt!

- "Për secilin prej jush, Ne caktuam ligj e program." - Për çdo popull, Allahu i Lartësuar përcaktoi rrugë dhe ligje. Në fakt, në themel, të gjithë profetët kanë patur një ligj të përbashkët, por ka patur edhe disa ligje të veçanta, në varësi të popujve të tyre. Kryesisht, këto ligje të veçanta janë të tilla që e pranojnë ndryshimin në varësi të kohës, vendit dhe gjendjes së shoqërive, por gjithmonë kanë qenë urtësi dhe udhëzim i drejtë për ta. Megjithatë, bazat themelore të besimit dhe të ligjeve kanë qenë të pandryshueshme dhe të përbashkëta për të gjithë popujt dhe profetët e Zotit.

- "Sikur të donte Allahu, do t'ju bënte një popull *(në fe)*, por deshi t'ju sprovonte me atë që ju ka dhënë..." - Nëse do të dëshironte Allahu i Madhëruar, Ai do t'i bënte të gjithë popujt t'i nënshtroheshin një Sheriati të vetëm, pa asnjë ndryshim mes të parëve dhe të fundit. Por Allahu deshi që t'i sprovonte njerëzit dhe të vështronte se si do të vepronin ata.

Allahu i Madhëruar ka caktuar ligje që u janë përshtatur popujve përkatës dhe me qëllim që ata të garonin me njëri-tjetrin, se kush e kush të afrohej më shumë tek Ai, prandaj i Lartësuari thotë:

- "...prandaj përpiquni për punë të mira." - Garoni dhe përsosini veprat tuaja të mira.

Punët e mira përfshijnë veprat e detyruara[39] dhe ato të pëlqyeshme,[40] qofshin ato në drejtim të përgjegjësive ndaj Zotit, qofshin në lidhje me përgjegjësitë ndaj njerëzve e krijesave.

Njeriu duhet të jetë garues dhe ambicioz veçse në dy gjëra:

1. në shpejtësinë e kryerjes së veprave të mira, duke shfrytëzuar menjëherë rastin që i jepet për to, dhe:

2. në përpjekjet për t'i kryer veprat e mira në formën dhe mënyrën më të plotë e të saktë.

Kjo tregon se është detyrë të shpejtohet për ta falur namazin në fillimin e kohës, e po kështu çdo adhurim tjetër. Gjithashtu, njeriu nuk duhet të mjaftohet duke i kryer

---

[39] Vepra të detyruara janë ato punë e fjalë të cilat sheriati ka urdhëruar që të kryhen me urdhër kategorik. Ai që i kryen ato me sinqeritet për Allahun meriton shpërblim ndërsa ai që i lë ato pa i zbatuar pa pasur justifikim të pranueshëm dhe të konsiderueshëm nga sheriati, meriton ndëshkim.

[40] Vepra të pëlqyeshme janë ato punë e fjalë të cilat sheriati ka urdhëruar që të kryhen por jo me urdhër kategorik. Ai që i kryen ato me sinqeritet për Allahun meriton shpërblim ndërsa ai që i lë ato pa i zbatuar nuk ndëshkohet.

adhurimet aq sa të heqë detyrimin nga shpina, pra vetëm veprat e domosdoshme, por duhet të përpiqet që të kryejë edhe detajet e pëlqyeshme, që adhurimi të jetë i plotë. Në këtë mënyrë, realizohet garimi në plotësimin e urdhrave të Zotit.

- "Tek Allahu është kthimi i të gjithë juve, kur Ai do t'ju tregojë se për çfarë kishit kundërshtime." - Popujt e shkuar dhe ata që do të vijnë deri në Ditën e Fundit, Allahu i Gjithëfuqishëm do t'i tubojë të gjithë së bashku. Atë ditë do të ndahet e vërteta nga e kota, e drejta nga e gabuara, dhe Allahu i Madhërishëm do t'u tregojë krijesave për gjithçka që ata kishin kundërshtime, për sa i përket zbatimit të ligjeve dhe gjykimit me to. Ata që kanë përqafuar të vërtetën dhe kanë bërë vepra të mira e të sinqerta, Allahu i Madhëruar do t'i shpërblejë me bujarinë e Tij. Ndërsa pasuesit e epsheve dhe gjynahqarët, Allahu do t'i ndëshkojë sipas drejtësisë dhe urtësisë së Tij.

- "Gjyko mes tyre me atë që ka shpallur Allahu!" - Për këtë ajet është thënë se ai shfuqizoi ajetin 42 të kësaj sureje, ku thuhet: "Në qoftë se vijnë te ti *(për ndonjë gjykim)*, gjyko mes tyre ose distancohu prej tyre. Nëse prapsesh prej tyre, ata nuk mund të të bëjnë ty asnjë të keqe. Por nëse gjykon mes tyre, gjyko me drejtësi, se, me të vërtetë, Allahu i do të drejtit." Pra, pas këtij ajeti, nuk lejohet që i pyeturi të mos japë gjykim për çështjen që pyetet. Atij i duhet të gjykojë me ligjin që ka shpallur Allahu i Madhërishëm.

Megjithatë, mendimi më i saktë është se ajeti 42 nuk është i shfuqizuar, pasi ai tregon se Profeti (a.s.) ishte i lirë të gjykonte ose jo mes palëve, në rastin kur ata nuk synonin vërtet të gjykoheshin sipas Sheriatit, por donin ndonjë gjykim që u shkonte sipas qejfit. Ndërsa ky ajet që po komentohet tani tregon që, nëse i pyeturi zgjedh që të gjykojë mes palëve, atëherë ai duhet të gjykojë sipas Kur'ânit dhe Sunetit, pra, të gjykojë "me drejtësi", ashtu sikurse u shpjegua në ajetin 42. Fjala "drejtësi" nënkupton që gjykimi duhet të bazohet te Shpallja hyjnore, sepse kështu thotë Zoti: "Gjyko mes tyre me atë që ka shpallur Allahu". Kështu, çdo gjykim tjetër është shtrembërim dhe padrejtësi.

- "Mos ndiq dëshirat e tyre..." - Allahu i Lartësuar e përsërit urdhrin për të mos ndjekur dëshirat e shfrenuara të tyre, për shkak të rrezikshmërisë që kanë. Në ajetin tjetër porositej për mosndjekjen e pasioneve të tyre në fushën e gjykimit dhe të dhënies së fetvasë, ndërsa në këtë ajet bëhet fjalë vetëm për fushën e gjykimit mes tyre. Gjithsesi, në të dyja rastet është detyrë mbështetja në të vërtetën dhe mosndjekja e orekseve të njerëzve që e kundërshtojnë të vërtetën.

I Madhëruari e përforcon edhe më tej këshillën, kur thotë:


- "...dhe ruaju rrezikut të tyre, që të mos të shmangin nga ndonjë pjesë e Shpalljes që të dha Allahu." – Kuptimi: Ki shumë kujdes, që të mos mashtrohesh nga ata. Ji i kujdesshëm, që ata mos të të sprovojnë, lëkundin dhe të të pengojnë nga Shpallja e Zotit tënd. Pasimi i dëshirave të tyre bëhet shkak që ti të lësh të vërtetën, ndërkohë që duhet të ndodhë e kundërta.

- "Nëse ata refuzojnë, ti dije se Allahu ka për qëllim t'i ndëshkojë për disa nga gjynahet e tyre." - Nëse ata refuzojnë t'i nënshtrohen të vërtetës dhe i kthejnë shpinën rrugës tënde, dije se ky është një ndëshkim nga Allahu i drejtë për ta. Kështu i ndëshkon Allahu i Madhëruar gjynahqarët zullumqarë. Gjynahet janë shkaktarë të ndëshkimeve dhe sprovave të kësaj dynjaje dhe të jetës tjetër. Ndër të këqijat më të rrezikshme që sjellin gjynahet është kur robit i zbukurohet braktisja e rrugës dhe traditës së Profetit (a.s.).

- "Në të vërtetë, shumica e njerëzve janë jashtë rrugës." - Natyra e tyre është

tjetërsuar dhe tashmë atyre u është zbukuruar shkelja e kufijve të Zotit dhe mosndjekja e rrugës së Profetit (a.s.).

- "Vallë, mos po kërkojnë gjykimin e kohës së injorancës?" - Kuptimi: Çfarë kërkojnë ata, kur të kthejnë shpinën dhe refuzojnë t'i nënshtrohen gjykimit tënd? A mos kërkojnë gjykimin e xhahilijetit?! Gjykim injorance quhet çdo gjykim tjetër veç gjykimit të Allahut të Lartësuar dhe Profetit të Tij. Nuk ka mundësi të tretë: ose do të pranosh gjykimin e Zotit dhe të Profetit të Tij, ose do të ndjekësh gjykimin e injorancës. Ai që i kthen shpinën të parit, sigurisht që do të sprovohet me të dytin, i cili është gjykim i ngritur mbi padituri në e padrejtësinë. Për këtë arsye, Allahu i Lartësuar e quan "gjykim injorance". Ndërsa gjykimi i Allahut të Lartësuar është i ndërtuar mbi diturinë e madhe, drejtësinë absolute, barazinë dhe mirësinë, mbi dritën dhe udhëzimin e qartë, siç thotë i Lavdëruari:


الجزء السادس سورة المائدة
الجزء ٦
١١٧

- "A ka gjykim më të mirë se ai i Allahut, për një popull që beson bindshëm?" - Kuptimi: Vetëm ata që Zoti i ka pajisur me siguri të plotë, të bazuar në dijen e vërtetë të dhuruar nga Zoti, vetëm ata dinë të bëjnë dallimin mes dy llojeve të gjykimit. Ata dinë të dallojnë bukurinë, mrekullinë, dobinë dhe mirësinë që gjendet në gjykimin e Allahut. Në këtë mënyrë, bëhet detyrë për ta pasimi i gjykimit të Allahut, sepse ky gjykim është në përputhje edhe me ligjet e logjikës.

Ajetet 51 – 53

51. O ju që keni besuar! Mos zini miq as judejtë e as të krishterët. Ata janë miq të njëri-tjetrit. E kush prej jush i miqëson ata, ai është prej tyre. Vërtet, Allahu nuk udhëzon në rrugë të drejtë popullin e padrejtë.

52. E ata që në zemrat e tyre kanë sëmundje, i sheh të rendin drejt tyre dhe thonë: "Po frikësohemi se mos po na godet ndonjë e keqe!". Por Allahu do të sjellë fitoren ose diçka tjetër nga ana e Tij, e atëherë, ata do të pendohen për atë që e mbanin fshehtë në shpirtin e tyre.

53. Besimtarët thonë: "Këta ishin ata të cilët u betuan në Zotin me betimin më të fortë se ishin me ju? Ata i shkatërruan veprat e veta dhe aguan të dëshpëruar".

Shpjegimi i ajeteve

- "O ju që keni besuar! Mos zini miq as judejtë e as të krishterët. Ata janë miq të njëri-tjetrit. E kush prej jush i miqëson ata, ai është prej tyre." - Duke u treguar besimtarëve cilësitë jo të mira të judejve dhe të krishterëve, Allahu i Madhëruar i këshillon që të mos i zënë si miq e aleatë, sepse ata janë miq e aleatë të njëri-tjetrit kundër të tjerëve. Ata nuk mund të jenë aleatët dhe miqtë e besimtarëve. Përkundrazi, ata janë armiq, të cilët nuk i shqetëson aspak dëmtimi i besimtarëve.

Madje, ata nuk kursejnë asgjë për t'i devijuar dhe dëmtuar. Me çifutët e të krishterët miqësohet veçse kush është si ata, siç thotë i Lartësuari: "E kush prej jush i miqëson ata, ai është prej tyre." Miqësia dhe mbështetja e plotë tek ata e bën të detyrueshme kalimin në fenë e tyre. Në të njëjtën mënyrë, miqësitë dhe aleancat e vogla sjellin ato të mëdhatë, derisa të bëhesh njësh me ta.

- "Vërtet, Allahu nuk udhëzon në rrugë të drejtë popullin e padrejtë." - Ata që kanë padrejtësinë si cilësi të tyre dhe që mbështeten gjithmonë tek ajo, edhe sikur t'u shfaqet çdo lloj prove, kurrë nuk kanë për të ndjekur rrugën e drejtë dhe kurrë nuk do të nënshtrohen për të zbatuar porositë e Zotit.

Allahu i Madhëruar, pasi i ndalon besimtarët nga miqësimi dhe aleanca me çifutët dhe të krishterët, na zbulon se ka edhe njerëz që pretendojnë se e besojnë Atë, por që vazhdojnë të jenë miq me ta. Kështu, i Lartësuari thotë:

- "E ata që në zemrat e tyre kanë sëmundje, i sheh të rendin drejt tyre..." – Kuptimi: Do t'i shohësh dhe dëgjosh ata, që në zemrat e tyre kanë sëmundjen e dyshimit, hipokrizisë dhe besim të dobët, të thonë se miqësohen me ata vetëm për nevojë:

- "Po frikësohemi se mos po na godet ndonjë e keqe!". - Kuptimi: Druhemi se ndoshta fitorja do të jetë me çifutët dhe të krishterët, prandaj më mirë të ruajmë miqësinë me ta, që, nëse fitojnë, të jemi në anën e tyre.

Por, pa dyshim, ky është një mendim i keq për Allahun dhe për fenë e Tij, Islamin. Për këtë arsye, duke kundërshtuar këtë mendim të keq të tyre, Allahu i Lartësuar thotë:

- "Por Allahu do të sjellë fitoren ose diçka tjetër nga ana e Tij, e atëherë, ata do të pendohen për atë që e mbanin fshehtë në shpirtin e tyre." - Allahu i Madhëruar është i Plotpushtetshëm që t'ua japë fitoren muslimanëve mbi judejtë dhe të krishterët, ose të sjellë ndonjë gjë, për shkak të së cilës munafikët të humbin shpresën se mund të ketë ndonjë fitore për armiqtë e Islamit, duke u dëshpëruar për të keqen që i pret dhe për të mirat që do humbin.

Allahu i Plotpushtetshëm u jep fitore muslimanëve mbi çdo armik tjetër dhe e bën Islamin fenë triumfuese mbi çdo fe tjetër në faqen e dheut, dhe kjo sjell trishtim të madh në zemrat e munafikëve dhe qafirëve, që vetëm Allahu e di.

- "Besimtarët thonë: "Këta ishin ata të cilët u betuan në Zotin me betimin më të fortë se ishin me ju? Ata i shkatërruan veprat e veta dhe aguan të dëshpëruar"." - Besimtarët u çuditën nga fjalët e atyre me zemra të sëmura e thanë: "Këta bënë gjithë ato betime, se do të ishin së bashku me ju, për sa i përket besimit, ndihmës, dashurisë dhe miqësisë. Kurse tani doli në shesh ajo që e mbanin fshehtë në zemër! Por planet që kurdisën dhe ëndrrat e tyre të këqija për Islamin dhe muslimanët u shkatërruan dhe përfunduan me turp. Po kështu u shkatërruan edhe veprat e tyre, duke u bërë të dëshpëruar dhe të humbur, sepse nuk i arritën dot qëllimet që kishin".

Ajeti 54

54. O ju që keni besuar! Kush largohet, prej jush, nga feja e vet, *(le ta dijë se)* nuk ka dyshim se Allahu do të sjellë një popull tjetër, që Ai i do dhe ata e duan Atë; që është modest e i butë ndaj besimtarëve, por i ashpër dhe i fortë ndaj mohuesve; që lufton në rrugën e Allahut dhe që nuk i frikësohet kërcënimit të asnjë kërcënuesi. Kjo është dhuratë e Allahut, që ia jep atij që Ai do. Allahu është Dhurues i madh e i Gjithëdijshëm.

Shpjegimi i ajetit

- "O ju që keni besuar! Kush largohet, prej jush, nga feja e vet, *(le ta dijë se)* nuk ka dyshim se Allahu do të sjellë një popull tjetër, që Ai i do dhe ata e duan Atë..." - Allahu i Madhëruar na tregon se Ai është i Pasur dhe i Jonevojtar për botën. Çdokush që e lë fenë e Tij nuk e dëmton aspak Atë, por dëmton veçse vetveten. Allahu ka robër adhurues të sinqertë, burra të çiltër dhe të vërtetë, të cilët Ai i ka udhëzuar dhe është përkujdesur për udhëzimin e tyre. I Gjithëmëshirshmi e Mëshirëploti i ka veçuar ata për Veten e Vet, duke na treguar se do të kujdeset Vetë që t'i sjellë në ekzistencë.

Ata janë krijesat me cilësitë më të larta dhe me shpirtrat më të pastër. Cilësia më e mirë që ata kanë është që Allahu i do ata dhe ata e duan Allahun. Dashuria e Allahut për robin është mirësia më e madhe që Ai i ka dhuruar ndonjëherë robit dhe vlerësimi më i lartë për të. Kur Allahu i Madhëruar e do një rob, ia lehtëson atij shkaqet për ta realizuar këtë qëllim, duke i dhënë vullnet dhe sukses për të vepruar çdo të mirë dhe për të lënë çdo të keqe. Pas kësaj, edhe zemrat e njerëzve të tjerë fillojnë ta duan dhe nderojnë atë rob të zgjedhur dhe të përunjur ndaj Allahut, të cilin Ai e do.

Një nga cilësitë e domosdoshme të një robi që e do Allahun dhe e madhëron Atë është pasimi rigoroz i Traditës së Profetit të Tij, në çështjet e jashtme e të dukshme dhe në ato të brendshme e të fshehura, në drejtim të fjalëve, punëve dhe gjendjeve të tij, sikurse thotë i Lartësuari: "Thuaj: "Nëse e doni Allahun, atëherë më pasoni mua, që Allahu t'ju dojë dhe t'ju falë gjynahet tuaja." Allahu është Falës e Mëshirues. Thuaj: "Bindjuni Allahut dhe të Dërguarit!" Nëse ata refuzojnë, atëherë ta dinë se Allahu nuk i do jobesimtarët!" [Al Imran 32, 33].

Shenjë tjetër e dashurisë së Allahut për robin e Tij është dhe përpjekja e vazhdueshme e robit për t'u afruar tek Allahu i Madhëruar duke kryer vepra të mira të detyrueshme (farze) dhe të pëlqyeshme (nafile), sikurse ka përcjellë Profeti (a.s.) thënien e saktë prej Allahut të Lartësuar: "*Nuk afrohet ndonjëherë robi tek Unë me ndonjë vepër më të dashur për Mua sesa me atë vepër që ia kam bërë detyrë. Vazhdon robi që të afrohet tek Unë me vepra nafile të mira, derisa Unë e dua atë. Dhe kur Unë e dua atë, bëhem dëgjimi i tij, me të cilin ai dëgjon, vështrimi i tij, me të cilin ai vështron, dora e tij, me të cilën ai vepron, këmba e tij, me të cilën ai ecën. Nëse më kërkon, Unë i jap, nëse më kërkon mbrojtje dhe strehim, Unë e mbroj dhe strehoj*".

Një detyrë e domosdoshme për të dashur Allahun e Madhëruar është njohja e Tij dhe shpeshtimi i përkujtimit të Tij. Dashuria pa njohje është shumë e mangët, madje e paqenë, edhe nëse mund të pretendohet me fjalë. Gjithashtu, ai që e do Zotin, e shton përkujtimin e Tij. Nëse Zoti e do një rob, e shpërblen atë shumë dhe për vepra tepër të vogla. Nëse Zoti e do robin, ia fal atij edhe gabimet apo rrëshqitjet e shumta.

Cilësi tjetër e këtyre të përzgjedhurve fatlumë është edhe:

"...që është modest e i butë ndaj besimtarëve, por i ashpër dhe i fortë ndaj mohuesve" - Ata janë të thjeshtë dhe të butë ndaj besimtarëve, për shkak të dashurisë, mëshirës e dhembshurisë së madhe për ta. Ata vetë në përgjithësi kanë natyrë të butë dhe dashamirëse me njerëzit, prandaj butësia me besimtarët është mëse e pranueshme për natyrën e tyre. Ndërsa me qafirët, të cilët me arrogancë mohojnë Zotin, shpalljet hyjnore dhe profetët, me këta lloj njerëzish ata tregohen të fortë dhe të ashpër. Ata shfrytëzojnë të gjitha mundësitë dhe energjitë për të luftuar kundër qafirëve dhe për të triumfuar feja e Zotit dhe adhurimi i Tij si Një i vetëm. Ata përgatiten ashtu sikurse thotë i Madhëruari: "Përgatituni kundër tyre sa të keni mundësi, duke shtuar fuqinë e kuajt *(mjetet luftarake)* të caktuar për betejë, në mënyrë që ta frikësoni armikun e Allahut dhe armikun tuaj, si dhe të tjerë, për të cilët ju nuk i dini *(se kush janë)*, por Allahu di për ata. Çfarëdo që të shpenzoni për rrugën e Allahut, ajo do t'ju kompensohet

dhe nuk do t'ju bëhet padrejtësi". [Enfal 60]. I Lartësuari i ka përshkruar gjithashtu ata duke thënë: "...të ashpër dhe krenarë kundër qafirëve dhe të mëshirshëm mes njëri-tjetrit." [Fet'h 29]. Kësisoj, ashpërsia dhe urrejtja kundër armiqve të Zotit është nga një nga veprat e mira që të afrojnë tek i Madhërishmi.

Besimtarët i urrejnë qafirët dhe kufrin e tyre. Megjithatë, ashpërsia kundër qafirëve nuk duhet të ndikojë që të mos i ftojmë ata në Islam me mënyrat më të mira dhe më të bukura. Si ashpërsia ndaj tyre, ashtu edhe butësia e përdorur me ta kur i thërrasim në Islam janë në të mirë të tyre, për t'i zgjuar nga përhumbja dhe vdekja e kufrit.

Më pas, Allahu i Madhëruar tregon cilësi të tjera të të zgjedhurve:

- "...që lufton në rrugën e Allahut dhe që nuk i frikësohet kërcënimit të asnjë kërcënuesi. Kjo është dhuratë e Allahut, që ia jep atij që Ai do". - Ata luftojnë dhe përpiqen në rrugën e Zotit me pasurinë dhe veten e tyre, me fjalët dhe me veprat e tyre. Ata nuk i frikësohen kërcënimit të asnjë kërcënuesi. Ajo që ka rëndësi për ta është se si të kënaqin Zotin dhe si të ruhen nga ndëshkimi i Tij, e jo frika nga krijesat. Kjo tregon për fuqinë e vullnetit dhe të qëllimit të tyre, sepse kush ka zemër të dobët, edhe vullnetin e qëllimin i ka të dobët, dhe mjafton një vërejtje prej njerëzve, e ai dorëzohet. Kështu, fuqia e tij dobësohet gjatë përplasjes me kundërshtarët dhe qortuesit. Në zemrën e tij ekziston adhurimi i dikujt tjetër veç Zotit, në varësi të konsideratës që ai i kushton kënaqësisë dhe plotësimit të orekseve të njerëzve kundrejt urdhrave dhe porosive të Zotit. Zemra çlirohet nga adhurimi i çdo gjëje tjetër veç Allahut, veçse kur të mos ketë frikë dhe të mos i druhet askujt veç Allahut, kur vjen puna për zbatimin e porosive të Tij.

Pasi i lëvdon të zgjedhurit e Tij për ato cilësi të cilat vetë Ai ua dhuron nga bujaria e Vet, dhe të cilat i nxisin besimtarët që të bëjnë shumë punë të mira, përveç atyre që u përmendën, Allahu i Lartësuar ua kujton sërish se të gjitha ato janë thjesht mirësi e bujari prej Tij. Ai e bën këtë që ata të mos mashtrohen e të vetëkënaqen, por të tregohen mirënjohës dhe t'i shtojnë edhe më shumë falënderimet ndaj Tij. Duke e falënderuar Dhuruesin dhe duke treguar mirënjohje dhe përunjësi para Tij, Ai do t'ua shtojë edhe më shumë mirësinë e dhuruar, madje mirësia dhe bujaria e Tij do të përfshijë edhe të tjerët rreth tyre.

Mirësitë e Allahut janë të pakufishme dhe të panumërta, prandaj i Madhëruari thotë:

- "Allahu është Dhurues i madh e i Gjithëdijshëm." - Allahu është i Gjerë në mirësinë dhe bujarinë e Tij. Të shumta dhe të pakufishme janë mirësitë që Ai dhuron. Mëshira e Tij ka përfshirë gjithçka. Por të dashurve të Tij të zgjedhur Ai u jep mirësi të mrekullueshme, të cilat ua dhuron veçse atyre. Pa dyshim, Ai është i Gjithëdijshëm për ata që meritojnë bujarinë dhe mirësinë e Tij të posaçme. Ai e di shumë mirë se kujt ia jep mirësinë e Tij themelore dhe pjesët e saj.

Ajetet 55 – 56

55. Miku juaj është vetëm Allahu, i Dërguari i Tij dhe ata që besojnë, që falin namazin dhe që e japin zekatin me përulësi.

56. E kush ka mik Allahun, të Dërguarin e Tij dhe besimtarët, *(ta dijë se)* s'ka dyshim se pala e Allahut është ngadhënjyese.

Shpjegimi i ajeteve

Pasi na ndaloi nga miqësia me jobesimtarët, të çdo lloji qofshin: idhujtarë, çifutë e të krishterë, dhe pasi na bëri të ditur se përfundimi i tyre është shkatërrimi dhe humbja e qartë, Allahu i Madhëruar na tregon se me cilët është detyrë të miqësohemi dhe të afrohemi dhe ç'të mirash fitojmë nëse e bëjmë këtë. Ai thotë:

- "Miku juaj është vetëm Allahu, i Dërguari i Tij dhe ata që besojnë, që falin namazin dhe që e japin zekatin me përulësi." - Afrimiteti me Allahun e Madhëruar arrihet me besim të drejtë e të sinqertë, të ndërtuar mbi dituri të saktë dhe të vërtetë, si dhe me devotshmëri, duke kryer urdhrat e duke lënë ndalesat fetare, në shenjë dashurie, madhërimi e përunjësie për Allahun. Çdokush që ka besimin dhe devotshmërinë pa dyshim do të jetë mik i dashur i Allahut të Madhëruar. Dhe ai që është mik i Allahut është edhe mik i Profetit të Tij. Çdokush që është mik i dashur i Allahut dhe i Profetit të Tij, do të miqësohet dhe afrohet me ata që Zoti dhe Profeti i duan, pra, me besimtarët që besojnë me zemër dhe në praktikë, që i përkushtohen me sinqeritet Allahut, duke e falur namazin me rregull, që tregohen bamirës edhe me krijesat, duke u dhënë zekatin atyre që e meritojnë.

Allahu i Lartësuar thotë: "...që e japin zekatin me përulësi...", pra, duke shprehur varfërinë dhe përunjësinë e tyre të thellë para Allahut.

Allahu i Lartësuar thotë gjithashtu: "Miku juaj është vetëm Allahu, i Dërguari i Tij dhe ata që besojnë …", duke përdorur fjalën "vetëm". Nga kjo kuptohet se miqësia, dashuria dhe afrimiteti duhet të kufizohen veçse me ata që përmenden në ajet. Vetëm ata duhet të jenë miqtë, të dashurit e të afërmit tanë, ndërsa prej të tjerëve duhet të distancohemi.

Pastaj i Madhëruari përmend dobinë e kësaj miqësie dhe afrimiteti, duke thënë:

- "E kush ka mik Allahun, të Dërguarin e Tij dhe besimtarët, ***(ta dijë se)*** **s'ka dyshim se pala e Allahut është ngadhënjyese." –** Pra, do të jetë pjesëtar i palës së Allahut, do të jetë pjesë e adhuruesve të Allahut dhe të dashurve të Tij. Pa dyshim, pala e Allahut dhe të afërtit e Tij do të jenë triumfuesit. Atyre u takon përfundimi i mirë në dynja dhe ahiret, sikurse thotë Allahu i Lartësuar në një ajet tjetër: "Premtimi Ynë u është dhënë më parë robërve Tanë të dërguar, se ata, pa dyshim, do të ndihmohen dhe se ushtria Jonë do të jetë ngadhënjyese." [Saffat 171 – 173]. Ky është një përgëzim i madh për të gjithë ata që përpiqen sinqerisht të zbatojnë porositë e Allahut, duke u bërë prej të dashurve të Tij. Ata do të jenë gjithmonë të fituarit, edhe nëse ndonjëherë, me urtësinë e Tij, Allahu i Madhëruar do të lejojë që të sprovohen, duke ua dhënë fitoren armiqve të tyre. Këtë Allahu i Madhëruar e lejon përkohësisht, me urtësinë e Tij, por në përfundim fitorja i takon besimtarëve, miqve e të dashurve të Allahut të Madhëruar. Nuk ka më fjalëdrejtë se Allahu i Lartësuar.


Ajetet 57 – 58

57. O ju që keni besuar! Mos i zini miq ata të cilëve u është dhënë Libri para jush dhe as jobesimtarët, që tallen dhe luajnë me fenë tuaj. Frikësojuni Allahut, nëse jeni besimtarë.
58. Edhe ezanin tuaj për namaz ata e marrin për tallje e lojë. Me të vërtetë, ata janë njerëz që nuk kuptojnë.

Shpjegimi i ajeteve

- "O ju që keni besuar! Mos i zini miq ata të cilëve u është dhënë Libri para jush dhe as jobesimtarët, që tallen dhe luajnë me fenë tuaj." - Edhe në këto ajete Allahu i Lartësuar i ndalon besimtarët që t'i konsiderojnë ithtarët e Librit, pra, jehudët e të krishterët, si dhe çdo lloj jobesimtari, si miq të afërt, duke i dashur e mbështetur, duke u treguar të fshehtat e besimtarëve apo duke i ndihmuar në shumë çështje që dëmtojnë Islamin dhe muslimanët. Të gjitha këto sjellje bien ndesh me imanin. Besimi i drejtë e bën të detyrueshëm distancimin nga qafirët e çdo lloji.

- "Frikësojuni Allahut, nëse jeni besimtarë." – Është devotshmëria ndaj Zotit


الجزء السادس سورة المائدة
وَإِذَا نَادَيْتُمْ إِلَى الصَّلَوٰةِ اتَّخَذُوهَا هُزُوًا وَلَعِبًا ذَٰلِكَ بِأَنَّهُمْ قَوْمٌ
لَّا يَعْقِلُونَ ﴿٥٨﴾ قُلْ يَا أَهْلَ الْكِتَابِ هَلْ تَنقِمُونَ مِنَّا إِلَّا أَنْ آمَنَّا
بِاللَّهِ وَمَا أُنزِلَ إِلَيْنَا وَمَا أُنزِلَ مِن قَبْلُ وَأَنَّ أَكْثَرَكُمْ فَاسِقُونَ ﴿٥٩﴾
قُلْ هَلْ أُنَبِّئُكُم بِشَرٍّ مِّن ذَٰلِكَ مَثُوبَةً عِندَ اللَّهِ مَن لَّعَنَهُ اللَّهُ وَغَضِبَ
عَلَيْهِ وَجَعَلَ مِنْهُمُ الْقِرَدَةَ وَالْخَنَازِيرَ وَعَبَدَ الطَّاغُوتَ أُولَٰئِكَ شَرٌّ
مَّكَانًا وَأَضَلُّ عَن سَوَاءِ السَّبِيلِ ﴿٦٠﴾ وَإِذَا جَاءُوكُمْ قَالُوا آمَنَّا وَقَد
دَّخَلُوا بِالْكُفْرِ وَهُمْ قَدْ خَرَجُوا بِهِ ۗ وَاللَّهُ أَعْلَمُ بِمَا كَانُوا يَكْتُمُونَ
﴿٦١﴾ وَتَرَىٰ كَثِيرًا مِّنْهُمْ يُسَارِعُونَ فِي الْإِثْمِ وَالْعُدْوَانِ وَأَكْلِهِمُ
السُّحْتَ ۚ لَبِئْسَ مَا كَانُوا يَعْمَلُونَ ﴿٦٢﴾ لَوْلَا يَنْهَاهُمُ الرَّبَّانِيُّونَ
وَالْأَحْبَارُ عَن قَوْلِهِمُ الْإِثْمَ وَأَكْلِهِمُ السُّحْتَ ۚ لَبِئْسَ مَا كَانُوا
يَصْنَعُونَ ﴿٦٣﴾ وَقَالَتِ الْيَهُودُ يَدُ اللَّهِ مَغْلُولَةٌ ۚ غُلَّتْ أَيْدِيهِمْ وَلُعِنُوا
بِمَا قَالُوا ۘ بَلْ يَدَاهُ مَبْسُوطَتَانِ يُنفِقُ كَيْفَ يَشَاءُ ۚ وَلَيَزِيدَنَّ كَثِيرًا
مِّنْهُم مَّا أُنزِلَ إِلَيْكَ مِن رَّبِّكَ طُغْيَانًا وَكُفْرًا ۚ وَأَلْقَيْنَا بَيْنَهُمُ الْعَدَاوَةَ
وَالْبَغْضَاءَ إِلَىٰ يَوْمِ الْقِيَامَةِ ۚ كُلَّمَا أَوْقَدُوا نَارًا لِّلْحَرْبِ أَطْفَأَهَا
اللَّهُ ۚ وَيَسْعَوْنَ فِي الْأَرْضِ فَسَادًا ۚ وَاللَّهُ لَا يُحِبُّ الْمُفْسِدِينَ
﴿٦٤﴾
١١٨

që duhet t'ua imponojë besimtarëve një qëndrim të tillë kundrejt mohuesve. Dihet mirë se devotshmëria është kryerja e urdhëresave të Zotit dhe largimi nga ndalesat e Tij. Edhe armiqësia ndaj qafirëve është pjesë e këtyre porosive të Zotit.

Po kështu, duhet të përmendim edhe një fakt tjetër, në mënyrë që të kuptojmë se pse duhet t'i urrejmë mohuesit: ata e kundërshtojnë dhe e urrejnë besimin e muslimanëve, ata tallen e luajnë me adhurimet e muslimanëve, i përdhosin dhe nënçmojnë simbolet e tyre, sidomos namazin, i cili është nga shenjat më të dukshme dhe madhështore të Islamit. I Lartësuari thotë:

- "Edhe ezanin tuaj për namaz ata e marrin për tallje e lojë. Me të vërtetë, ata janë njerëz që nuk kuptojnë." - Kur muslimanët thërrasin ezanin për faljen e namazit, ata e përqeshin dhe tallen me të. Ata veprojnë kështu, për shkak të injorancës dhe mendjelehtësisë së tyre. Nëse do të kishin mend dhe logjikë, ata do të frenoheshin nga një sjellje e tillë dhe do të kuptonin se namazi është kulmi i mirësisë, që mund të ketë shpirti i njeriut.

Nga ana tjetër, nëse një besimtar e njeh dhe e kujton vazhdimisht gjendjen e qafirëve dhe armiqësinë e tyre ndaj Islamit dhe muslimanëve dhe, pas kësaj, përsëri nuk i urren dhe nuk armiqësohet me ta, kjo tregon që Islami në zemrën e tij është i pavlerë. Miqësimi me të tillë njerëz është shenjë treguese se atij nuk i intereson aspak fyerja dhe nënçmimi i besimit. Në fakt, ai është bosh nga besimi dhe dinjiteti. Si është e mundur që të thuash se je pasues i një feje të mrekullueshme, të vetmen fe që është e pranuar tek Zoti dhe, nga ana tjetër, të kënaqesh me miqësinë e atyre që e konsiderojnë atë si lojë dhe e trajtojnë me tallje?! Si mund të miqësohesh me injorantët, që përqeshin dhe e përdhosin këtë fe dhe besimtarët që jetojnë sipas saj?! Sigurisht, këto ajete i nxisin besimtarët që mohuesit e Zotit dhe të profetëve t'i konsiderojnë si armiq dhe kundërshtarë. Këtë e kupton çdokush që ka sadopak aftësi për të kuptuar.

Ajetet 59 – 63

59. Thuaju: "O ithtarë të Librit, a na shihni si të mangët vetëm pse besuam Allahun, pse besuam Shpalljen që zbriti për ne dhe ato që kanë zbritur më parë! S'ka dyshim, shumica juaj janë të shfrenuar!"

60. Thuaju: "A t'ju lajmëroj për një të keqe më të madhe, si dënim nga Allahu? Ajo është gjendja e atyre mbi të cilët goditi mallkimi i Allahut dhe zemërimi i Tij, disa prej të cilëve duke i shndërruar në majmunë e në derra e duke i bërë adhurues të Shejtanit. Këta janë në shkallën më të rëndë dhe më të devijuarit prej rrugës së drejtë."

61. Kur vijnë te ju, ata thonë: "Kemi besuar", ndërkohë që, në fakt, ata vijnë me

kufër dhe largohen me kufër. Allahu e di më së miri se çfarë fshehin ata.
62. Shumë prej tyre i sheh të nguten në gjynahe, në zullume dhe në ngrënie të haramit. Sa e shëmtuar është sjellja e tyre!
63. Pse, vallë, paria e tyre fetare nuk i ndal ata nga fjalët e shëmtuara dhe nga ngrënia e haramit?! Sa i keq është qëndrimi i tyre!

Shpjegimi i ajeteve

Allahu i Madhëruar e porosit Profetin e Tij t'u drejtohet ithtarëve të Librit që të pranojnë fenë Islame, të vetmen fe të drejtë, dhe t'u thotë atyre se ajo që ata e urrejnë dhe përbuzin është dhe duhet të jetë gjëja më e vyer dhe e nderuar për çdo njeri.

- "Thuaju: "O ithtarë të Librit, a na shihni si të mangët vetëm pse besuam Allahun, pse besuam Shpalljen që zbriti për ne dhe ato që kanë zbritur më parë! S'ka dyshim, shumica juaj janë të shfrenuar!"" – Kuptimi: Vallë, a po na urreni dhe po e konsideroni si mangësi tonën faktin që ne besojmë në Allahun, në shpalljet e Tij të shkuara dhe në atë të fundit, që besojmë në të gjithë profetët e tij të shkuar dhe Profetin e fundit?! Apo na urreni ngaqë ne besojmë se ai që nuk ka besimin tonë konsiderohet qafir, shkelës i kufijve të Zotit, i prishur dhe i shkatërruar?! Si mund ta konsideroni si mangësi atë që është detyra më e rëndësishme nga të gjitha detyrat, që rëndon mbi çdo të përgjegjshëm ligjërisht?! Shumica juaj janë të shthurur, shkelës të kufijve të Zotit të Madhëruar, të zhytur kokë e këmbë në gjynahe. Për këtë arsye, është më mirë për ju që të heshtni. A nuk ju mjafton që po ngarkoni vetveten me gjynahe dhe mosbindje ndaj Zotit, por dëshironi të zhyteni edhe më keq, duke urryer fenë që duhet ta doni dhe ta jetoni: Islamin?!

Të konsideruarit e fesë së vërtetë si mangësi dhe turp tregon se ata e shihnin besimin e vërtetë si një të keqe dhe kotësi. Atëherë, Allahu i Madhëruar i drejtohet Profetit (a.s.) dhe i thotë:

- "Thuaju: "A t'ju lajmëroj për një të keqe më të madhe, si dënim nga Allahu? Ajo është gjendja e atyre mbi të cilët goditi mallkimi i Allahut dhe zemërimi i Tij, disa prej të cilëve duke i shndërruar në majmunë e në derra e duke i bërë adhurues të Shejtanit." – Thuaju, o Profet, duke ecur me logjikën e tyre, a t'ju tregoj për diçka që është më "e keqe" se ajo të cilën ju e konsideroni si mangësi e turp? Gjendja më e keqe që ju duhet ta urreni dhe ta konsideroni si kërcënim për ju, është gjendja e atyre që Zoti i mallkoi, duke i dëbuar nga mëshira e Tij dhe duke u zemëruar me ta, për t'i ndëshkuar në dynja dhe në ahiret. Ai i shndërroi ata në majmunë e derra dhe i bëri adhurues të Shejtanit dhe të çdo gjëje tjetër veç Zotit.

- "Këta janë në shkallën më të rëndë dhe më të devijuarit prej rrugës së drejtë." - Mendojeni pak dhe kuptojeni se këta janë në gjendje më të keqe se ata që ju i shihni si të humbur dhe i urreni për besimin e tyre të saktë. Allahu i ka zgjedhur ata fatlumë, ndërsa mëshira e Tij është shumë pranë tyre. Allahu është i kënaqur me ta dhe i shpërblen në dynja dhe në ahiret, sepse ata ia përkushtojnë të gjitha adhurimet vetëm Atij, duke synuar kënaqësinë e Tij, edhe pse ju e urreni këtë gjë dhe e shihni si mangësi.

- "Kur vijnë te ju, ata thonë: "Kemi besuar", ndërkohë që, në fakt, ata vijnë me kufër dhe largohen me kufër." - Ata pretendojnë se janë besimtarë, ndërkohë vijnë e shkojnë me mosbesim. Ata thjesht janë mohues, edhe nëse pretendojnë se besojnë. Nuk ka në gjendje më të rëndë se këta të vetëmashtruar. Si nuk e kuptojnë këta të mjerë se:

- "Allahu e di më së miri se çfarë fshehin ata." – Pra, Allahu i di shumë mirë veprat e tyre të shëmtuara, mosbesimin dhe

hipokrizinë që fshihet në zemrat e tyre. Ai ka për të shpërblyer gjithësecilin sipas punës së bërë, e mirë apo e keqe qoftë.

Më pas, Allahu i Madhëruar zbulon mangësitë e tyre, duke treguar kështu ndihmën dhe mbështetjen e Tij për besimtarët:

- "Shumë prej tyre i sheh të nguten në gjynahe, në zullume dhe në ngrënie të haramit." - Shumë prej tyre i sheh të babëzitur në poshtërsi dhe padrejtësi, qoftë në lidhje me detyrimet ndaj Krijuesit, qoftë në lidhje me detyrimet ndaj krijesave, duke u shfaqur atyre armiqësi dhe arogancë. Ata, gjithashtu, nuk ruhen nga ngrënia e pasurisë haram.

Allahu i Madhëruar nuk thotë thjesht që ata kryejnë gjynahe, por thotë se ata nxitojnë të kryejnë gjynahe. Kjo tregon poshtërsinë, ligësinë dhe shëmtinë e shpirtit të tyre, që e dëshiron aq shumë padrejtësinë, edhe pse pretendojnë se qëndrojnë në nivele të larta.

- "Sa e shëmtuar është sjellja e tyre!" - Ky është një poshtërim për ta dhe për veprat e tyre të ndyra dhe të ndëshkueshme.

- "Pse, vallë, paria e tyre fetare nuk i ndal ata nga fjalët e shëmtuara dhe nga ngrënia e haramit?!" - Përse dijetarët, edukatorët dhe kleri nuk i ndalin ata nga krimet dhe gjynahet? Përse nuk i ndalin nga fjalët e këqija dhe ngrënia e pasurisë haram? Zoti i ka ngarkuar dijetarët që të ndihmojnë njerëzit me dijen që Ai u ka dhuruar, duke i udhëzuar tek e mira dhe duke i ndaluar nga të këqijat. Zoti i ka ngarkuar dijetarët që të largojnë prej njerëzve paditurinë, në mënyrë që askush të mos ketë më justifikim para Tij. Ata duhet të urdhërojnë për të mira, të ndalojnë nga të këqijat dhe t'u qartësojnë njerëzve porositë e Zotit të tyre. Ata duhet t'i nxisin njerëzit për të mirën dhe t'i qortojnë e paralajmërojnë që të mos u afrohen harameve.

- "Sa i keq është qëndrimi i tyre!" – Arsyeja është se ata nuk e kryejnë detyrën që iu është ngarkuar.

Ajetet 64 – 66

64. Judejtë thanë: "Dora e Allahut është e shtrënguar!" Të shtrënguara qofshin duart e tyre dhe qofshin të mallkuar, për atë që thanë! Jo, duart e Tij janë të shtrira dhe Ai shpenzon ashtu si dëshiron. Kjo që t'u zbrit ty do t'ua shtojë largimin dhe mohimin shumë prej atyre. Ne futëm armiqësi dhe urrejtje ndërmjet tyre, që do të vazhdojë deri në Ditën e Kijametit. Sa herë që ndezin zjarr për luftë, Allahu e shuan atë. Ata përpiqen pareshtur për shkatërrime në tokë, por Allahu nuk i do shkatërruesit.

65. Sikur ithtarët e Librit të besonin dhe të ruheshin, Ne do t'ua shlyenim gjynahet dhe do t'i fusnim në kopshtet e mirësisë dhe begatisë.

66. Sikur ta zbatonin Teuratin, Ungjillin dhe këtë që u shpall nga Zoti i tyre, ata do të kishin furnizim me bollëk nga qielli dhe toka. Ka prej tyre që janë të matur, por shumica prej tyre i kanë shumë të këqija veprat që punojnë.

Shpjegimi i ajeteve

Allahu i Lartësuar na tregon për fjalët e ulta dhe të shëmtuara të jehudëve dhe rreth besimit të tyre të turpshëm.

- "Judejtë thanë: "Dora e Allahut është e shtrënguar!"" – Pra, ata shpifën, - Allahu i poshtëroftë! - duke thënë se dora e Allahut është e shtrënguar nga mirësitë, dhurimet dhe bujaria. I pastër është Allahu nga shpifjet e këtyre të mjerëve!

- "Të shtrënguara qofshin duart e tyre dhe qofshin të mallkuar, për atë që thanë!" - Ky

është një mallkim kundër tyre, në përputhje të plotë me fjalët e ulta që ata thanë. Ata deklaruan paturpësisht për Allahun Bujar e Bamirës se koprracia është cilësi e Tij. Por Allahu i shpagoi ata, duke e bërë koprracinë cilësinë e tyre të pandashme. Kështu, ata u bënë njerëzit më dorështrënguar, më pak bamirës dhe më mendimkëqijtë për Allahun e Madhëruar. Ata u bënë njerëzit më të largët nga mëshira e Allahut, mëshirë e cila ka përfshirë çdo gjë, çdo vend mes botës së sipërme dhe të poshtme.

I Madhëruari u kthen përgjigjen:

- "Jo, duart e Tij janë të shtrira dhe Ai shpenzon ashtu si dëshiron." - Askush nuk mund ta pengojë Allahun e Madhëruar nga ajo që Ai dëshiron. Ai i ka shpërndarë gjithandej mirësitë e kësaj bote dhe mirësitë fetare, duke i urdhëruar robërit e Tij që t'i afrohen flladit të bujarisë dhe mëshirës së Tij. Allahu i Madhëruar i ka porositur ata që të mos ia mbyllin vetes portën e mirësive të Tij duke kryer gjynahe.

Dy duart e Allahut të Madhëruar janë gjithmonë të shtrira; ato vetëm dhurojnë e dhurojnë, ditën dhe natën. Mirësitë e Tij derdhen pa reshtur mbi krijesat. Ai largon trishtimet, i dhuron pasuri të varfërit, çliron të robëruarin, qetëson zemrën e nevojtarit, i përgjigjet lutësit, strehon të pastrehin, i përgjigjet nevojtarit; madje, Allahu u dhuron mirësi edhe atyre që nuk i luten. Ai e ruan dhe e shëron atë që kërkon shërim dhe ruajtje. Ai nuk nxitohet të privojë nga mirësitë të pabindurit dhe gjynahqarët, pasi në mirësitë e Tij kullotin edhe kope të mira, edhe kope të këqija. Megjithatë, për të zgjedhurit dhe të dashurit e Tij, Ai ka veçuar mirësinë më të madhe. Atyre u ka dhënë sukses që të bëjnë punë të mira, për të cilat i lëvdon dhe ua atribuon atyre, edhe pse në fakt ato janë dhuratë nga bujaria e Tij. Më pas, Ai u jep shpërblime të shpejta, që në këtë dynja, dhe të mëvonshme, në ahiret. Ai u jep shpërblime, të cilat nuk është e mundur të shpjegohen dhe përshkruhen, madje as nuk mund të shkojnë nëpër mendjen e robit. Allahu i Madhëruar tregohet i butë dhe i kujdesshëm për ta në të gjitha çështjet e tyre, duke u ofruar çdo mirësi dhe u larguar çdo të keqe dhe, në të shumtën e rasteve, ata nuk e ndiejnë dhe kuptojnë ndihmën dhe butësinë e Tij.


I Lartësuar dhe i Pastër nga çdo mangësi është Ai, i Cili është Dhuruesi i çdo mirësie për krijesat! Çdo mirësi që përjetojnë krijesat vjen vetëm prej Tij. Vetëm Atij i qahen dhe i drejtohen të gjithë për largimin e fatkeqësive dhe sprovave. Të shumta dhe të mrekullueshme janë begatitë e Atij, të Cilin askush nuk mund ta lëvdojë ashtu si i takon madhështisë së Tij. Ai është i lavdëruar ashtu sikurse e ka lavdëruar Veten e Vet.

I Lartësuar qoftë Allahu, pa bujarinë dhe mirësinë e të Cilit krijesat nuk mund të durojnë asnjë çast të shkurtër. Madje, ato as që mund të ekzistojnë dhe as të vazhdojnë të jenë, sepse është Ai që i bën të ekzistojnë dhe të vazhdojnë të jenë. Allahu e shëmtoftë këdo injorant që mendon se është i pavarur dhe jonevojtar për Zotin e Tij, dhe, aq më keq, që e përshkruan me cilësi që nuk i shkojnë Madhërisë së Tij.

Sikur Allahu i Madhëruar t'i merrte në përgjegjësi judejtë - e të tjerët si ata – për ato fjalë që thanë, qoftë edhe për një pjesë të tyre, ata do të ishin shkatërruar që në jetën e dynjasë, para ahiretit. Por pavarësisht nga fjalët dhe veprat e tyre të poshtra, i Madhëruari, Falësi dhe i Gjithëmëshirshmi i toleron dhe i afatizon. Ai nuk nxitohet që t'i ndëshkojë për veprat e fjalët e tyre, por u jep mundësi të reflektojnë. Sidoqoftë, le të mos harrojnë një fakt: Allahu i Madhëruar vërtet i afatizon, por kurrë nuk i harron apo t'i lërë pa i marrë në përgjegjësi.

- "Kjo që t'u zbrit ty do t'ua shtojë largimin dhe mohimin shumë prej atyre." - Ky lloj ndëshkimi është nga fatkeqësitë më të mëdha që mund të godasin robin.

Allahu i Madhëruar e ka bërë Shpalljen - të cilën ia zbriti robit dhe Profetit të Tij, - jetë


الجزء السادس سورة المائدة
وَلَوْ أَنَّ أَهْلَ ٱلْكِتَٰبِ ءَامَنُوا۟ وَٱتَّقَوْا۟ لَكَفَّرْنَا عَنْهُمْ
سَيِّـَٔاتِهِمْ وَلَأَدْخَلْنَٰهُمْ جَنَّٰتِ ٱلنَّعِيمِ ﴿٦٥﴾ وَلَوْ أَنَّهُمْ أَقَامُوا۟
ٱلتَّوْرَىٰةَ وَٱلْإِنجِيلَ وَمَآ أُنزِلَ إِلَيْهِم مِّن رَّبِّهِمْ لَأَكَلُوا۟
مِن فَوْقِهِمْ وَمِن تَحْتِ أَرْجُلِهِم ۚ مِّنْهُمْ أُمَّةٌ مُّقْتَصِدَةٌ ۖ
وَكَثِيرٌ مِّنْهُمْ سَآءَ مَا يَعْمَلُونَ ﴿٦٦﴾ ۞ يَٰٓأَيُّهَا ٱلرَّسُولُ
بَلِّغْ مَآ أُنزِلَ إِلَيْكَ مِن رَّبِّكَ ۖ وَإِن لَّمْ تَفْعَلْ فَمَا بَلَّغْتَ
رِسَالَتَهُۥ ۚ وَٱللَّهُ يَعْصِمُكَ مِنَ ٱلنَّاسِ ۗ إِنَّ ٱللَّهَ لَا يَهْدِى ٱلْقَوْمَ
ٱلْكَٰفِرِينَ ﴿٦٧﴾ قُلْ يَٰٓأَهْلَ ٱلْكِتَٰبِ لَسْتُمْ عَلَىٰ شَىْءٍ حَتَّىٰ
تُقِيمُوا۟ ٱلتَّوْرَىٰةَ وَٱلْإِنجِيلَ وَمَآ أُنزِلَ إِلَيْكُم مِّن رَّبِّكُمْ ۗ
وَلَيَزِيدَنَّ كَثِيرًا مِّنْهُم مَّآ أُنزِلَ إِلَيْكَ مِن رَّبِّكَ طُغْيَٰنًا وَكُفْرًا ۚ
فَلَا تَأْسَ عَلَى ٱلْقَوْمِ ٱلْكَٰفِرِينَ ﴿٦٨﴾ إِنَّ ٱلَّذِينَ ءَامَنُوا۟ وَٱلَّذِينَ
هَادُوا۟ وَٱلصَّٰبِـُٔونَ وَٱلنَّصَٰرَىٰ مَنْ ءَامَنَ بِٱللَّهِ وَٱلْيَوْمِ ٱلْءَاخِرِ
وَعَمِلَ صَٰلِحًا فَلَا خَوْفٌ عَلَيْهِمْ وَلَا هُمْ يَحْزَنُونَ ﴿٦٩﴾ لَقَدْ أَخَذْنَا
مِيثَٰقَ بَنِىٓ إِسْرَٰٓءِيلَ وَأَرْسَلْنَآ إِلَيْهِمْ رُسُلًا ۖ كُلَّمَا جَآءَهُمْ رَسُولٌۢ
بِمَا لَا تَهْوَىٰٓ أَنفُسُهُمْ فَرِيقًا كَذَّبُوا۟ وَفَرِيقًا يَقْتُلُونَ ﴿٧٠﴾
الحزب ١٢
١١٩

dhe gjallërim të shpirtit dhe zemrës së robit, lumturi të dynjasë dhe ahiretit të tij, e ka bërë atë fitore të mirësisë së dynjasë dhe ahiretit dhe shpëtues nga çdo e keqe që i kanoset në to. Shpallja hyjnore është mirësia më e madhe e sjellë për robërit dhe, si e tillë, ata duhet të nxitojnë ta pranojnë atë me përunjësi të thellë, ta zbatojnë dhe të jetojnë sipas saj. Ata duhet të tregojnë mirënjohje të thellë ndaj Allahut të Madhëruar, që ua dhuroi.

Nëse kjo Shpallje, e dhuruar për këto qëllime, nuk shërben për ta, por bëhet shkak që t'u shtohet edhe më tepër humbja e trishtimi, atëherë sinqerisht që ky është nga ndëshkimet më të mëdha. Atyre të mjerëve Shpallja nuk u sjell dobi, sepse ata e shtojnë kufrin e tyre, e teprojnë me padrejtësitë e tyre dhe e thellojnë devijimin e tyre. Shkaku është refuzimi nga ana e tyre i kësaj Shpalljeje, armiqësia e urrejtja kundër saj, si dhe polemikat pa të drejtë kundër saj, me dyshime e hamendësime të kota dhe të pabaza.

- "Ne futëm armiqësi dhe urrejtje ndërmjet tyre, që do të vazhdojë deri në Ditën e Kijametit." – Ata kurrë nuk bashkohen, kurrë nuk fitojnë, kurrë nuk bien dakord për diçka të dobishme. Ata vazhdimisht urrejnë njëri-tjetrin me zemrat e tyre dhe e shprehin këtë armiqësi me veprat e tyre, dhe kjo do të vazhdojë deri në Ditën e Kijametit.

- "Sa herë që ndezin zjarr për luftë, Allahu e shuan atë." - Ata hapin gjithmonë luftra për të goditur Islamin dhe besimtarët. Por sa herë që ndezin zjarrin e luftës, Allahu i Madhëruar e shuan atë, duke përçarë radhët e tyre dhe duke ndihmuar muslimanët të fitojnë.

- "Ata përpiqen pareshtur për shkatërrime në tokë..." - Ata sakrifikojnë dhe luftojnë me mish e me shpirt, për të hapur në tokë shkatërrim dhe shthurje dhe për përhapjen e fesë së tyre të kotë. Ata sakrifikojnë për ta paraqitur Islamin si të pavlerë.

- "...por Allahu nuk i do shkatërruesit." - Allahu i Madhëruar ka për ata urrejtjen më të madhe. Ai ka për t'i poshtëruar dhe ndëshkuar rëndë për prishjen e rendit në tokë. Pastaj i Lartësuari thotë:

- "Sikur ithtarët e Librit të besonin dhe të ruheshin, Ne do t'ua shlyenim gjynahet dhe do t'i fusnim në kopshtet e mirësisë dhe begatisë." - Kjo është bujaria dhe mirësia e madhe e Allahut të Lartësuar. Edhe pse më sipër Ai tregon besimin, fjalët dhe veprat e tyre të shëmtuara, përsëri i fton në pendim. Nëse ata e besojnë Allahun, engjëjt e Tij, të gjithë profetët e Tij, të gjitha shpalljet e Tij e ruhen nga gjynahet, Allahu i Madhëruar premton se do t'ua falë gjynahet e mbulojë të këqijat, edhe sikur të jenë sa të jenë, pastaj do t'i fusë në Xhenetin e mirësive, ku do të kenë çfarë u dëshiron shpirti dhe syri.

- "Sikur ta zbatonin Teuratin, Ungjillin dhe këtë që u shpall nga Zoti i tyre, ata do të kishin furnizim me bollëk nga qielli dhe toka." – Ky është urdhër që ata të angazhohen sinqerisht për të plotësuar porositë e të gjitha shpalljeve të Zotit.

Gjithashtu, imani nuk mund të jetë i plotë pa besuar Muhamedin (a.s.) dhe Shpalljen e fundit të Zotit, Kur'ânin. Nëse ata përpiqen që ta plotësojnë imanin me këtë mirësi të madhe nga Zoti i tyre, atëherë premtimi i Zotit është i mrekullueshëm: "furnizim me bollëk nga qielli dhe toka".

Pra, Allahu i Lartësuar do t'ua shtonte të mirat atyre, do t'ua zbriste shiun nga qielli dhe do t'ua mbinte bimët nga toka, sikurse ka thënë në një ajet tjetër: "E sikur banorët e vendeve të kishin besuar dhe të ishin ruajtur, Ne do t'ju hapnim begati nga qielli e toka, por ata mohuan, prandaj i dënuam me shkatërrim, për atë që merituan." [El ea'raf 96].

- "Ka prej tyre që janë të matur, por shumica prej tyre i kanë shumë të këqija veprat që punojnë." - Prej ithtarëve të Librit ka edhe nga ata që janë "të matur", që punojnë me Teuratin dhe Ungjillin, por jo me gjallëri dhe përkushtim të qartë. Megjithatë, shumica prej tyre bëjnë punë të këqija dhe dalin nga porositë e Zotit. Ndërsa të lavdëruarit, që garojnë dhe synojnë gradat e larta, ata janë shumë të pakët.

Ajeti 67

67. O i Dërguar! Përcille me qartësi atë që t'u zbrit prej Zotit tënd! Nëse nuk e bën këtë, atëherë nuk e ke kryer detyrën! Allahu të garanton mbrojtjen prej njerëzve. Nuk ka dyshim se Allahu nuk e udhëzon në rrugën e drejtë popullin që mohon.

Shpjegimi i ajetit

- "O i Dërguar! Përcille me qartësi atë që t'u zbrit prej Zotit tënd!" - Ky është një urdhër që Allahu i Madhëruar ia drejton të Dërguarit të Tij për të realizuar detyrën më të rëndësishme dhe më të nderuar për profetët: përcjelljen e qartë të Shpalljes te njerëzit. Ai i përfshin të gjithë urdhrat dhe porositë që umeti ka marrë prej Profetit (a.s.).

Profeti (a.s.) e zbatoi në mënyrë të përkryer detyrën e përcjelljes së Shpalljes hyjnore te populli i tij. Ai i ftoi njerëzit në rrugën e Zotit, i përgëzoi me premtimet e Zotit, nëse do bindeshin, dhe i kërcënoi me ndëshkimin dhe zemërimin e Tij, nëse do kthenin shpinën. Profeti (a.s.) ua lehtësoi rrugën drejt Zotit dhe Xhenetit, drejt lumturisë së dynjasë dhe ahiretit, e nuk ua vështirësoi. Ai arriti të edukojë një popull analfabet, të paditur, derisa ata u bënë edukatorë të botës. Ai e përcolli të vërtetën e Zotit të tij me fjalë, me vepra, me letra e mesazhe, nëpërmjet të dërguarve e korrierëve të tij. Pas kësaj, nuk mbeti mirësi dhe rrugë për arritjen e saj pa u sqaruar, e nuk mbeti e keqe dhe rrugë për t'u mbrojtur prej saj pa u bërë e ditur dhe pa u paralajmëruar. Për këtë kumtim të qartë e të plotë dëshmuan njerëzit më të mirë të këtij umeti, sahabët e zgjedhur dhe të nderuar dhe imamët e mëdhenj që erdhën pas tyre. Për të dëshmuan brezi më i zgjedhur dhe burrat më të spikatur të këtij umeti.

- "Nëse nuk e bën këtë, atëherë nuk e ke kryer detyrën!" – Nëse nuk e transmeton qartë mesazhin e Zotit tënd, atëherë nuk e ke kryer detyrën e ngarkuar.

- "Allahu të garanton mbrojtjen prej njerëzve." – Allahu i Madhëruar i ofron profetit të Tij mbrojtje dhe siguri prej njerëzve. Pra, kuptimi është: Qëllimi yt të jetë përcjellja e qartë e të vërtetës dhe edukimi i njerëzve. Të të mos largojë nga kjo përgjegjësi frika nga e keqja që vjen prej krijesave, sepse ata janë në dorën e Allahut, i Cili premton të të ruajë prej tyre. Ti ke detyrë veçse transmetimin e qartë të së

vërtetës. Së fundmi, çdokush që beson, beson për veten e vet.

- "Nuk ka dyshim se Allahu nuk e udhëzon në rrugën e drejtë popullin që mohon." - Ndërsa mohuesit, të cilët nuk kanë asnjë qëllim tjetër, veç plotësimit të epsheve dhe dëshirave të tyre të shfrenuara, Allahu i Madhëruar nuk ka për t'i udhëzuar në rrugën e besimit dhe nuk ka për t'u dhënë sukses për të arritur mirësinë, për shkak të mohimit të fortë që ata shprehin.

Ajeti 68

68. Thuaj: "O ithtarë të Librit, ju nuk jeni asgjë, derisa të zbatoni Teuratin, Ungjillin dhe atë që ju zbriti nga Zoti juaj. Shumë prej tyre, kjo që t'u zbrit ty do t'ua shtojë largimin dhe mohimin. Po ti mos u ligështo për popullin që nuk beson.

Shpjegimi i ajetit

U thuaj ithtarëve të Librit, duke vënë në dukje devijimin dhe humbjen e tyre: Ju nuk jeni askund në çështjet tuaja fetare. Ju nuk e besoni Muhamedin (a.s.), as Kur'ânin, as Profetin tuaj, as Librin që ju dha atij. Ju nuk e besoni të vërtetën e sigurt dhe nuk keni asnjë themel ku qëndroni. Ju do të vazhdoni të jeni të tillë, derisa të zbatoni Teuratin, Ungjillin dhe Kur'ânin, që ju zbriti nga Zoti juaj.

Në fakt, kështu do të vazhdoni të jeni, derisa të zbatoni atë që e shpalli Zoti juaj, i Cili kujdeset për ju dhe që vazhdimisht zbret mirësitë e Tij mbi ju. Mirësia më e madhe që ju ka dhuruar është zbritja e librave hyjnorë, si udhëzim dhe ligj për ju. Prandaj për këto mirësi është detyrë për ju që të shprehni mirënjohjen e thellë dhe përunjësinë ndaj Dhuruesit. Mirënjohja shprehet duke zbatuar porositë dhe ligjet e Zotit, duke plotësuar me besnikëri amanetin e ngarkuar prej Tij.

Ajeti 69

69. S'ka dyshim se kushdo që beson Allahun e Ditën e Gjykimit dhe bën vepra të mira, prej atyre që besuan, prej judejve, prej sabi'inëve e prej të krishterëve, për ta nuk do të ketë frikë e as pikëllim.

Shpjegimi i ajetit

Allahu i Madhëruar na flet për ithtarët e të gjithë librave të Tij: të Kur'ânit, Teuratit ose Ungjillit, dhe na njeh me rrugën e lumturisë të secilit prej tyre. I Lartësuari na tregon se kjo rrugë ka qenë e njëjtë për çdo popull, në çdo kohë. Besimi i sinqertë në Allahun Një dhe të Pashoq, besimi në Ditën e Llogarisë dhe kryeja e veprave të mira, ashtu siç i kërkon besimi i pastër dhe i drejtë (i sqaruar nga profetët e Zotit). Në të gjitha kohërat, çdokush që ka kryer këto detyra nuk ka pse të frikësohet dhe as të brengoset: nuk ka pse të frikësohet për të ardhmen dhe nuk ka pse të brengoset për të kaluarën. Ky është një gjykim i pandryshueshëm.

Ajetet 70 – 71

70. Prej bijve të Israilit Ne morëm një premtim të fortë dhe u dërguam profetë. Megjithatë, sa herë që u shkonte ndonjë profet me udhëzime që nuk u përshtateshin dëshirave të tyre, ata e mohonin ose e vrisnin.

71. Ata pandehnin se nuk do të kishin telashe për këtë, prandaj u verbuan e u shurdhuan. Pastaj Allahu ua pranoi pendimin. Megjithatë, më pas, shumë prej tyre mbetën të verbër e të shurdhër. Allahu sheh gjithçka që ata veprojnë.

Shpjegimi i ajeteve

- "Prej bijve të Israilit Ne morëm një premtim të fortë dhe u dërguam profetë." - I Madhëruari na tregon se Ai u ka marrë bijve të Israilit një premtim të madh:


premtimin për ta besuar drejt Allahun e Lartësuar dhe për të zbatuar detyrat dhe porositë e Tij, të cilat janë përmendur në ajetin tjetër të kësaj sureje: "Me të vërtetë, Allahu mori zotimin e bijve të Israilit, duke caktuar dymbëdhjetë prijës nga mesi i tyre. Allahu tha: "Unë jam me ju! Në qoftë se falni namazin, jepni zekatin, u besoni të dërguarve të Mi, i ndihmoni e respektoni ata, si dhe shpenzoni për hir të Allahut hua të mirë, pa dyshim që Unë do t'jua fal të këqijat tuaja dhe do t'ju fus në kopshte, nëpër të cilët rrjedhin lumenj. Çdokush prej jush që kundërshton pas kësaj, e ka humbur rrugën e drejtë". [Maide 12].

Allahu i Madhëruar u dërgoi atyre profetë njëri pas tjetrit, që t'i ftonin vazhdimisht në rrugën e drejtë dhe t'i kujtonin për porositë dhe udhëzimet e Tij të mrekullueshme. Por kjo nuk u vlejti aspak atyre, sepse:

- "Megjithatë, sa herë që u shkonte ndonjë profet me udhëzime që nuk u përshtateshin dëshirave të tyre, ata e mohonin ose e vrisnin." - Nëse e vërteta në të cilën i ftonte profeti nuk u shkonte pas oreksit, ata e mohonin, duke e konsideruar mashtrim. Ata i trajtonin profetët me vrazhdësi dhe armiqësi, duke i quajtur gënjeshtarë disa prej tyre, madje edhe duke i vrarë disa të tjerë.

- "Ata pandehnin se nuk do të kishin telashe për këtë, prandaj u verbuan e u shurdhuan." - Të mjerët mendonin se poshtërsitë e tyre, mohimi dhe padrejtësia ndaj profetëve nuk do t'u shkaktonte ndonjë problem dhe nuk do të ndëshkoheshin. Kështu, ata vazhduan të zhyteshin thellë e më thellë në humbjen dhe në gjynahet e tyre, duke u verbuar e shurdhuar ndaj së vërtetës. Megjithatë, kur ata u penduan, i Madhëruari nuk ua humbi shpresat. Ai thotë:

- "Pastaj Allahu ua pranoi pendimin." – Pra, pasi u penduan, Ai përsëri ua pranoi pendimin.


الجزء السادس سورة المائدة
وَحَسِبُوٓا۟ أَلَّا تَكُونَ فِتْنَةٌ فَعَمُوا۟ وَصَمُّوا۟ ثُمَّ تَابَ ٱللَّهُ عَلَيْهِمْ ثُمَّ
عَمُوا۟ وَصَمُّوا۟ كَثِيرٌ مِّنْهُمْ ۚ وَٱللَّهُ بَصِيرٌۢ بِمَا يَعْمَلُونَ ﴿٧١﴾
لَقَدْ كَفَرَ ٱلَّذِينَ قَالُوٓا۟ إِنَّ ٱللَّهَ هُوَ ٱلْمَسِيحُ ٱبْنُ مَرْيَمَ ۖ وَقَالَ ٱلْمَسِيحُ
يَٰبَنِىٓ إِسْرَٰٓءِيلَ ٱعْبُدُوا۟ ٱللَّهَ رَبِّى وَرَبَّكُمْ ۖ إِنَّهُۥ مَن يُشْرِكْ
بِٱللَّهِ فَقَدْ حَرَّمَ ٱللَّهُ عَلَيْهِ ٱلْجَنَّةَ وَمَأْوَىٰهُ ٱلنَّارُ ۖ وَمَا
لِلظَّٰلِمِينَ مِنْ أَنصَارٍ ﴿٧٢﴾ لَّقَدْ كَفَرَ ٱلَّذِينَ قَالُوٓا۟ إِنَّ ٱللَّهَ
ثَالِثُ ثَلَٰثَةٍ ۘ وَمَا مِنْ إِلَٰهٍ إِلَّآ إِلَٰهٌ وَٰحِدٌ ۚ وَإِن لَّمْ يَنتَهُوا۟
عَمَّا يَقُولُونَ لَيَمَسَّنَّ ٱلَّذِينَ كَفَرُوا۟ مِنْهُمْ عَذَابٌ أَلِيمٌ ﴿٧٣﴾
أَفَلَا يَتُوبُونَ إِلَى ٱللَّهِ وَيَسْتَغْفِرُونَهُۥ ۚ وَٱللَّهُ غَفُورٌ رَّحِيمٌ ﴿٧٤﴾
مَّا ٱلْمَسِيحُ ٱبْنُ مَرْيَمَ إِلَّا رَسُولٌ قَدْ خَلَتْ مِن قَبْلِهِ ٱلرُّسُلُ ۖ وَأُمُّهُۥ
صِدِّيقَةٌ ۖ كَانَا يَأْكُلَانِ ٱلطَّعَامَ ۗ ٱنظُرْ كَيْفَ نُبَيِّنُ لَهُمُ ٱلْءَايَٰتِ
ثُمَّ ٱنظُرْ أَنَّىٰ يُؤْفَكُونَ ﴿٧٥﴾ قُلْ أَتَعْبُدُونَ مِن دُونِ ٱللَّهِ مَا لَا
يَمْلِكُ لَكُمْ ضَرًّا وَلَا نَفْعًا ۚ وَٱللَّهُ هُوَ ٱلسَّمِيعُ ٱلْعَلِيمُ ﴿٧٦﴾ قُلْ
يَٰٓأَهْلَ ٱلْكِتَٰبِ لَا تَغْلُوا۟ فِى دِينِكُمْ غَيْرَ ٱلْحَقِّ وَلَا تَتَّبِعُوٓا۟ أَهْوَآءَ
قَوْمٍ قَدْ ضَلُّوا۟ مِن قَبْلُ وَأَضَلُّوا۟ كَثِيرًا وَضَلُّوا۟ عَن سَوَآءِ ٱلسَّبِيلِ ﴿٧٧﴾
١٢٠

Porta e pendimit ishte e hapur, por shumë shpejt shumica e tyre iu kthyen poshtërsive dhe shfrenimit. I Lartësuari na njofton për këtë kur thotë:

- "Megjithatë, më pas, shumë prej tyre mbetën të verbër e të shurdhër." – Pra, shumë prej tyre iu kthyen verbërisë dhe shurdhimit ndaj fakteve. Ata u zhytën sërish në krime dhe mosbindje. Vetëm një pakicë vazhdoi në rrugën e pendimit dhe të besimit të pastër ndaj Zotit.

Por të pabindurit harruan diçka shumë të rëndësishme. Ata harruan që:

- "Allahu sheh gjithçka që ata veprojnë." - Do të vijë dita kur Allahu do të shpërblejë gjithësecilin sipas punës së tij. Nëse ke vepruar mirë e me sinqeritet për Zotin, sipas porosive të Tij dhe të Profetit të Tij, do të shpërblehesh me të mira. Por nëse i ke shpërfillur porositë e Zotit dhe ke mohuar Profetin e Tij, duke bërë punë të këqija, do të

përballesh me drejtësinë e të Plotpushtetshmit.

Ajetet 72 – 75

72. Bëjnë kufër ata që thonë: "Allahu është ai, Mesihu, biri i Merjemes". Mesihu ka thënë: "O bijtë e Israilit, adhurojeni Allahun, Zotin tim dhe Zotin tuaj, sepse atij që adhuron diçka tjetër veç Allahut, Ai ia ka ndaluar Xhenetin dhe vendin do ta ketë në Zjarr. Për zullumqarët nuk ka ndihmues.

73. Gjithashtu, bëjnë kufër ata që thonë: "Allahu është i treti i Trinisë". Nuk ka në gjithësi të tjerë të adhuruar me meritë veç Një Zoti të vetëm. Nëse nuk ndalen nga ajo që thonë, ata që nuk besojnë do t'i kapë një dënim i dhembshëm.

74. A nuk po pendohen tek Allahu dhe t'i kërkojnë falje Atij, kur dihet mirë se Allahu është Falës i madh dhe Mëshirëplotë?

75. Mesihu, biri i Merjemes, është veçse një i dërguar, ashtu si pati shumë të dërguar edhe para tij. Nëna e tij ishte e sinqertë. Që të dy hanin ushqim. Vështro se si u sqarohen atyre argumentet, dhe shih pastaj se si ia kthejnë shpinën së vërtetës!

Shpjegimi i ajeteve

Allahu i Madhëruar na njeh me mohimin e krishterëve, kur thonë fjalët e tmerrshme, se:

- "Bëjnë kufër ata që thonë: "Allahu është ai, Mesihu, biri i Merjemes"." - Ata mendojnë se meqë Isai (a.s.) nuk kishte baba biologjik, atëherë duhet të jetë bir i Zotit. Por ishte vetë Isai (a.s.) ai që i ka kundërshtuar ata në këtë pretendim të kotë, kur thotë:

- "Mesihu ka thënë: "O bijtë e Israilit, adhurojeni Allahun, Zotin tim dhe Zotin tuaj..." – Pra, vetë Isai (a.s.) e ka pohuar për veten se ishte tërësisht rob, krijesë e Allahut dhe adhurues i përkushtuar ndaj Tij. Ai e ka pranuar se Allahu është Zoti i gjithçkaje dhe çdo gjë tjetër është krijesë e Tij, e varfër dhe nevojtare ndaj Tij. Isai (a.s.) gjithashtu ka thënë:

- "...sepse atij që adhuron diçka tjetër veç Allahut, Ai ia ka ndaluar Xhenetin dhe vendin do ta ketë në Zjarr. Për zullumqarët nuk ka ndihmues." – Pra, çdokush që, veç Allahut, konsideron si Zot dhe të adhuruar ndonjë gjë tjetër, çfarëdo qoftë dhe kushdo qoftë, Isai (a.s.) e çdokush tjetër, është i privuar nga Xheneti dhe vendin do ta ketë në zjarrin e Xhehenemit.

Ky është një gjykim i drejtë për ata që kryejnë krimin më të madh, idhujtarinë, sepse ata barazojnë krijesën me Krijuesin. Këta ia kushtojnë adhurimet dikujt tjetër veç Allahut. Allahu i Madhëruar i krijoi që ta adhurojnë Atë si Një të Vetëm, pra, ta veçojnë Atë me adhurime, ndërsa ata ia kushtojnë adhurimet dikujt që nuk e meriton atë, një krijese. Për këtë arsye, ata meritojnë përjetësinë në Zjarr. Të padrejtët kurrë nuk do të gjejnë shpëtim dhe askush nuk do të mund t'i ndihmojë ata të shpëtojnë nga ndëshkimi apo t'ua lehtësojnë atë.

- "Gjithashtu, bëjnë kufër ata që thonë: "Allahu është i treti i Trinisë". Kjo është njëra nga doktrinat e të krishterëve, madje doktrina themelore e tyre. Ata pretendojnë se Zoti është një trini, e përbërë nga tri pjesë: Zoti, Isai (Jezusi) dhe Merjemja (Maria). I Pastër dhe i Lartësuar është Allahu nga çdo mangësi me të cilën e përshkruajnë.

Ky është argumenti më i qartë që tregon mendjelehtësinë dhe dobësinë e të menduarit të të krishterëve. Si mund të pranohen të tilla fjalë të shëmtuara për Zotin e qiejve dhe të tokës?! Si është e mundur të barazosh dhe ngatërrosh Krijuesin me krijesat?! Si nuk arrijnë të vërejnë dhe kuptojnë madhështinë dhe pushtetin e Zotit të botëve?

Duke i kundërshtuar ata dhe çdo njeri tjetër të ngjashëm, Allahu i Madhëruar thotë:

- "Nuk ka në gjithësi të tjerë të adhuruar me meritë veç Një Zoti të vetëm." - Allahu ka çdo cilësi të plotë e absolute. Ai është i pastër nga çdo mangësi. Ai është i vetmi që krijon, administron dhe rregullon çështjet e krijesave. Çdo mirësi që u jepet krijesave vjen vetëm prej Allahut. Atëherë, si është e mundur që të adhurohet dikush tjetër veç Tij? I Lavdëruar dhe i Lartësuar qoftë Allahu i Madhëruar nga fjalët dhe shpifjet e shëmtuara, që trillojnë të padrejtët kriminelë!

Pastaj, Allahu i Madhëruar i kërcënon ata duke thënë:

- "Nëse nuk ndalen nga ajo që thonë, ata që nuk besojnë do t'i kapë një dënim i dhembshëm." - Ky kërcënim, normalisht, duhet të nxisë frikë-respekt ndaj të Madhërishmit dhe pendim tek Ai.

Më pas, Allahu i Lartësuar i fton ata në pendim, duke u treguar se do t'ua pranojë atë. Ai thotë:

- "A nuk po pendohen tek Allahu dhe t'i kërkojnë falje Atij, kur dihet mirë se Allahu është Falës i madh dhe Mëshirëplotë?" – Ata ftohen të kthehen të penduar në besimin e drejtë, duke e pranuar Allahun si të vetmin që meriton adhurimin dhe se Isai (a.s.) ishte rob, krijesë dhe adhurues i Allahut, është thjesht Profeti i Tij. Ata ftohen të pendohen nga besimi i kotë që pasonin më parë dhe t'i kërkojnë falje Allahut për ato fjalë të turpshme dhe të padrejta. Nëse e bëjnë këtë, pra, nëse pendohen, ta dinë se Allahu është Falës, mëshirëplotë. Ai i fal dhe i mbulon gjynahet e të penduarve, edhe sikur të kenë mbushur edhe kupën e qiellit. Ai i mëshiron të penduarit, duke ua pranuar pendimin dhe duke ua shndërruar veprat e këqija në vepra të mira.

Shihni me kujdes se me çfarë fjalësh ua bën Allahu ftesën: me fjalët më të zgjedhura, që tregojnë dashuri, butësi e mëshirë. Ai nuk u thotë "Pendohuni!", por u thotë: " A nuk po pendohen...?" Bëni dallimin!

Në vijim, Allahu i Madhëruar përshkruan natyrën e vërtetë të Isait (a.s.) dhe nënës së tij, ashtu si ishin në të vërtetë:

- "Mesihu, biri i Merjemes, është veçse një i dërguar, ashtu si pati shumë të dërguar edhe para tij." - Kjo është cilësia më e lartë që mund të ketë një njeri: Isai (a.s.) ishte njëri nga të zgjedhurit e Zotit, që Ai i veçoi për t'i bërë profetë të zgjedhur të Tij.

Në fakt, profetëve nuk u takon asgjë prej pushtetit të Zotit. Ata nuk kanë asnjë grimcë pushteti në dorën e tyre dhe asnjë të drejtë në vendosjen e ligjeve, përveç ligjeve që Zoti i urdhëroi të përcillnin te njerëzit. Isai (a.s.) ishte i njëjtë me të gjithë profetët para tij dhe nuk kishte asnjë shkak dhe arsye që ta nxirrte atë nga natyra njerëzore në gradën e hyjnores. Zotërimi, mbretërimi dhe pushteti janë cilësi të Zotit, e po kështu edhe merita e adhurimit dhe përunjësisë.

- "Nëna e tij ishte e sinqertë." - Edhe për nënën e Isait (a.s.), kjo është e shumta që mund të thuhet. Ajo ishte e sinqertë, grada kjo më e lartë pas asaj të profetëve. Sinqeriteti është siguria në besim dhe kryerja e veprave të mira sipas kësaj sigurie, për të kënaqur Allahun e Madhëruar.

Kjo është provë që dëshmon se Merjemja nuk ka qenë profete, por grada më e lartë që arriti ajo ishte *siddikije* - sinqeriteti. Mjafton kaq si nderim dhe mirësi për Merjemen. Po kështu, asnjë nga gratë e tjera të dalluara të botës nuk ka qenë profete, sepse Allahu i Madhëruar e caktoi profetësinë për llojin më të plotë të njerëzve, te burrat, sikurse thotë në këtë ajet: "Ne dërguam para teje vetëm se burra nga banuesit e qyteteve, të cilët i pajisëm me Shpallje." [Jusuf 109].

Mesazhi i këtij ajeti është shumë i qartë: Nëse Isai (a.s.) nuk kishte asnjë ndryshim

nga gjithë profetët e tjerë dhe nëna e tij ishte thjesht një grua e sinqertë, atëherë përse të krishterët i konsiderojnë ata si zota, që meritojnë të adhurohen ashtu si Allahu?!

- "Që të dy hanin ushqim." - Ky fakt është provë e qartë se ata ishin thjesht dy robër të varfër dhe nevojtarë, ashtu si çdo krijesë tjetër prej bijve të Ademit (a.s.). Ata kishin nevojë për ushqim e pije. Nëse do të ishin zota, nuk do të kishin nevojë për ushqim e pije, ose nuk do të kishin nevojë për asgjë, sepse Zoti i Madhëruar është dhe duhet të jetë i Pasur, Jonevojtar, i Lavdëruar dhe i Lartësuar nga mangësitë.

Pasi Allahu i Madhëruar sjell këtë provë, thotë:

- "Vështro se si u sqarohen atyre argumentet, dhe shih pastaj se si ia kthejnë shpinën së vërtetës!" - Kështu e qartëson Allahu i Madhëruar të vërtetën, kështu e zbardh dhe ndriçon atë, pa lënë asnjë grimë dyshimi rreth saj. Nëpërmjet këtyre fakteve dhe argumenteve, i Madhëruari mbjell sigurinë për të vërtetën e sjellë prej Tij. Por argumentet e Tij nuk u bëjnë dobi arrogantëve. Ata vazhdojnë të jenë të zhytur në mashtrimet dhe shpifjet e tyre. Kjo, pa dyshim, është thjesht kokëfortësi dhe padrejtësi nga ana e tyre.

Ajeti 76

76. Thuaju: A po adhuroni veç Allahut atë që nuk ka pushtet që t'ju sjellë as dëm e as dobi? Allahu është Gjithëdëgjues e i Gjithëdijshëm.

Shpjegimi i ajetit

- "Thuaju: A po adhuroni veç Allahut atë që nuk ka pushtet që t'ju sjellë as dëm e as dobi?" – Kuptimi: Thuaju atyre, o i Dërguar: Vallë, në vend të Zotit po adhurojnë krijesat, që janë nevojtare, të varfëra dhe që nuk kanë në dorë as dëm e as dobi?! Si adhuroni krijesat e dobëta dhe nevojtare, dhe e lini anash adhurimin e Zotit, që është i Vetmi që ka në dorë dobinë dhe dëmin, dhënien dhe privimin?!

- "Allahu është Gjithëdëgjues e i Gjithëdijshëm." - Allahu është Dëgjues i të gjitha zërave, në të gjitha gjuhët e ndryshme dhe i të gjitha kërkesave e lutjeve. Ai është i dijshëm për ato që shfaqen dhe për ato që mbulohen, për të fshehtat dhe për të dukshmet, për çështjet e shkuara dhe ato të ardhme. Për këtë arsye, vetëm Allahu, që është me cilësi të plota, i meriton të gjitha adhurimet.

Ajetet 77 – 81

77. "O ithtarë të Librit! Mos e teproni me fenë tuaj, duke dalë jashtë të vërtetës, dhe mos shkoni pas dëshirave të një populli para jush, që ka humbur, ka shkaktuar humbjen e shumë të tjerëve dhe që është larguar në tërësi prej rrugës së drejtë".

78. Ata bij të Israilit që mohuan të vërtetën u mallkuan prej gjuhës së Daudit dhe Isait, të birit të Merjemes. Ndodhi kështu, sepse ata kundërshtuan dhe e tepruan.

79. Ata nuk ndalonin njëri-tjetrin nga të këqijat që bënin. Sa e shëmtuar ishte sjellja e tyre!

80. Ke për të parë që shumë prej tyre miqësohen me mohuesit. Sa e keqe është ajo që kanë përgatitur për veten e tyre! Allahu është i zemëruar me ta dhe ata do jenë përjetësisht në ndëshkim.

81. Nëse me të vërtetë do të besonin Allahun, Pejgamberin dhe Shpalljen që i zbriti atij, atëherë nuk do t'i zinin miq ata. Por, në fakt, shumica e tyre janë të prishur!

Shpjegimi i ajeteve

Allahu i Lartësuar e porosit Profetin e Tij që t'u drejtohet ithtarëve të Librit me një këshillë të rëndësishme:

- "O ithtarë të Librit! Mos e teproni me fenë tuaj, duke dalë jashtë të vërtetës..." – Kuptimi: Mos i kaloni kufijtë, mos kaloni nga e vërteta tek e kota, - sikurse vepruan në fakt me pretendimet e gabuara rreth Mesihut, apo edhe me madhërimin e udhëheqësve të tyre.


- "...dhe mos shkoni pas dëshirave të një populli para jush, që ka humbur, ka shkaktuar humbjen e shumë të tjerëve dhe që është larguar në tërësi prej rrugës së drejtë". - Kurrë mos ndiqni hapat e gabuara të njerëzve që devijuan nga e vërteta, madje devijuan nga e vërteta edhe shumë të tjerë, duke u dhënë një besim dhe fe të gabuar.

Kështu, ata bënë njëherësh dy të këqija: devijimin e vetes dhe devijimin e të tjerëve. Këta janë udhëheqësit e ligësisë dhe të devijimit, prej të cilëve Allahu i Madhëruar na ka urdhëruar që të ruhemi dhe të mos i pasojmë. Kurrë nuk duhet të ndjekim dëshirat e shfrenuara dhe mendimet devijuese të tyre. Pastaj i Madhëruari thotë:

- "Ata bij të Israilit që mohuan të vërtetën u mallkuan prej gjuhës së Daudit dhe Isait, të birit të Merjemes." – Judejtë që mohuan të vërtetën u mallkuan, pra, u përjashtuan nga mëshira e Allahut. Dëshmia për këtë erdhi nga goja e Daudit (a.s.) dhe e Isait (a.s.), të birit të Merjemes. Pra, për këtë dëshmuan këta dy profetë të mëdhenj, të cilët dëshmuan, gjithashtu, se e vërteta ishte shumë e qartë dhe e kuptueshme për atë popull, prandaj mohimi i tyre ishte me vetëdije të plotë. Ata thjesht u treguan mendjemëdhenj e armiqësorë.

I Lartësuari i përmbledh arsyet e mallkimit të tyre në vijim:

- "Ndodhi kështu, sepse ata kundërshtuan dhe e tepruan." - Ata nuk iu bindën Allahut në urdhrat dhe ndalesat e Tij dhe shkelën të drejtat e krijesave, të drejta të vendosura nga vetë Allahu. Këto vepra u bënë shkak që ata



të meritonin ndëshkimin dhe të mallkoheshin. Pa dyshim, gjynahet dhe padrejtësitë sjellin ndëshkim të rëndë.

Ndër gjynahet që u sollën atyre ndëshkimin, Allahu i Madhëruar përmend:

- "Ata nuk ndalonin njëri-tjetrin nga të këqijat që bënin. Sa e shëmtuar ishte sjellja e tyre!" – Ata nuk kryenin detyrimet e Zotit, por bënin harame dhe nuk e ndalonin njëri-tjetrin nga ato. Në këtë mënyrë, të gjithë ngarkoheshin me gjynahe: edhe vepruesit, edhe vëzhguesit, që nuk këshillonin, edhe pse e kishin mundësinë ta bënin.

Kjo tregon për nënvlerësimin dhe shpërfilljen e madhe që u bënin ata çështjeve të besimit dhe të fesë së Zotit. Mosbindja ndaj Zotit shihej nga ata si diçka e vogël, që nuk meritonte shqetësim. Nëse në zemrat e tyre do të kishte respekt për të Madhëruarin, ata do të ndjenin sadopak keqardhje për shkeljen e kufijve të Tij, do të shqetësoheshin për zemërimin e Allahut.

Heshtja dhe moskëshillimi, edhe kur është mundësia për ta kryer një gjë të tillë, është një vepër që meriton ndëshkim, sepse ajo sjell shumë e shumë të këqija. Heshtja ndaj veprave të ndaluara është gjynah dhe mosbindje ndaj Zotit, edhe nëse vetë nuk e kryen poshtërsinë që e sheh dhe e dëshmon. Ashtu sikurse është detyrë largimi nga haramet, edhe ndalimi i atyre që i kryejnë ato është detyrë. Heshtja shpreh mosinteresim dhe nënvleftësim të mosbindjes ndaj Allahut. Ajo tregon se ti nuk e sheh atë si problem dhe fatkeqësi të madhe. Po ashtu, moskëshillimi u jep kurajo dhe justifikim gjynahqarëve që t'i shtojnë veprat e këqija, sepse askush nuk i qorton dhe nuk ua tërheq vërejtjen atyre. Në këtë mënyrë, pra, përhapet më tepër e keqja, ndërsa fatkeqësitë e dynjasë dhe të fesë rëndohen. Njëkohësisht, kështu shtohen e fuqizohen edhe gjynahqarët, dhe me fuqizimin e tyre, dobësohen besimtarët, aq sa të mos përballen me të keqen dhe ithtarët e saj. Nëse do të veprojnë që në fillim, do të jetë më e thjeshtë dhe rezultative.

Nga braktisja e urdhërimit për të mirë dhe ndalimit nga e keqja humbet dituria dhe përhapet injoranca. Nëse gjynahet veprohen lart e poshtë dhe askush prej të diturve nuk këshillon dhe as i ndalon, njerëzit do të fillojnë të mendojnë se këto gjynahe nuk janë më të ndaluara. Madje, ndonjë injorant mund ta paraqesë një haram, që është totalisht në kundërshtim me rrugën e Zotit e të Profetit (a.s.), si vepër të mirë apo si një adhurim. E ku ka poshtërsi më të madhe sesa të konsiderosh një haram, të cilin Zoti e ka ndaluar, si diçka të lejuar apo të pëlqyeshme dhe të mirë?! Kështu, realiteti tjetërsohet në zemrat e njerëzve, aq sa e vërteta shihet si e kotë dhe anasjelltas. Indiferenca ndaj gjynaheve bën që ato të zbukurohen në zemrat dhe mendjet e shumë njerëzve dhe, si rrjedhojë, të përhapen me shpejtësi, pasi njeriu e ka në natyrën e tij që të imitojë dhe të marrë shembull pjesëtarët e ngjashëm të shoqërisë ku jeton.

Pikërisht për shkak të këtyre pasojave e shumë e shumë të tjerave, Allahu i Madhëruar e veçoi këtë lloj gabimi, duke e përmendur dhe duke i mallkuar ata që e kryen dhe u familjarizuan me të.

- "Ke për të parë që shumë prej tyre miqësohen me mohuesit." – Domethënë: U shprehin atyre dashurinë, afrimitetin e mbështetjen e plotë.

- "Sa e keqe është ajo që kanë përgatitur për veten e tyre! Allahu është i zemëruar me ta dhe ata do jenë përjetësisht në ndëshkim." - Me ato vepra të shëmtuara dhe të dështuara, ata merituan zemërimin e Allahut, për shkak të të cilit zemërohet çdo gjë. Kështu, ata merituan përjetësinë në ndëshkimin e madh. Ata i bënë padrejtësi vetes së vet, duke i krijuar këtë përfundim dëshpërues. Ata i bënë padrejtësi vetes, duke e privuar nga mirësitë e përjetshme dhe të mrekullueshme në Xhenet.

- "Nëse me të vërtetë do të besonin Allahun, Pejgamberin dhe Shpalljen që i zbriti atij, atëherë nuk do t'i zinin miq ata." - Besimi i vërtetë tek Allahu, te Profeti dhe te Shpallja e Tij, e detyron robin që të miqësohet dhe ta dojë Allahun, Zotin e Tij, të afrohet dhe miqësohet me miqtë e Allahut dhe të besimtarëve. Po ashtu, si kusht i saktësisë së besimit në Allahun dhe i miqësisë me Të është distancimi nga armiqtë e Allahut dhe mosafrimi i tyre. Duke qenë se ata nuk e plotësuan këtë kusht, kjo tregon se ata nuk kishin iman.

- "Por, në fakt, shumica e tyre janë të prishur!" – Pra, shumica e tyre i kalojnë kufijtë e Allahut, duke mos iu bindur Atij dhe të Dërguarit. Pjesë e mosbindjes dhe shkeljes së kufijve ishte dhe miqësimi me armiqtë e Allahut të Lartësuar .

Ajetet 82 – 86

82. Ti do të vëresh se njerëzit me armiqësi të fortë kundër besimtarëve janë judejtë dhe idhujtarët. Ndërsa më të butët me besimtarët janë ata që thonë: "Ne jemi të krishterë". Ndodh kështu, sepse prej tyre ka dijetarë dhe adhurues asketë, të cilët nuk tregohen kryeneçë.
83. Kur e dëgjojnë atë që i është shpallur të Dërguarit, do të shohësh që prej syve të tyre rrjedhin lot, nga e vërteta që kanë kuptuar. Ata thonë: "Zoti ynë, ne kemi besuar, pra, na regjistro ndër ata që do të dëshmojnë!
84. Përse të mos e besojmë Allahun dhe të Vërtetën që na erdhi, duke qenë se ne shpresojmë që Zoti ynë të na bashkojë me njerëzit e mirë?!"
85. Për këto që thanë, Allahu i shpërbleu me kopshte, nëpër të cilët rrjedhin lumenj, ku do të jenë përgjithmonë. Ky është shpërblimi për vepërmirët!
86. Ndërkaq, ata që mohuan dhe s'i pranuan argumentet Tona janë banues të Zjarrit.

Shpjegimi i ajeteve

Allahu i Madhëruar na tregon në këto ajete për bashkësinë fetare më të afërt me muslimanët, me të cilët ata mund të afrohen, dhe për ata që kanë gjasat më të pakta për t'u afruar me muslimanët.

- "Ti do të vëresh se njerëzit me armiqësi të fortë kundër besimtarëve janë judejtë dhe idhujtarët." - Këto dy grupacione, në mënyrë kategorike janë më armiqësoret ndaj Islamit dhe muslimanëve. Ato janë në krye të armiqve që përpiqen më së shumti për dëmtimin e muslimanëve dhe të Islamit. Kjo ndodh për shkak të urrejtjes së madhe në zemrat e tyre dhe për shkak të padrejtësisë, smirës, inatit dhe mohimit të së vërtetës, me të cilët ata janë edukuar dhe kanë mbushur shpirtin e tyre.


- "Ndërsa më të butët me besimtarët janë ata që thonë: "Ne jemi të krishterë"." - Allahu i Lartësuar tregon disa shkaqe të këtij afrimiteti:

- "Ndodh kështu, sepse prej tyre ka dijetarë dhe adhurues asketë..." - Prej tyre ka dijetarë e asketë, që përpiqen e mundohen shumë me adhurimet e tyre. Pa dyshim, dashuria, asketizmi dhe adhurimet e shumta e zbusin zemrën dhe e bëjnë më të dhembshur. Ato e ruajnë zemrën nga ashpërsia dhe ftohtësia. Për këtë arsye, zemrat e tyre nuk kanë vrazhdësinë që i karakterizon judejtë, dhe as egërsinë, që i karakterizon idhujtarët.

- "...të cilët nuk tregohen kryeneçë." – Pra, ata nuk i karakterizon arroganca ndaj së vërtetës dhe mosnënshtrimi ndaj saj. Kjo i bën ata që të jenë më të afërt dhe më të dashur me muslimanët. Nuk ka dyshim se një njeri modest dhe i përulur është më pranë mirësisë sesa një arrogant e kryeneç.

- "Kur e dëgjojnë atë që i është shpallur të Dërguarit, do të shohësh që prej syve të tyre rrjedhin lot, nga e vërteta që kanë kuptuar." - Kur dëgjojnë Shpalljen që ju dha Muhamedit (a.s.), ajo ndikon drejt e në zemrat e tyre. Ata frikësohen dhe zemrat e tyre zbuten. Kjo shfaqet te lotët, që rrjedhin nga sytë e tyre për shkak të dëgjimit të së Vërtetës, për të cilën janë të bindur. Kështu, ata e besojnë dhe e pranojnë të vërtetën e Zotit. Ata dëshmojnë se besojnë, duke thënë:

- "Ata thonë: "Zoti ynë, ne kemi besuar, pra, na regjistro ndër ata që do të dëshmojnë!" – Ata që do dëshmojnë janë ndjekësit e Muhamedit (a.s.), të cilët dëshmojnë për njëshmërinë e Allahut, për vërtetësinë e Muhamedit (a.s.), për vërtetësinë e të gjithë profetëve të tjerë, si


الجزء السابع سورة المائدة
وَمَا لَنَا لَا نُؤْمِنُ بِاللَّهِ وَمَا جَاءَنَا مِنَ الْحَقِّ وَنَطْمَعُ أَن يُدْخِلَنَا
رَبُّنَا مَعَ الْقَوْمِ الصَّالِحِينَ ﴿٨٤﴾ فَأَثَابَهُمُ اللَّهُ بِمَا قَالُوا جَنَّاتٍ
تَجْرِي مِن تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ خَالِدِينَ فِيهَا وَذَٰلِكَ جَزَاءُ
الْمُحْسِنِينَ ﴿٨٥﴾ وَالَّذِينَ كَفَرُوا وَكَذَّبُوا بِآيَاتِنَا أُولَٰئِكَ
أَصْحَابُ الْجَحِيمِ ﴿٨٦﴾ يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا لَا تُحَرِّمُوا
طَيِّبَاتِ مَا أَحَلَّ اللَّهُ لَكُمْ وَلَا تَعْتَدُوا ۚ إِنَّ اللَّهَ لَا يُحِبُّ
الْمُعْتَدِينَ ﴿٨٧﴾ وَكُلُوا مِمَّا رَزَقَكُمُ اللَّهُ حَلَالًا طَيِّبًا
وَاتَّقُوا اللَّهَ الَّذِي أَنتُم بِهِ مُؤْمِنُونَ ﴿٨٨﴾ لَا يُؤَاخِذُكُمُ اللَّهُ
بِاللَّغْوِ فِي أَيْمَانِكُمْ وَلَٰكِن يُؤَاخِذُكُم بِمَا عَقَّدتُّمُ الْأَيْمَانَ
فَكَفَّارَتُهُ إِطْعَامُ عَشَرَةِ مَسَاكِينَ مِنْ أَوْسَطِ مَا تُطْعِمُونَ
أَهْلِيكُمْ أَوْ كِسْوَتُهُمْ أَوْ تَحْرِيرُ رَقَبَةٍ ۖ فَمَن لَّمْ يَجِدْ فَصِيَامُ
ثَلَاثَةِ أَيَّامٍ ۚ ذَٰلِكَ كَفَّارَةُ أَيْمَانِكُمْ إِذَا حَلَفْتُمْ ۚ وَاحْفَظُوا
أَيْمَانَكُمْ ۚ كَذَٰلِكَ يُبَيِّنُ اللَّهُ لَكُمْ آيَاتِهِ لَعَلَّكُمْ تَشْكُرُونَ ﴿٨٩﴾
يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا إِنَّمَا الْخَمْرُ وَالْمَيْسِرُ وَالْأَنصَابُ وَالْأَزْلَامُ
رِجْسٌ مِّنْ عَمَلِ الشَّيْطَانِ فَاجْتَنِبُوهُ لَعَلَّكُمْ تُفْلِحُونَ ﴿٩٠﴾
١٢٢

dhe për vërtetësinë e shpalljeve prej Allahut të Madhëruar. Ky umet, gjithashtu, do të dëshmojë për të gjithë popujt: a i kanë besuar apo mohuar profetët e tyre. Ky umet është i drejtë dhe dëshmia e tij është e pranueshme, sikurse ka thënë i Madhëruari: "Dhe kështu, Ne ju bëmë ju një popull të ekuilibruar, për të qenë dëshmitarë *(në Ditën e Gjykimit)* ndaj njerëzve. Edhe i Dërguari ka për të qenë dëshmitar ndaj jush....". [Bekare 143].

Me sa duket, këta besimtarë nga mesi i ithtarëve të Librit u qortuan dhe u luftuan për shkak të besimit të tyre te Muhamedi (a.s.), prandaj thanë:

- "Përse të mos e besojmë Allahun dhe të Vërtetën që na erdhi, duke qenë se ne shpresojmë që Zoti ynë të na bashkojë me njerëzit e mirë?!" - Pra, çfarë na pengon ne që të mos besojmë Allahun, ndërkohë që e Vërteta na erdhi e qartë. Kjo e vërtetë që na erdhi nuk pranon dyshime dhe luhatje. Ne shpresojmë që, me pasimin e saj, Zoti ynë të na fusë në Xhenet dhe të na bashkojë me vepërmirët. A nuk është normale që robi të nxitojë dhe të garojë madje, që të nënshtrohet e të punojë sipas fesë së drejtë dhe të mos largohet kurrë prej saj?!

Më tej, Allahu i Lartësuar thotë:

- "Për këto që thanë, Allahu i shpërbleu me kopshte, nëpër të cilët rrjedhin lumenj, ku do të jenë përgjithmonë. Ky është shpërblimi për vepërmirët!" - Për shkak se dëshmuan të vërtetën dhe shfaqën hapur nënshtrimin ndaj Allahut, Ai i shpërbleu me Xhenet.

Ky ajet flet për ata të krishterë të cilët e besuan Muhamedin (a.s.), si Nexhashiu etj. Në fakt, mes tyre do të gjesh gjithmonë nga ata që e zgjedhin Islamin, pasi u qartësohet kotësia e fesë së mëparshme. Pa dyshim, këta janë më pranë Islamit dhe mundësisë për ta pranuar të vërtetën sesa judejtë dhe idhujtarët. Pas shpërblimit të vepërmirëve, i Lartësuari vijon të përmendë ndëshkimin e vepërkëqijve:

- "Ndërkaq, ata që mohuan dhe s'i pranuan argumentet Tona janë banues të Zjarrit." - Pasi ata e mohuan Allahun dhe e konsideruan gënjeshtër Shpalljen e Tij, edhe pse e vërteta u bë tërësisht e qartë.

Ajetet 87 – 88

87. O ju që keni besuar! Mos i bëni haram të mirat që Allahu i lejoi për ju dhe mos i kaloni kufijtë, se, pa dyshim, Allahu nuk i do ata që i kalojnë kufijtë.

88. Hani nga ajo me të cilën Allahu ju furnizoi si hallall të mirë dhe ruajuni dënimit të Allahut, të Cilit ju i besoni.

Shpjegimi i ajeteve

- "O ju që keni besuar! Mos i bëni haram të mirat që Allahu i lejoi për ju..." – Domethënë, të mirat prej ushqimeve dhe pijeve. Falënderojeni Allahun dhe jini

mirënjohës Atij për këto të mira. Kurrë mos ia ktheni ato me mosmirënjohje dhe shpërfillje. Gjithashtu, mos i bëni të ndaluara ato që Zoti i lejoi për ju. Në të kundërt, do të bëni njëherësh disa të këqija: do të thoni të pavërteta rreth Allahut, do të mohoni mirësitë e Tij e do të konsideroni haram ato që Allahu i lejoi dhe i bëri të pastra për ju. Këto janë vepra të këqija dhe të dënueshme.

Allahu i Madhëruar ka ndaluar nga veprat e këqija dhe ka thënë:

- "...dhe mos i kaloni kufijtë, se, pa dyshim, Allahu nuk i do ata që i kalojnë kufijtë." - Allahu i urren ata dhe ka për t'i ndëshkuar për gjynahet dhe padrejtësitë e tyre.

Pastaj Allahu i Madhëruar urdhëron për të kundërtën e asaj që veprojnë idhujtarët, të cilët bëjnë haram atë që Ai e ka bërë të lejuar:

- "Hani nga ajo me të cilën Allahu ju furnizoi si hallall të mirë..." - Hani prej të mirave, me të cilat Ai ju ka furnizuar dhe jua ka lehtësuar.

Shfrytëzoni pasurinë që Zoti jua ka lehtësuar ta arrini, por me këto kushte:
- Së pari, të jetë e lejuar, pra, jo e marrë me mënyra të ndaluara, si vjedhja, grabitja, rrëmbimi etj.
- Së dyti, të jetë e këndshme, e mirë dhe e pastër. Kjo përjashton ushqimet e pista dhe jo të këndshme, si llojet e ndryshme të kafshëve mishngrënëse etj.

- "...dhe ruajuni dënimit të Allahut, të Cilit ju i besoni." – Kuptimi: Jini të devotshëm ndaj Allahut, të Cilin ju e besoni. Nëse imani juaj është i saktë dhe i vërtetë, ai duhet të prodhojë devotshmëri dhe kujdes të madh në plotësimin e detyrimeve ndaj Tij. Imani nuk mund të jetë i plotë pa treguar devotshmëri dhe pa i dhënë meritën Allahut të Madhëruar.

Ajeti tregon se, nëse dikush vendos t'ia ndalojë vetes një ushqim të caktuar të lejuar, duke u betuar për këtë ndalesë, ai ushqim në vetvete nuk është bërë haram. Megjithatë, nëse robi i kthehet përsëri atij ushqimi dhe e konsumon atë, atëherë ai duhet të kompensojë thyerjen e betimit. Kompensimi ndryshon sipas rasteve, të cilat sqarohen në librat e *fikh*-ut.

Nga ajeti kuptohet, gjithashtu, se njeriu nuk duhet t'ia ndalojë vetes atë gjë që Zoti e ka lejuar dhe që nuk është e dëmshme për të. Për këtë arsye, le ta konsumojë atë, me qëllimin që ta ndihmojë vetveten për një adhurim më të mirë ndaj Allahut të Madhëruar.


Ajeti 89

89. Allahu nuk ju merr në përgjegjësi për betimet tuaja të paqëllimta, por për ato që i keni bërë duke pasur si qëllim përbetimin. Shpagimi i tij është ushqimi i dhjetë të varfërve me po atë ushqim mesatar që ushqeni edhe familjen tuaj, ose veshja e tyre, ose lirimi i një robi. Kush nuk ka mundësi t'i bëjë këto, le të agjërojë tri ditë. Ky është shpagimi për betimet tuaja të thyera. Ruajini betimet tuaja! Kështu jua sqaron Allahu dispozitat e Veta, që të jeni mirënjohës.

Shpjegimi i ajetit

- "Allahu nuk ju merr në përgjegjësi për betimet tuaja të paqëllimta..." – Domethënë, për ato betime që nuk janë bërë duke patur si qëllim vetë betimin ose që njeriu i thotë duke menduar se ka të drejtë për një çështje. Kështu, ai betohet për të vërtetuar a argumentuar një çështje, por më pas e kupton se është e pasaktë.

- "...por për ato që i keni bërë duke pasur si qëllim përbetimin." – Pra, për betimet e qëllimshme, sikurse thuhet në një ajet tjetër: "Allahu nuk ju merr në përgjegjësi për betimet tuaja të paqëllimta, por për ato që i bëni qëllimisht me gjithë zemër. Allahu është Falës dhe i Butë". [Bekare 225].


الجزء السابع سورة المائدة
إِنَّمَا يُرِيدُ ٱلشَّيْطَٰنُ أَن يُوقِعَ بَيْنَكُمُ ٱلْعَدَٰوَةَ وَٱلْبَغْضَآءَ
فِى ٱلْخَمْرِ وَٱلْمَيْسِرِ وَيَصُدَّكُمْ عَن ذِكْرِ ٱللَّهِ وَعَنِ
ٱلصَّلَوٰةِ ۖ فَهَلْ أَنتُم مُّنتَهُونَ ﴿٩١﴾ وَأَطِيعُوا۟ ٱللَّهَ وَأَطِيعُوا۟
ٱلرَّسُولَ وَٱحْذَرُوا۟ ۚ فَإِن تَوَلَّيْتُمْ فَٱعْلَمُوٓا۟ أَنَّمَا عَلَىٰ رَسُولِنَا
ٱلْبَلَٰغُ ٱلْمُبِينُ ﴿٩٢﴾ لَيْسَ عَلَى ٱلَّذِينَ ءَامَنُوا۟ وَعَمِلُوا۟ ٱلصَّٰلِحَٰتِ
جُنَاحٌ فِيمَا طَعِمُوٓا۟ إِذَا مَا ٱتَّقَوا۟ وَّءَامَنُوا۟ وَعَمِلُوا۟ ٱلصَّٰلِحَٰتِ
ثُمَّ ٱتَّقَوا۟ وَّءَامَنُوا۟ ثُمَّ ٱتَّقَوا۟ وَّأَحْسَنُوا۟ ۗ وَٱللَّهُ يُحِبُّ
ٱلْمُحْسِنِينَ ﴿٩٣﴾ يَٰٓأَيُّهَا ٱلَّذِينَ ءَامَنُوا۟ لَيَبْلُوَنَّكُمُ ٱللَّهُ بِشَىْءٍ
مِّنَ ٱلصَّيْدِ تَنَالُهُۥٓ أَيْدِيكُمْ وَرِمَاحُكُمْ لِيَعْلَمَ ٱللَّهُ مَن يَخَافُهُۥ
بِٱلْغَيْبِ ۚ فَمَنِ ٱعْتَدَىٰ بَعْدَ ذَٰلِكَ فَلَهُۥ عَذَابٌ أَلِيمٌ ﴿٩٤﴾ يَٰٓأَيُّهَا
ٱلَّذِينَ ءَامَنُوا۟ لَا تَقْتُلُوا۟ ٱلصَّيْدَ وَأَنتُمْ حُرُمٌ ۗ وَمَن قَتَلَهُۥ
مِنكُم مُّتَعَمِّدًا فَجَزَآءٌ مِّثْلُ مَا قَتَلَ مِنَ ٱلنَّعَمِ يَحْكُمُ بِهِۦ ذَوَا
عَدْلٍ مِّنكُمْ هَدْيًۢا بَٰلِغَ ٱلْكَعْبَةِ أَوْ كَفَّٰرَةٌ طَعَامُ مَسَٰكِينَ
أَوْ عَدْلُ ذَٰلِكَ صِيَامًا لِّيَذُوقَ وَبَالَ أَمْرِهِۦ ۗ عَفَا ٱللَّهُ عَمَّا
سَلَفَ ۖ وَمَنْ عَادَ فَيَنتَقِمُ ٱللَّهُ مِنْهُ ۗ وَٱللَّهُ عَزِيزٌ ذُو ٱنتِقَامٍ ﴿٩٥﴾
١٢٣

Ndërsa kompensimi për thyerjen e betimit të qëllimshëm tregohet në vijim:

- "Shpagimi i tij është ushqimi i dhjetë të varfërve me po atë ushqim mesatar që ushqeni edhe familjen tuaj, ose veshja e tyre, ose lirimi i një robi." - Ky ushqim duhet të jetë i ngjashëm me atë që njeriu ushqen familjen e vet. Veshja duhet të paktën aq sa mund të falësh namazin me të. Për sa i përket lirimit të robit, ai duhet të jetë një rob besimtar, sikurse është sqaruar në një ajet tjetër. Nëse bëhet njëri nga këto tri veprime, çlirohesh nga shkelja e betimit.

- "Kush nuk ka mundësi t'i bëjë këto, le të agjërojë tri ditë. Ky është shpagimi për betimet tuaja të thyera." - Ndërsa kush nuk e ka mundësinë të kryejë njërin nga veprimet e mësipërme, e ka detyrë që të agjërojë tri ditë. Ky agjërim, gjithashtu, shlyen gjynahun e shkeljes së betimit.

- "Ruajini betimet tuaja!" – Pra, ruajuni dhe mos u betoni në Allah duke gënjyer. Gjithashtu, mos u betoni shpesh, dhe kur të betoheni, plotësojeni betimin tuaj. Mos e thyeni betimin, vetëm nëse thyerja e tij është gjëja më e mirë. Pra, mos e merrni betimin si pengesë që ju ndalon nga veprat e mira dhe bamirësia. [41]

- "Kështu jua sqaron Allahu dispozitat e Veta, që të jeni mirënjohës." - Ajetet e Allahut sqarojnë hallallin nga harami dhe qartësojnë ligjet e Tij. Allahu i Madhëruar na i qartëson këto ligje, që ne të tregohemi mirënjohës dhe falënderues ndaj Tij. Ne duhet t'i jemi mirënjohës Allahut që na mësoi ato gjëra që nuk i dinim. Robi e ka për detyrë ta falënderojë Allahun për mirësitë e shumta të Tij, ndër të cilat është dhe sqarimi me imtësi i dispozitave ligjore.

Ajetet 90 – 91

90. O ju që keni besuar, s'ka dyshim se vera, bixhozi, idhujt dhe hedhja e shigjetës *(për fall)* janë vepra të ndyra nga Shejtani. Kështu, largohuni prej tyre, që të jeni të shpëtuar!

91. Nëpërmjet verës dhe bixhozit, Shejtani dëshiron veçse të hedhë armiqësi mes jush, t'ju pengojë nga përmendja e Zotit dhe t'ju largojë nga namazi. Atëherë, a po hiqni dorë?!

Shpjegimi i ajeteve

Allahu i Madhëruar tregon se sa të këqija janë këto vepra të shëmtuara dhe na bën të ditur, gjithashtu, se ato janë prej Shejtanit. Ato janë të ndyra dhe të poshtra. Allahu i Madhëruar na urdhëron që t'u largohemi atyre gjërave, pasi nëse e bëjmë këtë, Ai na

[41] I Madhëruari thotë në një ajet tjetër: "Mos i bëni betimet tuaja në Allahun pengesë, kur doni të bëni vepra të mira, të ruheni nga të këqijat dhe të pajtoni njerëzit. Allahu është Dëgjues dhe i Gjithëditur". [Bekare 224].

premton suksesin në dynja dhe në ahiret. Ky sukses arrihet veçse duke u larguar nga çdo gjë të cilën i Lartësuari e ka bërë haram, e në mënyrë të veçantë prej atyre që janë përmendur në këtë ajet.

Fjala "*el hamr* " (vera) në ajet nënkupton çdo lloj pijeje dehëse. "*El mejsir*" (bixhoz) quhen të gjitha llojet e lojrave, në të cilat vendoset një shumë parash ose pasuri nga të dyja palët, me qëllimin për t'i fituar njëra palë. "*El ensab*" quhen idhujt, putat e statujat, që adhurohen veç Allahut. Ndërsa "*el ezlamu*" (hedhja e shigjetës) janë shigjetat apo mjetet e tjera, që shërbejnë për të hedhur short. Këto janë katër gjëra, nga të cilat Allahu i Madhëruar na ka ndaluar t'u afrohemi.

Gjithashtu, Allahu i Madhëruar tregon edhe të këqijat që ato sjellin, që të na motivojë më shumë në lënien e tyre. Ai i ka quajtur ato "*rixhsun*" – "të ndyra" në aspektin e vlerës etike të tyre, edhe nëse nuk janë të tilla nga ana fizike. Ndyrësitë janë gjëra nga të cilat ne duhet të largohemi. Ne nuk duhet të lejojmë kurrë që të ndotemi prej tyre.

Allahu i Madhëruar i ka përshkruar ato, gjithashtu, si vepra prej Shejtanit, i cili është armiku më i përbetuar dhe i pamëshirshëm i njeriut. Nuk ka dyshim që njeriu duhet të ruhet dhe të jetë i kujdesshëm ndaj këtij armiku dhe nga kurthet e tij. Ai nuk duhet t'i përngjasë dhe ta shoqërojë armikun e vet në punët e tij të ndyra dhe të dëmshme, sidomos kur bëhet fjalë për ato punë, nëpërmjet të cilave Shejtani e nënshtron dhe e shkatërron prenë e tij. Duhet kujdes dhe shumë durim për të mos bërë asnjë vepër që e ndihmon këtë armik të pamëshirshëm.

Allahu i Madhëruar na njoftoi se suksesi i vërtetë mund të arrihet veçse duke u larguar prej këtyre punëve. Në të kundërt, kryerja e tyre e privojnë njeriun nga arritja e mirësive, që i dëshiron, dhe e zhyt në mjerim, të cilit i druhet.

Këto vepra nxisin urrejtjen, armiqësinë dhe përçarjen mes vëllezërve. Kjo është arsyeja që i Mallkuari kujdeset në mënyrë të veçantë për përhapjen e tyre, sidomos pijet dehëse, kumarin dhe bastet. Ato janë mjetet më efikase për futjen e armiqësisë dhe urrejtjes mes njerëzve. Kështu, i dehuri nuk është i aftë të gjykojë dhe arsyetojë drejt dhe me qetësi. Më pas, fjalët e pamenduara nxisin zemërim dhe armiqësi, dhe përfundimi mund të shkojë deri në vrasje. Edhe në baste e kumare, kur njëra palë fiton mbi tjetrën, pa bërë asnjë shkëmbim, nxitet urrejtja dhe armiqësia.

Po ashtu, këto punë të këqija, si pijet dehëse dhe kumari, e pengojnë zemrën e robit nga përkujtimi i Allahut të Madhëruar dhe nga namazi, ndërkohë që adhurimi i Allahut është rruga e lumturisë së robit dhe qëllimi pse është krijuar. Ato e shpërqendrojnë mendjen e robit, aq sa ai nuk është në gjendje të angazhohet me gjë tjetër veç tyre. Madje, ai arrin deri aty sa nuk e di se ku ndodhet.

E ku ka punë më të keqe sesa ajo që e ndyn vepruesin e saj, e bën atë koleg të Shejtanit dhe viktimë të kurtheve të tij, aq sa të shndërrohet në një bagëti të nënshtruar dhe të pafuqishme në duart e bariut të saj; një vepër që e pengon dhe e privon robin nga arritja e çdo të mire dhe shpëtimi nga të këqijat, që nxit armiqësinë dhe urrejtjen ndaj besimtarëve dhe që pengon nga përkujtimi i Allahut, nga namazi e nga adhurimet e tjera! A ka të keqe më të madhe se kaq?! Për këtë arsye, Allahu i Lartësuar iu drejtohet mendjeve të kthjellëta dhe të shëndosha, duke u thënë: "A po hiqni dorë?" Njeriu me logjikë mjafton që të shohë vetëm disa prej këtyre ligësive që sjellin haramet, që të frenohet dhe të ndalet. Ai nuk ka nevojë për vërejtje më të fortë apo të përsëritur. I zgjuari, edhe me një shenjë kupton!

Ajeti 92

92. Bindjuni Allahut, bindjuni të Dërguarit dhe kini kujdes! Nëse refuzoni, atëherë

dijeni se obligimi i të Dërguarit Tonë është vetëm komunikimi i qartë.

Shpjegimi i ajetit

Bindja ndaj Allahut të Lartësuar dhe bindja ndaj Profetit (a.s.) janë një. Ai që i bindet Allahut i është bindur Profetit (a.s.), dhe ai që i është bindur Profetit i është bindur edhe Allahut.

Bindja ndaj Allahut të Madhëruar dhe Profetit (a.s.) arrihet me dy kushte:

1. Duke zbatuar të gjithë urdhrat dhe porositë e tyre, qofshin fjalë apo punë, të dukshme apo të brendshme, të detyrueshme apo të pëlqyeshme, për të drejtat e Krijuesit dhe Profetit të Tij, apo për të drejtat e krijesave.

2. Duke u larguar nga çdo gjë që Zoti i Madhëruar dhe Profeti e kanë ndaluar, në të gjitha drejtimet e lartpërmendura.

Siç shihet, ky është një nga urdhrat më gjithëpërfshirës të të gjithë urdhrave të Zotit. Pastaj i Madhëruari e përforcon porosinë e Tij gjithëpërfshirëse, duke thënë: "...dhe kini kujdes!" Pra, ruajuni që të mos kundërshtoni urdhrat e Zotit dhe të Profetit (a.s.), sepse kjo sjell ligësi dhe dëshpërim të madh. Nëse u ktheni shpinën atyre, dijeni se Profeti kishte për detyrë veçse transmetimin e qartë të mesazhit të Zotit dhe, sigurisht, që ai e kreu plotësisht detyrën e tij. Nëse udhëzoheni në rrugën e drejtë dhe përpiqeni sinqerisht për të jetuar sipas saj, kjo është në të mirën tuaj. Por nëse punoni keq dhe devijoni, kjo do të rëndojë mbi ju, sepse Allahu i Madhëruar ka për t'ju marrë në llogari.

Ajeti 93

93. Nuk ka gjynah për ata që kanë besuar dhe kanë bërë punë të mira, për atë që kanë ngrënë, për sa kohë që ata ruhen, besojnë e bëjnë vepra të mira, e sërish ruhen dhe besojnë, e vazhdimisht ruhen dhe bëjnë vepra të mira. Allahu i do punëmirët.

Shpjegimi i ajetit

Kur u shpallën ajetet e ndalimit kategorik të pijeve dehëse, shumë besimtarë deshën të dinin gjendjen e vëllezërve të tyre besimtarë që kishin konsumuar pijet dehëse dhe që kishin vdekur para se ato të ndaloheshin. Atëherë, Allahu i Madhëruar shpalli këto ajete dhe tha: "Nuk ka gjynah për ata që kanë besuar dhe kanë bërë punë të mira, për atë që kanë ngrënë". Pra, nuk ka gjynah për ata që kanë konsumuar pijet dehëse dhe kumarin para se të zbriste ndalimi për to.

Dikush mund të mendojë se në këtë gjykim hyjnë edhe dy vepra të tjera: adhurimi i putave dhe praktikimi i shortit, por ajeti i përjashton ata. I Lartësuari thotë: "...për ata që kanë besuar dhe kanë bërë punë të mira". Pra, është fjala për ata që u largohen gjynaheve dhe që kanë besim të drejtë tek Allahu, besim që i nxit ata vazhdimisht për punë të mira. Ky sqarim i fundit është i nevojshëm, sepse njeriu mund të plotësojë këtë kusht për njëfarë kohe dhe pastaj ta lërë atë. Por jo. Ai duhet të jetë në gjendje të tillë, deri sa t'i vijë vdekja. Pra, qëllimi është që të jetë i vazhdueshëm në punë të mira. Allahu i do punëmirët, që e përkryejnë adhurimin e përkushtuar ndaj Krijuesit të tyre dhe që tregohen gjithashtu bamirës e të dobishëm ndaj krijesave të Tij. Kjo përfshin edhe ata njerëz të cilët ushqehen me haram dhe kryejnë gjynahe, edhe pasi janë qartësuar rreth tyre, dhe pastaj pendohen tek Allahu i Madhëruar, përpiqen të jenë të devotshëm, besojnë sinqerisht e saktësisht dhe bëjnë punë të mira. Edhe këtyre Allahu i Madhëruar ua fal gjynahet dhe nuk i ndëshkon për to.

Ajetet 94 – 96

94. O ju që keni besuar! Allahu do t'ju provojë me ndalim nga një gjueti që e

arrijnë duart dhe shigjetat tuaja, që Allahu ta dallojë atë që i frikësohet Atij, kur askush nuk e sheh. Kushdo që e kalon kufirin pas këtij qartësimi, do të ketë një dënim të dhembshëm.

95. O ju që keni besuar! Mos gjuani duke qenë në ihram. Kushdo që kryen gjueti me paramendim, si dënim duhet të therë një kafshë shtëpiake të ngjashme me kafshën që ka vrarë, për të cilën vendosin dy njerëz të drejtë nga mesi juaj, duke e kushtuar atë si kurban në Qabe, ose të ushqejë të varfër si kompensim, ose të agjërojë në atë masë, që ta ndiejë ndëshkimin për gjynahun e bërë. Allahu e ka falur atë që ka kaluar. Ndërsa atij që i kthehet (*gjynahut)* pas ndalimit, Allahu do ta ndëshkojë. Allahu është i Plotfuqishëm dhe i Zoti për shpagim.

96. Ju është lejuar gjuetia e detit dhe çdo ushqim i tij, për t'u kënaqur ju dhe udhëtarët, por ju është ndaluar gjahu i tokës, sa të jeni në ihram! Kijeni frikë Allahun, para të Cilit do të grumbulloheni!

Shpjegimi i ajeteve

Një ndër mirësitë e shumta që Allahu i Madhëruar u ka bërë robërve të Tij është që i ka përgatitur ata për sprovat me të cilat do t'i godasë, me gjykimin dhe caktimin e Tij. Ai u tregon në Librin e Tij mënyrat e sprovimit, që ata të binden dhe të rrinë të përgatitur për çdo rast. Pas këtij paralajmërimi, çdokush do të zgjedhë shpëtimin ose humbjen, i vetëdijshëm dhe i qartë për atë që bën.

Kështu, thotë i Madhëruari:

- "O ju që keni besuar! Allahu do t'ju provojë me ndalim nga një gjueti që e arrijnë duart dhe shigjetat tuaja..." - Allahu i Madhëruar ka për ta vënë në provë besimin tuaj. Ai do t'ju sprovojë me diçka të vogël e të lehtë, jo me diçka të madhe e të rëndë. Kjo sprovë do të jetë si lehtësim nga Allahu i Madhëruar. Është vetë Zoti që jua mundëson gjuetinë, me shtiza dhe me duar.

Pastaj Allahu i Madhëruar tregon urtësinë e këtij sprovimi:

"...që Allahu ta dallojë atë që i frikësohet Atij, kur askush nuk e sheh." – Pra, që Allahu i Madhëruar t'jua shfaqë krijesave haptazi atë që fshihet në zemrat e tyre, dhe kështu shpërblimi dhe ndëshkimi të ngrihen mbi fakte të dukshme dhe jo thjesht mbi dijen e Allahut të Madhëruar. Kështu, Allahu i Madhëruar do t'i shfaqë ata që i frikësohen Atij edhe fshehtazi dhe që largohen nga ndalesat e Tij edhe kur e kanë mundësinë që t'i kryejnë ato, dhe më pas do t'i shpërblejë me mirësi të shumta. Ai do t'i shfaqë edhe ata të cilët nuk i frikësohen Atij, të cilët sa herë që u jepet mundësia që të gjuajnë edhe kur e kanë të ndaluar, ata e bëjnë, pa u drojtur nga Zoti dhe përgjegjësia para Tij.

- "Kushdo që e kalon kufirin pas këtij qartësimi, do të ketë një dënim të dhembshëm." - Çdokush që i kalon kufijtë e Zotit, pasi i janë sqaruar, ai meriton dhe do të marrë një ndëshkim të dhimbshëm, realitetin e të cilit e di veçse Allahu i Madhëruar. Ky ndëshkim është i merituesshëm, sepse ata nuk kanë asnjë justifikim për veprat e tyre.

Devotshmëria e shpërblyeshme është ajo e fshehta, kur asnjë krijesë nuk të sheh dhe dëshmon. Ndërsa shfaqja e devotshmërisë në praninë e njerëzve, mund të jetë sa për sy e faqe, dhe njeriu nuk meriton shpërblim për këtë vepër.

Pastaj Allahu i Lartësuar e shpreh qartë ndalimin e gjuetisë gjatë kohës së ihramit (për haxh ose umre). Ai thotë:

- "O ju që keni besuar! Mos gjuani duke qenë në ihram." - Kjo ndalesë përfshin gjithçka që lidhet me gjuetinë, si: veprimet përgatitore për gjueti, pjesëmarrjen në gjueti,

ndihmesën në të, qoftë edhe duke treguar prenë apo duke dhënë armën, madje ndalohet edhe ngrënia e gjahut, nëse është gjuajtur për atë që është në ihram. Ky është respekt për adhurimet e rëndësishme dhe madhështore të haxhit dhe umres. Pra, gjuetia që në kohët e tjera është e lejuar, gjatë kohës së ihramit është e ndaluar.

- "Kushdo që kryen gjueti me paramendim, si dënim duhet të therë një kafshë shtëpiake të ngjashme me kafshën që ka vrarë, për të cilën vendosin dy njerëz të drejtë nga mesi juaj, duke e kushtuar atë si kurban në Qabe..." - Ai që bën gjueti dhe e vret kafshën e gjuetisë me qëllim, ai detyrohet që ta kompensojë këtë veprim duke bërë kurban një kafshë të përafërt me kafshën që ka vrarë (si lopë, dele, deve etj.). Domethënë, ai duhet të shohë se cilës kafshë shtëpiake i ngjan dhe i përafrohet më shumë për nga vlera kafsha që ka vrarë. Është detyrë, pra, të gjendet dhe përcaktohet përafërsia dhe ngjashmëria e duhur. Ky përcaktim bëhet nga ata që Zoti i ka quajtur "*dheuej adlin*"- të drejtët. Pra, dy njerëz të drejtë, të cilët dinë të përcaktojnë ngjashmërinë dhe përafërsinë. Kështu vepruan sahabët, të cilët, për gjuajtjen dhe vrasjen e një pëllumbi bënë të detyrueshëm kurbanin e një deleje, për vrasjen e një struci bënë të detyrueshëm kurbanin e një budneje, ndërsa për vrasjen e lopëve të egra, bënë të detyrueshme kurbanin e një lope të butë. Megjithatë, nëse nuk ka kafshë të butë shtëpiake që i përngjan apo i përafrohet gjahut të paligjshëm, atëherë shikohet vlera e tij monetare, ashtu sikurse thotë rregulli bazë për dëmshpërblimin e të dëmtuarve.

Më tej, Allahu i Madhëruar na udhëzon që kurbanin e kompensimit ta çojmë në Qabe.

- "...ose të ushqejë të varfër si kompensim, ose të agjërojë në atë masë, që ta ndiejë ndëshkimin për gjynahun e bërë. Allahu e ka falur atë që ka kaluar." - Dëmshpërblimi për gjahun e ndaluar mund të nxirret edhe në formë ushqimi për të varfërit, me të njëjtën vlerë sa bagëtia e kurbanit të kompensimit.

Shumë dijetarë kanë thënë që, pasi përcaktohet lloji i bagëtisë që do të bëhet kurban, përcaktohet vlera e saj monetare, me të cilën do të blihet ushqim për të varfërit. Pastaj, çdo të varfëri i jepet nga një *mudde* (dy grushta) grurë ose gjysmë *sa*-i me lloje të tjera ushqimi, si oriz etj. Kjo është një mënyrë kompensimi, pra, duke ushqyer të varfërit. Mënyra tjetër është duke agjëruar nga një ditë për çdo të varfër që duhej të ushqehej. Për shembull, për dhjetë të varfër është detyrë që të agjërohet dhjetë ditë.
Allahu i Madhëruar bëri të detyrueshme këto shlyerje për gjuetinë e ndaluar, me qëllim që gabimtari t'i ndjejë pasojat e mosbindjes së tij. Por ai që i kthehet përsëri kësaj vepre të ndaluar ka për t'u ndëshkuar nga Allahu i Madhëruar:

- "Ndërsa atij që i kthehet (*gjynahut*) pas ndalimit, Allahu do ta ndëshkojë. Allahu është i Plotfuqishëm dhe i Zoti për shpagim." - Shtrohet pyetja: A është i detyruar për kompensim dhe a është i kërcënuar me këtë ndëshkim si ai që e bën gjuetinë me dashje, edhe ai që e bën pa dashje? Ndërkohë, Allahu i Madhëruar ka thënë: "Kushdo që kryen gjueti me paramendim...".

Në lidhje me këtë, shumica e dijetarëve kanë thënë se ai që vret gjahun pa dashje çlirohet vetëm nga ndëshkimi i Allahut të Lartësuar, por jo nga përgjegjësia për kompensim. Rregulli për kompensimin e dëmeve thotë qartë se çdokush që dëmton jetën dhe pasurinë e atyre që nuk lejohet t'i cenosh, ai është i detyruar që t'i kompensojë, sido që të jetë, me qëllim apo pa qëllim. Allahu i Lartësuar ka përcaktuar tri lloje masash për çdo dëmtim: shpagimin, ndëshkimin në dynja dhe ndëshkimin në ahiret. Ai që e bën me qëllim dëmtimin i meriton të trija masat ndëshkimore. Ndërsa ai që e bën pa qëllim mund të çlirohet nga


ndëshkimi në dynja dhe ndëshkimi në ahiret, por jo nga detyrimi për kompensim. Kësisoj, përcaktimi në ajet: "Kushdo që kryen gjueti me paramendim...", është bërë për të përjashtuar nga dënimi i Zotit veprën e bërë pa dashje, por jo nga detyrimi për kompensim. Ky ishte mendimi i shumicës së dijetarëve.

Disa dijetarë të tjerë janë të mendimit se ai që e bën këtë vepër pa dashje përjashtohet edhe nga detyrimi për kompensim. Thënë ndryshe, kompensimi është detyrim vetëm për atë që e ka bërë me qëllim, sepse këtë e tregon qartë ajeti, me kuptimin e drejtpërdrejtë të tij. Edhe rregulli për kompensimin e dëmeve në jetë dhe pasuri është i saktë, por ka një ndryshim mes rasteve të zakonshme dhe rastit të gjahut të ndaluar. Ndryshimi është se në rastet e zakonshme kemi të bëjmë me shkelje të hakut të krijesave, prandaj është i detyrueshëm kompensimi i dëmit. Ndërsa në rastin e gjuetisë së ndaluar kemi të bëjmë me hakun e Allahut, dhe përderisa ai që e bën pa dashje çlirohet nga gjynahu dhe ndëshkimi i Zotit, duhet të jetë i çliruar edhe nga detyrimi për kompensim.

Fjala "gjueti" në ajet nënkupton si gjuetinë tokësore, ashtu edhe atë të detit. Pra, ndalesa i përfshin të dyja llojet e gjahut, prandaj Allahu i Madhëruar veçon gjahun e detit, që është hallall. I Lartësuari thotë:

- "Ju është lejuar gjuetia e detit dhe çdo ushqim i tij, për t'u kënaqur ju dhe udhëtarët..." – Pra, gjuetia në det është lejuar edhe gjatë kohës së ihramit. Lejohet si ushqimi që del i gjallë prej detit, ashtu dhe kafshët e detit të ngordhura në të.
Allahu i Lartësuar i lejoi këto ushqime, gjithashtu, me qëllim që bashkë me ne, të përfitojnë edhe shoqëruesit tanë të udhëtimit në det.

- "...por ju është ndaluar gjahu (*sajd*) i tokës, sa të jeni në ihram!" – Nga fjala "*sajd*" (gjah) nënkuptohet që, së pari, gjahu


الجزء السابع سورة المائدة
أُحِلَّ لَكُمْ صَيْدُ ٱلْبَحْرِ وَطَعَامُهُۥ مَتَٰعًا لَّكُمْ وَلِلسَّيَّارَةِ ۖ
وَحُرِّمَ عَلَيْكُمْ صَيْدُ ٱلْبَرِّ مَا دُمْتُمْ حُرُمًا ۗ وَٱتَّقُوا۟ ٱللَّهَ ٱلَّذِىٓ
إِلَيْهِ تُحْشَرُونَ ﴿٩٦﴾ * جَعَلَ ٱللَّهُ ٱلْكَعْبَةَ ٱلْبَيْتَ ٱلْحَرَامَ
قِيَٰمًا لِّلنَّاسِ وَٱلشَّهْرَ ٱلْحَرَامَ وَٱلْهَدْىَ وَٱلْقَلَٰٓئِدَ ۚ ذَٰلِكَ لِتَعْلَمُوٓا۟
أَنَّ ٱللَّهَ يَعْلَمُ مَا فِى ٱلسَّمَٰوَٰتِ وَمَا فِى ٱلْأَرْضِ وَأَنَّ ٱللَّهَ بِكُلِّ
شَىْءٍ عَلِيمٌ ﴿٩٧﴾ ٱعْلَمُوٓا۟ أَنَّ ٱللَّهَ شَدِيدُ ٱلْعِقَابِ وَأَنَّ ٱللَّهَ
غَفُورٌ رَّحِيمٌ ﴿٩٨﴾ مَّا عَلَى ٱلرَّسُولِ إِلَّا ٱلْبَلَٰغُ ۗ وَٱللَّهُ يَعْلَمُ مَا
تُبْدُونَ وَمَا تَكْتُمُونَ ﴿٩٩﴾ قُل لَّا يَسْتَوِى ٱلْخَبِيثُ وَٱلطَّيِّبُ
وَلَوْ أَعْجَبَكَ كَثْرَةُ ٱلْخَبِيثِ ۚ فَٱتَّقُوا۟ ٱللَّهَ يَٰٓأُو۟لِى ٱلْأَلْبَٰبِ
لَعَلَّكُمْ تُفْلِحُونَ ﴿١٠٠﴾ يَٰٓأَيُّهَا ٱلَّذِينَ ءَامَنُوا۟ لَا تَسْـَٔلُوا۟ عَنْ
أَشْيَآءَ إِن تُبْدَ لَكُمْ تَسُؤْكُمْ وَإِن تَسْـَٔلُوا۟ عَنْهَا حِينَ يُنَزَّلُ
ٱلْقُرْءَانُ تُبْدَ لَكُمْ عَفَا ٱللَّهُ عَنْهَا ۗ وَٱللَّهُ غَفُورٌ حَلِيمٌ ﴿١٠١﴾
قَدْ سَأَلَهَا قَوْمٌ مِّن قَبْلِكُمْ ثُمَّ أَصْبَحُوا۟ بِهَا كَٰفِرِينَ ﴿١٠٢﴾ مَا جَعَلَ
ٱللَّهُ مِنۢ بَحِيرَةٍ وَلَا سَآئِبَةٍ وَلَا وَصِيلَةٍ وَلَا حَامٍ وَلَٰكِنَّ ٱلَّذِينَ
كَفَرُوا۟ يَفْتَرُونَ عَلَى ٱللَّهِ ٱلْكَذِبَ ۖ وَأَكْثَرُهُمْ لَا يَعْقِلُونَ ﴿١٠٣﴾
١٢٤

të jetë kafshë e egër dhe jo e zbutur. Pra, vrasja e kafshëve të buta për ushqim nuk konsiderohet gjah. Së dyti, gjahu duhet të jetë i ngrënshëm, domethënë që lejohet të hahet. Kësisoj, vrasja e kafshëve jo të ngrënshme nuk konsiderohet si gjah për të cilin je i detyruar të kompensosh.

- "Kijeni frikë Allahun, para të Cilit do të grumbulloheni!" – Frika ndaj Allahut tregohet duke zbatuar ato gjëra të cilat Ai i ka urdhëruar dhe duke iu larguar atyre të cilat Ai i ka ndaluar. Për të qenë sa më e lehtë arritja e kësaj, duhet të kujtojmë shpesh se do të ringjallemi dhe do të grumbullohemi para Allahut, për t'u llogaritur dhe shpërblyer sipas veprave tona. Nëse tregohemi të devotshëm, të gëzohemi, se shpërblimi do të jetë i madh. Por nëse nuk jemi të tillë dhe nuk përpiqemi për të arritur frikën ndaj Allahut, atëherë do të jemi të rrezikuar nga ndëshkimi i të Drejtit.

Ajetet 97 – 99

97. Allahu e bëri Qaben, Shtëpinë e Shenjtë, vend rimëkëmbjeje për njerëzit; edhe muajin e shenjtë, edhe kurbanin, edhe ato me qafore. Këtë, që ta dini se Allahu e di çfarë ka në qiej dhe çfarë ka në tokë dhe se Allahu është i Dijshëm për gjithçka.

98. Dijeni se Allahu e ka ndëshkimin të rreptë, dhe dijeni se Allahu është Falës e Mëshirëplotë.

99. I Dërguari nuk ka tjetër obligim, veç kumtimit të qartë. Allahu e di atë që e publikoni dhe atë që e mbani fshehtë.

Shpjegimi i ajeteve

- "Allahu e bëri Qaben, Shtëpinë e Shenjtë, vend rimëkëmbjeje për njerëzit; edhe muajin e shenjtë, edhe kurbanin..." - Allahu i Madhëruar e bëri Qaben dhe adhurimet që kryen në të si rimëkëmbëse të njerëzve. Nëpërmjet adhurimeve të kryera në Shtëpinë e Lashtë, Allahu i Madhëruar u rimëkëmb njerëzve besimin dhe çështjet e tyre të dynjasë. Ato plotësojnë Islamin dhe fshijnë gjynahet e tyre.

Duke synuar këtë faltore madhështore, njerëzit arrijnë mirësitë dhe bujarinë e pakufishme të Allahut të Lartësuar, sepse për ta vizituar atë shpenzohen pasuri dhe kryhen sakrifica të mëdha. Atje grumbullohen muslimanë nga çdo vend i botës, ku njihen dhe ndihmojnë njëri-tjetrin. Ata këshillohen dhe bashkëpunojnë me njëri-tjetrin për çështje të ndryshme, fetare ose jofetare. Allahu i Lartësuar thotë në një ajet tjetër: "Bëju thirrje njerëzve për haxh! Ata do të vijnë në këmbë ose hipur në deve të rraskapitura, që vijnë prej të gjitha vendeve të largëta, për të qenë të pranishëm në dobitë e tyre, e që të përmendin emrin e Allahut në ditë të caktuara *(në shenjë falënderimi)* për kafshët e bagëtitë me të cilat Ai i ka furnizuar. Hani prej tyre *(kurbanëve)* dhe ushqeni të ngushtuarin e të varfërin." [Haxh 27, 28].

Pikërisht se Qabeja është rimëkëmbëse e njerëzve, disa dijetarë kanë thënë se kryerja e haxhit është *farz kifaje* çdo vit.[42] Kësisoj, nëse të gjithë njerëzit nuk do ta kryenin haxhin në Shtëpinë e Shenjtë, çdokush që e ka pasur mundësinë për kryerjen e saj do të ishte gjynahqar. Madje, nëse njerëzit të tërë do ta braktisnin haxhin, kjo do të shënonte rrënimin e tyre, pasi do humbte faktori që sjell rimëkëmbjen e mirësive të tyre, dhe Kijameti do të ndodhte shpejt.

- "...edhe ato me qafore" - Po kështu, si dobi për njerëzit janë edhe bagëtitë e shënuara me qafore, të cilat janë llojet më të mira të kurbaneve, nëpërmjet të cilave fitohet shpërblimi nga Allahu i Madhëruar.

- "Këtë, që ta dini se Allahu e di çfarë ka në qiej dhe çfarë ka në tokë dhe se Allahu është i Dijshëm për gjithçka." - Dhe pikërisht prej diturisë dhe urtësisë së Tij, Ai bëri Shtëpinë e Shenjtë. Ai e di shumë mirë për çdo mirësi tonën në dynja dhe ahiret.

- "Dijeni se Allahu e ka ndëshkimin të rreptë, dhe dijeni se Allahu është Falës e Mëshirëplotë." – Kuptimi: Njohja e këtyre dy fakteve le të jetë gjithmonë në zemrat tuaja, duke qenë të sigurt për to. Dijeni dhe kujtojeni vazhdimisht se Allahu është Ndëshkues i rreptë. Ndëshkimi i Tij godet në këtë dynja dhe në ahiret ata që nuk i binden Atij. Por dijeni dhe kujtojeni vazhdimisht që Allahu është gjithashtu Falës e Mëshirëplotë, në dynja dhe ahiret, për ata që i binden. Kjo njohje do të bëjë që në zemrat tuaja të lindë dhe të forcohet frika nga ndëshkimi i Tij dhe shpresa për faljen, mëshirën dhe shpërblimin e Tij. Ajo, gjithashtu, do t'ju nxisë që të punoni me këtë frikë dhe shpresë. Pastaj i Lartësuar i thotë:

[42] Ndërsa haxhi një herë në jetë është *farz ajn,* për atë njeri që ka mundësi.

- "I Dërguari nuk ka tjetër obligim, veç kumtimit të qartë." - Dhe Profeti (a.s.) e përcolli saktësisht dhe plotësisht mesazhin e Zotit të tij, duke e kryer kështu të vetmen detyrë të tij.

- "Allahu e di atë që e publikoni dhe atë që e mbani fshehtë." - Allahu do t'ju shpërblejë për veprat tuaja, të cilat Ai i di imtësisht dhe i ka të shënuara me korrektësi.

Ajeti 100

100. Thuaj: "Nuk është e njëjtë e keqja dhe e mira, edhe nëse shtimi i së keqes të mahnit. Kini frikë Allahun, o ju mendarë, që të shpëtoni!

Shpjegimi i ajetit

Duke i nxitur njerëzit për punë të mira dhe duke i këshilluar që të largohen nga të këqijat, Allahu i Lartësuar thotë:

- "Thuaj: "Nuk është e njëjtë e keqja dhe e mira, edhe nëse shtimi i së keqes të mahnit." – Pra, nuk janë të njëjtë besimi dhe mohimi, bindja ndaj Zotit dhe mosbindja ndaj Tij, banorët e Xhenetit dhe banorët e Zjarrit, veprat e mira dhe veprat e këqija, pasuria hallall dhe pasuria haram. Gjithashtu, e keqja nuk iu vlen aspak atyre që e kanë. Përkundrazi, ajo i dëmton ata në çështjet e dynjasë dhe të fesë.

- "Kini frikë Allahun, o ju mendarë, që të shpëtoni!" - Allahu i Madhëruar iu drejtohet të mençurve, me mendje të shëndoshë dhe arsyetim të saktë, sepse nga ata shpresohet që mund të përfitojnë nga porositë e Tij të mrekullueshme, që mirësia të punojë tek ata dhe nëpërmjet tyre. Ai tregon se çelësi i shpëtimit dhe suksesit është devotshmëria, pra, zbatimi i urdhrave dhe largimi nga ndalesat e Tij, në shenjë dashurie, madhërimi e nënshtrimi për Të. Shpërfillja e devotshmërisë është rrugë drejt humbjes së çdo mirësie dhe drejt zhytjes në ligësi dhe dëshpërim.

Ajetet 101 – 102

101. O ju besimtarë! Mos pyesni për gjëra që, sikur t'ju kthehej përgjigjja e drejtpërdrejtë, nuk do t'ju pëlqente, e nëse do të pyesnit për to kur shpallej Kur'âni, ato do t'ju bëheshin të qarta. Allahu jua ka falur kërshërinë. Allahu është Falës dhe i Butë.
102. Të tilla pyetje i ka bërë edhe një popull para jush, por pastaj u bënë jobesimtarë.

Shpjegimi i ajeteve

- "O ju besimtarë! Mos pyesni për gjëra që, sikur t'ju kthehej përgjigjja e drejtpërdrejtë, nuk do t'ju pëlqente..." - Allahu i Lartësuar i ndaloi robërit e Tij që t'i drejtonin Profetit (a.s.) pyetje të tilla që, nëse do të merrnin përgjigjjen e hapur, atyre do t'u vinte rëndë dhe do ta kishin të vështirë të zbatonin detyrimet që do të dilnin. Si për shembull, disa muslimanë e pyetën Profetin (a.s.) për prindërit e tyre, në ishin në Zjarr apo në Xhenet. Kur ata të merrnin përgjigjen se prindërit e tyre ishin në Zjarr, atëherë do të ndiheshin shumë keq. Të tilla janë edhe pyetjet për gjëra që nuk ndodhin kurrë, apo pyetje, përgjigjja e të cilave i vështirëson dispozitat dhe e rëndon umetin, ose pyetjet që, në realitet, nuk kanë ndonjë interes etj. Ndërsa pyetjet e dobishme dhe të nevojshme, nëpërmjet të cilave mëson si ta adhurosh Allahun dhe t'i bindesh Atij më mirë, nuk janë të ndaluara. Madje, ne jemi urdhëruar që t'i bëjmë të tilla pyetje, sikurse ka thënë i Lartësuari: "Ne edhe para teje dërguam veçse burra, të cilëve u dhamë shpallje. Pyetni dijetarët nëse nuk dini." [El nahl 43].

- "...e nëse do të pyesnit për to kur shpallej Kur'âni, ato do t'ju bëheshin të qarta. Allahu jua ka falur kërshërinë. Allahu është Falës dhe i Butë." – Kuptimi: Ju mund

të pyesni për ndonjë ajet, që nuk e kuptoni, apo për ndonjë gjykim, për ta qartësuar atë më mirë. (Kjo mund të ndodhte gjatë kohës kur shpallej Kur'âni, pra, gjatë jetës së Profetit). Por ju nuk duhet të gërmoni në ato çështje që vetë Allahu i Madhëruar i ka lënë në heshtje. Pra, mos i krijoni vështirësi vetes, duke kërkuar të zbuloni çështje që nuk ju sjellin ndonjë dobi dhe që vetë Zoti i ka lënë në heshtje, si lehtësim për ju.

Allahu është Falës, i Butë e i Mëshirshëm, që nuk nxitohet në ndëshkim. Pranojeni dhe kërkojeni faljen dhe mëshirën e Tij, shfaqeni veten tuaj ndaj bamirësisë dhe bujarisë së Tij. Lutuni dhe kërkoni mëshirën e Allahut dhe bëni punë që e kënaqin Atë.

- "Të tilla pyetje i ka bërë edhe një popull para jush, por pastaj u bënë jobesimtarë." – Për të tilla çështje, që ju ndaloheni të pyesni, kanë pyetur popujt para jush, të cilët përfunduan si jobesimtarë. Ata bënin pyetje jo për të mësuar rrugën e drejtë, por thjesht për të polemizuar dhe për kokëfortësi. Megjithatë, kur merrnin përgjigje, ata nuk e pranonin. Për këtë arsye, sipas një hadithi të saktë, Profeti (a.s.) ka thënë: "Atyre gjërave nga të cilat ju kam ndaluar, largojuni, ndërsa nga ato që ju kam urdhëruar të kryeni, bëni sa të mundeni! Popuj para jush u shkatërruan nga pyetjet dhe kërkesat e shumta drejtuar profetëve të tyre dhe pastaj nga kundërshtimi i tyre."

Ajetet 103 – 104

103. Allahu nuk veçoi as Behirën, as Saibën, as Vesilën dhe as Hamën, por ata që nuk besojnë trillojnë gënjeshtra për Allahun, dhe shumica e tyre nuk e kuptojnë.

104. Kur atyre u thuhet: "Ejani në udhëzimin që ka zbritur Allahu dhe tek i Dërguari, ata thonë: "Na mjafton ajo rrugë ku gjetëm prindërit tanë", edhe nëse prindërit e tyre nuk dinin asgjë dhe nuk ishin në rrugë të drejtë.

Shpjegimi i ajeteve

- "Allahu nuk veçoi as Behirën, as Saibën, as Vesilën dhe as Hamën..." - Kjo është një goditje për idhujtarët, të cilët bënin fetarisht të ligjshme ato gjëra që Zoti nuk i kishte ligjëruar dhe konsideronin haram ato që Zoti i kishte lejuar. Ata e bënin këtë veprim duke u bazuar në arsyetimet e tyre të liga dhe të kota.

Kështu, idhujtarët u ngjisnin bagëtive që i konsideronin si të shenjta emra të stisur nga vetë ata, duke kundërshtuar dhe mospërfillur gjykimin e Zotit në konsiderimin hallall apo haram të gjërave. Për ata, Behira ishte deveja që ndalonin të përdorej për bartje, duke pretenduar se ishte e shenjtë, dhe këtë kafshë e dallonin duke i bërë një të çarë në vesh. Ndërsa Saiba quhej një bagëti çfarëdo: deve, lopë ose dele, e cila, pasi arrinte një moshë të caktuar, konsiderohej e shenjtë nga ata, prandaj nuk e thernin për ta ngrënë. Madje, disa njerëz e veçonin një pjesë të pasurisë të tyre dhe e konsideronin si '*Saiba*', pra, të paprekshme. Kurse Hama quhej deveja që ata e ndalonin të përdorej si kafshë shtëpie, kur ajo plotësonte disa cilësi të caktuara.

Megjithatë, të gjitha këto kafshë konsideroheshin të shenjta nga idhujtarët, pa pasur argument nga Allahu i Madhëruar. Ata thjesht trillonin, nga injoranca e tyre. Prandaj Allahu i Madhëruar thotë:

- "...por ata që nuk besojnë trillojnë gënjeshtra për Allahun, dhe shumica e tyre nuk e kuptojnë." - Ata nuk kishin as dëshmi nga Zoti, nëpërmjet profetëve të Tij, e as logjikë të pranueshme. Megjithatë, ata ishin të vetëkënaqur me mendimet dhe trillimet e tyre, të bazuara në injorancë dhe padrejtësi.

- "Kur atyre u thuhet: "Ejani në udhëzimin që ka zbritur Allahu dhe tek i Dërguari, ata

thonë: "Na mjafton ajo rrugë ku gjetëm prindërit tanë", edhe nëse prindërit e tyre nuk dinin asgjë dhe nuk ishin në rrugë të drejtë." - Kur ata ftoheshin të pasonin Shpalljen e Profetit (a.s.), ata kthenin shpinën dhe nuk pranonin të nënshtroheshin duke thënë: "Na mjafton ajo rrugë ku gjetëm prindërit tanë", me kuptimin: Preferojmë që të ndjekim atë fe në të cilën gjetëm të parët tanë, edhe sikur të mos na shpëtojë nga ndëshkimi i Allahut. Nëse të parët e tyre do të ishin të urtë dhe të mençur, çështja do të ishte më e pranueshme, por ata ishin të paditur dhe nuk arsyetonin drejt. Ata ishin zhytur në injorancë të thellë e nuk dinin asgjë rreth udhëzimit të Zotit dhe dritës së sjellë prej Tij nëpërmjet shpalljeve dhe profetëve. Mjerë për ata që pasojnë injorantët dhe mjerë për ata që nuk kanë dituri të saktë e logjikë të pastër, dhe shpërfillin Shpalljen e Allahut dhe udhëzimin e Profetit, të cilat e mbushin zemrën me dituri, besim, udhëzim dhe siguri të plotë.


Ajeti 105

105. O ju që keni besuar! Ju jeni përgjegjës për veten tuaj! Ai që është i humbur nuk mund t'ju dëmtojë, nëse ju jeni në rrugë të drejtë. Tek Allahu do të ktheheni të gjithë dhe Ai do t'ju tregojë se çfarë keni punuar.

Shpjegimi i ajetit

- "O ju që keni besuar! Ju jeni përgjegjës për veten tuaj! Ai që është i humbur nuk mund t'ju dëmtojë, nëse ju jeni në rrugë të drejtë..." – Pra, përpiquni që ta pastroni veten tuaj! Punoni që ta disiplinoni veten tuaj, që ajo t'i nënshtrohet rrugës së drejtë. Nëse ju rregulloni veten tuaj, atëherë ju nuk mund të dëmtoheni nga ata që kanë devijuar prej rrugës së drejtë. Ata dëmtojnë veçse veten e vet.

Ky ajet nuk duhet kuptuar gabim. Dikush mund të mendojë se ai të thotë që urdhërimi për të mira dhe ndalimi nga të këqijat nuk



është ndonjë gjë e domosdoshme. Por ky është një mendim i gabuar, sepse që feja e robit të jetë e plotë, duhet që ai të kryejë edhe detyrën e urdhërimit për të mirë dhe të ndalimit nga e keqja. Nëse nuk ka mundësi që të ndalojë të keqen dhe të urdhërojë për të mira me vepra dhe me fjalë, kjo nuk është e pamundur që të kryhet me zemër. Nëse e bën me zemrën e tij, atë nuk ka për ta dëmtuar humbja e të devijuarve.

- "Tek Allahu do të ktheheni të gjithë dhe Ai do t'ju tregojë se çfarë keni punuar." - Përfundimi juaj është tek Ai, para të Cilit do të grumbulloheni Ditën e Gjykimit. Ai do t'ju llogarisë dhe shpërblejë për veprat që keni bërë, të mira apo të këqija.

Ajetet 106 – 108

106. O ju që keni besuar! Nëse ju godet sprova e vdekjes ndërsa jeni duke udhëtuar nëpër botë, dëshmia lidhur me

testamentin e atij që i është afruar vdekja, bëhet me dy dëshmitarë të drejtë nga mesi juaj, ose dy të tjerë jo prej jush. Nëse dyshoni, i ndalni ata të dy pas namazit dhe le të betohen në Allahun *(duke thënë):* "Ne nuk do ta shesim betimin në Allahun për asnjë çmim, edhe sikur të jetë fjala për çfarëdo të afërmi, dhe dëshminë që na urdhëron Allahu nuk do ta fshehim kurrë, sepse atëherë do të ishim gjynahqarë!"

107. Nëse zbulohet se ata të dy vërtet e kanë shkelur, atëherë merren dy të tjerë prej atyre që kanë më shumë meritë, të cilët duhet të betohen në Allahun *(duke thënë):* "Pa dyshim, dëshmia jonë është më e drejtë se dëshmia e atyre të mëparshmëve. Ne nuk po gënjejmë, sepse përndryshe do të ishim nga të padrejtët!"

108. Kështu është më e sigurt që ata të sjellin dëshminë e tyre saktësisht, ose të frikësohen se ndoshta dëshmitë e tyre do të hidhen poshtë nga dëshmi të tjera. Kini frikë Allahun dhe bëhuni të dëgjueshëm, se Allahu nuk e udhëzon në rrugë të drejtë popullin e prishur.

Shpjegimi i ajeteve

- "O ju që keni besuar! Nëse ju godet sprova e vdekjes ndërsa jeni duke udhëtuar nëpër botë, dëshmia lidhur me testamentin e atij që i është afruar vdekja, bëhet me dy dëshmitarë të drejtë nga mesi juaj..." - Allahu i Lartësuar na mëson se si duhet të veprojmë kur na shfaqen shenjat e vdekjes gjatë ndonjë udhëtimi dhe duhet të lëmë testament. Së pari, Ai na urdhëron që të marrim dëshmitarë.

Pra, nëse njeriu i ndien këto shenja dhe krijon bindje se është duke vdekur, atëherë është deyrim për të që të shkruajë një testament dhe të marrë dy dëshmitarë të drejtë, të cilëve u pranohet dëshmia, për të vërtetuar testamentin.

- "...ose dy të tjerë jo prej jush..." – Domethënë, që nuk janë muslimanë, por janë çifutë, të krishterë ose të tjerë. Kjo lejohet kur është e nevojshme dhe nuk ka dëshmitarë muslimanë. Kështu veprohet gjatë udhëtimeve, kur befasohemi me vdekjen. Në këtë situatë, fjala e të tillë dëshmitarëve është e pranueshme, prandaj i Lartësuari nuk e përsërit urdhrin për t'i marrë si dëshmitarë.

Megjithatë, prej tyre duhet që të merret fjala që do të dëshmojnë me drejtësi. Thotë i Madhëruari:

- "Nëse dyshoni, i ndalni ata të dy pas namazit dhe le të betohen në Allahun *(duke thënë)*: "Ne nuk do ta shesim betimin në Allahun për asnjë çmim, edhe sikur të jetë fjala për çfarëdo të afërmi, dhe dëshminë që na urdhëron Allahu nuk do ta fshehim kurrë, sepse atëherë do të ishim gjynahqarë!"" - Dëshmitarët kapen pas namazit të ikindisë, të cilin e respektojnë, dhe bëhen që të betohen se do të thonë të drejtën dhe nuk do ta tjetërsojnë dëshminë. Ata duhet të thonë: Ne nuk do ta shesim betimin në Allah për asnjë çmim, edhe sikur të jetë fjala për çfarëdo të afërmi. Me fjalë të tjera, nuk do të gënjejmë për hir të ndonjë interesi të dynjasë, qoftë edhe sikur të bëhet fjalë për ndonjë të afërm. Kurrë nuk do të fshehim dëshminë e vërtetë, por do ta sjellim ashtu sikurse e kemi dëgjuar. Nëse e ndryshojmë dëshminë e vërtetë, atëherë do të jemi gjynahqarë.

Nëse, nëpërmjet hetimit të fakteve, zbulohet se ata kanë gënjyer, atëherë le të dëshmojnë dy të tjerë, sikurse thotë i Madhëruari:

- "Nëse zbulohet se ata të dy vërtet e kanë shkelur, atëherë merren dy të tjerë prej atyre që kanë më shumë meritë, të cilët duhet të betohen në Allahun *(duke thënë):* "Pa dyshim, dëshmia jonë është më e drejtë se dëshmia e atyre të mëparshmëve. Ne nuk po gënjejmë, sepse përndryshe do të ishim nga të padrejtët!"" – Pra, le të

dëshmojnë dy burra nga të afërmit e të ndjerit, sa më të afërt të jetë e mundur. Ata duhet të betohen se dëshmia e tyre është më e vërtetë dhe më parësore të pranohet. Duhet të betohen, gjithashtu, se dy të parët kanë gënjyer dhe se dëshmia e tyre është më e pranueshme. Ata duhet të thonë se, nëse gënjejnë, atëherë qofshin prej zullumqarëve.

Në vijim, Allahu i Lartësuar tregon urtësinë e kësaj dëshmie nga të afërmit e të ndjerit, nëse dy dëshmitarët e parë kanë gënjyer. Ai thotë:

- "Kështu është më e sigurt që ata të sjellin dëshminë e tyre saktësisht, ose të frikësohen se ndoshta dëshmitë e tyre do të hidhen poshtë nga dëshmi të tjera." – Pra, bërja e dëshmisë me të tilla përbetime i jep asaj më tepër siguri e vërtetësi. Po ashtu, dëshmitarët duhet të druhen se, nëse gënjejnë, dëshmia e tyre nuk do të pranohet dhe do t'u kalojë të afërmve të të ndjerit.

- "Kini frikë Allahun dhe bëhuni të dëgjueshëm, se Allahu nuk e udhëzon në rrugë të drejtë popullin e prishur." – Njerëz të prishur janë ata që shkelin kufijtë e Allahut të Madhëruar. Ata nuk e pranojnë udhëzimin e Tij dhe as nuk kanë qëllim që ta gjejnë rrugën e drejtë.

Nga këto ajete kuptojmë se kur njeriu është në udhëtim dhe i afrohet vdekja, zakonisht nuk është e lehtë të gjejë dëshmitarë. Nëse mundet, ai duhet të zgjedhë dy dëshmitarë të drejtë muslimanë. Nëse nuk gjen, lejohet që të marrë si dëshmues dy jomuslimanë. Megjithatë, për shkak të statusit të tyre si jobesimtarë, u është dhënë e drejta të afërmve të të ndjerit që, nëse kanë dyshime në dëshminë e tyre, t'u kërkojnë që të betohen pas namazit të ikindisë se ata nuk gënjejnë, nuk kanë tradhtuar dhe nuk e kanë ndryshuar dëshminë. Kështu ata e kanë kryer detyrën e tyre. Nëse të afërmit e të ndjerit nuk e besojnë dëshminë e qafirëve dhe, duke u nisur nga prova dhe fakte, ata mendojnë se dëshmia e tyre është e gënjeshtërt apo e tjetërsuar, atëherë të afërmit nxjerrin dy dëshmitarë nga mesi i tyre. Ata duhet të betohen në Allahun e Madhëruar dhe të thonë se dëshmia e tyre është më e drejtë se dëshmia e dy të parëve, të cilët kanë gënjyer.

Këto ajete kanë zbritur për ngjarjen e Temim el Darit dhe Adij Ibn Bedaes, kur Budejl ibnu Ebi Merjem (i cili ishte musliman) ua la testamentin atyre të dyve (Temimit dhe Adijit të cilët ishin të krishterë). Kjo është një histori tepër e njohur. Megjithatë, Allahu është më i ditur për gjithçka.


Këto ajete janë prova mbështetëse të shumë çështjeve. Kështu, prej tyre mësohet se lënia e testamentit është e lejuar ligjërisht, madje e detyrueshme për atë njeri që po i afrohet vdekja. Testamenti pranohet nëse thuhet nga dikush të cilit i është afruar vdekja, duke parë shenjat e saj, dhe nëse akoma e ka mendjen në rregull. Por për të pranuar vërtetësinë e testamentit, është e detyrueshme që të jenë dy dëshmitarë të drejtë muslimanë. Dëshmia e dy jomuslimanëve pranohet veçse në rastet e domosdoshme, sipas medhhebit të Imam Ahmedit. Disa dijetarë të tjerë pretendojnë se ky gjykim i fundit është i shfuqizuar, por ai është një mendim i pabazë dhe pa argument. Nëse e sheh me kujdes ajetin, kupton se dëshmia e dy qafirëve në raste domosdoshmërie është e pranueshme edhe në raste të tjera, përveç dëshmisë për testamentin. I këtij mendimi ka qenë edhe shejhu i Islamit Ibn Tejmije.

Nga ajetet mësohet gjithashtu, se:

1. Lejohet udhëtimi i muslimanit së bashku me një jomusliman, nëse nuk ka pengesa.

2. Udhëtimi për tregti është i lejuar.

3. Nëse thjesht dyshohet në dëshminë e dëshmitarëve, pa patur ndonjë shenjë apo provë për këtë, u lejohet të afërmve të të ndjerit që t'i ndalojnë dy dëshmitarët pas namazit të ikindisë dhe t'u kërkojnë atyre të betohen sipas formulës së sjellë nga Allahu i



Madhëruar: "Ne nuk do ta shesim betimin në Allahun për asnjë çmim, edhe sikur të jetë fjala për çfarëdo të afërmi, dhe dëshminë që na urdhëron Allahu nuk do ta fshehim kurrë, sepse atëherë do të ishim gjynahqarë!"

4. Nëse për dëshmitarët nuk ekziston ndonjë dyshim dhe nuk ka fakte që tregojnë padrejtësi nga ana e tyre, nuk është e nevojshme që ata të mbahen për t'u betuar.

5. Ajeti tregon për rëndësinë e madhe të dëshmisë dhe të përforcimit të saj me betimin në Allah. Për këtë arsye, është detyrë që dëshmia të bëhet me drejtësi dhe vërtetësi.

6. Lejohet verifikimi i pohimeve të dëshmitarëve duke i ndarë ata dhe duke ua marrë dëshminë secilit më vete.

7. Nëse nëpërmjet faktesh vërtetohet se dy dëshmitarët kanë gënjyer, atëherë u lejohet të afërmve të të ndjerit që të betohen se betimi i tyre është më i vërtetë dhe parësor për t'u pranuar se dëshmia e dy të tjerëve, të cilët kanë gënjyer dhe e kanë ndryshuar të vërtetën. Kjo do të thotë që faktet dhe provat, së bashku me dëshminë e tyre, konsiderohen si argumente të pranueshme.

Ajetet 109 – 110

109. Ditën kur Allahu do t'i mbledhë profetët do t'u thotë: "Si ju janë përgjigjur?" Ata do të thonë: "Ne nuk kemi dijeni; vetëm Ti i di të gjitha të fshehtat!"

110. Allahu i thotë: "O Isa, biri i Merjemes, përkujto mirësinë Time ndaj teje dhe ndaj nënës sate, se si të fuqizova me Shpirtin e Shenjtë, se si ti u flisje njerëzve kur ishe foshnjë djepi dhe i rritur, se si ta mësova ty Librin e Urtësinë, Teuratin e Ungjillin; se si, me vullnetin Tim, krijoje një figurë shpendi prej balte, e pasi fryje në të, ajo bëhej zog, me urdhrin Tim; se si i shëroje të verbërit e lindur të tillë dhe të sëmurët nga lebra, me vullnetin Tim; se si i ngjallje të vdekurit, me vullnetin Tim; se si i pengova sulmet e judejve kundër teje atëherë kur u shkove me argumente të qarta e kur mohuesit nga radhët e tyre thanë: "Kjo është veçse magji e qartë!"

Shpjegimi i ajeteve

- "Ditën kur Allahu do t'i mbledhë profetët do t'u thotë: "Si ju janë përgjigjur?"" - Allahu i Lartësuar na flet për Ditën e Gjykimit, duke na përshkruar ngjarjet e frikshme e të mëdha që do të ndodhin atë ditë. Ai na njofton se do t'i mbledhë të gjithë profetët e do t'i pyesë ata se si iu përgjigjën popujt ftesës së tyre.

- "Ata do të thonë: "Ne nuk kemi dijeni; vetëm Ti i di të gjitha të fshehtat!"" - Profetët do të përgjigjen: Dija e plotë të

takon vetëm Ty, o Zoti ynë! Ti je më i dituri për gjithçka, Ti je njohës i çdo gjëje të dukshme apo të fshehtë! Asgjë nuk mund t'i fshihet diturisë Tënde!

- "Allahu i thotë: "O Isa, biri i Merjemes, përkujto mirësinë Time ndaj teje dhe ndaj nënës sate..." - Përkujtoje mirësinë e Zotit me zemrën dhe me fjalët e tua dhe zbato gjithçka që Zoti të porosit, në shenjë mirënjohjeje ndaj Tij. Adhuroje dhe bindju Atij për mirësitë me të cilat të dalloi mbi shumë të tjerë.

I Lartësuari vijon të përkujtojë:

- "...se si të fuqizova me Shpirtin e Shenjtë..." – Kuptimi: Të fuqizova me Shpirtin e Shpalljes, i cili të pastroi dhe të lartësoi. Ai të forcoi dhe të bëri të aftë që të mbash përgjegjësinë e ngarkuar nga Allahu për t'i ftuar njerëzit në rrugën e Tij.

Disa thonë që emërtimi "*Ruh el Kudus*" ose "Shpirti i Shenjtë" nënkupton Xhibrilin (a.s.), Melekun e Shpalljes, të cilin Allahu i Lartësuar e vendosi që ta shoqëronte Isain (a.s.) në çdo kohë dhe ta ndihmonte në momente vështirësie.

- "...se si ti u flisje njerëzve kur ishe foshnjë djepi dhe i rritur..." - Ajo nuk ishte një e folur çfarëdo, por ishte me fjalë të dobishme dhe urtësi, nga të cilat përfitojnë folësi dhe dëgjuesi, dhe këto janë fjalët që thuhen në ftesën e njerëzve në rrugën e Zotit.

Allahu i Lartësuar e pajisi Isain (a.s.) me cilësi të mrekullueshme, ashtu sikurse vëllezërit e tij profetë dhe sidomos ata më të zgjedhurit. Ai filloi t'u fliste njerëzve që në moshë të vogël, duke i ftuar në mirësi dhe duke i ndaluar nga të këqijat. Allahu i Madhëruar e dalloi Isain (a.s.) nga profetët e tjerë me disa veçori. Ai u foli njerëzve që kur ishte në djep: "Atëherë ajo u dha shenjë për nga ai *(Isai)*. Ata thanë: "Si t'i flasim atij që është foshnjë në djep?" Ai *(Isai)* tha: "Unë jam rob i Allahut. Ai më ka dhënë mua Librin dhe më ka bërë profet. Më ka bërë dobiprurës kudo që të jem dhe më ka porositur për të falur namaz dhe për të dhënë zekat për sa të jem gjallë! Ai më ka bërë të edukuar ndaj nënës sime, e nuk më ka bërë kryelartë e të padëgjueshëm! Selami është me mua ditën kur u linda, ditën kur të vdes dhe ditën kur të dal *(prej varrit)* i gjallë!" [Merjem 29 – 33].

- "...se si ta mësova ty Librin e Urtësinë, Teuratin e Ungjillin..." - Fjala "Librin" nënkupton të gjithë librat e mëparshëm që iu shpallën profetëve të bijve të Israilit, e në mënyrë të veçantë Teuratin. Isai (a.s.) ishte më i dituri rreth Teuratit, pas Musait (a.s.). Kjo fjalë përfshin, gjithashtu, edhe Ungjillin. Ndërsa "Urtësia" është njohja e qëllimeve të ligjit të Zotit, dobive e mësimeve të tij, si dhe gjykimeve të fshehura në të. Urtësia është edhe mënyra më e mençur e ftesës së njerëzve te besimi në Zot dhe tek e mira. Urtësia është, gjithashtu, përkujdesja e Allahut për çdo gjë, në mënyrën më të mirë.

- "...se si, me vullnetin Tim, krijoje një figurë shpendi prej balte, e pasi fryje në të, ajo bëhej zog, me urdhrin Tim; se si i shëroje të verbërit e lindur të tillë dhe të sëmurët nga lebra, me vullnetin Tim; se si i ngjallje të vdekurit, me vullnetin Tim" – Isai (a.s.) krijonte me baltë figurën e një zogu dhe, pasi i frynte, ai kthehej në një zog të vërtetë, me lejen e Allahut të Madhëruar. Ai shëronte të verbërit e plotë, lebrën dhe, me lejen e Zotit, ringjallte të vdekurin. Këto ishin shenja dhe mrekulli të qarta, të pamundura të arrihen nga shkenca e mjekësisë apo nga çdokush tjetër. Allahu i Madhëruar e mbështeti profetin Isa nëpërmjet këtyre mrekullive dhe e ndihmoi që të kryente misionin e tij.

- "...se si i pengova sulmet e judejve kundër teje atëherë kur u shkove me argumente të qarta e kur mohuesit nga radhët e tyre thanë: "Kjo është veçse magji e qartë!"" - Edhe kur u erdhi e vërteta e

qartë, e mbështetur me ato mrekulli madhështore, që e bënin të detyrueshme besimin, ata shpifën duke thënë: "Kjo është magji e hapur." Jo vetëm kaq, por ata tentuan edhe që ta vrisnin Isain (a.s.). Por Allahu i Madhëruar e ruajti Profetin e Tij dhe e shpëtoi nga duart e tyre. Këto e shumë të tjera ishin mirësi, me të cilat Zoti e begatoi profetin e Tij, duke e porositur që të tregohej mirënjohës dhe ta kryente me përgjegjësi detyrën e thirrjes së njerëzve në rrugën e Zotit. Dhe, në të vërtetë, ai e kreu të plotë detyrën me të cilën u ngarkua nga Zoti i tij. Ai duroi në rrugën e Zotit, ashtu si edhe vëllezërit e tij profetë të zgjedhur dhe të dalluar.

Ajetet 111 – 115

111. Kujto se si, kur i frymëzova dishepujt: "Të më besoni Mua dhe të Dërguarin Tim!", ata thanë: "Ne besuam, prandaj dëshmo se ne jemi muslimanë".
112. Kujto kur dishepujt thanë: "O Isa, biri i Merjemes, a mundet Zoti yt të na zbresë një sofër nga qielli?" Ai u tha: "Kini frikë Allahun, nëse jeni besimtarë!"
113. Ata thanë: "Ne dëshirojmë të hamë nga ajo, që të na qetësohen zemrat tona, që të dimë me siguri të plotë se na ke thënë të vërtetën e të bëhemi dëshmues të saj!"
114. Isai, biri i Merjemes, tha: "O Allah! O Zoti ynë! Zbritna nga qielli një sofër, që të jetë festë për ne dhe për ata pas nesh, të jetë shenjë prej Teje! Na dhuro, se Ti je Furnizuesi më i mirë!"
115. Allahu thotë: "Unë atë jua zbres, por çdokush prej jush që mohon pas kësaj, Unë kam për t'i dhënë një dënim ashtu si nuk është dënuar askush prej njerëzve".

Shpjegimi i ajeteve

- "Kujto se si, kur i frymëzova dishepujt: "Të më besoni Mua dhe të Dërguarin Tim!", ata thanë: "Ne besuam, prandaj dëshmo se ne jemi muslimanë"." – Kuptimi: Përkujto mirësinë Time ndaj teje, kur të bëra me mbështetës dhe pasues, kur i mbusha zemrat e dishepujve me besimin tek Unë dhe te Profeti. Nëpërmjet teje, Unë u dhurova atyre Shpalljen dhe, kur ti i ftove, ata e pranuan, e besuan dhe u bindën që të jetonin dhe punonin sipas saj. Ata thanë: "Ne e besuam Allahun, prandaj dëshmo për ne se jemi muslimanë, pra, të dorëzuar tërësisht ndaj një Zoti të vetëm." Kështu, ata shprehën njëherazi dy cilësi të tyre:

1. besimin e fortë në zemrat e tyre, që i bëri të jenë të shpëtuar dhe larg hipokrizisë apo luhatjeve.

2. islamin e tyre, që shprehet me bindje të plotë e dorëzim ndaj Zotit dhe vepra të mira konkrete, që tregojnë këtë dorëzim.

Dishepujt ishin ndihmësit e rrugës së Allahut, sikurse thotë Allahu i Madhëruar në një ajet tjetër: "O ju që keni besuar, bëhuni ndihmës të *(fesë së)* Allahut, sikurse Isai, biri i Merjemes, u tha dishepujve: "Kush do të jetë ndihmësi im për rrugën e Allahut?" Dishepujt thanë: "Ne do të jemi ndihmësit e rrugës së Allahut!" Disa prej bijve të Israilit besuan e disa nuk pranuan. Ata që besuan, Ne i mbështetëm kundër armiqve të tyre, dhe ata fituan!" [Saf 14].

- "Kujto kur dishepujt thanë: "O Isa, biri i Merjemes, a mundet Zoti yt të na zbresë një sofër nga qielli?"" - Dishepujt kërkuan një tryezë me ushqim. Në fakt, kjo kërkesë nuk u bë për shkak të ndonjë dyshimi rreth fuqisë të Allahut të Madhëruar, sepse ajo u bë me tepër edukatë. Por duke qenë se kërkesa, në njëfarë kuptimi, binte ndesh me nënshtrimin e plotë ndaj Zotit, Isai i këshilloi dishepujt e tij:

- "Ai u tha: "Kini frikë Allahun, nëse jeni besimtarë!"" – Besimi në zemër e bën njeriun të ruajë gjithmonë bindjen e devotshmërinë ndaj Allahut, pa qenë nevoja

të kërkojë shenja dhe mrekulli, pas të cilave nuk e di çfarë do të ndodhë.

Por dishepujt e qetësuan Isain, duke i thënë se nuk kishin patur atë qëllim, por një qëllim tjetër, që ishte i mirë. Ata e kishin bërë kërkesën, sepse kishin nevojë të hanin:

- "Ata thanë: "Ne dëshirojmë të hamë nga ajo..." – Kjo dëshmon se ata kishin nevojë për ushqim.

Përveç kësaj, ata thanë: "Duam që të na qetësohen zemrat me besim të fortë, kur të shohim këtë mrekulli madhështore dhe të prekshme. Kështu, imani ynë do të arrijë gradën *ajn el jakin*, pra, sigurinë e plotë për një çështje, njëlloj sikur ta shihje me sy." Kjo i ngjan shumë kërkesës që profeti dhe i dashuri i Zotit, Ibrahimi (a.s.), i bëri Atij: "Zoti im! Më mundëso të shoh se si i ngjall të vdekurit!" Ai *(Zoti)* i tha: "A nuk beson?!" Ai *(Ibrahimi)* u përgjigj: "Sigurisht që besoj, por desha që zemrës sime t'i shtohej bindja." Ai *(Zoti)* tha: "Merr katër shpendë, e pastaj, në çdo kodër vendos nga një pjesë të tyre! Pastaj thirru atyre, dhe ata kanë për të ardhur me shpejtësi! Dije se Allahu është i Plotfuqishëm e i Urtë". [Bekare 260].

- "...që të na qetësohen zemrat tona..." – Robi ka gjithnjë nevojë që të shtojë besimin, diturinë dhe sigurinë e tij në besim. Prandaj edhe dishepujt, duke sqaruar qëllimin që patën me kërkesën e tyre, thanë:

- "...që të dimë me siguri të plotë se na ke thënë të vërtetën e të bëhemi dëshmues të saj!" – Kuptimi: Kështu do të jemi më të ditur dhe të sigurt që ti je profet besnik dhe se Mesazhi që solle prej Zotit tënd është i vërtetë. Me këtë mrekulli përforcuese, ne do të jemi dëshmitarë të së vërtetës, që ti po sjell, dhe kjo do të jetë e vlefshme edhe për brezat që do të vijnë pas nesh. Me këtë dëshmi, e vërteta do të provohet më shumë dhe askush nuk do të ketë më pikëpyetje.

Pasi i dëgjoi dhe e kuptoi qëllimin e dishepujve, Isai (a.s.) iu përgjigj kërkesës së tyre:


- "Isai, biri i Merjemes, tha: "O Allah! O Zoti ynë! Zbritna nga qielli një sofër..." - Zbritja e kësaj tryeze të kryhej gjatë ndonjë feste, që të gjithë njerëzit ta shihnin. Ajo do të ishte një mrekulli e dukshme për të gjithë, e paharrueshme edhe pas kalimit të viteve.

Edhe festat e muslimanëve apo sezonet e veçanta të adhurimit, Allahu i Madhëruar i ka bërë si mënyra për të rikujtuar traditën e profetëve. Ato janë bërë, gjithashtu, për të kujtuar mirësitë dhe begatitë e shumta të Allahut mbi ta. Më tej, Isai (a.s.) tha:

- "...që të jetë festë për ne dhe për ata pas nesh, të jetë shenjë prej Teje! Na dhuro, se Ti je Furnizuesi më i mirë!" – Kështu, Isai (a.s.) e kërkoi atë mrekulli, për dy arsye: që ajo të ishte e dobishme për fenë dhe besimin, si një mrekulli që do të forconte imanin dhe do të shtonte përkushtimin ndaj Zotit dhe, së dyti, që të ishte e dobishme për dynjanë e tyre, pra, si furnizim për ta, për t'u ushqyer.

- "Allahu thotë: "Unë atë jua zbres, por çdokush prej jush që mohon pas kësaj, Unë kam për t'i dhënë një dënim ashtu si nuk është dënuar askush prej njerëzve"." – Arsyeja e ndëshkimit është se, pasi sheh një mrekulli kaq të madhe, njeriu mohon thjesht për kokëfortësi.

Allahu i Madhëruar tha se do ta zbriste atë shenjë, duke paralajmëruar se, nëse ata do ta mohonin, atëherë Ai do t'i ndëshkonte keq, por nuk thotë në ajet a e zbriti në të vërtetë sofrën apo jo. Kështu, ka mundësi që Ai të mos e ketë zbritur atë, për shkak se vetë ata nuk e kanë kërkuar më, pas atij paralajmërimi. Mbase kjo është arsyeja përse nuk është përmendur kjo ngjarje në ungjijtë e sotëm të të krishterëve. Megjithatë, ka mundësi që sofra (ose tryeza) edhe të jetë zbritur, ashtu sikurse premtoi Zoti, dhe Ai nuk e thyen kurrë premtimin e Tij, por nuk


الجزء السابع سورة المائدة
قَالَ عِيسَى ٱبْنُ مَرْيَمَ ٱللَّهُمَّ رَبَّنَآ أَنزِلْ عَلَيْنَا مَآئِدَةً مِّنَ ٱلسَّمَآءِ
تَكُونُ لَنَا عِيدًا لِّأَوَّلِنَا وَءَاخِرِنَا وَءَايَةً مِّنكَ ۖ وَٱرْزُقْنَا وَأَنتَ
خَيْرُ ٱلرَّٰزِقِينَ ﴿١١٤﴾ قَالَ ٱللَّهُ إِنِّى مُنَزِّلُهَا عَلَيْكُمْ ۖ فَمَن يَكْفُرْ بَعْدُ
مِنكُمْ فَإِنِّىٓ أُعَذِّبُهُۥ عَذَابًا لَّآ أُعَذِّبُهُۥٓ أَحَدًا مِّنَ ٱلْعَٰلَمِينَ ﴿١١٥﴾
وَإِذْ قَالَ ٱللَّهُ يَٰعِيسَى ٱبْنَ مَرْيَمَ ءَأَنتَ قُلْتَ لِلنَّاسِ ٱتَّخِذُونِى
وَأُمِّىَ إِلَٰهَيْنِ مِن دُونِ ٱللَّهِ ۖ قَالَ سُبْحَٰنَكَ مَا يَكُونُ لِىٓ أَنْ أَقُولَ
مَا لَيْسَ لِى بِحَقٍّ ۚ إِن كُنتُ قُلْتُهُۥ فَقَدْ عَلِمْتَهُۥ ۚ تَعْلَمُ مَا فِى نَفْسِى
وَلَآ أَعْلَمُ مَا فِى نَفْسِكَ ۚ إِنَّكَ أَنتَ عَلَّٰمُ ٱلْغُيُوبِ ﴿١١٦﴾ مَا قُلْتُ لَهُمْ
إِلَّا مَآ أَمَرْتَنِى بِهِۦٓ أَنِ ٱعْبُدُوا۟ ٱللَّهَ رَبِّى وَرَبَّكُمْ ۚ وَكُنتُ عَلَيْهِمْ
شَهِيدًا مَّا دُمْتُ فِيهِمْ ۖ فَلَمَّا تَوَفَّيْتَنِى كُنتَ أَنتَ ٱلرَّقِيبَ عَلَيْهِمْ ۚ
وَأَنتَ عَلَىٰ كُلِّ شَىْءٍ شَهِيدٌ ﴿١١٧﴾ إِن تُعَذِّبْهُمْ فَإِنَّهُمْ عِبَادُكَ ۖ وَإِن
تَغْفِرْ لَهُمْ فَإِنَّكَ أَنتَ ٱلْعَزِيزُ ٱلْحَكِيمُ ﴿١١٨﴾ قَالَ ٱللَّهُ هَٰذَا يَوْمُ يَنفَعُ
ٱلصَّٰدِقِينَ صِدْقُهُمْ ۚ لَهُمْ جَنَّٰتٌ تَجْرِى مِن تَحْتِهَا ٱلْأَنْهَٰرُ خَٰلِدِينَ
فِيهَآ أَبَدًا ۖ رَّضِىَ ٱللَّهُ عَنْهُمْ وَرَضُوا۟ عَنْهُ ۚ ذَٰلِكَ ٱلْفَوْزُ ٱلْعَظِيمُ ﴿١١٩﴾ لِلَّهِ
مُلْكُ ٱلسَّمَٰوَٰتِ وَٱلْأَرْضِ وَمَا فِيهِنَّ ۚ وَهُوَ عَلَىٰ كُلِّ شَىْءٍ قَدِيرٌ ﴿١٢٠﴾
١٢٧

është përmendur në ungjijtë e sotëm të të krishterëve, për shkak të harresës dhe shpërfilljes së tyre të një pjese të Shpalljes së Zotit. Ashtu siç ka mundësi që të mos jetë përmendur fare në Ungjill, por thjesht është transmetuar nga brezi në brez. Ky mendim mund të mbështetet te fjalët e dishepujve, që thanë: "...e të bëhemi dëshmues të saj!" Gjithsesi, Allahu i Lartësuar është më i Dituri për të vërtetën.

Ajetet 116 – 120

116. **Allahu *(në Ditën e Gjykimit)* do të thotë: "O Isa, biri i Merjemes! Ti, vallë, u the njerëzve: "Më besoni mua dhe nënën time si dy zota veç Allahut!?" Ai do të thotë: "Larg çdo të mete je Ti *(o Zoti im)*! Nuk më takon mua të them atë që s'është e vërtetë. Po ta kisha thënë atë, Ti do ta dije! Ti e di çfarë ka në shpirtin tim, ndërsa unë nuk e di atë që është tek Ty. Ti je Njohësi i të fshehtave!**

117. **Unë nuk u kam thënë atyre asgjë tjetër, veç asaj që Ti më urdhërove: "Ta adhuroni Allahun, Zotin tim dhe Zotin tuaj!" Unë isha dëshmues i tyre, sa isha ndër ta. Por pasi Ti më more mua, ishe Ti mbikëqyrësi i tyre. Ti je dëshmues i çdo gjëje!"**

118. **Nëse i dënon ata, në të vërtetë ata janë robërit e Tu. E nëse i fal ata, Ti je i Plotfuqishmi e i Urti.**

119. **Allahu thotë: "Kjo është dita kur të sinqertëve u bën dobi sinqeriteti i tyre. Atyre u takojnë kopshte, nëpër të cilët rrjedhin lumenj, ku do të qëndrojnë përgjithmonë. Allahu është i kënaqur me ta dhe ata janë të kënaqur me Të. Kjo është fitorja e madhe."**

120. **Vetëm Allahut i takon sundimi i qiejve dhe i tokës dhe gjithçka që ata përmbajnë. Ai është i Plotfuqishëm për çdo gjë.**

Shpjegimi i ajeteve

- "Allahu *(në Ditën e Gjykimit)* do të thotë: "O Isa, biri i Merjemes! Ti, vallë, u the njerëzve: "Më besoni mua dhe nënën time si dy zota veç Allahut!?" Ai do të thotë: "Larg çdo të mete je Ti *(o Zoti im)*!" - Ky është një qortim i rëndë për krishterët që thonë se Allahu është trini. Kështu, kur Allahu i Madhëruar ta pyesë Isain (a.s.) për atë qëndrim të të krishterëve, Isai do të distancohet prej tyre, duke thënë: "*Subhaneke*!" - i Pastër, i Lartësuar dhe larg çdo mangësie që trillojnë rreth Teje je Ti, o Zoti im!

- "Nuk më takon mua të them atë që s'është e vërtetë." – Kuptimi: Nuk më takon mua dhe as është prej cilësive të mia që të them gjëra të tilla. Asnjë lloj krijese, as engjëjt e afërt të Zotit, as profetët e askush tjetër nuk ka të drejtë dhe nuk meriton të adhurohet. Të gjithë, pa përjashtim, janë robër të nënshtruar të Allahut, janë krijesa të varfra e të pafuqishme.

- "Po ta kisha thënë atë, Ti do ta dije! Ti e di çfarë ka në shpirtin tim, ndërsa unë nuk e di atë që është tek Ty. Ti je Njohësi i të fshehtave!" – Kuptimi: Ti, o Zoti im, je më i dituri për ato që unë thashë. Ti di çdo të fshehtë.

E tillë ishte edukata dhe mënyra e të folurit të Mesihut (a.s.) me Zotin e tij. Kur u pyet, ai nuk tha thjesht: "Jo, unë nuk e kam thënë një gjë të tillë", por zgjodhi tjetër mënyrë, duke treguar se grada në të cilën e ngriti Zoti nuk e lejonte ndryshe. Allahu është i Pastër dhe i Lartësuar që Profeti i zgjedhur dhe i ndihmuar prej Tij të thoshte fjalë të tilla të pahijshme. Dituria e plotë, për të dukshmet dhe për të fshehtat, i takon të Gjithëditurit, Allahut të Madhëruar.

Pastaj Isai (a.s.) tregon se për çfarë i urdhëroi bijtë e Israilit:

- "Unë nuk u kam thënë atyre asgjë tjetër, veç asaj që Ti më urdhërove: "Ta adhuroni Allahun, Zotin tim dhe Zotin tuaj!"" - Kuptimi: Unë jam një rob i nënshtruar, që ndjek urdhrat e Tua. Unë kurrë nuk do të guxoja të dilja jashtë tyre, për shkak se unë i frikësohem madhështisë Tënde! Unë i urdhërova ata që të adhuronin një Zot të vetëm, duke ia përkushtuar fenë dhe adhurimin veçse Atij. Ky urdhër e përjashton adhurimin e gjithçkaje tjetër, veç Teje. As nëna ime e as unë nuk mund të jemi të adhuruar, se ne jemi thjesht robër dhe krijesa. Unë ua sqarova atyre se Ti je Zoti i tyre dhe Zoti im.

- "Unë isha dëshmues i tyre, sa isha ndër ta." - Kuptimi: Për sa kohë që isha mes tyre, unë dëshmoj për ata që e zbatuan porosinë time dhe për ata që nuk pranuan ta zbatojnë atë.

- "Por pasi Ti më more mua, ishe Ti mbikëqyrësi i tyre. Ti je dëshmues i çdo gjëje!" - Kuptimi: Pasi Ti më ngrite lart, ishe Ti mbikëqyrësi dhe vështruesi i asaj se çfarë fshihej në gjoksin e tyre. Ti je dëshmues për gjithçka. Dija, dëgjimi e shikimi Yt përfshijnë gjithçka. Dija Jote përfshin çdo njohje, dëgjimi Yt përfshin gjithçka që mund të dëgjohet e shikimi Yt përfshin gjithçka që mund të shikohet. Ti je Ai që do t'i shpërblesh të gjithë, sipas diturisë Tënde, për veprat që kanë bërë, të mira apo të këqija qofshin. Ti je më i mëshirshëm për ta, se ata për veten e vet. Nëse nuk do të ishin robër të pabindur dhe arrogantë, Ti nuk do t'i ndëshkoje.

- "Nëse i dënon ata, në të vërtetë ata janë robërit e Tu. E nëse i fal ata, Ti je i Plotfuqishmi e i Urti." - Kuptimi: Nëse Ti i fal ata, këtë e bën prej fuqisë Tënde absolute, pra, jo si ata që falin nga dobësia dhe pafuqia. Ti je i Urtë dhe i fal ata që i plotësojnë kushtet për të arritur faljen Tënde.

Më pas, Allahu i Lartësuar tregon se si do të jetë gjendja e robërve në Ditën e Gjykimit: si do të jetë gjendja e të fituarve dhe atyre të humburve; si do të jetë gjendja e të lumturve dhe e të trishtuarve.

- "Allahu thotë: "Kjo është dita kur të sinqertëve u bën dobi sinqeriteti i tyre." - Të sinqertët ose të vërtetët (*el sadikun*) janë ata, qëllimi, fjalët dhe veprat e të cilëve janë në përputhje me porositë e Zotit dhe për të kënaqur Atë. Ata janë udhëzuar në rrugën e drejtë dhe me qëndrueshmëri vazhdojnë në këtë rrugë. Ditën e Gjykimit, këta do të gjejnë frytet e këtij qëndrimi të mirë. Atë ditë, Allahu do t'i nderojë ata me grada të larta pranë Tij, në kopshtet e mirësisë, siç thotë më pas:

- "Atyre u takojnë kopshte, nëpër të cilët rrjedhin lumenj, ku do të qëndrojnë përgjithmonë. Allahu është i kënaqur me ta dhe ata janë të kënaqur me Të. Kjo është fitorja e madhe." - Ndërsa gënjeshtarët do të jenë në një gjendje krejt të kundërt me të sinqertët. Ata do të ballafaqohen me pasojat e trillimeve të tyre po atë ditë.

- "Vetëm Allahut i takon sundimi i qiejve dhe i tokës dhe gjithçka që ata përmbajnë. Ai është i Plotfuqishëm për çdo gjë." - Allahut i takon mbretërimi dhe sundimi i qiejve dhe tokës, sepse Ai është Krijuesi i tyre. Ai kujdeset për mbarëvajtjen e tyre, nëpërmjet ligjeve të Tij të krijimit dhe funksionimit të gjërave. Është Ai që vendos rregullat dhe ligjet që dëshiron për ne. Është Ai, gjithashtu, i vetmi të Cilit i takon të llogarisë dhe shpërblejë krijesat me drejtësi. Ai është i Plotpushtetshëm për gjithçka. Asgjë nuk del jashtë pushtetit dhe vullnetit të Allahut. Gjithçka i nënshtrohet dëshirës dhe ligjeve të Tij.

Këtu përfundon vëllimi i parë i tefsirit të Shejh Abdur-rahman ibn Nasir El sa'dij

Falënderimi dhe lavdia e plotë i takojnë vetëm Allahut të Madhëruar!

Tabela e lëndës

Fq

- Parathënia e përkthyesit ..... 3.
- Parathënia e autorit ..... 3.
- Suretu El fatiha ..... 7.
- Suretu El bekare ..... 11.
- Suretu Al Imran ..... 262.
- Suretu El nisâ 393
- Suretu El mâideh ..... 529.